

Remzije ISTREFI • Bekim SEJDIU • Ledi BIANKU

MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

PËRMBLEDHJE E RASTEVE KRYESORE
TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË
KOSOVËS, TË GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE
TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË
BASHKIMIT EVROPIAN



Prishtinë, 2023

MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

PËRMBLEDHJE E RASTEVE KRYESORE TË GJYKATËS
KUSHTETUESE TË KOSOVËS, TË GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË GJYKATËS SË
DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

Remzije ISTREFI
Bekim SEJDIU
Ledi BIANKU

Prishtinë, 2023

TITULLI: Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të Njeriut - Përmbledhje e rasteve kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian

BOTUES: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës

AUTOR: Remzije ISTREFI, Bekim SEJDIU dhe Ledi BIANKU

KOORDINIMI: Daniel BRAUN dhe Granit TËRNAVA

RECENSENTË: Prof. dr. Enver Hasani dhe Prof. dr. Xhezair Zaganjori

LEKTURA: Gazmend Vitija

DIZAJNI: Tedel

SHTYPI: ArtGraphics

SHTYPI: 250 ekzemplarë

Publikimi mund të shkarkohet falas në: <http://www.kas.de/Kosovo>

Vërejtje: Qëndrimet e prezantuara në këtë libër janë pikëpamje personale të autorëve dhe ato nuk i paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad-Adenauer. Ky botim nga Fondacioni Konrad Adenauer është vetëm për informacion. I njëjti nuk mund të përdoret për qëllime fushate gjatë një fushate zgjedhore.

Këshilli i Fakultetit Juridik me Vendim (Nr. prot. 07/76), i datës 09/11/2021 ka lejuar botimin e Librit “Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut përmbledhje e rasteve kryesore të gjykatës kushtetuese të Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian” te autoreve Remzije ISTREFI, Bekim SEJDIU, Ledi BIANKU, si dhe ka emëruar për recensentë: Prof. Dr. Enver Hasani dhe Prof. Dr. Xhezair Zaganjori.

Raporti recensentëve është aprovuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit Juridik (Nr.prot.10/22) i datës 17/03/2022.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	23
RECENSENTËT	25
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	39
LISTA E SHKURTESAVE	45
Barazia para Ligjit.....	51
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS	
KUSHTETUESE TË KOSOVËS	52
1.1. KO130/15. PARASHTRUES: PRESIDENTJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS... 52	
1.2. KO119/10. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	54
1.3. KO01/19. PARASHTRUES: QEMAJL KURTISHI, ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL NË PRIZREN.....	57
2. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	59
2.1. GORZELIK DHE TË TJERËT kundër POLONISË	59
2.2. STANKOV DHE ORGANIZATA E BASHKUAR MAQEDONASE ILINDEN kundër BULLGARISË.....	67
2.3. VALKOV DHE TË TJERËT kundër BULLGARISË	73
2.4. MOLLA SALI kundër GREQISË	81
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	86
3.1. SERVET KAMBERAJ kundër ISTITUTO PER L'EDILIZIA SOCIALE DELLA PROVINCIA AUTONOMA DI BOLZANO (IPES), ETJ.....	86
3.2. ANTON LAS kundër PSA ANTWERP NV	90
3.3. BALÁZS-ÁRPÁD IZSÁK DHE ATTILA DABIS kundër KOMISIONIT EVROPIAN	95

Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit99

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS

KUSHTETUESE TË KOSOVËS.....92

- 1.1. KO203/19. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT
I REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... 100

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË

DREJTAT E NJERIUT 104

- 2.1. BAKA kundër HUNGARISË..... 104

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË

BASHKIMIT EVROPIAN 111

- 3.1. A.K. kundër KRAJOWA RADA SĄDOWNICTWA
dhe C.P. dhe D.O. kundër SĄD NAJWYŻSZY 111

Gjuhët 119

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS

KUSHTETUESE TË KOSOVËS..... 120

- 1.1. KO65/19. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT
I REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... 120

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË

DREJTAT E NJERIUT 123

- 2.1. ÇËSHITJA “QË LIDHET ME DISA ASPEKTE TË LIGJEVE
MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE NË ARSIM NË BELGJIKË”
kundër BELGJIKËS 123
- 2.2. KNOX kundër ITALISË 128

3.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË

BASHKIMIT EVROPIAN 132

- 3.1. REPUBLIKA ITALIANE kundër KOMISIONIT EVROPIAN..... 132

Vlerat..... 137

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS

KUSHTETUESE TË KOSOVËS..... 138

- 1.1. KO219/19. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT I
REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... 138

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË

DREJTAT E NJERIUT 142

- 2.1. SAVICKAS DHE TË TJERËT kundër LITUANISË 142

3. PËRMBLEDHJE TË RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN	145
3.1. ASSOCIAÇÃO SINDICAL DOS JUÍZES PORTUGUESES kundër TRIBUNAL DE CONTAS.....	145

Dinjiteti i Njeriut151

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	152
1.1. KI39/09. PARASHTRUES: AVNI KUMNOVA.....	152
1.2. KI 108/18. PARASHTRUES: BLERTA MORINA	155

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	160
2.1. OLEKSANDR VOLKOV kundër UKRAINËS	160
2.2. CHRISTINE GOODWIN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	166

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN	171
3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË	171
3.2. FEDERATA MBRETËRORE BELGE E SHOQËRIVE TË FUTBOLLIT kundër JEAN-MARC BOSMAN	182
3.3. MBRETËRIA E HOLANDËS kundër PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	189

Barazia para Ligjit.....195

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	196
1.1. KO157/18. PARASHTRUES: GJYKATA SUPREME	196

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	200
2.1. “GASUS DOSIER- UND FÖRDERTECHNIK” GmbH kundër MBRETËRISË SË HOLANDËS	200
2.2. S.A. “DANGEVILLE” kundër FRANCËS.....	206
2.3. FAMULLIA KATOLIKE GREKE LUPENI DHE TË TJERËT kundër RUMANISË.....	211

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË	216
3.1. SOCIAAL FONDS VOOR DE DIAMANTARBEIDERS kundër S.A. CH. BRACHFELD & SONS dhe CHOUGOL DIAMOND CO.....	216

3.2. CARLOS BOWLES kundër BANKËS QENDRORE
EVROPIANE (BQE)220

E Drejta për Jetën.....225

**1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË
KOSOVËS226**

1.1. KI41/12. PARASHTRUES: GËZIM DHE MAKFIRE KASTRATI -
PRINDËRIT E SË NDJERËS D.K.....226

**2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT228**

2.1. OPUZ kundër TURQISË228

**3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE
TË DREJTËSISË237**

3.1. SEKRETARI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME kundër N.A.
ME PALË NDËRHYRËSE QENDRËN AIRE237

E Drejta e Integritetit Personal.....243

**1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË
KOSOVËS244**

1.1. KI27/12, KI31/12, KI32/12, KI33/12. PARASHTRUES: MYKYREME
HOXHA, MERITA HOXHA, MËRGIM HOXHA DHE BLERIM HOXHA...244

**2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT247**

2.1. N.Ç. kundër TURQISË247
2.2. SÖDERMAN kundër SUEDISË254
2.3. Y. kundër SLLOVENISË258

**3.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË
BASHKIMIT EVROPIAN262**

3.1. BOSTON SCIENTIFIC MEDIZINTECHNIK GMBH kundër
AOK SACHSEN-ANHALT – DIE GESUNDHEITSKASSE dhe
BETRIEBSKRANKENKASSE RWE262

Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës 267

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS268

1.1. KI127/18. PARASHTRUES: TUSH KOLËGJERAJ268

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT271

2.1. EL-MASRI kundër “ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË
MAQEDONISË”271

2.2. SOERING kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR278

2.3. SELMOUNI kundër FRANCËS.....282

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN287

3.1. PÁL ARANYOSI DHE ROBERT CĂLDĂRARU287

3.2. DIETER KROMBACH kundër ANDRÉ BAMBERSKI296

Ndalimi i Sklavërisë dhe i Punës së Detyruar301

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS302

1.1. KI 77/19. PARASHTRUES MUSA ISLAMI.....302

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT304

2.1. C.N. dhe V. kundër FRANCËS304

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN311

3.1. BASHKIA E NIVELES kundër RUDY MATZAK.....311

E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë315

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS316

1.1. KI 10/18. PARASHTRUES: FAHRI DEQANI.....316

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT321

2.1. IRLANDA kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....321

2.2. McKAY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....328

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË

BASHKIMIT EVROPIAN.....333

- 3.1. FMS, FNZ, SA, SA JUNIOR kundër ORSZÁGOS IDEGENRENDÉSZETI
FŐIGAZGATÓSÁG DÉL-ALFÖLDI REGIONÁLIS IGAZGATÓSÁG333

Të Drejtat e të Akuzuarit.....343

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË

KOSOVËS344

- 1.1. KI29/15. PARASHTRUES: BARDHYL KAMERI344
1.2. KI106/10. PARASHTRUES: BINAK THAQI.....346

2.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË

DREJTAT E NJERIUT349

- 2.1. ALEKSANDR ALEKSANDROV kundër RUSISË349

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË

BASHKIMIT EVROPIAN.....354

- 3.1. CIPRIAN VASILE RADU.....354

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm.....357

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË

KOSOVËS358

- 1.1. KI22/16. PARASHTRUES: NASER HUSAJ358
1.2. KI181/19, KI182/19, KI183/19 KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19,
KI165/19, KI166/19,KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19,KI171/19,
KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19. PARASHTRUES: FLLANZA NAKA,
FATMIRE LIMA DHE LEMAN MASAR ZHUBI361
1.3. KI193/19. PARASHTRUES: SALIH MEKAJ365
1.4. KI187/18 DHE KI11/19. PARASHTRUES: MUHAMET IDRIZI368
1.5. KI47/17. PARASHTRUESE: SELVETE ALIJI.....372
1.6. KI56/21. PARASHTRUES: EMRUSH BERISHA378
1.7. KI235/19. PARASHTRUES: KOMPANIA E SIGURIMEVE
“ALLIANZ SUISSE VERSICHERUNGSGESELLSCHAFT AG”381
1.8. KI39/20. PARASHTRUESE: CIHAN OZKAN.....384
1.9. KI31/18. PARASHTRUESE: KOMUNA E PEJËS389

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË

DREJTAT E NJERIUT	398
2.1. BURDOV kundër RUSISË (Nr. 2)	398
2.2. MICALLEF kundër MALTËS.....	403
2.3. RAMOS NUNES DE CARVALHO E SÁ kundër PORTUGALISË	409
2.4. RUIZ TORIJA kundër SPANJËS	417
2.5. REGNER kundër REPUBLIKËS ÇEKE	421
2.6. “STRAN GREEK REFINERIES” dhe STRATIS ANDREADIS kundër GREQIS	427
2.7. DRIZA kundër SHQIPËRISË	434
2.8. SCHATSCHASCHWILI kundër GJERMANISË	439
2.9. SEJDOVIC kundër ITALISË	445
2.10. MOREIRA FERREIRA kundër PORTUGALISË (2)	450
2.11. XHERAJ kundër SHQIPËRISË.....	454
2.12. M.S.S. kundër BELGJIKËS DHE GREQISË	462
2.13. MORICE kundër FRANCËS.....	469
2.14. KYPRIANOU kundër QIPROS	476

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË

BASHKIMIT EVROPIAN.....	480
3.1. “POHOTOVOSTĚ S. R. O.” kundër MIROSLAV VAŠUTA.....	480
3.2. CHRONOPOST SA dhe LA POSTE kundër UNION FRANÇAISE DE L'EXPRESS (UFEX) E.A.	485
3.3. Z.Z. kundër SEKRETARIT TË SHTETIT PËR PUNËT E BRENDSHME.....	493
3.4. REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË kundër AGJENCISË EVROPIANE TË PRODUKTEVE KIMIKE (ECHA)	498
3.5. KOMISIONI EVROPIAN kundër IRLANDËS.....	500
3.6. BANCO DE SANTANDER SA.....	506
3.7. “SILVER PLASTICS GMBH & CO. KG” & “JOHANNES REIFENHÄUSER HOLDING GMBH & CO. KG” kundër KOMISIONIT EVROPIAN.....	510
3.8. JOÃO FILIPE FERREIRA DA SILVA E BRITO DHE TË TJERË kundër ESTADO PORTUGUÊS.....	518
3.9. VASILKA IVANOVA GOGOVA kundër ILIA DIMITROV ILIEV	524
3.10. BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND kundër AZIZ HASAN	528
3.11. A. K. kundër. KRAJOWA RADA SĄDOWNICTWA DHE C.P. DHE D.O. kundër SĄD NAJWYŻSZY.....	534

E Drejta për Mjete Juridike543

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS544

- 1.1. KI 86/18. PARASHTRUES: SLAVICA ĐORDEVIĆ.....544
- 1.2. KI193/18. PARASHTRUES: AGRON VULA548

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT553

- 2.1. MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERËT kundër SHQIPËRISË.....553
- 2.2. RAMADHI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË.....564
- 2.3. HIRST kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR (Nr. 2)573

3.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN580

- 3.1. DEUTSCHE UMWELTHILFE eV kundër FREISTAAT BAYERN580
- 3.2. BANK MELLI IRAN kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN ..585
- 3.3. “SYRIAN LEBANESE COMMERCIAL BANK SAL” kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN592

Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale..... 599

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS600

- 1.1. KI86/18. PARASHTRUES: NASER AVDYLI600

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT603

- 2.2. G.I.E.M. S.R.L. DHE TË TJERË kundër ITALISË611

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN619

- 3.1. PJSC ROSNEFT OIL COMPANY kundër HER MAJESTY’S TREASURY E.A.619
- 3.2. PROCEDURA PENALE kundër M.A.S. DHE M.B.....628

E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër 637

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS638

- 1.1. KI58/17. PARASHTRUES: UKË MUÇAJ.....638

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	641
2.1. BOCHAN kundër UKRAINËS (Nr. 2)	641
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	647
3.1. MINISTERO DELL'ECONOMIA E DELLE FINANZE ET AGENZIA DELLE ENTRATE kundër PAOLO SPERANZA.....	647
3.2. ÅKLAGAREN K. HANS ÅKERBERG FRANSSON.....	651
 Liria e Lëvizjes	 657
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	658
1.1. KI06/10. PARASHTRUES: VALON BISLIMI.....	658
2.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	662
2.1. KOTIY kundër UKRAINËS	662
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	667
3.1. HRISTO GAYDAROV kundër DIRECTOR NA GLAVNA DIREKTSIA “OHRANITELNA POLITSIA” PRI MINISTERSTVO NA VATRESHNITE RABOTI.....	667
 E Drejta e Privatësisë	 671
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	672
1.1. KI56/18. PARASHTRUES: AHMET FRANGU	672
1.2. KI01/21. PARASHTRUESE: AJSHE ALIU	677
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	681
2.1. AKTAŞ DHE ASLANISKENDER kundër TURQISË	681
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	685
3.1. U. kundër STADT KARLSRUHE.....	685
3.2. “FACEBOOK IRELAND” DHE TË TJERËT	689

E Drejta e Martesës dhe Familjes.....695

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS696

1.1. KI63/09. PARASHTRUES: BAJRAM SANTURI696

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT699

2.1. BABIARZ kundër POLONISË699

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN702

3.1. SOHA SAHYOUNI kundër RAJA MAMISCH.....702

Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë707

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS708

1.1. KI36/11. PARASHTRUES: ARJETA HALIMI708

2.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT712

2.1. EWEIDA DHE TË TJERËT kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR ..712

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN719

3.1. SAMIRA ACHBITA ET CENTRUM VOOR GELIJKHEID VAN KANSEN EN VOOR RACISMEBESTRIJDING kundër G4S SECURE SOLUTIONS NV... 719

Konfesionet Fetare.....725

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS726

1.1. KI133/17. PARASHTRUES: ALI GASHI.....726

2.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT729

2.1. FERNÁNDEZ MARTÍNEZ kundër SPANJËS729

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN736

VERA EGENBERGER kundër

3.1. EVANGELISCHES WERK FÜR DIAKONIE UND ENTWICKLUNG EV.....736

Liria e Shprehjes745**1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS746**

1.1. KI 130/16. PARASHTRUES: HAMDI IBRAHIMI746

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT749

2.1. KUDESHKINA kundër RUSISË.....749

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN753

3.1. NH kundër ASSOCIAZIONE AVVOCATURA PER I DIRITTI LGBTI – RETE LENFORD753

E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike759**1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS760**

1.1. KI205/13. PARASHTRUES: FETI ISLAMI760

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT762

2.1. MAGYAR HELSINKI BIZOTTSAG kundër HUNGARISË762

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN768

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër PATRICK BREYER768

Liria e Medieve775**1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS776**

1.1. KO63/12. PARASHTRUES: ALMA LAMA DHE 10 DEPUTETË TË TJERË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.776

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT778

2.1. BÉDAT kundër ZVICRËS778

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN785

3.1. DMITRII KONSTANTINOVICH KISELEV kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN785

Liria e Tubimit791

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS792

1.1. KO54/20. PARASHTRUES: PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS792

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT798

2.1. NAVALNYYE kundër RUSISË798

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN806

3.1. EUGEN SCHMIDBERGER, INTERNATIONALE TRANSPORTE UND PLANZÜGE kundër REPUBLIK ÖSTERREICH.....806

Liria e Asociimit.....813

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS814

1.1. KO97/12. PARASHTRUES AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS814

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT818

2.1. MAGYAR KERESZTÉNY MENNONITA EGYHÁZ DHE TË TJERËT kundër HUNGARISË818

2.2. REFAH PARTISI (PARTIA E MIRËQENIES) DHE TË TJERËT kundër TURQISË824

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN829

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË829

3.2. FRONT NATIONAL kundër PARLAMENTIT EVROPIAN834

Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes839

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS840

1.1. KI207/19. PARASHTRUES: NISMA SOCIALDEMOKRATE, ALEANCA KOSOVA E RE DHE PARTIA E DREJTËSISË840

1.2. KI 152/17. PARASHTRUES SHAQIR TOTAJ.....847

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	851
2.1. SITAROPOULOS DHE GIAKOUPoulos kundër GREQISË.....	851
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	857
3.1. M. G. EMAN, O. B. SEVINGER kundër COLLEGE VAN BURGEMEESTER EN WETHOUDERS VAN DEN HAAG	857
3.2. THIERRY DELVIGNE kundër COMMUNE DE LESPARRE-MÉDOC & PRÉFET DE LA GIRONDE.....	863
Mbrojtja e Pronës	867
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	868
1.1. KI 144/14 DHE KI 156/14. PARASHTRUES: VILIJAMIN HAJDUKOVIC DHE STANKA TUS.....	868
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	873
2.1. KASMI kundër SHQIPËRISË.....	873
2.3. VUČKOVIĆ DHE TË TJERËT kundër SERBISË.....	878
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	885
3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË	885
E Drejta për Arsimin	891
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	892
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	892
2.1. MÜRSEL EREN kundër TURQISË	892
2.2. ÇAM kundër TURQISË	895
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	899
3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË	899

E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit 907

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	908
1.1. KO131/12. PARASHTRUES SHAIPI MUJA DHE 11 DEPUTET TË TJERË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	908
1.2. KI 55/11 PARASHTRUES: FATMIR PIRECI	914
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	917
2.1. FÁBIÁN kundër HUNGARISË.....	917
2.1. GJYLI kundër SHQIPËRISË	922
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN	927
3.1. DENNIS MAC QUEN, DEREK POUTON, CARLA GODTS, YOUSSEF ANTOUN DHE “GRANDVISION BELGIUM SA”	927
3.2. RY kundër KOMISIONIT EVROPIAN.....	930

Të Drejtat e Fëmijës935

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	936
1.1. KI113/17. PARASHTRUES: X.....	936
1.2. KI36/12 PARASHTRUES: BAJRAM LUTA	940
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	942
2.1. PARADISO DHE CAMPANELLI kundër ITALISË	942
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN	949
3.1. J. McB. kundër L. E.	949

Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale955

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	956
1.1. KI124/10 PARASHTRUESE: SHKURTE KRASNIQI.....	956
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	959

2.1. FEDULOV kundër RUSISË	959
2.1. DAUTI kundër SHQIPËRISË.....	964
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	968
3.1. GEORG NEIDEL kundër STADT FRANKFURT AM MAIN	968
Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor	973
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	974
1.1. KI56/09 PARASHTRUESE: FADIL HOXHA DHE TË TJERËT	974
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	978
2.1. TËTAR kundër RUMANISË.....	978
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	981
3.1. L. B., STICHTING VARKENS IN NOOD, STICHTING DIERENRECHT, STICHTING LEEFBAAR BUITENGEBIED kundër COLLEGE VAN BURGEMEESTER EN WETHOUDERS VAN DE GEMEENTE ECHT-SUSTEREN	981
Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	989
1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS	990
1.1. KI94/13. PARASHTRUES: AVNI DOLI, MUSTAFA DOLI, ZIJA DOLI DHE XHEMILE OSMANAJ.....	990
2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	995
2.1. KUDŁA kundër POLONISË.....	995
3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	999
3.1. ASSOCIAZIONE NAZIONALE GRANOSALUS – LIBERI CEREALICOLTORI & CONSUMATORI kundër KOMISIONIT EVROPIAN	999

3.2. YASSIN ABDULLAH KADI DHE AL BARAKAAT INTERNATIONAL FOUNDATION kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EVROPIANE 1006

Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore 1015

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS 1016

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT 1016

2.1. MERABISHVILI kundër GJEORGJISË..... 1016

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN 1023

3.1. STEFANO MELLONI kundër MINISTERIO FISCAL..... 1023

Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme 1031

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS 1032

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT 1032

2.1. L AWLESS kundër IRLANDËS (3) 1032

2.2. BROGAN DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.. 1036

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN 1042

3.1. N. S. kundër SEKRETARIT TË SHTETIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME dhe M. E. DHE TË TJERË kundër KOMISIONERIT PËR APLIKIMET PËR REFUGJATË dhe MINISTRIT TË DREJTËSISË, BARAZISË DHE REFORMËS NË DREJTËSI 1042

PARATHËNIE

Të dashur lexues,

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe mekanizmave të mbrojtjes së këtyre të drejtave mbeten një fushë e rëndësishme e angazhimit të Fondacionit Konrad Adenauer gjithandej nëpër botë. Përmes shumë aktiviteteve dhe publikimeve ne synojmë avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut.

Ky libër të cilin e keni në dorë, i shkruar nga profesorët e nderuar Prof. Dr. Remzije Istrefi, Prof. Dr. Bekim Sejdiu dhe Prof. Dr. Ledi Bianku, të cilët kanë edhe përvojë në fushën e gjyqësisë dhe mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut, trajton temën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë përmbledhjen e rasteve kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij publikimi është të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të komunitetit juridik, veçanërisht të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, për mbrojtjen gjyqësore të të Drejtave të Njeriut në Kosovë. Më konkretisht, ky publikim synon të ofrojë udhëzime konciz për secilën të drejtë individuale të njeriut që mbrohet me Kushtetutën e Kosovës dhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ dhe të GJDBE-së, lidhur me këto të drejta. Përpilimi i përmbledhjeve të rasteve të GJEDNJ-së, të GJDBE-së dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës do t'i shërbejë komunitetit më të gjerë juridik në Kosovë: gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Odën e Avokatëve, insitucionet trajnuese, dhe agjenci dhe shoqata të tjera profesionale, aktive në fushën e gjyqësorit. Nga kjo përmbledhje do të përfitojnë veçanërisht profesorët dhe studentët e Fakulteteve Juridike në Kosovë,

të cilët mund ta përdorin atë si tekst shkollor për lëndët e së drejtës kushtetuese, e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, organizatave ndërkombëtare dhe lëndëve të tjera të së drejtës publike të të gjitha programeve të studimit.

Në veçanti, ky libër do të kontribuojë në rritjen e punës praktike në klinikat juridike universitare. Kështu, komuniteti juridik në Kosovë ka në dispozicion një burim të përshtatshëm për përdoruesit, në formë të përkufizimit konceptual dhe përmbledhjes së rasteve.

Si Fondacion Konrad Adenauer, ndihemi të kënaqur nga mundësia të kontribuojmë përmes autorëve të respektuar për avancimin e mëtejshëm të të Drejtave të Njeriut në Kosovë.

Daniel Braun,
Drejtor i Zyrës së Konrad-Adenauer-Stiftung për Kosovë

RECENSENTË

Prof. Dr. Enver HASANI

Një libër i duhur, në një kohë të duhur

Me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, nisi puna për miratimin e dokumentit themelor juridik të vendit, kushtetutës, në mënyrë që të implementohej zotimi i marrë nga autorët e Deklaratës së Pavarësisë, që thoshte se Kosova do të jetë një shtet i modeluar sipas parimeve dhe vlerave të konstitucionalizmit liberal perëndimor. Kushtetuta u miratua në mesin e prillit të vitit 2008, kurse hyri në fuqi dy muaj më pas, saktësisht më 15 qershor të po atij viti. Që atëherë, ajo ka dirigjuar fatin e Kosovës, duke e shtyrë atë në drejtim të formësimit të saj si shtet, përgjatë vijave të kulturave juridiko-kushtetuese, që origjinën e formimit e kanë në antikitetin greko-romak. Shija liberale e konstitucionalizmit të proveniencës perëndimore, qartë bie në sy që në leximin e preambulës së dokumentit themelor juridik të Kosovës, njëjtë si në kushtetutat e vendeve të tjera me sistem të njëjtë kushtetues sipas të cilave modelohet. Në fakt, në çdo germë të saj, si dhe në shpirtin që reflektohet përgjatë pjesës së saj operative, Kushtetuta nuk lë asnjë dyshim sa i përket orientimit kulturor të vendit, duke shërbyer si një kornizë për lindjen dhe formësimin e një identiteti tjetër kushtetues nga ai historik që ka qenë prezent në ditën e hyrjes së saj në fuqi. Ai identitet mëton të shkatërrojë dhe zëvendësojë identitetet nacionaliste nga e kaluara, të cilat nuk i reflekton në asnjë dispozitë apo fjali të saj. Në asnjë vend nuk reflektohet kultura materiale e asnjërit prej etnive që jetojnë në Kosovë, që kanë shtetësinë apo janë banorë të saj. Në vend të këtij lojaliteti etnik, që dikur ka qenë dominant, Kushtetuta sforcon një patriotizëm kushtetues në kuptimin habermasian të fjalës, që ankorohet në vlera dhe parime të civilizimit bashkëkohor perëndimor të proveniencës liberale, ku toleranca dhe bashkëjetesa me popujt e kulturat e ndryshme janë shtyllë themelore e bashkësisë politike.

Gjyqësori i zakonshëm dhe gjyqësia e posaçme, tanimë gjerësisht e njohur si gjyqësia kushtetuese, kanë një rol të veçantë në promovimin dhe përshpejtimin e ngjizjes së këtij nacionalizmi të ri kushtetues, të këtij identiteti që nuk ankoron lojalitetin e qytetarëve dhe të etnive në prejardhjen e tyre biologjike, regjionale, kulturore dhe tjetër, por në normat dhe parimet kushtetuese që promovojnë barazinë dhe kultivojnë tolerancën në diversitet të popujve dhe kulturave të ndryshme e kundërthënëse me njëra tjetrën. Ndërtimi i këtij mekanizmi të drejtësisë, me gjyqësorin e zakonshëm dhe ndarjen e tij nga gjyqësia kushtetuese, ka rrjedhur si pasojë e drejtpërdrejtë e faktit se interpretimi me qëllim të implementimit të Kushtetutës së Kosovës nuk mund të imagjinohet pa dy shtyllat si më sipër të drejtësisë. Kapitujt dy dhe tre të Kushtetutës së Kosovës, si dhe mishërimi i demokracisë konsociacionale në secilën dispozitë të saj mbi organizimin dhe përbërjen e organeve qendrore dhe lokale, e bëjnë të domosdoshëm ndërtimin e një mekanizmi kushtetues të pavarur dhe paanshëm, që t'i japë udhë dispozitave kushtetuese nga këta dy kapituj si dhe atyre që sanksionojnë dhe promovojnë demokracinë konsociacionale. Në krye të dizajnit kushtetues qëndron, si një “besëlidhje e re kushtetuese” e kosovarëve, që kanë folur përmes gojës së kushtetutbërësit të tyre më 15 prill 2008, zotimi për të interpretuar çdo gjë që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat njerëzore sipas standardeve dhe interpretimeve të Gjykatës së Strasburgut. Ekziston një listë e gjerë, krahas këtij zotimi nga neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, që shpërfaqet në nenin e saj 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], që shpalos një sërë instrumentesh dhe marrëveshjesh ndërkombëtare që zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në rendin juridik kosovar. Krejt kjo përpjekje për ndërtimin e këtij sistemi kushtetues, me mekanizmat e tij përcjellës, do të ishte e kotë sikur mos të shoqërohej me një përpjekje tjetër fisnike, tërësisht intelektuale, në fushën e profesionit të drejtësisë, që mëton të edukojë dhe të përditësojë studentin, studiuesin, juristin, avokatin, politikanin, shkurt të gjithë ata që bien në pozitë për të interpretuar Kushtetutën e Kosovës. Kjo përpjekje vjen e materializuar në mënyrë sublimë në librin *Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut: Përmbledhje e rasteve kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian*”, të autorëve Remzije Istrefi, Bekim Sejdiu, dhe Ledi Bianku.

Libri ngërthen një analizë gjithëpërfshirëse të praktikës gjyqësore të tri gjykatave të specifikuar në titull, gjithnjë nga këndvështrimi i lirive dhe të drejtave të njeriut. Trajtimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, merr si pikë referimi korpusin e të drejtave të njeriut që garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me synimin që lexuesit t'i jepet një pasqyrë e qartë e kompatibiliteteve në mes të përcaktimeve kushtetuese dhe detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës, për aq sa ato kanë të bëjnë me nenin 22 të Kushtetutës. Jurisprudenca e dy gjykatave të tjera evropiane, ndaj së cilës Kosova nuk ka detyrim të drejtpërdrejtë dhe kontraktual ndërkombëtar, është dhënë në dritën e detyrimit primar të vendit, duke pasur parasysh faktin që kjo jurisprudencë, në fund të fundit, përbën një pjesë të jurisprudencës që prodhohet përgjatë interpretimit të një rendi juridik regional që ka të bëjë me Evropën, pjesë e së cilës është Kosova. Në këtë kuptim, ky libër është një përpyetje e rrallë në vend, në mos e vetme, që hedh dritë mbi praktikën e tri gjykatave të sipërcekura. Ndonëse autorët nuk mëtojnë të tërheqin paralele në mes të praktikave të tri gjykatave, elementet krahasuese përvijohen vetvetiu përgjatë tërë librit. Këtë do ta ndiejë lexuesi në çdo moment. Libri për qëllim primar ka ofrimin e një analize gjithëpërfshirëse dhe sistematike në sferën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës, bazuar në krahasimin e kësaj mbrojtjeje me standardet e interpretimit të akteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Praktika e pasur e tri gjykatave, e përfshirë në këtë libër, dëshmon katërçipërisht forcimin e vazhdueshëm të karakterit gjyqësor të të drejtave të njeriut, të shpërfaqura nëpër norma juridike të pavarura, që mbrohen gjithnjë e më shumë përmes rrugëve efektive gjyqësore. Përveç të drejtave individuale të garantuara nga kapitulli i dytë i Kushtetutës, libri përfshin edhe disa vendime të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me dispozitat themelore nga Kapitulli I, që ngërthejnë disa nga parimet kushtetuese bazë, siç janë ndarja e pushteteve, vlerat kushtetuese, barazia para ligjit, barazia e gjuhëve etj. Libri ndjek një kronologji, sipas neneve të kapitujve një dhe dy të Kushtetutës, duke pasur për fokus kryesor këtë të fundit. Në thelb, kapitulli i dytë i jep frymë dhe jetë kapitullit të parë që përshkruan dhe sanksionon rendin juridik-kushtetues të vendit. Pikërisht për këtë arsye, ky libër shërben si një udhërrëfyes i çmuar profesional për sistemin e drejtësisë në Kosovë, institucionet ligj-zbatuese dhe fakultetet juridike.

Për të arritur objektivat e lartcekura të librit, autorët kanë përzgjedhur me kujdes listën e rasteve kryesore të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Një vlerë e çmuar e librit, padyshim, është fakti se ai sjell para audiencës juridike në Kosovë jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Autorët me një punë të zellshme dhe analizë shteruese kanë paraqitur rastet kryesore të kësaj Gjykate, përkitazi me të drejtat individuale që i mishëron Karta Evropiane e Lirive Themelore dhe që gjejnë paralelen e tyre konkordante në Kushtetutën e Kosovës. Duhet potencuar se audienca juridike në Kosovë nuk është e familjarizuar sa duhet me praktikën gjyqësore të Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropian, të paktën jo në masën sa me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Autorët e kanë ndërtuar analizën në këtë libër duke paraqitur së pari përmbajtjen origjinale të nenit përkatës të Kushtetutës, që pasohet nga rastet kryesore lidhur me nenin në fjalë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Strasburgut dhe Gjykatës së Luksemburgut.

Lista e rasteve të trajtuara përfshin kryesisht aktgjykime dhe një numër aktvendimesh të Gjykatës Kushtetuese (aktvendime për papranueshmëri të kërkesave kushtetuese). Rastet e përzgjedhura nga autorët janë rastet kryesore, që në masë të madhe kanë qenë përcaktues për praktikën e tri gjykatave në fjalë, kundruall të drejtave specifike. Për t'i bërë më të kuptueshme rastet e përzgjedhura, autorët kanë paraqitur në formë të përmbledhur këto aspekte: çështjen kryesore juridike të ngritur në rastin para gjykatës përkatëse, përmbledhjen e fakteve të rastit, pretendimet e palës parashtruese të kërkesës, arsyetimin (analizës) e gjykatës dhe, në fund, vendimin gjyqësor. Në paraqitjen e rasteve, autorët kanë vënë theksin sidomos në qasjet dhe qëndrimet e gjykatave në fjalë përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtjesore *vis-a-vis* të drejtave dhe lirive individuale. Ndërtimi i një analizë konsistente mbi praktikën e tri gjykatave të ndryshme është një sfidë në vetvete. Kjo, duke qenë se Gjykata Kushtetuese është gjykatë kombëtare, për dallim nga gjykatat e Strasburgut dhe Luksemburgut, që janë gjykata mbikombëtare, gjegjësisht ndërkombëtare. Sidoqoftë, thjerrëzat profesionale të këtyre tri gjykatave, përkitazi me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të njeriut, janë të njëjta dhe të ndërlidhura. Kjo vlen sidomos për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, e cila në praktikën e saj mbështetet fuqimisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Libri përmban praktikën gjyqësore të tri gjykatave, me afro tridhjetë të drejta individuale të trajtuara, të cilat i garanton Kushtetuta e Kosovës (si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Karta Evropiane e Lirive Themelore). Kjo ndërmarrje akademike, padyshim, është materializuar falë një pune të madhe të autorëve. Nuk është vetëm vëllimi i librit prej rreth 740 faqesh që provon këtë, por edhe serioziteti i trajtimeve doktrinare të rasteve dhe, mbi të gjitha, cilësia e produktit që ka sot në duar lexuesi shqip.

Libri përmban një strukturë të balancuar të rasteve, duke paraqitur një numër të përafërt vendimesh gjyqësore të tri gjykatave, përkitazi me secilën nga të drejtat individuale, duke filluar nga e drejta në jetë dhe ndalimi i torturës, deri tek të drejtat mjedisore. Për secilën të drejtë individuale, autorët janë kujdesur që të trajtojnë një numër të përafërt rastesh nga të tri gjykatat (1-4 raste për secilën të drejtë). Një qasje e tillë, domosdo, ka qenë e pamundur të ndiqet në mënyrë konsistente, sepse jurisprudenca e gjykatave në fjalë ndryshon, varësisht nga natyra e të drejtës së mbrojtur. Kështu, siç mund të vërehet edhe në libër, praktika gjyqësore është shumë më e pasur për disa të drejta, siç është e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, apo të drejtat pronësore, sesa kur bëhet fjalë për disa të drejta e liri të tjera, siç janë, ta zëmë, liria e arsimit apo ndalimi i skllavërisë. Për më tepër, për disa nga të drejtat e garantuara në Kushtetutën e Kosovës nuk ka ende praktikë gjyqësore (siç është, ta zëmë, liria e artit dhe shkencës).

Për fund, vëllimi dhe struktura e librit dhe, sidomos, kredencialet intelektuale dhe përvoja praktike profesionale e autorëve, e bëjnë këtë libër një burim të rëndësishëm për profesionistët juridikë në Republikën e Kosovës dhe më gjerë. Kjo ka qenë arsyeja që e thamë në titull, se bëhet fjalë për një libër të duhur, në kohën e duhur. Kësaj do t'i shtonim edhe fjalinë “dhe për njerëz të duhur”, marrë parasysh faktin se, në gjyqësorin e rregullt, shumë pak po i kushtohet rëndësi jurisprudencës së Strasburgut, me rastin e vendosjes së rasteve aty.

Prof. Dr. Enver Hasani

Ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë
2022

Prof. dr. Xhezair ZAGANJORI

Libri me titull “Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të Njeriut”, botuar si përmbledhje e jurisprudencës kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, është padyshim shumë interesant dhe mjaft i dobishëm. Si i tillë, ai do të lexohet e shfrytëzohet gjerësisht nga studentët dhe pedagogët e drejtësisë, si dhe nga çdo jurist i praktikës në detyrën e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, punonjësit të administratës shtetërore, e të tjerë, pasi përmes tij merret informacion i rëndësishëm e me vlerë jo vetëm për punën dhe angazhimin e përditshëm, por edhe për nxitjen e mëtejshme të kërkimit shkencor e hulumtues në fushën e të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, mendoj se ky libër mund dhe duhet të shfrytëzohet shumë mirë edhe nga njerëzit e politikës, si dhe pse jo, edhe nga njerëzit e thjeshtë. Sepse shumica e popullsisë natyrisht që di diçka për kushtetutën, si një dokument themelor i shtetit demokratik që ndër të tjera evidenton edhe të drejtat individuale. Megjithatë, ky informacion është shpesh përgjithësisht i mangët apo sipërfaqësor. Libri në fjalë krijon mundësinë që kjo njohje të jetë më e plotë dhe më e thellë, pasi në mënyrë të përmbledhur e një lexuesin me vendimmarrjen e gjykatave më të rëndësishme kombëtare e evropiane, të angazhuara specifikisht në këtë drejtim, duke i dhënë kështu jetë dhe kuptim më të qartë e më të plotë aspekteve të shumta e komplekse të të drejtave themelore. Në këtë mënyrë, çdo njeri i kupton dhe ndërgjegjësohet më shumë për realizimin e këtyre të drejtave, duke fituar njëkohësisht edhe një mjet praktik për mbrojtjen e tyre, kundër ndërhyrjeve apo cenimit arbitrar nga organet e të tre pushteteve: legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Sepse në demokraci, pushteti shtetëror është në funksion të garantimit të një jete më të mirë, më të begatë e më të sigurt për individin, ndaj ushtrimi i tij, pra i pushtetit shtetëror, duhet të bëhet gjithnjë brenda kufijve kushtetues e ligjorë. Por nga ana tjetër, edhe individi kupton më mirë gjithashtu se krahas të drejtave individuale, ka njëkohësisht edhe mjaft detyrime ndaj shtetit e shoqërisë, të cilat duhet t’i realizojë me korrektesën, angazhimin dhe përkushtimin maksimal.

Për sa më sipër, sigurisht që është meritë e padiskutueshme e autorëve të këtij libri, gjyqtarëve dhe lektorëve me përvojë të Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi dhe z. Bekim Sejdiu, si dhe z. Ledi Bianku, ish-gjyqtar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, njëkohësisht pedagog dhe autor të mjaft punimeve me vlerë në fushën e të drejtave të njeriut. Që të tre autorët së bashku, me mjaft prakticitet e profesionalizëm, kanë ditur fillimisht të përzgjedhin me kujdes vendimet gjyqësore të tre gjykatave të përmendura më sipër (rreth 180 vendime), dhe më pas, materialin tepër voluminoz, ta formatojnë e përpunojnë shkencërisht, duke e paraqitur në mënyrë të shkurtuar, të thjeshtë e shumë të qartë në këtë botim prej rreth 740 faqesh. Një angazhim akademik ky shembullor, për t’u pasur zili. Në çdo rast, pikë reference kryesore është që në fillim formulimi i së drejtës themelore konkrete që përmban Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Sigurisht që formulime e garanci thuajse tërësisht të ngjashme për këtë të drejtë ka respektivisht si në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe në Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore. Më pas, në bazë e në funksion të sqarimit sa më mirë të kësaj të drejte, jepet me radhë jurisprudencë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian. Kjo bëhet natyrshëm me argumentin e thjeshtë se të tre gjykatat e mësipërme paraqiten praktikisht si tre katalizatorët kryesorë të të drejtave themelore thuajse në çdo sistem shtetëror të së drejtës në Kontinentin Evropian, pavarësisht faktit nëse ky sistem i përket grupimit monist apo dualist të së drejtës.

Më pas, për çdo të drejtë kushtetuese me natyrë themelore, të përgjithshme, civile, politike apo edhe me natyrë sociale, ekonomike e kulturore, jepen thuajse në mënyrë të barabartë për ilustrim e sqarim, një deri në katër raste gjykimi për secilën prej gjykatave të mësipërme. Përrjashtim bën vetëm “E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm”, e cila sigurisht që për shkak të elementëve të shumtë që përfshin, është elaboruar me një numër më të madh vendimesh, respektivisht nëntë vendime nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe nga 13 vendime prej dy gjykatave të tjera, pra të Gjykatës së Strasburgut dhe Gjykatës së Luksemburgut. Konstatohet lehtësisht se në çdo vendim janë evidentuar elementët më të rëndësishëm. Shumë shkurt jepen faktet kryesore, për të kuptuar më mirë çështjen e trajtuar, e më pas *ratio decidendi* i vendimit si dhe pjesë të përzgjedhura nga *obiter dicta*, të cilat e kanë ndihmuar gjykatën respektive në arsyetim dhe në arritjen e konkluzioneve.

Libri, në fakt, të jep edhe një kënaqësi tjetër. Përmes tij tregohet qartësisht se konstitucionalizmi si vlerë me rëndësi qendrore në shtetin demokratik dhe si doktrinë politike po funksionon mjaft mirë në shtetin më të ri të Evropës, në Kosovë. Që me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, shihet që zhvillimet në këtë drejtim kanë qenë aty jo vetëm spektakulare, por edhe mjaft të matura. Aspirata shekullore për pavarësi dhe krijimin e një shteti të fortë, si dhe vrulli për ndryshimin, përparimin e integrimin e një populli të nëpërkëmbur, janë shoqëruar përgjithësisht pa ekcese apo ekstremizma nacionaliste, fetare, politike apo ideologjike. Hapat kanë qenë të vegjël, por shumë të sigurt, falë edhe ndihmës e bashkëpunimit të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare. U fillua menjëherë me aprovimin e Kushtetutës së Kosovës vetëm dy muaj pas shpalljes së pavarësisë, e cila vlerësohet me të drejtë si mjaft moderne. Kjo jo vetëm për faktin e thjeshtë se, ashtu si çdo kushtetutë e çdo demokracie si formë e qeverisjes, ajo realizon mjaft mirë dy funksionet qendrore të saj: a) Konstituimin dhe institucionalizimin e pushtetit shtetëror, bazuar në parimet e shoqërive perëndimore, si dhe b) Garantimin juridiko – formal të dimensionit të vlerave, që në thelb janë pikërisht të drejtat dhe liritë individuale. Ajo shkon shumë më tej se kaq. Që në preambulën e saj Kushtetuta shpalos qartësisht objektivin madhor “...për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdheu i të gjithë qytetarëve të vet;...”, pavarësisht racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve politike. Në paragrafin e dytë të nenit 3 të Kushtetutës saktësohet shprehimisht se “*Ushtrimi i autoritetit publik ... bazohet në parimin e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut...*”. Kjo frymë përshkon të gjithë Kushtetutën. Për më tepër, ajo parashikon krijimin e Gjykatës Kushtetuese, si autoriteti më i lartë apo përfundimtar në Republikën e Kosovës, për interpretimin e Kushtetutës dhe kontrollin e përputhshmërisë së ligjeve me aktin themelor të shtetit. Në kuadër të këtyre detyrave të rëndësishme, Gjykata Kushtetuese shqyrton edhe kërkesat e individëve mbi shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre, të garantuara nga Kushtetuta. Këto të drejta mund të mbrohen nga Gjykata Kushtetuese edhe përmes formave të tjera të kontrollit kushtetues, veçanërisht përmes kontrollit incidental, iniciuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, (shih pikat 7 dhe 8 të nenit 113 të Kushtetutës). Nga ana tjetër, duhet theksuar gjithashtu se

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke i njohur në tërësi të drejtës ndërkombëtare, e në veçanti, të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, një vend të privilegjuar në rendin e brendshëm juridik, ndihmon e lehtëson dukshëm edhe detyrën e Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave themelore. Në pikën 2 të nenit 19 të Kushtetutës theksohet qartë se *“..marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës..”*. Pavarësisht se gjer tani me sa duket, Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ende nuk i është dhënë rasti të interpretojë nocionin *“norma juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare”*, duket që bëhet fjalë për normat *ius cogens*, të cilat i drejtohen të gjithë bashkësisë ndërkombëtare, duke formuar kështu njëkohësisht edhe të ashtuquajturin Juridiksion Universal, që do të thotë krijimin e mundësive për ndjekjen e dënimit, kudo dhe në çdo kohë, të individëve që kryejnë vepra penale veçanërisht të rënda, siç janë gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, tortura, skllavëria dhe puna e detyruar, pirateria, e të tjerë. Nuk mund të lë pa përmendur gjithashtu edhe detyrimin që vendos neni 22 i Kushtetutës për zbatimin e drejtpërdrejtë brenda juridiksionit të Republikës së Kosovës të disa marrëveshjeve dhe instrumenteve të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të miratuara në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa kundër Torturës), si dhe në kuadër të Këshillit të Evropës (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare). Detyrimet e mësipërme plotësohen edhe me një detyrim tjetër kushtetues mjaft specifik e me shumë vlerë për shtetin e ri të Kosovës, i cili përmendet në nenin 53 të Kushtetutës, ku thuhet ndër të tjera se *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore... (duhet të) interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Nga sa më sipër, është për t’u vlerësuar në mënyrë të veçantë fakti që këto detyrime vendosen për marrëveshje, instrumente e institucione tepër të rëndësishme ndërkombëtare, në një kohë që praktikisht, jo për fajin e disponibilitetin e saj, në mënyrë paradoksale, Kosova ende nuk është anëtare e OKB-së dhe e Këshillit të Evropës. Sidoqoftë,

përsërisim se Kosova, ashtu si edhe mjaft nga demokracitë e reja që lindën pas ndryshimeve të mëdha në Evropë në vijim të rënies së Murit të Berlinit, ka ditur të adoptojë standardet më të mira kushtetuese e ligjore, duke e shoqëruar këtë proces me ndërtimin e mekanizmave të rinj, si mjeti më efektiv dhe garancia më e madhe për mbrojtjen e rendit kushtetues, zbatimin e parimeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës si dhe zbatimin gjithnjë e më të mirë të të drejtave themelore, si premisa të rëndësishme për ndërtimin e një shoqërie të civilizuar, të hapur e liberale, por që respekton me rigorozitet ligjin, dinjitetin dhe barazinë e çdo individ. Një pjesë e mirë e këtyre detyrave e objektivave kushtetuese rezulton të jenë elaboruar e zbatuar në mënyrë progresive dhe me mjaft sukses edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke dhënë kështu një kontribut me vlera të jashtëzakonshme edhe në garantimin sa më efektiv të të drejtave individuale. Kjo duket mjaft qartë edhe përmes vendimeve të shumta që shpalosen në këtë libër. Siç rezulton edhe nga ky punim, standardet e vendosura prej saj në mjaft aspekte të të drejtave themelore jo vetëm që janë në një linjë apo përkojnë në shumë drejtime me ato të dy gjykatave të tjera prestigjioze evropiane, pra të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, por në ndonjë rast mund të thuhet me plot gojë se edhe i tejkalojnë ato...

Pas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, e drejta individuale respektive e garantuar në Kushtetutën e Kosovës ilustron në libër me shembuj nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Siç kemi theksuar, kjo gjetje interesante është njëkohësisht edhe mjaft e rëndësishme, pavarësisht se në këndvështrimin formalo – juridik, ndërsa vendimet e gjykatave kushtetuese kanë natyrë *erga omnes*, ato të Gjykatës së Strasburgut kanë natyrë deklarative. Megjithatë, në thelb, ato janë thuajse identike me ato të gjykatave kushtetuese. Praktikisht pranohet se edhe vendimet e GJEDNJ-së kanë natyrë *erga omnes*. Jo më kot, vetë shtetet anëtare në Këshillin e Evropës kanë rënë dakord që mbikëqyrja e zbatimit të veçantë dhe të përgjithshëm (implementimit të masave me natyrë të përgjithshme për mospërsëritjen e shkeljeve analoge në të ardhmen) të vendimeve të kësaj gjykate (GJEDNJ) të bëhet nga Komiteti i Ministrave të Punëve të Jashtme. Një vend të veçantë në këtë drejtim kanë vendimet pilot. Nga ana tjetër, thuajse në të gjitha kushtetutat e shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, veçanërisht

në ato të demokracive të reja, thuhet shprehimisht se interpretimi i të drejtave kushtetuese individuale duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare, që normalisht do të thotë në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në rastin e Kosovës kjo thuhet shprehimisht në nenin 53 të Kushtetutës, ndërsa në rastin e Shqipërisë, pikë referimi janë standardet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me mundësinë e kufizimit të të drejtave themelore (shih paragrafin e dytë të nenit 17 të Kushtetutës së Shqipërisë). Kjo do të thotë se marrë në tërësi, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk është thjesht një marrëveshje ndërkombëtare, por ajo përbën njëkohësisht edhe të drejtë kushtetuese për shtetet anëtare. Pikërisht për këtë arsye, Konventa në fjalë quhet shpesh Instrument Kushtetues i Rendit Publik Evropian (Constitutional Instrument of Public European Order). Ndaj ka dhe duhet të ketë bashkëpunim e dialog të vazhdueshëm mes gjykatave kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sidomos kur bëhet fjalë për zbatimin e parimeve të Proporcionalitetit, Hapësirës së Vlerësimit, Subsidiaritetit, e të tjerë, si dhe të dinamikës së vetë të drejtave themelore, realizuar veçanërisht përmes interpretimit evolues, interpretimit purposivist apo edhe atij teleologjik. Një nxitje tjetër mjaft e rëndësishme në dialogun mes gjykatave kushtetuese të vendeve anëtare me GJEDNJ do të jetë edhe Protokollin 16 i Konventës, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2018, megjithëse numri i shteteve ratifikuese mbetet ende relativisht i vogël. Sidoqoftë, në librin që po prezantohet, konstatohet ndërkaq se edhe në mungesë të anëtarësisë formale, bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe GJEDNJ-së realizohet praktikisht në mënyrë mjaft të kënaqshme.

Siç është theksuar, autorët e librit kanë vendosur në vijim edhe vendimet respektive të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian për çështje të të drejtave individuale, në një kohë që në këtë rast nuk ka asnjë detyrim ligjor apo kushtetues në Kosovë që të imponojë referimin në standardet e së drejtës evropiane në këtë fushë apo në jurisprudencën e kësaj gjykate, ashtu siç është vepruar për Konventën dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mendoj se kjo gjetje e dobishme është bërë jo thjesht vetëm për faktin e perspektivës së padiskutueshme evropiane të shtetit të Kosovës, por mbi të gjitha për shkak të vokacionit dhe të impaktit gjithnjë e në rritje të jurisprudencës së Gjykatës së Luksemburgut edhe për të drejtat e njeriut. Ky ndryshim domethënës në angazhimin e kësaj gjykate

në këtë fushë vihet re qartësisht veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës (1 dhjetor 2009), përmes të cilit, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian fiton status të njëjtë me atë të dy traktateve kryesore të kësaj organizate tepër të rëndësishme ndërkombëtare me karakter *sui generis*. Në fakt, Karta zbatohet normalisht vetëm atëherë kur çështja apo problemi konkret që ka të bëjë me një të drejtë individuale bie në fushëveprimin e së drejtës të Bashkimit Evropian. Por praktika po tregon se këto raste nuk janë të pakta, e aq më tepër, nevoja e operimit me Kartën e të Drejtave Themelore imponohet tashmë edhe për shkak të detyrimit për të garantuar dimensionin e vlerave të BE-së, përmendur shprehimisht në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian, sipas të cilit, në themelet e kësaj organizate janë pikërisht “... *dinjiteti i njeriut, liria, demokracia, barazia, shteti i të drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e personave që u përkasin pakicave...*”. Pikërisht ky angazhim ngre nevojën e bashkëpunimit sa më të ngushtë të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kryetari i Gjykatës së Luksemburgut, njëkohësisht prej vitesh edhe profesor shumë i njohur i së drejtës evropiane, Koen Lenaerts, thekson me shumë vend se vetëm kështu mund të krijohen sinergji të përbashkëta për mbrojtjen sa më efektive të të drejtave të njeriut në Evropë. Kjo gjë imponohet në fakt edhe nga paragrafi i dytë i nenit 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian, i cili urdhëron anëtarësimin e Bashkimit Evropian, si organizatë ndërkombëtare, në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për më tepër, në paragrafin e tretë të po këtij neni parashikohet shprehimisht se është pikërisht kjo Konventë si dhe traditat e përbashkëta kushtetuese të Shteteve Anëtare në BE, që përbëjnë parimet e përgjithshme të së drejtës së BE. Prandaj si të tilla, sigurisht që ato duhet të shërbejnë si pikë referimi edhe në interpretimin e të drejtave individuale të garantuara nga Karta. Padyshim që mbi këtë bazë ndërtohet edhe bashkëpunimi me gjykatat kushtetuese të Shteteve Anëtare në BE, përfshi këtu edhe gjykatat kushtetuese të vendeve që aspirojnë anëtarësimin në këtë organizatë ndërkombëtare, siç është edhe rasti i Kosovës dhe ai i Shqipërisë.

E pra, është e qartë që dobia dhe vlerat e librit që po prezantohet, janë shumëdimensionale. Përmes tij arrihet të kuptohen, zbatohen e mbrohen më mirë e më qartë të drejtat individuale, aq të domosdoshme në shtetin demokratik. Sepse përmes vendimeve të tri gjykatave

tepër të rëndësishme e me vokacion të padiskutueshëm kombëtar e ndërkombëtar, sqarohen mjaft mirë jo vetëm standardet ligjore bazë, por edhe parimet e përgjithshme me të cilat operohet në fushën e të drejtave të njeriut. Prandaj është e vetëkuptueshme që procesi vendimmarrës mbi të drejtat themelore duhet të jetë shpeshherë mjaft kreativ. Gjyqtarit i duhet të veprojë me kurajo e iniciativë në situata e rrethana konkrete e të panjohura, e jo rrallë edhe me mangësi apo boshllëqe ligjore. Këtu duhet shtuar gjithashtu edhe vetë evoluimi apo dinamika e të drejtave individuale, imponuar nga zhvillimet e shkencës e të teknologjisë moderne, si dhe nga progresi ekonomi e shoqëror në tërësi. Për këto arsye edhe gjykata nuk mund të jetë më thjesht “La Bouche de la Loi”, siç thoshte Monteskje. Ajo ka tashmë një relevancë të re dhe rëndësi mjaft të madhe në sistemin kushtetues, veçanërisht në garantimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe të drejtave themelore. Vendimtare është të jetë realisht e pavarur në ushtrimin e funksionit apo misionit të saj, në shërbim të shtetit dhe njerëzve.

Së fundi, dua të ritheksoj se gjuha e përdorur në libër është mjaft e pasur, e qartë dhe e kuptueshme edhe për publikun e gjerë, pavarësisht se shpesh operohet me koncepte e parime të doktrinës juridike. Është meritë e padiskutueshme e të tre autorëve, që si gjyqtarë e lektorë me përvojë në fushën e së drejtës, kanë arritur të ofrojnë esencën e vendimeve që paraqesin, duke përdorur një stil të lehtë, interesant dhe mjaft informues. Në këtë mënyrë jepet njëkohësisht edhe një kontribut me vlerë për të perceptuar gjerësisht përmbajtjen dhe perspektivën e shkëlqyer të katalogut të të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Prof. Dr. Xhezair Zaganjori
Tiranë, 2022

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Karakteri gjyqësor i të drejtave të njeriut është tipar dallues i demokracive liberale. Së këndejmi, në Republikën e Kosovës sikundër edhe në vendet tjera të Evropës Lindore, një prej reflektimeve më besnike të triumfit të demokracisë liberale mbi sistemin totalitar komunist ishte mbrojtja kushtetuese e lirive individuale. Kjo nënkupton jo vetëm garantimin e tyre me dispozita kushtetuese dhe ligjore, por dhe mbrojtjen e tyre në rrugë gjyqësore. Në të kundërtën, të drejtat e njeriut do mbeteshin vetëm koncepte ideologjike, jo norma juridike që mbrohen në procedura gjyqësore.

Kundrejt këtij sfondi, ideja për një libër që ofron perspektivën e gjyqësisë kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, të cilat i garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e ka burimin në përvojat tona personale, si gjyqtarë dhe profesorë universitarë të drejtësisë.

Përgjatë punës sonë të ndërlidhur me sistemin gjyqësor në Republikën e Kosovës, sikundër dhe gjatë përvojës tonë akademike, kemi vënë re mungesë informacioni profesional për praktikën gjyqësore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut që ofron Kushtetuta e Republikës së Kosovës, gjegjësisht Kapitulli II i saj. Kjo është pasojë edhe e mungesës së literaturës që në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse pasqyron jurisprudencën gjyqësore mbi të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat individuale që i garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Libri *Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të Njeriut: Përmbledhje e Rasteve Kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian*, është një hap i rëndësishëm në drejtim të plotësimit të kësaj zbrazëtire. Si i tillë, ky libër është përpjekje jona për t'i ofruar audiencës juridike të Kosovës, një burim gjithëpërfshirës të interpretimeve gjyqësore mbi normat dhe konceptet themelore të të drejtave të njeriut, që janë të mishëruara në Kushtetutën e Kosovës.

Për ta bërë të dobishëm këtë libër për profesionistë dhe studiues të drejtësisë në Kosovë dhe për audiencën shqipfolëse përgjithësisht, jemi përpjekur që libri të jetë sa më i kuptueshëm dhe i lehtë për t'u përdorur nga lexuesi. Padyshim, kjo është një sfidë në vetvete nëse merret parasysh fakti se përmbledhja në një tekst të vetëm e praktikës së tri gjykatave, me tri juridiksione të ndryshme, domosdo ka prodhuar një libër voluminoz.

Metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij libri konsiston në dy hapa:

Së pari, si pikë referuese për përgatitjen e librit është marrë katalogu i të drejtave të njeriut, siç garantohen në Kushtetutën e Kosovës. Kjo do të thotë se përzgjedhja e rasteve gjyqësore është bërë duke u bazuar në listën e të drejtave të njeriut të cilat i përcakton Kushtetuta e Kosovës. Pra, libri është ndërtuar në atë mënyrë që si orientim ka pasur të drejtat individuale të njeriut që i garanton Kushtetuta e Kosovës. Rrjedhimisht, fokus i librit është Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], ku janë të listuara një gamë e gjerë e të drejtave individuale. Por, pavarësisht se jurisprudenca e tri gjykatave ka si pikë reference katalogun e të drejtave të njeriut, të paraqitur në Kapitullin II të Kushtetutës, libri në fillim ka paraqitur edhe disa raste gjyqësore që kanë pasur të bëjnë me nene të Kapitullit I [Dispozitat Themelore], të Kushtetutës. Këto janë kryesisht raste të ashtuquajtura të “kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë”, ku parashtrues të kërkesave në Gjykatën Kushtetuese ishin Presidenti, Qeveria, një numër i caktuar deputetësh, Avokati i Popullit apo Komunitat, ndërsa objekt i shqyrtimit të kërkesave në këto raste ishin ligje apo akte të përgjithshme të miratuara nga Qeveria apo institucionet tjera qendrore.¹ Këto raste nuk kanë pasur të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejta individuale të njeriut, por me pretendime për cenim të parimeve themelore kushtetuese të mishëruara në Kapitullin I [Dispozitat Themelore], si sovraniteti, forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit, vlerat etj. Megjithatë, disa prej këtyre rasteve janë ndërlidhur me nene specifike të Kapitullit I, që prekin edhe të drejtat e njeriut. Kjo përfshin nenet 3 [Barazia Para Ligjit], neni 5 [Gjuhët], neni 7

¹ Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, kërkesat për kontroll abstrakt të kushtetutshmërisë, të paraqitura nga institucionet publike shënohen me KO, ndërsa kërkesat e paraqitura nga individët shënohen me KI.

[Vlerat]. Pra, nëse një rast, siç është ta zëmë rasti KO 130/15, Presidentja ka kontestuar një akt të Qeverisë, me pretendimin se ai cenon, ndër të tjera, edhe nenin 3 [Barazia Para Ligjit]; apo nëse Avokati i Popullit ka kontestuar një Ligj të Kuvendit me pretendimin se ai cenon nenin 7 [Vlerat], siç është rasti KO 119/10, këto dhe raste të ngjashme janë përfshirë në këtë libër – pavarësisht se ato raste kanë pasur të bëjnë me Kapitullin I të Kushtetutës. Në ndërlidhje me këtë, duhet sqaruar se e drejta për barazi para ligjit është e garantuar edhe me nenin 3 të Kapitullit I edhe me nenin 24 të Kapitullit II të Kushtetutës. Duke qenë se libri ka ndjekur renditjen kronologjike të të drejtave individuale, siç janë listuar në nenet përkatëse të Kushtetutës, rastet që kanë pasur të bëjnë me barazinë para ligjit janë paraqitur dy herë (ato janë raste të ndryshme, të ngritura mbi nene të ndryshme, por për të njëjtën të drejtë). Pra, rastet që kanë pasur të bëjnë me barazinë para ligjit janë paraqitur edhe tek neni 3 edhe tek neni 24 i Kushtetutës. Dallimi qëndron në faktin se rastet e ngritura sipas nenit 3 nuk janë paraqitur nga individët, por nga institucionet gjegjëse shtetërore, të cilat kanë kontestuar kushtetutshmërinë e ligjeve apo akteve të tjera të përgjithshme.

Së dyti, janë përzgjedhur rastet kryesore për të drejtat përkatëse të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Fillimisht janë paraqitur rastet më pikante për të drejtën përkatëse, të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Mandej, përzgjedhja e rasteve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë të BE-së, është bërë duke i gjetur rastet e krahasueshme me ato të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për secilën nga të drejtat individuale. Ta zëmë, nëse është trajtuar një rast i Gjykatës Kushtetuese lidhur me lirinë e lëvizjes, janë gjetur rastet të ngjashme të dy gjykatave evropiane në fjalë, që kanë pasur të bëjnë me lirinë e lëvizjes. Ngjashmëria e rasteve është bërë duke pasur parasysh jo vetëm të drejtën e cenuar, por edhe ngjashmërinë e fakteve të rastit. Në ndërlidhje me këtë duhet vënë në pah se është fakt evident se mandati i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është i ndërlidhur me të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sikundër që mandati i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian ka të bëjë me interpretimin e të drejtës së BE-së. Kjo përfshin në radhë të parë traktatet e BE-së, duke përfshirë edhe Kartën e të Drejtave Themelore. Por, korpusi i të drejtave të njeriut

që garanton Kushtetuta e Kosovës është pothuajse i njëjtë me ato të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Prandaj, jurisprudenca e të tri gjykatave, në thelb, është mbi të njëjtat të drejta.

Duke u marrë si pikë referimi kapitujt I dhe II të Kushtetutës, në libër janë përfshirë 36 të drejta përkatësisht nën specifikë të Kushtetutës së Kosovës. Këtu përfshihen disa të drejta që njihen nga Kushtetuta e Kosovës, por të cilat nuk përcaktohen shprehimisht (specifikisht) në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këtu hyjnë, ta zëmë, Liria e Artit dhe Shkencës, që garantohet me nenin 48 të Kushtetutës dhe nenin 13 të Kartës së të Drejtave Themelore, por jo edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sikundër që në analizë nuk përfshihen të drejta specifike që garantohen nga dy instrumentet evropiane në fjalë, por nuk garantohen shprehimisht nga Kushtetuta e Kosovës. Këtu hyjnë të drejta si, barazia në mes të bashkëshortëve, që garantohet në nenin 5 të Protokollit VII të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sikundër edhe një numër të drejtash specifike që i garanton vetëm Karta e të Drejtave Themelore, siç janë ta zëmë, mbrojtja e të dhënave personale (neni 8), liria e afarizmit (neni 16) të drejtat e të moshuarve (neni 25).

Sipas kësaj metodologjie janë analizuar dhe paraqitur rreth 180 raste të të tria gjykatave, gjegjësisht: GJKK, GJEDNJ dhe GJDBE.

Ndonëse libri nuk është një studim krahasues në mes të qasjeve të të tri gjykatave, mënyra sesi janë paraqitur rastet i mundëson lexuesit që të hedhë vështrim krahasues në mes të këndvështrimeve dhe interpretimeve të të tria gjykatave. Skema e përdorur për paraqitjen e rasteve është bërë duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur: *Çështjen kyçe; faktet kryesore të rastit; përmbledhjen e pretendimeve të parashtruesve; arsyetimin e gjykatës; dhe vendimin e gjykatës.*

Një sfidë tjetër me të cilën jemi ballafaquar gjatë përmbledhjes së rasteve të gjykatave ka të bëjë me faktin se për disa të drejta të caktuara ka munguar praktika gjyqësore e ndonjërisht nga gjykatat, siç është rasti me mungesën e praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhje me: Nenin 47 [E drejta për arsimin], Nenin 48 [Liria e artit dhe e shkencës]; Nenin 56 [Të drejtat dhe liritë themelore gjatë gjendjes

së jashtëzakonshme]. Në këto raste, ky fakt është shënuar në formë sqaruese. Megjithatë, praktika e GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, në lidhje me Nenin 47 [E drejta për arsimin], Nenin 55 [Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore]; Nenin 56 [Të drejtat dhe liritë themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme], është reflektuar në përmbledhje, në mënyrë që lexuesi të jetë i informuar për arsyetimin dhe shtjellimet që i kanë dhënë gjykatat në fjalë, në lidhje me këto nene. Sa i përket Nenit 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut], ky nen nuk ngrihet në mënyrë të pavarur, por në ndërlidhje me nenet tjera. GJKK e citon këtë nen në shumicën e rasteve, kur referohet në praktikën e GJEDNJ-së. Megjithatë, në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka elaborim të veçantë vetëm të këtij neni. Po ashtu, ka raste gjyqësore që kanë prekur më shumë se një të drejtë individuale. Ta zëmë, rasti KI36/11 i GJKK-së ka ngritur pretendime edhe lidhur me nenin 38 [Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë], si dhe me nenin 47 [E drejta për shkollim]. Ne i kemi dhënë përparësi të drejtës që ka qenë në epiqendër të kërkesës kushtetuese dhe në dritën e rrethanave të rastit. Rrjedhimisht, rasti është paraqitur vetëm një herë, tek njëra nga të drejtat (në rastin e mësipërm, rasti është paraqitur i ndërlidhur me nenin 38). Por, nëse nuk ka pasur rast tek e drejta tjetër (siç ka ndodhur në rastin e mësipërm), atëherë tek ajo e drejtë është bërë sqarimi përkatës duke e udhëzuar lexuesin që të referohet në rastin specifik të paraqitur në ndërlidhje me të drejtën tjetër.

Tek të gjitha rastet e paraqitura janë dhënë vegëzat e vendimeve të gjykatave përkatëse, ku ato mund të gjinden në formë elektronike, si dhe datat e shpalljes së atyre vendimeve.

Një sqarim tjetër me rëndësi për lexuesit ka të bëjë me terminologjinë dhe emërtimet e përdorura në tekst, e që i janë përshtatur emërtimeve dhe diskursit të përdorur nga tri gjykatat përkatëse. Kështu, për paraqitësit e kërkesave (palët që iniciojnë procedurën gjyqësore), GJKK përdor termin parashtruesi, GJEDNJ termin kërkuesi, ndërsa tek GJDBE përdoret, në varësi të procedurës së ndjekur, termi ankuesi, ose gjykata referuese. Po ashtu, janë specifikuar edhe institucionet gjyqësore të BE-së vendimet e të cilave janë përmbledhur, përkatësisht, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) ose Tribunali i BE-së. Një pasqyrë e terminologjisë së përdorur është paraqitur edhe tek lista e shkurtesave.

Autorët

LISTA E SHKURTESAVE

AALK	– Autoriteti i autorizuar për të lidhur kontrata pune, Komisioni Evropian
AGG	– Ligji i përgjithshëm mbi barazinë në trajtim, Gjermani
AIA	– Air Atlantis SA, ndërmarrje në sektorin e fluturimeve çarter, Portugali
AKP	– Agjencia Kosovare e Pronës
AKP	– Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKR	– Aleanca Kosova e Re
AMDH	– Autoriteti belg i mbrojtjes së të dhënave, Belgjikë
BE	– Bashkimi Evropian
BQE	– Banka Qendrore Evropiane
CBS	– Banka Tregtare e Sirisë, Siri
CCBE	– The Council of Bars and Law Societies of Europe (Këshilli i Avokatëve dhe Shoqatave të Avokatëve të Evropës)
CIA	– Central Intelligence Agency
CPVP	– Komisioni belg për mbrojtjen e privatësisë, Belgjikë
CSM	– Conselho Superior da Magistratura (Këshilli i Lartë i Gjyqësorit), Portugali
CSM	– Conseil supérieur de la magistrature (Komisioni Kombëtar i Shërbimit Ligjor), Francë
DÇPB	– Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
DKA	– Drejtoria Komunale e Arsimit
DPT	– Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Spanjë
DRPR	– Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme
DSS	– Departamenti i Sigurimeve Sociale, Mbretëri e Bashkuar
DHM	– Dhoma e Madhe
DUDNJ	– Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
ECHA	– Agjencia Evropiane e Produkteve Kimike
EULEX	– Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FBF	– Federata Mbretërore Belge e Shoqërive të Futbollit, Belgjikë

MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

FCA	– Financial Conduct Authority (Autoriteti britanik i kontrollit financiar), Mbretëri e Bashkuar
FEDEX	– Federal express International, Francë
FFF	– Federata Franceze e Futbollit, Francë
FKF	– Fondi i Kompensimit Financiar, Shqipëri
FKN	– Fondi i kompensimit në natyrë, Shqipëri
GATS	– Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve, Organizata Botërore e Tregtisë
GDR	– Global depositary receipt (Certifikatë ndërkombëtare e letrave me vlerë)
GG	– Grundgesetz (Ligji Themelor i Gjermanisë)
GJDBE	– Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
GJDKE	– Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane
GJEDNJ	– Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJKK	– Gjykata Kushtetuese e Kosovës
HEE	– Hapësira Ekonomike Evropiane
HOOS	– Zdrúžení na ochranu občana spotřebiteľa (Shoqata për mbrojtjen e konsumatorit), Sllovaki
ICAO	– Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IPES	– Instituti për Strehimin Social i Krahinës Autonome të Bolzanos, Itali
IRA	– Ushtria Republikane Irlandeze
IRG	– Ligji gjerman për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështjet penale, Gjermani
KBI	– Këshilli i Bashkësisë Islame
KÇPB	– Komisioni për Çështje Pronësore Banesore
KDKGJK	– Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
KDTH	– Karta e të Drejtave Themelore
KE	– Këshilli i Evropës
KEDNJ	– Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
KKPB	– Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
KLD	– Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ukrainë
KPFT	– Kushtet e Punësimit të Funkionarëve të Tjerë të Bashkimit Evropian
KPMSHCK	– Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës
KPP	– Kodi i Procedurës Penale, Gjeorgji

KQZ	– Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Kosovë
KRS	– Krajowa Rada Sądownictwa (Këshilli Kombëtar Gjyqësor), Poloni
KS OKB	– Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
LGBTI	– Komuniteti i lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjnorëve ose interseksualëve
LMD	– Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore
LVV	– Lëvizja Vetëvendosje
LZP	– Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
MAP	– Ministria e Administratës Publike
MOCEOP	– Movement for Optional Celibacy of Priests (Lëvizja pro beqarisë fakultative për priftërinjtë)
MPB	– Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	– Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NI	– Numri i Sigurimit Kombëtar, Mbretëri e Bashkuar
NSSI	– Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore, Bullgari
OBT	– Organizata Botërore e Tregtisë
OJQ	– Organizatë joqeveritare
OKB	– Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSYM	– Qendra e Përzgjedhjes dhe Vendosijes së Studentëve të Këshillit të Arsimit të Lartë – Turqi
PD	– Partia e Drejtësisë
PE	– Parlamenti Evropian
PDAÁ	– Akti i Planifikimit dhe Zhvillimit 2010, Irlandë
PDK	– Partia Demokratike e Kosovës
PPJS	– Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë e Bashkimit Evropian
PZAP	– Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QKUK	– Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QNR	– Qendra e Numërimit të Rezultateve
RCL	– Klubi Mbretëror i Futbollit Liezh, Belgjikë
RFJ	– Republika Federale e Gjermanisë
RPGD	– Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të dhënave të tilla
RTHV	– Regjistri Themeltar i të Vdekurve
SFEI	– Sindikata franceze e dërgesave ekspres ndërkombëtare

MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SFMI	– Kompania franceze e dërgesave ndërkombëtare
SIAC	– Komisioni i Posaçëm i Ankimeve për Imigracionin, Mbretëri e Bashkuar
SLCB	– Syrian Lebanese Commercial Bank SAL
SPEA	– Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit
SHKP	– Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Shqipëri
TAP	– Transportes Aereos Portugueses, kompani ajrore në Portugali
TBE	– Traktati i Bashkimit Evropian
TDI	– Groupe technique des députés indépendants (Grupi Teknik i Deputetëve të Pavarur në Parlamentin Evropian)
TEAC	– Tribunal Económico-Administrativo Central, Spanjë
TFBE	– Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
TGI	– Toulouse Tribunal de Grand Instance (Tribunali i Madh i Instancës së Tulusë), Francë
TKE	– Traktati i Komunitetit Evropian
TKEE	– Traktati i Komunitetit Ekonomik Evropian
TRIPS	– Marrëveshja mbi aspektet e së drejtës të pronësisë intelektuale të lidhura me tregtinë
TRLIS	– Ligji i rishikuar për Tatimet e Korporatave, Spanjë
TVSH	– Tatimi mbi vlerën e shtuar
UAE	– Urdhërarrest evropian
UFEX	– Union française de l'express, Francë
UNHCR	– United Nations High Commissioner for Refugees
UNM	– United National Movement, Gjeorgji
UPBMO	– Shoqata belge e specialistëve të okulistikës dhe kirurgjisë së syve, Belgjikë
VTPD	– Lista e vendet dhe territoreve përtej detit, Shtojca II e Traktatit të Komunitetit Evropian
WRV	– Weimarer Verfassung (Kushtetuta e Weimarit), Gjermani
ZBLD	– Ligji për Dokumentet Identifikuese, Bullgari
ZKKK	– Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete
ZPO	– Zivilprozessordnung (Kodi i Procedurës Civile), Gjermani

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ne, Populli i Kosovës,

Të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet;

Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë-të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit;

Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social;

Të sigurt që shteti i Kosovës do të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë Evropës, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje;

Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë;

Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike;

Në mënyrë solemne, miratojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Barazia para Ligjit

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1 KO130/15. PARASHTRUES: PRESIDENTJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf]

23 dhjetor 2015

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Thelbi i kërkesës ishte vlerësimi i përputhshmërisë së parimeve që përmbante dokumenti i titulluar “Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore”, me frymën e Kushtetutës, si dhe me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre].*

Faktet kryesore

Presidentja e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 84 (9) parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmbante dokumenti i titulluar “Asociacioni/Bashkësia e komunave serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, Kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Akti i kontestuar ishte derivat i «Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë”, të nënshkruar në Bruksel, më 19 prill 2013, në mes të Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Kryeministrit të Republikës së Serbisë.

Përmbledhja e pretendimeve

Presidentja e Republikës së Kosovës, ndër të tjera, pretendoi se akti i kontestuar, si akt i ndërmjetëm juridik i miratuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, rregullonte çështje që hyjnë në gamën e çështjeve që prekin frymën e Kushtetutës, si në kuptim të promovimit të shumëetnicitetit, të drejtave dhe lirive themelore individuale, të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe gjithashtu edhe në kuptim të natyrës së institucioneve që rrjedhin nga Kushtetuta.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht miratoi kërkesën e parashtrueses (Presidentes së Republikës) për masë të përkohshme, duke pezulluar zbatimin e aktit të kontestuar deri në vendosjen e rastit. Para se të siguronte përgjigje thelbësore ndaj pyetjeve të veçanta kushtetuese të bëra nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata konstatoi se parashtruesja ishte palë e autorizuar për të ngritur një kërkesë të tillë në Gjykatën Kushtetuese dhe se dokumenti që përmbante kërkesa mund të ishte objekt i shqyrtimit kushtetues. Në shqyrtimin e meritave të kërkesës, Gjykata Kushtetuese gjeti se disa parime të përgjithshme të përfshira në dokumentin në shqyrtim para Gjykatës nuk i plotësonin në tërësi standardet kushtetuese të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjykata konstatoi që Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe duhet të themelohet, siç është paraparë me Marrëveshjen e Parë, të nënshkruar në vitin 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Por, Gjykata Kushtetuese gjeti se disa parime të përgjithshme të përfshira në dokumentin në shqyrtim kushtetues (Parimet e Asociacionit) nuk i plotësonin në tërësi standardet kushtetuese të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me: (i) Kapitujt II dhe III të Kushtetutës – që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e komuniteteve; (ii) çështje të vetëqeverisjes lokale dhe çështje që lidhen me statusin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se çdo legjislacion apo dokument që rrjedh nga dokumenti në shqyrtim kushtetues (Parimet e Asociacionit) duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht: (i) Kapitujt II dhe III të Kushtetutës në lidhje me të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e komuniteteve, (ii) çështje të vetëqeverisjes lokale dhe

çështjet që lidhen me statusin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës. Gjykata mbështeti arsyetimin e saj duke u bazuar kryesisht në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjegjësisht në legjislacionin për çështje të vetëqeverisjes lokale dhe të shërbimit civil, në instrumente të ndryshme juridike ndërkombëtare, në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata, më shumicë votash, shpalli kërkesën të pranueshme dhe konstatoi që Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe do të themelohet, siç është paraparë më Marrëveshjen e Parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës; konstatoi se “Parimet, siç janë elaboruar në «Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore”, nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

1.2. KO119/10. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[\[https://gjk-ks.org/decision/vlersim-i-kushtetutshmrise-nenit-14-paragrafit-1-6-nenit-22-nenit-24-nenit-25-dhe-nenit-27-te-ligjit-prte-drejtat-dhe-prgegjsit-e-deputetit-nr-03111/\]](https://gjk-ks.org/decision/vlersim-i-kushtetutshmrise-nenit-14-paragrafit-1-6-nenit-22-nenit-24-nenit-25-dhe-nenit-27-te-ligjit-prte-drejtat-dhe-prgegjsit-e-deputetit-nr-03111/)

8 dhjetor 2011

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së disa neneve të caktuara të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, me pretendimin se këto nene të këtij Ligji u mundësonin deputetëve të Kuvendit të realizojnë pensione që ishin më të favorshme se çdo përfitim tjetër pensional për qytetarët e tjerë dhe si të tilla nuk ishin në harmoni me vlerat e proklamuarat të rendit kushtetues i cili bazohet në parimet e demokracisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale.

Faktet kryesore

Më 4 qershor 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit. Një numër organizatash jo-qeveritare i ishin drejtuar me një shkresë Presidentit të Republikës së Kosovës, me kërkesë që të mos e shpallte Ligjin në fjalë. Më 5 korrik 2010, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit u dekretua nga Presidenti. Pas kësaj, një numër edhe më i madh organizatash joqeveritare, të mbështetura edhe nga Sindikata e Pensionistëve të Kosovës, iu drejtuan Institucionit të Avokatit të Popullit me një kërkesë të përbashkët që Avokati i Popullit, në bazë të autorizimeve të tij kushtetuese, të kontestonte kushtetutshmërinë e Ligjit në fjalë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. OJQ-të argumentonin se neni 22 i Ligjit në fjalë ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Më 26 nëntor 2010, Avokati i Popullit e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar kushtetutshmërinë e Ligjit në fjalë, si dhe duke kërkuar që të vendoset një masë e përkohshme për të ndaluar zbatimin e këtij ligji deri në vendosjen meritore të rastit.

Përmbledhja e pretendimeve

Avokati i Popullit pretendoi se Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit përmbante dispozita që u mundësonin deputetëve të Kuvendit të Kosovës të realizonin pensione që ishin më të favorshme se çdo përfitim tjetër pensional për qytetarët e tjerë dhe, rrjedhimisht, dispozitat përkatëse të atij Ligji nuk ishin në pajtim me parimet kushtetuese të barazisë, të sundimit të ligjit, të mosdiskriminimit dhe të drejtësisë sociale. Avokati i Popullit në mënyrë të veçantë argumentoi se pensioni suplementar i paraparë me nenin 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit ishte qartazi joproporcional me pensionet mesatare në vend. Si i tillë, ai nen i Ligjit në fjalë nuk ishte në harmoni me vlerat e shpallura në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rendi kushtetues i së cilës bazohet në parimet e demokracisë, barazisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vendosi që të shqiptojë masën e përkohshme në kohëzgjatje prej tre muajsh, duke pezulluar zbatimin e Ligjit të kontestuar. Gjykata arsyetoi se parashtruesi kishte paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse se zbatimi i këtij Ligji mund të rezultonte në dëme të pariparueshme dhe se kjo masë e përkohshme ishte në interesin publik. Në vlerësimin e meritave të rastit, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se me rastin e përcaktimit të së drejtës për pension suplementar për deputetët e Kuvendit të Kosovës (në shumën e 50%, 60% ose 70% të pagës aktuale bazë të deputetit, varësisht nga numri i mandateve të kaluara në Kuvend), si dhe me rastin e përcaktimit të moshës 55-vjeçare si kusht tjetër për ta fituar të drejtën për pension suplementar, Kuvendi në mënyrë të paarsyeshme kishte devijuar nga aktet normative që ishin në fuqi deri atëherë, përkitazi me fitimin e së drejtës për pension. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se pensionet që duhej t'u paguheshin deputetëve të pensionuar ishin qartazi joproporcionale me pensionet mesatare në vend, meqë Ligji përcaktonte pensione që do të ishin 8-10 herë më të larta se pensionet mesatare në vend. Sipas Gjykatës Kushtetuese, një shpërpjesëtim i tillë që favorizonte dukshëm deputetet në krahasim me qytetarët e tjerë ekzistonte edhe sa i përket moshës së pensionimit, duke qenë se Ligji përcaktonte moshën 55-vjeçare si kusht për përfitimin e pensionit nga deputetet, duke zbritur kështu kufirin e përgjithshëm të moshës 65-vjeçare për pensionimin e qytetarëve të tjerë. Gjykata vuri në pah se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohej në parimet e demokracisë, barazisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale. Duke qenë se pensionet e propozuara duhej të paguheshin nga buxheti shtetëror pa kontributin e deputetëve, Ligji ishte diskriminues ndaj pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë dhe të gjithë pensionistëve të tjerë në Kosovë. Si i tillë, ai shkelte parimet e barazisë dhe të drejtësisë sociale të mbrojtura me Kushtetutë, pa shpjegim apo arsyetim të mjaftueshëm për ndonjë qëllim legjitim publik për një trajtim të tillë diskriminues.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata njëzëri konstatoi se neni 14, paragrafi 1.6, neni 22, neni 24, neni 25 dhe neni 27 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nr.

03/L-111, nuk ishin në pajtim me nenet 3.2, 7 dhe 74 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Gjykata i shpalli të pavlefshme nenet në fjalë.²

1.3. KO01/19. PARASHTRUES: QEMAJL KURTISHI, ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL NË PRIZREN.

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/ko_01_09_vendimi_al.pdf]

18 mars 2010

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Parashtruesi i kërkesës, si Zëvendës-Kryesues i Kuvendit Komunal për Komunitete në Komunën e Prizrenit, kontestoi nenin 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit, mbi emblemën e Komunës, e cila përmbante shtëpinë e Lidhjes së Prizrenit, vitin 1878 dhe mbishkrimin “Prizren”. Çështja kyçe kushtetuese e ngritur përmes kësaj kërkesë kishte të bënte me pretendimin se emblema e Komunës së Prizrenit nuk pasqyronte strukturën shumëetnike të Komunës dhe, rrjedhimisht, komuniteteve etnike jo shumicë u ishin shkelur të drejta për barazi para ligjit si dhe garancitë kushtetuese, për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

Faktet kryesore

Më 15 tetor 2008, Komuna e Prizrenit nxori Vendimin për miratimin e Statutit Komunal. Neni 7 i këtij Statuti parashikonte se Komuna ka emblemën, flamurin dhe simbolin e saj. Emblema e Komunës është “Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit”, e rrethuar me fjalët në vijim “1878 – Prizren”. Përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë në atë kohë kishin propozuar që fjalët “Komuna”, “Opština”, “Belediye” (në gjuhët shqipe, serbe dhe turke) të shkruheshin brenda rrethit të emblemës, pa vitin “1878”. Ata kishin argumentuar se viti 1878 (viti i “Lidhjes së Prizrenit”),

² SQARIM: Shkelja u referohet neneve të Kushtetutës nga Kapitulli I [Dispozitat e Përgjithshme] dhe nenit 74 që flet për ushtrimin e funksionit të deputetit.

kishte rëndësi historike vetëm për shqiptarët, si komunitet shumicë. Ndërsa, sipas tyre, komuna e Prizrenit ishte komunë shumëetnike, në të cilën jetonin edhe komunitete të tjera etnike. Ky propozim nuk ishte pranuar.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi që simboli i Lidhjes së Prizrenit pasqyrore vetëm rëndësinë kulturore-historike të komunitetit shqiptar dhe që emblema nuk kishte elemente të cilat tregonin komunitetet tjera që jetojnë në këtë Komunë. Ai pretendoi që emblema komunale duhet të simbolizojë dhe të transmetojë porosinë e bashkëjetesës së komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve, si dhe praninë e etnive të shumta, kulturave të shumfishta, fetë e shumta dhe gjuhët e shumta. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendoi se simboli i Komunës së Prizrenit nuk ishte miratuar në Kuvend me dy të tretat e votave, prandaj nuk ishte respektuar as procedura ligjore për nxjerrjen e Vendimit në fjalë.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vuri në pah se përgjatë gjithë Kushtetutës ekzistojnë referenca në parime të barazisë dhe shumëetnicitetit, për shembull, në përshkrimin e karakterit shumëetnik të simboleve shtetërore të Kosovës, në trajtimin e vlerave bazë, në trajtimin e barazisë para ligjit, në trajtimin e barazisë para gjykatave dhe në shumë pjesë tjera. Gjykata më tutje theksoi se të drejtat e njeriut që garanton Kushtetuta janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme si dhe janë baza e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Ndërsa Kapitulli III i Kushtetutës, përcakton dhe garanton “Të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre”. Më tej, Gjykata theksoi se neni 57.3 i Kushtetutës shprehimisht u jep pjesëtarëve të komuniteteve “të drejtën e shprehjes së lirë, nxitjes dhe zhvillimit të identitetit dhe attributeve të komuniteteve të tyre”. Një nga mënyrat që komunitetet “shprehin, nxisin dhe zhvillojnë identitetin dhe atributet e tyre” është përmes angazhimit në procesin politik, duke marrë pjesë në shqyrtimin e miratimit të Statutit të Komunës, si dhe duke dhënë sugjerime konstruktive për formën e emblemës që Komuna zgjedh të miratojë.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, emblema përfaqëson arritjet, shpresën dhe idealet e gjithë qytetarëve prandaj ajo duhet të respektojë gjithë qytetarët e Komunës – të të gjitha grupeve etnike. Për ta bërë të mundur që qytetarët e Prizrenit ta shohin dhe ta ndjejnë atë në këtë mënyrë, emblema e Komunës do të duhej të ishte simbol i gjithë qytetarëve. Në dritën e këtij sfondi normativo-kushtetues, Gjykata konstatoi se kur Komuna ka vendosur të shpallë emblemën, në të cilën shtëpia e Lidhjes së Prizrenit shoqërohet me vitin 1878, ata kanë promovuar trashëgiminë dhe traditën shqiptare pa vëmendje ndaj komuniteteve të tjera duke shkelur të drejtat e komuniteteve joshumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata, njëzëri (me një mendim konkurrues), vendosi që neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit nuk ishte në pajtim me Kushtetutën dhe urdhëroi Komunën e Prizrenit që ta ndryshojë atë në mënyrë që ai të ishte në përputhje me Kushtetutën.

2. PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. GORZELIK DHE TË TJERËT kundër POLONISË

[44158/98]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

17 shkurt 2004

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: Refuzimi për të regjistruar një shoqatë që e quan veten organizatë të një pakice kombëtare. Njohja e një statusi të veçantë zgjedhor për një shoqatë që promovon identitetin dhe kulturën e një grupi etnik.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Jerzy Gorzelik, Rudolf Kolodziejczyk dhe Erwin Sowa (kërkuesit), të gjithë shtetas polakë, kundër Polonisë. Të tre kërkuesit të cilët e përshkruajnë veten si “silesianë”, së bashku me 190 persona të tjerë, vendosën të formojnë një shoqatë të quajtur “Bashkimi i Njerëzve të Kombësisë Silesiane” (anglisht: “Union of People of Silesian Nationality”; polonisht: “Związek Ludności Narodowości Śląskiej”). Më 11 dhjetor 1996, kërkuesit, duke vepruar në emër të komitetit të përkohshëm të menaxhimit (Komitet Założycielski) të “Unionit të Njerëzve të Kombësisë Silesiane”, paraqitën kërkesë për regjistrimin e shoqatës së tyre në Gjykatën Rajonale Katowice (Sąd Wojewódzki), duke u bazuar, ndër të tjera, në nenin 8 (2) të Ligjit për Shoqatat (Prawo o stowarzyszeniach), të 7 prillit 1989. Kërkuesit me rastin e dorëzimit të kërkesës për regjistrim, dorëzuan edhe memorandumimin e asociimit së bashku me dokumentet e tjera të kërkuara nga ai Ligj.

Autoritetet polake refuzuan të regjistrojnë shoqatën me arsyetimin se, si emri i synuar, ashtu edhe disa dispozita të memorandumit të shoqatës, i cili i karakterizonte silesianët si një “pakicë kombëtare”, nënkuptonin se qëllimi i tyre i vërtetë ishte të anashkalonin dispozitat e Ligjit Zgjedhor. Gjithashtu, sipas autoriteteve polake nëse anëtarët e Unionit do të njiheshin si “pakicë kombëtare”, ata automatikisht do të kishin fituar privilegje të pabazuara dhe të pazbatueshme.

Më 27 janar 1997, Guvernatori i Katovicës, duke vepruar përmes Departamentit të Çështjeve Civile (Wydział Obywatelski), paraqiti në Gjykatë komentet e tij mbi kërkesën. Komentet përmbanin argumente të gjata kundër lejimit të regjistrimit të shoqatës. Guvernatori i Katovicës sugjeroi që, si parakusht për regjistrimin e shoqatës, emri i saj të ndryshohej dhe referenca për një pakicë kombëtare silesiane të fshihej nga memorandumimi. Pas disa ankesave të kërkuesve, por edhe të Guvernatorit pranë Gjykatës Rajonale, kjo e fundit miratoi kërkesën e kërkuesve për regjistrimin e shoqatës së tyre. Guvernatori paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila më pas anuloi vendimin e shkallës së parë dhe hodhi poshtë kërkesën e kërkuesve për regjistrimin e kësaj shoqate. Gjykata vuri në dukje pasojat që do të kishte njohja e një pakice kombëtare silesiane, përkatësisht të drejtat e pakicave që do të rrjedhin nga statutet e ndryshme, dhe mori parasysh mendimet e ekspertëve

sipas të cilave, megjithëse silesianët përbënin grup etnik, tiparet e një kombi nuk ishin zhvilluar plotësisht. Prandaj, ata nuk mund të konsideroheshin pakicë kombëtare dhe regjistrimi nuk mund të bëhej me një memorandum të tillë. Kërkuesit u ankuan për çështjet ligjore në Gjykatën e Lartë, e cila ankesë u hodh poshtë për të njëjtat arsye.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretendonin se autoritetet polake kishin refuzuar në mënyrë arbitrare të regjistrojnë shoqatën «Bashkimi i Njerëzve të Kombësisë Silesiane» (“Union of People of Silesian Nationality”). Ata pretenduan se në rastin e tyre është shkelur neni 11 [Liria e tubimit dhe e organizimit] i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “KEDNJ” ose “Konventa”). Ata pohuan se fakti që shumica e polakëve nuk arritën të njihnin ekzistencën e një kombi silesian nuk do të thotë se nuk kishte një komb të tillë. Ata cituan botime të ndryshme shkencore e historike dhe vazhduan me shpjegimin se fakti që silesianët formonin një grup të veçantë, ishte pranuar tashmë që nga fundi i Luftës së Parë Botërore. Për më tepër, silesianët gjithmonë kishin kërkuar të ruanin identitetin e tyre dhe përbënin një grup të veçantë, pavarësisht nëse Silesia e Epërme i përkiste Gjermanisë ose Polonisë. Për pasojë, çdo krahasim midis tyre dhe Krakovianëve (Cracovians [*Krakowiacy*]), Malësorëve (Highlanders [*Górale*]) dhe Mazurianëve (Mazurians [*Mazurzy*]), ishte krejtësisht i pajustificuar, sepse këto grupe as nuk e konsideronin veten si pakica kombëtare, as nuk ishin perceptuar ndonjëherë si të tilla në të kaluarën. Kërkuesit cituan disa letra të Ministrisë së Brendshme që ishin botuar nga shtypi dhe që shpjegonin se Projektligji për Pakicat Kombëtare dhe Etnike kishte deklaruar në mënyrë eksplicite se “një deklaratë që një person i përket një pakice nuk duhet të vihet në pikëpyetje ose të verifikohet nga autoritetet publike”.

Kërkuesit, në thelb, kritikuan mungesën e një përkufizimi të një pakice kombëtare ose një procedure sipas së cilës një pakicë e tillë mund të merrte njohje sipas ligjit të brendshëm. Ata pretenduan se kjo zbrazëti ligjore e bëri të pamundur që ata të parashikonin se çfarë kriteresh kërkoheshin të plotësonin për regjistrimin e shoqatës së tyre dhe u la autoriteteve një pushtet të pakufizuar diskrecional në këtë sferë.

Nga ana tjetër, më 9 prill 1997, Guvernatori i Katovicës paraqiti një kërkesë në gjykatë. Ai mbajti qëndrimin e tij të mëparshëm. Më 14 prill 1997, ai dorëzoi dy letra nga Ministria e Brendshme (të 4 shkurtit dhe 10 prillit 1997, respektivisht), drejtuar Departamentit të Çështjeve Qytetare të Zyrës së Guvernatorit të Katovicës. Në pjesët relevante të letrës së 4 shkurtit 1997 theksohet:

“Ne ndajmë dyshimet tuaja nëse disa banorë të Silesisë duhet të konsiderohen si pakicë kombëtare. Prandaj ne ju sugjerojmë që t’i paraqisni vëzhgimet tuaja në gjykatë, duke treguar këto dyshime dhe që t’i kërkon gjykatës t’ju japë leje për t’u bashkuar në procedurë si palë.

Ne sugjerojmë që të mbështeteni në faktin se Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nuk është ratifikuar nga Polonia, kështu që dispozitat e saj [nuk zbatohen në sistemin juridik vendor].

Sipas mendimit tonë, as rrethanat historike dhe as etnografike, nuk justifikojnë mendimin se banorët e Silesisë mund të njihen si pakicë kombëtare. “

Në pjesët relevante të letrës së 10 prillit 1997 theksohet:

“[...] Argumentet e parashtruara nga komiteti i përkohshëm i menaxhimit të shoqatës [në kërkesën e tyre të 13 marsit 1997] nuk përmbajnë asnjë element të ri; [në veçanti] ... [Konventa] nuk përbën ligjin e zbatueshëm në Poloni.

Po kështu, letrat e Ministrisë së Brendshme [për interpretimin e Projektligjit për Pakicat Kombëtare dhe Etnike] nuk e ndryshojnë situatën. Ndjenja e përkatësisë ndaj një kombi bie brenda sferës së lirive personale; ajo në vetvete nuk sjell ndonjë pasojë juridike. [Në të kundërt,] formimi i një organizate të një pakice kombëtare është një fakt juridik i cili sjell pasoja ligjore të tilla si, për shembull, ato të referuara në Aktin e Zgjedhjeve të vitit 1993. Në rrethanat, regjistrimi i shoqatës së quajtur ‘Bashkimi i Njerëzve të Kombësisë Silesian’ mund të lejohej me kusht që të ishte vërtetuar ekzistenca e një kombi të tillë. “

Arsyetimi i Gjykatës

Në vendimin e saj të 20 dhjetorit 2001, Dhoma (Chamber) konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 11. Ajo u shpreh se refuzimi për të regjistruar shoqatën e parashtruesve ishte nxitur nga nevoja për të mbrojtur sistemin zgjedhor shtetëror. Përpyekja e mundshme për të kërkuar privilegje të pajustificuara sipas Ligjit Zgjedhor, ishte përcaktuar në paragrafin 2 të asaj dispozite (shih paragrafët 64 e vijues të vendimit të Dhomës).

Kërkuesit, në letrën e tyre të 20 marsit 2002, kërkuan që çështja t'i referohej Dhomës së Madhe, duke theksuar se një refuzim për të regjistruar një shoqatë nuk mund të bazohej - siç kishte ndodhur në rastin e tyre - thjesht në përshtypjet ose supozimet për veprimet e ardhshme të shoqatës. Ata kritikuan përfundimin e Dhomës (Chamber) se deklarata në paragrafin 30 të memorandumit të asociimit se Unioni i tyre do të ishte një "organizatë e pakicës kombëtare silesiane", kishte krijuar përshtypjen se më vonë ata mund të aspironin të dilnin në zgjedhje dhe të fitonin privilegje sipas Ligjit Zgjedhor. Në lidhje me këtë, ata argumentuan se jo vetëm që ky konstatim nuk ishte mbështetur nga asnjë provë që tregonte se ky ishte me të vërtetë qëllimi i tyre, por gjithashtu se regjistrimi i shoqatës së tyre nuk do t'u kishte dhënë atyre ndonjë privilegj të tillë automatikisht pasi, në mungesë të ndonjë përkufizimi të konceptit të "pakicës kombëtare" në ligjin polak, kjo çështje i ishte lënë Kolegjit Shtetëror Zgjedhor të vendoste.

Qeveria polake u pajtua plotësisht me gjetjet dhe konkluzionet e Dhomës dhe konsideroi se argumentet e kërkuesve duhet të refuzohen. Në arsyetimin e saj, Gjykata vërejti se argumentet e kërkuesve për paparashikueshmërinë e supozuar të ligjit polak nuk kishin të bënin me dispozitat ligjore mbi të cilat u bazua në të vërtetë refuzimi për të regjistruar shoqatën e tyre.

Gjykata vuri në pah se Ligji për Shoqatat u jep gjykatave autoritetin për të regjistruar shoqatat. Në këtë kontekst, gjykatat kishin kompetencë për të verifikuar, ndër të tjera, pajtueshmërinë e memorandumit të shoqatës me ligjin, përfshirë autorizimet për të refuzuar regjistrimin nëse konstatohet se kushtet e Ligjit për Shoqatat nuk janë plotësuar. Në

rastin aktual, gjykatat polake refuzuan regjistrimin sepse konsideruan se shoqata e kërkuesve nuk mund ta përshkruante veten në mënyrë legjitime si një “organizatë e një pakice kombëtare”, një përshkrim që do t’i jepte asaj qasje në privilegjet zgjedhore të dhëna sipas nenit 5 të Ligjit të Zgjedhjeve për Sejm të vitit 1993 (*Ordynacja wyborcza do Sejmu Rzeczypospolitej Polskiej* – ‘the 1993 Elections Act), pasi populli silesian nuk përbënte një “pakicë kombëtare” sipas ligjit polak.

Gjykata u shpreh se nuk i takonte asaj të shprehë qëndrim dhe pikëpamje mbi përshtatshmërinë e metodave të zgjedhura nga legjislatura e një shteti të paditur për të rregulluar një fushë të caktuar. Detyra e Gjykatës kufizohet në përcaktimin nëse metodat e miratuara dhe efektet që ato sjellin janë në përputhje me Konventën.

Lidhur me argumentin e kërkuesve se ligji polak nuk jepte ndonjë përkufizim të një “pakice kombëtare”, Gjykata theksoi së pari se, siç e kishte theksuar me të drejtë Dhoma (Chamber), një përcaktim i tillë do të ishte shumë i vështirë për t’u formuluar. Në veçanti, nocioni nuk është përcaktuar në asnjë traktat ndërkombëtar, përfshirë Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Pakicat Kombëtare (shih paragrafin 62 të aktgjykimit të Dhomës dhe paragrafin 46 dhe, për shembull, nenin 27 të Paktit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 39 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave që u përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, të vitit 1992).

Po kështu, praktika në lidhje me njohjen zyrtare nga shtetet të pakicave kombëtare, etnike ose të tjera brenda popullsisë së tyre ndryshon nga vendi në vend apo edhe brenda vendeve. Zgjedhja se çfarë forme duhet të ketë një njohje e tillë dhe nëse duhet të zbatohet përmes traktateve ndërkombëtare ose marrëveshjeve dypalëshe ose të përfshihet në Kushtetutë ose në një ligj të veçantë, për nga natyra e gjërave, duhet t’i lihet kryesisht shtetit në fjalë, në varësi nga rrethanat e veçanta kombëtare.

Ndërsa duket se është një pikëpamje e përbashkët evropiane se, siç përcaktohet në parathënien e Konventës, “ historia evropiane ka treguar

se mbrojtja e pakicave kombëtare është thelbësore për stabilitetin, sigurinë demokratike dhe paqen në këtë kontinent” dhe se respektimi i tyre është kusht *sine qua non* për një shoqëri demokratike, nuk mund të thuhet se shtetet kontraktuese janë të detyruara nga ligji ndërkombëtar të miratojnë një koncept të veçantë të «pakicës kombëtare» në legjislacionin e tyre ose të prezantojnë një procedurë për njohjen zyrtare të grupeve minoritare.

Në Poloni, rregullat e zbatueshme për pakicat kombëtare ose etnike nuk gjenden në një dokument të vetëm, por ndahen midis një sërë instrumentesh, përfshirë Kushtetutën, Ligjin Zgjedhor dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Garancitë kushtetuese u jepen pakicave kombëtare dhe etnike. Kushtetuta nuk bën dallim midis pakicave kombëtare dhe etnike në lidhje me identitetet e tyre fetare, gjuhësore dhe kulturore, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, zakoneve, traditave dhe kulturës së tyre, ose krijimin e institucioneve arsimore dhe kulturore. Ndërsa Ligji Zgjedhor paraqet privilegje të veçanta vetëm në favor të “organizatave të regjistruara të pakicave kombëtare”, ai nuk jep asnjë indikacion për kriteret që duhet të përmbushë një “pakicë kombëtare” për të regjistruar organizatën e saj. Megjithatë, Gjykata konsideroi se mungesa e një përkufizimi të qartë të konceptit të “pakicës kombëtare” në legjislacionin e brendshëm, nuk do të thotë se shteti polak ka shkelur detyrën e tij për të hartuar ligjin në terma mjaft të saktë. As nuk gjeti ndonjë shkelje për faktin se shteti polak zgjodhi të njohë pakicat përmes marrëveshjeve dypalëshe me vendet fqinje dhe jo sipas një procedure të veçantë të brendshme. Gjykata pranoi se, për arsyet e shpjeguara më lart, në lidhje me çështjen në shqyrtim mund të jetë e vështirë të hartohen ligjet me një shkallë të lartë saktësie. Madje mund të jetë e padëshirueshme të formulohen rregulla të ngurta. Prandaj, shteti polak nuk mund të kritikohet për përdorimin e një kategorizimi të përgjithshëm ligjor të pakicave dhe për lënien e interpretimit dhe zbatimit të atyre nocioneve në praktikë.

Rrjedhimisht, Gjykata nuk konsideroi se lënia në diskrecion të autoriteteve për të përcaktuar kriteret e zbatueshme në lidhje me përkufizimin e “shoqatave të regjistruara të pakicave kombëtare” bazuar në nenin 5 të Ligjit të Zgjedhjeve të vitit 1993, nënkuptonte siç pretenduan kërkuesit, autoritet vlerësimi të pakufizuar dhe arbitrar. Sa i përket procedurës së regjistrimit, ishte e pashmangshme dhe në përputhje me

rolin gjykues që u ishte dhënë atyre që gjykatat kombëtare të liheshin me detyrën e interpretimit të nocionit të “pakicës kombëtare”, të dalluar nga “pakica etnike” në kuptimin e kushtetutës, dhe vlerësimin nëse shoqata e kërkuesve kualifikohet si një “organizatë e një pakice kombëtare”.

Në vlerësim të Gjykatës, në rishikimin e parimeve përkatëse, Gjykata e Supreme dhe Gjykata e Apelit morën parasysh të gjitha dispozitat ligjore të zbatueshme për shoqatat dhe pakicat kombëtare, si dhe faktorët socialë dhe faktorë të tjerë juridikë, përfshirë të gjitha pasojat juridike që mund të sjellë regjistrimi i shoqatës së kërkuesve në formën që ata propozuan.

Gjykata theksoi se, përkundër asaj që pretenduan kërkuesit, ato gjykata nuk duket se e kanë transformuar pa nevojë procedurën e regjistrimit në një mosmarrëveshje mbi konceptin e kombësisë silesiane. Përkundrazi, ishte deklarata në paragrafin 30 të memorandumit të shoqatës që bëri të nevojshme shqyrtimin e asaj çështjeje në procedurë. Kërkuesit duhet të kenë qenë të vetëdijshëm, kur u hartua ai paragraf, se gjykatat nuk do të kishin alternativë tjetër përveçse të interpretonin nocionin e “pakicës kombëtare” siç zbatohet në rastin e tyre.

Duke pasur parasysh vlerësimet më sipër, Gjykata ishte e bindur që ligji polak i zbatueshëm në rastin aktual është formuluar me një saktësi të mjaftueshme, për qëllimet e paragrafit 2 të nenit 11 të Konventës, për t’u mundësuar kërkuesve të rregullojnë sjelljen e tyre.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi, njëzëri, se nuk ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës.

2.2. STANKOV DHE ORGANIZATA E BASHKUAR MAQEDONASE ILINDEN kundër BULLGARISË

[29221/95 dhe 29225/95]

GJEDNJ [Seksioni i Parë]

2 tetor 2001

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: refuzimi për të regjistruar një shoqatë me pikëpamje separatiste. Ndërhyrja në të drejtën për tubim paqësor. Mohimi i të drejtave kolektive të një pakice etnike.

Faktet kryesore

Organizata e Bashkuar Maqedonase Ilinden (kërkuesi) është një shoqatë që vepron në jug-perëndim të Bullgarisë (në një zonë të njohur me emrin Pirin ose si rajoni gjeografik i Pirin Makedonia). Kryetar i saj për një periudhë të pasaktësuar ka qenë Iordan Kostadinov Ivanov (kërkuesi), shtetas bullgar që jeton në Sandanski, Bullgari. Kërkuesi tjetër quhet Boris Stankov, një shtetas bullgar i lindur më 1926, i cili jeton në Petrich, Bullgari. Në kohën e zhvillimit të ngjarjeve të çështjes, ai ishte kryetari i një dege të shoqatës, në këtë rast kërkueses

Shoqata ishte themeluar më 1990 me qëllimin për të bashkuar maqedonasit në Bullgari mbi baza rajonale dhe kulturore dhe për të arritur njohjen e minoritetit maqedonas në Bullgari. Më 1991 shoqatës iu refuzua regjistrimi përderisa gjykatat konstatuan se qëllimet e saj reale ishin të drejtuara kundër unitetit të kombit, se ajo nxiste urrejtjen etnike dhe përbënte rrezik për tërësinë territoriale të Bullgarisë.

Çështja e paraqitur para Gjykatës ishte e kufizuar në ngjarjet dhe zhvillimet në periudhën ndërmjet viteve 1994 dhe 1997, kur autoritetet ndaluan mbajtjen e tubimeve përkujtimore të organizuara nga shoqata dhe z. Stankov, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend me zhvillimin e ceremonive zyrtare.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit parashtruan se ndalimi i takimeve të organizuara prej tyre në përkujtim të ngjarjeve të caktuara historike dhe qëndrimi i autoriteteve në kohën përkatëse kishin për qëllim shtypjen e shprehjes së lirë të ideve në tubimet paqësore. Si të tilla ato përbënin ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas nenit 11 të Konventës, parë në këtë sfond si *lex specialis*, në lidhje me nenin 10 të Konventës.

Ata pretenduan se ndërhyrja nuk ishte “e përcaktuar me ligj” pasi mungesa e regjistrimit të shoqatës së tyre (e cila ishte mbështetur nga kryetarët e bashkive), nuk ishte ndër arsyet që justifikonte ndalimin e protestave sipas nenit 12 të Aktit të Takimeve dhe Marshimeve.

Për më tepër, kërkuesit konsideruan si të pabazë pohimin e Qeverisë se tubimet e organizuara prej tyre paraqitnin kërcënim. Sipas kërkuesve, protestimet ishin krejtësisht paqësore; qëllimi i tyre ishte të përkujtonin ngjarjet historike të konsideruara si pjesë e rëndësishme e historisë së popullit maqedonas. Tubimet, të cilat normalisht zgjatnin rreth tre orë, kishin filluar gjithmonë me leximin e teksteve dhe kishin vazhduar me poezi, muzikë dhe këngë.

Qëllimi i autoriteteve - sipas kërkuesve - kishte qenë të shtypte përhapjen e idesë se një pakicë maqedonase ekzistonte në Bullgari. Mund të ketë qenë e vërtetë që shumica e popullsisë bullgare konsideronte se nuk kishte pakicë maqedonase në vendin e tyre dhe se demonstrimi i ideve të kërkuesve mund të trondiste dhe të dukej ofendues për atë shumicë. Sidoqoftë, ishte thelbësore, në një shoqëri demokratike pluraliste, të lejohej shprehja e lirë e ideve të pakicave dhe ishte detyrë e autoriteteve t’u garantonin kërkuesve të drejtën për të protestuar në mënyrë paqësore.

Ata më tej pohuan se ndalimet e tubimeve për të cilat ankoheshin, megjithëse të kufizuara në vende të caktuara historike dhe në data të veçanta, përbënin në realitet një ndalim të përgjithshëm të takimeve të shoqatës, pasi asnjë takim i vetëm i organizuar nga ajo nuk ishte autorizuar. Një ndalim i tillë sipas kërkuesve ishte joproporcional.

Asgjë në materialin e paraqitur nga Qeveria nuk mund të çonte në përfundimin se ata po kërkonin shkëputjen nga Bullgaria. Edhe nëse kishte ndonjë dyshim në këtë drejtim, një ndalim total i përkujtimeve ishte një reagim disproporcional.

Në anën tjetër, Qeveria ngriti pretendimet në lidhje me synimin e kërkuesve për të mbajtur protesta “paqësore”, pasi dyshohej se kishte prova që disa nga anëtarët e organizatës ishin të armatosur. Në këtë drejtim, Qeveria iu referua dy dokumenteve që kishte dorëzuar. Ajo gjithashtu iu referua provave që pretendohet se demonstrojnë se, që nga viti 1990 takimet e Ilindenit ishin shënuar gjithmonë me konflikte dhe përplasje, verbale dhe fizike, midis mbështetësve të shoqatës dhe të tjerëve. Kjo ishte e pashmangshme për shkak të deklaratave provokuese antibullgare të bëra në ato takime dhe gjuhës ofenduese të përdorur.

Më tej, Qeveria pretendoi se anëtarët e shoqatës nuk ishin penguar kurrë të vizitonin vendet historike në fjalë me kusht që ata të mos mbanin postera ose materiale të tjera që përmbajnë kërcënime kundër unitetit të kombit, integritetit territorial të vendit ose të drejtave të tjerëve. Liria e tubimit të tyre ishte kështu e paprekur. Nëse konsiderohej se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtat e kërkuesve sipas nenit 11 të Konventës, kjo ndërhyrje kishte qenë e ligjshme dhe ishte bazuar në dispozita të qarta të Kushtetutës dhe Aktit të Takimeve dhe Marshimeve.

Qeveria kundërshtoi pretendimin e kërkuesve se arsyet e ndalimeve kishin ndryshuar vazhdimisht - duke pretenduar kështu mungesën e një baze të qartë ligjore. Sipas Qeverisë, arsyet për të gjitha ndalimet ishin aktivitetet dhe deklaratat antikushtetuese të shoqatës kërkuese (të cilat kërcënonin integritetin territorial të vendit dhe sigurinë kombëtare) dhe shtimi i rrezikut të incidenteve që rrezikonin rendin publik.

Duke iu referuar vendimeve të Gjykatës Supreme të viteve 1990 dhe 1991 dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 29 shkurtit 2000, Qeveria theksoi se shoqata kërkuese ishte shpërndarë pasi ishte vërtetuar se aktivitetet e saj kërcënonin integritetin territorial të vendit dhe kishin qenë antikushtetuese. «Informacioni i besueshëm» se një tubim drejtohej kundër integritetit territorial të vendit ishte një bazë e vlefshme për ndalimin e një tubimi të tillë, sipas nenit 12 (2) të Aktit të Takimeve dhe

Marshimeve. Sipas autoriteteve, vendimet e tyre që ndalonin takimet, me faktin se shoqatës i ishte refuzuar regjistrimi, ishin në përputhje me ligjin, duke qenë se sipas autoriteteve, masat të cilat u ndërmorën e për të cilat u ankuan kërkuesit ndoqën një numër qëllimesh legjitime: mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe integritetit territorial, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, garantimin e rendit publik në bashkësinë lokale dhe parandalimin e çrregullimeve dhe krimeve.

Sipas pikëpamjes së Qeverisë, shoqata kërkuese Ilinden cenoi të drejtat dhe liritë e të tjerëve sepse aspironte të krijonte një komb maqedonas midis njerëzve që i përkisnin kombit bullgar dhe kërkoi imponimin e një identiteti dhe institucioneve maqedonase në rajonin e Pirinit duke përjashtuar të gjitha institucionet bullgare. Një pjesë e vogël e mbështetësve të atyre ideve - rreth 3,000 në një rajon me një popullsi prej rreth 360,000 - kishin marrë të drejtën për të folur për të gjithë njerëzit. Qeveria pretendoi se, shoqata e kërkuesve ishte një grup separatist i cili kërkonte shpërnguljen e rajonit të Pirinit nga Bullgaria. Ai paraqiste një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare dhe integritetin territorial të vendit. Duke iu referuar kontekstit historik dhe aktual të Bullgarisë dhe Ballkanit, Qeveria parashtroi se këmbëngulja e shoqatës kërkuese për diferencimin dhe “të drejtat kolektive”, pavarësisht faktit se çdo person në Bullgari gëzonte plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë, përfshirë të drejtat kulturore dhe politike, zbuluan se qëllimi i tyre i vërtetë ishte që popullatës bullgare t’i imponohej një identitet i huaj kombëtar. Sipas Qeverisë - mjetet propagandistike të përdorura nga Ilindenit, nuk kishin për qëllim mbrojtjen e të drejtave të një pakice të tillë, por konvertimin e popullsisë bullgare në maqedonase dhe, më pas, ndarjen e rajonit nga vendi.

Në kontekstin e kalimit të vështirë nga regjimet totalitare në demokraci, dhe për shkak të krizës ekonomike dhe politike, tensionet midis komuniteteve bashkëjetuese, ku ato ekzistonin në rajon, ishin veçanërisht shpërthyes. Ngjarjet në ish-Jugosllavi ishin një shembull. Propaganda e separatizmit në kushte të tilla, me të drejtë, ishte parë nga autoritetet si një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe paqen në rajon. Për më tepër, autoritetet kombëtare ishin të vendosura më mirë për të vlerësuar ato rreziqe. Autoritetet kishin miratuar kështu praktikën e moslejimit të takimeve të Ilindenit në të njëjtën kohë dhe vend me festimet zyrtare.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 11, duke pasur parasysh që neni 11 i Konventës ishte i zbatueshëm në këtë rast, që kishte në mënyrë të qartë një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për tubim paqësor, ndërhyrje e cila ishte e parashikuar nga ligji dhe ndiqte një qëllim legjitim, Gjykata u përqendrua në faktin nëse ndërhyrja ishte apo jo e nevojshme në një shoqëri demokratike për arritjen e qëllimit legjitim.

Gjykata vuri në dukje se shoqatës kërkuese i ishte refuzuar regjistrimi më 1990 dhe 1991 me arsyetimin se ishte antikushtetuese. Gjykata vlerësoi se, edhe pse vlerësimet e gjykatave ishin pa dyshim të rëndësishme, një referencë e menjëhershme vetëm në faktin se organizata ishte konsideruar antikushtetuese - dhe për këtë arsye i ishte refuzuar regjistrimi, nuk ishte e mjaftueshme për të arsyetuar në bazë të nenit 11 paragrafit 2 të Konventës një praktikë të ndalimit të vazhdueshëm të mbajtjes së tubimeve paqësore. Për këtë arsye, Gjykata shkoi më tej për të vlerësuar kriteret e veçanta të referuara nga autoritetet për të arsyetuar ndalimet dhe kuptimin e ndërhyrjes ndaj lirisë së kërkuesve për tubim.

Gjykata vlerësoi se në qoftë se do të kishte pasur përgatitje për veprime të armatosura, siç u pretendua nga ana e Qeverisë, kjo e fundit duhet të kishte qenë në gjendje të sillte para saj prova shumë më bindëse se sa një artikull gazete dhe një kopje të një fletushke të shpërndarë nga ajri. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se asnjë shqetësim serioz nuk kishte ndodhur gjatë takimeve të mëparshme në të cilat kishin marrë pjesë kërkuesit dhe se askush nuk ishte ndjekur penalisht në vijim të tyre. Rreziku i incidenteve të vogla nga ana tjetër nuk e justifikonte ndalimin e plotë të tubimit.

Gjykata konstatoi se autoritetet kishin pasur mundësi që të parandalonin parullat separatiste, që bënë thirrje për autonomi të rajonit të Pirin Maqedonisë, ose edhe për shkëputje nga Bullgaria, në qoftë se të tilla do të ishin menduar të hidheshin nga disa prej pjesëmarrësve. Megjithatë, fakti që një grup bëri thirrje për autonomi ose qoftë edhe për shkëputje të një pjese të territorit të vendit - duke kërkuar pra ndryshime thelbësore kushtetuese dhe territoriale - nuk

mund të justifikonte në vetvete ndalimin e tubimeve të grupit. Thirrjet për ndryshime territoriale në fjalime dhe demonstrata nuk përbënin në vetvete një kërcënim për tërësinë territoriale dhe sigurinë kombëtare. Thelbi i demokracisë është aftësia e saj për t'i zgjidhur problemet me anë të një debati të hapur. Vendosja e ndalimeve ndaj lirisë së shprehjes dhe tubimit, përveç rasteve të nxitjes së dhunës ose mohimit të parimeve të demokracisë, përbënte një shkelje të demokracisë dhe madje shpesh e vinte atë në rrezik. Në një shoqëri demokratike të bazuar në parimin e shtetit të së drejtës, ideve politike që bëjnë të ndryshojë rendi ekzistues dhe realizimi i së cilave synohet të bëhet me mjete demokratike duhet t'u lejohet një mundësi shprehjeje nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së tubimit si dhe me anë të mjeteve të tjera. Gjykata përfundoi me vlerësimin se mundësia e bërjes së deklaratave separatiste nuk justifikonte ndalimin e tubimeve të shoqatës Ilinden.

Duke analizuar të gjitha provat përpara saj, Gjykata nuk gjeti ndonjë të dhënë që takimet paraqitnin një platformë për propagandimin e dhunës ose rrëzimin e demokracisë në një masë të tillë që të kërkohej ndalimi i tyre. Pjesa më e madhe e deklaratave të Ilindenit vinin në dukje bazueshmërinë në debatin publik dhe presionin politik dhe hidhnin poshtë shprehimisht dhunën. Deklaratat e shkëputura që dukej se bënin thirrje për dhunë, përmbanin një element ekzagjerimi përderisa kërkonin thjesht të tërhiqnin vëmendjen dhe në çdo rast ato mund të trajtoheshin me një ndjekje penale të personave përgjegjës.

Duke pasur parasysh që takimet e Ilindenit krijuan njëfarë tensioni për shkak se heronj kombëtarë bullgarë u konsideruan si martirë maqedonas, Gjykata konstatoi se fakti që ngjarjet preknin simbole dhe identitetin kombëtar nuk mund të shihej në vetvete si një faktor që justifikonte lënien e një hapësire më të madhe vlerësimi autoriteteve shtetërore. Këto të fundit duhej të bënin kujdes të veçantë që të siguronin që opinionin publik kombëtar të mos mbrohej në kurriz të pikëpamjeve të pakicave pavarësisht se sa jopopullore ato mund të jenë (kërkuesit kishin vetëm afro 3000 mbështetës).

Në vijim, Gjykata vuri në dukje se vendi i tubimeve kishte qenë me rëndësi themelore për kërkuesit si dhe për personat e tjerë që kishin marrë pjesë në ceremonitë zyrtare dhe se nuk arriti të tregohej para saj

se takimet përkujtimore të kërkuesve nuk mund të ishin zhvilluar në mënyrë paqësore, qoftë në të njëjtën kohë, qoftë pak kohë më vonë.

Si përfundim, Gjykata konstatoi se, përderisa nuk kishte rrezik real dhe të parashikueshëm për veprime të dhunshme, për thirrje për dhunë ose për mosrespektim të parimeve të demokracisë, ndalimi i tubimeve të kërkuesve nuk ishte i justifikueshëm në bazë të paragrafit 2 të nenit 11.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti që ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës. Gjykata u akordoi secilit prej kërkuesve 40 000 (dyzet mijë) Franga franceze për dëm jomaterial dhe 36,127 (tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) Franga franceze për shpenzime dhe pagesa ligjore.

2.3. VALKOV DHE TË TJERËT kundër BULLGARISË

[2033/04, 19125/04, 19475/04, 19490/04, 19495/04, 19497/04, 24729/04, 171/05 dhe 2041/05]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

8 mars 2012

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *kufizimi i pensioneve me efekt të uljes së konsiderueshme të tyre, ndikimi në të drejtën e pronës, sigurimet shoqërore, kuptimi i 'pasurisë', margjina e vlerësimit.*

Faktet kryesore

Çështja u ngrit në nëntë kërkesa (kërkesat u bashkuan) nga nëntë shtetas bullgarë, Valko Stanilov Valkov, Vasil Kirilov Galabov, Atanas Vladimirov Gonevski, Ivan Zahariev Slavkov, Boyko Dimitrov Sodev, Vaço Dimitrov Baev, Georgi Sotirov Atanasov, Stoyan Hristov Stoyanov, dhe Lali Nanev Avreiski (kërkuesit), respektivisht më 6 janar, 14 maj, 29 qershor dhe 7 dhjetor 2004. Kërkuesit janë të gjithë pensionistë që kanë dalë në pension në data të ndryshme midis viteve 1979 dhe 2002. Sa herë që shuma nominale mujore e pensioneve të tyre tejkalonte

shumën maksimale të pensionit të përcaktuar deri në fund të vitit 1999 në nenin 47c të Ligjit për Pensionet të vitit 1957 (dhe që nga fillimi i vitit 2000 në paragrafin 6 të dispozitave të përkohshme dhe përmbyllëse të Kodit të Sigurimeve Shoqërore 1999), pensionet e tyre ishin kufizuar.

Në praktikë, kjo funksionoi si në vijim: në vendimet individuale në lidhje me secilin prej kërkuesve, Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore (në tekstin e mëtejshëm: “NSSI”) llogariti pensionet e tyre mujore sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara së pari në Ligj dhe më pas në Kod, dhe më pas i kufizoi pensionet duke iu referuar dispozitave të lartpërmendura. Sa herë që pensionet përditësoheshin ose rillogariteshin, i njëjti proces përsëritej.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretenduan se ata kishin një pritje legjitime që do të merrnin shumën e plotë të pensioneve të tyre, bazuar në kontributet që u ishte kërkuar të jepnin gjatë gjithë punësimit të tyre. Pas hyrjes në fuqi të paragrafit 6 (1) të dispozitave kalimtare dhe përmbyllëse të Kodit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 1999, ata kishin pritur që kufiri mbi shumën maksimale të pensionit të hiqej më 31 dhjetor 2003 dhe që nga ajo datë ata të do të merrnin shumën e plotë të pensioneve të tyre. Shtyrja pasuese e heqjes së kufirit (kufizues) ishte kështu një ndërhyrje në të drejtën e tyre të pronës.

Kërkuesit nuk kundërshtuan se kjo ndërhyrje ishte e paligjshme, por argumentuan se asaj i mungonte një bazë e arsyeshme. Ishte e vërtetë që Gjykata Kushtetuese kishte vendosur se vendosja e një kufiri pensionesh ishte një çështje që kishte të drejtë ta bënte legjislativi. Sidoqoftë, projektligji i vitit 2004 për ndryshimin e Kodit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 1999, i cili kishte kufizuar përgjithmonë pensionet e të gjithë pensionistëve, të drejtat e të cilëve ishin grumbulluar para 31 dhjetorit 2009, nuk ishte shoqëruar me ndonjë shënim shpjegues ose nga ndonjë debat në Parlament. E njëjta vlen edhe për ndryshimet e Kodit të vitit 2009.

Sipas kërkuesve, edhe nëse mund të pranohej që kufiri i pensioneve ndiqte një qëllim legjitim, ai ishte jo proporcional. Kjo sepse, ai nuk arriti

të prodhonte kursime të konsiderueshme për sistemin e pensioneve, dhe preku një pakicë shumë të vogël pensionistësh (rreth 2%) duke ulur ndjeshëm shumën e pensioneve të tyre. Për më tepër, kur u kufizuan përgjithmonë pensionet e kërkuesve, në fuqi nga 1 janari 2004, shteti nuk u kishte ofruar asnjë formë kompensimi.

Nga ana tjetër, Qeveria (e Bullgarisë) argumentoi para Gjykatës se kufiri mbi shumën maksimale të pensionit ishte nxitur nga konsiderata financiare, konkretisht nga situata ekonomike momentale. Pensionet në Bullgari bazoheshin në parimin e solidaritetit social, i cili kërkonte që të gjithë ata që kishin mbushur një moshë të caktuar të gëzonin të drejtën në pension, por edhe që kontributi personal i secilit individ të merret parasysh në përcaktimin e shumës së pensionit.

Qeveria në parashtrimet e saj ishte dakord që të drejtat e sigurimeve shoqërore ishin brenda fushës së nenit 1 të Protokollit nr. 1, por vuri në dukje se kjo dispozitë nuk garantonte një shumë të caktuar pensioni dhe nuk kërkonte nga shtetet që të zgjidhnin një model të veçantë të sigurimeve shoqërore. Edhe nëse ishte teorikisht e mundur të paguheshin kërkuesit në shumën e plotë nominale të pensioneve të tyre, ekzistonin një numër faktorësh që do ta bënin të vështirë arritjen në praktikë. Popullsia po plakej dhe raporti midis pensionistëve dhe personave në punë aktive po përkeqësohej. Nëse autoritetet vendosin të paguajnë shumën e plotë të pensionit, edhe nëse tejkalon kufirin, kjo mund të rezultojë në një mungesë fondesh për të paguar pensionet e të tjerëve që kishin kontribuar më pak në financimin e sistemit të pensioneve. Kjo mund të çonte në një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, i cili garanton një të ardhur minimale për secilin pensionist. Aq më tepër në mes të një krize të rëndë ekonomike dhe demografike. Sipas Qeverisë, kërkuesit nuk mund të pohojnë se ata kishin një pritje legjitime që ata do të merrnin shumën e plotë të pensioneve të tyre pas 31 dhjetorit 2003, sepse ishte e pamundur të parashikohej se si do të evoluonte legjislacioni në të ardhmen. Legjislacioni ishte produkt i zhvillimeve shoqërore, të cilat po ndryshonin me shpejtësi. Kërkuesit duhej të tregonin se kufiri mbi pensionet e tyre kishte rezultuar në një barrë individuale dhe të tepruar.

Sipas pikëpamjes së Qeverisë, kufizimi i pensioneve në 35% të të ardhurave maksimale mujore për qëllime të sigurimeve shoqërore ishte

në interesin publik. Sistemi i pensioneve në Bullgari ishte i bazuar në modelin e pagës dhe qëllimi i ligjvënësit ishte të garantonte një shumë minimale pensioni dhe potencialin për rritjen e tij.

Në argumentet e tyre shtesë, Qeveria parashtroi se për aq sa neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk garantonte një shumë të caktuar pensioni, ankesa e kërkuësve ishte e papajtueshme *ratione materiae*. Ishte në diskrecionin e ligjvënësit për të zgjedhur një model të veçantë të sigurimeve shoqërore. Përballë vështirësive demografike dhe financiare, Bullgaria kishte zgjedhur të kufizonte shumën maksimale të pensionit të nivelit të parë. Megjithatë, ajo kishte parashikuar një pension vullnetar të nivelit të tretë dhe nuk kishte asnjë indikacion se kërkuësit ishin përpjekur të përfitonin nga ajo mundësi. Ishte gjithashtu e rëndësishme të theksohet se kufiri i pensioneve të tyre ishte rritur disa herë dhe se disa prej tyre që kishin shërbyer në forcat e armatosura nuk kishin paguar vetë kontributet e pensionit dhe ishin pensionuar në kushte shumë të favorshme. Prandaj, bilanci i drejtë i kërkuar nuk ishte prishur në dëm të tyre.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata vuri në dukje se parimet që zbatohen përgjithësisht në rastet sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 janë njësoj të rëndësishme kur bëhet fjalë për pensionet (shih *Andrejeva kundër Letonisë* [DHM], nr. 55707/00, paragrafi 77, 18 shkurt 2009). Kështu, kjo dispozitë nuk garanton të drejtën për të fituar pronë (shih, midis autoriteteve të tjera, *Van der Mussel kundër Belgjikës*, 23 nëntor 1983, paragrafi 48, Seria A nr. 70; *Slivenko kundër Letonisë* (Vendim.) [DHM], nr. 48321/99, paragrafi 121, GJEDNJ 2002-II dhe *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], nr. 44912/98, paragrafi 35 (b), GJEDNJ 2004-IX). As nuk garanton, si të tillë, ndonjë të drejtë për një pension të një shume të caktuar (shih, ndër autoritetet e tjera, *Müller kundër Austrisë*, nr. 5849/72, raport i Komisionit i 1 tetorit 1975, Vendimet dhe Raportet (DR) 3, fq. 25, *T. kundër Suedisë*, nr. 10671/83, vendim i Komisionit i 4 marsit 1985, (DR) 42, f. 229; *Kuna kundër Gjermanisë* (Vendim.), nr. 52449/99, KEDNJ 2001-V (ekstrakte); *Lenz kundër Gjermanisë* (Vendim), nr. 40862/98, KEDNJ 2001-X; *Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, nr. 60669/00, paragrafi 39, GJEDNJ 2004-IX; *Apostolakis kundër Greqisë*, nr. 39574/07, paragrafi 36, 22 tetor 2009; *Wieczorek kundër Polonisë*, nr. 18176/05,

paragrafi 520, 8 dhjetor 2009; *Poulain kundër Francës* (Vendim), nr. 52273/08, 8 shkurt 2011; dhe *Maggio dhe të tjerët*, paragrafi 55).

Megjithatë, kur një shtet kontraktues ka në fuqi legjislacion që parashikon pagesën si të drejtë të një pensioni – pavarësisht nëse kushtëzohet apo jo me pagesën paraprake të kontributeve – ky legjislacion duhet të konsiderohet se gjeneron një interes pronësor që bie në kuadrin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 për personat që plotësojnë kërkesat e tij (shih *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 42184/05, paragrafi 64, GJEDNJ 2010). Ulja ose ndërprerja e një pensioni mund të përbëjë, për rrjedhojë, ndërhyrje në pronë që duhet të justifikohet (shih *Kjartan Ásmundsson*, cituar më lart, paragrafi 40; *Rasmussen kundër Polonisë*, nr. 38886/05, paragrafi 71, 28 prill 2009; dhe *Wieczorek*, paragrafi 57).

Në rastin konkret, pensionet e kërkuarve u llogaritën së pari në përputhje me rregullat e përgjithshme të Ligjit të Pensioneve të vitit 1957 dhe, më pas të Kodit të Sigurimeve Shoqërore 1999 (në rastet e atyre kërkuarve që dolën në pension pas 1 janarit 2000). Për shkak se shumata e dala nga ato llogaritje ishin, në rastin e secilit kërkuar, mbi kufirin e pensioneve të përcaktuar në nenin 47c të Aktit dhe, më vonë, në paragrafin 6 (1) të dispozitave kalimtare dhe përmbyllëse të Kodit, pensionet e tyre u shkurttoheshin në nivelin e lejuar nga kufiri. Kufiri në këtë mënyrë mund të konsiderohet ose si një dispozitë që kufizon shumën e pensionit pasi të jetë llogaritur sipas rregullave të përgjithshme, dhe kështu të jetë një ndërhyrje në një “pronë” të kërkuarve, ose si pjesë e grupit të përgjithshëm të dispozitave ligjore që rregullon mënyrën në të cilën shumata e pensionit duhet të llogaritet, dhe kështu përbën një rregull që i afekton kërkuarët të kenë ndonjë “pronë” në lidhje me tepricën.

Gjykata nuk konsideroi se kufiri ishte një “privim i pronës” brenda kuptimit të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Ajo më tepër duhet të konsiderohet si një ndërhyrje ndaj ‘të drejtës për gëzimin paqësor të pasurisë’ së kërkuarve, brenda kuptimit të fjalisë së parë të paragrafit të parë. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, autoritetet kombëtare, për shkak të njohurive të tyre të drejtpërdrejta për shoqërinë dhe nevojat e saj, janë në parim më mirë të vendosura se gjyqtari ndërkombëtar për të vendosur se çfarë është “në interesin publik”.

Në rastin konkret, kërkuesit vunë në dyshim qëllimin e kufirit, duke thënë se nuk ishte, siç pretendohet nga Qeveria, bazuar në konsideratat që kishin të bënin me qëndrueshmërinë financiare të sistemit të pensioneve. Ishte më tepër një rezultat i perceptimeve se publiku nuk do të toleronte pensione shumë të larta dhe se Ligji i Pensioneve i vitit 1957 kishte bërë të mundur daljen në pension me kushte tepër bujare. Gjykata, nga ana e saj, vërejti se kufiri padyshim rezultoi në kursime për sistemin e pensioneve. Sidoqoftë, nuk e konsideroi të nevojshme të përcaktohet nëse ato kursime ishin vërtet të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të sistemit. Ajo vërejti se duke respektuar kufirin, Gjykata Kushtetuese mori mendimin se ajo bazohet në “kërkesat e drejtësisë sociale”. Edhe duke supozuar se pohimet e kërkuesve për qëllimin e vërtetë të kufirit janë të sakta, Gjykata nuk konsideroi se ishte e paligjshme që legjislatura bullgare të kishte parasysh konsideratat shoqërore, ose se gjykimi i saj në atë drejtim ishte haptazi pa bazë të arsyeshme.

Në vlerësim të asaj se a ka pasur një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet për t’u realizuar, Gjykata vuri në dukje se funksioni i rishpërndarjes së sistemit të pensioneve mund të arrihet në mënyra të ndryshme, të tilla si vendosja e formulave të llogaritjes së përfitimeve progresive, vendosja e kufijve për të drejtat e pensionit ose taksimi i pensioneve të larta. Në Bullgari, ligjvënësi ka zgjedhur të përjashtojë pensionet e nivelit të parë dhe të dytë nga taksimi, por ka vendosur një kufi mbi shumën maksimale të pensionit sipas nivelit të parë. Gjykata theksoi se ajo nuk ishte në gjendje të konstatojë se kjo ishte në vetvete një masë disproporcionale.

Argumenti kryesor i kërkuesit kundër kufirit (ceiling) ishte se, ndryshe nga punëtorët e ditëve të sotme, në lidhje me të cilët ekziston një kufi mbi të ardhurat e pensionit, ata ishin të detyruar të paguajnë kontribute relativisht të larta në shumën e plotë në pagat e tyre; prandaj ata kishin të drejtë për pensione në përpjesëtim me ato kontribute. Sidoqoftë, ky argument nuk qëndron në shqyrtim. Në radhë të parë, nuk mund të anashkalohej fakti se deri në vitin 1996, kontributet paguheshin vetëm nga punëdhënësit, të cilëve u ndalohej zbritja e tyre nga shpërblimet e punonjësve; që vazhdon të jetë rasti për personelin ushtarak, nëpunësit

civilë dhe disa kategori të tjera të punonjësve të shtetit. Ndryshe nga skemat e nivelit të dytë dhe të tretë, ku kontributet lidhen drejtpërdrejt me kthimin e pritshëm të përfitimeve, kontributet e nivelit të parë nuk kishin dhe ende nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me kontributet e daljes në pension.

Së dyti, Gjykata u shpreh se nuk mund të anashkalonte faktin se kufiri i pensioneve u vendos dhe, më e rëndësishmja, u mbajt në një kohë kur sistemi bullgar i pensioneve po kalonte nëpër një reformë gjithëpërfshirëse. Ishte e qartë se modeli i ri i pensioneve në Bullgari parashikonte sigurimin e të ardhurave më të larta të pensionit përmes skemave të pensionit të nivelit të dytë dhe të tretë, të cilat, ndryshe nga skema e nivelit të parë, financohen, bazuar në skema kontributesh të përcaktuara. Në atë kontekst, kufiri, si dhe vazhdimet e tij deri në fund të vitit 2009, dhe pastaj në fund të 2011 dhe 2013, mund të shihen si një masë kalimtare që shoqëron transformimin e përgjithshëm të sistemit të pensioneve.

Së treti, theks i veçantë duhet vënë në faktin se kërkuesit ishin të detyruar të pësonin një reduktim të arsyeshëm dhe proporcional dhe jo një humbje totale të të drejtave të tyre të pensionit. Në të vërtetë, ata nuk pësuan një rënie aktuale të pagesave mujore që merrnin, por thjesht ata nuk panë që heqja e shpallur e kufirit të pensioneve, të materializohej. Kërkuesit janë fituesit më të mëdhenj në mesin e më shumë se dy milionë personave në Bullgari, të cilët aktualisht janë duke marrë një pension. Prandaj, në qëndrimin e Gjykatës, ata vështirë se mund të konsideroheshin si të ngarkuar me një barrë të tepruar dhe joproporcionale, ose se kanë pësuar një dëmtim të thelbit të të drejtave të tyre të pensionit.

Së katërti, nuk mund të anashkalohej fakti që skemat e pensioneve publike bazohen në parimin e solidaritetit midis kontribuuesve dhe përfituesve (shih *Ackermann dhe Fuhrmann kundër Gjermanisë* (Vendim), nr. 71477/01, 8 shtator 2005). Ashtu si skemat e tjera të sigurimeve shoqërore, ato janë një shprehje e solidaritetit të një shoqërie me anëtarët e saj të cënueshëm (shih *Goudswaard Van der Lans*, dhe *Wieczorek*, paragrafi 64, të dyja të cituara në vendim), dhe nuk mund të krahasohen me skemat e sigurimeve private (shih

Müller, cituar në vendim). Në të vërtetë, siç është vërejtur, sistemet e pensioneve të vendeve të ndryshme ndryshojnë në theksin relativ që ata vënë në rishpërndarjen kundrejt elementëve të sigurimit. Së fundmi, Gjykata arsyetoi se nuk mund të anashkalohej se shuma e kufirit dhe mënyra në të cilën llogaritej, kishin evoluar me kalimin e viteve. Duke pasur parasysh këto konsiderata, Gjykata arriti në përfundimin se kufiri i kundërshtuar mbi shumën maksimale të pensionit bie brenda hapësirës së vlerësimit të Bullgarisë, në rregullimin e politikës së saj të sigurimeve shoqërore. Prandaj, Gjykata arriti në përfundim se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesve për shkelje të nenit 14, sipas vlerësimit të Gjykatës, neni 14 plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe të Protokolleve. Ai nuk ka ekzistencë të pavarur, pasi ka efekt vetëm në lidhje me “gëzimin e të drejtave dhe lirive” të mbrojtura nga ato dispozita. Sidoqoftë, zbatimi i tij nuk nënkupton domosdoshmërisht shkeljen e një prej të drejtave thelbësore të garantuara me Konventë. Ndalimi i diskriminimit në nenin 14 shtrihet përtej gëzimit të të drejtave dhe lirive që Konventa dhe Protokollat e saj kërkojnë që secili shtet të garantojë. Zbatohet edhe për ato të drejta shtesë, që bien brenda fushës së përgjithshme të çdo neni të Konventës, për të cilat shteti ka vendosur vullnetarisht t’i sigurojë. Është e nevojshme, por edhe e mjaftueshme, që faktet e çështjes të bien «brenda kufijve» të një ose më shumë prej neneve të Konventës (shih *Carson dhe të tjerët*, dhe *Stummer*). Në përputhje me qasjen e saj sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, të marrë vetëm, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të përcaktojë nëse faktet e çështjes bien brenda fushës së asaj dispozite. Edhe duke supozuar se neni 14 është i zbatueshëm, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të asaj dispozite.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi, se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe, se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1.

2.4. MOLLA SALI kundër GREQISË

[20452/14]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

18 qershor 2020

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: privimi/përjashtimi i kërkueses nga pjesa më e madhe e trashëgimisë së burrit të saj të ndjerë për shkak të zbatimit të ligjit të Sheriatit, edhe pse ai kishte zgjedhur t'i linte asaj pronën e tij, sipas ligjit të zakonshëm.

Faktet kryesore

Rasti ishte paraqitur më 5 mars 2014 nga znj. Chatitze Molla Sali (kërkuësja), një shtetase greke, kundër Republikës Greke. Kërkesa e saj kishte të bënte me aspektin ligjor të trashëgimisë së lënë nga bashkëshorti i ndjerë. Kërkuësja dhe bashkëshorti i saj (i ndjerë) ishin pjesëtarë të komunitetit të pakicës myslimane. Në shkurt 2008, para vdekjes, i ndjeri, Mustafa Molla Sali, kishte vizituar një noter dhe kishte hartuar një testament në përputhje me Kodin Civil Grek. Ai i kishte lënë të gjitha pronat e tij gruas së tij, znj. Chatitze Molla Sali. Veprimi tij (testamenti), praktikisht, rezultoi në përjashtimin e pjesës tjetër të familjes së tij nga prona e tij dhe veçanërisht dy motrave të tij. Në qershor 2008, testamenti ishte hapur dhe miratuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Komotinit. Në prill 2010, kërkuësja vazhdoi me pranimin formal të trashëgimisë, ndërsa ndërmoi të gjitha hapat e nevojshëm për të regjistruar pronën në Regjistër të Pronës.

Ndërkohë, në dhjetor 2009, dy motrat e të ndjerit kishin filluar procedurat ligjore me qëllim që të kundërshtonin vlefshmërinë e testamentit të hartuar nga vëllai i tyre. Konkretisht, ato argumentuan në procedurat gjyqësore kombëtare se ato dhe vëllai i tyre i vdekur i përkisnin pakicës myslimane të Trakisë Perëndimore dhe se, për shkak të obligimeve detyruese ndërkombëtare, përkatësisht nga Traktati i Sevrës (1920) dhe Traktati i Lozanës (1923), ligji Islamik ishte ligji i zbatueshëm për marrëdhënie të caktuara të shtetasve grekë me besim mysliman. Prandaj ato pretenduan se çdo aspekt i vazhdimësisë

së të drejtave pronësore të të ndjerit duhet të kishte ndodhur sipas ligjit islam të trashëgimisë në vend të rregullave të Kodit Civil dhe se, rrjedhimisht, ato duhet të kishin trashëguar tre të katërtat e pasurisë. Gjykata e Shkallës së Parë në Rodop dhe Gjykata e Apelit e Trakisë ku ishin zhvilluar procedurat e rregullta theksuan se nuk ishte ligjërishit e mundur të shfuqizohej një testament i tillë pa shkaktuar një trajtim diskriminues. Gjykata e Apelit, veçanërisht, nënvizoi ndër të tjera se trashëgimlënësi nuk ishte i detyruar të respektonte ligjin fetar. Kjo ndodhi sepse një qytetar grek me besim mysliman ishte i lirë të zgjidhte llojin e testamentit me të cilin ai/ajo dëshiron të përcaktojë fatin e pronës së tij/saj *post mortem*, duke ushtruar një të drejtë në të njëjtën pozitë ligjore si të gjithë shtetasit grekë.

Në janar 2012, motrat e trashëgimlënësit apeluan për çështje ligjore dhe iu drejtuan Gjykatës Greke të Kasacionit (Areios Pagos). Gjykata e Kasacionit përsëriti qëndrimin e saj të vendosur prej kohësh se e drejta islame zbatohet në Greqi si e drejtë e brendshme bazuar në detyrimet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, pjesë e së cilës ishte edhe Traktati i Athinës (1913). Si pasojë, siç pohoi gjykata, marrëdhëniet ndër-njerëzore të grekëve me besim mysliman rregulloheshin nga ligji i tyre fetar dhe Myftiu lejohej të ushtronte juridiksionin për një numër çështjesh, përfshirë testamentet islame dhe trashëgiminë. Për më tepër, gjykata theksoi se rregullimi ligjor fetar, Sheriati (Sharia Law), i rëndësishëm në mënyrë specifike për grekët me besim mysliman, ishte inkorporuar në rendin juridik kombëtar në përputhje me nenin 28 të Kushtetutës, i cili i akordonte atij mbizotërim mbi çdo normë tjetër të përcaktimit të kundërt. Si pasojë, testamenti i të ndjerit duhej të shpallej i pavlefshëm. Çështja u dërgua në Gjykatën e Apelit të Trakisë.

Pas dërgimit të çështjes, Gjykata e Apelit u pajtua me aktgjykimin e Gjykatës së Kasacionit. Ankesat vijuese të kërkuases në Gjykatën e Kasacionit nuk ishin të suksesshme. Kërkesja iu drejtua Gjykatës duke pretenduar shkelje të nenit 6.1 të Konventës në lidhje me nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkesja theksoi se në testamentin e tij, burri i saj i kishte lënë asaj të gjithë pronën e tij të luajtshme dhe të paluajtshme. Sidoqoftë,

testamenti kishte pasoja në dy shtete, në Greqi dhe në Turqi, sepse në kohën materiale pasuria e paluajtshme e të ndjerit kishte katër prona në Greqi, si dhe katër prona në Turqi. Kërkuesja parashitroi se Kodi Civil Grek nuk parashikonte rihapjen e procedurave në gjykatat vendase pas konstatimit të një shkeljeje të Konventës në një vendim të Gjykatës. Për më tepër, ajo pretendoi se nuk kishte asnjë mjet efektiv në Turqi për të kundërshtuar vendimin e 18 janarit 2018, në të cilin Gjykata Civile e Shkallës së Parë e Bakırköy kishte vendosur se vendimet e Gjykatës Greke të Kasacionit ishin përfundimtare dhe detyruese për gjykatat turke, të cilat në përputhje me rrethanat nuk ishin të detyruara të rishqyrtonin rastin. Si rezultat, vendimet e Gjykatës Greke të Kasacionit ishin baza e vetme ligjore për paraqitjen e pretendimeve për privimin e të drejtave të saj pronësore në Turqi pranë GJEDNJ-së.

Në ato rrethana, kërkuesja argumentoi se kthimi i pronës në fjalë do të ishte forma e vetme e përshtatshme e dëmshpërblimit për shkeljen e Konventës. Një kthim i tillë mund të sigurohet lehtësisht nëse Gjykata urdhëron korrigjimin e regjistrimit të pronave të trashëguara në Regjistrin e Tokës në emrat e motrave të burrit të saj të ndjerë.

Në mungesë të mundësisë së kthimit në gjendje të mëparshme (*restitutio in integrum*), kërkuesja fitoi Gjykatën t'i japë asaj kompensim prej 44,103 eurosh, që korrespondonte me tre të katërtat e vlerës së tri pronave në fjalë në Greqi dhe kompensim prej 936,912.50 eurosh në lidhje me katër pronat në Turqi. Kërkuesja kërkoi 30,000 euro në lidhje me dëmin jomonetar. Ajo pretendoi se kishte pësuar stres të tepruar nga publiciteti që shoqëronte procedurat në çështjen e saj para gjykatave greke dhe para GJEDNJ-së dhe nga ekspozimi i saj publik si një e ve myslimane e moshuar që luftonte kundër zbatimit të ligjit të Sheriatit në Greqi. Kërkuesja gjithashtu kërkoi 5,828.33 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet e bëra para gjykatave vendase dhe para Gjykatës, të ndara si më poshtë: 2,401,05 euro për tarifatat ligjore para gjykatave vendase; 1,364 euro dhe 1,100 euro për tarifatat e përfaqësuesve ligjorë para Gjykatës; dhe 963.28 euro për shpenzimet që lidhen me seancën dëgjimore para Dhomës së Madhe.

Sa i përket palës së paditur, në kohën kur ajo paraqiti vëzhgimet e saj, Qeveria argumentoi para së gjithash se vlerësimi i dëmit material të

pësuar nga kërkuesja ishte i parakohshëm, i pasigurt dhe hipotetik. Regjistrimi në Regjistrin e Tokës i pronës që i ishte lënë trashëgim kërkueses nuk ishte korrigjuar ende, siç kërkohet nga motrat e burrit të saj të ndjerë, sepse ankesa e kërkueses kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për motrat e trashëgimlënësit ishte ende në pritje para Gjykatës së Apelit të Trakisë. Në fakt, regjistrimi i pronës përkatëse në emër të kërkueses (në lidhje me pjesën e trashëguar nga burri i saj) mund të ndryshohej vetëm me një aktgjykim të pakthyeshem në përputhje me dispozitat e nenit 7 të Ligjit nr. 2664/1998.

Qeveria pretendoi se çdo kërkesë e paraqitur nga kërkuesja në lidhje me pronën në Turqi ishte e papranueshme, e pabazuar, e paqartë dhe e pamundur për t'u vlerësuar. Ata theksuan se ajo pronë ishte jashtë juridiksionit të gjykatave greke. Në asnjë fazë nuk kishte qenë objekt i procedurave në ato gjykata dhe nuk ishte pjesë e çështjes në Gjykatë; ishte subjekt i procedurave ende në pritje para gjykatave turke dhe, rrjedhimisht, çështja e të drejtave të trashëgimisë së parashtrueses në Turqi ishte e parakohshme. Për më tepër, kërkuesja nuk e kishte të vendosur pronësinë e asaj prone ose statusin e saj ligjor me efekt nga vdekja e burrit të saj e deri më sot.

Qeveria argumentoi më tej se kërkuesja kishte dështuar të ndërmernte hapat e nevojshëm për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e testamentit të burrit të saj në Turqi para se të ishte shfuqizuar nga Gjykata e Kasacionit e Greqisë, dhe nuk e kishte vërtetuar këtë. Madje duke supozuar se testamenti do të ishte i vlefshëm në Greqi, do të kishte qenë i vlefshëm edhe në Turqi për qëllimet e ekzekutimit të tij, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se ligji në fuqi kishte qenë ligji turk. Nëse Gjykata e Kasacionit e Greqisë nuk do të kishte zhvleftësuar testamentin, gjykatat turke do të kishin marrë parasysh nëse testamenti ishte në kundërshtim me politikën publike turke për arsye të tjera.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata arsyetoi se në praktikën e saj gjyqësore në rastet kur nxirret një aktgjykim në të cilin konstatohet shkelje, shteti i paditur ka detyrim ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të bërë dëmshpërblimin e pasojave të saj. Shtetet kontraktuese që janë palë në një çështje janë në

parim të lira të zgjedhin mjetet sipas të cilave ata do të respektojnë një vendim në të cilin Gjykata ka gjetur shkelje.

Gjykata ritheksoi se në aktgjykimin e saj kryesor ajo gjeti shkelje të nenit 14 të Konventës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 mbi bazat e mëposhtme: burri i kërkueses kishte vendosur, në një testament të hartuar në përputhje me të drejtën civile greke para një noteri grek, për t'ia lënë trashëgim të gjithë pronën e tij, dhe se Gjykata e Kasacionit e Greqisë konsideroi se ligji islamik (Sheriati; Sharia Law) i trashëgimisë duhet të zbatohet në rastin e saj. Kjo pati si pasojë privimin e kërkueses nga përfitimi i testamentit të bërë nga burri i saj dhe, konkretisht, nga tre të katërtat e pasurisë së lënë në trashëgim nga ai. Ndërsa për pronën në Turqi, Gjykata konsideroi se, në rrethanat specifike të rastit, nuk kishte juridiksion.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata, njëzëri, vendosi se kishte shkelje të nenit 14 në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Gjykata konstatoi se marrja e masave nga shteti i paditur për të siguruar që kërkuesja të ruajë pronësinë e saj mbi pronën e lënë në Greqi, ose, në rast të një ndryshimi në regjistrin e tokës, që të drejtat e saj të pronësisë të rivendosen, do të përbëjnë korrigjimin e duhur për shkeljen e të drejtave të saj. Në rast se masa të tilla nuk merren brenda një viti, shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkueses shumën prej 41,103.36 (dyzet e një mijë e njëqind e tre euro dhe tridhjetë e gjashtë cent) eurosh, plus çdo taksë që mund të kërkohet, në lidhje me dëmin material.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. *SERVET KAMBERAJ kundër ISTITUTO PER L'EDILIZIA SOCIALE DELLA PROVINCIA AUTONOMA DI BOLZANO (IPES), ETJ.*

GJDBE [Dhoma e Madhe]
Çështja C-571/10

24 prill 2012

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=121961&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=13611727>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: e drejta për trajtim të barabartë në lidhje me sigurimet shoqërore, ndihmën sociale dhe mbrojtjen sociale.

Faktet kryesore

Z. Kamberaj është një shtetas shqiptar, i cili që nga viti 1994 banon dhe punon në Krahinën Autonome të Bolzanos. Ai ka një leje qëndrimi pa afat. Që nga viti 1998 e deri më 2008, ai kishte përfituar nga një ndihmë për strehimin, të parashikuar në nenin 2, paragrafi 1, (k), të Ligjit të Krahinës. Më 22 mars 2010, IPES³ e informoi z. Kamberaj se kërkesa e tij për ndihmë për vitin 2009 ishte refuzuar, për shkak se buxheti i destinuar për shtetasit e vendeve të treta, i përcaktuar në përputhje me Vendimin nr. 1885, ishte shteruar.

Më 8 tetor 2010, z. Kamberaj bëri një padi në Gjykatën e Bolzanos me pretendimin se refuzimi përbënte diskriminim ndaj tij. Sipas tij, një rregullim kombëtar siç është ai i Ligjit krahinor dhe Vendimi nr. 1885

3 IPES – Instituti për strehimin social i Krahinës Autonome të Bolzanos.

ishte i papajtuëshëm sidomos me Direktivat 2000/43⁴ dhe 2003/109⁵, për aq sa rezervon për shtetasit e vendeve të treta, të cilët janë banorë afatgjatë një trajtim më pak të favorshëm sesa ndaj qytetarëve të Bashkimit Evropian, për sa i përket ndihmës për strehimin.

Në procedurat përpara gjykatës së Bolzanos, autoritetet krahinore të Bolzanos pretenduan se ishte e nevojshme të parashikohej një shpërndarje proporcionale e ndihmës ndërmjet grupeve gjuhësore të pranishme në atë krahinë, italiane, gjermane dhe ladin, në mënyrë që të ruhet paqja shoqërore midis atyre që aplikojnë për ndihmë sociale.

Gjykata e Bolzanos sqaroi se, sipas ligjit krahinor, popullsia rezidente në Krahinën Autonome të Bolzanos është e ndarë në dy kategori, pra në qytetarë të BE, qoftë italianë apo jo, për të cilët ndihma për strehim i nënshtrohet pa dallim bërjes së deklaratës së përkatësisë në një prej tre grupeve gjuhësore, dhe shtetasve të vendeve të treta, për të cilët nuk kërkohet kjo deklaratë.

Ajo gjykatë, me një vendim të ndërmjetëm, i njohu z. Kamberaj të drejtën për ndihmë për strehim për muajt tetor 2009 - qershor 2010, një shumë prej 453, 62 euro në muaj.

Për shkak se zgjidhja e kësaj çështje varej nga interpretimi i së drejtës së BE-së, Gjykata e Bolzanos vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i drejtojë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: “Gjykata” ose “GJDBE”) shtatë pyetje. Thelbi i këtyre pyetjeve konsistonte në dilemën nëse një rregullim i brendshëm nacional, kushtetues, legjislativ ose rajonal, mund të shmangej, në cilat kushte dhe sipas cilave procedura – sidomos duke pas parasysh vendin e KEDNJ-së në sistemin ligjor të BE-së, për të vënë në zbatim të drejtpërdrejtë legjislacionin e BE ndaj mosdiskriminimit, edhe kur paditësi është shtetas i një shteti të tretë dhe jo qytetar i BE-së?

4 Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e 29 qershorit 2000 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis personave pa dallim racor ose origjine etnike.

5 Direktiva e Këshillit 2003/109/EC e 25 nëntorit 2003 në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë banorë afatgjatë.

Vendimi i Gjykatës

Paraprakisht GJDBE rikujtoi kushtet e pranimit dhe përgjigjen ndaj kërkesave paragjykimore të bëra nga gjykatat e brendshme në bazë të nenit 267 të TFBE-së. Ajo theksoi se refuzimi i një kërkesë të bërë nga një gjykatë kombëtare është i mundur vetëm nëse bëhet e qartë se interpretimi i kërkuar i së drejtës së BE-së nuk ka asnjë lidhje me realitetin ose me objektin e procedurës kryesore ose kur problemi është hipotetik ose Gjykata nuk ka elementet e nevojshme faktike dhe ligjore për të dhënë një përgjigje të dobishme për pyetjet e shtruara⁶. Në këtë kuptim, Gjykata vendosi se disa nga pyetjet e Gjykatës së Bolzanos ishin të papranueshme. Pas kësaj, ajo iu dha përgjigje dy çështjeve që, në themel, ishin të vlefshme nga pyetjet e Gjykatës së Bolzanos dhe në kuadrin e rrethanave të çështjes.

Së pari, referenca e bërë nga neni 6 (3) i Traktati i Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: “TBE”) në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk kërkon që një gjykatë kombëtare, në rast të një konflikti midis një rregulli të ligjit kombëtar dhe KEDNJ-së, të zbatojë direkt dispozitat e kësaj Konvente, duke përjashtuar zbatimin e sundimit të ligjit kombëtar të papajtueshëm me të. Pa dyshim, kjo dispozitë e Traktatit të BE-së pasqyron parimin që të drejtat themelore formojnë një pjesë integrale të parimeve të përgjithshme të ligjit, të cilat Gjykata siguron që ato të respektohen. Sidoqoftë, ky nen nuk rregullon marrëdhëniet midis KEDNJ-së dhe sistemeve ligjore të shteteve anëtare dhe nuk përcakton pasojat që do të nxirren nga një gjyqtar kombëtar në rast të një konflikti midis të drejtave të garantuara nga kjo Konventë dhe një rregulli të së drejtës kombëtare.

Së dyti, në lidhje me thelbin e çështjes, pra diskriminimin e shtetasve të shteteve të treta në raport me qytetarët e BE-së në lidhje me mbështetjen sociale për strehim, Gjykata theksoi se neni 11 paragrafi 1 (d) i Direktivës 2003/109⁷, në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta, të cilët janë

6 Gjykata i referohet jurisprudencës së saj *Asnef-Equifax dhe Administración del Estado*, C - 238/05, vendim i 23 nëntorit 2006, Rec. f. I - 11125, paragrafi 17.

7 Paragrafët relevantë të këtij neni përcaktojnë: “*Banorët afatgjatë përfitojnë nga trajtimi i barabartë me shtetasit në lidhje me:*

... *d) sigurimet shoqërore, asistenca sociale dhe mbrojtja sociale siç përcaktohet nga legjislacioni kombëtar;*

banorë afatgjatë, duhet të interpretohet sikur përjashton legjislacionin kombëtar ose rajonal që parashikon, në lidhje me dhënien e ndihmës për strehimin, një trajtim të ndryshëm të një shtetasi të një vendi të tretë që përfiton nga statusi i banorit afatgjatë i dhënë në përputhje me dispozitat e kësaj direktive - krahasuar me trajtimin e shtetasve që banojnë në të njëjtën krahinë ose rajon gjatë shpërndarjes së fondeve për këtë ndihmë, me kusht që kjo ndihmë u jepet njëerës nga tri kategoritë e referuara në këtë dispozitë dhe paragrafi 4 i të njëjtit nen nuk gjen zbatim. Paragrafi 4 i nenit 11 të Direktivës 2003/109 parashikon se “Në çështjet e ndihmës sociale dhe mbrojtjes sociale, shtetet anëtare mund të kufizojnë trajtimin e barabartë në shërbimet thelbësore”.

Gjykata theksoi se integrimi i shtetasve të vendeve të treta të cilët janë vendosur përgjithmonë në shtetet anëtare dhe e drejta e këtyre shtetasve për përfitimin e trajtimit të barabartë në fushat e renditura në nenin 11 (1) të Direktivës 2003/109 është rregulli i përgjithshëm, dhe përjashtimi parashikuar në paragrafin 4 të të njëjtit nen, duhet të interpretohet strikt. Një autoritet publik, qoftë në nivel kombëtar, rajonal apo lokal, mund t’i referohet këtij përjashtimi vetëm nëse autoritetet kompetente për zbatimin e Direktivës 2003/109 në këtë shtet anëtar janë shprehur qartë se ata synojnë t’i referohen këtij përjashtimi.

Kuptimi dhe qëllimi i konceptit të ‘shërbimeve thelbësore’ që përfshihet në nenin 11 paragrafi 4 të Direktivës 2003/109 duhet të përcaktohen, duke marrë parasysh kontekstin në të cilin përfshihet ky nen dhe objektivin e ndjekur nga kjo Direktivë, përkatësisht integrimin e shtetasve të vendeve të treta që kanë qëndruar legalisht dhe përgjithmonë në shtetet anëtare. Dispozita e fundit duhet të kuptohet se lejon shtetet anëtare të kufizojnë trajtimin e barabartë që gëzojnë mbajtësit e statusit të dhënë nga ajo direktivë, me përjashtim të ndihmës sociale ose përfitimeve të mbrojtjes sociale të dhëna nga autoritetet publike, të cilat qoftë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal, ndihmojnë individin për të përmbushur nevojat e tij themelore.

f) aksesit në mallra dhe shërbime dhe sigurimi i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion të publikut, si dhe qasja në procedurat për ndarjen e banesave;

Për sa kohë që ndihma për strehimin përmbush qëllimin e përcaktuar në nenin 34 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, përkatësisht për të siguruar një jetë të denjë për të gjithë ata që nuk kanë burime të mjaftueshme, nuk mund të pranohet, sipas së drejtës së BE-së se ajo nuk është pjesë e shërbimeve thelbësore sipas kuptimit të nenit 11 (4) të Direktivës 2003/09. I takon gjykatës kombëtare të bëjë gjetjet e nevojshme, duke marrë parasysh qëllimin e ndihmës së kontestuar, shumën e saj, kushtet për akordimin e saj dhe vendin e kësaj ndihme në sistemin kombëtar të ndihmës sociale.

3.2. ANTON LAS kundër PSA ANTWERP NV

**GJDBE [Dhoma e Madhe]
Çështja C-202/11**

16 prill 2013

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=136301&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1330795>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Barazia para ligjit e të punësuarve në lidhje me hartimin e kontratave të punës në një gjuhë që ata e kuptojnë.

Faktet kryesore

Z. Las, është shtetas holandez me banim në Holandë, dhe mbi bazën e një kontrate punësimi të 10 korrikut 2004, të hartuar në anglisht, u punësua si Shef Financash, për një periudhë të pacaktuar, nga “PSA Antwerp”. Kjo e fundit është një kompani me seli në Anversë (Belgjikë), por që i përket një grupi shumëkombësh me seli në Singapor që administron terminalat e porteve. Kontrata e punës parashikonte që z. Las t’i kryente detyrat e punës në Belgjikë, por disa mund t’i kryente edhe nga Holanda.

Me një letër të 7 shtatorit 2009, të hartuar në anglisht, z. Las u pushua nga puna me efekt të menjëhershëm. Në përputhje me nenin 8 të kontratës

së punës, “PSA Antwerp” i pagoi z. Las pagën e largimit të barabartë me pagën e tre muajve si dhe kompensim shtesë që korrespondon me pagën e gjashtë muajve.

Në përgjigjen e tij të 26 tetorit 2009, avokati i z. Las pretendoi se kontrata e punës dhe, në veçanti, neni 8 që kishte të bënte me dëmshpërblimin në rast ndërprerjeje të marrëdhënies së punës, nuk ishin hartuar në gjuhën holandeze, dhe duhet të deklaroheshin të pavlefshme, në përputhje me sanksionin e parashikuar në nenin 10 të Dekretit për përdorimin e gjuhëve – përderisa “PSA Antwerp” është një kompani me zyrën e saj të regjistruar në rajonin holandisht-folës në Mbretërinë e Belgjikës. Avokati i z. Las pretendoi se kushtet e nenit 8 të kontratës së punës nuk ishin detyruese për palët dhe se z. Las kishte të drejtë të kërkonte dëmshpërblim më të lartë nga PSA.

Sipas Kushtetutës së saj, Belgjika ka katër rajone gjuhësore: përkatësisht, frëngjishtfolës, holandishtfolës, rajoni dygjuhësh i Brukselit, dhe rajoni gjermanofolës. Neni 5 i Dekretit të Vlaamse Gemeenschap,⁸ i 19 korrikut 1973, që rregullon përdorimin e gjuhëve në çështjet e marrëdhënieve shoqërore midis punëdhënësve dhe punëtorëve, parashikon:

“Të gjitha aktet dhe dokumentet e punëdhënësve, të kërkuara nga ligji, të gjitha dokumentet e destinuara për stafin e tyre, hartohen nga punëdhënësi në gjuhën holandeze”.

Kurse neni 10 i po atij dekreti parashikon:

“Dokumentet ose aktet që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij dekreti janë të pavlefshme. Pavlefshmëria deklarohet nga gjyqtari”.

Pasi nuk u arrit një marrëveshje mes palëve, z. Las, më 23 dhjetor 2009, bëri padi në Arbeidsrechtbank⁹ të Anversës në mënyrë që kjo të mund të përcaktonte shumën e dëmshpërblimit në rrethanat konkrete. Përpara kësaj gjykate, z. Las përsëriti argumentin se neni 8 i kontratës së tij të punës është i pavlefshëm për shkak se shkel dispozitat e Dekretit për përdorimin

⁸ Rajoni holandishtfolës.

⁹ Gjykata e punës në sistemin belg.

e gjuhëve. “PSA Antwerp” argumentoi se dekreti nuk ishte i zbatueshëm përderisa kontrata e punës kishte të bënte me një person që ushtronte të drejtën e tij për lëvizjen e lirë të punëtorëve brenda BE-së. Sipas saj, zbatimi i dekretit do të përbënte një pengesë për këtë liri themelore të BE-së e cila nuk mund të justifikohet nga arsye thelbësore të interesit të përgjithshëm brenda kuptimit të praktikës gjyqësore të GJDBE-së. “PSA Antwerp” shtoi se kontrata e punës duhej të respektohej për sa kohë që ishte në përputhje me vullnetin e palëve, ishte hartuar në një gjuhë të kuptueshme prej tyre, përkatësisht në anglisht, dhe sidomos pasi drejtori i Kompanisë që e nënshkroi atë është shtetas i Singaporit, që nuk flet holandisht.

Në ato rrethana, Arbeidsrechtbank e Anversës vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i drejtojë Gjykatës së Luksemburgut çështjen vijuese për një vendim paraprak:

“A shkel [dekreti për përdorimin e gjuhëve] nenin 45 të TFBE-së në lidhje me lëvizjen e lirë të punëtorëve në BE përderisa detyron një kompani me seli në rajonin holandishtfolës, nën sanksionin e pavlefshmërisë, të hartojë në holandisht të gjitha dokumentet në lidhje me marrëdhënien e punës kur punëson një punëtor për një punë me karakter ndërkombëtar?”

Vendimi i Gjykatës

Fillimisht, GJDBE theksoi se kontrata e punës në fjalë përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 45 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: “TFBE”), pasi ajo ishte lidhur midis një shtetasi holandez me banim në Holandë dhe një kompanie të themeluar në territorin e Mbretërisë së Belgjikës. Së dyti, në kundërshtim me atë që pretendon paditësi në procedurën kryesore, z. Las, zbatimi i nenit 45 të TFBE-së mund të pretendohet jo vetëm nga vetë punëtorët, por edhe nga punëdhënësit e tyre. Në të vërtetë, për të qenë efektive dhe e dobishme, e drejta e punëtorëve për t’u angazhuar dhe punësuar pa diskriminim, duhet të plotësohet domosdoshmërisht nga e drejta e punëdhënësve për t’i angazhuar ata në përputhje me rregullat për lëvizjen e lirë të punëtorëve¹⁰.

10 Shih vendimet e 11 janarit 2007, ITC, C - 208/05, ECR I - 181, paragrafi 23, dhe i 13 dhjetorit 2012,

Gjykata theksoi se dispozitat e TFBE-së në lidhje me lëvizjen e lirë të personave synojnë të lehtësojnë, për shtetasit e shteteve anëtare, ushtrimin e aktiviteteve profesionale të çdo lloji në territorin e BE-së dhe të ndalojnë masat të cilat mund të pengojnë këta shtetas kur ata dëshirojnë të ushtrojnë një aktivitet ekonomik në territorin e një shteti anëtar tjetër¹¹.

Këto dispozita dhe, në veçanti, neni 45 i TFBE-së përjashtojnë çdo masë e cila, edhe e zbatueshme pa diskriminim në bazë të shtetësisë, mund të pengojë ose të bëjë më pak tërheqës ushtrimin nga qytetarët e BE-së, të lirive themelore të garantuara nga Traktati¹².

Gjykata konstatoi se në hartimin e kontratave ndërkufitare të punës të lidhura nga punëdhënësit që kanë vendin e tyre të biznesit në rajonin holandishtfolës në Belgjikë, është e vlefshme vetëm gjuha holandeze. Ajo thekson se një legjislacion i tillë mund të ketë një efekt dekurajues mbi punëtorët dhe punëdhënësit nga shtetet e tjera anëtare që nuk flasin holandisht dhe prandaj përbën një kufizim në lëvizjen e lirë të punëtorëve.

Ajo ka pranuar që kufizime të tilla mund të pranohen vetëm me kusht që të ndjekin një objektiv me interes të përgjithshëm, të jenë të përshtatshme për të garantuar arritjen e saj dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme¹³.

Qeveria belge argumentoi se legjislacioni i lartpërmendur plotëson nevojën e trefishtë: së pari, për të nxitur dhe stimuluar përdorimin e një prej gjuhëve të saj zyrtare; së dyti, për të siguruar mbrojtjen e punëtorëve duke i lejuar ata të familjarizohen me dokumente në gjuhën e tyre si dhe të përfitojnë nga mbrojtja efektive e institucioneve përfaqësuese të punëtorëve dhe e autoriteteve administrative dhe gjyqësore që duhet të vendosin mbi këto dokumente dhe; së fundmi,

Caves Krier Frères, C - 379/11, paragrafi 28.

11 Vendimi i 8 nëntorit 2012, *Radziejewski*, C- 461/11, paragrafi 29.

12 Vendimi i 10 marsit 2011, *Casteels*, C - 379/09, ECR I - 1379, paragrafi 22.

13 Vendimi i 1 prillit 2008, *Qeveria e rajonit Francez dhe qeveria e rajonit Walloon*, C - 212 / 06, ECR I - 1683, paragrafi 55.

të sigurojnë efektivitetin e kontrolleve dhe mbikëqyrjen e inspektoratit të punës.

Në lidhje me objektivin e parë, Gjykata u shpreh se, në përputhje me nenin 4 paragrafi 2 të TBE-së, ajo respekton pasurinë e larmisë së tij kulturore dhe gjuhësore dhe identitetin kombëtar të shteteve anëtare, i cili përfshin gjithashtu mbrojtjen e gjuhës zyrtare të këtyre të fundit¹⁴. Prandaj, qëllimi i nxitjes dhe i stimulimit të përdorimit të gjuhës holandeze, e cila është një nga gjuhët zyrtare në Belgjikë, përbën një interes të ligjshëm, i cili justifikon, në parim, një kufizim të detyrimeve të vendosura nga neni 45 i TFBE-së.

Në lidhje me objektivat e dytë dhe të tretë, përkatësisht mbrojtjen sociale të punëtorëve dhe lehtësimin e kontrolleve administrative përkatëse, Gjykata ka pranuar ndërkaq që këto janë arsye thelbësore të interesit të përgjithshëm të tilla që justifikojnë një kufizim në ushtrimin e lirive themelore të njohura nga Traktati¹⁵.

Megjithatë, Gjykata u shpreh se për të përmbushur kërkesat e së drejtës së BE-së, legjislacioni, siç është ai në fjalë, duhet të jetë proporcional në raport me ato objektiva.

Në çështjen konkrete, duket se shkelja e detyrimit për të hartuar në gjuhën holandeze një kontratë pune të lidhur midis një punëtori dhe një punëdhënësi që ka vendin e tij të biznesit në rajonin holandishtfolës të Belgjikës sanksionohet nga pavlefshmëria e kësaj kontrate. Sidoqoftë, palët në një kontratë pune ndërkufitare nuk zotërojnë domosdoshmërisht gjuhën zyrtare të shtetit anëtar në fjalë. Në një situatë të tillë, formimi i vullnetit të lirë dhe të informuar mes palëve kërkon që ata të jenë në gjendje të hartojnë kontratën e tyre në një gjuhë tjetër nga gjuha zyrtare e atij shteti anëtar. Një rregullim nga një shtet anëtar, i cili jo vetëm që kërkon përdorimin e gjuhës së tij zyrtare për kontratat ndërkufitare të punës, por që do u njihje vlerë ligjore edhe kontratave të tilla në një gjuhë të njohur për të gjithë palët e interesuara

14 Vendimi *Runevič-Vardyn et Wardyn*, C-391/09, Rec. p. I-3787, paragrafi 86.

15 Vendimet e 18 korrikut 2007, *Komisioni kundër Gjermanisë*, C - 490/04, ECR I - 6095, paragrafët 70 dhe 71, si dhe të 7 tetorit 2010, *dos Santos Palhota dhe të tjerët*, C - 515/08, ECR I - 9133, paragrafi 47.

do ta cenonte më pak lirinë e lëvizjes së punëtorëve dhe do të ishte i përshtatshëm për të garantuar objektivat e ndjekura nga ky rregullim.

Në dritën e sa më sipër, duhet të konsiderohet se legjislacioni objekt i pyetjes nga Arbeidsrechtbank e Anversës shkon përtej asaj që është rreptësisht e nevojshme për të arritur objektivat e paraqitura nga Qeveria belge dhe nuk mund të konsiderohet si proporcional.

Në ato rrethana, përgjigja e pyetjes është që neni 45 i TFBE-së duhet të interpretohet se ndalon rregullimet nga një entitet federal i një shteti anëtar, siç është ai në rastin konkret, i cili kërkon që çdo punëdhënës që ka selinë e tij në territorin e këtij entiteti, t'i hartojë kontratat ndërkufitare të punës ekskluzivisht në gjuhën zyrtare të kësaj njësie federale, nën sanksionin e shpalljes së këtyre kontratave të pavlefshme nga gjykata.

3.3. BALÁZS-ÁRPÁD IZSÁK DHE ATILA DABIS kundër KOMISIONIT EVROPIAN

GJDBE

Çështja C-420/16 P

7 mars 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=211423&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13699094>]

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: e drejta për t'u regjistruar e nismës së qytetarëve evropianë që synojnë përmirësimin e situatës së rajoneve me pakica kombëtare.

Faktet kryesore

Z. Balázs-Árpád Izsák dhe z. Attila Dabis janë dy qytetarë të BE-së me banim në Rumani, përkatësisht në Hungari. Në qershor 2013, së bashku me pesë persona të tjerë, ata i paraqitën Komisionit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: "Komisioni") një propozim në kuadrin e Nismës të Qytetarëve

Evropianë me titull *“Politika e kohezionit për barazinë e rajoneve dhe ruajtjen e kulturave rajonale”*. Kjo nismë synonte që politika e kohezionit të BE-së t’i kushtojë vëmendje të veçantë zonave gjeografike, karakteristikat etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore të të cilave ndryshojnë nga ato të zonave përreth (në tekstin e mëtejshëm: “rajone të pakicave kombëtare”). Objektivi kryesor i nismës ishte që të lejohehin rajonet me një pakicë kombëtare të kenë qasje, në formën e masave të mbështetjes, ruajtjes ose zhvillimit, në mbështetjen që rrjedh nga politika e lartpërmendur. Kjo, me qëllim që të parandalojë që ato të mos mbeten ekonomikisht në disavantazh krahasuar me rajonet përreth.

Në këtë kontekst, organizatorët e Nismës të Qytetarëve Evropianë pretendonin në veçanti se zbatimi i politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian kërcënonte karakteristikat specifike etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore të rajoneve me një pakicë kombëtare dhe se këto karakteristika përbënin një pengesë demografike serioze dhe të vazhdueshme që BE-ja duhet ta luftojë në kuadër të politikës së saj të kohezionit.

Sipas Traktatit të BE-së, në kuadër të një Nisme të Qytetarëve Evropianë, qytetarët e BE-së, kur janë më shumë se një milion shtetas nga një e katërta e Shteteve Anëtare të BE, mund të marrin një nismë ligjore për të ftuar Komisionin që, brenda kuadrit të kompetencave të tij, t’i propozojë ligjvënësit të Bashkimit që të miratojnë një akt ligjor për qëllimet e zbatimit të traktateve. Para se të fillojnë të mbledhin numrin e kërkuar të nënshkrimeve, organizatorët e një Nisme të Qytetarëve Evropianë duhet ta regjistrojnë atë në Komision, i cili shqyrton qëllimin dhe objektivat e tij. Komisioni mund ta refuzojë regjistrimin e një nisme të tillë, veçanërisht kur objekti i saj është haptazi jashtë kompetencës së tij.

Me një vendim të 25 korrikut 2013, Komisioni Evropian refuzoi të regjistrojë propozimin për një Nismë të Qytetarëve Evropianë të paraqitur nga z. Balázs-Árpád Izsák, z. Attila Dabis dhe pesë ankuesit e tjerë, me arsyetimin se objekti i saj ishte haptazi jashtë kompetencës së tij për t’i propozuar një akt ligjor ligjvënësit të BE-së. Pas këtij refuzimi z. Balázs-Árpád Izsák dhe z. Attila Dabis u ankuan në Tribunalin e BE duke kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit. Me një vendim të 10 majit 2016, Tribunali e hodhi poshtë ankesën kundër vendimit të Komisionit me arsyetimin, sidomos, se organizatorët nuk kishin demonstruar

ekzistencën e kërcënimeve dhe pengesave të lartpërmendura për rajonet në fjalë. Z. Izsák dhe z. Dabis e apeluar vendimin e Tribunalit në Gjykatën e Drejtësisë të BE-së.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata rikujtoi që një Nismë e Qytetarëve Evropianë synon të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe ta bëjë BE-në më të arritshme. Rrjedhimisht, qytetarët duhet të kenë qasje të lehtë në këtë instrument. Sipas Tribunalit, përgjigja e pyetjes nëse politika e kohezionit mund të përbëjë një bazë ligjore për të vlerësuar në nivelin e BE-së interesat e rajoneve me pakica kombëtare, të cilat konsiderojnë se janë në disavantazh, hasin në pengesa madje janë edhe të kërcënuar nga kjo politikë, duhet të përfshinte një vlerësim të fakteve dhe provave, për të cilat barra e provës u mbetej organizatorëve të Nismës së Qytetarëve Evropianë. Gjykata nga ana e saj vërejtë se, duke arsyetuar kështu, Tribunali kishte bërë një gabim ligjor në lidhje me kushtin për regjistrimin e Nismës së Qytetarëve Evropianë dhe ndarjen e detyrave midis organizatorëve të një Nisme të Qytetarëve Evropianë dhe Komisionit në kuadër të procesit të regjistrimit të një nisme.

Në të vërtetë, sipas Gjykatës, pyetja nëse masa e propozuar në kuadrin e një Nisme të Qytetarëve Evropianë bie brenda fushës së kompetencave të Komisionit nuk është çështje faktike ose vlerësimi provash që u nënshtrohet rregullave për barrën e provës, por është në thelb një çështje e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të traktateve.

Në këto kushte, kur Komisioni merr një kërkesë për të regjistruar një propozim të një Nisme të Qytetarëve Evropianë nuk i takon atij, që në këtë fazë, të verifikojë nëse janë paraqitur provat e të gjitha fakteve në të cilat është mbështetur propozimi, as nëse arsyet që qëndrojnë në themel të propozimit janë të mjaftueshme. Komisioni duhet të kufizohet në shqyrtimin nëse, nga pikëpamja objektive, masat e parashikuara në mënyrë abstrakte mund të merren në bazë të traktateve.

Në këto rrethana, Gjykata anuloi vendimin e Gjykatës së Përgjithshme si dhe vendimin e kontestuar të Komisionit dhe arriti në përfundimin se Komisioni kishte gabuar në ligj duke refuzuar të regjistrojë Nismën e Qytetarëve Evropianë që synon përmirësimin e situatës së rajoneve me pakica kombëtare.

Sidoqoftë, Gjykata konfirmoi gjetjen e bërë nga Tribunali që karakteristikat specifike etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore të rajoneve me një pakicë kombëtare nuk bien brenda konceptit të “pengesës demografike serioze dhe të vazhdueshme” dhe, për këtë arsye, nuk mund të merren parasysh nën këtë koncept për qëllimet e politikës së kohezionit. Në të vërtetë, këto karakteristika nuk ka të ngjarë të përbëjnë sistematikisht, për qëllimet e zhvillimit ekonomik, një hendikep krahasuar me rajonet përreth.

Prandaj, Gjykata anuloi vendimin e Tribunalit dhe vendimin e Komisionit.

Neni 4

Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit

- 1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*
- 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*
- 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*
- 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.*
- 6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*
- 7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO203/19. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2020/07/ko_203_19_agj_shq.pdf]

19 nëntor 2019

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i njihte Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Administratës Publike, kompetenca për çështje të punësimit të kategorisë së zyrtarëve publikë për të gjitha institucionet shtetërore, duke përfshirë institucionet e pavarura. Çështja kushtetuese që ngërthente kërkesa në fjalë ishte përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar të votuar nga Kuvendi, përkatësisht vlerësimi nëse i njëjti ishte në pajtueshmëri me parimin e “ndarjes së pushteteve”, “pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese” dhe parimin e “barazisë para ligjit”, të garantuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës.

Faktet kryesore

Më 2 shkurt 2019, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Neni 1 [Qëllimi] i Ligjit i kontestuar përcaktonte se Ligji ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës. Më 11 mars 2019, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me nenin 86 [Hyrja në fuqi] të Ligjit të kontestuar parashihej që “Ky ligji hyn në fuqi (6) muaj pas publikimit në “Gazetën Zyrtare”. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës kontestoi një mori nenesh dhe dispozitash specifike të Ligjit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Ligji i kontestuar e vishte me kompetenca Qeverinë, përkatësisht Ministrinë e Administratës Publike (e cila ndërkohë u shkri në Ministrinë e Punëve të Brendshme), për administrimin e çështjes së punësimit për të gjitha institucionet shtetërore, duke përfshirë institucionet e pavarura. Kjo sipas parashtruesit (Avokatit të Popullit), cenonte pavarësinë kushtetuese të Institucionit të Avokatit të Popullit të garantuar me nenin 132 të Kushtetutës, si dhe institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese. Sipas parashtruesit të kërkesës, shkelja e pavarësisë së institucionit të Avokatit të Popullit e garantuar me nenin 132 të Kushtetutës, konsistonte në faktin se Ligji i kontestuar nuk përmbante ndonjë dispozitë specifike, lidhur me personelin e Avokatit të Popullit, për të siguruar pavarësinë e tij. Sipas tij, Ligji i kontestuar si dhe Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura synim kishin marginalizimin e institucioneve të pavarura dhe futjen e tyre nën mbikëqyrjen e Qeverisë, gjë që paraqiste ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës iu referua neneve specifike të Ligjit të kontestuar, duke theksuar se Ligji e autorizonte Qeverinë që të miratojë politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarëve publikë, si dhe për t'i miratuar aktet nënligjore lidhur me Ligjin e kontestuar, por nuk përcaktonte se në çfarë mase Qeveria mund të ushtrojë pushtetin ndaj institucioneve të pavarura. Sipas parashtruesit të kërkesës, përjashtimet që parashiheshin me këtë Ligji nuk ishin adekuate dhe logjike dhe bënin trajtim të pabarabartë, duke qenë se Ligji i kontestuar përjashtonte nga zbatimi i tij nëpunësit civilë të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa nuk i përjashtonte nëpunësit civilë në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe në institucionet e pavarura. Përcaktimet e tilla të Ligjit të kontestuar, sipas parashtruesit të kërkesës, shkelnin parimin e ndarjes së pushteteve, meqenëse dihet qartë se sikur Kuvendi ashtu dhe gjyqësori janë pushtete të ndara nga Qeveria, sikurse edhe institucionet e pavarura.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vendosi që të lejojë vënien e masës së përkohshme, kështu që fillimisht masa e përkohshme u vendos më 19 nëntor 2019 dhe më pas u vazhdua më 26 shkurt 2020. Për sa i përket meritave (thelbit) të rastit, Gjykata arsyetoi se Ligji i kontestuar i jepte kompetenca të gjera Qeverisë që të menaxhonte dhe mbikëqyrte nëpunësit civilë të administratës publike, duke përfshirë edhe nëpunësit civilë të institucioneve të pushtetit gjyqësor. Për më tepër, Ligji i kontestuar i jepte Qeverisë kompetenca për të nxjerrë një varg aktesh nënligjore për të rregulluar më tej çështje të rëndësishme lidhur me nëpunësit civilë siç janë, çështjet e rekrutimit, emërimit, ngritjes në detyrë, orarit të punës, klasifikimit të pozitive, shkeljeve disiplinore, e që në thelb ndikonte edhe në funksionimin, klasifikimin e pozitive por edhe në sistematizimin dhe strukturën organizative të institucioneve përkatëse të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura. Kuvendi, megjithëse përmes Ligjit të kontestuar i kishte dhënë kompetencë Qeverisë që të menaxhojë me sistemin e shërbimit civil në të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe sistemin e drejtësisë, por Kuvendi kishte përjashtuar vetveten, duke përcaktuar në Ligj se Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore lidhur me nëpunësit e Kuvendit. Me këtë zgjidhje legislative ishte siguruar që Qeveria nuk do të kishte kompetenca ndërhyrëse në menaxhimin e nëpunësve të Kuvendit, gjegjësisht të Legjislativit; ndërkaq që për pushtetin e gjyqësorit dhe institucionet e pavarura kushtetuese nuk ishte paraparë asnjë garanci për të parandaluar ndërhyrjet në menaxhimin e nëpunësve të tyre. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi se Kuvendi kishte dështuar që të njëjtin përjashtim ta përcaktojë edhe për nëpunësit e sistemit të drejtësisë, ashtu që të siguronte ndarjen e pushteteve jo vetëm në aspekt të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe lidhur me stafin mbështetës të tyre, njësoj sikurse kishte bërë për nëpunësit e Kuvendit dhe të Qeverisë. Andaj, Gjykata vlerësoi se, duke mos përfshirë nëpunësit civilë të institucioneve të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë], në përjashtimet e nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, Ligji i kontestuar cenonte parimin e ndarjes së pushtetit të garantuar me nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, si dhe pavarësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë të përcaktuara në Kapitullin VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, të përcaktuara me Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Rregullimet ligjore të cilat krijojnë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë funksionale dhe organizative të tyre janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parimet e vlerat e proklamuar aty. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se Kuvendi, duke autorizuar Qeverinë që përmes Ligjit të kontestuar të nxjerrë akte nënligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit, duke përfshirë, klasifikimin e pozitive, kriteret për rekrutim dhe çështje të tjera edhe në Institucionet e Pavarura kushtetuese, pa marrë për bazë pavarësinë e tyre - cenonte thelbin e pavarësisë së Institucioneve të Pavarura kushtetuese të garantuar me Kapitullin VIII dhe XIX të Kushtetutës, si autoritete shtetërore publike të ndara nga Legjislativi, nga Ekzekutivi dhe nga Gjyqësori i rregullt.

Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se shkeljet e lartpërmendura bënë që Ligji i kontestuar të mos ishte në përputhshmëri me Kushtetutën në raport me gjyqësorin dhe me institucionet e pavarura, dhe se ndaj tyre nuk mund të zbatohet përderisa nuk respekton pavarësinë e tyre institucionale dhe organizative.

Sa i përket institucioneve të tjera lidhur me të cilat parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatë, konkretisht nëpunësve të Agjencisë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësve civilë të Policisë së Kosovës, Gjykata theksoi se Agjencitë e Pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, nuk kanë statusin e njëjtë me atë të Institucioneve të Pavarura kushtetuese të cekura në mënyrë shprehimore në Kapitullin XII të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se Ligji i kontestuar duke përfshirë nëpunësit e Agjencisë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit të kontestuar, nuk cenonte parimin e barazisë të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata njëzëri konstatoi që Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykatën Kushtetuese, Institucionin e Avokatit të Popullit, Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Medieve, dhe se Ligji në fjalë nuk cenonte dispozitat e Kushtetutës në raport me Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe nëpunësit civilë të Policisë së Kosovës. Gjykata Kushtetuese vendosi që nuk ishte e nevojshme që Ligji i kontestuar të shfuqizohej në tërësinë e tij, por kërkoi nga Kuvendi që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara specifikisht në dispozitiv të Aktgjykimit.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. BAKA kundër HUNGARISË

[20261/12]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

23 qershor 2016

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: reformat kushtetuese dhe legislative çuan në përfundimin e parakohshëm të mandatit të gjyqtarit, duke përjashtuar gjyqtarin nga posti më i lartë në gjyqësorin hungarez, si rezultat i pikëpamjeve të shprehura publikisht në cilësinë e tij profesionale pa i dhënë asnjë mundësi për rishikim gjyqësor; qasja në gjykatë, përcaktimi nëse ka të drejta dhe detyrime civile, pamundësia e Kryetarit të Gjykatës Supreme për të kundërshtuar përfundimin e parakohshëm të mandatit.

Faktet kryesore

Kërkuesi, András Baka, ishte gjyqtar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shtatëmbëdhjetë vjet (1991-2008). Më 22 qershor 2009, ai u zgjodh nga Parlamenti hungarez si Kryetar i Gjykatës së Lartë për një mandat gjashtëvjeçar, deri më 22 qershor 2015. Si Kryetar i Gjykatës së Lartë, kërkuesi kishte një rol menaxherial dhe gjyqësor, kryesisht nëpërmjet kryesimit të diskutimeve për të ruajtur qëndrueshmërinë në praktikën gjyqësore. Ai ka qenë edhe kryetar i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, dhe për rrjedhojë kishte detyrimin e qartë ligjor për të shprehur mendimin e tij për projektligjet parlamentare që prekin gjyqësorin, bazuar dhe duke marrë parasysh mendimet dhe konsideratat e gjykatave të tjera në vend. Në vitin 2000, Parlamenti hungarez ndërmoi një sërë reformash gjithëpërfshirëse, kushtetuese dhe legislative. Kërkuesi kritikoi publikisht disa aspekte të këtyre reformave gjithëpërfshirëse kushtetuese dhe legislative, të iniciuara nga Qeveria e dytë Orbán, që prekën drejtpërdrejt gjyqësorin, veçanërisht uljen e moshës së detyrueshme të pensionit për gjyqtarët nga 70 në 62 vjeç.

Në prill të vitit 2011, Parlamenti miratoi Ligjin e ri Themeltar të Hungarisë - Kushtetutën e Re (Fundamental Law of Hungary (the new Constitution)), e cila zëvendësoi Kushtetutën e vitit 1949 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2012. Neni 25 i Ligjit Themeltar e shpall Kúria-n si organin suprem gjyqësor të vendit, me të cilin i dhanë Gjykatës së Lartë – Kúrias – kompetencat e reja që i atribuohen në fushën e sigurimit të qëndrueshmërisë në praktikën gjyqësore, në menaxhimin e gjyqësorit dhe në funksionimin e Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, si dhe në lejimin e ankimit kushtetues kundër vendimeve të gjyqësorit.

Në dhjetor 2011, Parlamenti miratoi disa dispozita kalimtare për Ligjin Themeltar, duke parashikuar që Kúria do të ishte pasardhësi ligjor i Gjykatës së Lartë dhe se mandati i Kryetarit të Gjykatës së Lartë do të përfundonte me hyrjen në fuqi të Ligjit Themeltar. Për më tepër, ligji i ri për Organizimin dhe Administrimin e Gjykatave vendosi një kriter të ri për zgjedhjen e Kryetarit të ri të Kúrias, pra të paktën pesë vjet përvojë si gjyqtar në Hungari. Kombinimi i këtyre dispozitave çoi në përfundimin e mandatit të kërkuesit dhe në papërshtatshmërinë e tij për një mandat të ri, si dhe në humbjen e shpërblimit dhe përfitimeve përkatëse.

Procedura legjislativë në lidhje me dispozitat kalimtare filloi vetëm në fund të nëntorit 2011, tri javë pas një fjalimi parlamentar të mbajtur nga kërkuesi në të cilin ai kritikoi reformat e planifikuara në drejtësi. Meqenëse nuk kishte mundësi për shqyrtim gjyqësor në nivel kombëtar, kërkuesi paraqiti kërkesë kundër Hungarisë në GJEDNJ më 14 mars 2012. Më 15 dhjetor 2014 çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi se pas shkarkimit të tij të parakohshëm atij i ishte mohuar qasja në gjykatë, në kundërshtim me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe që mandati i tij ishte përfunduar si pasojë e faktit që ai kishte shprehur mendimin e tij profesional në lidhje me reformën legjislativë, në kundërshtim me nenin 10 (Liria e shprehjes). Gjithashtu parashtruesi u ankua se nuk kishte zgjidhje efektive sipas nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive), dhe që ai ishte diskriminuar në kundërshtim me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit).

Arsyetimi i Gjykatës

Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 6, Gjykata fillimisht përcaktoi nëse mbrojtjet e nenit 6 ishin të zbatueshme në rastin e kërkuesit. Bazuar në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, në mënyrë që neni 6.1 të gjejë zbatim duhet të ekzistojë një mosmarrëveshje (kontest) e mirëfilltë dhe serioze në lidhje me një të drejtë të mbrojtur nga e drejta vendore. Gjykata gjeti se, në përputhje me ligjin e brendshëm, mandati i kërkuesit si Kryetar i Gjykatës Supreme do të zgjaste për një periudhë prej gjashtë vitesh, përveç nëse ajo do të ishte ndërprerë pas marrëveshjes së ndërsjellë, dorëheqjes ose shkarkimit. Kështu, kishte ekzistuar e drejta për parashtruesin për të shërbyer në mandatin e tij deri në skadimin e një kohëzgjatje të tillë, ose derisa të përfundonte mandati i tij gjyqësor. Kjo gjithashtu u mbështet nga parimet kushtetuese në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe pazëvendësueshmërinë e gjyqtarëve. Rrjedhimisht, kërkuesi pa dyshim mund të pretendonte se kishte të drejtë për mbrojtje nga shkarkimi nga detyra gjatë mandatit të tij. Fakti që mandati i tij u përfundua *ex lege* nga legjislati i ri nuk mund të hiqte, në mënyrë retrospektive, argumentimin e së drejtës së tij sipas rregullave të zbatueshme në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij.

Megjithatë, në praktiken e saj gjyqësore, Gjykata ka deklaruar se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin në mes të autoriteteve dhe shërbyesve civilë ishin të përjashtuara nga fushëveprimi i nenit 6.1, sepse nuk përbënin padi civile.

Për të përcaktuar nëse e drejta e pretenduar nga parashtruesi ishte “civile”, Gjykata zbatoi kriteret e zhvilluara në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* ([GC], 63235/00, 19 prill 2007). Për sa i përket kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen - nëse ligji kombëtar përjashtonte shprehimisht qasjen në gjykatë për postin ose kategorinë e stafit në fjalë - Gjykata vuri re se në disa raste në të cilat kishte gjetur se kushti ishte përmbushur, përjashtimi në fjalë ishte i qartë dhe i shprehur. Sidoqoftë, në rastin aktual, kërkuesi nuk ishte përjashtuar shprehimisht nga e drejta e qasjes në gjykatë. Në vend të kësaj, qasja e tij ishte penguar nga fakti që përfundimi i parakohshëm i mandatit të tij ishte përfshirë në dispozitat kalimtare të legjislacionit të ri që kishte hyrë në fuqi më 2012. Kjo e kishte përjashtuar atë nga kontestimi i masës para Tribunalit të Shërbimit, gjë të cilën do të kishte qenë në gjendje ta bënte në rast të një shkarkimi në bazë të kornizës ligjore të mëparshme. Prandaj, Gjykata ishte e mendimit se, në rrethanat specifike të çështjes, ajo duhej të përcaktonte nëse e drejta për qasje në gjykatë ishte përjashtuar sipas ligjit të brendshëm më parë, dhe jo në kohën kur ishte miratuar masa e kundërshtuar në lidhje me kërkuenin.

Gjykata më tej vuri në dukje që në mënyrë që legjislacioni kombëtar që përjashtonte qasjen në gjykatë të ketë ndonjë efekt sipas nenit 6.1 në një rast të veçantë, ai duhej të ishte në përputhje me sundimin e ligjit, i cili ndalon ligjet e drejtuara kundër një personi të caktuar, si në rastin e kërkuetit. Në dritën e këtyre konsideratave, nuk mund të përfundohej se ligji kombëtar përjashtonte shprehimisht qasjen në gjykatë për një kërkesë bazuar në paligjshmërinë e pretenduar të përfundimit të mandatit të kërkuetit. Kushti i parë i testit *Vilho Eskelinen* nuk ishte përmbushur dhe neni 6 ishte i zbatueshëm në rastin e tij.

Si rezultat i legjislacionit, pajtueshmëria e të cilit me kërkesat e sundimit të shtetit të së drejtës (Rule of Law) ishte e dyshimtë, përfundimi i parakohshëm i mandatit të kërkuetit nuk u shqyrtua, as ishte i hapur për rishikim, nga ndonjë organ që ushtron kompetenca gjyqësore.

Duke vërejtur rëndësinë në rritje që instrumentet ndërkombëtare dhe të Këshillit të Evropës, si dhe praktika gjyqësore e gjykatave ndërkombëtare dhe praktika e organeve të tjera ndërkombëtare, po i jepnin drejtësisë procedurale në çështjet që përfshijnë largimin ose shkarkimin e gjyqtarëve, Gjykata konsideroi se shteti i paditur kishte dëmtuar thelbin e së drejtës së kërkuarit për qasje në gjykatë.

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuarit për shkelje të nenit 10, Gjykata fillimisht përcaktoi nëse neni 10 gjente zbatim në rastin e kërkuarit; nëse masa e kontestuar përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes në thelbin e saj duke cenuar kështu ushtrimin e së drejtës së tij për të mbajtur një post publik në administrimin e drejtësisë (që kërkonte edhe deklarimin e opinioneve profesionale në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit). Apo pretendimi i kërkuarit ishte cenim i lirisë së shprehjes së kërkuarit në formën e një “formaliteti apo kushtëzimi ose edhe gjobe”; nëse ndërhyrja në të drejtën e kërkuarit ishte e ‘justifikuar dhe e paraparë me ligj’; si dhe përfundimisht nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nëse neni 10 ishte i zbatueshëm – sa i përket vlerësimit të ndërhyrjes së autoritetit në të drejtat e kërkuarit të garantuara me nenin 10 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht gjeti se neni 10 ishte i zbatueshëm pasi masat e kundërshtuara ishin nxitur nga deklaratat e kërkuarit për një çështje të caktuar dhe nuk kishin të bënin me përshtatshmërinë e tij në shërbimin publik ose me aftësinë e tij profesionale për të ushtruar funksione gjyqësore. Në raste të tjera, Gjykata kishte gjetur se masa për të cilën ishte bërë ankesa nuk kishte lidhje me ushtrimin e lirisë së shprehjes.

Nëse masa e kontestuar përbënte ndërhyrje në të drejtën e kërkuarit për lirinë e shprehjes në thelbin e saj, në rastin aktual, asnjë gjykatë vendase nuk kishte shqyrtuar kurrë pretendimet e kërkuarit ose arsyet për përfundimin e mandatit të tij. Prandaj, faktet e çështjes duhej të vlerësoheshin dhe të konsideroheshin “në tërësinë e tyre” dhe, gjatë vlerësimit të provave, Gjykata miratoi standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm”. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje se në vitin 2011, kërkuari, në cilësinë e tij profesionale si Kryetar i Gjykatës Supreme dhe i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, kishte shprehur publikisht pikëpamje kritike mbi reformat e ndryshme legislative që

prekin gjyqësorin. Pavarësisht nga siguria e dhënë nga dy anëtarë të shumicës parlamentare dhe të Qeverisë në të njëjtin vit në kuptimin që legjislacioni që po miratohej, nuk do të përdorej për t'i dhënë fund padrejtësisht mandatit të personave të zgjedhur nën regjimin e mëparshëm ligjor, propozimet për të përfunduar mandatin e kërkuesit u bënë publike dhe u paraqitën në Parlament menjëherë pasi ai mbajti një fjalim parlamentar në nëntor 2011 dhe u miratuan brenda një kohe të shkurtër. Duke pasur parasysh sekuencën e ngjarjeve në tërësinë e tyre, kishte prova *prima facie* të një lidhjeje shkakësore midis ushtrimit të lirisë së shprehjes së kërkuesit dhe përfundimit të mandatit të tij. Kështu, barra e provës u zhvendos te Qeveria.

Për sa i përket arsyeve të paraqitura nga Qeveria për të justifikuar masën e kundërshtuar, nuk ishte e qartë se ndryshimet e bëra në funksionet e autoritetit suprem gjyqësor ose detyrat e Kryetarit të saj ishin të një natyre të tillë themelore sa ato mund ose duhej të kishin nxitur përfundimin e parakohshëm të mandatit të kërkuesit. Si pasojë, Qeveria kishte dështuar të tregonte bindshëm se masa e kundërshtuar ishte e lidhur me shuarjen e postit dhe të funksioneve të kërkuesit në kontekstin e reformës së autoritetit të lartë gjyqësor. Prandaj, mund të supozohet se përfundimi i parakohshëm i mandatit të kërkuesit u nxit nga pikëpamjet dhe kritikata që ai kishte shprehur publikisht në cilësinë e tij profesionale, dhe kështu përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës së tij për lirinë e shprehjes në kundërshtim me garancitë e nenit 10.

Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar – megjithëse ishte e dyshimtë nëse legjislacioni në fjalë ishte në përputhje me kërkesat e shtetit të së drejtës – Gjykata vazhdoi me supozimin se ndërhyrja ishte parashikuar me ligj. Shtetet Palë të Konventës nuk mund të kërkonin ligjërisht pavarësinë e gjyqësorit për të justifikuar një masë të tillë si përfundimi i parakohshëm i mandatit të një kryetari gjykate për arsye që nuk ishin përcaktuar me ligj dhe që nuk kishin të bënin me ndonjë arsye të paaftësisë profesionale ose të sjelljes së pahijshme. Në këto rrethana, masa e kundërshtuar u duk se ishte e papajtueshme me synimin për të ruajtur pavarësinë e gjyqësorit. Bazuar në këto vlerësime, Gjykata gjeti se ka shkelje të nenit 10 duke qenë se ndërhyrja nuk ishte e justifikuar.

Nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike; në rastin aktual, ndërhyrja e kundërshtuar ishte nxitur nga kritikantët që kërkuar kishin shprehur publikisht në cilësinë e tij profesionale si Kryetar i Gjykatës Supreme dhe i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë. Nuk ishte vetëm e drejta e tij por edhe detyra e tij për të shprehur mendimin e tij mbi reformat legislative të cilat ka të ngjarë të kishin një ndikim në gjyqësor dhe në pavarësinë e tij. Kërkuar kishin shprehur pikëpamjet dhe kritikantët e tij për çështje me interes publik dhe deklaratat e tij nuk kishin shkuar përtej kritikave nga një perspektivë rreptësisht profesionale. Prandaj, pozicioni dhe deklaratat e tij kërkuar një shkallë të lartë të mbrojtjes për lirinë e tij të shprehjes dhe një kontroll të rreptë të çdo ndërhyrjeje, me një hapësirë të ngushtë vlerësimi që u jepet autoriteteve vendase. Për më tepër, ai u largua nga posti i tij më shumë se tre vjet para mbarimit të afatit të caktuar të zbatueshëm sipas legjislacionit në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij. Kjo vështirë se mund të pajtohet me vëmendjen e veçantë që duhet t'i kushtohet natyrës së funksionit gjyqësor si një degë e pavarur e pushtetit shtetëror dhe parimit të pazëvendësueshmërisë së gjyqtarëve, i cili ishte një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore. Përfundimi i parakohshëm i mandatit të kërkuar pa dyshim që kishte një efekt tronditës pasi që kjo duhet ta ketë dekurajuar jo vetëm atë, por edhe gjyqtarë dhe kryetarë të tjerë të gjykatave në të ardhmen nga pjesëmarrja në debatin publik mbi reformat legislative që prekin gjyqësorin dhe më përgjithësisht për çështjet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Prandaj, dhe bazuar në këto vlerësime Gjykata gjeti se ndërhyrjet në të drejtën e kërkuar për lirinë e shprehjes të përcaktuar me nenin 10 nuk kishin qenë “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, dhe përbënin shkelje të nenit 10.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 13 dhe të nenit 14, Gjykata gjeti se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ndaras.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës; konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës; se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa sipas nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 10; se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa sipas nenit 14 të Konventës

në lidhje me nenin 6.1 dhe neni 10.5. Gjithashtu, Gjykata, vendosi, (a) që shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit brenda tre muajsh, (i) 70,000 (shtatëdhjetë mijë) euro, plus çdo taksë që mund të jetë e nevojshme të paguhet, në lidhje me dëmin material dhe jomaterial; (ii) 30,000 (tridhjetë mijë euro) euro, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. A.K. kundër KRAJOWA RADA SĄDOWNICTWA dhe C.P. dhe D.O. kundër SĄD NAJWYŻSZY

GJDBE [Dhoma e Madhe]

Çështjet e bashkuara C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18

19 nëntor 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=220770&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13699595>]

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: Gjykata referuese duhet të verifikojë pavarësinë e dhomës së re disiplinore të Gjykatës Supreme Polake

Faktet kryesore

Në çështjen C-585/18, A.K., gjyqtar i Naczelny Sąd Administracyjny¹⁶, i cili kishte arritur moshën 65-vjeçare para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Gjykatën e Lartë, deklaroi, sipas nenit 37.1 dhe nenit 111.1. të këtij ligji, se kërkonte të vazhdonte të ushtrojë funksionet e tij.¹⁷ Më 27

¹⁶ Gjykata Supreme Administrative

¹⁷ Sipas nenit 37 të Ligjit të 8 dhjetorit 2017:

“1. Gjyqtarët e Gjykatës Supreme dalin në pension në ditëlindjen e tyre të 65-të, përveç nëse bëjnë, dymbëdhjetë muaj më herët dhe gjashtë muaj më së voni para se të mbushin moshën 65 vjeç, një deklaratë

korrik 2018, Krajowa Rada Sądownictwa (KRS)¹⁸, në përputhje me nenin 37.1.a të Ligjit në fjalë dha një mendim negativ për këtë kërkesë. Më 10 gusht 2018, A.K. bëri rekurs ankesë kundër këtij mendimi para Sąd Najwyższy.¹⁹ Në mbështetje të këtij rekursi, A.K. argumentoi në veçanti se nxjerrja e tij e parakohshme në pension në moshën 65-vjeçare, shkelte nenin 19.1, nënparagrafin 2, të TBE-së dhe nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: “Karta”), si dhe Direktivën 2000/78, në veçanti, nenin 9 (1) të saj.

Çështjet C-624/18 dhe C-625/18 kanë të bëjnë me dy gjyqtarë të Sąd Najwyższy, C.P. dhe D.O., të cilët gjithashtu kishin mbushur 65 vjeç para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Gjykatën Supreme, por të cilët nuk kishin bërë një deklaratë sipas nenit 37.1 dhe nenit 111.1 të këtij Ligji. Pasi u vunë në dijeni se Presidenti i Republikës, në zbatim të nenit 39 të ligjit në fjalë, dekretoi daljen e tyre në pension që nga 4 korriku 2018, ata iu drejtuan Sąd Najwyższy me rekurse kundër këtij dekreti, me qëllim që të vërtetohej se marrëdhënia e tyre e punës si gjyqtarë në shërbim aktiv në Gjykatën e Lartë nuk kishte ndryshuar, që nga ajo datë, në një marrëdhënie pune si gjyqtar në pension i po asaj gjykate. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, ata përmendën, në veçanti, një shkelje të nenit 2.1 të Direktivës 2000/78 që ndalon diskriminimin bazuar në moshë.

Këto rekurse iu paraqitën Dhomës së Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejshëm: ‘Dhoma e Punës’). Megjithatë kjo e fundit bëri të qartë se sipas nenit 131 të Ligjit të ri të

që tregon dëshirën e tyre për të vazhduar të ushtrijnë funksionet e tyre dhe të paraqesin një certifikatë, të hartuar nën kushtet e zbatueshme për kandidatët për magistraturën e vendit, duke vërtetuar se gjendja e tyre shëndetësore i lejon ata të ushtrijnë funksionet, dhe nëse [presidenti i Republikës] jep autorizim për vazhdimin e funksioneve të tyre pranë Gjykatës Supreme.

1.a. Para dhënies së një autorizimi të tillë, Presidenti i Republikës kërkon mendimin e KRS. KRS ia transmeton mendimin e tij Presidentit brenda 30 ditëve nga dita në të cilën ky i fundit ka ftuar për mendim. Nëse KRS nuk ka dhënë mendimin e tij brenda afatit të përcaktuar në fjalinë e dytë, ky mendim konsiderohet i favorshëm.

1 ter. Kur jep mendimin e përmendur në paragrafin 1 bis, KRS merr parasysh interesin e gjyqësorit ose një interes të rëndësishëm shoqëror, në veçanti emërimin racional të anëtarëve të Gjykatës Supreme ose nevojat që rezultojnë nga ngarkesa e punës së Dhomave të Gjykatës Supreme.”

18 Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit.

19 Gjykata Supreme.

Gjykatës Supreme, rekursët në çështjet C - 624/18 dhe C - 625/18 duhet t'i paraqiteshin Dhomës Disiplinore, por kjo nuk ishte konstituuar ende. Megjithëse, pas një ndryshimi, Ligji i lartpërmendur nuk i prekte më ankuesit në çështjen kryesore dhe as gjyqtarët e tjerë që ishin tashmë në detyrë në Gjykatën e Lartë kur ai hyri në fuqi. Rrjedhimisht, ata qëndruan ose u rivendosën në funksionet e tyre. Por gjykata referuese ende konsideroi se ishte ballafaquar me një problem të natyrës procedurale.

Në këto rrethana, Dhoma e Punës dhe e Sigurimeve Shoqërore, si gjykatë referuese, pyeti GJDBE nëse neni 9 (1) i Direktivës 2000/78 dhe neni 47 i Kartës kërkojnë që ajo të lërë të pazbatuara dispozitat kombëtare që i rezervojnë juridiksionin për të shqyrtuar veprime të tilla një dhome që nuk është konstituuar ende. Dhoma e Punës nënvizoi, megjithatë, se kjo pyetje mund ta humbasë rëndësinë në rast të plotësisht efektiv të posteve të gjyqtarëve brenda Dhomës Disiplinore.²⁰

Në vijim, në kërkesat e saj për referim të GJDBE-së në këto tri çështje, gjykata referuese vlerësoi se, duke marrë parasysh veçanërisht rrethanat në të cilat duhet të bëhet emërimi i gjyqtarëve të rinj të Dhomës Disiplinore, ekzistojnë dyshime serioze nëse kjo Dhomë dhe anëtarët e saj do të ofrojnë garanci të mjaftueshme të pavarësisë dhe paanësisë. Në këtë drejtim, ajo vuri në dukje se gjyqtarët e Dhomës Disiplinore të Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me një propozim nga KRS. Më tutje, Gjikata referuese theksoi se, sipas ndryshimeve të bëra me Ligjin e 8 dhjetorit 2017 për Këshillin Kombëtar të Gjyqësorit dhe në disa ligje të tjera, pesëmbëdhjetë anëtarët gjyqtarë të KRS, nga njëzet e pesë që përbëjnë këtë të fundit, nuk do të zgjidhen më nga asamblëtë e përgjithshme të gjyqtarëve në të gjitha nivelet, por nga Dieta²¹. Sipas gjykatës referuese, kjo situatë minon parimin e ndarjes së pushteteve, si bazë e shtetit demokratik të së drejtës dhe nuk përputhet me standardet ndërkombëtare dhe evropiane që mbizotërojnë në këtë fushë.

20 Sipas nenit 131 të ligjit për Gjykatën Supreme: *“Derisa të emërohen të gjithë gjyqtarët e Dhomës Disiplinore të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Supreme nuk mund të transferohen në një post në Dhomën Disiplinore.”*

21 Parlamenti polak.

Gjithashtu, si kushtet, sidomos procedurale, në të cilat anëtarët e KRS-së u zgjedhën dhe u emëruan gjatë vitit 2018, ashtu edhe një shqyrtim i mënyrës sesi ky organ ka vepruar deri më tani, nxjerrin në pah një nënshtrim të KRS-së ndaj pushtetit politik dhe paaftësinë e tij për të ushtruar misionin kushtetues për të siguruar pavarësinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve.

Gjykata referuese përfundoi duke nënvizuar se procedura me të cilën KRS thirret për të zgjedhur kandidatët për postin e gjyqtarit të Dhomës Disiplinore, të cilët nuk mund të zgjidhen nga anëtarët e Gjykatës Supreme në detyrë, ishte hartuar në mënyrë të tillë që KRS të mund të veprojë në një mënyrë diskrecionale, pa pasur ndonjë mundësi reale të kontrollit në këtë drejtim. Në mënyrë të veçantë, sipas nenit 44 të Ligjit në fjalë, vendimet e KRS-së do të bëheshin përfundimtare nëse nuk kundërshtohen nga të gjithë kandidatët, gjë që do të përjashtonte çdo mundësi efektive të rishikimit gjyqësor të tij.

Në këtë kontekst, gjykata referuese pyeti për rëndësinë që duhet t'i kushtohet, në lidhje me respektimin e kërkesës që del nga e drejta e BE-së, pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve të shteteve anëtare. Kjo nënkupton pavarësinë nga pushteti politik, të organit përgjegjës për zgjedhjen e gjyqtarëve, dhe, nga ana tjetër, rrethanat që lidhen me zgjedhjen e anëtarëve të një dhome gjyqësore të krijuar *ex nihilo* në një shtet anëtar të caktuar, kur kjo është kompetente për çështje që bien në fushën e veprimit të së drejtës së BE-së. Gjykata referuese dëshironte të dinte nëse, kur një dhomë e tillë gjyqësore nuk e plotëson kërkesën e pavarësisë, a duhet të interpretohet e drejta e BE-së sikur i kërkon asaj të përjashtojë zbatimin e dispozitave të ligjit kombëtar (i cili, duke i rezervuar këtë kompetencë kësaj dhome të re ia heqë nga juridiksioni Dhomës aktuale të Punës, si gjykatë referuese).

Vendimi i Gjykatës

Me një urdhër të 26 nëntorit 2018, GJDBE u dha përparësi këtyre çështjeve për vetë rëndësinë e tyre. Ajo u shpreh që e drejta për një ankim efektiv, e garantuar nga neni 47 i Kartës dhe e riafirmuar, në një fushë specifike,

nga Direktiva 2000/78²², e ndalon që mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e së drejtës së BE-së t'i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të një organi që nuk përbën një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Sipas Gjykatës, ky është rasti kur kushtet objektive në të cilat është krijuar organi në fjalë, karakteristikat e tij dhe mënyra në të cilën anëtarët e tij janë zgjedhur, janë të tilla që krijojnë dyshime legjitime, në sytë e palëve ndërgjyqëse, për sa i përket pandikueshmërisë së këtij organi në lidhje me elementët e jashtëm, në veçanti, nga ndikimet direkte ose indirekte të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, dhe asnjënjësia e tij në lidhje me interesat që përplasen. Kështu që këto elemente ka të ngjarë të çojnë në mungesën e shfaqjes së pavarësisë ose paanësisë së organit në fjalë që ka të ngjarë të minojë besimin që drejtësia duhet të frymëzojë te palët ndërgjyqëse në një shoqëri demokratike.

I takon gjykatës referuese të përcaktojë, duke marrë parasysh të gjithë informacionin përkatës në dispozicion të saj, nëse kjo është me të vërtetë çështja në lidhje me Dhomën e re Disiplinore të Gjykatës Supreme të Polonisë. Në një rast të tillë, parimi i përparësisë së të drejtës së BE-së kërkon që ajo të lërë të pazbatuar dispozitat e së drejtës së brendshme që ia rezervon juridiksionin ekskluziv kësaj Dhome të re Disiplinore për të shqyrtuar mosmarrëveshjet në lidhje me nxjerrjen në pension para kohe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë këto mosmarrëveshje do të mund të shqyrtohen nga një gjykatë që plotëson kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë dhe e cila do të kishte juridiksion në këtë fushë nëse dispozita e lartpërmendur nuk do e përjashtonte atë.

Paraprakisht, Gjykata, pasi konfirmoi zbatueshmërinë, në këtë rast, të nenit 47 të Kartës dhe të nenit 19.1, nënparagrafi 2, të TBE-së, rikujtoi se kërkesa për pavarësi të gjykatave është pjesë e përmbajtjes thelbësore të së drejtës për një mbrojtje efektive gjyqësore dhe të së drejtës themelore për një gjykim të drejtë. Këto të drejta, në vetvete, janë të një rëndësie thelbësore si garantuese të mbrojtjes së të gjitha të drejtave që palëve ndërgjyqëse u lindin nga e drejta e Bashkimit Evropian dhe për respektimin e vlerave të përbashkëta të shteteve anëtare të përcaktuara

22 Direktiva e Këshillit 2000/78 / EC e 27 nëntorit 2000 që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (GZ 2000, L 303, f.16).

në nenin 2 të TBE-së, në veçanti vlerën e shtetit ligjor. Ajo më pas kujtoi në detaje praktikën e saj gjyqësore mbi fushën e kësaj kërkesë të pavarësisë dhe vuri në dukje, në veçanti, se, në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve që karakterizon funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësia e gjykatave duhet të jetë e garantuar në raport me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv.

Në vijim, Gjykata nënvizoi elementet specifike që duhet të shqyrtohen nga gjykata referuese për t'i dhënë asaj mundësi të vlerësojë nëse Dhoma Disiplinore e Gjykatës Supreme ofron apo jo garanci të mjaftueshme të pavarësisë.

Së pari, Gjykata tregoi se fakti i thjeshtë se gjyqtarët e Dhomës Disiplinore emërohen nga Presidenti i Republikës nuk është i tillë që të krijojë varësi nga pushteti politik ose të lindin dyshime për paanshmërinë e tyre nëse, pasi të emërohen, ata nuk i nënshtrohen asnjë presioni dhe nuk marrin udhëzime në ushtrimin e funksioneve të tyre. Për më tepër, ndërhyrja në procedurën e zgjedhjes e Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit, përgjegjës për propozimin e gjyqtarëve që duhen emëruar, krijon premisat që ta kufizojë hapësirën e manovrimit të Presidentit të Republikës, me kusht që ky organ të jetë vetëmjaftueshëm i pavarur në raport me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe në raport me Presidentin e Republikës.

Në këtë drejtim, Gjykata sqaroi se ishte e rëndësishme të merreshin parasysh elementet faktike dhe ligjore që kishin të bënin me kushtet në të cilat u emëruan anëtarët e Këshillit të ri Gjyqësor dhe me mënyrën në të cilën ai përmbush rolin e tij të mbrojtësit të pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve. Gjykata gjithashtu tregoi se ishte e nevojshme të verifikohej shtrirja e shqyrtimit gjyqësor të propozimeve të Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit, sidomos përderisa vendimet e emërimit të Presidentit të Republikës, nga ana e tyre, nuk ka gjasa që t'i nënshtrohen një kontrolli të tillë.

Së dyti, Gjykata nënvizoi elemente të tjera që karakterizojnë më drejtpërdrejt Dhomën Disiplinore. Për shembull, ajo tregoi se, në kontekstin e veçantë që rezultoi nga miratimi, i kontestuar fuqishëm, i dispozitave të Ligjit të ri për Gjykatën e Lartë të cilën ajo e deklaroi në kundërshtim me ligjin e BE-së në vendimin e saj të 24 qershorit

2019,²³ ishte me rëndësi të theksohej se Dhomës Disiplinore i ishte dhënë juridiksion ekskluziv për të shqyrtuar mosmarrëveshjet në lidhje me daljen e parakohshme në pension të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se kjo Dhomë duhet të përbëhej vetëm nga gjyqtarë të sapoemëruar, dhe se kjo duket se gëzon një shkallë veçanërisht të lartë të autonomisë brenda Gjykatës së Lartë. Në përgjithësi, në disa raste, Gjykata ka specifikuar se, ndërsa secili prej elementeve të shqyrtuara, të marra në izolim, nuk është domosdoshmërisht i tillë që të vërë në dyshim pavarësinë e këtij organi, përfundimi mund të jetë i ndryshëm kur këto tri elemente konsiderohen të kombinuara.

23 *Komisioni kundër Polonisë* (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C-619/18.

Neni 5

Gjuhët

- 1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.*
- 2. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO65/19. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[<https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-nenit-32-paragrafi-1-nenit-41-paragrafet-1-3-dhe-1-4-dhe-nenit-76-paragrafi-2-ne-lidhje-me-nenin-2-paragrafi-7-dhe-nenin-22-paragrafi-1-3-te-ligjit-nr-06/>]

23 korrik 2019

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Avokati i Popullit, si parashtrues i kërkesës, kontestoi kushtetutshmërinë e disa neneve të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë. Nenet e Ligjit në fjalë pretendohej se mund të ishin në kundërshtim me nenin 5 [Gjuhët] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës. Për sa i përket nenit 5 [Gjuhët], çështja kryesore e ngritur me këtë kërkesë ishte se a cenon nenin 5 të Kushtetutës neni 32 (1) i Ligjit të kontestuar, i cili lejonte lëshimin e dokumenteve noteriale edhe në gjuhët tjera që nuk janë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Faktet kryesore

Më 23 nëntor 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin nr. 06/L-010 për Noterinë (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar). Më 26 dhjetor 2018, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Më 19 prill 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatën Kushtetuese kërkesën në të cilën kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 2), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit të kontestuar. Njëkohësisht, parashtruesi kërkoi nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme dhe të pezullojë zbatimin e neneve të kontestuara të Ligjit me qëllim që të evitohet shkaktimi i dëmeve të pariparueshme për subjektet e caktuara.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës kontestoi nenet 32 (paragrafi 1), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit të kontestuar (Ligjit për Noterinë), me pretendimin që nenet e cekura ishin në shkelje të nenit 5 [Gjuhët] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Për sa i përket nenit 32 (1), parashtruesi i kërkesës pretendoi se neni në fjalë ishte në kundërshtim me nenin 5 [Gjuhët], sepse lejonte lëshimin e dokumenteve edhe në gjuhët tjera që nuk janë zyrtare në Republikën e Kosovës. Ndërsa përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parashtruesi argumentoi se neni 41 (1.3) dhe (1.4) i Ligjit të kontestuar ishte në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], sepse kërkonte nga noterët që disa shërbime t'i kryejnë pa pagesë. Për të tepër, në këtë kuadër, parashtruesi pretendoi se neni 76 (2) i Ligjit të kontestuar, në mënyrë prapavepruese ka ndryshuar moshën e pensionimit të noterëve nga mosha 70-vjeçare në 65-vjeçare, me ç' rast atyre u janë mohuar pritjet legjitime dhe fitimi i ardhshëm, çka ka rezultuar me shkelje të së drejtës në pronë të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që Gjykata të vendosë masë të përkohshme dhe të pezullojë zbatimin e neneve të kontestuara deri në vendimin përfundimtar të saj.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vendosi që të lejojë vënien e masës së përkohshme dhe më pas vazhdimin e saj (fillimisht, masa e përkohshme u vendos më 20 maj 2019 dhe më pas u vazhdua më 19 korrik 2019).

Për sa i përket meritave të rastit, Gjykata Kushtetuese arsyetoi që pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 32 i Ligjit të kontestuar (Ligjit për Noterinë) shkelte nenin 5 [Gjuhët] të Kushtetutës, ishin të pabazuara sepse Ligji në fjalë nuk vendoste drejtpërdrejt detyrime të reja për shërbimin noterial, për sa i përket lëshimit të dokumenteve edhe në gjuhë të tjera, përveç gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës. Porse ato shërbime – pra lëshimi i dokumenteve edhe në gjuhët tjera që nuk janë zyrtare në Republikën e Kosovës – Ligji i parashihte

ekskluzivisht si mundësi dhe se zbatimi dhe realizimi i tyre do të varej nga secili ushtrues i funksioneve noteriale individualisht (në mënyrë diskrecionale).

Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar ishin në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata iu referua neneve në fjalë, të cilët përcaktonin se dhënia e pëlqimit nga bashkëshorti për mosregjistrim të pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve duhej të bëhej me pëlqim të veçantë, jo përmes kontratës, pa kosto financiare dhe dhënia e pëlqimit të sërishëm pas një periudhe të caktuar kohore, për të njëjtën pronë, nga bashkëshorti që ka hequr dorë më parë për regjistrimin e pronës së përbashkët, në emër të dy bashkëshortëve, duhej të bëhej pa ndonjë tarifë shtesë financiare. Në dritën e kësaj, Gjykata arsyetoi se paragrafët e nenit në fjalë nuk ishin në kundërshtim me të drejtat pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, përmes dispozitave në fjalë të Ligjit për Noterinë, ligjvënësi, duke ndjekur trendet bashkëkohore në një shoqëri demokratike dhe me qëllim të promovimit dhe përmirësimit të të drejtave pronësore të të dy gjinive, kishte paraparë saktësisht masën në të cilën ushtruesit e funksioneve të noterit duhet të kryejnë disa punë të caktuara juridike pa kompensim monetar. Gjykata, po ashtu gjeti se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se nenet përkatëse të Ligjit të kontestuar, që shkurtonin moshën e pensionimit të noterëve, nuk ishin në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës ishin të pabazuara sepse, mes tjerash, “pritjet legjitime”, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk ofrojnë garanci që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional. Në fund, Gjykata u shpreh se Kuvendi si organ ligjvënës – për shkak të pozitës së tij dhe legjitimitetit demokratik – është në pozitë më të mirë se sa Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar dhe avancuar politikat e ekonomike dhe sociale të vendit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese njëzëri konstatoi se nenet e kontestuara 32 (paragrafi 1), 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4), në lidhje me nenet 2 (paragrafi 7) dhe 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/010 për Noterinë, nuk ishin

në kundërshtim me nenet 5 [Gjuhët] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës; me shumicë votash, konstatoi se neni i kontestuar 76 (paragrafi 2) i Ligjit nr. 06/010 për Noterinë, nuk ishte në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutë.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. ÇËSHTJA “QË LIDHET ME DISA ASPEKTE TË LIGJEVE MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE NË ARSIM NË BELGJIKË” kundër BELGJIKËS

[1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64]
GJEDNJ [Dhoma Plenare]

9 shkurt 1967

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: legjislacioni gjuhësor belg, në lidhje me arsimin, cenonte të drejtat e njeriut, përkatësisht nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1 (E drejta për arsimim) të marsit 1952.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit bazuar në gjashtë kërkesa kundër Mbretërisë së Belgjikës të paraqitura pranë Komisionit sipas nenit 25 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Këto kërkesa, më e hershmja prej të cilave daton më 16 qershor 1962 dhe më e fundit, më 28 janar 1964, u bënë nga banorë të Alsemberg dhe Beersel, Kraainem, Antwerp dhe rrethinat, Genti dhe rrethinat, Louvain dhe rrethinat dhe Vilvorde (kërkuesit).

Kërkuesit paraqitën, ndërmjet viteve 1962 dhe 1964, gjashtë kërkesa në emër të tyre dhe në emër të fëmijëve të tyre, duke pretenduar se legjislacioni gjuhësor belg në lidhje me arsimin cenonte të drejtat e tyre sipas Konventës Evropiane, përkatësisht sipas nenit 8 në lidhje me nenin

14 dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1 të marsit 1952. Të gjithë kërkuesit ishin banorë të Alseberg, Beersel, Antwerp, Gent, Louvain dhe Vilvorde, të cilat i përkisnin rajonit të konsideruar me ligj si holandisht-folës, ose të Kraainem. Aktet kundër të cilave ata ngritën pretendimet për shkelje të të drejtave të tyre, në thelb përcaktonin se gjuha e arsimit do të jetë holandishtja në rajonin holandishtfolës, frëngjishtja në rajonin frëngjishtfolës dhe gjermanishtja në rajonin gjermanofolës.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretenduan shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe nenin 2 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ (E drejta për arsimim). Në veçanti, kërkuesit kundërshtonin Ligjet e 27 korrikut 1955, të 29 majit 1959 dhe të 30 korrikut 1963 “në lidhje me përdorimin e gjuhëve në arsim”, Ligjin e 14 korrikut 1932 “Mbi rregulloret gjuhësore në arsimin fillor dhe të mesëm”, dhe Ligjin e 15 korrikut 1932 “Për dhënien e gradave akademike”. Edhe pse Ligjet e 14 dhe 15 korrikut 1932 u shfuqizuan me Ligjin e 30 korrikut 1963, ato ishin ende në fuqi kur kërkuesit ngritën çështjet e tyre para Komisionit, ku edhe i kundërshtuan së bashku me legjislacionin më të ri.

Nenin 4 të Ligjit të 30 korrikut 1963 iu kushtua vëmendje e veçantë. Ai parashikonte që gjuha e arsimit të jetë holandishtja në rajonin holandishtfolës, frëngjishtja në rajonin frëngjishtfolës dhe gjermanishtja në rajonin gjermanofolës. Në Kraainem dhe në pesë komuna të tjera në periferi të Brukselit, ku gjuha e zakonshme është holandishtja, në çerdhet/kopshtet dhe në shkollat fillore, por jo edhe të mesme, arsimi lejohej në frëngjisht nëse kjo ishte gjuha amtare ose e zakonshme e fëmijës dhe me kusht që kreu i familjes të jetë banues në një nga këto komuna.

Kërkuesit, fëmijët e të cilëve ishin gjithsej më shumë se 800, pohuan se ligji i rajoneve holandeze, ku ata jetonin, nuk përfshinte dispozita adekuate për arsimin në gjuhën frënge. Ata u ankuan gjithashtu se shteti belg u ndaloi grantet institucioneve në këto rajone të cilat nuk ishin në përputhje me dispozitat gjuhësore të përcaktuara në legjislacionin për shkollat dhe refuzoi të “homologonte” certifikatat e lëshuara nga këto institucione.

Më tej, kërkuesit pretenduan se shteti nuk i lejoi fëmijët e tyre të ndiqnin mësimet e frëngjishtes që ekzistonin në vende të caktuara, duke i detyruar në këtë mënyrë kërkuesit t'i regjistronin fëmijët e tyre në shkollat lokale, në kundërshtim me aspiratat e tyre, ose t'i dërgonin më larg, gjë që përfshinte rreze dhe vështirësi të ndryshme.

Qeveria argumentoi se e drejta për arsimim në gjuhën e dikujt (sipas përkatësisë etnike) nuk ishte përfshirë në Konventë dhe Protokoll, dhe se kërkuesit nuk i përkisnin një pakice kombëtare sipas kuptimit të nenit 14.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesve, Gjykata fillimisht u bazua në nenin 2 të Protokollit nr. 1, sepse shtetet kontraktuese parashikuan shprehimisht rregullimin e së drejtës për arsimim në këtë nen. Në termat e fjalisë së parë të këtij neni, theksohet se “asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim”. Gjykata theksoi se, me gjithë formulimin e saj negativ, kjo dispozitë përdor termin ‘e drejtë’ dhe flet për ‘të drejtën për arsimim’. Po kështu, preambula e Protokollit nr. 1 specifikon se objekti i Protokollit nr. 1 qëndron në zbatimin kolektiv të ‘të drejtave dhe lirive’. Prandaj nuk ka dyshim se neni 2 parashikon një të drejtë. Megjithatë, mbetet për të përcaktuar përmbajtjen e kësaj të drejte dhe shtrirjen e detyrimit që ajo u vendos shteteve.

Formulimi negativ tregon, siç konfirmohet nga puna përgatitore, se Palët Kontraktuese nuk njohin një të drejtë të tillë për arsimim që do t'u kërkonte atyre të krijojnë me shpenzimet e tyre ose të subvencionojnë arsimin e çdo lloji të veçantë ose në një nivel të caktuar. Megjithatë, nga kjo nuk mund të konkludohet se shteti nuk ka asnjë detyrim pozitiv për të siguruar respektimin e një të drejte të tillë që mbrohet nga neni 2 i Protokollit nr. 1. Duke qenë se një ‘e drejtë’ ekziston, ajo sigurohet, në bazë të nenit 1 të Konventës, për këdo brenda juridiksionit të një shteti kontraktues.

Për të përcaktuar qëllimin e ‘së drejtës për arsimim’, sipas kuptimit të fjalisë së parë të nenit 2 të Protokollit nr. 1, Gjykata duhet të ketë parasysh qëllimin e kësaj dispozite. Gjykata vëren në këtë kontekst se

të gjitha Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës zotëronin, në kohën e hapjes së Protokollit nr. 1 për nënshkrimin e tyre, dhe ende zotërojnë një sistem arsimor të përgjithshëm dhe zyrtar. Prandaj, as nuk ka pasur dhe as tani nuk ka asnjë çështje për t'i kërkuar çdo shteti të krijojë një sistem të tillë, por thjesht për t'u garantuar personave që i nënshtrohen juridiksionit të Palëve Kontraktuese të drejtën, në parim, për të përfituar nga mjetet dhe mundësitë e mësimdhënies ekzistuese në një kohë të caktuar.

Gjykata theksoi se, Konventa nuk parashikon asnjë detyrim specifik në lidhje me shtrirjen e këtyre mjeteve dhe mënyrën e organizimit ose subvencionimit të tyre. Në veçanti, fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit nr. 1 nuk specifikon gjuhën në të cilën duhet të zhvillohet arsimi në mënyrë që të respektohet e drejta për arsimim. Ai nuk përmban dispozita të sakta të ngjashme me ato në nenet 5 (2) dhe 6 (3) (a) dhe (e). Megjithatë, e drejta për arsimim do të ishte e pakuptimtë nëse nuk nënkuptonte, në favor të përfituesve të saj, të drejtën për t'u arsimuar në gjuhën kombëtare ose në një nga gjuhët kombëtare, sipas rastit.

Fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit nr. 1, rrjedhimisht, garanton, në radhë të parë, të drejtën e qasjes në institucionet arsimore që ekzistojnë në një kohë të caktuar, por një qasje e tillë përbën vetëm një pjesë të së drejtës për arsimim. Që 'e drejta për arsimim' të jetë efektive, është më tej e nevojshme që, ndër të tjera, individit që është përfitues, duhet të ketë mundësinë për të nxjerrë fitim nga arsimi i marrë, domethënë të drejtën për të marrë, në përputhje me rregullat në fuqi në çdo shtet, dhe në një formë ose në një tjetër, njohjen zyrtare të studimeve që ka kryer. Gjykata do të merret me këtë çështje në më shumë detaje kur të shqyrtojë të fundit nga gjashtë pyetjet specifike të renditura në parashtresat e atyre që u paraqitën para saj.

E drejta për arsim e garantuar nga fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit nr. 1 nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, rregullim që mund të ndryshojë në kohë dhe vend, sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve. Është e vetëkuptueshme se një rregullim i tillë nuk duhet të dëmtojë thelbin e së drejtës për arsimim dhe as të bjerë ndesh me të drejta të tjera të parashikuara në Konventë. Gjykata vlerëson se qëllimi i përgjithshëm i vendosur për veten e tyre nga Palët

Kontraktuese, nëpërmjet Konventës ishte sigurimi i mbrojtjes efektive të të drejtave themelore të njeriut, dhe kjo, pa dyshim, jo vetëm për shkak të kontekstit historik në të cilin është lidhur Konventa, por edhe zhvillimet sociale dhe teknike në epokën tonë që u ofrojnë shteteve mundësi të konsiderueshme për rregullimin e ushtrimit të këtyre të drejtave. Prandaj, Konventa nënkupton një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut, duke i kushtuar rëndësi të veçantë këtyre të fundit.

Gjykata përfundimisht theksoi se fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit nr. 1 nuk përmban në vetvete asnjë kërkesë gjuhësore. Ai garanton të drejtën e qasjes në institucionet arsimore ekzistuese në një kohë të caktuar dhe të drejtën për të përfituar, në përputhje me rregullat në fuqi në çdo shtet dhe, në një formë ose në një tjetër, njohjen zyrtare të studimeve të përfunduara.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se Akti belg i 2 gushtit 1963 nuk ishte në përputhje me nenin 14 të Konventës lexuar në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1, mbi bazën e asaj se ai pengonte disa fëmijë të kishin qasje – në shkollat në gjuhën frënge në komunat në periferi të Brukselit vetëm për shkak të vendbanimit të prindërve të tyre. Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të neneve 8 dhe 14 të Konventës dhe të nenit 2 të Protokollit nr. 1, në lidhje me legjislacionin dhe pikat e tjera të kontestuara në fjalë. Në marrjen e vendimit të saj, Gjykata vlerësoi se parimi i trajtimit të barabartë i parashikuar në nenin 14 shkelej nëse dallimi nuk kishte justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk ndiqte një qëllim legjitim dhe nuk ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur. Për më tepër, Gjykata konsideroi se e drejta për arsim nënkupton të drejtën për t'u arsimuar në gjuhën kombëtare dhe nuk përfshinte dispozitën që të respektohen preferencat gjuhësore të prindërve.

2.2. KNOX kundër ITALISË

[76577/13]

GJEDNJ [Seksioni i parë]

24 janar 2019

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: shkelje e të drejtave për shkak të keqtrajtimeve gjatë marrjes në pyetje nën akuzën për vepër penale, shkelje të drejtave në gjykim të drejtë për shkak të mungesës së avokatit dhe sjelljes së përkthyeses si dhe moskujdesit të duhur të autoriteteve gjatë marrjes në pyetje nën akuzë për vepër penale; vendosja në një shkallë të konsiderueshme mundimi, një situatë të padurueshme psikologjike; kushtet e përgjithshme të intervistimit/marrjes në pyetje duhej të kishin alarmuar autoritetet e brendshme për mundësinë e cenimit të dinjitetit dhe të aftësisë së saj për vetëvendosje; mosinçimi i ndonjë hetimi që do të hidhte dritë mbi faktet.

Fakte kryesore

Rasti është ngritur nga Amanda Knox (kërkuesja), me shtetësi amerikane, e cila në kohën e ngjarjeve ishte studente 20-vjeçare, me qëndrim të përkohshëm në Itali. Ajo kishte gjetur një punë të përkohshme në një bar që menaxhohej nga D.L. Pas zbulimit të trupit të një vajze të pajetë që jetonte në të njëjtin apartament si edhe kërkuesja, ajo dhe partneri i saj u intervistuan nga policia dhe u monitoruan bisedat e tyre telefonike.

Më 6 nëntor 2007, në orën 1:45 të mëngjesit, kërkuesja u intervistua nga tre punonjës policie dhe A.D., e cila ishte thirrur si përkthyesë. Ndërmjet të tjerash, ajo deklaroi që krimet i kishte kryer D.L. Prokurori publik pastaj e intervistoi kërkuesen në orën 5:45 të mëngjesit, ku të pranishëm ishin A.D. dhe disa punonjës policie. Kërkuesja pretendoi se nuk ishte e asistuar nga një avokat mbrojtës gjatë intervistës. Në orën 8:30 të paradites, kërkuesja dhe shoku i saj dhe D.L. u arrestuan formalisht me akuzën e sulmit seksual dhe vrasje me dashje. Pasi dha një alibi, D.L. më vonë u lirua. Rreth orës 1 të pasdites, dhe gjatë gjithë procedurës, kërkuesja u shpreh për gjendjen e saj të shokut dhe konfuzionit gjatë

intervistës së saj inkriminuese nën presionin e policisë dhe ajo e tërhoqi akuzën e saj ndaj D.L. Megjithatë, ajo u akuzua formalisht më 14 maj 2008 për shkak të kallëzimit keqdashës. Pas një seance më 13 mars 2009, në të cilën kërkuesja pretendoi se ajo ishte keqtrajtuar gjatë intervistës së saj të datës 6 nëntor 2007 dhe u ankua në lidhje me sjelljen e përkthyeses A.D., mbrojtja e saj kërkoi transmetimin e informacionit të Zyra e Prokurorit Publik por nuk ndodhi asgjë. Në shtator 2015, Gjykata e Kasacionit e shpalli kërkuesen të pafajshme në lidhje me akuzat e vrasjes me dashje dhe të sulmit seksual dhe vuri re që dënimi prej tre vitesh burgim për kallëzim të rremë me keqdashje ndaj D.L. kishte marrë formë të prerë. Kërkuesja u shpall e pafajshme edhe për akuzën e kallëzimit të rremë të punonjësve të policisë dhe prokurorit.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesja pretendoi shkelje të nenit 3 (Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues), në aspektin procedural dhe thelbësor/material të këtij neni. Kjo për shkak të ankesave të saj të përsëritura në lidhje me trajtimin dhe vendosjen e saj në gjendje shoku gjatë intervistimit dhe marrjes në pyetje; shkelje të nenit 6 paragrafët 1 dhe 3 (c) për shkak të mos qasjes dhe mos pranisë së mbrojtësit të autorizuar/avokatit; pretendime për shkelje të nenit 6, paragrafët 1 dhe 3 (e) për faktin që përkthyesja A.D. kishte luajtur rolin e një ndërmjetëseje, duke tejkaluar kështu detyrimet që pritëshin nga një përkthyes.

Arsyetimi i gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 3, Gjykata vërejti se më 6 nëntor 2007, disa orë pas bërjes së deklarimeve inkriminuese në lidhje me D.L., dhe gjatë gjithë procedurës, kërkuesja kishte theksuar që ajo ishte në një gjendje ekstreme shoku dhe konfuzioni dhe që policia e kishte vënë atë nën presion. Gjykata e Apelit, në vendimin e saj të 3 tetorit 2011, kishte nxjerrë përfundimin që kërkuesja në fakt ishte vendosur në një shkallë të konsiderueshme mundimi, duke e vendosur atë në një situatë të padurueshme psikologjike nga e cila ajo ishte përpjekur të dilte duke inkriminuar D.L.-në. Përveç kësaj, përkthyesja kishte vepruar më shumë si 'ndërmjetëse', edhe pse ajo nuk e kishte të nevojshme të shkonte përtej detyrës së saj të interpretimit. Një nga punonjësit

e policisë e kishte përqafuar dhe përkëdhelur kërkuesen dhe i kishte shtrënguar dorën, duke vepruar kështu në mënyrë të papërshtatshme, veçanërisht në kontekstin kur ajo kishte bërë kallëzime që më vonë u karakterizuan si keqdashëse dhe që kishin rezultuar në dënimin e saj. Sjellja e sipërpërmendur, që hidhte dritë mbi kushtet e përgjithshme në të cilat ishte intervistuar kërkuesja, duhej të kishte alarmuar autoritetet e brendshme për mundësinë e cenimit të dinjitetit dhe të aftësisë së saj për vetëvendosje. Me gjithë ankesat e saj të përsëritura, trajtimi për të cilin ishte bërë ankesë nuk ishte bërë shkak për ndonjë hetim që do të hidhte dritë mbi faktet dhe mbi ndonjë përgjegjësi. Posaçërisht, kërkesa e avokatit e datës 13 mars 2009, për përcjelljen e informatave dhe dokumenteve në lidhje me trajtimin e kërkueses te prokurori publik kishte mbetur pa përgjigje.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 6 paragrafët 1 dhe 3 (c), Gjykatat vlerësoi fillimisht aplikueshmërinë e nenit 6 në rastin para saj. Në këtë vlerësim, Gjykata përsëriti që një ‘akuzë penale’ ekziston nga momenti që një individ njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për një pretendim që ai/ajo ka kryer një vepër penale ose nga momenti në të cilin situata e tij është ndikuar thelbësisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si rezultat i një dyshimi ndaj tij. Kërkuesja mund të konsiderohet si e dyshuar nga momenti që ajo ka bërë deklaratimet e saj para prokurorit publik, në orën 5:45 të mëngjesit, më 6 nëntor 2007. Kështu, jo më vonë se ora 5:45 të mëngjesit, në ngarkim të saj ishte një akuzë në kuptim të Konventës.

Në lidhje me atë nëse kishte shkaqe detyruese për të justifikuar kufizimin e së drejtës së saj të qasjes tek një avokat – Qeveria ishte mbështetur në interpretimin e praktikës gjyqësore vendore për të vënë në dukje që deklaratimet e kundërshtuara të datës 6 nëntor 2007, megjithëse nuk ishte i pranishëm asnjë avokat, mund të përdoreshin si provë, pasi ato në vetvete përbënin vepër penale. Megjithatë, Gjykata vuri re që ky interpretim ishte i përgjithshëm në objekt dhe Qeveria nuk kishte mundur të provonte që ka pasur rrethana të posaçme në këtë çështje për të justifikuar kufizimet mbi të drejtën e kërkueses. Për pasojë, nuk ka pasur shkak detyrues të përshtatshëm për të justifikuar kufizimet mbi qasjen e saj tek një avokat.

Në lidhje me drejtësinë procedurale në tërësinë e saj, Gjykata vërejtë se disa orë pas intervistës së datës 6 nëntor 2007, kërkuesja e cila ishte e pambrojtur si e huaj dhe si vajzë 20-vjeçare që nuk kishte shumë kohë që ishte në Itali dhe që nuk fliste rrjedhshëm italisht, i kishte tërhequr deklaratimet e saj. Megjithatë, gjashtë muaj më vonë, më 14 maj 2008, ajo u akuzua për kallëzim penal të rremë. Deklarimet e kontestuara ishin marrë në kontekstin e një presioni të lartë psikologjik, e që nuk ishte hetuar. Dhe këto deklarime përbënin në vetvete veprën penale për të cilën ajo ishte akuzuar dhe në këtë mënyrë prova e vërtetë mbi bazën e së cilës ajo ishte dënuar për bërjen e kallëzimit keqdashës. Së fundmi, protokollin e intervistës së kërkueses, të orës 5:45 të mëngjesit, nuk tregonte që ajo ishte vënë në dijeni në lidhje me të drejtat e saj procedurale. Për pasojë, kufizimi i qasjes së kërkueses në ndihmën ligjore gjatë intervistës së saj të 6 nëntorit 2007, në orën 5:45 të mëngjesit, kishte cenuar në mënyrë të pakthyeshme drejtësinë e procedurës.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 6, paragrafët 1 dhe 3 (e), Gjykata theksoi se fakti që përkthyesja A.D., kishte luajtur rolin e një ndërmjetëseje, duke demonstruar një qëndrim mirëdashës, deri sa kërkuesja, duke qenë e akuzuar për një vepër penale, po bënte deklaratimet e saj, kishte shkuar përtej detyrave që priteshin nga një përkthyes gjuhësor. Megjithatë, autoritetet nuk e kishin vlerësuar sjelljen e A.D.-së për të konsideruar nëse asistenca e saj si përkthyes kishte qenë në pajtim me garancitë e nenit 6, paragrafët 1 dhe 3 (e) të Konventës, ose për të konsideruar nëse kjo sjellje kishte pasur ndikim në rezultatin e procedurës penale në ngarkim të kërkueses. Përveç kësaj, protokollin përkatës i policisë nuk përmendte shkëmbimet ndërmjet kërkueses dhe A.D.-së gjatë intervistës së datës 6 nëntor 2007. Ky mosveprim fillestar kishte pasur pasoja mbi të drejtat e tjera, që ishin të ndara, por të lidhura ngushtë me të drejtën në fjalë dhe kishte minuar të gjithë drejtësinë e procedurës në tërësi.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 3 në aspektin procedural; shkelje të nenit 6 paragrafët 1 dhe 3; shkelje të nenit 6, paragrafët 1 dhe 3 (e) (c). Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 3 (aspekti material), pasi që nuk kishte prova të mjaftueshme për të nxjerrë përfundimin

që kërkuesja i ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues për të cilin ajo u ankua. Në pajtim me nenin 41, Gjykata urdhëroi shtetin italian që t'i paguajë parashtrueses shumën prej 10,400 (dhjetë mijë e katërqind) eurosh në lidhje me dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. REPUBLIKA ITALIANE kundër KOMISIONIT EVROPIAN

Tribunali i BE
Çështja - T-185/05

2008

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=68778&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13701023>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Një njoftim për vend pune si funksionar i BE-së u anulua sepse nuk ishte botuar në Gazetën Zyrtare në të gjitha gjuhët e BE-së duke krijuar diskriminim mbi baza shtetësie dhe gjuhe.

Faktet kryesore

Në mbledhjen e tij të 1678-të, më 10 nëntor 2004, Komisioni Evropian miratoi një vendim (në tekstin e mëtejshëm: "Vendimi"), formulimi i të cilit, siç del nga dokumenti që Republika Italiane i bashkëngjiti ankesës, ishte si vijon:

"Komisioni ka vendosur që botimet e jashtme të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian të njoftimeve të konkursit për postet e larta drejtuese tani e tutje do të jenë në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht, për një periudhë e cila në parim duhet të përfundojë më 1 janar 2007. Ky vendim kushtëzohet nga kapaciteti i përkthimit i disponueshëm brenda Drejtorisë së Përgjithshme

për Përkthim, merr parasysh rregullat procedurale të miratuara për rekrutimin e drejtuesve të lartë [SEC (2004) 252] dhe 'pjesë e zbatimit të komunikimit të Komisionit të 26 majit 2004 me titull 'Përkthimi: balancimi i kërkesës dhe ofertës' [SEC (2004) 638/6]".

Dokumenti SEC (2004) 252, i 27 shkurtit 2004, me titull "Rekrutimi i drejtuesve të lartë nga Shtetet e reja Anëtare" miratoi rregullat e procedurës për rekrutimin e drejtuesve të lartë të Komisionit nga dhjetë shtetet anëtare të cilat aderuan më 1 maj 2004. Ndër këto rregulla është ajo e përcaktuar në pikën 5.2, fjalia e fundit, sipas të cilit:

"Procedurat e përzgjedhjes do të kryhen në anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht".

Dokumenti SEC (2004) 638/6, i 26 majit 2004, me titull "Përkthimi: Balancimi i ofertës dhe kërkesës" tregon zhvillimet dhe kufijtë e parashikueshëm të kapaciteteve të përkthimit dhe kërkesën për përkthim brenda Komisionit pas zgjerimit të vitit 2004, si dhe harton një plan veprimi duke përfshirë masat që synojnë të sigurojnë kufizimin dhe menaxhimin e kërkesës për përkthime gjatë një faze tranzitore. Sipas këtyre masave, gjatë fazës kalimtare, disa dokumente të Komisionit do të përkthehen vetëm në gjuhë të caktuara zyrtare, ndërsa dokumentet e tjera, të kualifikuara si "jothelbësore" si njoftimet për pushime dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me procedurat e përzgjedhjes së personelit, nuk përmenden në mënyrë specifike në këtë dokument.

Më 9 shkurt 2005, Komisioni publikoi, vetëm në gjermanisht, anglisht dhe frëngjisht, Njoftimin për konkurs COM/2005/335 (OJ C 34 A, f. 3, 'njoftimi i konkursit'), me qëllim plotësimin e postit, në klasën A*15-16, të Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Nën titullin "Aftësitë e kërkuara për punë", njoftimi i konkursit përmendte, në veçanti, se "[të gjithë] kandidatët duhet [...] të kenë një njohuri të plotë të një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian dhe një njohuri të kënaqshme të një tjetre nga këto gjuhë". Nën titullin "Procedura e aplikimit", njoftimi i konkursit specifikonte, në veçanti:

"Kandidatët duhet t'i bashkëngjisin aplikimit të tyre elektronik një Curriculum vitae (CV) dhe [...] një letër motivimi. CV dhe

letra e motivimit duhet të jenë të hartuara në frëngjisht, anglisht ose gjermanisht”.

Ndërmjet datave 15 dhe 23 shkurt 2005, Komisioni publikoi në të përditshmet kryesore të të gjitha shteteve anëtare, përfshirë të përditshmet italiane *La Repubblica*, të 17 shkurtit 2005 dhe *Corriere della Sera*, të 18 shkurtit 2005, si dhe në organe të caktuara të shtypit ndërkombëtar, njoftime të shkurtra në gjuhën e secilit organ të shtypit përkatës që informonin të interesuarit për botimin e njoftimit të konkursit, duke dhënë edhe referencën e këtij.

Republika e Italisë kërkoi para Tribunalit të BE anulimin e këtyre akteve të sipërpërmendura me argumentin se ato shkelin, ndër të tjera, nenin 12 të Traktatit për Komunitetin Evropian (në tekstin e mëtejshëm: “TKE”), nenin 22 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE, si dhe parimet e mosdiskriminimit për shkak të kombësisë dhe respektimin e larmisë gjuhësore.

Vendimi i Gjykatës

Paraprakisht, në përgjigje të pretendimeve të Komisionit, Tribunali vlerësoi nëse padia mund të pranohej, pra nëse një shtet anëtar i BE-së, Republika e Italisë në këtë rast, mund t’i referohej nenit 230 të TKE-së.

Tribunali vuri në pah se neni 230 i TKE-së lejon shtetet anëtare të kundërshtojnë, me anë të një padie për anulim, çdo akt të Komisionit, pa përjashtuar ato që lidhen me marrëdhëniet e këtij të fundit me zyrtarët e tij dhe nëpunësit e tjerë. Megjithëse në të drejtën e BE-së, mosmarrëveshjet “midis Komunitetit dhe agjentëve të tij” zgjidhen në bazë të nenit 236 të TKE-së dhe ky nen duhet kuptuar që zbatohet, ekskluzivisht, për personat që kanë cilësinë e nëpunësit civil ose agjentit evropian dhe për ata që e pretendojnë këtë cilësi. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që neni 236 i TKE-së i heq të drejtën një shteti anëtar për të ngritur një padi për anulim në bazë të nenit 230 të TKE-së, kundër akteve të Komisionit, me arsyetimin se ato akte rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me funksionin e funksionit publik evropian.

Në lidhje me natyrën e aktit, Tribunali vlerësoi se rregullat e procedurës së rekrutimit që i miraton një institucion, në bazë të nenit 29 (2) të

Rregullores së Personelit, për rekrutimin e personelit të lartë drejtues, janë të detyrueshme për atë institucion dhe, në atë kuptim, prodhojnë efekte juridike, brenda kuptimit të praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e nenit 230 të TKE-së. Prandaj, Tribunali vendosi ta pranojë padinë e Republikës Italiane.

Në lidhje me themelin e çështjes, Tribunali kujtoi se referencat e shumta në Traktat për përdorimin e gjuhëve në Bashkimin Evropian, përfshirë, në veçanti, nenet 290 dhe 314 të TKE-së, nuk mund të konsiderohen si shfaqje e një parimi të përgjithshëm të së drejtës komunitare, që i siguron çdo qytetari evropian të ketë të drejtë që çdo masë që mund të ndikojë në interesat e tyre në çdo rrethanë të jetë e hartuar në gjuhën e tyre. Një parim i tillë nuk del as nga Rregullorja nr. 1 që vendos regjimin gjuhësor të Komunitetit Ekonomik Evropian.

Megjithatë, njoftimet për vende të lira pune të cilat, duke përcaktuar kriteret në lidhje me mundësitë e punësimit, vendosin se cilat kandidatura mund të pranohen dhe cilat jo. Në këtë mënyrë, këto njoftime përbëjnë akte që ndikojnë negativisht në kandidatët e mundshëm, kandidimi i të cilëve përjashtohet nga këto kriteret.

Nëse një institucion vendos të botojë në Gazetën Zyrtare tekstin e plotë të njoftimit të konkursit për një post të lartë drejtues vetëm në gjuhë të caktuara, duhet që, për të shmangur diskriminimin në bazë të gjuhës midis kandidatëve potencialisht të interesuar për këtë njoftim, të marrë masat e përshtatshme për të informuar të gjithë kandidatët në fjalë për ekzistencën e njoftimit të konkursit në fjalë dhe për versionet në të cilat u botua i plotë. Me kusht që të plotësohet ky kusht, botimi në Gazetën Zyrtare i një njoftimi për konkurs në një numër të kufizuar gjuhësh nuk ka të ngjarë të çojë në diskriminim midis kandidatëve të ndryshëm, nëse vërtetohet se këta të fundit e zotërojnë mjaftueshëm të paktën të njëjën prej këtyre gjuhëve për t'i mundësuar atyre të informohen si duhet për përmbajtjen e njoftimit. Nga ana tjetër, publikimi në Gazetën Zyrtare i tekstit të njoftimit të konkursit vetëm në gjuhë të caktuara të BE-së, kur persona që kanë njohuri të gjuhëve të tjera të BE-së kanë të drejtë të aplikojnë, në “mungesë të masave shtesë që synojnë ta lejojnë këtë kategori të kandidatëve të mundshëm të informohen siç duhet për përmbajtjen e këtij njoftimi”, ka të ngjarë të përbëjë një diskriminim në dëm të tyre. Në

fakt, në këtë hipotezë, kandidatët në fjalë do të ishin në një pozicion më pak të favorshëm në krahasim me kandidatët e tjerë, pasi ata nuk do të ishin në gjendje të informoheshin si duhet për kriteret dhe kualifikimet e kërkuara nga njoftimi i konkursit, si dhe për rregullat e procedurës së rekrutimit. Për më tepër, një njohuri e tillë është një parakusht i domosdoshëm për paraqitjen optimale të aplikimit të tyre, në mënyrë që të maksimizohen shanset e tyre për t'u zgjedhur për postin në fjalë.

Tribunali konstaton se në lidhje me njoftimet për vendet e lira për postet e larta drejtuese që nuk kërkojnë njohuri të paktën të njërës nga tri gjuhët e lartpërmendura, vendimi nuk parashikon ndonjë masë që u mundëson kandidatëve të mundshëm, të cilët nuk kanë zotërim të paktën të njërës prej këtyre gjuhëve, që të informohen si duhet për përmbajtjen e këtyre njoftimeve, të disponueshme vetëm në të tri gjuhët në fjalë. Madje nuk është parashikuar që këta kandidatë të kenë as mundësinë t'i drejtohen Komisionit me qëllim që të marrin një përkthim të njoftimit të konkursit në fjalë.

Megjithëse njoftimi u botua në gazetatat e të gjitha vendeve anëtare në gjuhët përkatëse, Tribunali vlerëson se gjithsesi kandidatët duhet t'i referoheshin versionit të Gazetës Zyrtare në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht.

Nga të gjitha sa më sipër rezulton se zbatimi i vendimit përkatës mund të çojë në diskriminim në bazë të gjuhës midis kandidatëve për një procedurë përzgjedhjeje. Për këto arsye, Tribunali arriti në përfundimin se njoftimi për vendet e lira të punës, i publikuar në përputhje me procedurat e parashikuara në vendim duhej të anulohet.

Neni 7

Vlerat

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO219/19. PARASHTRUES: AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/gjk_ko_219_19_agj_shq.pdf]

9 korrik 2020

***Çështja kyçele drejta e pretenduar:** Avokati i Popullit, si parashtrues i kërkesës, kontestoi kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, me pretendimin se ai shkel disa nene të Kushtetutës. Çështja kushtetuese që ngërthente kërkesa ishte (mos)përputhshmëria me Kushtetutën e Ligjit të kontestuar të votuar nga Kuvendi, përkatësisht pretendimi se i njëjti nuk ishte në pajtueshmëri me parimin e ndarjes së pushteteve dhe atë të sigurisë juridike, si parime themelore kushtetuese të mishëruara në disa nene të Kushtetutës.*

Faktet kryesore

Më 8 qershor 2018, Projektligji për Pagat në sektorin publik u publikua në platformën elektronike për konsultime publike dhe ka qenë i hapur për komente deri me 28 qershor 2018. Më 3 shtator 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektligjin për Pagat. Më 14 gusht 2018, Ministria e Integritimit Evropian përpiloi Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me “*acquis*” të Bashkimit Evropian për Projektligjin për Pagat. Më 24 gusht 2018, Ministria e Administratës Publike i dërgoi Zyrës së Kryeministrit versionin përfundimtar të Projektligjit për Pagat, me kërkesën që i njëjti të shqyrtohej dhe miratohej në mbledhje të Qeverisë. Më 3 shtator 2018, Ministria e Financave dorëzoi në MAP Opinionin lidhur me vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Pagat. Ministria e Financave sqaroi se Ligji në fjalë do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe se kjo kosto buxhetore shtesë nuk ishte pjesë e projeksioneve buxhetore 2019-2021. Më 3 shtator 2018, Qeveria përmes Vendimit Nr. 08/63 aprovoi Ligjin e kontestuar dhe më 7 shtator

2018, Qeveria e procedoi Ligjin e kontestuar në Kuvend dhe më 12 shtator 2018 Kryetari i Kuvendit ua dërgoi deputetëve të Kuvendit draftin e Ligjit të kontestuar dhe e ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, që ta shqyrtojë Projektligjin në fjalë dhe t’ia paraqesë Kuvendit një Raport me rekomandime. Më 8 tetor 2018, Komisioni Funkcional i lartcekur rekomandoi miratimin në parim të Projektligjit për Pagat. Më 25 tetor 2018, Kuvendi miratoi Projektligjin në parim dhe i ngarkoi pesë komisione parlamentare përkatëse që të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe t’i paraqesin raportet e tyre me rekomandime. Më 30 janar 2019, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, vendosi që Komisionit Funkcional t’i rekomandojë që Projektligji për Pagat dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu, ky komision paraqiti disa amendamente. Më 30 janar 2019, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim vendosi që Komisionit Funkcional t’i rekomandojë që Projektligji për Pagat nuk cenon dhe nuk prek të drejtat e komuniteteve. Më 31 janar 2019, Komisioni për Integritet Evropianë i shpjegoi Komisionit Funkcional që fushëveprimi i Projektligjit për Pagat nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së. Më 31 janar 2019, Komisioni për Buxhet dhe Financa, vendosi që Komisionit Funkcional t’ia paraqesë rekomandimin që Projektligji për Pagat përmban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Më 1 shkurt 2019, Komisioni Funkcional u dorëzoi deputetëve të Kuvendit një “Raport me Rekomandime” për Projektligjin në fjalë. Në këtë Raport u shpjegua që në Projektligjin fillestar prej 32 neneve në tërësi, u propozuan gjithsej 58 amendamente të cilat kishin marrë përkrahjen e Komisionit Funkcional ndërkaq, pa përkrahje të Komisionit Funkcional, u propozuan edhe 19 amendamente të tjera. Më 2 shkurt 2019, Kuvendi e procedoi për lexim të dytë Projektligjin për Pagat dhe, me Vendimin Nr. 06-V-310 e miratoi Ligjin e kontestuar. Më 12 shkurt 2019, Ligji i kontestuar iu dërgua Presidentit të Republikës së Kosovës për dekretim dhe shpallje në Gazetën Zyrtare. Më 1 mars 2019, Ligji i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare. Neni 34 [Hyrja në fuqi] i Ligjit të kontestuar përcaktonte që “Ky ligji hyn në fuqi 9 (nëntë) muaj pas publikimit në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës”. Më 1 dhjetor 2019, Ligji i kontestuar hyri në fuqi. Më 5 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Ligji për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejshëm: “Ligji i kontestuar”) nuk ishte në pajtueshmëri me nenet kushtetuese në vijim: nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafin 1 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], nenin 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], nenin 109 [Prokurori i Shtetit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme], nenin 142 [Agjencitë e Pavarura], nenin 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit], në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së dhe me paragrafin 2 të nenit 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ). Në këtë vazhdë, parashtruesi pretendoi se Ligji i kontestuar nuk ka arritur që të bartë frymën kushtetuese në kuptim të: (i) ndarjes së pushteteve; (ii) barazisë para ligjit; (iii) garantimit të së drejtës pronësore; dhe (iv) sundimit të ligjit.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vendosi që të lejojë vënien e masës së përkohshme dhe, më pas, vazhdimin e saj (fillimisht, masa e përkohshme u vendos më 12 dhjetor 2019 dhe më pas u vazhdua më 30 mars 2020). Në shqyrtimin e meritave të rastit, Gjykata arsyetoi se Ligji i kontestuar përmbante një mori problemesh serioze të nivelit kushtetues e që do të mund të përmbledheshin me sa vijon: (i) Ligji i kontestuar kundërshtonte vetë qëllimin e tij për “harmonizim” të pagave në nivel të të gjithë sektorit publik - duke bërë përjashtime arbitrare dhe të paarsyetuara për disa institucione, ndër të tjera Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bankën Qendrore të Kosovës, dhe vetë Kuvendin; (ii) Ligji i kontestuar përjashtonte në tërësi pavarësinë e pushtetit Gjyqësor duke mos i lënë asnjë kompetencë vetërregulluese për çështje që ndërlidhen me jetësimin e pavarësisë “funktionale, organizative dhe buxhetore”; (iii) Ligji i kontestuar, ndonëse theksonte se pagat rregulloheshin me këtë Ligj, e kishte zbritur rregullimin ligjor për shumë

çështje në nivel të akteve nënligjore, duke i dhënë mundësi rregullimi nënligjor vetëm Ekzekutivit dhe Legjislativit; (iv) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore, gjashtëmbëdhjetë (16) ishin për Qeverinë dhe dy (2) për Kuvendin, ndërkaq asnjë kompetencë vetërregulluese për Gjyqësorin ose Institucionet e Pavarura; (v) pushtetit Gjyqësor dhe Institucioneve të Pavarura nuk iu mundësua asnjë kompetencë vetërregulluese përmes së cilës ato do të mund të gëzonin pavarësinë e tyre “institucionale, organizative, strukturore dhe buxhetore” në raport me organizimin e brendshëm dhe stafin e tyre; (vi) ishte miratuar vetëm një (1) nga tetëmbëdhjetë (18) aktet nënligjore që është dashur të miratohen brenda periudhës nëntë mujore të *vacatio legis*, respektivisht deri më 1 dhjetor 2019; (vii) siç konfirmohej nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, për rreth 42% të pozitive nuk ishte e mundur të deshifrohej paga ngase e njëjta përfundimisht do të përcaktohej përmes klasifikimeve përkatëse me akte nënligjore të Qeverisë; (viii) siç konfirmohej nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve “kostoja buxhetore shtesë” e Ligjit të kontestuar “nuk ishte pjesë e projeksioneve buxhetore 2019-2021”; (ix) siç konfirmohej nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Transfereve, edhe po të hynte në fuqi Ligji i kontestuar (në kohën e dorëzimit të përgjigjes nga Ministria më 22 maj 2020), i njëjti nuk do të mund të zbatohet në tërësi në mungesë të akteve nënligjore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash, vendosi se Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, në tërësinë e tij, nuk ishte në përputhshmëri me nenet e Kushtetutës si në vijim: nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; nenin 7 [Vlerat]; nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]; nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]; nenin 109 [Prokurori i Shtetit]; nenin 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]; nenin 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; nenin 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; nenin 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Medie]. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese me shumicë votash vendosi të shpallë të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. SAVICKAS DHE TË TJERËT kundër LITUANISË

[66365/09]

GJEDNJ [Dhoma]

15 tetor 2013

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: shkelje e së drejtës në mjetet juridike efektive për shkak të zgjatjes së tepërt të procedurave, pakësim i së drejtës në pronë.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga pesë ish-gjyqtarë lituanezë dhe nga znj. Vaškeliënė, në emër të bashkëshortit, një gjyqtari lituanez (kërkuesit), i cili vdiq më 2005. Pas një uljeje të pagave të gjyqtarëve për 30% në vitin 1999, kërkuesit filluan procedurat para gjykatave vendase duke pretenduar pagimin e pjesës së humbur të pagave të tyre. Procedimi gjyqësor përfundoi në vitet 2009-10, kur Gjykata e Lartë Administrative përfundimisht miratoi pjesërisht pretendimet e kërkuesve. Duke u mbështetur, ndër të tjera, në nenet 6.1 dhe 13 të Konventës, kërkuesit u ankuan para GJEDNJ-së për tejzgjatje të procedurave të brendshme dhe për mungesën e një mjeti juridik efektiv të brendshëm në atë drejtim.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke iu referuar nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesit u ankuan për faktin se sipas Ligjit mbi Kompensimin për pjesën e papaguar të shpërblimit të gjyqtarëve shteti nuk kishte asnjë pengese për të shlyer pjesën e papaguar të pagave në tërësi dhe kishte kufizuar në tre vjet periudhën në lidhje me të cilën mund të paguhet kompensimi. Kërkuesit pohuan se në këtë mënyrë atyre u ishte pakësuar prona e tyre.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ritheksoi se qëllimi i nenit 35.1, i cili përcakton rregullin mbi shterimin e mjeteve juridike të brendshme, është t'u japë shteteve kontraktuese mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e pretenduara kundër tyre përpara se këto pretendime të paraqiten në GJEDNJ. Rregulli në nenin 35.1 bazohet në supozimin, pasqyruar në nenin 13 të Konventës - me të cilën ajo ka një afërsi të afërt - se ekziston një mjet efektiv juridik i disponueshëm në lidhje me shkeljen e pretenduar në sistemin e brendshëm. Në këtë mënyrë, është një aspekt i rëndësishëm i parimit që makineria e mbrojtjes e vendosur nga Konventa është ndihmëse e sistemeve kombëtare që ruajnë të drejtat e njeriut. Kështu që ankesa që synohet të bëhet më pas në Gjykatë duhet së pari të jetë bërë - të paktën në përmbajtje – pranë organit të duhur vendas dhe në përputhje me kërkesat zyrtare dhe afatet e përcaktuara në ligjin e brendshëm (shih, ndër shumë të tjera autoritete, *Selmouni kundër Francës* [DHM], nr. 25803/94, 74, KEDNJ 1999 - V, dhe praktikën gjyqësore të cituar në të).

Sidoqoftë, mjetet e vetme juridike të cilat neni 35 i Konventës kërkon të shterohen janë ato që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara dhe në të njëjtën kohë janë të disponueshme dhe të mjaftueshme. Ekzistenca e mjeteve juridike të tilla duhet të jetë mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. I bie shtetit të paditur të vërtetojë se këto kushte të ndryshme janë përmbushur (shih *Vernillo kundër Francës*, 20 shkurt 1991, 27, Seria A, nr. 198; *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, 66, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1996 - IV; dhe *Dalia kundër Francës*, 19 shkurt 1998, 38, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998). Për më tepër, sipas “parimeve të njohura përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare”, mund të ketë rrethana të veçanta që e lirojnë parashtruesin nga detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme juridike me të cilat disponon (shih *Selmouni*, cituar më lart, 75). Sidoqoftë, Gjykata theksoi se ekzistenca e dyshimeve të thjeshta në lidhje me perspektivat e suksesit të një mjeti juridik të veçantë që nuk është qartazi e kotë nuk është një arsye e vlefshme për mosshterimin e mjeteve juridike të brendshme (shih *Van Oosterwijck kundër Belgjikës*, 6 nëntor 1980, 37, Seria A nr. 40; dhe *Brusco kundër Italisë* (Vendim), nr. 69789/01, KEDNJ 2001-IX).

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vërejti se pagat e kërkesve ishin ulur që nga viti 2000. Masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet ishin justifikuar duke iu referuar ekzistencës së situatës veçanërisht të vështirë ekonomike dhe situatës financiare në Lituani. Madje, sipas Gjykatës, ulja e pagave të zyrtarëve publikë ishte kërkuar për të financuar arsimin, kujdesin shëndetësor, mirëqenien sociale dhe nevojat e tjera të shoqërisë. Prandaj, Gjykata u bind se në marrjen e vendimit për uljen e pagave të nëpunësit civil autoritetet lituaneze kishin pasur parasysh interesin publik. Gjykata gjithashtu vlerësoi se ulja e pagave në sektorin publik nuk e kishte veçuar gjyqësorin. Përkundrazi, ulja e pagave të gjyqtarëve ka qenë pjesë e një programi shumë më të gjerë të masave shtrënguese që prekën pagat në të gjithë sektorin publik. Në çdo rast, reduktimi i pagave të gjyqtarëve nuk kishte qenë joproporcional dhe nuk përbënte kërcënim për jetesën e tyre. Së fundi, ndërkohë që vërehet se rregullat e uljes së pagave, për fat të keq, nuk kishin pasur një dispozitë specifike në lidhje me një kufizim në kohë të masave shtrënguese, Gjykata vuri në dukje se në kohën kur kërkesat i ishin dorëzuar asaj, gjykatat dhe legjislacioni lituanez kishin përcaktuar masat si të përkohshme deri në përmirësimin e situatës ekonomike të shtetit lituanez, në vitin 2003. Kërkesit ishin kompensuar përfundimisht për humbjen e pagës së tyre me një vendim gjykate në përputhje me Ligjin e vitit 2000. Prandaj, Gjykata nuk e konsideroi se zvogëlimi i përkohshëm i pagave të gjyqtarëve i kishte bërë kërkesit të bartnin një barrë të tepërt ose kishte ndikuar në pavarësinë ose në aftësinë për të kryer funksionet e tyre si gjyqtarë. Prandaj, kjo pjesë e kërkesës ishte në përputhje me rrethanat dhe u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar (sipas nenit 35.3).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata shpalli kërkesat të papranueshme si qartazi të pabazuara.

3. PËRMBLEDHJE TË RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. ASSOCIAÇÃO SINDICAL DOS JUÍZES PORTUGUESES kundër TRIBUNAL DE CONTAS

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C64/16

27 shkurt 2018

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=199682&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13701430>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar; Rasti kishte të bënte me Ligjin që miratoi Parlamenti portugez për ulje të pagave në sektorin publik, përfshirë edhe në gjyqësor, për shkak të krizës ekonomike. Kjo ngriti pretendime për cenimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor, si vlera themelore të së drejtës së BE-së.

Faktet kryesore

Me Ligjin nr. 75/2014, Parlamenti portugez uli, me efekt nga tetori 2014 dhe përkohësisht, pagat e disa kategorive të funksionarëve në sektorin publik. Në zbatim të akteve administrative të “menaxhimit të pagave” të miratuara në bazë të këtij ligji, u ulën edhe pagat e gjyqtarëve të Tribunal de Contas²⁴

Associação Sindical dos Juizes Portugueses (“ASJP”)²⁵, duke vepruar në emër të gjyqtarëve të Tribunal de Contas, u ankua në Gjykatën e Lartë Administrative, duke kërkuar anulimin e këtyre akteve administrative

²⁴ Gjykata e Llogarive ose e Auditimit në Portugali.

²⁵ Shoqata e Sindikatave të Gjyqtarëve Portugezë.

me efekt që nga tetori 2014 e në vijim, detyrimin e palës së paditur për të kompensuar uljet e pagës që ishin bërë ndërkaq, së bashku me kamatëvonesat sipas normës ligjore, si dhe njohjen e së drejtës së palëve të interesuara për të marrë pagat e tyre të plota. Në mbështetje të ankesës së tyre, ASJP argumentoi se masat e uljes së pagave shkelnin “parimin e pavarësisë së gjyqtarëve”, të parashikuar jo vetëm nga Kushtetuta Portugeze, por edhe nga e drejta e BE-së, në nenin 19.1, nënparagrafi 2, të TBE-së si dhe në nenin 47 të Kartës.

Sipas Gjykatës së Lartë Administrative, masat për të zvogëluar përkohësisht shumën e shpërblimit në sektorin publik bazoheshin në nevojën për të zvogëluar deficitin e tepërt të buxhetit të Portugalisë gjatë vitit 2011. Ajo vlerësoi se këto masa u morën në kuadër të së drejtës së BE-së. Ose, të paktën, e kishin origjinën e tyre te BE, përderisa këto masa i ishin imponuar Qeverisë portugeze nga vendimet e BE-së, duke kushtëzuar me to dhënien e një ndihme financiare. Gjithsesi, ajo kujtoi se kompetenca diskrecionale e shtetit portugez për orientimin e politikës së tij buxhetore, të njohur nga institucionet e BE-së, nuk e liron atë nga detyrimi i saj për të respektuar parimet e përgjithshme të së drejtës së Unionit, përfshirë atë të pavarësisë së gjyqtarëve. Sipas Gjykatës së Lartë Administrative, garantimi i mbrojtjes efektive gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga rendi ligjor i BE-së, sipas nenit 19.1, nënparagrafi 2 i TBE-së, bëhet kryesisht nga gjykatat vendase. Këto gjykata duhet të vënë në jetë këtë mbrojtje në përputhje me parimet e pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuara në nenin 47 të Kartës. Në këtë drejtim, ajo theksoi se pavarësia e organeve gjyqësore varet nga garancitë që i jepen statusit të anëtarëve të tyre, përfshirë për sa i përket pagave.

Në këto rrethana, Gjykata e Lartë Administrative vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i drejtojë Gjykatës së Drejtësisë të BE-së pyetjen vijuese, për një vendim paraprak:

“Duke pasur parasysh domosdoshmëritë e eliminimit të deficitit të tepërt buxhetor dhe të ndihmës financiare të rregulluar nga dispozitat evropiane, parimi i pavarësisë së gjyqtarëve, siç rrjedh nga neni 19, paragrafi 1, nënparagrafi 2, i TBE-së, neni 47 i Kartës dhe jurisprudenca e GJDBE-së, a duhet të interpretohet në kuptimin që këto standarde kundërshtojnë masat që

parashikojnë uljen e pagave për gjyqtarët portugezë, pasi ato janë vendosur në mënyrë të njëanshme dhe të vazhdueshme nga organet e tjera sovraane, siç del nga neni 2 i Ligjit [nr. 75/2014]?”

Vendimi i Gjykatës

Gjykata arsyetoi se, sipas nenit 2 të TBE-së, BE bazohet në vlera të tilla, siç është shteti i së drejtës, të cilat janë të përbashkëta për shtetet anëtare në një shoqëri ku, ndër të tjera, mbizotëron drejtësia. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se besimi i ndërsjellë midis shteteve anëtare dhe, në veçanti, gjykatave të tyre bazohet në premisën themelore sipas së cilës shtetet anëtare ndajnë një sërë vlerash të përbashkëta mbi të cilat është themeluar BE-ja, siç është specifikuar në këtë nen. Gjykata kujtoi gjithashtu se BE është një bashkësi e së drejtës në të cilin individët kanë të drejtë të kundërshtojnë në gjykatë ligjshmërinë e çdo vendimi ose të ndonjë akti tjetër kombëtar që lidhet me zbatimin e një akti të BE-së ndaj tyre.

Sipas Gjykatës, neni 19 i TBE-së, i cili mishëron vlerën e shtetit të së drejtës të theksuar në nenin 2 të TBE-së, ia beson detyrën e rishikimit gjyqësor në rendin juridik të Bashkimit Evropian jo vetëm GJDBE-së, por edhe gjykatave kombëtare. Këto gjykata përmbushin, në bashkëpunim me GJDBE-në, një funksion që u është caktuar atyre së bashku, me qëllim që të sigurojnë respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e traktateve. Prandaj, u takon shteteve anëtare, sidomos në bazë të parimit të bashkëpunimit luajal të përcaktuar në nënparagrafin 1 të nenit 4.3 të TBE-së, të sigurojnë, në territorin e tyre, zbatimin dhe respektimin e së drejtës së BE-së. Në këtë drejtim dhe siç parashikohet në nënparagrafin 2 të nenit 19.1 të TBE-së, shtetet anëtare krijojnë mjete ankimore të nevojshme për t'u siguruar palëve ndërgjyqëse respektimin e së drejtës së tyre për mbrojtje efektive gjyqësore në fushat e mbuluara nga e drejta e BE-së. Kështu, u takon shteteve anëtare që të sigurojnë një sistem mjetesh dhe procedurash ligjore që sigurojnë rishikim efektiv gjyqësor në këto fusha.

GJDBE më tutje arsyetoi se parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore të të drejtave që individëve u lindin nga e drejta e BE-së e të cilit i referohet nënparagrafi 2 i nenit 19 (1) të TBE-së, përbën, në fakt, një parim të përgjithshëm të së drejtës së BE-së që buron nga traditat kushtetuese të

përbashkëta të shteteve anëtare, i cili është parashikuar në nenet 6 dhe 13 të KEDNJ dhe është afirmuar tani edhe në nenin 47 të Kartës. Ekzistenca e një rishikimi gjyqësor efektiv që synon të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtën e BE-së është përbërës i natyrshëm i shtetit të së drejtës. Si rrjedhojë, çdo shtet anëtar duhet të sigurojë që organet që përfshihen si gjykata, sipas kuptimit të përcaktuar nga e drejta e BE-së, në sistemin e tij të mjeteve juridike në fushat e mbuluara nga e drejta e BE-së të plotësojnë kriteret e mbrojtjes efektive gjyqësore. Ndërmjet elementeve që merren parasysh në vlerësimin e statusit të “gjykatës” janë: baza ligjore e krijimit të organit (gjykatës), qëndrueshmëria e tij, natyra e detyrueshme e vendimmarrjes, natyra kontradiktore e procedurës para tij (parimi i kontradiktoritetit procedural), zbatimi i rregullave të së drejtës nga ana e tij si dhe pavarësia e tij.

Në çështjen në fjalë, përderisa Tribunal de Contas është i aftë të vendosë, si ‘gjykatë’, brenda kuptimit të përmendur në paragrafin më lart, mbi çështjet në lidhje me zbatimin ose interpretimin e së drejtës së BE-së, shteti anëtar i interesuar duhet të sigurojë që ai organ i plotëson kriteret e mësipërme për të ofruar mbrojtje efektive gjyqësore, në përputhje me nenin 19.1, nënparagrafi 2, i TBE-së. Në mënyrë që të mund të garantohet kjo mbrojtje, ruajtja e pavarësisë së një organi të tillë është thelbësore, siç konfirmohet nga paragrafi 2 i nenit 47 të Kartës, i cili përmend qasjen në një gjykatë “të pavarur” ndërmjet kriterëve që lidhen me të drejtën themelore për mjete ligjore efektive.

Garancia e pavarësisë si pjesë përbërëse e natyrshme e funksionit të gjyqimit, kërkohet jo vetëm në nivelin e BE-së, për gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës dhe Tribunalit të BE, siç parashikohet në nenin 19.2, nënparagrafi 3 të TBE-së, por edhe për gjykatat kombëtare, në nivelin e shteteve anëtare. Pavarësia e gjykatave kombëtare është, në veçanti, thelbësore për funksionimin e duhur të sistemit të bashkëpunimit gjyqësor të mishëruar në mekanizmin e kërkesave paragjykimore të parashikuar në nenin 267 të TFBE-së, përderisa ky mekanizëm mund të përdoret vetëm nga një organ përgjegjës për zbatimin e së drejtës së BE-së, i cili plotëson, në veçanti, kriterin e pavarësisë.

GJDBE më tutje argumentoi se nocioni i pavarësisë presupozon, në veçanti, që organi në fjalë t’i ushtrojë funksionet e tij gjyqësore në një

autonomi të plotë, pa iu nënshtruar ndonjë lidhjeje hierarkike ose varësie ndaj askujt dhe pa marrë urdhra ose udhëzime nga askush. Ajo mbrohet kështu nga ndërhyrjet ose presionet e jashtme që mund të cenojnë pavarësinë e gjykimit të anëtarëve të saj dhe të ndikojnë në vendimet e tyre. Ashtu si pandryshueshmëria e anëtarëve të organit në fjalë, shpërblimi i tyre në një nivel të drejtë në raport me rëndësinë e funksioneve që ata kryejnë përbën një garanci të qenësishme të pavarësisë së gjyqtarëve.

Në këtë çështje masat e uljes së pagave në fjalë në procedurën kryesore u miratuan për shkak të kërkesave të lidhura me eliminimin e deficitit buxhetor të shtetit portugez dhe në kontekstin e një programi të ndihmës financiare të BE për atë shtet anëtar. Këto masa parashikuan një ulje të kufizuar të pagave, deri në një përqindje që ndryshon në varësi të nivelit të tyre. Këto ulje janë zbatuar jo vetëm për anëtarët e Tribunal de Contas, por, më gjerë, për zyrtarë të ndryshëm publikë dhe për persona që ushtrojnë funksione në sektorin publik, përfshirë përfaqësuesit e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Prandaj, këto masa nuk mund të perceptohen se janë miratuar posaçërisht në lidhje me anëtarët e Tribunal de Contas. Përkundrazi, ato janë të ngjashme me masat e përgjithshme që synojnë që funksionarët e shërbimit civil kombëtar të kontribuojnë në përpjekjet për kursim, të diktuar nga domosdoshmëritë e zvogëlimit të deficitit të tepërt në buxhetin e shtetit portugez.

Së fundmi, siç shihet nga titulli i Ligjit nr. 75/2014 dhe nga vetë formulimi i nenit 1, paragrafi 1, masat e uljes së pagave të vendosura nga ky ligj, të cilat hynë në fuqi më 1 tetor 2014, kishin një karakter të përkohshëm. Ato morën fund përfundimisht më 1 tetor 2016. Në këto rrethana, masat e uljes së pagave nuk mund të konsiderohen si cenim i pavarësisë së anëtarëve të Tribunal de Contas.

Neni 23

Dinjiteti i Njeriut

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI39/09. PARASHTRUES: AVNI KUMNOVA

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_39_09_shq.pdf]

3 nëntor 2011

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar; Çështja kryesore kushtetuese e ngritur në këtë rast kishte të bënte me pretendimin se, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, parashtruesit i ishin shkelur disa të drejta të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenet kushtetuese në vijim: nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], si dhe me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

Faktet kryesore

Më 16 mars 2005, parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar një kontratë pune me kompaninë Ibër-Lepenc për një periudhë të pacaktuar kohore, me të cilën parashtruesi i kërkesës do të punësohej si inxhinier për mirëmbajtjen e pajisjeve elektroteknike. Kontrata, ndër të tjera, parashihte që «palët kontraktuese mund të heqin dorë nga kontrata, sipas kushteve të parashikuara me Ligj dhe Kontratë kolektive». Më 11 korrik 2005, Ibër-Lepenci mori Vendim për të ndërprerë kontratën e punës me parashtruesin e kërkesës për këto arsye: përmbushje e pakënaqshme e detyrave; refuzim i paarsyeshëm për të kryer obligimet e kontratës së punës; sjellje të një natyre aq serioze sa do të ishte e paarsyeshme të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës; dhe mungesë e paarsyeshme nga puna. Më 20 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Bordit të Menaxhmentit të Ibër-Lepencit dhe më 21 korrik 2005, ai kërkoi nga Inspektorati i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit të punëdhënësit. Më 28 korrik 2005, Inspektori ishte përgjigjur se vendim

me të cilin Ibër-Lepenci kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me parashtruesin e kërkesës nuk kishte efekt juridik. Inspektori konkludoi se, në bazë të nenit 24 të Kontratës Kolektive, nuk duhej të ishte Drejtori Gjeneral, por Komisioni disiplinor, i caktuar nga punëdhënësi apo Këshilli i Menaxhmentit ose Bordi i ndërmarrjes, organi kompetent për shqiptimin e masave disiplinore në rastet e shkeljes së rëndë të kritereve të punës. Inspektori më tej vendosi se mungesa e këshillës juridike në Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit ishte shkelje e të drejtave themelore për mbrojtjen e marrëdhënieve të punës dhe urdhëroi ndërmarrjen Ibër-Lepenci që të eliminojë parregullsitë dhe Bordin e Menaxhmentit të Ibër-Lepencit të anulojë Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Më 20 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës parashtroi kundërshtim ndaj vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së tij të punës dhe më 29 korrik 2005, Bordi i Menaxhmentit të ndërmarrjes Ibër-Lepenci e refuzoi kundërshtimin e parashtruar dhe konfirmoi vendimin e kontestuar. Pas kësaj, parashtruesi inicioi procedurë në Gjykatën Komunale të Prishtinës e cila, më 24 prill 2006, vendosi se Vendimi 01-1429 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit ishte i paligjshëm dhe si i tillë duhej të anulohet, sepse ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe Ligjin mbi Marrëdhëniet e Punës. Gjykata Komunale urdhëroi ndërmarrjen Ibër-Lepenci që të kthejë parashtruesin e kërkesës në pozitën dhe detyrat e tij dhe të njëjtit t'i njihen të gjitha të drejtat nga kontrata e punës prej 30 qershorit 2005 – data e ndërprerjes – deri në kthimin e parashtruesit të kërkesës në punë. Ndërmarrja Ibër-Lepenci paraqiti ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe, më 2 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi plotësisht konkluzionet faktike dhe arsyetimin ligjor të Gjykatës Komunale. Gjykata e Qarkut argumentoi se vendimi i kontestuar i ndërmarrjes Ibër-Lepenci, me të cilin ishte shqiptuar masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me parashtruesin e kërkesës, ishte si pasojë e dispozitave të procedurave disiplinore, por punëdhënësi nuk kishte iniciuar procedura të tilla disiplinore në pajtim me aktet normative të zbatueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës si dhe në pajtim me nenet 59, 60 dhe 61 të Ligjit mbi të Drejtat Themelore të Marrëdhënieve së Punës, i zbatueshëm në Kosovë. Pas kësaj, ndërmarrja Ibër-Lepenci paraqiti revizion në Gjykatën Supreme.

Më 27 maj 2009, Gjykata Supreme e miratoi kërkesën e Ibër-Lepencit për revizion, duke kthyer në rigjykim vendimet e gjykatave më të ulëta dhe hodhi poshtë pretendimin e parashtruesit se marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë në kundërshtim me ligjin dhe kontratën e zbatueshme kolektive. Gjykata Supreme arsyetoi se gjykatat e shkallëve më të ulëta kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, pasi që në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ishte paraparë që ndërprerja e kontratës së punës mund të bëhet pa obligimin për të iniciuar procedura disiplinore dhe se punëdhënësi ishte obliguar vetëm për të njoftuar të punësuarin rreth qëllimit të tij për të ndërprerë kontratën e punës në rastet e rënda të sjelljes së keqe, ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave nga i punësuarin dhe se një njoftim i tillë duhej të përfshinte arsyet për një largim të tillë, ashtu siç ka vepruar Ibër-Lepenci. Më pas, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori Publik dhe iu drejtua Zyrës së Avokatit të Popullit, por që të dyja veprimet ishin të pasuksesshme. Më 18 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi pretendoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrim të Profesioneve] të Kushtetutës, si dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Parashtruesi argumentoi se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte i padrejtë sepse e kishte aplikuar gabimisht ligjin kur kishte vendosur se punëdhënësi i tij kishte vepruar drejt.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën të pranueshme për shqyrtimin e meritave të saj. Lidhur me meritat e kërkesës, Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk kishte mundur të vërtetojë shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese. Gjykata theksoi se kompetenca e saj ishte e kufizuar në shqyrtimin e pretendimeve për shkeljet kushtetuese, siç është p.sh, se a ka pasur parashtruesi gjykim të drejtë e jo që të zgjidhë edhe kontestet ligjore ose faktike. Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk

kishte mundur të dëshmojë se procedurat e Gjykatës Supreme ishin të padrejta ose arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk kishte mundur të vërtetojë shkeljen e Kushtetutës, gjegjësisht se ishin cenuar të drejtat e tij kushtetuese.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash, vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk kishte shkaktuar shkelje të neneve 23, 24, 49 të Kushtetutës dhe as të nenit 13 të KEDNJ-së.

1.2. KI 108/18. PARASHTRUES: BLERTA MORINA

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/10/ki_108_18_av_shq.pdf]

5 shtator 2019

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore kushtetuese e ngritur përmes kësaj kërkesë ishte shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Agjencisë së Regjistrimit Civil përmes së cilit ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës, si person transgjinator, për ndërrim ligjor të emrit nga “Blerta” në “Blert” dhe ndërrim ligjor të shënuesit të gjinisë nga gjinia femërore “F” në gjininë mashkullore “M”. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se Agjencia e Regjistrimit Civil i kishte shkelur atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], si dhe nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duhet sqaruar fillimisht se Gjykata Kushtetuese, në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ për sa i përket personave transgjinator, iu referua parashtruesit të kërkesës në gjininë mashkullore, duke respektuar kështu vetidentifikimin e tij me atë gjini.

Faktet kryesore

Parashtruesi i kërkesës kur kishte lindur ishte regjistruar në librat e regjistrit civil të Republikës së Kosovës me emrin “Blerta Morina” dhe me shënuesin e gjinisë femërore, përkatësisht “F”. Parashtruesi i kërkesës gjithnjë kishte pasur tendenca të identifikohet me gjininë mashkullore dhe jo atë femërore të përcaktuar në lindje. Si i rritur, ai pohonte se jeton dhe paraqitet si “burrë në të gjitha sferat e jetës,” prandaj emri dhe gjinia e shënuar në dokumentet e tij të identifikimit nuk përkonin me emrin me të cilin ai prezantohet dhe me gjininë me të cilin ai identifikohet. Në vitin 2017 parashtruesi i kërkesës kishte vizituar psikologun dhe psikoterapeutin, me qëllim të diskutimit të çështjes së trajtimit hormonal për “tranzicion” fizik nga femër në mashkull dhe, pas marrjes së rekomandimit pozitiv nga eksperti mjekësor në vitin 2018, ai kishte filluar trajtimin hormonal përkitazi me tranzicionin.

Më 4 prill 2018, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë në Zyrën e Gjendjes Civile, Departamenti për Punë të Përgjithshme Administrative në Komunën e Gjakovës. Parashtruesi kishte kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile që emri personal dhe shënuesi i gjinisë të ndryshoheshin në të gjitha dokumentet e identifikimit në mënyrë që “emri dhe shënuesi i gjinisë të jenë në harmoni me identitetin e tij gjinor”. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kishte shpjeguar se ai, qysh nga fëmijëria, kishte tendenca të vishej si mashkull dhe të identifikohet me gjininë mashkullore dhe jo atë femërore të përcaktuar në lindje. Kërkesën e tij për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të gjinisë, parashtruesi i kërkesës e kishte argumentuar duke theksuar se ai ndihej i diskriminuar dhe i përjashtuar nga shoqëria për shkak të mospërputhjes së identitetit të tij gjinor me shënuesin e gjinisë në dokumentet e tij të identifikimit.

Më 26 prill 2018, Zyra e Gjendjes Civile përmes Vendimit nr. 02-201-02-8319 e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës nuk i plotësonte kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ për Emrin Personal. Sipas Zyrës së Gjendjes Civile, arsyet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës nuk qëndrojnë dhe nuk e përmbushin qëllimin e nën-paragrafit 1 të paragrafit 1 të nenit 6 të këtij Udhëzimi Administrativ për Emrin Personal pasi që emri “Blerta” nuk e pengonte integrimin e personit në

shoqëri në Republikën e Kosovës. Zyra e Gjendjes Civile nuk arsyetoi refuzimin e kërkesës për ndërrimin e shënuesit të gjinisë. Më 29 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Agjencinë e Regjistrimit Civil, kundër vendimit të Zyrës së Gjendjes Civile. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil që të anulonte vendimin e kontestuar të Zyrës së Gjendjes Civile sepse, sipas pretendimit, i njëjti ishte i “paligjshëm dhe diskriminues”. Më 13 qershor 2018, Agjencia e Regjistrimit Civil, përmes Vendimit nr. 64/04, e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se Vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile ishte nxjerrë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për sa i takon ankesës së parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-miratimin e ndërrimit të emrit personal nga “Blerta” në “Blert”, Agjencia e Regjistrimit Civil theksoi se arsyeja e dhënë nga parashtruesi i kërkesës për ndërrimin e emrit personal nuk qëndron sepse nuk është “dhënë asnjë dëshmi, shkrësë, shënim tjetër apo fotografi, dokument arkivor që tregon se emri personal Blerta Morina po e pengon personin në integrimin e saj në shoqëri”. Për sa i takon aspektit të dytë, përkatësisht ankesës së parashtruesit të kërkesës lidhur me mosmiratimin e kërkesës së tij për ndërrim të shënuesit të gjinisë, Agjencia e Regjistrimit Civil theksoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është e bazuar “sepse sipas ligjit nënkuptohet që vërtetimi i gjinisë dhe eventualisht ndërrimi apo korigjimi i këtij përbërësi të gjendjes civile bëhet vetëm me një raport apo vendim mjekësor”. Më tutje, Agjencia e Regjistrimit Civil theksoi që “personi duhet që ndryshimet eventuale të përbërësve të gjendjes civile që janë fakte që rrjedhin nga ngjarje natyrore ku përfshihet edhe gjinia e personit si fakt natyror duhet të rregullohen me raport mjekësor, pastaj raporti mjekësor prodhon pasoja juridike në përbërësit e gjendjes civile”.

Më 24 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës ngriti padi për konflikt administrative në Gjykatën Themelore, kundër Vendimit nr. 64/04 të Agjencisë së Regjistrimit Civil. Në ndërkohë, në intervalin kohor dhjetor 2018 – korrik 2019, parashtruesi kishte paraqitur pesë kërkesa në Gjykatën Themelore duke kërkuar përshpejtimin e vendosjes së rastit në konflikt administrativ.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Agjencia e Regjistrimit Civil i ka shkelur atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 36 [E drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare) të KEDNJ. Përveç kësaj, kërkesë kryesore procedurale e parashtruesit të kërkesës para Gjykatës Kushtetuese ishte që ai të lirohet nga detyrimi për të shteruar mjetin juridik të përcaktuar me ligj, përkatësisht “padinë për konflikt administrativ”. Për sa i përket shterimit të mjeteve juridike, parashtruesi arsyetoi se në sistemin juridik të Republikës së Kosovës detyrimi për shterimin e mjeteve juridike bazohet në supozimin se ky rend juridik siguron mjete efektive për adresimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë. Parashtruesi argumentoi se pa paragjykuar vendimin që do të merrte Gjykata Themelore apo Gjykata e Apelit, periudha e stërgjatë kohore për shqyrtimin dhe zgjidhjen e një lënde administrative në rastin e parashtruesit e bën mjetin juridik të papërshtatshëm dhe joefektiv pikërisht për shkak të rrethanave të veçanta të rastit konkret. Po ashtu, parashtruesi pretendoi se ekzistonte mundësia reale që Gjykata Themelore të mos e vendos rastin në merita, por vetëm ta kthejë në procedurë administrative pranë organeve administrative që veçse kanë vendosur, gjithë që e bën kohëzgjatjen e procedurës së paku dyfish më të gjatë. Prandaj, parashtruesi pretendoi se mjetet juridike në dispozicion ishin joefektive për adresimin e shkeljeve përkatëse dhe rrjedhimisht kërkoi që bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, të lirohej nga përmbushja e këtij detyrimi të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese.

Për sa i përket meritave të kërkesës, parashtruesi theksoi se refuzimi i ndërrimit të emrit të tij ka cenuar të drejtën e tij në privatësi e cila, sipas praktikës së GJEDNJ-së, përfshin edhe identitetin gjinor. Parashtruesi argumentonte se GJEDNJ ka theksuar se “nocioni i autonomisë personale është parim i rëndësishëm që përcakton interpretimin e garancive nga neni 8 i KEDNJ-së dhe që, duke qenë se në vetë esencën e KEDNJ-së qëndron respekti për dinjitetin dhe lirinë njerëzore, e drejta

e personave transgjinator në zhvillim personal, siguri fizike dhe morale është e mbrojtur nga KEDNJ” (parashtruesi iu referua disa rasteve të GJEDNJ për të mbështetur këtë argument). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi se vendimi i lartcekur është nxjerrë edhe në shkelje të së drejtave të tij të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i njeriut] të Kushtetutës. Parashtruesi gjithashtu pretendoi se vendimi i Agjencisë së Regjistrimit Civil ishte nxjerrë në shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës dhe rrjedhimisht ishte diskriminues, sepse përjashtonte parashtruesin, mbi bazën e identitetit gjinor, nga përfitimi i të drejtave të garantuara për të gjithë qytetarët e tjerë.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vendosjen e këtij rasti, Gjykata Kushtetuese u ndal te (mos)plotësimi i kushtit të shterimit të mjeteve juridike për pranueshmërinë e kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata vuri theksin në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e një mjeti juridik efektiv në rrethanat e rastit të tij. Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të parashtruesit të kërkesës, Gjykata shqyrtoi specifikisht nëse padia për konflikt administrativ ishte mjet juridik efektiv dhe i mjaftueshëm. Gjykata konstatoi se padia për konflikt administrativ ishte mjet juridik efektiv dhe mjaftueshëm i sigurt në teori dhe në praktikë. Sipas Gjykatës, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta, ky mjet juridik ishte në gjendje të ofrojë zgjidhje përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij/saj të garantuara me Kushtetutë, si dhe të ofrojë mundësi të arsyeshme për sukses. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se kërkesa ishte papranueshme, për shkak se nuk ishin shteruar mjetet juridike.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, njëzëri, vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme për shkak të moshterimit të mjeteve juridike.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. OLEKSANDR VOLKOV kundër UKRAINËS

[21722/11]

GJEDNJ [Seksioni V]

9 janar 2013

***Çështja kyçe /e drejta e pretenduar:** shkarkimi i një gjyqtari të Gjykatës së Lartë dhe shkeljet e procedurale që çuan në të; çështjet që lidhen me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit; defektet strukturore të sistemit të disiplinës gjyqësore; mungesa e periudhës së kufizimit për caktimin e dënimit disiplinor mbi gjyqtarët dhe abuzimi i sistemit të votimit elektronik në Parlament gjatë miratimit të vendimit për shkarkimin e gjyqtarit; përbërja e dhomës që shqyrton çështjen e caktuar nga një gjyqtar mandati i të cilit si kryetar i gjykatës ka skaduar; largimi i një gjyqtari për “shkelje të betimit” në mungesë të një interpretimi të qëndrueshëm të asaj vepre dhe të mbrojtjeve procedurale të kërkuara*

Faktet kryesore

Rasti është ngritur më 30 mars 2011, nga Oleksandr Fedorovych Volkov (kërkuesi), një shtetas ukrainas. Nga viti 2003, kërkuesi ishte gjyqtar i Gjykatës Supreme të Ukrainës dhe nga viti 2007 Kryetar i Dhomës Ushtarake të asaj gjykate. Në vitin 2007 ai u zgjodh në postin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm: “KLD”), por nuk mori detyrën pas refuzimit të Kryetarit të Komitetit Parlamentar të Gjyqësorit (“Komiteti Parlamentar”) për t’i lejuar që ai të bëjë betimin. Në vitin 2008 dhe 2009, dy anëtarë të KLD-së - njëri prej të cilëve u zgjodh Kryetar i KLD-së më vonë - kryen hetime paraprake për sjellje të pahijshme të mundshme nga kërkuesi. Ata arritën në përfundimin se ai kishte rishikuar vendimet e dhëna nga vëllai i gruas së tij - disa prej tyre datonin që nga viti 2003 - dhe se ai kishte qenë fajtor për

shkelje të rënda procedurale, disa nga veprimet e tij datonin që nga viti 2006. Pas këtyre hetimeve, Kryetari i KLD-së paraqiti dy kërkesa në Parlament për shkarkimin e kërkuarit nga posti i gjyqtarit. Më 2010 Parlamenti, pasi shqyrtoi këto aplikime nga KLD, një rekomandim nga Komiteti Parlamentar, votoi për shkarkimin e kërkuarit për “shkelje të betimit”. Sipas kërkuarit, gjatë votimit elektronik shumica e anëtarëve të parlamentit munguan dhe të pranishmit përdorën karta votimi që u përkisnin kolegëve të tyre të munguar. Kërkuari sfidoi shkarkimin e tij përpara Gjykatës së Lartë Administrative, e cila gjeti që kërkesa e KLD-së për ta shkarkuar pas hetimit të Kryetarit të KLD-së kishte qenë e ligjshme dhe e vërtetuar. Gjykata e Lartë Administrative gjeti më tej se vendimi i KLD-së bazuar në rezultatet e hetimit tjetër kishte qenë i paligjshëm, sepse kërkuari dhe vëllai i gruas së tij nuk ishin konsideruar të afërm sipas legjislacionit në fuqi në atë kohë. Sidoqoftë, ajo refuzoi të prishë aktet e KLD-së në atë rast, duke vërejtur se sipas dispozitave në fuqi ajo nuk kishte asnjë fuqi për ta bërë këtë. Gjykata e Lartë Administrative më tej vuri në dukje se nuk kishte pasur shkelje procedurale as para komisionit parlamentar, as në Parlament.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuari u ankua për shkelje të të drejtave të tij sipas Konventës gjatë shkarkimit të tij nga posti i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Në veçanti, ai pretendoi sipas nenit 6 të Konventës se (i) çështja e tij nuk ishte shqyrtuar nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”; (ii) procedurat para Këshillit të Lartë të Drejtësisë kishin qenë të padrejta, në atë që ato nuk ishin kryer në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji i brendshëm duke siguruar masa të rëndësishme mbrojtëse procedurale, duke përfshirë afatet e parashkrimit të dënimeve disiplinore; (iii) Parlamenti kishte miratuar një vendim për shkarkimin e tij në një mbledhje plenare pa një shqyrtim të duhur të çështjes dhe duke abuzuar sistemin elektronik të votimit; (iv) çështja e tij nuk ishte dëgjuar nga një “gjykatë e themeluar me ligj”; (v) vendimet në çështjen e tij ishin marrë pa vlerësimin e duhur të provave dhe argumentet e rëndësishme të ngritura nga mbrojtja nuk ishin adresuar si duhet; (vi) mungesa e kompetencës së mjaftueshme nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative (“KLP”) për të rishikuar aktet e miratuara nga KLD ishte në kundërshtim me “të drejtën e tij për gjykatë”; dhe (vii) parimi i

barazisë së armëve nuk ishte respektuar. Kërkuesi gjithashtu u ankua se shkarkimi i tij nuk ishte në përputhje me nenin 8 të Konventës dhe se ai nuk kishte asnjë mjet efektiv juridik në lidhje me këtë, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6.1, gjatë shqyrtimit të çështjes së kërkuesit dhe gjatë marrjes së vendimit detyrues, GJEDNJ vërejti se KLD, komisioni parlamentar dhe mbledhja plenare e Parlamentit, kishin kryer një funksion gjyqësor të kombinuar. Vendimi detyrues për shkarkimin e kërkuesit më tej ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë Administrative, e cila ishte një gjykatë klasike në kuadër të gjyqësorit vendor. Prandaj, nuk mund të arrihej në përfundimin që e drejta vendore “shprehimisht përjashtonte qasjen në gjykatë” siç pretendonte kërkuesi. Kështu, në rastin e kërkuesit neni 6 zbatohet në aspektin civil të tij (“*civil limb*”).

Më tej, Gjykata vuri në pah se dënimi i caktuar për kërkuesin ishte një masë klasike disiplinore për sjellje të pahijshme profesionale dhe, për sa i përket të drejtës vendore, ishte në kontrast me dënimet e së drejtës penale për marrjen e një vendimi të gabuar me qëllim nga një gjyqtar. Po ashtu, ishte i rëndësishëm fakti që shkarkimi i kërkuesit nga posti i gjyqtarit nuk e kishte parandaluar atë formalisht që të punojë në një cilësi tjetër brenda profesionit ligjor. Prandaj, në rastin e kërkuesit neni 6 nuk ishte i zbatueshëm sipas aspektit të tij penal (“*criminal limb*”).

Sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë së organeve që vendosën çështjen e kërkuesit, Gjykata theksoi se për sa i përket procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve, nevoja e pjesëmarrjes së konsiderueshme të gjyqtarëve në organin disiplinor përkatës ishte njohur në Kartën Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët. Megjithatë, KLD përbëhej nga njëzet anëtarë të cilët ishin emëruar nga organe të ndryshme. Tre anëtarë ishin emëruar drejtpërdrejt nga Presidenti i Ukrainës, tre nga Parlamenti i Ukrainës, dhe dy nga Konferenca Mbarëukrainase e Prokurorëve. Ministri i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm ishin anëtarë *ex officio* të KLD-së. Staf i jogjyqësor i emëruar drejtpërdrejt nga autoritetet ekzekutive dhe legjislative përbënte shumicën dërrmuese të anëtarëve të KLD-së. Për pasojë, çështja e kërkuesit ishte vendosur

nga gjashtëmbëdhjetë anëtarë të KLD-së, të cilët kishin marrë pjesë në seancë, prej të cilëve vetëm tre ishin gjyqtarë. Për më tepër, vetëm katër anëtarë të KLD-së punonin aty me orar të plotë. Anëtarët e tjerë vazhdonin të punonin dhe të merrnin rroga jashtë KLD-së, çka në mënyrë të pashmangshme përfshinte varësinë e tyre materiale, hierarkike dhe administrative ndaj punëdhënësve të tyre kryesorë dhe rrezikonte si pavarësinë, ashtu edhe paanshmërinë e tyre. Gjykata iu referua gjithashtu opinionit të Komisionit të Venecias që prania e Prokurorit të Përgjithshëm në një organ që merrej me emërimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve krijonte rrezikun që gjyqtarët nuk do të vepronin në mënyrë të paanshme në raste të tilla, ose që Prokurori i Përgjithshëm nuk do të vepronte në mënyrë të paanshme kundruall gjyqtarëve, me vendimet e të cilëve ai nuk kishte qenë dakord. Më tej, anëtarët e KLD-së të cilët kishin zhvilluar hetimet paraprake në çështjen e kërkuarit dhe kishin parashtruar kërkesat për shkarkimin e tij kishin marrë pjesë më pas në vendimet për ta larguar parashtruesin nga posti. Njëri prej atyre anëtarëve ishte emëruar Kryetar i KLD-së dhe kishte kryesuar seancën e çështjes së kërkuarit. Roli i atyre anëtarëve në ngritjen e akuzave disiplinore kundër parashtruesit, të bazuara mbi rezultatet e hetimeve paraprake të zhvilluara nga vetë ata, hidhte dyshime objektive mbi paanshmërinë e tyre në marrjen e vendimit për themelet e çështjes së kërkuarit. Rrjedhimisht, faktet e kërkesës në fjalë zbuluan disa çështje serioze në lidhje me mangësitë procedurale në procedurat para KLD-së dhe me atë që dukej të ishte njëanshmëri personale nga ana e disa anëtarëve të caktuar të KLD-së që kishin vendosur çështjen e kërkuarit. Kështu, procedurat para KLD-së nuk kishin qenë në përputhje me parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë që kërkohen nga neni 6.1.

Gjykata vërejti në lidhje me Komisionin Parlamentar se Kryetari i Komisionit dhe njëri prej anëtarëve të tij ishin gjithashtu anëtarë të KLD-së dhe kishin marrë pjesë në vendosjen e çështjes së kërkuarit në të dy nivelet. Rrjedhimisht, ata mund të mos kenë vepruar në mënyrë të paanshme gjatë shqyrtimit të parashtrësive të KLD-së. Përveç kësaj, konsideratat e Gjykatës në lidhje me mungesën e paanshmërisë personale ishin po aq relevante për këtë fazë të procedurës. Më tej, duhet të merret parasysh mirë fakti që kryetari, së bashku me dy anëtarë të Komisionit Parlamentar, kishin bërë kërkesë në KLD-së për nisjen e hetimeve paraprake për sjelljen e pahijshme të mundur

të kërkuesit. Njëkohësisht, anëtarët e KLD-së nuk kishin mundur të tërhiqeshin meqenëse legjislacioni përkatës nuk parashikonte asnjë procedurë tërheqjeje. Kjo tregonte mungesën e garancive të duhura për pajtueshmërinë e procedurave me testin e paanshmërisë objektive.

Sa i përket Mbledhjes plenare e Parlamentit, Gjykata theksoi se në atë fazë, përcaktimi i çështjes ishte kufizuar me miratimin e një vendimi detyrues të bazuar mbi gjetjet e mëparshme të KLD-së dhe Komisionit Parlamentar. Në tërësi, procedura në mbledhjen plenare nuk ishte forum i përshtatshëm për shqyrtimin e çështjeve të faktit dhe ligjit, për vlerësimin e provave dhe përcaktimin e kualifikimit ligjor të fakteve. Roli i politikanëve të pranishëm në Parlament, të cilëve nuk u kërkohesh të kishin përvojë ligjore dhe gjyqësore, nuk ishte sqaruar mjaftueshëm nga Qeveria dhe nuk ishte arsyetuar se ishte në përputhje me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë së një tribunali.

Në lidhje me Gjykatën më të Lartë Administrative: Gjykata theksoi se Gjykata më e Lartë Administrative kishte fuqinë t'i deklaronte vendimet e KLD-së dhe të Parlamentit të paligjshme pa pasur mundësinë t'i prishte ato dhe të merrte hapa të mëtejshëm. Nuk kishte rivendosje automatike në postin e një gjyqtari ekskluzivisht mbi bazën e vendimit deklarativ të Gjykatës më të Lartë Administrative. Për më tepër, argumente të rëndësishme të paraqitura nga parashtruesi nuk ishin diskutuar si duhej nga Gjykata më e Lartë Administrative. Kështu, shqyrtimi gjyqësor i çështjes së parashtruesit nuk kishte qenë i mjaftueshëm. Më tej, gjyqtarët e Gjykatës më të Lartë Administrative ishin gjithashtu nën juridiksionin disiplinor të KLD-së dhe po ashtu mund t'u nënshtroheshin procedurave disiplinore para KLD-së. Prandaj, ata nuk kishin mundësi të demonstronin "pavarësinë dhe paanshmërinë" që kërkohet nga neni 6.

Kështu, autoritetet vendase nuk kishin arritur të siguronin përcaktimin e pavarur dhe të paanshëm të çështjes së parashtruesit dhe shqyrtimi gjyqësor i mëpasshëm nuk i kishte korrigjuar ato defekte, gjë që kishte rezultuar në shkelje.

Sa i përket mungesës së një periudhe kufizimi për caktimin e një dënimi disiplinor – Gjykata theksoi se kërkuesi ishte vënë në pozitë të vështirë,

sepse ai duhej të përgatiste mbrojtjen e tij para KLD-së në vitin 2010 në lidhje me ngjarje disa prej të cilave kishin ndodhur në të kaluarën e largët (në vitet 2003 dhe 2006). E drejta vendase nuk parashikonte kufizime kohore në lidhje me procedurat për shkarkimin e një gjyqtari për “shkelje të betimit”. Ndërkohë që Gjykata nuk e konsideroi të duhur të cekte se sa e gjatë duhet të ishte periudha kufizuese, një qasje e tillë pa afat në çështje disiplinore ku përfshihej gjyqësori paraqiste një rrezik serioz për parimin e sigurisë ligjore, gjë që kishte rezultuar në shkelje.

Në lidhje me procedurën e votimit në mbledhjen parlamentare të Parlamentit – Vendimi për shkarkimin e parashtresit ishte votuar në mungesë të shumicës së anëtarëve të Parlamentit. Anëtarët e Parlamentit që kishin qenë të pranishëm kishin hedhur me qëllim dhe në mënyrë të paligjshme vota të shumëfishta, të cilat u përkisnin kolegëve të tyre që mungonin. Prandaj, vendimi ishte marrë në shkelje të Kushtetutës, të Ligjit për Statusin e Anëtarëve të Parlamentit dhe të Rregullores së Parlamentit. Gjykata më e Lartë Administrative kishte dështuar në shqyrtimin e duhur të kësaj çështjeje, gjë që kishte rezultuar në shkelje.

Sa i përket përbërjes së dhomës së Gjykatës më të Lartë Administrative – Sipas së drejtës vendase, përbërja e dhomës së veçantë e cila do të shqyrtonte çështjen e kërkesit duhej të caktohej nga Kryetari i Gjykatës më të Lartë Administrative, por mandati i tij pesëvjeçar si Kryetar kishte skaduar në kohën kur kryheshin këto veprime. Dispozitat përkatëse të së drejtës kombëtare që rregullonin procedurën për emërimin e kryetarëve të gjykatave ishin deklaruar antikushtetuese dhe procedurat e reja ende nuk ishin miratuar. Ndërkohë, emërimi i kryetarëve të gjykatave kishte qenë çështje debatesh të shumta mes autoriteteve ukrainase. Gjykata nuk mundi të gjente që dhoma që kishte vendosur në lidhje me çështjen kishte pasur një përbërje që e plotësonte kriterin e një “gjykate të themeluar me ligj” dhe, për pasojë, Gjykata konstatoi shkelje.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 8, GJEDNJ gjeti se shkarkimi i kërkesit përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe familjare. Gjetja e Gjykatës që vota parlamentare për vendimin për shkarkimin e tij nga detyra nuk kishte qenë e ligjshme

sipas së drejtës vendase ishte e mjaftueshme për të gjetur që ndërhyrja në fjalë nuk kishte qenë e justifikuar dhe kësaj ishte në shkelje të nenit 8. Në kohën kur ishte vendosur çështja e kërkuarit nuk kishte rregulla apo praktika që përcaktonin një interpretim të qëndrueshëm të nocionit të “shkeljes së betimit” dhe nuk ishin vendosur mekanizma të përshtatshëm mbrojtës për të ndaluar zbatimin arbitrar të dispozitave përkatëse. Në mënyrë të veçantë, e drejta kombëtare nuk caktonte kufij kohorë për procedurat kundër një gjyqtari për “shkelje të betimit”, çka e kishte lënë të hapur lirinë e veprimit të autoriteteve disiplinore dhe kishte minuar parimin e sigurisë juridike. Për më tepër, e drejta vendore nuk kishte përcaktuar një shkallë të përshtatshme dënimesh për vepra disiplinore dhe nuk kishte hartuar rregulla për të siguruar që zbatimi i tyre të ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Së fundi, nuk kishte pasur një kornizë të përshtatshme për shqyrtimin e pavarur dhe të paanshëm të një shkarkimi për shkak të “shkeljes së betimit” që sipas Gjykatës, rezultoi në shkelje.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 dhe të nenit 8 të Konventës. Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 13, Gjykata konstatoi se nuk ka nevojë të shqyrtohen fare. Gjykata vendosi që Ukraina do të sigurojë rivendosjen e kërkuarit në postin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë sa më shpejt të jetë e mundur. Shteti i paditur duhet t’i paguajë kërkuarit shpenzimet në lidhje me dëmin jomaterial.

2.2. CHRISTINE GOODWIN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

[28957/95]

GJEDNJ [Seksioni i Tretë]

11 qershor 2002

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: statusi ligjor i transseksualëve në Mbretërinë e Bashkuar dhe veçanërisht trajtimi i tyre në sferën e punësimit, sigurimit social, pensioneve dhe martesës.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Christine Goodwin (kërkuesja), një shtetase e Mbretërisë së Bashkuar e lindur në vitin 1937. Kërkuesja, e cila ishte regjistruar në lindje si mashkull, jetonte si grua nga viti 1985 dhe në vitin 1990 iu nënshtrua një operacioni për ndryshim gjinie, të siguar dhe paguar nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar. Ajo ankohej për mungesën e njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë. Në veçanti, ajo pretendoi se punëdhënësi i saj ishte në gjendje të gjurmonte identitetin e saj, sepse Departamenti i Sigurimeve Sociale (DSS) refuzoi t'i jepte një numër të ri të Sigurimit Kombëtar (NI), se të dhënat e departamentit ende tregonin gjininë e saj si mashkull dhe se dosja e saj ishte e shënuar “sensitive”, duke i shkaktuar kështu vështirësi praktike. Më tej, ajo ankohej se ajo ishte konsideruar si e ‘papërshtatshme’ për pensionin shtetëror në moshën 60-vjeçare, në moshën kur gratë e fitojnë këtë të drejtë. Së fundi, ajo pretendoi se i ishte dashur të heqë dorë nga disa përparësi/përfitime, sepse nuk ka dashur të paraqesë certifikatën e saj të lindjes, e cila tregon gjininë në momentin e regjistrimit. Ajo gjithashtu pretendoi se kishte probleme dhe u përball me ngacmime seksuale në punë gjatë dhe pas ndryshimit të gjinisë.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenet 8, 12, 13 dhe 14 të Konventës, kërkuesja u ankua për trajtimin e saj në lidhje me punësimin, sigurimet shoqërore dhe pensionet dhe pamundësinë e saj për t'u martuar. Një nga pretendimet e saj të ishte se ajo nuk mund të martohej me partnerin e saj, meqenëse Akti i Lidhjeve Martesore i vitit 1973 [6] (“*Matrimonial Causes Act*”) e ndalon atë. Akti ishte mbështetur gjithashtu nga jurisprudenca, pasi në rastin *Corbett kundër Corbett* ishte vendosur se gjinia duhet të përcaktohet me aplikimin e “testeve kromosomale, gonadale dhe gjentiale”. Ky përdorim i kriterëve biologjike u miratua gjithashtu në *R kundër Tan*. Ligji kërkon që gjinia e fëmijës të shënohet në certifikatën e lindjes. Kriteret për përcaktimin e gjinisë së fëmijës nuk janë përcaktuar në Aktin e vitit 1953, por praktika tregon se zyrtari i gjendjes civile përdor kriteret biologjike, të përcaktuara më sipër. Korrigjimet mund të bëhen vetëm nëse ka ndonjë gabim. Kur bëhet fjalë për punësim, çdo qytetari i jepet vetëm një numër unik NI, prandaj, gjinia e transseksualëve regjistrohet siç është regjistruar në lindje.

Kërkuesja parashtroi se, pavarësisht paralajmërimeve nga Gjykata në lidhje me nevojën për reforma ligjore, Qeveria ende nuk kishte ndërmarrë ndonjë hap konstruktiv për të adresuar vuajtjet e përjetuara nga kërkuesja si dhe transseksualët e tjerë. Ajo theksoi se mungesa e njohjes ligjore të gjinisë së saj të ndryshuar ka qenë shkak i përvojave të shumta diskriminuese dhe poshtëruese në jetën e përditshme. Në të kaluarën, në veçanti nga viti 1990 deri më 1992, ajo u keqtrajtua në vendin e saj të punës dhe nuk mori mbrojtje të duhur kundër diskriminimit. Ajo pohoi se ndërmori të gjitha procedurat e veçanta përmes të cilave ajo do të duhej të përfitonte nga kontributet e saj, megjithatë ajo nuk arriti të marrë përfitimet e kontributit për shkak të gjinisë, përfitime këto që do t'i gëzonte nëse ajo ishte njohur si një grua, për qëllime ligjore. Kërkuesja me tutje theksoi se, vetë fakti se DSS praktikoi një politikë të shënimit të të dhënave të transseksualëve si të ndjeshëm ('sensitive'), paraqiste një ndryshim në trajtim. Për pasojë, kërkuesja nuk mund të merrte pjesë në DSS pa pasur nevojë të bëjë një takim të veçantë. Kërkuesja më tej pohoi se fakti se ligjërisht nuk kishte ndërruar identitetin dhe gjininë e saj ishte rrezik permanent për të sepse punëdhënësit e rinj të saj mund të mësonin identitetin e saj të kaluar në bazë të numrit të saj NI, i cili nuk kishte ndërruar asnjëherë. Kërkuesja u ankua se shteti kishte dështuar që të jetë në harmoni me obligimet pozitive për të siguruar të drejtën për transformim të gjinisë dhe për këtë ka rezultuar në dështimin e respektimit të së drejtës në jetë private të garantuar sipas nenit 8 të Konventës. Tutje, kërkuesja u ankua se e drejta e saj nga nenin 12 i Konventës nuk u realizua. Ajo u ankua se megjithëse aktualisht gëzonte një marrëdhënie të plotë fizike me një burrë, ajo dhe partneri i saj nuk mund të martoheshin sepse atë ligji ende e trajtonte si një burrë. Kërkuesja, mbështetur në nenin 14 të Konventës, gjithashtu u ankua se mungesa e njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë së saj ishte shkak i përvojave të shumta diskriminuese dhe i paragjyqimeve. Së fundmi, kërkuesja pretendoi se kishte mungesë të mjeteve efektive juridike për të adresuar shkeljet.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e kërkueses për shkelje të nenit 8, Gjykata kishte vendosur më parë se refuzimi i qeverisë së paditur për të ndryshuar regjistrin e lindjeve ose për të lëshuar certifikata të modifikuara të lindjes, nuk mund të konsiderohej një ndërhyrje në të

drejtën për respektimin e jetës private dhe se nuk kishte asnjë detyrim pozitiv për të ndryshuar sistemin ekzistues ose për të lejuar shënime tjera të reja në regjistrin e lindjeve. Megjithatë, Gjykata kishte sinjalizuar për problemet serioze me të cilat përballen transseksualët dhe theksoi rëndësinë e mbajtjes në shqyrtim të nevojës për masat e duhura ligjore. Për këtë arsye vendosi të vlerësojë se cili ishte interpretimi dhe zbatimi i duhur i Konventës “në dritën e tanishme-rrethanat e kohës”.

Në rastin konkret, pavarësisht se iu nënshtrua një operacioni të ndryshimit të gjinisë, kërkuesja mbeti, për qëllime ligjore, mashkull, me efekte pasuese në jetën e saj, ku gjinia ishte me rëndësi ligjore. Stresi dhe tjetërsimi që lindin nga një mospërputhje midis pozitës në shoqëri të marrë nga një transseksual postoperativ dhe statusit të vendosur me ligj, nuk mund të konsiderohet si një shqetësim i vogël që rrjedh nga një formalitet. Ndryshimi i gjinisë së kërkueses u krye nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar dhe u duk e palogjikshme të refuzohej njohja e efekteve ligjore, si rrjedhojë e ndërrimit të gjinisë. Sa i përket argumenteve kundërpeshuese të një natyre të interesit publik, Gjykata nuk ishte e bindur se gjendja e shkencës mjekësore ose e njohurive shkencore ofronin ndonjë argument përcaktues në lidhje me njohjen ligjore të transseksualëve. Gjykata, gjithashtu, i kushtoi më pak rëndësi mungesës së provave të një qasjeje të përbashkët evropiane ndaj çështjes sesa dëshmive të qarta dhe të pakontestueshme të një tendence të vazhdueshme ndërkombëtare në favor jo vetëm të rritjes së pranimit social të transseksualëve, por edhe të njohjes ligjore të identitetit të ri gjinor të transseksualëve pas operacionit. Sa i përket natyrës historike të sistemit të regjistrimit të lindjeve, përjashtime janë bërë tashmë në rastet e legjitimitit dhe të birësimit dhe bërja e një përjashtimi të mëtejshëm në rastin e transseksualëve nuk do të përbënte kërcënim për të gjithë sistemin ose nuk do të krijonte ndonjë perspektivë reale të paragjykimit për palët e treta. Për më tepër, Qeveria kishte bërë propozime për reformë që do të lejonte ndryshimin e vazhdueshëm të të dhënave të gjendjes civile. Edhe pse niveli i ndërhyrjes së përditshme që pësonte kërkuesja nuk ishte aq i madh sa në rastet e tjera, thelbi i Konventës është respektimi i dinjitetit dhe lirisë njerëzore dhe, në shekullin e njëzetë, është edhe e drejta e transseksualëve për zhvillim personal, fizik dhe moral. Siguria në kuptimin e plotë që gëzojnë të tjerët në shoqëri nuk mund të konsiderohet si një çështje polemike që kërkon kalimin

e kohës për të hedhur dritë më të qartë mbi çështjet e përfshira. Me pak fjalë, situata e pakënaqshme në të cilën jetonin transseksualët pas operacionit, në një zonë të ndërmjetme, nuk ishte më e qëndrueshme. Vështirësitë e paraqitura nga çdo ndryshim i madh në sistem nuk ishin të pakapërcyeshme nëse kufizoheshin te transseksualët pas operacionit. Asnjë vështirësi konkrete ose thelbësore ose dëmtim i interesit publik nuk ishte demonstruar që ka të ngjarë të rrjedhë nga ndonjë ndryshim në statusin e transseksualëve dhe, për sa i përket pasojave të tjera të mundshme, në mënyrë të arsyeshme mund të pritet që shoqëria të tolerojë njëfarë shqetësimi për t'u mundësuar individëve të jetojnë me dinjitet dhe me vlera në përputhje me identitetin gjinor të zgjedhur prej tyre. Qeveria nuk mund të pretendonte më se çështja binte brenda kufijve të vlerësimit dhe ekuilibri i drejtë i natyrshëm në Konventë anonte në mënyrë vendimtare në favor të kërkuases. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi njëzëri shkelje të Konventës në lidhje me nenin 8.

Në lidhje me pretendimet e kërkuases për shkelje të nenit 12, Gjykata rikujtoi se fjalia e parë e kësaj dispozite i referohet shprehimisht të drejtës së një burri dhe një gruaje për t'u martuar. Gjykata nuk u bind se ende mund të supozohej se ato terma duhej t'i referoheshin një përcaktimi të gjinisë, thjesht, nga kriteret biologjike. Gjykata theksoi se kanë ndodhur ndryshime të mëdha shoqërore në institucionin e martesës që nga miratimi i Konventës, si dhe ndryshime dramatike që sollën zhvillimet në mjekësi dhe shkencë në fushën e transseksualitetit. Gjykata kishte konstatuar, sipas nenit 8, se një test i faktorëve biologjikë kongruentë nuk mund të ishte më vendimtar në mohimin e njohjes ligjore të ndryshimit të gjinisë. Megjithatë, e drejta sipas nenit 8 nuk përfshinte të gjitha çështjet sipas nenit 12, ku kushtet e vendosura nga ligjet kombëtare përmenden në mënyrë specifike, dhe për këtë arsye Gjykata shqyrtoi nëse në rastin konkret caktimi i gjinisë në ligjin kombëtar sipas gjinisë së regjistruar në lindje, ishte një kufizim që cenonte vetë thelbin e së drejtës për t'u martuar. Në këtë drejtim, ishte artificiale të pohohej se transseksualëve pas operacionit nuk u ishte hequr e drejta për t'u martuar sepse ata mbetën në gjendje të martoheshin me një person të ish-gjinisë së kundërt. Kërkuësja jetonte si grua dhe do të dëshironte të martohej me një burrë, por nuk kishte mundësi ta bënte këtë dhe, për këtë arsye, mund të pretendonte se ishte shkelur thelbi i së drejtës së saj për t'u martuar. Prandaj, Gjykata konstatoi njëzëri shkelje të nenit 8.

Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 14, Gjykata theksoi se çështjet ishin shqyrtuar sipas nenit 8 dhe nuk u ngrit asnjë çështje e veçantë sipas nenit 14. Rrjedhimisht, Gjykata njëzëri konstatoi se nuk ka çështje të veçantë për t'u shqyrtuar sipas nenit 14.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 13, Gjykata theksoi se përderisa nuk ekzistonte asnjë mjet juridik në të drejtën e brendshme përpara hyrjes në fuqi të Aktit për të Drejtat e Njeriut të vitit 1998, neni 13 nuk mund të interpretohet se kërkon një mjet juridik kundër gjendjes së ligjit të brendshëm. Pas kësaj date, do të ishte e mundur që kërkuesja të ngrinte ankesat e saj përpara gjykatave vendase. Gjykata konstatoi njëzëri se nuk ka shkelje.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 8, dhe shkelje të nenit 12 të Konventës. Gjykata tutje konstatoi se nuk ishte ngritur ndonjë çështje e veçantë sipas nenit 14, dhe se nuk kishte shkelje as të nenit 13.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË

GJDBE

Çështja C286/12

6 nëntor 2012

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=129324&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13701649>]

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: duke miratuar një legjislacion që parashikon daljen e parakohshme në pension të gjyqtarëve, prokurorëve dhe noterëve, Hungaria ka shkelur mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të moshës.

Faktet kryesore

Deri më 31 dhjetor 2011, legjislacioni hungarez i lejonte gjyqtarët hungarezë që të qëndronin në detyrë deri në moshën 70-vjeçare. Ligji i ri (“Ligji Themelor”), i cili u miratua në 25 prill 2011 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2012, parashikonte në nenin 26. 2 të tij, që “me përjashtim të Presidentit të Kúrias²⁶, gjyqtarët mund të qëndrojnë në detyrë deri në moshën e përgjithshme të pensionit”. Neni 12.1 i dispozitave kalimtare të Ligjit Themelor parashikonte se:

“Nëse një gjyqtar arrin moshën e përgjithshme të pensionit sipas nenit 26.2 të Ligjit Themelor para 1 janarit 2012, ai do të dalë në pension më 30 qershor 2012. Nëse ai arrin moshën e përgjithshme të pensionit sipas nenit 26.2 të Ligjit Themelor ndërmjet 1 janarit 2012 dhe 31 dhjetorit 2012, ai do të dalë në pension më 31 dhjetor 2012”.

Një parashikim identik përmbante neni 29.3 i Ligjit Themelor dhe neni 13 i dispozitave kalimtare në lidhje me prokurorët hungarezë.

Ligjet organike nr. CLXII, nr. CLXIV dhe nr. XLI të vitit 2011 në lidhje me gjyqtarët, prokurorët dhe noterët, të cilat hynë në fuqi më 1 janar 2012, parashikonin të njëjtat kriterë. Si pasojë e këtyre dispozitave një numër gjyqtarësh, prokurorësh dhe noterësh u larguan nga funksionet e tyre, pasi kishin arritur moshën 62-vjeçare.

Më 17 janar 2012, Komisioni Evropian i dërgoi një letër njoftimi zyrtar Hungarisë në të cilën shprehu pikëpamjen e tij se, duke miratuar dispozitat legjislative në lidhje me kufirin e moshës për pension të detyrueshëm të gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të noterëve, ai shtet anëtar (Hungaria) kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Direktivës 2000/78.²⁷ Në përgjigjen e saj të 17 shkurtit 2012, Hungaria i kundërshtoi këto pretendime. Më 7 mars 2012, Komisioni miratoi një mendim të arsyetuar duke kërkuar që Hungaria të marrë

²⁶ Gjykata e Lartë në Hungari.

²⁷ Direktiva 2000/78 / EC e Këshillit e 27 nëntorit 2000 “Për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në marrjen në punë dhe ushtrimin e punës”

masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e saj brenda një muaji nga marrja e mendimit. Qeveria hungareze u përgjigj me një letër të datës 30 mars 2012. Duke mos qenë i kënaqur me përgjigjen e marrë, më 7 qershor 2012 Komisioni bëri padinë objekt shqyrtimi në Gjykatë. Me një dokument të veçantë të depozituar në kancelarinë e Gjykatës së Drejtësisë në të njëjtën ditë, Komisioni paraqiti një kërkesë për zbatimin e procedurës së përshpejtuar të referuar në nenin 23a të Statutit të GJDBE-së, kërkesë e cila u pranua nga Presidenti i Gjykatës me urdhrin e 13 korrikut 2012.

Megjithëse më 16 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese Hungareze vendosi të shfuqizojë, me efekt prapaveprues, një pjesë të legjislacionit hungarez të kritikuar nga Komisioni, ky i fundit vendosi ta vazhdojë procedurën përpara Gjykatës.

Komisioni pretendoi se dispozitat përkatëse ishin në kundërshtim me nenet 2 dhe 6 (1) të Direktivës 2000/78,²⁸ përderisa ato diskriminonin në mënyrë të pajustificuar dhe, në çdo rast, nuk ishin as të përshtatshme dhe as të nevojshme për të arritur qëllimet e supozuara legjitime në të cilat thirrej Hungaria.

Hungaria pretendoi se çështja në fjalë kishte humbur një pjesë të objektit të saj pasi që Gjykata Kushtetuese i kishte anuluar me efekt prapaveprues nenet 90 (ha) dhe 230 të Ligjit të vitit 2011 në lidhje me

28 Neni 2 (1) dhe (2) i kësaj direktive parashikon:

"1. Për qëllimet e kësaj Direktive, "parimi i trajtimit të barabartë" nënkupton mungesën e ndonjë diskriminimi të drejtpërdrejtë ose indirekt, bazuar në një nga arsyet e referuara në Nenin 1.

2. Për qëllimet e paragrafit 1:

a) diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur një person trajtohet më pak i favorshëm sesa një tjetër, ka qenë ose do të ishte në një situatë të krahasueshme, në bazë të një prej arsyeve të referuara në Nenin 1;

b) diskriminimi indirekt ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë dukshëm neutrale ka të ngjarë të rezultojë në një disavantazh të veçantë për personat e një feje ose besimi, të aftësisë së kufizuar, moshës ose të një orientimi të dhënë seksual, në lidhje me njerëzit e tjerë, përveç nëse:

(i) ajo dispozitë, kriter ose praktikë justifikohet objektivisht nga një objektivi legjitim dhe mjetet për të arritur atë objektivi janë të përshtatshme dhe të nevojshme, ose [...]"

Neni 6 (1) i kësaj direktive është formuluar si më poshtë:

"Pavarësisht nga Neni 2 (2), Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që ndryshimet në trajtimin e bazuar në moshë nuk përbëjnë diskriminim kur ato justifikohen objektivisht dhe arsyeshëm, sipas ligjit kombëtar, nga një objektivi i ligjshëm, veçanërisht përmes punësimit të ligjshëm, tregut të punës dhe profesional objektivat e politikave të trajtimit dhe se mjetet për të arritur këtë objektivi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.

Këto ndryshime në trajtim mund të përfshijnë veçanërisht:

a) vendosja e kushteve të veçanta për aksesin në punësim dhe aftësim profesional, punësim dhe punë, përfshirë kushtet e pushimit nga puna dhe shpërblimi, për të rinjtë, punëtorët e moshuar dhe ata me vartësi, me qëllim promovimin e integritit të tyre profesional ose sigurimin e mbrojtjes së tyre; [...]"

gjqtarët. Prandaj, sipas saj, nuk kishte më nevojë për të vendosur për pjesën përkatëse të padisë.

Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet paraprake, Gjykata vlerësoi se nga praktika gjyqësore rezulton se ekzistenca e një shkeljeje duhet të vlerësohet në bazë të situatës në shtetin anëtar në fund të afatit të caktuar, në mendimin e arsyetuar të Komisionit dhe se ndryshimet e bëra më pas nuk mund të merren parasysh nga Gjykata.²⁹ Gjykata vuri në pah që në fund të periudhës së caktuar nga Komisioni në mendimin e arsyetuar, dispozitat kombëtare në fjalë ishin në fuqi. Përveç kësaj, siç e pranoi vetë Hungaria në seancë, autoritetet kompetente kombëtare kishin marrë, në bazë të këtyre dispozitave, akte individuale administrative që ndërprisnin marrëdhëniet e punës të personave të interesuar. Për më tepër, anulimi me efekt prapaveprues i dispozitave të kundërshtuara nuk ndikonte drejtpërdrejt në vlefshmërinë e akteve individuale me të cilat u ndërpreu marrëdhëniet e punës së personave në fjalë, përderisa ata nuk mund të riktheheshin automatikisht në funksionet e tyre. Përkundrazi, për t'u rikthyer në punë, këta persona ishin të detyruar të paraqesin padi për anulimin e atyre akteve, rezultati i së cilave, siç u konfirmua në seancë nga vetë Hungaria, nuk ishte i sigurt. Në këto rrethana Gjykata vendosi se ishte e nevojshme të merrte në shqyrtim themelin (meritat) e ankesës.

Në lidhje me themelin e ankesës, Gjykata konstatoi se nuk diskutohej që dispozitat kombëtare në fjalë parashikonin që gjyqtarët, prokurorët dhe noterët në fjalë të pushojnë funksionet e tyre automatikisht, kur mbushin 62 vjeç. Personat që ushtrojnë këto profesione dhe kanë arritur moshën 62-vjeçare janë në një situatë të krahasueshme me atë të personave më të rinj që ushtrojnë të njëjtat profesione. Sidoqoftë, të parët, për shkak të moshës së tyre, janë të detyruar të pushojnë funksionet e tyre. Në këto kushte, këto dispozita që kërkojnë daljen automatikisht në pension për personat që mbushin moshën e caktuar duhet të konsiderohen se parashikojnë një trajtim më pak të favorshëm

²⁹ Shih, në veçanti, vendimet e 29 janarit 2004, *Komisioni k. Austrisë*, C - 209/02, ECRI -1211, paragrafi 16, i 19 korrikut 2012, *Komisioni k. Italisë*, C - 565/10, paragrafi 22.

ndaj tyre, në krahasim me të gjithë njerëzit e tjerë që ushtronin të njëjtat veprimtari profesionale. Këto dispozitat krijonin një ndryshim në trajtimin bazuar drejtpërdrejt në moshë, siç referohet në nenin 2 (1) dhe (2) (a) të Direktivës 2000/78.

Hungaria argumentoi se këto dispozita ulën kufirin e moshës për ndërprerjen e detyrueshme të aktivitetit për të rregulluar një situatë diskriminimi pozitiv, nga i cili përfitonin gjyqtarët, prokurorët dhe noterët sipas regjimit të mëparshëm në fuqi, përderisa ata, ndryshe nga funksionarët e tjerë të shërbimit publik, qëndronin në detyrë deri në moshën 70 vjeç.

Megjithatë, Gjykata vlerësoi se një rrethanë e tillë nuk mund të vinte në pikëpyetje ekzistencën e një ndryshimi në trajtim midis personave që duhet të ndërpresin funksionet e tyre për shkak të moshës 62-vjeçare dhe atyre që mund të vazhdojnë funksionet përderisa nuk e kanë arritur këtë moshë. Në të vërtetë, ndryshimi në trajtim për shkak të moshës bazohet në vetë ekzistencën e një kufiri moshe përtej të cilit personat në fjalë pushojnë funksionet e tyre, pavarësisht nga moshja e miratuar për këtë kufi dhe, *a fortiori*, për atë që ishte e zbatueshme më parë.

Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se dispozitat në fjalë krijonin një trajtim të ndryshëm bazuar direkt në moshën, sipas kuptimit të dispozitave të neneve 1 dhe 2 (2) (a) të Direktivës 2000/78. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se ishte e nevojshme të verifikohet nëse dispozitat e kontestuara justifikohen nga një objektiv legjitim dhe nëse mjetet e zbatuara për të arritur këtë janë të përshtatshme dhe të nevojshme, duke respektuar kështu parimin e proporcionalitetit.

Për sa i përket objektivit të ndjekur nga ato dispozita, edhe pse Komisioni pretendoi se mungesa e saktësisë në legjislacionin kombëtar në fjalë për sa i përket objektivit të ndjekur çonte në mungesën e një objektivit të tillë, Gjykata vlerësoi se për këtë qëllim ishte e rëndësishme që të analizoheshin elementë të tjerë, të nxjerrë nga konteksti i përgjithshëm i masës në fjalë, që mund të çonin në identifikimin e objektivit që qëndronte në themel të kësaj të fundit, për qëllimet e ushtrimit të rishikimit gjyqësor të masës në fjalë. Në lidhje me këtë, Gjykata kujtoi se objektivat mund të konsiderohen si “legjitimë” brenda kuptimit të

nenit 6.1.1 të Direktivës 2000/78 dhe, rrjedhimisht, të tilla që justifikojnë përjashtimin nga parimi i ndalimit të diskriminimit bazuar në moshën, kur ato lidhen me politikën sociale, të tilla si ato për punësimin, tregun e punës ose formimin profesional.³⁰

Për sa i përket objektivit të vendosjes së një standardi uniform për të gjitha profesionet që përfshihen në shërbimin publik, kufijtë e moshës për ndërprerjen e detyrueshme të punësimit, Gjykata vlerësoi se për sa kohë që ndjekja e një objektivit të tillë bën të mundur sigurimin e respektimit të parimit të trajtimit të barabartë për të gjithë personat në një sektor të caktuar dhe në lidhje me një element thelbësor të marrëdhënies së tyre të punës, siç është koha e pensionimit, ky objektiv mund të përbëjë një objektiv legjitim të politikës së punësimit.

Për sa i përket objektivit të krijimit të një strukture më të ekuilibruar moshe që lehtëson qasjen e juristëve të rinj në profesionet e gjyqtarit, prokurorit ose noterit, Gjykata ka pasur ndërkaq mundësinë të vlerësojë se qëllimi i vendosjes së një strukture moshe të ekuilibruar mes funksionarëve të rinj dhe atyre më të vjetër, në mënyrë që të nxisë punësimin dhe promovimin e të rinjve, për të përmirësuar menaxhimin e stafit dhe në këtë mënyrë të parandalojë mosmarrëveshjet e mundshme në lidhje me aftësinë e punonjësit për të ushtruar aktivitetin e tij përtej një moshe të caktuar, duke ruajtur gjithmonë një funksionim të duhur të sistemit gjyqësor, mund të përbëjë një objektiv legjitim të punësimit dhe politikës së tregut të punës.

Në përfundim të sa më sipër, Gjykata vlerësoi se dispozitat e kundërshtuara nga Komisioni justifikohen nga objektiva legjitimë. Gjithsesi është e nevojshme të vlerësohet edhe nëse këto dispozita përbëjnë mjete të përshtatshme dhe të nevojshme për të arritur arritjen e këtyre dy objektivave.

Sa i përket objektivit të parë, këto dispozita, në parim, janë një mjet i përshtatshëm për të arritur objektivin e uniformizimit të ndjekur

30 Shih vendimet e 5 marsit 2009, *Age Concern England*, C - 388/07, Rec. F I - 1569, paragrafi 46 dhe të 18 qershorit 2009, *Hütter*, C-88/08, ECR I-5325, paragrafi 41.

nga Hungaria, përderisa ato synonin, nëse jo eliminimin, të paktën zvogëlimin në mënyrë të konsiderueshme të larmisë të moshës për daljen e detyrueshme në pension për të gjitha profesionet e sektorit të drejtësisë. Sidoqoftë, për të shqyrtuar nëse dispozitat në fjalë shkonin përtej asaj që ishte e nevojshme për të arritur atë objektiv pa cenuar padrejtësisht interesat e personave në fjalë, ishte e nevojshme që ato të vlerësohen në kontekstin legjislativ në të cilin ato bënin pjesë, duke marrë në konsideratë si dëmin që mund t'u shkaktojnë personave në fjalë, ashtu edhe përfitimet që rrjedhin prej tyre për shoqërinë në përgjithësi dhe individët që e përbëjnë atë. Duhet të theksohet, në lidhje me këtë, se kategoritë e personave të prekur nga ato dispozita gëzonin, deri në hyrjen e tyre në fuqi, një përjashtim që i lejonte ata të qëndronin në detyrë deri në moshën 70-vjeçare. Duke pasur kështu një pritshmëri legjitime që të qëndronin në detyrë deri në atë moshë. Sidoqoftë, dispozitat në fjalë sollën një ulje të menjëhershme dhe të konsiderueshme të kufirit të moshës për daljen e detyrueshme në pension, pa parashikuar masa kalimtare që mund të mbronin pritshmërinë legjitime të personave në fjalë.

Nga efekti i legjislacionit në fjalë, i cili hyri në fuqi vetëm më 1 janar 2012, nga njëra anë, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që kishin arritur moshën 62-vjeçare para kësaj date u detyruan të largohen nga detyra pas gjashtë muajsh, më 30 qershor 2012, dhe ata që e mbushën këtë moshë mes 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2012 u larguan nga detyra më 31 dhjetor 2012, pra pas një periudhe që në çdo rast është më e shkurtër se një muaj. Noterët që mbushën moshën 62-vjeçare para 1 janarit 2014 do të largoheshin nga detyra e tyre në atë datë, d.m.th. jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të skemës së re të pensioneve. Në këto kushte, personat në fjalë u larguan automatikisht dhe përfundimisht nga tregu i punës pa pasur kohë për të marrë masa, në veçanti të një natyre ekonomike dhe financiare, gjë që kërkohet në një situatë të tillë, duke marrë parasysh faktin që, “nga njëra anë, pensioni i tyre ishte të paktën 30% më i ulët se rroga dhe, nga ana tjetër, ndërprerja e aktivitetit nuk merr parasysh periudhat e kontributit, gjë që nuk garanton të drejtën në pension të plotë”.

Gjykata theksoi se Hungaria nuk dha asnjë provë për të vërtetuar se dispozita më pak kufizuese, si për shembull një shkallë më graduale, do të kishte bërë të mundur arritjen e objektivit në fjalë.

Për këto arsye, Gjykata arriti në përfundimin se dispozitat në fjalë nuk ishin të nevojshme për të arritur qëllimin e uniformitetit të pretenduar nga Hungaria.

Për sa i përket objektivit të dytë, që synon krijimin e një strukture më të ekuilibruar moshe, duke lehtësuar hyrjen e juristëve të rinj në profesionet e gjyqtarit, prokurorit ose noterit dhe duke u garantuar atyre një karrierë më të shpejtë, natyrisht që ulja e kufirit të moshës për daljen e detyrueshme në pension sjell si pasojë hapjen e shumë posteve të cilat ka të ngjarë të zihen nga juristë të rinj, si dhe përshtetimin e rotacionit dhe të ripërtëritjes së personelit në profesionet në fjalë. Sidoqoftë, efekte të tilla afatshkurtra dukshëm pozitive ka të ngjarë të vënë në pikëpyetje mundësinë e arritjes së një “strukture moshe” vërtet të ekuilibruar në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Fakti që tetë grupmosha do të zëvendësohen nga një, përkatësisht ajo e vitit 2012, bën që kjo normë rotacioni do të pësojë një ngadalësim po aq drastik më 2013, kur vetëm një grupmoshë do të duhet të zëvendësohet.

Si rrjedhojë, Gjykata konsideroi se dispozitat në fjalë nuk janë të përshtatshme për të ndjekur objektivin e krijimit të një “strukture moshe” më të ekuilibruar.

Në këto kushte, Gjykata vendosi se dispozitat në fjalë krijojnë një diskriminim në trajtim i cili nuk respekton parimin e proporcionalitetit dhe se, për këtë arsye, i dha të drejtë Komisionit.

3.2. P. kundër S. DHE KËSHILLIT TË KONTESË SË KORNUELLIT

GJDBE

Çështja 13/94

30 prill 1996

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=C%2D13%2F94>]

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: zbatimi i parimit të trajtimit të njëjtë për burrat dhe gratë për sa i përket të drejtës për punësim, trajnim, promovim profesional dhe kushte të punës.

Faktet kryesore

P., kishte punuar si drejtor në një institucion arsimor që administrohej për një periudhë kohe nga Këshilli i Kontesë së Kornuellit (në tekstin e mëtejme: “Këshilli i Kontesë”), autoriteti administrativ për krahinën. Në fillim të prillit 1992, një vit pasi ishte marrë në punë, P. informoi S., Drejtor Studimesh, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe i Financave të institucionit, mbi qëllimin e tij për të ndryshuar gjininë. Kjo filloi me një “test jetësor”, periudhë gjatë të cilës P. mbante veshje dhe sille si grua, pasuar nga një ndërhyrje kirurgjike për t’i dhënë fizikut të tij atributet e një gruaje.

Në fillim të shtatorit 1992, pasi kishte bërë operacione të lehta kirurgjikale, P., iu dha një njoftim tre muaj më herët për pushimin nga puna më 31 dhjetor 1992. Operacioni i fundit kirurgjik u krye para pushimit të tij nga puna, por pasi P. i ishte dhënë njoftimi.

P. paraqiti një padi kundër S. dhe Këshillit të Kontesë para Gjykatës së Punës me arsyetimin se ajo kishte qenë viktimë e diskriminimit gjinor. S. dhe Këshilli i Kontesë këmbëngulën se arsyeja për pushimin e saj nga puna ishte numri i tepërt i punëtorëve.

Gjykata e Punës konstatoi se një situatë e tillë nuk trajtohej nga Akti i vitit 1975 për Diskriminimin Gjinor, përderisa ai zbatohet vetëm për rastet kur një burrë ose grua trajtohej në mënyrë të diferencuar për shkak se ai ose ajo i përkiste njërit prej seksëve. Në kuadrin e legjislacionit anglez, P. konsiderohej

se ishte ende mashkull. Nëse P. do të kishte qenë femër përpara se të ndryshonte gjininë, punëdhënësi përsëri do ta pushonte atë nga puna për shkak të operacionit. Megjithatë, Gjykata e Punës ishte e pasigurt nëse situata i përkiste fushëveprimit të Direktivës 76/207/ të Këshillit të Komunitetit Ekonomik Evropian, të datës 9 shkurt 1976, “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në lidhje me mundësinë e punësimit, trajnimit profesional dhe promovimit, dhe kushteve të punës”.

Qëllimi i Direktivës, sipas nenit 1.1 të saj, ishte të vinte në jetë në shtetet anëtare parimin e trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë, veçanërisht për sa i përket të drejtës për t’u punësuar, përfshirë promovimin dhe trajnimin profesional, si dhe kushtet e punës. Neni 2.1 i Direktivës parashikonte që parimi i trajtimit të barabartë nënkuptonte se nuk duhej të kishte “asnjë diskriminim të çfarëdo lloji, qoftë për arsye gjinie, qoftë direkt qoftë indirekt”.

Gjithashtu, paragrafi i tretë në preambulën e Direktivës parashtronte se trajtimi i njëjtë për burrat dhe gratë përbënte një nga objektivat e Komunitetit, me qëllim të harmonizimit sa më të madh të kushteve të jetesës dhe të punës.

Duke konsideruar se kishte dyshime nëse fusha e veprimit e Direktivës ishte më e gjerë sa ajo e legjislacionit kombëtar, Gjykata e Punës vendosi të pezullonte procedurat dhe t’i drejtonte Gjykatës (së BE-së) disa pyetje për një vendim paraprak. Thelbi i këtyre pyetjeve ishte nëse përbënte shkelje të Direktivës largimi nga puna për arsye lidhur me ndryshimin e gjinisë dhe nëse neni 3 i Direktivës, i cili i referohet diskriminimit për arsye të gjinisë, ndalon trajtimin e një punëtori për shkak të gjendjes transseksuale të punëtorit”.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vlerësoi se një largim nga puna, siç ishte ky rast, duhej të konsiderohej nën dritën e nenit 5.1 të Direktivës, i cili parashikon se:

“Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në lidhje me kushtet e punës, përfshirë kushtet që rregullojnë largimet nga puna, kërkon që burrave dhe grave duhet t’u garantohen kushte të njëjta pa diskriminim për shkak të gjinisë”.

Në kuadrin e këtij neni duhet të sqarohet se a ndalohej largimi nga puna i një personi transseksual për shkaqe që lidheshin me ndryshimin e gjinisë së tij.

Mbretëria e Bashkuar dhe Komisioni Evropian pohuan se largimi i një personi nga puna për shkak se ai ose ajo ishte transseksuale, ose sepse ai ose ajo kishte kryer një operacion për ndryshimin e gjinisë, nuk përbënte diskriminim gjinor për qëllimet e Direktivës.

Në mbështetje të këtij argumenti, Mbretëria e Bashkuar solli një dokument ku thuhej se punëdhënësi do ta kishte larguar nga puna P., nëse ky i fundit do të kishte qenë më parë grua dhe do të bënte operacion për t'u bërë burrë.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka mbrojtur pikëpamjen se “termi trans-seksual” zakonisht zbatohet për ata persona që i përkisnin fizikisht një gjinie dhe kishin bindjen se i përkisnin gjinisë tjetër. Ata shpesh kërkonin të arrinin një identitet më të integruar, të qartë, duke iu nënshtruar një trajtimi mjekësor dhe operacioneve kirurgjikale për t'ia përshtatur karakteristikat e tyre fizike natyrës psikologjike të tyre.

Gjykata e Luksemburgut shprehet se parimi i trajtimit të njëjtë “për burrat dhe gratë” të cilit i referohej Direktiva, nënkuptonte se nenet 2.1 dhe 3.1 tregonin veçanërisht se “nuk duhet të kishte diskriminim për arsye gjinie”. Kështu, Direktiva 76/207/KEE ishte thjesht një shprehje, në fushën përkatëse, e parimit të barazisë, i cili ishte një nga parimet themelore të së drejtës komunitare.

Për pasojë, fusha e zbatimit të Direktivës nuk mund të kufizohej vetëm në diskriminimin bazuar në faktin se një person ishte i njërit apo tjetrit seks. Qëllimi i Direktivës ishte që të aplikohet ndaj diskriminimit që ushtrohej për shkak të ndryshimit të seksit të personit në fjalë.

Ky diskriminim bazohet, kryesisht, në gjininë e personit në fjalë. Në rastin kur një punëtor pushohet nga puna për shkak se ai ose ajo synonte të kryente ose kishte kryer ndryshim gjinie, ai ishte trajtuar në mënyrë të pafavorshme në krahasim me personat e gjinisë që ai ose ajo konsiderohej se i përkiste përpara se të ndryshonte gjininë.

Largimi nga puna i personit në fjalë duhet të konsiderohet se ishte në kundërshtim me nenin 5.1 të Direktivës, me përjashtim të rastit kur pushimi nga puna mund të justifikohet në kuadrin e nenit 2.2. Megjithatë, nuk kishte asnjë provë të sjellë para Gjykatës që do të sugjeronte se situata ishte e tillë në këtë çështje.

Nga sa u tha më lart, rezultonte se përgjigjet për pyetjet e referuara nga Gjykata e Punës duhej të ishin që, në pikëpamjen e objektivit të ndjekur nga Direktiva, neni 5.1 i Direktivës ndalon pushimin nga puna të një personi transseksual për shkak të ndryshimit të gjinisë së tij.

3.3. FEDERATA MBRETËRORE BELGE E SHOQËRIVE TË FUTBOLLIT kundër JEAN-MARC BOSMAN

GJDBE

(Çështja C 415/93)

15 dhjetor 1995

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=C-415/93>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Pagesat për transferimet e lojtarëve që u ka mbaruar kontrata ndërmjet klubeve të shteteve të ndryshme anëtare dhe kufizimi i numrit të lojtarëve me shtetësi nga shtete të tjera anëtare shkelin të drejtën komunitare

Faktet kryesore

Z. Jean-Marc Bosman ishte një futbollist profesionist me shtetësi belge. Që më 1988 ai luante në bazë të një kontrate me Klubin Mbretëror të Liezhit (në tekstin e mëtejshëm: RCL³¹), një nga ekipet e divizionit të parë të kampionatit belg. Në bazë të kësaj kontrate e cila skadonte më 30 qershor 1990, z. Bosman përfitonte mesatarisht 120 000 franga belge (BFR) në muaj, përfshirë edhe bonuset. Më 21 prill 1990, RCL i propozoi

31 Nga emri original Royal Club Liégeois SA.

z. Bosman një kontratë të re me afat njëvjeçar me një pagesë prej 90 000 BFR në muaj, që ishte edhe minimumi i pagesës i parashikuar nga rregullorja e Federatës Mbretërore Belge të Shoqërive të Futbollit (FBF).

Meqenëse z. Bosman nuk pranoi ta nënshkruante kontratën e re, ai u përfshi në listën e transferimeve dhe hyri vetë në negociata me klubin e Dunkerkut, në divizionin e dytë francez. Ky klub pranoi ta angazhonte z. Bosman me një kontratë njëvjeçare, me një rrogë mujore prej 100 000 BFR dhe një prim prej 900 000 BFR. Më 27 korrik 1990 u nënshkrua edhe kontrata ndërmjet RCL dhe Klubit të Dunkerkut, e cila parashikonte transferimin për një vit të z. Bosman kundrejt një pagese prej 1 200 000 BFR, me një opsion për transferim përfundimtar kundrejt një pagese prej 4 800 000 BFR. Transferimi dhe pagesa përkatëse do të hynin në fuqi sapo FBF t'i përcillte Federatës Franceze të Futbollit (FFF) certifikatën e transferimit të z. Bosman, veprim që duhej bërë përpara fillimit të kampionatit, më 2 gusht 1990. Duke dyshuar për aftësinë paguese të klubit të Dunkerkut, RCL nuk i kërkoi FBF-së që t'ia përcjellë këtë certifikatë FFF-së dhe të dy kontratat e lartpërmendura ngelën pa efekt. Më 31 korrik 1990, RCL pezulloi z. Bosman duke e penguar që të luante për të gjithë sezonin futbollistik që sapo fillonte.

Më 8 gusht 1990 z. Bosman iu drejtua gjykatës së shkallës së parë të Liezhit me një padi kundër RCL-së. Ai bëri gjithashtu një kërkesë për një vendim që detyronte RC Liege dhe URBSFA³² t'i paguanin atij paraprakisht 100,000 BFR për çdo muaj deri sa të gjente një punëdhënës të ri, duke i detyruar të paditurit të mos e pengonin aktivitetin e tij. Me urdhrin e 9 nëntorit 1990, gjyqtari që mori në shqyrtim padinë e urdhëroi RC Liege dhe URBSFA t'i paguante z. Bosman një pagesë paraprake prej 30,000 BFR në muaj dhe të mos pengonin aktivitetin e z. Bosman. Ai gjithashtu i bëri një kërkesë paragjykimore Gjykatës së Luksemburgut për një vendim paraprak në lidhje me interpretimin e nenit 48 të Traktatit të KEE-së, përta i përket rregullave të transferimeve të lojtarëve profesionistë (rregullat e transferimit). Megjithëse gjykata e Liezhit i dha të drejtë z. Bosman, të paditurit e apeluar vendimin.

32 Federata Mbretërore Belge e Shoqërive të Futbollit.

Ndërkohë, z. Bosman kishte nënshkruar me një klub të kategorisë së dytë, Saint-Quentin, në tetor 1990, me kusht që të luante për këtë ekip nëse kërkesa e tij para Gjykatës të përfundonte me sukses. Megjithatë, kontrata me të u ndërpre në fund të sezonit. Në shkurt 1992, z. Bosman nënshkroi një kontratë të re me klubin e futbollit francez Saint-Denis de la Reunion, e cila gjithashtu u ndërpre. Pasi kërkoji oferta të tjera në Belgjikë dhe Francë, më në fund z. Bosman nënshkroi me Olympic de Charleroi, një klub belg i kategorisë së tretë. Sipas gjykatës kombëtare, ka prova të konsiderueshme rrethore që mbështesin mendimin se, pavarësisht nga statusi “i lirë” që urdhri i gjykatës i garantoj lojtarit, z. Bosman ishte bojkotuar nga të gjitha klubet evropiane, të cilat mund ta kishin punësuar.

Më 9 prill 1992, z. Bosman ndryshoi pretendimet e tij fillestare duke i kërkuar gjykatës që të shprehej se rregullat e transferimit dhe dispozitat mbi shtetësinë nuk ishin të zbatueshme për të dhe që palët e paditura të paguanin dëmin e shkaktuar nga moslejimi i transferimit të z. Bosman te klube të tjera futbollit. Ai kërkoji gjithashtu që çështja t’i referohet Gjykatës për një vendim paragjykimor. Kur çështja shkoi përsëri në apel me kërkesë të të paditurve, Gjykata e Apelit vendosi të pezullonte gjykimin dhe t’i drejtohej Gjykatës së Luksemburgut që kjo të jepte një vendim paraprak në lidhje me dy pyetjet vijuese:

“A interpretohen nenet 48, 85 dhe 86 të Traktatit të Romës, të 25 marsit 1957, në mënyrë të tillë që: (i) i ndalohet një klubi futbollit të kërkojë dhe të marrë një shumë parash nga një klub i ri që punëson një prej lojtarëve të tij, i cili po përfundon kontratën?; dhe (ii) a u ndalohet shoqatave apo federatave kombëtare dhe ndërkombëtare që të përfshijnë në rregulloret e tyre përkatëse dispozita që kufizojnë përfshirjen e lojtarëve të huaj nga Komuniteti Evropian në ndeshjet e organizuara prej tyre?”

Vendimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se duke pasur parasysh objektivat e komunitetit, sporti i nënshtrohet së drejtës komunitare për aq sa përbën një aktivitet ekonomik sipas kuptimit të nenit 2 të Traktatit. I tillë është rasti i aktiviteteve të futbollistëve profesionistë dhe gjysmëprofesionistë, kur janë të punësuar me pagesë ose ofrojnë një shërbim me pagesë.

Për qëllimet e zbatimit të dispozitave komunitare mbi lirinë e lëvizjes të punëtorëve, nuk është e nevojshme që punëdhënësi të jetë një ndërmarrje. E vetmja kërkesë e nevojshme është ekzistenca ose qëllimi për të krijuar një marrëdhënie punësimi. Rregullat mbi marrëdhëniet e punës ndërmjet punëdhënësve në një sektor të aktivitetit bëjnë pjesë në fushën e zbatimit të dispozitave komunitare mbi lirinë e lëvizjes së punëtorëve nëse zbatimi i tyre cenon kushtet e punësimit të tyre.

Kjo zbatohet edhe për rregullat që kanë të bëjnë me transferimin e lojtarëve ndërmjet klubeve të futbollit. Megjithëse këto rregullojnë më shumë marrëdhëniet e biznesit ndërmjet klubeve sesa marrëdhëniet e punësimit ndërmjet klubeve dhe lojtarëve, këto rregulla kanë të bëjnë me mundësitë e lojtarëve për të gjetur punësim dhe me kushtet e ofrimit të punësimit, meqenëse klubet që bëjnë punësimin duhet të paguajnë tarifë për një lojtar që rekrutohet nga një klub tjetër.

Dispozitat komunitare në lidhje me lirinë e lëvizjes të personave dhe lirinë për ofrimin e shërbimeve nuk përjashtojnë rregullat ose praktikën e sportit që justifikohen nga arsye joekonomike dhe që kanë të bëjnë me natyrën dhe kontekstin e veçantë sportive të caktuara. Një kufizim i tillë, në lidhje me fushën e zbatimit të dispozitave në fjalë, duhet të mbetet i kufizuar brenda objektivit të tij dhe, para së gjithash, nuk mund të përdoret për të përjashtuar plotësisht një aktivitet sportiv nga fusha e zbatimit të Traktatit.

Liria e lëvizjes të punëtorëve, e garantuar nga neni 48 i Traktatit, është një liri themelore në sistemin komunitar dhe fusha e zbatimit të saj nuk mund të kufizohet nga detyrimi komunitar për të respektuar lirinë kulturore, kombëtare dhe krahinore të shteteve anëtare, kur zbatohen kompetencat e kufizuara të nenit 128 (1) të Traktatit të KEE-së në fushën e kulturës dhe sportit.

Parimi i lirisë së krijimit të shoqatave, parashikuar në nenin 11 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe që rezulton edhe nga traditat kushtetuese mbizotëruese në shtetet anëtare, është njëra nga të drejtat themelore që, ashtu siç ka vendosur Gjykata në mënyrë të vazhdueshme dhe siç është ripohuar në preambulën e Aktit Unik Evropian dhe në nenin F (2) të Traktatit të Bashkimit Evropian mbrohen nga sistemi juridik

komunitar. Megjithatë, rregullat që mund të kufizojnë lirinë e lëvizjes së sportistëve profesionistë, të nxjerra nga shoqatat sportive, nuk mund të konsiderohen të nevojshme për të garantuar gëzimin e lirisë nga këto shoqata, nga klubet ose lojtarët e tyre dhe as nuk mund të shikohen si rrjedhojë e pashmangshme e kësaj lirie.

Parimi i subsidiaritetit nënkupton që ndërhyrja e autoriteteve komunitare në fushën e organizimit të aktiviteteve sportive duhet të kufizohet vetëm atëherë kur është e nevojshme. Edhe kur interpretohet në mënyrë të përgjithshme, subsidiariteti nuk mund të krijojë një situatë ku liria e shoqatave private për të miratuar rregulla sportive të kufizojë ushtrimin e të drejtave që Traktati u garanton individëve.

Neni 48 i Traktatit të KEE-së nuk zbatohet vetëm ndaj akteve të autoriteteve publike, por shtrihet edhe tek rregullat e çdo natyre tjetër, që kanë për synim punësimin kolektiv me pagesë. Heqja nga shtetet anëtare e pengesave ndaj lirisë së qarkullimit të personave do të vihej në rrezik nëse heqja e barrierave shtetërore do të shmangej nga vënia e pengesave që burojnë nga veprimtaria e shoqatave dhe organizatave, që nuk rregullohen nga e drejta publike. Për më tepër, nëse fusha e zbatimit të nenit 48 të Traktatit të KEE-së do të kufizohej në aktet e autoriteteve publike, do të ekzistonte rreziku i krijimit të pabarazisë në zbatimin e tij. Kjo pasi kushtet e punës në shtete të ndryshme anëtare ndonjëherë rregullohen nga dispozitat ligjore ose nënligjore dhe ndonjëherë nga marrëveshjet ose aktet e tjera, që lidhen ose nxirren nga personat privatë. Asgjë nuk i ndalon individët që të përdorin bazat e nenit 48 të Traktatit të KEE-së lidhur me rendin publik, sigurinë publike apo shëndetin publik për të justifikuar kufizime të lirisë së qarkullimit të punëtorëve, të cilat pretendohet se i kanë krijuar vetë individët. As fusha e zbatimit dhe as përmbajtja e këtyre arsyeve justifikuese nuk cenohen nga natyra publike apo private e rregullave kufizuese që mbështesin të tilla arsye.

Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vendosi se neni 48 i Traktatit të KEE-së zbatohet për rregullat e miratuara nga shoqatat sportive, të cilat përcaktojnë kushtet në të cilat sportistët profesionistë hyjnë në një marrëdhënie pune me pagesë.

Pozita e një futbollisti profesionist, i cili është shtetas i një shteti anëtar dhe që ka pranuar një ofertë punë sipas nenit 48.3 (a) të Traktatit të KEE-së dhe ka lidhur një kontratë pune me një klub të një shteti tjetër anëtar me qëllim që të ushtrojë në atë shtet punë me pagesë, nuk mund të klasifikohet thjesht si çështje e brendshme dhe të mos rregullohet nga e drejta komunitare.

Neni 48 i Traktatit të KEE-së e ndalon zbatimin e rregullave të vendosura nga shoqatat sportive, sipas të cilave një futbollist profesionist shtetas i një shteti anëtar, me përfundimin e kontratës me klubin e mëparshëm, nuk mund të punësohet nga një klub i një shteti tjetër anëtar, kur ky klub nuk i paguan klubit të parë një tarifë transferimi, trajnimi ose përgatitjeje. Edhe pse këto rregulla nuk ndryshojnë nga ato që rregullojnë transferimet brenda të njëjtit shtet anëtar, ato mund ta kufizojnë lirinë e lëvizjes të lojtarëve që duan të ushtrojnë veprimtari në një shtet tjetër anëtar, duke penguar ose vështirësuar largimin e tyre nga klubet, të cilave u përkasin edhe pasi të kenë përfunduar kontratat e punës me këto klube.

Këto rregulla nuk janë mjet i përshtatshëm për arritjen e qëllimeve legjitime, si mbajtja e ekuilibrit financiar dhe konkurrues ndërmjet klubeve dhe nxitja e kërkimit të talenteve dhe trajnimi i lojtarëve të rinj. Ato nuk ia heqin mundësinë klubeve më të pasura për të siguruar shërbimet e lojtarëve më të mirë dhe as nuk mënjanojnë mjetet financiare si faktor vendimtar në sportet konkurruese, aq sa të ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme ekuilibrin. Tarifat e parashikuara në këto rregulla janë të pasigurta dhe në çdo rast nuk u përgjigjen shpenzimeve faktike të trajnimit të bërë nga klubet. Së fundmi, qëllimet që synohen mund të arrihen të paktën me po të njëjtin efikasitet me mjete të tjera, që nuk pengojnë lirinë e lëvizjes të punëtorëve. Pra, Gjykata arriti në përfundimin se vendosja e këtyre pagesave ishte në kundërshtim me nenin 48 të Traktatit të KEE-së.

Së dyti, Gjykata analizoi rregullat e miratuara nga shoqatat e sportit, sipas të cilave në ndeshjet e garave që organizojnë ato, klubet e futbollit mund të nxjerrin në fushë vetëm një numër të kufizuar futbollistësh profesionistë që janë shtetas të shteteve të tjera anëtare.

Sipas Gjykatës, këto rregulla bien ndesh me parimet e ndalimit të diskriminimit mbi baza shtetësie për sa i takon punësimit, shpërblimit dhe kushteve të punës dhe të punësimit. Ka pak rëndësi, nëse këto rregulla nuk kanë të bëjnë me punësimin e këtyre lojtarëve për të cilin nuk vihen kufizime, por e rëndësishme është shkalla deri ku klubet e tyre i nxjerrin në fushë për të luajtur. Meqenëse pjesëmarrja e lojtarëve në gara të tilla është qëllimi thelbësor i aktivitetit të lojtarëve profesionistë, një rregull që kufizon pjesëmarrjen natyrisht që kufizon edhe shanset e lojtarit për punësim.

Këto rregulla, që nuk kanë të bëjnë me ndeshje të veçanta ndërmjet ekipeve që përfaqësojnë vendet e tyre, por zbatohen për të gjitha garat zyrtare ndërmjet klubeve, nuk mund të justifikohen me arsyen se nuk kanë natyrë ekonomike dhe nuk janë vetëm për interes sportiv, si p.sh.: mbajtja e lidhjes tradicionale ndërmjet klubeve dhe shteteve të tyre përkatëse, meqenëse lidhjet e klubit të futbollit me shtetin anëtar ku klubi është krijuar, nuk mund të konsiderohen thjesht aktivitet sportiv; krijimi i numrit të nevojshëm të lojtarëve të skuadrës kombëtare me qëllim që t'u jepen ekipeve kombëtare lojtarët më të mirë në të gjitha pozicionet e fushës. Pavarësisht se ekipet kombëtare duhet të kenë lojtarë me shtetësi të vendit përkatës lojtarët e ekipit kombëtar nuk ka pse të jenë të regjistruar në klubet e atij vendi. Një arsye tjetër është mbajtja e ekuilibrit konkurrues ndërmjet klubeve, meqenëse nuk ka rregulla për të kufizuar mundësinë e klubeve të pasura për të blerë lojtarët më të mirë të kombëtareve, duke prishur në të njëjtën masë ekuilibrin.

Për këto arsye, Gjykata vendosi se rregulli i kufizimit, nga klubet, të numrit të lojtarëve me shtetësi nga një shtet anëtar tjetër, përbën diskriminim mbi bazën shtetësisë dhe është në kundërshtim me nenin 48 të Traktatit të KEE-së.

3.4. MBRETËRIA E HOLANDËS kundër PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C-377/98

9 tetor 2001

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=C-377/98>]

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Kjo çështje kishte të bënte me pretendimet nëse një direktivë evropiane mbi patentat mbronte sa duhet dinjitetin njerëzor dhe kontrollonte si duhet manipulimet gjenetike në lidhje me kafshët dhe bimët.*

Faktet kryesore

Më 6 korrik 1998, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian miratuan Direktivën 98/44/KE që kishte të bënte me mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike³³ (në tekstin e mëtejshëm: “Direktiva”). Kjo Direktivë u miratua në bazë të nenit 100 A të Traktatit të KE-së³⁴, qëllimi i direktivës është që shtetet anëtare të bëheshin përgjegjëse për mbrojtjen, në përputhje me angazhimet e tyre ndërkombëtare, të shpikjeve bioteknologjike nëpërmjet legjislacionit të tyre kombëtar për patentat. Për këtë qëllim, Direktiva specifikonte në veçanti se çfarë, ndërmjet shpikjeve në lidhje me bimët, kafshët dhe trupin e njeriut, mund ose nuk mund të ishte objekt i marrjes së një patente.

Me një padi të 19 tetorit 1998, Mbretëria e Holandës, duke u mbështetur në nenin 173 të Traktatit të KE-së³⁵, kërkoi anulimin e kësaj Direktive. Ajo deklaroi që në fillim se po vepronte me kërkesë të shprehur të Parlamentit të Holandës, në funksion të kundërshtimit që është shprehur nga deputetët mbi manipulimet gjenetike në lidhje me kafshët

33 OJ L 213, f. 13.

34 Aktualisht neni 114 i TFBE-së pas ndryshimeve me Traktatin e Lisbonës.

35 Aktualisht neni 263 i TFBE-së pas ndryshimeve me Traktatin e Lisbonës.

dhe bimët dhe me dhënien e patentave për produktet e proceseve bioteknologjike që mund të favorizojnë manipulime të tilla.

Me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së 28 prillit 1999, Komisionit të Komuniteteve Evropiane iu lejua të ndërhyjë në mbështetje të konkluzioneve të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian. Me urdhër të Kryetarit të Gjykatës të 3 majit 1999, u lejuan gjithashtu të ndërhyjnë, por në favor të padisë së Mbretërisë së Holandës, edhe Republika Italiane dhe Mbretëria e Norvegjisë³⁶.

Vendimi i Gjykatës

Së pari, Gjykata sqaroi se baza juridike mbi të cilën miratohet një akt komunitar duhet të përcaktohet në bazë të objektit kryesor të një akti. Në këtë drejtim, është e qartë që Direktiva 98/44 në lidhje me mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike ndjek objektivin e promovimit të kërkimit dhe zhvillimit në fushën e shpikjeve gjenetike në Komunitetin Evropian. Ajo synon ta realizojë këtë objektiv me anë të heqjes së pengesave të një natyre ligjore, në tregun e brendshëm, të përfaqësuar nga dallimet legjislative dhe praktike midis shteteve Anëtare, të cilat mund të pengojnë dhe çekuilibrojnë aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit në këtë fushë. Prandaj, përafrimi i legjislacioneve të shteteve Anëtare nuk përbën një objektiv të rastësishëm ose ndihmës të direktivës, por korrespondon me vetë thelbin e saj. Fakti që ajo ndjek gjithashtu një objektiv që bie brenda neneve 157 të KE-së dhe 163 të KE-së³⁷, në këto rrethana, nuk është i tillë që të bëjë përdorimin e nenit 100a të Traktatit të papërshtatshëm si bazë ligjore për Direktivën në fjalë.

Gjykata thekson se neni 6 i Direktivës 98/44, në lidhje me mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, që përjashton nga patentimi shpikjet, shfrytëzimi tregtar i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin ose moralin publik, u lë autoriteteve administrative dhe gjykatave të shteteve anëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi në zbatimin

36 Mbretëria e Norvegjisë ndërhyri për shkak se Direktiva në fjalë ishte e zbatueshme edhe për vendet anëtare të Hapësirës Ekonomike Evropiane. Ndërhyrja e saj u pranua nga Gjykata me një vendim në bazë të nenit 37 të Statutit të Gjykatës.

37 Aktualisht nenet 173, respektivisht 179, pas ndryshimeve me Traktatin e Lisbonës.

e këtij kriteri përjashtimi. Megjithatë, kjo hapësirë për manovrim nuk është diskrecionale pasi Direktiva i sqaron këto koncepte, nga njëra anë, duke specifikuar se thjesht ndalimi nga një dispozitë ligjore ose administrative nuk e bën shfrytëzimin tregtar të një shpikjeje në kundërshtim me rendin, publikun ose moralin dhe, nga ana tjetër, duke përmendur katër shembuj të proceseve dhe të përdorimeve që nuk janë të patentueshme.

Kjo duket veçanërisht nga neni 4 i Direktivës 98/44, në lidhje me mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, sipas së cilit një patentë nuk mund të jepet për një varietet bimor, por mund të jepet për një shpikje, fizibiliteti teknik i së cilës nuk kufizohet në një varietet të caktuar bimor. Kjo do të thotë që një modifikim gjenetik i një varieteti të caktuar bimor nuk është i patentueshëm, por që një modifikim i një shtrirjeje më të madhe, për shembull në lidhje me një specie, mund të jetë.

Nenet 8 dhe 9 të Direktivës 98/44, në lidhje me mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, sipas së cilave mbrojtja e dhënë nga patenta mbulon çdo material biologjik të përfutur nga riprodhimi ose shumëzimi i materialit biologjik që përmban informacion të patentuar, nuk kanë të bëjnë për parimin e patentimit, por me shtrirjen e mbrojtjes në fjalë. Prandaj, kjo e fundit mund të shtrihet edhe mbi një varietet bimor, pa qenë ky i fundit i patentueshëm.

Në parim, ligjshmëria e një akti të Komunitetit nuk varet nga përputhshmëria e tij me një konventë ndërkombëtare në të cilën Komuniteti nuk është palë, siç është Konventa e Munihut e 5 tetorit 1973 për dhënien e patentave evropiane. Ligjshmëria e tij nuk mund të vlerësohet as në dritën e instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare, si marrëveshja për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe marrëveshjet mbi aspektet e së drejtës të pronësisë intelektuale të lidhura me tregtinë (TRIPs) dhe mbi pengesat e tregtisë teknike që janë pjesë e tyre, të cilat nuk figurojnë, në parim, duke marrë parasysh natyrën dhe ekonominë e tyre, ndër standardet në lidhje me të cilat Gjykata shqyrton ligjshmërinë e akteve të institucioneve të Komunitetit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk mund të zbatohet për Konventën e Rio de Zhaneiros të 5 qershorit 1992 mbi diversitetin biologjik, e cila, ndryshe nga marrëveshja për themelimin e Organizatës Botërore

të Tregtisë, nuk bazohet rreptësisht në parimin e reciprocitetit dhe përfitimeve reciproke. Në lidhje me këtë, edhe duke supozuar se kjo Konventë përmban dispozita që nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë, në kuptimin që ato nuk krijojnë të drejta të cilave individët mund t'u referohen drejtpërdrejt në gjykatë, kjo rrethanë nuk do të përbënte pengesë për gjykatat që të kontrollojnë respektimin e detyrimeve që i takojnë Komunitetit si palë në këtë Konventë.

I takon Gjykatës që gjatë kontrollit të pajtueshmërisë së akteve të institucioneve me parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare, të sigurojë respektimin e së drejtës themelore të dinjitetit njerëzor dhe të integritetit të personit. Për sa i përket lëndëve të gjalla me origjinë njerëzore, Direktiva 98/44, në lidhje me mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, rregullon të drejtën e patentave në një mënyrë mjaft rigoroze në mënyrë që trupi i njeriut të mbetet efektivisht i padisponueshëm dhe i patjetërsueshëm dhe në këtë mënyrë të ruhet dinjiteti njerëzor. Nga njëra anë, në fakt, neni 5 paragrafi 1 i Direktivës e ndalon që trupi i njeriut, në fazat e ndryshme të konstituimit dhe zhvillimit të tij, të përbëjë një shpikje të patentueshme. Nga ana tjetër, as elementët e trupit të njeriut nuk janë në vetvete të patentueshëm dhe analiza e tyre nuk mund të jetë objekt mbrojtjeje. Vetëm shpikjet që lidhin një element natyror me një proces teknik duke bërë të mundur izolimin ose prodhimin e tij me qëllim aplikimin industrial mund të jenë objekt i një aplikimi për patentë. Kështu, një element i trupit të njeriut mund të jetë pjesë e një produkti që ka të ngjarë të marrë mbrojtje për patentë, por ai nuk mund të jetë subjekt i ndonjë përvetësimi në mjedisin e tij natyror.

Kështu, mbrojtja e parashikuar nga Direktiva lidhet vetëm me rezultatin e një pune shpikëse, shkencore ose teknike dhe shtrihet në të dhënat biologjike që ekzistojnë në gjendjen natyrore të njerëzit vetëm në masën e nevojshme për realizimin dhe shfrytëzimin e një aplikimi të veçantë industrial. Për më tepër, e drejta për integritetin e personit, e cila përfshin, brenda kuadrit të mjekësisë dhe të biologjisë, pëlqimin e lirë dhe të informuar të dhuruesit dhe marrësit, nuk gjen veprim ndaj një Direktive që lidhet vetëm me dhënien e patentave dhe fushëveprimi i së cilës për rrjedhojë nuk shtrihet ndaj operacioneve para dhe pas dhënies së patentës, pavarësisht nëse ka të bëjë me kërkimin apo me përdorimin e produkteve të patentuara.

Detyrimi për të motivuar direktivat, që rrjedh nga neni 190 i Traktatit³⁸ nuk do të thotë të kërkohet që miratimi i propozimeve dhe opinioneve, të përmendura në të njëjtin nen, të përfshijë përsëritjen e rrethanave faktike që bëjnë të mundur të vërtetohet se secili prej institucioneve që ndërhyjnë në procedurën legjislative, ka respektuar rregullat e veta të procedurës. Vetëm në rast se ka dyshime serioze për rregullsinë e procedurës, një institucion justifikohet të hetojë atë.

Në këto kushte, Gjykata hodhi poshtë padinë e Mbretërisë së Holandës dhe la në fuqi Direktivën e lartpërmendur.

38 Aktualisht neni 296 i TFBE-së pas ndryshimeve me Traktatin e Lisbonës.

Neni 24

Barazia para Ligjit

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO157/18. PARASHTRUES: GJYKATA SUPREME

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/ko_157_18_agj_shq.pdf]

28 mars 2019

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Objekt shqyrtimi i kësaj kërkesë (“kontroll kushtetues incidental”, sipas nenit 113.8 të Kushtetutës) ishte vlerësim nëse neni 14.1.7 i Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, që detyronte vetëm kompanitë e sigurimeve në Kosovë për të paguar për buxhetin e Kryqit të Kuq të Kosovës, ishte në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 119 [Marrëdhëniet Ekonomike] dhe 120 [Financat Publike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 14.1.7 i Ligjit të kontestuar përcaktonte se: “1. Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga: [...] 1.7 sigurimi i obligueshëm i automjeteve, një për qind (1%) nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit”.

Faktet Kryesore

Ligji për Kryqin e Kuq (Ligji i kontestuar) ishte miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 qershor 2010 dhe më 26 nëntor 2010. Shoqata e Sigurimeve të Kosovës kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për anulimin e nenit 14, paragrafi 1.7 të atij Ligji. Më 23 maj 2011, Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur kërkesën e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës si të papranueshme, pasi konstatoi se parashtruesi nuk ishte palë e autorizuar për të kontestuar Ligjin në fjalë. Më 2 dhjetor 2014, Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës parashtroi një kërkesë tjetër në Gjykatë Kushtetuese, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit të kontestuar. Më 3

shkurt 2015, Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur të papranueshme atë kërkesë, pasi kishte konstatuar se tashme kishte nxjerrë një vendim për rastin në fjale dhe nuk ishte ofruar bazë për një vendim të ri. Në një datë të pacaktuar, Kryqi i Kuq kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Kompanisë “Illyria”, duke kërkuar që t’ia paguajë asaj një për qind (1%) të bruto primit të vlerës së sigurimit të obliguar të automjeteve të realizuar nga Kompania «Illyria», për periudhën 2010-2016. Më 16 nëntor 2016, Gjykata Themelore kishte aprovuar kërkesëpadinë e Kryqit të Kuq duke e detyruar Kompaninë “Illyria” që t’i paguante shumën prej 248.648,16€, me kamatë dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.065 €. Gjykata Themelore arsyetoi se obligimi për pagesën e shumës së vendosur me aktgjykimin e cekur më lart rrjedh nga neni 14, paragrafi 1.7 i Ligjit të kontestuar. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Kompania “Illyria” kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit dhe më 12 qershor 2018, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar si të pathemeltë atë ankesën. Kompania “Illyria” kishte paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke kërkuar nga Gjykata Supreme që lënda të referohet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar me Kushtetutën, si dhe duke kërkuar që të pezullohet zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese. Më 15 tetor 2018, gjykata referuese e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Thelbi i kërkesës së Gjykatës Supreme, si “Gjykatë referuese,” konsistonte në pretendimin se paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit të kontestuar, i cili i detyronte vetëm kompanitë e sigurimeve në Kosovë të paguajnë 1% nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjeteve të siguruara dhe i cili nuk parasheh ndonjë detyrim për kontribut për kompanitë e tjera në Kosovë, i vendoste kompanitë e sigurimeve në pozitë të pabarabartë në raport me kompanitë e tjera, në kundërshtim me parimin e vendosur në paragrafin 2 të nenit 119 të Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme], ku parashihet që *“Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme”*. Gjykata referuese po ashtu pohoi se e drejta e pronës së qytetarëve, si

personave fizikë dhe ndërmarrjeve private, është e garantuar më ligj dhe më Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme argumentoi se më të drejtë e paditura (kompania Illyria) ngrehte pretendime për (mos) përputhshmërinë e dispozitës së lartpërmendur ligjore më nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Arsyetimi i Gjykatës

Pasi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për pranueshmëri të kërkesës, Gjykata Kushtetuese iu referua praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, ose status, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së. Gjykata po ashtu vuri në pah se në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme. Më tutje, Gjykata arsyetoi se, për qëllimet e interpretimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, një trajtim ndryshe është i pabarabartë dhe arbitrar nëse: 1) nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se nuk ndjek një qëllim legjitim, ose 2) kur nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (përkatësisht përpjesëtueshmërie) ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë për të vendosur nëse dhe deri në çfarë mase mund të arsyetohet trajtimi i pabarabartë në rrethana të njëjta. Po ashtu, Gjykata u shpreh se në rastin konkret, ligjvënësi nëpërmjet kufizimit të të drejtave kishte për qëllim arritjen e një qëllimi që përkon me interesin e përgjithshëm shoqëror. Megjithatë, sipas Gjykatës, nuk ishte i qartë fakti se pse ligjvënësi nuk e kishte shtrirë dhe shpërndarë detyrimin financiar, të vendosur me dispozitën e ligjit të kontestuar edhe te subjektet e tjera ekonomike, por vetëm të kompanitë e sigurimeve që ofrojnë këtë lloj të sigurimit. Pra, Gjykata vërejti se as Kuvendi dhe as ndonjë instancë tjetër përkatëse nuk kishin paraqitur ndonjë arsyetim të qëndrueshëm se përse Ligji i kontestuar i ngarkonte me detyrim vetëm kompanitë e sigurimit, për të kontribuar në financimin e Kryqit të Kuq e jo kompanitë/sectorët e tjerë. Gjykata arsyetoi se, po që se pagesa e paraparë me dispozitën e Ligjit të kontestuar do të shpërndahej në mënyrë

të arsyeshme dhe proporcionale ndaj të gjitha subjekteve ekonomike, kjo do të ishte në pajtim me kërkesat e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, me pozitën e barabartë në treg të garantuar me nenin 119 të Kushtetutës, si dhe me kërkesat paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 55 të Kushtetutës. Në dritën e shtjellimeve të mësipërme, Gjykata konsideroi se detyrimi vetëm i kompanive të sigurimit për të paguar shumën e caktuar nga të hyrat e realizuara nga sigurimi i autopërgjegjesisë, si kontribut për buxhetin e Kryqit të Kuq, nuk ishte i justifikuar, gjegjësisht nuk ishte i bazuar në arsye objektive. Rrjedhimisht, nuk ekzistonte një qëllim legjitim që do të arsyetonte trajtimin e pabarabartë të kompanive të sigurimit të automjeteve. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata gjeti se si rrjedhojë e trajtimit të pabarabartë të kompanive të sigurimit në raport me kompanitë e tjera në Kosovë, dhe duke pasur parasysh se pagesa nga kompanitë e sigurimeve të 1% të shumës nga bruto primi i autopërgjegjesisë zvogëlon pasurinë e kompanive të sigurimeve, paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit të kontestuar gjithashtu nuk është në pajtueshmëri me të drejtën e pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës.

Gjykata gjithashtu sqaroi se gjykata referuese po ashtu kishte ngritur edhe çështjen e pajtueshmërisë së Ligjit të kontestuar me nenin 120 [Financat Publike] të Kushtetutës. Mirëpo, duke pasur parasysh se Gjykata gjeti shkelje të nenit 24, 46 dhe 119 të Kushtetutës, ajo nuk e konsideroi të nevojshme vlerësimin e pajtueshmërisë së Ligjit të kontestuar me nenin 120 të Kushtetutës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të shpallë që paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës; dhe vendosi që paragrafi 1.7 i nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës ishte i pavlefshëm, nga dita e hyrjes në fuqi të Aktgjykimit.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. “GASUS DOSIER- UND FÖRDERTECHNIK” GmbH kundër MBRETËRISË SË HOLANDËS

[15375/89]

GJEDNJ [Dhoma]

23 shkurt 1995

Çështja kyçele drejta e pretenduar: ndërhyrja si rezultat i ushtrimit të kompetencave të autoriteteve tatimore sipas nenit 16 (3) të Aktit të mbledhjes së taksave të vitit 1845 (Invorderingswet).

Faktet kryesore

Rasti u referua në Gjykatë nga Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut (“Komisioni”), më 9 dhjetor 1993, kundër Mbretërisë së Holandës. Kërkesa ishte paraqitur në Komision sipas nenit 25, më 6 korrik 1989, nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me personalitet juridik sipas ligjit gjerman (Gesellschaft mit beschränkter Haftung), Gasus Dosier- und Fördertechnik GmbH.³⁹ Kompania “Gasus Dosier- und Fördertechnik” GmbH (në tekstin e mëtejshëm: kompania kërkuese “Gasus”), është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, që kishte zyrën të regjistruar në Würzburg, Gjermani. Më 17 qershor 1980, agjenti i kompanisë kërkuese “Gasus” në Holandë mori një porosi nga një kompani holandeze, “Atlas Junior Beton” B.V. (në tekstin e mëtejshëm: “Atlas”) e Leiderdorp, për një mikser betoni dhe pajisje ndihmëse. Porosia u konfirmua me shkrim nga vetë Kompania kërkuese “Gasus”, më 18 qershor 1980. Kompania kërkuese “Gasus” i bashkëngjiti letrës së tyre kushtet e tyre të përgjithshme të shitjes, si më poshtë:

³⁹ Kërkesa (nr. 15375/89) e Komisionit iu referua neneve 44 dhe 48 (neni 44, neni 48) dhe deklaratës me të cilën Holanda njohu juridiksionin e detyrueshëm të Gjykatës (neni 46). Objekti i kërkesës ishte marrja e një vendimi nëse nga faktet e çështjes rezultonte shkelje nga shteti përgjegjës të detyrimeve të tij sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1).

“Ne ruajmë pronësinë e mallrave të dorëzuara derisa të paguhen plotësisht të gjitha shumat e duhura, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen, duke përfshirë pretendimet ndihmëse që vijnë nga biznesi me klientin”.

dhe

“Në rastin e biznesit të huaj (Auslandsgeschäfte), do të zbatohet vetëm ligji i Republikës Federale Gjermane”.

Kompania kërkuese “Gasus” më pas mori një porosi nga “Atlas” për pajisje ndihmëse shtesë dhe e konfirmoi atë me shkrim në 21 korrik 1980, duke shtuar përsëri kushtet e tyre të përgjithshme të shitjes. Ndër të tjera, në këtë porosi u cek se “Atlas” do të siguronte pajisje ngritëse dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për montimin e makinës, pjesa kryesore e së cilës peshonte pesë tonë. Midis 25 korrikut dhe 28 gushtit 1980, kompania kërkuese “Gasus” dërgoi fatura tek “Atlas” në total 125,401,24 marka gjermane (DEM), për të cilat Atlas nuk kundërshtoi. Kompania “Gasus” pranoi vetëm 21,672 DEM në pagesë para ngjarjeve për të cilat u ankua.

Makineria u instalua në ambientet e “Atlas” nga kompania kërkuese “Gasus”; punët për instalimin e makinerisë së kontraktuar u zhvilluan nga 28 korriku deri më 2 gusht 1980.

Më 31 korrik 1980, përmbaruesi tatimor (belastingdeurwaarder) sekuestroi të gjitha pasuritë e luajtshme në ambientet e “Atlas”, për shitje të detyruar në zbatim të tri shkresave të ekzekutimit, të lëshuara nga Mbledhësi i Taksave Direkte, gjithsej 67,741.59 gulden holandez (NLG). Regjistrimi zyrtar (procesverbali) përmend edhe mikserin e betonit. Njoftimi për konfiskimin iu dha Kompanisë “Atlas”, por jo kompanisë kërkuese “Gasus”.

Duke mos qenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre financiare, “Atlas” kërkoi një moratorium, i cili iu dha nga Gjykata Rajonale e Hagës më 16 tetor 1980. Marrësi, një avokat i caktuar nga Gjykata Rajonale, pa që nuk ishte e mundur që “Atlas” të vazhdonte aktivitetin e tij në mënyrë të pavarur dhe arriti të zgjojë interesimin e një kompani tjetër,

“Van Baarsen Wandplatten” BV (“Van Baarsen”), për t’i marrë përsipër vazhdimin e prodhimit.

Nën presionin e klientëve të “Atlas”-it, të cilët insistuan që një marrëveshje e kënaqshme për vazhdimin e prodhimit duhet të arrihej deri më 23 tetor 1980, “Atlas”, marrësi dhe “Van Baarsen” arritën një marrëveshje në atë datë, që “Van Baarsen” të merrte përsipër vazhdimin e prodhimit. Kjo marrëveshje do të arrihej vetëm me bashkëpunimin e hipotekëmbajtësve të “Atlasit”:

- dy banka që kishin financuar “Atlas”-in dhe kishin përcaktuar që pronësia e disa prej pasurive të luajtshme të saj të transferohej në mirëbesim si siguri.

- dhe mbledhësi i taksave direkte, i cili kishte sekuestruar të gjitha pasuritë e luajtshme të pranishme në ambientet e “Atlas”-it.

Marrëveshja i nënshtrohej kushtit që asnjë palë e tretë të mos mund të pretendonte një të drejtë më të mirë për mallrat e mbuluara nga ajo. “Van Baarsen” do të paguante një shumë prej 500,000 NLG për marrjen në dorëzim të makinave dhe inventarit të “Atlas”-it. Gjysma e kësaj shume do t’i paguhej autoriteteve tatimore dhe gjysma tjetër një banke, NIB, e cila ishte pronari i besuar i disa mallrave që nuk i nënshtroheshin konfiskimit nga autoritetet tatimore. “Van Baarsen” vazhdoi aktivitetet e “Atlas”-it në ambientet e këtij të fundit nga 27 tetori, duke përdorur makineritë e “Atlas”-it.

Më 21 tetor 1980, kompania kërkuese “Gasus” i dërgoi një letër marrësit të “Atlasit”, e cila arriti tek ai më 24 tetor. Në të, ata deklaruan se nga paratë që u kishte borxh kompania “Atlas”, ata kishin marrë vetëm 21,672 DEM dhe kërkuan pagesën e pjesës së mbetur. Kompania kërkuese “Gasus” gjithashtu njoftoi se betonieri do të merrej përsëri më 30 tetor, nëse garancitë e mjaftueshme për pagesë nuk do të siguroheshin deri më 28 tetor. Pagesa nuk u bë, por nuk rezulton se kompania kërkuese “Gasus” kishte ndërmarrë ndonjë veprim.

Përmbledhja e pretendimeve

Fillimisht, kompania kërkuese “Gasus” pretendoi para Komisionit se nuk kishte pasur qasje në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, në shkelje të nenit 6 paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt] dhe se atyre u ishte marrë prona në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës]. Më 21 tetor 1992, Komisioni e shpalli kërkesën (nr. 15375/89) të pranueshme në lidhje me ankesat sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe të papranueshme për pjesën e mbetur. Në raportin e 21 tetorit 1993, Komisioni shprehu mendimin, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit.

Para Gjykatës Kompania kërkuese “Gasus” u ankua për sekuestrimin nga organet tatimore dhe shitjen e mëpashme të betonierit me miratimin e tyre të heshtur. Ata u mbështetën në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në lidhje me këtë pretendim, kompania kërkuese “Gasus” theksoi se ata ia kishin shitur betonierin “Atlas”-it, me kusht që t’i ruhej pronësia derisa të paguhej çmimi i plotë. Duke qenë se në momentin e sekuestrimit nuk ishte paguar çmimi i plotë, betonieri kishte mbetur në pronësi të kompanisë kërkuese “Gasus”. Kjo, sipas pretendimit të tyre, nënkuptonte se sekuestrimi dhe shitja e mëvonshme e asaj makinerie nga autoritetet tatimore të Holandës, kishte ndërhyrë në të drejtën e tyre të pronës konkretisht në “gëzimin paqësor të pasurisë [së tyre]”.

Në deklaratimet përfundimtare para Gjykatës, Qeveria deklaroi se kërkesa e kompanisë kërkuese “Gasus”, bazuar në pretendimet për shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1, duhet të shpallet e papranueshme pasi nuk ishin shteruar mjetet juridike të brendshme (neni 26 i Konventës) dhe se kërkesa ishte në çdo rast e pabazuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata nuk u pajtua me Qeverinë se fakti që pretendimi i kompanisë kërkuese “Gasus” kundër “Atlas”-it ishte bërë i pavlefshëm nuk ishte pasojë e veprimit të ndërmarrë nga autoritetet tatimore. Sidoqoftë, sipas Gjykatës, ishte e vërtetë që kompania kërkuese “Gasus” ishte angazhuar në një sipërmarrje tregtare e cila, për nga natyra e saj, përfshinte një element rreziku. Gjykata vuri në dukje se, faktet e çështjes tregonin

se Kompania kërkuese “Gasus” ishte mjaftueshëm e vetëdijshme për rrezikun sa për të ndërmarrë hapa për ta kufizuar atë.

Pasi e lejoi “Atlas” -in të paguante me këste çmimin e blerjes së betonierit dhe duke qenë e vetëdijshme për rrezikun që “Atlas” mund të mos bënte pagesat me kohë, kompania kërkuese “Gasus” rezervoi pronësinë mbi betonierin derisa të paguhej çmimi i plotë. Kjo, sipas ligjit holandez, u siguroi atyre një shkallë të konsiderueshme sigurie, pasi pretendimet e tyre ndaj betonierit patën përparësi ndaj pretendimeve të të gjithë kreditorëve të tjerë, përveç autoriteteve tatimore, të cilat kishin të drejtë sipas nenit 16 (3) të Aktit të vitit 1845 për ta konfiskuar atë dhe për të marrë të ardhurat për shtetin.

Ashtu si Komisioni, Gjykata konsideroi se kompania kërkuese “Gasus” mund të kishte eliminuar krejtësisht rrezikun duke mos pranuar të jepnin kredi për “Atlas” -in: ata mund të kishin përcaktuar pagesën e tërë çmimit të blerjes paraprakisht ose përndryshe të refuzonin shitjen e betonierit që në fillim. Gjykata gjithashtu theksoi që kompania kërkuese “Gasus” mund të ketë marrë siguri shtesë, për shembull në formën e garancisë bankare, të cilat kalojnë rrezikun te një palë tjetër.

Prandaj, Gjykata konsideroi se ishte e panevojshme që ajo të përcaktonte nëse kompania kërkuese “Gasus” mund të ketë konstatuar ekzistencën dhe shkallën e borxheve tatimore të “Atlasit”, pikë kjo që ishte kontestuese.

Sipas Gjykatës, nuk ishte pa rëndësi që pronarët e mallrave që u konfiskuan sipas nenit 16 (3) të Aktit të vitit 1845 me vetëdije i kishin lejuar ato të shërbenin si «orendi» të lokaleve të debitorit tatimor. Prandaj, ata mund të mbaheshin përgjegjës në një farë mase që i mundësuan debitorit tatimor të paraqesë një pamje të aftësisë kredimarrëse.

Për më tepër, Gjykata u shpreh se pavarësisht nëse autoritetet tatimore kishin apo jo ndonjë detyrim ligjor ose tjetër për të qenë më fleksibël në lidhje me debitorët tatimorë që gjendeshin në vështirësi të përkohshme financiare, ata nuk kanë në dispozicion mjetet e njëjta me kreditorët tregtarë për t’u mbrojtur nga pasojat e problemeve financiare të debitorëve të tyre. Ata gjithashtu nuk kanë ndonjë mënyrë tjetër për të mbrojtur veten nga përpjekjet e debitorëve të tyre për të zgjidhur

probleme të tilla, duke ia vendosur pronësinë e “orendive” të tyre një pale tjetër, si një mjet për huazim përmes një sigurie.

Gjykata pranoi argumentin e Qeverisë se fakti që betonieri për të cilin kompania kërkuese “Gasus” kishte rezervuar pronësinë u sekuestrua, ndërsa mallrat që i nënshtroheshin të drejtave të pronësisë fiduciare të NIB-së ishin kursyer nuk mjafton të demonstrojë se konfiskimi i betonierit ishte arbitrar. Ndërsa betonieri i furnizuar nga Kompania kërkuese “Gasus” kualifikohej si “orendi”, ky nuk ishte rasti me mallrat mbi të cilat NIB mund të kërkonte të drejta. Ky dallim u bazua në ligj, siç sqarohet nga një korpus i praktikës gjyqësore të vendosur prej kohësh, dhe ishte në harmoni me politikën e deklaruar të Ministrit të Financave.

Së fundmi, sipas mendimit të Gjykatës, duhet të merret parasysh se, siç ishte bërë e qartë nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj në këtë rast, sipas ligjit holandez, palët e treta, pasuritë e të cilave janë sekuestruar sipas nenit 16 (3) të Aktit të vitit 1845, mund të kërkojnë që përdorimi që u është bërë kompetencave të dhëna nga ai nen, të shqyrtohet në mënyrë adekuate nga një gjykatë në një procedurë që plotëson kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës.

Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa e proporcionalitetit ishte përmbushur. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi që nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

2.2. S.A. “DANGEVILLE” kundër FRANCËS

[36677/97]

GJEDNJ [Seksioni i dytë]

16 prill 2002

Çështja kyçele drejta e pretenduar: kompania e taksapaguesve pretendonte shkelje të së drejtës së pronës të përcaktuar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ; edhe pse ishte kreditor i rregullt i shtetit ishte privuar përfundimisht nga mundësia e marrjes/tërheqjes së borxhit të saj me vendimet e Conseil d'Etat; kompanitë e tjera që nuk kishin paguar TVSH-në kishin qenë në pozitë më të favorshme krahasuar me tatimpaguesit.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit kundër Republikës Franceze nga një kompani franceze, S.A. “Dangeville” (në tekstin e mëtejme: “kompania kërkuese”), pranë Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut. Kompania kërkuese, S.A. “Dangeville”, ishte një shoqëri ndërmjetësish të sigurimeve, aktiviteti biznesor i së cilës i nënshtrohej tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH). Ajo pagoi 292,816 franga franceze TVSH për aktivitetin tregtar që kishte kryer në vitin 1978. Dispozitat e Direktivës së Gjashtë të Këshillit të Komunitetit Evropian, të cilat ishin të zbatueshme nga 1 janari 1978, përjashtuan nga TVSH-ja “transaksionet e sigurimit dhe risigurimit, duke përfshirë shërbimet përkatëse të kryera nga sigurimet e ndërmjetësit dhe agjentët e sigurimeve”. Më 30 qershor 1978, shteti francez u njoftua për Direktivën e Nëntë të Këshillit të Komunitetit Evropian, e cila i dha Francës kohë shtesë për të zbatuar dispozitat e nenit 13 B (a) të Direktivës së Gjashtë të vitit 1977. Megjithatë, duke qenë se nuk kishte efekt retroaktiv, Direktiva e Gjashtë ishte e zbatueshme nga 1 janari deri më 30 qershor 1978. Kompania kërkuese, duke u mbështetur në Direktivën e Gjashtë, kërkoi rimbursim të TVSH-së të paguar për vitin 1978. Gjykata Administrative dhe më pas Conseil d'Etat hodhën poshtë padinë e saj duke argumentuar, ndër të tjera, se një Direktivë nuk mund të referohet drejtpërdrejt kundër një dispozite të ligjit kombëtar.

Me Urdhrin administrativ të 2 janarit 1986 u anuluan vlerësimet tatimore shtesë të vendosura ndaj ndërmjetësve të sigurimeve që nuk kishin paguar TVSH-në për atë periudhë. Në lidhje me këtë, kompania kërkuese paraqiti një kërkesë të dytë, e cila u hodh poshtë përfundimisht nga një tjetër aktgjykim i Conseil d’Etat, i 30 tetorit 1996, duke vendosur se kompania kërkuese nuk mund të kërkonte me anë të padisë për të marrë dëmshpërblim në tatim, të cilës i ishte refuzuar procedura me një vendim i cili ishte bërë *res judicata*. Megjithatë, në një gjykim në të njëjtën datë për një rast të paraqitur nga një kompani tjetër, veprimtaria e së cilës dhe pretendimet fillimisht ishin identike me ato të kërkuese, Conseil d’Etat vendosi ndryshe nga vendimi i tij i mëparshëm dhe mbështeti kërkesën e asaj kompanie për rimbursim nga shteti.

Përmbledhja e pretendimeve

Kompania kërkuese pretendoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke argumentuar se ishte kreditor i shtetit por ishte privuar përfundimisht nga mundësia e marrjes/tërheqjes së borxhit të saj me vendimet, përmes së cilave ishin hedhur poshtë pretendimet e saj nga Conseil d’Etat. Ajo u ankua gjithashtu për shkelje të nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, mbi arsyetimin se kompanitë e tjera që nuk kishin paguar TVSH-në kishin qenë në pozitë më të favorshme krahasuar me tatimpaguesit që kishin bërë kohë pas kohë deklaratat e TVSH-së dhe se një tjetër kompani kishte përfituar shmangie nga vendimi i mëparshëm dhe kishte marrë rimbursim të TVSH-së, pavarësisht se situatat e tyre ishin identike. Kompania kërkuese theksoi se duke miratuar qarkoren administrative të ndërprerjes së procedurave kundër kompanive që nuk kishin paguar TVSH-në, autoritetet kishin diskriminuar ata duke u dhënë atyre që kishin shkelur taksën e tyre një avantazh ndaj taksapaguesve që i bindeshin ligjit; se diskriminimi ishte shtuar nga dështimi i autoriteteve për të ndërmarrë ndonjë veprim për të rimbursuar shumatat të cilat taksapaguesit që e respektojnë ligjin, kishin paguar gabimisht.

Kompania kërkuese argumentoi se Qarkorja administrative nuk ndiqte një qëllim legjitim dhe se mjetet e përdorura nuk ishin proporcionale në mënyrë të arsyeshme me qëllimin e ndjekur. Nëse qëllimi i Qarkores

administrative do të kishte qenë bartja/transpozimi i Direktivës së Gjashtë të vitit 1977 në ligjin e brendshëm, nuk do të kishte asnjë justifikim për ndryshimin në trajtim midis kompanive të përfshira në Direktivën e Gjashtë. Ato kompani që kishin paguar vullnetarisht TVSH-në, edhe pse u ishte ngarkuar në mënyrë të paligjshme, nuk kishin marrë ndonjë përfitim në këmbim.

Së fundmi, kompania kërkuese pretendoi se kishte marrë një trajtim më pak të favorshëm (gjegjesisht diskriminues), në krahasim me kompanitë tjera dhe në veçanti kompania S.A. “Revert et Badelon”. Të dy kompanitë kishin paguar të njëjtën taksë, kishin bërë një kërkesë fillestare për një rimbursim, apeluar në gjykatën administrative dhe, pas hedhjes poshtë të kërkesave të tyre, bënë apelime pothuajse të njëkohshme në Conseil d’Etat në 1982. Conseil d’Etat kishte hedhur poshtë ankesën e kompanisë kërkuese në 1986, ndërsa dokumentacioni i apelit të kompanisë S.A. “Revert et Badelon” kishte humbur dhe shqyrtimi i ankesës u shty, derisa u caktua për t’u dëgjuar në të njëjtën seancë me ankesën e dytë të kompanisë kërkuese. Conseil d’Etat nxori vendime të ndryshme në të dy rastet, pavarësisht faktit se pozicioni ligjor i të dy kompanive ishte identik, ndryshimi i vetëm ishte se dosja e çështjes së S.A. “Revert et Badelon” ishte vonuar nga Conseil d’Etat për disa vjet. Ankimi nga S.A. “Revert et Badelon” nuk u shqyrtua për dhjetë vjet pas ankesës se kësaj kompanie dhe ajo përfitoi nga zhvillimet e favorshme në praktikën gjyqësore.

Në anën tjetër, Qeveria konsideroi se, as vendimet e Conseil d’Etat, as Qarkorja administrative e miratuar më 2 janar 1986 nga autoritetet tatimore nuk përbënin diskriminim. Vendimet në çështjen e kompanisë kërkuese dhe të kompanisë S.A. “Revert et Badelon” nuk kishin të bënin me të njëjtën çështje të ligjit ose të ankuesve në situata identike. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kishte vendosur që nuk mund të kishte diskriminim përveç nëse ndryshimi në trajtim kishte të bënte me persona në situata identike (Qeveria iu referua rasteve *Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 8 korrikut 1986, Seria A nr. 102, dhe *Johnston dhe të tjerët kundër Irlandës*, aktgjykim i 18 dhjetorit 1986, Seria A nr.112). Qeveria vuri në dukje se ankesat e paraqitura njëkohësisht me ankesën e parë të kompanisë kërkuese ishin hedhur poshtë gjithashtu. Sidoqoftë, Qeveria pranoi që vendimet e vitit 1986 të Conseil d’Etat mbi

ankesën e kompanisë kërkuese dhe vendimi i saj mbi ankesën e “Revert et Badelon” ishin në kundërshtim. Arsyja e ndryshimit ishte se Conseil d’Etat, i cili në këtë rast kishte argumente identike përpara vetes, vendosi në çështjen e dytë - e cila, dhjetë vjet pas së parës, ngriti të njëjtën çështje të ligjit – për pasojë u shmang nga praktika gjyqësore e mëparshme. Ndryshimet në praktikën gjyqësore, të cilat si përkufizim përfshinin një konflikt midis vendimeve të dhëna para dhe pas ndryshimit, nuk mund të konsiderohen se shkelin nenin 14. Nëse do të konsiderohen ndryshe, sipas Qeverisë, do të ishte në kundërshtim me interpretimin tradicional të Gjykatës të dispozitave të nenit 14 (shih Çështjen në lidhje me aspekte të caktuara të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë (meritat), aktgjykim i 23 korrikut 1968, Seria A nr. 6).

Së fundmi, Qeveria argumentoi që ndryshimi në trajtim duhej të vihej në kontekst, pasi kompanitë të cilat, ashtu si kompania parashtruese, kishin paguar TVSH-në kishin gëzuar një përjashtim nga taksa e punësimit dhe kishin qenë në gjendje t’ua kalonin tërë ose një pjesë të TVSH-së klientëve të tyre, ndryshe nga kompanitë që nuk kishin paguar TVSH-në.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e kompanisë kërkuese për shkelje të nenit 1 i Protokollit nr. 1, Gjykata arsyetoi se ky nen ishte i zbatueshëm sepse shuma që i detyrohej shteti kompanisë kërkuese, për TVSH-në e paguar, përbënte një të drejtë prone. Kompania kërkuese kishte pritur legjitime që të siguronte rimbursimin e TVSH-së. Gjatë shqyrtimit të arsyetimit për ndërhyrje në të drejtën e kompanisë kërkuese për të respektuar pasurinë e tij, duhej të përcaktohej nëse ishte vendosur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe nevojës për të mbrojtur të drejtat themelore të kompanisë parashtruese. Lidhur me pikën e parë, Udhëzimi administrativ i vitit 1986 kishte për qëllim të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me Direktivën e Gjashtë të Komunitetit, që ishte një qëllim legjitim dhe i pajtueshëm me “interesin e përgjithshëm”.

Sidoqoftë, interpretimi veçanërisht i rreptë i Conseil d’Etat i parimit ligjor tradicional të “dallimit të mjeteve të apelimit” e kishte privuar

kompaninë kërkuese nga procedura e vetme e brendshme e që mund të ofronte një mjet juridik të mjaftueshëm për të siguruar përputhshmërinë me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Asgjë në lidhje me interesin e përgjithshëm nuk mund të justifikojë refuzimin e Conseil d'Etat për të nxjerrë pasojat e një dispozite të ligjit të Komunitetit, që ishte drejtpërdrejt e zbatueshme. Ndërhyrja në fjalë ishte pasojë e dështimit të Parlamentit për të harmonizuar ligjin e brendshëm me një direktivë të Komunitetit.

Gjykata më tutje u shpreh se, megjithëse kjo pajtueshmëri u arrit përmes Qarkores administrative të janarit 1986, vendimi i Conseil d'Etat i dhënë dy muaj e gjysmë më vonë, në mars 1986, nuk solli rezultatet e pritura. Ndërsa dukej se kishte vështirësi në zbatimin e ligjit të Komunitetit në nivelin e brendshëm, kompania kërkuese nuk duhej të barte pasojat e këtyre vështirësive dhe ndryshimeve midis autoriteteve të ndryshme të vendit. Ndërhyrja në zotërimet (të drejtat pronësore) të kompanisë kërkuese nuk pasqyron kërkesat e interesit të përgjithshëm. Pamundësia e kompanisë kërkuese për të realizuar pretendimin e saj ndaj shtetit dhe mungesa e procedurave të brendshme që sigurojnë një mjet juridik efektiv për të mbrojtur të drejtën për të respektuar gëzimin e zotërimeve të saj pronësore, prishën ekuilibrin e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtës themelore të individit. Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja e autoriteteve në gëzimin e pronës ndaj kompanisë kërkuese ishte joproporcionale.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Në funksion të konstatimit të saj, Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej neni 14 në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Bazuar në nenin 41 Gjykata kërkoi që shteti i paditur t'i paguante parashtruesit 21,734.49 (njëzet e një mijë e shtatë qind e tridhjetë e katër euro e dyzet e nëntë cent) euro për dëmin material dhe 21,190.41 (njëzet e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë euro e dyzet e një cent) euro për shpenzimet.

2.3. FAMULLIA KATOlike GREKE LUPENI DHE TË TJERËT kundër RUMANISË

[76943/11]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

29 nëntor 2016

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: refuzimi nga gjykatat vendore për të pranuar kërkesën për kthimin e një ndërtese të kishës, në bazë të ligjit të zakonshëm, përbente shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, mosrespektim të parimit të sigurisë juridike dhe shkeljen e së drejtës për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme; pretendime për diskriminim për shkak të fesë në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Famullia Katolike Greke Lupeni (kërkuesi i parë), Dioqeza Katolike Greke e Lugo (kërkuesi i dytë) dhe Arkidioqeza Katolike Greke Lupeni (kërkuesi i tretë), kundër Rumanisë, më 14 dhjetor 2011. Në vitin 1948 kërkuesit, entitete që i përkisnin Kishës Katolike të Ritit Lindor (Greke Katolike ose Uniate), u shpërndanë në bazë të Dekretit Legjislativ nr. 358/1948. Në bazë të dekretit, e gjithë prona që i përkiste i kaloi shtetit, me përjashtim të pronës së famullisë e cila i kaloi Kishës Ortodokse në përputhje me Dekretin nr. 177/1948, i cili parashikonte që nëse shumica e adhuruesve të një kishe bëheshin anëtarë të një kishe tjetër, pronat që i përkisnin të parës do të kalonin në pronësi të kësaj të fundit. Në vitin 1967 ndërtesa e kishës dhe oborri i kishës ngjitur që i përkisnin famullisë, u regjistruan në regjistrin e tokës si të transferuara në Kishën Ortodokse Rumune.

Pas rënies së regjimit komunist në dhjetor 1989, Dekreti Legjislativ nr. 358/1948 u shfuqizua me Dekretin Legjislativ nr. 9/1989. Kisha Uniate u njoh zyrtarisht në Dekretin Legjislativ nr. 126/1990 për disa masa në lidhje me Kishën Rumune të Bashkuar me Romën (Kisha Katolike Greke). Neni 3 i atij dekreti parashikonte që statusi ligjor i pronës që u përkiste famullive katolike greke do të përcaktohej nga komitete të përbashkëta të përbëra nga

përfaqësues të klerit katolik grek dhe ortodoks. Në marrjen e vendimeve të tyre, komitetet duhej të merrnin parasysh “dëshirat e besimtarëve në komunitetet që zotëronin këto prona”. Neni 3 i Dekretit Legjislativ nr. 126/1990 u plotësua me Urdhëresën e Qeverisë nr. 64/2004, datë 13 gusht 2004 dhe Ligji nr. 182/2005. Dekreti, i ndryshuar, specifikonte se në rast mosmarrëveshjeje midis anëtarëve të klerit që përfaqësonin dy emërtimet në komitetin e përbashkët, pala me interes që i jepte të drejtën për të nisur procedurat gjyqësore mund ta bënte këtë sipas ligjit të zakonshëm.

Famullia u rivendos ligjërisht më 12 gusht 1996 dhe ndërmori masa për ta kthyer ndërtesën e kishës dhe oborrin fqinj. Mbledhjet e komitetit të përbashkët dështuan në zgjidhjen e çështjes. Prandaj, parashtruesit filluan procedurat gjyqësore sipas ligjit të zakonshëm, por pa sukses. Gjykatat e bazuan vendimin e tyre në kriterin e veçantë të “dëshirave të besimtarëve në komunitetet që zotërojnë këto prona”. Pas ndjekjes së procedurave vendore, kërkuesit iu drejtuan GJEDNJ-së.

Me një vendim të 19 majit 2015, Dhoma e Gjykatës arriti në përfundimin, unanimisht, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6.1 dhe të nenit 14 në lidhje me nenin 6.1.

Më 19 tetor 2015, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesve.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 6.1 dhe nenin 13 të Konventës, kërkuesit ngritën, në thelb, tri ankesa. Së pari, ata parashtruan se kishte pasur shkelje të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë, duke pretenduar se gjykatat vendore nuk e kishin zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre duke zbatuar rregullat e ligjit të zakonshëm, por në bazë të kriterit të përcaktuar me Dekretin Legjislativ nr. 126/1990, i zbatueshëm në kuadrin e procedurës jogjyqësore, përkatësisht dëshirave të besimtarëve në komunitetin që ishte në posedim të pronës. Së dyti, kërkuesit parashtruan, pa iu referuar në mënyrë eksplicite parimit të sigurisë juridike, se zbatimi i këtij kriteri nuk ishte i parashikueshëm dhe e kishte bërë qasjen e tyre në një gjykatë iluzive. Së treti, ata u ankuan për tejzgjatjen e procedurës.

Kërkuesit gjithashtu pohuan se ata ishin diskriminuar në gëzimin e së drejtës së qasjes në gjykatë sipas nenit 6.1 të Konventës, sepse i përkisnin një pakice të caktuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata theksoi se në rastin aktual, Dhoma kishte shqyrtuar ankesat e kërkuesve vetëm në bazë të nenit 6.1 të Konventës, duke pasur mendimin se garancitë e nenit 13 u mbuluan nga garancitë më të rrepta të nenit 6. Gjykata [Dhoma e Madhe] u pajtua me këtë qasje dhe vazhdoi vlerësimin në të njëjtën mënyrë. Gjithashtu, Gjykata [Dhoma e Madhe] përsëriti se Dhoma e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte argumentet e kërkuesve në lidhje me zbatimin e kriterit të dëshirave të besimtarëve në kontekstin e një veprimi sipas ligjit të zakonshëm për rikthimin e posedimit nga këndvështrimi i së drejtës për qasje në gjykatë dhe i së drejtës për respektim të parimit të sigurisë juridike. Duke përsëritur praktikën e saj gjyqësore të vendosur mbi kompetencën e saj për të karakterizuar faktet e paraqitura para saj (shih *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, 19 shkurt 1998, 44, Raportet e vendimeve dhe aktgjykimeve 1998-I), Gjykata vlerësoi se nuk ka arsye për t'u larguar nga qasja e Dhomës, dhe për këtë arsye ajo do të shqyrtojë argumentet e kërkuesve edhe nga këndvështrimi i pajtueshmërisë me këtë parim.

Sa i përket pretendimeve të kërkuesve për të drejtën e tyre për qasje në gjykatë – Gjykata vërejti se kërkuesit nuk ishin penguar të ngrinin padinë e tyre për kthimin e ndërtesës së kishës para gjykatave vendore, të cilat kishin kryer një shqyrtim të hollësishëm të çështjes së tyre. Gjykatat vendore, të cilat ishin të pavarura dhe të paanshme, kishin një fuqi diskrecionale të vlerësimit në ushtrimin e kompetencës së tyre juridiksionale dhe roli i tyre nuk kufizohej në miratimin e një rezultati të paracaktuar. Kështu, ajo që ishte në rrezik në këtë çështje nuk ishte një pengesë procedurale që pengonte qasjen e kërkuesve në gjykata, por një dispozitë thelbësore e cila, megjithëse ishte e tillë që të kishte ndikim në rezultatin e procesit, nuk i pengonte gjykatat që të shqyrtonin themelin e mosmarrëveshjes. Në realitet, kërkuesit u ankuan për vështirësinë në përmbushjen e kushteve të vendosura nga e drejta materiale për të arritur kthimin e vendit të adhurimit në fjalë.

Megjithatë, Gjykata theksoi se dallimi ndërmjet elementeve procedurale dhe atyre thelbësore mbeti përcaktues i zbatueshmërisë dhe, sipas rastit, i fushëveprimit të garancive të nenit 6 të Konventës, i cili, në parim, nuk mund të kishte asnjë zbatim për kufizimet thelbësore të një të drejte që ekziston sipas ligjit të brendshëm. Kriteri i dëshirave të besimtarëve në fjalë në këtë çështje nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë si kufizues i juridiksionit të gjykatave për të vendosur për veprimet për rikthimin e posedimit në lidhje me vendet e kultit, por si cilësues i një të drejte thelbësore. Gjykatat vendase në rastin konkret kishin juridiksion të plotë për të zbatuar dhe interpretuar ligjin kombëtar, pa u detyruar nga refuzimi i famullisë ortodokse për të arritur një zgjidhje miqësore në kuadrin e procedurës para komitetit të përbashkët.

Kriteri kontestues kishte shkaktuar debate të ashpra kur u miratua nga Parlamenti dhe kur u bënë ndryshime në Dekretin Legjislativ nr. 126/1990 me Ligjin nr.182/2005. Njëlloj, të dy Kishat në fjalë ishin konsultuar si pjesë e procesit legjislativ që rezultoi në miratimin e kriterit kontestues. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë kishte qenë konsistente në lidhje me përputhshmërinë e këtij kriteri me Kushtetutën, si në zbatimin e tij nga komisionet e përbashkëta, ashtu edhe kur zbatohet në kontekstin e proceseve gjyqësore të bazuara në dispozitat e ligjit të zakonshëm.

Në vendimin për çështjen *Famullia Katolike Greke Sâmbata Bihor kundër Rumanisë* (48107/99, 12 janar 2010), Gjykata kishte gjetur një kufizim në të drejtën e qasjes në gjykatë pasi kishte shqyrtuar kornizën ligjore që ekzistonte përpara ndryshimeve të bëra në tekstin e nenit 3 të Dekretit Legjislativ nr. 126/1990 me Urdhëresën nr. 64/2004 dhe Ligjit nr. 182/2005, pra para se të vihej në dispozicion mundësia, e parashikuar qartë nga këto ndryshime, për ngritjen e procedurave ligjore bazuar në dispozitat e ligjit të zakonshëm. Duke pasur parasysh konsideratat e parashtruara më sipër, kërkuesve nuk u është hequr e drejta për të përcaktuar meritat e pretendimeve të tyre në lidhje me të drejtën e tyre pronësore mbi një vend kulti. Vështirësitë e hasura nga kërkuesit në përpjekjet e tyre për të siguruar kthimin e ndërtesës së kontestuar të kishës kishin rezultuar nga ligji në fuqi në kohën relevante dhe nuk kishin lidhje me ndonjë kufizim në të drejtën e qasjes në gjykatë. Bazuar në këtë vlerësim, Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë.

Sa i përket pajtueshmërisë me parimin e sigurisë juridike; interpretimi kontradiktor i konceptit të “të ligjit të zakonshëm” kishte ekzistuar brenda vetë Gjykatës së Lartë, e thirrur për t’i zgjidhur këto mosmarrëveshje në shkallën e fundit. Kjo ishte reflektuar në vendimet e gjykatave më të ulëta, të cilat kishin dhënë edhe vendime kontradiktore. Nga viti 2012 e në vazhdim, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese kishin përafuar qëndrimet e tyre përkatëse në procedurat për kthimin e objekteve të kultit, gjë që kishte rezultuar, në praktikë, në harmonizimin e praktikës gjyqësore të gjykatave më të ulëta. Megjithatë, nga viti 2007 deri në vitin 2012, Gjykata e Lartë kishte dhënë vendime diametralisht të kundërta. Këto luhatje në interpretimin gjyqësor nuk mund të konsideroheshin si praktikë gjyqësore në zhvillim, e cila është një tipar i natyrshëm i çdo sistemi gjyqësor, duke qenë se Gjykata e Lartë kishte ndryshuar pozicionin e saj. Së fundi, pasiguria juridike kishte të bënte me çështjet e qasjes në gjykatë dhe të së drejtës materiale të zbatueshme. Rrjedhimisht, në çështjen në fjalë kishin ekzistuar “ndryshime të thella dhe të gjata” në praktikën gjyqësore, (në kuptimin e vendimit të Dhomës së Madhe në çështjen *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë* ([DHM], 13279/ 05, 20 tetor 2011).

Gjykata vërejti se konteksti në të cilin ishte shqyrtuar padia e ngritur nga kërkuesit, përkatësisht një pasiguri në praktikën gjyqësore, shoqëruar me dështimin për të përdorur në kohë mekanizmin e parashikuar në legjislacionin e brendshëm për të siguruar praktikë konsistente edhe brenda gjykatës më të lartë në vend, kishin cenuar parimin e sigurisë juridike dhe, duke vepruar kështu, kishin ndikuar në privimin e parashtruesve nga një gjykim i drejtë. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi shkelje në këtë aspekt.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës në lidhje me të drejtën për qasje në gjykatë; se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike; se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së procedurave; se, duke pasur parasysh konkluzionet e saj sipas nenit 6.1 të Konventës në lidhje me mosrespektimin e parimit të sigurisë juridike, nuk ishte e nevojshme të shqyrtohet veçmas ankesa sipas nenit

14 të Konventës në ndërlidhje me nenin 6.1., për aq sa kishte të bëjë me pretendimin për një dallim në trajtim në krahasim me famullitë e tjera katolike greke; se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës lidhur me nenin 6.1 në lidhje me të drejtën e qasjes në gjykatë. Gjykata vendosi që shteti i paditur duhet t'u paguajë parashtruesve: 4,700 (katër mijë e shtatëqind) euro dhe 8,567 (tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) euro, në lidhje me kostot dhe shpenzimet; 696,33 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e tre cent) për parashtruesit së bashku.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË

3.1. SOCIAAL FONDS VOOR DE DIAMANTARBEIDERS kundër S.A. CH. BRACHFELD & SONS dhe CHOUGOL DIAMOND CO

GJDBE

(Çështjet e bashkuara 2 dhe 3-69)

1 korrik 1969

[DA1969/00049 EL1969-1971/00059 PT1969-1970/00063 ES1967-1969/00317 SVI/00399 FII/00397) ECLI:EU:C:1969:30]

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Kjo çështje kishte të bënte me pajtueshmërinë e një ligji belg të vitit 1962 me Traktatin e KEE-së, përderisa ky ligj parashikonte se të gjithë importuesit e diamanteve të papërpunuara, duhet të taksoheshin me 0.33% të vlerës të diamanteve të importuara dhe kjo taksë do të shkonte drejtpërdrejt si kontribut në Fondin Social të Punëtorëve të Diamantit në Belgjikë, duke përbërë diskriminim indirekt

Faktet kryesore

Në vitin 1962, Belgjika miratoi një ligj i cili parashikonte se të gjithë importuesit e diamanteve të papërpunuara, duhet të taksoheshin me 0.33% të vlerës të diamanteve të importuara. Kjo taksë do të shkonte drejtpërdrejt si kontribut në Fondin Social të Punëtorëve të Diamantit (*Sociaal Fonds voor de Diamantarbeiders*), i cili ofronte mbështetjen sociale ndaj punëtorëve belgë të industrisë së trajtimit të diamanteve.

Për shkak se një numër i konsiderueshëm i importuesve nuk e pagoi këtë kontribut, Fondi iu drejtua gjyqtarit të Rrethit të Anversës, që është edhe qyteti ku është i përqendruar ky aktivitet, duke paditur 200 importues se nuk kishin paguar detyrimin në fjalë. Gjatë procedurave të brendshme gjyqësore, këta të fundit kundërshtuan pajtueshmërinë e Ligjit të vitit 1962 me Traktatin e Komunitetit Ekonomik Evropian (Traktati i KEE-së), sidomos me nenet e tij⁹, 12, 13, 18, 37 dhe 95.

Gjyqtari belg pezulloi procedurat e brendshme dhe iu drejtua Gjykatës së Luksemburgut me një sërë pyetjesh lidhur me interpretimin e neneve të lartpërmendura, pyetje të cilat, sipas Gjykatës, kishin të gjitha një objekt të përbashkët, pikërisht qartësimin e nocionit të detyrimit me pasoja të njëjta si dhe shtrirjen e ndalimit të këtyre detyrimeve.

Vendimi i Gjykatës

Në kushtet kur objekti i pyetjeve të gjyqtarit belg ishte në themel i njëjti, Gjykata vlerësoi se ishte me vend të jepej një përgjigje e përbashkët.

Ajo kujtoi që në fillim se sipas nenit 9 të Traktatit të KEE-së, Komuniteti bazohet në një bashkim doganor i cili konsiston në ndalimin, ndërmjet shteteve anëtare, të detyrimeve doganore dhe “të të gjitha detyrimeve që kanë pasoja të njëjta”, si dhe në miratimin e një tarife doganore të përbashkët në marrëdhëniet e tyre me shtetet e tjera. Ajo shtoi gjithashtu se neni 12 i Traktatit të KEE-së ndalon miratimin e detyrimeve të reja doganore në import.⁴⁰ Gjykata theksoi gjithashtu që pozita

40 Në versionin aktual të Traktatit, pas kalimit të periudhës kalimtare, ky nen që aktualisht

strukture dhe rëndësia konceptuale e këtyre dy neneve në të gjithë logjikën e Traktatit të KEE-së bën të qartë rëndësinë e këtyre dispozitave dhe të ndalimeve që ato parashikojnë. Sipas Gjykatës, ky status është ofruar pikërisht për të siguruar që parimet e lartpërmendura të mos anashkaloheshin nga moria e praktikave doganore ose fiskale.

Gjykata kujtoi nga ana tjetër se sipas nenit 17 të Traktatit të KEE-së -së ndalimet e parashikuara nga neni 9, gjejnë zbatim edhe kur detyrimet doganore kanë karakter fiskal. Kurse sipas nenit 95, çdo shteti i ndalohet të vendosë taksa të brendshme më të larta ndaj produkteve të importuara sesa ndaj produkteve të veta.

Gjykata sqaroi në vijim se Traktati i KEE-së kur sanksionon ndalimin e detyrimeve doganore, nuk bën dallim ndërmjet mallrave që hyjnë apo jo në konkurrencë me mallrat e brendshme. Ai synon që ndalimi i detyrimeve doganore të mos kufizohet në eliminimin e karakterit të tyre mbrojtës ndaj mallrave të brendshme, por i ka dhënë këtij rregulli një shtrirje të përgjithshme për të siguruar efektivisht lëvizjen e lirë të mallrave.

Prandaj, Gjykata theksoi se nga tërësia e sistemit juridik të Traktatit të KEE-së dhe karakteri i përgjithshëm dhe absolut i ndalimit të çdo detyrimi doganor ndaj mallrave që lëvizin ndërmjet shteteve të ndryshme rezulton se këto detyrime nuk janë të lejueshme pavarësisht nga qëllimi për të cilin ato janë parashikuar dhe pavarësisht nga destinacioni i të ardhurave. Sipas Gjykatës, pengesat që këto detyrime, qoftë edhe minimale, u krijojnë mallrave kur kalojnë kufirin, e justifikon ndalimin e plotë të tyre. Gjykata arsyetoi se nocioni i ndalimit të detyrimeve me pasoja të njëjta veçse e plotëson dhe e bën më efikas nocionin e ndalimit të detyrimeve doganore, dhe të dy këto koncepte së bashku përpiqen të eliminojnë zbatimin e çdo barre monetare ndaj mallrave që kalojnë kufijtë e brendshëm.

Gjykata saktësoi se për të kuptuar nëse një taksë ka pasoja të njëjta me detyrimet doganore, duhen marrë në konsideratë objektivat e Traktatit

mban numrin 25, nuk flet më për detyrime të reja, pra për standstill, por kërkon shfuqizimin dhe pavlefshmërinë e çdo detyrimi të mëparshëm apo jo.

të KEE-së në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave. Në këtë këndvështrim, Gjykata bëri të qartë se një detyrim monetar, qoftë edhe minimal, i vendosur në mënyrë të njëanshme, pavarësisht nga emërtimi dhe teknika e tij dhe që u vihet qoftë mallrave të huaja, qoftë atyre vendase, për shkak të faktit se ato kalojnë kufirin, kur nuk është në fakt një detyrim doganor, përbën një detyrim me pasojë të njëjtë, në kuptimin e neneve 9 dhe 12 të Traktatit të KEE-së edhe kur nuk merret në dobi të shtetit, kur nuk ka asnjë pasojë diskriminuese ose mbrojtëse dhe kur produkti që duhet ta paguajë nuk është në konkurrencë me një produkt nacional.

Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, neni 95 dhe vijues saktësojnë se nocioni i detyrimit me pasoja të njëjta nuk përfshin taksat që, brenda shtetit, prekin në të njëjtën mënyrë produktet e brendshme të ngjashme ose të krahasueshme, dhe as taksat që, në mungesë të këtyre produkteve, janë pjesë e një takse të brendshme të përgjithshme, ose kur, brenda limiteve të Traktatit të KEE-së, kanë për qëllim të kompensojnë taksa të tilla të brendshme.

Gjykata vuri në dukje se këto dispozita, përderisa parashikojnë detyrime të sakta dhe të qarta e që nuk kërkojnë marrjen e asnjë mase të mëtejshme specifike nga ana e shteteve, janë drejtpërdrejtë të zbatueshme. Si të tilla ato krijojnë të drejta subjektive drejtpërdrejt për individët.

Gjykata saktësoi gjithashtu se Traktati i KEE-së ndalon çdo detyrim monetar në eksport dhe import ndërmjet shteteve anëtare dhe në këtë kuadër nuk bën asnjë dallim në lidhje me shtetasit e shteteve anëtare e as në lidhje me shtetësinë e personave juridikë që preken nga këto detyrime. Në këtë kuptim, zbatimi i neneve të lartpërmendura është krejt indiferent ndaj këtyre konsideratave.

Në lidhje me pyetjen nëse vendosja e një detyrimi të tillë ndaj importeve nga shtete të treta, jashtë Komunitetit, është gjithsesi e ndaluar për shkak se pengon vendosjen e tarifës doganore të përbashkët, Gjykata iu referua faktit se detyrimi në fjalë është miratuar përpara hyrjes në fuqi të tarifës së përbashkët doganore. Megjithatë, *a priori*, ajo pranoi se pas hyrjes së fuqi të kësaj tarife, zbatimi i detyrimeve të njëanshme doganore nga ana e shteteve ndaj importeve nga vende të treta mund të pengojë respektimin e tarifës së përbashkët doganore.

3.2. CARLOS BOWLES kundër BANKËS QENDRORE EVROPIANE (BQE)

Tribunali i Funksionit Publik të BE-së

17 dhjetor 2015

[\[https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?lgrec=fr&td=%3BALL&language=en&num=F-114/10&jur=F\]](https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?lgrec=fr&td=%3BALL&language=en&num=F-114/10&jur=F)

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Kjo çështje kishte të bënte me diskriminimin në lidhje me përfitimin nga skemat e pensioneve të personave që kryejnë edhe funksione sindikale përveç atyre zyrtare.*

Përmbledhja e fakteve

Parashtruesi, Carlos Bowles, ka qenë anëtar i personelit të BQE-së që nga 1 dhjetori 2003 dhe ka punuar si ekspert në Drejtorinë e Përgjithshme (DG) “Çështjet Ekonomike”. Ai u zgjodh anëtar i bordit të Sindikatës Ndërkombëtare dhe Evropiane të Shërbimeve Publike (‘Sindikata IPSO’) nga 6 marsi 2008 deri më 22 shtator 2009. Që nga 23 shtatori 2009, ai ka qenë anëtar i bordit drejtues të asaj Sindikate. Më 1 prill 2008, ankuesi u zgjodh gjithashtu anëtar i komitetit mbikëqyrës që përfaqësonte interesat e përfituesve të skemës së pensioneve të BQE -së (“Komiteti i Mbikëqyrjes së Pensioneve”, në tekstin e mëtejshmë: “KMP”), mandat që e mbajti deri më 30 mars 2011 dhe të cilin e ka ushtruar përsëri që nga 1 prilli 2014. Më 25 qershor 2008, parashtruesi u zgjodh anëtar i Komitetit të Personelit të BQE -së, një mandat që ai e mbante ende në ditën kur paraqiti kërkesën. Që nga 24 qershori 2010, ai ka qenë zëdhënës i komitetit në fjalë.

Reduktimet në kohën e punës që iu dhanë parashtruesit në mënyrë që ky të përmbushte mandatet e tij si anëtar i Komitetit të Personelit, i KMP-së dhe sindikatës IPSO ishin si më poshtë:

- nga 27 qershori 2008 deri më 23 qershor 2010: 50% si anëtar i komitetit të personelit dhe 50% de facto për KMP-në dhe sindikatën IPSO;

- nga 24 qershori 2010 deri më 31 dhjetor 2010: 75% si anëtar i komitetit të personelit dhe 25% de facto për KMP-në dhe sindikatën IPSO;

- nga 1 janari 2011 deri më 31 mars 2014: 100% si anëtar i komitetit të personelit;

- që nga 1 prilli 2014: 75% si anëtar i komitetit të personelit dhe 25% për KMP-në.

Çdo vit, BQE zbaton një procedurë për rishikimin e pagave dhe shpërblimeve (tani e tutje “RVPSH”), qëllimi i së cilës është shpërblimi, në formën e rritjes individuale të pagës dhe/ose shpërblimeve, performancës dhe kontributeve individuale të personelit duke bërë që niveli i pagave të tyre të varet, nga njëra anë, nga kontributi i tyre në suksesin e sektorit të tyre dhe, në përgjithësi, në suksesin e BQE -së dhe, nga ana tjetër, nga zhvillimi i tyre individual. Kur e sheh të përshtatshme, BQE mund të akordojë edhe një rritje të mëtejshme të pagës (“Shtesë Tjetër e Pagës”, në tekstin e mëtejshme: “SHTP”), një grupi të kufizuar të personelit që duket se meriton më shumë gjatë periudhës përkatëse. SHTP rregullohet nga Qarkorja administrative nr. 1/2011, e 14 shkurtit 2011.

Me një sërë vendimesh të miratuara në fund të viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, BQE i dha parashtruesit, sipas RVPSH në lidhje me periudhat përkatëse kalendarike rritje pagash për punën e tij si ekspert në DG “Çështjet Ekonomike”, si dhe rritje pagash dhe një shpërblim si anëtar i Komitetit të Personelit, duke përlllogaritur kohën e punës së reduktuar që i ishte njohur atij gjatë këtyre periudhave.

Më 3 mars 2014, BQE publikoi në faqen e saj të intranetit një ekstrakt nga vendimi i bordit të saj drejtues të 25 shkurtit 2014, me anë të së cilit iu jepte SHTP 17 anëtarëve të personelit. Emri i parashtruesi nuk figuronte në atë listë. Më 23 prill 2014, ankuesi bëri një kërkesë për një shqyrtim paragjyqësor të vendimit të lartpërmendur. Me një vendim të 1 korrikut 2014, kjo kërkesë u hodh poshtë me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte demonstruar se kishte pasur një vit të dytë performance të shkëlqyer që të meritonte një SHTP.

Parashtruesi kërkoi para Tribunalit anulimin e këtyre vendimeve dhe të urdhërojë BQE-në të kompensojë dëmin material të pësuar, që konsiston në humbjen e një shansi për të marrë një SHTP në 2014, me vlerë 51,962 euro, ose, nëse jo, anulimin e procedurës që çoi në vendimin që i mohonte parashtruesit një SHTP dhe organizimin e një procedure të re për SHTP, për vitin 2014. Ai pretendoi gjithashtu një dëm moral prej 5000 eurosh. Kjo padi u mbështet në nenin 36.2 të Protokollit mbi Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, i cili i bashkëngjitet Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funkcionimin e BE-së.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vuri në pah se, në lidhje me dhënien e SHTP-së anëtarëve të personelit të BQE-së, performanca e të cilëve është vlerësuar e shkëlqyer gjatë dy nga tri vitet para dhënies së SHTP-së, neni 2, paragrafi 3, i Qarkores Administrative nr. 1/2011 e vendos një përfaqësues të personelit në një pozicion diskriminues. Kjo pasi që është absolutisht e pamundur që ai të demonstrojë një vit të dytë të performancës së shkëlqyer për shkak të aktivitetit të tij me kohë të plotë si përfaqësues i personelit për tre vjet, kjo dispozitë është e paligjshme. Në këtë drejtim, Gjykata arsyetoi se nuk mund të argumentohet në mënyrë bindëse se ushtrimi nga personi i interesuar i së drejtës së tij për reduktim nga koha e punës për të kryer detyrat e tij në Komitetin e Personelit ishte rezultat i një zgjedhjeje personale. Gjykata theksoi se kjo zgjedhje për të qenë në gjendje të kërkojë përjashtime nga orari i punës me qëllim të ushtrimit të një mandati të përfaqësimit të personelit ishte një e drejtë themelore, siç del qartë nga nenet 27 dhe 28 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Përveç kësaj, Gjykata arsyetoi se ushtrimi i së drejtës themelore për trajtim të barabartë, i cili është i mishëruar në nenet 20 dhe 21 të Kartës, nuk mund të kufizohet me rregullore që i vendosin përfaqësuesit e personelit në një situatë të pafavorshme dhe diskriminuese në krahasim me anëtarët e tjerë të personelit, përderisa këto kufizime nuk janë as të nevojshme dhe as nuk përmbushin një objektiv me interes të përgjithshëm ose nevojë për të mbrojtur të drejtat ose liritë e të tjerëve.

Sidoqoftë, sipas Gjykatës, meqenëse situata e një përfaqësuesi të personelit dhe ajo e një anëtari të personelit janë faktikisht të ndryshme, ata nuk mund të trajtohen në mënyrë të barabartë. Prandaj ndaj tyre mund të zbatohen vetëm kritere të përshtatshme për SHTP, të cilat marrin parasysh dallimet në pozitën në mes të anëtarëve të personelit dhe përfaqësuesve të personelit, duke i lejuar këtij të fundit, si çdo anëtari tjetër të personelit, të demonstrojë një vit të dytë të performancës së shkëlqyer gjatë një periudhe trevjeçare, edhe nëse ata bëjnë zgjedhjen për të ushtruar funksione me kohë të plotë edhe për më shumë se një vit në Komitetin e Personelit.

Neni 25

E Drejta për Jetën

- 1. Secili individ gëzon të drejtën për jetën.*
- 2. Dënimi me vdekje është i ndaluar.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI41/12. PARASHTRUES: GËZIM DHE MAKFIRE KASTRATI - PRINDËRIT E SË NDJERËS D.K.

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_41_12_shq.pdf]

26 shkurt 2013

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Objekt shqyrtimi i kësaj kërkesë ishte shkëlja kushtetuese, gjegjësisht cenimi i së drejtës në jetë i shkaktuar nga mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë që pati si pasojë vdekjen (vrasjen) e D.K., e cila ishte bija e parashtruesve të kërkesës.

Faktet kryesore

E ndjera D.K., kishte themeluar bashkësi jashtëmartesore me një person, nga e cila kishin një vajzë. Pas çrregullimit të marrëdhënieve, D.K. kishte paraqitur padi për shkëputjen e bashkësisë jashtëmartesore dhe ishte larguar së bashku me vajzën. Pas mosmarrëveshjeve që ishin pasuar më kërcënime për jetë nga ish-partneri i saj, D.K. më 26 prill 2011, kishte kërkuar urdhër për mbrojtje emergjente nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Gjykata Komunale në Prishtinë nuk i ishte përgjigjur D.K.-së, duke mos aprovuar e as refuzuar kërkesën e saj. Pas disa ditësh, përkatësisht më 18 maj 2011, D.K. kishte humbur jetën tragjikisht si pasojë e plagëve të marra me armë zjarri nga ish-partneri i saj. Më 17 prill 2012, parashtruesit (pra, prindërit e D.K.) dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Ndërkohë, më 29 korrik 2011, organizata joqeveritare CLARD (Centre for Legal Aid and Regional Development), sipas autorizimit të parashtruesve, i kishte dorëzuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës një shkresë, gjegjësisht «kërkesë për efikasitet në zbatimin e Ligjit Kundër Dhunës në Familje», duke u referuar në rastin e D. K.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit (prindërit e së ndjerës) paraqitën kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës (si viktimë e tërthortë), duke pretenduar se Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka vepruar sipas Ligjit Nr., 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Sipas parashtruesve, shkelja nuk ishte pasojë e një vendimi gjyqësor, por nga mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, rrjedhimisht me këtë mosveprim ajo Gjykatë kishte bërë shkelje të nenit 25 [E Drejta për Jetën], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesit gjithashtu pretenduan se Këshilli Gjyqësor i Kosovës jo vetëm që nuk adresoi rastin e D.K-së, mirëpo nuk ofroi mjete juridike për rastet e ardhshme të dhunës në familje, kur viktimat kërkojnë veprime nga gjykatat komunale, por ato nuk veprojnë fare.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht shpalli kërkesën të pranueshme për shqyrtim të meritave të saj. Më pas, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Komunale në Prishtinë ishte përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës [E Drejta për Jetën], në ndërlidhje me nenin 2 të KEDNJ-së. Gjykata gjeti se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë në kërkesën e së ndjerës D.K., për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga KGJK-ja për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta, atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën dhe parashtruesit e kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese gjeti se ka pasur shkelje të së drejtës për jetën, të përcaktuar me nenin 25 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 2 të KEDNJ-së, si dhe shkelje të së drejtës për mjete juridike, të parapara me nenin 32 dhe me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje edhe me nenin 13 të KEDNJ-së. Gjykata e konsideroi të panevojshëm trajtimin e pretendimit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të parapara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të KEDNJ-së; shkelje të së drejtës për mjete juridike, të paraparë me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. OPUZ kundër TURQISË

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2233401/02%22%5D%7D>
GJEDNJ [Seksioni i Tretë]

9 qershor 2009

Çështja kyçele drejta e pretenduar: dhuna në familje dhe detyrimet e autoriteteve shtetërore për mbrojtje në raste të tilla; dështimi i autoriteteve për mbrojtjen e jetës si pasojë e dhunës në familje; dëmtimet dhe ankthi si rezultat i dhunës së ushtruar përbënte torturë; pasiviteti diskriminues dhe i përgjithshëm nga gjykatat turke kishte krijuar një klimë që favorizonte dhunën në familje.

Faktet kryesore

Kërkuesja, Nahide Opuz, është një shtetase turke që ka lindur në vitin 1972 dhe jeton në Turqi. Në vitin 1990, znj. Opuz filloi të jetonte me H.O., djalin e bashkëshortit të nënës së saj. Kërkuesja dhe H.O. u martuan në nëntor 1995 dhe patën tre fëmijë në vitet 1993, 1994 dhe 1996. Çifti kishte probleme serioze në marrëdhënien e tyre që në fillim të marrëdhënies dhe u divorcuan.

Në periudhën mes prillit 1995 dhe marsit 1998, kishte pasur katër incidente për shkak të sjelljes së dhunshme dhe kërcënuese të H.O. kundrejt kërkueses dhe nënës së saj, për të cilat ishin njoftuar edhe

autoritetet. Këto incidente përfshinin rrahje, grindje të ashpra, përdorim i thikës nga H.O. si edhe se sulmit që H.O. kishte bërë me makinën e tij për të goditur të dy gratë. Pas kësaj dhune të përsëritur, gratë u ishin nënshtruar kontrolleve mjekësore. Të dy gratë kishin pasur dëshmi nga mjeku se kishin pësuar dëmtime që u vinin në rrezik jetën.

Ndaj H.O. kishte filluar procedura penale për kërcënim për jetën, lëndim të rëndë e të përsëritur të trupit dhe tentativë për vrasje. Për sa i përket incidentit me thikë, ishte vendosur që të mos hetohej për mungesë provash. H.O. ishte arrestuar dy herë dhe po kaq herë ishte vendosur që ai të hetohej në gjendje të lirë.

Megjithatë, kërkuesja dhe nëna e saj kishin tërhequr kallëzimet penale e edhe gjykatat e brendshme i kishin mbyllur rastet, për arsye se procedimi nuk mund të vazhdohej sipas Kodit Penal nëse tërhiqeshin paditë. Megjithatë, procedura në lidhje me incidentin me makinë ndaj nënës të kërkueses kishte vazhduar, duke parë dëmtimet e rënda të pësuarat prej saj, dhe H.O. ishte dënuar me tre muaj burg, dënim që më vonë iu konvertua në gjobë.

Më 29 tetor 2001, kërkuesja u godit shtatë herë me thikë nga H.O. dhe u dërgua në spital. H.O. u dënua për sulm me thikë dhe mori një tjetër gjobë prej thujtaje 840 mijë lirash turke (rreth 385 euro), shumë të cilën mund ta paguante me tetë këste. Pas këtij incidenti, nëna e kërkueses bëri një kërkesë që H.O. të mbahej në gjendje arresti, duke kujtuar se në disa raste të mëparshme ajo dhe vajza e saj ishin detyruar të tërhiqnin kallëzimet kundër tij për shkak të presionit të pareshtur dhe kërcënimeve për jetën e tyre.

Më në fund, më 11 mars 2002, nëna e kërkueses, pasi kishte vendosur të shpërngulej në Izmir me vajzën e saj, po udhëtonte në furgonin e mbushur me orenditë e shtëpisë, kur H.O. kishte detyruar automjetin të ndalonte, duke hapur derën e pasagjerit dhe kishte vrrarë nënën e kërkueses.

Më mars 2008, H.O. u dënua për vrasje dhe armëmbajtje pa leje. Ai u dënua me burgim të përjetshëm dhe u lirua gjatë procedurës në apel. Në prill 2008, kërkuesja paraqiti një tjetër kallëzim penal pranë prokurorisë,

duke i kërkuar që të merrnin masa për ta mbrojtur atë, meqenëse pas lirimit ish-bashkëshorti i saj kishte filluar ta kërcënonte përsëri. Në maj dhe nëntor 2008, përfaqësuesi i kërkueses informoi GJEDNJ se nuk ishte marrë ende asnjë prej masave të kërkuara dhe Gjykata kërkoi shpjegim. Pas kësaj, autoritetet turke morën masa specifike për ta mbrojtur kërkuesen, si për shembull, duke shpërndarë fotografinë e ish-burrit të saj dhe gjurmët e tij të gishtërinjve në të gjitha stacionet e policisë me urdhrin për ta arrestuar, në rast se do të gjendej pranë vendbanimit të kërkueses.

Përmbledhja e pretendimeve

Në lidhje me pretendimin *për shkeljen e nenit 2 të Konventës*, kërkuesja pretendoi se dhuna në familje ishte toleruar nga autoritetet e shoqëria dhe se autorët e dhunës gëzonin pandëshkueshmëri. Në lidhje me këtë, ajo vuri në dukje se, pavarësisht se ajo kishte dorëzuar shumë ankesa penale në Zyrën Qendrore të Prokurorisë së Diarbakirit, nuk ishte marrë asnjë nga masat mbrojtëse të parashikuara nga Ligji nr. 4320 për mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së saj dhe të nënës së saj. Përkundrazi, në një numër rastesh, autoritetet ishin përpjekur ta bindnin kërkuesen dhe nënën e saj të tërhiqnin denoncimin ndaj H.O-s. Autoritet e vendit kishin qëndruar pasivë përballë kërcënimeve për vdekje që bënte H.O., duke e lënë kërkuesen dhe nënën e saj në mëshirë të dhunuesit.

Kërkuesja theksoi se me anë të kërkesës së datës 27 shkurt 2002, nëna e saj i ishte drejtuar Zyrës Qendrore të Prokurorisë dhe kishte informuar autoritetet për kërcënimet me vdekje që i kishte bërë H.O. Megjithatë, Prokurori Publik nuk kishte bërë asgjë për mbrojtjen e jetës të së ndjerës. Sipas mendimit të kërkueses, fakti që autoritetet nuk i kishin marrë seriozisht ankesat e së ëmës, ishte një tregues i qartë që dhuna në familje tolerohej nga shoqëria dhe autoritetet e vendit. Kërkuesja pretendoi gjithashtu se, megjithëse H.O. ishte dënuar për vrasje, dënimi i caktuar për të, nuk ishte i tillë që të kishte efekt ndalues dhe ishte në mënyrë të konsiderueshme më i lehtë se dënimi normal për veprën e vrasjes. Dhënia e një dënimi të butë kishte ardhur nga fakti që në parashtrimin e mbrojtjes së tij para Gjykatës së Krimeve të Rënda, i pandehuri kishte pretenduar se nënën e saj e kishte vrarë për të mbrojtur nderin e tij. Ishte praktike e përgjithshme për gjykatat penale në Turqi që të jepnin

dënime më të ulëta për çështje që kishin të bënin me “krime nderi”; gjykatat penale ose jepnin dënime shumë të buta, ose nuk i dënonin fare autorët e këtyre krimeve.

Në lidhje me pretendimet e kërkueses, Qeveria theksoi se menjëherë pas paraqitjes së ankesave, autoritetet i kishin regjistruar ato, kishin kryer ekzaminimet mjekësore, kishin marrë në pyetje dëshmitarët, kishin analizuar vendin e incidenteve dhe ankesat ua kishin përcjellë autoriteteve përgjegjëse ligjore. Kur kishte qenë e domosdoshme dhe në varësi të rrezikshmërisë të incidentit, dhunuesi ishte ndaluar nga policia dhe ishte dënuar nga gjykatat penale. Këto procedura ishin kryer brenda kohës më të shkurtër të mundur. Autoritetet ishin treguar të kujdesshme dhe të ndjeshme ndaj ankesave të bëra pa shfaqur asnjë lloj neglizhence. Megjithatë, sipas Qeverisë, duke tërhequr denoncimet e tyre, kërkuesja dhe nëna e saj i kishin penguar autoritetet në ndjekjen e procedurave penale ndaj H.O-së. e kështu kishin kontribuar në pandëshkueshmërinë e dhunuesit. Në lidhje me këtë, nga dosja e rastit nuk rezultonte që kërkuesja dhe nëna e saj i kishin tërhequr denoncimet e tyre si rezultat i ndonjë presioni të ushtruar mbi to, qoftë nga H.O., apo nga prokurori i ngarkuar me hetimin në fjalë. Gjithashtu, në shumicën e rasteve, gjykatat penale nuk e kishin dënuar H.O-në, sepse provat kundër tij kishin qenë të pamjaftueshme. Në këto kushte, nuk mund të pritej që autoritetet të ndanin kërkuesen nga bashkëshorti i saj dhe të dënonin këtë të fundit, ndërkohë që ata jetonin së bashku si një familje, pasi kjo gjë do të çonte në shkelje të së drejtës së tyre sipas nenit 8 të Konventës.

Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga nëna e kërkueses më 27 shkurt 2002, Qeveria pretendoi se përmbajtja e kësaj kërkesë nuk ishte e ndryshme nga ato të mëparshmet dhe ishte e një natyre të përgjithshme. Nuk kishte fakte konkrete apo të dhëna specifike që tregonin se jeta e saj ishte në rrezik. Në kërkesën e saj, nëna nuk kërkonte asnjë lloj mbrojtjeje, por thjesht kërkonte shqyrtim të shpejtë të ankesës së saj dhe ndëshkimin e bashkëshortit të kërkueses. Megjithatë, pas marrjes së kërkesës së datës 27 shkurt 2002, autoritetet e regjistruan atë dhe mbajtën një seancë dëgjimore më 27 maj 2002, e cila u pasua edhe nga seanca të tjera. Në fund, mbas vrasjes së nënës së kërkueses nga H.O., ky i fundit ishte dënuar dhe kishte marrë një ndëshkim të rëndë.

Në lidhje me pretendimin *për shkeljen e nenit 3 të Konventës*, kërkuesja pretendoi se dëmtimet dhe ankthi që ka kaluar si rezultat i dhunës së ushtruar mbi të nga bashkëshorti kishte kaluar në torturë, brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës. Pavarësisht nga dhuna e vazhdueshme dhe kërkesat e saj të vazhdueshme për ndihmë, organet kombëtare kishin dështuar në mbrojtjen e saj nga bashkëshorti. Mungesa e ndjeshmërisë dhe e tolerancës, e dëshmuar nga organet kombëtare përballë situatës së dhunës në familje, e kanë bërë kërkuesen të ndihej e pavlerë, e pashpresë dhe e brishtë.

Në lidhje me pretendimin *për shkeljen e nenit 14*, në ndërlidhje me nenin 2 dhe 3 të Konventës, kërkuesja pretendoi se e drejta e brendshme e shtetit të paditur është diskriminuese dhe e pamjaftueshme për mbrojtjen e grave, pasi jeta e një gruaje trajtohet si më pak e rëndësishme për shkak të unitetit familjar. Kodi Civil i mëparshëm, në fuqi në atë kohë, përmbante dispozita të shumta që bënin dallime ndërmjet burrave dhe grave, të tilla si: burri është kreu i familjes, dëshirat e tij kanë përparësi si përfaqësuesi i unitetit familjar, etj. Kodi Penal i atëhershëm, po ashtu, i trajtonte gratë si qytetare të dorës së dytë. Gruaja konsiderohej kryesisht si pronë e shoqërisë dhe e burrit brenda familjes. Treguesi më i rëndësishëm i kësaj ishte fakti se veprat seksuale ishin të përfshira në seksionin e titulluar “Krimet e Lidhura me Moralin e Përgjithshëm dhe me Rregullin në Familje”, ndërkohë që, në fakt, veprat penale kundër grave janë sulme të drejtpërdrejta ndaj të drejtave dhe lirive të tyre personale. Për shkak të këtij perceptimi, Kodi Penal parashikon sanksione më të lehta për personat që vrasin gratë e tyre për çështje të nderit të familjes. Fakti që H.O. ka marrë një dënim me 15 vjet është pasojë e këtij klasifikimi në Kodin Penal.

Pavarësisht nga reformat e kryera nga Qeveria në fushat e Kodit Civil dhe të Kodit të Familjes, përkatësisht në vitin 2002 dhe 2004, dhuna në familje e ushtruar nga burrat tolerohet ende dhe ushtruesit e dhunës nuk ndëshkohen nga organet gjyqësore dhe administrative. Kërkuesja dhe nëna e saj ishin viktima të shkeljes së nenit 2, 3, 6 dhe 13 vetëm për shkak të faktit që ishin gra. Në lidhje me këtë, kërkuesja tërhoqi vëmendjen e Gjykatës ndaj pamundësisë që një burrë të jetë viktimë e një dhune të këtij lloji.

Qeveria tha se nuk kishte diskriminim gjinor në çështjen në fjalë, pasi dhuna në fjalë ishte reciproke. Më tej, nuk mund të pretendohet se kishte diskriminim të institucionalizuar që vinte si rezultat i ligjeve penale ose të familjes, ose nga praktika gjyqësore ose administrative. As nuk mund të thuhet se e drejta e brendshme përmbante ndonjë dallim formal ose të shprehur ndërmjet burrave dhe grave. Nuk ishte provuar se organet e brendshme nuk e kishin mbrojtur të drejtën e jetës së kërkueses për shkak të faktit se ajo ishte grua.

Qeveria theksoi se për shkak të reformave të realizuara në vitin 2002 dhe 2004, përkatësisht të disa dispozitave të Kodit Civil dhe miratimit të një Kodi të ri Penal, si dhe hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 4320, legjislacioni turk parashikon garanci të mjaftueshme, të cilat i plotësojnë kërkesat ndërkombëtare për mbrojtjen e grave ndaj dhunës në familje. Qeveria përfundoi duke thënë se kjo padi duhet të deklarohet e papranueshme për shkak të dështimit të përdorimit të mjeteve efektive të brendshme ligjore, ose se është tërësisht e pabazuar, pasi këto pretendime nuk ishin sjellë kurrë në vëmendje të organeve të brendshme dhe, në çdo rast, janë tërësisht të pathemelta.

Sa i përket pretendimit *për shkeljen e nenit 6 dhe 13 të Konventës*, kërkuesja pretendoi se proceset penale të ngritura ndaj H.O.-së nuk ishin efektive dhe se kishin dështuar të siguronin mbrojtje të mjaftueshme për të dhe nënën e saj.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 2

(i) *Dështimi i autoriteteve për mbrojtjen e jetës së nënës së kërkueses*

Gjykata përsëriti se detyra e shtetit, sipas nenit 2 të Konventës, përfshin edhe detyrimin për të siguruar që e drejta për jetën të mos cenohet jo vetëm nga autoritetet por edhe nga individët e tjerë. Në analizën e këtij detyrimi, Gjykata mori parasysh disa elemente. Së pari, ajo konstatoi se autoritetet e dinin, ose duhet ta kishin ditur në atë kohë, ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e kërkueses dhe të nënës

së saj nga H.O., dhe për këtë arsye kishin përgjegjësi për të vepruar pozitivisht në përgjigje të thirrjeve të kërkueses dhe të nënës së saj se jetët e tyre ishin në rrezik. Në vijim, Gjykata vlerësoi se autoritetet nuk kishin arritur të merrnin masa brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të priteshin prej tyre për ta shmangur këtë rrezik. Ata nuk kishin marrë masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, të parashikuara nga Ligji për Mbrojtjen e Familjes dhe nuk kishin urdhëruar që H.O. të mos ishte në kontakt me kërkuesen dhe nënën e saj. Gjykata vlerësoi se dhuna e përshkallëzuar, në këtë rast, si për shembull, një sulm vdekjeprurës, jo vetëm që ishte i mundur, por edhe i parashikueshëm, duke parë historinë e sjelljes së dhunshme të H.O.-së, precedentët e tij penalë ndaj së shoqes dhe nënës së saj, si edhe kërcënimin e vazhdueshëm nga ana e tij për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Sipas praktikës së përbashkët juridike në shtetet anëtare, sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më tepër duhet që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht, në interes publik, edhe sikur viktimat t'i kenë tërhequr kallëzimet e tyre. Megjithatë, duke vendosur vazhdimisht për t'i pushuar procedurat penale kundër H.O.-së., autoritetet i qenë referuar ekskluzivisht nevojës për t'iu shmangur ndërhyrjes në atë, që ato e perceptonin si një "çështje familjare". Me sa duket, autoritetet nuk i kishin marrë në konsideratë arsyet që qëndronin pas tërheqjes së kallëzimeve, pavarësisht se nëna e kërkueses kishte deklaruar se ajo dhe vajza e saj kishin qenë të detyruara ta bënin këtë për shkak të kërcënimeve me vdekje dhe presionit të H.O.-së. Gjykata u shpreh se, pavarësisht nga tërheqja e kallëzimeve nga ana e viktimave, kuadri ligjor duhej t'i kishte dhënë mundësi organeve të akuzës që të vazhdonin procedimin penal kundër H.O.-së., për shkak se sjellja e tij e dhunshme kishte qenë aq serioze sa të përlligjte hetimet dhe se kishte pasur një kërcënim konstant për integritetin fizik të kërkueses.

Për pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendore nuk kishin treguar kujdesin e duhur për të parandaluar dhunën ndaj kërkueses dhe nënës së saj, në veçanti duke marrë masa parandaluese penale apo të ndonjë lloji tjetër kundër H.O.-së.

ii) në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv

Gjykata rikujtoi se në bazë të nenit 2 të Konventës autoritetet kanë për detyrë që të kryejnë një hetim efektiv për të zbuluar shkaqet e humbjes së jetës së një personi dhe për të vënë para drejtësisë përgjegjësit. Ajo theksoi se një detyrim i tillë përfshin edhe nevojën për procedura të menjëhershme dhe efektive. Në rrethanat e çështjes konkrete ajo konstatoi se procedurat penale në ngarkim të H.O.-së për vrasje, të cilën për më tepër e kishte pranuar vetë, kishin zgjatur ndërkaq për më shumë se gjashtë vjet dhe ishin ende në zhvillim e sipër para Gjykatës së Kasacionit. Në këto kushte, këto procedura nuk mund të konsideroheshin si efektive. Për më tepër, sistemi ligjor penal nuk kishte pasur asnjë efekt parandalues në këtë rast. Për këto arsye, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 2 edhe në këtë aspekt.

Në lidhje me nenin 3

Gjykata vlerësoi se reagimi i autoriteteve ndaj sjelljes së H.O.-së, kishte qenë haptazi i papërshtatshëm, duke parë seriozitetin e kërcënimeve të tij. Vendimet gjyqësore, të cilat nuk kishin ofruar asnjë masë të dukshme ndaluese ose ndonjë efekt parandalues ndaj H.O.-së., kishin qenë të paefektshme dhe madje shfaqnin njëfarë tolerance kundrejt veprimeve të tij. Veçanërisht, pas incidentit me makinë, H.O. kishte qëndruar vetëm 25 ditë në burg dhe ishte ndëshkuar vetëm me gjobë për dëmtimet e rënda që i kishte shkaktuar nënës së kërkueses. Edhe më e habitshme ishte se si ndëshkim për goditjen shtatë herë me thikë të kërkueses, ai mori thjesht një gjobë të vogël, të cilën mund ta paguante me këste.

Gjykata konstatoi se deri në janar 1998, kohë kur edhe hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Familjes, legjislacioni turk nuk ofronte masa specifike administrative dhe policore për të mbrojtur personat e brishtë nga dhuna në familje. Madje edhe pas kësaj date, autoritetet turke nuk i kishin aplikuar me efektivitet ato masa e sanksione në mbrojtje të kërkueses.

Në përfundim, Gjykata vërejti me shqetësim të madh se dhuna e pësuar nga kërkuesja në fakt nuk kishte marrë fund dhe se autoritetet vazhdonin të tregoheshin pasive. Me gjithë kërkesën e kërkueses në prill 2008, asgjë

nuk u bë deri kur Gjykata i kërkoi Qeverisë që t'i paraqiste informacion mbi masat që autoritetet kishin marrë në mbrojtje të saj. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 për shkak të dështimit të autoriteteve për të marrë masa mbrojtëse në formën e ndalimit efektiv të cenimeve serioze të integritetit personal të parashtrueses të pësuar nga ana e ish-bashkëshortit të saj.

Në lidhje me nenin 14

Sipas raporteve të depozituara nga kërkuesja, të cilat u përpiluan nga dy organizata të rëndësishme të shoqërisë civile dhe që nuk u kundërshtuan nga Qeveria, numri më i lartë i viktimave të dhunës në familje ishte pikërisht në Diarbakir, ku kishte jetuar edhe kërkuesja në kohën kur ndodhën ngjarjet. Të gjitha viktimat ishin gra, shumica e të cilave me origjinë kurde, analfabete ose me një nivel të ulët arsimimi dhe në përgjithësi pa ndonjë burim të pavarur të ardhurash. Në fakt, raportet sugjerorin se dhuna në familje tolerohej nga autoritetet dhe se mjetet ankimore të treguara nga Qeveria nuk funksiononin në mënyrë efektive. Për rrjedhojë, Gjykata konsideroi se kërkuesja kishte qenë në gjendje të vërtetonte se dhuna në familje prekte kryesisht gratë dhe se pasiviteti diskriminues dhe i përgjithshëm nga gjykatat turke kishte krijuar një klimë që favorizonte dhunën në familje. Duke pasur parasysh këtë, dhuna e pësuar nga kërkuesja dhe nëna e saj mund të konsiderohej si e bazuar tek gjinia, që përbënte një formë të diskriminimit kundër grave. Me gjithë reformat e ndërmarra nga Qeveria në vitet e fundit, mungesa e përgjithshme e reagimit nga ana e sistemit gjyqësor dhe mosndëshkimi i dhunuesve, siç u vërtetua në rastin e kërkueses, treguan se kishte angazhim të pamjaftueshëm në marrjen e masave të duhura për të zgjidhur problemin e dhunës në familje. Për pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 14, në lidhje me nenet 2 dhe 3.

Në lidhje me nenet e tjera

Duke parë përfundimet e mësipërme, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme shqyrtimin e të njëjtave fakte në kontekstin e neneve 6 dhe 13.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në lidhje me vdekjen e nënës së kërkueses; se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, lidhur me dështimin e organeve për të mbrojtur kërkuesen nga dhuna në familje të ushtruar nga ish-bashkëshorti i saj; se kishte shkelje të nenit 14, në lidhje me nenin 2 dhe 3 të Konventës. Bazuar në nenin 41, Gjykata i akordoi parashtrueses 30,000 (tridhjetë mijë) euro për dëmin jomaterial dhe 6,500 (gjashtë mijë e pesëqind) euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË

3.1. SEKRETARI I SHTETIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME kundër N.A. ME PALË NDËRHYRËSE QENDRËN AIRE

GJDBE

Çështja C-115/15

30 qershor 2016

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=C-115/15>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: *Kjo çështje kishte të bënte me mbrojtjen që u ofron e drejta e BE-së shtetasve të shteteve të treta që kanë qenë viktime të dhunës në familje.*

Faktet kryesore

N.A. është një shtetase pakistaneze e cila në shtator të vitit 2003 u martua me K.A., një shtetas gjerman, dhe në mars 2004, çifti u transferua në Mbretërinë e Bashkuar. Çifti kishte dy vajza, M.A. dhe I.A., të lindura të dyja në Mbretërinë e Bashkuar respektivisht më 14 nëntor 2005 dhe 3 shkurt 2007, të cilat kishin shtetësinë gjermane.

Pas transferimit, marrëdhëniet bashkëshortore u përkeqësuan dhe N.A. ishte edhe viktimë e akteve të dhunës në familje. Në tetor 2006, K.A. u largua nga shtëpia dhe në dhjetor 2006 u largua nga Mbretëria e Bashkuar. Ndërsa banonte në Mbretërinë e Bashkuar, K.A. kishte pasur statusin e personit të punësuar dhe atë të personit të vetëpunësuar.

K.A. pretendoi se martesë me N.A. ishte zgjidhur, pas një padie për zgjidhje martese sipas së drejtës myslimane (talaq), të pranuar në Karaçi, Pakistan, më 13 mars 2007. Në shtator 2008, N.A. filloi procedurat e zgjidhjes së martesës në Mbretërinë e Bashkuar. Këto procedura u bënë përfundimtare më 4 gusht 2009. N.A.-së iu njoh kujdestaria e dy fëmijëve.

Dy vajzat, M.,A., dhe I.A. kishin ndjekur shkollën në Mbretërinë e Bashkuar, përkatësisht që nga janari 2009 dhe shtatori 2010. N.A. kërkoi të drejtën e qëndrimit të përhershëm në Mbretërinë e Bashkuar, por kjo kërkesë iu hodh poshtë nga Sekretari i Shtetit për Çështjet e Brendshme.⁴¹

N.A. e apeloj këtë vendim pranë Tribunalit të Epërm (Dhoma e Imigrimit dhe Azilit), i cili shqyrtoi tri pretendimet e ngritura nga N.A. në mbështetje të apelit të saj. Tribunali vendosi, së pari, se N.A. nuk mund të pretendonte të ruante të drejtën e saj të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar sipas nenit 13 (2) të Direktivës 2004/38, me arsyetimin se, që nga data e zgjidhjes së martesës, K.A. nuk i gëzonte më të drejtat e tij sipas Traktatit në atë shtet anëtar. Së dyti, Tribunali vendosi se, megjithatë, N.A. kishte të drejtën e qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar në bazë të nenit 20 të TFBE-së, siç interpretohet nga GJDBE në vendimin e 8 marsit 2011, Ruiz Zambrano,⁴² dhe, nga ana tjetër, në bazë të nenit 12 të Rregullores nr. 1612/68. Së treti, Tribunali vlerësoi se refuzimi i së drejtës së qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar për N.A. do t'i detyronte fëmijët e saj, M.A. dhe I.A., të largoheshin nga ky shtet anëtar me nënën e tyre, pasi vetëm asaj iu dha kujdestaria dhe një urdhër dëbimi për këta fëmijë do të shkelte të drejtat e tyre sipas nenit 8 të KEDNJ.

41 Ministri i Brendshëm në Mbretërinë e Bashkuar.

42 Çështja C-34/09, BE: C: 2011: 124.

N.A. e apeloj vendimin në lidhje me pretendimin e parë pranë Gjykatës së Apelit. Kurse Sekretari i Shtetit e apeloj vendimin e Tribunalit në lidhje me argumentin e dytë me pretendimin se, të drejtat që M.A. dhe A.B. gëzojnë nga nenet 20 dhe 21 të TFBE-së si qytetarë të BE-së, mund të shkelen vetëm nëse ato detyrohen të largohen nga territori i BE-së i marrë në tërësi. Përderisa ato janë shtetase gjermane, ky detyrim nuk ekziston pasi ato mund të banojnë në Gjermani.

Në këto rrethana, Gjykata e Apelit vendosi të pezullonte procedurën dhe t'i drejtohej Gjykatës me pyetjet e mëposhtme, për një vendim paraprak:

- 1) A duhet që një shtetas i një shteti të tretë, ish-bashkëshort i një qytetari të BE-së, të jetë në gjendje të vërtetojë se ish-bashkëshorti i tij ose i saj i ka ushtruar të drejtat që rrjedhin nga Traktatet në shtetin anëtar pritës në kohën e zgjidhjes së martesës, në mënyrë që të ruante të drejtën e qëndrimit sipas nenit 13 (2) të Direktivës 2004/38?
- 2) A përfiton një qytetar i BE-së, sipas së drejtës së BE-së, nga e drejta e qëndrimit në një shtet anëtar pritës sipas neneve 20 dhe 21 të TFBE-së kur shteti i vetëm anëtar i BE-së, në të cilin ky shtetas ka të drejtë të banojë është shteti i kombësisë së tij, por është gjetur, me vendim të një gjykate kompetente, se largimi i tij nga shteti anëtar pritës drejt shtetit të shtetësisë do të përbënte shkelje të të drejtave që gëzon sipas nenit 8 të KEDNJ-së dhe sipas nenit 7 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së?
- 3) Nëse qytetari i BE i përmendur në pyetjen 2 më sipër është fëmijë, a ka prindi që ka i vetëm kujdestarinë e këtij fëmije, të drejtë të qëndrojë në shtetin anëtar pritës në rast se këtij fëmije do t'i duhej të shoqëronte prindin po qe se ky i fundit largohet nga shteti anëtar pritës?
- 4) A ka një fëmijë të drejtë të banojë në shtetin anëtar pritës sipas nenit 12 të Rregullores nr. 1612/68⁴³ nëse prindi i fëmijës që është qytetar i BE dhe që ka punuar në shtetin anëtar pritës, pushon së jetuari në atë shtet para se fëmija të fillojë shkollën atje?"

43 Aktualisht neni 10 i Rregullores nr. 492/2011/BE.

Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pyetjen e parë, Gjykata u shpreh se nënparagrafi i parë i nenit 13.2 (c) të Direktivës 2004/38 mbi të drejtën e qytetarëve të BE dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe banuar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, duhet të interpretohet në kuptimin se një shtetas i një vendi të tretë, i divorcuar nga një qytetar i BE-së nga i cili ka pësuar akte dhune në familje gjatë martesës, nuk mund të përfitojë nga ruajtja e së drejtës së tij të qëndrimit në shtetin anëtar pritës kur procedurat e divorcit kanë filluar pas largimit të bashkëshortit qytetar i BE-së nga ai shtet anëtar.

Nga termat e përdorur si në titull ashtu edhe në formulimin e nenit 13.2 të Direktivës 2004/38 rrjedh, para së gjithash, që ruajtja e së drejtës së qëndrimit për anëtarët e familjes së një qytetari të BE-së por që vetë nuk janë shtetas të një shteti anëtar është parashikuar veçanërisht në rast të zgjidhjes së martesës.

Më tej, Gjykata vuri në pah se sfondi i nenit 13.2 të Direktivës 2004/38 përbën një derogim nga parimi sipas të cilit të drejtën e hyrjes dhe qëndrimit në një shtet anëtar e gëzojnë jo të gjithë shtetasit e shteteve të treta, por vetëm ata që janë anëtarë të familjes, sipas kuptimit të nenit 2.2 të asaj direktive, të një qytetari të BE-së i cili ka ushtruar të drejtën e tij të lëvizjes së lirë në vendosjen e tij në një shtet anëtar tjetër nga shteti anëtar i shtetësisë së tij. Në fakt, kjo dispozitë mbulon rastet e jashtëzakonshme kur divorci nuk sjell humbjen e së drejtës së qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta, megjithëse pas divorcit të tyre, shtetasit në fjalë nuk i plotësojnë më kushtet e përcaktuara në nenin 7.2 të asaj direktive, dhe në veçanti ato që lidhen me statusin e anëtarit të familjes të një qytetari të BE-së.

Së fundi, në lidhje me qëllimin e nenit 13.2 të Direktivës 2004/38, kjo dispozitë plotëson objektivin, e përcaktuar në recitalin 15 të saj, ofrimin e mbrojtjes ligjore për anëtarët e familjes në rast të zgjidhjes së martesës, anulimit të martesës ose përfundimit të një partneriteti të regjistruar, duke marrë, për këtë qëllim, masa për të siguruar që, në raste të tilla, anëtarët e familjes që tashmë qëndrojnë në shtetin anëtar pritës të ruajnë individualisht të drejtën e tyre të qëndrimit. Në këtë drejtim, është e qartë nga memorandumimi shpjegues i propozimit për

atë direktivë që neni 13.2 i saj synon të ofrojë një mbrojtje ligjore për shtetasit e shteteve të treta, e drejta e qëndrimit të të cilëve është e lidhur me marrëdhënien familjare të përfaqësuar nga martesë dhe që mund shantazhohen me zgjidhje martesë, dhe një mbrojtje e tillë është e nevojshme vetëm në rast të një divorci përfundimtar, ndërkohë që, në rast të ndarjes faktike, e drejta e banimit të bashkëshortit shtetas i një vendi të tretë nuk cenohet në asnjë mënyrë.

Nga kjo rrjedh se zbatimi i nenit 13.2 të Direktivës 2004/38, përfshirë të drejtën që rrjedh nga nënparagrafi i tij i parë (c), i nënshtrohet divorcit të personave të interesuar. Kështu, kur një shtetas(e) i(e) një shteti të tretë ka qenë gjatë martesës viktimë e akteve të dhunës në familje të kryera nga një qytetar i BE nga i cili është divorcuar, duhet që ky i fundit të banojë në shtetin anëtar pritës, sipas nenit 7.1 të Direktivës 2004/38, deri në datën e fillimit të procedurës së divorcit, në mënyrë që ai shtetas të ketë të drejtë të përfitojë nga nënparagrafi i parë i nenit 13.2 (c) të asaj direktive.

Në lidhje me pyetjen e katërt, Gjykata u shpreh se neni 12 i Rregullores nr. 1612/68, që lidhej me lëvizjen e lirë të punëtorëve brenda Komunitetit, duhet të interpretohet në kuptimin që një fëmijë dhe prindi që ka kujdestarinë e vetme, kur si shtetas të një shteti të tretë përfitojnë në bazë të kësaj dispozite nga e drejta e qëndrimit në një shtet anëtar pritës, kur prindi tjetër është qytetar i BE-së dhe ka punuar në atë shtet anëtar, por ka pushuar së jetuari atje përpara se fëmija të fillojë shkollimin.

Në këtë drejtim, sipas Gjykatës, e drejta për arsimim në shtetin anëtar pritës të fëmijëve të punëtorëve migrantë varet nga vendbanimi paraprak i fëmijës në atë shtet. Kur këta fëmijë kanë lindur ose janë vendosur në atë shtet anëtar si anëtarë të familjes së një punëtori migrant, mund të përfitojnë nga një e drejtë e tillë në atë shtet anëtar. Neni 12 i Rregullores nr. 1612/68 synon në veçanti të sigurojë që fëmijët e një punëtori që është shtetas i një shteti anëtar, edhe nëse ky i fundit nuk ndjek më një aktivitet punësimi në shtetin anëtar pritës, të fillojë dhe, kur është e përshtatshme, të përfundojnë arsimin e në këtë shtet. Nga kjo rrjedh se e drejta e fëmijëve për trajtim të barabartë për sa i përket qasjes në arsim nuk varet nga fakti se babai ose nëna e tyre ka statusin e punëtorit migrant në shtetin anëtar pritës. Për më tepër, në

mënyrë që një fëmijë të përfitojë nga e drejta e parashikuar nga dispozita e nenit 12 të Rregullores Nr. 1612/68 kjo nuk kërkon që prindi, si ish-punëtor migrant, të banojë ende në shtetin anëtar pritës kur fëmija fillon shkollën ose studimet ose të jetë i pranishëm në territorin e atij shteti anëtar gjatë shkollimit ose studimeve të fëmijës së tij/saj.

Së fundmi, e drejta për qasje në arsim kupton të drejtën e qëndrimit të pavarur të fëmijës së një punëtori migrant ose të një ish-punëtori migrant, kur ky fëmijë dëshiron të vazhdojë studimet e tij në shtetin anëtar pritës, si dhe të drejtën e qëndrimit të prindit që ka kujdestarinë e këtij fëmije. Në fakt, kur fëmijët gëzojnë, sipas nenit 12 të Rregullores nr. 1612/68, të drejtën për të vazhduar arsimin e tyre në shtetin anëtar pritës, refuzimi për t'i dhënë prindit në fjalë mundësinë e qëndrimit në shtetin anëtar pritës gjatë shkollimit të fëmijëve të tij mund të jetë e tillë që t'i privojë fëmijët nga një e drejtë e njohur nga e drejta e BE-së.

Në lidhje me pyetjen e dytë dhe të tretë, Gjykata u shpreh se neni 21 i TFBE-së duhet të interpretohet se i jep një qytetari të mitur të BE-së të drejtën e qëndrimit në shtetin anëtar pritës, me kusht që ai të përmbushë kushtet e përcaktuara në nenin 7.1 të Direktivës 2004/38, në veçanti, atë të pasjes së burimeve të mjaftueshme dhe të sigurimit të plotë shëndetësor, në mënyrë që të mos bëhen barrë në sistemin e ndihmës sociale të shtetit anëtar pritës gjatë qëndrimit. GJDBE u shpreh se i takon Gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit t'i verifikojë këto rrethana. Nëse është kështu, e njëjta dispozitë i lejon prindit që ka kujdestarinë efektive të këtij qytetari të Bashkimit Evropian të banojë me të në shtetin anëtar pritës. Në të vërtetë, refuzimi për të lejuar që prindi, shtetas i një shteti anëtar ose i një shteti të tretë, i cili ka kujdestarinë e një shtetasi të mitur të BE, të cilit i njihet e drejta e qëndrimit nga neni 21 i TFBE-së dhe Direktiva 2004/38, të qëndrojë me atë shtetas në shtetin anëtar pritës do të privonte të drejtën e qëndrimit të këtij të fundit nga çdo efekt i dobishëm, duke pasur parasysh se gëzimi i së drejtës së qëndrimit nga një fëmijë i vogël nënkupton domosdoshmërisht se ai fëmijë ka të drejtën të shoqërohet nga personi që siguron kujdes efektiv dhe, për këtë arsye, duhet që ky person të jetë në gjendje të banojë me të në shtetin anëtar pritës gjatë këtij qëndrimi.

Neni 26

E Drejta e Integritetit Personal

Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin:

- (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;*
- (2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;*
- (3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin;*
- (4) të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI27/12, KI31/12, KI32/12, KI33/12. PARASHTRUES: MYKYREME HOXHA, MERITA HOXHA, MËRGIM HOXHA DHE BLERIM HOXHA

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_27_12_ki_31_12_ki_32_12_ki_33_12_shq.pdf]

5 korrik 2013

***Çështja kyçele drejta e pretenduar:** Çështja kryesore e këtij rasti ishte se a ishin cenuar disa të drejta kushtetuese të parashtruesve, duke përfshirë të drejtën për integritet personal, nga vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë lidhur me një kontest pronësor të bartur nga trashëgimlënësi i parashtruesve të kërkesës.*

Faktet kryesore

Ky rast kishte të bënte më një kontest pronësor rreth një patundshmërie, që prindi, gjegjësisht bashkëshorti i ndjerë i parashtruesve të kërkesës e kishte pasur me një person tjetër. Pas vdekjes së trashëgimlënësit, kontesti kishte vazhduar kundër parashtruesve të kërkesës, në cilësi të trashëgimtarëve. Më 9 janar 2008, Gjykata Komunale në Pejë kishte nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 90/03, me të cilin i kishte njohur palës kundërshtare ndërgjyqëse (si paditëse) të drejtën e pronësisë mbi një banesë që ishte objekt kontesti. Gjykata Komunale kishte detyruar parashtruesit e kërkesës që t'ia pranonin palës kundërshtare ndërgjyqëse të drejtën e pronësisë mbi banesën në fjalë dhe ta lejonin atë që të bënte ndryshimet në regjistrin e të drejtave për patundshmëri në Zyrën komunale kadastrale në Pejë. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Komunale kishte arsyetuar se “në mes të paraardhësit (trashëgimlënësit) të parashtruesve dhe palës kundërshtare ndërgjyqëse kishte ekzistuar një marrëveshje fiktive, me shkrim, për shitblerjen e një prone të patundshme, si dhe një marrëveshje reale gojore mbi ndërtimin e përbashkët. Edhe përkundër faktit se nuk ekzistonte një marrëveshje

me shkrim dhe se në vend të saj ekzistonte kontrata e shitblerjes së patundshmërisë, Gjykata Komunale konsideroi se kontrata mbi ndërtimin e përbashkët kishte qenë qëllimi i vërtetë dhe real i palëve kontraktuese. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, parashtruesit kishin parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Më 9 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë kishte nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 313/2010, duke e refuzuar ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin C. nr. 90/03, të Gjykatës Komunale në Pejë. Më 19, 26 dhe 27 mars 2012, parashtruesit dorëzuan individualisht kërkesat e ndara në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit pretenduan se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë, C. 90/03, i datës 09.01.2008 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, AC Nr. 313/2010, i datës 09.11.2011, kishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia Para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 16 [Epërsia e Kushtetutës], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia Para Ligjit], neni 25 [E Drejta për Jetën], neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal], neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], neni 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], në lidhje me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e tyre të garantuara me nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si në vijim: nenin 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut], nenin 2 [E Drejta për Jetën], nenin 3 [Ndalimi i torturës], neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], neni 10 [Liria e shprehjes], neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive], neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], nenin 1 të Protokollit nr. 1, neni 2, neni 3 dhe neni 4 të Protokollit nr. 7, nenin 1 të Protokollit nr. 12. Parashtruesit arsyetonin pretendimet e tyre duke kundërshtuar mënyrën sesi gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kishin konstatuar gjendjen faktike dhe kishin bërë interpretimet përkatëse ligjore.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht kishte vendosur për bashkimin e kërkesave. Më tutje, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesat ngrinin çështje që kishin të bënin me mënyrën se si gjykatat e rregullta kishin bërë konstatimet e fakteve dhe interpretimet përkatëse ligjore. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese sqaroi se nuk ishte detyrë e saj të merrej me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Pasi gjeti se parashtruesit kishin dështuar të tregonin pse dhe si gjykatat e rregullta i kishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, Gjykata vendosi që kërkesa ishte e papranueshme për shqyrtim të meritave, sepse ajo ishte qartazi e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi që të shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. N.Ç. kundër TURQISË

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2240591/11%22%5D%7D>

GJEDNJ [Seksioni i Dytë]

9 shkurt 2021

Çështja kyçele drejta e pretenduar: mungesa e hetimeve efektive rezultoi në dështimin për të mbrojtur integritetin personal të një fëmije të cenueshëm gjatë proceseve penale tepër të gjata në lidhje me abuzimin seksual; pretendime për shkelje të së drejtës në privatësi për shkak të dështimit për të mbrojtur integritetin personal të një fëmije të cenueshëm gjatë proceseve penale tepër të gjata në lidhje me abuzimin seksual: shkelje

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga N.Ç., (kërkuesja) një shtetase turke, e lindur më 2 janar 1990, e cila jeton në Stamboll (Turqi). Në korrik 2002, dy gra detyruan N.Ç. për të punuar si prostitutë. Më 8 janar 2003 kërkuesja bëri denoncim kundër grave, si dhe ndaj burrave me të cilët kishte kryer marrëdhënie seksuale. Prokurori publik i Mardinit hapi një hetim penal. Policia identifikoi njëzet e tetë të dyshuar. Në ndërkohë, kërkuesja iu nënshtrua disa ekzaminimeve mjekësore. Ndërmjet 14 dhe 21 janar 2003, njëzet e shtatë të dyshuar u vendosën në paraburgim nga gjyqtarë hetues nga gjykata të ndryshme. Më 20 janar 2003, prokurori ngriti aktakuzë ndaj njëzet e tetë personave me akuzën e përdhunimit të një vajze nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç, dhe “mbajtje për dëshirat seksuale”, nxitje për prostitucion dhe përfshirje në mbajtje. Katër persona të tjerë u akuzuan gjatë procedurës. Më 24 janar 2003, Gjykata e Madhe e Mardinit la në fuqi vendimin për vendosjen e njëzet e shtatë të dyshuarve në paraburgim dhe vendosi mbajtjen e seancës. Kërkuesja, prindërit e saj dhe Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve, pranë Ministrisë së Çështjeve Familjare, iu bashkuan procedurës penale si palë civile.

Më 24 shkurt 2003, kërkuesja, babai i saj, njëzet e tetë të pandehurit dhe përfaqësuesit e palëve u paraqitën në seancën dëgjimore në Gjykatën e Pavarur të Mardinit; duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të çështjes, publiku u përjashtua nga salla e gjyqit. Të njëjtën ditë familjarët e të pandehurve të caktuar sulmuan kërkuesen dhe përfaqësuesit e saj, me ç'rast u detyruan të largohen nga godina e gjykatës pas seancës. Kërkesës së avokatëve të saj për caktimin e masave mbrojtëse nuk iu dha asnjë përgjigje.

Më 14 maj 2003, gjykata e shkallës së lartë rrëzoi një kërkesë të re të përfaqësuesve të kërkueses, të cilët kishin kërkuar që gjykimi të zhvendoset në një rajon tjetër për arsye sigurie; me shumicë votash vendosi edhe lirimin e gjashtëmbëdhjetë të pandehurve. Më 15 maj dhe 26 qershor 2003, të pandehurit e mbetur u liruan. Më 28 shtator 2010, në mbyllje të seancës së saj të tridhjetë e pestë, Gjykata e Mardinit (Mardin Assize Court) shpalli të pafajshëm tre të pandehur për akuzën e përdhunimit të së miturës, për mungesë provash. Në lidhje me akuzën “Rrëmbim i detyruar për përmbushje të dëshirave seksuale” për secilin nga lokacionet ku u mbajt kërkuesja, Gjykata (Assize Court) riklasifikoi veprat penale dhe vlerësoi se kërkuesja kishte pranuar të qëndronte.

Duke vënë në dukje më tej se afati maksimal i parashkrimit të përgjegjësisë penale në lidhje me “mbajtje me pëlqim” kishte skaduar, u hoq kjo pjesë e akuzës për të gjithë të pandehurit. Ajo hoqi edhe akuzën e nxitjes së prostitucionit në lidhje me tre të pandehurit që kishin bashkëpunuar me dy femrat E.A. dhe T.T.

Gjykata (Assize Court) vlerësoi gjithashtu se akti seksual me një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç ishte i ndaluar në të gjitha rastet nga neni 414 i ish-Kodit Penal, i zbatueshëm për faktet e çështjes, por që nëse viktimi kishte rënë dakord, paragrafi i parë i kësaj dispozite do të zbatohej; vetëm paragrafi i dytë u klasifikua si version i cili përbënte një krim. Në dritën e një raporti psikiatrik dhe të disa fakteve, Gjykata (Assize Court) vlerësoi se kërkuesja nuk kishte qenë “plotësisht e gatshme” dhe se nuk kishte asnjë provë që të lejonte një përfundim se të pandehurit e kishin detyruar atë të vepronte ashtu siç veproi.

Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë (Assize Court) vendosi të zbatojë paragrafin e parë të nenit 414, dhe të dënimit minimal të përcaktuar në atë dispozitë, për të gjithë të pandehurit, me dy përjashtime, atëherë shqiptoi dënime të ndryshme me burg në zbatim të dispozitave të ndryshme të Kodit të mësipërm.

Më 13 mars 2003, kërkesja u vendos në një institucion të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve në Malatya; ajo më pas u transferua në një institucion të ngjashëm në Adana për monitorim psikiatrik dhe më pas u zhvendos në Stamboll. Kjo masë u zbatua deri në moshën madhore.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenet 3 (Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës), 6 (E drejta për një gjykim të drejtë), 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës, kërkesja u ankua se nuk kishte marrë mbështetje profesionale gjatë procedurës, se ajo ishte poshtëruar para të pandehurve dhe se ishte kërcënuar prej tyre, me dijeninë e autoriteteve gjyqësore. Ajo gjithashtu u ankua se dy akuza ishin hequr si të parashkruara, dhe se dënimet e të pandehurve ishin zbutur në bazë të sjelljes së mirë në seanca. Ajo konsideroi se nuk ka qenë e mbrojtur gjatë procedurës dhe se ato procedura kanë qenë joefektive për shkak të kohëzgjatjes dhe të rezultatit të tyre. Duke u mbështetur në nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), ajo pretendoi se ishte diskriminuar për shkak të gjinisë së saj.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve në lidhje me shkeljen e neneve 3 dhe 8, Gjykata theksoi se pragu i ashpërsisë i kërkuar për zbatimin e nenit 3 të Konventës, u plotësua në rastin e kërkeses. Duke pasur parasysh moshën e saj të re në kohën përkatëse, ajo kishte qenë në një situatë të cenueshme. Në këtë kontekst, abuzimi seksual që kishte përjetuar ajo dhe pretendimet për viktimizimin dytësor, pra mangësitë në procedurën penale për të garantuar mbrojtjen e parashtrueses ishin mjaft serioze për t'u përfshirë në fushëveprimin e nenit 3. Më tej, në funksion të ndikimit të të dy aspekteve të ankesave të kërkeses në integritetin e

saj fizik dhe psikologjik, ngjarjet për të cilat ankohej kërkuesja, binin gjithashtu në fushëveprimin e nenit 8 të Konventës.

Në vlerësim të (a) mbrojtjes së kërkueses gjatë procedurës, Gjykata vërejti se një hetim u hap me shpejtësi pas ankesës së kërkueses dhe shumica e të pandehurve u dënuan me burgim. Megjithatë, në një rast kaq të rëndë, në lidhje me shfrytëzimin seksual të një vajze nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç, Gjykata nuk mund të kufizohej në këtë konstatim të përgjithshëm për të vlerësuar nëse shteti i paditur kishte përmbushur apo jo detyrimet e tij sipas neneve 3 dhe 8.

Sa i përket (b) dështimit për t'i ofruar ndihmë kërkueses gjatë procedurës, Gjykata vërejti se instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave të dëmit fizik ose mendor dhe për mbrojtjen kundër viktimizimit dytësor, përmbajnë dhe japin udhëzime në lidhje me ndihmën që duhet t'u ofrohet fëmijëve viktimë të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual. Në këtë rast, për tetëmbëdhjetë muaj pas dorëzimit të ankesës së saj, kërkuesja nuk u mbështet në asnjë moment nga një asistent social, një psikolog apo ndonjë ekspert, as para policisë ose prokurorit, as gjatë seancave para gjykatës së shkallës së lartë. Ky konstatim ishte i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se kërkuesja nuk kishte marrë përkujdesje në mënyrën e duhur gjatë procedurës në fjalë.

Në vlerësim të (c) pretendimeve për dështimin e autoriteteve për të mbrojtur kërkuesen nga të pandehurit, Gjykata vërejti se situata e kërkueses u përkeqësua gjatë seancave gjyqësore, pasi nuk u mor asnjë masë për ta ndarë atë nga të pandehurit. Gjatë disa seancave, ajo u vendos përballë të pandehurve dhe u detyrua të rrëfente në detaje sulmet, kërcënimet dhe përdhunimet e të cilave kishte qenë viktimë, të cilat padyshim i kishin krijuar një mjedis jashtëzakonisht frikësues. Megjithatë, dosja nuk përmbante asnjë tregues se viktimë e kishte kërkuar këtë ballafaqim apo edhe se kishte qenë e nevojshme për një ushtrim adekuat dhe efektiv të të drejtave të mbrojtjes, kështu që Gjykata nuk mund të arrinte në përfundimin se ishte kryer një ushtrim i duhur balancues. Kështu, kishte pasur një dështim për të mbrojtur kërkuesen nga të pandehurit në këtë rast të rëndë prostitucioni dhe abuzimi seksual kundër një fëmije nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç.

Në lidhje me (d) kërkesën për rindërtimin e sërishëm (të panevojshëm) të përdhunimeve, Gjykata vërejti se kërkueses i ishte kërkuar të riprodhonte, përpara të gjithë të pandehurve dhe përfaqësuesve të tyre, pozicionet në të cilat kishin ndodhur aktet seksuale. Gjykata e shkallës së lartë nuk kishte marrë asnjë masë për të reduktuar poshtërimin që kërkuësja e konsideronte në mënyrë legjitime se kishte pësuar në këtë drejtim. Për më tepër, në dosjen e lëndës nuk kishte asgjë për të shpjeguar pse ky rindërtim ka qenë i nevojshëm për të vërtetuar faktet apo karakterizimin e tyre në ligj. Për kërkuesen, këto seanca duhet të kenë qenë, si rrjedhim, jashtëzakonisht traumatike dhe thjesht vendimi për t'i zhvilluar ato pa lejuar qasje publikut, nuk ishte në vetvete e mjaftueshme për ta mbrojtur atë nga dëmtimi i dinjitetit të saj dhe nga ndërhyrja në jetën e saj private. Ato seanca dëgjimore kishin ndikuar negativisht në integritetin e saj personal dhe kishin tejkaluar ndjeshëm nivelin e shqetësimit të qenësishëm në dhënien e dëshmisë si viktimë e shfrytëzimit dhe sulmeve të supozuara seksuale. Rrjedhimisht, ato në asnjë mënyrë nuk mund të justifikoheshin me kërkesat e një gjykimi të drejtë për të pandehurit.

Sa i përket (e) ekzaminimeve mjekësore të përsëritura, Gjykata theksoi se kërkuësja u mor në pyetje në dhjetë raste me kërkesë të autoriteteve gjyqësore, ose për të përcaktuar moshën e saj të saktë, ose për të përcaktuar pasojat e përdhunimeve të kryera ndaj saj. Ky numër i tepërt dhe i pashpjegueshëm i ekzaminimeve mjekësore, shumë prej tyre jashtëzakonisht ndërhyrëse, përbënte kështu një ndërhyrje të papranueshme në integritetin fizik dhe psikologjik të kërkueses.

Në vlerësim të pretendimit për (f) mungesë të sigurisë, Gjykata vërejti se në mbyllje të seancave, kërkueses iu kërkuua gjithashtu të përballej me qëndrimin agresiv të të afërmeve të të pandehurve, në masën që në një rast ishte e nevojshme një shoqërim policie për t'i mundësuar asaj të largohet nga qyteti. Dukej se autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë parandaluese në lidhje me këtë. Nuk kishte asnjë justifikim për refuzimin nga Gjykata të asistencës për të zhvendosur gjyqin në një qytet tjetër, një praktikë që ishte gjithsesi e zakonshme në çështjet e ndjeshme penale dhe që mund të kishte ndihmuar për të siguruar funksionimin e rregullt të seancave dhe sigurinë e kërkueses.

Në vlerësimin e (g) pëlqimit të viktimës, Gjykata theksoi për aq sa kërkuesja kundërshtoi vlefshmërinë e pëlqimit të saj duke argumentuar moshën e saj shumë të re në kohën përkatëse, detyra e Gjykatës ishte të shqyrtonte nëse legjislacioni i kundërshtuar dhe zbatimi i tij në çështjen në fjalë, të kombinuara me mangësitë e pretenduara në hetim, kishte pasur të meta aq serioze sa të përbënin shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit të paditur sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës. Dinjiteti njerëzor dhe integriteti psikologjik kërkonin vëmendje të veçantë kur kemi të bëjmë me një fëmijë viktimë të sulmit seksual dhe detyrimet e shtetit imponojnë zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës. Kështu, interesat më të mira të fëmijës duhej të kishin përparësi dhe autoritetet kombëtare duhej t'u përgjigjeshin në mënyrën e duhur nevojave që lindnin nga brishtësia e veçantë e fëmijës. Dështimi i autoriteteve kombëtare për të bërë përpjekje thelbësore për të vërtetuar të gjitha rrethanat që lidhen me ngjarjet dhe dështimi i tyre për të kryer një vlerësim të ndjeshëm ndaj kontekstit të pëlqimit të viktimës mund të shkaktojë probleme në lidhje me dispozitat në fjalë. Megjithatë, dhënia e peshës ekuivalente pëlqimit të një fëmije nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç dhe pëlqimit të një të rrituri nuk mund të jetë në asnjë rrethanë e pranueshme në kontekstin e një rasti që përfshin shfrytëzimin dhe abuzimin seksual. Hetimi dhe konkluzionet e tij duhej të fokusoheshin kryesisht në çështjen e mungesës së pëlqimit. Rrjedhimisht, Gjykata vuri në dukje me interes se formulimi i nenit 414 të Kodit Penal, që tregon aktin si “përdhunim”, nuk përmbante asnjë përmendje të termit “pëlqim” ose “vullnet” ose ndonjë sinonim për to; as neni 416 i Kodit Penal, që dënonte edhe marrëdhëniet seksuale konsensuale me një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç, i cili theksonte më shumë nevojën për të mos marrë parasysh pëlqimin për një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Megjithatë, gjykatat kombëtare i kishin kushtuar peshë vendimtare “pëlqimit” të kërkueses në përfundimin se neni 414.1 ishte i zbatueshëm; ata e kishin interpretuar atë dispozitë si kriminalizim të çdo marrëdhënieje seksuale, qoftë edhe në bazë konsensuale, me një të mitur nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç, pa treguar megjithatë pse në rastin konkret as kërcënimet dhe dhuna e pretenduar, as pagesat e bëra, nuk konsideroheshin se përmbushnin kriteret e përcaktuara në nenin 414.2, të interpretuara nga autoritetet kombëtare si situata që sjellin “mungesë pëlqimi” nga ana e viktimës. Kjo dispozitë parashikonte afate më të gjata burgimi, duke iu referuar “forcës, dhunës ose kërcënimit”

ose “mjeteve mashtruese që e bëjnë viktimën të paaftë për të rezistuar”; ky kriter i fundit nuk përcaktoi ndonjë kufi për sa i përket natyrës fizike, psikologjike ose materiale të mjeteve mashtruese në fjalë.

Interpretimi i diskutueshëm i autoriteteve gjyqësore kishte qenë madje i tepruar në lidhje me një nga të pandehurit, i cili kishte kërcënuar se do të informonte familjen e parashtrueses për aktivitetet e saj në mënyrë që të kishte marrëdhënie seksuale me të në disa raste. Duke iu referuar një vendimi të Gjykatës së Kasacionit se elementet përbërëse të një kërcënimi nuk do të zbuloheshin nëse kërcënimi rrjedh nga aktivitetet e individit në fjalë, gjykata e shkallës së lartë vlerësoi se veprimet e këtij të pandehuri nuk mund të karakterizoheshin si kërcënim, duke përjashtuar kështu zbatimin e paragrafit të dytë të nenit 414. Sipas mendimit të Gjykatës, ky interpretim mund të ketë një logjikë në një kontekst të përshtatshëm, si p.sh. kur një kriminel kërcënohej me zbulim, në mënyrë që personi që kërcënonte mund të përfitonte financiarisht. Megjithatë, ishte krejtësisht e papranueshme të bëhej një analogji e tillë në lidhje me kërcënimet e bëra ndaj viktimës në kontekstin e shfrytëzimit seksual dhe përdhunimit të një fëmije.

Autoritetet gjyqësore kishin bërë përpjekje të mëdha për të shmangur zbatimin e nenit 414.2, i cili parashikonte dënime më të gjata me burg, dhe nuk kishin shfaqur asnjë shqetësim në asnjë fazë për brishtësinë e kërkueses, e cila kishte qenë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç në kohën përkatëse. Ky interpretim kufizues, i cili nuk merrte parasysh moshën e viktimës, ishte plotësisht në kundërshtim me një vlerësim objektiv të kontekstit të ndjeshëm të këtij rasti dhe me mbrojtjen e një fëmije viktimë e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.

Sa i përket (h) efektivitetit të hetimit, Gjykata vërejti se procedura penale kishte zgjatur rreth njëmbëdhjetë vjet, ishte shqyrtuar katër herë në dy nivele juridiksioni. Edhe pse çështja kishte qenë komplekse, si për shkak të vështirësisë për të vërtetuar faktet ashtu edhe për numrin e të pandehurve, nuk dukej se ndonjë vonesë mund t'i atribuohet sjelljes së kërkueses ose avokatëve të saj. Ekzaminimet e shumta mjekësore të pashpjegueshme kishin shkaktuar zvarritje të konsiderueshme në procedurë. Atëherë kishte pasur një periudhë të pashpjegueshme pasiviteti, e cila kishte zgjatur pothuajse pesë vjet. Dy periudhat në të

cilat çështja kishte qenë në pritje në Gjykatën e Kasacionit, secila prej një viti, ishin gjithashtu të pashpjeguara. Më tej, akuzat për burgim të rremë dhe nxitje për prostitucion ishin parashkruar. Kështu, sjellja e autoriteteve gjyqësore kishte qenë krejtësisht e papajtueshme me kërkesën për shpejtësinë dhe nevojën e përshpejtimit në këtë rast, e cila kërkonte vëmendje të veçantë dhe trajtim prioritar për të garantuar mbrojtjen e një fëmije.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 dhe 8 të Konventës si dhe përcaktoi që shteti i paditur bazuar në nenin 41 t'i paguajë parashtrueses 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro për dëmet materiale dhe jomateriale.

2.2. SÖDERMAN kundër SUEDISË

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%225786/08%22%5D%7D>

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

12 nëntor 2013

Çështja kyçe/le drejta e pretenduar: mungesa e dispozitave të qarta ligjore që kriminalizojnë aktin e filmimit të fshehtë të një fëmije të zhveshur; mospërmbushja e obligimeve pozitive të shtetit suedez sipas nenit 8 për të ofruar mjete juridike kundër shkeljes së integritetit personal.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga znj. Eliza Söderman (kërkuesja), një shtetase suedeze, kundër Mbretërisë së Suedisë, paraqitur në Gjykatë më 21 janar 2008.

Në vitin 2002, kur kërkuesja ishte katërmbëdhjetë vjeç, ajo zbuloi se njerku i saj kishte fshehur një videokamerë në shportën e rrobave në banjë. Kamera u drejtua në vendin ku kërkuesja ishte zhveshur përpara se të bënte dush. Ajo ia çoi nënës së saj, e cila e dogji filmin pa e parë askush. Incidenti u raportua në vitin 2004 kur nëna dëgjoi se edhe kushërira e kërkueses kishte përjetuar incidente me njerkun. Njerku u

ndoj penalisht dhe në vitin 2006 u dënua nga një gjykatë e rrethit për ngacmim seksual sipas Kapitullit 6, seksioni 7, i Kodit Penal, siç ishte i përcaktuar në kohën materiale. Megjithatë, dënimi i tij u anulua në apel pasi Gjykata e Apelit konstatoi se akti i tij nuk përfshihej në përkufizimin e veprës penale të ngacmimit seksual. Gjykata e Apelit vazhdoi të vërë në dukje se sjellja mund të kishte përbërë veprën e veçantë të tentativës për pornografi të fëmijëve, por nuk e shqyrtoi më tej çështjen në mungesë të ndonjë akuze. Gjykata e Lartë refuzoi apelimin.

Në një vendim të 21 qershorit 2012, një Dhomë e Gjykatës konstatoi, me katër vota për, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës. Kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 19 nëntor 2012.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesja u ankua se shteti suedez nuk kishte përmbushur detyrimin e tij sipas nenit 8 për t'i ofruar asaj mjete juridike kundër shkeljes së integritetit të saj personal nga njerku i saj, kur ai kishte tentuar fshehurazi ta filmonte atë lakuriq në banjën e tyre kur ajo ishte 14 vjeç. Ajo u mbështet gjithashtu në nenin 13 të Konventës.

Gjykata ritheksoi se, duke qenë e zonja e karakterizimit që duhet dhënë në ligj fakteve të një çështjeje (shih, për shembull, *Aksu kundër Turqisë* [DHM], nr. 4149/04 dhe 41029/04, paragrafi 43, GJEDNJ 2012), ajo konsideroi se ankesa e kërkueses kishte të bënte ekskluzivisht me mjetet juridike në dispozicion të saj kundër njerkut të saj, jo me ato të disponueshme kundër shtetit për të zbatuar thelbin e një të drejte ose lirie të Konventës në nivel kombëtar. Prandaj, Gjykata vendosi se ankesa duhet të shqyrtohej vetëm sipas nenit 8 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 8, Gjykata mbështeti gjetjet e gjykatave vendore që veprimi i njerkut përbënte shkelje të integritetit personal të kërkueses. Edhe pse ngjarja në fjalë nuk kishte përfshirë dhunë, abuzim apo kontakt fizik, ajo kishte ndikuar te kërkuesja në aspekte tepër intime të jetës së saj private. Nuk kishte prova që autoritetet vendore kishin dështuar të vepronin në pajtim me

detyrimin e tyre për të zhvilluar ndjekje penale efektive. Çështja para Gjykatës ishte pra, nëse, në rrethanat e rastit, Suedia kishte pasur një kornizë ligjore të mjaftueshme për të mbrojtur kërkuesen nga veprimet e njerikut të saj, në përputhje me detyrimet e saj sipas nenit 8. Dhoma e Madhe zgjodhi një qasje të ndryshme nga qasja e Dhomës, e cila kishte pohuar që “vetëm defektet domethënëse në legjislacion dhe në praktikë, dhe zbatimin e tyre, do të përbënin shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit sipas nenit 8”. Një test i tillë kaq domethënës në lidhje me defektet, edhe pse i kuptueshëm në kontekstin e hetimeve, nuk kishte rol kuptimplotë në vlerësimin e faktit nëse shteti i paditur kishte pasur një *kornizë ligjore të mjaftueshme* në përputhje me detyrimet e tij pozitive meqenëse çështja para Gjykatës kishte të bënte me pyetjen nëse ligji i kishte ofruar nivel të pranueshëm mbrojtjeje kërkueses në ato rrethana.

Për sa i përket mundësisë që akti i njerikut të mund të kishte përbërë pornografi të fëmijëve në tentative sipas Kodit Penal, Gjykata nuk u bind që akti ishte mbuluar nga ajo vepër. Nuk kishte informacione që prokurori kishte marrë në konsideratë ngritjen e akuzës kundër njerikut për atë krim. Përkundrazi, Qeveria e paditur kishte renditur disa arsye të mundshme përse prokurori mund të kishte vendosur që të mos vepronte në këtë mënyrë; në mënyrë të veçantë vështirësitë në mbledhjen e provave të mjaftueshme për të treguar që kishte pasur një pamje “pornografike”. Sipas kërkueses, edhe nëse filmi – i cili ishte shkatërruar – do të ekzistonte ende, materiali vështirë se do të ishte cilësuar si pornografik. Termi “pamje pornografike” nuk ishte i përkufizuar nga Kodi Penal i Suedisë dhe përgatitjet për dispozitën mbi pornografinë e fëmijëve theksuan se qëllimi i saj nuk ishte të penalizonin të gjitha fotot e fëmijëve lakuriq.

Për sa i përket dispozitës mbi veprën e ngacmimit seksual sipas Kodit Penal – i cili penalizonte në mënyrë të veçantë ekspozimin në mënyrë ofenduese dhe sjelljen e paturpshme përmes fjalëve ose veprimeve – Gjykata e Apelit kishte gjetur që njeriku nuk mund të mbahej penalisht përgjegjës për një akt të izoluar të filmimit të kërkueses pa dijeninë e saj. Sipas të drejtës suedeze në fuqi në atë kohë, kishte qenë kriter që, në mënyrë që të ekzistonte vepra e ngacmimit seksual, kryesi duhet të kishte pasur për qëllim që viktima ta kuptonte veprimin e tij, ose të ishte indiferent ndaj

rrizikut që viktima të mund ta kuptonte këtë. Megjithatë, ai kriter nuk ishte përmbushur në rastin e kërkueses. Njerku nuk ishte shpallur i pafajshëm për ngacmim seksual për shkak të mungesës së provave, por për shkak se, në atë kohë, akti i tij nuk kishte mundur të përbënte ngacmim seksual të përcaktuar me ligj. Dispozita mbi ngacmimin seksual, sipas tekstit të saj në kohën materiale, nuk do të kishte mundur ligjërisht ta mbulonte aktin në fjalë dhe kështu nuk e kishte mbrojtur dot parashtruesen nga mungesa e respektit për jetën e saj private.

Zbrazëtitë në mbrojtjen e të drejtave të saj nuk ishin zgjidhur nga ndonjë dispozitë tjetër e së drejtës penale në atë kohë. Në fakt, mungesa e një dispozite që mbulonte aktin e izoluar të filmimit apo fotografimit të fshehtë apo jokonsensual kishte qenë çështje shqetësimi për një kohë të gjatë në Suedi. Tani, kohët e fundit, ishte miratuar legjislacion i ri, i hartuar për të mbuluar një akt të tillë si ai në rastin e parashtrueses, dhe kishte hyrë në fuqi në vitin 2013.

Në rastin konkret, kërkimi i zgjidhjes në kuadër të së drejtës penale, sipas mendimit të Gjykatës, nuk ishte domosdoshmërisht e vetmja mënyrë se si shteti i paditur mund t'i kishte përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 8. Për sa i përket zgjidhjes së çështjes në kuadër të së drejtës civile, duke shpallur njerkun të pafajshëm, Gjykata e Apelit njëkohësisht kishte rrëzuar pretendimin civil të parashtrueses për dëmshpërblim. Sipas Kodit të Procedurës Gjyqësore, kur ndjekjes penale i bashkëngjitej një pretendim civil, gjetja e gjykatës në lidhje me çështjen e përgjegjësisë penale ishte detyruese për vendimin e pretendimit civil. Për më tepër, nuk kishte baza të tjera mbi të cilat kërkuesja mund të ishte mbështetur për të vërtetuar pretendimin e saj për dëmshpërblim. Së fundi, Gjykata nuk u bind që gjykatat suedeze mund t'i kishin caktuar asaj dëmshpërblim vetëm mbi bazën e gjetjes së një shkeljeje të Konventës.

Si përfundim, Gjykata nuk u bind që e drejta përkatëse suedeze, e cila ishte në fuqi në atë kohë, kishte siguruar mbrojtjen e së drejtës së kërkueses për respekt ndaj jetës së saj private në pajtim me detyrimet e shtetit sipas nenit 8. Akti i kryer nga njerku i saj kishte shkelur integritetin e saj dhe ishte rënduar nga fakti që ajo ishte e mitur, që incidenti kishte ndodhur në shtëpinë e saj, dhe që kryesi ishte një person nga i cili ajo normalisht duhet të priste dhe tek i cili ajo presupozohej të kishte besim.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8. Bazuar në nenin 41, Gjykata përcaktoi që shteti i paditur duhet t'i paguajë parashtrueses 10,000 (dhjetëmijë) euro për dëmet jomateriale.

2.3. Y. kundër SLOVENISË

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2241107/10%22%5D%7D>

GJEDNJ [Seksioni i Pestë]

28 maj 2015

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: dështimi për të mbrojtur integritetin personal të kërkuases në procedurat penale në lidhje me abuzimin seksual, procedura penale në lidhje me sulmet seksuale në kundërshtim me detyrimin pozitiv të shtetit të paditur për të ofruar mbrojtje ligjore efektive kundër abuzimit seksual, pasi ato ishin vonuar në mënyrë të paarsyeshme, mungesa e paanësisë, dhe ekspozimi ndaj përvojave traumatike duke shkelur integritetin personal, mungesë e një mjeti juridik efektiv siç kërkohet nga neni 13 i Konventës.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Y. (kërkuessa), një shtetase sllovene kundër Republikës së Sllovenisë, paraqitur në Gjykatë më 17 korrik 2010. Kryetari i Seksionit pranoi kërkesën e kërkuases për të mos zbuluar emrin e saj (Rregulli 47.4 i Rregullores së Gjykatës).

Në vitin 2001, në moshën 14-vjeçare, kërkuessa dyshohet se ishte viktimë e sulmeve të përsëritura seksuale nga një mik i familjes, X. Pas një ankese penale nga nëna e kërkuases, hetimet filluan në vitin 2003 dhe kundër X u iniciuan procedura penale në vitin 2007. Në vitin 2009, pasi mbajtën gjithsej 12 seanca, gjykatat vendase e shpallën të pafajshëm X nga të gjitha akuzat me arsyetimin se disa nga pretendimet e kërkuases në lidhje me kushtet fizike të X ishin hedhur poshtë nga një ekspert, duke e bërë kështu të pamundur, sipas mendimit të gjykatave

vendore, për të vërtetuar fajin e X përtej dyshimit të arsyeshëm. Ankesa e Prokurorit të Shtetit kundër atij aktgjykimi u refuzua në vitin 2010, sikurse edhe kërkesa e kërkueses drejtuar Prokurorit të Lartë të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë disa muaj më vonë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuësja u ankua sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës se procedura penale në lidhje me sulmet seksuale kundër saj kishte qenë në kundërshtim me detyrimin pozitiv të shtetit të paditur për të ofruar mbrojtje ligjore efektive kundër abuzimit seksual, pasi ajo ishte vonuar në mënyrë të paarsyeshme, i mungonte paanësia, dhe e kishte ekspozuar atë ndaj disa përvojave traumatike duke shkelur integritetin e saj personal. Për më tepër, kërkuësja pretendoi se nuk kishte pasur një mjet juridik efektiv në lidhje me ankesat e saj, siç kërkohet nga neni 13 i Konventës.

Duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e ankesave të kërkueses, Gjykata vlerësoi se vonesat dhe paragjykimet e pretenduara të gjykatave vendase duhet të shqyrtohen vetëm sipas nenit 3 të Konventës (shih *PM kundër Bullgarisë*, nr. 49669/07, paragrafi 58, 24 janar 2012),

Më tej, kërkuësja u ankua se shteti kishte dështuar në mbrojtjen e integritetit të saj personal gjatë procesit. Lidhur me këtë, ajo pohoi se eksperti i gjinekologjisë B. kishte tejkalluar detyrën e tij dhe në vend që t'i përgjigjej pyetjes së gjyqtarit hetues lidhur me probabilitetin e marrëdhënieve seksuale, ishte vendosur të zbulonte nëse ishte kryer vepër penale, duke i bërë kërkueses një sërë pyetjesh që e kishin vënë atë në pozitën që duhej të mbrohej kundër tij. Për më tepër, megjithëse parashtruesja ishte marrë në pyetje gjatë hetimit, më pas asaj iu desh të dëshmonte në katër seanca para Gjykatës së Rrethit Maribor, në të cilat i pandehuri ishte lejuar personalisht ta torturonte me pyetje të shumta provokuese dhe të përsëritura, pavarësisht faktit se ai ishte i përfaqësuar ligjërisht dhe ato pyetje mund të ishin bërë nga avokati i tij.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve për shkelje të nenit 8, Gjykata fillimisht shqyrtoi nëse shteti i paditur kishte ofruar mbrojtje të mjaftueshme

të së drejtës së kërkueses për respektimin e jetës së saj private, dhe veçanërisht për integritetin e saj personal, në lidhje me mënyrën, në të cilën ajo ishte marrë në pyetje gjatë procedurës kundër abuzuesit të saj të dyshuar për krim seksual. Duke vepruar kështu, Gjykata duhej të vendoste një ekuilibër të drejtë midis të drejtave të kërkueses si viktimë e thirrur për të dëshmuar në procedimin penal, të mbrojtura nga neni 8, dhe atyre të mbrojtjes, përkatësisht të drejtës së të akuzuarit për të thirrur dhe të marrë në pyetje dëshmitarët siç përcaktohet në nenin 6.3 (d). Ndryshe nga qëndrimi në rastet e tjera të ngjashme të shqyrtuara më parë nga Gjykata, të cilat të gjitha ishin sjellë nga personat e akuzuar, në rastin konkret Gjykata duhej ta shqyrtonte këtë çështje nga këndvështrimi i viktimës së pretenduar.

Në rastin konkret, interesat e sigurimit të një gjykimi të drejtë kërkonin që X-it t'i jepej një mundësi për të marrë në pyetje kërkuesen, veçanërisht pasi dëshmia e kërkueses në gjyq siguronte të vetmen provë të drejtpërdrejtë në çështje dhe provat e tjera të paraqitura ishin kontradiktore.

Megjithatë, duke pasur parasysh se procedurat penale në lidhje me veprat seksuale u perceptuan si një përvojë shumë e pakëndshme dhe e zgjatur nga viktima/kërkuesja, dhe se një konfrontim i drejtpërdrejtë midis të akuzuarve për abuzim seksual dhe viktimave të tyre të supozuara përfshinte rrezikun e traumatizimit të mëtejshëm për viktimat, ekzaminimi nga i pandehuri duhej t'i nënshtrohej vlerësimit më të kujdesshëm nga gjykatat kombëtare. Në të vërtetë, disa instrumente ndërkombëtare, duke përfshirë ligjet e Bashkimit Evropian, parashikojnë që viktimave të, ndër të tjera, abuzimit seksual, duhet t'u jepen të drejta të caktuara, duke përfshirë detyrën e shtetit për t'i mbrojtur ato nga frikësimi dhe viktimizimi i përsëritur kur japin dëshmi për abuzimin.

Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje se marrja në pyetje e kërkueses ishte shtrirë në katër seanca gjyqësore të mbajtura në shtatë muaj, një periudhë e gjatë e cila në vetvete ngriti shqetësime, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e ndonjë arsyeje të dukshme për intervalet e gjata ndërmjet seancave. Për më tepër, në dy nga ato seanca X e kishte marrë në pyetje personalisht kërkuesen, duke kontestuar vazhdimisht vërtetësinë e përgjigjeve të saj dhe duke iu drejtuar asaj me pyetje të

natyrës personale. Sipas mendimit të Gjykatës, këto pyetje synonin të sulmonin besueshmërinë e kërkueses, si dhe të degradonin karakterin e saj. Megjithatë, pavarësisht nga detyra e autoriteteve gjyqësore për të mbikëqyrur formën dhe përmbajtjen e pyetjeve dhe komenteve të X dhe, nëse ishte e nevojshme, për të ndërhyrë, ndërhyrja e kryetarit të trupit gjykues ka qenë e pamjaftueshme për të zbutur atë që ka qenë qartësisht një përvojë shqetësuese për kërkuesen.

Për sa i përket pretendimit të kërkueses se avokati i X duhet të ishte përjashtuar nga procedura pasi ai ishte konsultuar prej saj për sulmet seksuale pak pasi ndodhën ngjarjet e supozuara, Gjykata konstatoi se ligji vendor i zbatueshëm, ose mënyra në të cilën ai ishte aplikuar në rastin konkret, nuk kishte marrë parasysh mjaftueshëm interesat e kërkueses. Kjo ndodhi sepse efekti negativ psikologjik i marrjes në pyetje nga avokati i X kishte tejkaluar në mënyrë të konsiderueshme shqetësimin që do të kishte përjetuar kërkuesja nëse do të merrej në pyetje nga një avokat tjetër. Për më tepër, çdo informacion që ai mund të kishte marrë prej saj në cilësinë e tij si avokat duhet të ishte trajtuar si konfidencial dhe nuk duhet të ishte përdorur për të përfutur një person me interesa të kundërta në të njëjtën çështje.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje papërshtatshmërinë e pyetjeve të bëra ndaj kërkueses nga gjinekologu i caktuar nga gjykata e rrethit për të përcaktuar nëse ajo kishte kryer marrëdhënie seksuale në kohën materiale. Në këtë drejtim, autoriteteve iu kërkua të siguronin që të gjithë pjesëmarrësit në procedurë të thirrur për t'i ndihmuar ata në hetim ose në procesin e vendimmarrjes t'i trajtonin viktimat dhe dëshmitarët e tjerë me dinjitet dhe të mos u shkaktonin atyre shqetësime të panevojshme. Megjithatë, gjinekologut të emëruar jo vetëm që i mungonte trajnimi i duhur në kryerjen e intervistave me viktimat e abuzimit seksual, por gjithashtu i ishte drejtuar parashtrueses me pyetje dhe vërejtje akuzuese që tejkalonin qëllimin e detyrës së tij dhe të ekspertizës së tij mjekësore. Si pasojë, kërkuesja ishte vënë në një pozicion mbrojtës në mënyrë të panevojshme duke shtuar stresin e procedurës penale.

Edhe pse autoritetet vendore kishin marrë një sërë masash për të parandaluar traumatizimin e mëtejshëm të kërkueses, masat e tilla në

fund kishin rezultuar të pamjaftueshme për t'i ofruar asaj mbrojtjen e nevojshme për të vendosur një ekuilibër të duhur midis të drejtave dhe interesave të saj të mbrojtura nga neni 8 dhe të drejtave të mbrojtjes së X, të mbrojtura sipas nenit 6 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8, dhe shkelje të nenit 3 për shkak të dështimit të autoriteteve të shtetit të paditur për të siguruar hetim dhe ndjekje të shpejtë lidhur me ankesën e parashtrueses për abuzim seksual. Bazuar në nenin 41, Gjykata përcaktoi që shteti i paditur t'i paguajë parashtrueses 9,500 (nëntë mijë e pesëqind) euro për dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. BOSTON SCIENTIFIC MEDIZINTECHNIK GMBH kundër AOK SACHSEN-ANHALT – DIE GESUNDHEITSKASSE dhe BETRIEBSKRANKENKASSE RWE

GJDBE

çështjet e bashkuara C-503/13 dhe C-504/13

5 mars 2015

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=162686&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13610398>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Në këtë çështje, Gjykata vendosi prezumimin e përgjegjësisë faktike për produktet mjekësore defektoze që vendosen në trupin e njeriut dhe mund të cenojnë shëndetin ose integritetin e tij

Faktet kryesore

Direktiva mbi produktet me defekt⁴⁴ parashikon që prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga një defekt në produktin e tij.

Një kompani në Gjermani tregtonte stimulues kardiak, si dhe defibrilatorë automatikë të implantueshëm në trupin e njeriut. Kontrollat e mëvonshme të cilësisë të kryera nga kompania treguan se këto produkte mund të jenë defekte dhe të përbëjnë rrezik për shëndetin e pacientëve. Përballë kësaj situate, prodhuesi rekomandoi që mjekët të zëvendësonin stimuluesit e ritmit të implantuar në trupin e pacientëve me stimulues të tjerë kardiakë të vënë në dispozicion pa pagesë. Së bashku me këtë, prodhuesi rekomandoi që mjekët kurues të çaktivizonin një çelës të defibrilatorëve.

Kompanitë e sigurimit të personave të cilëve iu ndërrua stimuluesi kardiak ose defibrilatori, kërkuan rimbursimin e kostove që lidheshin me ndërhyrjet e rekomanduara nga prodhuesi i tyre.

Gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes midis siguruesve (Aok Sachsen-Anhalt – Die Gesundheitskasse dhe Betriebskrankenkasse Rwe) dhe kompanisë që tregton këto pajisje mjekësore (Boston Scientific Medizintechnik GmbH) dhe për të qenë në gjendje të zgjidhë mosmarrëveshjen në procedurën para saj, Bundesgerichtshof⁴⁵ pezulloi procedurën para saj dhe i parashtrori dy pyetje për një vendim paraprak (GJDBE):

1. a mund të mos konsiderohen të dëmtuar stimuluesit kardiakë dhe defibrilatorët automatikë që janë zëvendësuar dhe implantuar në trupin e të siguarve në fjalë, kur këto pajisje i përkasin një grupi produktesh që paraqesin rrezik dëmtimi dhe kur nuk janë gjetur defekte në pajisje, por vetëm një rrezik potencial dëmtimi?
2. nëse përgjigja e kësaj pyetjeje është po, atëherë a përbëjnë kostot e

44 Direktiva e Këshillit 85/374/EEC e 25 korrikut 1985 (OJ L 210, f. 29).

45 Gjykata Federale Gjermane.

heqjes së produktit dhe instalimit të një pajisjeje zëvendësuese dëm të shkaktuar nga lëndimi trupor?

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se, duke pasur parasysh funksionin e tyre dhe brishtësinë e pacientëve që i përdorin ato, pajisjet mjekësore në fjalë u nënshtrohen kërkesave veçanërisht të larta të sigurisë. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se mundësia e mungesës së sigurisë së këtyre produkteve, e cila përfshin përgjegjësinë e prodhuesit, qëndron në potencialin jonormal të dëmit që ato mund t'i shkaktojnë personit.

Në këto kushte, Gjykata vendos se konstatimi i një defekti të mundshëm në një pajisje mjekësore bën të mundur cilësimin si defektoz të të gjitha produkteve të të njëjtit model, pa qenë e nevojshme të tregohet defekti i produktit në çdo rast.

Për më tepër, Gjykata thekson se, në lidhje me zëvendësimin e stimuluesve kardiakë të kryer sipas rekomandimeve të vetë prodhuesit, kostot e lidhura me atë zëvendësim përbëjnë dëm për të cilin prodhuesi është përgjegjës sipas Direktivës.

Në lidhje me defibrilatorët automatikë të implantueshëm për të cilët prodhuesi ka rekomanduar vetëm çaktivizimin e një çelësi, Gjykata konstaton se i takon gjykatës gjermane të konstatojë nëse një çaktivizim i tillë është në gjendje të eliminojë defektin e produkteve ose nëse zëvendësimi i tyre është i nevojshëm për këtë qëllim.

Si përfundim, në lidhje me pyetjen e parë, GJDBE u shpreh se neni 6(1) i Direktivës 85/374/KEE duhet të interpretohet se kupton se gjetja e një defekti të mundshëm në produkte që i përkasin të njëjtit grup ose që i përkasin të njëjtës seri prodhimi, si p.sh. stimuluesit kardiak dhe defibrilatorët automatikë të implantueshëm bën që një produkt i tillë të cilësohet si i dëmtuar pa pasur nevojë të shënohet defekti në fjalë në këtë produkt.

Në lidhje me pyetjen e dytë, Gjykata u përgjigj se nenet 1 dhe 9, paragrafi 1, (a) i Direktivës 85/374 duhet të interpretohen ashtu që

dëmi i shkaktuar nga një operacion kirurgjik për të zëvendësuar një produkt me defekt, si një stimulues kardiak ose një defibrilator kardiak i implantueshëm, përbën “dëm të shkaktuar nga vdekja ose lëndimi trupor”, për të cilin prodhuesi është përgjegjës, kur ky operacion është i nevojshëm për të eliminuar defektin e produktit në fjalë.

Neni 27

Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës

Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI127/18. PARASHTRUES: TUSH KOLËGJERAJ

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/10/ki_127_18_av_shq.pdf]

21 tetor 2019

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Kërkesa kishte të bënte me një dënim me gjobë, i cili për shkak të mospagesës ishte zëvendësuar me dënim me burgim, të cilin gjykatat ia kishin shqiptuar parashtruesit të kërkesës për shkak të fyerjes së gjykatës dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Çështja kyçe ishte se a i kishin shkelur parashtruesit të kërkesës vendimet gjyqësore disa të drejta kushtetuese, duke përfshirë ndalimin e torturës, trajtimin mizor, çnjerëzor ose poshtërues.*

Faktet kryesore

Më 29 shtator 2014, ishte nxjerrë Urdhri përmbarrimor kundër parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij, sipas propozimit të N.P. Kompania Regjionale për Ujitje “Radoniqi-Dukagjini,” për shkak të detyrimeve të papaguara në lidhje me furnizimin me ujë. Më 31 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Prizren kundër urdhrin të përmbarruesit privat. Më 20 shkurt 2015, Gjykata Themelore në Prizren e kishte hedhur poshtë prapësimin e parashtruesit të kërkesës për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore. Pas këtij vendimi, në bazë të kërkesës së të vëllait të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur dy herë lidhur me këtë rast, duke shpallur dy kërkesat përkatëse si të papranueshme. Më 8 prill 2015, Gjykata Themelore në Prizren kishte nxjerrë aktvendimin me të cilin e kishte dënuar parashtruesin e kërkesës me gjobë në të holla, për shkak të fyerjes së gjykatës dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Gjykata Themelore kishte përcaktuar që gjoba në të holla mund të ndryshohej në dënim me burgim nëse nuk do paguhej brenda një afati

të caktuar. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit e cila e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Më 27 qershor 2017, Gjykata Themelore në Prizren kishte nxjerrë një aktvendim tjetër, me të cilin dënimin me gjobë në të holla e kishte ndryshuar në dënim me burgim (për shkak të mospagesës së dënimit me gjobë). Me 11 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës ishte dërguar në qendrën e paraburgimit në Prizren me qëllim të vuajtjes së dënimit me burgim. Me 14 korrik 2017, Gjykata Themelore në Prizren kishte nxjerrë aktvendimin me të cilin kishte anuluar aktvendimin e mëparshëm, duke qenë se ishte shlyer dënimi me gjobë në të holla. Më 27 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore. Më 23 gusht 2017, Gjykata Themelore në Prizren kishte nxjerrë aktvendim me të cilin kishte hedhur poshtë si të palejuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore kishte arsyetuar se sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mund ta paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij dhe gjyqtari i procedurës paraprake dhe se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës themelore me aktvendim hedh kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nëse kërkesa është paraqitur nga personi i paautorizuar. Sipas Gjykatës Themelore, në rrethanat e rastit konkret, gjoba në të holla kishte qenë e shqiptuar në procedurën përmbarimore për shkak të fyerjes së gjyqtarit dhe kreditorit, e cila gjobë, për shkak të mospagimit brenda afatit, ishte zëvendësuar me dënim me burgim, që nënkupton se gjatë kësaj procedure i njëjti nuk ishte në cilësinë e të pandehurit në procedurë. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore (të 23 gushtit 2017), duke kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të sanksionit penal. Më 10 tetor 2017, Gjykata e Apelit kishte nxjerrë Aktvendimin AC. nr. 825/17, me të cilin kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetim se i dënuari (parashtruesi i kërkesës), si kërkesën ashtu edhe ankesën e tij e ka bazuar në faktin se i njëjti ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, por fakti që personi i dënuar ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme nuk përbën bazë për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit. Më 31 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimin e kontestuar atij i ishin shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24, 27 dhe 29 të Kushtetutës. Në kërkesën e tij, parashtruesi nuk argumentonte se si kishte ardhur deri te shkeljet e pretenduara, duke përfshirë këtu edhe shkeljen e pretenduar të nenit 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues]. Parashtruesi i kërkesës e kishte formuluar kërkesën e tij në formë të pyetjeve të parashtruara Gjykatës Kushtetuese, duke pyetur Gjykatën nëse vendimet e kontestuar ishin në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet përkatëse.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese konstatoi që parashtruesi i kërkesës aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, PN. br. 825/17, të 6 tetorit 2017 e kishte pranuar më 17 tetor 2017, ndërsa kërkesën e tij e kishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 31 gusht 2018. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte dorëzuar pas afatit ligjor prej katër (4) muajsh i cili është i përcaktuar me Ligj dhe me Rregullore të Punës të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit për shkelje të të drejtave kushtetuese (duke përfshirë edhe shkeljet e pretenduara të nenit 27).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës vendosi njëzëri që të shpallë kërkesën të papranueshme si të paafatshme.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. EL-MASRI kundër “ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË”

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2239630/09%22%5D%22%7D>
GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

13 dhjetor 2012

Çështja kyçel e drejta e pretenduar: ekstradimi dhe ushtrimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues gjatë dhe pas dorëzimit të jashtëzakonshëm të kërkuesit nga autoritetet maqedonase në CIA; pretendime për trajtim degradues, trajtimi çnjerëzor, torturë, dhe mungesë të hetimit efektiv.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Khaled El-Masri, një shtetas gjerman (kërkuesi), i cili pretendoi se më 31 dhjetor 2003 gjatë udhëtimit të tij me autobus për në Shkup u ndalua në kufirin maqedonas për shkak të dyshimit për vlefshmërinë e pasaportës së tij. Ai u mor në pyetje nga autoritetet maqedonase për lidhje të mundshme me disa organizata dhe grupe islamike. Më vonë ai u dërgua në një dhomë hoteli në Shkup ku u mbajt për njëzet e tre ditë. Gjatë ndalimit të tij, ai është vëzhguar gjatë gjithë kohës dhe është marrë në pyetje në mënyrë të përsëritur. Kërkesat e tij për të kontaktuar ambasadën gjermane u refuzuan. Në një rast, kur ka deklaruar se do të largohej, i është drejtuar një armë në kokë dhe është kërcënuar. Në ditën e trembëdhjetë të izolimit, kërkuesi filloi një grevë urie për të protestuar kundër ndalimit të tij të vazhdueshëm. Më 23 janar 2004, i lidhur me pranga dhe sy të lidhur, ai u fut në një makinë dhe u dërgua në Aeroportin e Shkupit. Atje ai u vendos në një dhomë, u rrah rëndë nga disa burra të maskuar, u zhvesh dhe u sodomizua me një objekt. Më pas, i prangosur dhe i mbuluar me kapuç, dhe i nënshtruar

një privimi total shqisor, ai u detyrua me forcë në një avion të CIA-s, i cili u rrethua nga agjentë të sigurimit maqedonas, të cilët formuan një kordon rreth aeroplanit. Kur ishte në aeroplan, kërkuesi u hodh në dysHEME, u lidh me zinxhirë dhe u qetësua me forcë. Në atë pozicion, kërkuesi u dërgua në Kabul (Afganistan), ku u mbajt i burgosur për pesë muaj.

Më 29 maj 2004 kërkuesi u kthye në Gjermani nëpërmjet Shqipërisë. Në tetor 2008, kërkuesi bëri një kallëzim penal për rrëmbim dhe ushtrim torture ndaj tij nga persona me funksione zyrtare por të pidentifikuar. Ai bëri gjithashtu një padi civile për shpërblim dëmi në lidhje me të njëjtat rrethana. Kallëzimi i tij penal u hodh poshtë nga prokuroria si i pabazuar ndërsa procesi civil, pas rreth gjashtëmbëdhjetë seancash dhe shumë shtyrjesh ishte ende në gjykim në gjykatën e shkallës së parë në Shkup.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendonte se ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka qenë përgjegjëse për keqtrajtimin të cilit ai i ishte nënshtruar në kundërshtim me nenet 3, 5, 8, 10 dhe 13 të KEDNJ-së. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjes në këndvështrimin e Konventës, një Dhomë e Gjykatës hoqi dorë nga juridiksioni i saj duke ia kaluar drejtpërdrejt çështjen Dhomës së Madhe, në përputhje me nenin 30 të Konventës. Qeveria maqedonase mohoi çdo përgjegjësi për keqtrajtimin e kërkuesit dhe kundërshtoi besueshmërinë e raporteve të ekspertëve mbi shëndetin e tij mendor. Qeveria më tej pohoi se, edhe pse hetimi penal mbi pretendimet e kërkuesit kishte qenë jo-efektiv, kjo i atribuohet vonesës së kërkuesit në paraqitjen e ankesës së tij dhe faktit se ai ishte ankuar ndaj autorëve të pidentifikuar. Nga ana tjetër, ajo pretendoi se kërkuesi ishte ankuar përtej afatit prej 6 muajsh të parashikuar nga neni 35 paragrafi 1 i Konventës.

Gjykata vlerësoi së pari se kallëzimi penal ishte një mjet për t'u shteruar për qëllimet e nenit 35 paragrafi 1 të Konventës, dhe theksoi se afati gjashtë mujor fillon të ecë jo nga data kur prokurori ka marrë vendim për pushimin e çështjes, por nga data kur kërkuesi ka marrë dijeni për këtë vendim.

Disa nga palët e treta në procedurë argumentuan se e drejta për të vërtetën në rastet e zhdukjeve me forcë të personave është e mishëruar në KEDNJ, si pjesë e neneve 2, 3 dhe 5, dhe sidomos 13. Për më tepër, ato argumentuan se taktikat e ndalimeve të jashtëzakonshme, si ato për të cilat ankohej kërkuesi, përbënin shkelje të parimit të moskthimit (non-refoulement) sipas së drejtës ndërkombëtare. Në lidhje me përcaktimin e fakteve dhe vlerësimin e provave, Gjykata konstatoi se palët nuk binin dakord për versionin e fakteve, dhe se në mungesë të konstatimeve zyrtare në nivel nacional, Gjykata theksoi se do ta bënte vetë përcaktimin e fakteve të çështjes. Ajo theksoi se, megjithëse në këtë rol standardi i zbatueshëm ishte ai i provave “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, roli i saj specifik juridiksional në kuadër të nenit 19 të Konventës dhe procedurat në bazë të kësaj të fundit jo në çdo rast kushtëzohen nga parimi *affirmanti incumbit probatio*. Jurisprudenca e saj në bazë të neneve 2 dhe 3, por edhe të nenit 5, kur një person humb jetën, keqtrajtohet, ose mbahet në rrethana për të cilat autoritetet janë ose duhet të jenë në dijeni ose në vende nën kontrollin e autoriteteve atëherë barra e provës mund t’iu kalojë autoriteteve.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për shkelje të nenit 3(a) në aspektin procedural, Gjykata theksoi se me paraqitjen e kallëzimit penal, kërkuesi kishte sjellë në vëmendjen e prokurorit publik pretendimet e tij se agjentët e shtetit e kishin keqtrajtuar dhe ishin përfshirë në mënyrë aktive në dorëzimin (rendition) e tij të mëvonshëm nga agjentët e CIA-s. Ankesat e tij ishin mbështetur nga provat që kishin dalë në dritë gjatë rrjedhës së hetimeve ndërkombëtare dhe të huaja. Respektivisht, Gjykata theksoi se kërkuesi kishte paraqitur rrethanat faktike të një rasti *prima facie* të sjelljes së pahijshme nga ana e forcave të sigurisë të shtetit të paditur. Megjithatë, pothuajse dy muaj e gjysmë më vonë, prokurori publik e kishte refuzuar ankesën për mungesë provash. Përveçse kishte kërkuar informacion nga Ministria e Brendshme, ajo nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesit. Për më tepër, megjithëse pretendimet e kërkuesit në lidhje me kohën dhe mënyrën e transferimit të tij në Afganistan kishin qenë jashtëzakonisht në përputhje me rrjedhën aktuale të avionit në fjalë, hetuesit kishin mbetur pasivë dhe nuk e kishin ndjekur atë pistë të

hetimit, duke konsideruar përkundrazi se nuk ishte e nevojshme për masa të tjera hetimore. Duke pasur parasysh provat e konsiderueshme, e të disponueshme kur kërkuesi parashtrij ankesën e tij, një përfundim i tillë ishte i pamjaftueshëm nga ajo që mund të pritej nga një autoritet i pavarur.

Një aspekt tjetër i karakterit joadekuat të hetimit ishte ndikimi i mos hetimit në të drejtën e kërkuesit për të hetuar të vërtetën lidhur me rrethanat përkatëse të rastit. Çështja kishte një rëndësi të madhe jo vetëm për kërkuesin dhe familjen e tij, por edhe për viktimat e tjera të krimeve të ngjashme dhe për publikun e gjerë, i cili kishte të drejtë të dinte se çfarë kishte ndodhur. Çështja e «dorëzimit të jashtëzakonshëm»⁴⁶ kishte tërhequr vëmendjen mbarëbotërore dhe kishte shkaktuar inicimin e hetimeve nga shumë organizata ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, duke përfshirë organet e OKB-së për të drejtat e njeriut, Këshillin e Evropës dhe Parlamentin Evropian. Koncepti i “sekreteve shtetërore” shpesh është përdorur për të penguar kërkimin e së vërtetës. Privilegji i “sekretit shtetëror” ishte pohuar gjithashtu nga Qeveria e SHBA-së në çështjen e kërkuesit para gjykatave amerikane. Gjykata theksoi se, pavarësisht kompleksitetit të pamohueshëm të rrethanave që lidhen me çështjen në fjalë, shteti i paditur është dashur të përpiqej të ndërmerre një hetim adekuat për të parandaluar çdo shfaqje mosndëshkimi në lidhje me akte të caktuara. Prandaj, hetimi i përmbledhur që ishte kryer në këtë rast nuk mund të konsiderohej si efektiv. Përfundim: shkelje (njëzëri).

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesit për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 3 (b) - në aspektin përmbajtjesor gjykata konsideroi se sa i përket (i) trajtimit në hotel – kërkuesi kishte jetuar në mënyrë të pamohueshme në një gjendje ankthi të përhershëm për shkak të pasigurisë së tij për fatin e tij gjatë seancave të marrjes në pyetje të cilave ai i ishte nënshtruar. Për më tepër, një trajtim i tillë ishte bërë qëllimisht me qëllim të nxjerrjes së një pranimit të fajësisë ose informacioni për lidhjet e tij të dyshuara me organizatat terroriste.

⁴⁶ Teknika “extrordinary renditioni” (dorëzim i jashtëzakonshëm) ka filluar të përdoret si teknike sistematike nga viti 1999 ndaj personave të dyshuar për terrorizëm.

Vuajtjet e kërkuesit ishin shtuar edhe nga natyra e fshehtë e operacionit dhe nga fakti që ai ishte mbajtur i pa komunikuar për njëzet e tre ditë në një hotel, një vend i jashtëzakonshëm ndalimi jashtë çdo kuadri gjyqësor. Prandaj, trajtimi të cilit i ishte nënshtruar kërkuesi gjatë kohës sa ishte në hotel, rezultonte në trajtim çnjerëzor dhe degradues. Përfundim: shkelje (njëzëri).

Sa i përket (ii) trajtimit në aeroport – Gjykata ritheksoi se për të njëjtin model të trajtimit të aplikuar ndaj kërkuesit në rrethana të ngjashme, Gjykata tashmë kishte konstatuar se ishte në kundërshtim me nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar të OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike. Edhe pse kërkuesi kishte qenë në duart e ekipit të posaçëm të dorëzimit të CIA-s, aktet në fjalë ishin kryer në prani të zyrtarëve të shtetit të paditur dhe brenda juridiksionit të tij. Rrjedhimisht, shteti i paditur duhej të konsiderohej si përgjegjës sipas Konventës për veprimet e kryera nga zyrtarë të huaj në territorin e tij me miratimin ose pajtimin e autoriteteve të tij. Kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë kërcënim për rrëmbyesit e tij. Kështu, forca fizike e përdorur ndaj tij në aeroport ka qenë e tepruar dhe e pajustificuar në rrethanat e krijuara. Masat ishin përdorur në kombinim dhe me paramendim, me qëllim që të shkaktonin dhimbje ose vuajtje të forta për të marrë informacion, për të shkaktuar dënimin ose për të frikësuar kërkuesin. Një trajtim i tillë përbënte torturë. Si rrjedhojë, shteti i paditur duhet të konsiderohet drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljen e të drejtave të kërkuesit sipas aspektit të nenit 3(b), pasi agjentët e tij e kishin lehtësuar në mënyrë aktive trajtimin dhe nuk kishin marrë asnjë hap të nevojshëm për ta parandaluar atë që të ndodhte.

Sa i përket (iii) transferimit të kërkuesit, Gjykata theksoi se nuk kishte asnjë provë që transferimi i tij në paraburgim të agjentëve të CIA-s kishte qenë në përputhje me një kërkesë legjitime për ekstradimin e tij ose ndonjë procedurë tjetër ligjore të njohur në të drejtën ndërkombëtare për transferimin e një të burgosuri tek autoritetet e huaja. As nuk ishte treguar të kishte ekzistuar ndonjë urdhër-arresti në atë kohë që autorizonte dorëzimin e kërkuesit në duart e agjentëve amerikanë. Më tej, provat sugjeruan se autoritetet maqedonase kishin dijeni për destinacionin në të cilin kërkuesi do të fluturonte nga Aeroporti i Shkupit. Ata ishin gjithashtu të vetëdijshëm ose duhet të ishin të vetëdijshëm se ekzistonte një rrezik real që kërkuesi do t'i nënshtrohej një trajtimi

në kundërshtim me nenin 3, pasi në atë kohë ishin publikuar raporte të ndryshme në lidhje me praktikat e përdorura ose të toleruara nga autoritetet amerikane, qartazi në kundërshtim me parimet e Konventës. Së fundi, shteti i paditur nuk kishte kërkuar asnjë garanci nga autoritetet amerikane për të shmangur rrezikun e keqtrajtimit të kërkuarit. Prandaj, duke pasur parasysh mënyrën në të cilën kërkuari ishte transferuar nën kujdestarinë e autoriteteve amerikane, Gjykata vlerësoi se ai i ishte nënshtruar “dorëzimit të jashtëzakonshëm”, domethënë një transferimi jashtëgjyqësor të personave nga një juridiksion ose Shtet në një tjetër, për qëllime të ndalimit dhe marrjes në pyetje jashtë sistemit normal ligjor, ku ekzistonte një rrezik real torture ose trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuarit për shkelje të nenit 5 (a) në aspektin përmbajtësor, Gjykata theksoi se në lidhje me (i) paraburgimin në Shkup, mbajtja e kërkuarit në hotel nuk ishte autorizuar nga një gjykatë ose nuk ishte vërtetuar nga ndonjë procesverbal ndalimi. Kërkuari nuk kishte pasur qasje të një avokat, dhe nuk i ishte lejuar të kontaktonte me familjen e tij, ose me një përfaqësues të Ambasadës Gjermane dhe atij i ishte hequr çdo mundësi për t’u sjellë para një gjykate për të kontestuar ligjshmërinë e ndalimit të tij. Ishte krejtësisht e papranueshme që në një shtet që i nënshtrohet sundimit të ligjit, një person mund t’i hiqet liria në një vend të jashtëzakonshëm paraburgimi, jashtë çdo mbikëqyrje gjyqësore. Ndalimi i papranuar dhe i pakomunikuar i kërkuarit në një vend kaq të pazakontë si një hotel, kishte shtuar arbitraretin e privimit të lirisë. Kjo përbënte një shkelje veçanërisht të rëndë të së drejtës së tij për liri dhe siguri.

Sa i përket (ii) paraburgimit të mëvonshëm, në rastin në fjalë, kërkuari i ishte nënshtruar “dorëzimit të jashtëzakonshëm”, i cili përfshinte paraburgim jashtë sistemit normal ligjor dhe i cili, me anashkalimin e qëllimshëm të procesit të rregullt ligjor, ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit dhe vlerat e mbrojtura nga Konventa. Për më tepër, ndalimi i të dyshuarve për terrorizëm në kuadër të programit «extraordinary rendition» të drejtuar nga autoritetet amerikane tashmë ishte konstatuar se ishte arbitrar në raste të tjera të ngjashme. Në rrethana të tilla, duhet të ishte e qartë për autoritetet maqedonase se, pasi iu dorëzua autoriteteve amerikane, kërkuari ishte përballur me një

rrezik real të shkeljes flagrante të të drejtave të tij sipas nenit 5. Autoritetet maqedonase jo vetëm që nuk arritën të përmbushnin detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur kërkuesin nga ndalimi në kundërshtim me këtë dispozitë, ata gjithashtu kishin lehtësuar në mënyrë aktive ndalimin e tij të mëvonshëm në Afganistan duke ia dorëzuar CIA-s, pavarësisht faktit se ata kishin qenë në dijeni ose duhej të kenë qenë të vetëdijshëm për rrezikun e atij transferimi. Duke pasur parasysh sa më sipër, rrëmbimi dhe ndalimi i kërkuesit ishte “zhdukje me forcë” siç përcaktohet në të drejtën ndërkombëtare. Qeveria e paditur do të mbahej përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të kërkuesit sipas nenit 5 të Konventës gjatë gjithë periudhës së robërisë së tij.

Sa i përket (b) aspektit procedural, Gjykata kishte gjetur tashmë sipas nenit 3 se shteti i paditur nuk kishte kryer një hetim efektiv mbi pretendimet e kërkuesit për keqtrajtim. Për të njëjtat arsye, Gjykata vërejti se në rastin e kërkuesit nuk ishte kryer asnjë hetim kuptimplotë për pretendimet e besueshme të kërkuesit se ai ishte arrestuar në mënyrë arbitrare.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 3 për shkak të dështimit të shtetit të paditur për të kryer një hetim efektiv mbi pretendimet e kërkuesit për keqtrajtim, për shkak të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues të cilit iu nënshtrua kërkuesi gjatë qëndrimit në hotelin në Shkup; se shteti i paditur është përgjegjës për keqtrajtimin të cilit i është nënshtruar kërkuesi në Aeroportin e Shkupit, për shkak të përgjegjësisë së shtetit të paditur në lidhje me transferimin e kërkuesit nën ndalimin nga ana e autoriteteve amerikane. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 5, për shkak se ndalimi i kërkuesit në hotel për njëzet e tre ditë ishte arbitrar, për robërinë e mëvonshme të kërkuesit në Afganistan; se shteti i paditur dështoi të kryejë një hetim efektiv mbi pretendimet e kërkuesit për ndalim arbitrar. Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës; shkelje të nenit 13 të Konventës për shkak të mungesës së mjeteve juridike efektive në lidhje me ankesat e kërkuesit sipas neneve 3, 5 dhe 8 të Konventës. Gjykata vendosi që a) që shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve, 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) euro, si dhe çdo taksë që mund të jetë e nevojshme të paguhet.

2.2. SOERING kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2214038/88%22%5D%7D>

GJEDNJ[Dhoma e Madhe]

7 korrik 1989

Çështja kyçele drejta e pretenduar: pretendime për shkelje të detyrimit për parandalim të torturës dhe trajtimin çnjerëzor në rast të lejimit të ekstradimit të një personi në Shtetet e Bashkuara, ku mund të dënohet me vdekje dhe të detyrohet të presë në “rreshtin e vdekjes” përpara ekzekutimit; shkelje e së drejtës në gjykim të drejtë si pasojë e mungesës së ndihmës juridike falas; dhe mostrajtim i duhur i rastit; si dhe pretendime për mungesë të mjeteve efektive juridike.

Faktet e rastit

Kërkesa është ngritur nga Jen Soering, shtetas gjerman (kërkuesi), i lindur më 1 gusht 1966. Kërkuesi ishte zhvendosur në Shtetet e Bashkuara me prindërit e tij në moshën 11 vjeçare. Nga muaji prill i vitit 1986 mbahej në gjendje arresti në Mbretërinë e Bashkuar, në pritje të ekstradimit për në Shtetet e Bashkuara, ku do të gjykohej për vrasje në shtetin e Virxhinias. Ai dyshohej se më 30 mars 1989, në moshën 18 vjeçare, kishte vrarë prindërit e të dashurës së tij në Bedford County të shtetit të Virxhinias.

Në gusht të vitit 1986, Shtetet e Bashkuara kërkuan ekstradimin e kërkuesit mbi bazën e Traktatit të Ekstradimit të vitit 1972 ndërmjet SHBA-ve dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në tetor 1986, Ambasada Britanike u paraqiti një kërkesë Shteteve të Bashkuara, ku kërkonte sigurime se në rast se kërkuesi ekstradohej dhe dënohej për krimet, ai nuk do të dënohej me vdekje ose dënimi me vdekje nuk do të zbatohet. Në mars të vitit 1987, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, gjithashtu, i kërkoi Mbretërisë së Bashkuar ekstradimin e kërkuesit për ta gjykuar në lidhje me vrasjet e pretenduara. Këtë e bëri mbi bazën e shtetësisë së kërkuesit dhe mbështetur në Traktatin e Ekstradimit të vitit 1872 ndërmjet Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në maj

1987, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e njoftoi Republikën Federale të Gjermanisë se ka arritur në përfundimin se duhet të vazhdojë të shqyrtojë kërkesën e Shteteve të Bashkuara për ekstradimin e kërkuesit dhe se kishte marrë sigurime nga Prokurori i Bedford County se nuk kishte për qëllim të kërkonte dënimin me vdekje.

Në qershor 1987, procedura e ekstradimit u zhvillua në Gjykatën e Magjistratëve në Bow Street. Në këtë rast, kërkuesi i paraqiti gjykatës një raport psikiatrik që theksonte se në kohën kur ishte kryer krimi ai vuante nga një çrregullim psikik, gjë e cila e lironte atë nga përgjegjësia. Përkundër kësaj, Gjykata e Magjistratëve gjeti se kishte prova të mjaftueshme për ta ekstraduar atë në Shtetet e Bashkuara dhe se kërkuesi duhej të priste urdhrin e Sekretarit Britanik të Shtetit për ta ekstraduar atë. Një kërkesë e mëpasshme për rigjykim të çështjes ishte refuzuar. Pretendimet e kërkuesit ishin se sigurimet e ofruara nga SHBA-të ishin aq të padobishme sa asnjë Sekretar Shteti i arsyeshem nuk do t'i konsideronte si të kënaqshme ose të mjaftueshme sipas Nenit IV të Traktatit për Ekstradim. Më 3 gusht 1998, Sekretari i Shtetit nënshkroi urdhrin që kërkuesi t'i dorëzohej autoriteteve të Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, si rezultat i ankesës së paraqitur në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe masave të përkohshme mbrojtëse, fillimisht të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe më pas të Gjykatës, deri në datën e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkuesi nuk ishte transferuar në Shtetet e Bashkuara. Në anën tjetër, Ligji i aplikueshem në shtetin e Virxhinias e njeh dënimin me vdekje, dhe personat të cilët marrin një dënim të tillë duhet të presin në të ashtuquajturin “radha ose korridori i vdekjes (death row)”. Koha mesatare që një i burgosur kalon përpara ekzekutimit është gjashtë deri në tetë vjet. Vonesat kryesisht rrjedhin si rezultat i kundërpasive të të dënuarve si në gjykatat shtetërore, ashtu dhe në ato federale. Mjeti i përdorur i ekzekutimit është goditja me energji elektrike.

Përveç Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar kundër të cilës ishte paraqitur rasti, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, gjithashtu, ishte përfaqësuar. Pretendimi i Qeverisë Gjermane mbështetej në nenin 48 (b) të Konventës, që i jep të drejtën shtetit të mbrojë përpara Gjykatës shtetasin e tij, i cili pretendohet të jetë viktimë e shkeljes së Konventës.

Përmbledhje e pretendimeve

Kërkuesi pretendon se vendimi i Sekretarit Britanik të Shtetit që të transferojë atë pranë autoriteteve të Shteteve të Bashkuara, po të zbatohet, do të përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës, që thekson se “askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”. Andaj çështja e parë e shqyrtuar kishte të bënte me atë nëse ekstradimi nga një shtet palë i Konventës te një palë e tretë mund të krijojë përgjegjësinë e këtij shteti në bazë të nenit 3, për shkak të keqtrajtimit që personi i ekstraduar mund të vuajë në shtetin ku ekstradohet. Përveç pyetjes nëse kishte rrezik real që kërkuesi të dënohej me dënim me vdekje në Virxhinia, çështja kyçe, që do të pasonte këtë dënim, kishte të bënte me fenomenin e korridorit të vdekjes. Për dallim nga kërkuesi dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nuk konsideronte se rreziku i dënimit me vdekje përmbante një shkallë të mjaftueshme të mundësisë për të vënë në zbatim nenin 3 të Konventës. Kërkuesi, gjithashtu, kishte ngritur pretendime në bazë të nenit 6 të Konventës. Sipas tij, mungesa e ndihmës ligjore falas në Virxhinia për të financuar kundërpaditë para gjykatave federale, do t’jua pamundësonte përfaqësimin ligjor siç kërkohet në nenin 6 (3c). Së fundmi, kërkuesi kishte pretenduar shkelje të nenit 13, pasi, sipas tij, nuk kishte mjete efektive juridike në lidhje me pretendimin e tij që kishte të bënte me nenin 3 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ka bërë të qartë në këtë rast se KEDNJ nuk rregullon sjelljet e shteteve të cilat nuk janë palë e Konventës dhe as nuk përmban detyrime për shtetet palë që t’ua imponojnë standardet e Konventës shteteve të tjera. Gjithashtu, Gjykata vërejtë se ekstradimi si mjet për të parandaluar shmangien nga drejtësia nuk mund të shpërfillet dhe se Konventa nuk përmban një të drejtë që parandalon ekstradimin. Në anën tjetër, Gjykata thekson se ndalesa absolute e torturës dhe e dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese tregon se neni 3 i Konventës paraqet një rën prej vlerave më themelore të një shoqërie demokratike. Në parim, Gjykata ka vlerësuar se institucionet e Konventës nuk shprehen në lidhje me ekzistencën e shkeljeve të mundshme të Konventës. Megjithatë, në rastin konkret në kuptim të

mbrojtjeve të nenit 3, Gjykata ka vlerësuar se ekstradimi i një personi të arrestuar nga një shtet palë mund të ngrejë përgjegjësinë e këtij shteti në bazë të Konventës, në rast se ka bazë thelbësore për të besuar se personi i ekstraduar do të ishte në rrezik që të i nënshtrohej torturës ose do të përballej me një rrezik të vërtetë për t'u trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese në shtetin pritës. Kësisoj, vendimi i një shteti palë për të ekstraduar mund të ngrejë çështje që lidhen me nenin 3 të Konventës.

Në vijim të këtij përcaktimi dhe pasi Gjykata gjeti se kishte arsye thelbësore për të besuar se nëse kërkuesi do ekstradohej në Shtetet e Bashkuara, mund të dënohej me vdekje dhe, si pasojë e këtij dënimi, do të ekspozohej ndaj “fenomenit të rreshtit të vdekjes”, ajo pranoi se ky fenomen paraqiste burim të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtërues. Tutje Gjykata sqaroi se, në pajtim me praktikën e saj gjyqësore, trajtimi ose ndëshkimi duhet të jetë i një shkalle minimale të ashpërsisë për të hyrë në kuadër të nenit 3 të Konventës. Në mënyrë që një ndëshkim ose trajtim të jetë “çnjerëzor” ose “poshtërues”, vuajtja ose poshtërimi në cilëndo rrethanë duhet të shkojë përtej ndëshkimit apo trajtimit të lidhur me një formë të ndëshkimit legjitim. Në shqyrtim të rrethanave të veçanta të rastit Gjykata vëren se një i burgosur i dënuar duhet të kalojë vite të tëra jetese në ankth dhe tensioni në rritje për shkak të procedurave komplekse të aplikueshme pas-dënimit në shtetin Virxhinia. Së dyti, vlerësimi i kushteve të mbajtjes në regjimin e posaçëm të “rreshtit ose korridorit të vdekjes” gjithashtu janë faktor që vlerësohen dhe bien në kuadrin e nenit 3 të Konventës. Së treti, moshë e re e kërkuesit në kohën e kryerjes së veprës dhe gjendja e tij mendore në atë kohë janë faktorë shtesë që kërkojnë trajtimin e çështjes në kuadër të përmbajtjes së garancive të nenit 3. Së fundmi, ishte ekzistenca e mundësisë së ekstradimit të kërkuesit në Gjermani, që do të mundësonte shmangien e rrezikut të mosndëshkimit të një kriminelit të arratisur ashtu dhe rrezikun e vuajtjes intensive në mbajtjen gjate pritjes për ekzekutim në “radhë të vdekjes”. Në përfundim, Gjykata përcaktoi se vendimi i Sekretarit të Shtetit për të ekstraduar kërkuesin, po që se do të zbatohet, do të përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shkelje të nenit 6 të Konventës, për atë se në shtetin e Virxhinias mungonte ndihma juridike falas për të financuar apelimet e ndryshme në gjykatat federale, Gjykata gjeti se faktet e rastit konkret nuk shpërfaqin një rrezik të mohimit flagrant të së drejtës për

grykim të drejtë andaj ky pretendim nuk ngrit çështje të ndarë bazuar në nenin 6 paragrafi 3 të Konventës. Ndërsa lidhur me pretendimet bazuar në nenin 6 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 (d), Gjykata konstaton se nuk ka juridiksion. Sa i përket pretendimit të kërkuesit për shkelje të nenit 13 të Konventës, në lidhje me atë se nuk kishte mjete efektive juridike në Mbretërinë e Bashkuar, Gjykata erdhi në përfundimin se kërkesat e këtij neni nuk ishin shkelur. Për të ardhur në këtë përfundim, Gjykata kishte shqyrtuar procedurat gjyqësore të ndjekura në Mbretërinë e Bashkuar. Sa i përket dëmshpërblimit, Gjykata theksoi se gjetja e shkeljes në lidhje me nenin 3 në vetvete paraqet dëmshpërblim të drejtë për qëllime të nenit 50 të Konventës. Gjykata po ashtu i njohu kërkuesit të drejtën për t'iu kompensuar të gjitha shpenzimet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti se vendimi për të ekstraduar kërkuesin, në qoftë se do të ishte zbatuar, do të kishte shkelur nenin 3 të Konventës; ndërsa lidhur me pretendimet bazuar në nenet 6 dhe 13 të Konventës, Gjykata gjeti se nuk ka shkelje.

2.3. SELMOUNI kundër FRANCËS

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%225803/94%22%5D%7D>

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

28 qershor 1999

Çështja kyçe / E drejta e pretenduar: pretendime për trajtim çnjerëzor deri në shkallën e torturës gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim policor; shkelje e së drejtës në proces të drejtë gjyqësor si pasojë e tejzgjatjes së procedurave.

Faktet e rastit

Rasti u ngrit nga Ahmed Selmouni (kërkuesi), me shtetësi të dyfishtë holandeze dhe marokiene. Kërkuesit iu caktua burgimi prej trembëdhjetë vjet pasi u dënua për vepra penale të trafikimit të drogës në Francë. Pasi u

arrestua më 25 nëntor 1991, kërkuesi u mbajt në paraburgim për tri ditë. Gjatë kësaj kohe, ai pretendon se iu nënshtrua keqtrajtimit serioz e të përsëritur që përfshinte dhunë të vazhdueshme fizike dhe seksuale, dhe fyerje të vazhdueshme në baza nacionale. Kërkuesi u ankua vazhdimisht gjatë ekzaminimeve mjekësore se ai ishte duke iu nënshtruar keqtrajtimit. Një mjek i praktikës së përgjithshme mjekësore ekzaminoi kërkuesin në së paku pesë raste të veçanta gjatë tre ditëve që ai ishte paraburgosur. Një raport mjekësor i përgatitur me kërkesë të kërkuesit në përgjigje të pretendimeve të tij vuri në dukje të paktën 22 dëmtime të veçanta, duke konkluduar se vërehen dëmtime, shenja të traumës si dhe “lezione të një origjine traumatike [...] të shkaktuara në një kohë që korrespondon me periudhën e mbajtjes në polici”. Oficerët e policisë të përmendur në deklaratat e kërkuesit pretendonin se lëndimet ishin shkaktuar si pasojë e kacafytjes gjatë arrestimit. Megjithatë, një doktor i rishikoi shënimet mjekësore të kërkuesit dhe në një raport të ndarë komentoi se edhe pse disa nga dëmtimet mund t’i atribuohen përleshjes gjatë arrestimit, dëmtimet e tjera janë shkaktuar pas arrestimit, duke mbështetur kështu versionin e ngjarjes së kërkuesit. Të gjitha vizitat mjekësore dhe intervistat u regjistruan dhe u dërguan tek Prokurori Publik në Bobigny më 2 dhjetor 1992 si pjesë e procedurave të depozituara. Në anën tjetër, me një aktgjykim të datës 7 dhjetor 1992, Divizioni i Trembëdhjetë i Gjykatës Penale në Bobigny dënoi kërkuesin me pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe përjashtim të përhershëm nga territori francez. Ndërsa në një procedurë civile nga autoritetet doganore, kërkuesi u urdhërua të paguante një shumë totale prej njëzet e katër milionë franga franceze.

Një hetim i ri penal dhe civil i akuzave të pretenduara nga kërkuesi u iniciua në shkurt të vitit 1993. Një rishqyrtim mjekësor në qershor të vitit 1993 vuri në dukje se plagët e mbetura po shëroheshin mirë, por nuk gjeti prova për sulme seksuale “kryesisht për shkak të kohës që kishte kaluar që nga veprat e pretenduara. Mjeku vuri në dukje se kërkuesi nuk e përmendi sulmin seksual në atë kohë, sepse ‘ndihej i turpëruar’. Kërkuesi, gjithashtu kishte probleme me syrin tij të majtë, por mjeku ekzaminues arriti në përfundimin se do të kërkohet ekzaminimi i mëtejshëm për të përcaktuar nëse kishte lidhje midis këtij dëmtimi dhe keqtrajtimit të dyshuar. Në një aktgjykim të datës 16 shtator 1993, Gjykata e Ankesave e Parisit i zvogëloi dënimin me burg në trembëdhjetë vjet dhe e vërtetoi pjesën tjetër të aktgjykimit. Më 27 qershor 1994 Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë ankesën e kërkuesit.

Përmbledhje e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi se trajtimi i tij gjatë qëndrimit në paraburgim e kaloi pragun e ashpërsisë së kërkuar për t'u konsideruar torturë sipas nenit 3 të Konventës, duke pretenduar se motivimi i punonjësve të policisë ishte të nxjerrin një pranim të fajësisë/dëshmi nga ai. Gjithashtu, kërkuesi pretendoi se procedurat në lidhje me ankesat kundër oficerëve të policisë nuk janë kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor siç kërkohet nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Sipas pretendimeve preliminare të Qeverisë, ankesa e bazuar në nenin 3 nuk mund të shqyrtohej nga Gjykata pasi që kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike vendore. Fillimisht, Komisioni e më pas edhe Gjykata gjeti se kërkuesi kishte plotësuar kërkesat e nenit 35 të Konventës. Gjykata vërejt se duke pasur parasysh seriozitetin e pretendimeve të kërkuesit dhe kohëzgjatjen e kohës që kishte kaluar që kur kishin ndodhur ngjarjet, autoritetet nuk kishin marrë të gjitha masat pozitive të kërkuara në rrethanat e rastit në mënyrë që të sjellin hetimin në një përfundim të shpejtë. Gjykata theksoi se qëllimi i nenit 35 është që shtetet kontraktuese ta kenë mundësinë e parandalimit ose vënies së të drejtës në rastet kur ka shkelje të pretenduara kundër tyre para se këto pretendime të dorëzohen në Institucionet e Konventës.⁴⁷ Mjetet juridike që parashikohen në nenin 35 të Konventës janë ato që lidhen me shkeljet e pretenduara dhe në të njëjtën kohë janë në dispozicion dhe të mjaftueshme. Sipas Gjykatës, ekzistenca e këtyre mjeteve juridike duhet të jetë e mjaftueshme, të jetë e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Në rastin aktual, Gjykata theksoi se sapo kërkuesi u lirua nga arrestimi i policisë më 29 nëntor 1991, gjykatësi hetues që u mor me procedimet kundër tij urdhëroi të hartohet një raport mjekësor dhe gjithashtu të kryhet një hetim paraprak nën autoritetin e prokurorit publik. Megjithatë, Gjykata vërejt se në rrjedhën e atyre hetimeve asnjë deklaratë nuk është marrë nga kërkuesi deri më shumë se një vit pas ngjarjeve në fjalë dhe se hapja e një hetimi gjyqësor

⁴⁷ *Hentrich kundër Francës* i 22 shtatorit 1994, Seria A nr. 296-A, f. 18, § 33, dhe *Remli kundër Francës*, Aktgjykimi i 23 prillit 1996, Raportet 1996-II, f. 571, § 33

nuk ishte kërkuar deri pasi që kërkuesi paraqiti, më 1 shkurt 1993, një ankesë penale së bashku me një ankesë civile.

Gjykata vërejti se rrethanat e rastit tregojnë se ka pasur një numër të vonesave të tjera të cilat duhet të merren parasysh. Pothuajse një vit ka kaluar midis ekzaminimit mjekësor më 7 dhjetor 1991 dhe intervistimit të kërkuetit nga Inspektorati Policor; pas kësaj, përsëri gati një vit kaloi mes hapjes së një hetimi gjyqësor; dhe dy vjet dhe mbi tetë muaj kaluan mes datës në të cilën janë identifikuar dhe datën në të cilën ishin të vendosur nën hetim policët e akuzuar. Gjykata më tutje vërejti se, pesë vite pas ngjarjeve askush nuk ishte akuzuar për veprat pavarësisht nga faktit se oficerët e policisë të akuzuar nga kërkuesi ishin identifikuar. Për më tepër, oficerët e policisë nuk u paraqitën përfundimisht para Gjykatës Penale deri gati pesë vjet pasi ata ishin identifikuar. Sipas mendimit të Gjykatës, çështja rrjedhimisht nuk është nëse ka pasur një hetim, pasi duket se ka pasur një të tillë, por çështja për trajtim është nëse hetimi ishte “efektiv”. Duke pasur parasysh si më sipër, Gjykata konsideron, që autoritetet nuk kanë marrë masat pozitive të kërkuara në rrethanat e rastit për të siguruar që mjeti juridik i përmendur nga Qeveria ishte efektiv. Prandaj, duke pasur parasysh mungesën e shpjegimit bindës nga ana e Qeverisë në lidhje me “efektivitetin” dhe “përshtatshmërinë” e mjeteve juridike Gjykata konsideroi se kërkuesi nuk kishte në dispozicion një mjet juridik të mjaftueshëm për të realizuar të drejtën e tij, me këtë edhe dëmshpërblimin në lidhje me shkeljet që ai pretendonte. Gjykata hodhi poshtë pretendimin e Qeverisë se kërkesa e kërkuetit duhet të hedhet poshtë për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike vendore, dhe e shpalli kërkesën të pranueshme.

Në lidhje me keqtrajtimin e kërkuetit, Gjykata vërejti se ankesat e tij për mënyrën e keqtrajtimin ishin të njëjta dhe asnjëherë nuk ndryshuan. Gjithashtu, vërejti se certifikatat mjekësore dhe raportet e hartuara në pavarësi të plotë nga mjekët, vërtetuan ekzistencën e një numri të madh të goditjeve të shkaktuara ndaj kërkuetit dhe intensitetin e tyre. Gjykata konsideroi se kur një individ merret në polici në shëndet të mirë, por në kohën e lirit, është evidente se ka pësuar lëndime, është detyrë e Shtetit të japë një shpjegim të besueshëm se si u shkaktuan lëndimet. Dështimi i shtetit për të bërë këtë paraqet shkelje të nenit 3

të Konventës.⁴⁸ Prandaj, autoritetet franceze kanë qenë të obliguara të japin një shpjegim të besueshëm se si u shkaktuan lëndimet e kërkuarit. Njëkohësisht, Gjykata vërejti se nga raportet dhe dokumentet e rastit Qeveria asnjëherë nuk kundërshtoi faktet e pretenduara nga kërkuari në lidhje me ngjarjet. Gjykata theksoi, si një argument plotësues, se ato fakte janë marrë si të vërtetuara nga Gjykata Penale dhe nga Gjykata e Apelit e Versajës - me përjashtim të pohimeve për përdhunimin seksual dhe humbjes së mprehtësisë pamore. Prandaj, Gjykata është e mendimit se, në lidhje me ankesat e paraqitura nga kërkuari, këto fakte mund të supozohen se kanë qenë të bazuara. Gjykata konsideroi, megjithatë, se nuk është vërtetuar se kërkuari u abuzua seksualisht, pasi akuza ishte bërë shumë vonë për t'u provuar ose mohuar me dëshmi mjekësore.

Sa i përket peshës/përmasave të dhunës së pretenduar, Gjykata mori parasysh vendimin e Komisionit, ku ishte konsideruar se nga goditjet e marra kërkuarit i ishin shkaktuar lëndime dhe vuajtje akute fizike dhe mendore. Për më tepër trajtimi duket se i ishte shkaktuar atij qëllimisht dhe, me qëllim të marrjes së një pranimi të fajësisë ose informacioni. Sipas Komisionit, një trajtim i tillë, i shkaktuar nga një ose më shumë zyrtarë shtetërorë dhe për të cilat certifikatat mjekësore mbanin dëshmi, ishte i një natyre mizore dhe se ky trajtim mund të përshkruhet vetëm si torturë. Prandaj, Gjykata duke marrë parasysh të gjitha sjelljet e policisë ndaj kërkuarit, konsideroi se dhuna fizike dhe dhuna mendore, në tërësi e përdorur kundër kërkuarit i shkaktoi atij dhimbje dhe vuajtje “të rënda” dhe ishte veçanërisht serioze dhe mizore. Një sjellje e tillë konsiderohet si akt torture për qëllimet e nenit 3 të Konventës. Si pasojë Gjykata gjeti se ka shkelje të nenit 3 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet e kërkuarit se procedurat në lidhje me ankesat e tij kundër oficerëve të policisë nuk ishin kryer brenda një kohe të arsyeshme siç kërkohet nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës, Gjykata konsideroi se periudha për shqyrtimin e kohëzgjatjes së procedurës e përcaktuar në nenin 6 paragrafi 1 filloi të rrjedh në momentin kur kërkuari ka paraqitur shprehimisht ankesën dhe u intervistua nga një oficer i

48 *Tomasi kundër Francës*, 27 gusht 1992, Seria A nr. 241-A, fq. 40-41, §§ 108-11, dhe *Ribitsch kundër Austrisë*, Aktgjykimi i 4 dhjetorit 1995, Seria A nr. 336, f. 25-26, § 34.

Inspektorati Kombëtar të Policisë, domethënë më 1 dhjetor 1992. Gjykata vërejtë se kjo formë e thjeshtë e ankesës penale është një mjet i ofruar nga ligji francez dhe se prokurori publik u informua për ankesën e kërkuarit që më 2 dhjetor 1992, kur ishte hartuar procesverbali i intervistës dhe i ishte dorëzuar atij. Duke pasur parasysh natyrën dhe seriozitetin ekstrem të pretenduar, Gjykata nuk konsideroi se ajo duhet të marrë si pikënisje datën 1 shkurt 1993, data në të cilën kërkuari paraqiti padinë penale për t’u bashkuar me procedurat civile më pas. Gjykata konsideroi se as kompleksiteti i rastit dhe sjellja e kërkuarit nuk e arsyetojnë tejzgjatjen e procedurave. Gjykata vërejtë se procedurat, në tërësi, kanë zgjatur më shumë se gjashtë vjet e shtatë muaj. Duke pasur parasysh seriozitetin e fakteve të supozuara, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës, kishte tejkalar “kohën e arsyeshme” të parashikuar nga neni 6 paragrafi 1.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti se ka shkelje të nenit 3 dhe nenit 6 paragrafi 1 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. PÁL ARANYOSI DHE ROBERT CĂLDĂRARU

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështjet e bashkuara C-404/15 dhe C-659/15 PPU

5 prill 2016

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=175547&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13703819>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Një gjykatë e një shteti anëtar duhet të sigurohet që personat e kërkuar që dorëzohen në zbatim të urdhërarresteve evropiane, nuk do t’u nënshtrohen, në destinacion, torturës apo trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Faktet kryesore

a) Çështja C-404/15

Z. Pál Aranyosi është shtetas hungarez, i lindur më 14 korrik 1996 në Szikszó në Hungari. Një gjyqtar për hetimet paraprake i Miskolci járásbíró⁴⁹ lëshoi dy urdhërarreste evropiane (në tekstin e mëtejme: “UAE”).⁵⁰, përkatësisht më 4 nëntor dhe 31 dhjetor 2014, kundër z. Aranyosi, duke kërkuar dorëzimin e tij tek autoritetet gjyqësore hungareze me qëllim vazhdimin e procedurave penale në ngarkim të tij.

Sipas UAE të 4 nëntorit 2014, z. Aranyosi dyshohej se, më 3 gusht 2014, kishte hyrë në një shtëpi banimi në Sajohidveg, në Hungari dhe dyshohej se kishte vjedhur, ndër të tjera, 2500 euro dhe 100000 forintë hungareze (HUF),⁵¹ kartëmonedha si dhe sende të tjera me vlerë. Sipas UAE të 31 dhjetorit 2014, z. Aranyosi akuzohej se më 19 janar 2014 ka hyrë nga dritarja në një shkollë në Sajohidveg dhe më pas kishte thyer disa dyer brenda ndërtesës dhe kishte vjedhur pajisje teknike si dhe 244,000 HUF,⁵² duke shkaktuar një dëm prej 55,000 HUF⁵³.

Në bazë të këtyre dy UAE u bë një njoftim për kërkim në sistemin e informacionit Shengen, gjë që shërbeu për arrestimin e z. Aranyosi më 14 janar 2015 në Bremen, në Gjermani. Ai u dëgjua të njëjtën ditë nga gjyqtari i Amtsgericht Bremen.⁵⁴ Z. Aranyosi deklaroi se ai ishte shtetas hungarez, se jetonte në Bremerhaven, në Gjermani, me nënën e tij, se ishte beqar, se kishte një partnere dhe një fëmijë 8 muajsh. Ai kundërshtoi faktet me të cilat akuzohej dhe tregoi se nuk ishte dakord për procedurën e thjeshtuar të dorëzimit. Përfaqësuesi i Prokurorit të Përgjithshëm të Bremenit urdhëroi lirimin e z. Aranyosi me arsyetimin se nuk kishte rrezik të dukshëm që ai t’i shmangej procedurës së dorëzimit. Më 14 janar 2015, Generalstaatsanwaltschaft Bremen⁵⁵, duke iu referuar kushteve të paraburgimit në disa burgje hungareze, të cilat

49 Gjykata e rrethit në Miskolc, Hungari.

50 Parashikuar nga Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/584, i ndryshuar me Vendimi Kuadër 2009/299. (tani e tutje Vendimi Kuadër).

51 Afërsisht 313 euro.

52 Afërsisht 760 €.

53 Afërsisht 170 €.

54 Gjykata e Rrethit në Bremen, Gjermani.

55 Zyra e Prokurorisë Publike të Bremenit.

nuk plotësonin standardet minimale evropiane, i kërkoi informacion Miskolci járásbíróság⁵⁶ se në cilën qendër do të mbahej i akuzuari në rast dorëzimi.

Me një letër të 20 shkurtit 2015, marrë me faks më 15 prill 2015 përmes Ministrisë së Drejtësisë së Hungarisë, Prokuroria Publike e Qarkut Miskolc informoi se, në këtë procedim penal konkret, masa shtrënguese e arrestit me burg dhe kërkesa për dënim me burg nuk ishin të domosdoshme. Prokuroria publike në fjalë tregoi se kishte disa masa shtrënguese më pak kufizuese se privimi i lirisë në ligjin penal hungarez dhe se ishin marrë parasysh disa sanksione të tjera që nuk përfshinin privim të lirisë. Masat shtrënguese para dhe pas akuzës do të vareshin nga prokurori publik, i cili ishte i pavarur dhe dënimi dhe sanksionet eventuale si dhe vendi i vuajtjes së tyre ishin në kompetencën e autoriteteve gjyqësore hungareze. Në këtë drejtim, ligjet hungareze ofronin garanci ekuivalente për procedurat penale të bazuara në vlerat evropiane.

Më 21 prill 2015, Zyra e Prokurorit Publik të Bremenit kërkoi që dorëzimi i z. Aranyosi tek autoriteti gjyqësor lëshues për qëllimin e ndjekjes penale të shpallej i ligjshëm. Ajo theksoi në veçanti se, megjithëse prokurori publik i rrethit të Miskolcit nuk kishte treguar se në cilin institucion ndëshkues do të burgosej i pandehuri në rast dorëzimi në Hungari, nuk kishte prova konkrete që, në rast dorëzimi, i akuzuari mund t'i nënshtrohej torturës ose ndonjë trajtimi tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Avokati i z. Aranyosi kërkoi që kërkesa e Prokurorit Publik të Bremenit të hidhej poshtë me arsyetimin se Zyra e Prokurorisë Publike të Qarkut Miskolc nuk kishte treguar se në cilin burg do të mbahej i pandehuri. Prandaj do të ishte e pamundur të verifikoheshin kushtet e paraburgimit.

b) Çështja C659/15 PPU

Z. Robert Căldăraru është një shtetas rumun i lindur më 7 dhjetor 1985 në Brasov, Rumani.

⁵⁶ Gjykata e Qarkut Miskolc.

Me një vendim të Juecătoria Făgăraş⁵⁷ të 16 prillit 2015, z. Căldăraru u dënua me burgim prej një viti e tetë muaj, për drejtim mjete pa patentë. Sipas arsyeve të vendimit, dënimi i referohej një dënimi me burg prej një viti për drejtim mjete pa patentë, i dhënë me kusht më 17 dhjetor 2013 nga Juecătoria. Făgăraş. Ky dënim u bë përfundimtar pas një vendimi të Curtea de Apel Braşov⁵⁸ të 15 tetorit 2015. Më 29 tetor 2015, u lëshua një UAE kundër z. Căldăraru dhe në sistemin e informacionit Shengen u fut një njoftim për kërkimin e tij.

Z. Căldăraru u arrestua në Bremen më 8 nëntor 2015. Në të njëjtën ditë, Amtsgericht Bremen⁵⁹ lëshoi një urdhër arresti kundër z. Căldăraru. Gjatë seancës së tij para asaj gjykate, z. Căldăraru deklaroi se ai nuk ishte dakord për procedurën e thjeshtuar të dorëzimit tek autoritetet rumune. Më 9 nëntor 2015, Zyra e Prokurorit Publik të Bremenit kërkoi që z. Căldăraru të vendosej në “paraburgim me qëllim ekstradimi”. Me një vendim të 11 nëntorit 2015, Hanseatisches Oberlandesgericht në Bremen⁶⁰ e pranoi këtë kërkesë. Ajo vlerësoi se vendosja e z. Căldăraru në “paraburgim me qëllim ekstradimi” nuk dukej “*prima facie* e paligjshme”, sipas kuptimit të nenit 15.2 të IRG-së, dhe konstatoi ekzistencën e një rreziku që z. Căldăraru t’i shmangej procedurës së dorëzimit autoriteteve rumune, duke justifikuar vendosjen e tij në “paraburgim për qëllime ekstradimi”, në përputhje me nenin 15.1 të IRG-së. Më 20 nëntor 2015, Zyra e Prokurorit Publik të Bremenit kërkoi që dorëzimi i z. Căldăraru tek autoritetet rumune të shpallej i ligjshëm. Për më tepër, ky autoritet vuri në dukje se Juecătoria Făgăraş nuk ishte në gjendje të tregonte se në cilin burg do të mbahej z. Căldăraru në Rumani.

c) Problemi përpara gjykatave gjermane në lidhje me të dy çështjet

Hanseatisches Oberlandesgericht në Bremen⁶¹ vlerësoi se kërkesat e paraqitura respektivisht nga autoritetet hungareze dhe rumune plotësonin kushtet e Ligjit gjerman për ndihmën juridike

57 Gjykata e Shkallës së Parë të Fagaras, Rumani.

58 Gjykata e Apelit në Brasov, Rumani.

59 Gjykata e Qarkut në Bremen, Gjermani.

60 Gjykata e Lartë Rajonale, Bremen.

61 Gjykata e Lartë Rajonale, Bremen.

ndërkombëtare në çështjet penale⁶² (në tekstin e mëtejshëm: IRG). Sipas saj, veprat për të cilat akuzohej z. Aranyosi dhe për të cilat ishte dënuar z. Căldăraru përbënin vepra penale në Gjermani dhe në shtetet e tyre përkatëse, si dhe dënoheshin me të paktën një vit burgim në Gjermani dhe respektivisht, në Hungari dhe Rumuni. Megjithatë, ajo gjykatë u shpreh se dorëzimi duhet të shpallej i paligjshëm në rast se binte në kundërshtim me një nga kushtet e parashikuara në nenin 73 të IRG-së.

Në lidhje me z. Aranyosi, në dritën e informacionit të disponueshëm, ajo gjykatë ishte e bindur se kishte prova të forta se, në rast dorëzimi tek autoriteti gjyqësor hungarez, z. Aranyosi mund t'u nënshtrohej kushteve të paraburgimit që shkelnin KEDNJ-në dhe të drejtat themelore si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës të parashikuara në nenin 6 të TBE-së.⁶³

Edhe në lidhje me z. Căldăraru, ajo Gjykatë vlerësoi se, nën dritën e informacionit të disponueshëm, kishte prova bindëse që, në rast dorëzimi, z. Căldăraru mund t'u nënshtrohej kushteve të paraburgimit që shkelnin nenin 3 të KEDNJ-së dhe të drejtat themelore, si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës të parashikuara në nenin 6 TEU.⁶⁴

62 Gesetz über die internationale Rechtshilfe in Strafsachen (Ligji për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështjet penale), i 23 dhjetorit 1982, i amenduar nga ligji për Urdhër-Arrestin Evropian (Europäisches Haftbefehlsgesetz), i 20 korrikut 2006 (BGBl. f. 2006 I, 2006), 1721.

63 Gjykata e Lartë Rajonale, Bremen kujtoi se GJEDNJ e kishte dënua Hungarinë për shkak të mbipopullimit të burgjeve (vendimi *Varga dhe të tjerë kundër Hungarisë*, nr. 14097/12, 45135/12, 73712/12, 34001/13, 44055/13 et 64586/13, 10 mars 2015). GJEDNJ kishte konsideruar se ishte vërtetuar që Hungaria kishte shkelur nenin 3 të KEDNJ duke i mbajtur të burgosurit në qeli shumë të vogla dhe të mbipopulluara. GJEDNJ-ja e kishte konsideruar këtë procedurë si një rast pilot pasi që kishte regjistruar rreth 450 ankesa të ngjashme kundër Hungarisë për kushte çnjerëzore të paraburgimit. Gjykata e Lartë Rajonale e Bremenit vërejti gjithashtu se ka indikacione konkrete që kushtet e paraburgimit të cilave do t'u nënshtrohej z. Aranyosi në rast të dorëzimit të tij tek autoritetet hungareze nuk përmbushin standardet minimale të parashikuara nga e drejta ndërkombëtare, sipas një raporti të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës. Ky vlerësim i referohet veçanërisht mbipopullimit të konsiderueshëm të burgjeve të vëzhguara gjatë vizitave të kryera ndërmjet viteve 2009 dhe 2013.

64 Gjykata e Lartë Rajonale, Bremen kujtoi se në disa vendime të dhëna më 10 qershor 2014, GJEDNJ dënoi Rumaninë për shkak të mbipopullimit në burgjet e saj (GJEDNJ, *Voicu kundër Rumanisë*, nr. 22015/10; *Bujorean kundër Rumanisë*, nr. 13054 / 12; *Constantin A. Burlacu kundër Rumanisë*, nr. 51318/12, dhe *Mihai Laurențiu Marin kundër Rumanisë*, nr. 79857/12). GJEDNJ konsideroi se ishte vërtetuar se shteti rumun kishte shkelur nenin 3 të KEDNJ-së duke i burgosur kërkuesit në qeli shumë të vogla dhe të mbipopulluara, pa ngrohje të mjaftueshme, të ndotura dhe pa ujë të ngrohtë për t'u larë. Ajo vërejti gjithashtu se indikacionet konkrete se kushtet e paraburgimit të cilave do t'u nënshtrohej z. Căldăraru në rast dorëzimi tek autoritetet rumune nuk përmbushin standardet minimale të parashikuara nga e drejta ndërkombëtare konfirmoheshin në një raport të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës. Ky vlerësim i referohet veçanërisht mbipopullimit të konsiderueshëm të burgjeve të vëzhguara gjatë vizitave të bëra ndërmjet 5 dhe 17 qershorit 2014.

Në bazë të këtyre informacioneve, dhe duke pasur parasysh kushtet e nenit 73 të IRG-së, Gjykata e Lartë Rajonale e Bremenit nuk e konsideroi veten në gjendje të vendosë mbi ligjshmërinë e dorëzimit të z. Aranyosi autoriteteve hungareze dhe të z. Căldăraru. Vendimi i saj do të varej në thelb nga garancitë e dhëna respektivisht nga autoritetet hungareze dhe rumune.

Në këto rrethana, Gjykata e Lartë Rajonale e Bremenit vendosi të pezullojë procedurën në të dy këto raste dhe t'i drejtojë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, për një vendim paraprak pyetjen nëse neni 1.3 i Vendimit Kuadër duhet të interpretohet në kuptimin që, në prani të elementeve serioze që dëshmojnë për një papajtueshmëri të kushteve të paraburgimit në shtetin anëtar që lëshon UAE, me të drejtat themelore, veçanërisht me nenin 4 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejshëm: "Karta"), autoriteti gjyqësor ekzekutues mund ose duhet të refuzojë ekzekutimin e vendimit të këtij Urdhri të lëshuar kundër një personi për qëllime të procedurës penale ose ekzekutimit të një dënimi me burg, ose nëse mund ose duhet ta kushtëzojë dorëzimin e atij personi me marrjen nga shteti anëtar që lëshon Urdhrin, të informacionit që i mundëson atij të sigurohet që këto kushte burgimi të jenë në përputhje me të drejtat themelore. Për më tepër, ai pyeti nëse nenet 5 dhe 6.1 të Vendimit Kuadër duhet të interpretohen ashtu që një informacion i tillë mund të sigurohet nga autoriteti gjyqësor i shtetit anëtar që lëshon urdhrin apo nëse dhënia e këtij informacioni varet nga ai shtet anëtar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vlerësoi se shtetet anëtare dhe, rrjedhimisht, gjykatat e tyre, kur zbatojnë të drejtën e BE-së, siç është rasti i autoritetit gjyqësor që lëshon një UAE dhe i autoritetit gjyqësor që e ekzekuton atë në zbatim të dispozitave kombëtare, të miratuara në bazë të vendimit kuadër, janë të detyruara të respektojnë nenin 4 të Kartës, në lidhje me ndalimin e trajtimit dhe dënimit çnjerëzor ose poshtërues, siç del edhe nga neni 51.1 i saj. Nga kjo rrjedh se, kur një autoritet gjyqësor i shtetit anëtar ekzekutues disponon prova për një rrezik real të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues të personave të ndaluar në shtetin anëtar që lëshon një UAE, sipas standardit të mbrojtjes së të drejtave themelore

të garantuara nga drejta e BE-së dhe, në veçanti, nga neni 4 i Kartës, kërkohet që ai të vlerësojë ekzistencën e këtij rreziku kur duhet të vendosë për transferimin e personit të interesuar tek autoritetet e shtetit anëtar lëshues. Në të vërtetë, ekzekutimi i një urdhri të tillë nuk mund të çojë në trajtim çnjerëzor ose poshtërues të atij personi. Për këtë qëllim, autoriteti gjyqësor ekzekutues, para së gjithash, duhet të bazohet në informacione objektive, të besueshme, të sakta dhe të përditësuara siç duhet mbi kushtet e paraburgimit që mbizotërojnë në shtetin anëtar lëshues dhe që tregojnë në realitet mangësi sistemike ose të përgjithshme, ose që prekin disa grupe njerëzish, apo edhe qendra të caktuara paraburgimi. Këto elemente mund të rezultojnë veçanërisht nga vendimet gjyqësore ndërkombëtare, të tilla si vendimet e GJEDNJ-së, nga vendimet gjyqësore të shtetit anëtar lëshues, si dhe nga vendimet, raportet dhe dokumentet e tjera të hartuara nga organet e Këshillit të Evropës ose të sistemit të Kombeve të Bashkuara.

Megjithatë, sipas Gjykatës, konstatimi i ekzistencës së një rreziku real të trajtimit çnjerëzor ose degradues për shkak të kushteve sistemike dhe të përgjithshme të paraburgimit në shtetin anëtar lëshues, si i tillë, nuk mund të çojë në refuzimin e ekzekutimit të një UAE. Në të vërtetë, pasi të jetë vërtetuar ekzistenca e një rreziku të tillë, atëherë është e nevojshme që autoriteti gjyqësor ekzekutues të vlerësojë, në mënyrë konkrete dhe të saktë, nëse ka arsye serioze dhe të provuara për të besuar se personi në fjalë do të përballet me këtë rrezik për shkak të kushteve të paraburgimit të tij të parashikuara në shtetin anëtar lëshues. Ekzistenca e thjeshtë e provave të dështimeve qoftë sistemike apo të përgjithshme, apo që prekin grupe të caktuara njerëzish, apo edhe qendra të caktuara të paraburgimit në lidhje me kushtet e paraburgimit në shtetin anëtar lëshues nuk nënkupton, në fakt, domosdoshmërisht që, në një në rast, personi në fjalë do t'i nënshtrohej trajtimit çnjerëzor ose poshtërues nëse do t'u dorëzohej autoriteteve të atij shteti anëtar. Rrjedhimisht, për të garantuar respektimin e nenit 4 të Kartës në rastin individual të personit që është objekt i UAE-së, autoriteti gjyqësor ekzekutues, i cili vjen në dijeni me elemente objektive, të besueshme, të sakta dhe të përditësuara siç duhet, që dëshmojnë për ekzistencën e këtyre mangësive, duhet të verifikojë nëse, në rrethanat e rastit, ka arsye serioze dhe të provuara për të besuar se, pas dorëzimit të personit shtetit anëtar lëshues, ai person do t'i nënshtrohet një rreziku real në

atë shtet anëtar për trajtim çnjerëzor ose poshtëruës, sipas kuptimit të atij neni.

Autoriteti gjyqësor i shtetit anëtar ekzekutues, në përputhje me nenin 15.2 të Vendimit Kuadër 2002/584, mbi UAE dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet shteteve anëtare, të ndryshuar me Vendimin Kuadër 2009/299, duhet t'i kërkojë autoritetit gjyqësor të shtetit anëtar lëshues që t'i japë urgjentisht çdo informacion shtesë të nevojshëm në lidhje me kushtet në të cilat parashikohet mbajtja e personit objekt i UAE në atë shtet anëtar. Kjo kërkesë mund të lidhet gjithashtu me ekzistencën, në shtetin anëtar lëshues, të çdo procedure dhe mekanizmi kombëtar ose ndërkombëtar për monitorimin e kushteve të paraburgimit të lidhura, për shembull, me vizitat në institucionet e heqjes së lirisë, të cilat bëjnë të mundur vlerësimin e gjendjes aktuale të kushteve të paraburgimit në këto ambiente.

Në përputhje me nenin 15.2 të Vendimit Kuadër, autoriteti gjyqësor ekzekutues mund të caktojë një afat për marrjen e informacionit shtesë të kërkuar nga autoriteti gjyqësor lëshues. Kjo periudhë duhet t'i përshtatet rastit specifik, në mënyrë që t'i lejohet këtij të fundit koha e nevojshme për të mbledhur informacionin e përmendur, nëse është e nevojshme duke kërkuar ndihmën e autoritetit qendror ose një prej autoriteteve qendrore për këtë qëllim në shtetin anëtar lëshues, në kuptimin e nenit 7 të Vendimit Kuadër.

Në bazë të nenit 15.2 të Vendimit-Kuadër, ky afat duhet megjithatë të marrë parasysh nevojën për të respektuar afatet kohore të përcaktuara në nenin 17 të Vendimit Kuadër. Autoriteti gjyqësor lëshues është i detyruar t'ia japë këtë informacion autoritetit gjyqësor ekzekutues. Nëse, në dritën e informacionit të dhënë në bazë të nenit 15.2 të Vendimit Kuadër, si dhe çdo informacioni tjetër në dispozicion të autoritetit gjyqësor ekzekutues, ky i fundit konstaton se ka, në lidhje me personin objekt të UAE, një rrezik real të trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, ekzekutimi i këtij UAE duhet të shtyhet por nuk mund të anulohet. Në rast se informacioni i marrë nga autoriteti gjyqësor ekzekutues nga autoritetit gjyqësor lëshues çon në përjashtimin e ekzistencës së një rreziku real që personi në fjalë do t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës në shtetin anëtar lëshues, autoriteti gjyqësor ekzekutues duhet të miratojë,

brenda afateve kohore të përcaktuara nga Vendimi Kuadër, vendimin e tij për ekzekutimin e UAE, pa paragjykuar mundësinë që personi në fjalë, pasi të dorëzohet, të përdorë, në rendin juridik të shtetit anëtar lëshues, mjetet e apelimit që e lejojnë atë të kundërshtojë, nëse është e nevojshme, ligjshmërinë e kushteve të paraburgimit të tij në një institucion të heqjes së lirisë në këtë shtet anëtar. Nëse ekzistenca e këtij rreziku nuk mund të përjashtohet brenda një afati të arsyeshëm, ai autoritet duhet të vendosë nëse është rasti që t'i japë fund procedurës së dorëzimit.

Në përputhje me nenin 6 të Kartës, autoriteti gjyqësor ekzekutues mund të vendosë të mbajë një person në paraburgim vetëm nëse procedura për ekzekutimin e UAE është përmbushur në mënyrë mjaft të zellshme dhe, pra, se kohëzgjatja e paraburgimit nuk është e tepërt. Ky autoritet duhet të marrë parasysh, në rastin e personave që i nënshtrohen një UAE për qëllime të ndjekjes penale, parimin e prezumimit të pafajësisë të garantuar nga neni 48 i Kartës. Në këtë drejtim, autoriteti gjyqësor ekzekutues duhet të përmbushë kriterin e proporcionalitetit, të parashikuar në nenin 52.1 të Kartës, në lidhje me kufizimin e çdo të drejte ose lirie të njohur prej saj. Në të vërtetë, lëshimi i një UAE nuk mund të justifikojë mbajtjen e personit në fjalë në paraburgim pa asnjë kufizim kohor. Në çdo rast, nëse organi gjyqësor ekzekutues arrin në përfundimin se është i detyruar t'i japë fund paraburgimit të të kërkuarit, atëherë i takon atij, në bazë të neneve 12 dhe 17.5, të Vendimit Kuadër 2002/584, në lidhje me UAE dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet shteteve anëtare, të ndryshuar me Vendimin Kuadër 2009/299, të procedojë me lirim të përkohshëm të këtij personi, duke marrë çdo masë që e konsideron të nevojshme për të parandaluar ikjen e tij dhe për të siguruar që kushtet materiale të nevojshme për dorëzimin efektiv të tij mbeten në fuqi për aq kohë sa nuk është marrë vendim përfundimtar për ekzekutimin e UAE.

Neni 1.3, neni 5 dhe neni 6.1, të Vendimit Kuadër 2002/584, që kanë të bëjnë me UAE dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet shteteve anëtare, të ndryshuar me Vendimin Kuadër 2009/299, duhet të interpretohen ashtu që, në prani të elementeve objektive, të besueshme, të sakta dhe të përditësuara siç duhet, të dëshmojnë për ekzistencën e mangësive qoftë sistematike apo të përgjithshme, apo që prekin grupe të caktuara njerëzish, apo edhe

qendra të caktuara paraburgimi në lidhje me kushtet e paraburgimit në shtetin anëtar lëshues, autoriteti gjyqësor ekzekutues duhet të verifikojë, në mënyrë konkrete dhe të saktë, nëse ka arsye serioze dhe të provuara për të besuar se personi objekt i një UAE të lëshuar për qëllime të procedimit penal ose vuajtjes së dënimit me burgim, i nënshtrohet një rreziku real të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, sipas nenit 4 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, në rast të dorëzimit të shteti anëtar lëshues. Për këtë qëllim, ai duhet të kërkojë dhënien e informacionit shtesë autoritetit gjyqësor lëshues, i cili, pasi ka kërkuar, nëse është e nevojshme, ndihmën e autoritetit qendror ose të një prej autoriteteve qendrore të shtetit anëtar lëshues, sipas nenit 7 të Vendimit Kuadër, duhet t'ia përcjellë këtë informacion brenda afatit kohor të caktuar në një kërkesë të tillë. Autoriteti gjyqësor ekzekutues duhet ta shtyjë vendimin e tij për dorëzimin e personit në fjalë derisa të marrë informacion shtesë që i mundëson të përjashtojë ekzistencën e një rreziku të tillë.

3.2. DIETER KROMBACH kundër ANDRÉ BAMBERSKI

GJDBE

Çështja C - 7/98

28 mars 2000

[\[https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=45196&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13706850\]](https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=45196&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13706850)

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Kjo çështje ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në sistemin e BE-së dhe me arsye të rendit publik.*

Përmbledhja e fakteve

Pas vdekjes në Gjermani të një vajze 14-vjeçare, e cila ishte me shtetësi franceze, autoritetet gjermane filluan procedurat hetimore në ngarkim të z. Krombach. Këto procedura u pushuan.

Pas kërkesës së z. Bamberski, babai i viktimës, u hap një hetim në Francë, duke qenë se autoritetet franceze vlerësuan se ishin kompetente për

këtë për shkak të shtetësisë së viktimës. Në përfundim të këtij hetimi, me vendim të Gjykatës Penale të Apelit të Parisit, çështja në ngarkim të z. Krombach iu kalua Gjykatës Penale të Shkallës së Parë të Parisit.

Z.. Krombach u njoftua për këto procedura si dhe për padinë civile të babait të viktimës. Edhe pse u urdhërua të paraqitej personalisht, z. Krombach nuk u paraqit në seancë. Në mungesë të paraqitjes, Gjykata Penale e Shkallës së Parë e Parisit i zhvilloi procedurat në mungesë, siç parashikohet nga nenet 627 dhe nenet vijuese të Kodit francez të Procedurës Penale. Në përputhje me nenin 630 të atij Kodi, sipas të cilit avokati nuk mund të paraqitet në emër të të akuzuarit të munguar, Gjykata Penale mori vendim pa dëgjuar avokatët e caktuar nga z. Krombach.

Me një vendim të 9 marsit 1995, ajo gjeti se z. Krombach ishte fajtor për ushtrim dhune me pasojë jo të qëllimshme vdekjen, dhe e dënoi me pesëmbëdhjetë vjet burg. Me vendimin e 13 marsit 1995, duke vendosur mbi interesat e palës civile, ajo urdhëroi, gjithashtu (në mungesë), që z. Krombach t'i paguante z. Bamberski një kompensim prej 350,000 FRF.

Me kërkesë të z. Bamberski, Kryetari i një trupi gjykues në gjykatën civile të Landgericht Kempten, vendosi që vendimi i 13 marsit 1995 ishte i zbatueshëm në Gjermani. Pasi Oberlandesgericht hodhi poshtë ankesën e paraqitur nga z. Krombach, ky i fundit apeloi pranë Bundesgerichtshof me një "Rechtsbeschwerde", ku argumentoi se ai nuk kishte qenë në gjendje të mbrohej në mënyrë efektive kundër dënimit të tij nga gjykata franceze.

Në këto rrethana, Bundesgerichtshof vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i referojë pyetjet e mëposhtme Gjykatës së Luksemburgut për një vendim paraprak:

"(1) A munden rregullat në lidhje me juridiksionin të kenë të bëjnë me politikën publike të përmendur në nenin 27.1 të Konventës së Brukselit, kur, në lidhje me një person me banim në territorin e një shteti tjetër palë (neni 2.1, i Konventës së Brukselit), shteti i origjinës e bazoi juridiksionin e tij vetëm në shtetësinë e viktimës (siç parashikohet në nenin 3.2, të Konventës së Brukselit për Francën)?

Nëse pyetja e parë merr përgjigje negative:

2) A mundet që gjykata e shtetit të kërkuar (neni 31.1 i Konventës së Brukselit), në kuadrin e politikës publike të përmendur në nenin 27.1 të Konventës së Brukselit, të marrë parasysh faktin se gjykata e shtetit të origjinës ka refuzuar mbrojtjen e të akuzuarit nga një avokat në procedurën civile (neni II i Protokollit të 27 shtatorit 1968 në lidhje me interpretimin e Konventës së Brukselit), me arsyetimin se i pandehuri, me vendbanim në një shtet tjetër palë, po ndiqet penalisht për një vepër penale të kryer me dashje dhe se ai nuk është paraqitur personalisht?

Nëse pyetja e dytë merr përgjigje negative:

3) A mundet gjykata e shtetit të kërkuar, në kuadër të politikës publike të përmendur në nenin 27.1 të Konventës së Brukselit, të marrë parasysh faktin se gjykata e shtetit të origjinës e bazoi juridiksionin e saj vetëm në shtetësinë e viktimës (shih pyetjen e parë më lart) dhe për më tepër refuzoi të lejojë që i pandehuri në fjalë të përfaqësohet nga një avokat (shih pyetjen e dytë më lart)?”

Vendimi i Gjykatës

Në përgjigjen e saj ndaj pyetjeve që i ishin drejtuar, Gjykata u shpreh se, pavarësisht se shtetet anëtare, në parim, mbeten të lira të vendosin, në saje të rezervës së përfshirë në nenin 27.1 të Konventës së 27 shtatorit 1968 lidhur me juridiksionin gjyqësor dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare, sipas kuptimit të tyre kombëtar, mbi kërkesat e rendit të tyre publik, kufijtë e këtij nocioni interpretohen në kuadrin e Konventës. Prandaj, megjithëse Gjykatës nuk i takon të përcaktojë përmbajtjen e rendit publik në një shtet anëtar, asaj i takon megjithatë të kontrollojë kufijtë brenda të cilave gjyqtari i një shteti anëtar mund t'i referohet këtij nocioni në mënyrë që të mos njohë një vendim që buron nga një juridiksion i një shteti tjetër anëtar.

Sipas sistemit të Konventës, përveç rasteve të caktuara të renditura në mënyrë shteruese në nenin 28.1, asnjë prej të cilëve nuk korrespondon me faktet e çështjes në procedurën kryesore, gjykata e shtetit që i drejtohet kërkesa nuk mund të rishikojë juridiksionin e gjykatave të

shtetit të origjinës. Ky parim themelor, i përcaktuar në nenin 28.3 (1) të asaj Konvente, përforcohet nga sqarimi, i përfshirë në fjalinë e dytë të së njëjtës dispozitë, sipas të cilit “rregullat që lidhen me juridiksionin nuk kanë të bëjnë me politikën publike të përmendur në nenin 27.1”.

Sipas Gjykatës, nga kjo rrjedh se politika publike në shtetin që i drejtohet kërkesa, nuk mund të kundërshtojë njohjen ose ekzekutimin e një vendimi të dhënë në një shtet tjetër palë me arsyetimin e vetëm se gjyqtari i origjinës nuk ka respektuar rregullat e Konventës në lidhje me juridiksionin.

Në këto kushte, gjyqtari i shtetit të kërkuar, gjyqtari gjerman në këtë rast, nuk mund t’i referohet klauzolës së rendit publik referuar në nenin 27.1 të lartpërmendur, thjesht sepse gjyqtari i shtetit të origjinës, gjyqtari francez në këtë rast, e bazoi vendimin mbi juridiksionin e tij në shtetësinë e viktimës së një vepre penale.

Referimi te klauzola e rendit publik, e parashikuar në nenin 27.1 të Konventës së 27 shtatorit 1968, mund të imagjinohet vetëm nëse njohja ose ekzekutimi i vendimit të dhënë në një shtet tjetër palë do të cenonte në mënyrë të papranueshme rendin juridik të shtetit të kërkuar, ose nëse do shkelte një parim themelor. Me qëllim që të respektohet ndalimi i rishikimit të themelit të një vendimi të huaj, cenimi duhet të përbëjë një shkelje të qartë të një rregulli ligjor të konsideruar si thelbësor në rendin juridik të shtetit të kërkuar ose një të drejtë të njohur si themelore në këtë rend juridik.

Referimi te klauzola e rendit publik, e përfshirë në nenin 27.1, të lartpërmendur, duhet të jetë i mundur vetëm në raste të jashtëzakonshme kur garancitë e përfshira në të drejtën e shtetit të origjinës dhe në vetë Konventën nuk ishin të mjaftueshme për të mbrojtur të pandehurin nga një shkelje e hapur e së drejtës së tij për t’u mbrojtur në procedurat para gjyqtarit të origjinës, siç njihet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rrjedhimisht, neni II i Protokollit që i është bashkangjitur Konventës, i cili njih të drejtën për t’u mbrojtur pa u paraqitur personalisht para gjykatave penale të një shteti palë, të personave që nuk janë shtetas të atij shteti dhe me vendbanim në një shtet tjetër palë, me përjashtim të rasteve kur ndiqen penalisht për një vepër të kryer pa

dashje, nuk mund të interpretohet sikur ia ndalon gjyqtarit të shtetit të kërkuar që në një situatë të tillë dhe për një person që ndiqet për një vepër penale të kryer me dashje, të marrë parasysht, për qëllimet e klauzolës së rendit publik të përmendur në nenin 27.1, sipërcituar, faktin se gjyqtari i shtetit të origjinës i ka refuzuar këtij të fundit të drejtën për t'u mbrojtur pa u paraqitur personalisht. Sipas Gjykatës, vetëm kur ka një mohim të tillë të së drejtës për t'u mbrojtur personalisht, gjyqtari i shtetit që i bëhet kërkesa mund t'i referohet klauzolës së nenit 27.1 të Konventës së 27 shtatorit 1968 lidhur me juridiksionin gjyqësor dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare.

Neni 28

Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar

- 1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë.*
- 2. Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer punë të detyruar. Punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë.*
- 3. Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI 77/19. PARASHTRUES MUSA ISLAMI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/ki_77_19_av_shq.pdf]

17 korrik 2020

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Rasti kishte të bënte me procedurën administrative dhe gjyqësore të nisur nga parashtruesi i kërkesës i cili kërkonte që, pas emërimit si ushtrues detyre i udhëheqësit të një divizioni, të trajtohej me pagë të njëjtë nga Ministria e Financave me udhëheqësin tjetër të divizioneve, në kuadër të të njëjtit Departament. Çështja kryesore e këtij rasti ishte se a ishin cenuar disa të drejta kushtetuese kundër parashtruesit, duke përfshirë nenin 28 që ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar, nga vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe gjykatave të rregullta, përmes të cilave nuk i ishte mundësuar parashtruesit të kërkesës të fitonte pagën në lartësinë e kërkuar.*

Faktet kryesore

Më 20 shkurt 2014, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave e kishte caktuar parashtruesin e kërkesës si Ushtrues Detyre i Udhëheqësit në Divizionin Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll Qendror Harmonizues. Pas këtij vendimi atij nuk i ishte barazuar paga me udhëheqësit në divizionet e tjera. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Financave, duke kërkuar nivelizim të pagës. Më 3 nëntor 2014, Komisioni në fjalë i Ministrisë së Financave kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se ai Komision merrej vetëm me shqyrtimin e ankesave e jo të kërkesave, prandaj Komisioni nuk ishte kompetent të vendoste për nivelizimin e pagave. Më 19 nëntor 2014, parashtruesi i

kërkesës kishte paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (KPMSHCK), duke kërkuar që Ministria e Financave ta trajtonte me pagë të njëjtë me udhëheqësin tjetër të divizionit, në kuadër të të njëjtit Departament. Më 19 janar 2015, KPMSHCK-ja kishte hedhur poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se e njëjta ishte paraqitur pas afatit të paraparë ligjor. Me 20 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Vendimit të KPMSHCK-së dhe më 10 janar 2018, Gjykata Themelore kishte refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Edhe Gjykata e Apelit (përmes Aktgjykimit AA. nr. 99/20180), më 12 shkurt 2019, kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore. Më 14 maj 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës Kushtetuese se atij i ishin shkelur të drejtat e garantuara me nenet kushtetuese në vijim: neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], **neni 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar]** dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ai nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë sepse Ministria e Financave nuk e kishte bërë nivelizimin e pagës së parashtruesit të kërkesës, edhe pasi që ai ishte emëruar si Ushtrues Detyre i Udhëheqësit në Divizionin Qendror Harmonizues për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll Qendror Harmonizues. Ai argumentoi se edhe nëse kishte humbur të drejtën e ankesës për një muaj ai kishte kryer këtë funksion 3 vjet pa ndërprerë, prandaj i takonte e drejta për nivelizim të pagës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimet e kontestuara të KPMSHCK dhe të gjykatave të rregullta atij ishin shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesi i kërkesës e kishte ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie (jo kushtetutshmërie), përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjeve

nga ana e gjykatave të rregullta. Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se nuk ishte detyrë e saj që të merrej me gabimet e ligjit që pretendohet të ishin bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese vendosi që kërkesa ishte e papranueshme për shqyrtim të meritave të saj, sepse ajo ishte qartazi e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi që të shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. C.N. dhe V. kundër FRANCËS

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2267724/09%22%5D%7D>

GJEDNJ [Seksioni i Pestë]

11 janar 2013

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar; dështimi i autoriteteve për të mbrojtur të miturën e cila ishte mbajtur në robëri, punë e detyrueshme, kërcënim, trajtim çnjerëzor dhe frikë nga deportimi në shtëpinë e xhaxhait të saj.

Faktet kryesore

Kërkueset, dy motra C.N. (kërkuesja e parë) dhe V. (kërkuesja e dytë), ishin shtetase franceze të lindura në Burundi të cilat mbërritën në Francë me tri motrat e tyre më të vogla në vitet 1990. Kërkueset, ishin

larguar nga Burundi pas luftës civile të vitit 1993, gjatë së cilës prindërit e tyre u vranë. Ato u sollën në Francë me ndërmjetësim të xhaxhait të tyre dhe gruas së tij (z. dhe znj. M.), shtetas të Burundit që jetonin në Francë. Këtyre të fundit iu besua kujdestaria e kërkueseve dhe motrave të tyre më të reja. Z. dhe znj. M. jetonin në një shtëpi në Ville d'Avray me shtatë fëmijët e tyre, një prej të cilëve ishte me aftësi të kufizuara. Tri motrat më të vogla u morën nga familjet pritëse. Kërkueset, pretendonin se nga data e mbërritjes së tyre, ato ishin detyruar të kryenin punët e shtëpisë dhe të kujdeseshin për shtatë fëmijët e tyre. Vetëm kërkuesja e dytë shkonte në shkollë. Kërkuesja, e parë ishte e zënë gjithë ditën me punët e shtëpisë dhe duke u kujdesur për kushëririn e saj me aftësi të kufizuara. Ajo qëndroi një kohë të gjatë pa bërë asnjë kërkesë tek autoritetet në lidhje me statusin e saj, dhe besonte se qëndrimi i saj në Francë ishte i paligjshëm. Znj. M. e kërcënonte se do ta kthente në Burundi. Ajo u shtrua në spital në disa raste nën emrin e kushëririt të saj. Në vitin 1999, pasi u njoftuan nga një shoqatë ("Enfance et Partage"), autoritetet filluan një hetim paraprak. Imuniteti diplomatik i xhaxhait të kërkueseve, një punonjës i UNESCO-s, që përfaqësonte Burundin, u hoq dhe ai u akuzua për cenim të dinjitetit personal, një vepër penale sipas neneve 225-14 dhe 225-15 të Kodit Penal. U morën raporte psikiatrike të cilat dëshmuuan vuajtjet mendore në rastin e kërkueses së parë, u konstatua frikë dhe ndjenjë braktisjeje, pasi ajo e konsideronte kthimin e saj në Burundi me një rrezik vdekjeprurës dhe braktisjen e motrave të saj më të vogla. Me një aktgjykim të 17 shtatorit 2007, Gjykata Penale Nanterre gjeti z. dhe znj. M. fajtorë për të gjitha akuzat e ngritura kundër tyre (për të dy bashkëshortët, nënshtrimi i individëve në kushte pune dhe jetese të papajtueshme me dinjitetin njerëzor duke përfituar nga cenueshmëria ose gjendja e varësisë, dhe për znj. M. sulm i rëndë). Megjithatë, pas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Versajë, më 29 qershor 2009, u konfirmua vetëm dënimi i znj. M. për sulm të qëllimshëm dhe të rëndë kundër kërkueses së dytë. Znj. M. u urdhërua të paguajë një gjobë penale prej 1.500 eurosh dhe t'iu paguante kompensim kërkueseve, për dëmin jomaterial, në përputhje me kërkesën e saj. Prokurori publik nuk apeloi pikat/çështjet e ligjit kundër atij aktgjykimi. Ankesat në pikat e ligjit të parashtuara nga kërkueset, dhe nga znj. M. u hodhën poshtë, më 23 qershor 2010, nga Divizioni Penal i Gjykatës së Kasacionit.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 3 të Konventës, kërkuesja e dytë pretendoi se ajo kishte pësuar trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar nga ana e znj. M., dhe se shteti kishte dështuar në detyrimin e tij për ta mbrojtur. Kërkuesja e parë pohoi se ajo ishte përdorur si “shërbëtore e shtëpisë” nga z. dhe znj. M., pa pagesë dhe pa pushim. Ajo pretendoi se ishte e detyruar që të ngrihej herët dhe të shkonte në shtrat vonë dhe nganjëherë duhej të ngrihej në mes të natës për t’u kujdesur për djalin me aftësi të kufizuara të çiftit. Ajo theksoi se gjatë katër viteve që kaloi në shtëpinë e z. dhe znj. M. ajo nuk mori asnjë trajnim profesional që mund t’i kishte mundësuar asaj të kërkonte një punë tjetër dhe të ikte nga kontrolli i tyre. Gjykata e Apelit e Versajës kishte vërtetuar se kushtet e saj të punës dhe të jetesës ishin “të varfra, të pakëndshme”. Ajo kurrë nuk kishte pranuar me dëshirë të bënte punët e shtëpisë në kushte të tilla. Përkundrazi, ajo kishte punuar nën kërcënimin se do të kthehej në Burundi, që për të ishte sinonim i vdekjes dhe i braktisjes së motrave të saj më të vogla. Kërkuesja, e parë gjithashtu deklaroi se z. dhe znj. M. e kishin mbajtur atë në një situatë të paligjshme administrative përballë autoriteteve franceze. Në këtë pikë, kërkuesja vuri në dukje se edhe nëse vërtetohej se ajo dhe motra e saj ishin përfshirë në pasaportën diplomatike të znj. M., ajo prapë kërkohej, si e huaj, dhe nuk ishte në gjendje të paraqesë një leje qëndrimi të vlefshme në polici në rast të kontrollit të identitetit. Ajo gjithashtu vuri në dukje se sipas marrëveshjes së 2 korrikut 1954 midis Qeverisë dhe UNESCO-s për largimin e bashkëshortëve dhe “anëtarëve të familjes të varur” të diplomatëve nga formalitetet e qëndrimit, situata e saj në territorin francez ishte e ligjshme vetëm për aq kohë sa ajo qëndroi me z. M. dhe ishte “e varur” prej tyre. Ajo nuk kishte mundësi të gjente strehim ose punë jashtë shtëpisë së z. dhe znj. M. Sipas kërkueses së parë, këto rrethana treguan se ajo e bëri punën në fjalë nën detyrim.

Kërkuesja e dytë, e cila shkoi në shkollë, pohoi se ajo duhej të ndihmonte, apo edhe të zëvendësonte motrën e saj në punët e shtëpisë kur të kthehej nga shkolla. Ajo konsideroi se z. dhe znj. M. e trajtuan atë dhe motrën e saj si “qen”, duke pasur parasysh se edhe një “shërbëtore” paguhej për punën që ajo bëri. Në vëzhgimet e saj në përgjigje të atyre të Qeverisë, ajo parashtroi se fakti që ajo shkonte në shkollë nuk do të thoshte se punët e shtëpisë që duhej të bënte kur nuk ishte në shkollë nuk mund të

klasifikoheshin si punë e detyruar ose robëri. Ajo argumentoi se vetëm fakti që puna në fjalë ishte kryer në kohë të caktuara nuk mjaftonte për të vërtetuar se ajo e bëri atë me vullnetin e saj të lirë ose se nuk ishte bërë nën kërcënimin e një forme ndëshkimi. Përkundrazi, ajo argumentoi se znj. M. vazhdimisht e kërcënonte se do ta kthente në Burundi dhe se ajo e keqtrajtonte kur ajo refuzonte të bënte siç i ishte thënë. Meqenëse dhuna që znj. M. ushtroi ndaj saj, ishte ndëshkuar nga gjykatat vendase, nuk mund të kishte dyshim se puna që ajo kishte bërë ishte kryer nën kërcënimin e ndëshkimit. Së fundmi, ajo argumentoi se pasi kishte qenë midis dhjetë dhe katërmëdhjetë vjeç në atë kohë, ajo nuk mund të konsiderohej se kishte dhënë pëlqimin për të bërë punët e shtëpisë, të cilat nuk kishin qenë thjesht të rastit ose herë pas here. Bazuar në këto përvoja, kërkueset theksuan se duke qenë se ishin detyruar të bënin punët e shtëpisë për z. dhe znj. M. kundër vullnetit të tyre, ato i ishin nënshtruar punës me dhunë ose të detyruar.

Kërkueset, pretenduan se ato ishin mbajtur në një gjendje të varësisë së plotë administrative dhe financiare nga z. dhe znj. M. dhe nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të qëndronin në shtëpinë e tyre dhe të vazhdonin të punonin për ta, që sipas tyre kjo ishte gjendje skllavërie e cila ndalohet me nenin 4 të Konventës. Ky pretendim u kundërshtua nga Qeveria. Kërkueset, duke u mbështetur në nenin 13 të Konventës u ankuan gjithashtu se nuk kishte pasur një hetim efektiv pas ankesës së tyre që mund të çonte në dënimin e atyre që ishin përgjegjës.

Qeveria përjashtoi plotësisht mundësinë që kërkuesja e dytë t'i ishte nënshtruar punës së detyruar. Qeveria pretendoi se ajo ishte përfshirë në punët e shtëpisë vetëm herë pas here, si çdo anëtar tjetër i familjes. Megjithatë, Qeveria pranoi se kërkuesja, e parë ishte angazhuar më shumë nga z. dhe znj. M. për të bërë punët e shtëpisë, pasi ajo nuk shkonte në shkollë dhe ishte motra më e madhe. Megjithatë, ekzistenca e një kërcënimi ose dënimi nuk ishte vërtetuar në lidhje me kërkuesen e parë. Qeveria vuri në dukje se znj. M. kishte kontaktuar shërbimet sociale që kërkonin ndihmë për të, dhe i kishte gjetur një punë të paguar. Këto veprime hodhën poshtë idenë se znj. M. donte ta mbante kërkuesen, në një gjendje varësie. Qeveria arriti në përfundimin se as kërkuesja e parë dhe as e dyta nuk kishin asnjë bazë për të pretenduar se ato i ishin nënshtruar punës së detyruar sipas kuptimit të nenit 4.2 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Lidhur me pretendimin se është shkelur neni 3, Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase, përfshirë Gjykatën e Apelit të Versajës, vërtetuan se kërkuesja e dytë i ishte nënshtruar dhunës nga znj. M. Megjithatë, ajo konsideroi se, edhe duke supozuar se trajtimi në fjalë bie brenda fushës së nenit 3 të Konventës, kërkuesja e dytë nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljes së asaj dispozite. Në të vërtetë, gjykatat vendase e shpallën znj. M. fajtores për dhunë të rëndë. Përveç kësaj, kërkueses së dytë iu dha kompensim për vuajtjet e shkaktuara, në shumën që ajo pretendoi. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se kërkuesja e dytë nuk mund të pretendonte më se është “viktimë” e një shkeljeje të Konventës sipas kuptimit të nenit 34. Rrjedhimisht, sipas Gjykatës, kjo ankesë ishte qartazi e pabazuar dhe se kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet sipas nenit 35.3 dhe 4 të Konventës.

Ndërkaq lidhur me shkeljen e nenit 4, Gjykata përsëriti se neni 4 parasheh një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike. Gjykata ritheksoi se sipas nenit 4 të Konventës, shteti mund të mbahet përgjegjës jo vetëm për veprimet e tij të drejtpërdrejta, por edhe për dështimin e tij për të mbrojtur në mënyrë efektive viktimat e skllavërisë, ose punës së detyruar ose të detyrueshme për shkak të detyrimeve të tij pozitive.

Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesja e parë dhe e dytë pretendonin se kanë punuar, në formën e punëve të shtëpisë, në shtëpinë e z. dhe znj. M., kundër vullnetit të tyre. Megjithatë, Gjykata u shpreh se nuk ishte e bindur që dy kërkueset ishin vendosur në një situatë të ngjashme sa i përket sasisë së punës së kryer. Kërkuesja e parë, e cila nuk ndoqi shkollën, ishte përgjegjëse për të gjitha punët e shtëpisë në shtëpinë e z. dhe znj. M. dhe duhej të kujdesej për djalin e tyre me aftësi të kufizuara. Ajo punonte shtatë ditë në javë, pa ditë pushimi dhe pa pagesë, duke u ngritur herët dhe duke shkuar për të fjetur vonë (dhe nganjëherë edhe duke u ngritur në mes të natës për t’u kujdesur për djalin me aftësi të kufizuara të z. dhe znj. M.), dhe ajo nuk kishte kohë për aktivitete të kohës së lirë. Ndërsa, kërkuesja e dytë ndoqi shkollën dhe kishte kohë të bënte detyrat e shtëpisë kur të kthehej në shtëpi nga shkolla. Vetëm atëherë ajo ndihmonte kërkuesen e parë me punët e shtëpisë.

Në rastin konkret, Gjykata konsideroi se kërkuesja e parë ishte e detyruar të punonte aq shumë, saqë pa ndihmën e saj z. dhe znj. M. do të duhej të punësonin dhe të paguanin një shërbëtoreshë profesionale. Kërkuesja e dytë, nga ana tjetër, nuk ka siguruar prova të mjaftueshme se ajo kishte kontribuar në ndonjë masë të tepër në mirëmbajtjen e familjes së z. dhe znj. M. Për më tepër, megjithëse nuk është e diskutueshme që kërkuesja e dytë ishte viktimë e keqtrajtimit nga znj. M., nuk është vërtetuar se dhuna në fjalë ishte e lidhur drejtpërdrejt me shfrytëzimin e pretenduar, domethënë me punët e shtëpisë në fjalë. Prandaj, Gjykata ishte e mendimit se keqtrajtimi i shkaktuar ndaj kërkueses së dytë nga znj. M., nuk binte brenda fushës së nenit 4. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konsideroi se vetëm kërkuesja e parë i plotëson kushtet e “punës së kryer me dhunë ose të detyruar”, sipas kuptimit të nenit 4.2 të Konventës, domethënë që individi e bëri punën jo vullnetarisht.

Gjykata, duke u bazuar në raportin global “Kostoja e shtrëngimit”, të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në 1999 (shih paragrafin 52 të këtij vendimit të GJEDNJ), theksoi se nocioni i “dënimit” përdoret në kuptimin e gjerë, siç konfirmohet nga përdorimi i termit «çdo dënim». «Dënimi» mund të shkojë deri në dhunën fizike ose kufizimin, por mund të marrë edhe forma më delikate, të një natyre psikologjike, të tilla si kërcënimet për të denoncuar viktimat në polici ose autoritetet e emigracionit kur statusi i tyre i punësimit është i paligjshëm (po aty). Në çështjen në fjalë, Gjykata vërejti se znj. M. kërcënonte rregullisht se do t’i kthente kërkueset në Burundi, e cila për kërkuesen e parë përfaqësonte vdekjen dhe braktisjen e motrave të saj më të vogla. Sipas mendimit të Gjykatës, kthimi në Burundi u pa nga kërkuesja e parë si një “dënim” dhe kërcënim për t’u kthyer mbrapa si “kërcënim” i atij “dënimi” që do të ekzekutohej. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesja e parë iu nënshtrua “punës me dhunë ose punës së detyruar”, sipas kuptimit të nenit 4.2 të Konventës nga z. dhe znj. M. Kërkuesja e dytë, nga ana tjetër, u vendos në një situatë e cila nuk binte në fushën e asaj dispozite.

Ndërkaq në pretendimin për skllavëri, bazuar në disa fakte, ndër to edhe mosndjekja e shkollës nga kërkuesja e parë, puna pa asnjë ditë pushimi dhe pa aktivitete të kohës së lirë, Gjykata konsideroi se kërkuesja e parë

në fakt ishte mbajtur në një gjendje skllavërie nga z. dhe znj. M. Gjykata vlerësoi se ka pasur shkelje të nenit 4 të Konventës në rastin e kërkuases së parë, në lidhje me detyrimin pozitiv të shtetit për të vendosur një kornizë legjislative dhe administrative për të luftuar në mënyrë efektive skllavërinë dhe punën e detyruar, por nuk kishte shkelje të nenit 4 në lidhje me detyrimin procedural të shtetit për të kryer një hetim efektiv në rastet e skllavërisë dhe punës së detyruar. Lidhur me ankesën e kërkueseve sipas nenit 13 të Konventës, Gjykata theksoi se kjo ankesë ishte konsumuar. Pas shqyrtimit të ankesës se nuk ishte kryer një hetim efektiv nga pikëpamja e detyrimeve pozitive të shtetit sipas nenit 4, Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të asaj dispozite në këtë pikë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata e deklaroi kërkesën të pranueshme, përveç për ankesën e shkeljes së nenit 3 të Konventës në lidhje me kërkuesen e dytë. Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Konventës për kërkuesen e parë, në lidhje me detyrimin pozitiv të shtetit për të vendosur një kornizë legjislative dhe administrative për të luftuar në mënyrë efektive skllavërinë dhe punën e detyruar. Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të Konventës në lidhje me kërkuesen e parë, në lidhje me detyrimin procedural të shtetit për të kryer një hetim efektiv në rastet e skllavërisë dhe punës së detyruar. Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të Konventës, në lidhje me kërkuesen e dytë. Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej veçmas ankesa sipas nenit 13. Gjykata vendosi që shteti i paditur t'i paguante kërkuases së parë, shumë prej 30,000 (tridhjetë mijë) eurosh, në lidhje me të gjithë dëmin e pësuar, plus çdo taksë që mund të kërkohej të paguhet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. BASHKIA E NIVELES kundër RUDY MATZAK

GJDBE

Çështja C-518/15

21 shkurt 2018

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=199508&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13706967>]

Çështja kyçe/le drejta e pretenduar: Kjo çështje ka të bëjë me llogaritjen e punës jashtë orarit, sidomos kur zjarrfikësit janë në gatishmëri në shtëpi, dhe me shpërblimin përkatës, sipas të drejtës së BE-së

Faktet kryesore

Departamenti i zjarrfikësve të qytetit të Nivelles në Belgjikë përbëhet nga zjarrfikës profesionistë dhe zjarrfikës vullnetarë. Zjarrfikësit vullnetarë marrin gjithashtu pjesë në misionet. Ndër misionet e tjera që u janë caktuar atyre përfshihen edhe ato të gatishmërisë në shtëpi ose si roje në kazermë. Oraret e këtyre shërbimeve caktohen në fillim të vitit.

Z. Matzak hyri në shërbim të Bashkisë të Nivelles më 1 gusht 1980 dhe fitoi statusin e zjarrfikësit vullnetar një vit më vonë. Ai gjithashtu ishte i punësuar në një kompani private. Më 16 dhjetor 2009, z. Matzak nisi procedurat gjyqësore me pretendimin që Bashkia e Nivelles duhet t'i paguante atij një shumë të përkohshme prej një euro si dëmshpërblim për mospagesën gjatë viteve të shërbimit të tij si zjarrfikës vullnetar, në veçanti për shërbimet e tij të gatishmërisë në shtëpi.

Me vendimin e 22 marsit 2012, Tribunali i Punës në Nivelles pranoi pjesën më të madhe të pretendimeve të z. Matzak. Bashkia e Nivelles apeloj kundër këtij vendimi në Gjykatën e Punës në Bruksel. Me vendimin

e 14 shtatorit 2015, në apel, Gjykata e Punës së Brukselit e konfirmoi pjesërisht vendimin e shkallës së parë. Për sa i përket shpërblimit të kërkuar për shërbimet e gatishmërisë në shtëpi të cilat, sipas z. Matzak duhet të konsiderohen si kohë pune, Gjykata e Punës shtroi pyetjen nëse shërbime të tilla mund të konsiderohen si të përfshira në përkufizimin e kohës së punës sipas kuptimit të Direktivës 2003/88 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 4 nëntorit 2003, mbi aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës.

Në ato rrethana, Gjykata e Punës e Brukselit vendosi të pezullonte procedurën dhe t'i parashtrojë GJDBE pyetjet e mëposhtme për një vendim paraprak:

- a) Nëse neni 17. 3, (c), (iii) i Direktivës 2003/88 interpretohet ashtu që i autorizon shtetet anëtare për të përjashtuar kategori të caktuara të zjarrfikësve të punësuar nga shërbimet publike nga të gjitha dispozitat që sigurojnë transpozimin e kësaj directive, përfshirë atë që përcakton kohën e punës dhe periudhat e pushimit?
- b) Përderisa Direktiva 2003/88 parashikon vetëm standardet minimale, a duhet interpretuar në kuptimin se nuk pengon legjislacionin kombëtar të mbajë ose të miratojë një kohë më pak kufizuese të kohës së punës?
- c) Duke marrë parasysh nenin 153.5 të TFBE-së dhe objektivat e Direktivës 2003/88, neni 2 i asaj Directive i cili përcakton konceptet kryesore të përdorura prej saj dhe, në veçanti, ato të kohës së punës dhe periudhave të pushimit, a duhet interpretuar si i papërshtatshëm për konceptin e kohës së punës e cila duhet shpërblyer në rastet e gatishmërisë në shtëpi?
- d) A e ndalon Direktiva 2003/88 që koha e gatishmërisë në shtëpi të konsiderohet si kohë pune kur, megjithëse i punësuar i në gatishmëri në shtëpinë e tij, kufizimet që rëndojnë mbi të gjatë gatishmërisë, si detyrimi për t'iu përgjigjur thirrjeve nga punëdhënësi brenda 8 minutash, e kufizojnë shumë mundësinë për aktivitete të tjera?

Vendimi i Gjykatës

Gjykata e Luksemburgut argumentoi se neni 17. 3, (c), (iii) i Direktivës 2003/88/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 4 nëntorit 2003, në lidhje me disa aspekte të organizimit të kohës së punës, duhet interpretuar në kuptimin që shtetet anëtare nuk mund t'i shmangin disa

kategori zjarrfikësish të punësuar nga shërbimet publike të zjarrfikësve nga tërësia e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e kësaj direktive, përfshirë nenin 2 të saj, që përcakton në veçanti konceptet e “kohës së punës” dhe të “periudhës së pushimit”.

Gjykata saktësoi se neni 15 i Direktivës 2003/88 duhet të interpretohet në kuptimin që nuk i lejon shteteve anëtare të mbajnë ose të miratojnë një përkufizim më pak kufizues të konceptit të “kohës së punës” sesa ai i përcaktuar në nenin 2 të kësaj Direktive. Sipas formulimit të nenit 15 të Direktivës 2003/88, shtetet anëtare janë të lira të zbatojnë ose të miratojnë ligje, akte nënligjore ose dispozita administrative më të favorshme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve. Nga ai nen rrjedh se dispozitat kombëtare të cilave u referohet janë ato që mund të krahasohen me ato të parashikuara nga Direktiva 2003/88 mbi mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve. Sidoqoftë, këto dispozita të fundit mund të jenë vetëm ato të cilat, për shkak të funksionit dhe qëllimit të tyre, synojnë të vendosin një nivel minimal mbrojtjeje për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve. Ky është rasti për dispozitat që bien nën kapitujt 2 dhe 3 të asaj Direktive. Nga ana tjetër, dispozitat e Kapitullit 1 të asaj direktive, i cili përfshin nenet 1 dhe 2 të saj, janë të një natyre të ndryshme. Në fakt, këto të fundit nuk përcaktojnë periudha minimale të kohës së pushimit as nuk kanë të bëjnë me aspekte të tjera të organizimit të kohës së punës, por përcaktojnë përkufizimet e nevojshme për të kufizuar objektin e Direktivës 2003/88 si dhe fushën e saj të veprimit.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se, nga formulimi i nenit 15 të Direktivës 2003/88, i lexuar në dritën e sistemit të krijuar nga ajo direktivë, rrjedh se opsioni i parashikuar në nenin e fundit nuk zbatohet për përkufizimin e konceptit të “kohës së punës”, që parashikohet në nenin 2 të asaj direktive.

Nga ana tjetër, Gjykata arsyetoi se neni 2 i Direktivës 2003/88 duhet të interpretohet se nuk iu kërkon shteteve anëtare të përcaktojnë shpërblimin për periudhat e gatishmërisë në shtëpi, siç janë ato në fjalë në procedurat kryesore në bazë të kualifikimit paraprak të këtyre periudhave si “kohë pune” ose “periudhë pushimi”. Në lidhje me këtë, duhet të kihet parasysh se është e zakonshme që Direktiva 2003/88 nuk rregullon çështjen e

shpërblimit të punëtorëve, pasi kjo çështje, sipas nenit 153 (5) të TFBE-së, nuk përfshihet brenda kompetencave të BE-së. Prandaj, megjithëse shtetet anëtare janë të lira të caktojnë shpërblimin e punonjësve që përfshihen në fushën e Direktivës 2003/88 në funksion të përkufizimit të koncepteve të "kohës së punës" dhe "periudhës së pushimit", që figurojnë në nenin 2 të kësaj Direktive, ato nuk janë të detyruara ta bëjnë këtë.

Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, neni 2 i Direktivës 2003/88 duhet të interpretohet në kuptimin që koha e shërbimit që kalon një punëtor në shtëpi me detyrimin për t'iu përgjigjur thirrjeve të punëdhënësit të tij brenda 8 minutave, duke kufizuar ndjeshëm mundësitë për të pasur aktivitete të tjera, duhet të konsiderohet si "kohë pune". Gjykata shprehet se të përjashtosh nga koncepti i "kohës së punës" periudhën e gatishmërisë në shtëpi duke u kufizuar në regjimin e pranisë fizike në vendin e punës, do të vinte në dyshim objektivin e Direktivës 2003/88, që është garantimi i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, duke i lejuar ata të përfitojnë nga periudhat minimale të pushimit dhe periudhat e përshtatshme të ndërprerjes së punës.

Përveç kësaj, është e qartë nga praktika gjyqësore e Gjykatës se faktori përcaktues për klasifikimin e "kohës së punës", në kuptimin e Direktivës 2003/88, është fakti se punëtori është i detyruar të jetë fizikisht i pranishëm në një vend të caktuar nga punëdhënësi dhe të mbetet në dispozicion të këtij të fundit në mënyrë që të jetë në gjendje të ofrojë menjëherë shërbimet e duhura nëse është e nevojshme. Këto detyrime, të cilat e bëjnë të pamundur për punonjësit e interesuar të zgjedhin vendin e tyre të qëndrimit gjatë periudhave të shërbimit, duhet të konsiderohen si të përfshira në fushën e ushtrimit të funksioneve të tyre.

Së fundi, Gjykata theksoi se situata është e ndryshme në rastet kur i punësuarit është në gatishmëri sipas një sistemi shërbimi i cili kërkon që ai të jetë i arritshëm në çdo kohë pa qenë i detyruar të jetë i pranishëm në ambientet e punës. Sipas Gjykatës, edhe nëse ai është në dispozicion të punëdhënësit përderisa mund të kontaktohet, në këtë situatë, punëtori mund ta menaxhojë kohën e tij me më pak kufizime dhe t'i kushtohet interesave të tij. Në këto kushte, vetëm koha e lidhur me ofrimin e vërtetë të shërbimeve duhet të konsiderohet si «kohë pune», sipas kuptimit të Direktivës 2003/88.

Neni 29

E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

(3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;

(4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë; (5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

5. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

6. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI 10/18. PARASHTRUES: FAHRI DEQANI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/10/ki_10_18_agj_shq.pdf]

21 tetor 2019

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore e këtij rasti ishte se parashtruesit të kërkesës i ishin cenuar e drejta e lirisë dhe sigurisë (neni 29 i Kushtetutës), si dhe e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës), pasi ai ishte akuzuar për dy vepra penale dhe ishte mbajtur në paraburgim nga viti 2010 – 2012 dhe mandej nga viti 2013 deri në vitin 2018, në pritje të aktgjykimit përfundimtar.

Faktet kryesore

Parashtruesi i kërkesës ishte arrestuar me 31 korrik 2010 dhe ishte vendosur në paraburgim. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë kishte ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se kishte kryer veprat penale të “shtytjes në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë,” sipas nenit 147 [Vrasja e rëndë], lidhur me nenin 24 [Shtytja] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe “vrasje në tentativë,” sipas nenit 146 [Vrasja] në lidhje me nenet 20 [Tentativa] dhe 23 [Bashkëkryerja] të KPPK-së. Paraburgimi i tij në pritje të gjykit kishte zgjatur deri më 3 shtator 2012, kur Gjykata e Qarkut kishte nxjerrë vendimin, me të cilin ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim. Kundër aktgjykit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë. Më 26 nëntor 2013, Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe duke e kthyer çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim. Gjatë periudhës ndërmjet 3 shtatorit 2012 dhe 26 nëntorit 2013, paraburgimi i parashtruesit ishte paraburgim pas aktgjykit të dënues, përderisa, si rezultat i aktgjykit të Gjykatës së Apelit me të cilin rasti ndaj parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim, periudha e dytë e paraburgimit në pritje të gjykit kishte filluar me 26 nëntor 2013 dhe kishte vazhduar deri më datën e nxjerrjes së Aktgjykit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [PKR nr. 155/15], të 6 prillit 2018, me të cilin parashtruesi i kërkesës përsëri ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim efektiv. Kundër aktgjykit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë dhe, me 7 gusht 2018, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit. Kundër Aktgjykit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila më 19 shkurt 2019, me Aktgjykimin PML. Nr. 19/2019, e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Më 17 janar 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimi i Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, për vazhdimin

e paraburgimit në pritje të gjyqimit të tij, kishin shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri], dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Lidhur me nenin 31, paragrafi 2 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës argumentoi se ishte shkelur gjykimi brenda një kohe të arsyeshme, sepse atij i ishte vazhduar paraburgimi, siç pretendonte ai, për më shumë se 7 vjet. Ai më tej argumentoi se qëndrimi i tij edhe me tutje nën masën e paraburgimit ishte shkelje e së drejtës së lirisë dhe sigurisë dhe cenonte parimin e prezumimit të pafajësisë, duke pasur parasysh se ai faktikisht po e vuante një dënim dhe jo një masë të sigurisë, siç ishte përcaktuar me ligj.

Arsyetimi i Gjykatës

Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit, i konfirmuar nga Gjykata Apelit dhe Gjykata Supreme, nuk justifikonte vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës. Sipas Gjykatës Kushtetuese, gjykatat e rregullta kishin dështuar të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm se pse masat alternative (më të buta sesa paraburgimi) nuk ishin të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese mori parasysh se Gjykata Themelore kishte arsyetuar se përveç që ekzistonte dyshimi i bazuar për kryerjen e veprës penale, po ashtu kishte bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit për arsyet si në vijim: 1) marrë për bazë peshën e rëndë të veprës penale; 2) mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe rrethanat dhe mjedisin në të cilat ishte kryer vepra penale; 3) faktin se ende ishin të acaruar marrëdhëniet në mes të familjes së parashtruesit të kërkesës dhe familjes së viktimës; dhe se 4) ekzistonte rreziku se me lëshimin e parashtruesit të kërkesës në liri mund të vinte deri te përsëritja e veprës penale ose veprave të ngjashme. Këtë arsyetim të Gjykatës Themelore e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykata Kushtetuese vuri në pah se në lidhje me vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme përveç që vërtetoi arsyetimin dhe konstatimin e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, përdori saktësisht të njëjtin arsyetim sikurse dy gjykatat

e shkallës më të ulët. Gjykata Kushtetuese gjithashtu vuri në pah se argumenti i dhënë në vendimet e tri gjykatave të rregullta – sidomos faktin se ende ishin të acaruar marrëdhëniet në mes të familjes së parashtruesit (pandehurit) dhe familjes së viktimës dhe kjo lë të besohet se me lirimin e të pandehurit ai mund të përsëriste veprën penale – nuk mund të ishte pafundësisht bazë për vazhdimin e paraburgimit. Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin që, sidomos gjatë vitit 2017, vazhdimi i paraburgimit ndaj parashtruesit nga Gjykata Themelore pushoi të ishte i mbështetur në arsyetim relevant dhe të mjaftueshëm. Në këtë vazhdë, Gjykata Kushtetuese gjeti se Gjykata Themelore në pesë (5) Aktvendimet e saj të fundit të vitit 2017, në vazhdimësi kishte dhënë arsyetim identik. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese theksoi se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur shkelje të nenit 5 (3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në një numër të madh rastesh në të cilat gjykatat kishin përdorur formulime stereotipe për vazhdimin e paraburgimit, pa marrë parasysh dhe pa argumentuar bindshëm nevojën e vazhdimin të paraburgimit mbi bazën e fakteve dhe rrethanave specifike të rastit. Prandaj, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Themelore në këto aktvendime, i konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, ishte një arsyetim i përgjithësuar dhe jo mjaftueshëm i arsyetuar, ku qartësisht mungonte një analizë dhe vlerësim i argumentuar dhe bindës i fakteve dhe rrethanave konkrete të rastit. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese gjeti se vendimet e gjykatave të rregullta dështuan të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm se pse vazhdimi i paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës ishte i domosdoshëm dhe pse masat alternative nuk ishin të zbatueshme në rastin konkret. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se vazhdimi i paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në pritje të gjykimit të tij, i konfirmuar me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme Pml. nr. 357/201), të 22 dhjetorit 2017, përbënte shkelje të nenit 29, paragrafit 1, pikës (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5, paragrafin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese mori parasysh faktin se në ndërkohë parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me burgim efektiv përmes aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të 6 prillit 2018. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese sqaroi që kjo procedurë nuk ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese dhe se objekt i shqyrtimit ishte vetëm vlerësimi i aktgjykimin të Gjykatës Supreme, të kontestuar me kërkesë të parashtruesit (i 22 dhjetorit 2017),

përkitazi me procedurën e vazhdimit të paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës.

Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të kohëzgjatjes së masës së paraburgimit në pritje të dënimit të tij, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kjo çështje nuk binte në kuadër të fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, vendosi njëzëri që të shpallë kërkesën të pranueshme dhe, me shumicë votash, të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, i 22 dhjetorit 2017, nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], paragrafi 1, pika (2), të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri), paragrafi 3, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. IRLANDA kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%225310/71%22%5D%7D>

GJEDNJ [Seksioni i Tretë]

20 mars 2018

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: aplikimi ndërshtetëror, kërkesa për rishikim të një aktgjykimi bazuar në faktin e ri të pretenduar pa ndikim vendimtar në gjetjet e aktgjykimit fillestar. Vlerësimi i pragut në të cilin ‘trajtimi mizor dhe i pazakontë’ bëhet ‘torturë’ për qëllimet e nenit 3 të KEDNJ, dhe rrethanat në të cilat neni 15 ‘derogimi në kohë lufte ose në kohë të tjera emergjente’ lejojnë një devijim të vlefshëm nga standardet e vendosura nga neni 5 (E drejta për liri dhe siguri) dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt).

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Qeveria e Irlandës (Qeveria kërkuese) kundër Qeverisë së Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (Qeveria e paditur) më 16 dhjetor 1971 pranë Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Komisioni”) bazuar në nenin 24 të mëparshëm të Konventës. Komisioni miratoi raportin e tij më 25 janar 1976. Çështja iu referua Gjykatës nga Qeveria kërkuese. Fillimisht, rasti u bazua në pretendimet kundër praktikës së Qeverisë së Irlandës së Veriut e njohur si Operacioni Demetrius, i cili përbëhej nga një seri “masash jashtëgjyqësore të ndalimit dhe internimit të terroristëve të dyshuar.” Objektivi kryesor i këtyre masave ishin anëtarët e dyshuar të IRA-s, edhe pse pranohet se disa persona ishin arrestuar gabimisht në bazë të “informacioneve joadekuate ose të pasakta”. Një nga teknikat më serioze të marrjes në pyetje të përdorura për katërbëdhjetë të burgosur u bë e njohur si “pesë teknikat”. Kjo përbëhej nga sa vijon:

“Ngritja në mur (që detyron të paraburgosurit të qëndrojnë në një pozicion stresi për orë të tëra); Mbulimi (mbajtja e një çantë mbi kokat e të paraburgosurve gjatë gjithë kohës, përveç gjatë marrjes në pyetje); Nënshtrimi ndaj zhurmës së lartë të vazhdueshme; Privimi i gjumit; Privimi nga ushqimi dhe pijet.”

Pretendimet në rastin fillestar ishin që “dhuna fizike është përdorur ndonjëherë në zbatimin e dhunshëm të pesë teknikave.” Një i burgosur kaloi tre javë në spital pasi iu nënshtrua “shkelmave dhe rrahjeve, gjatë ose midis një serie ‘intervistash’ të kryera nga Dega e Posaçme ” (shih: paragrafi 111 i raportit origjinal në kërkesën [5310/71](#)). Të paktën dy të paraburgosur zhvilluan “simptoma akute psikiatrike” si rezultat i marrjes në pyetje (shih: paragrafin 104 të raportit origjinal në kërkesën [5310/71](#)).

Qeveria e paditur (Mbretëria e Bashkuar) në këtë rast argumentoi se këto masa ishin të nevojshme sepse “procedurat normale të rendit dhe ligjit ishin bërë të papërshtatshme për t’u marrë me terroristët e IRA-s”. Frikësimi i përhapur “e bëri të pamundur marrjen e provave të mjaftueshme për të siguruar një dënim penal kundër terroristëve të njohur të IRA-s në mungesë të një pranimi të fajësisë që është i pranueshëm ose të dëshmisë së policisë ose ushtrisë.” Hapësira të mëdha të vendbanimeve të komunitetit katolik ishin përcaktuar si zona të ndaluara për policinë dhe forcat e sigurisë. Kufiri ndërkombëtar paraqiste gjithashtu sfida për zbatimin e ligjit. Këta faktorë i bënë autoritetet britanike të arrinin në përfundimin se nuk kishte “shpresa për të fituar mbi terroristët me mjete politike.” Si të tilla, këto masa ishin të domosdoshme për t’u përballur me kërcënimin që paraqiste IRA e cila ishte angazhuar në një fushatë të organizuar dhe të motivuar politikisht, me qëllim për të përmbysur shtetin (shih: paragrafin 36 të raportit origjinal në kërkesën [5310/71](#)).

Qeveria irlandeze i kundërshtoi këto veprime. Duke vlerësuar se “Nëse trajtimi i personave në paraburgim.... përbënte një praktikë administrative në kundërshtim me nenin 3; nëse internimi pa gjyq dhe paraburgim.... përbënte një praktikë administrative në kundërshtim me nenet 5 dhe 6 në lidhje me nenin 15;” si dhe nëse Operacioni Demetrius – që shënjestronte disidentët e IRA-s – përbënte diskriminim në bazë të

opinionit politik (që do të shkelte nenin 14 për ndalimin e diskriminimit), GJEDNJ në kërkesën fillestare (5310/71) konstatoi se pesë teknikat shkaktuan “vuajtje intensive fizike dhe mendore për personat që u nënshtroheshin dhe gjithashtu çuan në shqetësime akute psikiatrike gjatë marrjes në pyetje”, por jo domosdoshmërisht shkaktuan lëndime trupore (shih: paragrafin 167 të raportit origjinal në kërkesën 5310/71).

Kësisoj, Gjykata arriti në përfundimin se pesë teknikat shkelnin nenin 3 pasi ato përbënin “trajtim çnjerëzor dhe degradues”. Megjithatë, ky trajtim nuk u konsiderua aq serioz sa të përbënte “torturë”, e cila ishte e rezervuar për shkeljen më të rëndë të nenit 3. Gjykata vendosi se megjithëse neni 5 mund të ishte shkelur, ekzistenca e një emergjence që do të lejonte një derogim “është krejtësisht e qartë nga faktet”, duke arritur në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje. Gjykata konstatoi se neni 6 përputhej me nenin 5, që do të thotë se nuk kërkohej shqyrtim i mëtejshëm. Më në fund, pasi IRA kreu shumicën e dhunës, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të heshtur të nenit 14.

Përfundimisht, në vendimin e saj për çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* (5310/71, të datës 18 janar 1978), Gjykata theksoi se, në kontekstin e krizës në Irlandën e Veriut të shënuar nga terrorizmi dhe çrregullimi civil, përdorimi i pesë teknikave nga autoritetet për marrje në pyetje në vitin 1971 përbënte një praktikë të trajtimit çnjerëzor dhe degradues, në kundërshtim me nenin 3, dhe se përdorimi në fjalë i pesë teknikave nuk përbënte një praktikë torture sipas kuptimit të këtij neni.

Më 4 qershor 2014, rrjeti televiziv irlandez transmetoi një program të titulluar “Dosjet e torturës”, i cili diskutoi procedurat fillestare para Komisionit dhe Gjykatës dhe theksoi një numër dokumentesh, të cilat ishin vënë në dispozicion nga arkivat e Mbretërisë së Bashkuar. Më 4 dhjetor 2014, Qeveria kërkuese informoi Gjykatën se së fundmi kishte marrë dijeni për dokumentet, të cilat nuk ishin të njohura nga Gjykata në kohën e marrjes së vendimit dhe që mund të kishin një ndikim vendimtar në vendimin e Gjykatës për çështjen specifike, nëse përdorimi i pesë teknikave përbënte torturë ose jo.

Përmbledhja e pretendimeve

Qeveria kërkuese kërkoi rishikimin e vendimit të Gjykatës të 18 janarit 1978 në lidhje me efektin se përdorimi i pesë teknikave të marrjes në pyetje të cilat në përmbajtjen e tyre përbënin një praktikë jo thjesht të trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, por të torturës sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Rrjedhimisht, Qeveria kërkuese kërkoi rishikim të aktgjykimit në kuptim të rregullit 80 të Rregullores së Gjykatës për dy arsytet e mëposhtme:

– së pari, që një ekspert psikiatrik i thirrur nga Qeveria e paditur në procedurën fillestare kishte mashtruar Komisionin në lidhje me efektet e rënda dhe afatgjata të pesë teknikave, dhe,

– së dyti, se Qeveria e atëhershme e paditur kishte fshehur informacione të rëndësishme në lidhje me këto teknika.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të kërkesës për rishikim të vendimit fillestar të Gjykatës të nxjerrë nga Komisioni më 18 janar 1978, Gjykata theksoi fillimisht se rregulli 80 i Rregullores së Gjykatës që përcakton mundësinë e rishikimit të vendimit ishte një procedurë e jashtëzakonshme, rrjedhimisht, kërkesat për rishikim të vendimeve duhet t'i nënshtroheshin një shqyrtimi të rreptë.

Fillimisht, Gjykata vlerësoi (a) nëse afati kohor prej gjashtë muajsh i përcaktuar në rregullin 80.1 të Rregullores së Gjykatës është respektuar. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejti se Qeveria e paditur kishte parashtruar se Qeveria kërkuese kishte marrë disa dokumente të rëndësishme edhe para qershorit 2014. Ata argumentuan, së pari, se afati kohor prej gjashtë muajsh për një kërkesë rishikimi filloi të rrjedhë nga data, në të cilën Qeveria kërkuese mund të kishte ditur në mënyrë të arsyeshme faktet e reja dhe, së dyti, se faktet e konstatuara nga burime të qasshme publikisht do të trajtoheshin si të njohura.

Për sa i përket kërkesës të veçantë të rregullit 80.1, përkatësisht nëse fakti i ri “nuk mund të ishte i njohur në mënyrë të arsyeshme” për palën që

kërkon rishikim, ai lidhej me situata në të cilat faktet e reja që përbënin bazën për kërkesën për rishikim mund të kishin qenë tashmë të njohura për palën para dhënies së aktgjykimit origjinal, jo, si në rastin konkret, shumë kohë pas përfundimit të procedurës fillestare. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e jashtëzakonshme të procedurës së rishikimit, e cila vuri në pikëpyetje karakterin përfundimtar të vendimeve të Gjykatës, mund të argumentohet se pasi të ishte në dijeni për arsyet e mundshme për rishikim, një palë kishte një detyrë të caktuar të kujdesit dhe kështu duhej të ndërmerre hapa të arsyeshëm për të vërtetuar nëse arsye të tilla ekzistonin në të vërtetë, në mënyrë që ta vendosnin Gjykatën në një pozicion për të vendosur mbi çështjen pa vonesë (shih *Grossi dhe të tjerët kundër Italisë* (rishikim), 18791/03, 30 tetor 2012).

Kërkesa aktuale për rishikim ishte e një natyre komplekse: rrethanat dolën nga një numër i konsiderueshëm dokumentesh të cilat, të analizuar së bashku, e çuan Qeverinë kërkuese në përfundimin se kishte një bazë për të kërkuar rishikim. Qeveria kërkuese nuk kishte qëndruar pasive kur mori dokumente që mund të zbulonin fakte të reja para qershorit 2014. Këto dokumente ishin dorëzuar për shqyrtim nga avokati, i cili kishte këshilluar se ato nuk ishin në vetvete të mjaftueshme për të merituar një kërkesë për rishikim. Për sa i përket faktit nëse ata kishin për detyrë të bënin më shumë, duhet theksuar se dokumentet përkatëse nuk ishin të disponueshme. Qeverisë kërkuese do t'i duhej të kryente kërkime të gjera midis një game të gjerë dokumentesh potencialisht të rëndësishme në arkivat kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar.

Si përmbledhje, Qeveria kërkuese nuk kishte “marrë njohuri” për ndonjë fakt të ri para qershorit 2014. Gjykata gjithashtu dyshoi nëse Qeveria kërkuese mund të kishte “marrë njohuri” në mënyrë të arsyeshme për dokumentet që përmbajnë faktet në mbështetje të kërkesës së tyre për rishikim para qershorit 2014. Prandaj, kërkesa për revizion ishte dorëzuar brenda afatit gjashtë mujor të përcaktuar në rregullin 80.1 të Rregullores së Gjykatës.

Në vlerësim të asaj se (b) nëse ka pasur fakte “të cilat nga natyra [e tyre] mund të kenë një ndikim vendimtar” në vendimin e 18 janarit 1978, Gjykatat shqyrtoi fillimisht (i) objektin e kërkesës për rishikim. Në këtë rast, Gjykata vërejti se edhe pse Qeveria kërkuese nuk po kërkonte të

ndryshohej konstatimi i Gjykatës për shkeljen e nenit 3, por arsyet mbi të cilat bazohej ky përfundim, rishikimi i kërkuar lidhej me një gjetje të rëndësishme në lidhje me aktgjykimin fillestar të përcaktuar në dy pika të veçanta të dispozitivit të tij dhe përbënte çështje që mund të ishin objekt i kërkesës për rishikim.

Më pas, Gjykata shqyrtoi (ii) nëse dokumentet e paraqitura nga Qeveria kërkuese me pretendimet e tyre paraqitën fakte të reja. Gjykata ritheksoi se në ato raste kur dokumentet janë dorëzuar në mbështetje të një kërkesë për rishikim, duhej vlerësuar nëse ato ofronin prova të mjaftueshme *prima facie* në mbështetje të versionit të palës për ngjarjet. Për të bërë këtë vlerësim, Gjykata kishte parasysh zhvillimin e procedurës fillestare dhe në veçanti mënyrën në të cilën u vërtetuan faktet e rastit.

Lidhur me dokumentet e paraqitura në mbështetje të bazës së parë për rishikim, Gjykata dyshoi nëse dokumentet përmbanin prova të mjaftueshme *prima facie* të faktit të ri të supozuar se eksperti psikiatrik kishte mashtruar Komisionin në lidhje me efektet serioze dhe afatgjata të pesë teknikave. Sa i përket bazës së dytë të rishikimit, Gjykata vërejti se përderisa një numër dokumentesh të paraqitura në mbështetje treguan se Qeveria e atëhershme e Mbretërisë së Bashkuar donte të shmangte çdo hetim të detajuar në përdorimin e pesë teknikave, faktet përkatëse si të tilla nuk ishin “të panjohura” për Gjykatën në kohën e procedurës fillestare. Në vendimin fillestar, Gjykata kishte shprehur keqardhje për qëndrimin e Qeverisë së paditur, e cila jo gjithmonë i kishte ofruar ndihmën e dëshirueshme.

Në vlerësimin (iii) nëse faktet e reja të supozuara ishin me “ndikim vendimtar”, në mënyrë që të ndërmerrej rishikimi, duhej të tregohej se kishte një gabim fakti dhe një lidhje shkakësore midis faktit të vërtetuar gabimisht dhe një përfundimi, të cilin Gjykata e kishte nxjerrë. Duhet të ishte e qartë nga arsyetimi i përfshirë në vendimin fillestar se Gjykata nuk do të kishte arritur në një përfundim specifik nëse do të ishte në dijeni të gjendjes së vërtetë të fakteve. Në të kundërtën, aty ku mbetën dyshime nëse një fakt i ri kishte apo jo një ndikim vendimtar në vendimin fillestar, siguria juridike duhej të mbizotëronte dhe vendimi përfundimtar duhej të qëndronte.

Duke pasur parasysh formulimin e rregullit 80 dhe qëllimin e procedurës së rishikimit, kërkesa për rishikim nuk kishte për qëllim të lejonte një palë të kërkonte një rishikim në dritën e jurisprudencës së mëvonshme të Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata e bëri vlerësimin e saj në dritën e praktikës gjyqësore mbi nenin 3 siç ishte në atë kohë.

Në procedurat fillestare, Komisioni kishte theksuar se kishte ekspertë të tjerë që konsideronin se efektet e mëvonshme të aplikimit të pesë teknikave ishin mjaft të vogla dhe nuk prodhonin efekte afatgjata. Megjithatë, pasiguria në këtë drejtim nuk e kishte penguar atë të arrinte në përfundimin se përdorimi i pesë teknikave përbënte torturë sipas kuptimit të nenit 3.

Duke iu kthyer gjykimit fillestar, çështja e efekteve të mundshme afatgjata të përdorimit të pesë teknikave nuk ishte përmendur në vlerësimin ligjor. U konsiderua e vështirë të argumentohej se gjykimi fillestar i kishte kushtuar ndonjë rëndësi të veçantë pasigurisë për efektet e tyre afatgjata, e lëre më të konsiderohej ky si një element vendimtar për të arritur në një përfundim tjetër përveç përfundimit të arritur nga Komisioni në lidhje me çështjen kontestuese/pretendimet. Siç rrjedh nga arsyetimi i gjykimit fillestar, ndryshimi midis nocioneve “torturë” dhe “trajtim çnjerëzor dhe poshtërues” ishte një çështje shkalle në varësi të intensitetit të vuajtjes së shkaktuar. Domosdoshmërisht, vlerësimi i atij ndryshimi në shkallë, varej nga një sërë elementësh.

Pa një tregues në gjykimin fillestar se, po të ishte treguar se pesë teknikat mund të kishin efekte të rënda psikiatrike afatgjata, ai element do ta kishte çuar Gjykatën në përfundimin se përdorimi i pesë teknikave kishte pasojë “shumë serioze” dhe vuajtje mizore”, se ato duhej të cilësoheshin si një praktikë torture, Gjykata nuk mundi të arrinte në përfundimin se faktet e reja të supozuara mund të kishin një ndikim vendimtar në vendimin fillestar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi që kërkesa për rishikim të hedhet poshtë.

2.2. McKAY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

GJEDNJ [Seksioni i Tretë]

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%222543/03%22%5D%7D>

3 tetor 2006

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: shkelje e së drejtës në liri në pamundësi të paraqitjes para një gjyqtari që kishte kompetencë ligjore të aprovonte lirim nga paraburgimi

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Mark McKay (kërkuesi), shtetas britanik që jeton në Bangor, (Irlandë e Veriut) kundër Mbretërisë së Bashkuar. Më 6 janar 2001, në ora 10:00, kërkuesi u arrestua me dyshimin për kryerjen e një grabitjeje të një stacioni të benzinës në Bangor, Qarku Down. Më 7 janar 2001, ai pranoi se ishte përgjegjës për grabitjen, për të cilën u akuzua më pas ditën e nesërme. Më 8 janar 2001, në orën 10:00, kërkuesi bëri paraqitjen e tij të parë në Gjykatën e Magjistratëve (Magistrate Court), ku ai u kërkoi avokatëve të tij që të bënin një kërkesë për lirim me dorëzani. Oficeri i policisë i dha dëshmi gjykatës duke deklaruar se grabitja nuk ishte e lidhur me terrorizmin dhe se, sipas kushteve të duhura, ndaj tij nuk duhet të kishte kundërshtim për lirim me dorëzani. Gjyqtari rezident (Resident Judge) e refuzoi kërkesën, duke treguar se vepra penale ishte një vepër e caktuar dhe se në bazë të legjislacionit në fuqi ai nuk kishte fuqinë për të urdhëruar lirim. Më 8 janar 2001, kërkuesi bëri kërkesë në Gjykatën e Lartë për lirim me dorëzani, e cila pas dëgjimit më 9 janar 2001, e aprovoi atë. Më 12 prill 2001, pranë Gjykatës së Kurorës kërkuesi u shpall fajtor për veprën e grabitjes dhe u dënua me dy vjet burgim në një institucion korrektues të kryesve të rinj të veprave penale, pasuar me një vit sprovues. Kërkuesi bëri një kërkesë për shqyrtim gjyqësor duke u bazuar në papajtueshmërinë e legjislacionit të aplikueshëm në rastin e tij me nenet 5 dhe 14 të Konventës. Më 3 maj 2002, Gjykata e Lartë e hodhi poshtë kërkesën e kërkuesit. Më 16 maj 2002, Gjykata e Divizionit miratoi lejen për të apeluar në Dhomën e Lordëve duke vlerësuar se ankesa e

kërkuesit ishte me rëndësi të përgjithshme publike për shqyrtim nëse legjislacioni ishte në përputhje me Konventën dhe nëse neni 5 kërkon që gjykata, para së cilës sillet një i akuzuar në pajtim me nenin 5.3, ka fuqinë të vendosë për lirimin me dorëzani. Më 4 dhjetor 2002, e drejta për apelim u refuzua nga Dhoma e Lordëve. Ligji dhe praktika përkatëse vendase që rregullon çështjen në fjalë bazohet në nenin 67 (2) të Aktit të Terrorizmit të vitit 2000 (i cili hyri në fuqi më 19 shkurt 2001) që është në thelb i njëjtë me nenin 3 (2) të Aktit të vitit 1996 të Irlandës së Veriut (Dispozitat Emergjente, në fuqi në kohën e paraqitjes së parashtruesit), i cili ndër të tjera parasheh: “Duke iu nënshtruar nënparagrafëve (6) dhe (7) një person për të cilin zbatohet ky seksion nuk do të lirohet me dorëzani, përveç: (a) nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë ose i Gjykatës së Apelit, ose (b) nga gjyqtari i gjykatës së gjykimit për shtyrjen e gjykimit të një personi të akuzuar për vepër penale të caktuar.” Juridiksioni i vetëm i Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit dhe Gjyqtarit të Gjyqit për dhënien e lirit me dorëzani në rast të veprave penale të planifikuara daton nga viti 1973 dhe bazohet në dispozitat fillestare të Ligjit të Irlandës së Veriut (Dispozitat Emergjente) të vitit 1973. Arsyetimi rrjedh nga Raporti Diplock (“Raporti i Komisionit për të shqyrtuar procedurat ligjore për trajtimin e veprimtarive terroriste në Irlandën e Veriut” (1972 Cmnd. 5185), i cili konkludoi se magjistratët rezidentë që dëgjuan kërkesat për dorëzanimin ishin veçanërisht të ndjeshëm ndaj kërcënimeve. Akti i vitit 2000 parasheh pozitën, që do të shqyrtohet çdo vit nga Parlamenti dhe deri më tani është ripërtëritë për 12 muaj të tjerë. Në raportin e vitit 2002 të Rishikuesit të Pavarur, Lordi Carlile i Berriew Q.C. rekomandoi kthimin e kërkesave për lirim me dorëzani në gjykatën e magjistratëve. Ai rekomandoi që pushteti t’i jepej një numri të vogël të magjistratëve të trajnuar posaçërisht. Megjithatë, në raportin e tij të vitit 2004, ai vuri në dukje një rrezik të vazhdueshëm nga krimi i sofistikuar terrorist dhe nga shumë vepra të rënda penale me një lidhje të fortë terroriste, me krimin e bashkuar me një lidhje paraushtarake në rritje dhe me nivele të konsiderueshme të frikësimit. Gjatë marrjes në konsideratë për dhënien apo jo të kompetencës magjistratëve rezidentë për t’u marrë me kërkesat për lirimin me dorëzani, ai nuk e përsëriti rekomandimin e tij të mëparshëm, duke vërejtur se vlerësimi i sigurisë ishte se do të kishte një kërcënim të madh të frikësimit dhe të dhunës ndaj tyre dhe personave afër tyre. Ai megjithatë pajtohet që seancat e lirit me dorëzani duhet të jenë në dispozicion gjatë fundjavave dhe ky ndryshim kishte hyrë menjëherë në fuqi.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u ankua për faktin se personat e akuzuar për vepra penale të planifikuara nuk mund të kërkonin lirimin me dorëzani para gjykatës së magjistraturës. Atyre u kërkohet të bënin një kërkesë në Gjykatën e Lartë dhe mund të merrte deri në katër ditë para se të shqyrtohej kërkesa, gjë që sipas tij ishte në kundërshtim me nenin 5 të Konventës, pasi ndan kompetencën për dhënien e lirit me dorëzani nga gjykata, para së cilës një i akuzuar është sjellë në pajtim me nenin 5.3 dhe e lë të akuzuarin të kërkojë lirimin me dorëzani diku tjetër nga vendi ku bën propozimin e tij. Qeveria parashtroi se qëllimi i nenit 5.3 ishte të siguronte një mbrojtje kundër paraburgimit arbitrar duke ofruar një shqyrtim të pavarur për arsyet e ndalimit të një të akuzuari dhe për të siguruar lirimin, nëse vazhdimi i paraburgimit nuk ishte i justifikuar. Zyrtari gjyqësor në fjalë duhej të ishte i pavarur me kompetencën për të urdhëruar lirimin. Megjithatë, sipas Qeverisë, asgjë në tekstin e nenit 5 ose në jurisprudencën e Gjykatës nuk kërkon që gjykata, para së cilës duhet të sillet një person i arrestuar, duhet të jetë e njëjta gjykatë që ka fuqinë të vendos mbi dorëzaninë dhe lirimin me dorëzani. Sipas Qeverisë, personi i ndaluar duhet të sillet menjëherë përpara një gjykate ose zyrtari të autorizuar për të ushtruar pushtetin gjyqësor; ai duhet gjithashtu të ketë mundësinë për të aplikuar për lirim me dorëzani. Vetëm e para kërkohet të jetë automatike; e dyta - çështja e lirit me dorëzani, bëhet relevante vetëm kur arrestimi dhe paraburgimi konsiderohen të ligjshme dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht pjesë të shqyrtimit automatik të meritave. Qeveria parashtroi se neni 5.3 u respektua në rastin e kërkuesit. Gjyqtari kujdestar/magjistrati ishte në gjendje të shqyrtonte bazën ligjore, mbi të cilën kërkuesi ishte ndaluar dhe duhej të bindej se arrestimi dhe paraburgimi ishin të ligjshëm dhe, si rrjedhojë, nuk ishin arbitrare; nëse nuk do të ishte i bindur, gjyqtari do të ishte i detyruar të urdhëronte lirimin e kërkuesit. Kështu, kërkuesi mori një shqyrtim të shpejtë nga një gjyqtar, përkitazi me bazën ligjore të arrestimit dhe të vazhdimin të paraburgimit të tij. Ai gjithashtu kishte të drejtë dhe mori një shqyrtim të shpejtë nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë për të drejtën e tij për lirimin me dorëzani. Duke iu referuar hapësirës së vlerësimit, përfaqësuesit e Qeverisë konkluduan se legjislacioni përfaqësonte një ekuilibër të drejtë midis të drejtave individuale dhe kërkesave të mbrojtjes së shoqërisë kundër një rreziku të vazhdueshëm nga krimi terrorist dhe një shkallë të lartë kërcënimi dhe

ishte plotësisht në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Konventës në promovimin e sundimit të ligjit. Kërkuesi në anën tjetër pohoi se regjimi i veprave penale të planifikuara mbulonte shumë raste, të tilla si rasti i tij, ku nuk kishte as dyshim të bazuar për lidhje me terrorizmin dhe, rrjedhimisht, arsyetimi i Qeverisë nuk kishte bazë në fakt apo në politikë. Mbështetja në kërcënimet e mundshme të gjyqtarëve/magjistratëve në rastet terroriste nuk mund të justifikonte logjikisht heqjen e juridiksionit të tyre për të vendosur lidhur me çështjet e lirimit me dorëzani. Kërkuesi argumentoi se gjyqtari, para së cilit shfaqet një i akuzuar, duhej të ushtronte një autoritet gjyqësor, jo thjesht juridiksionin për të vendosur lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit, por gjithashtu nëse paraburgimi është i justifikuar objektivisht në bazë të meritave. Tutje, sipas tij, praktika gjyqësore e Gjykatës tregoi se shqyrtimi duhej të ishte mjaft i gjerë sa për të përfshirë rrethanat e ndryshme që ishin në favor të dhe kundër ndalimit. Edhe nëse hetimi mbi ligjshmërinë formale i parapriu logjikisht një hetimi mbi përshtatshmërinë e lirimit me dorëzani, ishte jo i duhur interpretimi i jurisprudencës, që lejonte heqjen e juridiksionit për të shqyrtuar lirimin me dorëzani. Sipas kërkuesit, detyrimi i pakushtëzuar që një person i ndaluar të paraqitet para një zyrtari të tillë, bie mbi shtetin dhe duhej të ndodhte menjëherë dhe automatikisht. Prandaj, kërkuesi parashtrroi se në rastin e tij kishte shkelje të nenit 5.3 që gjyqtari/magjistrati nuk kishte kompetencë të merrte parasysh lirimin me dorëzani dhe se atij i kërkohet, me propozimin e tij, të bënte një kërkesë për dorëzani. Një kërkesë e tillë mund të ndikonte veçanërisht te personat më të cenusshëm, siç janë të dobëtit apo të sëmurët mendorë, ata që i nënshtrohen keqtrajtimit në paraburgim ose që nuk janë në gjendje të flasin gjuhën e gjykatës.

Arsyetimi i Gjykatës

Duke pasur parasysh ankesat e kërkuesit dhe parashtrimet e palëve, Gjykata gjeti se lindin pyetje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Ankesa nuk mund të konsiderohet si e pabazuar në kuptim të nenit 35. 3 të Konventës, meqenëse nuk ishte përcaktuar asnjë arsye tjetër për shpalljen e saj të papranueshme. Gjykata vërejtë se kërkuesi ishte arrestuar më 6 janar 2001, në orën 10:00, me dyshimin për kryerjen e një vjedhje të një stacioni të benzinës, ndërsa u akuzua në orën 12.37 të mëngjesit, ditën pasuese. Më 8 janar 2001, në orën 10:00, kërkuesi bëri paraqitjen e tij të parë në gjykatën e magjistraturës, e cila e ktheu në

paraburgim. Për Gjykatën nuk ishte çështje diskutabile se magjistrati kishte kompetencën për të shqyrtuar ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit dhe nëse kishte baza të arsyeshme për dyshim dhe, për më tepër që, ai kishte fuqinë të urdhëronte lirim nëse këto kërkesa nuk ishin respektuar. Kjo vetëm siguroi garanci të kënaqshme kundër keqpërdorimit të pushtetit nga ana e autoriteteve dhe siguroi përputhjen me pjesën e parë të nenit 5.3 duke qenë e menjëhershme, automatike dhe duke u zhvilluar para një zyrtari gjyqësor të autorizuar në mënyrë të rregullt. Çështja e liritimit në pritje të gjykimit ishte një çështje e veçantë e cila logjikisht u bë e rëndësishme vetëm pas themelimit të ekzistencës së një baze të ligjshme dhe një baze të Konventës për paraburgim. Në rastin e kërkuarit, çështja u trajtue rreth njëzet e katër orë më vonë, më 9 janar 2001, nga Gjykata e Lartë e cila urdhëroi lirim të tij. Asnjë element i abuzimit ose arbitraritetit të mundshëm nuk vjen nga fakti se ishte një gjykatë apo gjykatës tjetër që e bëri këtë, as nga fakti që shqyrtimi ishte i varur nga kërkesa e tij. Avokati i kërkuarit paraqiti një kërkesë të tillë pa ndonjë pengesë ose vështirësi; nuk është e dukshme dhe as nuk duhet të vendoset në këtë rast, se sistemi në veprim do të parandalonte të dobët ose të pambrojturit që ta shfrytëzonin këtë mundësi. Ndonëse është e vërtetë se policia nuk kishte asnjë kundërshtim për lirim me kusht dhe se nëse magjistrati kishte pasur të drejtën të lirojë me kusht, kërkuari do të lirohej një ditë më parë, megjithatë Gjykata konsideroi se procedura në këtë rast është kryer me shpejtësinë e duhur, që çoi në lirim të tij tri ditë pas arrestimit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 5 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. FMS, FNZ, SA, SA JUNIOR kundër ORSZÁGOS IDEGENRENDÉSZETI FŐIGAZGATÓSÁG DÉL-ALFÖLDI REGIONÁLIS IGAZGATÓSÁG

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështjet e bashkuara C924/19 PPU dhe C925/19 PPU

14 maj 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=226495&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13707651>]

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: në këtë vendim, përveç interpretimeve të rëndësishme mbi situatën e azilkërkuesve sipas së drejtës së BE-së, GJDBE sqaron se vendosja e azilkërkuesve ose atyre që u është refuzuar azili në zonën e transitit Rösztke, duhet të cilësohet si heqje lirie

Faktet kryesore

Çështja C924/19 PPU ka të bëjë me një çift të martuar, FMS dhe FNZ, shtetas afganë. Sipas dëshmimeve të tyre, rreth tre vjet më parë, ata ishin larguar nga Afganistani për arsye politike për në Turqi me një vizë një mujore dhe se kjo vizë ishte zgjatur për gjashtë muaj nga autoritetet turke. Ata pohuan gjithashtu se kaluan përmes Bullgarisë dhe Serbisë përpara se të hynin në Hungari për herë të parë. Ata deklaruan se nuk kishin aplikuar për azil në asnjë vend tjetër dhe se nuk “nuk kanë qenë subjekt i ndonjë keqtrajtimi apo ndonjë sulmi serioz”, sipas kuptimit të nenit 15 të Direktivës 2011/95⁶⁵ (në tekstin e mëtejshëm: “Direktiva e Kualifikimit”).

⁶⁵ Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kualifikohen për mbrojtje shtesë, dhe për përmbajtjen e

Çështja C925/19 PPU kishte të bënte me një shtetas iranian, SA, dhe djalin e tij të mitur, SA i riu. SA dëshmoi se ai ishte larguar nga Republika Islamike e Iranit dy vjet e gjysmë më parë, me arsyetimin se ishte divorcuar nga gruaja e tij, se ai ishte afruar më shumë me fenë e krishterë, por pa u pagëzuar, dhe se gjatë fëmijërisë së tij ka qenë viktimë e dhunës seksuale nga ana e anëtarëve të familjes. Ai gjithashtu sqaroi se arsyet që e detyruan të largohet nga vendi i origjinës nuk ishin politike apo të lidhura me përkatësinë e mundshme të një komuniteti pakicë etnik ose fetar dhe se ai kishte mbërritur në Hungari nëpërmjet Turqisë, Bullgarisë dhe Serbisë.

Të gjithë këta persona mbërritën në Hungari përmes Serbisë, dhe paraqitën kërkesa për azil në zonën e transitit Röszke, që ndodhet në kufirin serbo-hungarez. Kërkesat e tyre u refuzuan si të papranueshme sepse ata kishin mbërritur në Hungari nga një vend i konsideruar i sigurt⁶⁶ ku nuk do të ekspozoheshin ndaj ndonjë rreziku të keqtrajtimit dhe për këtë arsye u miratuan vendime për kthimin e të gjithë këtyre personave në Serbi.

Megjithatë, Serbia refuzoi ripranimin e të interesuarve në territorin e saj, me arsyetimin se kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e ripranimit të lidhur me BE-në⁶⁷ nuk ishin përmbushur, përderisa parashtruesit ishin futur legalisht në Hungari. Pas këtij vendimi të autoriteteve serbe, Drejtoria Hungareze e Policisë së Migracionit nuk e shqyrtoi thelbin e kërkesave të sipërpërmendura për azil, por ndryshoi vendin e destinacionit të përmendur në vendimet fillestare të kthimit, duke e zëvendësuar atë me vendin e origjinës përkatëse të palëve të interesuara, përkatësisht Afganistan dhe Iran. Ankimet e parashtruesve kundër këtyre vendimeve të fundit u refuzuan gjithashtu. Megjithëse një ankim i tillë nuk parashikohet në ligjin hungarez, të gjithë azilkërkuesit në këto dy çështje iu drejtuan gjykatave hungareze me qëllim anulimin e

mbrojtjes së dhënë (rinovuar).

66 Ky nocion është parashikuar në nenin 33, paragrafi 2, (c), të Direktivës 2013/32. Në lidhje me këtë nocion shih edhe vendimin e GJDBE të 19 marsit 2020, *Bevándorlási és Menekültügyi Hivatal (Tompa)*, C564/18, EU:C:2020:218, paragrafët 36, 40 dhe 41.

67 Në lidhje me Serbinë shih marrëveshjen e lidhur mes Komunitetit Evropian dhe Republikës së Serbisë në lidhje me ripranimin e personave me qëndrim të parregullt, bashkëngjitur vendimit të Këshillit të 8 nëntorit 2007 (JO 2007, L 334, p. 45).

vendimeve që refuzonin kundërshtimin e tyre ndaj këtyre vendimeve që ndryshonin destinacionin e kthimit të tyre dhe kërkonin që autoritetet përgjegjëse për azilin të zhvillonin një procedurë të re azili.

Parashtruesit paraqitën gjithashtu padi për mosveprim në lidhje me vendosjen dhe mbajtjen e tyre në zonën e transitit Röscke. Në të vërtetë, fillimisht atyre iu kërkua të qëndronin në sektorin e kësaj zone transiti të rezervuar për azilkërkuesit, përpara se të urdhëroheshin të vazhdonin të qëndronin në sektorin e po kësaj zone për personat që u është refuzuar kërkesa për azil.

Zona e transitit Röscke, e vendosur në kufirin midis Hungarisë dhe Serbisë, rrethohej nga një gardh i lartë dhe tela me gjemba dhe brenda saj ka kontejnerë metalikë të destinuar veçanërisht për strehimin e shtetasve të vendeve të treta të pranishëm në këtë zonë. Sipërfaqja e kontejnerit, në të cilin ishin vendosur parashtruesit nuk kalonte 13 m² dhe ky kontejner ishte i pajisur me krevate marinari dhe dollapë. Prania e policisë ose e rojeve të armatosura sigurohej gjatë gjithë kohës brenda dhe jashtë kësaj zone transiti, si dhe në afërsi të rrethojës në fjalë.

Kjo zonë transiti ishte e ndarë në disa sektorë të destinuar për të akomoduar, veçmas, azilkërkuesit dhe shtetasit e vendeve të treta, kërkesat për azil të të cilëve janë refuzuar. Këta sektorë ishin të ndarë nga njëri-tjetri me rrethoja, në mënyrë që mundësia e lëvizjes nga një sektor në tjetrin të ishte jashtëzakonisht e kufizuar. Përveç kësaj, është e qartë nga urdhri për referencë në çështjen C-924/19 PPU se ishte e mundur të dilje nga një sektor vetëm dy herë në javë për afërsisht një orë, në mënyrë që të shkohej në sektorët e tjerë.

Szegedi Közigazgatási és Munkaügyi Bíróság⁶⁸ para së cilës ishin paraqitur këto ankesa pezulloi procedurat dhe i referoi disa pyetje Gjykatës së Drejtësisë të BE-së, duke u përqendruar në bazën e papranueshmërisë për vlerësimin e një vendi të sigurt transiti dhe natyrën e zonës së transitit Röscke, nëse mbajtja e parashtruesve në atë zonë përbënte ndalim *de facto* dhe, nëse po, a ishte ky ndalim në pajtim me të drejtën e BE-së.

68 Tribunali administrativ dhe i çështjeve të punës në Szeged, Hungari.

Përmbledhja e vendimit

Gjykata e Luksemburgut konstatoi se të gjitha këto pyetje që i janë adresuar nga Tribunali administrativ i Szeged, kishin të bënin me interpretimin e Direktivës 2008/115⁶⁹ (në tekstin e mëtejshëm: “Direktiva e Kthimit”), Direktivës 2013/32⁷⁰ (në tekstin e mëtejshëm: “Direktiva e Procedurave”) dhe Direktivës 2013/33⁷¹ (në tekstin e mëtejshëm: “Direktiva e Pritjes”), dhe nëse qëndrimet e autoriteteve hungareze të përshkruara më lart janë në përputhje me dispozitat e zbatueshme të këtyre Direktivave në rastin konkret.

Së pari, Gjykata i dha përgjigje pyetjes në lidhje me kompetencën e gjykatës kombëtare për të shqyrtuar padinë e parashtruesve për anulimin kundër vendimeve që refuzonin kundërshtimin e tyre ndaj modifikimit të vendit të kthimit⁷². Në përgjigjen e saj, Gjykata theksoi se një vendim që ndryshon vendin e destinacionit të përmendur në vendimin fillestar të kthimit është aq thelbësor sa duhet të konsiderohet si një vendim i ri për kthimin e parashtruesve. Sipas nenit 13 të Direktivës së Kthimit, personat në lidhje me të cilët merret një vendim i tillë duhet të kenë më pas një mjet juridik efektiv për t’u ankuar kundër tij, i cili gjithashtu duhet të jetë në përputhje me të drejtën për mbrojtje efektive gjyqësore të garantuar nga neni 47 i Kartës. Në këtë këndvështrim, Gjykata kujtoi se, ndërkohë që shtetet anëtare mund të parashikojnë që vendimet e kthimit të kundërshtohen para autoriteteve të tjera përveç autoriteteve gjyqësore, azilkërkuesi ndaj të cilët merret një vendim kthimi nga një autoritet administrativ duhet, megjithatë, në një fazë të caktuar të procedurës, të jetë në gjendje të kundërshtojë rregullsinë e tij përpara të paktën një organi gjyqësor.

Në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje se personat në fjalë mund të kundërshtonin vendimet e marra nga Drejtoria e policisë së

69 Titulli i plotë është Direktiva 2008/115/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 dhjetorit 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta të zbatueshme në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të paligjshëm.

70 Direktiva 2013/32/ BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 qershorit 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

71 Direktiva 2013/33/ BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 26 qershor 2013 mbi vendosjen e standardeve për pritjen e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare (e riformuar).

72 Që ishte pyetja e pestë që i drejtohej nga Tribunali hungarez.

migracionit dhe të modifikonin vendin e tyre të kthimit, vetëm duke i kundërshtuar vendimet para autoritetit përgjegjës për azilin dhe se një rishikim i mëvonshëm gjyqësor nuk ishte i garantuar. Megjithatë, Drejtoria e policisë së migracionit, duke qenë nën autoritetin e ministrit përgjegjës për policinë, hyn në pushtetin ekzekutiv, dhe në këto kushte nuk plotëson kushtin e pavarësisë që kërkohet të gëzojë një gjykatë në kuptimin e nenit 47 të Kartës. Në rrethana të tilla, parimi i përparësisë së të drejtës së BE-së, si dhe e drejta për mbrojtje efektive gjyqësore, kërkojnë që gjykata kombëtare të deklarohet kompetente për të dëgjuar ankesën që synon të kundërshtojë një vendim kthimi që ndryshon vendin e destinacionit fillestar, duke lënë të pazbatuara, nëse është e nevojshme, dispozitat kombëtare që e pengojnë atë ta bëjë këtë gjë.

Problemi i dytë me të cilin u mor Gjykata në këtë çështje⁷³ ishte nëse arsyet e papranueshmërisë të parashikuara nga legjislacioni hungarez mbi justifikimin e refuzimit të kërkesave për azil ishin apo jo të pajtueshme me të drejtën e BE-së. Ky legjislacion lejonte një refuzim të tillë kur parashtruesi kishte mbërritur në Hungari përmes një vendi të cilësuar si një “vend i sigurt transit” në të cilin ai nuk ishte ekspozuar ndaj persekutimit ose rrezikut të dëmtimit serioz, ose në të cilin i ofrohej një mbrojtje e përshtatshme.

Duke iu referuar praktikës së saj⁷⁴, Gjykata theksoi se natyra shteruese e arsyeve të papranueshmërisë të renditura sipas nenit 33.2 të Direktivës së Procedurave bënte që një arsye e tillë të ishte në kundërshtim me këtë nen. Ajo theksoi se legjislacioni në fjalë nuk përputhet me kërkesën e moskthimit dhe nuk ka asnjë tregues në lidhje me përmbajtjen e garancive të mbrojtjes adekuate në vendin transit. Për më tepër, thjesht kalimi transit i një personi përmes një vendi të tretë nuk mund të konsiderohet si një ‘lidhje’ sipas nenit 38.2 të Direktivës dhe vetëm elementi i transitit nuk mund të përmbushë detyrimet e autoriteteve kombëtare për të analizuar individualisht sigurinë e vendit të tretë dhe rëndësinë e marrëdhënies sipas të njëjtës dispozitë. Së fundmi, Gjykata theksoi se koncepti i vendi të sigurt të transitit nuk mund të

73 Që ishin pyetja e parë dhe e dytë që i drejtohehin nga Tribunali hungarez.

74 Vendimi i 19 marsit 2020, *Bevándorlási és Menekültügyi Hivatal* (Tompaa), C 564/18, BE: C: 2020: 218.

bazohet as në nenin 35, pasi ai nuk kushtëzohet nga gëzimi i mbrojtjes ndërkombëtare nga parashtruesi ose nga mbrojtja e përgjithshme e mjaftueshme ndaj moskthimit, e cila është një kërkesë sipas atij neni.

Në lidhje me pasojat e një vendimi papranueshmërie, Gjykata kujtoi se autoriteteve kombëtare u kërkohet të mos zbatojnë legjislacionin kombëtar që është në kundërshtim me një dispozitë drejtpërdrejt të zbatueshme të së drejtës së BE-së, siç është neni 33 i Direktivës së Procedurave. Megjithatë, ajo theksoi se një vendim administrativ që është nxjerrë në bazë të një ligji kombëtar që më vonë u konstatua se ishte i pazbatueshëm pasi ishte në kundërshtim me të drejtën e BE-së, nuk mund të priset nëse ka marrë formë të prerë. Pas një analize të gjerë të parimit *res judicata* në të drejtën e BE-së, Gjykata arriti në përfundimin se një autoriteti kombëtar për çështjet e azilit nuk i kërkohet të rishqyrtojë *ex officio* një kërkesë për mbrojtjen ndërkombëtare e cila është refuzuar si e papranueshme, kur ky refuzim është konfirmuar me një vendim gjyqësor por se vendimi është gjetur në kundërshtim me të drejtën e BE-së në vijim në bazë të jurisprudencës së mëvonshme të GJDBE-së. Sipas Gjykatës, kjo nuk kërkohet nga Direktiva e Procedurave, as nga neni 18 i Kartës, që garanton të drejtën për azil.

Megjithatë, Gjykata konfirmoi se palët e interesuara mund të paraqesin gjithmonë një kërkesë të re, e cila do të cilësohet si një “kërkesë e mëvonshme” në kuptimin e Direktivës së Procedurave. Në lidhje me këtë, megjithëse neni 33 i asaj Direktive parashikon që një kërkesë e mëvonshme e cila nuk zbulon ndonjë element apo fakt të ri mund të konsiderohet e papranueshme, ekzistenca e një vendimi të GJDBE-së që konstaton se një nga arsyet e papranueshmërisë sipas legjislacionit kombëtar është në kundërshtim me ligjin e BE-së, duhet të konsiderohet si një fakt i ri. Kjo edhe kur parashtruesi nuk i referohet shprehimisht asaj arsyeje në kërkesën e re. Për më tepër, në përgjithësi, Gjykata vendosi se arsyeja e papranueshmërisë e parashikuar në nenin 33 të Direktivës së Procedurave nuk është e zbatueshme kur autoriteti kombëtar i azilit konstaton se refuzimi përfundimtar i kërkesës së parë për azil është bërë në kundërshtim me të drejtën e BE-së. Ky konstatim është i domosdoshëm kur kjo papajtueshmëri është deklaruar nga një vendim i Gjykatës ose kur është vërtetuar, si një e gjetur anësore, nga një gjykatë kombëtare. Të pranosh ndryshe, sipas Gjykatës, do të thotë të mohohet

efektiviteti i së drejtës së parashtruesve për mbrojtje ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 18 të Kartës dhe në Direktivave 2011/95 dhe 2013/32, të përmendura më lart. Për këto arsye, dhe për të shmangur shkeljen e vazhdueshme të së drejtës së BE-së, neni 33.2 (d) i Direktivës së Procedurave nuk do të zbatohet për një aplikim të mëvonshëm kur autoriteti kompetent konstaton se refuzimi përfundimtar i kërkesës së parë është në kundërshtim me të drejtën e BE-së.

Problemi i tretë, dhe ndoshta më i rëndësishmi me të cilin u mor Gjykata në këtë çështje kishte të bënte me situatën e parashtruesve në zonën e transitit Röscke, në lidhje me rregullat që rregullojnë ndalimin e kërkuarve për mbrojtje ndërkombëtare⁷⁵ dhe atë të shtetasve të vendeve të treta në situatë të parregullt⁷⁶. Në lidhje me këtë, Gjykata vendosi fillimisht se vendosja e personave në fjalë në këtë zonë transiti duhet të konsiderohet si masë e heqjes së lirisë. Për të arritur në këtë përfundim, ai sqaroi se koncepti “heqje lirie”, i cili ka të njëjtin kuptim në kontekstin e Direktivave të ndryshme të lartpërmendura, i referohet një mase shtrënguese që nënkupton një privim dhe jo një kufizim të thjeshtë të lirisë së lëvizjes të personit të interesuar dhe e izolon atë nga pjesa tjetër e popullsisë, duke i kërkuar të qëndrojë përgjithmonë në një perimetër të vogël dhe të mbyllur. Megjithatë, për Gjykatën, kushtet që mbizotërojnë në zonën e transitit të Röscke përbëjnë një privim lirie, veçanërisht për shkak se personat në fjalë nuk mundën, ligjërisht, të largohen vullnetarisht nga kjo zonë në asnjë drejtim. Në veçanti, ata nuk mund të largohen drejt Serbisë, pasi një përpjekje e tillë, nga njëra anë, do të konsiderohej e paligjshme nga autoritetet serbe dhe, për rrjedhojë, do t’i ekspozonte ndaj sanksioneve dhe, nga ana tjetër, do të rrezikonte t’i privonte nga çdo mundësi për marrjen e statusit të refugjatit në Hungari.

Gjykata më pas shqyrtoi pajtueshmërinë e kësaj heqjeje lirie me kërkesat e vendosura nga e drejta e BE-së. Për sa i përket kritereve në lidhje me vendosjen e masës, Gjykata u shpreh se, në bazë të nenit 8 të Direktivës së Pritjes dhe nenit 15 të Direktivës së Kthimit, asnjë

75 Sipas Direktivave të Procedurave dhe të Pritjes.

76 Sipas Direktivës së kthimit.

kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare dhe asnjë shtetas i një vendi të tretë që i nënshtrohet një vendimi për kthimin, nuk mund t'u hiqet liria vetëm me arsyetimin se nuk mund të plotësojë nevojat e tyre. Ajo shtoi se nenet 8 dhe 9 të Direktivës së Pritjes dhe neni 15 i Direktivës së Kthimit përjashtojnë, respektivisht, që një kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare ose një shtetasi të një vendi të tretë që është objekt i një vendimi kthimi, t'u hiqet liria pa miratimin paraprak me një vendim të arsyetuar që urdhëron këtë masë dhe pa e shqyrtuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e një mase të tillë.

Gjykata sqaroi gjithashtu kriteret në lidhje me vazhdimin e heqjes së lirie dhe, më konkretisht, kohëzgjatjen e saj. Në lidhje me kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, ajo vendosi se neni 9 i Direktivës së Pritjes nuk kërkon që shtetet anëtare të caktojnë një periudhë maksimale të ndalimit. Megjithatë, ligji i tyre kombëtar duhet të sigurojë që paraburgimi të zgjasë vetëm për aq kohë sa arsyetimi që e justifikon atë gjen zbatim dhe që procedurat administrative në lidhje me këtë arsye të kryhen me kujdes. Nga ana tjetër, për shtetasit e vendeve të treta që janë objekt i një vendimi kthimi, nga neni 15 i Direktivës së Kthimit rezultojnë se heqja e lirisë, edhe kur zgjatet, nuk mund të kalojë afatin prej dhjetë muajsh dhe mund të zbatohet për sa kohë që procedurat e largimit janë në zhvillim e sipër dhe kryhen me gjithë kujdesin e duhur.

Për më tepër, në lidhje me ndalimin e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare në kontekstin specifik të një zone transiti, është gjithashtu e nevojshme të merret parasysh neni 43 i Direktivës së Procedurave. Nga kjo dispozitë rezultojnë se shtetet anëtare mund t'u kërkojnë kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare të qëndrojnë në kufijtë e tyre ose në një nga zonat e tyre të transitit, në mënyrë që, përpara se të vendosin për të drejtën e hyrjes së tyre në territor, të shqyrtojnë nëse kërkesa e tyre nuk është e papranueshme. Megjithatë, një vendim duhet të merret brenda katër javësh, në rast të kundërt, shteti anëtar në fjalë duhet t'i japë kërkuesit të drejtën për të hyrë në territorin e tij dhe për të paraqitur kërkesën e tij sipas procedurës së zakonshme. Prandaj, ndërkohë që shtetet anëtare, brenda kuadrit të një procedure të përmendur në nenin 43, mund t'i ndalojnë kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare që arrijnë në kufijtë e tyre, një ndalim i tillë nuk mund të kalojë në asnjë rrethanë katër javë nga data e paraqitjes së kërkesës.

Më në fund, Gjykata vendosi se ligjshmëria e një mase të heqjes së lirisë, siç është ndalimi i një personi në një zonë transiti, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, në zbatim, sidomos, të nenit 9 të Direktivës së Pritjes dhe nenit 15 të Direktivës së Kthimit. Prandaj, në mungesë të dispozitave kombëtare që parashikojnë një kontroll të tillë, parimi i sundimit të ligjit të BE-së dhe e drejta për mbrojtje efektive gjyqësore kërkojnë që një gjykatë kombëtare të deklarohet kompetente për të vendosur mbi këtë çështje. Për më tepër, nëse në fund të shqyrtimit të saj, gjykata kombëtare vlerëson se heqja e lirisë në fjalë është në kundërshtim me të drejtën e BE-së, ajo duhet të jetë në gjendje të zëvendësojë vendimin e autoritetit administrativ që e ka urdhëruar atë masë dhe të urdhërojë lirimin e menjëhershëm të personave në fjalë, ose të mund të vendosë një masë alternative ndaj heqjes së lirisë.

Përveç kësaj, kur heqja e lirisë së një kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare, është konsideruar e paligjshme dhe ka përfunduar, ai duhet të jetë në gjendje të përfitojë nga kushtet materiale të pritjes që i takon gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij. Në veçanti, nga neni 17 i Direktivës së Pritjes del se, nëse ai nuk ka mjetet e jetesës, ai ka të drejtë të marrë ose një kompensim financiar që i mundëson të gjejë strehim ose një akomodim. Nga ky këndvështrim, neni 26 i Direktivës së Pritjes parashikon që një kërkues i tillë të jetë në gjendje të bëjë një padi para një gjykate që synon t'i garantojë atij këtë të drejtë strehimi, duke pasur mundësinë e dhënies së masave të përkohshme në pritje të vendimit përfundimtar. Nëse asnjë gjykatë nuk ka juridiksion sipas ligjit kombëtar, parimi i epërsisë së ligjit të BE-së dhe e drejta për mbrojtje efektive gjyqësore kërkojnë, edhe në këtë rast, që një gjykatë të deklarohet kompetente për të dëgjuar pretendimet dhe për të garantuar këtë të drejtë për strehim.

Neni 30

Të Drejtat e të Akuzuarit

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;*
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;*
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;*
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;*
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI29/15. PARASHTRUES: BARDHYL KAMERI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_29_15_shq.pdf]

26 tetor 2015

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Çështja kryesore e ngritur përmes kësaj kërkesë ishte se a i ishin cenuar parashtruesit të kërkesës të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], pasi që Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, përkritazi me dënimin e tij me kusht për veprën penale vjedhje e rëndë.

Faktet kryesore

Më 19 qershor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e rëndë” dhe i kishte shqiptuar dënimin me kusht, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Më 18 gusht 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës kishte miratuar ankesën e Prokurorit Publik në Gjilan, përkritazi me vendimin për dënim, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës masën e burgimit efektiv në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. Më 6 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për zëvendësimin e dënimit me burg me masën e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi. Më 10 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se me shqiptimin e dënimit me burgim ishin shkelur nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese theksoi se parashtruesi i kërkesës pretendonte se të drejtat e tij ishin shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta. Por, sipas Gjykatës Kushtetuese, ai nuk kishte treguar se si këto vendime kishin shkelur të drejtat e tij kushtetuese (duke përfshirë edhe të drejtat e të akuzuarit, të garantuar me nenin 30 të *Kushtetutës*). Parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* e cila do të argumentonte shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit për *Gjykatën Kushtetuese* dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

1.2. KI106/10. PARASHTRUES: BINAK THAQI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_106_10_shq.pdf]

4 tetor 2011

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: *Parashtruesi i kërkesës në këtë rast ishte dënuar për vrasje me armë të zjarrit dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Sipas parashtruesit, gjatë procedurave në gjykatat e rregullta atij i ishin shkelur një mori të drejtash kushtetuese, duke përfshirë të drejtat nga neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], si dhe të drejtat sipas neneve 5, 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës. Kjo për arsye se një raport i autopsisë që ishte pranuar në gjykimin e tij kishte qenë në gjuhën angleze, duke e privuar kështu parashtruesin nga mundësia për ta kontestuar raportin ose për ta përdorur atë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve.*

Faktet kryesore

Më 21 tetor 2007, Gjykata e Qarkut në Pejë e kishte dënuar parashtruesin e kërkesës për vrasje, sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Kundër këtij vendimi, parashtruesi përmes avokatit të tij mbrojtës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke u thirrur në një sërë bazash. Këto baza përfshinin keqinterpretimin nga Gjykata e Qarkut të një numri të madh të fakteve dhe arritjen në konkluzione të shumta të gabuara. Në ankesë, parashtruesi gjithashtu kishte pretenduar se vetëmbrojtja nuk ishte konsideruar drejt nga Gjykata e Qarkut. Ankesa gjithashtu i ishte referuar dënimit me burg për të dy akuzat, duke theksuar se dënimet ishin shumë të ashpra. Më 25 shtator 2008, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte hedhur poshtë ankesën si të pabazuar. Më 14 gusht 2009, parashtruesi përmes avokatit të tij mbrojtës kishte paraqitur propozim për rihapjen e procedurës, në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Baza përfshinte, por nuk ishte e kufizuar në faktin që ekzistonte një raport i pakompletuar i autopsisë lidhur me shkaqet e vdekjes dhe se raporti i autopsisë ishte vetëm në gjuhën angleze. Gjykata e Qarkut në Pejë, me vendimin e 8

prillit 2010, e kishte hedhur poshtë kërkesën për rihapjen e procedurës penale, duke theksuar se çështja ishte *res judicata*. Parashtruesi kishte paraqitur ankesë kundër këtij vendimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe, më 12 korrik 2010, Gjykata Supreme e kishte refuzuar ankesën si të pabazuar. Parashtruesi më pas kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe, më 1 shtator 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë e kishte hedhur poshtë këtë kërkesë si të papranueshme. Parashtruesi kishte paraqitur ankesë kundër këtij vendimi dhe, më 5 tetor 2010, Gjykata Supreme e kishte refuzuar ankesën si të pabazuar.

Më 21 tetor 2010, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi në kërkesë pretendoi se i ishin shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 5 [Gjuhët], nenin 24.2 [Barazia para Ligjit], nenin 30.1 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31.1.4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]. Pretendimi themelor i parashtruesit ishte se raporti i autopsisë për të ndjerin (viktimën) ishte në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe dhe se parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij nuk kishin pasur mundësi ta kontestonin atë (ta vinin atë në dyshim), apo t'u shtronin pyetje dëshmitareve në lidhje me raportin në fjalë.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht shqyrtoi pranueshmërinë e kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata theksoi së thelbi i kërkesës kishte të bënte me pretendimin se raporti i autopsisë ishte në gjuhën angleze dhe se parashtruesi nuk kishte pasur mundësi ta kuptonte përmbajtjen e tij apo të shtronte pyetje në mënyrë të kryqëzuar lidhur më të. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesi nuk tregonte (argumentonte) se cila provë në raportin e autopsisë do të kishte pasur vlerë përkatëse provuese për të hedhur dyshim në aktgjykimin origjinal dhe në dënimin për vrasje dhe përdorim të paautorizuar të armës.

Më tutje, Gjykata Kushtetuese sqaroi se ajo nuk e gëzon juridiksionin e apelit dhe, parimisht, ajo nuk mund të ndërhynte në mënyrën se si gjykatat e rregullta kishin bërë vlerësimin e fakteve dhe kishin marrë vendimet përkatëse. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj, ajo nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se nuk kishte prova në kërkesë për të sugjeruar që parashtruesi e kishte kundërshtuar raportin e autopsisë në gjuhën angleze, mungesën e tij në gjuhën shqipe, apo mundësinë e tij të humbur për ta vënë në pyetje raportin apo për t’u parashtruar dëshmitarëve pyetje në mënyrë të kryqëzuar gjatë gjykimit fillestar në Gjykatën e Qarkut në Pejë. As që këto çështje ishin ngritur në ankesën e parashtruesit, të 21 prillit 2008, drejtuar Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se parashtruesi nuk i kishte shteruar mjetet juridike dhe, për pasojë, kërkesa ishte e papranueshme.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 55 (2) të Rregullores së punës, me shumicë votash, vendosi ta shpallë kërkesën të papranueshme.

2.PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. ALEKSANDR ALEKSANDROV kundër RUSISË

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2214431/06%22%5D%7D>

[Seksioni i Tretë]

10 shtator 2018

Çështja kyç/e drejta e pretenduar; gjykata i kishte dhënë një dënim me burg për arsyen e vetme që ai nuk kishte një vendbanim të përhershëm në rajonin në të cilin ishte gjykuar; vendbanimi ishte përmendur në mënyrë eksplicite si një faktor në vendimin e dënimit, kjo kishte bërë një dallim në trajtimin e barabartë midis parashtruesit dhe shkelësve të tjerë të dënuar për vepra të ngjashme.

Faktet kryesore

Kërkesa ishte ngritur më 10 shkurt 2006 nga Aleksandr Valeryevich Aleksandrov, një shtetas rus (kërkuesi) kundër Federatës Ruse. Në vitin 2005, një gjykatë rrethi në Moskë e kishte shpallur kërkuesin fajtor për shkelmimin e një polici deri sa kërkuesi ishte në gjendje të dehur dhe e kishte dënuar atë me një vit burg. Kur vendosi për dënimin e duhur, gjykata renditi një numër rrethanash të cilat e bënë kërkuesin *prima facie* të përshtatshëm për një dënim me burgim, e jo për një dënim tjetër siç është lirimi me kusht ose një gjobë. Megjithatë, u konstatua se dy elemente e rënduan të drejtën e kërkuesit për një dënim më të butë, i pari ishte “rrethanat e veçanta në të cilat ishte kryer vepra penale”, dhe i dyti ishte mungesa e një vendbanimi të përhershëm brenda Rajonit të Moskës, i cili nuk ishte rajoni i vendbanimit të zakonshëm të kërkuesit, por rajoni ku ishte kryer vepra dhe ishte shpallur dënimi. Ankesa e kërkuesit ishte hedhur poshtë.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u bazuar në nenin 14 të Konventës, kërkuesi u ankua se gjykata i kishte dhënë një dënim me burgim për arsyen e vetme që ai nuk kishte një vendbanim të përhershëm në rajonin në të cilin ishte gjykuar.

Qeveria pretendoi se kërkuesi ishte dënuar nga një gjykatë kompetente dhe se dënimi i tij ishte përcaktuar në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit të brendshëm. Ata argumentuan më tej se çështjet e drejtësisë së procedurave penale dhe të dënimit të përshtatshëm binin brenda fushës së nenit 6 të Konventës dhe, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, ishin jashtë kompetencave të Gjykatës. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, gjykata dënuese kishte marrë parasysh natyrën e veprës penale dhe personalitetin e kërkuesit. Mungesa e vendbanimit të përhershëm në Moskë ose në Rajonin e Moskës ishte marrë parasysh, por kjo nuk ishte as arsyeja e vetme dhe as vendimtare për të vendosur për të mos shqiptuar një dënim me kusht. Qeveria më në fund parashtrroi se kërkuesi nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi të paragjykimimit nga ana e gjykatave vendase ose shembuj të rasteve analoge ku ishin dhënë dënime me kusht.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht vuri në pah se neni 14 plotësonte dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe Protokolleve. Pra, neni 14 nuk ka ekzistencë të pavarur, pasi ka efekt vetëm në lidhje me “gëzimin e të drejtave dhe lirive” të mbrojtura nga ato dispozita. Sidoqoftë, zbatimi i nenit 14 nuk nënkupton domosdoshmërisht shkeljen e një prej të drejtave thelbësore të garantuara nga Konventa, dhe në këtë masë është autonome. Në mënyrë që një çështje të lindë sipas nenit 14 duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge, ose përkatësisht të ngjashme (shih *DH dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [DHM], nr. 57325/00, 175, KEDNJ 2007-IV). Megjithatë, vetëm dallimet në trajtim të bazuara në një karakteristikë personale (ose “status”) me të cilat personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri, janë bazë për zbatimin e nenit 14. Sipas Gjykatës, fjalët “status tjetër”, në tekstin e kësaj dispozite në përgjithësi, u është dhënë një kuptim i gjerë dhe interpretimi i tyre nuk është kufizuar në karakteristikat, të cilat janë personale në kuptimin që ato janë të lindura ose të qenësishme.

Gjykata ritheksoi se një trajtim i ndryshëm i personave në situata analoge ose përkatësisht të ngjashme do të konsiderohet diskriminues vetëm nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm - me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një bazë të arsyeshme, dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet për t'u realizuar. Si rregull i përgjithshëm, shteti kontraktues gëzon një marginë mirëkuptimi në vlerësimin nëse dhe në çfarë mase dallimet në situata të tjera të ngjashme justifikojnë një trajtim të ndryshëm.

Gjykata përsëriti se çështjet e dënimit të përshtatshëm dalin, në parim, jashtë fushëveprimit të Konventës dhe nuk është roli i saj të vendosë se cila është kohëzgjatja e përshtatshme e (para)burgimit e zbatueshme për një vepër të veçantë. Megjithatë, kur një politikë apo vendim dënimi prek individët në një mënyrë diskriminuese - për shembull, kur dënimi me burgim i përcaktuar në bazë të dispozitave ligjore vendore dallon midis shkelësve për shkak të moshës ose gjinisë së tyre - Gjykata ka pranuar se mund të ketë një pretendim të argumentueshëm për shkelje të nenit 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 5.1 (a).

Në përputhje me rrethanat, rasti aktual duhet të merret në lidhje me një vendim individual i cili, sipas kërkuesit, paraqiti një ndryshim në trajtim bazuar në vendbanimin e tij. Prandaj, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse shteti i paditur kishte paraqitur një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtim të ndryshëm të pretenduar.

Fillimisht, Gjykata theksoi se kërkuesi u privua nga liria pasi u dënua nga një gjykatë kompetente, një rast që mbulohet shprehimisht nga neni 5.1 (a) i Konventës. Gjykata theksoi se faktet e çështjes binin “brenda fushës” së nenit 5 të Konventës. Prandaj, sipas Gjykatës, neni 14 i Konventës ishte i zbatueshëm në rastin konkret.

Përkitazi me dy bazat, mbi të cilat gjykata refuzoi që kërkuesit t'i shqiptojnë një dënim tjetër, e jo burgimi, Gjykata vërejti se e para prej tyre, një referencë në “rrethanat e veçanta” të veprës, mund të merrej si një analizë e situatës *de fakto*. Edhe pse gjykata nuk shpjegoi, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, arsyen që kërkonte një ndëshkim më të ashpër të kërkuesit, kjo bazë nuk ishte diskriminuese në shikim të parë.

Ndërsa baza e dytë e mbështetur nga gjykata - mungesa e vendbanimit të përhershëm të kërkuesit brenda Rajonit të Moskës - kërkonte një qasje të ndryshme. Gjkata theksoi se ajo tashmë kishte konstatuar se “vendi i banimit përbën një aspekt të statusit personal për qëllimet e nenit 14”. Përderisa vendbanimi i kërkuesit u përmend në mënyrë shprehimore si një faktor në vendimin e dënimit, ai paraqiti një ndryshim në trajtim të mbështetur në këtë bazë, midis kërkuesit dhe shkelësve të tjerë të dënuar për vepra të ngjashme. Gjkata gjithashtu theksoi se ndryshimi në trajtimin e paraqitur nga Gjkata e Qarkut Chertanovskiy dhe e vërtetuar në apel nga Gjkata e Qytetit të Moskës nuk duket se rrjedh nga ligji i brendshëm dhe se Kodi Penal parashikon mundësinë që një person, i cili është duke vuajtur një dënim me kusht, të ndryshojë vendbanimin e tij në kushte të caktuara.

Sipas mendimit të Gjykatës, nuk është e nevojshme të përcaktohet se deri në çfarë mase secila nga këto dy baza ndikoi në masën e dënimit, për të cilën u ankua kërkuesi. Gjkata përsëriti se në rastet e diskriminimit ku më shumë se një bazë është pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm të situatës së kërkuesit, bazat nuk duhet të konsiderohen në mënyrë alternative, por në të njëjtën kohë (të gjitha bazat). Rrjedhimisht, paligjshmëria e njëres prej arsyeve ka efektin e komprometimit të të gjithë vendimit. Prandaj, Gjkata duhej të shqyrtonte nëse vendimi që vendos një dallim bazuar në vendbanimin e kërkuesit ishte i justifikuar në mënyrë objektive dhe të arsyeshme.

Gjkata pranoi se në vendosjen nëse një dënim jo me burg do të ishte i përshtatshëm për arritjen e objektivave të drejtësisë penale, gjykatat vendase mund të marrin në konsideratë ndikimin e rrethanave personale të shkelësit në mënyrën e zbatimit të tij. Sidoqoftë, mbështetja në çdo bazë të mbrojtur sipas nenit 14 të Konventës do të kërkonte një justifikim që mund të kalojë për një arsye objektive dhe të arsyeshme. Në rastin konkret, Gjkata vuri në dukje se gjykata vendëse thjesht tregoi se kërkuesi nuk kishte vendbanim të përhershëm brenda Rajonit të Moskës, dhe rajoni ku gjendej nuk ishte rajoni i vendbanimit të zakonshëm të kërkuesit, por rajoni ku ishte kryer vepra penale. Por ajo nuk kishte shpjeguar në asnjë formë rëndësinë e këtij fakti në vendimin për shqiptimin e dënimit me burg. Ndërsa pranoi ekzistencën e lidhjeve të forta shoqërore në qytetin e lindjes të tij, Cheboksary, ku ai kishte

referenca të mira nga fqinjët dhe kolegët e tij të punës, Gjykata e rrethit nuk justifikoi pse përfitimi i një dënimi jo me burgim duhej të ishte i kushtëzuar me faktin e të pasurit një vendbanim të përhershëm jashtë rajonit të tij të lindjes dhe pranë vendit ku ai ishte gjykuar dhe dënuar. Gjykata e apelit, nga ana e saj, nuk e trajtoi argumentin e diskriminimit të bërë nga avokati i kërkuesit dhe nuk ofroi asnjë justifikim për dallimin në trajtim.

Gjykata theksoi se, në përgjigjen e saj, Qeveria nuk kishte argumentuar se çfarë qëllimi legjitim kishte dallimi në trajtimin e ndjekur dhe si mund të justifikohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme. Faktorët që Qeveria kishte përmendur ishin thjesht shpjegime të mekanizmave që çuan në dallimin në trajtim, për të cilin u ankuan. Në çdo rast, Gjykata sqaroi se nuk i takonte Gjykatës të spekulonte mbi arsyet e vendimeve të gjykatave vendase, kur ato arsye nuk janë të dukshme nga vendimet e gjykatave.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se nuk ishte dëshmuar se dallimi në trajtim kishte ndjekur një qëllim legjitim ose kishte pasur një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se në rastin e kërkuesit ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës, në ndërlidhje me nenin 5. Gjykata vendosi që kërkuesit t'i paguheshin 10,000 (dhjetë mijë) euro dëmshpërblim, në emër të dëmit jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. CIPRIAN VASILE RADU

GJDBE

Çështja C - 396/11

29 janar 2013

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=132981&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13707840>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Në rastin e miratimit të një urdhër-arresti evropian, nuk është e nevojshme që personi në fjalë të dëgjohet përpara se të miratohet ky urdhër.

Faktet kryesore

Më 25 maj dhe 3 qershor 2009, Gjykata e Apelit e Konstancës në Rumani, si autoriteti gjyqësor ekzekutues, mori disa kërkesa nga autoritetet gjyqësore gjermane në lidhje me dorëzimin e z. Radu, i kërkuar në lidhje me katër urdhra-arresti evropianë të lëshuara nga prokurorët gjermanë të Münsterit, Coburgut, Bielefeldit dhe Verdenit, respektivisht, më 14 mars 2007, 16 mars 2007, 8 gusht 2007 dhe 26 shkurt 2008, në lidhje me veprën penale të vjedhjes me dhunë sipas kuptimit të nenit 211 të Kodit Penal rumun. z. Radu nuk pranoi të dorëzohej.

Me vendim të 5 qershorit 2009, Gjykata e Apelit e Konstancës urdhëroi ekzekutimin e tri urdhër-arresteve evropiane, përkatësisht ato të lëshuara nga prokurorët e Münsterit, Koburgut dhe Verdenit. Nga ana tjetër, ajo gjykatë refuzoi, sipas nenit 98 (2) (b) të Ligjit nr. 302/2004, ekzekutimin e urdhër-arrestit evropian të lëshuar më 8 gusht 2007 nga Zyra e Prokurorit publik të Bielefeldit, me arsyetimin se z. Radu është paditur në Rumani para Gjykatës së Bacău për të njëjtin fakt që përbën thelbin e urdhrit në fjalë. Prandaj, ajo shtyu dorëzimin e z. Radu deri në përfundimin e procedurave mbi këtë rast

përpara gjykatave rumune, duke mbajtur në fuqi masën parandaluese të ndalimit të marrë kundër z. Radu për një periudhë prej tridhjetë ditësh.

Me vendimin e 18 qershorit 2009, Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe e Drejtësisë e Rumanisë e anuloi këtë vendim dhe e dërgoi çështjen në Gjykatën e Apelit të Konstancës. Ajo urdhëroi gjithashtu lirimin e z. Radu, duke e shoqëruar atë me një masë parandaluese që i kufizonte të drejtën e tij për të lëvizur lirshëm, domethënë ndalimin e largimit nga komuna e vendbanimit të tij, qyteti Bacău, pa njoftuar gjyqtarin, dhe duke i imponuar disa detyrime të tjera.

Në seancën e 22 shkurtit 2011 në Gjykatën e Apelit të Konstancës, z. Radu kundërshtoi ekzekutimin e urdhër-arresteve evropiane të lëshuara kundër tij. Ai argumentoi, para së gjithash se, në datën e miratimit të Vendimit Kuadër 2002/584, as të drejtat themelore të parashikuara në KEDNJ dhe as ato që përfshihen në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejme: “Karta”) nuk ishin përfshirë shprehimisht në Traktatet e BE-së. Megjithatë, në bazë të nenit 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE), dispozitat e Kartës dhe të KEDNJ-së ishin bërë pjesë e së drejtës parësore të Bashkimit Evropian dhe, për rrjedhojë, Vendimi Kuadër 2002/584 tani e tutje duhet të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Kartën dhe KEDNJ-në. Më tej, z. Radu nënvizoi se ky Vendim Kuadër nuk është zbatuar në mënyrë koherente nga shtetet anëtare. Në veçanti, legjislacioni gjerman që ka transpozuar Vendimin Kuadër të lartpërmendur, u shpall antikushtetues dhe i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë (Bundesverfassungsgericht), në vendimin e saj të 18 korrikut 2005, para se të miratohej një ligj i ri. Në këto rrethana, ekzekutimi i një urdhërarresti evropian do t’i nënshtrohej një kushti reciprociteti. Së fundmi, z. Radu argumentoi se autoritetet gjyqësore të shtetit anëtar ekzekutues duhet të verifikojnë nëse të drejtat themelore të garantuara me Kartë dhe me KEDNJ respektohen në shtetin anëtar kërkues. Nëse nuk do të ishte kështu, këto autoritete do të kishin të drejtë të refuzonin ekzekutimin e urdhërarrestit evropian në fjalë, edhe nëse kjo arsye për mosekzekutim nuk parashikohet shprehimisht nga Vendimi Kuadër 2002/584.

Në ato rrethana, Gjykata e Apelit e Konstancës vendosi të pezullojë procedurën dhe i parashtrroi Gjykatës së Luksemburgut gjashtë pyetje, thelbi i të cilave ishte nëse ajo ka të drejtë të shqyrtojë apo jo nëse lëshimi

i një urdhërarresti evropian përputhet me të drejtat themelore dhe, nëse ky është rasti, të refuzojë ekzekutimin e tij, edhe pse nuk parashikohet mundësia për mosekzekutim as me Vendimin Kuadër 2002/584, as me legjislacionin kombëtar që e ka transpozuar atë. Ajo gjithashtu kërkoi të sqarohet nëse një refuzim i tillë është i mundur kur ky vendim kuadër nuk është transpozuar në shtetin anëtar lëshues.

Vendimi i Gjykatës

Sipas Gjykatës, Vendimi Kuadër 2002/584 në lidhje me urdhërarrestin evropian dhe procedurat e dorëzimit midis shteteve anëtare, i ndryshuar me Vendimin Kuadër 2009/299, duhet të interpretohet ashtu që autoritetet gjyqësore ekzekutuese nuk mund të refuzojnë ekzekutimin e një urdhërarresti evropian me arsyetimin se personi i kërkuar nuk është dëgjuar në shtetin anëtar lëshues para lëshimit të këtij urdhri arresti.

Fakti që urdhërarresti evropian është lëshuar me qëllim të zhvillimit të procedurave penale pa u dëgjuar personi i kërkuar nga autoritetet gjyqësore lëshuese, nuk figuron ndër kriteret për mosekzekutimin e një urdhri të tillë, siç parashikohet nga dispozitat e Vendimit Kuadër 2002/584.

Për më tepër, Gjykata theksoi se pajtueshmëria me nenet 47 dhe 48 të Kartës nuk kërkon që një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të jetë në gjendje të refuzojë për këtë arsye ekzekutimin e një urdhërarresti evropian të lëshuar për qëllime të ndjekjes penale. Nga njëra anë, detyrimi për autoritetet gjyqësore lëshuese për të dëgjuar personin e kërkuar para lëshimit të një urdhër-arresti të tillë evropian do të cenonte në mënyrë të pakthyeshme vetë sistemin e dorëzimit të parashikuar nga Vendimi Kuadër i vitit 2002/584 dhe, rrjedhimisht, realizimin e zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, pasi, veçanërisht për qëllimet e parandalimit të ikjes së personit në fjalë, një urdhërarresti i tillë duhet të përfitojë nga një efekt i caktuar befasië. Nga ana tjetër, ligjvënësi evropian, në nenet 8, 13 deri në 15 dhe 19 të Vendimit Kuadër 2002/584, ka siguruar respektimin e së drejtës për t'u dëgjuar në shtetin anëtar ekzekutues në mënyrë që të mos rrezikojë efektivitetin e mekanizmit të urdhërarrestit evropian. Megjithatë, asnjë nga këto dispozita nuk parashikon një detyrim për autoritetet gjyqësore lëshuese të dëgjojnë personin e kërkuar para lëshimit të një urdhërarresti evropian me qëllim të kryerjes së procedurave.

Neni 31

E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI22/16. PARASHTRUES: NASER HUSAJ

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_22_16_shq.pdf]

9 qershor 2016

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore në këtë rast ishte se a i kishte shkelur Gjykata Supreme të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kur kishte refuzuar kërkesën për revizion të parashtruar nga ai në një kontest pronësor, me ç'rast nuk kishte adresuar fare pretendimin kryesor të tij në revizion se në gjykimin në Gjykatën e Apelit kishte marrë pjesë një gjyqtar, ndaj të cilit parashtruesi paraprakisht kishte bërë kallëzim penal.

Faktet kryesore

Më 20 janar 2010, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, duke kërkuar që t'i vërtetohej pronësia mbi disa parcela tokësore. Më 19 qershor 2013, Gjykata Themelore e kishte refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Më 27 korrik 2013, parashtruesi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kjo gjykatë kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Më 20 nëntor 2015, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Në arsyet e revizionit, parashtruesi kishte theksuar se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit ishte bërë shkelje e rëndë e dispozitave të procedurës kontestimore sepse në Kolegjin e Gjykatës së Apelit kishte marrë pjesë edhe një gjyqtar i cili ishte nën hetime sipas kallëzimit penal të bërë nga parashtruesi. Prandaj, parashtruesi kishte argumentuar se gjyqtari në fjalë nuk ka pasur të drejtë të marrë pjesë në Kolegj dhe të vendosë sipas ankesës. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 335/2015) kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

Gjykata Supreme kishte arsyetuar se aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët nuk ishin përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Më 1 shkurt 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se aktgjykimi i kontestuar kishte cenuar të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 21 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore - Parimet e Përgjithshme] dhe me nenin **31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**, sepse kishte qenë i njëanshëm në baza personale. Si argument kryesor për të mbështetur pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatave, parashtruesi ngriti çështjen e pjesëmarrjes së një gjyqtari në Kolegjin shqyrtues të Gjykatës së Apelit, edhe pse parashtruesi kishte ushtruar kallëzim penal ndaj tij. Në këtë vazhdë, parashtruesi argumentoi se Gjykata Supreme e kishte refuzuar revizionin e tij shumë shpejt dhe nuk e kishte adresuar fare pretendimin e tij që lidhej me rrethanën se gjyqtari në fjalë (gjyqtari i paditur nga ana e tij), nuk do duhej të merrte pjesë në vendosjen e rastit të tij në Kolegjin e Gjykatës së Apelit.

Arsyetimi i Gjykatës

Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese vuri në spikamë se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, ku bazë kryesore ankimore ishte pjesëmarrja e një gjyqtari në përbërjen e Gjykatës së Apelit, i cili gjyqtar, sipas parashtruesit, kishte konflikt interesi në lëndën e tij dhe kundër të cilit parashtruesi kishte paraqitur kallëzim penal. Gjykata Kushtetuese më tutje vuri në dukje se Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e tij për revizion, duke arsyetuar se aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët nuk ishin përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo gjykatë (Gjykata Supreme) kujdesej sipas detyrës zyrtare, e as shkelje të tjera ligjore, të pretenduara nga revizioni. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese theksoi se në arsyetimin e saj Gjykata Supreme nuk kishte marrë parasysh pretendimet e parashtruesit për pjesëmarrjen e gjyqtarit në përbërjen e Kolegjit të Gjykatës së Apelit – edhe pse në

kërkesën për revizion parashtruesi kishte ngritur pretendimin lidhur me pjesëmarrjen e këtij gjyqtari në kolegjin e Gjykatës së Apelit. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese sqaroi se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata Kushtetuese theksoi se duke dhënë një vendim të arsyetuar gjykatat u dëshmojnë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe mundësojnë realizimin e mbikëqyrjes publike të administrimit të drejtësisë. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese sqaroi se gjykatat e rregullta nuk ishin të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ato duhej të adresonin pretendimet që ishin relevante për çështjen në shqyrtim, për më tepër nëse ato pretendime ngriheshin në faza të ndryshme të procedurës, siç kishte ndodhur në këtë rast. Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se parashtruesi ankohej se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk kishte adresuar fare një nga pretendimet kryesore të tij në kërkesën për revizion, e që kishte të bënte me pjesëmarrjen e një gjyqtari në gjykim në shkallën e dytë gjyqësore, lidhur me paanshmërinë e të cilit parashtruesi kishte ngritur dyshime serioze. Gjykata Kushtetuese konsideroi se kjo çështje ishte e karakterit thelbësor për rastin dhe sikur Gjykata Supreme të adresonte pretendimin e parashtruesit lidhur me paanshmërinë e kolegjit të Gjykatës së Apelit – pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej atij pretendimi, atëherë do të përmbushej kushti i “palës së dëgjuar” dhe i administrimit të duhur të drejtësisë. Gjykata Kushtetuese theksoi se nuk ishte detyrë e saj të ekzaminonte se a ishin të qëndrueshme pretendimet e parashtruesit në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, sipas Gjykatës Kushtetuese, drejtësia procedurale e kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur - sidomos nëse ato kishin të bënin me çështje të rëndësishme sikurse paanshmëria e gjykatave. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se paraqitja e paanshmërisë së gjykatave është e rëndësishme, në dritën e postulatit juridik se «drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por ajo duhet edhe të shihet që po bëhet”. Ky ishte element qenësor i besimit që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të ngjallin te publiku. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se mosadresimi nga ana e Gjykatës Supreme i pretendimit të parashtruesit të kërkesës përkitazi me një çështje thelbësore të procesit gjyqësor, përbënte një të metë të pakapërcyeshme të aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Prandaj,

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kishte shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, vendosi njëzëri që kërkesën ta shpallte të pranueshme dhe, me shumicë votash, vendosi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 335/2015, të 14 dhjetorit 2015.

***1.2. KI181/19, KI182/19, KI183/19 KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19.
PARASHTRUES: FLLANZA NAKA, FATMIRE LIMA DHE LEMAN MASAR ZHUBI***

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/02/ki_181_182_183_19_agj_shq.pdf]

15 shkurt 2021

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Rasti kishte të bënte me një procedurë gjyqësore që kishin ndjekur punëtorët e një ndërmarrjeje shoqërore të privatizuar, për të realizuar të drejtën në përfitim të 20% nga privatizimi i ndërmarrjes. Çështja kryesore në këtë rast ishte se a ishte shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e parashtruesve të kërkesës më vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me të cilin ishte ndryshuar në dëm të parashtruesve vendimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme (që ishte shkallë e parë gjyqësore), pa u mbajtur seancë dëgjimore.

Faktet kryesore

Ndërmarrja Shoqërore NSH “Agimi” Gjakovë ishte privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në vitin 2010. Parashtruesit e kërkesës kishin qenë punëtorë të asaj ndërmarrjeje në intervale të caktuara kohore. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime nga privatizimi ishte publikuar më 22 dhjetor 2011. Më 13 dhjetor 2011, AKP-ja kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e parashtruesve lidhur me mospërfshirjen e tyre në listën e përkohshme të punëtorëve me të drejtën e përfitimit të 20 % të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes. Parashtruesit kishin paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), kundër vendimit të AKP-së, përkatësisht për shkak të mospërfshirjes së tyre në listën përfundimtare të punëtorëve të ndërmarrjes së privatizuar. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme kishte vendosur që parashtruesit Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi të përfshiheshin në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesën nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH “Agimi”. AKP-ja kishte paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur, në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme (me Aktgjykimin AC-I -3-0181-A0008) e kishte pranuar si të bazuar ankesën e AKP-së lidhur me parashtruesit e kërkesave dhe kishte urdhëruar që të njëjtit të hiqeshin nga lista e përfituesve të 20% nga procesit i privatizimit të NSH “Agimi” Gjakovë. Ndërmjet datave 3 – 5 tetor 2019, parashtruesit e kërkesave, përmes postës, dorëzuan kërkesat në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit e kërkesave pretenduan se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, i datës 29 gusht 2019, kishte shkelur të drejtat e tyre kushtetuese të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], **31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**, dhe 46 [Mbrojtja e Pronës], në ndërlidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Lidhur me pretendimin për të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesit argumentuan se Kolegji i Apelit

i Dhomës së Posaçme ishte dashur që të mbante seancë (*dëgjimore*) publike, duke i ftuar të gjithë ankuesit për t'i paraqitur drejtpërdrejt dhe në mënyrë transparente pretendimet dhe provat e tyre, sidomos duke pasur parasysh faktin se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme pjesës dërmuese të tyre u kishte njohur të drejtën për përfitim nga 20% i shitjes së NSH "Agimi". Parashtruesit e kërkesave po ashtu pretenduan shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së barazisë para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave pretenduan se diskriminimi ndaj tyre konsistonte në faktin se punëtorët më të drejta legjitime ishin larguar nga lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta për përfitim nga shitja e ndërmarrjes shoqërore.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese paraprakisht kishte vendosur bashkimin e rasteve (kërkesave). Për sa u përket meritave, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se përmes ankesave të parashtruara në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme (si shkallë e parë gjyqësore), parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar mbajtjen e së njëjtës, duke theksuar së bazuar në nenet përkatëse të Ligjit për Dhomës së Posaçme seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse faktet dhe provat e dorëzuara ishin mjaft të qarta. Kolegji i Specializuar kishte marrë vendim në dobi të parashtruesve. Ndaj këtij vendimi vetëm AKP kishte paraqitur ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (si shkallë e dytë gjyqësore në këtë rast). Kolegji i Apelit kishte vendosur në dobi të AKP-së dhe kundër parashtruesve. Kolegji i Apelit kishte vendosur të heqë dorë nga pjesa e seancës *dëgjimore*, duke iu referuar neneve përkatëse të Ligjit për Dhomat e Posaçme të Gjykatës Supreme. Pra, Gjykata Kushtetuese theksoi se parashtruesit e kërkesës nuk kishin kërkuar seancë dëgjimore në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kishin kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkuptonte heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e lironte Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtonte me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore.

Më tutje, Gjykata Kushtetuese sqaroi se, në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Gjykata Kushtetuese theksoi se në rastet kur një palë përkatëse nuk ka kërkuar seancë dëgjimore, gjykata duhet të vlerësojë nëse mungesa e një kërkesë të tillë mund të konsiderohet sikur heqje dorë e nënkuptuar nga një seancë dëgjimore, gjithmonë duke pasur parasysh ligjin e zbatueshëm dhe rrethanat e rastit. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesve të kërkesës iu ishte mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy shkallët gjyqësore të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme nuk kishte trajtuar çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike (që do arsyetonin mosmbajtjen e seancës dëgjimore) dhe se nuk ekzistonin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje fakti dhe ligji dhe kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës, pa arsyetuar heqjen dorë nga seanca dëgjimore. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit i Dhomës së Posaçme ishte nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, me shumicë votash, vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

1.3. KI193/19. PARASHTRUES: SALIH MEKAJ

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/12/ki_193_19_agj_shq.pdf]

31 dhjetor 2020

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore e ngritur me këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kishte të bënte me atë se a ishin shkelur parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural nga Gjykata Supreme, sepse më rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme nuk kishte shqyrtuar fare përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të paraqitur ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit.

Faktet kryesore

Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare. Më 28 maj 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte vendosur t'i lironte nga aktakuza parashtruesin e kërkesës (dhe të bashkakuzuarit e tjerë). Më 13 gusht 2018, Prokuroria Speciale kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Më 23 tetor 2018, Gjykata e Apelit kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e ushtruar nga Prokuroria Speciale. Më 28 dhjetor 2018, Prokurori i Shtetit kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë. Gjykata Supreme një kopje të kërkesës ua kishte dërguar parashtruesit të kërkesës dhe personave të tjerë të akuzuar, për t'ua mundësuar atyre parashtrimin e përgjigjes ndaj pretendimeve të Prokurorit të Shtetit. Më 26 shkurt 2019, në Gjykatën Supreme ishte dorëzuar përgjigja e parashtruesit të kërkesës kundër pretendimeve të Prokurorit të Shtetit (e cila ishte dërguar me postë nga ana e tij, më 21 shkurt 2019). Më 5 qershor 2019, Gjykata Supreme (përmes Aktgjykimit Pml. 36/2019), miratoi pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga Prokurori i Shtetit. Më 28 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse më rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme ka qenë e detyruar që krahas kërkesës së Prokurorit të Shtetit ta shqyrtonte edhe përgjigjen e tij si palë kundërshtare në procedurë. Sipas parashtruesit, edhe ai do të *duhej të kishte* të drejtë t'i paraqiste argumentet e tij kundër kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjykata ka qenë e detyruar që t'i shqyrtonte me të njëjtën vëmendje, sikurse argumentet e palës tjetër e që në këtë rast ishte Prokuroria e Shtetit. Më tutje, parashtruesi i kërkesës argumentoi se përgjigja e tij jo vetëm që nuk ishte shqyrtuar fare, por në gjithë aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme as që përmendej se ai kishte paraqitur përgjigje në kërkesën e Prokurorisë së Shtetit. Sipas tij, kjo jo vetëm që paraqiste shkelje të parimit të barazisë së palëve në procedurë, por paraqiste edhe një sjellje arbitrare nga ana e Gjykatës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese sqaroi se detyrimi i gjykatave për njoftimin e palës për ushtrimin e mjetit juridik kundër tyre nga pala kundërshtare nuk është qëllim në vetvete, por është hap i domosdoshëm procedural për t'ua mundësuar palëve që të trajtohen në mënyrë të barabartë; të kenë mundësi të kundërshtojnë pretendimet dhe argumentet e palës kundërshtare dhe të paraqesin rastin e tyre në mënyrë efektive. Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese shtoi se gjykatat e rregullta nuk duhet të mjaftohen vetëm me faktin se palët kanë pranuar njoftimin për ushtrimin e mjetit juridik kundër tyre, por gjykatat duhet t'i sigurojnë palët që pikëpamjet dhe argumentet e tyre janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të rregullt, ashtu që t'iu garantohet një mbrojtje sa më efektive ndaj pretendimeve të ngritura kundër tyre. Në të kundërtën, mosmarrja në shqyrtim e kundërshtimeve dhe argumenteve të tyre, me automatizëm i vendos ato në një disavantazh të konsiderueshëm kundruall palës kundërshtare. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se Gjykata Supreme ishte mjaftuar

vetëm me përmbushjen e aspekteve formale-procedurale, domethënë vetëm me dërgimin e njoftimit parashtruesit të kërkesës për ushtrimin e mjetit juridik kundër tij, duke mos e trajtuar fare përgjigjen e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme nuk kishte dhënë ndonjë arsytim në aktgjykimin e saj se pse përgjigjja e parashtruesit të kërkesës nuk ishte marrë në shqyrtim. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese theksoi se Gjykata Supreme kishte vepruar ndryshe ndaj të pandehurës tjetër në këtë rast, përgjigjja e së cilës ishte shqyrtuar nga Gjykata Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesi i kërkesës ishte vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* Prokurorit të Shtetit, duke u privuar nga mundësia për të pasur një ballafaqim real dhe përmbajtjesor me argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si palë kundërshtare në procedurë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ishte marrë në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, si elemente qenësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, me shumicë votash, vendosi ta shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë shkelje të nenit 31.1 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019.

1.4. KI187/18 DHE KI11/19. PARASHTRUES: MUHAMET IDRIZI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/08/ki_187_18_ki_11_19_agj_shq.pdf]

26 gusht 2019

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore e ngritur me këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kishte të bënte me cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës, për shkak se në nxjerrjen e vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme në përbërje të Kolegjit kishte marrë pjesë gjyqtari, i cili kishte qenë pjesë e kolegeve vendimmarrëse edhe në faza të mëhershme të së njëjtës çështje penale.

Faktet kryesore

Më 29 dhjetor 2008, Prokuroria e Qarkut në Gjilan kishte ngritur aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se ai në bashkëveprim me një person tjetër dhe i ndihmuar edhe nga një person i tretë kishte kryer veprën penale të përcaktuar në nenin 147 (Vrasje e rëndë), në lidhje me nenet 20 (Tentativa) dhe 23 (Bashkëkryerja), si dhe nenin 328 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Më 8 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan e kishte liruar parashtruesin e kërkesës nga akuzat. Prokuroria e Qarkut kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme dhe më 7 mars 2012, Gjykata Supreme kishte miratuar ankesën e Prokurorisë së Qarkut dhe kishte kthyer çështjen në rigjykim. Më 22 nëntor 2017, Gjykata Themelore në procedurën e rigjykimit e kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e kishte dënuar me 3 vite burgim. Kundër aktgjykimit të lartcekur ankesë kishin parashtruar edhe parashtruesi i kërkesës edhe Prokuroria Themelore në Gjilan. Më 19 prill 2018, Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesat e Prokurorisë Themelore dhe të parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij, ndaras, kishin parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Prokurori i Shtetit kishte paraqitur përgjigje në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, duke propozuar që ato të refuzoheshin si të

pabazuara. Më 18 tetor 2018, Gjykata Supreme duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga i dënuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, gjithashtu e kishte refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Më 30 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të tij, dorëzoi kërkesën KI187/18 në Gjykatë Kushtetuese, ndërsa më 14 janar 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi personalisht kërkesën KI11/19 në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Në kërkesën KI187/18, parashtruesi i kërkesës nuk kishte qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendonte se i ishin cenuar përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Ai vetëm kishte pretenduar se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale (duke u referuar në disa nene specifike). Ndërsa në kërkesën KI11/19, parashtruesi pretendoi se Gjykata Supreme, përmes aktgjykimit të 3 dhjetorit 2018, i kishte shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 39 (Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kjo sepse njëri nga gjyqtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut, që kishte nxjerrë aktgjykimin e 8 qershorit 2009, po ashtu kishte marrë pjesë si anëtar i Kolegjit të Gjykatës Supreme që kishte vendosur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (që ishte ushtruar kundër atij aktgjykimi). Parashtruesi po ashtu pretendoi se përfaqësuesi i tij nuk e kishte mbrojtur në mënyrën e duhur gjatë procesit gjyqësor dhe se mbrojtjen e kishte bërë në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë. Si shkelje tjetër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi se gjykatat kishin bërë tejkalimin e aktakuzës fillestare në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi vendosjen e masës së përkohshme ashtu që të pezullohej fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg derisa të merrej një vendim nga Gjykata Kushtetuese.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese paraprakisht kishte vendosur bashkimin e rasteve (kërkesave). Lidhur me kërkesën KI187/18, Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte qartësuar se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendonte se i ishin cenuar përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Pra, parashtruesi i kërkesës nuk kishte qartësuar saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa KI187/19 nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë, siç ishin përcaktuar me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 39 të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën KI187/18 të papranueshme për *shqyrtim të meritave të saj*. Për sa i përket kërkesës KI11/19, Gjykata Kushtetuese theksoi se parashtruesi kontestonte aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke pretenduar, ndër të tjera, se aktgjykimi ishte nxjerrë nga një gjykatë e anshme në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, sepse një gjyqtar kishte marrë pjesë në vendimmarrje gjyqësore në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese përpunoi konceptin e paanësisë subjektive dhe objektive të gjykatës, në dritën e praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës *Evropiane për të Drejtat e Njeriut* përkitazi me pjesëmarrjen e një gjyqtari në faza të ndryshme të së njëjtës çështje penale. Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML.nr.293/2018, i 3 dhjetorit 2018, ishte nxjerrë nga përbërja e Kolegjit, në të cilin kishte marrë pjesë gjyqtari i cili edhe në faza të mëhershme të së njëjtës çështje penale kishte qenë pjesë e kolegjeve vendimmarrëse. Kjo kishte rezultuar në dyshime legjitime për paanshmërinë e gjykatës. *Këto dyshime*, sipas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, në rrethanat e rastit konkret ishin objektivisht të justifikueshme. Gjykata Kushtetuese sqaroi edhe faktin se në mes të pjesëmarrjes së gjyqtarit në fjalë në Kolegjin e Gjykatës së Qarkut, përkatësisht nxjerrjes së Aktgjykimit të 8 qershorit 2009 dhe pjesëmarrjes së tij në Kolegjin e Gjykatës Supreme, përkatësisht nxjerrjes së Aktgjykimit PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018, çështja e parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në rigjykim, përmes Aktvendimit të 7 marsit 2012 të Gjykatës Supreme. Në gjykimin e ri, gjyqtari kishte marrë pjesë vetëm në Kolegjin e Gjykatës Supreme, i cili kishte shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të 19 prillit

2018, të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se neni 39 i Kodit të Procedurës Penale përcaktonte si arsye për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi i një çështjeje vetëm “marrjen pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal,” siç kishte ndodhur në rrethanat e rastit konkret. Gjykata Kushtetuese gjithashtu theksoi se përjashtimi i gjyqtarit nuk ishte i varur detyrimisht nga kërkesa e palëve në procedurë (në rrethanat e rastit konkret nuk kishte pasur kërkesë *për përjashtim të gjyqtarit* nga parashtruesi i kërkesës). Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 293/2018, i 3 dhjetorit 2018, ishte në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse ishte cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës.

Për sa i përket dy pretendimeve të parashtruesit se mbrojtësi i tij kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin për Avokatinë, duke dëmtuar interesat e tij dhe se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e caktuara të procedurës penale, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës – siç kishte bërë parashtruesi në rastin konkret – nuk ishte e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, pranë Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit e kërkesave duhet të *ndërtojnë* pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse.

Në fund, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi edhe kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme duke kërkuar që të pezullohej fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg derisa të merrej një vendim nga Gjykata Kushtetuese. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese sqaroi se ajo e kishte shpallur të papranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML.nr.226/2018, të 16 tetorit 2018, ndërsa e kishte shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018, duke e kthyer të njëjtin në rivendosje në Gjykatën Supreme. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme detyrohej që të shqyrtojë edhe një herë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë që e kishte parashtruar i pandehuri, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Kushtetuese theksoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [PAKR.nr.108/2018], i 19 prillit 2018, ishte i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm bazuar në nenin 485 të Kodit të

Procedurës Penale. Prandaj, Gjykata Kushtetuese sqaroi se aktgjykimi i saj në rastin konkret kishte shpallur të pavlefshëm vetëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018 dhe nuk ndikonte drejtpërsëdrejti në efektin juridik që prodhonte Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, i 19 prillit 2018. Prandaj, Gjykata Kushtetuese refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi të shpallë kërkesën KI187/18 të papranueshme; të shpallë kërkesën KI11/19 të pranueshme për shqyrtim në merita; të konstatojë se në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018, ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 293/2018, të 3 dhjetorit 2018.

1.5. KI47/17. PARASHTRUESE: SELVETE ALIJI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/12/ki_47_17_agj_shq.pdf]

28 dhjetor 2018

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore e ngritur me këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kishte të bënte me atë se a ishte shkelur e drejta e parashtrueses së kërkesës për të marrë pjesë efektivisht në shqyrtim gjyqësor si dhe parimi i barazisë së armëve, sepse ajo nuk ishte thirrur të marrë pjesë në procedurën për zgjidhjen e martesës që ishte zhvilluar në Gjykatën Themelore dhe nuk ishte njoftuar fare se ishte shkurorëzuar. Kjo ishte bërë me arsyetimin se gjykata nuk kishte mundur të vë kontakt me parashtruesen dhe së njëjtës i ishte caktuar përfaqësuesi i përkohshëm ligjor.

Faktet kryesore

Më 22 tetor 2014, ish-bashkëshorti i parashtrueses nëpërmjet përfaqësuesit të tij kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë për zgjidhjen e martesës. Më 6 nëntor 2014, përfaqësuesi i paditësit (ish-bashkëshortit) në Gjykatën Themelore kishte paraqitur propozimin për caktimin e një avokati si përfaqësues të përkohshëm ligjor për palën e paditur - përkatësisht parashtruesen e kërkesës - për shkak se, sipas tij, nuk dihej vendbanimi e as adresa e saj. Propozimi përmbante emrin konkret të një avokati, i cili propozohej të caktohej nga gjykata si përfaqësues i përkohshëm ligjor i palës së paditur (parashtrueses së kërkesës). Më 26 mars 2015, Gjykata Themelore kishte caktuar pikërisht avokatin e propozuar nga përfaqësuesi i ish-bashkëshortit, si përfaqësues të përkohshëm ligjor për parashtruesen e kërkesës. Më 14 prill 2015, ky aktvendim ishte publikuar në një gazetë ditore. Më 15 tetor 2015, Gjykata Themelore kishte caktuar seancën e tentimit të pajtimit, në të cilën kishin marrë pjesë paditësi, avokati i tij dhe përfaqësuesi i përkohshëm i parashtrueses së kërkesës. Në këtë seancë, kryetari i trupit gjykues kishte konstatuar se seanca e tentim pajtimit nuk do të mbahej pasi që mungonte e paditura por kishin angazhuar përfaqësuesin e saj. Megjithatë, nga procesverbali shihej se Gjykata Themelore kishte konstatuar se palët e pranishme në atë seancë ishin deklaruar për padinë dhe kishin shprehur qëndrimet e tyre lidhur me themelësinë e padisë së paraqitur. Në po të njëjtën ditë, pra më 15 tetor 2015, Gjykata Themelore kishte mbajtur seancën gjyqësore në prani të paditësit dhe të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse dhe kishte nxjerrë aktgjykimin, me të cilin kishte zgjidhur martesën ndërmjet parashtrueses dhe ish-bashkëshortit të saj. Më 6 janar 2016, aktgjykimi ishte bërë i plotfuqishëm sepse ndaj tij nuk ishte ushtruar ankesë nga asnjëra palë në procedurë. Sipas pohimeve të parashtrueses, më 11 mars 2016, ajo kishte shkuar në Zyrën e Gjendjes Civile për të nxjerre një ekstrakt dhe nga ekstrakti i marrë kishte mësuar se gjendja e saj martesore kishte ndryshuar dhe se në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile ajo evidentohej si e shkurorëzuar. Më 21 mars 2016, parashtruesja e kërkesës nëpërmjet përfaqësuesit ligjor (tani të përzgjedhur nga ana e saj), kishte parashtruar në Gjykatën e Apelit propozim për përsëritjen e procedurës. Më 13 qershor 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendimin nr. 49/2016, të nxjerrë nga gjyqtari individual, kishte hedhur poshtë

si të palejuar kërkesën e parashtrueses për përsëritje të procedurës. Në arsyetimin e këtij aktvendimi theksohej se neni 88 i Ligjit për Familjen parasheh se nëse martesë është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkëputjen nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike. Më 8 korrik 2016, parashtruesja e kërkesës, duke u mbështetur në udhëzimin juridik të dhënë në Aktvendimin nr. 49/2016, kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar ekzistimin e shkeljes thelbësore të rregullave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Më 9 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 2812/2016, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtrueses, ndërsa e kishte vërtetuar Aktvendimin nr. 49/2016 të po kësaj gjykate (të nxjerrë nga gjyqtari individual). Më 14 prill 2017, parashtruesja e kërkesës, nëpërmjet postës, e dërgoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se procedura gjyqësore e zhvilluar në Gjykatën Themelore dhe në mungesë të saj, pa e njoftuar atë fare, por edhe procedurat e zhvilluara mbi bazën e ankimit të saj në Gjykatën e Apelit, kishin rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përkatësisht asaj i ishte cenuar e drejta për një shqyrtim publik dhe të paanshëm, si dhe parimi i barazisë së armëve. Parashtruesja theksoi se asaj nuk i ishte mundësuar që të merrte pjesë në shqyrtimin kryesor dhe se procedura kontestimore kishte përfunduar pa pjesëmarrjen e saj. Ajo iu referua nenit 6 (1) të KEDNJ-së, i cili parasheh se në përcaktimin e të drejtave të tij/saj, çdokush ka të drejtë për dëgjim të drejtë dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës vuri në pah se në vitin 2014 kishte shkëputur jetën faktike me paditësin dhe paditësi kishte qenë në dijeni se ku jetonte ajo. Parashtruesja e kërkesës sqaroi se ajo kishte jetuar me ish-bashkëshortin një periudhë të gjatë kohore së bashku në adresën e njëjtë dhe se ajo kishte kontaktuar me të dhe se ai i kishte thënë se kur të fillonte procedura për zgjidhjen e martesës me shkëputje ajo do të njoftohej nga ana e organit kompetent. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës pretendoi se konstatimet e gjyqtarit

individual të Gjykatës së Apelit ishin në kundërshtim me nenin 83 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sepse sipas kësaj dispozite, Gjykata brenda afatit prej 7 ditësh kur të paditurit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, duhet të japë shpalljen, e cila duhet të botohet në Gazetën Zyrtare dhe të afishohet në tabelën e shpalljeve të Gjykatës së çështjes, e jo që vendimet për përfaqësues të përkohshëm të shpalleshin në një gazetë ditore (siç kishte ndodhur në këtë rast).

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese vuri në pah se e drejta për të qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit është pjesë e së drejtës për shqyrtim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo është parakusht për realizimin e së drejtës së palës për pjesëmarrje efektive në gjykim, si dhe për respektimin e parimit të kontradiktoritetit procedural. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë palës në procedurë një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën gjyqësore dhe të marrë masa për të siguruar praninë e palës. Megjithatë, gjithnjë duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se në konteste jopenale e drejta e palës për të qenë e pranishme, personalisht, në procedurë garantohet gjithmonë vetëm në rastet kur karakteri personal, mënyra e jetesës apo sjellja e palës kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për gjykimin e rasti. Në raste të tjera, është e mjaftueshme që pala të përfaqësohet nga avokati, gjegjësisht përfaqësuesi. Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se një seancë e shqyrtimit kryesor, ku ishin trajtuar Faktet Kryesore, ishte mbajtur në Gjykatën Themelore, me pjesëmarrjen e palës paditëse dhe ku e paditura (parashtruesja e kërkesës) ishte përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur nga gjykata pa dijeninë e saj. Gjykata Kushtetuese, më tej, theksoi se parachtruesja nuk kishte asnjë informacion për përmbajtjen e seancës kryesore gjyqësore dhe se nga dosja e lëndës nuk mund të konstatohej se Gjykata Themelore kishte bërë përpjekje për ta njoftuar parachtruesen lidhur me mbajtjen e seancës. Nga dosja e lëndës së Gjykatës Themelore, vërehej qartë se asnjë nga fletëdërgesat që lidheshin me zhvillimin e procedurave në këtë rast nuk ishin dërguar në emër të parachtrueses së kërkesës, e cila kishte cilësinë e palës së paditur në procedurë, por i tërë komunikimi zyrtar ishte bërë me përfaqësuesin e përkohshëm i cili ishte caktuar nga gjykata. Gjykata Kushtetuese po ashtu potencoi se

Gjykata e Apelit kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses për përsëritje të procedurës. Në këtë sfond faktik të rastit, Gjykata Kushtetuese vuri ne dukje se, si praktikë e përgjithshme, në rastet në të cilat ka pasur një seancë dëgjimore në shkallë të parë, ose për të cilën është hequr dorë në atë shkallë, nuk ka të drejtë absolute për një seancë dëgjimore. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese konsideroi se për parashtruesen e kërkesës nuk kishte pasur një seancë dëgjimore, në të cilën ajo kishte marrë pjesë efektivisht në gjykimin e shkallës së parë dhe, gjithashtu, parashtruesja nuk kishte hequr dorë vullnetarisht nga kjo e drejtë. Përkundrazi, ajo ishte ankuar në shkallën më të lartë gjyqësore, gjegjësisht në Gjykatën e Apelit dhe se ankesat e saj nuk ishin marrë parasysh. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese theksoi faktin se parashtruesja ishte ankuar edhe lidhur me mënyrën se si asaj i ishte caktuar përfaqësuesi i përkohshëm ligjor. Gjykata Kushtetuese argumentoi se nga dosja e lëndës vërehej se Gjykata Themelore nuk kishte bërë përpjekjeje për ta kontaktuar parashtruesen, edhe pse ajo kishte cilësinë e palës në procedurë dhe ajo gjykatë nuk kishte dhënë asnjë shpjegim lidhur me këtë çështje. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kishte pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, sa i përket së drejtës për të qenë i pranishëm dhe për të marrë pjesë efektivisht në shqyrtim gjyqësor.

Për sa i përket pretendimeve të parashtrueses për cenimin e parimit të barazisë së armëve, Gjykata Kushtetuese fillimisht sqaroi se çdokush që është palë në procedurë gjyqësore duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij/saj dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë në mes të palëve. Në këtë drejtim, e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve u garantohet thjesht prania fizike gjatë procedurës civile, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, sikundër edhe gjyqtari gjatë gjykimit t'u japë mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Sipas Gjykatës Kushtetuese, shkelja e këtij garancioni procedural vetvetiu rezulton në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese theksoi se në gjykimin e shkallës së parë në Gjykatën Themelore, parashtruesja e kërkesës jo vetëm që nuk mori pjesë personalisht por as nuk kishte informacion për mbajtjen e gjykimit.

Parashtruesja, për më tepër, nuk ishte njoftuar as me përmbajtjen e padisë dhe nuk kishte pasur asnjë mundësi të paraqiste përgjigje ndaj padisë. Gjykata Kushtetuese po ashtu theksoi se parashtrueses së kërkesës i ishte caktuar nga Gjykata Themelore përfaqësuesi i ligjor i përkohshëm, bazuar në propozimin e palës paditëse dhe se ai përfaqësues nuk kishte kundërshtuar padinë dhe nuk kishte paraqitur fare ankesë ndaj aktgjykimit të shkallës së parë. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se në situatën kur parashtruesja e kërkesës nuk kishte marrë pjesë në seancën dëgjimore të shkallës së parë; kur asaj nuk i ishte dhënë mundësia për të paraqitur argumentet e saj, qoftë drejtpërdrejt apo përmes përfaqësuesit ligjor; kur argumentet e palës kundërshtare ishin dëgjuar dhe ishin marrë parasysh dhe kur parashtruesja nuk kishte pasur asnjë lloj mundësie t'i kundërshtojë ato, ishte e qartë se parimi i barazisë së armëve në procedurë nuk ishte respektuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë së ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së; ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 2860/2014, të 15 tetorit 2015, dhe aktvendimet e Gjykatës së Apelit, CN. nr. 49/2016 dhe Ac. nr. 2812/2016, të vitit 2016.

1.6. KI56/21. PARASHTRUES: EMRUSH BERISHA

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/ki_56_21_av_shq.pdf]

25 tetor 2021

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Rasti kishte të bënte me dënimin që i ishte shqiptuar nga gjykatat parashtruesit të kërkesës, lidhur më një aksident trafiku që ai kishte shkaktuar. Çështja kyçe e ngritur në këtë rast kishte të bënte me pretendimin e parashtruesit se gjykatat nuk kishin marrë parasysh argumentet dhe provat e tij, pretendim ky që ngrinte dyshime për cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës).

Faktet kryesore

Parashtruesi i kërkesës kishte shkaktuar aksident trafiku, i cili kishte qenë me fatalitet për persona të tjerë. Si rezultat i kësaj, më 20 qershor 2019, Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, kishte ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik. Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale rrezikim i trafikut publik dhe e kishte dënuar atë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh, si dhe i kishte shqiptuar një dënim plotësues, marrjen e lejes së vozitjes. Parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila ishte aprovuar nga kjo e fundit më 28 shkurt 2020, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte ndryshuar dhe dënimi me burgim ishte zvogëluar në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh, si dhe marrja e lejes së vozitjes në afat prej 1 (një) viti. Tutje, parashtruesi i kërkesës kishte bërë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme, të cilën kjo e fundit, më 9 nëntor 2020, e kishte refuzuar si të pabazuar.

Më 4 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese pretendoi shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo sepse, sipas parashtruesit, Gjykata Supreme, me rastin e vendosjes, fare nuk kishte analizuar kërkesën e tij për vërtetimin e drejtë dhe të saktë të të gjitha provave që gjinden në dosje të lëndës. Po ashtu sipas parashtruesit, gjykatat e rregullta ishte dashur të evidentonin shkeljet e ligjit penal lidhur me ekspertizat e ekspertëve të komunikacionit dhe të arrinin në një përfundim të drejtë dhe të saktë, duke pasur parasysh faktin se pas pranimit të fajësisë nuk ishin vlerësuar drejt provat që gjendeshin në dosje të lëndës.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi plotësimin e kushteve për pranueshmërinë e kërkesës për vendosje të meritave të saj. Në këtë drejtim, në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se ajo nuk kishte juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Gjykata Kushtetuese nuk kishte as juridiksion për të vlerësuar, nëse gjendja faktike ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kishin pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese ritheksoi më tej se nuk ishte detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Sipas Gjykatës Kushtetuese, ishte roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Pas këtyre shpjegimeve të përgjithshme, Gjykata Kushtetuese gjeti se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, ishte mjaftueshëm i arsyetuar dhe rrjedhimisht, plotësonte kriteret e vendimit të arsyetuar gjyqësor, të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se gjykatat e rregullta i kishin trajtuar me kujdes pretendimet e parashtruesit të kërkesës, sa i përket pranimit të fajësisë dhe marrjes parasysh të ekspertizës, duke arsyetuar

tutje se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar fajësinë në prani të mbrojtësit të tij, pasi paraprakisht e kishte kuptuar dhe ishte njoftuar nga gjykata, lidhur me natyrën dhe pasojat e pranimi të kryerjes së veprës penale. Kurse sa i përket marrjes parasysht të ekspertizës së dytë, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se kjo ekspertizë ishte marrë parasysht dhe vlerësuar nga ana e Gjykatës së Apelit, ku dhe në bazë të saj parashtruesit të kërkesës i ishte ndryshuar vendimi për dënim, duke ia ulur dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës Themelore. Për pasojë, dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në aktvendimin e publikuar, Gjykata Kushtetuese konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm, ishin pretendime që kualifikoheshin si pretendime të “*shkallës së katërt*”. Si të tilla, ato pretendime të parashtruesit të kërkesës ishin qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi që ta shpallë kërkesën të papranueshme.

1.7. KI235/19. PARASHTRUES: KOMPANIA E SIGURIMEVE “ALLIANZ SUISSE VERSICHERUNGSGESELLSCHAFT AG”

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/06/ki_235_19_agj_shq.pdf]

14 qershor 2021

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Parashtruese e kërkesës në këtë rast ishte një kompani e sigurimeve, gjegjësisht “Allianz Swiss Versicherungs- Gesellschaft AG” me seli në Cyrih të Zvicrës. Rasti kishte të bënte me një aksident të trafikut të vitit 2009 dhe me kërkesën e kompanisë parashtruese që të kompensohej për dëmin që e kishte kompensuar, nga një kompani tjetër e sigurimeve, përmes subrogimit. Çështja kyçe e ngritur në këtë rast kishte të bënte me kontestimin nga ana e kompanisë parashtruese të vendimit të Gjykatës Supreme lidhur me llogaritjen e kamatëvonesës, e cila ishte bërë në kundërshtim me praktikën gjyqësore në raste të ngjashme. Kjo rrethanë ngrinte dyshime për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor, të dyja këto elemente thelbësore të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës).

Faktet kryesore

Rrethanat e këtij rastit ndërlidheshin me një aksident të vitit 2009, në të cilin, e siguruara e kompanisë parashtruese (personi Sh.Z) kishte humbur jetën. Përgjegjësia për aksident kishte rënë mbi personin H.K., i cili ishte i siguar i BKS-së dhe i cili ishte dënuar për veprën penale rrezikim i trafikut publik në vitin 2010. Kompania parashtruese e kishte kompensuar familjen e së ndjerës në shumën prej 36,000.00 euro. Në vitin 2015, kompania parashtruese e kërkesës i ishte drejtuar BKS-së me kërkesë për kompensim mbi bazën e së drejtës në subrogim të përcaktuar përmes Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD) dhe në mungesë të një marrëveshjeje me kompaninë BKS, kishte parashtruar padi në Gjykatë Themelore. Më 31 tetor 2017, Gjykata Themelore e kishte miratuar kërkesëpadinë e kompanisë parashtruese duke e detyruar kompaninë BKS t’ia paguante kompanisë parashtruese shumën e kompensimit prej 36.000.00 euro. Po ashtu, Gjykata Themelore kishte

detyruar kompaninë BKS t'ia paguante kompanisë parashtruese kamatën prej dymbëdhjetë (12%) për qind në vit, duke filluar nga 5 qershori 2015 deri në pagesën përfundimtare. Më 31 janar 2019, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e kompanisë BKS dhe kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Pas kësaj, kompania BKS kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme dhe kjo e fundit, me Aktgjykimin [E.Rev.nr.32/2019] të 31 korrikut 2019, përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e kompanisë parashtruese në kompensimin përkatës mbi bazën e subrogimit. Por, Gjykata Supreme kishte ndryshuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata Supreme kishte përcaktuar që kamata vjetore duhet të ishte tetë për qind (8%) në vit, bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe jo dymbëdhjetë për qind (12%) në vit, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, siç kishin vendosur gjykatat e shkallës më të ulët.

Më 20 dhjetor 2019, kompania parashtruese dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Kompania parashtruese pretendoi se Aktgjykimi E.Rev.nr.32/2019, i 31 korrikut 2019, i Gjykatës Supreme ishte në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Në këtë sfond, kompania parashtruese argumentoi se aktgjykimi në fjalë kishte shkelur parimin e sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme. Po ashtu, kompania parashtruese pretendoi se aktgjykimi në fjalë i kishte shkelur të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor, përkitazi me ndryshimin e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, në lidhje me lartësinë e kamatëvonesës.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi plotësimin e kriterëve për pranueshmërinë e kërkesës për vendosje të meritave të saj. Më tutje, Gjykata vlerësoi pretendimet e kompanisë parashtruese përkitazi me sigurinë

juridike dhe të drejtën për vendim të arsyetuar. Në këtë sfond, Gjykata Kushtetuese shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga GJEDNJ-ja dhe praktika e saj gjyqësore përkitazi me konsistencën gjyqësore dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar. Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata Kushtetuese iu referua të ashtuquajturit test që aplikon GJEDNJ-ja për të konstatuar divergjencën gjyqësore në prizmin e parimit të sigurisë juridike. Në këtë vazhdë, Gjykata konstatoi se në rastin në shqyrtim nuk ishte provuar ekzistenca e dallimeve “të thella dhe afatgjate” lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe se po ashtu ekzistonin mekanizma për harmonizimin e konsistencës së praktikës gjyqësore. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 kishte nxjerrë “Mendim Juridik për Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes”. Më tej, Gjykata Kushtetuese theksoi se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rregullin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial. Gjykata Kushtetuese po ashtu rikujtoi se Gjykata Supreme, me rastin e prishjes së aktgjykimeve të gjykatave më të ulëta përkitazi me kamatëvonesën, kishte përjashtuar aplikimin e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm duke konstatuar se kamatëvonesa në lartësi prej 12 % ishte paraparë vetëm për mostrajtimin dhe krijimin e vonesave të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Prandaj, paditësi, përkatësisht kompania parashtruese kishte të drejtë vetëm në kamatëvonesën prej tetë për qind (8%) në vit, të përcaktuar përmes nenit 382 të LMD-së. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk kishte cenuar parimin e sigurisë juridike.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi që ta shpallë kërkesën të papranueshme dhe, me shumicë votash, konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E.Rev.nr.32/2019, i 31 korrikut 2019, është në përputhshmëri më nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

1.8. KI39/20. PARASHTRUESE: CIHAN OZKAN

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/02/ki_39_20_av_shq.pdf]

12 shkurt 2021

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: *Ky rast kishte të bënte me procedurën e dëbimit me forcë të të huajve, gjegjësisht të disa qytetarëve turq dhe pretendimin se në këtë rast ishin shkelur parimet për largimin me forcë të të huajve, të përcaktuara me nenin 1 (Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe, rrjedhimisht, garancionet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës).*

Faktet kryesore

Parashtruesi i kërkesës është shtetas i Turqisë i cili punonte në Kosovë dhe kishte leje qëndrimi për shtetas të huaj. Parashtruesit të kërkesës i ishte revokuar leja e qëndrimit më 23 mars 2018. Më 29 mars 2018, ndaj parashtruesit të kërkesës, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Drejtoria për Migrim) kishte nxjerrë Urdhër për Largim me Forcë nga territori i Republikës së Kosovës. Urdhri për Largim me Forcë ishte ekzekutuar në të njëjtën ditë nga ana e autoriteteve kosovare.

Lidhur me parashtruesin e kërkesës ishin duke u zhvilluar dy procedura: 1) procedura lidhur me revokimin e lejes së qëndrimit të parashtruesit të kërkesës; dhe, 2) procedura lidhur me Urdhrin për largimin me forcë të parashtruesit të kërkesës nga territori i Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës u ankua para Gjykatës Kushtetuese lidhur me procedurën e dytë që ndërliidhej me Urdhrin për largimin me forcë të parashtruesit të kërkesës nga territori i Republikës së Kosovës.

Lidhur me revokimin e lejes së qëndrimit të parashtruesit të kërkesës: Më 23 mars 2018, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim i Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: MPB) kishte nxjerrë Vendim për revokimin e lejes së qëndrimit të parashtruesit të kërkesës. Më 7

maj 2018, parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore. Parashtruesi kishte paraqitur ankesë kundër vendimit për revokimin e lejes së qëndrimit (ankesa ishte paraqitur përmes bashkëshortes së tij), duke kërkuar anulimin e atij vendimi. Më 25 shtator 2018, Gjykata Themelore kishte nxjerrë aktgjykim me të cilin e kishte miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e kishte anuluar vendimin e MPB-së për revokimin e lejes së qëndrimit të parashtruesit të kërkesës. Përmes aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore e kishte kthyer çështjen në rivendosje në MPB. MPB-ja kishte paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke kërkuar, ndër të tjera, që Gjykata e Apelit të vendoste rastin meritorisht. Më 27 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit kishte nxjerrë aktvendim me të cilin kishte miratuar si të bazuar ankesën e MPB-së dhe e prishi aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke e kthyer çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore. Më 21 shkurt 2019, Gjykata Themelore kishte nxjerrë aktgjykim, duke e miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe duke e anuluar vendimin e MPB-së për revokimin e lejes së qëndrimit, si dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje në MPB. Kundër këtij aktgjykimi, MPB-ja kishte paraqitur ankesë dhe më 18 gusht 2019, Gjykata e Apelit kishte nxjerrë aktgjykim duke refuzuar si të pabazuar ankesën e MPB-së dhe duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Më 1 tetor 2019, duke vepruar në procedurën e rivendosjes, MPB-ja përsëri kishte nxjerrë vendim për revokimin e lejes së qëndrimit të parashtruesit të kërkesës, me efekt retroaktiv nga 23 marsi 2018. Parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore, kundër vendimit për revokimin e lejes së qëndrimit. Parashtruesi njoftoi Gjykatën Kushtetuese se, në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata Themelore ende nuk kishte vendosur lidhur me këtë padi. Parashtruesi nuk e kontestonte këtë procedurë para Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me Urdhrin për largimin me forcë të parashtruesit të kërkesës nga territori i Republikës së Kosovës: Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës, përmes Urdhrit nr. 47/2018, kishte urdhëruar largimin me forcë të parashtruesit të kërkesës nga territori i Republikës së Kosovës. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës (së bashku edhe me pesë shtetas të tjerë turq të akuzuar nga Turqia si pjesëtar të lëvizjes gyleniste), ishte ndaluar nga Policia e Kosovës dhe ishte larguar me forcë për në Turqi. Parashtruesi, më rastin e paraqitjes

së kërkesës, kishte informuar se ai ishte dënuar me shtatë (7) vite burgim në Turqi. Më 16 prill 2018, parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të tij, kishte paraqitur ankesë në Komisionin e Ankesave për të Huaj, ndaj Urdhrit të Drejtorisë për Migrim. Më 4 maj 2018, Komisioni i Ankesave kishte nxjerrë vendim, duke refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Procedura e parë gjyqësore lidhur me Urdhrin për largimin me forcë të parashtruesit të kërkesës: Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore kundër vendimit të Komisionit të Ankesave, duke kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Ankesave dhe të urdhrin të Drejtorisë për të Migrim. Ai po ashtu kishte kërkuar shpërblimin e dëmit jomaterial, në një shumë të caktuar parash. Më 20 dhjetor 2018, Gjykata Themelore e kishte miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit, ashtu që kishte anuluar vendimin e Komisionit të Ankesave, duke arsyetuar se ai vendim “përbante të meta, për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohej ligjshmëria e tij”. Ndërsa Gjykata Themelore kishte hedhur poshtë si të palejuar pjesën e kërkesëpadisë për sa i përket kërkesëpadisë për anulimin e urdhrin të Drejtorisë për Migrim dhe për dëmshpërblim. Kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës Themelore, parashtruesi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit. Më 16 prill 2019, Gjykata e Apelit kishte miratuar si të bazuar ankesën e parashtruesit, duke prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit kërkoi nga Gjykata Themelore që, nëse konstaton paligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Ankesave, të vendoste në mënyrë meritore edhe për pikat tjera të kërkesëpadisë, duke përfshirë edhe vendimin për dëbimin, të Drejtorisë së Migrimit për dëmshpërblimin.

Procedura e dytë gjyqësore lidhur me Urdhrin për largimin me forcë të parashtruesit të kërkesës: Më 16 korrik 2019, pas rikthimit të rastit në rishqyrtim, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit A.nr.1051/2019 e kishte miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke anuluar vendimin e Komisionit të Ankesave dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në organin administrativ. Gjykata Themelore kishte refuzuar pjesën e kërkesëpadisë sa i përket kërkesës për anulimin e urdhrin për dëbim të Drejtorisë për Migrim dhe kërkesës për kompensim të dëmit. Parashtruesi kishte paraqitur ankesë në

Gjykatën e Apelit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Asnjëra nga palët në këtë procedurë nuk kishte paraqitur ankesë lidhur me pikën e aktgjykimit të Gjykatës Themelore, me të cilën ishte anuluar vendimi i Komisionit të Ankesave. Më 16 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarës D.H. të Gjykatës së Apelit, nga vendosja e lëndës së parashtruesit të kërkesës. Më 16 tetor 2016, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës D.H. Më 22 tetor 2019, Gjykata e Apelit e kishte miratuar si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e kishte prishur në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore. Gjykata e Apelit kishte kërkuar nga Gjykata Themelore që të vepronte sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, që kishte dhënë përmes Aktvendimit AA.nr.124/2019, të 16 prillit 2019. Gjykata e Apelit po ashtu kishte urdhëruar që çështja në Gjykatën Themelore të vendosej nga një gjyqtar i vetëm. Kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës së Apelit, parashtruesi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme. Më 1 gusht 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit ARJ-UZVP.nr.149/2019, e kishte hedhur poshtë si ta palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

Më 24 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës kontestoi para Gjykatës Kushtetuese vetëm procedurën e dytë gjyqësore lidhur me urdhrin për largimin me forcë, konkretisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.669/2019, që e kishte prishur në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore A.nr.1051/2019, duke përfshirë edhe pikën (1) e cila nuk kishte qenë objekt ankese. Parashtruesi pretendoi se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit, të 22 tetorit 2019, i ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara më nenin 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (E drejta për një proces të rregullt). Çështja kryesore që ngriti parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, kishte të bënte me pretendimin se Gjykata e Apelit duke prishur në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke përfshirë pikën (1)

të Aktgjykimit për të cilën asnjëra palë nuk kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, ka shkelur parimin “*res judicata*” duke shkelur kështu të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Në këtë kuadër, parashtuesi i kërkesës argumentoi se vendimi i kontestuar kishte prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në tërësi, duke e kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje, përkundër faktit se aktgjykimi në fjalë [A. nr.1051/19], i Gjykatës Themelore në Prishtinë ishte atakuar vetëm në pikën II të dispozitivit të tij përmes ankesës së paraqitur nga parashtuesi i kërkesës. Ndërsa ndaj pikës I të dispozitivit të atij aktgjykimi nuk ishte paraqitur ankesë. Rrjedhimisht, sipas parashtuesit, pika I e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore A.nr.1051/2019 përbënte çështje *res judicata*.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht iu referua praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në bazë të së cilës sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Në këtë kuadër, Gjykata vuri në dukje se sipas KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vendimet lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe deportimin e të huajve nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile të parashtuesve apo akuzën penale ndaj tij/saj brenda kuptimit të nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së. Andaj, lidhur me largimin me forcë të të huajve (siç është rasti me procedurat të cilat i konteston parashtuesi para Gjykatës Kushtetuese), zbatohet neni 1 (Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve) i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, i cili nen përmban garancitë procedurale që aplikohen lidhur me largimin me forcë të të huajve.

Në këtë sfond, duke pasur parasysh që rasti i parashtuesit ishte duke u shqyrtuar nga gjykatat e rregullta, si dhe faktin që neni 6 i KEDNJ nuk aplikohet në rastet e procedurës për dëbimin e të huajve nga vendi, Gjykata Kushtetuese theksoi se ajo nuk mund të vlerësonte nëse parashtuesit të kërkesës i ishin respektuar të drejtat e tij procedurale të garantuara në paragrafin 1 të nenit 1 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, pa pasur një vendim përfundimtar nga gjykata e rregullta lidhur me “ligjshmërinë” e vendimit për dëbim e tij nga Kosova. Prandaj, Gjykata

Kushtetuese gjeti se procedurat e iniciuara nga parashtruesi i kërkesës ishin ende në fazën e vendosjes, rrjedhimisht kërkesa e parashtruesit para Gjykatës Kushtetuese ishte e parakohshme.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës e kishte paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese para se të shteronte të gjitha mjetet efektive të parapara në legjislacionin përkatës. Prandaj, kërkesa e parashtruesit para Gjykatës Kushtetuese ishte e parakohshme dhe, si e tillë, duhej të shpallej e papranueshme.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 39.1 (b) të Rregullores së punës, me shumicë votash, vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme.

1.9. KI31/18. PARASHTRUESE: KOMUNA E PEJËS

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/ki_31_18_agj_shq.pdf]

23 prill 2019

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky rast kishte të bënte me një procedurë kontestimore që ishte zhvilluar në gjykatat e rregullta në mes të Komunës së Pejës dhe një kompanie private ku gjykatat e rregullta kishin detyruar Komunën e Pejës t'i paguajë kompanisë private shumën e të hollave në vlerë prej 392,515.00 eurosh, në emër të dëmit kontraktues. Çështja kushtetuese që ngrihej në këtë rast ishte pretendimi i Komunës së Pejës se i ishte cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës), sepse gjendja faktike nuk ishte vërtetuar në mënyrë të plotë dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk e plotësonte standardin e vendimit të arsyetuar.

Faktet kryesore

Më 15 shtator 2005, parashtruesja e kërkesës, përkatësisht Komuna e Pejës, kishte hyrë në një marrëveshje kontraktuale trepalëshe me Shërbimin Policor të Kosovës, tashmë Policia e Kosovës dhe kompaninë private, “DPZ Gashi Towing Service”. Objekti i kontratës trepalëshe ishte kryerja e shërbimeve nga “DPZ Gashi Towing Service” për rimorkim, përkatësisht tërheqje të automjeteve të parkuara në mënyrë jashtëligjore apo të aksidentuara dhe vendosjen e tyre në bazën e caktuar të parkingut. Kontrata përcaktonte që ky shërbim do të kërkohej nga Policia e Kosovës, në rastet kur ndodhte ndonjë aksident në trafik, apo kur për arsye të tjera ishte e nevojshme që të bëhej rimorkimi i automjeteve. Më 18 shtator 2007, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) kishte marrë vendim për vazhdimin e kontratës trepalëshe nga data 15 shtator 2007 deri “në shpalljen e tenderit dhe zgjedhjes së përfituesit më të volitshëm”. Më 19 tetor 2009, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) kishte marrë vendim për vazhdimin e kontratës trepalëshe edhe për tre muaj. Në vendim thuhej se kjo kontratë do të vazhdohej “për tre muaj - deri në përfundim të zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjen e përfituesit me tender për kryerjen e këtyre shërbimeve”.

Më 19 maj 2010, “DPZ Gashi Towing Service” i ishte drejtuar parashtrueses së kërkesës (Komunës së Pejës) me një letër, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar që të bëhet shpallja e ankandit publik për shitjen e automjeteve që ishin konfiskuar nga Policia e Kosovës e të cilat po mbaheshin në parkingun e “DPZ Gashi Towing Service”. Në letrën në fjalë, ndër të tjera, thuhej se sipas kontratës veturat që merreshin nga ana e Policisë pas 90 ditësh, Komuna e Pejës ishte e obliguar t’i vendoste në ankand publik. Kompania po ashtu kishte njoftuar Komunën e Pejës se kishin një numër të madh të veturave që ishin marrë për kundërvajtje dhe qëndronin më shumë se 90 ditë në parkingun e kompanisë. Më 25 maj 2010, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) i ishte përgjigjur kërkesës së përsëritur të “DPZ Gashi Towing Service” duke i rekomanduar “që të procedonin në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2009 të Policisë së Kosovës neni 8 (Tjetërsimi) dhe në bazë të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, respektivisht nenit 35 (Heqja dorë nga pronësia) që pronari në mënyrë

të qartë duhet të shprehet se heqë dorë nga pronësia e tij në atë send, me (vendim gjyqësor)". Më 1 korrik 2010, si pasojë e mospajtimeve lidhur me zbatimin e Kontratës, "DPZ Gashi Towing Service" kishte parashtruar padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë [tashmë Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike], kundër parashtrueses së kërkesës dhe Policisë së Kosovës. Nëpërmjet kësaj padie, "DPZ Gashi Towing Service" kishte kërkuar që palët e paditura të detyroheshin të paguanin dëmin prej 663,450.00 eurosh, plus kamatën dhe shpenzime procedurale, për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve që dilnin nga kontrata.

Në lidhje me padinë e parashtruar nga "DPZ Gashi Towing Service", gjykatat e rregullta kishin marrë gjithsej tetë vendime. Ishin marrë tri vendime nga gjykata e shkallës së parë; një vendim për korigjim të një vendimi të shkallës së parë; dy vendime në nivel apeli, si dhe dy vendime nga Gjykata Supreme në bazë të revizionit të parashtruar. Në Gjykatën Kushtetuese u kontestua vendimi i fundit i grupit të tretë të vendimeve, i marrë nga Gjykata Supreme, përkatësisht Aktgjykimi E. Rev. nr. 20/2017, i 20 nëntorit 2017.

Grupi i parë i vendimeve të gjykatave të rregullta: Më 4 prill 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e "DPZ Gashi Towing Service". Kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike, të paditurat kishin paraqitur ankesat e tyre. Më 26 qershor 2014, Gjykata e Apelit kishte pranuar si të bazuara ankesat e të paditurave dhe e kishte kthyer lëndën në rigjykim pranë Gjykatës Ekonomike e Qarkut.

Grupi i dytë i vendimeve të gjykatave të rregullta: Më 11 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes aktgjykimit sërish e kishte miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e "DPZ Gashi Towing Service". Kundër aktgjykimit të lartpërmendur, të paditurat kishin paraqitur ankesat e tyre. Më 8 korrik 2016, Gjykata e Apelit përmes aktgjykimit kishte refuzuar ankesat e të paditurave si të pabazuara duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të paditurat kishin paraqitën kërkesat e tyre për revizion para Gjykatës Supreme. Më 7 dhjetor 2016, Gjykata Supreme përmes aktvendimit kishte pranuar revizionet e të paditurave

dhe kishte prishur aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe i kishte kthyer çështjen në rigjykim Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata Supreme kishte konsideruar se revizionet e parashtruara nga të paditurat ishin të themelta me arsyetimin se aktgjykimet e instancave më të ulëta “ishin marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale e që për pasojë, gjendja faktike kishte mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë”.

Grupi i tretë i vendimeve të gjykatave të rregullta. Më 15 qershor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes aktgjykimit të saj të tretë për të njëjtën çështje e kishte miratuar në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të “DPZ Gashi Towing Service” ku nga kërkesëpadia fillestare prej 663,450.00 eurosh, tashmë “DPZ Gashi Towing Service” kërkonte 392,515.00 euro. Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte detyruar të paditurat që, në mënyrë solidarë, t’ia paguanin “DPZ Gashi Towing Service” shumën prej 392,515.00 eurosh në emër të dëmit kontraktues që rridhte nga kontrata, së bashku me kamatën ligjore dhe shpenzimet procedurale. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ankesë kishin paraqitur që të dy të paditurat (gjegjësisht Komuna e Pejës dhe Policia). Më 15 qershor 2017, Gjykata e Apelit përmes aktgjykimit i kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e të paditurave dhe kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, dy të paditurat kishin paraqitur kërkesë për revizion për Gjykatën Supreme. Parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) në kërkesën për revizion kishte pretenduar se vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit ishin marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Konkretisht, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) në kërkesën për revizion kishte paraqitur argumentet e përmbledhura si në vijim: (i) Aktgjykimi i shkallës së dytë dhe të parë nuk e kanë përfillur qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme, të paraqitur në Aktgjykimin Rev. E. nr. 35/2016 dhe nuk kanë mënjanuar të metat në procedurë të rigjykimit; (ii) Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë qartësuar se në çfarë baze juridike i kanë mbështetur aktgjykimet e tyre, meqë nuk është e qartë se borxhi i akorduar a duhet të paguhet në emër të “borxhit kontraktues apo shpërblimit të dëmit” e që ka qenë edhe vërejtje e Gjykatës Supreme; (iii) Kontrata nuk e ka detyruar “DPZ Gashi Towing Service” që të ruajë

automjetet mbi afatin 90 ditor, prandaj është e palogjikshme se përse janë detyruar të paditurat të dëmshpërblejnë “DPZ Gashi Towing Service” për ruajtjen e automjeteve për kohën pas skadimit të afatit 90-ditor; (iv) Gjykata e Apelit shkon përtej secilit interpretim të shkallës së parë dhe vendos pozitivisht mbi kërkesën e “DPZ Gashi Towing Service” mbi një bazë krejt tjetër juridike, pa seancë dhe pa vërtetimin e gjendjes faktike; (v) Gjykata e Apelit konsideron gabimisht se pas shfuqizimit të nenin 3.6 të kontratës dispozitat e tjera të kontratës mbetën në fuqi konform nenit 103.2 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD) dhe se “DPZ Gashi Towing Service” duhet të kompensohet konform nenit 3.1 dhe 3.2 të Kontratës; (vi) Gjykata e Apelit ka interpretuar fakte të cilat nuk janë vërtetuar gjatë procedurës në shkallën e parë dhe ka nxjerrë paralele në mes të këtij rasti me raste të tjera të cilat i vlerëson të ngjashme ndërkaq që dëshmitë konkrete mungojnë; (vii) Gjykata e Apelit, ashtu sikur edhe gjykata e shkallës së parë, nuk e bën fare ndërlidhjen e ekspertizës me dëmshpërblimin e akorduar, duke e bërë kështu aktgjykimin edhe më të pakuptimtë; dhe (viii) Gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk janë lëshuar fare në kontestimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me vazhdimin e kontratës dhe se nuk ekziston një detyrim i kontraktuar, meqë neni 4.5 i kontratës parasheh që nëse të paditurat nuk e organizojnë ankandin, atëherë ankandi organizohet nga “DPZ Gashi Towing Service”. Më 20 nëntor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit E. Rev. nr. 20/2017, kishte refuzuar revizionin e parashtrueses së kërkesës (Komunës së Pejës), si palë e parë e paditur; ndërkaq revizionin e palë së dytë të paditur, përkatësisht Policisë së Kosovës e kishte pranuar si të bazuar. Gjykata Supreme kishte vendosur që pagesa e “dëmit kontraktues” prej 392,515.00 eurosh, tashmë të akorduar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duhej ta paguante vetëm parashtruesja e kërkesës e vetme dhe jo në baza solidare së bashku me Policinë e Kosovës.

Procedura e përmbarimit të vendimeve të gjykatave të rregullta: Në bazë të vendimeve të gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës ishte obliguar t’ia paguante kompanisë private “DPZ Gashi Towing Service” shumën prej 392,515.00 eurosh, në emër të dëmit kontraktues, së bashku me kumatën ligjore dhe shpenzimet procedurale. Në një datë të pacaktuar, “DPZ Gashi Towing Service” kishte paraqitur propozim për përmbarim të vendimeve të gjykatave të rregullta. Më 6

shtator 2017, përmbaruesi privat përmes urdhrit përmbarimor kishte miratuar propozimin për përmbarim të “DPZ Gashi Towing Service”. Parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) kishte parashtruar prapësim kundër urdhrit të lartcekur të përmbaruesit privat. Më 28 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Pejë, përmes aktvendimit e kishte refuzuar prapësimin e parashtruar nga parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat. Më 10 janar 2018, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) kishte paraqitur ankesë kundër aktvendimit të lartcekur. Më 8 janar 2019, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës (Komunës së Pejës) të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë.

Më 5 mars 2018, Komuna e Pejës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesja e kërkesës, gjegjësisht Komuna e Pejës kontestoi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017. Ajo pretendoi se ky aktgjykim i kishte shkelur të drejtën për “barazi para ligjit” të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës; të drejtën për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm”, përkatësisht të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtën për “mjete juridike” të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës. Parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) kishte paraqitur dy lloje të pretendimeve kryesore. Grupi i parë i pretendimeve kishte të bënte me pretendimet se gjendja faktike nuk ishte vërtetuar plotësisht; dhe grupi i dytë kishte të bënte me pretendimet se Gjykata Supreme kishte dështuar të ofronte një vendim të arsyetuar, duke mos u përgjigjur në disa argumente të saj të paraqitura në kërkesën për revizion. Lidhur me pretendimin për mosvërtetim të plotë të gjendjes faktike, Komuna e Pejës pretendoi se asnjëra nga instancat gjyqësore nuk e kishte bërë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike. Sipas saj, gjykatat e rregullta asnjëherë nuk e kishin vërtetuar faktin nëse kontrata e datës 18 shtator 2009 [vazhdimi i tretë i Kontratës] ishte lidhur në kuptim të LMD-së. Kjo për faktin se palët asnjëherë nuk kishin nënshkruar aneks të kontratës por se vetëm kishte ekzistuar një vendim i brendshëm i parashtrueses së kërkesës (Komunës

së Pejës), i cili ishte marrë në mënyrë kundërligjore dhe pa prokurim në prag të zgjedhjeve. Më tutje, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) pretendoi se asnjëherë nuk ishte vërtetuar fakti se “DPZ Gashi Towing Service”, si kryes i shërbimeve, i ka ruajtur me të vërtetë automjetet sikur është kontraktuar, në vendin e kontraktuar dhe sipas kushteve të kontraktuara. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) pretendoi se gjykatat nuk e kishin vërtetuar faktin nëse automjetet tanimë ishin shitur apo jo nga “DPZ Gashi Towing Service” edhe pse ky i fundit në një seancë dëgjimore kishte deklaruar si i kishte shitur ato.

Lidhur me pretendim për mosarsyetim të vendimit nga Gjykata Supreme, parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) pretendoi se Gjykata Supreme i kishte shkelur të drejtën për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse kishte injoruar vërejtjet procedurale lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike të paraqitura në kërkesën për revizion. Më tutje, Komuna e Pejës pretendoi se precizimi i padisë nga ana e “DPZ Gashi Towing Service” [nga 663,450.00 euro në 392,515.00 euro] ishte bërë në kundërshtim me dispozitat e procedurës kontestimore dhe Gjykata Supreme nuk e kishte trajtuar këtë pretendim të saj në aktgjykimin e kontestuar, përkundër faktit se ajo e kishte parashtruar në kërkesën për revizion.

Parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës) kërkoi që Gjykata Kushtetuese të shpallte si kundër kushtetues vendimin e Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 20/2017, të 20 nëntorit 2017, si dhe vendimet e shkallëve më të ulëta gjyqësore të ndërlidhura me të. Në kërkesën e saj para kësaj Gjykate, Komuna e Pejës i referohej veçanërisht kërkesës për vendosje të masës së përkohshme. Në këtë drejtim, Komuna e Pejës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të miratonte masën e përkohshme ngase Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Ek. nr. 587/2016, i 15 qershorit 2017, ishte bërë vendim i cili mund të ekzekutohej dhe se ekzekutimi i tij mund të paraqiste situata që këto mjete nuk do të mund të ktheheshin asnjëherë tek parashtruesja e kërkesës (Komuna e Pejës), në qoftë se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese do të rezultonte si e suksesshme. Po ashtu, parashtruesja e kërkesës argumentoi se kërkesa për masë të përkohshme ishte në interes publik, ngase në rast të ekzekutimit këto mjete do të merreshin nga buxheti i Republikës së Kosovës dedikuar

Komunës së Pejës dhe ajo (Komuna e Pejës) nuk do të kishte mundësi të realizonte projekte me interes publik.

Kompania “DPZ Gashi Towing Service” kishte paraqitur komente në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës (Komunës së Pejës) dhe duke kërkuar refuzimin e saj.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, më 27 shkurt 2019, kishte shqyrtuar ndaras kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme dhe, përmes një vendimi për masë të përkohshme të publikuar më 4 mars 2019, kishte miratuar të njëjtën duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore të punës. Gjykata Kushtetuese kishte miratuar masën e përkohshme, deri më 30 prill 2019, *“pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxjerrë përkitazi me meritat e kërkesës”*.

Para skadimit të masës së përkohshme, përkatësisht më 12 prill 2019, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi kërkesën e parashtrueses në tërësi dhe konsideroi që e njëjta ngrehte çështje të natyrës kushtetuese, vendosja e të cilave kërkonte shqyrtimin e meritave të kërkesës. Pas shqyrtimit të meritave të kërkesës, Gjykata Kushtetuese gjeti se në rastin konkret nuk kishte pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së dhe se parashtruesja e kërkesës kishte përfituar nga garancitë kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese. Para se të arrinte tek ai përfundim, Gjykata Kushtetuese trajtoi gjerësisht pretendimet kryesore të parashtrueses së kërkesës se gjendja faktike nuk ishte vërtetuar plotësisht nga gjykatat e rregullta dhe se Gjykata Supreme kishte dështuar të ofronte një vendim të arsyetuar, duke mos u përgjigjur në disa argumente të saj të paraqitura në kërkesën për revizion.

Për sa i takon pretendimeve konkrete të parashtrueses së kërkesës, përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e ligjit material dhe procedural, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Supreme (sikundër edhe gjykatat e shkallëve më të ulëta), i kishte kushtuar vëmendje të duhur standardeve gjegjëse dhe aspekteve të nevojshme të vërtetimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike. Po ashtu,

Gjykata Kushtetuese nuk gjeti se kishte arbitraritet në mënyrën sesi Gjykata Supreme kishte interpretuar ligjin material dhe procedural, të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret.

Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese iu referua qëndrimit të saj të përgjithshëm se, parimisht, vërtetimi i saktë dhe i drejtë i gjendjes faktike, sikundër edhe interpretimet përkatëse ligjore, bien në kompetencë të gjykatave të rregullta. Argumentet për shkelje kushtetuese janë të qëndrueshme vetëm nëse vërtetohet se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ – që nuk u konstatua në rastin konkret.

Për sa i takon pretendimit të parashtrueses së kërkesës përkitazi me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Supreme nuk ia kishte shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës për një vendim të arsyetuar – komponentë kjo qenësore e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Gjykatës Kushtetuese arsyetoi se, përkundër faktit që Gjykata Supreme mund të mos ishte përgjigjur në çdo pikë të ngritur nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata Supreme me vendimin e saj kishte adresuar argumentet dhe pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës dhe rrjedhimisht kishte përmbushur obligimin për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor. Në këtë vazhdë, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se Gjykata Supreme kishte arsyetuar vendimin e saj për sa i takon ligjshmërisë së kontratës dhe kishte dhënë mendimin e saj përfundimtar, të bazuar në ligj, lidhur me atë se cilat nene ishin të aplikueshme dhe në bazë të cilave nene parashtruesja e kërkesës detyrohet të paguajë dëmshpërblimin e akorduar kundrejt “DPZ Gashi Towing Service”. Gjykata Kushtetuese iu referua (duke cituar) pjesës relevante të arsyetimit të Gjykatës Supreme, për sa i takon kontratës.

Duke qenë se me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese u konstatua kushtetutshmëria e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme dhe rrjedhimisht e të gjitha vendimeve të tjera të ndërlidhura me të, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me praktikën e saj të përgjithshme, e shfuqizoi masën e përkohshme të vendosur parapakisht.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, nenet 20.2, 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 20/2017, i 20 nëntorit 2017, ishte në përputhshmëri me nenet 24, 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. BURDOV kundër RUSISË (Nr. 2)

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%22233509/04%22%5D%7D>

[Seksioni i parë]

15 janar 2009

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: dështimi vazhdueshëm i autoriteteve për të zbatuar tri vendime të brendshme që urdhërojnë pagesa monetare nga autoritetet; dështimi i autoriteteve kompetente shtetërore për të paguar përfitimet në tërësi dhe në kohë adekuate duke përfshirë ndryshimet valutore; dështimi i autoriteteve kompetente shtetërore për të njohur shkeljen dhe zhdëmtuar dëmin si pasojë e vonesave në kompensim; mungesa e mjeteve juridike të brendshme efektive në lidhje me moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të aktgjykimeve në favor të kërkuarit.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Anatolij Tikhonoviç Burdov, shtetas rus (kërkuar) kundër Federatës Ruse. Kërkuar ishte i lindur në vitin 1952 dhe jetonte në Shakhty, në rajonin Rostov të Federatës Ruse. Më 1 tetor 1986 kërkuar u thirr nga autoritetet ushtarake për të marrë pjesë në operacionet emergjente në vendin e katastrofës bërthamore të Çernobilit. Ai ishte i

angazhuar në operacionet deri më 11 janar 1987 dhe, si rezultat, vuajti nga ekspozimi i gjerë ndaj emetimeve radioaktive. Këtë e vërtetoi edhe eksperti mjekësor i cili ndërlidhi pasojat shëndetësore me aktivitetet e tij në situatën emergjente lidhur me katastrofën e Çernobilit. Bazuar në këtë kërkuesi kishte të drejtë për përfitime të ndryshme sociale. Nga viti 1997 e në vazhdim, kërkuesi paditi në mënyrë të përsëritur autoritetet kompetente shtetërore, duke kërkuar pagesën e përfitimeve shoqërore në lidhje me kontributin e tij në operacionet emergjente në vendin e katastrofës së centralit bërthamor të Çernobilit. Gjykatat miratuan kërkesat e tij, por një numër vendimesh të tyre mbetën të pazbatuara për periudha të ndryshme kohore. Në vitin 2000, kërkuesi paraqiti ankesën e parë në GJEDNJ në lidhje me moszbatimin e vendimeve gjyqësore vendore. Në vitin 2002, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Në një rezolutë të vitit 2004, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës tregoi se, brenda kohës së lejuar, Qeveria i kishte paguar kërkuesit shumën e kompensimit të drejtë (just satisfaction), të paraparë në aktgjykimin e vitit 2002 brenda kohës së lejuar. Komiteti i Ministrave rikujtoi se problemi më i përgjithshëm i mosekzekutimit të vendimeve të gjykatave të brendshme në Rusi po trajtohej nga autoritetet, nën mbikëqyrjen e Komitetit, në kontekstin e çështjeve të tjera në pritje. Ndërkohë, parashtruesi kishte marrë vendime të tjera në favor të tij. Ato u zbatuan plotësisht, por disa prej tyre me vonesa që shkonin nga një deri në gati tre vjet.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi se dështimi i vazhdueshëm dhe i zgjatur i autoriteteve për të respektuar vendimet e detyrueshme në favor të tij, shkelte të drejtën e tij për gjykim të drejtë, sipas nenit 6 të Konventës dhe të drejtën e tij për gëzimin paqësor të zotërimeve të tij, sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1. Në lidhje me këto pretendime, Qeveria fillimisht argumentoi në qëndrimet se kërkuesi i nuk kishte shteruar mjetet juridike të brendshme. Megjithatë, në qëndrimet e tyre të mëtejshme në përgjigje të kërkuesit, Qeveria u tërhoq nga kundërshtimi i tyre për mosshkrimin e mjeteve juridike vendore. Qeveria gjithashtu argumentoi se kërkuesi nuk mund të pretendonte më se ishte viktimë e shkeljeve të pretenduara: dëmi i shkaktuar nga vonesat në zbatim ishte kompensuar me shpërblime shtesë të dhëna nga gjykatat, sipas

nenit 208 të Kodit të Procedurës Civile. Qeveria mbështeti përgjigjen e vet duke iu referuar vendimeve të caktuara të GJEDNJ-së (veçanërisht *Nemakina kundër Ruisë* (vendim), nr. 14217/04, 10 korrik 2007, dhe *Derkach kundër Ruisë* (vendim), nr. 3352/05, 3 maj 2007).

Qeveria argumentoi më tej se ankesat ishin qartazi të pabazuara. Sipas mendimit të tyre, periudhat kohore nga marrja e dokumenteve të nevojshme nga autoritetet kompetente deri në pagesën efektive të vendimeve gjyqësore kishin filluar nga trembëdhjetë ditë deri në nëntë muaj, që ishte e arsyeshme në dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës. Qeveria fajësoi kërkuesin për tërheqjen e vazhdueshme të urdhrin të ekzekutimit në lidhje me vendimin e 17 prillit 2003 dhe dërgimin e tij në mënyrë të njëpasnjëshme tek autoritetet e ndryshme. Aktgjykimi i 4 dhjetorit 2003 u zbatua vetëm gjashtë muaj pas korigjimit të tij më 9 mars 2006. Së fundi, vendimi i 24 marsit 2006 u zbatua në dy hapa: më 2 nëntor 2006 në pjesën më të madhe të tij dhe më 17 gusht 2007 për pjesën e mbetur, gjegjësisht vetëm nëntë muaj pas ekzekutimit të pjesshëm. Qeveria përfundimisht iu referua kompleksitetit të procedurave përmbartimore në këtë rast, duke qenë se ishin përfshirë disa aktgjykime (procedura). Ata gjithashtu theksuan rrethanat objektive, të tilla si kompleksiteti i sistemit buxhetor federal me shumë nivele dhe ndryshimet legjislative, të cilat kishin çuar në vonesa në zbatim, për të cilat Qeveria nuk ishte përgjegjëse.

Në anën tjetër kërkuesi parashtroi se ai ishte ankuar para autoriteteve të ndryshme shtetërore, përfshirë Ministrinë e Financave, Thesarin Federal, zyrën e prokurorit dhe përmbartuesit gjyqësor, për pagesa të pamjaftueshme, të parregullta dhe/ose vonesa në zbatimin e vendimeve në favor të tij. Sipas mendimit të tij, autoritetet shtetërore duhet të kishin treguar zell në këtë drejtim, por nuk kishin arritur të ndërmerren veprimet e nevojshme. Ai konsideroi se vonesat çuditërisht të shkurtra në ekzekutimin e vendimeve të 22 majit 2007 dhe 21 gushtit 2007 ishin, me sa duket, rezultat i vendimit të Gjykatës për t'i komunikuar kërkesën e tij Qeverisë.

Kërkuesi nuk pretendoi mungesën e mjeteve juridike të brendshme efektive në lidhje me ankesën e tij për moszbatimin e zgjatur nga autoritetet të aktgjykimeve vendore në favor të tij. Megjithatë, Gjykata

vërejtje se numri i ankesave në lidhje me padrejtësinë e mjeteve juridike vendase po rritej gjithnjë e më shumë para Gjykatës, në veçanti, në rastet në lidhje me moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të aktgjykimeve vendore. Prandaj, Gjykata vendosi për të shqyrtuar këtë çështje sipas nenit 13 në rastin aktual dhe kërkoi nga palët që të paraqesin vërejtjet.

Në lidhje me shkeljen e nenit 13, kërkuesi nuk paraqiti ndonjë argument specifik mbi ekzistencën e mjeteve juridike të brendshme dhe efektivitetin e tyre. Në vëzhgimet e tij të mëparshme, ai përsëriti se i kishte paraqitur ankesat e tij pa sukses tek autoritetet e ndryshme, përfshirë Ministrinë e Financave, Thesarin Federal, zyrën e prokurorit dhe përmbaruesin. Ndërkaq Qeveria argumentoi se kishte disa mjete juridike të brendshme efektive kundër moszbatimit që nuk ishin përdorur nga parashtuesi në rastin në fjalë. Një shembull i praktikës gjyqësore u siguroi: me një vendim të 13 korrikut 2007, Gjykata e Qarkut Leninskiy në Cheboksary, Republika e Chuvashiya, gjeti mosveprimin nga departamenti i thesarit rajonal si të paligjshëm dhe urdhëroi pagesën e shumës së akorduar nga gjykata brenda një dite pune. Ndër të tjera, Qeveria arriti në përfundimin se ligji rus parashikonte një përmbledhje të mjeteve të ndryshme juridike të cilat duhet të konsiderohen në tërësi; ato ishin të formuluar me qartësi dhe u zbatuan në praktikë siç kërkohet nga neni 13 i Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata arsyetoi se Qeveria në mënyrë shprehimore ka hequr dorë nga kundërshtimi i argumentit për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme nga kërkuesi dhe vendosi që të mos shqyrtojë këtë çështje. Gjykata përsëriti se një vendim ose masë e favorshme për kërkuesin, siç është ekzekutimi i një vendimi pas vonesës së konsiderueshme, në parim nuk është i mjaftueshëm për ta privuar atë nga statusi i tij si “viktimë”, përveç nëse autoritetet vendore e kanë pranuar, qoftë shprehimisht ose në thelb, dhe më pas kanë dhënë dëmshpërblim për shkeljen e Konventës. Dëmshpërblimi i dhënë duhet të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm, në të kundërtën pala mund të vazhdojë të pretendojë se është viktimë e shkeljes.

Qeveria argumentoi se gjykatat vendase i kishin dhënë kërkuesit kompensim për vonesat në zbatimin e vendimeve në favor të tij, me

anë të indeksimit të vendimeve fillestare sipas nenit 208 të Kodit të Procedurës Civile. Kërkuesi nuk e kundërshtoi këtë fakt, por argumentoi se ai vazhdoi të kishte statusin e viktimës. Prandaj, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse çmimet e indeksimit përbënin kompensim të shkeljeve të Konventës, gjegjësisht nëse përbënin korrigjim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në këtë drejtim. Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit nuk iu dha dëmshpërblimi adekuat dhe i mjaftueshëm në lidhje me shkeljet e pretenduara, prandaj ai, prapëseprapë, mund të pretendonte se ishte viktimë sipas nenit 34 të Konventës. Prandaj, Gjykata arriti në përfundim se kundërshtimi i Qeverisë duhej të hidhej poshtë.

Sipas Gjykatës, e drejta për gjykim të drejtë, e mbrojtur nga neni 6, do të ishte iluzore nëse sistemi juridik i brendshëm i një shteti kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar, detyrues, të mos zbatohet në dëm të njërës palë. Prandaj, ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë integrale e “gjykimit” për qëllimet e nenit 6. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se, duke vonuar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Qytetit Shakhty, të 17 prillit 2003, 4 dhjetorit 2003 dhe 24 marsit 2006, autoritetet nuk kishin respektuar të drejtën e parashtruesit për qasje në gjykatë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të dështimit të vazhdueshëm dhe të zgjatur të shtetit për të zbatuar tri vendime të brendshme që urdhërojnë pagesa monetare nga autoritetet për kërkuesin; se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, për shkak të mungesës së mjeteve juridike të brendshme efektive në lidhje me moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të aktgjykimeve në favor të kërkuesit. Gjykata vendosi njëzëri se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të zbatimit të vendimeve të 22 majit 2007 dhe 21 gushtit 2007. Gjykata kërkoi nga shteti i paditur që t’i paguante parashtruesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, 6,000 (gjashtë mijë) euro, si dhe çdo taksë që mund të kërkohet, në lidhje me dëmin jomaterial.

2.2. MICALLEF kundër MALTËS

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2217056/06%22%5D%7D>

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

15 tetor 2009

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: njohja e statusit të viktimës bazuar në kërkesën e paraqitur në emër të motrës së kërkuesit, e cila kishte vdekur; pretendimi në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës për një gjykim të drejtë për shkak parregullsive në procedurën paraprake; paanshmëria e gjykatës në bazë të lidhjeve familjare të gjyqtarit me përfaqësuesit ligjorë; mungesa e së drejtës ligjore për të kundërshtuar paanshmërinë e një gjyqtari në bazë të lidhjeve familjare me avokatin e palës kundërshtare.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Joseph Micallef, një qytetar maltez (kërkuesi), kundër Maltës, më 15 prill 2006. Kërkuesi është vëllai i znj. M., e cila banonte në një apartament mbi Z. F. Më 17 korrik 1985, Z. F. kishte bërë një kërkesë për nxjerrjen e një urdhri që ndalonte znj. M. të vendoste rrobat e saj për tharje mbi oborrin e apartamentit të tij, gjë që sipas tij cenonte të drejtën e tij të pronës. Në lidhje me këtë, Z. F. u mbështet në dispozitat e nenit 403 të Kodit Civil të Maltës. Në një rast, mbas një seancë dëgjimore për urdhrin ndalues e mbasi znj. M. dhe avokati i saj, Dr. A., ishin larguar nga salla e gjyqit, gjyqtari kryesues kishte ndryshuar datën e seancës së ardhshme, e cila qe caktuar që më parë. Për rrjedhojë, znj. M., në padijeni për datën e re, nuk ishte e pranishme në seancë. Në mungesë të saj, më 29 nëntor 1985, Gjyqtari kryesues nxori urdhrin ndalues në favor të Z. F., sipas ligjit maltez, siç ishte në atë kohë. Z. F. për pretendimin e tij pronësor që mbrohej nga urdhri, duhej të hapte proces në gjykatë brenda katër ditësh nga koha e lëshimit të urdhrin ndalues, përndryshe urdhri nuk ishte më i vlefshëm. Në përputhje me këtë, më 5 dhjetor 1985, Z. F. bëri kërkesën për fillimin e procesit në gjykatë. Më 6 mars 1992, gjykata përkatëse që mori në shqyrtim themelin e çështjes së ngritur nga Z. F. mori vendim kundër znj. M., dhe nxori një urdhër ndalues të

përhershëm ndaj saj. Më 24 mars 1992, përderisa nuk ishte paraqitur asnjë kërkesë për apel, vendimi u bë i formës së prerë. Në lidhje me këtë çështje ishin zhvilluar një grup procedurash para gjykatave vendore, përfshirë edhe kërkesën kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese të Maltës e cila e deklaroi kërkesën të papranueshme.

Pasi që kërkesa u dorëzua nga kërkuesi pranë GjEDNJ, fillimisht kërkesa iu dorëzua Seksionit të Katërt të Gjykatës i cili vendosi, se në këtë rast kishte shkelje të nenit 6.1 të Konventës për shkak të mungesës së paanshmërisë objektive të Gjykatës së Apelit.

Më pas, më 7 korrik 2008, një panel i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën e Qeverisë për t'ia referuar çështjen Dhomës së Madhe në përputhje me nenin 43 të Konventës. Dhoma, e cila e ngriti çështjen me kërkesë të saj, vërejti se znj. M., viktima e drejtpërdrejtë, kishte vdekur derisa ishte duke ndjekur mjetet e brendshme juridike, që do të thotë se synonte të ankohej në Gjykatë për shkeljen e pretenduar. Ajo vërejti gjithashtu se, pas vdekjes së viktimës, gjykatat e brendshme nuk e kishin refuzuar kërkesën e kërkuesit për të ndërhyrë në procesin kushtetues e, më pas, për të apeluar vendimin në cilësinë e tij si vëlla i paditëses. Veç kësaj, Gjykata e kishte diskrecionin për t'ia njohur statusin e viktimës një kërkuesi dhe për të vazhduar shqyrtimin e një kërkesë kur kjo kishte të bënte me një çështje të një interesi të përgjithshëm. Dhoma gjykoi se pamundësia, në bazë të së drejtës së brendshme, për të apeluar dhe mos pranuar një gjykatës në panel i cili kishte lidhjeve me avokatin e njëjës palë, ishte një çështje mjaftueshëm me interes të përgjithshëm. Duke vërejtur, gjithashtu, se Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë, Dhoma konkludoi se kërkuesi kishte të drejtë të paraqiste kërkesën në fjalë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi ankohej për mungesë paanshmërie nga ana e Gjykatës së Apelit dhe, për pasojë, zonjës M (motrës së tij) i ishte mohuar mundësia për të bërë parashtrimet e saj, duke shkelur të drejtën e saj për një seancë të rregullt gjyqësore, parashikuar në nenin 6 të Konventës.

Qeveria kundërshtoi pranueshmërinë e kërkesës dhe ngriti një sërë çështjesh paraprake sipas neneve 34 dhe 35.1 të Konventës. Qeveria

e kundërshtoi pranueshmërinë e kërkesës për tri arsye: së pari, se kërkuesi nuk mund ta kishte statusin e viktimës pasi nuk kishte qenë palë në procedurë; së dyti, se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike të brendshme; dhe, së treti, se neni 6 nuk ishte i zbatueshëm për procedurat e masës së përkohshme (ndaj urdhrit ndalues).

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë për mospasjen e statusit të viktimës, Gjykata vlerësoi se viktima e drejtpërdrejtë kishte vdekur gjatë periudhës kur ishin ndjekur procedurat e rregullta, të cilat kishin zgjatur mbi dhjetë vjet në shkallë të parë dhe ishin të nevojshme për të shteruar mjetet juridike vendore. Juridiksionet kushtetuese nuk e kishin refuzuar kërkesën e kërkuetit për të ndërhyrë në proces në cilësinë e tij si vëlla dhe trashëgimtar i paditëses (motrës së tij) dhe as nuk kishin refuzuar të pranonin ankesën e tij. Për më tepër, ai ishte detyruar të bartë shpenzimet e çështjes së ngritur nga motra e tij dhe kështu ishte e mundur edhe të konsiderohet se kishte një interes të arsyeshëm për të kompensuar shpenzimet. Për më tepër, rasti ngriti çështje të rëndësishme në lidhje me administrimin e drejtë të drejtësisë dhe duke u lidhur kështu me interesin e përgjithshëm. Prandaj, kërkuesi kishte të drejtë të prezantonte kërkesën aktuale.

Në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike vendore, Gjykata vërejti se në periudhën kohore përkatëse nuk kishte pasur dispozitë sipas ligjit maltez për kundërshtimin e një gjyqtari në bazë të marrëdhënies familjare në cilësi të dajës-nipit me një avokat. Në ngritjen e kësaj çështjeje para gjykatave vendore, të cilat kishin hedhur poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve të zakonshme juridike dhe shqyrtuan thelbin e ankesës, kërkuesi kishte përdorur mjetet juridike që ishin të disponueshme për të dhe që lidheshin, në thelb, me faktet e ankmuara në Gjykatë.

Në vlerësim të zbatueshmërisë së nenit 6.1, Gjykata theksoi se procedurat e udhëhequra nga kërkuesi (dhe motra e tij), pranë gjykatave vendore ishin një grup procedurash të lidhura me procedurat paraprake (procedurat për masat e përkohshme) dhe meritat e çështjes. Si të tilla, ato nuk mund të shiheshin si të ndara nga njëra-tjetra. Edhe

pse procedurat paraprake normalisht nuk binin në mbrojtjen e nenit 6, Gjykata vërejtë se tani kishte një konsensus të gjerë midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6 për masat e përkohshme, duke përfshirë procedurat e masës së përkohshme. Ky është edhe qëndrimi i miratuar nga GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore. Në procedura tepër të gjata, vendimi i një gjyqtari për një urdhër të masës së përkohshme shpesh do të ishte i barabartë me një vendim mbi themelin e padisë, për një periudhë të konsiderueshme kohore, apo edhe përgjithmonë në raste të jashtëzakonshme. Më tutje, Gjykata theksoi se ndodh që, shpesh, që të dy procedurat, procedura e masës së përkohshme dhe ajo kryesore, vendosin për të njëjtat “të drejta civile ose detyrime”, sipas kuptimit të nenit 6 dhe prodhojnë të njëjtat efekte. Në rrethanat e rastit aktual, Gjykata nuk e konsideroi të pranueshme që procedurat e masës paraprake, me automatizëm, ishin jopërcaktuese të të drejtave dhe detyrimeve civile. Gjykata theksoi se nuk ishte e bindur se një defekt në procedura paraprake domosdoshmërisht do të korrigjohet në një fazë të mëvonshme, respektivisht në procedurat përkitazi me meritat, pasi që çdo cenim i pësuar deri atëherë është i pakthyeshëm dhe me pak mundësi reale për korrigjim të dëmit të shkaktuar, me përjashtim të mundësisë së kompensimit material.

Prandaj, Gjykata konsideroi se ishte një ndryshim i nevojshëm në praktikën gjyqësore të deritashme (përkitazi me zbatimin e nenit 6 në procedurat gjyqësore paraprake). Neni 6 do të ishte i zbatueshëm nëse e drejta në pyetje, si në thelb, ashtu edhe në procedurë, ishte “civile” sipas kuptimit të nenit 6 dhe se masa e përkohshme mund të konsiderohet në mënyrë efektive përcaktuese për të drejtën civile ose detyrimin në fjalë. Megjithatë, Gjykata pranoi se në raste të jashtëzakonshme mund të mos ishte e mundur të ketë pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e nenit 6.

Gjykata përfundimisht konstatoi se zbatueshmëria e nenit 6 ndaj masave të përkohshme do të varet nga plotësimi i disa kushteve. Së pari, e drejta që kontestohet si në procedurën kryesore, ashtu edhe në atë të masës së përkohshme duhet të jetë “civile”, sipas kuptimit të Konventës. Së dyti, natyra e masës së përkohshme, objekti dhe qëllimi i saj, si dhe efektet e saj në të drejtën në fjalë duhet të shqyrtohen hollësisht. Sa herë që mund të konsiderohet se një masë e përkohshme në mënyrë efektive përcakton të drejtën ose detyrimin civil në fjalë, pavarësisht

kohëzgjatjes së saj, do të zbatohet neni 6. Një aktgjykim ndërmjetësues mund të barazohet me masat e përkohshme dhe të njëjtat kritere janë të rëndësishme për të përcaktuar nëse neni 6 është i zbatueshëm në aspektin e tij civil (civil limb).

Gjykata theksoi se përderisa pavarësia dhe paanësia e gjykatës apo e gjyqtarit mbetet një mbrojtje e patjetërsueshme në të gjitha procedurat, garancitë e tjera procedurale mund të zbatohen vetëm në përputhje me natyrën dhe qëllimin e procedurës së përkohshme në fjalë. Në rastin konkret, thelbi i së drejtës në fjalë në procedurën kryesore kishte të bënte me shfrytëzimin e të drejtave pronësore dhe për rrjedhojë me një të drejtë të karakterit “civil”. Qëllimi i urdhrit ishte të përcaktonte të drejtën e kontestuar në procedurën kryesore dhe ishte menjëherë e zbatueshme. Prandaj, Gjykata arriti në përfundim se neni 6 ishte i zbatueshëm.

Në vlerësimin e themelit (meritave) të kërkesës së kërkuetit, Gjykata theksoi se parimi i paanshmërisë së gjykatës nënkupton mungesën e paragjyimit apo të njëanshmërisë dhe ekzistenca apo jo e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Sipas jurisprudencës së vazhdueshme të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6.1 duhet vendosur përmes një testi subjektiv ku i kushtohet vëmendje bindjeve dhe sjelljes personale të një gjyqtari të caktuar, d.m.th., nëse gjyqtari, në një çështje të caktuar, ka demonstruar paragjykim personal apo njëanshmëri; dhe përmes një testi objektiv, d.m.th., duke vërtetuar nëse vetë gjykata e, ndër të tjera, përbërja e saj ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e saj. Megjithatë, Gjykata theksoi se nuk ka një ndarje të ngushtë midis paanshmërisë subjektive dhe objektive, pasi sjellja e një gjyqtari jo vetëm që mund të nxisë objektivisht dyshime për paanshmërinë nga këndvështrimi i vëzhguesit të jashtëm (testi objektiv), por mund të ndërlidhet edhe me çështjen e bindjes së tij personale (testi subjektiv). Kështu, në disa raste kur mund të jetë e vështirë të sigurohen prova, me të cilat do të kundërshtohet prezumimi i paanshmërisë subjektive të gjyqtarit, kërkesa e paanshmërisë objektive ofron një garanci tjetër të rëndësishme.

(i) Testi subjektiv: Gjykata solli në vëmendje se në zbatimin e testit subjektiv, Gjykata ka konstatuar vazhdimisht se “paanshmëria

personale e një gjyqtari duhet të prezumohet derisa të ketë prova për të kundërtën”. Prandaj, duhet vendosur në çdo rast individual nëse marrëdhënia në fjalë është e një natyre dhe shkalle të tillë që të tregojë mungesën e paanshmërisë ndaj një pjesë të gjykatës. Në këtë aspekt edhe paraqitja (dukja) mund të ketë një rëndësi të caktuar, në dritën e maksimës se “drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe të shihet se po bëhet”. Në këso rastesh është në pyetje besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë te publiku. Kështu, çdo gjyqtar, në lidhje me të cilin ka një arsye legjitime për t’u frikësuar nga mungesa e paanshmërisë duhet të tërhiqet.

Me qëllim që gjykatat të frymëzojnë te publiku besimin që është i domosdoshëm, duhet të merren parasysh edhe çështjet e organizimit të brendshëm të gjykatës. Ekzistenca e procedurave kombëtare për sigurimin e paanshmërisë, përkatësisht e rregullave që rregullojnë tërheqjen e gjyqtarëve është një faktor i rëndësishëm në këtë drejtim. Lidhjet profesionale ose personale ndërmjet një gjyqtari dhe një pale në një çështje, ose me avokatin e palës, gjithashtu mund të ngrenë çështje të paanshmërisë së gjykatës. Edhe faktorët indirekt mund të merren parasysh në këtë drejtim.

Gjykata theksoi se sipas ligjit maltez, siç qëndronte në kohën përkatëse, nuk kishte detyrim automatik për gjyqtarin që të tërhiqej në rastet kur mund të kishte çështje të paanshmërisë. Po ashtu, një palë në një gjyq nuk mund të kundërshtonte një gjyqtar për shkak të një marrëdhënie të ngushtë familjare (vëlla ose motër), e lëre më një marrëdhënie xhaxha – nip ndërmjet gjyqtarit dhe avokatit që përfaqëson palën tjetër. Që atëherë ligji maltez ishte ndryshuar dhe tani përfshin marrëdhëniet e ngushta familjare (vëlla-motër) si bazë për tërheqjen nga gjykimi. Në kontestin në fjalë, në çështjen e kërkuarit, Gjykata u shpreh se lidhjet e ngushta familjare ndërmjet gjyqtarit dhe avokatit të palës kundërshtare mjaftuan për të justifikuar në mënyrë objektive frikën që trupit gjykues i mungonte paanshmëria. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi shkëlqje të nenit 6 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata refuzoi kundërshtimet paraprake të paraqitura nga Qeveria; konstatoi se ka pasur shkëlqje të nenit 6.1 të Konventës, në lidhje me

kërkesën për paanësi; konstatoi njëzëri se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohet veçmas ankesa e kërkuarit në lidhje me të drejtën e znj. M. për të bërë parashtrës; vendosi që shteti përgjegjës duhej t'i paguante kërkuarit 2,000 (dy mijë) euro plus çdo taksë që mund t'i ngarkohej në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

2.3. RAMOS NUNES DE CARVALHO E SÁ kundër PORTUGALISË

[[55391/13](#), [57728/13](#) dhe [74041/13](#)]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

6 nëntor 2018

***Çështja kyç/e drejta e pretenduar:** mungesa e dëgjimit publik dhe shtrirja e kufizuar e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë mbi vendimet disiplinore të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit; mungesa e pretenduar e pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës së Lartë për shkak të rolit të dyfishtë të Kryetarit të saj dhe përvojës së mëhershme të gjyqtarëve të saj, të lidhur me Këshillin e Lartë të Gjyqësorit.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Paula Cristina Ramos Nunes de Carvalho e Sá, një shtetase portugeze (kërkuarja), kundër Republikës së Portugalisë më 8 gusht 2013. Në vitin 2010 dhe 2011, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (Conselho Superior da Magistratura, në tekstin e mëtejshëm: “CSM”) ngriti tri grupe procedurash disiplinore kundër kërkuarës, në cilësinë e saj si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Vila Nova de Famalicão: së pari, sepse e kishte quajtur inspektorin gjyqësor përgjegjës për vlerësimin e performancës së saj një “gënjeshtar” gjatë një bisede telefonike, dhe duke e akuzuar atë se ishte “inert dhe me mungesë të kujdesit të shtuar”; së dyti, për përdorimin e dëshmisë së rreme në procedurat e mëhershme; dhe së treti, sepse ajo kishte kërkuar nga hetuesi gjyqësor, gjatë një bisede private, të mos marrë masa disiplinore kundër dëshmitares në emër të saj, e cila ishte thirrur gjatë grupit të parë të procedurave. Midis 2011 dhe 2012, CSM në seancë plenare, duke

vendosur në tri grupet e procedurave, urdhëroi kërkuesen të paguante gjobën prej 20 ditësh pune pa pagesë për veprimet në kundërshtim me detyrën dhe obligimin e saj në cilësi të gjyqtares për ndershmëri dhe përshtatshmëri. CSM po ashtu e pezulloi kërkuesen nga detyra për 100 ditë, për shkelje të detyrës së saj të ndershmërisë; dhe e pezulloi atë për 180 ditë për veprim në kundërshtim me detyrat e saj të besnikërisë dhe të ndershmërisë. Në vitin 2013, Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme njëzëri i hodhi poshtë tri ankesat e parashtruara nga kërkuesja kundër vendimeve të CSM-së, pa mbajtur seancë dëgjimore. Gjykata e Lartë konstatoi, ndër të tjera, se detyra e saj nuk ishte të shqyrtonte faktet, por vetëm të shqyrtonte nëse faktet kishin qenë të arsyeshme dhe koherente. Në vitin 2014, CSM në seancën plenare grupoi së bashku dënimet e shqiptuara në të tri grupet e procedurave disiplinore dhe shqiptoi një dënim të vetëm - pezullimin nga puna prej 240 ditësh për kërkuesen. Ajo në fakt u pezullua nga detyra vetëm për 100 ditë, pasi zbatimi i pjesës së mbetur të dënimit ishte i parashkruar.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 6.1 (E drejta për një gjykim të drejtë), kërkuesja pretendoi shkelje të së drejtës së saj për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme me juridiksion të plotë dhe të drejtës së saj për dëgjim publik. Më tej ajo u ankua se, në funksion të riklasifikimit të fakteve nga CSM, ajo nuk ishte e informuar në detaje për natyrën e akuzave kundër saj dhe rrjedhimisht nuk kishte pasur kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së saj. Kërkesat u dorëzuan në GJEDNJ më 16 gusht dhe 8 nëntor 2013. Në vendimin e Dhomës, të 21 qershorit 2016, Gjykata vendosi njëzëri se kishte shkelje të nenit 6 të Konventës (E drejta për proces të rregullt). Më 20 shtator 2016, Qeveria kërkoi që çështja t'i referohej Dhomës së Madhe sipas nenit 43 dhe, më 17 tetor 2016, paneli i Dhomës së Madhe e pranoi kërkesën. Një seancë publike u mbajt më 22 mars 2017.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e kërkueses për shkelje të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt), Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi si në vijim: për sa i përket çështjes së mungesës së pretenduar të pavarësisë dhe

paanshmërisë së gjykatës, Gjykata vuri në dukje se kërkuesja nuk ishte ankuar për mungesë pavarësie dhe paanshmërie nga ana e CSM-së në formularët e saj të aplikimit. Për më tepër, Gjykata e kishte njoftuar Qeverinë vetëm për ankesat e kërkueses në lidhje me mungesën e pretenduar të qasjes në gjykatë, mungesën e pretenduar të pavarësisë dhe të paanshmërisë së Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë, dhe për mungesën e dëgjimit publik. Ankesa në fjalë ishte gjithashtu e ndarë nga ankesat, në lidhje me të cilat Qeveria ishte ftuar të paraqiste vëzhgime dhe e njëjta nuk ishte e lidhur thelbësisht me to, aq sa të mos mund të shqyrtohet veçmas. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se ankesa lidhur me mungesën e pretenduar të pavarësisë dhe paanshmërisë së CSM-së, që ishte bërë për herë të parë në parashtrimet e kërkueses të 30 tetorit 2015, ishte e pasafatshme duke qenë se procedurat kishin përfunduar në vitin 2013, pra më shumë se gjashtë muaj para dorëzimit të kërkesës. Prandaj, Gjykata e hodhi poshtë këtë ankesë të kërkueses.

Zbatueshmëria e nenit 6 të Konventës: në lidhje me pretendimet e kërkueses se ajo nuk ishte informuar në detaje për akuzën ndaj saj, dhe se ajo nuk kishte kohë të mjaftueshme dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes së saj, Gjykata vërejti se çështja kishte të bënte me procedurat disiplinore të zbatueshme për gjyqtarët, të zhvilluara nga një organ drejtues dhe disiplinor – CSM – që i nënshtrohet mbikëqyrjes së Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë. Pra, as organet e ndjekjes, as gjykatat penale nuk ishin përfshirë në përcaktimin e rasteve dhe veprimet për të cilat kërkuesja ishte akuzuar nuk ishin të natyrës penale. Në rastin konkret, veprat (shkeljet) dhe sanksionet që mund të vendoseshin, kishin qenë thjesht disiplinore. Kështu, procedura disiplinore kundër kërkueses nuk kishte të bënte me përcaktimin e një akuze penale në kuptimin e nenit 6.3 të Konventës, i cili mbron vetëm personat “e akuzuar për një vepër penale”. Për rrjedhojë, Gjykata hodhi poshtë ankesën e kërkueses se ajo nuk ishte informuar në detaje për akuzën kundër saj dhe për këtë arsye nuk kishte pasur kohën dhe lehtësitë e duhura për të përgatitjen e mbrojtjes së saj, duke konstatuar se ankesa ishte e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës.

Pavarësia dhe paanshmëria e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë në lidhje me rolin e dyfishtë të Kryetarit të Gjykatës Supreme - Gjykata

vërejtje se ankesa e kërkueses kishte të bënte me gjykatën më të lartë në Portugali, e cila përbëhej ekskluzivisht nga gjyqtarë profesionistë të cilët ishin të pavarur, kishin mandat të garantuar dhe u nënshtroheshin rregullave të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se përbërja e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë është përcaktuar me statusin e gjyqtarëve, që të veprojnë në bazë të kriterëve objektive si vjetërsia e gjyqtarëve dhe anëtarësimi i tyre gjatë vendosjes për caktimin e tyre në çështje. Për më tepër, kryetari i Gjykatës Supreme nuk ka qenë i angazhuar në atë divizion *ad hoc* dhe anëtarët e divizionit u emëruan zyrtarisht nga Zëvendëskryetari më i vjetër i Gjykatës së Lartë. Përveç kësaj, kërkuesja nuk pretendoi se gjyqtarët e Divizionit Gjyqësor kishin vepruar nën udhëzimet e Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose se Kryetari kishte demonstruar njëanshmëri, as nuk pretendoi se Kryetari i Gjykatës së Lartë mund të kishte ndikuar te gjyqtarët e Gjykatës së Lartë - Divizioni Gjyqësor në ndonjë mënyrë apo mjet tjetër. Në veçanti, nuk u vërtetua se ata gjyqtarë kishin qenë emëruar posaçërisht për të gjykuar çështjen e saj. Kështu, nuk ekzistonte asnjë provë e tillë për të ngjallur frikë objektivist të justifikuar te kërkuesja. Prandaj, Gjykata e Lartë konstatoi se roli i dyfishtë i Kryetarit nuk ishte i tillë që të hidhte dyshime mbi pavarësinë dhe paanshmërinë objektive të asaj gjykate në nxjerrjen e vendimit lidhur me ankesat e kërkueses kundër vendimeve të CSM-së.

Sa i përket rolit të CSM-së në lidhje me karrierën e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe procedurat disiplinore kundër tyre, Gjykata iu referua vendimit të saj në rastin *Oleksandr Volkov(2)*, në lidhje me çështje të ngjashme. Gjykata vuri në dukje se, në rastin konkret, nuk ishte identifikuar asnjë çështje serioze në lidhje me mangësitë strukturore ose shfaqjen e njëanshmërisë brenda CSM-së portugeze. Gjykata theksoi, ndër të tjera, rëndësinë e parimit të pavarësisë së gjyqësorit në Portugali, e cila mbrohej si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga dispozita të tjera të ligjit të brendshëm. Ajo më tej vuri në dukje se gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët shpesh ishin në fazat përfundimtare të karrierës së tyre, nuk u nënshtroheshin më vlerësimeve të performancës dhe as nuk ishin në kërkim të promovimit, dhe se autoriteti disiplinor i CSM-së mbi ta ishte në realitet mjaft teorik. Gjykata vërejtje se nuk kishte ndonjë dëshmi specifike për për mungesën e paanësisë, siç është ekzistenca e

pezullimit të procedurës disiplinore ndaj njërit prej anëtarëve që kishin shqyrtuar ankesat e kërkuases. Në terma më të përgjithshëm, Gjykata e konsideroi normale që gjyqtarët, në kryerjen e detyrave të tyre gjyqësore dhe në kontekste të ndryshme duhet të shqyrtojnë një shumëllojshmëri të rasteve duke ditur se ata vetë, në një moment në karrierën e tyre, mund të jenë në një pozicion të ngjashëm me njërin nga palët, përfshirë të pandehurin. Megjithatë, një rrezik thjesht abstrakt i këtij lloji nuk mund të konsiderohej si i përshtatshëm për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e një gjyqtari në mungesë të rrethanave specifike që kanë të bëjnë me situatën e tij/saj individuale. Rrjedhimisht, Gjykata nuk pa prova të mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë nga ana e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme, dhe konstatoi se nuk kishte pasur shkelje.

Shqyrtimi i mbajtur nga Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë dhe mungesa e dëgjimit publik (seancës): Gjykata vendosi të shqyrtojë bashkërisht ankesat në lidhje me pamjaftueshmërinë e pretenduar të shqyrtimit të mbajtur nga Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë dhe ankesës së saj lidhur me mungesën e një seance dëgjimore, pasi të dy pretendimet ishin të lidhura ngushtë. Gjykata saktësoi se, për të përcaktuar nëse Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme kishte gëzuar juridiksion të plotë sipas kuptimit të praktikës gjyqësore të institucioneve të Konventës, do të marrë parasysh kompetencat e atij organi dhe praktikën gjyqësore të tij. Në lidhje me këtë, Gjykata kishte vendosur më parë se ajo duhet të kishte parasysh kompetencat e gjyqësorit në fjalë dhe faktorë të tillë si: (a) objekti i vendimit të ankimit dhe në veçanti, nëse ankesa kishte të bënte apo jo me një çështje të specializuar që kërkon njohuri profesionale ose përvojë dhe nëse ajo përfshinte ushtrimin e lirisë administrative dhe, nëse po, në çfarë mase; (b) mënyrën në të cilën është arritur ai vendim dhe, në veçanti, garancitë procedurale të disponueshme në procedurat para organit administrativ; dhe (c) përmbajtjen e mosmarrëveshjes, duke përfshirë arsyet e dëshiruara dhe të vërteta të apelit (Gjykata citoi, ndër të tjera autoritetet, *Bryan kundër Mbretërisë së Bashkuar* (3).

Objekti i vendimeve të kundërshtuara të CSM-së, konkretisht mjetet e veprimeve të veçanta administrative, të cilat kërkuessa i kundërshtoi, siç ekzistonin bazuar në ligjin portugez në kohën përkatëse, ishte

çështja nëse parashtruesja kishte shkëlur detyrimet e saj profesionale. Gjykata konsideroi, së pari, se rishikimi i një vendimi për vendosjen e një dënimi disiplinor ndryshonte nga rishikimi i një vendimi administrativ që nuk përmbante një element të tillë ndëshkues. Së dyti, vuri në dukje se procedura disiplinore në rastin konkret kishte të bënte me një gjyqtar. Në lidhje me këtë, Gjykata theksoi se, edhe nëse ato nuk hyjnë në fushëveprimin e nenit 6 të Konventës, sipas aspektit të tij penal, dënimet disiplinore megjithatë mund të sjellin pasoja të rënda për jetën dhe karrierën e gjyqtarëve. Prandaj, shqyrtimi gjyqësor i zhvilluar duhet të ishte i përshtatshëm bazuar në objektin e kontestit, që do të thotë, në rastin konkret, në natyrën disiplinore të vendimeve administrative në fjalë. Kjo konsideratë zbatohet me forcë edhe më të madhe në procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve, të cilët duhet të gëzonin respektin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre. Kur një shtet anëtar inicion procedura të tilla disiplinore, besimi i publikut në funksionimin dhe pavarësinë e gjyqësorit është në rrezik; në një shtet demokratik, ky besim garanton vetë ekzistencën e shtetit të së drejtës.

Në lidhje me procedurat para CSM, Gjykata mori parasysh se një autoritet disiplinor dhe një organ jogjyqësor i kishte lejuar kërkueses mundësinë për të ngritur një mbrojtje. Megjithatë, në rastin e kërkueses procedurat përpara seancës plenare të CSM-së kishin qenë me shkrim dhe kërkuesja nuk kishte mundur të merrte pjesë në seancat e saj në asnjë nga tri grupet e procedurave në lidhje me të. Sipas legjislacionit kombëtar, ato seanca nuk ishin të hapura as për personin në fjalë e as për anëtarët e publikut dhe CSM nuk ishte e autorizuar me ligj për të mbajtur seanca dëgjimore publike. Kështu, kërkuesja nuk kishte pasur mundësi për të bërë parashtrime verbale, as mbi çështjet faktike dhe dënimet ose për çështje të ndryshme juridike. Për më tepër, seanca plenare e CSM-së nuk kishte dëgjuar asnjë provë nga dëshmitarët, megjithëse nuk ishte vetëm besueshmëria e kërkueses që kishte qenë në rrezik, por edhe ajo e dëshmitarëve të rëndësishëm. Prandaj Gjykata mori parasysh se CSM nuk kishte ushtruar kompetencat e saj diskrecionale mbi një bazë faktike adekuate. Në procedurën para Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë – organ gjyqësor – kërkuesja kishte mohuar se e kishte quajtur inspektorin gjyqësor “gënjeshtar” dhe të kishte kërkuar që të mos ngrihej procedurë kundër dëshmitarit, të cilin ajo kishte dashur ta thërriste. Këto fakte ishin “vendimtare” dhe kërkuesja ishte

përballur me mundësinë e dënimeve shumë të rënda (largim nga detyra ose pezullim), të cilat mbanin një shkallë të konsiderueshme stigme dhe ishin të prira të kishin pasoja të pakthyeshme mbi të jetën dhe karrierën.

Për sa i përket masës së shqyrtimit të mbajtur nga Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë në lidhje me vërtetimin e fakteve, ai divizion kishte deklaruar shprehimisht se nuk kishte juridiksion të plotë në çështjet disiplinore, por kishte detyrën vetëm për të rishikuar ligjshmërinë e vendimeve kontestuese. Në veçanti, Divizioni kishte theksuar se nuk kishte juridiksion kur bëhej fjalë për “mbledhjen e provave ose vërtetimin e fakteve kyçe”. Prandaj, dukej se, në funksion të kufijve të vendosur sa i përket juridiksionit, nga legjislacioni dhe nga praktika e tij gjyqësore, Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë ishte i autorizuar të shqyrtojë vetëm pikat vendimtare në procedurë, përkatësisht përmbajtjen e bisedave të parashtrueses me inspektorin gjyqësor dhe hetuesin gjyqësor. Gjykata vuri në dukje se vlerësimi i fakteve përfshinte shqyrtimin e çështjeve në lidhje me besueshmërinë dhe kredibilitetin e kërkueses dhe dëshmitarëve. Pasi konstatoi se nuk kishte juridiksion për rishqyrtuar faktet dhe provat, madje as edhe në bazë të materialit të dosjes në dispozicion, rrjedhimisht, Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë kishte refuzuar kërkesën e kërkueses për një dëgjim publik. Sipas mendimit të Gjykatës, mosmarrëveshja për sa i përket fakteve dhe pasojave të dënimeve disiplinore për reputacionin e kërkueses, e kishin bërë të nevojshme për Divizionin Gjyqësor të Gjykatës së Lartë që të kryente një rishikim që ishte mjaftueshëm i plotë për t'i mundësuar asaj fillimisht të përcaktojë, për shembull, nëse kërkuësja kishte bërë disa vërejtje gjatë bisedës së saj telefonike me inspektorin gjyqësor ose në takimin e saj privat me hetuesin gjyqësor dhe së dyti për të formuar përshtypjen e saj për kërkuesen, duke i dhënë asaj një mundësi për të shpjeguar gojarisht versionin e saj për këtë situatë. Gjykata përsëriti në lidhje me këtë se nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore para CSM-së dhe se Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme ka qenë organi i parë dhe i vetëm gjyqësor që i shqyrtoi ankesat e kërkueses kundër vendimeve të CSM-së. Në rastin konkret kërkuësja kërkoi një dëgjim publik. Prandaj, ajo duhet të kishte pasur mundësinë për një seancë dëgjimore; kjo do të kishte lejuar një përballje verbale ndërmjet palëve dhe një shqyrtim më të plotë të faktet, të cilat u kontestuan. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se – duke marrë parasysh, në veçanti, kontekstin specifik

të procedurës disiplinore të zhvilluar ndaj një gjyqtari, ashpërsinë e dënimeve, faktin që garancitë procedurale përpara CSM-së ishin të kufizuara dhe nevojën për të vlerësuar, provat faktike që shkojnë në favor të besueshmërisë së kërkueses dhe të dëshmitarëve dhe që përbëjnë një aspekt vendimtar të çështjes – efekti i kombinuar i dy faktorëve, përkatësisht pamjaftueshmëria e shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar nga Divizioni Gjyqësor i Gjykatës së Lartë dhe mungesa e seancës, qoftë në fazën e procedurës disiplinore, qoftë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, nënkuptonte se çështja e kërkueses nuk ishte dëgjuar në përputhje me kërkesat e nenit 6.1 të Konventës. Në ato rrethana Gjykata vendosi të kufizohet në shqyrtimin e çështjes nëse Gjykata Supreme kishte bërë një shqyrtim të mjaftueshëm të vërtetimit të fakteve; kështu vendosi të mos shqyrtojë dy aspektet e mbetura të shqyrtimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë, përkatësisht shqyrtimin e shkeljes së detyrimeve profesionale dhe shqyrtimin e sanksioneve disiplinore të shqiptuara.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata, njëzëri, deklaroi se, meqenëse kërkuësja nuk respektoi afatin gjashtëmujor, nuk është në gjendje të shqyrtojë në themel ankesën për mungesë të pavarësisë dhe paanshmërisë nga ana e CSM-së; hodhi poshtë, kundërshtimin paraprak të Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme në lidhje me ankesat për mungesën e pretenduar të pavarësisë dhe paanshmërisë së Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë dhe shtrirjen e shqyrtimit të tij; shpalli të papranueshme ankesën në të cilën pretendohet shkelje e nenit 6.3 (a) dhe (b) për shkak se kërkuësja nuk ishte informuar në detaje për akuzën kundër saj dhe për rrjedhjet nuk kishte kohën dhe lehtësitë e duhura për përgatitjen e mbrojtjes së saj; konstatoi, se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës në lidhje me ankesën për mungesë pavarësie dhe paanshmërie nga ana e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë; konstatoi, se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës për shkak të mungesës së seancës dëgjimore, dhe, hodhi poshtë pretendimet për shpërblim të drejtë.

2.4. RUIZ TORIJA kundër SPANJËS

[18390/91]

GJEDNJ [Dhoma]

9 dhjetor 1994

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: shkëputje kontrate për qiramarrje; dështimi i plotë nga Audiencia Provincial në Madrid për të adresuar në gjykimin e saj parashtrësën që pretendonte se veprimi ishte parashkruar; shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë.

Faktet kryesore

Rasti iu referua Gjykatës nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut («Komisioni»), më 9 shtator 1993, bazuar në kërkesën e ngritur kundër Mbretërisë së Spanjës nga Eusebio Ruiz Torija (kërkuesi), një shtetas spanjoll, të paraqitur më 15 mars 1991. Kërkuesi kishte qenë qiramarrës i një lokali në Madrid që nga viti 1960, kur në vitin 1988 qiradhënësi filloi procedurat në Gjykatën e Shkallës së Parë Madrid nr. 15 për shkëputjen kontratës së qirasë dhe dëbimin e tij. Sipas qiradhënësit, instalimi i makinave të lojërave në ambientet që i përkasin një pale të tretë, pa pëlqimin e qiradhënësit, përbënte një nga bazat ligjore për përfundimin e një qiraje. Në deklaratën e tij të mbrojtjes, pretendimet kryesore të kërkuesit ishin se instalimi i makinave kishte qenë i ligjshëm dhe se paditësi kishte vepruar me keqbesim. Në fund të argumenteve të tij ligjore, ai shtoi:

“Së fundi, [unë thirrem] në periudhën pesëmbëdhjetë vjeçare të parashkrimit për veprimet in personam e cila parashikohet në nenin 1964 të Kodit Civil [shih paragrafin 15 më poshtë]. Sipas nenit 1969, koha fillon të rrjedhë për këtë qëllim në ditën, në të cilën mund të ishte ngritur padia. Në periudhën mbi njëzet e tetë vjet që nga nënshkrimi i qirasë, [unë] kam qenë në gjendje, në çdo kohë dhe deri më tani pa ndonjë kundërshtim nga ana e qiradhënësit, të siguroj këtë lloj shërbimi, i zakonshëm në këtë lloj ndërmarrjeje, në formën e makinave zbavitëse të të gjitha llojeve që u shfaqën radhazi në treg, të tilla si juke-box, bar-football, bilardo, lojëra për fëmijë, etj. “

Më 13 shkurt 1989, Gjykata e Shkallës së Parë Madrid nr. 15 hodhi poshtë veprimin e qiradhënësit me arsyetimin se instalimi i makinave të lojërave nuk mund të konsiderohej si një transferim ose një nënqira dhe nuk ishte shkelje e detyrimeve të tij kontraktuale nga Ruiz Torija. Gjykata nuk e shqyrtoi kundërshtimin se veprimi ishte i parashkruar.

Me apelimin e qiradhënësit, kundërshtuar nga kërkuesi si i paditur, Audiencia Provincial e Madridit⁷⁷ nxori aktgjykim më 30 janar 1990 duke anuluar vendimin e kundërshtuar dhe duke lejuar veprimin për dëbimin e kërkuesit, pa vendosur mbi çështjen nëse veprimi ishte i parashkruar. Ndërkohë, ishte zbuluar se pronari i makinave ishte një palë e tretë, e cila ishte përgjegjëse për mirëmbajtjen e makinave dhe që i kaloi gjysmën e fitimeve të kërkuesit. Kjo ishte një situatë që binte në përkufizimin ligjor të një transferimi ose nënqiraje të paautorizuar dhe përbënte shkelje të kontratës të mbështetur nga qiradhënësi.

Meqenëse nuk ishte e mundur për të që në këtë rast të apelonte për çështje ligjore në Gjykatën Supreme, kërkuesi paraqiti një apel Amparo⁷⁸ në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 24 paragrafi 1 të Kushtetutës. Me një vendim të 29 tetorit 1990, Gjykata Kushtetuese e shpalli apelimin të papranueshëm. Ajo konstatoi se në mënyrë të arsyeshme mund të nxirret përfundimi nga aktgjykimi i apeluar se shqyrtimi i bazueshmërisë së padisë për ndërprerjen e qirasë ka sjellë rrëzimin e nënkuptuar të parashtresës se veprimi ishte i parashkruar.

Përmbledhja e pretendimeve

Fillimisht, Qeveria pretendoi se kërkesa ishte e papranueshme për shkak të dështimit të shterimit të mjeteve juridike të brendshme. Kërkuesi, sipas Qeverisë, duhet të kishte paraqitur një kërkesë për t'u

77 Audiencia Nacional de España ("Gjykata Kombëtare e Spanjës"), është një gjykatë e lartë në Spanjë.

Ajo ka selinë e saj në Madrid, me juridiksion mbi të gjithë Spanjën, ndryshe nga shumica e gjykatave që kanë një shtrirje territoriale.

78 Amparo është një nga autoritetet kryesore që Kushtetuta i jep Gjykatës Kushtetuese. Objekti i këtij procesi është mbrojtja nga cenimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në nenet 14 deri në 29 dhe 30.2 të Kushtetutës, që burojnë nga dispozita, akte ligjore, mosveprime ose veprime të thjeshta të qeverisë së shtetit, të Rajoneve Autonome, organet e natyrës territoriale, korporative ose institucionale, si dhe stafit të tyre. I vetmi pretendim që mund të zbatohet nëpërmjet amparos është rivendosja ose ruajtja e të drejtave ose lirive për të cilat bëhet ankimi.

“bashkuar” me apelin në mënyrë që t’i mundësojë Audiencia Provincial të Madridit të shqyrtojë çështjen e parashkrimit; ai nuk duhej që vetëm të kundërshtonte apelin e qiradhënësit si i paditur. Sipas kërkuesit, dështimi total i Audiencia Provincial për të adresuar në aktgjykimin e tij parashtresën që pretendonte se veprimi ishte i parashkruar shkelte nenin 6 paragrafi 1.

Sipas Qeverisë, pretendimi se veprimi ishte i parashkruar ishte krejtësisht i pabazuar dhe nuk kishte lidhje me objektin e procedurës. Instalimi i makinave të lojërave me funksione dhe karakteristika krejtësisht të ndryshme ishte i parëndësishëm në llogaritjen e periudhës kohore për të cilën makinat e lojërave kishin qenë në shërbim. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë duke pasur parasysh faktin se makinat e lojërave nuk ishin autorizuar në Spanjë deri në vitin 1977. Meqenëse sipas nenit 359 të Kodit të Procedurës Civile, gjyqtarëve u kërkohet të vendosnin vetëm për çështjet që kishin qenë “objekt argumentimi”, Audiencia Provincial nuk ishte e detyruar t’i përgjigjej parashtresës.

Përveç kësaj, edhe duke supozuar se gjykata e apelit ishte e detyruar t’i përgjigjej kësaj parashtrese, dështimi i saj për ta bërë këtë mund të konsiderohet si një refuzim i nënkuptuar. Në të vërtetë kjo ishte pikëpamja e marrë nga Gjykata Kushtetuese. Meqenëse parashkrimi ishte një çështje paraprake, fakti që Audiencia Provincial përcaktoi meritat nënkuptonte refuzimin e kundërshtimit.

Kërkuesi kundërshtoi këto argumente. Megjithëse makinat e lojërave nuk ishin autorizuar në Spanjë deri në vitin 1977, ato ishin toleruar shumë para asaj date. Për më tepër, meqenëse qiradhënësi i ishte referuar instalimit të paautorizuar të makinave që i përkisnin një pale të tretë si arsye për përfundimin, ishte e natyrshme të tërhiqte vëmendjen e gjykatës në faktin se më parë kishte pasur makina të tjera, pa dyshim me funksione të ndryshme, por të cilat gjithashtu u përkisnin palëve të treta. Së fundi, asnjë rregull nuk i detyroi gjykatat ta konsiderojnë çështjen e parashkrimit si një çështje paraprake.

Gjithashtu kërkuesi u shpreh, ndër të tjera, se padia e ngritur nga qiradhënësi për dëbimin e tij ishte e parashkruar. Ky parashtrim është bërë me shkrim para gjykatës së shkallës së parë dhe është formuluar

në mënyrë mjaft të qartë dhe të saktë. Për më tepër, u paraqitën prova për ta mbështetur atë. Audiencia Provincial, e cila prishi vendimin e shkallës së parë dhe nxori një vendim të ri për meritat, ishte e detyruar, sipas ligjit procedural në fuqi, të rishikonte të gjitha parashtrimet e bëra në shkallë të parë, pasi ato kishin qenë “objekt argumentimi” dhe pavarësisht nëse ishin përsëritur shprehimisht në apel.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata përsëriti se neni 6 paragrafi 1 i Konventës detyron gjykatat të japin arsyetime për aktgjykimet e tyre, por nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të hollësishme për çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet ky detyrim, për të dhënë arsye, mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Për më tepër, është e nevojshme të merret parasysh, ndër të tjera, larmia e parashtrësive që një palë ndërgjyqëse mund të sjellë para gjykatave dhe dallimet ekzistuese në shtetet kontraktuese në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, opinionin juridik dhe prezantimin dhe hartimin e aktgjykimeve. Kjo është arsyeja pse pyetja nëse një gjykatë ka dështuar të përmbushë detyrimin për të deklaruar arsyet, që rrjedhin nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të çështjes.

Gjykata vuri në dukje se nuk është detyrë e saj të shqyrtojë nëse deklarimi lidhur me parashkrimin ishte i bazuar; u takon gjykatave kombëtare të përcaktojnë çështje të asaj natyre. Megjithatë, Gjykata u shpreh se nuk ishte bindur nga argumenti i Qeverisë se parashtrimi i bazuar në parashkrim ishte aq i pabazuar, saqë ishte e panevojshme që gjykata e apelit t’i referohej atij. Fakti që gjykata e shkallës së parë lejoi të paraqiten prova në mbështetje të këtij pretendimi sugjeron të kundërtën. Prandaj, meqenëse çështja e parashkrimit do të kishte qenë vendimtare në këtë rast, Audiencia Provincial duhej të kishte adresuar parashtrësën në aktgjykimin e saj.

Prandaj, sipas Gjykatës, ishte e nevojshme të përcaktohej nëse në rastin konkret heshtja e gjykatës së apelit mund të interpretohej në mënyrë të arsyeshme si një refuzim i nënkuptuar. Gjykata nuk ishte e detyruar të shqyrtonte çështjen e parashkrimit para se të merrte parasysh argumentet në themel. Për më tepër, pyetja nëse veprimi

ishte i parashkruar binte në një kategori ligjore krejtësisht tjetër nga ajo e arsyeve për përfundimin e qirasë; prandaj kërkonte një përgjigje specifike dhe të shprehur. Në mungesë të një përgjigjeje të tillë, ishte e pamundur të konstatohet nëse Audiencia Provincial thjesht neglizhoi të merrej me pretendimin se veprimi ishte i parashkruar, ose nëse kishte ndërmend ta refuzonte atë dhe, nëse ky do të ishte qëllimi i tij, cilat ishin arsyet e saj për të vendosur kështu. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafit 1; se aktgjykimi aktual përbën në vetvete shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me dëmin jomaterial të pretenduar; vendosi se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit brenda tre muajve, 1.000.000 (një milion) peseta për shpenzimet.

2.5. REGNER kundër REPUBLIKËS ÇEKE

[35289/11]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

19 shtator 2017

Çështja kyçele drejta e pretenduar: procedura administrative e padrejtë për shkak të pamundësisë së qasjes në një provë vendimtare të klasifikuar si konfidenciale që ishte vënë në dispozicion të gjykatave nga i pandehuri; drejtësia e shqyrtimit gjyqësor të një vendimi administrativ për revokimin e lejes së sigurisë (security clearance), e cila kishte qenë thelbësore për ushtrimin e një funksioni publik.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Václav Regner, një shtetas çek (kërkuesi), kundër Republikës Çeke, më 25 maj 2011. Në bazë të një kontrate të nënshkruar më 2 nëntor 2004 dhe që rregullohej nga dispozitat e Kodit të Punës, kërkuesi u bë punonjës i Ministrisë së Mbrojtjes. Më 27 dhjetor 2004,

përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë i kërkoi Autoritetit të Sigurisë Kombëtare (Národní bezpečnostní úřad – “Autoriteti”) t’i jepte kërkuesit certifikatën e sigurisë duke i dhënë atij qasje në informacionin e klasifikuar shtetëror në kategorinë “sekret”, në përputhje me detyrat që do të kryente ai. Më 1 janar 2005, kërkuesi filloi detyrat e tij si drejtor i Departamentit të administrimit të pasurisë së Ministrisë. Më 19 korrik 2005, Autoriteti i dha kërkuesit leje sigurie, e vlefshme deri më 18 korrik 2010, duke konfirmuar se ai kishte qasje në informacionin e klasifikuar shtetëror në kategorinë “sekret”. Gjatë vitit 2006, kërkuesi u emërua zëvendës i Zëvendësministrit të Parë të Mbrojtjes, ndërkohë që vazhdoi të kryente detyrat e tij si drejtor i Departamentit të administrimit të pasurisë së Ministrisë. Më 7 tetor 2005, Autoriteti mori informacion konfidencial nga shërbimi inteligjent, i klasifikuar (“i kufizuar”). Më pas filloi një hetim për të verifikuar informacionin e marrë. Gjatë këtij hetimi, shërbimi i inteligjencës i dha Autoritetit informacione të tjera të klasifikuara dhe të bashkangjitura në dosjen e sigurisë me numrin 77. Në bazë të këtij informacioni, Autoriteti i revokoi kërkuesit certifikatën e sigurisë, më 5 shtator 2006. Kishte dy arsye për atë vendim: së pari, kërkuesi nuk kishte treguar, siç duhej të bënte kur aplikonte për certifikatë sigurie, se mbante poste drejtorësh në një sërë kompanish dhe llogari në banka të huaja; dhe së dyti, kërkuesi konsiderohej se përbënte rrezik për sigurinë kombëtare, sipas kuptimit të nenit 14(3) (d) të Ligjit nr. 412/2005. Në lidhje me këtë rrezik, vendimi nuk tregoi megjithatë se në cilin informacion konfidencial bazohej, pasi ky ishte klasifikuar “i kufizuar” dhe për rrjedhojë nuk mund t’i zbulohej ligjërisht kërkuesit. Vendimi tregonte se faktet e vërtetuara në lidhje me sjelljen e tij, siç dokumentohen në informacionin e marrë nga Autoriteti më 7 tetor 2005, vinin dyshime mbi përshtatshmërinë e tij për verifikim sigurie dhe aftësinë e tij për të mos u ndikuar dhe për të mbajtur sekret informacione të ndjeshme, dhe kështu tregoi se ai nuk ishte më i besueshëm.

Pas një ankimimi administrativ nga kërkuesi, drejtori i Autoritetit, pasi mori një mendim nga bordi i ankesave, konfirmoi më 18 dhjetor 2006 vendimin e Autoritetit të datës 5 shtator 2006, por për arsye pjesërisht të ndryshme. Ai e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën se kërkuesi kishte dështuar të zbulonte informacione të caktuara përpara se t’i jepej leja e sigurisë. Megjithatë, ai ishte dakord me konkluzionet e Autoritetit në

lidhje me ekzistencën e një rreziku sigurie, i cili kishte dalë nga hetimi i kryer nga Autoriteti dhe nga dokumentet e klasifikuara.

Ndërkohë, më 4 tetor 2006, kërkuesi kishte kërkuar që të shkarkohej, për arsye shëndetësore, nga detyrat e tij si zëvendës i Zëvendësministrit të Parë të Mbrojtjes dhe nga detyrat e drejtorit të Departamentit të Administrimit të Pasurive të Ministrisë. Ai u hoq nga detyra në të njëjtën ditë sipas nenit 65.2 të Kodit të Punës. Më 20 tetor 2006 ai nënshkroi një marrëveshje, në bazë të nenit 43 të Kodit të Punës, duke përfunduar kontratën me pëlqim reciprok, me efekt nga 31 janari 2007.

Më 19 janar 2007, kërkuesi depozitoi një kërkesë në Gjykatën Komunale të Pragës për shqyrtim gjyqësor të vendimit që revokonte lejen e tij të sigurisë. Ai dhe avokati i tij u lejuan të konsultonin dosjen, por pjesët e klasifikuara si konfidenciale u përjashtuan. Megjithatë, dokumentet që përmbajnë informacion për ekzistencën e një rreziku, përfshirë dokumentet konfidenciale, i ishin dërguar nga Autoriteti gjykatës, e cila kishte qasje në to. Në seancën dëgjimore, kërkuesit iu dha mundësia të bënte parashtratat e tij dhe të deklaronte se cilat mendonte se ishin arsyet për revokimin e lejes së tij të sigurisë. Ai deklaroi se besonte se informacioni në fjalë ishte dhënë nga një shërbim i inteligjencës ushtarake, i cili kishte kërkuar të hakmerrej ndaj tij për refuzimin e tij për të pranuar një propozim për të bashkëpunuar në një mënyrë që tejkaloonte detyrimet e tij ligjore.

Në një vendim të datës 1 shtator 2009, gjykata hodhi poshtë kërkesën për shqyrtim gjyqësor. Gjykata arsyetoi se në një procedurë për revokimin e certifikatës së sigurisë, autoriteti përkatës mund të zbulonte vetëm arsyet për revokimin e lejes që bazoheshin në dokumente jo të klasifikuara dhe në nivelin e tyre të konfidencialitetit.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 6.1 të Konventës, kërkuesi u ankua se procedimi administrativ kishte qenë i padrejtë sepse ai nuk kishte mundur t'i shihte provat vendimtare, të klasifikuara si informacione konfidenciale, të cilat ishin vënë në dispozicion në gjykata nga i pandehuri.

Në një vendim të datës 26 nëntor 2015, Dhoma e Gjykatës u shpreh njëzëri se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës. Dhoma konstatoi se procedura e vendimmarrjes gjyqësore kishte përmbushur parimin e kontradiktoritetit procedural, barazinë e armëve dhe garancionet procedurale (të nenit 6), që garantojnë mbrojtje të pozitës (interesave) të kërkuesit.

Më 2 maj 2016, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit për shkeljen e nenit 6, Gjykata vlerësoi si në vijim:

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 6.1: Gjykata arsyetoi se aftësia e kërkuesit për të kryer detyrat e tij ka qenë e kushtëzuar me autorizimin për qasje në informacionin e klasifikuar. Revokimi i certifikatës së tij të sigurisë e kishte bërë të pamundur për kërkuesin që të kryente plotësisht detyrat e tij dhe kishte ndikuar negativisht në aftësinë e tij për të marrë një post të ri në shërbimin civil. Në ato rrethana, sipas Gjykatës, lidhja midis vendimit për revokimin e certifikatës së sigurisë së kërkuesit dhe humbjes së detyrave dhe punësimit të tij, kishte qenë më shumë se e dobët ose e largët. Prandaj, ai kishte qenë në gjendje të mbështetej në të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e atij revokimi para gjykatave.

Më tutje, Gjykata vuri në spikamë se marrëdhënia e punës ndërmjet kërkuesit dhe Ministrisë së Mbrojtjes bazohej në dispozitat e Kodit të Punës, i cili nuk përmbante ndonjë dispozitë specifike të zbatueshme për funksionet e kryera brenda administratës shtetërore, në mënyrë që në kohën konkrete të mos kishte shërbim civil, në kuptimin tradicional të termit, duke u dhënë nëpunësve publikë detyrime dhe privilegje jashtë fushëveprimit të ligjit të zakonshëm. Meqenëse mosmarrëveshjet e punës kishin të bënin me të drejtat civile sipas kuptimit të nenit 6.1 të Konventës, vendimi për tërheqjen e certifikatës së sigurisë së kërkuesit dhe procedurat pasuese kishin prekur të drejtat e tij civile.

Duke qenë kështu, edhe duke supozuar se kërkuesi duhej të konsiderohej si nëpunës civil, ai kishte mundur të aplikonte në gjykatat administrative për shqyrtim gjyqësor të vendimit të Autoritetit. Rrjedhimisht, neni 6 ishte i zbatueshëm në çështjen në fjalë në bazë të detyrimit të tij civil. Prandaj, Gjykata arriti në përfundim se kërkuesi mund të pretendonte se kishte statusin e viktimës për qëllimet e nenit 34 të Konventës.

Në vlerësim të meritave, Gjykata theksoi se në përputhje me kërkesat e ligjit çek, në rast të procedurave ligjore që kundërshtojnë një vendim që refuzon lëshimin ose revokimin e certifikatës së sigurisë, procedurat e ngritura nga kërkuesi ishin kufizuar në dy mënyra në lidhje me rregullat e ligjit të zakonshëm që garanton një gjykim të drejtë: së pari, dokumentet dhe informacionet e klasifikuara nuk ishin në dispozicion as të atij dhe as të avokatit të tij, dhe së dyti, përderisa vendimi për revokimin e certifikatës së sigurisë ishte bazuar në ato dokumente, arsyet e vendimit nuk i ishin zbuluar atij.

Gjykata vuri në dukje se bazuar në kompetencat e gjykatave vendore, atyre u lejohej qasja e pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara mbi të cilat ishte bazuar Autoriteti për të justifikuar vendimin e tij; ato kishin fuqinë për të kryer një ekzaminim të detajuar të arsyeve në të cilat ishte mbështetur Autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara; dhe gjykatat vendore mund të urdhëronin zbulimin e dokumenteve për të cilat ato konsideruan se nuk e arsyetonin atë klasifikim. Ato gjithashtu mund të vlerësonin meritat e vendimit të Autoritetit për revokimin e certifikatës së sigurisë dhe të anulonin, aty ku ishte e zbatueshme, një vendim arbitrar. Juridiksioni i tyre përfshinte të gjitha faktet e çështjes dhe nuk kufizohej në shqyrtimin e bazave të mbështetura nga kërkuesi, i cili ishte dëgjuar nga gjyqtarët dhe gjithashtu kishte mundur t'i bënte parashtrimet e tij me shkrim.

Gjykatat vendore kishin ushtruar siç duhet kompetencat e kontrollit në dispozicion të tyre në këtë lloj procedure, si në lidhje me nevojën e ruajtjes së konfidencialitetit të dokumenteve të klasifikuara, ashtu edhe në lidhje me arsyetimin e vendimit për revokimin e certifikatës së sigurisë së kërkuesit, duke dhënë arsyet për vendimet e tyre në lidhje me rrethanat specifike të çështjes në fjalë.

Prandaj, Gjykata e Lartë Administrative kishte konsideruar se zbulimi i dokumenteve të klasifikuara mund të kishte si pasojë zbulimin e metodave të punës së shërbimit të inteligjencës, zbulimin e burimeve të tij të informacionit ose do të kishte çuar në përpjekje për të ndikuar mbi dëshmitarët e mundshëm. Ai kishte shpjeguar se nuk ishte ligjërisht e mundur të tregojë se ku qëndronte saktësisht rreziku i sigurisë ose të tregojë saktësisht se cilat konsiderata mbështesnin përfundimin se ekzistonte një rrezik sigurie, arsyet dhe konsideratat në bazë të vendimit të Autoritetit që buronin ekskluzivisht nga informacioni i klasifikuar. Rrjedhimisht, nuk kishte asgjë që të sugjeronte se klasifikimi i dokumenteve në fjalë ishte vendosur në mënyrë arbitrare ose për një qëllim të ndryshëm nga interesi legjitim i treguar se po ndiqej. Sipas Gjykatës së Lartë Administrative, ishte pa mëdyshje e qartë nga dokumentet e klasifikuara se kërkuesi nuk i plotësonte më kushtet ligjore për t'ia besuar sekretet. Sjellja e tij kishte paraqitur një rrezik për sigurinë kombëtare. Në lidhje me këtë, në mars 2011 kërkuesi ishte ndjekur penalisht për pjesëmarrje në krimin e organizuar; ndihmë dhe nxitja e keqpërdorimit të pushtetit publik; bashkëpunim në ndikimin e paligjshëm në tenderimin publik dhe procedurat e prokurimit publik; dhe ndihmën dhe nxitjen e shkeljeve të rregullave detyruese që rregullojnë marrëdhëniet ekonomike. Ishte e kuptueshme që aty ku ekzistonin dyshime të tilla autoritetet e konsideronin të nevojshme për të ndërmarrë veprime të shpejta pa pritur rezultatin e hetimit penal, duke parandaluar zbulimin, në një fazë të hershme, të dyshimeve që prekin personat në fjalë, të cilat do të rrezikonin të pengonin hetimin penal. Megjithatë, do të kishte qenë e dëshirueshme – për aq sa është në përputhje me ruajtjen e konfidencialitetit dhe efektivitetit të hetimeve në lidhje me kërkuesin – që autoritetet kombëtare, ose të paktën Gjykata e Lartë Administrative, të kishin shpjeguar, qoftë vetëm në mënyrë të përmbledhur, shtrirjen e rishikimit që kishin kryer dhe akuzat ndaj kërkuesit. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje zhvillimet e reja pozitive në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë Administrative.

Përfundimisht, Gjykata theksoi se duke pasur parasysh procedurat në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe kufirin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet kombëtare, kufizimet që kufizojnë gëzimin e të drejtave të kërkuesit që i janë dhënë në përputhje me parimet e procesit kontradiktor dhe të barazisë të armëve ishin balancuar në mënyrë të

tillë që ekuilibri i drejtë midis palëve të mos ishte prekur në atë masë sa të cenonte vetë thelbin e së drejtës së kërkuesit për gjykim të drejtë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

2.6. “STRAN GREEK REFINERIES” dhe STRATIS ANDREADIS kundër GREQISË

[13427/87]

GJEDNJ [Dhoma]

9 dhjetor 1994

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: legjislacioni i krijuar për ta bërë të pavlefshëm dhe të pazbatueshëm një vendim arbitrazhi kundër shtetit; shkelje të së drejtës në gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor; shkelje e së drejtës së pronës.

Faktet kryesore

Rasti iu referua Gjykatës nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut bazuar në kërkesën e shoqërisë private me përgjegjësi të kufizuar në Greqi, “Stran Greek Refineries”, dhe nga aksionari i vetëm, Stratis Andreadis (kërkuesit), më 20 nëntor 1987 kundër Republikës Greke. Kërkuesi, Stratis Andreadis, vdiq në vitin 1989 dhe djali i tij, Petros Andreadis, deklaroi se do të vazhdonte me aplikimin.

“Stran Greek Refineries” (“Stran”), ishte një kompani në proces të likuidimit, e regjistruar në Athinë dhe kërkuesi, Stratis Andreadis, ishte aksionari i vetëm i saj. Në vitin 1972, kur Greqia qeverisej nën Juntën ushtarake, Andreadis lidhi një kontratë me autoritetet e atëhershme që të ndërtonte një rafineri të naftës në rajonin Megara pranë Athinës. Kontrata me autoritete greke që datonte më 22 korrik 1972, u ratifikua dhe u botua në Gazetën Zyrtare më 26 korrik të po atij viti. Kostoja e përgjithshme për këtë projekt do të ishte 76 milionë dollarë amerikanë,

ku të gjitha të drejtat dhe detyrimet do të transferoheshin me themelimin e kompanisë.

Një nga detyrimet e cekura në kontratë ishte që shteti të blinte një pronë për qëllimin e rafinerisë. Afati për të ishte fundi i vitit 1972. Përmes nxjerrjes së Dekretit Mbretëror nr. 450, Shteti kishte autorizuar Andreadis të importojë 58 milionë dollarë amerikanë për të financuar projektin.

Sidoqoftë, projekti u ndalua pasi shteti nuk ishte në gjendje të blinte truallin. Kjo u bë e ditur në një konferencë për shtyp në fund të shkurtit 1974. Blerja e dështuar ishte për shkak të vendimit të Qeverisë (të nxjerrë nga Ministrat e Industrisë dhe Bujqësisë) për të kthyer tokën që ishte shpronësuar tashmë. Më pas policia e Megaras urdhëroi që të ndërpritej puna në pronën e cekur. “Stran” kundërshtoi këtë urdhër tek autoritetet duke u bërë thirrje që të ratifikonin blerjen e pronës në fjalë. Autoritetet refuzuan të revokojnë urdhrin e policisë në Megara.

Pasi u rivendos demokracia greke, kontrata dhe Dekreti nr. 450 u rishikuan pasi u konsideruan të dëmshëm për ekonominë kombëtare. Autoritetet synonin të përfundonin kontratën duke u mbështetur në Ligjin nr. 141/1975 për “përfundimin e kontratave preferenciale të lidhura nën regjimin ushtarak”. Ky ligj përmbante autorizime të veçanta.

Nga mesi i nëntorit 1975, kërkuesit u ftuan nga Ministri i Koordinimit që, ose të rishikonin ose të përfundonin kontratën; megjithatë kërkuesit nuk iu përgjigjën kësaj ftese. Para përfundimit të kontratës më 14 tetor 1977, “Stran” kërkoi pagesën e shpenzimeve në lidhje me projektin pasi kishte marrë hua.

Përmbledhja e pretendimeve

Më 10 nëntor 1978, “Stran” ngriti një padi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës, duke kërkuar një shumë të caktuar në emër të kompensimit. “Stran” argumentoi se Qeveria kishte shkelur detyrimet e saj; së pari, duke ndaluar punën e vazhdueshme në ndërtimin e rafinerisë dhe së dyti, në dështimin për të blerë tokën e kërkuar. “Stran” gjithashtu kërkoi kthimin prej 240 milion dhrahmish si siguri për përfundimin e kontratës; dhe kërkoi rimbursimin e komisionit dhe tarifën e pullës fiskale.

Qeveria u përgjigj duke sfiduar juridiksionin e gjykatës dhe potencoi që mosmarrëveshja duhej të dërgohej në arbitrazh siç cekej në kontratë. Gjykata megjithatë refuzoi kundërshtimin, pasi klauzola e arbitrazhit ishte e pavlefshme për shkak të përfundimit të kontratës. Më 12 qershor 1980, Qeveria emëroi një arbitër me pretendimin që kompensimi i vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë e Athinës ishte i pabazuar. “Stran”, megjithatë argumentoi (pasi caktoi arbitrin e vet) se gjykata e arbitrazhit nuk kishte juridiksion dhe kërkoi nga arbitrazhi të priste derisa të përfundonin procedurat në gjykatën e shkallës së parë të Athinës.

Gjykata e arbitrazhit megjithatë konstatoi se ajo kishte juridiksion për mosmarrëveshjen pasi dështimi total për të realizuar kontratën ishte gjithashtu subjekt i arbitrazhit. Përmes provave të paraqitura në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës, gjykata e arbitrazhit konstatoi se përgjegjësia e humbjes së pësuar nga “Stran” u nda përkatësisht 30% dhe 70% ndaj “Stran”-it dhe Shtetit. “Stran”-it iu ngarkua një pjesë e humbjes për shkak të punës në tokën e shpronësuar pa lejet e nevojshme. Lidhur me kontrollin, gjykata e arbitrazhit ishte e mendimit se çeku i paraqitur si garanci është mbajtur në mënyrë të paligjshme nga shteti.

Pas procedurave të arbitrazhit dhe dhënies së vendimit të 27 shkurtit 1984, shteti më pas i kërkoi Gjykatës së Shkallës së Parë të Athinës që të anulonte vendimin e arbitrazhit. Shteti argumentoi se gjykata e arbitrazhit nuk kishte juridiksion, pasi kufiri i juridiksionit ka të bëjë me performancën, interpretimin, të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga kontrata. Prandaj, gjykata e arbitrazhit nuk kishte juridiksion nga fakti se pretendimet e “Stran”-it kundër saj dhe ishin parashkruar pas përfundimit të kontratës.

Gjykata e Shkallës së Parë e Athinës dha vendimin më 21 prill 1985. Ata hodhën poshtë argumentin e shtetit sepse klauzola e arbitrazhit në kontratë vazhdoi të prodhonte efekte në mosmarrëveshjet, të cilat ishin rritur gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

Më 19 dhjetor 1986, “Stran” tërhoqi padinë e tij të parë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës, por përsëri kërkoi të vazhdonte padinë për kthimin e çekut të paraqitur si siguri. Shteti e kundërshtoi këtë

ndërprerje meqë pohoi se veprimi i fundit do të kishte rezultuar i pafavorshëm për “Stran”-in dhe se shteti kishte një interes legjitim në kërkimin e një vendimi përfundimtar.

Nëpërmjet Gjykatës së Apelit në Athinë, ata lanë në fuqi vendimin e 21 prillit 1985, në të cilin ata deklaruan se edhe pse kontrata u ndërpre, klauzola e arbitrazhit në lidhje me kontratën mbizotëron. Më 15 dhjetor 1986, shteti apeloj në Gjykatën e Kasacionit. Seanca fillimisht ishte menduar të ishte më 4 maj 1987, megjithatë u shty për 1 qershor 1987 për shkak të Ligjit 1701/1987 i cili u miratua më 22 maj 1987. Ligji hyri në fuqi me botimin e tij në Gazetën Zyrtare të 25 majit 1982. Ky ligj i ri trajtonte rinegocimin mbi bizneset që përfshinin nxjerrjen e naftës dhe të gazit natyror në një zonë të detit të Trakisë. Neni 12 i Ligjit 1701/1987 megjithatë ishte i pafavorshëm për “Stran”-in, pasi me pak fjalë ai deklaroi se gjykata e arbitrazhit nuk ka juridiksion dhe se vendimet nuk do të jenë të zbatueshme për kërkesat kundër shtetit grek për kontratat që janë lidhur në periudhën 21 prill 1967 - 24 korrik 1974. Së fundmi, çdo procedurë gjyqësore në çfarëdo niveli që ishte në pritje në kohën e miratimit të këtij ligji shpallej e pavlefshme.

Gjykata e Kasacionit konsideroi se neni 12 (paragrafi 2) nuk ishte antikushtetues pasi privoi efektet e çdo vendimi të arbitrazhit të bërë pas përfundimit të kontratave. Gjykata e Kasacionit revokoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe shpalli vendimin e arbitrazhit të 27 shkurtit 1984 të pavlefshëm.

Pas vendimit dhe revokimit të bërë nga Gjykata e Kasacionit, Stran Greek Refineries dhe Stratis bënë hapin tjetër në Komision (GJEDNJ) më 20 nëntor 1987. Pretendimet e tyre lidheshin me shkelje të nenit 6 të Konventës sepse nuk kishin pasur një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Ata gjithashtu argumentuan se e drejta e tyre e pronës ishte shkelur për shkak të nenit 12 të Ligjit nr. 1701/1987.

Në parashtrësën e tyre, shteti argumentoi se kërkuesi (“Stran”) nuk kishte arritur të shteronte mjetet juridike të brendshme. Nëse Gjykata e Shkallës së Parë e Athinës do të rrëzonte kërkesën e paraqitur nga kërkuesi më 19 dhjetor 1986, atëherë ai do të ishte në gjendje të deklaronte papajtueshmërinë e nenit 12 paragrafi 3 të Ligjit nr.

1761/1987, kushtetutshmëria e të cilit nuk ishte përcaktuar nga Gjykata Plenare e Kasacionit. Qeveria gjithashtu argumentoi se kërkuesi duhet të kishte treguar shenja proteste kundër përfundimit të kontratës.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata vëren se pas përfundimit të kontratës se lidhur ndërmjet kërkuessve dhe shtetit grek, ata ngritën një padi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Athinës duke kërkuar që shteti duhet t'i rimbursojë ato në lidhje me shpenzimet që kanë pasur në lidhje me zbatimin e kontratës. Pretendimi i tyre, i cili në thelb ishte për dëmshpërblimin, bazohej kryesisht në pretendimin se shteti kishte qenë tashmë në shkelje të detyrimeve të tij sipas kontratës, përpara përfundimit të saj. Më pas, pretendimi në procedurën e arbitrazhit kishte një bazë të ngjashme. Gjykata e arbitrazhit lejoi pjesërisht kërkesat e kërkuessve me vendim i cili ishte i formës së prerë, i parevokueshëm dhe i ekzekutueshëm, që të dy këto, sipas kushteve të vetë kontratës (neni 27 paragrafi 9 i kontratës -) dhe në bazë të ligjit grek (neni 904 i Kodit të Procedurës Civile - shih paragrafin 25 të raportit në këtë vendim). Gjykata vëren se e drejta e kërkuessve sipas vendimit të arbitrazhit ishte e natyrës “monetare”, siç kishte qenë kërkesa e tyre për dëmshpërblim të lejuar nga gjykata e arbitrazhit. E drejta e tyre për të rikthyer shumat e dhëna nga arbitrazhi ishte një “e drejtë civile” sipas kuptimit të nenit 6 (neni 6), pa marrë parasysh natyrën e kontratës, sipas ligjit grek. Nga kjo rrjedh se rezultati i procedurës së iniciuar në gjykatat e rregullta nga shteti për anulimin e vendimit të arbitrazhit ishte vendimtare për një “të drejtë civile”. Bazuar në këto vlerësime, Gjykata theksoi se neni 6 paragrafi 1 është në përputhje me rrethanat dhe i zbatueshëm në rastin konkret.

Në lidhje me pretendimet e kërkuessit se ata ishin privuar nga një gjykim i drejtë, madje edhe për të drejtën e tyre për qasje në gjykatë (duke u mbështetur në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* të 21 shkurtit 1975 (Seria A nr. 18).

Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vuri re se procedurat pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 1701/1987 ishin të një rëndësie vendimtare për qëllime të hetimit të gjykatës - miratimi i ligjit në fjalë kishte qenë pikë kthese në procedurë, e cila deri në atë pikë kishte shkuar kundër shtetit. Në

çështjet gjyqësore që përfshijnë interesa private të kundërta, barazia e armëve nënkupton që secilës palë duhet t'i ofrohet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm kundrejt kundërshtarit të tij. Koha dhe mënyra e miratimit të nenit 12 - ndërhyrja e ligjvënësit u zhvillua në një kohë kur proceset gjyqësore në të cilat shteti ishte palë ishin në zhvillim e sipër.

Gjykata rikujtoi se parimi i shtetit të së drejtës dhe nocioni i gjykimit të drejtë të sanksionuar në nenin 6 përjashton çdo ndërhyrje të ligjvënësit në administrimin e drejtësisë, të krijuar për të ndikuar në përcaktimin gjyqësor të kontestit. Formulimi i paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 12 të Ligjit të ri (Projektligji u miratua më 22 maj 1987 dhe hyri në fuqi më 25 maj pas botimit në Gazetën Zyrtare), marrë së bashku, në mënyrë efektive përjashtoi çdo shqyrtim kuptimplotë të çështjes nga Divizioni i Parë i Gjykatës së Kasacionit. Pasi kushtetutshmëria e atyre paragrafëve ishin lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit në seancë plenare, Vendimi i Divizionit të Parë u bë i pashmangshëm. Si përfundim, duke pas parasysh të gjitha procedurat pranë gjykatave të rregullta dhe pranë gjykatës së arbitrazhit, shteti shkeli të drejtat e kërkuessve të garantuara sipas nenit 6 paragrafi 1 duke ndërhyrë në një mënyrë që ishte vendimtare për të siguruar që rezultati - i pashmangshëm - i procesit, në të cilin ishte palë, të ishte i favorshëm për të. Prandaj ka pasur shkelje të atij neni (neni 6.1).

Në lidhje me a) kohëzgjatjen e procedurave, Gjykata rikujtoi se periudha që duhet marrë në konsideratë llogaritet duke marrë parasysh fillimin e procedurave në rastin e kërkuessit: data në të cilën ka hyrë në fuqi deklarata greke që pranon të drejtën e ankimit individual. Ndërsa përfundimi i procedurës në rastin e kërkuessit: dorëzimi i vendimit të Gjykatës së Kasacionit që shpall të pavlefshëm vendimin e arbitrazhit. Gjykata konstatoi se gjithsej ishin: katër vjet, katër muaj dhe njëzet ditë.

Në lidhje me b) arsyet e zgjatjes së procedurave, Gjykata vërejti se procedura në Gjykatën e Kasacionit zgjati më shumë se tre vjet: periudhë e justifikuar në funksion të nevojës për të marrë parasysh Ligjin nr. 1701/1987 dhe nenin 563.2 të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata fillimisht vlerësoi:

Nëse ka pasur një “pronë” sipas kuptimit të nenit 1 - Ky vlerësim ishte i nevojshëm për të konstatuar nëse një borxh ndaj kërkuesve ishte vërtetuar mjaftueshëm për të qenë i detyrueshëm. Vendimi paraprak i Gjykatës së Shkallës së Parë të Athinës thjesht u dha kërkuesve shpresën se do të siguronin njohjen e pretendimit të paraqitur. Vendimi i arbitrazhit njohu qartë detyrimin e shtetit deri në një maksimum të shumave të specifikuar - sipas formulimit të tij, ai ishte përfundimtar dhe detyrues, nuk kërkonte asnjë masë të mëtejshme përmbarimore dhe nuk i nënshtrohej ndonjë apeli të zakonshëm ose të veçantë; sipas legjislacionit grek ai kishte fuqinë e një vendimi të formës së prerë dhe u konsiderua i zbatueshëm. E drejta për shumat e dhëna me vendim ishte pa dyshim e revokueshme, por vendimi nuk ishte anuluar nga gjykatat e rregullta civile – rrjedhimisht përbënte një “pronë”.

Nëse ka pasur një ndërhyrje - Gjykata vërejti se kërkuesit ishin në pamundësi të sigurojnë ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit me efekt përfundimtar, sipas të cilit shtetit i kërkohet të paguante shumën të specifikuar në lidhje me shpenzimet e bëra në përpjekje për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale apo edhe që ata të ndërmarrin veprime të mëtejshme për të rikthyer shumën të tilla përmes gjykatave: shumën për ndërhyrje në të drejtën pronësore të kërkuesve.

Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar - Njohja nga praktika gjyqësore e gjykatave ndërkombëtare dhe gjykatave të arbitrazhit që shtetet kanë fuqi sovrane për të ndryshuar apo edhe për të përfunduar kontratat e lidhura me individë privatë, me kusht që ata paguajnë kompensim - përfundimi i njëanshëm i kontratës nuk hyn në fuqi në lidhje me disa klauzola thelbësore, si klauzolat e arbitrazhit. Parimi i autonomisë së klauzolave të arbitrazhit ishte i pranuar në sistemin juridik grek dhe ishte zbatuar në rastin konkret nga Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe, me sa duket, nga gjyqtari raportues i Gjykatës së Kasacionit - pretendimet e kërkuesve të ngritura përpara zgjidhjes së kontratës nuk ishin të pavlefshme. Ndërhyrja në formën e një ligji që thirri për zgjidhjen e kontratës në fjalë me qëllim që të shpallej e pavlefshme klauzola e arbitrazhit dhe të anulohet vendimi i arbitrazhit

prish ekuilibrin që duhet të vendoset ndërmjet mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe kërkesave të interesit publik. Përfundimisht, Gjykata konstatoi se në lidhje me këtë pretendim kishte shkelje (njëzëri).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata njëzëri i hodhi poshtë kundërshtimet paraprake të Qeverisë; konstatoi se ka pasur shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë; vendosi që nuk kishte shkelje në kohëzgjatjen e procedurave; vendosi që shteti duhet t'i paguajë kërkuarit dëmin pasuror: 116,273,442 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzet e dy) dhrahmi, 16.054.165 (gjashtëmbëdhjetë milionë pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) dollarë amerikanë dhe 614,627 (gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) franga franceze, plus interes të thjeshtë prej 6% nga 27 shkurti 1984 deri në datën e gjykimit (shih paragrafin 83 të aktgjykimit); dhe përfundimisht hodhi poshtë pjesën e mbetur të kërkesës për shpërblim të drejtë.

2.7. DRIZA kundër SHQIPËRISË

[33771/02]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

13 nëntor 2007

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: padrejtësia e procedurave të brendshme dhe moszbatimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Pretendime për shkelje të nenit 13 të Konventës mbi mungesën e një mjetei juridik efektiv në lidhje me moszbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë në favor të kërkuarit dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me shkeljen e së drejtës së tij të pronës.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Ramazan Driza (kërkuarisi), shtetas shqiptar kundër Republikës së Shqipërisë më 4 shtator 2002. Kërkuarisi është trashëgimtar

i një parcele toke prej 6,000 metrash katrorë në Tiranë, e cila ishte shpronësuar nga autoritetet në vitin 1960. Të drejtat mbi këtë pasuri që i kishte takuar dikur të atit të tij, iu kthyen kërkuesit me një vendim gjyqësor të formës së prerë nga gjykata e shkallës së parë më 1994. Vendimi ishte marrë mbi bazën e Ligjit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës të vitit 1993. Përderisa kthimi në natyrë nuk ishte i mundur, Komisioni për Kthim dhe Kompensim të Pronave (Komisioni) kërkuesit ia njohu të drejtën e kompensimit për pronën me një pronë të të njëjtit lloj. Prona në fjalë mbulonte një sipërfaqe prej 5,000 metrash katrorë, ndërsa përbëhej nga dy parcela, të identifikuara si parcela e madhe dhe parcela e vogël. Titulli i pronësisë së kërkuesit u regjistrua në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme në Tiranë më 1996. Megjithatë, kërkuesit iu pamundësua që ta merrte pronën në posedim pasi që u shfaqën pretendime nga persona të tretë. Përkundër vendimit të formës së prerë, pronësia e kërkuesit mbi dy parcelat e tokës u sfidua në mënyrë të vazhdueshme përmes rrugëve administrative dhe gjyqësore, ndërsa përfundimisht erdhi edhe deri tek prishja e vendimit të vitit 1994 më 2001 përmes institutit të rekursit në interes të ligjit.⁷⁹

Gëzimi i pasurisë iu pamundësua kërkuesit fillimisht në lidhje me parcelën e vogël e cila i ishte dhënë në shfrytëzim një anëtareje të mëparshme të kooperativës, e cili më pas, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, pretendoi titull të plotë të pronësisë. Gjykata e Shkallës së Parë më 1997, vendosi që Komisioni duhej që së pari të kompensonte përdoruesin e tokës, e më pas ish-pronarin e saj, përkatësisht kërkuesin. Pas apelit të kërkuesit, Gjykata e Shkallës së Dytë vendosi në dobi të tij, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit. Vendimi i shkallës së dytë u bë i plotfuqishëm, teksa u konfirmua më 1998 edhe me vendimin e Seksionit Administrativ të Gjykatës së Lartë. E pakënaqur me këtë vendim, shfrytëzuesja e parcelës së vogël, si mjet të fundit, depozitoi një kërkesë për rekurs në interes të ligjit në Gjykatën e Lartë, me pretendimin se vendimet e shkallës së dytë dhe të tretë që i kishin njohur pronësinë kërkuesit, binin në kundërshtim me të drejtën materiale. Kërkesa u shqyrtua nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e cila pranoi

79 Mjet juridik me të cilin lejohej rishikimi i vendimeve të paneleve të Gjykatës së Lartë, fillimisht nga një panel tjetër e pastaj edhe nga trupi gjyqësor i plotë.

kërkesën për rekurs dhe prishi vendimet e shkallës së dytë dhe të tretë duke konstatuar se vendimi i Komisionit ishte bazuar në keqinterpretim të Ligjit mbi Pronën. Kërkuesi nuk u njoftua asnjëherë për këtë procedurë dhe si pasojë humbi mundësinë e apelimit të këtij vendimi në afatin prekluziv prej 6 muajsh. Paralelisht me çështjen e pronësisë mbi parcelën e vogël, kërkuesit iu kontestua edhe pronësia mbi pronën si tërësi. Më 1997, shfrytëzuesi i parcelës së madhe kishte paraqitur padi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë duke pretenduar se vendimi i Komisionit i vitit 1997 ishte i pavlefshëm si pasojë e mungesës së juridiksionit të këtij organi për të vendosur mbi çështjen. Gjykata e Shkallës së Parë shpalli të pavlefshëm vendimin e Komisionit që i njihte kërkuesit të drejtën e pronësisë mbi tokën në fjalë dhe sipas këtij vendimi, kërkuesit duhej t'i bëhej kompensimi në para. Kërkuesi apeloj këtë vendim në Gjykatën e Shkallës së Dytë pa sukses. Pastaj kërkuesi paraqiti kërkesë për rekurs pranë Gjykatës së Lartë, Seksioni Civil. Me vendimin e 7 dhjetorit të vitit 2000, u konstatua sërish se Komisioni kishte vepruar jashtë juridiksionit të vet, dhe si pasojë, kërkuesit nuk iu njoh e drejta mbi parcelën e madhe, por në emër të saj, atij duhej t'i bëhej kompensimi në vlerë monetare. I pakënaqur me vendimin e Gjykatës, kërkuesi e referoi rastin në Gjykatën Kushtetuese, e cila e deklaroi kërkesën të papranueshme, duke e konsideruar jashtë juridiksionit të saj.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 6.1 të Konventës në disa aspekte, të ndërlidhura me prishjen e vendimit të formës së prerë përmes institucionit të rekursit në interes të ligjit dhe zhvillimin e procedurave paralele mbi të njëjtën çështje. Kërkuesi pretendoi se qeveria kishte shkelur parimin e sigurisë juridike në dy raste të ndryshme. Në radhë të parë, duke përdorur një procedurë të tipit Brumărescu, rezultat i së cilës ishte prishja e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998 i cili linte në fuqi pjesërisht vendimin e Komisionit të datës 20 gusht 1996; dhe në radhë të dytë, duke dhënë vendime kontradiktore në një grup procesesh paralele, duke mos marrë parasysh vendimet e mëparshme të formës së prerë. Në të vërtetë, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 7 dhjetor 2000 që kundërshtoi në tërësi vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996, nuk mori parasysh përfundimet e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998.

Kërkuesi shfaq dyshimet e veta edhe sa i përket trupit gjykues, paanshmërinë e të cilit e vinte në mëdyshje. Ai u ankua në bazë të nenit 6.1 për mungesën e paanshmërisë së panelit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kështu, tre prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (TH.K., P.Z. dhe V.K.) ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues, i cili vendosi në disfavor të kërkuesit më 5 korrik 2001 dhe më 7 dhjetor 2000. Gjithashtu, Kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili paraqiti një kërkesë për rekurs në interes të ligjit në lidhje me vendimin e dhënë në favor të kërkuesit, ishte gjithashtu dy herë pjesë e trupit gjykues që vendosi në disfavor të tij në procese të ndryshme. Si pasojë e mosekzekutimit të këtyre dy vendimeve të formës së prerë, kërkuesi pretendoi se ishte privuar nga e drejta e tij në gëzim paqësor të pasurisë, e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Ndërkohë, sipas dëshmisë së tij, në parcelën e madhe të tokës janë ndërtuar ndërtesa të cilat i janë shitur pronarëve të tjerë, ndërkaq mbi parcelën e vogël janë ndërtuar ndërtesa të përkohshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesit për shkelje të nenit 6.1, në lidhje me mungesën e sigurisë juridike, për shkak të prishjes së vendimit të formës së prerë përmes institutit të rekursit në interes të ligjit, Gjykata vuri re se Gjykata e Lartë nuk ishte kufizuar vetëm në korigjimin, përkatësisht përmirësimin e gabimeve apo pasaktësive gjyqësore të vendimit në fjalë, por se kishte rigjykuar çështjen në themel, duke rënë kështu ndesh me parimin *res judicata*. Në këtë kontekst, Gjykata konsideroi se rrethanat e tilla paraqesin pasiguri juridike, prandaj ka shkelje të nenit 6.1. Ajo rikujtoi se juridiksioni i gjykatave më të larta për të mbikëqyrur rastet duhet ushtruar vetëm për të përmirësuar gabimet gjyqësore dhe në mbarëvajtjen e drejtësisë, por jo për të bërë një vlerësim të ri. Sipas Gjykatës, parimi i sigurisë juridike kërkon, mbi të gjitha, që kur gjykatat të japin një vendim i cili merr formë të prerë për një çështje të caktuar, më pas këto vendime nuk duhet të vihen në dyshim (*Brumărescu kundër Rumanisë*, nr. 28342/95, *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, *Rosca kundër Moldavisë*, nr. 6267/02).

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesit në lidhje me nenin 6.1, për mungesë të paanshmërisë së panelit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, si një element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë dhe për një proces

të rregullt gjyqësor, Gjykata vërejtë se këtë pretendim kërkuesi e bazoi në faktin se tre prej gjyqtarëve që kishin vendosur në procedurën pranë Gjykatës së Lartë, ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues, pasi që të njëjtit kishin vendosur në dëm të parashtruesit në shkallë të parë dhe të dytë lidhur me parcelën e madhe të tokës. E njëjta vlente sipas kërkuesit edhe për kryetarin e Gjykatës së Lartë, i cili kishte shqyrtuar kërkesën për rekurs në interes të ligjit në lidhje me vendimin e dhënë në favor të kërkuesit sa i përket parcelës së vogël. Në përcaktimin e anshmërisë së mundshme të gjyqtarëve në fjalë, Gjykata u lëshua në trajtimin e kriterit të paanshmërisë subjektive dhe asaj objektive të një gjyqtari. Bazuar në rrethanat e rastit, Gjykata konstatoi se Gjykata e Lartë nuk ishte e paanshme, si në aspektin subjektiv - për shkak të pranisë së kryetarit të Gjykatës Supreme në procedurën e mëparshme - ashtu edhe në atë objektiv meqë tre nga gjyqtarët do të duhej të vendosnin në lidhje me vendimet e tyre paraprake. Mungesa e paanshmërisë vlerësohet si shkelje e së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë nga një trup i paanshëm gjykues, përkitazi me nenin 6.1. Si aspekt tjetër të shkeljes së të drejtave të garantuara nga neni 6 .1, Gjykata e konsideroi mosmarrjen e masave të nevojshme nga autoritetet publike për të ekzekutuar vendimet e formës së prerë të datave 17 dhjetor 1998 dhe 7 dhjetor 2000. Sipas Gjykatës, këto vendime mund të interpretohen si detyrim i autoriteteve shqiptare për t'i siguruar kërkuesit një formë kompensimi në natyrë ose në vlerë, e cila do ta zhdëmtonte atë *in lieu* për ish-pronën e tij.

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, kërkuesi pretendoi se rrethanat e cekura në lidhje me dështimet procedurale në gjykatat vendore e kishin privuar atë edhe nga e drejta e tij për të poseduar pronën, duke shkelur kështu të drejtën e tij për gëzim paqësor të pasurisë. Ai argumentoi se prishja e vendimit të Komisionit dhe e vendimit gjyqësor të formës së prerë të vitit 1998 pa i dhënë kompensim, përbënte shkelje të të drejtave të tij të garantuara nën nenin 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata ritheksoi se termi “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 përfshin edhe “pretendimet” (claim) përderisa ato janë të bazuara në të drejtën e brendshme. Gjykata konsideroi se kërkuesi kishte një pretendim të bazuar në vendime gjyqësore, mos-ekzekutimi i të cilave përbën ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për gëzim paqësor të pasurisë së tij. Gjykata konsideroi të papranueshme arsyetimin e Qeverisë në pamundësinë për ekzekutim të vendimit për mungesë fondesh, andaj konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Në lidhje me nenin 13 të ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vërejtë se megjithëse mjetet juridike ishin paraparë në aspektin teorik, Gjykata rikujtoi se ato duhet të jenë të mundshme edhe në nivelin praktik për t'u konsideruar si mjete efektive. Gjykata vërejtë se shteti shqiptar akoma nuk kishte themeluar mekanizmat e nevojshëm të kërkuar në Ligjin për Pronën, që të merren me çështjen e kompensimit dhe vlerësimit të pronave, duke iu pamundësuar kështu qytetarëve një mjet juridik për të mbrojtur të drejtën e tyre. Kështu, Gjykata konsideroi se ka shkelje të nenit 13 të ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti se ka shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, të nenit 6 .1 dhe të nenit 13 ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata vendosi se kërkuarit duhet t'i kthehet parcela e vogël e tokës, si dhe të zhdëmtohet në para në emër të dëmeve materiale dhe jomateriale lidhur me këtë parcelë në një vlerë të përgjithshme prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) eurosh. Sa i përket dëmeve në lidhje me parcelën e madhe, Gjykata urdhëroi zhdëmtimin e parashtruesit në vlerë prej 500,000 (pesëqind mijë) eurosh.

2.8. SCHATSCHASCHWILI kundër GJERMANISË

[9154/10]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

15 shtator 2015

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: përdorimi i deklaratave të bëra më parë nga dëshmitarët që nuk morën pjesë në gjykim, rrjedhimisht, gjykimi kishte qenë i padrejtë dhe se parimi i barazisë së armëve ishte shkelur pasi kërkuar nuk kishte mundësi në çdo fazë të procedurës penale të shqyrtojë dyshimet e vetme dhe të drejtpërdrejta

Faktet kryesore

Rasti u ngrit kundër Republikës Federale të Gjermanisë, nga një shtetas georgjian, Swiadi Schatschaschwili (kërkuar), më 12 shkurt 2010.

Kërkuesi u dënua për grabitje me armë pas një gjyqi, ku dëshmia e mëparshme e dy viktimave u lexua si provë sepse ata nuk u paraqitën në gjykatë. Kur dëshmitarët raportuan incidentin në polici, ata thanë se po niseshin së shpejti për në vendin e tyre në Letoni dhe nuk planifikonin të ktheheshin në Gjermani. Si rezultat, prokuroria i kërkoi gjyqtarit hetues të merrte në pyetje dëshmitarët në mënyrë që të merrte një deklaratë që mund të përdorej në një gjykim të mëvonshëm.

Gjyqtari hetues e zhvilloi seancën e dëshmitarit pa prezencën e kërkuesit sepse ai ishte i shqetësuar se dëshmitarët nuk do të thoshin të vërtetën në prani të kërkuesit për shkak të stresit dhe tronditjes që kishin pësuar gjatë krimit. Kërkuesi nuk ishte i informuar për këtë procedurë dhe, as ai, as avokati që përfaqësonte interesin e tij, nuk ishte i pranishëm ose në gjendje të merrte në pyetje dëshmitarët. Gjykata u përpoq të detyrojë dëshmitarët që të paraqiten në gjyqin e kërkuesit për të dëshmuar duke paraqitur një kërkesë për ndihmë reciproke në gjykatën në Letoni për të urdhëruar paraqitjen e tyre.

Sidoqoftë, gjykata letoneze tha se dëshmitarët nuk ishin të disponueshëm për të marrë pjesë në gjyqin në Gjermani për shkak të çështjeve mjekësore dhe siguruan certifikata mjekësore që dokumentonin atë fakt. Si rezultat, gjykata lejoi që dëshmia e dëshmitarëve, e dhënë para gjyqtarit hetues në seancën e dëshmitarit, të lexohej si dëshmi në gjykimin e kërkuesit.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u ankua se gjykimi i tij kishte qenë i padrejtë dhe se parimi i barazisë së armëve ishte shkelur pasi, as atij dhe as avokatit të tij, nuk i ishte dhënë një mundësi në asnjë fazë të procedurës penale për të marrë në pyetje O. dhe P., të vetmet dëshmitare të drejtpërdrejta dhe viktima të veprës që dyshohet të jetë kryer nga kërkuesi në Göttingen në shkurt 2007. Para Dhomës së Madhe kërkuesi u pajtua se parimet e zhvilluara nga Gjykata në rastet Al-Khawaja dhe Tahery ishin të zbatueshme në rastin e tij. Ai theksoi se, në bazë të kësaj jurisprudence, dështimi për t'i dhënë mbrojtjes mundësi për t'i bërë pyetje një dëshmitari të prokurorisë, do të rezultonte në shkelje të nenit 6.3 (d) të Konventës. Kërkuesi tutje pretendoi se nuk kishte pasur një arsye të fortë për

mospjesëmarrjen e dëshmitareve O. dhe P. në gjyqin e tij. Vështirësitë psikologjike të shkaktuara nga vepra në Göttingen nuk i kishin penguar dëshmitaret që të jepnin deklaratat në polici dhe para gjyqtarit hetues në fazën hetimore. Sipas mendimit të kërkuesi, dënimi i tij kishte qenë i bazuar, së paku në masë vendimtare, në dëshmitë e dhëna nga O. dhe P., të cilët kishin qenë të vetmit dëshmitarë okularë të ngjarjeve në Göttingen. Ai nuk mund të ishte gjetur fajtor mbi bazën e provave të tjera në dispozicion, në qoftë se dëshmitë e dhëna nga dëshmitaret O. dhe P. do të ishin shpërfillur. Kërkuesi pretendoi përfundimisht se nuk ka pasur ndonjë faktor të kundërbalancimit për të kompensuar vështirësitë e shkaktuara në mbrojtje si pasojë e mungesës së dëshmitarëve në gjyq.

Arsyetimi i Gjykatës

Neni 6.1 në lidhje me nenin 6.3 (d): Për të vlerësuar nëse drejtësia e përgjithshme e gjykimit të kërkuesit ishte cenuar nga përdorimi i deklaratave të bëra më parë nga dëshmitarët që nuk morën pjesë në gjykim, Gjykata aplikoi dhe sqaroi më tej testin e vendosur në gjykimin e Dhomës së Madhe në rastet *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([DHM], 26766/05 dhe 22228/06, 15 dhjetor 2011). Në veçanti, ndërsa ishte e qartë se secili nga tre hapat e testit duhej të shqyrtohej nëse përgjigjet në pyetjet në hapat një (nëse kishte një arsye të fortë për mospjesëmarrjen e dëshmitarit) dhe dy (nëse dëshmia e dëshmitarit të munguar ishte baza e vetme ose vendimtare për dënimin e të pandehurit) ishin pozitive, mbeti e pasigurt nëse të tre hapat e testit duhej të shqyrtoheshin në rastet, në të cilat përgjigjja ose në hapin e parë ose në hapin e dytë ishte negative, si dhe në çfarë rendi do të shqyrtoheshin hapat. Gjykata vlerësoi se:

(i) Mungesa e arsyes së fortë për mospjesëmarrjen e një dëshmitari, megjithëse nuk mund të ishte vendimtare për padrejtësinë e një gjykimi, megjithatë ishte një faktor shumë i rëndësishëm që duhet të peshohet në ekuilibër kur vlerësohet drejtësia e përgjithshme e një gjykimi, dhe një faktor që mund të rrëzojë ekuilibrin në favor të gjetjes së shkeljes së nenit 6. 1 dhe 3 (d).

(ii) Ekzistenca e faktorëve të mjaftueshëm të kundërbalancimit duhej të rishikohej jo vetëm në rastet kur provat e dhëna nga një dëshmitar që

mungonte ishin baza e vetme ose vendimtare për dënimin, por edhe në ato raste kur ajo kishte peshë të konsiderueshme dhe pranimi i saj mund të ketë dëmtuar mbrojtjen. Shtrirja e faktorëve të kundërbalancimit të nevojshëm në mënyrë që gjykimi të konsiderohet i drejtë do të varet nga pesha e provave të dëshmitarit që mungon.

(iii) Si rregull, do të ishte me vend që të shqyrtohen tre hapat e testit Al-Khawaja sipas rendit të përcaktuar në atë aktgjykim. Megjithatë, të tre hapat ishin të ndërlidhur dhe, të marrë së bashku, shërbyen për të vërtetuar nëse procedurat penale në fjalë, në tërësi, ishin të drejta. Prandaj, mund të jetë e përshtatshme, në një rast të caktuar, të shqyrtohen hapat në një rend të ndryshëm, veçanërisht nëse një nga hapat rezulton të jetë veçanërisht vendimtar në lidhje me drejtësinë ose padrejtësinë e procedurës.

Gjykata vazhdoi të zbatonte testin Al-Khawaja në faktet e çështjes së kërkuesit:

(a) Nëse kishte arsye të forta për mospjesëmarrjen e dëshmitarëve në gjykim - Gjykata vuri në dukje në fillim se gjykata kishte marrë parasysh se dëshmitarët nuk kishin arsyetuar sa duhet refuzimin e tyre për të dëshmuar dhe nuk e kishte pranuar gjendjen e tyre shëndetësore ose frikën si justifikim për mungesën e tyre në gjyq. Pasi kontaktoi dëshmitarët individualisht dhe propozoi zgjidhje të ndryshme, gjykata gjithashtu kishte kërkuar në mënyrë të përsëritur nga gjykatat letoneze që, ose të kontrollonin gjendjen shëndetësore të dëshmitarëve dhe aftësinë e tyre për të dëshmuar nga një zyrtar mjekësor publik ose t'i detyronin ata të merrnin pjesë në seancë në Letoni. Meqenëse këto përpjekje rezultuan të kota, gjykata kishte pranuar të dhënat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve në fazën e hetimit si provë në procedurë. Kështu, mungesa e dëshmitarëve nuk mund t'i atribuohet gjykatës. Prandaj, kishte një arsye të fortë, nga këndvështrimi i gjykatës, për mospjesëmarrjen e dëshmitarëve në gjyq dhe për pranimin e dëshmive që ata kishin bërë në fazën paraprake.

(b) Nëse dëshmia e dëshmitarëve në mungesë ishte baza e vetme ose vendimtare për dënimin e kërkuesit - Gjykatat vendase nuk e treguan qartë nëse ato i konsideruan deklaratat e dëshmitarëve në fjalë si prova

“vendimtare”, domethënë, si të një rëndësie të tillë, që ka të ngjarë të jetë përcaktuese për rezultatin e çështjes. Pasi vlerësoi të gjitha provat që kishin qenë para gjykatave vendase, Gjykata vuri në dukje se dy viktimat e krimit ishin dëshmitarët e vetëm okularë të veprës në fjalë. Dëshmi të tjera të disponueshme ishin ose thashetheme, ose thjesht prova teknike dhe prova të tjera që nuk ishin përfundimtare. Në këto rrethana, provat e dëshmitarëve që mungonin kishin qenë “vendimtare”, domethënë përcaktuese të dënimit të kërkuesit.

(c) Nëse kishte faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues për të kompensuar të metat sipas të cilave punonte mbrojtja - Në arsyetimin e saj, gjykata e shkallës së parë e kishte bërë të qartë se ishte në dijeni të vlerës së zvogëluar të provave të deklaratave të paverifikuara të dëshmitarëve. Ajo kishte krahasuar përmbajtjen e deklaratave të bëra nga viktimat në fazën e hetimit dhe zbuloi se ato kishin dhënë përshkrime të hollësishme dhe koherente të rrethanave të veprës. Gjykata kishte vërejtur më tej se pamundësia e dëshmitarëve për të identifikuar kërkuesin tregonte se ata nuk kishin dëshmuar me qëllim inkriminimin e tij. Për më tepër, gjykata kishte shqyrtuar besueshmërinë e dëshmitarëve që mungonin dhe besueshmërinë e deklaratave të tyre në një mënyrë të kujdesshme.

Gjykata theksoi se ajo kishte para saj thashetheme inkriminuese shtesë dhe prova rrethanore që mbështesnin deklaratat e dëshmitarëve. Përveç kësaj, gjatë gjykimit kërkuesi kishte pasur mundësinë të jepte versionin e tij të ngjarjeve dhe të vinte dyshime mbi besueshmërinë e dëshmitarëve edhe duke pyetur dëshmitarët që kishin dhënë dëshmi të dëgjua. Megjithatë, ai nuk kishte pasur mundësi të merrte në pyetje dy viktimat në mënyrë indirekte ose në fazën e hetimit.

Në fakt, edhe pse autoritetet e akuzës mund të kishin caktuar një avokat për të marrë pjesë në seancën e dëshmitarit para gjyqtarit hetues, këto masa mbrojtëse procedurale nuk u përdorën në rastin e kërkuesit. Në lidhje me këtë, Gjykata u pajtua me kërkuesin se dëshmitarët u morën në pyetje nga gjyqtari hetues sepse, duke pasur parasysh kthimin e tyre të afërt në Letoni, autoritetet e akuzës konsideruan se kishte rrezik që provat e tyre të humbnin. Në këtë kontekst, dhe duke pasur parasysh se sipas ligjit të brendshëm, regjistrimet me shkrim të ekzaminimit të

mëparshëm të një dëshmitari nga një gjyqtar hetues mund të lexoheshin në gjyq nën kushte më pak të rrepta sesa regjistrimet e marrjes në pyetje të një dëshmitari nga policia, autoritetet kishin marrë rrezikun e parashikueshëm, i cili më pas u materializua, që as i akuzuari dhe as mbrojtësi i tij nuk do të ishin në gjendje t'i merrnin në pyetje në asnjë fazë të procedurës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e deklaratave të dëshmitarëve okularë të vetëm për veprën për të cilën kërkuesi u dënua, masat kundërbalancuese të marra nga gjykata vendase kishin qenë të pamjaftueshme për të lejuar një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së provave të paverifikuara. Prandaj, mungesa e një mundësie për kërkuesin që të marrë në pyetje ose të kërkojë që të merren në pyetje dy dëshmitarët në ndonjë fazë të procedurës e kishte bërë gjykimin në tërësi të padrejtë.

Në bazë të vlerësimeve më lart, Dhoma e Madhe konstatoi se pranimi i dëshmisë së dëshmitarëve që mungonin shkelte të drejtën e kërkuesit për një gjykim të drejtë, sepse ai nuk kishte mundësi të merrte në pyetje dy dëshmitarët. Në arritjen e këtij përfundimi, Dhoma e Madhe ndoqi jurisprudencën e mëparshme të GJEDNJ-së që përdori një test me tri pjesë për të pranuar dëshminë e dëshmitarit kur një dëshmitar nuk merr pjesë në gjykim: (i) nëse kishte një arsye të fortë për mospjesëmarrjen e dëshmitarit; (ii) nëse dëshmia e dëshmitarit që mungonte ishte baza e vetme vendimtare e dënimit të të pandehurit; dhe (iii) nëse kishte faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues ose masa procedurale për të kompensuar mungesën e mundësisë për të marrë në pyetje dëshmitarin në gjyq.

Dhoma e Madhe u pajtua se kishte një arsye të fortë për mungesën e dëshmitarëve në gjyq sepse gjykata bëri përpjekje të mjaftueshme për të detyruar dëshmitarët të marrin pjesë përmes një kërkese për ndihmë reciproke. Sidoqoftë, u zbulua se dy pjesët e tjera të testit mungonin. Ajo gjeti se dëshmia e dy dëshmitarëve ishte një faktor vendimtar në dënimin e kërkuesit, sepse e identifikoi dhe e lidhte atë drejtpërdrejt me krimin, ku provat e tjera të pranuar ishin periferike.

Më tej, ajo gjeti masa të pamjaftueshme procedurale për të kompensuar pamundësinë e kërkuesit për të marrë në pyetje dëshmitarët në gjyq,

duke vënë në dukje se kërkuesi nuk ishte njoftuar për seancën e dëshmitarit kur u kërkua të ruante dëshminë pasi dëshmitarët po ktheheshin në Letoni dhe kishte të ngjarë që nuk do të merrnin pjesë në gjyq. Si rezultat, as kërkuesi, as avokati që përfaqësonte interesat e tij nuk ishin në gjendje të merrnin në pyetje dëshmitarët para gjykimit, kur ata dhanë deklaratat e përdorura kundër kërkuesit për ta dënuar atë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2.9. SEJDOVIC kundër ITALISË

[56581/00]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

1 mars 2006

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: dënimi në mungesë pa pasur mundësinë për të paraqitur mbrojtjen para gjykatave.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Ismet Sejdovic (kërkuesi), një shtetas i Republikës Federale të atëhershme të Jugosllavisë, kundër Republikës Italiane më 22 mars 2000. Më 8 shtator 1992 S. u plagos për vdekje nga një e shtënë në një kamp udhëtarësh (campo nomadi) në Romë. Deklaratat fillestare të marra nga policia nga dëshmitarët treguan se kërkuesi kishte qenë përgjegjës për vrasjen. Më 15 tetor 1992, gjyqtari hetues i Romës lëshoi një urdhër për ndalimin e kërkuesit në pritje të gjykimit. Megjithatë, urdhri nuk mund të zbatohet pasi kërkuesi nuk mund të gjendej më. Si rezultat, autoritetet italiane konsideruan se ai kishte kërkuar qëllimisht t'i shmangej drejtësisë dhe më 14 nëntor 1992 e shpallën atë si “të arratisur” (*latitante*). Meqenëse autoritetet italiane nuk kishin arritur të kontaktojnë kërkuesin për ta ftuar të zgjidhte vetë mbrojtësin e tij, ata i caktuan atij një avokat, i cili u informua se klienti i tij dhe katër persona të tjerë ishin vendosur për gjykim në një datë të caktuar në Gjykata e Shkallës së Parë

në Romë. Avokati mori pjesë në gjykim, por kërkuesi mungonte. Në një vendim të datës 2 korrik 1996, Gjykata e Shkallës së Parë e Romës e shpalli fajtor kërkuesin për vrasje dhe armëmbajtje pa leje dhe e dënoi atë me njëzet e një vjet e tetë muaj burgim. Një nga të pandehurit e tjerë u dënua me pesëmbëdhjetë vjet e tetë muaj burgim për të njëjtat vepra, ndërsa tre të tjerët u shpallën të pafajshëm. Avokati i kërkuesit u informua se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ishte depozituar në sekretari. Ai nuk apeloi. Prandaj, dënimi u bë përfundimtar më 22 janar 1997. Më 22 shtator 1999 kërkuesi u arrestua në Hamburg nga policia gjermane sipas një urdhër-arresti të lëshuar nga zyra e prokurorit publik të Romës. Më 30 shtator 1999, Ministri italian i Drejtësisë kërkoi ekstradimin e tij. Ai shtoi se, pasi të ishte ekstraduar në Itali, kërkuesi do të kishte të drejtë të aplikonte sipas nenit 175 të Kodit të Procedurës Penale për leje apelimi jashtë afatit kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Romës. Me kërkesë të autoriteteve gjermane, zyra e prokurorit publik të Romës deklaroi se nga provat nuk rezultonte se kërkuesi ishte njoftuar zyrtarisht për akuzat kundër tij. Zyra e prokurorit publik nuk ishte në gjendje të thoshte nëse kërkuesi kishte kontaktuar me avokatin e caktuar për ta përfaqësuar atë. Në çdo rast, avokati kishte marrë pjesë në gjyq dhe kishte luajtur një rol aktiv në mbrojtjen e klientit të tij, duke thirrur një numër të madh dëshmitarësh. Për më tepër, Gjykata e Shkallës së Parë e Romës kishte vërtetuar qartë se kërkuesi, i cili ishte identifikuar nga shumë dëshmitarë si vrasësi i z. S., ishte fajtor. Sipas mendimit të zyrës së prokurorit publik, kërkuesi ishte arratisur menjëherë pas vdekjes së z. S. pikërisht për të shmangur arrestimin dhe gjykimin. Së fundi, prokuroria publike deklaroi: “Personi që do të ekstradohet mund të kërkojë leje për ankesë kundër aktgjykimit. Megjithatë, që një gjykatë të pranojë të rishqyrtojë çështjen, duhet të vërtetohet se i akuzuari gabimisht është konsideruar si ‘i arratisur’. Për ta përmbledhur, një gjykim i ri, qoftë edhe në formën e apelit (gjatë të cilit mund të paraqiten prova të reja), nuk jepet automatikisht”. Më 6 dhjetor 1999, autoritetet gjermane refuzuan kërkesën e qeverisë italiane për ekstradim me arsyetimin se legjislacioni i brendshëm i vendit kërkues nuk garantonte me siguri të mjaftueshme që kërkuesi do të kishte mundësinë për të rihapur gjykimin e tij. Ndërkohë, kërkuesi ishte liruar më 22 nëntor 1999. Ai nuk kishte paraqitur kundërshtim për ekzekutimin (incidente d’esecuzione), e as kërkesë për leje apelimi jashtë afatit bazuar në “Ligjin dhe praktikat përkatëse të brendshme” në Itali.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 6.1 pasi që sipas tij ai ishte dënuar në mungesë pa pasur mundësinë për të paraqitur mbrojtjen e tij përpara gjykatave italiane. Në lidhje me këtë, Dhoma konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës. Ajo konsideroi se kërkuesi, i cili nuk ishte informuar kurrë zyrtarisht për procedimet kundër tij, nuk mund të thuhej se kishte hequr dorë pa mëdyshje nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyqin e tij. Për më tepër, legjislacioni i brendshëm nuk i kishte dhënë atij me siguri të mjaftueshme mundësinë për t'u paraqitur në një gjykim të ri. Kjo mundësi kishte qenë objekt i paraqitjes së provave nga organet e ndjekjes ose nga personi i dënuar në lidhje me rrethanat, në të cilat ai ishte shpallur i arratisur dhe nuk kishte përmbushur kërkesat e nenit 6 të Konventës.

Qeveria e kundërshtoi kërkesën e kërkuesit në tërësi duke theksuar se mjetet juridike të brendshme nuk ishin shteruar pasi që kërkuesi nuk kishte përdorur mjetet juridike të parashikuara në nenet 175 dhe 670 të KPP-së. Në lidhje me këtë në vendimin e saj të datës 11 shtator 2003 mbi pranueshmërinë, Dhoma hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë se kërkuesi nuk kishte përdorur mjetin juridik nga neni 175 të KPP-së, duke u shprehur se, në rrethanat e veçanta të çështjes, një kërkesë për leje për ankese jashtë afatit do të kishte pasur pak mundësi për sukses dhe kishte pengesa objektive për ta përdorur atë.

Rasti iu referua Dhomës së Madhe.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesit për shkelje të nenit 6.1 në lidhje me gjykimin në mungesë, Gjykata rikujtoi parimet e vendosura në jurisprudencën e saj. Gjykata ritheksoi se, megjithëse nuk përmendet shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 6, fushëveprimi dhe qëllimi i nenit i marrë në tërësi tregon se një person “i akuzuar për një vepër penale” ka të drejtë të marrë pjesë në seancë. Për më tepër, nënparagrafët (c), (d) dhe (e) të paragrafit 3 i garantojnë “të gjithë të akuzuarit për një vepër penale” të drejtën “të mbrohet personalisht”, “të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët” dhe “të ketë ndihmën falas të

një përkthyesi nëse nuk mund të kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë”, dhe është e vështirë të shihet se si mund t’i ushtronte këto të drejta pa qenë i pranishëm (shih *Colozza*, 14, paragrafi 27; *T kundër Italisë*, 41, paragrafi 26; *FCB kundër Italisë*, cituar më lart, f. 21, paragrafi 33 dhe *Belziuk kundër Polonisë*, vendimi i 25 marsit 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-II, f. 570, paragrafi 37).

Gjykata shtoi se, megjithëse procedurat që zhvillohen në mungesë të të akuzuarit nuk janë në vetvete të papajtueshme me nenin 6 të Konventës, mohimi i drejtësisë megjithatë ndodh padyshim kur një person i dënuar në mungesë nuk është në gjendje të marrë më pas nga një gjykatë që e ka dëgjuar atë në përputhje me kërkesat e nenit 6, një përcaktim të ri të themelit të akuzës, në lidhje me ligjin dhe faktin, kur nuk është vërtetuar se ai ka hequr dorë nga e drejta për t’u paraqitur dhe për t’u mbrojtur (shih *Colozza*, cituar më sipër, f.15, paragrafi 29, dhe *Einhorn kundër Francës* (vendim), nr. 71555/01, paragrafi 33, GJEDNJ 2001-XI).

Konventa u lejon shteteve kontraktuese liri të konsiderueshme në lidhje me zgjedhjen e mjeteve për të siguruar që sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6, duke ruajtur në të njëjtën kohë efektivitetin e tyre. Megjithatë, detyra e Gjykatës është të përcaktojë nëse rezultati i kërkuar nga Konventa është arritur. Në veçanti, burimet e disponueshme sipas ligjit të brendshëm duhet të tregohen të jenë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale as nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur dhe për t’u mbrojtur dhe as nuk ka kërkuar t’i shpëtojë gjykimin (shih *Medenica*, cituar më lart, paragrafi 55). Në çështjen në fjalë, autoritetet italiane konsideruan, në thelb, se kërkuuesi kishte hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur në gjyq, sepse ai nuk mund të gjendej menjëherë pas vrasjes së z. S., e cila kishte ndodhur në prani të disa dëshmitarëve okularë. Ky interpretim u mbështet nga qeveria e paditur, e cila argumentoi se nga sjellja e kërkuarit mund të nxirret përfundimi se ai kishte synuar t’i shpëtonte gjykimin.

Gjykata rithekson se as shkronja dhe as fryma e nenit 6 të Konventës nuk e pengojnë një person të heqë dorë nga vullneti i tij i lirë, shprehimisht ose në heshtje, nga e drejta për garancitë e një gjykimi të drejtë; megjithatë, çdo heqje dorë duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me ndonjë interes të rëndësishëm publik (shih, *mutatis*

mutandis, Kwiatkowska kundër Italisë (vendim), nr. 52868/99, 30 nëntor 2000, dhe *Håkansson dhe Sturesson kundër Suedisë*, vendimi i 21 shkurtit 1990, Seria A nr. 171-A, f. 20, paragrafi 66).

Në çështjen në fjalë, ndryshe nga *Medenica* (cituar më lart, paragrafi 59), nuk ka asnjë provë që kërkuesi ka ditur për procedurat kundër tij ose për datën e gjykimit të tij. Vetëm mungesa e tij nga vendbanimi i tij i zakonshëm kur autoritetet u përpoqën ta arrestonin mund të krijonte përshtypjen se ai ishte në dijeni ose kishte frikë se policia po e kërkonte.

Gjykata e konsideron të panevojshme të spekulojë se çfarë e shkaktoi kërkuesin të largohej nga shtëpia e tij dhe të udhëtonte për në Gjermani. Ai rithekson se informimi i dikujt për një ndjekje penale të ngritur kundër tij është një akt juridik i një rëndësie të tillë, saqë duhet të kryhet në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore që mund të garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave të të akuzuarit, siç është edhe e qartë nga neni 6.3 (a) të Konventës. Njohuritë e paqarta dhe informale nuk mund të mjaftojnë (shih *T. kundër Italisë*, paragrafi 28).

Rrjedhimisht, edhe duke supozuar se kërkuesi ishte në dijeni të tërthortë se ishte iniciuar procedurë penale kundër tij, nuk mund të konkludohet se ai hoqi dorë pa mëdyshje nga e drejta për t'u paraqitur në gjyqin e tij. Mbetet për t'u përcaktuar nëse legjislacioni i brendshëm i jepte atij, me siguri të mjaftueshme, mundësinë për t'u paraqitur në një gjykim të ri. Në lidhje me këtë, Qeveria iu referua mjetit juridik të parashikuar në nenin 175 të KPP-së, duke vënë në dukje se në mënyrë që një person i dënuar në mungesë të aplikonte për leje apelimi jashtë afatit, mjaftonte që ai të provonte se nuk kishte qenë në dijeni të hapave të ndërmarrë në procedurë. Megjithatë, Gjykata vëren se në vendimin e saj për pranueshmërinë e ankimit, ajo hodhi poshtë një kundërshtim të Qeverisë se mjetet juridike të brendshme nuk ishin shteruar, duke konstatuar se mjeti juridik në fjalë do të kishte pasur pak mundësi për të përfunduar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës; se shkelja e ka origjinën nga një problem sistematik i lidhur me mosfunksionimin e legjislacionit dhe praktikës së brendshme të shkaktuar nga mungesa

e një mekanizmi efektiv për të siguruar të drejtën e personave të dënuar në mungesë – ku ata nuk janë informuar efektivisht për procedurën kundër tyre dhe nuk kanë hequr dorë pa mëdyshje nga e drejta e tyre për t'u paraqitur në gjyqin e tyre – për të marrë një përcaktim të ri të themelit të akuzës kundër tyre nga një gjykatë në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës; konstatoi se shteti i paditur duhet, nëpërmjet masave të duhura, t'i sigurojë të drejtën në fjalë kërkuarit dhe personave të tjerë në një pozicion të ngjashëm; konkludoi se konstatimi i shkeljes përbën në vetvete një kompensim të drejtë të mjaftueshëm për dëmin jomaterial të pësuar nga kërkuari.

2.10. MOREIRA FERREIRA kundër PORTUGALISË (2)

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

11 korrik 2017

[19867/12]

***Çështja kyçele drejta e pretenduar:** refuzimi nga gjykata vendore për të rihapur procedurën penale pas konstatimit të shkeljes së nenit 6 nga Gjykata Evropiane; refuzimi nga Gjykata e Lartë i kërkesës për rishikim të një vendimi penal në vijim të një vendimi të Gjykatës Evropiane që konstaton shkelje të nenit 6.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Francelina Moreira Ferreira, një shtetase portugeze (kërkuarja), kundër Republikës Portugeze, më 30 mars 2012. Çështja kishte të bënte me refuzimin nga Gjykata e Lartë të një kërkesë të paraqitur nga kërkuarja për rishikimin e një vendimi penal pas një vendimi të dhënë nga GJEDNJ më 5 korrik 2011. Kërkuarja ishte ndjekur penalisht dhe dënuar për sjellje kërcënuese dhe fyese dhe ishte urdhëruar të paguante dëmshpërblim për viktimat. Kërkuarja apeloj kundër vendimit të parë, por gjykata e apelit la në fuqi dënimin, megjithëse dënimi i saj u zvogëlua. Më pas, ajo paraqiti një kërkesë në GJEDNJ duke u ankuar se ajo nuk ishte dëgjuar personalisht nga gjykata e apelit. GJEDNJ u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6.1. Si rezultat

i vendimit të GJEDNJ-së, kërkuesja më pas paraqiti një kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë me arsyetimin se sipas vendimit të GJEDNJ-së të datës 5 korrik 2011, vendimi i Gjykatës së Apelit i 19 dhjetorit 2007 ishte i papajtueshëm me nenin 6.1 të GJEDNJ-së. Megjithatë, Gjykata e Lartë refuzoi të miratonte një rishikim, duke qenë se konstatoi që mungesa e seancës dëgjimore për kërkuesen në Gjykatën e Apelit kishte përbërë një parregullsi procedurale që nuk mund të shqyrtohej. Duke u mbështetur në nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), kërkuesja u ankua se Gjykata e Lartë kishte interpretuar dhe zbatuar gabimisht dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe konkluzionet e vendimit të GJEDNJ-së të vitit 2011, duke e privuar atë nga e drejta për rishikim të dënimit të saj. Më tej, kërkuesja parashtroi se rrëzimi i kërkesës së saj për rishikim nga Gjykata e Lartë ishte në kundërshtim me nenin 46 (Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve). Dhoma e Madhe mori në konsideratë parimin e subsidiaritetit dhe vlerësoi se refuzimi i Gjykatës së Lartë për të rihapur procedurat nuk e kishte shtrembëruar ose keqinterpretuar atë vendim dhe se arsyet mbi të cilat bazohej vendimi binin në kufirin e vlerësimit të autoriteteve vendase.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), kërkuesja u ankua se Gjykata e Lartë kishte hedhur poshtë kërkesën e saj për rishikim të aktgjykimit penal të nxjerrë kundër saj. Ajo parashtroi se Gjykata e Lartë kishte interpretuar dhe zbatuar gabim dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe konkluzioneve të vendimit të Gjykatës, të vitit 2011, duke e privuar atë nga e drejta për rishikim të zvogëlimit të dënimit të saj. Më tej, kërkuesja parashtroi se rrëzimi i kërkesës së saj për rishikim nga Gjykata e Lartë kishte qenë në kundërshtim me nenin 46 (Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve). Kërkesa është depozituar në GJEDNJ më 30 mars 2012. Më 12 janar 2016 Dhoma hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe. Një dëgjim u mbajt më 1 qershor 2016.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet e kërkueses për shkelje të nenit 6.1, Gjykata vuri në dukje se edhe pse procedurat e gjykuara nga Gjykata e Lartë

në mënyrë të pakundërshtueshme kishin të bënin me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës të vitit 2011, ato ishin të reja në lidhje me procedurat që përbënin objektin e atij vendimi. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se ankesa e znj. Moreira Ferreira lidhej me arsyet e dhëna nga Gjykata e Lartë për rrëzimin e kërkesës për shqyrtim. Kështu, Gjykata vërejti se në shqyrtimin e kërkesës për rishikim, Gjykata e Lartë kishte një rast me një çështje të re, domethënë vlefshmërinë e dënimit të kërkuësës në dritën e konstatimit të shkëljes së të drejtës për gjykim të drejtë. Gjykata konsideroi se pretendimi i mungesës së drejtësisë në procedurën e ndjekur gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim, dhe më konkretisht gabimet, të cilat i kontestonte kërkuësja, përbënte informacion. Gjykata konsideroi se neni 46 i Konventës nuk e përjashtonte shqyrtimin e ri të ankesës bazuar në nenin 6 të Konventës.

Gjykata më tej vërejti se Gjykata e Lartë kishte kryer një rishqyrtim mbi bazueshmërinë e një sërë aspektesh të çështjes së diskutueshme të mungesës së seancës dëgjimore për të dhe pasojat e asaj mungese për vlefshmërinë e dënimit të saj. Gjykata e Lartë kështu kishte konstatuar se vendimi i Gjykatës së Apelit nuk kishte qenë i papajtueshëm me vendimin e Gjykatës Evropiane. Duke arritur në përfundimin se vlefshmëria e dënimit nuk ishte objekt i ndonjë dyshimi serioz, ishte i detyruar të linte në fuqi dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Apelit. Duke pasur parasysh fushëveprimin e shqyrtimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata konsideroi se Gjykata e Lartë u ndal edhe një herë në përcaktimin e akuzës penale ndaj kërkuësës. Ajo vijoi që masat mbrojtëse të nenit 6.1 të Konventës ishin të zbatueshme për procedurat para Gjykatës së Lartë.

Gjykata vuri në dukje se në vendimin e saj të datës 21 mars 2012, Gjykata Supreme kishte konstatuar se parregullsia procedurale e konstatuar nga GJEDNJ nuk ka qenë mjaft serioze në mënyrë që të konsiderohet e papajtueshme dhe të ndikojë në marrjen ndryshe të vendimit nga ana e Gjykatës. Sipas Gjykatës Supreme, interpretimi i Gjykatës për nenin 449.1 (g) të Kodit të Procedurës Penale, dhe parregullsitë procedurale të konstatuara nuk krijuan asnjë të drejtë automatike për rihapjen e procedurave. Gjykata konsideroi se ky interpretim i ligjit portugez, i cili kishte efekt të kufizimit të situatave që mund të çonin në rihapjen e procedurave penale që kishin qenë të përfunduara me

efekt përfundimtar, nuk ishte arbitrar. Ky interpretim u mbështet nga jurisprudenca e vendosur e Gjykatës në kuptimin që Konventa nuk garantonte të drejtën e rihapjes së procedurave, dhe nga mungesa e një qasje uniforme midis shteteve anëtare për sa i përket procedurave dhe mekanizmave të rihapjes. Për më tepër, Gjykata përsëriti se konstatimi i shkeljes së nenit 6 të Konventës në përgjithësi nuk krijoi një situatë të vazhdueshme dhe nuk ia imponoi shtetit të paditur një detyrim procedural të vazhdueshëm.

Gjykata theksoi se në vendimin e saj të 5 korrikut 2011 Dhoma kishte konstatuar se një rigjykim ose rihapje e procedurës përfaqësonte “në parim një mënyrë të përshtatshme për të korrigjuar shkeljen”. Një rigjykim ose rihapje e procedurave ishte përshkruar kështu si zgjidhje e përshtatshme, por jo e nevojshme apo ekskluzive. Kështu, Gjykata ishte përmbajtur nga dhënia e indikacioneve për detyrimin se si të ekzekutohej një vendim dhe kishte zgjedhur t’i jepte shtetit një hapësirë të gjerë të veprimit në atë sferë. Rrjedhimisht, rihapja e procedurave nuk duket të ketë qenë mënyra e vetme për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës të 5 korrikut 2011. Në rastin më të mirë, ajo kishte përfaqësuar më së shumti një opsion të dëshirueshëm, vlera e të cilit ishte një çështje për t’u vlerësuar nga gjykatat vendase, duke pasur parasysh legjislacionin kombëtar dhe rrethanat e veçanta të rastit. Gjykata nuk mundi të arrinte në përfundimin se leximi i vendimit të Gjykatës së Lartë të vitit 2011, parë në tërësinë e tij, kishte qenë rezultat i një gabimi të qartë faktik ose ligjor që çoi në mohimin e drejtësisë.

Duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit dhe formulimin e vendimit të Gjykatës, të datës 5 korrik 2011, Gjykata vlerësoi se refuzimi i Gjykatës së Lartë për të rihapur procedurën e kërkuar nga kërkuësja nuk e kishte shtrembëruar apo keqinterpretuar atë aktgjykim dhe se bazat, mbi të cilat u mbështet bien në hapësirën e vlerësimit të autoriteteve vendase.

Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

Gjykata përsëriti se çështja e pajtueshmërisë nga Palët e Larta Kontraktuese me aktgjykimet e saj, bien jashtë juridiksionit të saj,

përveç rasteve kur është ngritur në kontekstin e “shkeljes së procedurës” të parashikuar në nenin 46 paragrafët 4 dhe 5.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

2.11. XHERAJ kundër SHQIPËRISË

[37959/02]

[Seksioni i Katërt]

29 korrik 2008

Çështja kyçele drejta e pretenduar: shkelja e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe cenimi i parimit të sigurisë juridike për shkak të prishjes së një vendimi të formës së prerë për lirim nga akuza e vrasjes

Faktet kryesore

Kërkuesi Arben Xheraj, është një shtetas shqiptar i lindur më 1970 dhe aktualisht në vuajtje të dënimit prej gjashtëmbëdhjetë vjetësh në Burgun e Viçencës (Itali) për trafik droge.

Më 1995, Zyra e Prokurorit për qytetin e Durrësit e akuzoi kërkuesin për vrasje, në bazë të provave nga babai i viktimës, i cili pohoi se viktimja, para vdekjes së tij, i kishte thënë se kërkuesi ishte një nga vrasësit. Më 27 nëntor 1996, kërkuesi, në mungesë, u shpall fajtor për vrasje dhe u dënua me njëzet vjet burgim nga Gjykata e Apelit Durrës. Më pas, duke u bazuar në provat dhe rrethanat e reja, kërkuesi kishte kërkuar rishikimin e vendimit me të cilin ishte dënuar. Më 27 nëntor 1998, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi ankimin e kërkuesit për rishikimin e vendimit të papranueshëm. Gjykata vendosi për themelin e çështjes dhe pas shqyrtimit të provave të reja dhe pas marrjes parasysh të kërkesës së zyrës së prokurorit, rrëzoi vendimin e gjykatës së apelit të datës 27 nëntor 1996 dhe e deklaroi të pafajshëm ankuesin më 14 dhjetor 1998 (vendimi i pafajësisë).

Më 8 tetor 1999, prokurori në Gjykatën e Apelit të Durrësit (“prokurori i apelit”) paraqiti një kërkesë për leje për të apeluar pas afatit kundër vendimit të pafajësisë në Gjykatën e Rrethit të Durrësit. Prokurori i apelit paraqiti si bazë për kërkesën e tij mangësitë nga ana e prokurorit të rrethit. Duke u thirrur në nenin 26.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) për përjashtimin e një prokurori në rastet e mungesës së paanësisë, përmbajtja e të cilit i referohet dorëheqjes së një gjyqtari sipas nenit 17 të KPP-së, prokurori i apelit pohoi se prokurori i rrethit që kishte marrë pjesë në procedurat e para gjyqësore nuk duhet të kishte marrë pjesë në procedurat e rishikimit. Neni 17.1 (c) i KPP parashikon që një gjyqtar duhet të përjashtohet “kur ai ka dhënë këshilla ose ka shprehur opinion në lidhje me çështjen e procedimit”.

Prokurori i apelit pretendoi se familja e viktimës, e cila kishte qenë palë e dëmtuar në procedurë, nuk ishte informuar në lidhje me procedurat e shfajësimit në përputhje me nenin 137 të KPP-së. Prokurori i apelit u njoftua për vendimin lirues në një datë të papërcaktuar para fundit të shtatorit 1999, kur ankesa e familjes së viktimës për vendimin e shfajësimit iu përcoll autoriteteve të tjera. Më 21 tetor 1999, Gjykata e Rrethit e Durrësit, në mungesë të ankuesit (kërkuesit në këtë rast) dhe në prani të një avokati mbrojtës të emëruar zyrtarisht, pavarësisht nga ekzistenca e një avokati të zgjedhur nga vetë kërkuesi, i dha prokurorit leje për të apeluar jashtë afatit.

Në një datë të pacaktuar, avokati i emëruar zyrtarisht në procedurën para Gjykatës së Rrethit të Durrësit paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Durrësit duke kundërshtuar vendimin e lartpërmendur, sepse kërkuesi nuk ishte njoftuar dhe vendimi nuk i ishte dërguar atij në përputhje me nenin 414 të KPP-së. Ndërkohë, në përputhje me vendimin e Gjykatës së Qarkut të 21 tetorit 1999, prokurori i apelit paraqiti ankesë kundër aktgjykimit lirues.

Më 15 dhjetor 1999, Gjykata e Apelit e Durrësit hodhi poshtë ankesën e avokatit me arsyetimin se vendimi që miratonte kërkesën e prokurorit për leje për të apeluar jashtë afatit nuk ishte objekt i apelimt në bazë të nenit 147.5 të KPP-së, pasi nuk i dha fund procedurës penale. Ajo gjithashtu hodhi poshtë ankesën e prokurorit pasi nuk kishte njoftuar në mënyrë eksplicite parashtruesin në përputhje me nenin 414 të KPP-të. Në një datë të pacaktuar prokurori apeloj në Gjykatën Supreme.

Më 19 prill 2000, Divizioni Penal i Gjykatës së Lartë prishi vendimin e Gjykatës së Apelit të Durrësit të 15 dhjetorit 1999. Ajo gjeti se kërkesat në lidhje me njoftimin e vendimeve gjyqësore avokatit të kërkuesit të caktuar sipas detyrës zyrtare ishin përmbushur që kur kërkuesi u konsiderua në cilësinë e një të arratisuri. Në përputhje me rrethanat, gjykata miratoi kërkesën e prokurorit për leje për të apeluar jashtë afatit kundër vendimit lirues dhe e dërgoi çështjen në Gjykatën e Apelit të Durrësit për një shqyrtim të ri.

Sipas parashtrimeve të prokurorit të apelit në Gjykatën e Apelit të Durrësit, shfajësimi duhej të konsiderohej i pavlefshëm përderisa nuk ishin paraqitur provat e reja, ndërsa edhe provat për një alibi, ishin paraqitur gjithashtu vonë. Për më tepër, prokurori që kishte marrë pjesë në procedurat e shqyrtimit gjyqësor kishte marrë pjesë gjithashtu në gjykimin e parë. Së fundmi, u pretendua se avokati i kërkuesit nuk legjitimohej (standing) për të filluar procedurat për rishikim gjyqësor pasi kërkuesi kishte nënshkruar një formë të autorizimit dy ditë pasi ishte paraqitur kërkesa për shqyrtim gjyqësor.

Më 18 dhjetor 2000, Gjykata e Apelit e Durrësit konfirmoi arsyetimin e parashtruar në vendimin e pafajësisë të 14 dhjetorit 1998 dhe hodhi poshtë ankesën e prokurorit. Avokati i kërkuesit u njoftua për vendimin. Në një datë të paspecifikuar, duke cituar të njëjtat arsye në Gjykatën e Apelit të Durrësit, prokurori apeloj në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se vendimi i pafajësisë ishte i pavlefshëm.

Më 20 qershor 2001 Divizioni Penal i Gjykatës Supreme la në fuqi bazën e apelit të prokurorit dhe, duke vendosur në themel, rrëzoi vendimin e pafajësisë. Ajo konstatoi se kishte pasur shkelje të dispozitave të KPP-së në lidhje me aftësinë ligjore të avokatit të kërkuesit për të paraqitur një kërkesë për rishikim gjyqësor më 11 dhjetor 1997. U konstatua se ai ishte caktuar për të vepruar nga kërkuesi më 13 dhjetor 1997, pra 2 ditë pasi ai e kishte paraqitur kërkesën në Gjykatën e Rrethit. Aktgjykimi iu dorëzua avokatit të caktuar zyrtarisht.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u ankua se vendimi i Gjykatës së Lartë i 20 qershorit 2001, i dhënë pas pafajësisë së tij përfundimtare, përbënte shkelje të së

drejtës së tij për proces të rregullt ligjor dhe se vendimi i pafajësisë, i cili ishte vendim përfundimtar u anulua nga kjo gjykatë. Ai u ankua gjithashtu për faktin se as ai dhe as avokati mbrojtës i zgjedhur prej tij nuk u njoftuan menjëherë për kërkesën e prokurorit për rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë. Ai u bazua në nenet 6.1 dhe 6.3 (a) dhe (c) të Konventës. Kërkuesi më tej u ankua për shkelje të nenit 10, pa ofruar asnjë arsytim. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje se ankesa e kërkuesit për nenin 10 mbetej e paprovuar dhe se ankimi ishte i pabazuar dhe duhet të hidhej poshtë në përputhje me nenin 35 paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Kërkuesi pretendoi gjithashtu se vendimi i Gjykatës së Lartë i 20 qershorit 2001 ka shkelur parimin *ne bis in idem* të parashikuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës dhe duhet të konsiderohet si një gjykim i dyfishtë (gjykim për të dytën herë) për të njëjtën veprë penale.

Në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të nenit 6.1, 6.3 (a) dhe (c) kërkuesi deklaroi se fillimisht atij i ati i caktoi një avokat të vepronte në emër të tij me anë të një autorizimi të nënshkruar më 10 dhjetor 1997. Ky autorizim u bë pjesë e dosjes së çështjes dhe nuk duhet të injorohet nga gjykatat e brendshme në lidhje me procedurat e njoftimit. Ai shtoi se prokurori nuk kishte arsye ligjore (aktivitete të paparashikuara ose *force majeure*) sipas nenit 147.1 të KPP-së për të kërkuar leje për apelim jashtë afatit kohor të përcaktuar kundër vendimit të pafajësisë, i cili ishte vendim përfundimtar, pasi autoritetet ishin të njoftuara për kërkesën për rishikim të gjykimit me anë të letrës së 26 gushtit 1998. Për sa i përket papajtueshmërisë së prokurorit të rrethit, i cili më parë kishte marrë pjesë në procesin që kishte çuar në dënimin e ankuesit në vitin 1996, kërkuesi argumentoi se papajtueshmëria e gjyqtarëve nuk zbatohet për prokurorët, nëse ata merrnin pjesë në procese në të njëjtin nivel gjykimi.

Qeveria parashtroi se kërkesa e prokurorit për leje për apelim jashtë afatit erdhi si rezultat i shkeljeve procedurale nga ana e gjykatës së rrethit, e cila nuk e kishte njoftuar familjen e viktimës për pafajësinë e kërkuesit në mënyrë që ata të mund të kishin të drejtë ankimi kundër vendimit të pafajësisë. Familja e viktimës u vu rastësisht në dijeni të atij vendimi disa muaj më vonë. Sipas mendimit të Qeverisë, një arsye tjetër

që çoi në apelimin e vonuar të prokurorit ishte fakti që prokurori që mori pjesë në seancat gjyqësore të pafajësisë në gjykatën e rrethit nuk i informoi eprorët e tij për proceset në fjalë. Qeveria është e mendimit se përderisa legjislacioni i brendshëm parashikon rishikimin e një vendimi gjyqësor, si dhe procedurën për të kërkuar rivendosje në afat, këto hapa nuk mund të konsiderohen si shkelje e parimit të sigurisë ligjore sipas nenit 6.1 të Konventës.

Qeveria parashtroi se kërkesa ishte e papranueshme, pasi ajo ishte depozituar jashtë afatit. Për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte deklaruar kërkesën e kërkuarit të papranueshme më 26 prill 2002, vendimi i fundit gjyqësor për qëllime të nenit 35 të Konventës, në fakt, është vendimi i Gjykatës së Lartë i 20 qershorit 2001, ndërsa kërkuari e kishte paraqitur kërkesën e tij më 20 shtator 2002. Në përgjigjen e tij, kërkuari parashtroi se apelimi në Gjykatën Kushtetuese është mjet i brendshëm juridik që duhet shteruar brenda rendit të brendshëm ligjor. Si rezultat, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për papranueshmërinë duhet të konsiderohet si vendimi i fundit gjyqësor i brendshëm.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës Gjykata theksoi se konstatimet e saj në vendimin për pranueshmërinë për çështjen *Balliu kundër Shqipërisë* (nr. 74727/01), i respektuar dhe në çështjen *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, (nr. 7352/03, paragrafi 32, 22 gusht 2006), ku ajo vendosi se një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë mund të konsiderohet si mjet efektiv që duhet të përdoret për qëllimet e nenit 35 të Konventës kur u ngritën çështjet që lidhen me një proces të rregullt ligjor. Gjykata mendoi se nuk kishte arsye për të rrëzuar këtë konstatim në rrethanat e çështjes në fjalë, dhe se kërkesa duhej të deklarohet e pranueshme.

Në lidhje me pretendimet e kërkuarit për shkelje të nenit 6.1, 6.3 (a) dhe (c) Gjykata vuri re se në këtë çështje vendimi përfundimtar që e nxjerr të pafajshëm kërkuarin për të gjitha akuzat u rishqyrtua dhe u anulua, duke i dhënë leje prokurorit për të bërë ankim jashtë afatit kundrejt vendimit të pafajësisë (shih, në ndryshim çështjen, *Fadin kundër Rusisë*, nr. 58079/00, paragrafi 34, 27 korrik 2006) dhe kjo pranohet nga të dyja

palët. Çështja që ngrihet është nëse mbi bazën e fakteve të çështjes dhe shqyrtimit të proceseve të rishikimit të vendimit autoritetet realizojnë, në nivelin më të lartë të mundshëm, një baraspeshë ndërmjet interesave të kërkuarit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale, duke respektuar në këtë mënyrë nenin 6. Thelbi i kërkesës së prokurorit për leje për apelim jashtë afatit më 8 tetor 1999 lidhet me shkeljen e garancive procedurale në faktin që pala e dëmtuar, d.m.th. familja e viktimës, nuk ishte njoftuar për vendimin e pafajësisë. Gjykata vuri re se sipas nenit 58.1 të KPP-së, pala e dëmtuar mund ta kërkojë ndjekjen e autorit të veprës dhe dëmshpërblimin. Sipas nenit 409 të KPP-së, pala e dëmtuar mund të bëjë ankesë, ose vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, në lidhje me aspektet penale dhe civile. Gjykata shprehu keqardhjen e saj për faktin se gjykata e brendshme nuk përmbushi kërkesat e njoftimit të parashikuara në nenin 137.1 të KPP-së. Gjithsesi, ajo vuri re se në bazë të dokumenteve të depozituara në dosjen e çështjes, nuk ka tregues që familjes së viktimës t'i jetë dhënë statusi i "palës së dëmtuar". Edhe po të supozohet se familjes së viktimës i është dhënë statusi i "palës së dëmtuar" dhe nëse do të kishte interesa në lidhje me ndonjë aspekt penal ose civil të pretenduar, ata vetë nuk bënë ndonjë ankesë në gjykatën e rrethit, as personalisht dhe as nëpërmjet përfaqësuesit të tyre ligjor. Ata nuk bënë as dhe një kërkesë për lejen për rivendosje në afat ose nuk ndërmorën në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë veprim të nevojshëm nëpërmjet ndihmës së zyrës së prokurorit. Familja e viktimës zgjodhi një tjetër rrugë. Ata depozituan një kërkesë në autoritete të tjera të brendshme, si për shembull në Zyrën e Presidentit të Republikës, autoritete të cilat nuk kishin kompetenca të merrnin asnjë lloj vendimi, përveçse t'ia kalonin ankesën zyrës së prokurorisë. Gjykata nuk e pranon argumentin e Qeverisë se prokurori që mori pjesë në procedurat e shfajësimit, edhe pse kishte marrë pjesë dhe më parë në proceset që kishin përfunduar në dënimin e kërkuarit, nuk kishte njoftuar eprorët e tij, duke çuar kështu në mosdorëzimin e një ankese brenda afateve kohore të parashikuara me ligj. Ajo gjykoi se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë të pandehurit. Me fjalë të tjera, rreziku i ndonjë gabimi të kryer nga autoriteti i prokurorisë, ose edhe nga gjykata, duhet të mbulohet nga shteti; gabimet institucionale nuk duhet t'i vihen barrë individit të përfshirë në çështje (shih më lart *Radchikov kundër Rusisë*, paragrafi 50). Për më tepër, nivelet më të larta në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm ishin të njoftuara për proceset e rishikimit të

vendimit gjyqësor, siç dëshmohej në letrën e 26 gushtit 1998. Situata në të cilën vendimi përfundimtar në favor të parashtruesit u vu në dyshim dhe u rishikua, mund të ishte shmangur nëse zyra e prokurorisë do të kishte bërë një ankesë të zakonshme brenda afatit kohor 10-ditor të parashikuar me ligj. Në çështjen në fjalë zyra e prokurorit dështoi në ushtrimin e së drejtës së saj për depozitim të kërkesës së zakonshme dhe lejoi kalimin e afatit ligjor prej 10 ditësh pa e kundërshtuar vendimin e pafajësisë. Kjo zyre kërkoi leje për rivendosje afati pas më shumë se nëntë muajsh, pasi vendimi në favor të parashtruesit ishte bërë përfundimtar dhe i zbatueshëm dhe pas deklarimit të tij të pafajshëm. Kërkesa e prokurorit nuk përmbante informacion në lidhje me datën kur kishte filluar llogaritja e afatit 10-ditor sipas kuptimit të nenit 147.3 të KPP-së, dhe as Qeveria nuk ka vënë në pah ndonjë rrethanë përjashtimore që do ta kishte parandaluar zyrën e prokurorit nga bërja e një kërkesë të rregullt në një kohë të arsyeshme. Gjykata vlerësoi se argumentet e palëve të përdorura nga prokurori për të justifikuar kërkesën për rivendosje në afat ishin të pamjaftueshme për të justifikuar vënien në pikëpyetje të një vendimi përfundimtar dhe për të përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Gjykata ishte e mendimit se lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendos një baraspeshë ndërmjet interesit të kërkuarit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale. Duke marrë parasysh këto konsiderata, Gjykata ishte e mendimit se duke i dhënë leje prokurorit për rivendosje në afat, Gjykata e Lartë cenoi parimin e sigurisë juridike, të parashikuar në nenin 6.1 të Konventës. Si rezultat, ka pasur shkelje të këtij neni.

Gjykata theksoi se kërkesat e paragrafit 3 të nenit 6 duhet të konsiderohen si aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar në paragrafin 1 (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, *Balliu kundër Shqipërisë*, nr. 74727/01, paragrafi 25, 16 qershor 2005). Në tërësi, Gjykatës i kërkohet të shqyrtonte nëse proceset që çuan në rigjykimin e kërkuarit, ishin të drejta (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, *Vanyan kundër Rusisë*, nr. 53203/99, . 63-68, 15 dhjetor 2005, *Imbrioscia kundër Zvicrës*, vendimi i 24 nëntorit 1993, seritë A nr. 275, . 38 dhe *S.N. kundër Zvicrës*, nr. 34209/96, paragrafi 43, GJEDNJ 2002V).

Duke pasur parasysh gjetjen e shkeljes në lidhje me anulimin e një vendimi përfundimtar sipas nenit 6.1 (shih paragrafin 61 të vendimit në

rastin në fjalë), Gjykata vërejti se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohet nëse në këtë çështje ka pasur cenim të nenit 6.1 në lidhje me nenin 6.3 (a) dhe (c).

Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës, Gjykata konstatoi se vendimi i pafajësisë i 14 dhjetorit 1998 u bë përfundimtar më 24 dhjetor 1998, pasi kundër tij nuk u bë asnjë apel brenda afatit prej dhjetë ditësh të parashikuar në ligj. Në këtë mënyrë, mbetet të përcaktohet nëse proceset që u zhvilluan pas dhënies së lejes për rivendosje në afat konsiderohen si gjykim i dytë ose si rihapje e proceseve të pafajësisë. Sipas mendimit të Gjykatës, neni 4 i Protokollit nr. 7 e bën të qartë dallimin ndërmjet një ndjekjeje ose gjykimi të dytë, i cili ndalohej nga paragrafi i parë i të njëjtit nen, dhe rihapjes së gjykimit në raste përjashtimore, gjë që parashikohet në paragrafin e dytë. Neni 4.2 i Protokollit nr. 7 parashikon shprehimisht mundësinë që një individ duhet ta pranojë ndjekjen për të njëjtat akuza, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, kur një çështje rihapet pas daljes së një prove të re ose pas zbulimit të një defekti thelbësor në proceset e mëparshme (shih *Nikitin*, cituar më lart, paragrafi 45). Legjislacioni shqiptar i lejonte në atë kohë dhe i lejon ende dhe sot secilës prej palëve në proces penal të kërkojë rivendosje në afat, kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 147.1 të KPP-së. Objekti i procesit, pas marrjes së lejes për rivendosje në afat, mbetet e njëjta akuzë penale për të cilën është dënuar ankuesi. Efekti përfundimtar i lejes për rivendosje në afat është që të rihapet procesi, të rrëzohet vendimi i pafajësisë dhe të përcaktohet akuza penale në vendimin e ri. Pra në një farë mënyre ky proces përbën një formë vijimësie të procesit të mëparshëm (shih *Nikitin*, cituar më lart, paragrafi 45). Si rezultat, Gjykata përfundoi se për qëllime të parimit *ne bis in idem*, qëllimi i lejes për rivendosje në afat përbente një përpjekje për të rihapur proceset e mëparshme, dhe jo një “gjykim të dytë”. Përfundimisht, Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 4.1 të Protokollit nr. 7 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës, se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa sipas nenit 6.3 (a) dhe (c) të Konventës, se nuk ka shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës. Gjykata

deklaroi se shteti duhet t'i paguajë kërkuessit, brenda tre muajve nga data kur ky vendim bëhet përfundimtar, 2 000 (dy mijë) euro për dëmet jomateriale, plus çdo taksë që mund të ketë nevojë të paguhet.

2.12. M.S.S. kundër BELGJIKËS DHE GREQISË

[30696/09]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

21 janar 2011

***Çështja kyç/e drejta e pretenduar:** Kushtet e ndalimit dhe të jetesës së azilkërkuessit të dëbuar sipas Rregullores së Dublinit; mangësitë në procedurën e azilit në Greqi dhe rreziku i dëbimit pa ndonjë shqyrtim serioz të meritave të kërkesës për azil ose qasje në mjetet juridike efektive; dëbimi dhe ekspozimi ndaj rreziqeve që lidhen me mangësitë në procedurave të azilit.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga M.S.S një shtetas afgan (kërkuessi) kundër Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Helenike më 11 qershor 2009. Kërkuessi, hyri në Bashkimin Evropian nëpërmjet Greqisë. Në shkurt të vitit 2009 ai mbërriti në Belgjikë, ku kërkoi azil. Në përputhje me Rregulloren e Dublinit, Zyra e të Huajve u kërkoi autoriteteve greke të marrin përgjegjësinë për kërkesën e tij për azil. Në fund të majit 2009, Zyra e të Huajve urdhëroi kërkuessin të largohej nga vendi për në Greqi. Kërkuessi paraqiti një kërkesë në procedurë jashtëzakonisht urgjente për të pezulluar ekzekutimin e atij urdhri, por kërkesa e tij u refuzua. Më 4 qershor 2009, autoritetet greke dërguan një dokument standard që konfirmonte se ishte përgjegjësia e tyre për të shqyrtuar kërkesën për azil dhe duke deklaruar se kërkuessi do të ishte në gjendje të aplikonte për azil pas mbërritjes në vend. Ai u kthye në Greqi më 15 qershor 2009. Me të mbërritur atje ai u dërgua menjëherë në paraburgim për katër ditë në një godinë pranë aeroportit, ku kushtet e paraburgimit dyshohet se ishin të tmerrshme. Më 18 qershor 2009 ai u lirua dhe iu dha një kartë azilkërkuessi dhe njoftimi për t'u paraqitur në selinë e policisë për të

regjistruar adresën ku mund të kontaktohej për më të rejat në lidhje me kërkesën e tij për azil. Kërkuesi nuk u paraqit në selinë e policisë. Duke mos pasur mjete jetese, ai jetonte në rrugë. Më pas, teksa po tentonte të largohej nga Greqia, ai u arrestua dhe u ndalua për një javë në pallatin ngjitur me aeroportin, ku dyshohet se u rrah nga policia. Pas lirimit, ai vazhdoi të jetonte në rrugë. Kur karta e tij e azilkërkuesit u ripërtëri në dhjetor 2009, u ndërmorën hapa për t'i gjetur strehim, por pa sukses.

Përmbledhja e pretendimeve

Pretendimet kundër Greqisë

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 3 të Konventës nga Greqia për shkak të kushteve të ndalimit. Parashtruesi u ankua për dy periudhat e ndalimit - e para nga 15-18 qershor 2009, pas mbërritjes së tij në aeroportin ndërkombëtar të Athinës, dhe e dyta, nga 01-07 gusht 2009, pas arrestimit të tij në aeroport. Ai pretendoi se kushtet e ndalimit në qendrën pranë aeroportit ndërkombëtar të Athinës ishin aq të tmerrshme sa përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës. Kërkuesi përshkroi kushtet e tij të paraburgimit si vijon: ai kishte qenë i mbyllur në një dhomë të vogël me njëzet persona të tjerë, lejoheshin të shkonin në tualete vetëm kur rojet ua lejonin, nuk ishin lejuar jashtë në ajër të hapur, u ishte dhënë shumë pak për të ngrënë dhe kishte fjetur në një dyshek të pistë, ose në dyshemenë e zhveshur. Ai më tej pretendoi se gjatë periudhës së dytë të ndalimit ishte rrahur nga rojet. Kërkuesi pretendoi se kushtet e ndalimit të tij në aeroportin ndërkombëtar të Athinës përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës.

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 3 të Konventës nga Greqia për shkak të kushteve të jetesës së azilkërkuesit duke theksuar se, gjendja e varfërisë ekstreme në të cilën ai kishte jetuar pasi kishte mbërritur në Greqi përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës brenda kuptimit të nenit 3. Ai pretendoi se, autoritetet greke nuk i kishin dhënë atij asnjë informacion në lidhje me strehimin e mundshëm dhe nuk i kishin ofruar atij asnjë lloj ndihme për jetesën edhe pse ata ishin të vetëdijshëm për situatën e pasigurt të azilkërkuesve në përgjithësi dhe çështjen e tij në veçanti. Ai parashtrroi se nuk i ishte dhënë asnjë broshurë informative

në lidhje me procedurën e azilit dhe se ai u kishte thënë autoriteteve disa here që ishte i pastrehë.

Kërkuesi pretendoi edhe shkelje nga ana e Greqisë të nenit 13 në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës, për shkak të mangësive në procedurën e azilit. Ai pretendoi se ai nuk kishte përfituar në të drejtën greke nga një mjet efektiv në lidhje me pretendimet e tij në bazë të neneve 2 dhe 3, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës.

Pretendimet kundër Mbretërisë së Belgjikës

Kërkuesi pretendoi shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës nga ana e Belgjikës për shkak të ekspozimit të tij ndaj rreziqeve që rrjedhin nga mangësitë në procedurën e azilit në Greqi. Ai pretendoi se, me dërgimin e tij në Greqi sipas Rregullores së Dublinit, kur ata ishin të vetëdijshëm për mangësitë në procedurën e azilit në Greqi dhe nuk e kishin vlerësuar rrezikun me të cilin ai do të ballafaqohej, autoritetet belge kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës. Tutje, kërkuesi parashtroi se, në kohën e dëbimit të tij autoritetet belge kishin pasur dijeni për mangësitë e procedurës së azilit në Greqi dhe se, kërkesa e tij për azil kishte pak shanse për t'u marrë në shqyrtim seriozisht nga autoritetet greke, duke e vënë atë përballë rrezikut të kthimit në vendin e tij të origjinës. Përveç raporteve të shumta ndërkombëtare tashmë të botuara në kohën e dëbimit të tij, avokati i tij e kishte shpjeguar në mënyrë të qartë situatën në lidhje me shkeljen sistematike të të drejtave themelore të azilkërkuesve në Greqi. Ai e kishte bërë këtë në mbështetje të ankimit drejtuar Këshillit të Mosmarrëveshjeve për të Huajt më 29 maj 2009 dhe të ankimit drejtuar Dhomës së Aktakuzave të Gjykatës së Apelit të Brukselit më 10 qershor 2009. Kërkuesi e konsideroi argumentin e autoriteteve belge se ai nuk mund të pretendojë të ketë qenë viktimë e mangësive në sistemin e azilit grek para se të arrinte në Belgjikë, si të pavend. Për më tepër provat formale të kësaj nuk mund të paraqiten *in abstracto* dhe para se rreziku të ishte materializuar, andaj autoritetet belge duhet të kishin marrë në konsideratë situatën e përgjithshme dhe të mos rrezikonin duke e kthyer.

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 3 të Konventës nga Belgjika për ekspozimin e kërkuesit ndaj kushteve të ndalimit dhe kushteve të jetesës në kundërshtim me nenin 3. Ai pretendoi se për shkak të kushteve të ndalimit dhe të jetesës, në të cilat gjendeshin azilkërkuesit në Greqi, duke e kthyer atë në atë vend, në zbatim të rregullores së Dublinit, autoritetet belge e kishin ekspozuar ndaj trajtimit të ndaluar sipas nenit 3 të Konventës. Gjithashtu, kërkuesi pretendoi edhe shkelje nga Belgjika të nenit 13 në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës për shkak të mungesës së një mjeti efektiv kundër urdhrin të dëbimit. Në lidhje me këtë ai pohoi se nuk kishte asnjë mjet të parashikuar në të drejtën belge, siç kërkohet sipas nenit 13 të Konventës, për t'u ankuar në lidhje me shkeljet e pretenduara të neneve 2 dhe 3 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve të kërkuesit në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 3, Gjykata vlerësoi:

(a) Kushtet e ndalimit në Greqi – Vështirësitë e shkaktuara nga numri në rritje i migrantëve dhe azilkërkuesve nga shtetet përreth kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian nuk i lirojnë shtetet nga detyrimet e tyre në lidhje me nenin 3. Sipas marrëveshjes së tyre të 4 qershorit 2009 për të marrë përgjegjësinë për kërkuesin, autoritetet greke kishin qenë në dijeni të identitetit të kërkuesit dhe statusit të tij si azilkërkues i mundshëm. Përkundër kësaj, ai ishte vendosur menjëherë në paraburgim pa shpjegime, praktikë kjo e përhapur sipas raporteve të ndryshme të prodhuara nga organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare. Ai kishte përjetuar kushte të këqija të paraburgimit dhe brutalitet dhe fyerje nga oficerët e policisë në qendrën e paraburgimit, edhe pse këto kushte tashmë ishin konstatuar si trajtim degradues, sepse viktimat ishin azilkërkues. Sado të shkurtra, periudhat që kërkuesi kishte kaluar në paraburgim nuk mund të konsideroheshin të parëndësishme. Të marra së bashku, ndjenja e arbitraritetit dhe ndjenja e inferioritetit dhe ankthit të shoqëruar shpesh me të, si dhe efekti i thellë që pa dyshim që kushte të tilla të paraburgimit kishin në dinjitetin e një personi, përbënin një trajtim poshtërues. Përveç kësaj, shqetësimi i kërkuesit ishte theksuar nga brishtësia e natyrshme në situatën e tij si azilkërkues. Gjykata konstatoi njëzëri se ka shkelje.

(b) Kushtet e jetesës në Greqi – Pavarësisht nga detyrimet që u ngarkohen autoriteteve greke sipas legjislacionit të tyre dhe Direktivës së Pritjes të Bashkimit Evropian, kërkuesi kishte jetuar për muaj të tërë në varfërinë më të tmerrshme, pa ushqim dhe strehë. Ai gjithashtu jetoi në frikë të vazhdueshme se mos sulmohej dhe grabitej, pa asnjë perspektivë që situata e tij do të përmirësohej. Kjo shpjegon se pse ai kishte tentuar të largohej nga Greqia në më shumë se një rast. Tregimi i tij për kushtet e tij të jetesës u vërtetua nga raportet e organizatave dhe organeve të ndryshme ndërkombëtare. Në asnjë moment kërkuesi nuk ishte informuar siç duhet për mundësitë e akomodimit që i kishte në dispozicion. Autoritetet nuk mund të mos ishin në dijeni se kërkuesi ishte i pastrehë dhe nuk duhej të prisnin që ai të merrte iniciativën për t'u raportuar në selinë e policisë për të siguruar nevojat e tij themelore. Kjo situatë kishte zgjatur që nga transferimi i tij në qershor 2009, megjithëse autoritetet mund të kishin shkurtuar ndjeshëm vuajtjet e tij duke shqyrtuar menjëherë kërkesën e tij për azil. Kështu ata nuk kishin marrë parasysh brishtësinë e kërkuesit si azilkërkues dhe duhet të mbahen përgjegjës – për shkak të mosveprimit dhe dështimit të tyre për të procesuar kërkesën e tij për azil – për kushtet që ai duhej të duronte për shumë muaj. Kushtet e jetesës së kërkuesit, të kombinuara me pasigurinë e zgjatur në të cilën ai jetonte dhe mungesën totale të ndonjë perspektive për përmirësimin e situatës së tij, kishin arritur nivelin minimal të ashpërsisë së kërkuar nga neni 3 i Konventës. Gjykata, me gjashtëmbëdhjetë vota për dhe një kundër, konstatoi shkelje.

(c) Transferimi i parashtruesit nga Belgjika në Greqi – Duke pasur parasysh se, ndërkohë që kërkesa e kërkuesit për azil ishte ende në pritje, raportet e prodhuara nga organizatat dhe organet ndërkombëtare jepnin të gjitha përshtime të ngjashme të vështirësive praktike të ngritura nga aplikimi i sistemit të Dublinit në Greqi, dhe Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët kishte paralajmëruar Qeverinë belge për situatën atje, autoritetet belge duhet të kenë qenë në dijeni të mangësive në procedurën e azilit në Greqi kur ishte lëshuar urdhri i dëbimit kundër tij, dhe nuk duhej të pritej që kërkuesi të mbajë të gjithë barrën e provës në lidhje me rreziqet me të cilat përballej duke u ekspozuar ndaj asaj procedure. Belgjika fillimisht kishte urdhëruar dëbimin vetëm në bazë të një marrëveshjeje të heshtur nga autoritetet greke dhe kishte vazhduar me zbatimin e masës pa dhënë asnjë garanci

individuale nga autoritetet greke, kur ato mund të kishin refuzuar lehtësisht transferimin. Autoritetet belge nuk duhet thjesht të kishin supozuar se kërkuesi do të trajtohej në përputhje me standardet e Konventës; ata duhet të kishin verifikuar se si autoritetet greke zbatonin legjislacionin e tyre për azilin në praktikë; por ata nuk e kishin bërë këtë. Gjykata konstatoi shkelje me gjashtëmbëdhjetë vota për dhe një kundër.

(d) Vendimi i autoriteteve belge për të ekspozuar kërkuesin ndaj kushteve të paraburgimit dhe kushteve të jetesës që mbizotëronin në Greqi – Gjykata kishte konstatuar tashmë se kushtet e paraburgimit të kërkuesit dhe kushtet e jetesës në Greqi ishin degraduese. Kushtet në fjalë kishin qenë të dokumentuara mirë dhe lehtësisht të verifikueshme në burime të shumta përpara transferimit të kërkuesit. Duke qenë kështu, duke e çuar kërkuesin në Greqi, autoritetet belge e kishin ekspozuar me vetëdije ndaj kushteve të paraburgimit dhe të jetesës që përbënin trajtim degradues. Gjykata konstatoi shkelje me pesëmbëdhjetë vota për dhe dy kundër.

Neni 13 i marrë së bashku me nenin 3 për shkak të mangësive në shqyrtimin nga autoritetet greke të kërkesës për azil të parashtruesit dhe rrezikut që ai përballej për t'u larguar drejtpërdrejt ose indirekt përsëri në vendin e tij të origjinës pa ndonjë shqyrtim serioz të themelit të kërkesës së tij dhe pa pasur qasje në mjet efektiv juridik. Gjykata konstatoi njëzëri shkelje.

(b) Në lidhje me Belgjikën – Gjykata konstatoi se procedura jashtëzakonisht urgjente nuk plotësonte kërkesat e praktikës gjyqësore të Gjykatës, sipas së cilës çdo ankesë se dëbimi në një vend tjetër do ta ekspozonte një individ ndaj trajtimit të ndaluar nga neni 3, duhet të shqyrtohet nga afër dhe me rigozitet, dhe organi kompetent duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë thelbin e ankesës dhe të ofrojë kompensimin e duhur. Duke qenë se shqyrtimi i rasteve nga Bordi i Apelit për të Huajt ishte kryesisht i kufizuar në verifikimin nëse personat në fjalë kishin paraqitur prova konkrete të dëmit të riparueshëm që mund të rezultonte nga shkelja e mundshme e pretenduar e nenit 3, ankimi i kërkuesit nuk do të kishte pasur asnjë shans për sukses. Gjykata konstatoi njëzëri shkelje.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës nga ana e Greqisë, se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës për sa i përket kushteve të jetesës së parashtruesit në Greqi; deklaroi njëzëri të pranueshme kërkesën kundër Greqisë sipas nenit 13 të shqyrtuar në lidhje me nenin 3 të Konventës; se ka pasur shkelje nga ana e Greqisë të nenit 13 të shqyrtuar në lidhje me nenin 3 të Konventës për shkak të mangësive në procedurën e azilit, së cilës i ishte nënshtruar ai dhe rrezikut të kthimit të tij në Afganistan pa një shqyrtim paraprak në themel të kërkesës së tij për azil dhe pa qasje në mjete juridike efektive; vendosi se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet të bazuara në nenin 13 të marrë në lidhje me nenin 2 të Konventës; vendosi se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës nga Belgjika për shkak të transferimit të kërkuarit në Greqi, se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e bazuara në nenin 2 të Konventës; vendosi, se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës nga Belgjika për shkak të transferimit të parashtruesit në Greqi, pasi duke bërë kështu e kishin ekspozuar atë ndaj kushteve të ndalimit dhe jetesës në atë shtet të cilat ishin në kundërshtim me Konventën; vendosi se ka pasur shkelje nga ana e Qeverisë belge të nenit 13 të shqyrtuar në lidhje me nenin 3 të Konventës; vendosi se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e bazuara në nenin 13 të marrë në lidhje me nenin 2 të Konventës; Pa paragjykuar masat e përgjithshme të kërkuara për të parandaluar shkelje të tjera të ngjashme në të ardhmen, Greqia duhej të vazhdonte, pa vonesë, me shqyrtimin e themelit të kërkesës për azil të parashtruesit në përputhje me kërkesat e Konventës dhe, në pritje të rezultatit të atij shqyrtimi, të përmbahet nga dëbimi i kërkuarit. Greqia dhe Belgjika duhet t'i paguanin kërkuarit përkatësisht, 1,000 (një mijë) dhe 24,900 (njëzet e katër mijë e nëntëqind) euro për dëmin jomaterial si dhe shpenzimet tjera të përcaktuara në këtë vendim.

2.13. MORICE kundër FRANCËS

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

23 prill 2015

[29369/10]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: gjykimi për shpifje përbënte ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe jo “e nevojshme në një shoqëri demokratike”; shkelje e së drejtës në gjykim nga një gjykatë e paanshme për shkak se në përbërje të trupit gjykues kishte qenë një gjyqtare e cila kishte shprehur paraprakisht dhe publikisht mbështetjen e saj për një nga palët civile; shkelje e lirisë së shprehjes për shkak të dënimit penal

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga një avokat francez, Olivier Morice (kërkuesi) kundër Republikës së Francës. Më 1995 Bernard Borrel, një gjyqtar i cili ishte dërguar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Francës dhe Xhibutit, si këshilltar i Ministrit të Drejtësisë së Xhibutit, u gjet i vdekur. Hetimi nga xhandarmëria e Xhibutit arriti në përfundimin se ai kishte kryer vetëvrasje. E veja e tij, znj. Borrel, e cila ishte gjithashtu gjyqtare kundërshtoi konstatimin e vetëvrasjes, dhe paraqiti një ankesë si palë civile. Ajo caktoi kërkuesin që ta përfaqësonite atë dhe fëmijët e saj të mitur në procedurë. U hapën dy hetime gjyqësore në lidhje me vrasjen me paramendim të kryer nga një person ose persona të panjohur. Hetimi gjyqësor iu caktua dy gjyqtarëve hetues M. dhe L.L në Tribunalin e Instancës së Lartë të Tulusë (*Toulouse Tribunal de Grand Instance* (TGI)). Në qershor 2000, Divizioni i Aktakuzave i Gjykatës së Apelit i hoqi dy gjyqtarë nga çështja për shkak të akuzave për parregullsi gjatë procesit të hetimeve, në veçanti, për shkak të dështimeve gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari, si dhe për shkak të shkeljeve të të drejtave të personave civilë gjatë organizimit të vizitave në vendin e ngjarjes. Rasti iu transferua një gjyqtari të ri hetues, gjyqtarit P.

Ndërkohë, Ministri i Drejtësisë i referoi Komisionit Kombëtar të Shërbimit Ligjor (Conseil supérieur de la magistrature – “CSM”), në

cilësinë e bordit disiplinor për gjyqtarët, disa veprime të njërit prej gjyqtarëve hetues (gjyqtarja M.) në çështjen Borrell. Veprimet për të cilat u ankua bazoheshin në një rast tjetër të njohur si rasti ‘Scientology’ që gjyqtarja M. dyshohet se e kishte keqmenaxhuar. Ndaj gjyqtares nuk u mor asnjë masë disiplinore, edhe pse ajo u qortua. Gjyqtari i ri hetues P. i bëri një kërkesë ish-gjyqtares, ndaj së cilës ishte ngritur akuza disiplinore për një video në lidhje me çështjen Borell. Në përgjigje ai mori një letër, në të cilën ish-gjyqtarja hetuese M. deklaronte se Morice dhe klientja e tij znj. Borrel ishin duke kryer një manipulim. Pjesë të kësaj letre u botuan më vonë në një artikull në gazetën “Le Monde”, i cili nxiti dy ish-gjyqtarët hetues të bënin një kallëzim penal për shpifje të një zyrtari publik, kundër drejtorit të botimit të “Le Monde”, gazetarit që kishte shkruar artikullin dhe z. Morice.

Gjykata Penale e Nanterres i shpalli fajtorë të pandehurit (drejtorin e botimit të Le Monde, gazetarin që kishte shkruar artikullin dhe z. Morice) për shpifje ndaj një zyrtari publik dhe i dënoi ata me gjobë. Në vitin 2003, Gjykata e Apelit e Versajës la në fuqi dënimet. Në vitin 2004, Gjykata e Kasacionit e prishi vendimin në tërësi dhe ia ktheu çështjen Gjykatës së Apelit në Rouen, e cila katër vjet më vonë në vitin 2008 gjithashtu la në fuqi dënimet. Kështu Morice dhe dy të bashkëpandehurit parashtruan një ankesë për çështje ligjore kundër atij aktgjykimi në GJEDNJ.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u mbështet, fillimisht, në nenin 10 të Konventës dhe në imunitetin e parashikuar në nenin 41 të Aktit për Lirinë e Shtypit, duke argumentuar se kjo dispozitë synonte të mbronte të drejtat e mbrojtjes dhe të mbronte avokatët në lidhje me thëniet e tyre ose komentet me shkrim të bëra në kontekstin e çdo lloj procesi gjyqësor, veçanërisht të një natyre disiplinore. Në lidhje me nenin 10 të Konventës, kërkuesi pohoi se: komentet në këtë rast kishin të bënin me një rast që kishte kohë që po mbulohej mediatikisht për shkak të rrethanave të dyshimta në të cilat një gjyqtar francez në Xhibuti u gjet i vdekur dhe mënyrës së dyshimtë, në të cilën ishte kryer hetimi gjyqësor. Kërkuesi argumentoi se Gjykata e Apelit nuk kishte të drejtë të konstatonte se ai kishte tejkalluar kufijtë e lirisë së tij të shprehjes, pasi nuk e kishte shqyrtuar mirëbesimin e tij në dritën e komenteve që ishin botuar në “Le Monde”,

por në lidhje me përmbajtjen e letrës drejtuar Ministrit të Drejtësisë. Më tej, kërkuesi argumentoi se nëse të gjithë avokatët do të ndaloheshin të flisnin për çështjet në pritje, asnjë armiqësi personale nuk mund të nxirret nga fakti i thjeshtë se ai kishte pasur një mosmarrëveshje me një nga gjyqtarët në kontekstin e veprimeve procedurale.

Para Dhomës së Madhe, kërkuesi argumentoi se dënimi i tij penal kishte sjellë shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes, siç parashikohet nga neni 10 i Konventës. Ai theksoi se praktika gjyqësore e vetë Gjykatës bazohet në mbrojtje të fortë për lirinë e shprehjes së avokatëve dhe se e drejta e avokatëve për të bërë deklarata për shtyp si pjesë e mbrojtjes së klientëve të tyre ishte pranuar shprehimisht. Ai gjithashtu vuri në dukje se në parim, në nivel evropian ekzistonte një tolerancë e konsiderueshme ndaj kritikave të avokatëve ndaj gjyqtarëve, edhe kur ato bëhen në një mjedis publik dhe mediatik. U argumentua se avokatëve duhet t'u sigurohet një mbrojtje funksionale që nuk kufizohet vetëm në sallën e gjyqit dhe të jetë sa më e gjerë, në mënyrë që të kontribuojnë efektivisht në mbrojtjen e klientëve të tyre dhe në informimin e publikut. Ai më tej parashittoi se Dhoma e Pestë kishte vendosur gabimisht në të njëjtën bazë lirinë e shprehjes së avokatëve dhe të drejtën e publikut për t'u informuar për çështje me interes të përgjithshëm, si dhe dinjitetin e profesionit ligjor dhe reputacionin e mirë të gjyqtarëve. Ai argumentoi se të parat ishin të drejta të garantuara nga neni 10 i Konventës, ndërsa të dytat ishin thjesht interesa që mund të kërkonin një kufizim, i cili duhej të mbetej i jashtëzakonshëm.

Ndërhyja e palëve të treta në këtë çështje para Dhomës së Madhe

Këshilli i Avokatëve dhe Shoqatave të Avokatëve të Evropës (CCBE) deklaroi se rasti në fjalë kishte të bënte me lirinë e shprehjes jashtë sallës së gjyqit dhe çdo kufizim duhej të merrte parasysh faktin se në çështje të ndjeshme dhe të profilit të lartë, avokatët shpesh nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të flasin publikisht për të shprehur shqetësimet për çështjet në lidhje me mbarëvajtjen e duhur të procedurave. Kësisoj, CCBE ishte i mendimit se në raste të tilla, avokatët duhet të kenë të njëjtën liri të fjalës dhe shprehjes si gazetarët, pasi kufizimi i lirisë së tyre të shprehjes, veçanërisht kur procedurat ishin pjesë e një sistemi inkuizitor si në Francë, i pengon ata të sigurojnë besimin e publikut dhe kontributin

në administrimin e duhur të drejtësisë. Dhoma e Avokatëve të Parisit, Këshilli Kombëtar i Avokatëve dhe Konferenca e Kryetarëve të Avokatëve Francez së bashku theksuan se deri vonë çështja e lirisë së fjalës së një avokati ishte ngritur vetëm brenda sallës së gjyqit ku avokati mbrohej me imunitet nga proceset ligjore. Ky imunitet mbronte edhe vërejtjet që mund të konsideroheshin fyese dhe shpifëse ose dëmtuese. Ata mendonin se çështja në rastin në fjalë ishte liria e shprehjes së avokatit për të mbrojtur klientin e tij kur i drejtohej shtypit dhe si të përcaktonte se kur ose nëse komentet u bënë të tepërta nëse ato preknin një kundërshtar, një gjyqtar ose një koleg avokat. Ata argumentuan para Gjykatës se dallimi midis shprehjes gjyqësore dhe jashtëgjyqësore ishte vjetërsuar dhe se fjala e një avokati, në fakt, bazohej në detyrën për të informuar, kështu që, ashtu si gazetarët, edhe avokatët ishin “vëzhgues të demokracisë”. Të gjitha palët e treta ishin të mendimit se avokatëve duhet t’u jepej imunitet kur komentet e tyre, sado të tepruara, ishin të lidhura me mbrojtjen e interesave të klientit të tyre dhe çdo kufizim në të drejtën për të shprehur pikëpamjet e tyre, duhet të konsiderohej i jashtëzakonshëm.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata rikujtoi parimet e përgjithshme në lidhje me lirinë e shprehjes, duke theksuar më pas se në ushtrimin e juridiksionit të saj mbikëqyrës, Gjykata duhet të shikojë ndërhyrjen në lirinë e shprehjes në dritën e kërkesës së çështjes në tërësi dhe të përcaktojë nëse ajo ishte “në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur”, dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për të justifikuar a janë “të arsyeshme dhe të mjaftueshme”. Në këtë mënyrë, Gjykata duhet të sigurohet se autoritetet kombëtare kanë aplikuar standarde të cilat ishin në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 10 dhe, për më tepër, autoritetet u mbështeten në një vlerësim të pranueshëm të fakteve. Gjykata theksoi se, në kuptim të nenit 10 të Konventës, ajo duhet të marrë parasysh rrethanat dhe sfondin e përgjithshëm në të cilin janë bërë deklaratat në fjalë (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, *Lingens*, paragrafi 40 dhe *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë* [DHM], nr. 21980/93, paragrafi 62, GJEDNJ 1999 deri në III).

Në lidhje me ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit, Gjykata theksoi se shprehja “autoriteti i gjyqësorit” përfshin, në veçanti, nocionin se

gjykatat janë pranuar nga publiku i gjerë si forumi i duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore dhe për përcaktimin e fajësisë së një personi apo pafajësisë në një vepër penale; duke shtuar, që publiku i gjerë duhet të ketë respekt dhe besim në kapacitetin e gjykatave për të përmbushur këtë funksion (shih *Worm kundër Austrisë*, 29 gusht 1997, paragrafi 40, Raporte 1997-V, dhe *Prager dhe Oberschlick*). Sipas Gjykatës, ajo që është në rrezik është siguria, me të cilën gjykatat në një shoqëri demokratike, duhet të frymëzojnë jo vetëm të akuzuarin, për aq sa u përket procedurave penale (shih *Kyprianou*, paragrafi 172), por edhe publikun e gjerë, (shih *Kudeshkina kundër Ruisë*, nr. 29492/05, paragrafi 86, 26 shkurt 2009, dhe *Di Giovanni*). Megjithatë, duke pasur parasysh se gjyqtarët janë pjesë e një institucioni themeltar të shtetit, ata mund të jenë, si të tillë, objekt i kritikave personale brenda kufijve të lejuar, dhe jo vetëm në mënyrë teorike dhe të përgjithshme (shih *July dhe SARL Libération*, paragrafi 74). Kur veprojnë në cilësinë e tyre zyrtare, ata në këtë mënyrë, mund të jenë subjekte që pranojnë një numër më të madh kritikash se një qytetar i zakonshëm (shih veçanërisht *July dhe SARL Libération*).

Në lidhje me statusin dhe lirinë e shprehjes së Avokatëve, Gjykata theksoi se statusi i veçantë i avokatëve u jep atyre një pozicion qendror në administrimin e drejtësisë, si ndërmjetës midis publikut dhe gjykatave. Prandaj, ata luajnë një rol të rëndësishëm për të siguruar që gjykatat, misioni i të cilave është thelbësor në një shtet të bazuar në sundimin e ligjit, të gëzojnë besimin e publikut (shih *Schöpfer kundër Zvicrës*, 20 maj 1998, paragrafët 29-30, Raporte 1998-III; *Nikula kundër Finlandës*, nr. 31611/96, paragrafi 45, GJEDNJ 2002-II; *Amihalachioaie kundër Moldavisë*, nr. 60115/00, paragrafi 27, GJEDNJ 2004-III; *Kyprianou* paragrafi 173; *André dhe të tjerë kundër Francës*, nr. 18603/03, paragrafi 42, 24 korrik 2008; dhe *Mor*, paragrafi 42). Megjithatë, për anëtarët e publikut që të kenë besim në administrimin e drejtësisë, duhet që të kenë besim në aftësinë e profesionistit ligjor për të siguruar përfaqësim efektiv (shih *Kyprianou*, paragrafi 175). Roli i veçantë i avokatëve, si profesionistë të pavarur, në administrimin e drejtësisë përfshin një numër detyrash, veçanërisht në lidhje me sjelljen e tyre (shih *Van der Musselle kundër Belgjikës*, 23 nëntor 1983, Seria A nr. 70; *Casado Coca kundër Spanjës*, 24 shkurt 1994, paragrafi 46, Seria A nr. 285-A; *Steur kundër Holandës*, nr. 39657/98, paragrafi 38, GJEDNJ 2003-XI; *Veraart*

kundër Holandës, nr. 10807/04, paragrafi 51, 30 nëntor 2006; dhe *Coutant kundër Francës* (vendim), nr. 17155/03, 24 janar 2008). Ndërsa ata u nënshtrohen kufizimeve në sjelljen e tyre profesionale, e cila duhet të jetë e matur, e ndershme dhe dinjitoze, ata gjithashtu gëzojnë të drejta dhe privilegje të veçanta që mund të ndryshojnë nga një juridiksion në tjetrin. Rrjedhimisht, liria e shprehjes është e zbatueshme edhe për avokatët.

Gjykata vërejtë se kërkuesi ishte dënuar penalisht me një gjobë për të paguar dëmet dhe shpenzimet, për shkak të vërejtjeve të tij lidhur me procedurat në rastin *Borrel*, të publikuara në një artikull në të përditshmen “Le Monde”, e cila përmbante tekstin e një letre dërguar nga parashtruesi dhe kolegu i tij te Ministri i Drejtësisë, ku kërkohet një hetim administrativ, si dhe deklaratat që i kishte bërë gazetarit që shkroi artikullin. Gjykata vërejtë që në fillim se ajo nuk po shqyrtonte mosmarrëveshjen ndërmjet palëve, nëse dënimi penal i kërkuesit përbën një ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës së tij për lirinë e shprehjes, siç garantohet me nenin 10 të Konventës. Ky është gjithashtu opinionin e Gjykatës. Më tej vërejtë se ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj, përkatësisht nga nenet 23, 29 dhe 31 të Ligjit të 29 korrikut 1881. Palët ranë dakord gjithashtu se qëllimi i ndërhyrjes ishte mbrojtja e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve. Gjykata nuk pa ndonjë arsye për të pranuar një pikëpamje të ndryshme. Ndërkohë që kërkuesi dëshironte të saktësonte që procedura kundër tij synonte edhe të “ruajë autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”, kjo çështje kishte të bënte me “nevojën” për ndërhyrje, dhe nuk mund të ndikonte në faktin që ishte ndjekur të paktën një nga “qëllimet legjitime” të mbuluara nga paragrafi 2 i nenit 10. Prandaj mbeti për t’u shqyrtuar nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, dhe kjo kërkonte që Gjykata të konstatojë nëse ishte proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e dhëna nga gjykatat e brendshme ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme.

Në rastin konkret, sfondi mund të shpjegohet jo vetëm me sjelljen e gjyqtarëve hetues dhe nga marrëdhëniet e parashtruesit me një prej tyre, por edhe nga historia shumë e veçantë e rastit, nga dimensionin e saj ndërshtetëror dhe mbulimi i konsiderueshëm nga mediat. Në dënimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit kishte marrë mendimin se fakti i thjeshtë i

pohimit se sjellja e një gjyqtari hetues ishte “plotësisht në kundërshtim me parimet e paanshmërisë dhe drejtësisë”, ishte një akuzë veçanërisht shpifëse.

Kështu, Gjykatës së Apelit iu kërkua të shqyrtonte vërejtjet e kundërshtuara, duke marrë parasysh plotësisht sfondin e çështjes dhe përmbajtjen e letrës, të marra në tërësi. Përdorimi i termit “pajtueshmëri” nuk mund të përbëjë “në vetvete” një sulm serioz ndaj nderit dhe reputacionit të gjyqtarit M. dhe prokurorit publik të Xhibutit. Për më tepër, deklaratat e kërkuarit nuk mund të reduktohen në shprehjen e thjeshtë të një marrëdhënieje antagoniste me gjyqtarin M. Vërejtjet e kundërshtuara ishin pjesë e një iniciative të përbashkët profesionale nga dy avokatë, për shkak të fakteve të reja, të vërtetuara dhe që ishin në gjendje të zbulonin mangësi serioze në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë dy gjyqtarët që kishin kryer më parë hetimin në një rast, në të cilin klientët e avokatëve ishin palë civile. Ndërsa vërejtjet e kërkuarit sigurisht kishin një kuptim negativ, duhej theksuar se, pavarësisht nga natyra dhe serioziteti i tyre disi armiqësor, pyetja kryesore në deklaratat kishte të bënte me funksionimin e një hetimi gjyqësor, i cili ishte një çështje me interes publik, duke lënë kështu pak hapësirë për kufizime në lirinë e shprehjes. Për më tepër, një avokat duhet të jetë në gjendje të tërheqë vëmendjen e publikut ndaj mangësive të mundshme në sistemin e drejtësisë dhe gjyqësori mund të përfitojë nga kritika konstruktive.

Sa i përket ruajtjes së autoritetit të gjyqësorit, Gjykata theksoi se gjyqtarët M. dhe L.L ishin anëtarë të gjyqësorit dhe për këtë arsye iu nënshtruan kufijve më të gjerë të kritikës së pranueshme sesa qytetarët e zakonshëm dhe komentet e kundërshtuara mund të drejtohen kundër tyre në atë cilësi. Për më tepër, vërejtjet e kërkuarit nuk ishin në gjendje të minonin zhvillimin e duhur të procedurave gjyqësore, duke pasur parasysh faktin se gjykata më e lartë e kishte tërhequr çështjen nga dy gjyqtarët hetues të përfshirë nga kritikën për të njëjtat arsye, dhe duke marrë parasysh sa më sipër, dënimi i kërkuarit nuk mund të shërbejë për të ruajtur autoritetin e gjyqësorit.

Vërejtjet e kundërshtuara të kërkuarit nuk kishin përbërë sulme të rënda dhe thelbësisht të pabazuara ndaj veprimeve të gjykatave, por

kritika të bëra ndaj gjyqtarëve M. dhe LL, si pjesë e një debati mbi një çështje me interes publik në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë, dhe në kuadrin e një rasti i cili kishte marrë mbulim të gjerë mediatik që në fillim. Ndërsa ato vërejtje mund të konsideroheshin si të ashpra, ato megjithatë përbënin gjykime me vlerë me një “bazë faktike” të mjaftueshme. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstatoi se gjykimi kundër kërkuesit për bashkëpunim në shpifje mund të konsiderohet si një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes dhe nuk ishte «i nevojshëm në një shoqëri demokratike» brenda kuptimit të nenit 10 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6.1, nenit 10 të Konventës dhe bazuar në nenin 41, vendosi që shteti duhet t’i paguajë parashtruesit 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në lidhje me dëmin jomaterial; 270 (dyqind e shtatëdhjetë) euro në lidhje me dëmin material.

2.14. KYPRIANOU kundër QIPROS

[73797/01]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

15 dhjetor 2005

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: shkelje e të drejtave individuale si rezultat i gjyqimit, dënimit dhe burgosjes për shpërfillje ndaj gjykatës në cilësi të avokatit mbrojtës; Avokati mbrojtës i gjetur në mospërfillje të gjykatës, më pas për t’u dënuar nga të njëjtët gjyqtarë para të cilëve kishte ndodhur mospërfillja, dhe përdorimi i gjuhës së njëanshme të theksuar nga gjyqtarët gjatë dënimit.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit kundër Republikës së Qipros nga Michalakis Kyprianou, shtetas qipriot (kërkuesi), më 9 gusht 2001. Kërkuesi duke vepruar si avokat mbrojtës gjatë një gjykimi për vrasje para Gjykatës së Shkallës së

Parë në Limasol (Limassol Assize Court), ishte ndërprerë nga gjyqtarët teksa po merrte në pyetje një dëshmitar të prokurorisë. Ai u ndje i penguar dhe kërkoi leje për t'u tërhequr nga çështja, por leja nuk iu dha. Si kundërpërgjigje, ai pretendoi se gjatë procedurës së marrjes në pyetje (cross examination), gjyqtarët kishin biseduar me njëri-tjetrin dhe i kishin dërguar njëri-tjetrit shënime.⁸⁰ Në lidhje me këto deklaratat të kërkuesit, gjyqtarët deklaruan se ishin “fyer thellë” “si persona”; dhe se nuk mund “të konceptojnë një rast tjetër të një përbuzjeje kaq të dukshme dhe të papranueshme të gjykatës nga çdo person, e lëre më nga një avokat”; dhe se “reagimi i gjykatës duhet të jetë i menjëhershëm dhe drastik, ... drejtësia do të ketë pësuar një goditje katastrofike”. Ata i dhanë kërkuesit mundësinë, ose të qëndronte prapa asaj që kishte thënë dhe të jepte arsyet pse nuk duhet t'i shqiptohet dënimi ndaj tij ose të tërhiqej. Kërkuesi nuk bëri asnjërin, dhe gjykata e gjeti atë në shpërfillje të gjykatës dhe e dënoi deri në pesë ditë burgim, për t'u ekzekutuar menjëherë, të cilën gjykata e vlerësoi të jetë “reagimi i vetëm adekuat”. Kërkuesi e vuajti dënimin me burg, edhe pse në fakt ai u lirua para kohe, në përputhje me legjislacionin. Për këtë dënim ai apeloi në Gjykatën e Lartë, e cila e hodhi poshtë ankesën e kërkuesit.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi se gjatë dënimit të tij për shpërfillje të gjykatës ai nuk pati një seancë dëgjimore nga një gjykatë e paanshme në kuptim të nenit 6.1 të Konventës. Tutje ai pretendoi shkelje të nenit 6.2 të Konventës sepse ai ishte prezumuar fajtor nga Gjykata e Rrethit Limasol (Assize Limassol) para se t'i ishte dhënë një mundësi për të mbrojtur veten. Ai pretendoi se kur gjykata i dha mundësinë për të bërë parashpresa, ato ishin kufizuar në çështjen e zbutjes së dënimit. Kërkuesi pretendoi edhe shkelje të nenit 6.3 (a) të Konventës, sepse sipas tij Gjykata e Lartë nuk e kishte informuar atë në detaje për akuzën e bërë ndaj tij. Përfundimisht, kërkuesi parashtrroi se vendimi për dënim dhe dënimi i tij (prej pesë ditësh burgim) shkelte nenin 10 të Konventës, pretendim ky shqyrtimin e të cilit Qeveria e kundërshtoi. Dhoma e Madhe theksoi se rrethanat

⁸⁰ “Ravasakia” - që mund të nënkuptojë, ndër të tjera, letra/shënime të shkurtra dhe sekrete, ose letra dashurie, ose mesazhe me përmbajtje të pakëndshme.

e rastit kërkojnë një shqyrtim të veçantë të ankesës së kërkuesit sipas nenit 10. Derisa çështja kryesore sipas nenit 6 ishte paanshmëria e gjykatës e cila përcaktoi kallëzimin penal kundër kërkuesi, ankesa sipas nenit 10 kishte të bënte me ndikimin e dënimit të kërkuesit në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Prandaj, sipas Gjykatës, kjo ishte një ankesë e një natyre të ndryshme nga ajo sipas nenit 6 dhe duhej të konsiderohej veçmas. Dhoma e Madhe theksoi se sa i përket zbatueshmërisë së nenit 10, nuk kontestohet që ky nen garanton lirinë e fjalës edhe për avokatët kur shprehen në emër të klientëve të tyre në gjykatë. Më 19 prill 2004, Qeveria kërkoi që rasti të referohej në Dhomën e Madhe, në përputhje me nenin 43 të Konventës dhe rregullin 73.

Arsyetimi i Gjykatës

Neni 6(1): Ky rast ishte drejtuar ndaj një defekti në procedurat përkatëse. Çështja e kërkuesit kishte të bënte me shpërfilljen e gjykatës, përkatësisht gjyqtarëve (nga ana e parashtruesit). Gjyqtarët kishin qenë objekt i drejtpërdrejtë i kritikave të kërkuesit për mënyrën në të cilën ata e kishin zhvilluar procedurën. Të njëjtit gjyqtarë atëherë kishin marrë vendimin për ta ndjekur penalisht kërkuesin, i kishin gjykuar çështjet që lindnin nga sjellja e tij, kishin përcaktuar fajësinë e tij dhe kishin shqiptuar dënimin (pesë ditë burgim) ndaj tij. Në një situatë të tillë ku roli i dëshmitarit, prokurorit dhe gjyqtarit ishin bërë një, ishte e arsyetuar frika objektive për sa i përket pajtueshmërisë së procedurës me parimin e njohur dhe të pranuar botërisht se askush nuk duhet të jetë gjyqtar në çështjen e tij ose të saj.

Në përputhje me rrethanat, Gjykata arsyetoi se paanshmëria e Gjykatës së Lartë dukej e hapur për dyshime dhe prandaj, frika e kërkuesit në këtë drejtim mund të konsiderohet se kishte qenë e arsyetuar objektivisht.

Duke iu kthyer pretendimit të kërkuesit se gjyqtarët në fjalë kishin vepruar nën paragjykimet personale, Gjykata vërejtë se gjyqtarët në vendimin e tyre për dënimin e kërkuesit kishin pranuar se ata ishin “fyer thellë” “si persona” nga kërkuesi. Kjo deklaratë në vetvete kishte treguar se gjyqtarët kishin qenë të ofenduar personalisht nga fjalët dhe sjellja e kërkuesit. Përveç kësaj, gjuha theksuese e përdorur nga gjyqtarët gjatë vendimit të tyre kishte përcjellë një ndjenjë të indinjatës dhe të tronditjes,

të cilat ishin në kundërshtim me qasjen e shkëputur (detached approach) që pritej në prononcimet gjyqësore. Gjyqtarët kishin vazhduar me shqiptimin e një dënimi me burgim prej pesë ditësh, i zbatuar menjëherë, të cilin ata e kishin konsideruar si të “vetmen përgjigje adekuate” për atë që kishte ndodhur. Përveç kësaj, gjyqtarët shprehën mendimin që në fillim të diskutimit të tyre që kërkuesin e konsideronin fajtor për veprën penale të mospërfilljes së gjykatës. Pasi vendosën se ai kishte kryer veprën e mësipërme, ata i kishin lënë të zgjidhte, qoftë të qëndrojnë prapa asaj që kishte thënë dhe të japë arsyet pse nuk duhet t’i shqiptohet atij dënimi, ose të tërhiqet. Edhe pse pa dyshim që gjyqtarët ishin të shqetësuar me mbrojtjen e administrimit të drejtësisë dhe integritetit të gjyqësorit dhe, për këtë qëllim, e panë të arsyeshme të nisin procedurën në fjalë, megjithatë nuk arritën të shkëputeshin sa duhet nga situata. Ky përfundim u përforcua edhe nga shpejtësia me të cilën ishte zhvilluar procedura dhe nga shkurtësia e shkëmbimeve ndërmjet gjyqtarëve dhe kërkuesit. Në këtë sfond dhe duke pasur parasysh veçanërisht elementet e cekura të sjelljes personale të gjyqtarëve, të marra së bashku, dyshimet e kërkuesit në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Lartë ishin të justifikuara. Për më tepër, Gjykata e Lartë si instancë e cila do të mund të korrigjonte shkeljet, kishte refuzuar të anulonte vendimin e gjykatës më të ulët, prandaj defekti në fjalë nuk ishte korrigjuar.

Neni 10: Gjykata vërejt se Gjykata e Rrethit në Limasol (Assize Court) e kishte dënuar kërkuesin me pesë ditë burgim, i cili nuk mund të mos konsiderohej si një dënim i ashpër, veçanërisht duke pasur parasysh që ai u zbatua menjëherë. Sjellja e tij mund të konsiderohet se kishte treguar mungesë respekti për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Megjithatë, edhe pse e pahijshme, komentet e tij kishin për qëllim dhe ishin kufizuar në mënyrën në të cilën gjyqtarët ishin duke gjykuar çështjen, veçanërisht në lidhje me marrjen në pyetje të tërthortë të një dëshmitari . Këtë ai e kishte kryer gjatë mbrojtjes së klientit të tij kundër një akuze për vrasje. Gjykata vërejt se dënimi në fjalë kishte qenë në mënyrë joproporcionale i rëndë dhe kishte qenë në gjendje të ketë një “efekt pengues” (“chilling effect”) në përmbushjen e detyrave të avokatit mbrojtës në përgjithësi.. Përfundimisht, Gjykata theksoi se Gjykata e Lartë nuk kishte arritur ekuilibrin e duhur ndërmjet nevojës për të mbrojtur autoritetin e gjyqësorit dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 6 (1), ndërsa lidhur me nenet 6 (2) dhe 6 (3) (a), Dhoma e Madhe konsideroi se nuk u ngrit ndonjë çështje e veçantë sipas këtyre dispozitave. Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 10, Gjykata konstatoi se kishte shkelje. Bazuar në nenin 41, Gjykata i akordoi parashtruesit 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro për dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. “POHOTOVOSTĚ S. R. O.” kundër MIROSLAV VAŠUTA

GJDBE

Çështja C-470/12

27 shkurt 2014

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=148384&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13708072>]

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: *Kjo çështje kishte të bënte me të drejtën e një shoqate për të ndërhyrë si palë e tretë në procedurat e ekzekutimit të një vendimi, të drejtë që në këtë rast e drejta e BE-së nuk e njeh si të tillë*

Faktet kryesore

“Pohotovost”, një shoqëri krediti në Sllovaki, i dha kredi konsumatore z. Miroslav Vašuta. Me një vendim të 9 dhjetorit 2010, Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit urdhëroi z. Vašuta t’i paguajë “Pohotovost” një shumë të caktuar.

“Pohotovost” bëri një kërkesë për ekzekutimin e këtij vendimi arbitrazhi, i cili ishte bërë përfundimtar. Më 25 mars 2011, përmbaruesi gjyqësor

i kontraktuar nga “Pohotovost” iu drejtua Gjykatës së Rrethit Svidník për autorizimin për të ekzekutuar vendimin e arbitrazhit në fjalë. Me vendimin e 29 qershorit 2011, kjo kërkesë u hodh poshtë për pjesën që kishte të bënte me pagesën e interesit të vonesës së pagesës dhe me shpenzimet në lidhje me këto pagesa. Gjithsesi, e njëjta gjykatë në fjalë miratoi kërkesën për ekzekutimin e të njëjtave pagesa për kreditorë të tjerë.

Më 9 shtator 2011, Združenie na ochranu občana spotrebiteľa HOOS (Shoqata për mbrojtjen e konsumatorit HOOS – në tekstin e mëtejme “Združenie HOOS”) kërkoi të ndërhyjë në procedurat përmbarimore, duke u mbështetur në nenin 93.2 të Kodit të Procedurës Civile. Në thelb, ajo pretendoi mungesë paanshmërie të përmbaruesit të kontraktuar, duke argumentuar në veçanti se ky i fundit në të kaluarën kishte një marrëdhënie pune me “Pohotovost”. Sipas saj, në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, fakti që ky përmbarues gjyqësor kishte qenë i punësuar nga “Pohotovost” ishte i papajtueshëm me kriterin e paanësisë së tij. Përveç kësaj, “Združenie HOOS” kërkoi pezullimin e të gjithë procedurave përmbarimore.

Në vëzhgimet e saj të 27 marsit 2012, “Pohotovost” pretendonte se ndërhyrja e “Združenie HOOS” para gjykatës ishte e papranueshme me arsyetimin se Kodi i Përmbarimit nuk parashikonte shprehimisht mundësinë e një ndërhyrjeje të tillë.

Me një urdhër të 24 majit 2012, Gjykata e Rrethit të Svidník e shpalli të papranueshme kërkesën e “Združenie HOOS” për të ndërhyrë në procedurat përmbarimore dhe hodhi poshtë kërkesën për pezullimin e atyre procedurave.

“Združenie HOOS” paraqiti apel kundër këtij urdhri më 18 qershor 2012. Ajo argumentoi, nga njëra anë, se z. Vašuta nuk kishte marrë informacion të mjaftueshëm. Nga ana tjetër, ajo gjykatë nuk aplikoi *ex officio* në dobi të z. Vašuta, argumentin për një klauzolë të padrejtë arbitrazhi, atë për rregulla të duhura mbrojtëse për konsumatorët dhe nuk nxori përfundime ligjore nga mungesa e referimit të përqindjes vjetore të konsumit në kontratën e kredisë. Sipas “Združenie HOOS” gjykata nuk e zbatoi saktë praktikën gjyqësore që rezulton në veçanti

nga vendimi i 6 tetorit 2009, “Asturcom Telecomunicaciones” (C 40/08, Rec. P. I 9579), dhe nga urdhri i 16 nëntorit 2010, “Pohotovost” (C 76/10, Rec. P. I 11557).

Nga dosja gjyqësore rezultonte se, në një vendim të 10 tetorit 2012, Gjykata Supreme e Republikës Sllovaqe kishte vendosur se ndërhyrja e një shoqate për mbrojtjen e konsumatorit nuk ishte e pranueshme në një procedurë përmbarimi kundër një konsumatori, pasi nuk është një proces gjyqësor, por ka për qëllim ekzekutimin e një vendimi mbi themelin që është përfundimtar dhe detyruës për debitorin. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese e Republikës Sllovaqe kishte mbajtur një qëndrim të ngjashëm në një vendim të 15 janarit 2013.

Gjykata e Rrethit Svidník vlerësoi se interpretimi nga Gjykata i Direktivës 93/13 mund të kishte një ndikim vendimtar në rezultatin e mosmarrëveshjes në procedurën kryesore. Në këto rrethana ajo vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i parashtrojë pyetjet e mëposhtme Gjykatës për një vendim paraprak:

“1) Nëse neni 6, paragrafi 1, neni 7, paragrafi 1 dhe neni 8 i Direktivës 93/13, të lexuara bashkë me dispozitat e neneve 38 dhe 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (Karta), interpretohen se kundërshtojnë një dispozitë kombëtare të tillë si neni 37, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit të Përmbarimit, i cili nuk lejon një shoqatë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit të ndërhyjë në procedurën e përmbarimit?

2) Nëse përgjigjja e pyetjes së parë sugjeron që dispozita në fjalë nuk është në kundërshtim me të drejtën e BE-së, dispozitat e nenit 37 paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Përmbarimit duhet të interpretohen se nuk përjashtojnë një gjykatë kombëtare që, në bazë të neneve 6.1, 7.1 dhe 8 të asaj direktive, të pranojë që një shoqatë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit të ndërhyjë në procedurën e ekzekutimit? “

Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me procedurën paragjykimore para saj, Gjykata sqaron paraprakisht se nga neni 267 i TFBE-së rezulton se procedura e vendimit paraprak presupozon që një mosmarrëveshje është në pritje përpara

gjykatave kombëtare, brenda kuadrit të së cilës ato janë të thirrura të marrin një vendim, i cili do të ketë parasysh vendimin paraprak. Nëse gjykata referuese i tregon Gjykatës se çështja para saj është ende në pritje, kjo është detyruese për Gjykatën dhe nuk mundet, në parim, të vihet në dyshim nga palët në procedurën kryesore.

Përveç kësaj, kur kundërshtohet urdhri për referencë, në përputhje me nenin 267 të TFBE-së, vlerësimi i rëndësisë dhe domosdoshmërisë së pyetjes së referuar për një vendim paraprak është, në parim, përgjegjësi e vetme e gjykatës kombëtare që bën referimin për një vendim paraprak, ndërsa Gjykata e Luksemburgut kryen vetëm një verifikim të kufizuar. Kështu, i takon asaj gjykate të nxjerrë pasojat e çdo vendimi të marrë në kuadrin e një kundërshtimi kundër urdhrit për referim për vendimin paraprak nga GJDBE dhe, në veçanti, të arrijë në përfundimin nëse është e përshtatshme ta vazhdojë kërkesën e saj për një vendim paraprak, ta ndryshojë atë ose ta tërheqë. Nga kjo rrjedh se Gjykata, në interes të qartësisë dhe sigurisë juridike, duhet t'i përmbahet urdhrit që vendos referimin për një vendim paraprak, i cili duhet të prodhojë efektet e tij për sa kohë që nuk është tërhequr ose ndryshuar nga gjykata që e ka lëshuar. Vetëm nëse gjykata e apelit vendos, në përputhje me rregullat e zbatueshme të së drejtës procedurale kombëtare, të anulojë refuzimin e gjykatës referuese për të marrë parasysh tërheqjen e kërkesës nga ankuesi dhe të urdhërojë tërheqjen e kërkesës së saj për një vendim paraprak, GJDBE mund të vlerësojë pasojat e një vendimi të tillë duke e çregjistruar çështjen nga lista e Gjykatës, pasi të ketë marrë, nëse është e nevojshme, vërejtjet e gjykatës referuese në këtë drejtim.

Në lidhje me thelbin e kërkesës, Gjykata shprehet se Direktiva 93/13, mbi kushtet e padrejta në kontratat e lidhura me konsumatorët, në veçanti nenet 6.1, 7.1 dhe 8 të asaj direktive, lexuar së bashku me nenet 38 dhe 47 të Kartës, duhet të interpretohet në kuptimin që nuk përjashton legjislacionin kombëtar i cili ndalon ndërhyrjen e një shoqate për mbrojtjen e konsumatorit në mbështetje të një konsumatori në procedurat e ekzekutimit të një vendimi përfundimtar të arbitrazhit.

Gjykata shprehet se, as Direktiva 93/13 dhe as ato që e pasuan atë, duke plotësuar sistemin rregullator për mbrojtjen e konsumatorit, nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që rregullon rolin që mund ose

duhet të kenë shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit në kontekstin e mosmarrëveshjeve individuale që përfshijnë një konsumator. Kështu, Direktiva 93/13 nuk rregullon çështjen nëse shoqata të tilla duhet të kenë të drejtën të pranohen të ndërhyjnë në mbështetje të konsumatorëve në kontekstin e mosmarrëveshjeve individuale. Nga kjo rrjedh se, në mungesë të legjislacionit të BE-së në lidhje me mundësinë që shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit të ndërhyjnë në mosmarrëveshjet individuale që përfshijnë konsumatorët, i takon rendit të brendshëm juridik të secilit shtet anëtar të vendosë rregulla të tilla, në bazë të parimit të autonomisë procedurale, me kusht, megjithatë, që ato të jenë jo më pak të favorshme se ato që rregullojnë situata të ngjashme që i nënshtrohen ligjit të brendshëm (parimi i barasvlerës) dhe që nuk e bëjnë të pamundur në praktikë ose tepër të vështirë ushtrimin e të drejtave të njohura nga e Drejta e BE-së (parimi i efektivitetit).

Në mungesë të ndonjë dispozite në Direktivën 93/13 që parashikon të drejtën që shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit të ndërhyjnë në mosmarrëveshjet individuale që përfshijnë konsumatorët, neni 38 i Kartës, në saje të të cilit sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së konsumatorit në politikat e BE-së, nuk mund të imponojë në vetvete një interpretim të asaj direktive në kuptimin e njohjes së asaj të drejte.

Për më tepër, për aq sa Direktiva 93/13 kërkon, në mosmarrëveshjet që përfshijnë një profesionist dhe një konsumator, një ndërhyrje pozitive që nuk ndërlidhet me palët në kontratë, nga gjykata kombëtare që shqyrton mosmarrëveshje të tilla, nuk mund të konsiderohet se refuzimi i pranimit të një ndërhyrje nga një shoqatë në mbështetje të një konsumatori në fjalë përbën shkelje të së drejtës për një mjet juridik efektiv të këtyre konsumatorëve ose shoqatave të tilla, të garantuara me nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

3.2. CHRONOPOST SA dhe LA POSTE kundër UNION FRANÇAISE DE L'EXPRESS (UFEX) E.A.

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështjet e bashkuara C-341/06 P dhe C-342/06 P

1 korrik 2008

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=C-341/06&language=en>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: *Kjo çështje kishte të bënte me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe sidomos për një gjykatë të krijuar me ligj, dhe për rëndësinë e këtij parimi në të drejtën e BE-së.*

Faktet kryesore

“La Poste”, një kompani franceze që operonte në një monopol ligjor në sektorin e shërbimeve postare, ishte pjesë përbërëse e administratës franceze deri në fund të vitit 1990. Nga 1 janari 1991, ajo u organizua si person juridik i rregulluar nga e drejta publike, në përputhje me dispozitat e Ligjit 90-568, të 2 korrikut 1990, në lidhje me organizimin e shërbimit publik të postës dhe telekomunikacionit. Ky ligj e autorizonte atë të kryejë aktivitete të caktuara të hapura për konkurrencë, në veçanti dërgimin e postës së shpejtë.

Kompania franceze e dërgesave ndërkombëtare (në tekstin e mëtejshëm: “SFMI”) është një kompani private, së cilës i ishte besuar menaxhimi i shërbimit të postës së shpejtë të “La Poste” që nga fundi i vitit 1985. Mënyra e funksionimit dhe marketingut të shërbimit të postës së shpejtë që SFMI ofronte nën emrin “EMS/Chronopost” u rregulluan me një udhëzim të Ministrisë Franceze të Postave dhe Telekomunikacionit të 19 gushtit 1986. Sipas këtij udhëzimi, “La Poste” duhej të siguronte logjistikë dhe asistencë komerciale për SFMI-në. Marrëdhëniet kontraktuale midis “La Poste” dhe SFMI ishin të rregulluara me marrëveshje, e para prej të cilave datonte nga viti 1986.

Në vitin 1992, struktura e biznesit të postës së shpejtë të kryer nga SFMI u ndryshua. “Sofipost” dhe “TAT” krijuan një kompani të re, “Chronopost”,

në të cilën ata ende zotëronin 66%, përkatësisht 34% të aksioneve. “Chronopost”, e cila kishte qasje ekskluzive në rrjetin “La Poste” deri më 1 janar 1995, u rifokusua në postën kombëtare të shpejtë. SFMI u ble nga “GD Express Worldwide France”, një degë e një ndërmarrjeje të përbashkët ndërkombëtare. SFMI mbajti aktivitetin ndërkombëtar të postës së shpejtë, duke përdorur “Chronopost” si agjent dhe ofrues shërbimesh në përpunimin e dërgesave të saj ndërkombëtare në Francë (në tekstin e mëtejshëm “SFMI-Chronopost”).

Sindikata franceze e dërgesave ekspres ndërkombëtare (SFEI) është një sindikatë profesionale sipas ligjit francez që bashkon pothuajse të gjitha kompanitë që ofrojnë shërbime të postës së shpejtë që konkurrojnë me “SFMI-Chronopost”.

Më 21 dhjetor 1990, SFEI bëri një ankesë në Komisionin e Komuniteteve Evropiane me pretendimin, sidomos, se ndihma logjistike dhe tregtare e ofruar nga “La Poste” për “SFMI-Chronopost” përbënte ndihmë shtetërore sipas kuptimit të nenit 92 të Traktatit të KE⁸¹. Ankesa denoncoi sidomos faktin se pagesat e “SFMI” për shërbimet e ofruara nga “La Poste” nuk korrespondonte me kushtet normale të tregut. Diferenca midis çmimit të tregut për blerjen e shërbimeve të tilla dhe atij që paguhet aktualisht nga “SFMI-Chronopost” përbënin ndihmë shtetërore. Një studim ekonomik, i kryer, me kërkesë të “SFEI”, nga firma konsulente “Braxton Associés”, i ishte bashkangjitur ankesës për të vlerësuar shumën e ndihmës gjatë periudhës 1986-1989.

Më 10 mars 1992, Komisioni informoi “SFEI”-në për mospranimin e ankesës. Më 16 maj 1992, “SFEI” dhe kompani të tjera paraqitën një padi për anulim të këtij vendimi para Gjykatës. Gjykata deklaroi se, pas vendimit të Komisionit të 9 korrikut 1992 për të tërhequr vendimin e 10 marsit 1992, nuk kishte nevojë për proces⁸².

Më 16 qershor 1993, SFEI dhe kompani të tjera ngritën një padi para Gjykatës Tregtare të Parisit kundër SFMI, Chronopost, La Poste dhe të

81 Aktualisht neni 107 i TFBE-së.

82 Urdhri i Gjykatës i 18 nëntorit 1992.

tjerëve. Me vendimin e 5 janarit 1994, Gjykata Tregtare e Parisit i referoi Gjykatës disa pyetje për një vendim paraprak mbi interpretimin e nenit 92 të Traktatit dhe nenit 93 të Traktatit të KE-së (tani neni 88 i KE-së), njëra prej të cilave kishte të bënte me konceptin e ndihmës shtetërore në rrethanat e këtij rasti. Me vendimin e 11 korrikut 1996, në rastin *SFEI dhe të tjerët*⁸³, Gjykata vendosi që “*ofrimi i ndihmës logjistike dhe tregtare nga një ndërmarrje publike për filialet e saj të së drejtës private që kryejnë një aktivitet të hapur për konkurrencë të lirë, mund të përbëjnë ndihmë shtetërore sipas kuptimit të nenit 92 të Traktatit nëse shpërblimi i marrë në këmbim është më i ulët se ai që do të ishte kërkuar në kushtet normale të tregut*”(paragrafi 62).

Më 20 mars 1996, Komisioni informoi Republikën Franceze për hapjen e procedurës së parashikuar në nenin 93.2 të Traktatit. Më 30 maj 1996, ajo i dërgoi Komisionit vërejtjet e saj në këtë drejtim. Më 17 gusht 1996, “SFEI” i paraqiti vërejtjet e saj Komisionit duke bashkëngjitur një studim të ri ekonomik, të kryer nga firma “Bain & Co”.

Më 1 tetor 1997, Komisioni miratoi një vendimin ku vlerëson se duhet dalluar dy kategori masash. Kategoria e parë konsiston në sigurimin nga “La Poste”, nga njëra anë, të ndihmës logjistike që konsiston në vënien në dispozicion të infrastrukturës postare në “SFMI-Chronopost” për grumbullimin, klasifikimin, transportin dhe shpërndarjen e artikujve të tyre. Dhe, nga ana tjetër, ndihmë komerciale, domethënë qasje nga “SFMI-Chronopost” te klientët e “La Poste”, ofrimi nga kjo e fundit i fondeve në favor të “SFMI-Chronopost”. Kategoria e dytë përbëhet nga masa specifike, të tilla si qasje e privilegjuar në Radio France dhe privilegjet tatimore dhe doganore.

Komisioni vlerësoi se pyetja përkatëse ishte ajo nëse “*kushtet e transaksionit midis La Poste dhe SFMI-Chronopost ishin të krahasueshme me ato të një transaksioni ekuivalent midis një kompanie mëmë private, e cila mund të jetë në situatë monopole (për shembull sepse mban të drejta ekskluzive), dhe filialeve të saj*”. Sipas Komisionit, nuk kishte përfitim financiar nëse çmimet e brendshme për produktet

83 Vendimi C - 39/94, Rec. P. I - 3547 [...].

dhe shërbimet e tregtuara midis kompanive që i përkisnin të njëjtit grup 'llogaritëshin në bazë të kostove të plota'.

Në nenin 1 të vendimit, Komisioni vërejti se Asistenca logjistike dhe tregtare e ofruar nga "La Poste" për filialin e saj "SFMI-Chronopost", transaksionet e tjera financiare midis këtyre dy kompanive, marrëdhëniet midis "SFMI-Chronopost" dhe Radio France, regjimi doganor i zbatueshëm për "La Poste" dhe "SFMI-Chronopost", sistemi i tatimit mbi pagën dhe tarifat e vulave të zbatueshme për "La Poste" dhe investimi i tij në platformat e mesazheve nuk përbëjnë ndihmë shtetërore në favor të "SFMI-Chronopost".

Më 30 dhjetor 1997, SFEL, që ishte bërë "Union française de l'express" (UFEX), si dhe tre kompani që janë anëtare të saj, "DHL International SA", "Federal express International" ("Fedex" Francë) SNC dhe "CRIE SA" ('UFEX dhe të tjerët') paraqitën një ankesë në Tribunalin e BE-së për anulimin e vendimit të kontestuar të Komisionit. "Chronopost", "La Poste" dhe Republika Franceze ndërhyjnë në mbështetje të Komisionit.

"UFEX" dhe të tjerët u mbështetën në katër kërkesa për anulim në mbështetje të veprimit të tyre, duke pretenduar, përkatësisht, shkelje të të drejtave të mbrojtjes, në veçanti të drejtës së qasjes në dosje, arsyetim të pamjaftueshëm, gabime faktike dhe gabime të dukshme vlerësimi si dhe shkelje të konceptit të ndihmës shtetërore.

Në vendimin e tij të 14 dhjetorit 2000, në rastin *Ufex dhe të tjerë kundër Komisionit*⁸⁴, Tribunali vendosi që vetëm pjesa e parë e pretendimit të katërt ishte e bazuar dhe neni 1 i vendimit të Komisionit duhej anuluar në pjesën që konstatonte se ndihma logjistike dhe tregtare e ofruar nga "La Poste" për filialin e saj, "SFMI-Chronopost", nuk përbën ndihmë shtetërore në favor të "SFMI-Chronopost", pa pasur nevojë të shqyrtojë aspektin e dytë të kësaj kërkesë ose kërkesat e tjera, për aq sa këto të fundit kanë të bëjnë me ndihmën logjistike dhe tregtare të ofruar nga "La Post" për filialin e saj, "SFMI-Chronopost". Pretendimet e tjera u refuzuan.

84 Vendimi T - 613/97, Rec. P. II - 4055.

Më 19 dhe 23 shkurt 2001, “Chronopost”, “La Poste” dhe Republika Franceze, në bazë të nenit 56 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, apeluan vendimin *Ufex dhe të tjerët kundër Komisionit*, të cituar më sipër. Këto ankesa u bashkuan.

Me vendimin e 3 korrikut 2003, *Chronopost dhe të tjerët kundër Ufex dhe të tjerët*⁸⁵, Gjykata shpalli të bazuar pretendimin e parë për shkelje të nenit 92.1 të Traktatit, për shkak të interpretimit të pasaktë nga Tribunali të konceptit të kushteve normale të tregut. Sipas Gjykatës, Tribunali kishte gabuar në interpretimin e nenit 92.1 të Traktatit duke vendosur se Komisioni nuk mund të vlerësonte ekzistencën e ndihmës në favor të “SFMI-Chronopost” duke iu referuar kostove të përballuara nga “La Poste”, por duhet të kishte kontrolluar nëse ndihmat e marra nga “La Poste” *“ishin të krahasueshme me ato të pretenduara nga një kompani private financiare ose një grup privat kompanish, që nuk operojnë në një sektor të rezervuar, duke ndjekur një politikë strukturore, globale ose sektoriale dhe të udhëhequr nga perspektiva afatgjata”*. Për këtë arsye, dhe pasi mori parasysh se nuk kishte nevojë të shqyrtonte pretendimet e tjera të apelit, Gjykata e anuloi vendimin *Ufex dhe të tjerët kundër Komisionit*, më sipër, dhe ia ktheu çështjen Tribunalit.

Në procedurën e dytë para Tribunalit, ky i fundit vendosi se *“se vendimi [i Komisionit] duhet të anulohet në pjesën që arrin në përfundimin se ndihma logjistike dhe tregtare e ofruar nga La Poste për SFMI-Chronopost nuk përbën ndihmë shtetërore”*.

Chronopost dhe La Poste e apeluan përsëri vendimin përpara Gjykatës duke i shtuar pretendimit për keqinterpretim të nocionit të ndihmës shtetërore, edhe pretendimet ligjore për përbërje të parregullt të formacionit gjyqësor të Tribunalit që anuloi vendimin e Komisionit dhe për mungesë arsyetimi në lidhje me elementin e ndihmës logjistike të ofruar nga La Poste ndaj SFMI-Chronopost.

Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e saj në procedurën e dytë, Gjykata theksoi se drejta për një gjykim të drejtë siç rrjedh, në veçanti, nga neni 6.1 i KEDNJ-së

85 Çështjet C-83/01 P, C-93/01 P dhe C- 94/01 P, ECR I – 6993.

përbën një të drejtë themelore, të cilën BE-ja e respekton si një parim të përgjithshëm në bazë të nenit 6.2 të TBE-së dhe nënkupton që të gjithë duhet të jenë në gjendje të dëgjohen në mënyrë të drejtë, publikisht dhe brenda një kohe të arsyeshme, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.

Gjykata theksoi, së pari, se një pretendim për parregullsi në përbërjen e Tribunalit duhet të konsiderohet si një pretendim i natyrës së politikës publike, i cili duhet të shqyrtohet *ex officio* nga gjyqtari i BE-së.

Fakti që të njëjtit gjyqtar të pranishëm në dy panele të njëpasnjëshme në lidhje me të njëjtën çështje i është besuar funksioni i gjyqtarit raportues është në vetvete pa ndikim në vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesën e paanshmërisë, pasi funksionet e përmendura kryhen në një formacion kolegjal.

Për më tepër, kërkesa e paanshmërisë mbulon dy aspekte. Nga njëra anë, gjykata duhet të jetë subjektivisht e paanshme, që do të thotë se asnjë nga anëtarët e saj nuk duhet të shfaqë ndonjë qëndrim ose paragjykim personal. Megjithatë, paansësia personale duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Nga ana tjetër, ajo duhet të jetë objektivisht e paanshme, domethënë duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim. Në këtë drejtim, fakti që i njëjti gjyqtar bën pjesë në dy panele që kanë trajtuar me radhë të njëjtën çështje nuk mundet, në vetvete, përveç elementeve të tjera objektive, të krijojë dyshime për paanshmërinë e juridiksionit.

Së dyti, kur një vendim i Komisionit arrin në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me ndihmë shtetërore në një rast të ankuar para tij, ky duhet t'i shpjegojë ankuesit si duhet arsyet se përse argumentet faktike dhe juridike të pretenduara në ankesë nuk ishin të mjaftueshme për të demonstruar ekzistencën e ndihmës shtetërore. Sidoqoftë, Komisioni nuk është i detyruar të marrë një pozicion mbi çështjet që janë qartësisht të parëndësishme, të pakuptimta ose haptazi dytësore. Për më tepër, ligjshmëria e një vendimi për ndihmë shtetërore duhet të vlerësohet në bazë të informacionit në dispozicion të Komisionit në kohën kur ai e ka miratuar atë.

Fakti që një vendim i Komisionit është ndër të parët në kohë që trajton çështjen komplekse të ndihmës shtetërore për llogaritjen e kostove të ndihmës së ofruar nga një kompani mëmë që operon në një treg të rezervuar për një filial që nuk operon në një treg të tillë, në vetvete, nuk justifikon një arsyetim të detajuar i cili duhet të hyjë domosdoshmërisht në detajet e llogaritjes së atyre kostove, nëse Komisioni konsideron se arsyet e parashtruesit në këtë drejtim janë haptazi të gabuara. Nëse supozohet se kjo qasje e Komisionit është në vetvete e pasaktë, kjo do të kishte ndikim në themelin e vendimit të kontestuar, por jo vlefshmërinë formale të tij. Marrëdhënia e nevojshme mes pretendimeve të parashtruesve dhe arsyeve për vendimin e Komisionit nuk mund të kërkojë që ky i fundit të refuzojë secilin prej argumenteve të përdorur në mbështetje të këtyre argumenteve. Mjafton që të përcaktohen faktet dhe argumentet ligjore me rëndësi thelbësore për ekonominë e vendimit. Për sa i përket koncepteve ekonomike dhe kontabël të përdorura nga Komisioni mbi natyrën e kostove dhe përbërësit e llogaritjeve financiare, të cilat janë rezultat i vlerësimeve komplekse teknike, përderisa ai vendim i Komisionit tregon qartë arsyetimin e ndjekur prej tij për të lejuar kundërshtimin e tij në themel, më pas, para gjykatës kompetente, do të ishte e tepërt të kërkohen arsye specifike për secilën nga zgjedhjet teknike ose secilën nga shifrat në të cilat bazohet ky arsyetim.

Së fundmi, Gjykata u shpreh se koncepti i ndihmës shtetërore mbulon jo vetëm shërbime pozitive të tilla si grante, hua ose investime në kapitalet e kompanive, por edhe ndërhyrje të cilat, në forma të ndryshme, zvogëlojnë tarifën që zakonisht prekin buxhetin e një kompanie dhe të cilat, prandaj, pa qenë subvencione në kuptimin e ngushtë, janë të së njëjtës natyrë dhe kanë efekte identike. Përfitimet indirekte që kanë të njëjtat efekte si subvencionet përfshijnë ofrimin e mallrave ose shërbimeve me kushte preferenciale.

Megjithatë, në kontekstin e transferimit, në një degë të së drejtës private, të klientelës së një shërbimi që nuk i përket sektorit të rezervuar, të krijuar nga kompania e saj mëmë që operon në një treg të rezervuar, nuk mund të shpërfillen plotësisht kushtet ligjore dhe ekonomike të transferimit në fjalë, kur këto, në vetvete, ka të ngjarë të krijojnë përfitime për avantazhin e ofruar nga ky transferim. Për më tepër, një klasifikim i tillë si ndihmë shtetërore mund të pranohet vetëm nëse transferimi

i klientëve, si i tillë, plotëson të gjitha kushtet e përmendura në nenin 92.1 të Traktatit⁸⁶. Për sa i përket pyetjes nëse një transferim i tillë do të shtrembërojë ose do të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën, kjo mund të ndodhë vetëm nëse ai ndryshon strukturën e tregut në fjalë dhe ndikon në situatën e kompanive konkurruese, tashmë të pranishme në këtë treg.

Në prani të një vendimi të Komisionit që konstaton se ndihma logjistike dhe tregtare e ofruar nga një kompani që i është besuar një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik filialit të saj, nuk përbën ndihmë shtetërore, gjyqtari evropian duhet të verifikojë nëse faktet e mbështetura nga Komisioni janë materialisht të sakta dhe nëse ato përcaktojnë që të gjitha kushtet që lejojnë klasifikimin si “ndihmë” brenda kuptimit të Traktatit janë plotësuar. Meqenëse ky është një vlerësim kompleks ekonomik, shqyrtimi gjyqësor i një akti të Komisionit që përfshin një vlerësim të tillë duhet të kufizohet në verifikimin e përputhshmërisë me rregullat e procedurës dhe arsyetimit, saktësinë materiale të fakteve të përdorura për të marrë vendimin në fjalë, nëse ka gabim flagrant në vlerësimin e këtyre fakteve ose mungesë e keqpërdorim të kompetencave. Përveç kësaj, meqenëse koncepti i ndihmës shtetërore i përgjigjet një situatë objektive e cila vlerësohet në datën, në të cilën Komisioni merr vendimin e tij, janë vlerësimet e bëra në atë datë që duhet të merren parasysh për të ushtruar këtë kontroll gjyqësor.

Në mungesë të çdo mundësie për të krahasuar situatën e një kompanie që i është besuar një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik, me atë të një grupi privat kompanish që nuk operojnë në një sektor të rezervuar, “kushtet normale të tregut”, të cilat janë domosdoshmërisht hipotetike, duhet të vlerësohen duke iu referuar elementeve objektive dhe të verifikueshme që janë në dispozicion.

Në ato rrethana, Gjykata u shpreh se Komisioni me të drejtë ishte në gjendje të bazonte vendimin e tij në të dhënat e vetme në dispozicion të tij, domethënë ato që dilnin nga raporti i një firme konsulence, të cilat bënë të mundur llogaritjen e shpenzimeve të kryera nga kompania.

86 Aktualisht 107 paragrafi 1, TFBE.

Përdorimi i të dhënave të tilla mund të jetë i hapur për kritika vetëm nëse vërtetohet se ato bazoheshin në vlerësime haptazi të gabuara.

3.3. Z.Z. kundër SEKRETARIT TË SHTETIT PËR PUNËT E BRENDSHME

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C-300/11

4 qershor 2013

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=137981&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13708632>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: *Një person ndaj të cilit merret një masë dëbimi me arsyetimin e rrezikut ndaj interesit të përgjithshëm, duhet të ketë mbrojtje ligjore efektive dhe të mund të dijë për këtë qëllim thelbin e arsyeve dhe të provave mbi të cilat është marrë vendimi i dëbimit.*

Faktet kryesore

Ankuesi ZZ ka kombësi të dyfishtë, franceze dhe algjeriane. Ai ishte i martuar që nga viti 1990 me një shtetase të Mbretërisë së Bashkuar, me të cilën kishte tetë fëmijë, të moshës 9 deri në 20 vjeç, në datën e paraqitjes së kërkesës për një vendim paraprak. Nga viti 1990 deri në vitin 2005, ZZ banonte ligjërish në Mbretërinë e Bashkuar. Në vitin 2004, Sekretari i Shtetit i dha atij të drejtën e qëndrimit të përhershëm në territorin e këtij shteti anëtar.

Pasi ZZ u largua nga Mbretëria e Bashkuar për në Algjeri në gusht 2005, Sekretari i Shtetit vendosi të anulonte të drejtën e tij të qëndrimit dhe t'i mohonte atij hyrjen në territorin e Mbretërisë së Bashkuar me arsyetimin se prania e tij ishte në dëm të interesit të përgjithshëm. SIAC (Komisioni i Posaçëm i Ankimeve për Imigracionin) kishte vendosur që ZZ nuk kishte të drejtë ankese kundër këtij vendimi të anulimit.

Në shtator 2006, ZZ udhëtoi për në Mbretërinë e Bashkuar, ku Sekretari i Shtetit vendosi të refuzonte hyrjen sipas nenit 19.1 të Rregullores së Imigrimit për arsye të sigurisë publike (në tekstin e mëtejshëm: “Vendimi i refuzimit”). Pas këtij vendimi, ZZ u kthye në Algjeri. Në datën e paraqitjes së kësaj kërkesë për një vendim paraprak, ai banonte në Francë.

ZZ apeloi kundër Vendimit të refuzimit, që u refuzua nga SIAC me arsyetimin se ky vendim ishte i justifikuar për arsye të rëndësishme të sigurisë publike. Para SIAC, ai përfaqësohej nga avokatë që i kishte zgjedhur vetë (në tekstin e mëtejshëm: “avokatë personalë”).

Në kuadrin e këtij apeli, Sekretari i Shtetit kundërshtoi vënien në dijeni të ankuesit me materialet, mbi të cilat ai kundërshtoi apelin e ZZ. Në përputhje me rregullat e procedurës të zbatueshme para SIAC, u emëruan dy “avokatë specialë” për të përfaqësuar interesat e ankuesit. Ata u këshilluan me të në bazë të “provave publike”, pra të provave që nuk ishin kufizuar nga Sekretari i Shtetit.

Më pas, informacioni që nuk iu bë i njohur ZZ, dhe në të cilin u bazua vendimi i refuzimit iu bë i njohur avokatëve specialë, të cilëve u ndalohej të këshilloheshin përsëri me ZZ ose avokatët e tij personalë apo t’ua bënë ditura informacionet pa autorizimin e SIAC. Në kuadrin e këtyre kufizimeve, avokatët specialë do të përfaqësonin interesat e ZZ para SIAC në lidhje me këto “prova konfidenciale”.

SIAC mbajti një seancë me dyer të mbyllura, në mungesë të ankuesit dhe të avokatëve të tij personalë, por në prani të avokatëve të tij specialë, ku shqyrtoi se deri në çfarë mase vënia në dijeni e ZZ për “provat konfidenciale”, në të cilat mbështetej Sekretari i Shtetit do të ishte në kundërshtim me interesin publik. Një seancë e ngjashme u zhvillua edhe përkitazi me apelin e ankuesit.

SIAC hodhi poshtë ankesën e ZZ dhe dha një vendim “publik” dhe një vendim “konfidencial”, ky i fundit i ishte bërë i njohur vetëm Sekretarit të Shtetit dhe avokatëve specialë të ZZ. Në vendimin publik, SIAC vuri në dukje, në veçanti, se “disa nga provat e çështjes kundër” ZZ, iu bënë të njohura atij dhe se këto nuk kishin të bënin me “aspektet kryesore”. Nga vendimi publik dilte se SIAC ishte i bindur që ZZ ishte përfshirë në

aktivitetet e rrjetit të Grupit Islamik të Armatosur dhe në aktivitete terroriste në vitet 1995 dhe 1996. Në lidhje me elementet faktike që iu zbuluan ZZ, nga vendimi del se objekte për të cilat ky i fundit kishte pranuar se ishin ose kishin qenë pronë e tij, ishin zbuluar në Belgjikë në vitin 1995, në vende të marra me qira nga një ekstremist i njohur, ku kishte një sasi të caktuar armësh dhe municionesh. Në lidhje me faktet e tjera të pretenduara nga Sekretari i Shtetit, të tilla si, në veçanti, qëndrimi në Itali si dhe në Belgjikë, kontaktet me persona të caktuar dhe posedimi i shumave të mëdha të parave, SIAC, konsideroi të besueshme dhe relevante qëndrimet e ZZ dhe dëshmitë që ofroi. Sidoqoftë, pretendimet e ngritura nga ky i fundit në lidhje me përfshirjen e tij në aktivitetet e rrjetit në fjalë nuk u pranuan nga SIAC, për arsye të shpjeguara veçanërisht në vendimin konfidencial.

Në vendimin e tij publik, SIAC arriti në përfundimin se “për arsye të cilat shpjegohen vetëm në gjykimin konfidencial”, ai kishte “fituar bindjen se sjellja personale e ZZ përfaqëson një kërcënim real, aktual dhe mjaft serioz, i cili cenon një interes themelor të shoqërisë, domethënë sigurinë e tij publike, dhe se kjo tejkalon të drejtën e parashtruesit dhe familjes së tij për të gëzuar jetën e tyre familjare në Mbretërinë e Bashkuar”.

ZZ e apeloj këtë vendim në Gjykatën e Apelit (Angli dhe Uells) (Divizioni Civil), megjithëse e gjeti të mbështetur vendimin e SIAC, ngriti pyetjen nëse ishte e lejueshme që SIAC të mos i bënte të njohura ZZ thelbin e arsyeve që përbënin bazën e vendimit të refuzimit. Në këto kushte, Gjykata e Apelit (Angli dhe Uells) (Divizioni Civil) vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i referojë Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE) pyetjen e mëposhtme për një vendim paraprak Gjykatës:

“Parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore, i përcaktuar në nenin 30 (2) të Direktivës 2004/38, i interpretuar në dritën e nenit 346.1, (a) të TFBE-së, a kërkon që një gjykatë që shqyrton apelin kundër një vendimi refuzimi ndaj një qytetari të BE-së për të hyrë në territorin e një Shteti Anëtar për arsye të rendit publik dhe sigurisë publike në zbatim të Kapitullit VI të Direktivës 2004/38 të sigurojë që thelbi i arsyeve të dhëna kundër këtij qytetari të BE t’i bëhet me dije, pavarësisht faktit se autoritetet e Shtetit Anëtar dhe gjykata kompetente kombëtare, pasi shqyrjuan të gjitha provat e mbështetura nga autoritetet e Shtetit Anëtar kundër tij, arritën në përfundimin se arsyet e sigurisë së Shtetit nuk justifikojnë zbulimin e këtyre arsyeve?”

Vendimi i Gjykatës

Megjithëse, sidomos sipas nenit 4.2 TBU, siguria kombëtare mbetet përgjegjësi e ekskluzive e secilit shtet anëtar dhe prandaj u takon shteteve anëtare të miratojnë masat e duhura për të siguruar sigurinë e tyre të brendshme dhe të jashtme, thjesht fakti që një vendim i marrë nga një autoritet kompetent kombëtar ka të bëjë me sigurinë e shtetit nuk mund të sjellë pazbatueshmërinë e së drejtës së BE-së.

Nenet 30.2 dhe 31 të Direktivës 2004/38, mbi të drejtën e qytetarëve të BE dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, lexuar në dritën e nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (Kartës), duhet të interpretohet ashtu që kërkon nga gjyqtari kombëtar kompetent të sigurojë që mosvënien në dijeni, nga autoriteti kompetent kombëtar, e personit në fjalë për arsyet e sakta dhe të plota, mbi të cilat bazohet një vendim i marrë sipas nenit 27 të asaj direktive është i justifikuar, dhe se provat mbështetëse janë kufizuar në atë masë sa është rreptësisht e nevojshme dhe që personit të interesuar t'i komunikohet, në çdo rast, thelbi i atyre arsyeve në një mënyrë që merr parasysh siç duhet konfidencialitetin e provave.

Është detyrë e autoritetit kombëtar kompetent që të sigurojë, në përputhje me rregullat procedurale kombëtare, prova se siguria e shtetit do të komprometohej në fakt nëse personave të interesuar u bëheshin të ditura arsyet e sakta dhe të plota që përbëjnë bazën e një vendimi të marrë në zbatim të nenit 27 të Direktivës 2004/38 dhe provat përkatëse. Kjo do të thotë që nuk ka asnjë prezumim në favor të ekzistencës dhe vlefshmërisë së arsyeve të dhëna nga një autoritet kombëtar. Gjyqtari kombëtar kompetent duhet të kryejë një shqyrtim të pavarur të të gjithë elementëve të ligjit dhe faktit, të referuara nga autoriteti kompetent kombëtar, dhe ai duhet të vlerësojë, në përputhje me rregullat procedurale kombëtare, nëse siguria e shtetit kundërshton vënien në dijeni të personit të interesuar.

Nëse rezulton se siguria shtetërore pengon vënien në dijeni të personit të interesuar mbi këto arsye, shqyrtimi gjyqësor i ligjshmërisë së një vendimi të marrë në përputhje me nenin 27 të Direktivës 2004/38,

siç parashikohet në nenin 31.1 të saj, duhet kryer në kuadër të një procedure, e cila balancon në mënyrë të duhur kërkesat e sigurisë së shtetit me ato të së drejtës për një mbrojtje efektive gjyqësore, duke e kufizuar çdo ndërhyrje në ushtrimin e kësaj të drejte, vetëm në çka është rreptësisht e nevojshme.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh nenin 47 të Kartës, procedura në fjalë duhet të garantojë, në masën më të madhe të mundshme, respektimin e parimit të kontradiktorialitetit, në mënyrë që të lejojë personin në fjalë të kundërshtojë arsyet, mbi të cilat bazohet vendimi në fjalë, si dhe për të paraqitur vëzhgime mbi provat në lidhje me të dhe, për këtë arsye, për të paraqitur argumentet e tij të mbrojtjes. Në veçanti, është e rëndësishme që personi në fjalë të informohet, në çdo rast, për thelbin e arsyeve mbi të cilat bazohet një vendim që refuzon hyrjen, sipas nenit 27 të Direktivës 2004/38. Nevoja për mbrojtjen e sigurisë shtetërore nuk mund të ketë efekt në privimin e personit në fjalë nga e drejta e tij për t'u dëgjuar dhe, për rrjedhojë, duke e bërë të paefektshme të drejtën e tij të apelit, siç parashikohet në nenin 31 të asaj direktive.

Ky balancim i së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore dhe interesit të mbrojtjes së sigurisë së shtetit në fjalë, nuk zbatohet në të njëjtën mënyrë për provat në themel të arsyeve të paraqitura para gjykatës kompetente kombëtare. Në fakt, në raste të caktuara, zbulimi i këtyre provave ka të ngjarë të rrezikojë drejtpërdrejt dhe veçanërisht sigurinë e shtetit sepse mund të rrezikojë jetën, shëndetin ose lirinë e personave ose të zbulojë metodat hetimore të përdorura posaçërisht nga autoritetet e sigurimit kombëtar dhe kështu të pengojë seriozisht, apo edhe parandalojë, përmbushjen e detyrave të këtyre autoriteteve.

Në ato rrethana, i takon gjykatës kombëtare kompetente, nga njëra anë, të sigurojë që thelbi i arsyeve që formojnë bazën e vendimit në fjalë t'i komunikohet personit në fjalë, në një mënyrë që merr parasysh siç duhet konfidencialitetin e provave dhe, nga ana tjetër, për të nxjerrë, sipas ligjit kombëtar, pasojat e çdo shkelje të këtij detyrimi.

•

3.4. REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË kundër AGJENCISË EVROPIANE TË PRODUKTEVE KIMIKE (ECHA)

**Vendim i Tribunalit
Çështja T-755/17**

20 shtator 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=T-755/17&language=EN>]

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Gjykata vlerësoi se Dhoma e Ankesave e Agjencisë Evropiane të Produkteve Kimike përbënte një mjet efektiv për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të vetë Agjencisë.

Faktet kryesore

Pas miratimit nga Agjencia Evropiane e Produkteve Kimike (në tekstin e mëtejshëm: ECHA) të një vendimi që kërkonte informacion shtesë nga kompanitë që regjistruan benpatin (një produkt kimik i rrezikshëm) në ECHA, këto kompani iu drejtuan Dhomës së Ankesave të Agjencisë, gjë që çoi në anulimin e pjesshëm të vendimit. Me ankimit e saj para Tribunalit, Republika Federale e Gjermanisë kërkoi anulimin e vendimit të Dhomës së Ankesave të ECHA-s, kryesisht, për shkak të mungesës së juridiksionit të asaj Dhome për të vendosur mbi ankesat që synojnë të demonstrojnë ekzistencën e gabimeve materiale të një vendimi të ECHA-s. Meqenëse argumentet e shtetit anëtar kërkues dështuan, ankesa u hodh poshtë pjesërisht nga Tribunali, i cili vendosi që Dhoma e Ankesave e ECHA-s është kompetente për të shqyrtuar këto pretendime.

Vendimi i Gjykatës

Së pari, Tribunali kujtoi, duke pasur parasysh në veçanti emërimin e anëtarëve të Dhomës së Ankesave në fjalë, në bazë të përvojës së tyre dhe aftësive të tyre shkencore dhe juridike, se ajo Dhomë ka ekspertizën e nevojshme për të proceduar me vlerësimet e elementeve të një natyre shkencore, dhe se kjo ekspertizë synon të sigurojë arritjen e një vlerësimi të balancuar si të aspekteve ligjore, ashtu edhe teknike.

Së dyti, Tribunali vuri në dukje se as Rregullorja nr. 1907/2006 dhe as Rregullorja nr. 771/2008 (2) nuk parashikojnë rregulla të veçanta në lidhje me ankesat kundër vendimeve për vlerësimin e substancave.

Së treti, Tribunali vlerësoi se objektivat e ndjekur nga mundësia e paraqitjes së një apeli para Dhomës së Ankesave, kundër një vendimi të ECHA-s, janë në favor të kompetencës së asaj Dhome për të shqyrtuar pretendimet që kërkojnë të demonstrojnë ekzistencën e gabimeve materiale në një vendim. Tribunali vlerësoi se intensiteti i kontrollit të kryer nga Dhoma e Ankesave e ECHA-s ishte më i madh se ai i një kontrolli të kryer nga gjyqtari i BE-së, pasi kompetencat e Dhomës nuk kufizohen në verifikimin e ekzistencës së gabimeve të dukshme, por shtrihet në verifikimin e aspekteve teknike të një vendimi që kërkon informacion shtesë. Për më tepër, një kompetencë e kufizuar e Dhomës së Ankesave të ECHA-s do të rezultonte në faktin se Dhoma në fjalë nuk do të ishte në gjendje të kryejë funksionin e saj, që konsiston në kufizimin e proceseve gjyqësore para gjyqtarëve të BE-së, duke garantuar gjithsesi të drejtën për një mjet efektiv. Kjo do të binte ndesh me rastet që tashmë kanë përfituar nga një shqyrtim i dyfishtë, domethënë, së pari, nga ajo Dhomë dhe, së dyti, nga Tribunali.

Së katërti dhe e fundit, Tribunali vendosi që një juridiksion i kufizuar i Dhomës së Ankesave të ECHA-s nuk do të garantonte një mjet efektiv sipas kuptimit të paragrafit 1 të nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Pasi kujtoi se Dhoma e Ankesave kufizohet në shqyrtimin gjyqësor të argumenteve të paraqitura që mund të demonstrojnë ekzistencën e një gabimi që dëmton vendimin e kontestuar, Tribunali vlerësoi se, po të kufizohej juridiksioni, pretendimet mbi ekzistencën e gabimeve materiale të një vendimi të ECHA-s nuk mund të ngrihen si duhet në kuadrin e një padie për anulim para Tribunalit kundër një vendimi të Dhomës. Një kompetencë e kufizuar e Dhomës së Ankesave, për më tepër, do të çonte në paraqitjen e ankesave të panevojshme para kësaj Dhome, në kuptimin që ankuesit që pretendojnë anulimin e një vendimi të ECHA-s duke pretenduar gabime materiale, duhet t'i drejtoheshin asaj Dhome, por këto ankesa do të refuzoheshin sistematikisht.

Në këto kushte, Tribunali e hodhi poshtë këtë pretendim të Qeverisë së Republikës Federale Gjermane.

3.5. KOMISIONI EVROPIAN kundër IRLANDËS

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C-261/18

12 nëntor 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=220533&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13709431>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Me këtë vendim Gjykata shprehet se vonesat në ekzekutimin e një vendimi të saj nga një shtet anëtar kanë shkelur parimet e gjyqimit të drejtë dhe të efikasitetit të së drejtës evropiane.

Faktet kryesore

Në vendimin e saj të 3 korrikut 2008, *Komisioni kundër Irlandës*⁸⁷, Gjykata vendosi që Irlanda nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas neneve 2, 4 dhe 5-10 të Direktivës 85/337, sepse nuk kishte marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që:

- para ekzekutimit të tyre të plotë ose të pjesshëm, projektet që përfshihen në fushën e Direktivës 85/337⁸⁸, në versionin e saj para ose pas modifikimeve nga Direktiva 97/11, duhet t'i nënshtrohen një rishikimi për të përcaktuar nëse duhet të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe më pas, kur ato ka të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme në mjedis si rezultat i natyrës, shtrirjes ose vendndodhjes së tyre, t'i nënshtrohen një vlerësimi në lidhje me ndikimin e tyre, në përputhje me nenet 5 deri në 10 të asaj Direktive, dhe

- dhënia e lejeve në lidhje me ndërtimin e një parku energjetik me erë dhe aktivitete të ngjashme në Derrybrien, në County Galway (Irlandë),

87 Çështja C-215/06, BE: C: 2008: 380.

88 Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e efekteve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis, (OJ 1985, L 175, f. 40).

si dhe kryerja e punimeve të paraprihet nga një vlerësim i ndikimit të projektit në mjedis, në përputhje me nenet 5 deri në 10 të asaj direktive.

Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje edhe në lidhje me ankesën e dytë që kishte të bënte me dështimin për të vlerësuar efektet në mjedis të parkut energjetik me erë dhe aktivitetet e lidhura me të në Derrybrien⁸⁹.

Në veçanti, në lidhje me dy fazat e para të ndërtimit të projektit të parkut energjetik me erë, Gjykata deklaroi, në paragrafin 98 të atij vendimi, se Irlandës i kërkohet të paraqiste projektet në lidhje me atë ndërtim në një studim të efekteve nëse këto projekte kishin ose kishte të ngjarë të kenë efekte të rëndësishme në mjedis, veçanërisht për shkak të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tyre.

Në lidhje me këtë, ajo vendosi, në paragrafin 103 të vendimit, se vendndodhja dhe shtrirja e projekteve për punimet e nxjerrjes së dherave, ndërtimi i rrugëve dhe afërsia e vendit me një lumë ishin elementë që vërtetonin se këto projekte, të pandashme nga instalimi i 46 turbinave me erë, kishin të ngjarë të krijonin efekte të konsiderueshme në mjedis dhe për këtë arsye duhet t'i nënshtroheshin një vlerësimi të efekteve të tyre në mjedis.

Për më tepër, në lidhje me kërkesën për leje në lidhje me fazën e tretë të ndërtimit të parkut energjetik me erë dhe modifikimin e dy fazave të para të ndërtimit të autorizuar fillimisht, Gjykata konstatoi, në paragrafin 110 të atij vendimi, se instalimi i 25 turbinave të reja, ndërtimi i rrugëve të reja të shërbimit si dhe ndryshimi i llojit të turbinave me erë, të lejuara fillimisht, dhe që synonin rritjen e prodhimit të energjisë elektrike, përderisa kishin të ngjarë të krijonin ndikime të rëndësishme në mjedis, duhet t'i nënshtroheshin një procedure aplikimi për leje dhe një vlerësimi të ndikimit të tyre në mjedis para se të autorizohen, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 5 deri në 10 të Direktivës 85/337.

89 Ibid., paragrafët 94 deri në 111.

Pas dhënies së këtij vendimi të 3 korrikut 2008, *Komisioni kundër Irlandës*, me një letër të 15 korrikut 2008, Komisioni i kërkoi Irlandës që t'i ofronte asaj, brenda dy muajve nga data e këtij vendimi, informacion mbi masat e marra për ekzekutimin e tij. Me letrën e 3 shtatorit 2008, Irlanda konfirmoi veçanërisht se e pranon plotësisht këtë vendim dhe se një vlerësim i përditësuar i ndikimit në mjedis, në përputhje me Direktivën 85/337, ishte planifikuar para fundit të vitit 2008.

Me letrat e 10 marsit dhe 17 prillit 2009, Irlanda e informoi Komisionin se po përgatiste një projekt legjislativ në mënyrë që të parashikonte një procedurë lejesh që lejonte, në raste të veçanta, modifikimin e lejeve të dhëna në shkelje të Direktivës 85/337, duke lëshuar një “leje zëvendësuese” dhe se, në zbatim të kësaj procedure, operatori i parkut energjetik me erë do të kërkonte një autorizim të tillë.

Më 26 qershor 2009, Komisioni i dërgoi një letër zyrtare Irlandës, në të cilën ai vuri në dukje, nga njëra anë, se kishte marrë vetëm një draft paraprak të legjislacionit që do të miratohej nga Irlanda me qëllim që të siguronte ekzekutimin e vendimit të 3 korrikut 2008, dhe, nga ana tjetër, që ai nuk kishte ende informacion mbi vlerësimin e planifikuar të ndikimit mjedisor të parkut energjetika me erë. Më 9 shtator 2009, Irlanda iu përgjigj kësaj letre, duke konfirmuar, nga njëra anë, se ndryshimi legjislativ i cili do të fuste procedurën e zëvendësimit do të miratohej së shpejti dhe, nga ana tjetër, se operatori i parkut energjetik me erë kishte dhënë pajtueshmërinë e tij në parim me qëllim paraqitjen e një kërkesë për një autorizim zëvendësues.

Më 22 mars 2010, Komisioni i dërgoi një letër tjetër Irlandës, duke i kërkuar që t'i dërgonte vërejtjet e saj brenda dy muajve nga marrja e asaj letre. Irlanda u përgjigj më 18 maj, 22 korrik dhe 13 shtator 2010. Në letrën e fundit, autoritetet irlandeze informuan Komisionin për miratimin, në korrik 2010, të Aktit të Planifikimit dhe Zhvillimit 2010 (në tekstin e mëtejshëm: “PDAA”). Pjesa XA e PDAA, në veçanti nenet 177B dhe 177C, parashikon një procedurë për rregullimin e autorizimeve të dhëna në kundërshtim me detyrimin për të vlerësuar ndikimet mjedisore.

Pas shkëmbimeve të mëtejshme midis autoriteteve irlandeze dhe Komisionit dhe njoftimit nga Irlanda për masa shtesë legjislative të

miratuara midis 2010 dhe 2012, Komisioni, me letrën e 19 shtatorit 2012, në veçanti i kërkoi Irlandës ta informonte nëse autoriteti kontraktues i parkut energjetik me erë do t'i nënshtrohej kësaj procedure të rregullimit.

Me letrën e 13 tetorit 2012, Irlanda tregoi se operatori i parkut energjetik me erë, në pronësi të plotë të një kompanie gjysmë publike, nuk pranoi të zbatonte procedurën e rregullimit lejes të parashikuar në Pjesën XA të PDAA dhe se as e drejta irlandeze dhe as ajo e BE-së nuk mund të kërkonin vënien në dyshim të lejeve të dhëna për ndërtimin e parkut energjetik me erë, të cilat janë bërë përfundimtare, dhe se parimi i sigurisë juridike të mos prapaveprueshmërisë së ligjit, si dhe praktika e Gjykatës në lidhje me autonominë procedurale të shteteve anëtare do të kundërshtonte tërheqjen e atyre lejeve.

Me letrën e 16 dhjetorit 2013, autoritetet irlandeze informuan Komisionin se operatori i parkut energjetik me erë kishte treguar se ishte i përgatitur për të kryer një vlerësim 'jozyrtar' të ndikimit të këtij parku me erë në mjedis, i cili megjithatë do të ishte në përputhje me kërkesat e Direktivës 85/337. Më 2014, Irlanda i dërgoi Komisionit një "koncept dokument" i cili përcaktonte një "udhërrëfyes" për procedurën e vlerësimit "jozyrtar" të ndikimeve të parkut energjetik me erë në mjedis. Irlanda gjithashtu mori përsipër, gjatë një takimi me Komisionin më 13 maj 2014, t'i komunikojë këtij të fundit draftin e një "memorandumi mirëkuptimi" i cili do të nënshkruhej midis operatorit të parkut energjetik me erë dhe Ministrit Irlandez për Mjedisin për një marrëveshje për të kryer një analizë jozyrtare mjedisore. Një draft i tillë iu komunikua Komisionit më 11 mars 2015 dhe më 7 mars 2016.

Komisioni në disa raste deklaroi se këto dokumente nuk mjaftonin që Irlanda të përmbushte detyrimet e saj. Me postë elektronike të 15 dhjetorit 2016, pas një takimi të 29 nëntorit 2016, shërbimet e Komisionit informuan autoritetet irlandeze se teksti përfundimtar i memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar duhet të arrinte në Komision deri në fund të vitit 2016 dhe se, përndryshe, ky i fundit mund t'i drejtohej përsëri Gjykatës në fillim të vitit 2017.

Më 22 dhjetor 2016, Irlanda i dërgoi Komisionit një version të ri të "Koncept Dokumentit" si dhe një "Dokument Fushëveprimi", të 2

dhjetorit 2015. Në letrën përcjellëse, autoritetet irlandeze treguan se nënshkrimi i këtyre dy dokumenteve ishte planifikuar për në fund të janarit 2017. Pas shkëmbimeve të mëtejshme me autoritetet irlandeze, Komisioni, me letrën e 26 janarit 2018, informoi Irlandën se, pavarësisht nënshkrimit të ‘dokumentit konceptual’, ai vlerëson se Irlanda vazhdon të mos respekton detyrimin e saj për të zbatuar plotësisht vendimin e 3 korrikut 2008, *Komisioni kundër Irlandës*. Nëntë vjet pas dhënies së këtij vendimi, asnjë përparim thelbësor nuk ishte bërë në vlerësimin e ndikimit të parkut energjetik me erë në mjedis.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se pas dhënies së vendimit të vitit 2008, Irlanda kishte miratuar një procedurë për rregullimin e situatës, përmes së cilës kërkoi t’i mundësonte operatorit të parkut energjetik me erë në Derrybrien që të pajtohej me kërkesat e Direktivës 85/337. Megjithatë, meqenëse operatori i parkut energjetik me erë nuk i ishte nënshtruar kësaj procedure dhe se kjo e fundit nuk ishte filluar sipas angazhimit zyrtar nga autoritetet irlandeze, Komisioni bëri një ankesë të dytë në Gjykatë.

Gjykata së pari shqyrtoi detyrimet që u takojnë shteteve anëtare kur një projekt është autorizuar në kundërshtim me detyrimin e vlerësimit paraprak të efekteve të tij në mjedis, të parashikuar në Direktivën 85/337. Gjykata kujtoi se shteteve anëtare u kërkohet, në bazë të parimit të bashkëpunimit të singertë, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të korrigjuar moskryerjen e një vlerësimi të ndikimit në mjedis. Në veçanti, ato janë të detyruar të kryejnë një vlerësim për qëllimet e lejes si dhe, gjithashtu, edhe pas vënies në punë të një instalimi. Një vlerësim i tillë duhet të marrë parasysh jo vetëm efektet e ardhshme të instalimit në fjalë, por edhe efektet mjedisore që janë shfaqur që nga përfundimi i tij. Kjo mund të çojë në ndryshimin ose tërheqjen e lejeve të dhëna në kundërshtim me detyrimin e vlerësimit paraprak.

Megjithatë, pavarësisht reformës legjislative që parashikoi një procedurë rregullimi, Irlanda nuk kishte kryer një vlerësim të ri të ndikimit të parkut energjetik me erë në mjedis, gjë që injoronte autoritetin e vendimit të vitit 2008.

Pastaj, Gjykata hodhi poshtë argumentet e ndryshme të parashtruara nga Irlanda për të justifikuar veten. Nga njëra anë, Irlanda nuk mund të mbështetet në dispozitat kombëtare që kufizojnë mundësitë për fillimin e procedurës së rregullimit të miratuar me qëllim ekzekutimin e vendimit të vitit 2008. Në këtë kontekst, Gjykata kujtoi se autoriteteve kombëtare u kërkohet të korrigjohin mosveprimin lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe se detyrimet që rrjedhin nga Direktiva 85/337 u vendosën gjithashtu mbi operatorin e parkut energjetik me erë, për aq sa kontrollohej nga Irlanda. Nga ana tjetër, megjithëse lejet për ndërtimin e parkut energjetik me erë në Derrybrien janë bërë përfundimtare, siguria ligjore dhe pritshmëria legjitime e operatorit të parkut energjetik me erë në të drejtat e fituara, nuk mund të mbështeten nga Irlanda për “ta përjashtuar nga pasojat që dalin nga konstatimi objektiv i mospërputhjes me Direktivën 85/337”. Në këtë drejtim, Gjykata theksoi se projektet, lejimi i të cilave nuk i nënshtrohet më proceseve gjyqësore direkte, nuk mund të konsiderohen thjesht të lejuara ligjërisht në lidhje me detyrimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes, kur kanë kaluar më shumë se njëmbëdhjetë vjet që nga vendimi i vitit 2008 pa u miratuar masat e nevojshme për të qenë në përputhje me të, dhe duke pasur parasysh aftësinë e Irlandës për të paguar, Gjykata e urdhëroi atë shtet anëtar t’i paguajë Komisionit një shumë prej 5,000,000 eurosh si dhe një gjobë prej 15,000 eurosh në ditë nga dhënia e vendimit deri në datën e ekzekutimit të vendimit të vitit 2008.

3.6. BANCO DE SANTANDER SA

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështja C-274/14

21 janar 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=222403&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13709623>]

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: Në këtë vendim, Gjykata sqaron se cilat janë tiparet e një organi në mënyrë që ai të mund të konsiderohet gjykatë sipas së drejtës së BE-së

Faktet kryesore

Në maj 2002, Banco de Santander Central Hispano SA (në tekstin e mëtejshëm: “Banco de Santander”), kompania mëmë e grupit fiskal 17/89, fitoi 100% të aksioneve në “AKB Holding GmbH” (në tekstin e mëtejshëm: “AKB”), kompani e themeluar sipas ligjit gjerman. Kjo blerje, çmimi i së cilës ishte 1,099,999,999 euro, ndërsa vlera kontabël e “AKB”-së u vlerësua në 183,909,000 euro, krijoi një mbivlerë financiare prej 916,091,000 euro (në tekstin e mëtejshëm: “mbivlera në fjalë”).

“AKB”, si kompani holding, ruajti një pjesëmarrje në kompanitë e mëposhtme, të gjitha të krijuara brenda BE-së, përkatësisht “AKB Datensysteme GmbH”, “AKB Autobörse AG”, “AKB Leasing GmbH”, “AKB Versicherungsdienst GmbH”, “AKB Privat und Handelsbank Aktien AG”, “AKB Vermögensverwaltung GmbH” dhe “AKB Marketing Services sp. z o.o”.

Gjatë muajit dhjetor 2002, “Banco de Santander” ia transferoi aksionet e “AKB”-së, çmimi i blerjes të të cilave ishte burimi i mbivlerës në fjalë, te “Holneth BV”, një kompani e themeluar sipas ligjit holandez, dhe “Santander Consumer Finance SA” (në tekstin e mëtejshëm: “SCF”), një

kompani e themeluar sipas ligjit spanjoll. Të dy këto kompani i përkasin grupit fiskal 17/89.

Duke pasur parasysh mbivlerën në fjalë, grupi fiskal 17/89 bëri zbritje në deklaratat e tij tatimore mbi të ardhurat e korporatave për vitet financiare 2002 dhe 2003, në zbatim të nenit 12 (5) të Ligjit Spanjoll të Detyrimeve Tatimore të Kompanive⁹⁰. Pas kontrollit nga autoritetet tatimore, këto zbritje për këto dy vite financiare u justifikuan vetëm pjesërisht dhe, “Banco de Santander” dhe “SCF” u njoftuan të bënin pagesën e detyrimeve tatimore për pjesën e pajustificuar.

Më 16 gusht 2010, “Banco de Santander” u ankua kundër këtij njoftimi për pagesë pranë Tribunal Económico-Administrativo Central⁹¹ (në tekstin e mëtejshëm: “TEAC”), duke argumentuar se mbivlera në fjalë, pavarësisht nga natyra e saj indirekte që rezulton nga fakti se blerja që e krijoi atë, kishte të bënte me një kompani holding, duhet zbritur nga taksa e kompanive sipas kushteve aktuale të nenit 12.5 të Ligjit të rishikuar për Tatimet e Korporatave (në tekstin e mëtejshëm: “TRLIS”). Ajo iu referua interpretimeve të mëparshme të nenit 12.5 të TRLIS nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Spanjë (në tekstin e mëtejshëm: DPT) dhe të vetë TEAC. Si edhe Vendimin 2011/5 të Komisionit të 28 tetorit 2009 mbi zbritjen tatimore të mbivlerave financiare në rast të pjesëmarrjes në kapitalet e kompanive të huaja, siç zbatohet nga Spanja⁹².

TEAC konsideroi se interpretimi administrativ, i cili më parë kundërshtonte aplikimin e zbritjes së taksës për blerjet indirekte të pronave, nuk përbën një burim ligjor. Në fakt, as DPT, as TEAC nuk do t’i përkisnin pushtetit legjislativ ose gjyqësor. Interpretimet e miratuara nga këto organe nuk janë përfundimtare, pasi ato i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykatat. Për më tepër, Tribunal Supremo⁹³ nuk kishte vendosur ende mbi zbatueshmërinë e nenit 12.5 të TRLIS për investimet indirekte në kapital.

90 Ley 43/1995, Reguladora del Impuesto de Sociedades, i ndryshuar.

91 Tribunali qendror ekonomik-administrativ.

92 OJ 2011, L 7, f. 48.

93 Gjykata Supreme në Spanjë.

Ky problem ka qenë objekt i disa vendimeve të njëpasnjëshme të pezullimit të procedurës. Këto u morën kryesisht me arsyetimin se TEAC, i cili pasi i riformuloi dy herë pyetjet drejtuar Gjykatës, tani shtoi edhe pyetjen mbi ndikimin e mundshëm të *pavlefshmërisë së Vendimit 2011/5, dhe të vendimeve të ngjashme të mëvonshme të Komisionit. Gjykata konstatoi pra se kërkesa për një vendim paragjykues në thelb kishte të bënte me interpretimin dhe vlefshmërinë e këtyre vendimeve të Komisionit në fushën e ndihmës shtetërore në lidhje me sistemin spanjoll të zbritjes ose amortizimit fiskal në rast të krijimit të një mbiulere financiare në rast investimesh në kapital të huaj. Vendimet e lartpërmendura të Komisionit ishin në shqyrtim e sipër para vetë Gjykatës në një sërë çështjesh në ato momente. Pavarësisht nga ky fakt i fundit, duke pasur parasysh në veçanti praktikën gjyqësore të Gjykatës pas kësaj kërkesë për një vendim paraprak dhe dyshimet e shprehura nga Komisioni lidhur me klasifikimin e TEAC si një «gjykatë» sipas kuptimit të nenit 267 të TFBE-së, dhe, Gjykata u shpreh se duhet ta merrte në shqyrtim këtë rast me qëllim që të shqyrtonte nëse TEAC përfshihej në këtë klasifikim.*

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konsideroi se ishte e nevojshme, si pikë paraprake, të shqyrtohej, në dritën e zhvillimeve të fundit në praktikën e saj gjyqësore⁹⁴, nëse organi referues mund të cilësohej si “gjykatë” sipas kuptimit të nenit 267 të TFBE-së.

Gjykata kujtoi që në fillim se ky cilësim nënkupton, në veçanti, se organi referues plotëson kriterin e pavarësisë. Në të vërtetë, pavarësia e gjykatave kombëtare përgjegjëse për zbatimin e ligjit të BE-së është thelbësore për funksionimin e duhur të sistemit të bashkëpunimit gjyqësor, **të mishëruar në mekanizmin e vendimit** paragjykimor **të parashikuar në nenin 267** të TFBE-së dhe ky mekanizëm nuk mund të vihet në lëvizje vetëm nga një organ përgjegjës për zbatimin e së drejtës së BE-së, i cili plotëson, në veçanti, këtë kriter të pavarësisë.

⁹⁴ Gjykata iu referua veçanërisht vendimeve të 16 shkurtit 2017, *Margarit Panicello* (C - 503/15, BE: C: 2017: 126), të 27 shkurtit 2018, *Associação Sindical dos Juizes Portugueses* (C -64 /16, BE: C: 2018: 117), dhe të 24 qershorit 2019, *Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme)* (C-619/18, BE: C: 2019: 531).

Për sa i përket, në radhë të parë, aspektit të jashtëm të konceptit të “pavarësisë”, Gjykata theksoi se ky koncept kërkon që organi në fjalë të ushtrojë funksionet e tij në autonomi të plotë, pa iu nënshtruar asnjë lidhjeje ose varësie hierarkike dhe pa marrë urdhra ose udhëzime, që nënkupton, në veçanti, parashikimin e rasteve të shkarkimit të anëtarëve të tij me dispozita të qarta legislative që ofrojnë garanci dhe që plotësojnë kërkesat e parimit të moslargimit, parim thelbësor i pavarësisë së gjyqtarëve. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se anëtarët e organit referues mund të shkarkohen me dekret mbretëror të miratuar në Këshillin e Ministrave, me propozim të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, pa u parashikuar ky regjim shkarkimi nga një rregullore e veçantë. Në këtë mënyrë, këta anëtarë nuk përfitojnë garanci të ndryshme nga ato të parashikuara nga rregullat e përgjithshme të së drejtës administrative.

Për sa i përket, së dyti, aspektit të brendshëm të konceptit të “pavarësisë”, Gjykata kujtoi se ajo iu bashkua konceptit të “paanësisë”, i cili kërkon respektimin e objektivitetit dhe mungesën e ndonjë interesi në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, përveç atyre rreptësisht të lidhura me zbatimin e rregullave ligjore. Kuptuar në këtë mënyrë, nocioni i «pavarësisë» kërkon që organi në fjalë të ketë statusin e «palës së tretë» në lidhje me autoritetin që miratoi vendimin e kundërshtuar. Megjithatë, karakteristikat e apelit të jashtëzakonshëm që mund të paraqiten para një dhome të posaçme të organit referues kundër vendimeve të këtij organi nuk lejojnë që ky i fundit të konsiderohet si «palë e tretë» në lidhje me interesat që përballen. Gjykata vuri në dukje, në veçanti, se paraqitja e një apeli të tillë i përket ekskluzivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, i cili do të jetë pjesë e formacionit që shqyrton këtë apel, ashtu siç do të jenë edhe drejtori i përgjithshëm ose drejtori i Shërbimit të Administratës Tatimore, nga të cilët varet organi përgjegjës i aktit që qëndron në themel të ankimit në fjalë.

Gjykata shtoi se fakti që organi referues nuk përbën një “gjykatë” në kuptimin e nenit 267 të TFBE-së, nuk e përjashton atë nga detyrimi për të siguruar zbatimin e ligjit të BE-së kur miratimi i vendimeve të tij, duke lënë pa zbatuar, nëse është e nevojshme, dispozita kombëtare në kundërshtim me dispozitat e së drejtës së BE-së që kanë efekt të drejtpërdrejtë. Për më

tepër, ekzistenca e mjeteve juridike kundër vendimeve të organit referues bën të mundur garantimin e efektivitetit të mekanizmit të vendimit paraprak, me kusht që gjykatat kombëtare të kenë mundësinë ose, kur është e përshtatshme, t'u kërkohet që t'ia referojnë çështjen Gjykatës për një vendim paraprak kur një vendim mbi interpretimin ose vlefshmërinë e së drejtës së BE-së është i nevojshëm për të dhënë gjykimin e tyre.

Duke pasur parasysh tërësinë e këtyre argumenteve, Gjykata u shpreh se kërkesa për një vendim paragjykimor e bërë nga TEAC është e papranueshme për shkak se ky organ nuk mund të cilësohet si “gjykatë”, sipas kuptimit të nenit 267 të TFBE-së.

3.7. “SILVER PLASTICS GMBH & CO. KG” & “JOHANNES REIFENHÄUSER HOLDING GMBH & CO. KG” kundër KOMISIONIT EVROPIAN

GJDBE

Çështja C-702/19 P

21 tetor 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=232723&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13710153>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: Në këtë vendim, Gjykata analizon respektimin e një sërë elementësh të procesit të rregullt në ankimin ndaj një gjobe të vënë nga Komisioni për shkelje të rregullave të konkurrencës në BE.

Faktet kryesore

Parashtruesi i parë, “Silver Plastics”, është një kompani që prodhon dhe furnizon produkte të ndryshme të paketimit të ushqimit, 99.75% e aksioneve të së cilës, në kohën e fakteve që çuan në miratimin e vendimit të kontestuar, kontrolloheshin nga parashtruesi i dytë, “Johannes Reifenhäuser Holding”.

Nga paragrafët 2 deri në 6 të vendimit të apeluar është e qartë se, pas një kërkesë për falje të paraqitur më 18 mars 2008 nga “Linpac Group Ltd” (në tekstin e mëtejshëm: “Linpac”), Komisioni Evropian filloi një procedurë në zbatim të nenit 101 të TFBE-së dhe nenit 53 të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane⁹⁵, në sektorin e paketimit të ushqimit të destinuar për shitje me pakicë, i cili çoi në miratimin e vendimit të kundërshtuar.

Komisioni konstatoi se kompanitë që operonin në sektorin e lartpërmendur kishin marrë pjesë, gjatë periudhave midis vitit 2000 dhe vitit 2008, në një shkelje të vetme dhe të vazhdueshme, që konsistonte në pesë akte të veçanta të shkeljes, të përcaktuara sipas zonës gjeografike të shërbyer, përkatësisht Italia, Evropa Jug-Perëndimore, Evropa Veri-Perëndimore, Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Franca (në tekstin e mëtejshëm: “shkelja në fjalë”). Produktet përkatëse ishin ambalazhe për paketimin e ushqimit me polistiren dhe, sa i përket kartelit për Evropë Veri-Perëndimore, paketime të ngurta.

Më konkretisht, Komisioni kishte konstatuar që “Silver Plastics” dhe “Johannes Reifenhäuser Holding” kishin shkelur nenin 101 të TFBE-së dhe nenin 53 të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane, duke marrë pjesë, gjatë periudhave të përmendura, në një shkelje të vetme dhe të vazhdueshme, të përbërë nga disa vepra të veçanta, që lidhen me polistirenin dhe paketime të ngurta të destinuara për sektorin e paketimit të ushqimit për shitje me pakicë dhe që mbulojnë territorin e Evropës Veri-Perëndimore, nga 13 qershor 2002 deri më 29 tetor 2007. Ato kishin shkelur gjithashtu, për të njëjtat shkaqe, nenin 101 të TFBE-së në lidhje me territorin francez nga 29 qershori 2005 deri më 5 tetor 2005.

Për këto dy shkelje Komisioni vendosi gjobat e mëposhtme:

i) “Silver Plastics” dhe “Johannes Reifenhäuser Holding”, bashkërisht dhe veç e veç të paguanin 20,317,000 euro.

⁹⁵ Marrëveshje e 2 majit 1992 (OJ 1994, L 1, f. 3).

ii) “Silver Plastics” dhe “Johannes Reifenhäuser Holding”, bashkërisht dhe veç e veç të paguanin 893,000 euro;

Parashtruesit bënë një padi në Tribunalin e BE-së duke kërkuar, kryesisht, anulimin e pjesshëm të vendimit të kundërshtuar dhe, në mënyrë alternative, një ulje të gjobave të vendosura ndaj tyre nga ky vendim. Kjo padi u hodh poshtë nga Tribunali.

Në apelin e tyre para Gjykatës, parashtruesit mbështetën shtatë pretendime si vijon: së pari, shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), lexuar së bashku me nenin 47.2 dhe nenin 48.2 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejme: “Karta”), si dhe parimin e së drejtës për t’u mbrojtur, së dyti, shkelje të së drejtës për procedura kontradiktore, së treti, shkelje të parimit të barazisë së armëve, së katërti, shkelje të detyrimit për të bërë të ditura arsyet e vendimit, së pesti, shkelje të nenit 23. 3 të Rregullores nr. 1/2003, së gjashti, shkelje të nenit 23.2 të Rregullores nr. 1/2003, në lidhje me konstatimin e ekzistencës së një njësie ekonomike, dhe, së shtati, shkeljen e së njëjtës dispozitë, në lidhje me kufirin e gjobës së vendosur bashkërisht dhe individualisht për parashtruesit.

Vendimi i Gjykatës

Parashtruesit pretendojnë se garancitë procedurale dhe të drejtat e mbrojtjes të përfshira në nenin 6, paragrafët 1 dhe 3, të KEDNJ-së, siç interpretohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: “GJEDNJ”), si dhe ‘në nënparagrafin 2 të nenit 47 dhe në nenin 48 (2) të Kartës, duhet të merren parasysh në kontekstin e procedurave para gjyqtarit të BE-së, përfshirë edhe në procedurat që lidhen me kartelet, pasi procedura të tilla janë të natyrës penale.

Megjithatë, përderisa Tribunali u kufizua në marrjen parasysh vetëm të procesverbalit të deklaratave të bëra nga Z.W. drejtuar avokatëve të “Silver Plastics”, pa e thirrur atë për ta dëgjuar personalisht si dëshmitar, ai ka shkelur parimin e një gjykimi të drejtë të garantuar në nenin 6 të KEDNJ-së si dhe në nenin 47, paragrafi 2 dhe nenin 48, paragrafi 2, të Kartës dhe ka minuar parimin e administrimit të drejtëpërdrejtë të provave.

Gjykata kujtoi, paraprakisht, se nëse, siç konfirmohet nga neni 6.3 i TBE-së, të drejtat themelore të përfshira në KEDNJ janë pjesë e së drejtës së BE-së, si parime të përgjithshme, dhe nëse neni 52.3 i Kartës parashikon se të drejtat që përmban ajo, që korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga KEDNJ, kanë të njëjtin kuptim dhe të njëjtën fushë të veprimit me ato që u janë dhënë atyre nga KEDNJ, kjo e fundit nuk përbën, për aq kohë sa Bashkimi Evropian nuk ka aderuar në të, një instrument ligjor të përfshirë zyrtarisht në rendin juridik të Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu kujton se, përderisa Karta përmban të drejta që korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga KEDNJ, neni 52.3 i Kartës synon të sigurojë konsistencën e nevojshme midis të drejtave që përmbahen në të dhe të drejtave përkatëse të garantuara nga KEDNJ, “pa e cenuar autonominë e së drejtës së BE-së dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian”⁹⁶. Neni 47.2 i Kartës korrespondon me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe neni 48 i Kartës është “i njëjtë” si neni 6, paragrafët 2 dhe 3, të KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata duhet të sigurojë që, interpretimi që i bën nenit 47.2 dhe nenit 48 të Kartës të sigurojë një nivel mbrojtjeje, i cili nuk cenon atë të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, siç interpretohet nga GJEDNJ⁹⁷.

Pasi kujtoi këto elemente themelore, Gjykata vlerësoi se kërkesa e parë e parashtruesve duhet të kuptohet si një tendencë për të argumentuar, në thelb, se, duke refuzuar të dëgjojë gojarisht, si dëshmitar, Z. W., Tribunali shkeli të drejtën e tyre për një gjykim të drejtë të garantuar sidomos nga neni 47.2 dhe neni 48.2 të Kartës. Siç është vendosur tashmë nga Gjykata, edhe nëse një kërkesë për dëgjimin e dëshmitarëve, tregon me saktësi faktet mbi të cilat është e nevojshme të dëgjohet dëshmitari ose dëshmitarët dhe arsyet që mund ta justifikojnë këtë, i takon Tribunalit të vlerësojë rëndësinë e kërkesës në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes dhe nevojën për të vazhduar me dëgjimin e dëshmitarëve. Ky diskrecion i Tribunalit pajtohet me të drejtën themelore për një gjykim të drejtë, në veçanti me dispozitat e nenit 47.2 dhe nenit 48.2 të Kartës, lexuar në lidhje me nenin 6.3 (d) të KEDNJ-së. Nga praktika e Gjykatës del se kjo dispozitë e fundit nuk njuh një të drejtë absolute të të akuzuarit për të

96 Vendimi i 20 marsit 2018, *Menci*, C - 524/15, BE: C: 2018: 197, pika 23.

97 Vendimi e 26 shtatorit 2018, *Belastingdienst kundër Toeslagen* (Efekti pezullues i apelit), C-175/17, BE: C: 2018: 776, paragrafi 35.

pyetur dëshmitarë para një gjykate dhe se, në parim, i takon gjyqtarit të vendosë nëse thirrja e një dëshmitari është apo jo e nevojshme. Neni 6.3 i KEDNJ-së nuk kërkon thirrjen e ndonjë dëshmitari, por kërkon barazi të plotë të armëve, duke siguruar që procedurat gjyqësore, të marra në tërësi, i kanë dhënë të akuzuarit një mundësi adekuate dhe të mjaftueshme për të kundërshtuar dyshimet që rëndojnë mbi të. Në rastin konkret, duhet të theksohet se, pas një shqyrtimi të hollësishëm të një grupi provash, të cilat parashtruesit ishin në gjendje t'i kundërshtonin në masë të madhe, Tribunali vërejti se Komisioni kishte vepruar në përputhje me standardin e kërkuar ligjor kur kishte konkluduar që “Silver Plastics” kishte marrë pjesë në marrëveshje dhe praktika të bashkërenduara kundër konkurrencës dhe se ajo kishte marrë pjesë në një shkelje të vetme dhe të vazhdueshme në tregun e Evropës Veri-Perëndimore. Tribunali vërejti gjithashtu se parashtruesit kishin paraqitur para tij deklarata nga disa persona, përfshirë ata të Z.W., të cilat, ata ishin në gjendje t'i përdornin për të mbështetur argumentet e tyre. Tribunali shtoi, në paragrafin 234 të atij vendimi, se arsyetimi i parashtruar nga parashtruesit për dobinë e dëshmive të atyre personave nuk tregonte se dëgjimi i tyre nga Tribunali, si dëshmitarë, mund të siguronte vlerë të shtuar të provave që ishin tashmë të pranishme në dosje.

Me ankesën e tyre të dytë, parashtruesit pretenduan, në thelb, në bazë të nenit 47.2 dhe nenit 48.2 të Kartës, të lexuar bashkë me nenin 6 të KEDNJ-së, se nuk kanë mundur ta pyesin vetë dëshmitarin Z. W. duke qenë se ai ishte “dëshmitari kryesor i prokurorisë” në procedurë. Këtij pretendimi Gjykata i përgjigjet se deklaratat e vetme me shkrim të Z.W., të marra në konsideratë nga Tribunali, janë ato të paraqitura nga vetë parashtruesit. Prandaj, ky argument i dytë u refuzua.

Për sa i përket argumentit të tretë për shkelje të parimit të barazisë së armëve, mjaftoi të theksohet se, meqenëse Tribunali nuk dëgjoi asnjë dëshmitar të propozuar nga Komisioni, ai nuk mund të kritikohet për shkeljen e atij parimi duke vendosur, në të njëjtën mënyrë, të mos dëgjojë dëshmitarët e propozuar nga parashtruesit. Nga ana tjetër, përderisa parashtruesit pretenduan se Tribunali, në thelb, ka shkelur detyrimin për të deklaruar arsyet për refuzimin e kërkesës së tyre për të dëgjuar dëshmitarët, del se në paragrafët 232 deri 235 të vendimit

të tij, Tribunali shtjelloi arsytet që e shtynë atë të konsiderojë se nuk ishte, as e nevojshme dhe as e përshtatshme, për t'i dhënë një përgjigje të favorshme kërkesës për të dëgjuar dëshmitarët e paraqitur nga parashtruesit. Duke vepruar kështu, Tribunali respektoi detyrimin për të dhënë arsye për gjykimet e tij.

Në lidhje me pretendimin e katërt se Tribunali nuk kishte arsyetuar si duhet vendimin e tij, Gjykata u shpreh se Tribunali kishte konstatuar se, më 13 qershor 2002, ndërmarrje të ndryshme konkurruese në tregun në fjalë, përfshirë “Silver Plastics”, ishin takuar për të diskutuar strategjitë e çmimeve në përfundim të një takimi tjetër të mbajtur në të njëjtën ditë, qëllimi i të cilit nuk ishte kundër konkurrencës. Në paragrafët 47 deri në 66 të vendimit të tij, Tribunali parashtrroi, në mënyrë shteruese, të gjitha provat të cilat, sipas mendimit të tij, tregonin se përfaqësuesit e “Silver Plastics” kishin marrë pjesë në takimin antikonkurrencë lidhur me çmimet. Përkundër asaj që pretendonin parashtruesit, nuk ishte në asnjë mënyrë e nevojshme që Tribunali të përcaktonte, në këtë drejtim, kohën e saktë të fillimit të takimit, objekti i të cilit nuk ishte kundër konkurrencës. Për sa i përket dëshmisë së Z.W., Tribunali vlerësoi se vetëm pohimet e caktuara të Z. W., të përfshira në deklaratat e tij të paraqitura nga ankuesit, ishin pak, ose jo të besueshme, pasi ato u kundërshtuan nga prova të tjera të përmendura nga Tribunali. Prandaj, në kundërshtim me atë që pretendonin parashtruesit në kërkesën e tyre, vendimit i Tribunalit nuk zbulon ndonjë shkelje të detyrimit të tij për të arsyetuar vendimin.

Parashtruesit pretenduan shkelje të nenit 101 të TFBE-së dhe të nenit 23.3 të Rregullores nr. 1/2003, pasi Tribunali kishte konstatuar se shkelja në fjalë në tregun e Evropës Veri-Perëndimore përbënte një shkelje të vetme dhe të vazhdueshme në lidhje me tregun për paketime të ngurta, të cilat mbulonin në veçanti periudhën nga 13 qershor 2002 deri më 24 gusht 2004, por pa treguar ekzistencën, gjatë asaj periudhe, në tregun në fjalë, të një plani të përgjithshëm që kishte vazhduar me shkelje individuale që lidheshin me të. Sipas Gjykatës, koncepti i një “vepre të vetme dhe të vazhdueshme”, siç njihet në praktikën gjyqësore të saj, presupozon ekzistencën e një “plani të përgjithshëm”, në të cilin akte të ndryshme, për shkak të objektit të tyre identik që shtrembërojnë konkurrencën në tregun e brendshëm, pavarësisht nëse

një ose më shumë nga këto akte mund të përbëjnë, në vetvete dhe të marra në mënyrë të izoluar, një shkelje të nenit 101 të TFBE-së⁹⁸. Nga kjo jurisprudencë rrjedh se pjesëmarrja e një ndërmarrjeje në një shkelje të vetme dhe të vazhdueshme nuk kërkon pjesëmarrjen e saj të drejtpërdrejtë në të gjitha sjelljet antikonkurrencë që përbëjnë atë shkelje dhe se, as nuk kërkohet që të gjitha ndërmarrjet që marrin pjesë në një shkelje të vetme dhe të vazhdueshme të jenë aktive në të njëjtin treg⁹⁹. Në rastin konkret, Tribunali konstatoi, në kontekstin e vlerësimit të fakteve, se shkelja në fjalë në tregun përkatës në të cilën morën pjesë parashtruesit, lidhej si me paketimet e polistirenit, ashtu edhe me ato të ngurta. Për këto arsye, Tribunali prandaj konsideroi se kishte një “plan të përgjithshëm” i cili mbulonte të dy këto produkte.

Parashtruesit pretenduan se Tribunali kishte vepruar në kundërshtim me fjalinë e parë dhe të dytë të nenit 23.2 të Rregullores nr. 1/2003, të lexuar bashkë me nenin 101.1 të TFBE-së, u bazua në premisën, sipas së cilës “Silver Plastics” dhe “Johannes Reifenhäuser Holding” formonin një njësi ekonomike, duke mos marrë parasysh fakte dhe dëshmi që ata kishin paraqitur.

Gjykata konstatoi se në paragrafin 265 të vendimit të tij, Tribunali vuri në dukje se, gjatë periudhës përkatëse, “Johannes Reifenhäuser Holding” zotëronte pothuajse të gjithë (99.75%) kapitalin e “Silver Plastics”. Prandaj, Tribunali konsideroi se Komisioni mund të mbështetet në supozimin se, në rastin e veçantë kur një kompani mëmë zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të gjithë ose pothuajse të gjithë kapitalin e filialit të tij që ka kryer një shkelje të rregullave të konkurrencës të BE-së, ekziston një supozim i kundërshtueshëm se kjo kompani mëmë vërtet ushtron ndikim vendimtar mbi filialin e saj¹⁰⁰. Me argumentet e tyre mbi këtë pikë, parashtruesit përsërisin, në thelb, argumentet që ata kishin paraqitur para Tribunalit për të demonstruar se “Johannes Reifenhäuser Holding” nuk ushtroi ndikim

98 Shih vendimin e 26 janarit 2017, Villeroy & Boch / Commission, C - 644/13 P, BE: C: 2017: 59, paragrafi 47.

99 Ibid. paragrafët 49-51.

100 Shih në këtë drejtim vendimin e 25 tetorit 1983, AEG-Telefunken / Commission, 107/82, EU:C:1983: 293, paragrafi 50, dhe të 16 qershorit 2016, Evonik Degussa dhe AlzChem / Commission, C - 155/14 P, BE:C:2016: 446, paragrafi 28.

vendimtar mbi “Silver Plastics”, pa specifikuar se çfarë gabimi kishte bërë Tribunali në vlerësimin e tij.

Sipas praktikës së vendosur të Gjykatës, një apel duhet të tregojë pikërisht elementet e kritikuara të vendimit ose urdhrin, anulimi i të cilit kërkohet, si dhe argumentet ligjore që mbështesin në mënyrë specifike këtë kërkesë. Një apel i cili, pa përfshirë një argument që synon në mënyrë specifike të identifikojë gabimin në ligj të vendimit ose urdhrin të apeluar, kufizohet vetëm në përsëritjen ose riprodhimin e arsyeve dhe argumenteve që i janë paraqitur tashmë Tribunalit, nuk e plotëson këtë kërkesë.

Së fundmi, parashtruesit pretenduan se Tribunali ka shkelur nënparagrafin 2 të nenit 23.2 të Rregullores nr. 1/2003, pasi përfshiu gabimisht në llogaritjen e gjobës së vendosur ndaj tyre, bashkërisht dhe veçmas, shifrën e biznesit të kryer në lidhje me aktivitetin e transferuar më pas në “Maschinenfabrik”, i cili çoi në tejkalimin e kufirit të parashikuar nga kjo dispozitë, që korrespondon me 10% të qarkullimit të secilës kompani të përfshirë nga shkelja.

Gjykata kujtoi se sipas nenit 23.2 të Rregullores nr. 1/2003, për secilën ndërmarrje dhe shoqatë ndërmarrjesh që kanë marrë pjesë në shkelje të dispozitave të nenit 101 ose 102 të TFBE-së, gjoba e vendosur nuk mund të kalojë 10% të qarkullimit të saj të përgjithshme të arritur gjatë vitit financiar të mëparshëm.

Tribunali konstatoi se vendimi u miratua më 24 qershor 2015 dhe, meqenëse viti financiar i “Johannes Reifenhäuser Holding” përfundonte më 30 qershor të çdo viti, në këtë rast «viti financiar i mëparshëm», sipas kuptimit të nenit 23.2 të Rregullores nr. 1/2003, ishte viti financiar 2013/2014, i cili përfundoi më 30 qershor 2014.

Faktet e mbështetura nga parashtruesit për ndarjen e “Maschinenfabrik” nga “Johannes Reifenhäuser Holding”, gjë që ndodhi në një datë shumë më vonë se periudha, gjatë së cilës ishte kryer shkelja në fjalë, nuk ishin në asnjë mënyrë të natyre që vë në dyshim qarkullimin e “Johannes Reifenhäuser Holding” gjatë vitit financiar 2013/2014. Gjykata shprehet se, nëse do të pranohet që një ndërmarrje që ka kryer një shkelje të rregullave të konkurrencës të BE-së mund të zvogëlojë ndjeshëm,

duke i shitur një sektor të aktiviteteve të saj një pale të tretë, disa ditë para miratimit të vendimit për vendosjen e një gjobë ndaj saj, kufirin të cilin kjo gjobë nuk duhet ta tejkalojë, atëherë efektiviteti i dënimeve të parashikuara nga Rregullorja nr. 1/2003 do të rrezikohet seriozisht. Prandaj edhe ky pretendim i shtatë, u refuzua si i pabazuar.

3.8. JOÃO FILIPE FERREIRA DA SILVA E BRITO DHE TË TJERË kundër ESTADO PORTUGUÊS

**GJDBE
C160/14**

9 dhjetor 2015

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=167205&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13710363>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Me këtë vendim, Gjykata sqaron kuptimin e parimeve të ekuivalencës dhe të efektivitetit për qëllimet e mjeteve gjyqësore efektive në të drejtën e brendshme, kur ato vënë në zbatim të drejtën e BE-së.*

Faktet kryesore

Më 19 shkurt 1993, “Air Atlantis SA” (‘AIA’), një ndërmarrje e themeluar më 1985 dhe aktive në sektorin e fluturimeve çarter, u shpërbë. Në këtë kontekst, parashtruesit në procedurën kryesore përpara gjykatave portugeze iu nënshtruan pushimit kolektiv nga puna.

Nga 1 maj 1993, “TAP”, një ndërmarrje e cila ishte aksionari kryesor i “AIA”-s, mbuloi disa prej fluturimeve që kishte planifikuar të bënte “AIA” gjatë periudhës nga 1 maji deri më 31 tetor 1993. “TAP” kreu gjithashtu një numër fluturimesh çarter, një treg në të cilin nuk kishte qenë aktiv deri atëherë, pasi rrugët në fjalë, më parë, shërbeheshin nga “AIA”. Për këtë qëllim, “TAP” përdori disa nga pajisjet e “AIA”-s, në veçanti katër avionë. “TAP” gjithashtu mori përsipër pagesën e qirave në lidhje me

këto avionë dhe mori edhe pajisjet e zyrave që i përkisnin “AIA”-s, si dhe prona të tjera të luajtshme. Për më tepër, “TAP” punësoi një numër të ish-punonjësve të “AIA”-s.

Paditësit në procedurën kryesore u ankuan para Tribunal do Trabalho de Lisboa¹⁰¹ kundër shkarkimit të tyre kolektiv, duke kërkuar që të punësoheshin nga “TAP” dhe të merrnin pagat e tyre.

Me një vendim të 6 shkurtit 2007, Tribunal do Trabalho de Lisboa, mbështeti pjesërisht padinë, duke urdhëruar punësimin e paditësve në funksionet e tyre si dhe pagesën e dëmshpërblimeve. Tribunal do Trabalho de Lisboa arriti në përfundimin se në këtë rast kishte pasur një transferim të një ndërmarrje, të paktën pjesërisht, për aq sa identiteti i ndërmarrjes ishte ruajtur dhe aktivitetet e saj ishin vazhduar, dhe se “TAP” kishte zëvendësuar ish-punëdhënësin e paditësve në kontratat e punës.

Ky vendim u apelua në Tribunal da Relação de Lisboa¹⁰² e cila, me vendimin e 16 janarit 2008, prishi vendimin e shkallës së parë, për aq sa ajo e kishte dënuar “TAP”-in për të rikthyer paditësit në punë dhe për t’u paguar pagat, me arsyetimin se e drejta për të apeluar kundër shkarkimit kolektiv në fjalë kishte skaduar.

Paditësit bënë rekurs për çështje ligjore në Supremo Tribunal de Justiça¹⁰³, i cili, me vendimin e 25 shkurtit 2009, vendosi se shkarkimi kolektiv nuk ishte i paligjshëm. Kjo gjykatë vuri në dukje se nuk është e mjaftueshme që një aktivitet tregtar “ thjesht të vazhdojë” që të jetë e mundur të arrihet në përfundimin se kemi transferim të një ndërmarrjeje, duke qenë se është gjithashtu e nevojshme që të ruhet identiteti i ndërmarrjes. Në rastin konkret, kur “TAP” mori përsipër fluturimet në fjalë në verën e vitit 1993, ai nuk përdori një “entitet” me të njëjtin identitet si “entiteti” i cili më parë i përkiste “AIA”-s. Në mungesë të identitetit midis dy “entiteteve” në fjalë, nuk mund të arrihet në përfundimin se ka një transferim të ndërmarrjes. Supremo Tribunal de Justiça vlerësoi gjithashtu se nuk kishte pasur kalim të klientëve nga “AIA” në “TAP”. Përveç kësaj, “AIA” kishte një ndërmarrje

101 Gjykata e Punës në Lisbonë.

102 Gjykata e Apelit në Lisbonë.

103 Gjykatën Supreme të Drejtësisë.

të lidhur me një pasuri të caktuar, në këtë rast një licencë, e cila nuk ishte e transferueshme, dhe që cila do ta kishte bërë të pamundur transferimin e ndërmarrjes, pasi mund të shiteshin vetëm pasuritë individuale por jo edhe institucioni si i tillë.

Në lidhje me zbatimin e së drejtës së BE-së, Supremo Tribunal de Justiça vërejtë se Gjykata, në situata kur një ndërmarrje vijonte aktivitete të kryera deri atëherë nga një ndërmarrje tjetër, kishte vendosur se kjo “rrethanë e thjeshtë” nuk çonte në përfundimin se ka pasur transferim të një njësie ekonomike, pasi «një njësi ekonomike nuk mund të kufizohet në aktivitetin për të cilin është përgjegjëse”.

Disa nga ankuesit i kërkuan Supremo Tribunal de Justiça që të bënte një kërkesë për një vendim paragjykimor në Gjykatë. Megjithatë, Supremo Tribunal de Justiça vlerësoi se “detyrimi gjykatave kombëtare, vendimet e të cilave nuk mund të apelohej sipas së drejtës së brendshme, që të bëjnë një kërkesë për një vendim paragjykimor, ekziston vetëm kur këto vlerësojnë se e drejta e BE-së është e nevojshme për të zgjidhur çështjen para tyre dhe kur lind një çështje interpretimi e kësaj të drejte”. Aq më tepër që duke pasur parasysh praktikën e Gjykatës në lidhje me interpretimin e rregullave të BE-së mbi transferimin e një ndërmarrje nuk kishte “asnjë dyshim” në interpretimin e atyre rregullave, “i cili të kërkonte një vendim paragjykimor”. Sipas Supremo Tribunal de Justiça, “vetë Gjykata e ka njohur shprehimisht se zbatimi i saktë i ligjit të BE-së mund të kërkohej me një qartësi të tillë që nuk lë vend për ndonjë dyshim të arsyeshëm në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së pyetjes së parashtruar, duke përjashtuar kështu edhe detyrimin për të kërkuar një vendim paragjykimor në këtë rast. Pra, duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitave të së drejtës së BE-së të cituara nga ankuesit, interpretimin e bërë nga Gjykata, të këtyre dispozitave dhe elementet e çështjes, nuk ka asnjë dyshim interpretimi.

Ankuesit ngritën një padi përpara Varas Cíveis de Lisboa¹⁰⁴ për përgjegjësi civile jashtëkontraktore kundër Estado português¹⁰⁵, duke kërkuar që të paguajë kompensimin për disa dëme materiale të

104 Seksioni Civil i Gjykatës së Lisbonës.

105 Republika Portugeze.

pësuara. Në mbështetje të padisë, ata pohuan se vendimi i Supremo Tribunal de Justiça i lartpërmendur ishte haptazi i paligjshëm, për aq sa përmban një interpretim të pasaktë të konceptit të “transferimit të selisë”, sipas kuptimit të Direktivës 2001/23, dhe në masën që ajo gjykatë nuk respektoi detyrimin e saj për t’i bërë Gjykatës pyetjet përkatëse të interpretimit të ligjit të BE -së.

L’Estado português argumentoi se kërkesa për kompensim të paraqitur duhet të bazohet në anulimin paraprak të vendimit përkatës nga gjykata kompetente. Varas Cíveis de Lisboa vlerësoi se ishte e nevojshme të dihej nëse vendimi i Supremo Tribunal de Justiça ishte apo jo haptazi i paligjshëm dhe nëse ai keqinterpretonte konceptin e ‘transferimit të selisë’, në dritën e Direktivës 2001/23 dhe nëse Supremo Tribunal de Justiça kishte një detyrim për të bërë kërkesë për një vendim paragjykimor, siç ishte kërkuar nga paditësit. Në lidhje me këto probleme ai i drejtoi pyetje Gjykatës së Luksemburgut.

Vendimi i Gjykatës

Për sa i përket interpretimit të nenit 1.1 të Direktivës 2001/23 mbi përfrimin e legjislacioneve të shteteve anëtare mbi ruajtjen e të drejtave të punëtorëve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, të njësive ekonomike ose të pjesëve të tyre, duhet të interpretohet ashtu që koncepti i “transferimit të ndërmarrjes” mbulon një situatë në të cilën një ndërmarrje aktive në tregun e fluturimeve charter shpërndahet nga aksioneri që ka shumicën e aksioneve të saj, i cili është vetë një ndërmarrje ajrore e transportit, dhe më pas, kjo e fundit zëvendëson ndërmarrjen e shpërbërë me marrjen përsipër të kontratave të qirasë së avionëve dhe duke vazhduar kontratat e fluturimeve charter, kryen veprimtari të kryera më parë nga ndërmarrja e shpërbërë, ripunëson disa punonjës të ndërmarrjes të shpërbërë, duke u caktuar atyre funksione identike me ato të ushtruara më parë dhe merr e përdor pajisje të vogla nga ndërmarrja e shpërbërë.

Për qëllimet e zbatimit të nenit 1.1 të Direktivës 2001/23, është i parëndësishëm fakti që njësia, nga e cila pajisjet dhe një pjesë e personelit janë marrë, është përfshirë në ndërmarrjen e transferuar, pa ruajtur strukturën e saj, për aq sa është mbajtur një lidhje midis, nga

njëra anë, këtyre pajisjeve dhe personelit të transferuar në ndërmarrjen e fundit, si dhe, nga ana tjetër, vazhdimin të aktiviteteve të kryera më parë nga ndërmarrja e shpërndarë. Në fakt, nuk është ruajtja e strukturës specifike të, por lidhja funksionale e ndërvarësisë dhe ndikimi reciprok mes këtyre faktorëve që përbën elementin relevant për të arritur në përfundimin e ruajtjes apo jo, të identitetit të subjektit të transferuar. Kështu, mbajtja e një lidhjeje të tillë funksionale midis faktorëve të ndryshëm të transferuar i lejon transferuesit t'i përdorë ato, edhe nëse janë të integruar, pas transferimit, në një strukturë të re të ndryshme organizative, në mënyrë që të ushtrojnë një veprimtari ekonomike identike ose të ngjashme.

Gjykata arriti në përfundimin, mbi këtë pikë, se neni 1.1 i Direktivës 2001/23 duhet të interpretohet ashtu që koncepti i «transferimit të ndërmarrjes» mbulon një situatë si kjo e përshkruar në paragrafët më sipër.

Në lidhje me problemin e dytë, atë të detyrimit të gjykatave kombëtare për t'i drejtuar Gjykatës një kërkesë paragykuese, kjo e fundit shprehet se paragrafi 3 i nenit 267 të TFBE-së duhet të interpretohet në kuptimin që një gjykate, vendimet e së cilës nuk i nënshtrohen një apeli gjyqësor sipas ligjit të brendshëm, kur ka vendime kontradiktore mbi interpretimin e këtij koncepti nga gjykatat më të ulëta, dhe kur shihen vështirësi të përsëritura në interpretimin e tij në shtete të ndryshme anëtare, asaj gjykate i kërkohet të paraqesë një çështje në GJDBE me një kërkesë për një vendim paraprak në lidhje me interpretimin e konceptit të “transferimit të selisë”, sipas kuptimit të nenit 1.1 të Direktivës 2001/23 për përafrimin e legjislacioneve të shteteve anëtare mbi ruajtjen e të drejtave të punëtorëve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, të njësive ekonomike ose të pjesëve të tyre.

Ndërsa është e vërtetë se procedura e përcaktuar me nenin 267 të TFBE-së është një instrument bashkëpunimi midis Gjykatës dhe gjykatave kombëtare, falë të cilave e para u siguron këtyre të fundit elementet e interpretimit të së drejtës së BE-së, të cilat janë të nevojshme për to për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që po shqyrtojnë, fakti mbetet se, kur nuk ka mjet juridik sipas ligjit të brendshëm kundër vendimit të një gjykate kombëtare, kjo e fundit, në parim, kërkohet që ta referojë çështjen në

Gjykatë, në përputhje me nenin 267.3 të TFBE-së, sa herë që një pyetje në lidhje me interpretimin e ligjit të BE-së ngrihet para saj, përveç rasteve kur ka vlerësuar se pyetja e ngritur nuk është e rëndësishme ose dispozita e ligjit në fjalë të BE-së është interpretuar tashmë nga Gjykata ose kur zbatimi i saktë i së drejtës së BE-së është aq evident sa nuk lë vend për dyshime të arsyeshme. Këto elemente duhet të vlerësohen në bazë të karakteristikave specifike të së drejtës së BE-së, të vështirësive specifike që dalin nga interpretimi i saj dhe rrezikut të divergjencave në praktikën gjyqësore brenda BE-së.

E drejta e BE-së dhe, në veçanti, parimet e shtjelluara nga GJDBE në çështjet e përgjegjësisë së shtetit për dëmin e shkaktuar ndaj individëve, si rezultat i një shkeljeje të ligjit evropian të kryer nga një gjykatë, vendimet e së cilës nuk mund të apelojnë sipas ligjit të brendshëm, duhet të interpretohet se është në kundërshtim me një legjislacion kombëtar i cili kërkon, si parakusht, anulimin e vendimit të dhënë nga kjo gjykatë që shkakton dëmin, ndërkohë që një anulim i tillë nuk është i mundur.

Në fakt, duke pasur parasysh rolin thelbësor të luajtur nga gjyqësori në mbrojtjen e të drejtave që individëve u burojnë nga rregullat e së drejtës së BE-së, efektiviteti i plotë i atyre rregullave do të vihej në dyshim dhe mbrojtja e të drejtave që ata gëzojnë do dobësohej nëse individët, në kushte të caktuara, nuk do të mund të merrnin dëmshpërblim kur të drejtat e tyre cenohen nga një shkelje e së drejtës së BE-së, që i atribuohet një vendimi përfundimtar të gjykatës më të lartë të një shteti anëtar. Kur gjykatat e brendshme arrijnë në përfundimin se janë përmbushur kushtet e lindjes së përgjegjësisë së shtetit, ato duhet të përcaktojnë, sipas së drejtës së brendshme, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar, me kusht që kriteret e parashikuara nga e drejta kombëtare për shpërblimin e dëmit nuk mund të jenë më pak të favorshme se ato për pretendime të ngjashme për dëmshpërblim në rast të shkeljes së të drejtës së brendshme (parimi i ekuivalencës) dhe as të jenë të një natyre të tillë që ta bëjnë, në praktikë, të pamundur ose tepër të vështirë për të marrë kompensim (parimi i efektivitetit). Gjykata vlerësoi se një legjislacion kombëtar i cili kërkon, si parakusht, anulimin e vendimit që ka shkaktuar dëmin, ndërsa një anulim i tillë, në praktikë, është i pamundur, mund ta bëjë tepër të vështirë marrjen e kompensimit për

dëmin e shkaktuar nga shkelja e së drejtës së BE-së. Një pengesë e tillë nga legjislacionin kombëtar ndaj zbatimit efektiv të së drejtës së BE-së dhe, në veçanti, të një parimi aq themelor sa ai i përgjegjësisë së shtetit për shkeljen e së drejtës së BE-së, i cili është përbërës i sistemit të traktateve mbi të cilat është themeluar BE-ja, nuk mund të justifikohen as nga parimi i *res judicata*, as nga parimi i sigurisë juridike.

3.9. VASILKA IVANOVA GOGOVA kundër ILIA DIMITROV ILIEV

GJDBE

Çështja C-215/15

21 tetor 2015

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=170122&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13710547>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: *Kjo çështje ka të bëjë me zhvillimin e procedurave civile në mungesë të njëjës prej palëve ndërgjyqëse*

Faktet kryesore

Znj. Gogova dhe z. Iliev, të dy shtetas bullgarë që jetojnë të ndarë në Itali janë prindër të një fëmije, i cili në datën e ngjarjeve përpara gjykatave italiane, ishte 10 vjeç. Ky fëmijë, me shtetësi bullgare, jeton me nënën e tij në Milano. Znj. Gogova dëshironte të vazhdonte pasaportën e fëmijës së saj, pasi i kishte skaduar më 5 prill 2012, në mënyrë që të udhëtonte me të në Bullgari. Sipas legjislacionit bullgar, vendimi në lidhje me marrjen e një pasaporte në emër të tij dhe udhëtimin e një fëmije të mitur merret me marrëveshje të ndërsjellë midis prindërve dhe aplikimi për pasaportë për një fëmijë të mitur duhet të bëhet pranë autoriteteve kompetente administrative nga të dy prindërit së bashku.

Meqenëse z. Iliev nuk bashkëpunoi me znj. Gogova në procedurën për lëshimin e një pasaporte të re në emër të fëmijës së tyre, kjo e fundit

bëri një padi në Rajonen Sad - Petrich¹⁰⁶ duke kërkuar që kjo gjykatë të zgjidhë mosmarrëveshjen mes saj dhe z. Iliev në lidhje me mundësinë që fëmija i tyre të pajiset me një pasaportë të re dhe të udhëtojë jashtë shtetit. Meqenëse ishte e pamundur të njoftohej z. Iliev për këto procedura, pasi ai nuk mund të gjendej në adresën e tij të deklaruar, gjykata caktoi një avokat *ad litem* për ta përfaqësuar atë, në bazë të nenit 47.6 të Kodit të Procedurës Civile. Ky avokat nuk e kundërshtoi juridiksionin e gjykatave bullgare dhe u shpreh se mosmarrëveshja duhet të zgjidhet në interesin më të mirë të fëmijës.

Me një urdhër të 10 nëntorit 2014, Rajonen sad - Petrich vendosi që kërkesa e znj. Gogova rregullohej nga neni 127a i Kodit të Familjes dhe kishte të bënte me përgjegjësinë prindërore në lidhje me një fëmijë, në kuptim të nenit 8 të Rregullores nr. 2201/2003. Përderisa fëmija në fjalë banonte në Itali, kjo gjykatë deklaroi se nuk kishte juridiksion për ta shqyrtuar këtë padi dhe e hodhi poshtë padinë.

Znj. Gogova apeloj kundër këtij urdhri në Okrazhen sad - Blagoevgrad¹⁰⁷. Kjo e fundit e la në fuqi këtë urdhër dhe vlerësoi gjithashtu se nuk kishte “shtrirje të juridiksionit” të gjykatave bullgare, në kuptimin e nenit 12.1 (b) të Rregullores nr. 2201/2003. Sipas gjykatës në fjalë, megjithëse z. Iliev nuk argumentoi se këto gjykata nuk kishin juridiksion, ai mori pjesë në proces nëpërmjet avokatit të caktuar në mungesë të tij.

Znj. Gogova bëri një kërkesë në Varhoven kasatsionen sad¹⁰⁸. Kjo e fundit vlerësoi se rezultati i procedurës para saj varej, në radhë të parë, nga fakti nëse procedura ligjore e parashikuar në nenin 127a.2 të Kodit të Familjes që bën të mundur kompensimin me vendim gjykate të mungesës së pëlqimit të njërit prej prindërve për lëshimin e një pasaporte dhe udhëtimin jashtë shtetit të fëmijës së tyre, rregullohej apo jo nga Rregullorja nr. 2201/2003, që përcakton juridiksionin gjyqësor në situata të tilla.

Prandaj ajo i referoi GJDBE-së dy pyetje që në thelb kishin të bënin me sa vijon. Së pari, nëse një procedurë e tillë ka të bëjë me “përgjegjësinë

106 Gjykata e Rrethit Petrich, Bullgari.

107 Gjykata Rajonale e Blagoevgrad, Bullgari.

108 Gjykata e Lartë e Kasacionit.

prindërore” brenda kuptimit të nenit 2.7 të asaj rregulloreje. Sipas asaj gjykate, në këtë kontekst, ishte gjithashtu e nevojshme të përcaktohet nëse e njëjta rregullore zbatohet për procedurat në fjalë pasi, në përputhje me ligjin bullgar, vendimi gjyqësor i marrë në kontekstin e asaj procedure duhet t’u paraqitet autoriteteve administrative bullgare në mënyrë që fëmija të autorizohet të udhëtojë jashtë shtetit ose që t’i lëshohet një pasaportë. Së dyti, gjykata referuese pyeti nëse, në rastin konkret, juridiksioni i gjykatave bullgare mund të bazohet në nenin 12.1 (b) të Rregullores 2201/2003, duke pasur parasysh faktin se avokati i caktuar zyrtarisht për të përfaqësuar z. Iliev nuk e kundërshtoi kompetencën e tyre për të shqyrtuar mosmarrëveshjen.

Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 12.3 (b) të Rregullores nr. 2201/2003, Gjykata u shpreh se padia, me të cilën njëri nga prindërit i kërkon gjyqtarit të kompensojë mungesën e pëlqimit të prindit tjetër për lëshimin e një pasaporte në emër të këtij fëmije dhe për udhëtimin e fëmijës së tyre jashtë shtetit anëtar të vendbanimit të këtij të fundit, përfshihet në fushëveprimin material të Rregullores nr. 2201/2003, në lidhje me juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e gjykimeve në çështjet martesore dhe çështjet e përgjegjësisë prindërore, edhe pse vendimi i shpallur në fund të këtij veprimi duhet të merret parasysh nga autoritetet administrative të shtetit anëtar, shtetas i të cilit është ai fëmijë, në kontekstin e procedurës administrative në lidhje me lëshimin e kësaj pasaporte.

Në fakt, rregullorja në fjalë zbatohet për çështjet civile që lidhen, sidomos, me atribuimin, ushtrimin, delegimin, tërheqjen totale ose të pjesshme të përgjegjësisë prindërore. Koncepti i përgjegjësisë prindërore është objekt, në nenin 2.7 të Rregullores nr. 2201/2003, i një përkufizimi të gjerë, në kuptimin që përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i jepen një personi fizik ose një personi juridik në bazë të një vendimi gjyqësor, të një atribuimi automatik ose të një marrëveshjeje në fuqi, në lidhje me personin ose pronën e një fëmije.

Një padi që i kërkon një gjyqtari kombëtar që të vendosë mbi nevojën që fëmija në fjalë të marrë një pasaportë dhe mbi të drejtën e prindit

paditës për të paraqitur kërkesën në lidhje me këtë pasaportë, si dhe për të udhëtuar jashtë shtetit me atë fëmijë, pa pëlqimin e prindit tjetër, ka si objekt ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mbi fëmijën në fjalë, sipas kuptimit të nenit 1.1 (b) të Rregullores 2201/2003, lexuar në lidhje me nenin 2.7 të kësaj rregulloreje.

Gjykata sqaron se neni 12.3 (b) i Rregullores nr. 2201/2003 mbi juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet martesore dhe në çështjet e përgjegjësisë prindërore, duhet të interpretohet në kuptimin që juridiksioni i gjykatave për të shqyrtuar një padi mbi çështjet e përgjegjësisë prindërore nuk mund të konsiderohet si i pranuar shprehimisht ose në ndonjë mënyrë tjetër pa mëdyshje nga të gjitha palët në procedurë, sipas kuptimit të kësaj dispozite, me arsyetimin e vetëm se avokati *ad litem* që përfaqëson të paditurin, i emëruar zyrtarisht nga këto gjykata për shkak të pamundësisë së njoftimit të këtij të fundit për padinë dhe për fillimin e procedurave, nuk ngriti mungesën e juridiksionit të gjykatave në fjalë.

Në fakt, nga njëra anë, një pranim i tillë presupozon të paktën që i padituri të ketë dijeni për procedurat që zhvillohen para këtyre gjykatave. Nëse kjo dijeni nuk është në vetvete, pranim i juridiksionit të gjykatave para të cilave është bërë padia, i padituri në mungesë, të cilit padia nuk i është dorëzuar dhe i cili nuk është në dijeni të procedurave të filluara, në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se ka pranuar këtë kompetencë.

Nga ana tjetër, vullneti i të paditurit në procedurën kryesore nuk mund të kuptohet nga qëndrimi i një përfaqësuesi *ad litem* të caktuar nga ato gjykata në mungesë të të paditurit. Meqenëse ky përfaqësues nuk ka asnjë kontakt me të paditurin, ai nuk mund të marrë nga ky i fundit informacionin e nevojshëm për të pranuar ose kundërshtuar juridiksionin e këtyre gjykatave.

3.10. BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND kundër AZIZ HASAN

GJDBE

Çështja C-360/16

25 janar 2018

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=198763&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13710750>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Kjo çështje ka të bëjë me procedurat gjyqësore në rast të vlerësimit të një kërkesë të re për azil sipas sistemit të Dublinit, kërkesë e cila duhet të marrë parasysh në themel të gjitha faktet e reja edhe kur kërkuesi është refuzuar më parë nga ai shtet.*

Faktet kryesore

Më 29 tetor 2014, z. Aziz Hasan, shtetas sirian, aplikoi për azil në Gjermani. Nga një kërkim në sistemin Eurodac doli që po i njëjti person kishte aplikuar më parë për mbrojtje ndërkombëtare në Itali, më 4 shtator 2014. Në këto kushte, më 11 nëntor 2014, autoritetet gjermane u kërkuan autoriteteve italiane të merrnin në ngarkim z. Hasan në bazë të Rregullores Dublin III. Autoritetet italiane nuk iu përgjigjën kësaj kërkesë.

Me një vendim të 30 janarit 2015, autoritetet gjermane e hodhën poshtë si të papranueshme kërkesën e z. Hasan për azil, me argumentin se Republika Italiane ishte shteti anëtar përgjegjës për shqyrtimin e asaj kërkesë dhe urdhëroi transferimin e ankuesit në Itali. Z. Hasan e kundërshtoi këtë vendim përpara Verwaltungsgericht Trier¹⁰⁹, duke kërkuar gjithashtu edhe marrjen e një mase pezulluese kundër largimit. Kjo gjykatë e refuzoi së pari kërkesën për efekt pezullues më 12 mars 2015, dhe pastaj edhe themelin e apelit më 30 qershor 2015.

109 Gjykata Administrative, Trier, Gjermani.

Më 3 gusht 2015, z. Hasan u transferua në Itali. Megjithatë, brenda atij muaji ai u kthye në Gjermani ilegalisht dhe apeloj kundër vendimit të Verwaltungsgericht Trier. Ky apel u lejua më 3 nëntor 2015, me një vendim të Oberverwaltungsgericht Rheinland-Pfalz¹¹⁰. Kjo e fundit gjykoi se transferimi i z. Hasan në Itali kishte ndodhur pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore të parashikuar në nenin 29.1 të Rregullores Dublin III dhe se, rrjedhimisht, Republika Federale e Gjermanisë (RFGJ) ishte tashmë përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës së tij për azil.

RFGJ bëri një kërkesë për rishikim të vendimit të Oberverwaltungsgericht Rheinland-Pfalz para Bundesverwaltungsgericht¹¹¹. Kjo e fundit vlerësoi se analiza e Gjykatës së Apelit ishte e pasaktë në lidhje me llogaritjen e afatit të parashikuar në nenin 29.1 të Rregullores Dublin III dhe se sipas saj, transferimi i z. Hasan në Itali ishte bërë para skadimit të këtij afati. Sidoqoftë, Bundesverwaltungsgericht vlerësoi se përgjegjësia fillestare e Republikës Italiane për të shqyrtuar kërkesën për azil të paraqitur nga z. Hasan nuk mund të përcaktohej përfundimisht, pasi nuk përjashtohej që kjo përgjegjësi të mënjanohej, në zbatim të nenit 3.2 të Rregullores Dublin III, për shkak të mangësive të mundshme sistemike, sipas asaj dispozite, në procedurën e azilit dhe të kushteve të mbrojtjes ndërkombëtare të azilkërkuësve në Itali. Prandaj ajo theksoi se nuk do të ishte e nevojshme të vendosej për afatin 6 mujor nëse, pas kthimit të paligjshëm të z. Hasan në Gjermani, përgjegjësia për shqyrtimin e kërkesës së tij për azil ishte transferuar tashmë në RFGJ në datën e vendimit të gjykatës së apelit ose nëse procedurat e ridërgimit në Itali mund të kryheshin ende në atë datë.

Në këto kushte, Bundesverwaltungsgericht vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i parashtrijë Gjykatës një sërë pyetjesh për një vendim paraprak. Thelbi i pyetjeve drejtuar Gjykatës kishte të bënte me mundësinë e paraqitjes së fakteve dhe rrethanave që janë në themel të nevojës për mbrojtje ndërkombëtare edhe pas refuzimit administrativ ose në shkallë të parë të kërkesës. Gjithashtu, pyetjet kishin të bënin me afatet se deri kur një shtet anëtar mund t'i bëjë një kërkesë për rimarrje një shteti anëtar tjetër dhe cilat janë pasojat e skadimit të këtyre afateve.

110 Gjykata e Lartë Administrative e Landit të Rheinland-Pfalz, Gjermani.

111 Gjykata Federale Administrative, Gjermani.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se neni 27.1 i Rregullores nr. 604/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 26 qershorit 2013, që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, të paraqitur në një nga shtetet anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi, i lexuar në dritën e recitalit 19 të kësaj rregulloreje dhe të nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, duhet të interpretohet se nuk përjashton një legjislacion kombëtar, siç është ai në fjalë në procedurën në Gjermani, i cili parashikon që shqyrtimi gjyqësor i vendimit të transferimit duhet të bazohet në situatën faktike që ekziston në kohën e seancës së fundit përpara gjykatës kombëtare ose, në mungesë të një seancë, në kohën kur ajo gjykatë vendos mbi apelimin.

Neni 27.1 i Rregullores Dublin III parashikon që azilkërkuesi ka të drejtë për një ankim efektiv, në formën e një apeli kundër vendimit të transferimit ose të një rishikimi, në fakte dhe në ligj, të këtij vendimi para një gjykate. Për më tepër, nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me nenin 29 të Rregullores Dublin III rrjedh se, duke pasur parasysh, nga njëra anë, objektivin e përmendur në recitalin 19 të asaj Rregulloreje për të siguruar, në përputhje me nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore, mbrojtjen efektive të personave të interesuar dhe, nga ana tjetër, me synimin për të siguruar shpejt përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për përpunimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare të përcaktuar në paragrafin 5 të kësaj rregulloreje, azilkërkuesi duhet të ketë qasje në një mjet efektiv dhe të shpejtë që i lejon atij t'u referohet rrethanave konkrete pas miratimit të vendimit të transferimit të tij, kur marrja parasysh e këtyre rrethanave është vendimtare për zbatimin e saktë të Rregullores. Legjislacioni, siç është ai gjerman, i cili i lejon azilkërkuesit që t'u referohen rrethanave në të cilat mbështetet vendimi për transferimin gjatë apelit kundër atij vendimi, përmbush këtë detyrim për të siguruar një mjet juridik efektiv dhe të shpejtë.

Në këtë kontekst, neni 27.1 i Rregullores Dublin III nuk mund të interpretohet sikur përjashton një legjislacion të tillë, thjesht, sepse mund të bëjë që gjykata që shqyrton apelin kundër një vendimi transferimi të marrë parasysh, në një situatë të tillë si ajo në procedurën

në Gjermani, rrethanat dhe faktet jo vetëm pas miratimit të atij vendimi, por edhe pas transferimit të personit në fjalë në zbatim të atij vendimi. Rrethana të tilla nuk ka të ngjarë të jenë të rëndësishme për qëllimet e zbatimit të rregullave të përfshira në atë rregullore, të cilat, ashtu si ato të parashikuara në nenin 29 paragrafët 1 dhe 2 të saj, rregullojnë kryerjen e procedurës së ripranimit të një azilkërkuesi. Megjithatë, ekzekutimi i transferimit, i cili përbën thjesht zbatimin e vendimit të transferimit, nuk mund të përcaktojë përfundimisht përgjegjësinë e shtetit anëtar në të cilin transferohet azilkërkuesi.

Neni 24 i Rregullores nr. 604/2013 duhet të interpretohet ashtu që, në një situatë të tillë si ajo para gjykatave gjermane, në të cilën një shtetas i një vendi të tretë, pasi ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në shtetin anëtar, transferohet në atë shtet anëtar pas refuzimit të një kërkesë të re të paraqitur në një shtet anëtar tjetër, pastaj kthehet, pa leje qëndrimi, në territorin e këtij të fundit, ky shtetas mund t'i nënshtrohet një procedure të re kthimi, por nuk është e mundur të kryhet një transferim i ri i këtij personi në të parin nga këto shtete anëtare pa u ndjekur një procedurë e tillë.

Lidhur me hapat proceduralë që duhen ndjekur, Gjykata kujton se, ndërsa neni 23 i kësaj rregulloreje rregullon situatat, në të cilat një kërkesë e re për mbrojtje ndërkombëtare është paraqitur në shtetin anëtar, neni 24 i asaj rregulloreje lidhet me rastet në të cilat asnjë aplikim i ri nuk është paraqitur në atë shtet anëtar. Nga kjo rrjedh se një person si parashtruesi, i cili, pasi ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një shtet anëtar, kthehet ilegalisht në territorin e një shteti anëtar tjetër pa paraqitur një kërkesë të re për mbrojtje ndërkombëtare në këtë shtet, mund të i nënshtrohet procedurës së parashikuar në nenin 24 të Rregullores Dublin III.

Fakti që një person i tillë, gjatë qëndrimit të parë në territorin e shtetit të dytë anëtar, në Gjermani në këtë rast, ka paraqitur ndërkaq një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, e cila është refuzuar në përputhje me nenin 26.1 të kësaj Rregulloreje, nuk e ndryshon këtë analizë. Po kështu, fakti që vendimi që refuzon një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur gjatë qëndrimit të parë në territorin e shtetit anëtar në fjalë, është në shqyrtim në apel nuk mund të përjashtojë zbatimin e nenit

24 të Rregullores Dublin III si ajo e parashtruesit, pasi, në mungesë të efektit pezullues të apelit, ai vendim rikthimi konsiderohet se prodhon efektet e tij.

Për më tepër, duke pasur parasysh që ligjvënësi i BE-së ka parashikuar, në nenin 24 të Rregullores Dublin III, një procedurë specifike të zbatueshme për një shtetas të një vendi të tretë, siç është rasti i parashtruesit, e cila përfshin në veçanti kërkesën e shtetit anëtar brenda një afati, skadimi i të cilit mund të ndikojë në situatën e këtij personi, ky i fundit nuk mund të transferohet në një shtet anëtar tjetër, pa përfunduar kjo procedurë, në bazë të një vendimi transferimi të mëparshëm, i cili tashmë është zbatuar në të shkuarën.

Neni 24.2 i Rregullores nr. 604/2013 duhet të interpretohet në kuptimin që, në një situatë të tillë si ajo në fjalë në procedurën kryesore, në të cilën një shtetas i një vendi të tretë është kthyer ilegalisht në territorin e një shteti anëtar (Gjermanisë në këtë rast) që e ka transferuar atë në një shtet anëtar tjetër në të kaluarën (Itali në këtë rast), kërkesa për ta pranuar atë duhet të dërgohet brenda afateve kohore të parashikuara në këtë dispozitë dhe ato nuk mund të fillojnë të ecin derisa shteti anëtar kërkues (Gjermania në këtë rast) të mos ketë dijeni për kthimin e personit në fjalë në territorin e tij.

Meqenëse ligjvënësi i BE-së nuk bën dallim, në nenin 24 të asaj rregulloreje, midis situatave në të cilat procedura e rimarrjes fillon për herë të parë dhe atyre në të cilat kjo procedurë rifillon pas kthimit, pa një leje qëndrimi, të personit të interesuar në shtetin anëtar kërkues pas një transferimi, afatet kohore të përcaktuara në këtë nen duhet të respektohen edhe në rastin e fundit.

Lidhur me llogaritjen e këtyre afateve kohore, është e rëndësishme të theksohet se ato kanë për qëllim të sigurojnë një kuadër për procedurën e rimarrjes dhe të kontribuojnë në përpunimin e shpejtë të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare duke siguruar që procedura e rimarrjes do të zbatohet pa vonesa të panevojshme. Për këtë qëllim, afatet kohore sigurojnë që shteti anëtar kërkues të fillojë procedurën e rimarrjes brenda një periudhe të arsyeshme kohore nga momenti kur ka informacionin që i mundëson atij t'i drejtohet me një kërkesë për

rimarrje një shteti anëtar tjetër. Këto afate ndryshojnë sipas natyrës së këtij informacioni. Kjo do të thotë se nuk është e logjikshme që i njëjti afat të fillojë të ecë në një datë në të cilën shteti anëtar kërkues nuk kishte informacionin që i mundësonte atij të fillonte procedurën e marrjes në dorëzim.

Neni 24.3 i Rregullores nr. 604/2013 duhet kuptuar se kur kërkesa për rimarrje nuk bëhet brenda afateve kohore të parashikuara në nenin 24.2 të kësaj Rregulloreje, shteti anëtar në territorin e të cilit gjendet ilegalisht personi në fjalë, është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së re për mbrojtje ndërkombëtare, që ky person duhet të ketë të drejtë ta paraqesë.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se, nëse neni 24.3 i Rregullores Dublin III do të interpretohej vetëm sikur personi duhet të ketë të drejtë të bëjë një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, por pa përcaktuar shtetin anëtar përgjegjës për shqyrtimin e asaj kërkesë, ajo dispozitë do të ishte e privuar nga çdo efekt i dobishëm.

Neni 24.3 i Rregullores nr. 604/2013 duhet të interpretohet ashtu që fakti që procedura e apelit e filluar kundër një vendimi që refuzon kërkesën e parë për mbrojtje ndërkombëtare të paraqitur në një shtet anëtar nuk ka përfunduar ende, nuk duhet të konsiderohet si e barasvlershme me paraqitjen e një kërkesë të re për mbrojtje ndërkombëtare në atë shtet anëtar, sipas kuptimit të kësaj dispozite.

Neni 24.3 i Rregullores nr. 604/2013 duhet të interpretohet ashtu që, kur kërkesa për rimarrje nuk bëhet brenda afateve kohore të parashikuara në nenin 24.2 të kësaj Rregulloreje dhe ankuesi ka nuk ka përdorur të drejtën që duhet të ketë për të bërë një kërkesë të re për mbrojtje ndërkombëtare, atëherë shteti anëtar në territorin e të cilit ky person ndodhet ilegalisht ende mund të paraqesë një kërkesë për rimarrje. Gjithashtu kjo dispozitë nuk autorizon transferimin e personit në fjalë në një shtet tjetër anëtar, pa bërë një kërkesë të tillë. Përderisa ligjvënësi i BE-së nuk i ka njohur skadimit të afateve të përcaktuara në nenin 24.2 të Rregullores ndonjë efekt tjetër, duhet të merret parasysh se, në rastet kur personi në fjalë nuk ka bërë kërkesë të re, shteti anëtar në territorin e të cilit ndodhet personi, vendos, nëse është e nevojshme, për të filluar

një procedurë rimarrjeje që synon kthimin e këtij personi në territorin e shtetit anëtar, në të cilin ai ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh, nga njëra anë, që shtetit anëtar përgjegjës i kërkohet, në përputhje me nenin 18.1 (b) deri (d) të Rregullores Dublin III, të marrë përsipër personin në fjalë në kushtet të parashikuara në nenet 23 deri në 25 dhe 29 të kësaj Rregulloreje dhe, nga ana tjetër, që asnjë nga këto nene nuk parashikon transferimin e këtij personi në mungesë të marrëveshjes, të shprehur ose të nënkuptuar, të shtetit anëtar të kërkuar për atë qëllim, neni 24.3 i Rregullores nuk mund të kuptohet si autorizim i një shteti anëtar për të vazhduar me transferimin e atij personi në një shtet anëtar tjetër pa bërë një kërkesë për rimarrje.

3.11. A. K. kundër. KRAJOWA RADA SĄDOWNICTWA DHE C.P. DHE D.O. kundër SĄD NAJWYŻSZY

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështjet e bashkuara C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18

19 nëntor 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=220770&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13710867>]

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: Ky vendim ka të bëjë me nocionin e pavarësisë dhe paanësisë së një organi që vendos mbi karrierën e gjyqtarëve polakë.

Faktet kryesore

Në çështjen C-585/18, A.K., ishte gjyqtar i Naczelny Sąd Administracyjny,¹¹² i cili kishte mbushur 65 vjeç para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Gjykatën Supreme. Në bazë të nenit 37.1,

¹¹² Gjykata Supreme Administrative në Poloni.

dhe nenit 111.1, të këtij ligji, ai deklaroi se dëshironte të vazhdonte të ushtronte funksionin e tij si gjyqtar. Më 27 korrik 2018, Krajowa Rada Sądownictwa¹¹³ (në tekstin e mëtejme: KRS), në përputhje me nenin 37.1 (a) të ligjit në fjalë, dha një opinion negativ në lidhje me deklaratën. Më 10 gusht 2018, A.K. apeloi në Sąd Najwyższy¹¹⁴ kundër këtij opinionit. Në mbështetje të apelit, A.K. argumentoi sidomos se nxjerrja e tij e parakohshme në pension në moshën 65-vjeçare shkelte nenin 19.1, nënparagrafin 2, të TBE-së dhe nenin 47 të Kartës Themelore të të Drejtave (në tekstin e mëtejme: Karta), si dhe Direktivën 2000/78, në veçanti, nenin 9.1 të saj.

Në çështjet C-624/18 dhe C-625/18, C.P. dhe D.O. ishin të dy gjyqtarë të Sąd Najwyższy, të cilët e kishin mbushur moshën 65-vjeçare para datës së hyrjes në fuqi të ligjit të ri për Gjykatën Supreme. Ata kishin bërë gjithashtu një deklaratë sipas nenit 37.1 dhe nenit 111.1, të këtij ligji, ku theksuan se dëshironin të vazhdonin të ushtronin funksionin e tyre si gjyqtarë. Pasi u informuan se Presidenti i Republikës, në zbatim të nenit 39 të ligjit në fjalë, kishte vendosur ndërprerjen e mandatit të tyre që nga 4 korriku 2018, ata iu drejtuan Sąd Najwyższy me padi të drejtuar kundër Presidentit, që synonin të vërtetohej se marrëdhënia e tyre e punës si gjyqtar në shërbimin aktiv brenda gjykatës në fjalë nuk ishte shndërruar, që nga ajo datë, në një marrëdhënie pune si gjyqtar në pension i së njëjtës gjykatë. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, ata theksojnë, në veçanti, shkelje të nenit 2.1 të Direktivës 2000/78 që ndalon diskriminimin në bazë të moshës.

Izba Pracy i Ubezpieczeń Społecznych¹¹⁵ (në tekstin e mëtejme: “Dhoma e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore”), para së cilës janë në shqyrtim e sipër këto tri ankesa, vendosi që t’i drejtohej me kërkesa për vendim paragjykimor GJDBE-së, ndërkohë që Dhoma Disiplinore nuk ishte krijuar ende. Në kërkesën e saj, gjykata referuese pyeti nëse neni 9.1 i Direktivës 2000/78 dhe neni 47 i Kartës kërkojnë që ajo të lërë mënjanë dispozitat kombëtare të cilat i kërkojnë që të mos i marrë në shqyrtim këto ankesa. Gjykata në fjalë nënvizoi, megjithatë, se kjo pyetje mund të

113 Këshilli Kombëtar Gjyqësor në Poloni.

114 Gjykata Supreme Polake.

115 Dhoma e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore e Gjykatës Supreme.

pushojë së qeni e rëndësishme në rast të ndarjes efektive të posteve të gjyqtarit brenda dhomës disiplinore. Për më tepër, në vendimet e saj për kërkesë paragjykimore, gjykata referuese vlerëson se, duke pasur parasysh sidomos rrethanat, në të cilat duhet të bëhet emërimi i gjyqtarëve të rinj të Dhomës Disiplinore, ka dyshime serioze nëse kjo dhomë dhe anëtarët e saj do të ofrojnë garanci të mjaftueshme të pavarësisë dhe paanësisë.

Gjykata referuese kujtoi se këta gjyqtarë të Dhomës Disiplinore emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të KRS-së. Ajo theksoi se, në bazë të reformës të miratuar me Ligjin e 8 dhjetorit 2017 për ndryshimet në Ligjin për Këshillin Kombëtar të Gjyqësorit dhe në disa ligje të tjera, pesëmbëdhjetë anëtarët e KRS-së, nga njëzet e pesë në total, që duhet të jenë gjyqtarë, nuk zgjidhen më, si më parë, nga asambljetë e përgjithshme të gjyqtarëve në të gjitha nivelet, por nga Dieta¹¹⁶. Sipas gjykatës referuese, kjo situatë minon parimin e ndarjes së pushteteve si bazë e sundimit demokratik të ligjit dhe nuk përputhet me standardet ndërkombëtare dhe evropiane që mbizotërojnë në këtë fushë, siç është e qartë, në veçanti, nga rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve, i 17 nëntorit 2010, të Opinionit nr. 904/2017 (CDL-AD (2017) 031) të Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), të 11 dhjetorit 2017, dhe Opinioni nr.10 (2007) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë drejtuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi Këshillat e Drejtësisë në shërbim të shoqërisë”, i 23 nëntorit 2007.

Për më tepër, të dyja kushtet, në veçanti ato procedurale, për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të KRS-së gjatë vitit 2018 dhe analiza e mënyrës në të cilën ka vepruar deri më tani ky organ, i konstituuar kështu, zbulon një ekspozim të KRS-së ndaj pushtetit politik dhe paaftësinë e tij për të ushtruar misionin e vet kushtetues për të siguruar pavarësinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve.

Gjithashtu, zgjedhjet e fundit për anëtarët e rinj të KRS-së duket se janë zhvilluar në mënyrë jotransparente dhe ka dyshime serioze në

116 Parlamenti Polak.

lidhje me pajtueshmërinë efektive, gjatë këtyre zgjedhjeve, me kërkesat e parashtruara nga legjislacioni në fuqi. Kriteret e përfaqësimit të llojeve dhe niveleve të ndryshme të gjykatave që rrjedhin nga neni 187 paragrafët 1 dhe 2 i Kushtetutës gjithashtu nuk janë respektuar. Në të vërtetë, KRS nuk do të kishte më, në mesin e saj, asnjë gjyqtar të zgjedhur nga Sąd Najwyższy, nga gjykatat e apelit ose nga gjykatat ushtarake, por përfshinte një përfaqësues të një gjykate administrative të rajonit, dy përfaqësues të gjykatave të qarkut dhe dymbëdhjetë përfaqësues të gjykatave të rrethit. Nga ana tjetër, një shqyrtim i aktiviteteve të KRS-së së sapoformuar tregonte për një mungesë tërësore të pozicioneve të miratuara nga ky organ me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë së Sąd Najwyższy në kontekstin e krizës së krijuar nga legjislacioni i reformave të fundit që kishte të bënte me këtë juridiksion. Nga ana tjetër, KRS-ja ose anëtarët e saj kanë kritikuar publikisht anëtarët e Sąd Najwyższy për bërjen e pyetjeve paraprake në GJDBE ose për bashkëpunimin me institucionet e BE-së, veçanërisht me Komisionin Evropian. Për më tepër, praktika e ndjekur nga KRS kur i kërkohet të japë një opinion mbi vazhdimin e mundshëm të funksioneve të një gjyqtari të Sąd Najwyższy përtej moshës së pensionit të vendosur rishtas në 65 vjet, konsiston, siç tregon sidomos çështja C-585/18, në dhënien e opinioneve negative pa arsytim ose thjesht riprodhimin e formulimit të nenit 37 (1b) të Ligjit të ri për Gjykatën Supreme.

Për më tepër, përzgjedhja e bërë nga KRS për të plotësuar gjashtëmbëdhjetë postet e gjyqtarëve brenda Dhomës Disiplinore, të shpallur vakante më 24 maj 2018 nga Presidenti i Republikës zbuloi se dymbëdhjetë kandidatët e përzgjedhur nga KRS, përkatësisht gjashtë prokurorë, dy gjyqtarë, dy këshilltarë ligjorë dhe dy akademikë, ishin ose njerëz që më parë kishin pasur poste në pushtetin ekzekutiv, ose njerëz të cilët, gjatë krizës së shtetit të së drejtës në Poloni, vepruan me urdhër të qeverisë politike ose në një mënyrë që përputhej me pritshmëritë e kësaj të fundit, domethënë, përfundimisht, njerëz që nuk plotësojnë kriteret ligjore ose njerëz që kanë pasur sanksione disiplinore në të kaluarën.

Së fundi, gjykata referuese theksoi se procedura në të cilën KRS-ja thirret për të zgjedhur kandidatët për postin e gjyqtarit të Dhomës Disiplinore, është projektuar dhe modifikuar më pas në mënyrë të tillë

që KRS të mund të veprojë sipas diskrecionit të saj, pa pasur ndonjë mundësi reale kontrolli në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, së pari, Gjykata Supreme nuk do të thirrej më për t'u shprehur në këtë proces emërimi dhe, kështu, vlerësimi efektiv dhe konkret i meritave të kandidatëve nuk do garantohej më. Së dyti, mosdorëzimi nga kandidatët i dokumenteve të përmendura në nenin 35.2 të Ligjit të KRS-së, të cilat janë thelbësore për qëllimet e vlerësimit të kandidatëve, nuk përbën më, sipas nenit 35. 3, të atij ligji një pengesë për hartimin e listës së kandidatëve të rekomanduar nga KRS. Së treti, sipas nenit 44 të ligjit në fjalë, vendimet e KRS-së do të ishin përfundimtare nëse nuk kundërshtoheshin nga të gjithë kandidatët, gjë që do të përjashtonte çdo mundësi efektive të shqyrtimit gjyqësor të tyre.

Në këtë kontekst, Sąd Najwyższy si gjykatë referuese shqetësohej mbi rëndësinë që duhet t'i kushtohet, në lidhje me respektimin e standardit që buron nga e drejta e BE-së, për pavarësinë e gjykatave dhe gjyqtarëve të shteteve anëtare, dhe veçanërisht faktorëve të tillë si, pavarësia nga pushteti politik e organit përgjegjës për përzgjedhjen e gjyqtarëve, dhe, nga ana tjetër, procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të një organi gjyqësor të krijuar *ex nihilo* në një shtet anëtar të caktuar, organ që është kompetent për të dhënë vendime që përfshihen në të drejtën e Unionit. Në këtë drejtim, Gjykata referuese kërkon të dijë që, nëse një organ i tillë gjyqësor nuk e plotëson kërkesën e pavarësisë, a duhet të interpretohet e drejta e BE-së sikur kërkon që të përjashtohet zbatimi i dispozitave të ligjit kombëtar, të cilat ia rezervojnë këtë kompetencë këtij organi gjyqësor, duke ndryshuar të gjitha rregullimet e mëparshme ligjore në këtë drejtim. Në këto kushte, Dhoma e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore vendosi të pezullojë procedimin dhe t'i drejtojë një sërë pyetjesh në këtë kuadër GJDBE-së, thelbi i të cilave është si më poshtë.

Sąd Najwyższy pyeti së pari nëse duhet që neni 267.3 i TFBE-së, i lexuar së bashku me nenin 19.1, dhe nenin 2 të TBE-së, si dhe nenin 47 të Kartës, të interpretohet në mënyrë që një organ gjyqësor që krijohet *ex nihilo* brenda një gjykate të shkallës së fundit të një shteti anëtar, kompetent për të shqyrtuar mosmarrëveshjet në lidhje me një gjyqtar të një gjykate kombëtare, në të cilin bëjnë pjesë vetëm gjyqtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar Gjyqësor, i cili, për shkak të modelit të tij kushtetues dhe mënyrës së funksionimit, nuk ofron garanci të

pavarësisë në raport me pushtetet legislative dhe ekzekutive, përbën një gjykatë të pavarur në kuptimin e së drejtës së BE-së?

Nëse pyetjes së parë i jepet përgjigje negative, gjykata referuese pyet nëse neni 267. 3 i TFBE-së, i lexuar bashkë me nenin 19.1, dhe nenin 2 të TBE -së, si dhe nenin 47 të Kartës, duhet të interpretohen sikur kuptojnë që edhe pse lloji i mosmarrëveshjes në fjalë normalisht ishte në kompetencën e Dhomës Disiplinore, të sapokrijuar brenda Gjykatës Supreme, për shkak të dyshimeve për pavarësinë e atij organi, duhej të linte mënjane rregullat kombëtare për kompetencat juridiksionale dhe, nëse ishte e nevojshme, ajo vetë të shqyrtonte themelin e këtyre mosmarrëveshjeve.

Edhe pse, pas një ndryshimi të fundit, ky ligj nuk kishte të bëjë më me gjyqtarët të cilët, ashtu si ankuesit në procedurën kryesore, ishin ndërkaq në detyrë në Gjykatën Supreme kur hyri në fuqi dhe që, rrjedhimisht, ata gjyqtarë vazhduan ose u rivendosën në funksionet e tyre, gjykata referuese ende vlerësoi se ishte përpara një problemi të një natyre procedurale.

Vendimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata, pasi konfirmoi zbatueshmërinë, në këtë rast, si të nenit 47 të Kartës, ashtu edhe të nenit 19.1, nënparagrafi 2, të TBE-së, kujtoi se kriteri i pavarësisë së gjykatave është pjesë thelbësore e së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore dhe e së drejtës themelore për një gjykim të drejtë, të drejta të cilat në vetvete janë të një rëndësie themelore si garantues të mbrojtjes së të gjitha të drejtave që palëve ndërgjyqëse u burojnë nga e drejta e BE-së dhe nga vlerat e përbashkëta që shtetet anëtare duhet të respektojnë sipas nenit 2 të TBE-së, në veçanti vlerën e shtetit të së drejtës. Më pas, ajo kujtoi në detaje praktikën e saj gjyqësore mbi fushëveprimin e kësaj kërkesë të pavarësisë dhe vuri sidomos në dukje se, në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve që karakterizon funksionimin e një shteti të sunduar nga ligji, pavarësia e gjykatave duhet të jetë e garantuar në lidhje me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv.

Në vijim, Gjykata nënvizoi elementet specifike që duhet të shqyrtohen nga gjykata referuese në mënyrë që t'i mundësojë asaj të vlerësojë

nëse Dhoma Disiplinore e Gjykatës Supreme ofron apo jo garanci të mjaftueshme të pavarësisë.

Së pari, Gjykata tregoi se vetëm fakti që gjyqtarët e Dhomës Disiplinore emërohen nga Presidenti i Republikës nuk ka të ngjarë të krijojë varësi nga pushteti politik, as të krijojë dyshime për paanësinë e tyre, nëse, pasi të emërohen, ata nuk i nënshtrohen asnjë presioni dhe nuk marrin udhëzime në ushtrimin e funksioneve të tyre. Për më tepër, pjesëmarrja paraprake e Këshillit Gjyqësor Kombëtar, përgjegjës për propozimin e gjyqtarëve për emërimin e tyre, ka të ngjarë të ngushtojë objektivisht hapësirën e Presidentit të Republikës, me kusht që, megjithatë, ai organ të jetë mjaft i pavarur në lidhje me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv si dhe me Presidentin e Republikës.

Në këtë drejtim, Gjykata sqaroi se ishte e rëndësishme të merreshin parasysh si elementet faktike, ashtu edhe ato juridike, që lidhen me kushtet në të cilat u emëruan anëtarët e Këshillit të ri Gjyqësor Polak, mënyrën sipas së cilës u emërua dhe se si e përmbush konkretisht rolin e tij si gardian i pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve. Kështu për shembull, Gjykata konstatoi se anëtarët e rinj të KRS-së u zgjodhën pas ndërprerjes së mandatit 4-vjeçar të anëtarëve të mëparshëm. Ajo vuri re gjithashtu se sipas formulës së parashikuar nga reforma, 23 nga 25 anëtarët që e përbëjnë aktualisht KRS-në mund të zgjidhen drejtpërdrejt nga pushteti politik. Në vijim, Gjykata konstatoi se kishte pretendime për parregullsi në procedurën e zgjedhjes së disa anëtarëve të KRS-së. Gjykata gjithashtu tregoi se ishte e nevojshme të verifikohej nëse mund të ushtrohej një kontroll gjyqësor mbi parregullsitë e pretenduara të përzgjedhjes së anëtarëve të KRS-së dhe pastaj edhe të mendimeve të saj¹¹⁷.

Së dyti, Gjykata shqyrtoi elemente të tjera që karakterizojnë më drejtpërdrejt Dhomën Disiplinore të Gjykatës Supreme (KRS). Për shembull, Gjykata kujtoi se, ajo Dhomë u krijua në një kohë dhe në kontekstin e miratimit të dispozitave të ligjit të ri për Gjykatën Supreme, të cilin për më tepër ajo e ka shpallur ndërkaq në kundërshtim me

117 Gjykata i referohet GJEDNJ në vendimin e 18 tetorit 2018, *Thiam kundër Francës*, paragrafët 25 dhe 81.

të drejtën e BE-së¹¹⁸. Ishte e rëndësishme të theksohej se Dhomës Disiplinore të Gjykatës Supreme iu dha juridiksion ekskluziv për të shqyrtuar mosmarrëveshjet në lidhje me nxjerrjen në pension të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, në zbatim të këtij ligji.

Së treti, Gjykata vuri re gjithashtu se Dhoma Disiplinore duhet të përbëhet vetëm nga gjyqtarë të sapoemëruar, duke larguar të gjithë gjyqtarët që ishin pjesë e saj deri në atë kohë. Për më tepër, megjithëse e krijuar si një dhomë brenda Gjykatës Supreme, KRS duket se gëzon një shkallë veçanërisht të lartë të autonomisë brenda kësaj Gjykate.

Gjykata ka specifikuar se, ndonëse secili nga elementët e shqyrtuar, të marrë në mënyrë të izoluar, nuk është domosdoshmërisht i tillë që të vërë në dyshim pavarësinë e këtij organi, konkluzioni është i ndryshëm kur këta elementë merren në shqyrtim së bashku.

118 Vendimi i GJDBE i 24 qershorit 2019, *Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme)*, C - 619/18, BE: C: 2019: 531.

Neni 32

E Drejta për Mjete Juridike

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI 86/18. PARASHTRUES: SLAVICA ĐORDEVIĆ

[<https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/ki-86-18-agj-shq.pdf>]

8 mars 2021

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Rasti kishte të bënte me mospërmbarimin e dy vendimeve gjyqësore në dobi të parashtrueses në një kontest pronësor, për shkak se gjykatat e rregullta i kishin kërkuar parashtrueses së kërkesës që të paguante shpenzimet e përmbarimit (në shumën prej 19.495,42 euro). Çështja kryesore e ngritur me këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kishte të bënte me atë se a i ishin shkelur parashtrueses së kërkesës të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet në vijim: nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Faktet kryesore

Në vitin 1997 parashtruesja e kërkesës kishte filluar ndërtimin e një objekti banimi në Prizren, të cilat punime më vonë ishin ndërprerë si rezultat i luftës në Kosovë. Pas vitit 1999, parcela në fjalë ishte uzurpuar nga një person. Ky i fundit kishte ndërtuar edhe dy kate të tjera mbi konstruksionin ekzistues të objektit të banimit në ndërtim e sipër që parashtruesja e kërkesës e kishte filluar, por që nuk kishte arritur ta përfundonte. Pas luftës, parashtruesja e kërkesës në cilësi të pronares kishte paraqitur kërkesë në Komisionin për Çështje Pronësore Banësore (në tekstin e mëtejshëm: “KÇPB”) për kthimin e pronës kontestuese në posedim të saj. Përmes vendimit të KÇPB-së ishte vërtetuar se parashtruesja e kërkesës: (i) gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës që ishte objekt kryesor kontesti në këtë rast; dhe se (ii) prona në fjalë duhet t’i kthehet asaj në posedim në një afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit të KÇPB-së. Duke qenë se prona në fjalë nuk

ishte liruar nga personi që e kishte uzurpuar atë, parashtruesja e kërkesës i ishte drejtuar Gjykatës Komunale në Prizren me kërkesë që prona lëndore t'i kthehet në ripozitim. Më 21 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prizren, përmes Aktgjykimit C.nr.462/10, kishte aprovuar kërkesën e parashtrueses. Ky Aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Pas përfundimit të procedurave të lartcekura për vërtetim pronësie para gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur kërkesë për përmbarim të Aktgjykimit [C.nr.462/10] të Gjykatës Komunale në Prizren, kërkesë kjo që ishte aprovuar nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit. Lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte caktuar një kompani ndërtimore e cila kishte caktuar një shumë prej 19.495,42 eurosh për rrënimin e kateve, të cilat personi që kishte uzurpuar pronën, i kishte ndërtuar në pronën e parashtrueses së kërkesës. Parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar që të lirohej nga pagesa e shpenzimeve të përmbarimit duke u thirrur në gjendje të rëndë financiare dhe në pamundësi të pagesës së shumës prej 19.495,42 euro. Kërkesën e tillë, Gjykata Themelore në Prizren e kishte refuzuar me arsyetimin se pala debitore (personi që kishte uzurpuar pronën) nuk e kishte deponuar shumën e domosdoshme të kërkuar për ekzekutimin e punimeve lidhur me rrënimin e objektit, është rregull që në raste të këtilla, ato shpenzime t'i paguajë paraprakisht si paradhënie kreditori (që ishte parashtruesja e kërkesës në rrethana të rastit konkret). Gjykata Themelore kishte kërkuar dhënien e mendimit ligjor nga Gjykata Supreme se si duhet të veprohet në situatën kur debitori nuk paguan shpenzimet, ndërkaq që kreditori nuk ka mundësi financiare t'i paguajë ato. Më 1 shkurt 2016, Gjykata Supreme, në opinionin juridik të saj, kishte sqaruar se neni 13 paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore përcakton se "shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht paguan kreditori, ndërsa debitori detyrohet që kreditorit më vonë t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit. Si rrjedhojë, Gjykata Themelore duke u bazuar kryesisht në mendimin juridik të Gjykatës Supreme kishte obliguar parashtruesen e kërkesës që të paguante paraprakisht shpenzimet përmbarimore, duke theksuar se, nëse e njëjta nuk i paguan, atëherë Gjykata Themelore do ta pezullojë procedurën përmbarimore. Ky Vendim i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar dhe konsideruar i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit.

Më 18 qershor 2018, parashtruesja parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese i kontestoi vendimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit që kishin rezultuar me pezullimin e procedurës përmbartimore. Parashtruesja e kërkesës pretendoi se i ishin shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt]; neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive]; nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës]; nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], si dhe me nenet përkatëse të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, gjegjësisht me nenin 2, nenin 8, nenin 10 dhe nenin 17. Parashtruesja e kërkesës, në thelb, pretendoi se në këtë çështje ekzistonte një vendim përfundimtar, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.462/10, i 21 dhjetorit 2011, i cili ishte bërë përfundimtar më 19 maj 2012 dhe i cili ende nuk ishte përmbartuar, përkundër përpjekjeve të saj të vazhdueshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese konstatoi se ekzistonin dy vendime të formës së prerë, përkatësisht vendimi i KÇPB-së, i 30 prillit 2005, sa i përket të drejtës së shfrytëzimit të pronës që ishte objekt kontesti, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, i 21 dhjetorit 2011, e i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 19 maj 2012, përmes së cilit urdhërohej personi i paditur që të lironte pronën e uzurpuar dhe të njëjtën t'ia kthente parashtrueses së kërkesës në gjendje të mëparshme. Gjykata konstatoi se mospërmbartimi i vendimit të KÇPB-së, të 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 21 dhjetorit 2011, si dhe pezullimi i këtij të fundit në procedurë përmbartimore nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren, përbënin shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Gjykata arsyetoi se përmbartimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, të

garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata gjithashtu konstatoi se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbarimin e vendimit të KÇPB-së dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, kishin shkaktuar gjithashtu edhe shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektive për përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm cenonte të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuar me nenin 32 dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me të drejtën për zgjidhje efektive, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së. Gjykata theksoi se nuk ishte detyrë e saj të përcaktonte se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme që gjykatat e rregullta t'i gjenin mekanizmat efikas për të përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet që përcaktoheshin me ligj dhe Kushtetutë. Barra e përmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm binte mbi gjykatat e rregullta, në këtë rast mbi Gjykatën Themelore në Prizren.

Më tutje, Gjykata Kushtetuese konstatoi se si rezultat i mospërmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm, parashtruesja e kërkesës ishte privuar pa të drejtë nga të drejtat e saj pronësore, siç garantoheshin me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në fund, Gjykata konsideroi se nuk duhej të merrej më tej me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, sepse pretendimet dhe kërkesat e tilla ishin konsumuar nga konstatimet e Gjykatës për shkelje të neneve 31, 32, 54 dhe 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi ta shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 dhe 46 të Kushtetutës dhe të konstatonte se Vendimi i KÇPB-së, i 30 prill 2005 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, i 21 dhjetorit 2011, ishin vendime të formës së prerë dhe, si të tilla, duhet të përmbaroheshin.

1.2. KI193/18. PARASHTRUES: AGRON VULA

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/05/ki_193_18_agj_shq.pdf]

12 maj 2020

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Çështja kryesore kushtetuese në këtë rast ishte se a ishin shkelur disa të drejta kushtetuese të parashtruesit, duke përfshirë edhe të drejtën për mjet juridik (neni 32 i Kushtetutës), për shkak të faktit se ai ishte pezulluar përkohësisht nga puna në Komunën e Gjakovës, në vitin 2003 dhe që nga ajo kohë kishte mbetur me status të pezulluar. Kjo, përkundër faktit se në vitin 2008 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës i kishte kërkuar punëdhënësit, përkatësisht Komunës së Gjakovës, që të zhvillonte procedurë disiplinore ndaj parashtruesit dhe parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar në vazhdimësi procedura gjyqësore për realizimin e të drejtave të tij.

Faktet kryesore

Në vitin 2003 Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Gjakovës kishte nxjerrë aktvendim për “suspendimin e përkohshëm” të parashtruesit të kërkesës nga vendi i punës Shefi i Preventivës dhe Hulumtimit të Zjarrit, duke filluar nga 20 gushti 2003 e deri në përfundimin e procedurës për konstatim të përgjegjësisë së tij disiplinore. Parashtruesi kishte pasur marrëdhënie pune me kohë të caktuar, sipas praktikës së atëhershme. Parashtruesi i kërkesës kishte filluar procedurë gjyqësore për të shfuqizuar vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv, të cilën e kishte fituar në Gjykatën Komunale në Gjakovë, por e kishte humbur në Gjykatën e Apelit dhe atë Supreme. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës ishte ankuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: “KPMK”). Më 25 shkurt 2008, KPMK-ja kishte nxjerrë Vendimin A 02 158/2005 me të cilën kishte miratuar pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte urdhëruar Komunën e Gjakovës që ta zhvillonte një procedurë disiplinore të re ndaj parashtruesit të kërkesës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. KPMK-ja kishte konstatuar se suspendimi i parashtruesit ishte bërë në kundërshtim me procedurën e paraparë me

Urdhëresën Administrative përkatëse lidhur me zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërkohë, për çështjen e parashtruesit të kërkesës ishin zhvilluar disa procedura administrative, kontestimore dhe përmbarimore, ku ishin nxjerrë një mori vendimesh në dobi por edhe në dëm të parashtruesit të kërkesës. Gjatë kësaj kohe, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur dy kërkesa edhe në Gjykatën Kushtetuese, të cilat ishin shpallur të papranueshme (njëra për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike dhe tjetra si qartazi e pabazuar). Vendimi i fundit në çështjen e parashtruesit të kërkesës ishte Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, i 18 shtatorit 2018, përmes së cilit kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e papranueshme për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (për shkak të faktit se parashtruesi kishte nisur vazhdimisht procedura gjyqësore për të realizuar të drejtën e tij).

Më 17 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së, nr. A 02 158/07, i 25 shkurtit 2008, nga Komuna e Gjakovës përbënte shkelje të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], në lidhje me nenet 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë të 19 dhjetorit 2012 dhe 29 tetorit 2014, kishin vërtetuar se Vendimi i KPMK-së, i 25 shkurtit 2008, ishte i formës së prerë dhe i përmbarueshëm. Ndërsa, sipas parashtruesit, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr.1459/15, i 26 tetorit 2015, kishte refuzuar prapësimin e debitorit, Komunës së Gjakovës dhe kishte vërtetuar aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 19 dhjetorit 2012 dhe 29 tetorit 2014. Sipas parashtruesit të kërkesës, vendimet e sipërpërmendura të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë kishin vërtetuar se Vendimi i KPMK-së, i 25 shkurtit 2008, ishte i formës së prerë dhe

i përmbarueshëm. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se vendimi i katërt i Gjykatës së Apelit, i 18 shtatorit 2018, kishte prishur vendimin e formës së prerë të KPMK-së, që më herët ishte vërtetuar me aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, të 26 tetorit 2015.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht theksoi qëndrimin e saj parimor se KPMK-ja është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutë, gjegjësisht në pajtim me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga vendimet e këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për të gjitha institucionet përkatëse, ku statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, KPMK-ja ka tiparet e një gjykate, gjegjësisht tribunali për shërbyesit civilë, në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, vendimet e KPMK-së janë të detyrueshme. Më tutje, Gjykata konstatoi se vendimi i KPMK-së ishte vërtetuar në procedurë përmbarimore nga Gjykata e Apelit, si shkallë e fundit, me aktvendimet e 26 tetorit 2015, përkatësisht 4 dhjetorit 2017. Këto aktvendime të Gjykatës së Apelit po ashtu kishin vërtetuar aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 31 tetorit 2014, përkatësisht 27 shkurtit 2015, të cilat kishin lejuar përmbarimin e vendimit të KPMK-së.

Gjykata Kushtetuese sqaroi se vendimi i KPMK-së nuk kishte përcaktuar se Komuna e Gjakovës duhej ta kthente parashtruesin e kërkesës në vendin e punës, por KPMK-ja kishte urdhëruar Komunën e Gjakovës që procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës ta zhvillonte në pajtim me ligjin për shërbyesit civilë. Sidoqoftë, Gjykata vuri theksin në faktin se përkundër përpjekjeve të pareshtura të parashtruesit të kërkesës që vendimi i KPMK-së të përmbarohej, ai vendim as pas 10 vitesh nuk ishte zbatuar asnjëherë dhe as nuk ishte shfuqizuar. Gjykata po ashtu mori në konsideratë përgjigjen e Komunës së Gjakovës se, duke qenë se parashtruesit të kërkesës i kishte skaduar kohëzgjatja e kontratës së punës, ndaj tij nuk ka mundur ta zhvillohej procedura disiplinore. Sidoqoftë, Gjykata vuri theksin në konstatimin e dhënë në Vendimin e KPMK-së, se suspendimi i parashtruesit nga vendi i punës, nga ana

e Komunës së Gjakovës, ishte bërë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi. Prandaj, sipas Gjykatës, efekti i aktvendimit joligjor të Komunës së Gjakovës për suspendimin e përkohshëm të parashtruesit të kërkesës nga vendi i tij i punës do duhej të sanohej duke u zbatuar Vendimi i KPMK-së. Aq më tepër kur përmbarueshmëria e vendimit të KPMK-së ishte konfirmuar me disa aktvendime të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe të Gjykatës së Apelit.

Gjykata Kushtetuese theksoi se përmbarimi i një vendimi të formës së prerë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar nenin 31 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, Gjykata arsyetoi se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, mungesa e efektivitetit të procedurave dhe moszbatimi i vendimeve nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës) – parim ky të cilin të gjitha autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara ta respektojnë.

Për sa i përket pretendimeve për cenim të së drejtës për mjete juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, përcaktojnë se sistemi juridik duhet të vë në dispozicion një mjet efektiv juridik që autorizon organin kompetent të adresojë thelbin e një pretendimi për shkelje të Kushtetutës. Në dritën e kësaj, Gjykata vuri në pah se duke kërkuar përmbarimin e vendimit të KPMK-së, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar disa herë gjykatave të rregullta si dhe vetë Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, Gjykata ritheksoi se, në procedurën përmbarimore, gjykatat e rregullta (të shkallës së parë dhe të dytë), kishin nxjerrë disa vendime në dobi të parashtruesit – që lejuan përmbarimin e aktvendimit të KPMK-së – dhe disa vendime të kundërta. Parashtruesi kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion për përmbarimin e aktvendimit të KPMK-së. Megjithatë, pavarësisht përpjekjes së tij, ai aktvendim nuk ishte përmbaruar as nga organet kompetente të Komunës së Gjakovës dhe as nga gjykatat kompetente. Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjeti se mjetet juridike të përdorura nga parashtruesi i kërkesës nuk kishin pasur ndonjë efekt praktik në situatën e tij. Gjykata u shpreh se mosekzistimi i mjeteve juridike

apo mekanizmave të tjerë efektive për përmbartimin e aktvendimit të KPMK-s (pavarësisht se cili do të ishte epilogu për parashtruesin nga përmbartimi i atij aktvendimi), cenonte të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuar me nenin 32 dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me të drejtën për zgjidhje efektive, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së.

Për sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve të tjera kushtetuese, Gjykata Kushtetuese theksoi se vendimi i KPMK-së nuk kishte përcaktuar që Komuna e Gjakovës duhej ta kthente parashtruesin e kërkesës në vendin e punës, por kishte urdhëruar Komunën e Gjakovës që procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës ta zhvillonte në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për shërbyesit civilë. Prandaj, Gjykata nuk trajtoi çështjen nëse parashtruesi i kërkesës duhet të kthehet, ose jo, në vendin e punës, përkatësisht nëse është cenuar neni 49 i Kushtetutës.

Në fund, Gjykata Kushtetuese sqaroi se, ndonëse moszbatimi i Vendimit të KPMK-së përbënte shkelje të garancive procedurale të parapara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, zbatimi i tij në rastin konkret mund të ishte i pamundur për arsye objektive. Kjo sepse mund të ishte objektivisht e pamundur që të zhvilloheshin procedura disiplinore, siç është kërkuar me Vendimin e KPMK-së të vitit 2008, sidomos për shkak se parashtruesi i kërkesës ka pasur marrëdhënie të punës me kohëzgjatje të caktuar. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit nën shqyrtim, Gjykata ishte e detyruar të mjaftohej me konstatimin e shkeljes së neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6.1 dhe 13 të KEDNJ-së, duke e udhëzuar parashtruesin e kërkesës në procedurë civile pranë gjykatave të rregullta, për kompensim eventual të dëmit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se mospërmbartimi i Vendimit të KPMK-së, A 02 158/2005, të 25 shkurtit 2008, ka shkaktuar shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe të udhëzojë parashtruesin e kërkesës në procedurë civile për kompensim eventual të dëmit.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TE GJYKATËS EVROPIANE PER TE DREJTAT E NJERIUT

2.1. MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERËT kundër SHQIPËRISË

[604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

31 korrik 2012

Çështja kyçele drejta e pretenduar: moszbatimi i vendimeve administrative të formës së prerë për kompensim në vend të kthimit të pronës; mungesa e mjetit të brendshëm ligjor efektiv që të mundësonte kompensim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për shkak të moszbatimit të zgjatur të vendimeve të Komisionit që jepnin kompensim; moszbatimi i vendimeve të favorshme administrative të formës së prerë.

Faktet kryesore

Çështja e ka zanafillën në tetë kërkesa (nr. 604/07, 43628/07, 34770/09) kundër Republikës së Shqipërisë nga njëzet shtetas shqiptarë, M. Puto, S. Puto, K. Puto, S. Puto dhe A. Puto (nr. 604/07), B. Dani, F. Dani, Fi.Dani, B. Dani, Gj. Dani, V. Dani, A. Dani dhe Ad. Dani, (nr. 43628/07), N. Ahmatas, M. Kreka, T. Kadiu, D. Kadiu, R. Kadiu dhe I. Kadiu (nr. 46684/07) dhe Sh. Muka (nr. 34770/09) (kërkuesit) përkatësisht më 16 nëntor 2006, 4 tetor 2007, 9 tetor 2007 dhe 18 qershor 2009.

Kërkesa nr. 604/07: Puto

Kërkuesit kanë lindur më 1925, 1925, 1929, 1958 dhe 1964. Të gjithë jetojnë në Shqipëri. Më 27 korrik 1995, Komisioni i Vlorës njohu titullin e pronës së trashëguar të kërkueseve ndaj një parcele toke 5,000 metra katrorë. Më tej vendosi që kërkuesit të kompensoheshin në një prej formave të parashikuara me ligj. Në vitet 1995, 1996 dhe 2002 kërkuesit i dërguan shkresa të ndryshme Komisionit rreth çështjes së kompensimit por nuk morën përgjigje zyrtare. Më 30 mars 2007 Agjencia informoi

kërkuesit se ishte në procesin e përcaktimit të hartave të vlerës së pronës dhe sigurimit të fondeve përkatëse. Rezultati do të hapte rrugën për vendosjen e kriterëve mbi kërkesat për kompensim. Më 6 tetor 2008 drejtori i Agjencisë vendosi *proprio motu* të verifikonte ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Vlorës të vitit 1995. Vendimi i Komisionit i vitit 1995 vazhdoi të mbetet i pazbatuar.

Kërkesa nr. 43628/07: Dani

Kërkuesit kanë lindur më 1937, 1941, 1944, 1950, 1936, 1960, 1962 dhe 1968. Të gjithë jetojnë në Shqipëri. Më 31 tetor 1994 Komisioni i Lezhës kërkuesve ua njohu titullin e trashëguar ndaj një parcele toke me sipërfaqe 3,434 metra katrorë, nga e cila 713 metra katrorë ishin kthyer. Kërkuesit do të kompensoheshin për pjesën e mbetur 2,721 metra katrorë në një prej formave të parashikuara me ligj. Në një datë të papërcaktuar kërkuesit kundërshtuan vendimin e Komisionit para gjykatës, duke pretenduar se atyre duhet t'u kthehej një sipërfaqe më e madhe. Më 10 dhjetor 1996, Gjykata e Rrethit të Lezhës vendosi që kërkuesve t'u kthehej një parcelë shtesë 1,187 metra katrorë. Si rrjedhojë, kërkuesve iu kthye një sipërfaqe e përgjithshme prej 1,900 metrash katrorë. Megjithatë, atyre nuk iu është dhënë kompensim në lidhje me pjesën e mbetur të pronës (1,534 metra katrorë).

Kërkesa nr. 46684/07: Ahmatas dhe të tjerë

Kërkuesit kanë lindur më 1928, 1932, 1948, 1949, 1953 dhe 1957. Të gjithë jetojnë në Shqipëri. Më 19 janar 1996, Komisioni i Korçës njohu titullin e trashëguar të kërkuesve ndaj një parcele toke me sipërfaqe 4,000 metra katrorë. Ai vendosi se meqë parcela e tokës ishte e zënë, kërkuesit do të kompensoheshin në një prej formave të parashikuara me ligj. Megjithatë, për këtë parcelë toke kërkuesve nuk u është dhënë ndonjë kompensim. Më 15 janar 1999, Komisioni i Korçës ua njohu titullin e trashëguar të kërkuesve ndaj një parcele toke bujqësore 59,546 metra katrorë. Ai vendosi se kërkuesit do të kompensoheshin nga shteti në shumën prej 1,018,236 lekë shqiptare ("LEK"). Megjithatë, atyre nuk ju dha ndonjë formë e kompensimit. Qeveria parashitroi se në vitin 2009 kërkuesit aplikuan dhe morën kompensim në shumën prej 2,000,000 LEK në lidhje me 200 metra katrorë nga Fondi i Kompensimit Financiar

(“FKF”). Qeveria nuk paraqiti asnjë dokument mbështetës për këtë parashtresë.

Kërkesa nr. 34770/09: Muka

Kërkuesi ka lindur më 1926 dhe jeton në Shqipëri. Më 7 qershor 1995 Komisioni i Tiranës njohu titullin e ligjshëm të kërkuesit ndaj dy parcelave toke përkatësisht 63 metra katrorë dhe 597 metra katrorë. Më tej ai vendosi se meqë parcelat e tokës ishin të zëna, kërkuesi do të kompensohej në një prej formave të parashikuara me ligj. Komisioni ia njohu kërkuesit të drejtën për refuzimin e parë të dy godinave të ndërtuara në sipërfaqen e tokës. Më 16 gusht 1995, Komisioni i njohu titullin e trashëguar kërkuesit ndaj një parcele tjetër toke 800 metra katrorë, nga e cila 178 metra katrorë ishin kthyer. Ai vendosi se, meqë 622 metra katrorë ishin të zëna, kërkuesi do të kompensohej në një prej formave të parashikuara me ligj. Në një datë të papërcaktuar kërkuesi paraqiti kërkesë për kompensim pranë Agjencisë në lidhje me vendimin e Komisionit të 7 qershorit 1995. Më 23 shkurt 2009, Agjencia rrëzoi pretendimin për kompensimin me arsyetimin se kërkuesi tashmë kishte përfituar nga kthimi i një parcele toke 178 metra katrorë. Brenda periudhës 30-ditore të njohur me ligj nuk u paraqit asnjë ankim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Përmbledhja e pretendimeve

Të gjithë kërkuesit (njëzet) pretenduan se pavarësisht titullit të trashëguar ndaj parcelave të tokës që u ishte njohur nga autoritetet, vendimet administrative përfundimtare, me të cilat u jepet kompensim në një nga mënyrat e parashikuara me ligj në vend të kthimit, nuk ishin zbatuar kurrë. Kërkuesit pretendonin shkelje të neneve 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), shkelje të nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa”) për shkak të moszbatimit të vendimeve administrative të formës së prerë që u jepnin atyre kompensim në vend të kthimit të pronave të tyre.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 13 të Konventës, kërkuesit parashtroan se nuk ishte marrë asnjë masë efektive për të garantuar zbatimin e vendimeve për dhënien e kompensimit. Procedura e

Agjencisë për dhënien e kompensimit financiar ishte tejet e zgjatur dhe e pasigurt. Përzgjedhja e përfituesve u bë me anë të hedhjes së shortit dhe kompensimi nuk mund të kalonte vlerën e një parcele toke 200 metra katrorë. Për më tepër, vlera e pronës nuk reflektonte vlerën e tregut. Llogaritja e tyre nuk ishte transparente dhe nuk parashikonte kamatëvonesën në rast të vonesës në pagesë.

Në lidhje me kompensimin me anë të obligacioneve shtetërore, siç u urdhërua nga Komisioni në kërkesën nr. 46687/07 (*Ahmatas* dhe të tjerë), kërkuesit parashtruan se Qeveria, në fakt nuk kishte lëshuar asnjëherë obligacione shtetërore për qëllim kompensimi. Për më tepër, ndërsa kjo formë kompensimi u parashikua sipas Ligjit për Pronësinë të vitit 1993, ajo nuk u përfshi në Ligjin aktual të Pronësisë të vitit 2004. Përfundimisht, kërkuesit deklaruan se autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë për dhënien e kompensimit në natyrë. Premtimet e autoriteteve për masa të ardhshme, duke përfshirë një projekt strategji mbi të drejtat e pronësisë, duhet të konsiderohen abuzive dhe më tej do të vononin procesin e kthimit dhe kompensimit.

Qeveria parashtroi se që prej vitit 2007 kompensimi financiar po jepej çdo vit në të gjithë vendin. Deri në vitin 2009 dhënia e kompensimit financiar u kufizua në vlerën e një parcele 200 metra katrorë mbi bazën e hartave të vlerës së pronave. Ish-pronarët të cilëve u ishin dhënë forma të tjera kompensimi nuk kishin të drejtë të merrnin kompensim financiar. Qëllimi i kësaj skeme ishte trajtimi në mënyrë të barabartë i ish-pronarëve të cilët nuk kishin marrë asnjëherë kompensim, qoftë me anë të kthimit të pjesshëm të parcelave të tyre të tokës ose me anë të llojeve të tjera të kompensimit. Duke filluar nga viti 2010, skema e kompensimit financiar duhet të bazohej në një shkallë përqindjeje, informacionet e hollësishme për të cilën do të përcaktoheshin nga një grup pune që ishte krijuar për atë qëllim.

Në bazë të përvojës së mëparshme, Qeveria deklaroi se në rast të një kërkesë të suksesshme për kompensim financiar, Agjencia paguante shumë e kompensimit brenda 10 deri 15 ditëve nga shpallja e rezultateve. Në lidhje me pagesën e kamatëvonesës, Qeveria argumentoi se ky interes ishte përfshirë në çmimet e hartave të vlerës së pronave që ishin përditësuar rregullisht. Çmimet reflektonin vlerën

aktuale të tregut dhe ishin disa herë më të larta sesa çmimi i caktuar në kohën e njohjes të të drejtave të pronësisë. Në rast të një kërkesë të pasuksesshme për kompensim financiar, ankuesi (ne këtë rast kërkuesi) duhet të riaplikonte vitin e ardhshëm me anë të paraqitjes së një kërkesë dhe deklarate standarde.

Në lidhje me mundësinë e dhënies së kompensimit në natyrë, Qeveria parashtroi se nuk ishte kryer asnjë kompensim në natyrë. Agjencia po punonte për përcaktimin dhe verifikimin e pronave shtetërore që do të shpërndareshin si kompensim në natyrë. Për më tepër, ish-pronarët do të ftoheshin për t'u bërë aksionarë në ndërmarrjet shtetërore si mjet për marrjen e kompensimit. Të ardhurat e nxjerra nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore do të përdroreshin për dhëniet e kompensimit financiar ish-pronarëve. Qeveria ritheksoi synimin e saj për dhënien e plotë të kompensimit ndaj ish pronarëve.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 6.1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës kërkuesit pretenduan se vendimet administrative të formës së prerë në favor të tyre mbetën të pazbatuara. Megjithëse disa kërkues morën kompensim të pjesshëm financiar, pjesa tjetër e vendimeve të Komisionit vazhdonte të mbetej e pazbatuar. Argumentet e Qeverisë në lidhje me mungesën e fondeve tashmë ishin rrëzuar nga Gjykata në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 7352/03, paragrafi 102, 22 gusht 2006). Kërkuesit argumentuan se, në bazë të vendimeve të formës së prerë të Komisionit, ata kishin një “pretendim” dhe rrjedhimisht, “pronat” brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Moszbatimi i këtyre vendimeve të formës së prerë për një periudhë të gjatë kohe, pa ndonjë justifikim, kishte çuar në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Qeveria argumentoi se pagesa e menjëhershme e të gjitha pretendimeve të kompensimit do të paralizonte mekanizmin e shtetit. Parimi i respektimit të detyrimeve nga shteti, siç referohet në jurisprudencën e Gjykatës, lidhej vetëm me raste sporadike dhe jo të përhapura të moszbatimit. Zbatimi i vendimeve të formës së prerë nuk shtrihej në situata të vazhduara që ishin krijuar para hyrjes në fuqi të Konventës, aq më tepër kur këto probleme ishin trashëguar nga një regjim totalitar që kishte shuar të gjitha të drejtat e pronësisë.

Qeveria e arsyetonte moszbatimimin e vendimeve administrative të formës së prerë me: (a) mungesën e fondeve; (b) ndryshimet e shpeshta të legjislacionit; (b) miratimin fillestar të hartave të vlerësimit të pronës jo më vonë se viti 2005; (c) mungesën e një sistemi të saktë adresash; (d) vështirësitë në identifikimin e trashëgimtarëve të ish-pronarëve që çonin në vonesa; dhe me (e) mungesën e të dhënave në lidhje me fazën e procedurave të rishikimit gjyqësor në lidhje me vendimet e Komisionit. Përfundimisht, Qeveria parashtrroi se ishin duke marrë masa të menjëhershme për të krijuar Fondin e kompensimit në natyrë (FKN) dhe për të përfshirë ish-pronarët në privatizimin e ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore. Duke marrë parasysh barrën e kompensimit me të cilën ishte ngarkuar shteti, ata parashtruan se kishin bërë përpjekjet maksimale për të garantuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë dhe të drejtën e ish-pronarëve për kompensim.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 13 të Konventës, Gjykata rikujtoi se ky nen shpreh drejtpërdrejt detyrimin e shtetit të parashikuar në nenin 1 të Konventës, për të mbrojtur të drejtat e njeriut para së gjithash brenda sistemit të tyre ligjor. Rrjedhimisht, ajo kërkon që shtetet të ofrojnë një mjet juridik të brendshëm për trajtimin e çështjes së një “ankimi të diskutueshëm” sipas Konventës dhe për dhënien e kompensimit të përshtatshëm (shihni *Kudla kundër Polonisë* [DHM], nr. 30210/96, paragrafi 152, GJEDNJ 2000-XI).

Objekti i detyrimeve të shteteve kontraktuese sipas nenit 13 ndryshon në varësi të natyrës së ankimit të ankuesit; “efektiviteti” i një “mjeti ligjor” brenda kuptimit të nenit 13 nuk varet nga siguria e një përfundimi të favorshëm për ankuesin. Njëkohësisht, mjeti ligjor i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë “efektiv” në praktikë si dhe në ligj, në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose vazhdimit të saj, ose të ofrimit të kompensimit të mjaftueshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur. Edhe nëse një mjet i vetëm ligjor nuk përmbush tërësisht në vetvete kërkesat e nenit 13, tërësia e mjeteve ligjore të parashikuara sipas ligjit të brendshëm mund ta realizojë këtë (shih *Wasserman kundër Ruisisë* (nr. 2), nr. 21071/05, paragrafi 45, 10 prill 2008).

Në çështjet në lidhje me moszbatimin e vendimeve të formës së prerë, çdo mjet i brendshëm ligjor për parandalimin e një shkeljeje që garanton zbatimin në kohë është, në parim, i një vlere më të madhe. Megjithatë, kur një vendim i formës së prerë është shpallur në favor të një individi kundër shtetit, në parim individi nuk duhet të detyrohet të iniciojë procedura përmbarimore (shihni, *mutatis mutandis*, *Metaxas kundër Greqisë*, nr. 8415/02, paragrafi 19, 27 maj 2004).

Ne rastin aktual, Gjykata vërejti se ankimet në fjalë lidheshin me moszbatimin e vendimeve të Komisionit që u jepnin kërkuesve kompensim në vend të kthimit të pronave. Gjykata shqyrtoi fillimisht çështjen e efektivitetit të zbatimit të këtyre vendimeve administrative në çështjen *Ramadhi* dhe të tjerë, ku konstatoi shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6.1 të Konventës. Më tej, Gjykata konstatoi si më poshtë:

“50. Gjykata vëren se asnjë prej Ligjeve për Pronësinë ose ndonjë dispozitë e brendshme përkatëse nuk ka rregulluar zbatimin e vendimeve të Komisionit. Në veçanti, Ligjet për Pronësinë nuk parashikonin afat statutor për ankim kundër këtyre vendimeve para gjykatave të brendshme ose për ndonjë mjet ligjor specifik për zbatimin e tyre. Më tej, Gjykata vëren se Ligjet për Pronësinë ia linin përcaktimin e formës dhe mënyrës përkatëse të kompensimit, Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktonte rregullat dhe metodat e hollësishme për këtë kompensim. Deri tani nuk janë marrë masa të tilla (...) dhe Qeveria nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me këtë.

51. Se autoritetet janë të angazhuara, siç pohoi Qeveria, ndaj kthimit të pronave dhe pagesa e kompensimit përkatës nuk çoi në zbatimin e vendimeve në favor të ankuesit, tashmë të pazbatuara për përkatësisht 12 dhe 11 vjet. Për më tepër, Qeveria nuk ka paraqitur prova se masat përkatëse do të ndërmerren brenda një kohe të shkurtër.

52. Faktorët e mësipërm janë të mjaftueshëm për t'i dhënë mundësinë Gjykatës të nxjerrë përfundimin se, duke mos mundur të marrë masat e nevojshme për parashikimin e mjeteve për zbatimin e vendimeve të Komisionit, ankuesit ishin privuar nga e drejta e tyre për mjet ligjor efektiv, duke u dhënë atyre mundësinë të garantonin zbatimin e të drejtës së tyre civile për kompensim (...)”

Gjykata vërejt se që prej miratimit të vendimit në *Ramadhi dhe të tjerët*, Qeveria ka miratuar një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore në lidhje me dhënien e kompensimit financiar, miratimin e hartave të vlerës së pronave, krijimin e IkFC-së dhe miratimin e Planit të Veprimit.

Gjykata vërejt se Komisioni kishte vendosur që kërkuesve në fjalë të kompensohen në një prej formave të parashikuara me ligj. Gjykata shqyrtoi tashmë, duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, nëse ishin marrë masat zbatuese për realizimin e sigurimve në një prej formave të kompensimit të parashikuara me ligj dhe nëse mund të konsiderohej që masat çuan në një mjet efektiv juridik në kuptim të nenit 13 të Konventës.

Kompensimi në natyrë: Gjykata vërejt parashtrimin e Qeverisë se deri tani, kjo formë kompensimi nuk ishte dhënë asnjëherë. Për më tepër, ajo ritheksoi përfundimet e saj në çështjen *Çaush Driza* në kuptimin që kjo formë kompensimi nuk është mjet juridik efektiv.

Kompensimi me anë të aksioneve shtetërore dhe të ardhurave nga procesi i privatizimit: Gjykata vërejt se Qeveria nuk kishte dhënë prova për të treguar se ky lloj kompensimi tashmë ishte dhënë në raste të mëparshme.

Obligacionet shtetërore: Gjykata vërejt se Ligji për Pronësinë i vitit 2004, i ndryshuar, nuk parashikonte kompensimin me anë të obligacioneve shtetërore dhe Qeveria nuk shpjegoi sesi ishte parashikuar zbatimi i vendimeve të Komisionit që u jepnin kërkuesve obligacione shtetërore si kompensim.

Kompensimi financiar: Gjykata vërejt se pjesa më e madhe e parashtrimeve të palëve fokusohet në dhënien e kompensimit financiar nga autoritetet për ish-pronarët gjatë periudhës 2005-2009, në lidhje me të cilën Gjykata bëri vërejtjet e mëposhtme.

Gjykata ritheksoi se në rastin e kërkuesve, vendimet e autoriteteve fillimisht njihnin të drejtën e një tyre për kompensim financiar vetëm nëse Komisioni kishte dhënë kompensim në lidhje me të gjithë pronën. Rrjedhimisht, siç u parashtrua nga Qeveria dhe siç u evidentua nga lista

e kërkuesve që kishin aplikuar për kompensim financiar në periudhën 2005-2008, nëse një kërkues merrte kthim të pjesshëm të pronës ose forma të tjera kompensimi, ai nuk do të kishte të drejtë të merrte kompensim financiar. Ky është qëndrimi i mbajtur në dy kërkesa (nr. 43628/07 (*Dani*) dhe 34770/09 (*Muka*). Kërkuesit në këto çështje nuk do të kishin të drejtë të merrnin kompensim financiar për shkak se u ishte dhënë më parë një parcelë toke.

Së dyti, vendimet e autoriteteve parashikonin një shumë maksimale kompensimi financiar të barabartë me vlerën prej 200 metra katrorë. Është e vërtetë se legjislacioni nuk kufizon shumën përfundimtare të kompensimit që duhet të jetë në vlerën e tregut, se Qeveria ishte angazhuar vazhdimisht për dhënien e kompensimit të plotë dhe se të gjithë kërkuesve në fjalë u ishte dhënë kompensimi në lidhje me parcelat e tokës mbi 200 metra katrorë. Megjithatë, kompensimi financiar është forma e vetme e kompensimit e dhënë aktualisht. Rrjedhimisht, nëse kërkuesit do të kishin aplikuar dhe do të ishin kompensuar në lidhje me 200 metra katrorë, e drejta e tyre për zbatimin e pjesës tjetër të vendimeve të tyre do të kishte qenë e pasigurt. Në fakt, megjithëse kërkuesit në kërkesën nr. 46684/07 (*Ahmata dhe të tjerët*) morën kompensim financiar, deri tani pjesa tjetër e vendimit në favor të tyre, mbeti e pazbatuar. Për më tepër, Gjykata nuk ishte e bindur se dhënia e kompensimit financiar e barabartë me vlerën prej 200 metra katrorë, pavarësisht parcelës së tokës të njohur për qëllime kompensimi, do të garantonte barazi efektive të trajtimit të kërkuesve, siç argumentohet nga Qeveria. Personat, situatat e të cilëve janë mjaft të ndryshme, duhet të trajtohen ndryshe (shih *Thlimmenos kundër Greqisë* [DHM], nr. 34369/97, paragrafi 44, GJEDNJ 2000-IV).

Së treti, përderisa një kërkuesi mund t'i kërkohet të marrë hapa të caktuar proceduralë për të aplikuar për kompensim financiar, Gjykata nuk mund të pranojë që një kërkuesi të pasuksesshëm në një vit të caktuar pararendës, duhet t'i kërkohet të riparaqesë ankim tjetër në vitin(et) pasardhës(e). Barra për të respektuar një vendim të formës së prerë kundër shtetit qëndron kryesisht tek autoritetet shtetërore, të cilat duhet të përdorin të gjitha mjetet e disponueshme në sistemin e brendshëm ligjor, me qëllim të përsheptimit të zbatimit, duke parandaluar kështu shkeljet e Konventës (*Burdov kundër Rusisë* (nr.

2), nr. 33509/04, paragrafi 98, GJEDNJ 2009). I takon shtetit të paditur të organizojë sistemin e tij ligjor në mënyrë të tillë, që të jetë i aftë të menaxhojë infrastrukturën teknike dhe logjistike për të garantuar që skema e kompensimit të jetë në çdo kohë “efektive dhe e shpejtë” (shihni *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], nr. 31443/96, paragrafi 194, GJEDNJ 2004-V).

Së katërti, nuk do të ishte efektive nëse dhënia e kompensimit financiar nuk do të merrte parasysh dëmin jomonetar të shkaktuar si rezultat i moszbatimit tejet të zgjatur (shihni *Scordino kundër Italisë* (nr.1) [DHM], nr. 36813/97, paragrafët 203-4, GJEDNJ 2006-V; *Burdov* (nr. 2). Në çështjen në fjalë, Gjykata nuk është e aftë të kuptojë sesi vendimet e autoriteteve justifikojnë dhe llogarisin dëmin jomonetar.

Si rezultat, Gjykata nxori përfundimin se kjo formë kompensimi nuk ishte efektive.

Bazuar në vlerësimet e mësipërme, Gjykata nxori përfundimin se nuk ka pasur mjet të brendshëm juridik efektiv që të mundësonte kompensim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për shkak të moszbatimit të zgjatur të vendimeve të Komisionit që jepnin kompensim. Rrjedhimisht, kishte shkelje të nenit 13 të Konventës. Për pasojë, Gjykata hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë se kërkuesit kishin dështuar të shteronin mjetet e brendshme juridike efektive.

Në lidhje me nenin 6.1 dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, Gjykata theksoi se tashmë kishte konstatuar shkelje të ngjashme të nenit 6.1 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në çështje të tjera në lidhje me vonesat në zbatimin e vendimeve administrative dhe të formës së prerë për pronat në lidhje me shtetin e paditur (shih, midis autoriteteve të tjera, *Ramadhi dhe të tjerë; Hamzaraj* (nr.1), paragrafët 24-27 dhe 38-43; dhe *Nuri kundër Shqipërisë*, nr. 12306/04, paragrafët 26-29 dhe 35-40, 3 shkurt 2009). Pas shqyrtimit nëse Qeveria ka bërë parashtrime përkatëse dhe të reja në lidhje me kërkesat në fjalë, Gjykata konstatoi se në rrethanat e kësaj çështjeje, vendimet e zbatueshme dhe të formës së prerë të Komisionit në favor të kërkuesve mbetën të pazbatuara për periudha nga 15 deri 17 vjet. Pas shqyrtimit të materialeve të paraqitura pranë saj, Gjykata nuk pa arsye të shmangej

nga përfundimet e saj në çështjet e mëparshme (*Ramadhi dhe të tjerë; Hamzaraj* (nr.1), paragrafët 24-27 dhe 38-43; dhe *Nuri kundër Shqipërisë*, nr. 12306/04, paragrafët 26-29 dhe 35-40, 3 shkurt 2009). Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 6.1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në secilin ankim.

Në lidhje me aplikimin e nenit 46 të Konventës,¹¹⁹ Gjykata, duke konsideruar se ankesat pasqyronin një problem të përhapur në Shqipëri që prek një numër të madh njerëzish, Gjykata vendosi që të zbatojë procedurën e gjykimit pilot në këtë rast. Sipas tij, Shqipëria duhej të merrte masat e përgjithshme me qëllim që, në mënyrë efektive të sigurojë të drejtën e kompensimit brenda 18 muajsh nga data, në të cilën aktgjykimi u bë i formës së prerë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi që të bashkojë kërkesat, konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës dhe për pasojë, rrëzoi kundërshtimin e Qeverisë në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme ligjore. Gjykata gjeti se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës; se shteti i paditur duhet të marrë, brenda tetëmbëdhjetë muajsh nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, masa për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të garantuara nga neni 6.1 i Konventës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1, në kontekstin e të gjitha çështjeve të ngjashme me çështjen në fjalë, në përputhje me parimet e Konventës, të vendosura në praktikën e Gjykatës; vendosi që do të shqyrtonte, nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, çështjet e depozituara përpara dhënies së vendimit në fjalë, pa cenuar në asnjë moment kompetencën e Gjykatës për të shpallur të papranueshëm ndonjë çështje të tillë ose për ta hequr nga lista pas një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve ose zgjidhjes së çështjes me mjete të tjera, në përputhje me nenet 37 ose 39 të Konventës. Gjykata vendosi që shteti i paditur duhet t'u

119 Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.

paguajë parashtruesve solidarisht, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, shumat e caktuara (shih vendimin e plotë të Gjykatës në rastin në fjalë në lidhje me shumat e akorduara për secilën kërkesë).

2.2. RAMADHI DHE TË TJERË kundër SHQIPËRISË

[38222/02]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

13 nëntor 2007

Çështja kyçele drejta e pretenduar: shkelje e së drejtës për proces të rregullt gjyqësor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Qarkut për kompensim të pronës; privim nga e drejta për zgjidhje efektive si pasojë e mungesës së mjeteve adekuate juridike për ekzekutimin e vendimit të Komisionit për kompensim të pronës; ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pronës si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës Supreme për kompensim të pronë; diskriminim nga gjykatat vendore bazuar në vendbanim.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga gjashtë shtetas shqiptarë, Shyqyri Ramadhi, Remzi Kapidani, Rabije Ramadhi, Xhemile Ramadhi, Dilaver Ramadhi dhe Nakib Ramadhi (kërkuesit), më 9 tetor 2002. Më 1 korrik 2005, pas vdekjes së Xhemile Ramadhi, vajza e saj, Shpresa Idrizi e zëvendësoi në procedurat para Gjykatës. Kërkuesit ishin trashëgimtarë të disa parcelave tokë dhe të dy dyqaneve, përkatësisht 46000 m² (tokë) dhe 150 m² (dyqane) që ndodheshin në rrethin e Kavajës, të cilat ishin konfiskuar gjatë regjimit komunist në Shqipëri, pa asnjë kompensim. Në vitin 1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Komisioni i Pronave) ua njohu kërkuesve titullin e trashëgimtarëve vetëm për një pjesë të tokave (15.500 m²) dhe për dy dyqane (150 m²). Sipas Ligjit të Pronësisë, Komisioni vendosi që një pjesë e pronave t'iu rikthehet kërkuesve në posedim dhe të kompensohen për dy dyqanet dhe një pjesë të tokës (5.500m²) për shkak të pamundësisë së rikthimit të pronës në tërësi. Kërkuesit rikthyen nën posedimin e tyre 10.000 m² tokë, por autoritetet dështuan të respektojnë

vendimin e Komisionit për kompensimin e dyqaneve dhe parcelës tjetër. Sa i përket 30.500 m² tokë më 1998, bazuar në Ligjin e Pronësisë, kërkuesit filluan procedurat pranë Komisionit të Tokës duke pretenduar pronësinë e parcelës së tokës me sipërfaqe prej 30 500 m². Më 11 nëntor 1998, Komisioni i Tokës ua njohu të drejtën e pronësisë vetëm tre kërkuesve të parë dhe hodhi poshtë pretendimet e tre kërkuesve të fundit me arsyetimin se tre kërkuesit e fundit nuk mund të pretendonin pronësinë e tokës bujqësore, përderisa ata nuk ishin banorë (rezidentë) të zonës ku ndodhej toka. Tre kërkuesit e parë regjistruan pronën e tyre në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Më 7 prill 1999, Komisioni i Tokës, në bazë të një kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, deklaroi pavlefshmërinë e titujve të pronësisë së tre kërkuesve me arsyetimin se vendimi i datës 11 nëntor 1998 binte në kundërshtim me ligjin material. Kërkuesit iniciuan procedurat gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë në Durrës, duke pretenduar të drejtat e pronësisë mbi pronën përkatëse. Më 4 shkurt 2000, Gjykata e Shkallës së Parë në Durrës prishi vendimin e 7 prillit 1999 të Komisionit të Tokës dhe vendosi rishqyrtimin (*de novo*) nga ky Komision, të pretendimeve të tre kërkuesve të fundit pasi që ishin refuzuar lidhur me njohjen e pronësisë së tokës, vendim ky i cili mori formën e prerë. Pas dhënies së urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata e Shkallës së Parë në Kavajë, Zyra e Përmbarimit urdhëroi Bashkinë e Kavajës të zbatonte vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, të 4 shkurtit 2000. Por Bashkia e Kavajës vendosi për mungesë juridiksioni lidhur me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, me arsyetimin se Komisioni i Tokës i Kavajës, nën juridiksionin e të cilit ishte kjo çështje, ishte shpërbërë në përputhje me udhëzimin e kryetarit të Bashkisë. Më 8 janar 2003 për qëllim të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, u krijua sërish Komisioni i Tokës i Kavajës, i cili konstatoi vlefshmërinë e titujve të pronësisë së tre kërkuesve të parë. Kërkuesit pretenduan se problemi i pronësisë mbetej ende i pazgjidhur, përderisa autoritetet vendore ua kanë transferuar parcelat e lartpërmendura personave të tretë, kështu që vendimi i Komisionit *de facto* ishte joefektiv. Në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, disa nga parcelat e tokës rezultojnë në pronësi të personave të tretë, ndërsa në një nga parcelat, sipas kërkuesve, persona të tretë kanë kryer ndërtime. Lidhur me këtë, Qeveria pretendoi se kërkuesit nuk realizuan regjistrimin e pronës së tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të marrë pronësinë e tokës në fjalë.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u bazuar në nenin 6.1 të Konventës dhe duke iu referuar nenit 13 të Konventës, kërkuesit pretenduan se u ishte shkelur e drejta pronësore për shkak së mungesës së mjeteve efektive që mundësojnë ekzekutimin e vendimeve të Komisioneve që u jepnin atyre të drejtën e kompensimit për një periudhë kohe të tejzgjatur. Qeveria e kundërshtoi këtë argument duke parashtruar se garancitë e parashikuara në nenin 6 nuk ishin të zbatueshme për ekzekutimin e vendimeve, të cilat sipas legjislacionit të brendshëm nuk ishin përfundimtare dhe të detyrueshme, siç ishte rasti i vendimeve të Komisionit të Pronave. Si rrjedhojë, ankesa duhet konsideruar e papranueshme dhe e papajtueshme *ratione materiae*. Qeveria parashtrroi se kërkuesit nuk kanë shterur mjetet e brendshme juridike, të parashikuara nga Ligji i Pronësisë. Kërkuesit kundërshtuan pikëpamjet e Qeverisë, duke parashtruar se legjislacioni i brendshëm parashikonte se vendimet e Komisionit, ashtu sikurse vendimet e Gjykatës së Rrethit gjeneronin tituj pronësie të detyrueshëm.

Më tej, kërkuesit pretenduan shkelje të nenit 6.1 si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Kavajës, të 4 shkurtit 2000, mbi të drejtat e tyre të pronësisë. Qeveria kundërshtoi argumentet e kërkuesve, duke parashtruar se ky vendim është ekzekutuar më 8 janar 2003, kur Komisioni i Tokës nxori një vendim lidhur me titullin e tyre përkatës të pronësisë. Qeveria parashtrroi se kërkuesve u mungonte statusi i viktimës, meqenëse ata nuk kishin ndërmarrë masat e nevojshme administrative për të regjistruar të dhënat e titujve të tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Sipas, Qeverisë, kërkuesit gjithashtu nuk kanë qenë në gjendje të provojnë që pronat e akorduara ndaj tyre, u janë shitur personave të tretë dhe, nëse është kështu, ata nuk e kanë paraqitur këtë çështje pranë gjykatave të brendshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata ritheksoi se neni 6.1, në aspektin civil të tij, aplikohet vetëm kur ekziston një mosmarrëveshje mbi një “të drejtë”, që konsiderohet, të paktën mbi baza të vërtetueshme, si e njohur në të drejtën e brendshme. Gjykata vërejti që në rastin konkret, nuk është kundërshtuar ekzistenca

e një mosmarrëveshjeje mbi një të drejtë të njohur nga legjislacioni vendor apo që mosmarrëveshja ishte e vërtetë dhe serioze, ose që rezultati i procedurave ishte drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë. Gjykata më tej, vërejti se mosmarrëveshja lidhur me këtë të drejtë, e cila për nga natyra është një e drejtë civile, është një mosmarrëveshjeje ndërmjet shtetit dhe kërkuesve për të përcaktuar të drejtën e pronësisë. Nëpërmjet vendimeve të Komisionit kompetent për çështjen në fjalë, shteti ua njohu të drejtën e kompensimit kërkuesve. Për më shumë se 12 vite, këto vendime nuk u kundërshtuan para ndonjë gjykate dhe ligjërishit asgjë nuk e pengonte ekzekutimin e tyre. Gjykata përsëriti se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike detyron kërkuesit të përdorin mjetet e brendshme që janë zakonisht në dispozicion. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë e sigurt, si në praktikë edhe në teori. Gjykata vërejti se Qeveria nuk ishte në gjendje të provonte efektivitetin e mjeteve të parashikuara nga Ligji i Pronësisë i vitit 2004 edhe në rastet tjera të trajtuara më parë. Gjykata ritheksoi se neni 6.1 mishëron ‘të drejtën për gjykim’, në të cilin qasja në gjykatë përbën vetëm një aspekt. Në rastin konkret, edhe pse kërkuesit nuk u penguan për të filluar procedurat për njohjen e të drejtave të tyre të pronësisë sipas Ligjit të Pronësisë, kjo nuk është e mjaftueshme, meqenëse e drejta për qasje në gjykatë përfshin, jo vetëm të drejtën për të filluar një proces, por dhe të drejtën për të siguruar një zgjidhje të mosmarrëveshjes nga një gjykatë. Megjithatë, thelbi i pretendimeve të kërkuesve në kuadër të nenit 6 ka të bëjë me mungesën e mjeteve për të adresuar mosekzekutimin e vendimeve të komisionit që u njihnin të drejtën e kompensimit, bazuar në Ligjin e Pronësisë, aspekt për të cilin Gjykata është e mendimit se është më e përshtatshme të shqyrtohet në kuadër të nenit 13. Gjykata vërejti se, pavarësisht nëse vendimi përfundimtar për t’u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjyqësor ose vendimi të një autoriteti administrativ, legjislacioni i brendshëm dhe Konventa parashikojnë që ai duhet të ekzekutohet. Në rastin konkret, Gjykata pohoi se asnjë masë nuk ishte ndërmarrë për të ekzekutuar vendimet e Komisionit në favor të kërkuesve. Gjykata vërejti se asnjë nga dispozitat e Ligjit të Pronësisë apo ndonjë dispozitë tjetër në legjislacionin e brendshëm përkatës, nuk rregullon ekzekutimin e vendimeve të Komisionit. Ligji i Pronësisë nuk parashikon as ndonjë afat ligjor për ankimimin e vendimeve të Komisionit pranë gjykatave të brendshme, as ndonjë mjet specifik për ekzekutimin e tyre. Masat

e tilla mungojnë dhe Qeveria nuk dha asnjë shpjegim për këtë. Fakti që, autoritetet janë të angazhuara, siç pohon Qeveria, për rikthimin e pronave dhe pagesën e kompensimit të përshtatshëm, nuk ka çuar në ekzekutimin e vendimeve në favor të kërkuësve, të pa-ekzekutuara prej 12 dhe 11 vitesh. Për më tepër, Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë provë për marrjen e ndonjë mase të menjëhershme. Bazuar në këto vlerësime, Gjykata konstatoi se kërkuësit u privuan nga e drejta e tyre për një mjet të brendshëm efektiv, i cili do t'u mundësonte sigurimin e zbatimit të së drejtës së tyre civile për kompensim.

Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 6.1 si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Kavajës, të 4 shkurtit 2000, mbi të drejtat e tyre të pronësisë, Gjykata vërejti se meqenëse vetëm tre kërkuësit e parë kishin qenë palë në këtë proces, Gjykata vlerësoi se tre kërkuësit e fundit nuk kanë provuar që ata mund të pretendojnë të jenë "viktima" për shkak mosekzekutimit të vendimit të lartpërmendur. Nga kjo rrjedh, që pretendimi i tre kërkuësve të fundit është i papajtueshëm *ratione personae* me përmbajtjen e Konventës në kuptim të nenit 35.3, dhe për këtë arsye e deklaroi të papranueshëm, ndërsa pretendimi i tre kërkuësve të parë nuk është i pabazuar në kuptim të nenit 35.3 të Konventës dhe se duhet të deklarohet i pranueshëm. Tre kërkuësit e parë parashtruan se për më tepër se 7 vjet, vendimi i 4 shkurtit 2000 i Gjykatës së Rrethit nuk ishte ekzekutuar. Qeveria argumentoi se autoritetet nuk mund të ishin përgjegjëse për mosekzekutimin e vendimit të sipërpërmendur duke qenë se ekzekutimi i tij varej nga marrja e masave të nevojshme nga kërkuësit, konkretisht duke kërkuar regjistrimin e të dhënave të titujve të tyre të pronësisë në regjistrin e tokës. Në lidhje me këtë, Gjykata ritheksoi se parimet e përgjithshme lidhur me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë janë përcaktuar në vendimin *Beshiri dhe të tjerët* dhe ato parime duhet të zbatohen edhe në rastet tjera. Gjykata vërejti se pas 2 vitesh mosveprimi pas vendimit të Gjykatës së Qarkut, Komisioni i Tokës la në fuqi titujt e pronësisë për tre parcelat e tokës dhe, që nga ajo kohë toka u vu në zotërim të personave të tretë. Qeveria nuk dha komente lidhur me këtë dhe nuk paraqiti asnjë informacion për të provuar të kundërtën. Duke konstatuar se shteti nuk kishte arritur të provojë efektivitetin e mjeteve juridike përkatëse dhe duke vërejtur se të drejtat e tre kërkuësve të parë dukej se ishin shumë larg nga realizimi i tyre, Gjykata konstatoi se autoritetet shtetërore nuk

kishin qenë në gjendje të ekzekutojnë vendimin e 4 shkurtit 2000 të Gjykatës së Rrethit. Për këto arsye, Gjykata konstatoi se ka shkelje të nenit 6.1 të Konventës, për sa i përket tre kërkuesve të parë.

Në lidhje me pretendimet e kërkuesve për shkeljen e së drejtës pronësore të garantuar nga neni 1 i Protokollit nr. 1, meqenëse Gjykata i ka deklaruar të papranueshme pretendimet e tre kërkuesve të fundit, për sa i përket mosekzekutimit të vendimit të 4 shkurtit 2000, këta kërkues nuk kanë pasur një “pritje të legjitime” të bazuar në dispozitat e Ligjit të Tokës e as në vendimet e dhëna për sa i përket pretendimit të tyre për kthimin e parcelës së tokës. Rrjedhimisht, pretendimet e tre kërkuesve janë të papajtueshme *ratione materiae* me përcaktimet e Konventës dhe duhet të hidhen poshtë. Ndërsa pretendimet e tre kërkuesve të parë në kuadër të nenit 1 të Protokollit nr. 1, për sa i përket mosekzekutimit të vendimit të 4 shkurtit 2000 dhe të gjitha pretendimet e kërkuesve për sa i përket mosekzekutimit të vendimeve të Komisionit të 1995 dhe 1996, janë të pranueshme në kuptimin e nenit 35.3 të Konventës.

Gjykata vërejti se, meqenëse pronat përkatëse të kërkuesve ishin shtetëzuar, ata kanë një pretendim për kompensim në natyrë ose vlerë monetare dhe me vendimet e 7 qershorit 1995 dhe 20 shtatorit 1996, atyre iu njoh e drejta e kompensimit financiar, ndërsa me vendimin e 4 shkurtit 2000, tre kërkuesve të parë iu njoh e drejta e kthimit të pronës së origjinës. Në këto rrethana, Gjykata vlerësoi se pretendimet e kërkuesve janë mjaftueshëm të bazuara për t’u cilësuar si “aset” për qëllimet e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Qeveria kundërshtoi aplikimin e garancive të këtij neni për vendimet në fjalë, meqenëse kërkuesit nuk kishin ngritur këtë problem para autoriteteve vendore. Më tej, Qeveria iu referua mungesës së fondeve dhe interesit të përgjithshëm për të arsyetuar mosekzekutimin e vendimeve të Komisionit dhe se kërkuesit ishin bartës të përgjegjësisë për shkak të mosmarrjes së veprimeve për regjistrim të pronës dhe marrjes në zotërim të saj, gjë që do t’u mundësonte atyre pretendim për ndërhyrje në të drejtat pronësore të garantuara nga neni 1 i Protokollit nr. 1.

Gjykata, duke pasur parasysh praktikën e vet gjyqësore, ku kishte shqyrtuar mosekzekutimin e një vendimi që njehej një titull pronësie, në kuadër të fjalisë së parë të nenit 1 të Protokollit nr. 12 dhe duke

konsideruar se rrethanat e rastit në fjalë janë të ngjashme me rrethanat më parë, konsideroi se duhet ta trajtojë rastin po në këtë aspekt, përkatësisht të analizojë nëse është vendosur një baraspeshë e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kriterëve të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Gjykata rikujtoi se shteti ka një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se cili është interesi i përgjithshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për kompensim për shkak të shtetëzimit ose shpronësimit, megjithatë, kjo hapësirë vlerësimi nuk është e pakufizuar. Në çështjen në fjalë, kanë kaluar 12 dhe 11 vjet, respektivisht, nga nxjerrja e vendimeve të Komisionit të 1995 dhe 1996, pa iu mundësuar kërkuessve pagimin e kompensimit. Gjykata vlerësoi se mosekzekutimi i vendimeve të Komisionit të 1995 dhe 1996 dhe të Gjykatës së Rrethit të 4 shkurtit 2000, kanë krijuar për kërkuessit një gjendje pasigurie lidhur me realizimin e të drejtave të tyre pronësore. Për më tepër, për një periudhë kohe të konsiderueshme, autoritetet i penguan ata nga gëzimi i përfitimit të të mirave materiale dhe përdorimi i tokës. Më tej, Gjykata nuk e vlerësoi si shumë bindës argumentin e Qeverisë se procedurat ishin komplekse dhe se nuk kishte procedura të caktuara të brendshme për llogaritjen e kompensimit, duke mbajtur në konsideratë faktin se ishte pikërisht mosveprimi i autoriteteve që shkaktoi “ndërhyrje” lidhur me çështjen në fjalë. Si përfundim, Gjykata konsideroi se Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë provë bindëse për të justifikuar mospërcaktimin, për një kohë kaq të gjatë, të shumës përfundimtare të kompensimit dhe moskthimin e parcelës së tokës tre parashtruesve të parë, parcelë kjo që tashmë ishte në zotërim të palëve të treta. Kjo rezulton në një ndërhyrje në të drejtën e pronësisë së parashtruesve, që në këndvështrimin e Gjykatës ka vendosur një barrë të pajustificueshme mbi ta.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat, Gjykata konstatoi se ka shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, lidhur me çështjen e kompensimit për të gjithë kërkuessit dhe, për sa i përket tre kërkuessve të parë, edhe lidhur me çështjen e rikthimit të pronës. Duke u bazuar në nenin 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit nr. 1, tre kërkuessit e fundit pretenduan se gjykatat vendore i kanë diskriminuar ata mbi bazën e banimit të tyre dhe si pasojë, kanë shkelur të drejtat e tyre të pronësisë. Gjykata vlerësoi se si rezultat i mosparaqitjes së çështjes së diskriminimit pranë gjykatave vendore, kërkuessit nuk kanë

përdorur mjetet e brendshme të ankimit për qëllimet e nenit 35.1. Si rrjedhojë, kjo kërkesë u hodh poshtë në përputhje me nenin 35.1 dhe 4 të Konventës. Në bazë të këtyre përfundimeve, Gjykata vërejtë se cenimi i të drejtave të kërkuësve të garantuara nga neni 6.1 i Konventës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 vjen nga një problem i përhapur që ndikon mbi një numër të madh njerëzish, konkretisht nga pengesa e pajustificueshme ndaj së drejtës së tyre për gëzim paqësor të pronës, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të Komisionit, i cili caktonte kompensim në përputhje me Ligjin e Pronësisë. Rritja e numrit të kërkesave të njëjta është një faktor rëndues për sa i përket përgjegjësisë së autoriteteve shqiptare në bazë të Konventës dhe është një kërcënim për efikasitetin në të ardhmen të sistemit të vendosur nga Konventa, kështu që sipas këndvështrimit të Gjykatës, vakumi ligjor i konstatuar në çështjen konkrete të kërkuësve, mund t'i japë jetë një numri të shumtë kërkesash të tjera të bazuara. Gjykata rithekson se, sipas nenit 46, shtetet kontraktuese duhet t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet, në të cilat ato janë palë, mbikëqyrja e ekzekutimit të të cilave është në kompetencë të Komitetit të Ministrave. Një ndër efektet e këtij neni është që, aty ku Gjykata konstaton shkelje, shteti i paditur ka detyrimin ligjor, jo vetëm për t'i paguar personave përkatës shumat e përcaktuara për një dëmshpërblim të drejtë, në bazë të nenit 41, por duhet të për zgjedhë dhe masat e përgjithshme dhe/ose kur është e përshtatshme masat e veçanta që duhet të adoptohen nga legjislati brendshëm, për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe të mënjanojë, sa të jetë e mundur, efektet. Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të ndër marrin-me fuqi prapavepruesemasat e nevojshme për rivendosjen e së drejtës së shkelur, në përputhje me parimin e subsidiaritetit të Konventës, ashtu që Gjykata të mos gjeje përsëri shkelje në një seri të gjatë rastesh të ngjashme. Gjykata vlerësoi se shteti i paditur duhet para së gjithash të parashikojë një mjet juridik që të sigurojë një korigjim të vërtetë dhe efektiv për shkeljet e identifikuar të Konventës në gjykimin në fjalë, si dhe lidhur me të gjitha ankimet e ngjashme në pritje, në përputhje me parimet për mbrojtjen e të drejtave të parashikuara në nenin 6.1 dhe 13 të Konventës dhe në nenin 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata veçse ka caktuar disa masa që Shqipëria, duhet të ndërmarrë për tejkalimin e këtyre problemeve. Duke parashikuar mjetin e duhur, shteti duhet, *inter alia* të caktojë organin kompetent, të përcaktojë rregullat procedurale, të sigurojë

zbatimin e këtyre rregullave në praktikë dhe të evitojë të gjitha pengesat për dhënien e kompensimit sipas Ligjit të Pronësisë. Këto objektiva mund të arrihen duke marrë masat e duhura ligjore, administrative dhe buxhetore. Sipas Gjykatës këto masa duhet të përfshijnë hartimin e hartave për vlerësimin e pronës, si dhe përcaktimin e një fondi të përshtatshëm, për të gjithë ata/ato, të cilëve u është dhënë e drejta të marrin kompensim në vlerë, e gjithë kjo për t'u mundësuar të gjithë kërkuesve të kenë një vendim gjyqësor të suksesshëm në favor të tyre, i cili i kompenson ata sipas Ligjit të Pronësisë, për të marrë sa më shpejt shumën ose tokën e caktuar. Këto masa duhet të trajtohen si çështje urgjente. Duke u bazuar në nenin 41 të Konventës, Gjykata vendosi që shteti u detyrohej kërkuesve për dëmshpërblimin material për humbjen e gëzimit të pronës dhe duhet t'u paguajë atyre dëmet materiale dhe jomateriale. Gjykata u caktoi bashkërisht, të gjithë kërkuesve, një shumë totale prej 64,000 (gjashtëdhjetë e katër mijë) eurosh, dëme materiale dhe jomateriale, lidhur me parcelën e tokës me sipërfaqe 5 500 m² dhe 150 m². Më tej, ajo u caktoi tre kërkuesve të parë një shumë totale prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) eurosh, së bashku me kthimin e parcelës së tokës me sipërfaqe 30 500 m². Në rast të moskthimit të parcelës së tokës nga shteti, brenda tre muajsh nga data kur ky vendim bëhet i plotfuqishëm, Gjykata vendosi se shteti duhet t'u paguajë së bashku tre kërkuesve të parë, një shumë prej 120,000 (njëqind e njëzet mijë) eurosh dëme materiale dhe jomateriale, lidhur me këtë pronë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se ka shkelje të nenit 6.1, të nenit 13 në ndërlidhje me nenin 6.1 si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, ndërsa hodhi poshtë pretendimet për shkelje të nenit 14 të Konventës, në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1.

2.3. HIRST kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR (Nr. 2)

[74025/01]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

6 tetor 2005

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: nëse mohimi i së drejtës për të votuar ndaj një të burgosuri, cenoi të drejtat e garantuara me Konventë; pretendime për heqjen e së drejtës së votës; pretendime për diskriminim për shkak të pamundësisë së votës për shkak mbajtjes së dënimit me burg; heqja e së drejtës e pengonte atë të ushtronte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes përmes votimit.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga John Hirst, një shtetas britanik (kërkuesi), kundër Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, më 5 korrik 2001. Kërkuesi ka vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm në një burg të Mbretërisë së Bashkuar deri në vitin 2004, kur dhe u lirua me kusht. Ai ishte dënuar me burg për shkak se në vitin 1980 ai u dënua për vrasje pas pranimit të fajësisë për shkak të përgjegjësisë së zvogëluar (si pasojë e aftësive të kufizuara mendore). Një raport mjekësor i cilësonte veprimet e tij si veprime anormale. Ai u dënua me burgim të përjetshëm me të drejtë rishikimi. Më 25 qershor të vitit 1994 u mblodh Bordi për Shqyrtimin e Akordimit të Lirimit me Kusht me qëllim vlerësimin e situatës së kërkuesit. Ky bord nuk e aprovoi lirimin e tij me kusht me argumentin se ai vazhdonte të përbënte rrezik të lartë për shoqërinë dhe për këtë arsye, kërkuesi vazhdoi mbajtjen e dënimit të tij në burg.

Ligji zgjedhor britanik i vitit 1983 ndalonte votimin për kërkuesin apo edhe persona të tjerë, të cilët vuanin dënim të ngjashëm me të. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë me pretendimin se duke i mohuar të drejtën e tij për të votuar ishte shkelur Konventa. Kërkesa e tij u refuzua nga gjykata, po ashtu edhe apelimi ndaj vendimit të gjykatës. I gjendur në këtë situatë, kërkuesi iu drejtua GJEDNJ, duke pretenduar se përjashtimi i tij nga mundësia dhe drejta për të votuar në Mbretërinë e Bashkuar përbënte shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Ai i mbështeti pretendimet e tij gjithashtu edhe në nenet 10 dhe 14 të Konventës.

Përmbledhja e pretendimeve

Fillimisht kërkuesi u ankua se i ishte hequr e drejta e tij e votës, e garantuar në nenin 3 të Protokollit nr. 1. Në vendimin e saj, Dhoma konstatoi se përjashtimi nga votimi i vendosur ndaj të burgosurve të dënuar në paraburgim ishte joproporcional. Ajo kishte parasysh faktin se vota i ishte hequr një grupi të madh njerëzish; se ai zbatohej automatikisht, pavarësisht nga gjatësia e dënimit ose nga rëndësia e veprës penale; dhe se rezultatet ishin arbitrare dhe anormale, në varësi të kohës së zgjedhjeve. Dhoma vuri në dukje më tej se, për aq sa përjashtimi nga votimi do të shihej si pjesë e dënimit të të burgosurit, nuk kishte asnjë justifikim logjik që skualifikimi të vazhdonte në rastin e kërkuesit aktual, i cili kishte përfunduar atë pjesë të dënimit të tij që ka të bëjë me dënimin dhe parandalimin.

Kërkuesi përmendi kushtet e vendimit të Dhomës, duke parashtruar se pretendimi i Qeverisë se do të kërkonte rishikimin rrënjësor të ligjeve të shumë shteteve kontraktuese ishte keqkuptuar pasi vendimi bazohej në situatën specifike në Mbretërinë e Bashkuar dhe i drejtohej heqjes së plotë të së drejtës së votës për personat e dënuar, që kishte rezultuar jo nga një vendim i arsyetuar dhe i justifikuar siç duhet pas një debati të plotë, por nga respektimi i traditës historike. Ai hodhi poshtë gjithashtu argumentin se Dhoma nuk i kishte dhënë peshën e duhur hapësirës së vlerësimit, duke pretenduar se në faktet e këtij rasti ky koncept kishte pak ndikim. Kërkuesi theksoi se ekzistonte një prezumim në favor të së drejtës së votës, e cila ishte në harmoni me natyrën themelore të demokracisë. Nuk ishte një privilegj, siç u pohua ndonjëherë, edhe për të burgosurit, të cilët vazhduan të gëzojnë të drejtat e tyre të paprekshme, nga të cilat mund të derogoheshin vetëm në rrethana shumë të jashtëzakonshme.

Arsyeja e mbështetur në Parlament ishte se heqja e së drejtës së një të burgosuri të dënuar, konsiderohej pjesë e dënimit të tij. Duke e kundërshtuar këtë, kërkuesi konsideroi se dënimi mund të hiqte në mënyrë legjitime të drejtat themelore përveç të drejtës për liri dhe

argumentoi se kjo nuk ishte në përputhje me qëllimin e deklaruar rehabilitues të burgut. Ai më tej iu referua trendit në Kanada, Afrikën e Jugut dhe shtete të ndryshme evropiane për të fituar të drejtën e të burgosurve për të votuar, duke pretenduar se nëntëmbëdhjetë vende nuk kishin asnjë ndalim, ndërsa tetë kishin vetëm një ndalim të pjesshëm ose specifik. Ai arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë arsye bindëse, përtej dënimit, për t'ua hequr të drejtën e votës të burgosurve të dënuar dhe se ky sanksion shtesë nuk ishte në përputhje me idenë se dënimi me burgim ishte privimi i lirisë dhe se i burgosuri në këtë mënyrë nuk humbi asnjë të drejtë themelore të tij, përveç nëse kjo kërkohet, për shembull, nga konsideratat e sigurisë. Sipas mendimit të tij, ndalimi kishte të bënte thjesht me gjykimin moral dhe ishte e papranueshme, si e barabartë me të zgjedhurit që përzgjedhin elektoratin, që e drejta e votës t'i nënshtrohet gjykimeve morale të imponuara nga personat që ishin zgjedhur.

Në anën tjetër, Qeveria parashtrroi se sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1, e drejta e votës nuk ishte absolute dhe se një hapësirë e gjerë vlerësimi do t'u lejohej shteteve kontraktuese në përcaktimin e kushteve, në të cilat ushtrohet e drejta e votës.

Sa i përket precedentit kanadez, ata vunë në dukje se rasti *Sauvé* (nr.2) u vendos me një shumicë të ngushtë prej pesë votash kundër katër, i cili kishte të bënte me një ligj që ishte i ndryshëm në tekst dhe strukturë dhe u interpretua nga gjykatat vendase, në të cilin doktrina e hapësirës së vlerësimit (margin of appreciation) nuk zbatohet dhe se kishte një kundërshtim të fortë i cili ishte më shumë në përputhje me praktikën gjyqësore të organeve të Konventës. Rasti i Afrikës së Jugut (*August and Another*) nuk ishte i rëndësishëm pasi kishte të bënte me pengesat praktike për të votuar, dhe jo një ndalim ligjor.

Qeveria argumentoi se moslejimi i votës në këtë rast ndoqi qëllimet e ndërthurura legjitime të parandalimit të krimit dhe ndëshkimit të shkelësve dhe rritjen e përgjegjësisë qytetare dhe respektimin e sundimit të ligjit, duke i privuar nga e drejta për t'u shprehur ata që kishin shkelur rregullat themelore të shoqërisë. Të burgosurit e dënuar kishin shkelur kontratën shoqërore dhe kështu mund të konsideroheshin se (humbnin përkohësisht) të drejtën për të marrë pjesë në qeverisjen e

vendit. Rekomandimi i Këshillit të Evropës në lidhje me menaxhimin e të burgosurve të përjetshëm të mbështetur nga Qendra AIRE në ndërhyrjen e saj, nuk ishte detyrues dhe nuk i referohej votimit dhe, në çdo rast, legjislacioni nuk ishte i papajtueshëm me parimet e tij.

Sa i përket efekteve të supozuara arbitrare, Qeveria argumentoi se, nëse gjykata nuk do të vendosë që nuk kishte fare hapësirë vlerësimi në këtë kontekst, duhet pranuar që diku duhet të përcaktohet një kufi. Së fundi, ndikimi në rastin e kërkuarit nuk ishte joproporcional pasi ai ishte burgosur përjetë dhe në asnjë rast nuk do të kishte përfituar nga një ndalim më i përshtatshëm, siç ishte ai në Austri, që do të prekte ata që ishin dënuar me një afat mbi një vit. Ata përfunduan me shqetësimin e tyre se Gjykata e Lartë kishte dështuar të jepte ndonjë shpjegim se çfarë hapash do të duhej të ndërmerre Mbretëria e Bashkuar për ta bërë regjimin e saj të pajtueshëm me nenin 3 të Protokollit nr. 1 dhe nxitën që, në interes të sigurisë juridike, shtetet kontraktuese të marrin udhëzime të hollësishme.

Si palë e tretë, Trusti i Reformës së Burgjeve (Prison Reform Trust) parashtrroi se mohimi i së drejtës së votës i të burgosurve të dënuar ishte një relik i shekullit të nëntëmbëdhjetë, i cili daton që nga Akti i Konfiskimit i vitit 1870, origjina e të cilit ishte rrënjësor në një nocion të vdekjes qytetare. Trusti argumentoi se përjashtimi shoqëror ishte një shkak kryesor i krimin dhe i përsëritjes së veprës, dhe se ndalimi i votimit ishte kundër ideve të rehabilitimit dhe përgjegjësisë qytetare, duke përjashtuar më tej ata që ishin tashmë në kufijtë e shoqërisë dhe duke i izoluar më tej ata nga komunitetet, në të cilat do të ktheheshin pasi të jenë liruar.

Qendra AIRE (AIRE Centre) tërhoqi vëmendjen në rekomandimin e Këshillit të Evropës për menaxhimin nga administratat e burgjeve të dënimeve me burgim të përjetshëm dhe të burgosurve të tjerë afatgjatë, i cili synonte t'u jepte udhëzime shteteve anëtare në luftimin e efekteve negative të burgimit afatgjatë dhe përgatitjen e të burgosurve për jetën në komunitet pasi të jenë liruar. Kjo qendër iu referua tri parimeve të përfshira në rekomandim: “parimi i normalizimit”, “parimi i përgjegjësisë” dhe “parimi i individualizimit”. Kështu argumentoi se, megjithëse nuk kishte asnjë referencë të qartë për të drejtën e të burgosurve për të votuar, këto parime mbështetën shtrirjen e votës

tek të burgosurit, duke nxitur lidhjen e tyre me shoqërinë, duke rritur ndërgjegjësimin për aksionet e tyre në shoqëri dhe duke marrë parasysh rrethanat e tyre personale dhe karakteristikat.

Në anën tjetër, Qeveria letoneze si palë e tretë ngriti shqetësimet se gjykimi i Dhomës (Chamber Judgement) do të kishte një efekt horizontal mbi vendet e tjera, të cilat vendosën një ndalim të përgjithshëm për të burgosurit e dënuar që të votonin në zgjedhje. Ata parashtruan se, në këtë fushë, shteteve duhet t'u jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi, veçanërisht duke marrë parasysh evolucionin historik dhe politik të vendit dhe se gjykata nuk ishte kompetente për të zëvendësuar pikëpamjen e një vendi demokratik me pikëpamjen e vet, për atë që ishte në interesin më të mirë të demokracisë.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 14 të Konventës, kërkuesi u ankua se ishte diskriminuar si i dënuar më burgim si dhe u ankua për shkelje të nenit 10 të Konventës duke pretenduar se përjashtimi nga e drejta në votë e pengoi atë të ushtronte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes përmes votimit.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata theksoi faktin se neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës është një e drejtë dhe jo një privilegj që mund t'u jepet personave të caktuar. Kjo e drejtë duhet të qëndrojë në bazë të çdo demokracie të zhvilluar në botë. Gjykata ritheksoi se, siç kishte cekur në raste të tjera, kjo e drejtë nuk është absolute dhe se palët e larta kontraktuese gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi mbi këtë drejtë. Zgjedhjet në vende të ndryshme vijnë dhe organizohen në forma të ndryshme për shkak të kontekstit të tyre historik dhe zhvillimeve të ndryshme ekonomike, sociale dhe kulturore. Gjykata theksoi se çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të ndjekë një qëllim objektiv legjitim dhe të respektojë parimin e proporcionalitetit. Përjashtimi i grupeve të ndryshme të popullsisë nga votimi duhet t'i shërbejë ruajtjes dhe garantimit të zgjedhjeve në vend dhe nuk duhet të cenojë thelbin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Për rastin e të dënuarve, Gjykata është shprehur edhe në çështje të tjera që ata janë të përjashtuar vetëm nga e drejta për të qenë të lirë dhe

gëzojnë çdo të drejtë tjetër të garantuar nga Konventa, duke theksuar këtu se privimi i lirisë vjen si pasojë e veprimeve të tyre në kundërshtim me ligjin. Nuk është e drejtë që të burgosurit të privohen nga e drejta e tyre për të votuar, vetëm për faktin se ata janë në atë gjendje.

Për sa i përket qëllimit legjitim, Gjykata u shpreh se neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk përcakton në mënyrë shteruese arsyet apo nevojën përse shteti mund t'ia privojë këtë të drejtë një individi, duke qenë se rastet mund të jenë nga më të ndryshmet. Në rastin konkret Qeveria u shpreh se në këtë mënyrë, ligji shërben në uljen e kriminalitetit në vend dhe nxit respektimin e ligjit. Gjykata e pranoi se kjo mund të konsiderohet si qëllim legjitim.

Duke u ndalur në parimin e proporcionalitetit, Gjykata u shpreh se numri prej 48 000 të dënuarish që ishin privuar nga kjo e drejtë, përbënte një numër të paneglizhueshëm personash. Sipas saj, ligji përfshinte një gamë të gjerë dënimesh dhe krimesh, që varionin nga dënimi me një ditë burg, në atë me burgim të përjetshëm, nga krime të lehta në ato me rrezikshmëri shumë të lartë.

Gjithashtu, Gjykata vuri theksin te mungesa e një debati parlamentar apo dhe ndërmjet ekspertëve të sistemit gjyqësor në Mbretërinë e Bashkuar, mbi ndryshimet e fundit lidhur me dënimet penale dhe të drejtat e njeriut, për të diskutuar proporcionalitetin e ligjit aktual. Në vend, përjashtimi i këtij grupi personash për të votuar shikohej më shumë si një çështje me rëndësi për Parlamentin sesa për sistemin e drejtësisë, ku asnjë gjykatë vendore nuk kishte marrë iniciativën për të shqyrtuar proporcionalitetin e këtij ligji.

Për sa i përket qëllimit të këtij ligji, Mbretëria e Bashkuar nuk ishte e vetmja palë e lartë kontraktuese që kishte marrë këto masa, madje ajo kishte ligjin me efektet më të lehta ndër ato shtete, që e privonin këtë të drejtë. Kishte pasur shumë raste që personat ishin lejuar të votonin dhe çdo person e fitonte të drejtën për të votuar në momentin që ai rifitonte lirinë.

Pavarësisht situatës së lartpërmendur, faktit që kishte pasur disa përmirësime me Aktin e vitit 2000, apo se Mbretëria e Bashkuar gëzonte një hapësirë të gjerë vlerësimi, Gjykata arsyetoi se kjo masë

ishite diskriminuuese dhe i hiqte të drejtën për të votuar një numri të konsiderueshëm njerëzish.

Gjykata u ndal në veçanti te fakti se çdo i dënuar, pavarësisht krimit apo dënimit, gjatë kohës që vuante dënimin e humbiste këtë të drejtë. Sipas Gjykatës, pavarësisht se Konventa i njuh një hapësirë të gjerë vlerësimi shteteve anëtare, kjo masë e përgjithshme nuk mund të pranohet se është në përputhje me frymën e Konventës. Në fund ajo u shpreh se në rastin objekt gjykimi ishte shkelur neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës.

Në lidhje me nenin 14 të Konventës, Gjykata theksoi se duke pasur parasysh përfundimin e mësipërm sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1, Dhoma e Madhe, ashtu si Dhoma, konsideroi se nuk lind asnjë çështje e veçantë sipas nenit 14 të Konventës.

Në lidhje me nenin 10 të Konventës, Gjykata konsideroi se neni 3 i Protokollit nr. 1 duhet parë si *lex specialis* në lidhje me ushtrimin e së drejtës së votës dhe, ashtu si Gjykata e Lartë, konstatoi se asnjë çështje e veçantë nuk lind sipas nenit 10 të Konventës në rastin aktual.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi që ka pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1; vendosi njëzëri se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës; vendosi njëzëri se nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. *DEUTSCHE UMWELTHILFE eV kundër FREISTAAT BAYERN*

GJDBE

Çështja C-752/18

19 dhjetor 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=221809&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13711036>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: masat që juridiksionet e shteteve anëtare duhet të marrin në mënyrë që kriteret e përcaktuara nga e drejta e BE-së të zbatohen në praktikë nga autoritetet administrative të këtyre vendeve.

Faktet kryesore

Sipas matjeve të vazhdueshme teknike të kryera në qytetin e Mynihut rezultonte se vlera kufi e përcaktuar nga dispozitat e kombinuara të nënparagrafit 2 të nenit 13.1 dhe Shtojcës XI, B, të Direktivës 2008/50¹²⁰ për dioksidin e azotit (NO₂), mesatarisht 40 µg/m³ gjatë një viti kalendarik, u tejkalua së tepërmi.

Pas një padie nga Deutsche Umwelthilfe, një organizatë gjermane për mbrojtjen e mjedisit, Verwaltungsgericht München¹²¹ me një vendim të 9 tetorit 2012, urdhëroi Landin e Bavarisë, të modifikonte planin e veprimit për cilësinë e ajrit për qytetin e Mynihut, duke marrë masat e nevojshme për të siguruar që vlera maksimale e përcaktuar

¹²⁰ Direktiva 2008/50 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 majit 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajrin e pastër për Evropën (OJ 2008, L 152 f. 1).

¹²¹ Gjykata Administrative e Mynihut, Gjermani.

për dioksidin e azotit të respektohet sa më shpejt në këtë qytet, në përputhje me Direktivën 2008/50¹²². Ky vendim u bë përfundimtar.

Me urdhër të 21 qershorit 2016, Verwaltungsgericht München e paralajmëroi Landin e Bavarisë se do ta dënonte me një gjobë prej 10.000 eurosh në rast të mosrespektimit të vendimit të lartpërmendur brenda një periudhe njëvjeçare nga njoftimi i urdhrit. Në apel Bayerischer Verwaltungsgerichtshof¹²³, me urdhrin e 27 shkurtit 2017, e paralajmëroi Landin e Bavarisë se do ta dënonte me gjoba prej 2 000 deri në 4000 euro, nëse ai nuk do merrte masat e nevojshme për t'u përshtatur me vlerat maksimale të përcaktuara nga Direktiva 2008/50, përfshirë vendosjen e ndalimeve të drejtimit të automjeteve për automjete të caktuara me naftë në zona të ndryshme urbane. Edhe ky urdhër u bë përfundimtar.

Meqenëse Landi i Bavarisë nuk respektoi plotësisht detyrimet që rridhnin nga urdhri i 27 shkurtit 2017, Verwaltungsgericht München, pas një kërkesë të Deutsche Umwelthilfe, me vendim të 26 tetorit 2017 e dënoi Landin e Bavarisë që të paguajë një gjobë prej 4,000 euro. Landi i Bavarisë nuk e apeloj këtë urdhër dhe pagoi gjobën. Pavarësisht nga kjo, Landi i Bavarisë vijoi të mos i respektonte detyrimet e tjera që rridhnin nga vendimi i 27 shkurtit 2017. Përkundrazi, përfaqësuesit e Landit të Bavarisë, përfshirë Kryeministrin e këtij Landi, shprehën publikisht qëndrimin për të mos respektuar detyrimet e lartpërmendura në lidhje me vendosjen e ndalimeve për qarkullimin e automjeteve.

Me vendimin e 28 janarit 2018, Verwaltungsgericht München, me kërkesë të Deutsche Umwelthilfe, e dënoi Landin e Bavarisë me një gjobë prej 4,000 eurosh, për shkak të mosrespektimit të një prej pikave të pjesës operative të vendimit të 27 shkurtit 2017, dhe e paralajmëroi se do vendoste një gjobë tjetër të njëjtë nëse Landi nuk respektonte, brenda një periudhe të re, një pikë tjetër të pjesës operative të atij vendimi. Nga ana tjetër, kjo gjykatë hodhi poshtë, në veçanti, kërkesën për miratimin e një urdhri për kufizimin e lirisë ndaj Ministrisë për Mjedisin dhe Mbrojtjen e Konsumatorit të Landit të Bavarisë ose, në

122 Direktiva 2008/50/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 majit 2008, në lidhje me cilësinë e ajrit dhe një ajër të pastër për Evropën (JO 2008, L 152, p.1)

123 Gjykata e Lartë Administrative e Landit të Bavarisë.

mungesë të kësaj, Kryeministrit të atij Landi. Landi i Bavarisë e apeloj vendimin e 28 janarit 2018 në Bayerischer Verwaltungsgerichtshof, e cila i hodhi poshtë ato me vendimin e 14 gushtit 2018. Sidoqoftë, apeli i paraqitur nga Deutsche Umwelthilfe kundër vendimit të 28 janarit 2018 që refuzonte kërkesën për vendosjen e një mase kufizimi lirie është ende në pritje para Bayerischer Verwaltungsgerichtshof. Sipas kësaj të fundit, nuk ka asnjë arsye për të besuar që Landi i Bavarisë do të respektojë urdhrin e 27 shkurtit 2017, nëse miratohen masat kufizuese në fjalë.

Sipas Bayerischer Verwaltungsgerichtshof kur pushteti ekzekutiv shpreh kaq qartë vendosmërinë e tij për të mos iu bindur vendimeve të caktuara gjyqësore, duhet të konsiderohet se vendosja e gjobave të reja periodike, edhe në shuma më të mëdha, nuk mund ta ndryshojë këtë sjellje. Në të vërtetë, pagesa e një gjobe nuk do të rezultonte në ndonjë dëm pasuror për Landin e Bavarisë. Përkundrazi, pagesa e gjobës do të bëhej duke e futur shumën e caktuar nga gjykata në një kategori të caktuar në buxhetin e Landit të Bavarisë dhe duke e regjistruar të njëjtën shumë si të ardhura nga fondi qendror i atij Landi. Sipas asaj gjykate, ndërsa, në parim, mund të jetë e mundur të sigurohet respektimi i detyrimeve dhe vendimeve gjyqësore në fjalë me anë të një mase kufizimi të lirisë të funksionarëve të caktuar të Qeverisë së Bavarisë së Epërme, të Ministrit të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Landit të Bavarisë ose të Kryeministrit të tij, ajo konsideroi se, për arsye të së drejtës kushtetuese, ky instrument, i parashikuar nga ZPO¹²⁴, nuk është i zbatueshëm në këtë rast.

Sipas gjykatës referuese, nëse do të vendoseshin masa kufizuese për funksionarët bavarezë sipas nenit 888 të ZPO-së, kjo do të vinte në kundërshtim me kriterin e përcaktuar nga Bundesverfassungsgericht¹²⁵, në urdhrin e saj të 13 tetorit 1970, se qëllimi i ligjvënësit kur miraton një dispozitë që shërben si bazë ligjore për kufizimin e lirisë, duhet të përfshijë objektivin për arritjen e të cilit kjo dispozitë zbatohet. Sipas Bayerischer Verwaltungsgerichtshof ky kriter nuk respektohet në këtë rast.

124 Kodi i Procedurës Civile në Gjermani.

125 Gjykata Kushtetuese Federale në Gjermani.

Në këto kushte, Bayerischer Verwaltungsgerichtshof i drejtoi GJDBE-së një sërë pyetjesh, thelbi i të cilave ishte nëse e drejta e BE-së kërkon një vlerësim të ndryshëm të situatës ligjore në fjalë në procedurën para saj, dhe nëse marrja e një mase kufizimi lirie, në një situatë të tillë si ajo në procedurën kryesore, kërkohet sipas së drejtës së BE-së, dhe se gjykatat gjermane nuk janë të detyruara të marrin parasysh pengesën që ngre praktika kushtetuese e lartpërmendur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se, në rrethanat e karakterizuara nga një refuzim i vazhdueshëm nga një autoritet kombëtar për të respektuar një vendim gjykatë që e urdhëron atë të kryejë një detyrim të qartë, të saktë dhe të pakushtëzuar që buron nga e drejta e BE-së, në veçanti nga Direktiva 2008/50, iu takon gjykatave kompetente kombëtare për të vendosur një masë kufizimi lirie ndaj funksionarëve të autoritetit administrativ përkatës. Gjykata vlerësoi se një kufizim i tillë mund të vendoset vetëm me qëllim që t'i urdhërojë ata të miratojnë masa për pastrimin e ajrit në Mynih nëse plotësohen dy kushte. Së pari duhet që kjo masë të jetë e parashikuar në legjislacionin e brendshëm dhe kjo bazë ligjore duhet të jetë mjaftueshëm e qasshme, e saktë dhe e parashikueshme në zbatimin e saj dhe, së dyti, kjo masë duhet të jetë proporcionale. Gjykata theksoi se është përgjegjësi e Bayerischer Verwaltungsgerichtshof të verifikojë nëse këto dy kushte janë plotësuar.

Në këtë drejtim, Gjykata para së gjithash kujtoi se u takonte së pari shteteve anëtare që të siguronin, kur zbatonin ligjin e BE-së, respektimin e së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore, të garantuar nga neni 47 i Kartës së Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejshëm: Karta), dhe në fushën e mjedisit, sipas nenit 9.4 të Konventës së Aarhusit¹²⁶. Kjo e drejtë është edhe më e rëndësishme pasi mosmiratimi i masave të kërkuara nga Direktiva 2008/50 rrezikonte shëndetin e personave. Megjithatë, një legjislacion kombëtar i cili çon në një situatë, në të cilën një vendim gjyqësor mbetet pa efekt, shkel thelbin e kësaj të drejte dhe e

126 Konventa për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështje Mjedisore, e nënshkruar në Aarhus më 25 qershor 1998 dhe e miratuar në emër të Komunitetit Evropian me Vendimin 2005/370/EC të Këshillit të 17 shkurtit 2005 (OJ 2005, L 124, f.1).

privon atë nga çdo efekt i dobishëm. Në një situatë të tillë, Gjykata kujtoi se u takon gjykatave gjermane të interpretojnë të drejtën kombëtare në mënyrë që, aq sa të jetë e mundur, ajo të përputhet me objektivat e ndjekura nga dispozitat e së drejtës së BE-së ose, nëse nuk arrin këtë, të lërë të pazbatuar çdo dispozitë kombëtare në kundërshtim me të drejtën e BE-së që ka efekt të drejtpërdrejtë.

Sidoqoftë, Gjykata kujtoi gjithashtu se respektimi i këtij detyrimi të fundit nuk mund të çojë në shkelje të së drejtës tjetër themelore, që është e drejta për liri, e garantuar nga neni 6 i Kartës dhe e cila mund të shkelet nga një masë kufizimi të lirisë së personit. Meqenëse e drejta për mbrojtje efektive gjyqësore nuk është absolute dhe mund të përfshijë kufizime, në përputhje me nenin 52.1 të Kartës, duhet të bëhet një baraspeshim i të drejtave themelore në fjalë. Sidoqoftë, për të përmbushur kërkesat e kësaj dispozite, një ligj që autorizon një gjyqtar të privojë një person nga liria duhet, para së gjithash, të jetë mjaftueshëm i qasshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që të shmangët çdo rrezik arbitrariteti, gjë që duhet përcaktuar nga gjykata referuese. Për më tepër, shpallja e një detyrimi nga organi që kërkon kufizimin e lirisë, mund të përdoret, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur nuk ekziston një masë më pak kufizuese, si gjoba periodike, gjoba më të rënda, pagesa e të cilave nuk do bëhej në favor të buxhetit nga ku ato paguhen. Sipas GJDBE-së, edhe ky element, në rastin konkret duhet vlerësuar nga gjykata referuese. Vetëm në rast se arrihet në përfundimin se kufizimi i vendosur ndaj të drejtës së lirisë së personit për shkak të një vendimi që e kufizon këtë liri, përputhet me këto kushte, të cilat e drejta e BE-së jo vetëm që i autorizon, por eventualisht edhe i kërkon, duke kujtuar që, në kuadër të një padie direkte para saj, Gjykata mund të gjejë shkelje të Direktivës 2008/50 nga autoritetet gjermane dhe të çojë në lindjen e përgjegjësisë së shtetit për dëmin që rrjedh.

3.2. BANK MELLI IRAN kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

GJDBE

Çështja C-548/09 P

16 nëntor 2011

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=114401&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13709188>]

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Gjykata pranon se në zbatim të sanksioneve ndërkombëtare në kuadër të luftës ndaj terrorizmit, organet e BE-së mund të vendosin kufizime ndaj lirive themelore, të tilla si prona, por që këto masa duhet të respektojnë formalitete të caktuara, sidomos ato të njoftimit të arsyeve të këtyre masave ndaj personit konkret.*

Faktet kryesore

Banka Melli (Bank Melli Iran) është një kompani tregtare iraniane në pronësi të shtetit iranian (parashtruesja) dhe çështja e ngritur para Tribunalit e ka origjinën në regjimin e sanksioneve të vendosura për t'i bërë presion Republikës Islamike të Iranit që t'u japë fund aktiviteteve bërthamore që paraqesin rrezik përhapjeje dhe zhvillimit të programeve të armëve bërthamore (në tekstin e mëtejshëm: "përhapja bërthamore"). Regjimi në fjalë e gjen burimin e tij në Rezolutën 1737 (2006) (4), të 23 dhjetorit 2006, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejshëm: "Këshilli i Sigurimit"), aneksi i së cilës rendiste personat dhe subjektet të cilat, sipas Këshillit të Sigurimit, ishin të përfshirë në përhapjen bërthamore në Iran, dhe fondet dhe burimet ekonomike të të cilëve do të ngriheshin. Kjo listë është përditësuar rregullisht nga Këshilli i Sigurimit përmes rezolutave të ndryshme. Sidoqoftë, vetë parastruesja nuk ishte subjekt i ndonjë mase për ngrirje fondesh nga Këshilli i Sigurimit.

Rezoluta 1737 (2006) u zbatua, për sa i përket Bashkimit Evropian, nga Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2007/140/CFSP i 27 shkurtit 2007, në

lidhje me miratimin e masave kufizuese kundër Iranit. Neni 5.1 (a) i atij Qëndrimi të Përbashkët parashikonte ngrirjen e fondeve të zotëruara, të mbajtura ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga subjektet dhe personat e caktuar nga rezoluta. Neni 5.1 (b) i tij e shtriu këtë masë tek personat dhe subjektet e njohura nga Këshilli si pjesëmarrës, të lidhur drejtpërdrejt ose që sigurojnë mbështetje për përhapjen bërthamore. Ky Qëndrim i Përbashkët parashikonte gjithashtu, në nenin 7.2, që lista e personave dhe subjekteve të referuara në nenin 5.1 (b) të hartohet dhe të ndryshohet nga Këshilli me unanimitet.

Për sa i përket kompetencave të Komunitetit Evropian, Qëndrimi i Përbashkët 2007/140 u pasua nga miratimi, në bazë të neneve 60 të KE-së dhe 301 të KE-së, të Rregullores (KE) nr. 423/2007 të Këshillit, të 19 prillit 2007. Me një përmbajtje shumë të ngjashme me atë të Qëndrimit të përbashkët, neni 7.1 i Rregullores në fjalë parashikon ngrirjen e fondeve që u përkasin personave, subjekteve dhe organeve të përcaktuara me rezolutën 1737 (2006), si dhe të gjitha fondeve që persona, subjekte ose organe të tilla zotërojnë, mbajnë ose kontrollojnë. Neni 7.2 i Rregullores nr. 423/2007 e shtrin këtë mundësi të ngrirjes të personat, subjektet ose organet e përcaktuara nga Këshilli dhe të njohura, në përputhje me nenin 5.1, (b), të Qëndrimit të Përbashkët 2007/140, si pjesëmarrës, duke qenë të lidhur drejtpërdrejt ose duke ofruar mbështetje për përhapjen bërthamore. Personat, subjektet dhe organet e përcaktuara nga Këshilli sipas nenit 7.2 të Rregullores Nr. 423/2007 renditen në Shtojcën V të saj.

Neni 15.2 i Rregullores nr. 423/2007 parashikon më tej që *“Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, krijon, rishikon dhe ndryshon [Shtojcën V] në përputhje të plotë me vendimet e Këshillit [miratuar sipas nenit 5.1, (b) të Qëndrimit të Përbashkët 2007/140”*. Gjithashtu sipas kushteve të së njëjtës dispozitë, Këshilli duhet të shqyrtojë listën në fjalë në intervale të rregullta, dhe të paktën çdo dymbëdhjetë muaj.

Neni 15.3 i Rregullores nr. 423/2007 parashikon se *“Këshilli do të japë arsyet individuale dhe specifike për vendimet e marra sipas paragrafit 2 dhe do t'i sjellë ato në vëmendjen e personave, subjekteve dhe organeve të interesuara”*.

Disa kohë pas miratimit të Rregullores nr. 423/2007, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1803 (2008) (7), të 3 marsit 2008, në të cilën u bën thirrje *“të gjitha Shteteve të tregojnë vigjilencë në lidhje me aktivitetet e kryera nga institucionet financiare të vendosura në territorin e tyre me të gjitha bankat me seli në Iran, në veçanti Banka Melli dhe Banka Saderat, si dhe me degët dhe agjencitë e tyre jashtë vendit, në mënyrë që të parandalohen që këto aktivitete të kontribuojnë në aktivitetet që paraqesin rrezik përhapje”*.

Me Qëndrimin e Përbashkët 2008/479/CFSP (9) më 23 qershor 2008, Këshilli ndryshoi Qëndrimin e Përbashkët 2007/140. Për shkak të aneksit të Qëndrimit të ri të Përbashkët, parashtruesja u përfshi ndërmjet subjekteve që i nënshtroheshin ngrirjes së fondeve në përputhje me nenin 5 .1 (b) të Qëndrimit të Përbashkët 2007/140. Përfshirja e saj u konfirmua nga Qëndrimi i Përbashkët 2008/652/PESC (10) i cili, nga ana tjetër, ndryshoi Qëndrimin e Përbashkët 2007/140.

Më 23 qershor 2008, në të njëjtën ditë me miratimin e Qëndrimit të Përbashkët 2008/479, Këshilli miratoi vendimin e kundërshtuar. Sipas pikës 4 të Tabelës B të shtojcës së atij vendimi, parashtruesja u përfshi në listën e Shtojcës V të Rregullores Nr. 423/2007. Ky regjistrim çoi në ngrirjen e fondeve të tij.

Në këto kushte, pika 4 e tabelës B të aneksit të vendimit të kontestuar përmend emrin e parashtrueses, adresën e saj postare në Teheran dhe datën e regjistrimit të saj (përkatësisht 26 qershor 2008). Për arsytet që e shtynë Këshillin të regjistrojë parashtruesen, pika 4 thotë se Banka Melli *“ofron ose përpiqet të sigurojë mbështetje financiare për kompanitë që marrin pjesë në programet bërthamore dhe hapësinore të Iranit ose blejnë mallra për këto programe (AIO, SHIG, SBIG, AEOL, Novin Energy Company, Mesbah Energy Company, Kalaye Electric Company dhe DIO). Banka Melli shërben si lehtësuese për aktivitetet e dyshimta iraniane. Ajo lehtësoi blerjet e shumta të pajisjeve të nevojshme për programet bërthamore dhe hapësinore iraniane. Ajo ka ofruar një sërë shërbimesh financiare në emër të njërive që lidhen me industrinë bërthamore dhe hapësinore të Iranit, përfshirë hapjen e letrave të kreditit dhe menaxhimin e llogarive. Shumica e kompanive të lartpërmendura i referohen rezolutave 1737 dhe 1747 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara”*.

Më 18 shtator 2008, Banka Melli paraqiti pranë Tribunalit të BE një padi për anulim të këtij vendimi dhe pretendoi, para së gjithash, anulimin e pikës 4 të Tabelës B të Shtojcës së vendimit të kontestuar për sa i përket vetes, si dhe filialeve dhe degëve të saj. Përpara Gjykatës ajo u tërhoq nga një pjesë e kërkesës së saj për sa i përket anulimit të vendimit të kontestuar në lidhje me filialet e saj.

Në mbështetje të përfundimeve të saj, parashtruesja ngriti një numër pretendimesh të cilat Tribunali i grupoi së bashku në pesë pika. Së pari, parashtruesja u bazua në pretendimin për shkelje të kërkesave procedurale thelbësore të Traktatit të KE-së, të rregullave ligjore në lidhje me zbatimin e tij dhe të nenit 7.2 të Qëndrimit të Përbashkët 2007/140, për abuzim me pushtetin dhe mungesë të bazës ligjore të vendimit të kontestuar. Pretendimi i dytë bazohej në shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, i treti në shkeljen e parimit të proporcionalitetit dhe të së drejtës së pronës, i katërti në shkeljen e së drejtës për t'u mbrojtur, të së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore dhe detyrimin për të deklaruar arsyet e parashikuara në nenin 15.3 të Rregullores nr. 423/2007 dhe së fundmi, pretendimi i pestë, u bazua në mungesën e juridiksionit të Komunitetit.

Tribunali i hodhi poshtë të gjitha pretendimet dhe urdhëroi parashtruesen të përballojë shpenzimet e bëra nga Këshilli.

Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e saj pas apelit të parashtrueses ndaj vendimit të Tribunalit, Gjykata kujtoi se parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore nënkupton që autoriteti i BE-së që miraton një akt që përfshin masa kufizuese në lidhje me një person ose një subjekt, në momentin e miratimit ose sa më shpejt të jetë e mundur pas miratimit, bën të ditur plotësisht arsyet ku bazohet ky akt, në mënyrë që t'i lejojë këtyre personave ose subjekteve të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit.

Për të respektuar këtë parim, neni 15.3 i Rregullores nr. 423/2007, në lidhje me miratimin e masave kufizuese kundër Iranit, kërkon që Këshilli të japë arsye individuale dhe specifike për vendimet e marra në përputhje me nenin 7.2 të asaj Rregulloreje dhe që t'ia bëjë ato të

ditura personave, subjekteve dhe organeve të interesuara. Në të vërtetë, ngrirja e fondeve ka pasoja të konsiderueshme për subjektet në fjalë, pasi mund të kufizojë ushtrimin e të drejtave të tyre themelore. Edhe pse Rregullorja nr. 423/2007 nuk parashikon formën në të cilën këto arsye “u bëhen me dije” personave, subjekteve dhe organeve të interesuara, publikimi në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian nuk është i mjaftueshëm. Në të vërtetë, nëse komunikimi i arsyeve individuale dhe specifike mund të konsiderohet se është kryer nga publikimi i vendimit në Gazetën Zyrtare, meqenëse vendimi për ngrirjen e fondeve duhet të publikohet gjithsesi sipas nenit 254, paragrafët 1 dhe 2 të TKE-së, duke marrë parasysh natyrën e tij rregullatore, interesi për të siguruar në mënyrë eksplicite këtë komunikim personave të interesuar, siç kërkon neni 15.3, nuk arrihet nga ky publikim. Nga kjo rrjedh se vetëm me anë të një komunikimi individual, Këshilli duhet të përmbushë detyrimin e tij sipas asaj dispozite.

Megjithatë, ndërkohë që një komunikim individual është, në parim, i nevojshëm, asnjë formë e veçantë nuk kërkohet nga neni 15.3 i Rregullores nr. 423/2007, i cili përmend vetëm detyrimin për të “bërë me dije”. Kësaj dispozite duhet t’i jepet efekt praktik, përkatësisht efekti për garantimin e mbrojtjes efektive gjyqësore për personat dhe subjektet e prekura nga masat kufizuese të miratuara në përputhje me nenin 7.2 të asaj Rregulloreje. Ky është rasti kur komunikimi nuk është bërë nga Këshilli, por informacion i mjaftueshëm i është transmetuar parashtrueses nga një autoritet bankar kombëtar dhe parashtruesja ka qenë në gjendje të bëjë një apel, pasi që mungesa e komunikimit nga Këshilli nuk kishte për pasojë privimin e subjektit nga mundësia për të ditur, në kohën e duhur, arsyet e vendimit të kontestuar dhe për të vlerësuar bazueshmërinë e masës për ngrirjen e fondeve të tij.

Sipas titullit të saj, Rregullorja nr. 423/2007 ka të bëjë me miratimin e masave kufizuese kundër Republikës Islamike të Iranit. Nga *considerandum*-et dhe të gjitha dispozitat e saj rrjedh se qëllimi i saj është të parandalojë ose ngadalësojë, me masa kufizuese në çështjet ekonomike, politikën bërthamore të ndjekur nga Irani, duke marrë parasysh rrezikun që paraqet kjo politikë. Pra, qëllimi janë rreziqet specifike prej programit iranian të përhapjes bërthamore dhe jo aktiviteti i përgjithshëm i përhapjes bërthamore.

Meqenëse qëllimi dhe përmbajtja e aktit në fjalë është haptazi miratimi i masave ekonomike që synojnë Republikën Islamike të Iranit, përdorimi i nenit 308 të KE-së nuk ishte i nevojshëm, pasi neni 301 i KE-së përbën një bazë ligjore të mjaftueshme përderisa lejon veprimet e synuara nga Komuniteti në ndërprerjen ose zvogëlimin, tërësisht ose pjesërisht, të marrëdhënieve ekonomike me një ose më shumë vende të treta, dhe një veprim i tillë mund të përfshijë masa për ngrirjen e fondeve ndaj subjekteve të tilla si një bankë, të cilat lidhen me regjimin e vendit të tretë në fjalë.

Për sa i përket nevojës për përfshirjen e Qëndrimit të Përbashkët 2007/140 si bazë ligjore, ai kundërshtohet nga teksti aktual i nenit 301 të KE-së, i cili parashikon mundësinë e miratimit të masave të Komunitetit kur një Qëndrim i Përbashkët ose një Veprim në kuadrin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) sipas dispozitave të Traktatit të BE-së në versionin e tij para Traktatit të Lisbonës, kërkojnë një veprim nga Komuniteti. Ky tekst tregon se Qëndrimi i Përbashkët ose Veprimi i Përbashkët duhet të ekzistojë që masat e Komunitetit të miratohen, por jo se këto masa duhet të bazohen në këtë Qëndrim të Përbashkët ose këtë Veprim të Përbashkët.

Në çdo rast, një Qëndrim i Përbashkët nuk mund të përbëjë bazën ligjore për një akt të Komunitetit. Në fakt, Qëndrimet e Përbashkëta të Këshillit mbi PPJS, siç janë Qëndrimet e Përbashkëta nr. 2007/140 dhe 2008/479, janë miratuar brenda kuadrit të Traktatit të BE-së, në përputhje me nenin 15 të tij, ndërsa rregulloret e Këshillit, siç është Rregullorja nr. 423/2007, janë miratuar brenda kuadrit të Traktatit të KE-së. Prandaj Këshilli mund të miratojë një akt të Komunitetit vetëm në bazë të kompetencave që i janë dhënë nga Traktati i KE-së, përkatësisht në këtë rast nenet 60 të KE-së dhe 301 të KE-së.

Rezolutat e Këshillit të Sigurimit, nga njëra anë, dhe qëndrimet dhe rregulloret e përbashkëta të Këshillit, nga ana tjetër, rregullohen nga sisteme ligjore të ndryshme. Po kështu, aktet e miratuara në kuadër të Kombeve të Bashkuara nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, të BE-së, miratohen nga organe që kanë kompetenca autonome, të cilat u atribuohen atyre nga statutet e tyre themelore që i kanë krijuar.

Gjatë hartimit të masave të Komunitetit që synojnë zbatimin e një rezolute të Këshillit të Sigurimit të referuar në një Qëndrim të Përbashkët, Komuniteti duhet të marrë parasysh kushtet dhe objektivat e rezolutës në fjalë. Gjithashtu, teksti dhe qëllimi i një rezolute të Këshillit të Sigurimit duhet të merren parasysh kur interpretohen rregulloret që synojnë zbatimin e tij. Sidoqoftë, pa vënë në dyshim përparësinë e një rezolute të Këshillit të Sigurimit në nivel ndërkombëtar, respekti nga institucionet e Komunitetit ndaj institucioneve të Kombeve të Bashkuara nuk mund të çojë në mungesë të kontrollit të ligjshmërisë së aktit të Komunitetit në lidhje me të drejtat themelore që janë pjesë përbërëse e parimeve të përgjithshme të së drejtës komunitare.

Kështu, kompetenca e dhënë Këshillit nga neni 7.2 i Rregullores nr. 423/2007, në lidhje me miratimin e masave kufizuese kundër Iranit, ka karakter autonom. Në këtë drejtim, një detyrim për të “marrë parasysh siç duhet” kushtet dhe objektivat e rezolutës në fjalë nuk bie ndesh në asnjë mënyrë me konstatimin se Këshilli vepron në mënyrë autonome, duke respektuar rregullat e rendit të tij juridik. Prandaj, në kundërshtim me atë që pretendon parashtruesja, Tribunali ka qenë korrekt duke vënë në dukje, në paragrafin 52 të vendimit të apeluar, rëndësinë e rezolutave të Këshillit të Sigurimit, por duke përshkruar kompetencën e Këshillit si autonome, në paragrafët 64 dhe 65 të atij vendimi.

Në lidhje me pretendimin dytësor për mbrojtje të së drejtës së pronës, Gjykata kujtoi se Tribunali me të drejtë kishte theksuar, në paragrafin 70 të vendimit të apeluar, se të drejtat themelore në fjalë në rastin konkret nuk janë të drejta absolute dhe se ushtrimi i tyre mund t’u nënshtrohet kufizimeve të justifikuara nga objektivat e interesit të përgjithshëm të ndjekur nga Komuniteti.

Ky është në fakt rasti me të drejtën në pronë dhe lirinë për të ushtruar një aktivitet ekonomik. Rrjedhimisht, mund të bëhen kufizime në të drejtën për të ushtruar lirshëm një aktivitet profesional, si dhe në të drejtën e pronës, me kusht që këto kufizime të përmbushin në mënyrë efektive objektivat e interesit të përgjithshëm të ndjekur dhe të mos përbëjnë, në fund, duke pasur parasysh qëllimin e ndjekur, një ndërhyrje të tepruar dhe të papranueshme, e cila do të minonte thelbin e të drejtave të garantuara në këtë mënyrë.

Në këtë drejtim, arsyeja e dhënë nga Tribunali në paragrafin 71 të vendimit të apeluar, që tregon rëndësinë parësore të ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ishte e mjaftueshme për të identifikuar objektivin e interesit të përgjithshëm të ndjekur. Ky argument duhet të lexohet në dritën e akteve të ndryshme, në kontekstin e miratimit të të cilave, merret vendimi i kontestuar. Si përfundim, Gjykata i rrëzoi pretendimet e parashtrueses.

3.3. “SYRIAN LEBANESE COMMERCIAL BANK SAL” kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Tribunali i BE-së

Çështjet e bashkuara T-174/12 dhe T-80/13

4 shkurt 2014

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=T-174/12&language=EN>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky vendim ka të bëjë me të drejtën për t'u mbrojtur efektivisht në rast të miratimit të sanksioneve nga organet e BE-së ndaj entiteteve të dyshuara se mbështesin terrorizmin

Faktet kryesore

Parashtruesi, “Syrian Lebanese Commercial Bank SAL” (në tekstin e mëtejshëm: “SLCB”), është një bankë libaneze, kapitali i së cilës është 84.2% në pronësi të Bankës Tregtare të Sirisë (“CBS”), e cila është në pronësi të shtetit sirian.

Më 9 maj 2011, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi, në bazë të nenit 29 të TBE-së, Vendimin 2011/273/CFSP në lidhje me masat kufizuese kundër Sirisë. Neni 4.1 parashikon që të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që u përkasin personave përgjegjës për shtypjen e dhunshme të ushtruar kundër popullsisë civile në Siri, dhe personave fizikë ose juridikë, dhe entiteteve të lidhura me to, si dhe të gjitha fondet dhe burimet që ata zotërojnë, mbajnë ose kontrollojnë, ngrihen. Kushtet e kësaj ngrirjeje përcaktohen në paragrafët e tjerë të të njëjtit

nen. Në bazë të nenit 5.1 të Vendimit 2011/273, Këshilli hartoi listën e këtyre personave.

Po kështu, Këshilli miratoi, në bazë të nenit 215.2 TFBE-së dhe Vendimit 2011/273, Rregulloren (BE) nr. 442/2011, të 9 majit 2011, në lidhje me masat kufizuese për shkak të situatës në Siri. Neni 4.1 i saj parashikon ngrirjen e të gjitha fondeve dhe burimeve ekonomike që u përkasin personave fizikë ose juridikë, subjekteve dhe organeve të renditura në Shtojcën II, që janë në pronësi, që mbahen ose kontrollohen prej tyre.

Me Vendimin e Këshillit 2011/684/CFSP, të 13 tetorit 2011, për ndryshimin e Vendimit 2011/273, CBS u përfshi në Shtojcën II të Vendimit 2011/273, me arsyetimin e mëposhtëm: “Bankë shtetërore që siguron mbështetje financiare për regjimin”.

Me Vendimin e Këshillit 2011/782/CFSP, të 1 dhjetorit 2011, në lidhje me masat kufizuese kundër Sirisë dhe shfuqizimin e Vendimit 2011/273, masat kufizuese në lidhje me CBS ngelën në fuqi, dhe CBS u përfshi në shtojcën II të vendimit 2011/782.

Me Vendimin Zbatues të Këshillit 2012/37/CFSP, të 23 janarit 2012, që zbaton Vendimin 2011/782, në Shtojcën I të vendimit 2011/782 u shtua edhe emri i bankës parashtruese, me arsyetimin: “Filiali i [CBS] që figuron tashmë në listë. Kontribuon në financimin e regjimit”.

Me Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 1011/2011, të 13 tetorit 2011, për ndryshimin e Rregullores Nr. 442/2011, CBS u shtua në Shtojcën IIa të Rregullores Nr. 442/2011, me të njëjtin motivim si ai i vendimi 2011/684.

Me Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 36/2012, të 18 janarit 2012, në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Siri dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 442/2011, masat kufizuese në lidhje me CBS ngelën në fuqi, dhe emri i saj figuronte në Shtojcën II të Rregullores Nr. 36/2012.

Me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (BE) nr. 55/2012, të 23 janarit 2012, duke zbatuar nenin 32.1 të Rregullores nr. 36/2012, emri i parashtrueses iu shtua Shtojcës II Rregullorja nr. 36/2012, me të njëjtin arsyetim si ai i Vendimit Zbatues 2012/37.

Më 24 janar 2012, Këshilli i dërgoi parashtrueses një letër në të cilën thuhet si më poshtë:

“Ne ju njoftojmë se Këshilli [...] ka vendosur që kompania juaj të përfshihet në listën e personave dhe subjekteve që përfshihen në Shtojcën I të vendimit 2011/782, të zbatuar me Vendimin e zbatimit 2012/37, dhe në Shtojcën II të Rregullores Nr. 36/2012, e zbatuar nga Rregullorja Zbatuese Nr. 55/2012. Arsyet që justifikojnë përfshirjen tuaj në këtë listë janë përmendur në shënimet përkatëse në shtojcat në fjalë. Ju do të gjeni të bashkangjitur një kopje të vendimit zbatues dhe rregulloreve zbatuese që regjistrojnë kompaninë tuaj në listën e lartpërmendur [...]”

Ankuesja e pranoi marrjen e kësaj letre më 8 shkurt 2012.

Më 24 janar 2012, Këshilli publikoi gjithashtu në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian njoftimin në vëmendje të personave dhe subjekteve, ndaj të cilave zbatohen masat kufizuese të parashikuara në Vendimin 2011/782, të zbatuara me Vendim. Rregullorja Zbatuese 2012/37, dhe në Rregulloren nr. 36/2012, të zbatuar nga Rregullorja Zbatuese nr. 55/2012.

Sipas këtij njoftimi, personat dhe subjektet e interesuara mund t'i paraqesin Këshillit një kërkesë për rishikimin e vendimit, me të cilin u përfshinë në listat që i bashkëngjiten akteve të përmendura në pikën 12 më sipër, duke paraqitur dokumentet mbështetëse.

Me 15 shkurt 2012, parashtruesja i dërgoi Këshillit një kërkesë për rishikim, me anë të së cilës, nga njëra anë, ajo kundërshtoi pjesëmarrjen në financimin e regjimit sirian dhe, nga ana tjetër, ajo kërkoi qasje në provat në dispozicion të Këshillit në lidhje me të, si dhe një seancë dëgjimore. Në mungesë të një përgjigjeje nga Këshilli, parashtruesja e përsëriti këtë kërkesë më 4 prill 2012.

Më 3 korrik 2012, Këshilli i komunikoi ankueses ekstraktin nga shënimi i Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit për delegacionet e shteteve anëtare të cilave iu ishte bashkangjitur dokumenti, i cili shërbeu si

bazë për përfshirjen e saj në listën e personave të përfshirë në masat kufizuese në lidhje me Sirinë (në tekstin e mëtejshëm: “dokumentet e komunikuar më 3 korrik 2012”) dhe, së dyti, refuzoi organizimin e një seance dëgjimore pasi mundësia e paraqitjes së vëzhgimeve me shkrim konsiderohej e mjaftueshme. Më 7 nëntor 2012, parashtruesja kërkoi një rishikim të mëtejshëm të situatës së saj.

Me Vendimin e Këshillit 2012/739/CFSP të 29 nëntorit 2012 në lidhje me masat kufizuese kundër Sirisë dhe shfuqizimin e Vendimit 2011/782, masat kufizuese ndaj parashtrueses dhe CBS ngelën në fuqi, dhe të dy kompanitë u përfshinë respektivisht në Shtojcat IB dhe II të Vendimit 2012/739. Sipas nenit 31 të Vendimit 2012/739, këto masa zbatoheshin deri më 1 mars 2013.

Me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (BE) nr. 1117/2012, të 29 nëntorit 2012, për zbatimin e nenit 32 (1) të Rregullores nr. 36/2012 (Fletoren Zyrtare L 330, f. 9), emrat e personave të tjerë janë shtuar në Shtojcën II të Rregullores nr. 36/2012 ndërsa emri i një personi është hequr nga ai person.

E njëjta procedurë si ajo e përshkruar në paragrafët 10-14 më lart u zhvillua edhe në lidhje me këtë rregullore të 29 nëntorit 2012. Më 6 mars 2013, Këshilli iu përgjigj kërkesës së parashtrueses duke e njoftuar, nga njëra anë, se mbajtja e saj në listat e personave të prekur nga masat kufizuese kundër Sirisë ishte e bazuar në dokumentet, një kopje të të cilave ajo e kishte marrë tashmë dhe, nga ana tjetër, se nuk kishte asnjë detyrim për ta thirrur në një seancë dëgjimore.

Vendimi i Gjykatës

Gjatë procedurës para Tribunalit, SLCB, ndër të tjera, dëshironte t'i ndryshonte vëzhgimet e saj në funksion të tekstit të rregullores zbatuese, të miratuar pas paraqitjes së ankesës. Kjo rregullore, e cila konfirmoi mbajtjen e emrit të SLCB në listë, u botua në Fletoren Zyrtare (Fletoren Zyrtare) së bashku me një njoftim që synonte të informonte personat e interesuar (përfshirë SLCB) për faktin se emri i tyre vazhdonte të ishte në atë listë. Këshilli e kundërshtoi këtë ndryshim, duke argumentuar se nuk ishte paraqitur brenda dy muajve nga publikimi i njoftimit.

Tribunali vërejtë para së gjithash se Këshilli nuk ishte në pamundësi t'i komunikonte rregulloret zbatuese SLCB-së, meqë ai tashmë i kishte komunikuar akte të tjera në të kaluarën parashtrueses dhe se ishte informuar për adresën e përfaqësuesve të saj. Më tej, Tribunali kujtoi se, në çdo rast, Rregullorja e Procedurës e Këshillit parashikon një periudhë shtesë prej katërmbëdhjetë ditësh për ngritjen e një padie kundër dokumenteve të botuara në Fletoren Zyrtare. Në këtë drejtim, ai konsideron se kjo periudhë shtesë zbatohet për ankesat e bëra jo vetëm kundër akteve, por edhe kundër njoftimeve të botuara në Fletoren Zyrtare. Në të vërtetë, objektivi i periudhës katërmbëdhjetë ditore, i cili konsiston në garantimin e një periudhe të mjaftueshme kohore për palët e interesuara për të paraqitur ankesë kundër dokumenteve të publikuara, zbatohet me analogji edhe me njoftimet. Prandaj, kjo periudhë duhet të zbatohet kur momenti që bën të fillojë periudha e apelimit është një njoftim i botuar në Fletoren Zyrtare, i cili lidhet me një akt të botuar në Fletoren Zyrtare.

Pasi e shpalli të pranueshme padinë, Tribunali konstatoi se Këshilli e kishte respektuar detyrimin e tij për të deklaruar arsyet. Në të vërtetë, pjesa e parë e arsyetimit (lidhja në kapitale midis SLCB dhe CBS) është e mjaftueshme për të vërtetuar se SLCB është futur në listë për shkak të statusit të saj si një degë e CBS. Edhe duke supozuar se pjesa e dytë e motivimit, që ka të bëjë me pjesëmarrjen në financimin e regjimit, nuk është mjaft e saktë, pjesa e parë e motivimit është e mjaftueshme në vetvete për të qenë në gjendje të arrihet në përfundimin se Këshilli ka përmbyshur detyrimin e tij për të deklaruar arsyet.

Tribunali vërejtë në vijim se Këshilli ishte në gjendje të merrte parasysht, me të drejtë, se SLCB është përfshirë, të paktën në mënyrë indirekte, në financimin e regjimit sirian. Sipas tij, fakti që kapitali i SLCB kontrollohet në 84.2% nga CBS, gjë që i lejon kësaj të fundit të kontrollojë asamblenë e përgjithshme të SLCB, dhe se CBS ofron mbështetje financiare, si një bankë në pronësi të plotë të shtetit, për regjimin në atë vend është padyshim një lidhje me personat që e mbështesin atë regjim. Për më tepër, lidhja e kapitalit midis këtyre dy bankave nuk vihet në dyshim nga fakti se aktivitetet e SLCB i nënshtrohen kontrollit të Bankës së Libanit, duke pasur parasysht se ky kontroll ka të bëjë me fondet në dispozicion të SLCB në Liban, dhe jo brenda Bashkimit Evropian.

Gjykata gjithashtu vërejtë se, me miratimin e masave kufizuese, Këshilli nuk ka shkelur as të drejtat e mbrojtjes, as të drejtën për mbrojtje efektive gjyqësore. Tribunali vërejtë se, pas përfshirjes së saj në listë, SLCB u informua për arsyet e përfshirjes së saj në listë dhe u ftua të paraqiste vëzhgimet e saj. Fakti që ky komunikim u bë pas regjistrimit të parë në listë nuk mund të konsiderohet në vetvete si shkelje e të drejtave të mbrojtjes. Në të vërtetë, një komunikim i tillë paraprak i arsyeve mund të rrezikojë efektivitetin e masave për ngrirjen e fondeve dhe burimeve ekonomike, ndërsa këto masa duhet të përfitojnë nga një efekt befasues dhe të zbatohen me efekt të menjëhershëm. Është e qartë se SLCB-së iu mundësua të mbrojë veten në mënyrë efektive kundër akteve në fjalë, pasi ishte në gjendje të paraqiste qëndrimet e saj para Këshillit dhe Tribunalit. Përveç kësaj, Këshilli nuk ndryshoi arsyetim për masat kufizuese në lidhje me SLCB, por vazhdoi të mbështetet në lidhjen ekzistuese në kapitale midis kësaj të fundit dhe CBS.

Neni 33

Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.

3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.

4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI86/18. PARASHTRUES: NASER AVDYLI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/06/ki_37_18_av_shq.pdf]

11 qershor 2018

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Kërkesa kishte të bënte me dënimin me burgim të parashtruesit të kërkesës për veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupin terrorist, vepra këto të kryera në territorin e Sirisë dhe Jordanisë. Çështja kushtetuese e ngritur nga parashtruesi përmes kërkesës kushtetuese ishte se a i ish-in shkelur parashtruesit të kërkesës të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës) dhe parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale (neni 33 i Kushtetutës), sepse vepra penale për të cilën ai u dënua nuk ishte kryer në territorin e Republikës së Kosovës, por në territorin e Sirisë.

Faktet kryesore

Në vitin 2014, parashtruesi i kërkesës ishte privuar nga liria. Më 7 maj 2015, Prokurori Special kishte parashtruar aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesës, për kryerjen e veprës penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”. Gjatë shqyrtimit në Gjykatën Themelore, parashtruesi kishte deklaruar se, qëllimi i udhëtimit të tij në Siri kishte qenë që të merrte disa dokumente nga Universiteti i Damaskut, ku ai kishte studiuar deri në vitin 2004. Sipas tij, gjatë udhëtimit të tij përmes Sirisë ai rastësisht kishte përfunduar me ushtarët e lëvizjes “Al Nusra”, të cilët më pas e kishin detyruar të përfundonte stërvitjet ushtarake. Më 29 prill 2015, Gjykata Themelore e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me 4 vjet e 6 muaj burgim. Gjykata Themelore gjeti se qëllimi i shkuarjes së të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) në Jordani dhe më vonë në Siri nuk kishte qenë që të regjistrohej në fakultet, sepse ai nuk kishte ofruar ndonjë dokument apo provë që do

të dëshmonte këtë, por ai kishte pasur për synim bashkimin me grupin terrorist "Al Nusra". Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Më 4 maj 2016, Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, theksohej se matja e dënimeve të shqiptuara ndaj të akuzuarve ishte bërë në pajtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit konform Kodit Penal, kështu që dënimet e shqiptuara ndaj tyre ishin në përpjesëtim me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme dhe, më 18 dhjetor 2017 Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

Më 9 mars 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me aktvendimin e kontestuar i ish-in shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]. Parashtruesi mbështeti pretendimet e tij në argumentin se sipas dispozitave të nenit 143.2 të Kodit Penal parashihet që vepra penale e organizimit dhe pjesëmarrja në një grup terrorist përbën një vepër penale nëse kryhet ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kosovës dhe jo në territorin e Sirisë apo të Jordanisë, të cilat nuk janë nën juridiksionin e sistemit juridik të Kosovës. Sipas parashtruesit, neni 33 i Kushtetutës [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] në ndërlidhje me nenin 7 të KEDNJ-së (Nuk ka dënim pa ligj), ish-in shkelur sepse ato përcaktojnë se askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vuri në pah se parashtruesi i kërkesës konsideroi se Gjykata Themelore kishte vërtetuar gabimisht gjendjen

faktike dhe nuk kishte dhënë arsye të duhura lidhur me vlerësimin e provave të paraqitura, që çuan në përfundimin e gabuar se ai kishte kryer veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”. Në lidhje me këtë, Gjykata sqaroi se nuk ishte detyrë e saj të shqyrtonte gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht apo zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, përveç nëse viheshin në pikëpyetje të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, Gjykata sqaroi se ajo nuk mund të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk ishte kompetente për të zëvendësuar gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, të cilat ato i kishin administruar.

Gjykata Kushtetuese gjeti se Gjykata Themelore e kishte përshkruar plotësisht procesin e vlerësimit të provave, duke i sjellë ato në lidhje të ndërsjellë dhe nxjerrjen e përfundimeve se parashtruesi kishte kryer veprën penale për të cilën ai ishte akuzuar. Sipas Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Themelore kishte arsyetuar mjaftueshëm vendimin e saj, vendim ky që ishte konfirmuar nga gjykatat e shkallës më të lartë. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar dhe vërtetuar ndonjë arbitraritet në vërtetimin e fakteve dhe në zbatimin e së drejtës materiale në vendimet e kontestuara. Gjykata sqaroi se ishte obligim i parashtruesit të kërkesës që të paraqesë prova *prima facie* që dëshmojnë për shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (d) dhe 2(d) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi që të shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. JORGIC kundër GJERMANISË

[74613/01]

[Seksioni i Pestë]

12 tetor 2007

***Çështja kyçele drejta e pretenduar:** shkelje e parimit Nullum crimen sine lege se përkufizimi i veprës penale të gjenocidit i përdorur nga gjykatat vendase ishte tepër i gjerë; shkelje e së drejtës në gjykatë të krijuar me ligj sepse gjykatat gjermane nuk kishin juridiksion për të gjykuar për vepra të rënda, përfshirë gjenocidin, të kryera në Bosnjë.*

Faktet kryesore

Kërkuesi ka lindur në vitin 1946. Në momentin e parashtrimit të kërkesës, ai mbahej i burgosur në Bohum (Gjermani). Në vitin 1969, kërkuesi shtetas i Bosnjë dhe Hercegovinës me origjinë serbe, hyri në Gjermani, ku qëndroi legalisht deri në fillimin e vitit 1992. Ai u kthye më pas në Kostajnicë, në qytetin e Dobozhit (Bosnjë), vendlindjen e tij. Më 16 dhjetor 1995, nën dyshime thellësisht të bazuara për kryerjen e akteve të gjenocidit, ai u ndalua tekta hynte në Gjermani dhe u vendos në burgim të përkohshëm. Me anë të një vendimi të 26 shtatorit 1997, Gjykata e Apelit e Dyseldorfit e shpalli kërkuesin fajtor për njëmbëdhjetë akuza gjenocidi (neni 220a nr. 1 dhe 3 të Kodit Penal), për vrasjen e njëzet e dy personave në njërën çështje, të shtatë të tjerëve në një tjetër dhe të një personi tjetër në një çështje të tretë, dhe për shumë akuza goditjesh dhe dëmtimesh të rrezikshme si edhe për sekuestrim në çështjet e tjera. Gjykata e Dyseldorfit e dënoi me masën e sigurisë burgim të përjetshëm, duke theksuar rëndësinë e veçantë të fajësisë së tij.

Më 30 prill 1999, pas një seance gjyqësore, Gjykata Federale e Drejtësisë, së cilës i ishte drejtuar me padi kërkuesi, e shpalli këtë të fundit fajtor për akuzën e gjenocidit si edhe për tridhjetë akuza vrasjeje. Ajo e dënoi

me burgim të përjetshëm dhe theksoi rëndësinë e veçantë të fajësisë së tij.

Më 12 dhjetor 2000, Gjykata Kushtetuese Federale refuzoi të shqyrtonte ankesën kushtetuese të kërkuesit. Ajo çmoi se juridiksionet penale nuk kishin shkelur asnjë dispozitë tjetër ligjore të Ligjit Themelor duke u shpallur kompetente për gjykimin e çështjes në përputhje me nenin 6 nr. 1 të Kodit Penal të kombinuar me nenin VI të Konventës mbi gjenocidin. Më 3 korrik 2002, Gjykata e Apelit e Dyseldorfit shpalli të papranueshme kërkesën për rihapjen e procedurës të parashtruar nga kërkuesi. Ajo vërejtë se fakti që njëri prej dëshmitarëve të cilin e kishte marrë në pyetje, i cili ishte i vetmi që kishte pohuar se e kishte parë parashtruesin të vriste njëzet e dy persona në Grabska, u dyshua për betim të rremë, nuk e përlligjte rihapjen e procesit, përderisa edhe nëse do të supozohej se ky dëshmitar i kishte sajuar pretendimet e ngritura ndaj kërkuesit, ky i fundit do të meritonte gjithsesi dënimin e burgosjes së përjetshme për gjenocid dhe tetë akuza të tjera vrasjeje. Me një vendim të 20 dhjetorit 2002 i dorëzuar më 28 janar 2003, Gjykata Federale e Drejtësisë e shpalli të pranueshme kërkesën e rihapjes së procesit të parashtruar nga kërkuesi, për pjesën që kishte të bënte me vrasjen e njëzet e dy personave në Grabska. Më 28 shkurt 2003, kërkuesi paraqiti një ankesë kushtetuese në të cilën thoshte se vendimet e Gjykatës së Apelit të Dyseldorfit dhe të Gjykatës Federale të Drejtësisë në lidhje me rihapjen e procesit të tij kishin shkelur të drejtën e lirisë të garantuar nga Ligji Themelor. Ai argumentonte se ishte gabim që ato kishin vendosur se, në kuadër të rihapjes së çështjes, çështja e rëndësisë së veçantë e fajësisë së tij nuk duhej të shqyrtohej përsëri. Por më 22 prill 2003, Gjykata Kushtetuese Federale refuzoi të pranojë ankesën kushtetuese të kërkuesit. Më 21 qershor 2004, Gjykata e Apelit e Dyseldorfit vendosi të hapë përsëri procedurën në lidhje me dënimin e kërkuesit për vrasjen me plumb të njëzet e dy personave në Grabska. Ajo konstatoi se i vetmi dëshmitar, i cili thoshte se kishte qenë i pranishëm në këto vrasje, ishte shpallur fajtor për deklaram të rremë nën betim, të paktën, për disa deklarime të tjera dhe shpalli se nuk mundej rrjedhimisht të përjashtonte mundësinë që, gjyqtarët që kishin gjykuar asokohe çështjen ta kishin liruar kërkuesin nga kjo akuzë, në rast se do ta kishin ditur se dëshmitari në fjalë kishte dhënë një sërë dëshmish të rreme. Gjithashtu, Gjykata e Apelit vendosi të ndërpresë procedurën lidhur me akuzat, në raport me të cilat ishte

pranuar kërkesa për rihapjen e procesit. Ajo çmoi se dënimi që duhej t'i jepej kërkuarit, nëse do të shpallej përsëri fajtor për vrasjen e njëzet e dy personave në Grabska, nuk do të kishte qenë konsiderueshëm më i rëndë se dënimi përfundimtar, që i ishte dhënë tashmë për gjenocid. Si rrjedhojë, vendimi i 26 shtatorit 1997 ruajti vlefshmërinë e tij në lidhje me gjenocidin dhe tetë akuzat për vrasje, si dhe në lidhje me nxjerrjen në pah të rëndësisë së veçantë të fajësisë së kërkuarit.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuari u ankua për shkelje të pretenduar të nenit 5.1 a) dhe 6.1 të Konventës në lidhje me dënimin e tij për gjenocid, të shpallur nga Gjykata e Apelit e Dyseldorfit dhe të vërtetuar nga Gjykata Federale e Drejtësisë si dhe nga Gjykata Kushtetuese Federale, të cilat, sipas tij, nuk ishin kompetente për të shqyrtuar çështjen e tij, as burgosjen e tij të mëtejshme. Në mbështetje të pretendimeve, kërkuari theksoi se ekziston një rregull e përgjithshme e së drejtës ndërkombëtare publike, përkatësisht parimi i mosndërhyrjes, që u ndalon normalisht juridiksioneve gjermane gjykimin e një të huaji rezident jashtë shtetit për fakte gjenocidi, të cilat dyshohet se i ka kryer në një shtet të huaj kundër viktimave të huaja. Kërkuari argumentoi në veçanti se në pajtim me nenin VI të Konventës për Gjenocidin, personat e akuzuar për gjenocid mund të gjykohen vetëm nga juridiksionet e shtetit, në territorin e të cilit është kryer akti apo nga një juridiksion ndërkombëtar. Kërkuari e pranoi se parimi i kompetencës universale, i njohur nga e drejta ndërkombëtare publike zakonore, mund, në teori, t'i lejojë një juridiksion kombëtar, përveç atij të përcaktuar me nenin VI të Konventës për Gjenocidin, të ushtrojë kompetencën e saj. Ai theksoi gjithsesi se mundësia që ka një juridiksion për t'u shpallur kompetent për mbështetjen në këtë parim, i cili i shmanget parimit të mosndërhyrjes, nuk njihet as nga e drejta ndërkombëtare e traktateve, as nga e drejta ndërkombëtare zakonore, atëherë kur bëhet fjalë për gjykimin e personave të akuzuar për gjenocid. Juridiksionet gjermane kësajsoj kanë dëshmuar arbitraritet duke u shpallur kompetente për çështjen.

Për Qeverinë, juridiksionet gjermane ishin njëkohësisht «tribunal[et] kompetent[e]», në kuptimin e nenit 5.1 a) të Konventës, për të shpallur

kërkuesin fajtor dhe «tribunal[e] të përcaktuar[a] nga ligji», në kuptimin e nenit 6.1. Qeveria vuri në pah se kërkuesi kishte jetuar në Gjermani për vite me radhë, se ishte ende banor zyrtar i saj dhe se ishte ndaluar në tokën gjermane. Ajo theksoi gjithashtu se Gjermania kishte marrë pjesë në misionet ushtarake dhe humanitare të organizuara në Bosnjë-Hercegovinë.

Qeveria theksoi gjithashtu se dispozitat e së drejtës gjermane në lidhje me kompetencën janë në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare publike. Në veçanti, ashtu si kjo është treguar në mënyrë bindëse nga juridiksionet gjermane, neni VI i Konventës për Gjenocidin, i cili parashtron kërkesat minimale që lidhen me detyrimin për të gjykuar faktet e gjenocidit, nuk u ndalon tribunaleve të një shteti tjetër nga ai në territorin e të cilit janë kryer faktet e gjenocidit, t'i gjykojë ato fakte.

Kërkuesi pretendoi edhe shkelje të nenit 6.1 dhe 3 d) të Konventës sepse sipas tij Gjykata e Apelit e Dyseldorfit duke refuzuar, në mbështetje të nenit 244.5 të Kodit Penal, të thërrasë në gjyq dëshmitarët e të akuzuarit, të cilët duhet të thirreshin nga jashtë, ai nuk ka përfituar nga një proces i bazuar në drejtësi sipas kuptimit të nenit 6.1 dhe 3 d) të Konventës. Ai gjithashtu u ankua se Gjykata e Apelit kishte refuzuar inspektimin e vendeve të supozuara të krimit, në Grabska, apo për të hartuar një plan të tyre. Qeveria e kundërshtoi këtë pretendim dhe theksoi se kërkuesi nuk i ka shteruar rrugët e brendshme të ankesës së tij në lidhje me refuzimin e Gjykatës së Apelit për të thirrur në gjyq njëzet e tetë dëshmitarë përderisa, gjithashtu theksoi se kërkuesi nuk mund të pretendojë se është ende viktimë e shkeljes së të drejtave të garantuara nga Konventa dhe se kërkesa e tij është e papajtueshme *ratione personae* dhe se e drejta për një proces të bazuar në drejtësi të garantuar nga neni 6 i Konventës nuk është shkelur në çështjen e kërkuesit.

Kërkuesi iu referua edhe shkeljes së nenit 6.1 dhe 3 d) të Konventës për faktin se Gjykata e Apelit, duke u mbështetur në fjalinë e dytë të nenit 244.5 të Kodit të Procedurës Penale, kishte refuzuar të thërrasë njëzet e tetë dëshmitarë të të akuzuarit, rezidentë jashtë shtetit, të cilët i kishte thirrur në gjyq, ndërkohë që ftoi dhe mori në pyetje jashtë dëshmitarë të thirrur nga akuza, të cilët po ashtu ndodheshin jashtë shtetit. Po

kështu edhe zbatimi i nenit 244.5 të Kodit të Procedurës Penale ka qenë arbitrar. Sipas mendimit të kërkuiesi, në rast se Gjykata e Apelit do të kishte ftuar dëshmitarët e propozuar nga ai në gjyq, ajo do të kishte vendosur menjëherë se dëshmitari i akuzës, për shkeljet e pretenduara në Grabska, nuk e kishte thënë të vërtetën.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 7 të Konventës, kërkuiesi theksoi se interpretimi i gjerë i nocionit të krimit të gjenocidit, i miratuar nga juridiksionet gjermane, nuk gjen asnjë mbështetje në hartimin e dispozitave të së drejtës gjermane dhe të së drejtës ndërkombëtare publike në lidhje me këtë shkelje, dhe se në mënyrë arbitrare gjyqtarët gjermanë kanë vendosur se fajësia e tij ishte veçanërisht e rëndë. Dënimi i tij ka rezultuar kështu me shkelje të nenit 7.1 të Konventës. Kërkuiesi tutje argumentoi se, për të shpallur një dënim për gjenocid sipas domethënies së nenit 220a të Kodit Penal, duhet që të jetë provuar qëllimi për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, racor, etnik ose fetar si të tillë. Kërkuiesi gjithashtu theksoi se interpretimi i bërë nga ana e juridiksioneve gjermane për nocionin e “qëllimit për të shkatërruar” sipas nenit 220a, i cili është përfshirë në Kodin Penal për të futur aty dispozitat e Konventës për Gjenocidin në të drejtën kombëtare, është i ndryshëm me interpretimin e të njëjtit nocion, që shfaqet në nenin II të kësaj Konvente, e cila ka vlerë ligjore brenda bashkësisë së shteteve.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 5.1 a) dhe 6.1 të Konventës, Gjykata vërejti se juridiksionet gjermane e kanë mbështetur kompetencën e tyre në nenin 6 nr. 1 dhe në nenin 220a të Kodit Penal, të marra së bashku (në versionet në fuqi në atë kohë). Në përputhje me këto dispozita, e drejta penale gjermane ishte zbatuar, dhe, për rrjedhojë, juridiksionet gjermane kanë qenë kompetente për të gjykuar personat e akuzuar për akte gjenocidi të kryera jashtë shtetit, pavarësisht nga kombësitë përkatëse të të akuzuarit dhe të viktimave. Kështu, vendimi i juridiksioneve të brendshme për t’u shpallur kompetente për gjykimin e kërkuiesit ka qenë në përputhje me brendinë e qartë të dispozitave vepruese të Kodit Penal. Duke qenë kështu, Gjykata duhej të përcaktonte edhe nëse një vendim i tillë ka qenë në përputhje me dispozitat e së drejtës ndërkombëtare publike të

zbatueshme në Gjermani. Ajo vërejtje në këtë drejtim se juridiksionet e brendshme kanë vendosur se parimi i kompetencës universale, i njohur nga e drejta ndërkombëtare publike e që gjendet i përfshirë në nenin 6 nr. 1 të Kodit Penal u ka mundësuar të shpallen kompetente, me kusht të respektimit të parimit të mosndërhyrjes, të parashtruar nga e drejta ndërkombëtare publike.

Për të përcaktuar nëse interpretimi i bërë nga ana e juridiksioneve të brendshme për rregullat dhe dispozitat e së drejtës ndërkombëtare publike të zbatueshme për çështjen e kompetencës ka qenë i arsyeshëm, Gjykata duhet gjithashtu të shqyrtojë interpretimin e dhënë për nenin VI të Konventës për Gjenocidin. Në këtë drejtim, ajo vëzhgoi, ashtu siç kanë bërë edhe juridiksionet e brendshme, se Palët kontraktuese të Konventës për Gjenocidin nuk ishin dakorduar, përkundër propozimeve e versioneve të para të tekstit, për të përfshirë në këtë nen parimin e kompetencës universale të juridiksioneve të brendshme të të gjitha shteteve kontraktuese për të shqyrtuar faktet e gjenocidit. Gjithsesi, në përputhje me nenin 1 të Konventës për Gjenocidin, palët kontraktuese kanë detyrimin *erga omnes* për të parandaluar dhe dënuar gjenocidin, ndalimi i të cilit i referohet *jus cogens*. Si rrjedhojë, arsyetimi i juridiksioneve kombëtare sipas të cilit, duke pasur parasysh qëllimin e Konventës për Gjenocidin, siç është shprehur konkretisht në këtë nen, kompetenca për të dënuar aktet e gjenocidit për shtetet, ligjet e të cilave, në këtë drejtim, parashikojnë eksterritorialitetin, duhet të konsiderohet si e arsyeshme (dhe madje bindëse).

Gjykata vendosi se interpretimi i bërë nga juridiksionet gjermane për dispozitat dhe rregullat e zbatueshme në të drejtën ndërkombëtare publike, në dritën e të cilave duhej të interpretoheshin dispozitat e Kodit Penal, nuk ka qenë arbitrare. Gjyqtarët gjermanë kishin rrjedhimisht motive të arsyeshme për t'u njohur si kompetentë për të gjykuar në lidhje me akuzat për gjenocid të cilat rëndonin mbi kërkuesin.

Që prej këtu rrjedh se çështja e kërkuesit ishte dëgjuar nga një tribunal i themeluar me ligj në kuptim të nenit 6.1 të Konventës. Kështu, nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

Duke mbajtur parasysh konkluzionin e mësipërm në lidhje me nenin 6.1, përkatësisht faktin që juridiksionet gjermane kanë vepruar në mënyrë

të arsyeshme duke u vlerësuar si kompetente për të gjykuar kërkuesin, Gjykata vendosi se burgimi dhe më pas dënimi i tij, i cili ishte shpallur pra “nga një tribunal kompetent”, ishte i rregullt në kuptimin e nenit 5.1 a) të Konventës. Rrjedhimisht, as këtu nuk ka shkelje të kësaj dispozite.

Në lidhje me nenin 6.1 a) dhe 3 d) të Konventës, Gjykata nuk e gjykoji të nevojshme për çështjen të vendosë në lidhje me përjashtimet e qeverive në lidhje me shterimin e rrugëve të brendshme të ankimimit, si edhe me cilësimin e kërkuesit si viktimë sepse, edhe në rast se supozohet se parashtruesi i ka shteruar të gjitha rrugët e brendshme të ankimimit dhe ende mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së nenit 6 të Konventës në të gjitha drejtimit, ajo vërejtje se kjo ankesë ishte në të gjitha aspektet e papranueshme.

Gjykata rikujtoi se u takon juridiksioneve kombëtare të çmojnë provat e mbledhura prej tyre dhe rëndësinë e atyre që të akuzuarit kërkojnë t'i paraqesin. Veçanërisht, neni 6.3 d) – i cili shpreh aspektet e veçanta të së drejtës në një proces të bazuar në drejtësi në nenin 6.1 – u lë atyre në parim kujdesin për të gjykuar. Ai nuk kërkon thirrjen dhe marrjen në pyetje të secilit prej dëshmitarëve të të akuzuarit. Gjithsesi, i takon Gjykatës të verifikojë nëse administrimi dhe vlerësimi i provave kanë shkelur parimin e një “barazie [të plotë] armësh” që do të njollose, rrjedhimisht, tërësinë e procedurave si të padrejta (shih, përkatësisht, *Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992, 33, seria A nr. 235-B, dhe *Heidegger kundër Austrisë* (vendim), nr. 27077/95, 5 tetor 1999).

Në lidhje me nenin 7 të Konventës, Gjykata kujtoi se garancia që jep neni 7 i Konventës është një element thelbësor për sundimin e së drejtës. Rrjedhimisht, ai nuk kufizohet vetëm në ndalimin e parimit të retroaktivitetit të së drejtës penale në dëm të të akuzuarit: ai shpreh gjithashtu, në mënyrë më të përgjithshme, parimin e ligjshmërisë së veprave penale dhe dënimeve (*nullum crimen, nulla poena sine lege*) dhe parasheh të mos interpretohet ligji penal në mënyrë ekstensive në dëm të të akuzuarit, për shembull përmes analogjisë. Prej këtu rrjedh se një shkelje duhet të përcaktohet shprehimisht nga ligji. Për sa i përket, së pari, përputhshmërisë së interpretimit të juridiksioneve gjermane me thelbin e shkeljes së gjenocidit, Gjykata vërejtje se gjyqtarët kombëtarë nuk kanë bërë një interpretim të ngushtë të këtij nocioni. Ata kanë konsideruar se

“qëllimi për të shkatërruar një grup” në kuptimin e nenit 220a të Kodit Penal, i interpretuar edhe në dritën e nenit II të Konventës për Gjenocidin, nuk kishte nevojë për qëllimin për të shkatërruar grupin në kuptimin fizik ose biologjik të termit: vullneti i autorit për ta shkatërruar atë si njësi shoqërore ishte më se i mjaftueshëm. Gjykata vërejti se juridiksionet e brendshme “qëllimit për të shkatërruar një grup si të tillë” i kanë bërë një interpretim sistemik, duke mbajtur parasysh nenin 220a.1 të Kodit Penal në tërësinë e tij, dhe në veçanti hipotezat nr. 4 (caktimi i masave që synojnë ndalimin e lindjeve brenda një grupi) dhe nr. 5 (transferimi i detyruar i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër) të kësaj dispozite, të cilat nuk përfshijnë shkatërrimin fizik të anëtarëve të gjallë të grupit në fjalë. Ajo konsideroi kështu se interpretimi – për më tepër i zbatuar edhe nga një numër i madh autorësh – i juridiksioneve të brendshme sipas të cilit “qëllimi për të shkatërruar një grup” nuk kishte nevojë për një shkatërrim fizik dhe është në pajtim me brendinë e dispozitës së Kodit Penal që e përkufizon krimin e gjenocidit të shkrirë në kontekstin e tij dhe nuk është i paarsyeshëm. Për më tepër, interpretimi i gjerë i nocionit të gjenocidit i bërë nga juridiksionet gjermane për çështjen, përkon me atë që mbronte një pjesë e doktrinës në epokën e kryerjes së akteve që inkriminojnë parashtruesin, por gjithashtu me atë të miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 47/121 të 18 dhjetorit 1992. Si rrjedhojë, mund të konsiderojmë në mënyrë të arsyeshme se interpretimi i bërë nga juridiksionet kombëtare për nocionin e gjenocidit është koherent me thelbin e kësaj shkeljeje dhe se ishte i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme në momentin e akteve. Për të gjitha këto kushte, u përkiste gjyqtarëve gjermanë të vendosnin për interpretimin e nocionit të gjenocidit, të cilët donin ta përshtatnin në të drejtën e brendshme. Kësisoj, dënimi i kërkuesit për gjenocid nuk ka rezultuar me shkelje të nenit i 7.1 të Konventës.

Për sa i përket ankesës tjetër të kërkuesit nga neni 7.1, sipas të cilit gjyqtarët kanë vendosur gabimisht se fajësia e tij ishte veçanërisht e rëndë, Gjykata vërejti se deklaratimet e kërkuesit në këtë drejtim kufizohen në një pretendim të gabimeve në fakte dhe në ligj. Ato nuk tregojnë as dukje të shkeljes së nenit 7.1, as shkelje të nenit 6.1 të Konventës. Gjykata vendosi rrjedhimisht se nuk ka pasur shkelje të nenit 7.1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi njëzëri se nuk ka pasur shkelje të neneve 5.1 a) dhe 6.1 të Konventës, se nuk ka pasur shkelje të nenit 7 të Konventës.

2.2. G.I.E.M. S.R.L. DHE TË TJERË kundër ITALISË

[1828/06, 34163/07 dhe 19029/11]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

28 qershor 2018

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: *Konfiskimi i detyrueshëm i tokës 'së zhvilluar në mënyrë të paligjshme', pavarësisht nga çdo përgjegjësi penale.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga tri kompani: (1) G.I.E.M. S.r.l.; (2) Byroja e Promovimit të Hoteleve S.r.l.; dhe (3) R.I.T.A. Sarda S.r.l. dhe (4) Falgest S.r.l. dhe drejtori i kompanisë së katërt (z. Gironda) (kompanitë kërkuese) kundër Republikës Italiane. Në bazë të ligjit italian të planifikimit, nëse konstatohet thelbësisht ekzistenca e veprës penale e 'zhvillimit të paligjshëm të truallit' ('Unlawful site development offence'), gjykata penale është e detyruar, pavarësisht nëse të pandehurit dënohen, të konfiskoje tokën e zhvilluar (dhe çdo ndërtesë mbi të), edhe nëse kjo është në zotërim të një pale të tretë (përveç rastit kur pretendohet të jetë vepruar në mirëbesim).

Kërkuesit u ankuan që ata ishin prekur nga masat e konfiskimit, pa qenë formalisht të dënuar (dhe as shoqëria dhe as drejtorët e tyre nuk ishin ndjekur penalisht; ose për shkak se vetëm drejtorët ishin ndjekur penalisht; ose për shkak se procedura penale ishte parashkruar – te rasti i z. Gironda).

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit parashtruan ankesat e mëposhtme:

(a) G.I.E.M. S.r.l pretendoi se kishte pasur shkelje të nenit 6.1, nenit 7 dhe nenit 13 të Konventës, si dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të konfiskimit të pasurisë së saj.

(b) Byroja e Promovimit të Hoteleve S.r.l. dhe R.I.T.A. Sarda S.r.l. pretenduan se kishte pasur shkelje të nenit 7 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të konfiskimit të pasurisë së tyre.

(c) Falgest S.r.l. dhe z. Girona pretendoi se kishte pasur shkelje të neneve 7 dhe 13 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, për shkak të konfiskimit të pronës së tyre. Z. Girona argumentoi gjithashtu se neni 6.2 i Konventës (prezumimi i pafajësisë) ishte shkelur.

Njoftimi për ankesat sipas neneve të lartpërmendura i është dorëzuar Qeverisë, përkatësisht më 30 mars 2009 për Kërkesën nr. 1828/06, më 5 qershor 2012 për Kërkesën nr. 34163/07 dhe më 30 prill 2013 për Kërkesën nr.19029/11. Kërkesat nr. 34163/07 dhe 19029/11 janë shpallur të papranueshme në lidhje me ankesat e tjera të paraqitura aty.

Më 17 shkurt 2015 Dhoma e Seksionit të Dytë e rekomandoi delegimin e rastit në Dhomën e madhe.

Sa i përket mundësisë së mbështetjes në nenin 4 të Ligjit Nr. 102, të 3 gushtit 2009, përfaqësuesi i kompanisë parashtruese G.I.E.M. S.r.l. u ankua se mjeti juridik në fjalë, që përcakton kriteret për vlerësimin e pronës së paluajtshme që do të kthehej pas një vendimi të gjykatës që konstatoi se konfiskimi shkelte Konventën, ishte i paefektshëm. Ata shpjeguan se, në rastin e klientit të tyre, toka e konfiskuar ishte kthyer tashmë më 2013 dhe, meqenëse nuk kishte ndërtime në atë tokë, nuk do të ishte e mundur të merrte ndonjë kompensim.

Përfaqësuesit e kompanisë parashtruese, Falgest S.r.l., deklaruan se një kërkesë ndërmjetme për rishikimin e urdhrin të përmbartimit do ta kishte lejuar atë vetëm të ngrinte pyetje që lidheshin me ekzistencën,

zbatimin, fushëveprimin dhe legjitimitetin material dhe procedural të urdhrorit, duke përjashtuar kështu një vlerësim të ri të fakteve nga gjyqtari përmbarues. Ata arritën në përfundimin se, edhe nëse kompania kërkuese do ta kishte përdorur këtë mjet juridik, ajo nuk do të kishte sukses në rikthimin e pronës së konfiskuar. Meqenëse nuk mund të siguronte korrigjimin e duhur, kërkesa ndërmjetësuese nuk ishte një zgjidhje efektive sipas kuptimit të nenit 35 .1 të Konventës.

Kompanitë parashtruese, Byroja për Promovimin e Hoteleve S.r.l. dhe R.I.T.A. Sarda S.r.l., nga ana e tyre, pyetën, në thelb, nëse kërkesa e ndërmjetme për rishikimin e urdhrorit të ekzekutimit ishte një mjet efektiv.

Qeveria ngriti kundërshtime paraprake në lidhje me të tri kërkesat. Sa i përket kompanisë së parë kërkuese, G.I.E.M S.r.l., Qeveria vuri në dukje se e kishte informuar Gjykatën gjatë procedurave të Dhomës, se para se të paraqiste kërkesën e saj në Strasburg, kompania kërkuese G.I.E.M S.r.l., kishte filluar procedurën në Gjykatën e Qarkut të Barit duke kërkuar kompensim të dëmit.. Sa i përket kompanisë kërkuese Falgest S.r.l., Qeveria kundërshtoi duke theksuar se mjetet juridike vendase nuk ishin shteruar pasi që, siç dëshmohet nga veprimi i suksesshëm i G.I.E.M. Srl, kompania kërkuese, në përputhje me nenin 676 të Kodit të Procedurës Penale, ka mundur dhe është dashur të paraqesë një kërkesë ndërmjetme për rishikimin e urdhrorit të ekzekutimit (neni 665 i Kodit të Procedurës Penale) dhe të kërkojë nga gjyqtari përmbarues që t'ia rikthejë titullin mbi pronën e konfiskuar.

Qeveria përsëriti kundërshtimin e saj për mosshkrim, tashmë të ngritur në lidhje edhe me kompaninë kërkuese G.I.E.M. S.r.l., duke shpjeguar se kjo kompani nuk e kishte përdorur mjetin juridik të parashikuar nga seksioni 4 i Ligjit Nr. 102, të 3 gushtit 2009.

Së fundmi, në lidhje me Byronë e Promovimit të Hotelit S.r.l. dhe R.I.T.A. Sarda S.r.l., Qeveria përsëriti argumentet e saj mbi nevojën për të paraqitur një kërkesë ndërmjetësuese për rishikimin e urdhrorit të ekzekutimit.

Qeveria përfundimisht parashtrroi se kërkesa duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 35.1 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 7 të Konventës

(a) Zbatueshmëria - Një rishikim i çështjes nën dritën e kriterëve të mëposhtme bëri që Dhoma e Madhe të konfirmojë përfundimin e arritur nga Dhoma në çështjen *Sud Fondi srl dhe të Tjerë kundër Italisë* (vendim) (75909/01, 30 gusht 2007, Shënimi Informativ 100): meqenëse masat e konfiskimit mund të konsideroheshin si 'sanksione penale' në kuptimin e nenit 7 të Konventës, ky nen ishte i zbatueshëm, edhe në mungesë të procedurës penale për qëllimet e nenit 6. Ky përfundim nuk përjashtoi mundësinë e autoriteteve të brendshme për të vendosur 'penalitetet' (brenda kuptimit autonom të atij koncepti) nëpërmjet procedurave të ndryshme nga ato të klasifikuara si 'penale' sipas ligjit të brendshëm. Në vlerësim të asaj se:

(i) A ishin vendosur konfiskimet pas dhënies së fajësisë për veprat penale? - Megjithëse më parë nuk ishte dhënë asnjë dënim penal në ngarkim të kompanive kërkuese ose përfaqësuesve të tyre, masa e kundërshtuar e konfiskimit ishte megjithatë e lidhur me një 'vepër penale' bazuar në dispozitat penale të përgjithshme. Sidoqoftë, një përfundim i ndryshëm në lidhje me këtë kriter në vetvete nuk do të ishte përfundimtar.

(ii) Kualifikimi i konfiskimit në ligjin e brendshëm - Neni 44 i Kodit të Ndërtimit, që rregullon masat e konfiskimit në fjalë në këtë çështje, përcaktohej në: 'Sanksione penale'.

(iii) Natyra dhe qëllimi i masës së konfiskimit - Natyra dhe qëllimi i konfiskimit të pronës së kompanive parashtruese ishin ndëshkimore, pasi masa e konfiskimit ishte një sanksion detyrues, që nuk i nënshtrohej verifikimit të dëmit faktik ose një rreziku specifik për mjedisin, dhe në këtë mënyrë mund të aplikohet edhe në mungesë të një aktiviteti faktik për transformimin e tokës.

(iv) Ashpërsia e efekteve të konfiskimit - Masa e kundërshtuar e konfiskimit ishte një sanksion tepër i ashpër dhe ndërhyrës. Brenda kufijve të truallit përkatës, ajo ndërhynte jo vetëm te trualli mbi të cilin ishte ndërtuar (ose ku synohej të ndërtohej) ose në lidhje me të cilin

ishte konstatuar një ndryshim i ndaluar i përdorimit, por edhe te të gjitha parcelat e tokës që përbënin truallin. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim.

(v) Procedurat e adoptimit dhe zbatimit të masave të konfiskimit - Masa ishte urdhëruar nga gjykatat penale. Gjykata nuk ishte e bindur nga argumenti që gjykatat penale kishin vepruar 'në vend të një autoriteti administrativ'. Roli i gjykatës penale nuk ishte thjesht verifikimi që të mos ishte kryer asnjë 'zhvillim truall' në mungesë ose në shkelje të një leje planifikimi, por gjithashtu të siguronte që 'zhvillimi', qoftë i autorizuar apo jo, të ishte në përputhshmëri me të gjitha rregullat e tjera të zbatueshme (rregullimet planifikuese). Me fjalë të tjera, gjykatat penale vepronin në mënyrë të pavarur nga autoriteti administrativ, pozicionin e të cilit ato mund të mos e merrnin parasysh. (Shih gjithashtu *Varvara kundër Italisë*, 17475/09, 29 tetor 2013, Shënim Informativ 167).

(b) Përputhshmëria me garancitë e nenit 7: (i) Nëse masat e kundërshtuara të konfiskimit kërkonin një element mendor - Dhoma e Madhe konfirmoi që neni 7, për qëllimet e ndëshkimit, kërkon një lidhje mendore që të demonstrojë një element të përgjegjësisë personale nga ana e autorit të veprës penale, pa të cilën ndëshkimi nuk mund të konsiderohet si i parashikueshëm.

Megjithatë, kjo kërkesë nuk e përjashton ekzistencën e formave të caktuara të përgjegjësisë objektive që rrjedh nga prezumimet e përgjegjësisë. Meqenëse Konventa duhet të lexohet si një e tërë, parimet e praktikës gjyqësore sipas nenit 6 paragrafi 2 duhej të zbatoheshin edhe sipas nenit 7.

(ii) Mungesa e një 'fajësimi' formal - Neni 7 përjashtonte caktimin e një sanksioni penal për një individ për sa kohë nuk është konstatuar dhe deklaruar paraprakisht përgjegjësia penale personale. Përndryshe do të shkelej parimi i prezumimit të pafajësisë i garantuar nga neni 6, paragrafi 2 i Konventës.

Gjykata, duke theksuar që të gjitha vendimet e saj kishin të njëjtën vlerë ligjore (pasi natyra e tyre detyruese dhe autoriteti interpretues

nuk varej nga struktura nga e cila ishin dhënë), deklaroi që vendimi *Varvara* nuk sillte në përfundimin që masat e konfiskimit për 'zhvillimin e paligjshëm të truallit' ('Unlawful site development offence) duhej të shoqëroheshin me përcaktim fajësie të vendosur nga gjykatat 'penale' brenda kuptimit të ligjit të brendshëm. Zbatueshmëria e nenit 7 nuk kishte efektin e 'kriminalizimit' nga ana e shteteve të procedurave që, në ushtrim të diskrecionit të tyre, ata nuk i kishin klasifikuar ashtu që të njëjtat të futeshin rigorozisht në sferën e ligjit penal. Ishte e nevojshme dhe e mjaftueshme për deklarimin e përgjegjësisë penale që të respektoheshin garancitë e parashikuara në nenin 7, me kusht që ajo të rridhte nga procedurat në pajtim me nenin 6. Gjykata megjithatë duhej të konstatonte nëse masat e kundërshtuara konfiskuese të paktën kërkonin një deklaram formale të përgjegjësisë penale në lidhje me kompanitë kërkuese. Meqenëse kompanitë kërkuese nuk ishin ndjekur penalisht vetë, çështja nëse deklarimi i përgjegjësisë penale i kërkuar nga neni 7 duhej të përmbushte kërkesat formale, dilte vetëm në lidhje me z. Gironda.

Ishte e nevojshme që fillimisht në një shoqëri demokratike të merret parasysh rëndësia e respektimit të shtetit të së drejtës dhe besimit publik në sistemin e drejtësisë, dhe së dyti, objekti dhe qëllimi i rregullave të zbatuara nga gjykatat italiane. Rregullat përkatëse synonin të shmangnin pandëshkueshmërinë që do të rridhte nga një situatë ku, nëpërmjet efektit të kombinuar të veprave penale komplekse dhe afateve relativisht të shkurtra të parashkrimit, autorët e këtyre veprave e shmangën sistematikisht ndjekjen penale dhe, mbi të gjitha, pasojat e sjelljes së tyre të papërshtatshme.

Sipas mendimit të Gjykatës, nëse gjykatat konstatuan që qëndronin të gjithë elementët e veprës penale të 'zhvillimit të paligjshëm të truallit' ('Unlawful site development offence), (si në çështjen e z. Gironda), ndërsa gjykimi u ndërpre thjesht për shkak të parashkrimit - dhe me kusht që të jenë respektuar të drejtat e mbrojtjes - këto konstatime mund të konsideroheshin sikur në thelb përbënin 'fajësimin' e kërkuar nga neni për vendosjen e një penalteti.

(iii) Nëse masat konfiskuese mund të vendoseshin mbi kompanitë kërkuese, që nuk ishin palë në gjykim - Duke pasur parasysh parimin

që një person nuk mund të dënohet për një veprim që përfshin përgjegjësinë penale të një tjetri, masa e konfiskimit që u aplikua, si në rastin në fjalë, për individët ose subjektet juridike që nuk ishin palë në gjykim, ishte në papajtueshmëri me nenin 7 të Konventës.

Meqenëse ligji italian që ishte në fuqi në atë moment nuk parashikonte përgjegjësinë e subjekteve juridike, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si të tilla, nuk mund të jenë 'palë' në procedurat penale, pavarësisht personalitetit të tyre juridik. Për pasojë, ato nuk mund të 'përfaqësoheshin' juridikisht në kontekstin e procedurave përkatëse penale në çështjen në fjalë. Në këtë mënyrë shoqëritë mbetën 'Palë të treta' në lidhje me këto procedura. Megjithatë, veprimet (dhe përgjegjësia pasuese) e përfaqësuesve të tyre përkatës ligjorë u atribuoheshin drejtpërdrejt këtyre shoqërive.

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1

Ankesa u shqyrtua në pajtim me paragrafin e dytë të kësaj dispozite. Në lidhje me qëllimin e ndjekur, shqyrtimi i çështjes së pronës tashmë të konfiskuar e bënte të dyshimtë që konfiskimi kishte kontribuar automatikisht në mbrojtjen e mjedisit.

Gjykata ritheksoi se çdo ndërhyrje në gëzimin paqësor të mjeteve të veta në zotërim duhet të marrë parasysh si më poshtë:

(i) Duhet të jetë proporcional, siç vlerësohet nën dritën e një numri faktorësh: mundësia e masave alternative më pak kufizuese; natyra e kufizuar ose e pakufizuar e sanksionit; dhe shkallën e fajësisë ose neglizhencës nga ana e parashtruesve (ose raportit ndërmjet sjelljes së tyre dhe veprës penale në fjalë).

(ii) Garancitë procedurale, që i ofrojnë individit një mundësi të arsyeshme për t'u shprehur në lidhje me çështjen dhe për të diskutuar çështjet përkatëse në gjykime bazuar në parimin e kontradiktoritetit që përputhen me parimin e barazisë së armëve. Aplikimi automatikisht i masës së kundërshtuar të konfiskimit - përveç se në lidhje me palët e treta në mirëbesim - ishte qartazi në papajtueshmëri me këto parime:

(i) ai nuk i lejonte gjykatat të konstatojnë se cilat instrumente ishin më të përshtatshme në lidhje me rrethanat specifike të çështjes ose, në përgjithësi, për të peshuar synimet legjitime përkundrejt të drejtave të atyre që prekeshin nga sanksioni; dhe

(ii) meqenëse kompanitë kërkuese nuk ishin palë në gjykimet përkatëse, asnjë prej garancive procedurale të përmendura më sipër nuk ishte i zbatueshëm për to.

Në lidhje me nenin 6, paragrafi 2 të Konventës

Girona në cilësinë e kërkuesit u ankua se gjykatat vendore e kishin shpallur fajtor, pavarësisht faktit që ndjekja penale e veprës në fjalë ishte parashkruar. Gjykata vërejti se, meqenëse kompanitë kërkuese nuk u ndoqën vetë dhe as nuk ishin palë në proces, nuk mund të ketë pasur një deklaram paraprake të përgjegjësisë së tyre. Rrjedhimisht, pyetja nëse deklarimi i përgjegjësisë penale të kërkuar nga neni 7 duhet të plotësojë kërkesat formale, lind vetëm në lidhje me Girona. Prandaj, në çështjen në fjalë, Gjykata duhej të konstatojë nëse, edhe pse vepra për të cilën u akuzua Girona ishte parashkruar, kishte të drejtë të marrë parasysh elementet e asaj veprë të përcaktuara nga gjykata vendore për të konstatuar se, në thelb, kishte pasur një deklaram të përgjegjësisë që mund të përmbushë parakushtet për vendosjen e një sanksioni në përputhje me nenin 7 të Konventës. Gjykata ishte e mendimit se, kur gjykatat konstatojnë se të gjitha elementet e veprës penale të “zhvillimit të paligjshëm të truallit” (Unlawful site development) janë nxjerrë në pah, ndërkohë që ndërpresin procedurat vetëm për shkak të parashkrimit, këto përfundime mund të konsiderohen, në thelb, si shpallje e fajësisë për qëllimet e nenit 7, i cili në raste të tilla nuk do të shkelet. Sipas Gjykatës kjo përbënte shkelje të së drejtës së tij për t’u prezumuar i pafajshëm.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi të bashkohen kërkesat; deklaroi kërkesat e pranueshme në lidhje me ankesat sipas nenit 6 paragrafët 1 dhe 2 dhe nenit 13 të Konventës, dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës; deklaroi kërkesat e pranueshme lidhur me ankesën sipas nenit 7 të Konventës; vendosi se ka pasur shkelje të nenit 7 të Konventës në lidhje me të gjitha

kompanitë parashtruese; vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 7 të Konventës në lidhje me Gironda; vendosi se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me të gjitha kompanitë kërkuese; vendosi se nuk ka nevojë të përcaktohet nëse ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës në lidhje me kompaninë G.I.E.M. S.r.l., dhe të nenit 13 në lidhje me kompanitë parashtruese G.I.E.M. S.r.l. dhe Falgest S.r.l.; vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6.2 të Konventës në lidhje me Gironda; vendosi se çështja e zbatimit të nenit 41 të Konventës nuk është gati për vendim.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. PJSC ROSNEFT OIL COMPANY kundër HER MAJESTY'S TREASURY E.A.

GJDBE [Dhomë e Madhe]
Çështja C72/15

28 mars 2017

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=189262&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13711217>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Kjo çështje ka të bëjë me kontrollin gjyqësor të ushtruar nga Gjykata e BE-së ndaj akteve të organeve të BE-së që parashikojnë sanksione ndaj subjekteve të shteteve të treta në kuadrin e politikës së jashtme dhe të sigurisë, si dhe me parimet e së drejtës që gjejnë zbatim në raste të tilla

Faktet kryesore

Pas ngjarjeve në Krime dhe në Ukrainën lindore, Krerët e Shteteve ose Qeverive të Shteteve Anëtare të BE-së, më 6 mars 2014, dënuan “shkeljen e paprovokuar nga Federata Ruse të sovranitetit dhe

integritetit territorial të Ukrainës”. Pas këtij qëndrimi ata vendosën të pezullojnë bisedimet dypalëshe me Federatën Ruse në lidhje me vizat, si dhe mbi marrëveshjen e re gjithëpërfshirëse, e cila do të zëvendësonte marrëveshjen e partneritetit BE-Rusi, dhe deklaruan se çdo masë tjetër nga Federata Ruse e cila do të destabilizonte situatën në Ukrainë do të kishte pasoja të mëdha për marrëdhëniet, sidomos ekonomike, midis BE-së dhe Shteteve Anëtare të saj nga njëra anë dhe, Federatës Ruse, nga ana tjetër.

Gjatë vitit 2014, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (në tekstin e mëtejshëm: “PPJS”), Këshilli i BE-së mori një sërë masash kufizuese në reagim të veprimeve të Federatës Ruse që i konsideroi si destabilizuese të situatës në Ukrainë. Duke pasur parasysh rëndësinë e situatës në atë shtet, pavarësisht miratimit, në mars 2014, të kufizimeve të udhëtimit dhe ngrirjes së pasurive ndaj personave të caktuar fizikë dhe juridikë, më 31 korrik 2014 Këshilli miratoi vendimin 2014/512, të ndryshuar më pas në shtator dhe dhjetor të të njëjtit vit. Me këtë vendim ai miratonte masa që kufizonin qasjen në tregjet e kapitalit, të mbrojtjes, të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe të teknologjive të ndjeshme, veçanërisht në sektorin e energjisë.

Meqenëse këto masa binin brenda fushëveprimit të TFBE-së dhe se zbatimi i tyre kërkonte akte në kuadrin e BE-së, Këshilli miratoi Rregulloren nr. 833/2014, e cila përmban dispozita më të detajuara për t’i dhënë efekt Vendimit 2014/512, si në nivel të BE-së, ashtu edhe të shteteve anëtare. Edhe Rregullorja në fjalë, e miratuar fillimisht në një ditë me vendimin, në vijim është përshtatur me ndryshimet e këtij të fundit. Qëllimi i këtyre masave ishte rritja e kostos së veprimeve të Federatës Ruse që synonin cenimin e integritetit territorial, sovranitetit dhe pavarësisë së Ukrainës dhe me shpresën për të nxitur një zgjidhje paqësore të krizës. Për këtë qëllim, Vendimi 2014/512 vendosi, në veçanti, ndalimet e eksportit të produkteve dhe teknologjive të caktuara të ndjeshme të destinuara për sektorin e naftës në Rusi, si dhe kufizime në qasjen në tregun evropian të kapitalit për operatorë të caktuar të atij sektori.

Rosneft është një kompani e regjistruar në Rusi, e specializuar në sektorët e naftës dhe gazit. Sipas informacionit të dhënë nga gjykata

referuese, 69.5% e aksioneve në këtë kompani mbahen nga Rosneftegaz OJSC, një kompani në pronësi të shtetit rus. Një pakicë e aksioneve të Rosneft, përkatësisht 19.75%, mbahet nga BP Russian Investments Ltd, një degë e kompanisë britanike të naftës BP plc. Pjesa e mbetur prej 10.75% e kapitalit aksionar të Rosneft është e listuar në bursë. Aktivitetet e Rosneft dhe të kompanive në grupin e tij, përfshijnë eksplorimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, projekte në det të hapur, rafinimin e hidrokarbureve si dhe tregtimin e naftës, gazit dhe produkte të tyre në Rusi dhe jashtë saj.

Që nga 8 shtatori 2014, Vendimi 2014/512 dhe rrjedhimisht, Rregullorja Nr. 833/2014 përmendin në shtojcat e tyre Rosneft si një entitet që u nënshtrohet kufizimeve të parashikuara nga ato akte. Rosneft filloi një sërë procedurash gjyqësore kundër masave kufizuese si para gjykatësit të BE-së, ashtu edhe para gjykatave angleze. Më 9 tetor 2014, ai bëri një padi për anulimin e këtyre akteve pranë Tribunalit të BE-së, e cila është ende në shqyrtim. Më pas, më 20 nëntor 2014, kjo kompani bëri një padi për rishikim gjyqësor para Gjykatës së Lartë të Drejtësisë (Angli dhe Uells) (në tekstin e mëtejshëm: “gjykata referuese”). Në kuadër të kësaj procedure, Rosneft pretendoi se masat kufizuese të miratuara nga Këshilli, si dhe masat e marra nga shtetet anëtare në zbatim të tyre, janë të pavlefshme.

Sipas gjykatës referuese, padia për rishikim gjyqësor e paraqitur para saj ka të bëjë, së pari, me masat kombëtare të miratuara nga Qeveria britanike me qëllim zbatimin e akteve të BE-së që parashikojnë sanksionet e kundërshtuara. Ky rishikim gjyqësor lidhet, nga njëra anë, me ligjshmërinë e akteve që parashikojnë sanksione penale për shkeljen e dispozitave të Rregullores nr. 833/2014 në lidhje me shërbimet financiare dhe sektorin e naftës dhe, nga ana tjetër, me saktësinë e disa deklaratave të FCA¹²⁷ në lidhje me nocionin e “ndihmës financiare” dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje për letrat me vlerë të transferueshme, të cilat sapo ishin emetuar në formën e certifikatave ndërkombëtare të letrave me vlerë (në tekstin e mëtejshëm: “GDR”).

127 Financial Conduct Authority (Autoriteti britanik i kontrollit financiar).

Megjithatë, gjykata referuese vlerësoi se padia lidhet gjithashtu me vlefshmërinë e akteve të BE-së. Duke iu referuar vendimit *Foto-Frost*¹²⁸ ajo kujtoi se nuk është kompetente të kontrollojë vlefshmërinë e atyre akteve, duke nënvizuar se masat e miratuara në kuadër të PPJS-së, mund të kenë pasoja të rënda për personat fizikë dhe juridikë dhe se parimi i qasjes në gjykatë, për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve ekzekutive, është themelor. Sipas asaj gjykate, Rosneft pretendoi, në thelb, se, së pari, aktet e kontestuara janë në kundërshtim me disa nene të marrëveshjes së partneritetit BE-Rusi. Së dyti, ato nuk respektojnë detyrimin për të deklaruar arsyet, të parashikuara në nenin 296 të TFBE-së, dhe, rrjedhimisht, të drejtën për një gjykim të drejtë dhe mbrojtje efektive gjyqësore. Së treti, dispozitat e atyre akteve që lidhen me sektorin e naftës janë të papajtueshme me parimin e trajtimit të barabartë dhe, miratimi i tyre përbën një keqpërdorim të kompetencave nga Këshilli. Së katërti, këto dispozita do të ishin joproportionale me objektivin e ndjekur nga aktet në fjalë dhe do të shkelnin lirinë e aktivitetit ekonomik dhe të drejtën e pronës të Rosneft. Së pesti, Rregullorja nr. 833/2014 nuk e zbatonte saktë Vendimin nr. 2014/512. Së gjashti, dhe së fundi, në masën që shteteve anëtare u kërkohej të vendosnin sanksione për të siguruar zbatimin e këtyre akteve, paqartësia e dispozitave të tyre do të cenonte parimet e sigurisë juridike dhe ligjshmërinë e veprave penale dhe dënimeve.

Për më tepër, duke marrë parasysh se është e rëndësishme që masat kufizuese në fjalë duhet të interpretohen në mënyrë uniforme në të gjithë BE-në, gjykata referuese shpjegoi se në shqyrtimin gjyqësor ajo gjeti, kundërshti në praktikën e shteteve të tjera anëtare në lidhje me interpretimin e dispozitave të caktuara të këtyre akteve. Gjykata referuese kujtoi se Rosneft kishte paraqitur tashmë një padi për anulim para Tribunalit të BE-së. Gjithsesi, i takonte këtij të fundit që, në përputhje me jurisprudencën e GJDBE-së të vlerësojë nëse është e përshtatshme ta pezullojë shqyrtimin e padisë për anulim, derisa GJDBE të shprehet mbi një kërkesë paragjykimore¹²⁹. Gjykata angleze, në thelb, pyeti së pari nëse GJDBE kishte juridiksion për të dhënë vendime paragjykimore në

128 Vendim i GJDKË të 22 tetorit 1987, Foto-Frost, 314/85, BE: C: 1987: 452.

129 Vendimi i 14 dhjetorit 2000, Masterfoods dhe HB, C 344/98, BE: C: 2000: 689.

lidhje me akte të miratuara në kuadër të PPJS-së, duke pasur parasysh veçanërisht nenin 19.1, si dhe nenet 24 dhe 40 të TBE-së, nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe nenin 275.2 të TFBE-së. Së dyti, ajo pyeti nëse masat në fjalë janë të vlefshme, a bie në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe saktësinë e ligjit në fuqi (*nulla poena sine lege certa*) që një shtet anëtar të vendosë sanksione penale, në bazë të nenit 8 të Rregullores 833/2014, para se qëllimi i shkeljes në fjalë të jetë sqaruar sa duhet nga Gjykata e Drejtësisë? Së treti, gjithmonë nëse masat në fjalë janë të vlefshme, a përfshin termi «ndihmë financiare», i parashikuar në nenin 4.3 të Rregullores 833/2014, përpunimin e një pagese nga një bankë ose një organ tjetër financiar?

Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e saj, Gjykata u shpreh se nenet 19, 24 dhe 40 të TBE-së, neni 275 i TFBE-së, si dhe neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së duhet të interpretohen ashtu që i njohin Gjykatës së Drejtësisë të BE-së juridiksion për të vendosur për një vendim paragjykimor, duke u shprehur, sipas nenit 267 të TFBE-së, mbi vlefshmërinë e një akti të miratuar në bazë të dispozitave që lidhen me PPJS-në, siç është vendimi 2014/512/CFSP i Këshillit i 31 korrikut 2014, i ndryshuar, me kusht që kërkesa për një vendim paraprak të ketë të bëjë ose me kontrollin e pajtueshmërisë së këtij vendimi me nenin 40 të TBE-së, ose me kontrollin e ligjshmërisë së masave kufizuese ndaj personave fizikë ose juridikë.

Në këtë drejtim, duhet të theksohet, së pari, se Traktatet nuk parashikojnë ndonjë procedurë të veçantë për kryerjen e një shqyrtimi të tillë gjyqësor. Në këto rrethana, ky kontroll bie në kompetencën e përgjithshme që neni 19 i TBE-së i jep Gjykatës për të siguruar respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e traktateve. Duke parashikuar këtë juridiksion të përgjithshëm, neni 19.3 (b) i TBE-së, parashikon se Gjykata vendos, me anë të një vendimi paragjykimor me kërkesë të gjykatave kombëtare, sidomos për vlefshmërinë e akteve të miratuara nga institucionet e BE-së.

Në radhë të dytë, është e nevojshme të analizohet juridiksioni i Gjykatës për të dhënë vendime paraprake në vlerësimin e vlefshmërisë

së vendimeve të miratuara në kuadrin e PPJS-së, siç është Vendimi 2014/512, kur ato parashikojnë marrjen e masave kufizuese ndaj personave fizikë ose juridikë. Ndërsa, natyrisht, neni 47 i Kartës nuk mund të krijojë juridiksion për Gjykatën, kur Traktatet e përjashtojnë atë, megjithatë parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore nënkupton që përjashtimi i juridiksionit të Gjykatës në çështjet e PPJS-së duhet të interpretohet në mënyrë të kufizuar. Meqenëse procedura që i lejon Gjykatës të japë një vendim paraprak synon të sigurojë respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve, në përputhje me funksionin që i është caktuar këtij institucioni në bazë të nenit 19.1 të TBE-së, do të ishte në kundërshtim me objektivat e kësaj dispozite dhe të parimit të mbrojtjes efektive gjyqësore që të interpretohej në mënyrë të kufizuar juridiksioni që i jep Gjykatës paragrafi 2 i nenit 275 të TFBE-së, të cilit i referohet neni 24.1 TBE¹³⁰.

Në këto rrethana, për aq sa Gjykata ka, në bazë të nenit 24.1 të TBE -së dhe të nenit 275.2 të TFBE-së, juridiksion material për të vendosur mbi vlefshmërinë e akteve të Unionit, sidomos në rast të masave kufizuese kundër personave fizikë ose juridikë, interpretimi i kësaj dispozite si përjashtim për gjykatat kombëtare nga mundësia që të pyesin Gjykatën për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit që parashikojnë marrjen e masave të tilla, do të binte ndesh me strukturën e sistemit të mbrojtjes efektive gjyqësore të krijuar nga Traktatet. Në të vërtetë, koherenca e sistemit të mbrojtjes gjyqësore kërkon, sipas praktikës gjyqësore të vendosur, që kompetenca për të deklaruar pavlefshmërinë e akteve të institucioneve të BE-së, të ngritura para një gjykate kombëtare, t'i rezervohet Gjykatës brenda kuadrit të nenit 267 të TFBE-së¹³¹. I njëjti përfundim vlen për vendimet në çështjet brenda PPJS-së, në lidhje me të cilat Traktatet i njohin Gjykatës kompetencën për shqyrtimin e ligjshmërisë.

130 Gjykata u referohet vendimeve të saj të 27 shkurtit 2007, *Gestoras Pro Amnistia dhe të tjerët kundër Këshillit*, C 354/04 P, BE: C: 2007: 115, paragrafi 53; të 27 shkurt 2007, *Segi dhe të tjerët kundër Këshillit*, C 355/04 P, BE: C: 2007: 116, pika 53; të 24 qershorit 2014, *Parlamenti kundër Këshillit*, C 658/11, BE: C: 2014: 2025, pika 70; të 12 nëntorit 2015, *Elitaliana kundër Eulex Kosova*, C 439/13 P, BE: C: 2015: 753, pika 42, si dhe më 19 korrik 2016, *H kundër Këshillit dhe Komisionit*, C 455/14 P, BE: C: 2016: 569, pika 40).

131 Shih, për këtë qëllim, aktgjykimet e 22 tetorit 1987, *Foto-Frost*, 314/85, BE: C: 1987: 452, pika 17, dhe e 6 tetorit 2015, *Schrems*, C-362/14, BE : C: 2015: 650, pika 62).

Gjykata kujtoi se kërkesa për një vendim paragjykimor për vlerësim të vlefshmërisë së një akti të BE-së përbën, ashtu si një padi për anulim, një mënyrë të kontrollit të ligjshmërisë së akteve të BE-së¹³². Kjo veçori thelbësore e sistemit të mbrojtjes gjyqësore të BE-së shtrihet edhe ndaj kontrollit të ligjshmërisë së vendimeve që parashikojnë miratimin e masave kufizuese kundër personave fizikë ose juridikë brenda kuadrit të PPJS-së. Sipas Gjykatës, as TBE-së dhe as TFBE-së nuk parashikojnë se padia për anulim e paraqitur para Tribunalit të BE-së, në zbatim të dispozitave të kombinuara të neneve 256 dhe 263 të TFBE-së, përbën metodën e vetme për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve që parashikojnë masa kufizuese kundër personave fizikë ose juridikë, duke kuptuar kështu vendimin paragjykimor si një mjet për vlerësimin e vlefshmërisë. Në këtë drejtim, neni 24.1, nënparagrafi 2, fjalia e fundit, e TBE-së i referohet nënparagrafit 2 të nenit 275 të TFBE jo që të përcaktojë llojin e procedurës, sipas së cilës Gjykata mund të rishikojë ligjshmërinë e vendimeve të caktuara, por llojin e vendimeve, ligjshmëria e të cilave mund të rishikohet nga Gjykata, në kuadrin e çdo procedure që ka si objekt kontrollin e ligjshmërisë. Megjithatë, duke qenë se zbatimi i një vendimi që parashikon masa kufizuese kundër personave fizikë ose juridikë është pjesërisht përgjegjësi e shteteve anëtare, kërkesa për një vendim paragjykimor për kontrollin e vlefshmërisë përmbush një funksion thelbësor në sigurimin e mbrojtjes efektive gjyqësore, sidomos kur, si në procedurën kryesore, ku si ligjshmëria e masave kombëtare zbatuese, ashtu edhe ajo e vendimit bazë të miratuar në kuadrin e PPJS vihen në pikëpyetje gjatë një procedure gjyqësore kombëtare. Duke pasur parasysh faktin se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që politikat e tyre kombëtare të jenë në përputhje me qëndrimet e BE-së të miratuara nga vendimet e Këshillit, të miratuara sipas nenit 29 të TBE-së, qasja e këtyre vendimeve në kontrollin gjyqësor është thelbësore kur ato parashikojnë miratimin e masave kufizuese kundër personave fizikë ose juridikë.

Gjykata u shpreh se shqyrtimi i pyetjes së dytë nuk ka nxjerrë në pah asnjë faktor të tillë që të ndikojë në vlefshmërinë e ndonjë nga

132 Gjykata kujtoi vendimet e saj të 22 tetorit 1987, *Foto-Frost*, 314/85, BE: C: 1987: 452, pika 16; të 21 shkurtit 1991, *Zuckerfabrik Süderdithmarschen dhe Zuckerfabrik Soest*, C 143/88 dhe C 92/89, BE: C: 1991: 65, pika 18; të 6 dhjetorit 2005, *ABNA dhe të tjerët*, C 453/03, C 11/04, C 12/04 dhe C 194/04, BE: C: 2005: 741, pika 103, si dhe të 3 tetorit 2013, *Inuit Tapiriit Kanatami dhe të tjerët kundër Parlamentit dhe Këshillit*, C 583/11 P, BE: C: 2013: 625, pika 95.

dispozitat e Vendimeve apo Rregulloreve të lartpërmendura të Këshillit apo të Shtojcave të Rregulloreve që kanë si objekt masat kufizuese në funksion të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë. Gjykata kujtoi se parimi i sigurisë dhe saktësisë ligjore i ligjit në fuqi (*nulla poena sine lege certa*) duhet të interpretohet në kuptimin që ai nuk e parandalon një shtet anëtar të vendosë sanksione penale që do të zbatohen në rast të shkeljes së dispozitave të Rregullores Nr. 833/2014, të ndryshuar, në përputhje me nenin 8 (1) të saj, para se qëllimi i atyre dispozitave dhe, për pasojë, edhe i dënimeve penale që rrjedhin, të sqarohet nga GJDBE.

Për sa i përket, së pari, parimit të përgjithshëm të sigurisë juridike, duhet të kujtojmë se ky parim themelor i së drejtës së BE-së kërkon, sidomos, që rregulloret të jenë të qarta dhe të sakta, në mënyrë që palët ndërgjyqëse të mund të dinë pa mëdyshje të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të marrin masat në përputhje me rrethanat¹³³. Së dyti, Gjykata theksoi se parimi i saktësisë së ligjit në fuqi (*nulla poena sine lege certa*), i cituar nga gjykata referuese, parashikohet nga neni 49 të Kartës, i titulluar “Parimet e ligjshmërisë dhe proporcionaliteti i veprave dhe dënimeve”, dhe i cili, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, përbën një shprehje të veçantë të parimit të përgjithshëm të sigurisë juridike¹³⁴. Ky parim nënkupton, në veçanti, që ligji përcakton qartë veprat penale dhe dënimet përkatëse. Ky kusht përmbushet kur pala ndërgjyqëse mund të dijë, nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të dhënë nga gjykatat, se cilat veprime dhe mosveprime i shkaktojnë përgjegjësi penale¹³⁵. Nga praktika gjyqësore e Gjykatës del qartë se parimi i saktësisë së ligjit në fuqi nuk mund të interpretohet si ndalim i sqarimit gradual të rregullave të përgjegjësisë penale me interpretime gjyqësore, për aq sa këto janë të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme¹³⁶.

133 Vendimi i 10 janarit 2006, *IATA dhe ELFAA*, C 344/04, BE: C: 2006: 10, paragrafi 68.

134 *Vendimi i 3 qershorit 2008, Intertanko dhe të tjerët*, C 308/06, BE: C: 2008: 312, pika 70.

135 Vendimi i 3 majit 2007, *Advocaten voor de Wereld*, C 303/05, BE: C: 2007: 261, paragrafi 50.

136 Shih, në këtë kuptim, vendimin e 28 qershorit 2005, *Dansk Rørindustri dhe Të tjerët kundër Komisionit*, C 189/02 P, C 202/02 P, C 205/02 P deri C 208/02 P dhe C 213/02 P, BE: C: 2005: 408, paragrafët 217 dhe 218.

Në lidhje me pyetjen e tretë, Gjykata konsideroi se shprehja “ndihmë financiare” e parashikuar në nenin 4.3 (b) të Rregullores 833/2014, e ndryshuar, duhet të interpretohet se nuk përfshin përpunimin e një pagese, si të tillë, nga një bankë ose organizatë tjetër financiare. Interpretimi kontekstual i nenit 4.3 (b) të Rregullores 833/2014 synon të demonstrojë, siç ka argumentuar në veçanti Qeveria gjermane në vëzhgimet e saj me shkrim, se, duke përdorur shprehjen “ndihmë financiare”, ligjvënësi i BE-së ka parashikuar akte të krahasueshme me subvencionet, kreditë dhe sigurimin e kredisë për eksport. Megjithatë, ndërsa këto akte kërkojnë përdorimin e burimeve të veta të institucionit financiar në fjalë, shërbimet e pagesave ofrohen, nga ana tjetër, nga ky institucion si një ndërmjetës që përcjell fonde nga një palë porositëse tek një palë e tretë, pa përfshirë mobilizimin e fondeve të vetë institucionit në fjalë. Në këto kushte, neni 4.3 i Rregullores 833/2014 nuk mund të interpretohet si detyrim ndaj institucioneve financiare për të marrë, për çdo pagesë në lidhje me një shitje të produkteve në Rusi të renditura në Shtojcën II të kësaj Rregulloreje, një autorizim shtesë, sipas nenit 3 të Rregullores 833/2014, për këtë operacion, kur këto institucione konstatojnë se transaksioni përbën një pagesë të plotë ose të pjesshme për një shitje të tillë. Në fakt, duke pasur parasysh në veçanti faktin se neni 4.3 (b) i Rregullores nuk ka për qëllim të krijojë as ngrirjen e aseteve, as kufizime në transferimin e fondeve, është e nevojshme të merret parasysh se nëse ligjvënësi i BE-së do kishte dëshiruar që çdo transfer bankar në lidhje me produktet e referuara në Shtojcën II të Rregullores 833/2014 t’i nënshtrohej një kërkesë për autorizim shtesë, ai do të përdorte terma të ndryshëm nga “ndihma financiare”. Së fundmi, nëse qëllimi i Rregullores nr. 833/2014 konsiston, në veçanti, në rritjen e kostos së veprimeve të Federatës Ruse kundrejt Ukrainës, duhet të theksohet se neni 4.3 (b), i Rregullores e ndjek këtë qëllim në mënyrë të qëndrueshme, duke vendosur kufizime në ndihmën financiare për eksportin në Rusi të produkteve të destinuara për industrinë e naftës, por pa kërkuar autorizim paraprak për përpunimin e pagesave, si të tilla. Interpretimi i mësipërm nuk paragjykon ndalimin e çdo përpunimi të pagesave në lidhje me një transaksion tregtar i cili, në vetvete, është i ndaluar sipas nenit 3.5 të Rregullores nr. 833/2014.

Në përgjigje të pyetjes së fundit neni 5.2 i Rregullores nr. 833/2014, i ndryshuar duhet të interpretohet në kuptimin që ndalon lëshimin, nga

12 shtatori 2014, të certifikatave ndërkombëtare që përfaqësojnë letra me vlerë (GDR), në bazë të një marrëveshjeje depozitimi të lidhur me një nga njësitë ekonomike të përfshira në Shtojcën VI të Rregullores nr. 833/2014, të ndryshuar me Rregulloren nr.1290/2014, përfshirë rastet kur këto certifikata përfaqësojnë aksionet e emetuara nga një prej këtyre njësive para kësaj date.

3.2. PROCEDURA PENALE kundër M.A.S. DHE M.B.

GJDBE (Dhoma e Madhe)

C42/17

5 dhjetor 2017

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=197423&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13700462>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: kjo çështje ka të bëjë me parimin e prapaveprueshmërisë së ligjit penal, dhe sidomos të afateve më të shkurtra të parashkrimit, në rast veprash penale që cenojnë interesat financiare të BE-së.

Faktet kryesore

Në vendimin *Taricco*, Gjykata vendosi që paragrafi i fundit i nenit 160 të Kodit Penal, i lexuar bashkë me nenin 161 të atij Kodi (në tekstin e mëtejshëm: “dispozitat përkatëse të Kodit Penal”), për aq sa parashikojnë që kur një akt që ndërpret procedurat penale në lidhje me mashtrimin e rëndë në fushën e TVSH-së ka efektin e zgjatjes së periudhës së parashkrimit me vetëm një të katërtën e kohëzgjatjes fillestare, mund të ndikojë në detyrimet e vendosura ndaj shteteve anëtare nga neni 325 paragrafët 1 dhe 2 të TFBE-së, në rast se këto dispozita kombëtare parandalojnë vendosjen e sanksioneve efektive dhe bindëse në një numër të konsiderueshëm rastesh të mashtrimit serioz që prekin interesat financiare të BE-së ose parashikojnë periudha më të gjata parashkrimi për rastet e mashtrimit që prekin interesat financiare të shtetit anëtar në fjalë sesa për rastet që prekin interesat e institucioneve

financiare të BE-së. Gjykata vendosi gjithashtu se i takonte gjykatës kombëtare kompetente që t'i jepte efekt të plotë nenit 325 paragrafët 1 dhe 2 të TFBE-së, duke lënë, nëse është e nevojshme, të pazbatueshme dispozitat e ligjit kombëtar, të cilat do të kishin efekt mosrespektimin nga shteti anëtar në fjalë, të detyrimeve që i takojnë nga dispozitat e përmendura të TFBE-së.

La Corte suprema di cassazione¹³⁷ dhe la Corte d'Appello di Milano¹³⁸, të cilat paraqitën kërkesa për kontroll incidental para Corte costituzionale¹³⁹ (gjykata referuese), vlerësonin se rregulli që rezultonte nga ai vendim ishte i zbatueshëm në kuadër të dy procedurave në gjykim e sipër para tyre. Në të vërtetë, këto procedura kishin të bënin me veprat penale që parashikohen në Dekretin nr. 74/2000, të cilat mund të cilësohen si të rënda. Për më tepër, vepra të tilla do të parashkruheshin nëse do zbatoheshin dispozitat përkatëse të Kodit Penal, përndryshe këto procedurat mund të rezultonin në dënime.

Për më tepër, Gjykata e Apelit e Milanos kishte dyshime nëse detyrimi që rrjedh nga neni 325.2 i TFBE-së është përmbushur në lidhje me procedurat në shqyrtim para saj. Në të vërtetë, vepra e bashkëpunimit me qëllim kontrabandën e duhanit të prodhuar jashtë, parashikuar në nenin 291 *quater* të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 43¹⁴⁰, megjithëse e krahasueshme me veprat penale që përfshihen në Dekretin nr. 74/2000, siç janë ato në fjalë në procedurën kryesore, nuk u nënshtrohet të njëjtave rregulla për periudhën e parashkrimit.

Në këto kushte, Gjykata e Kasacionit dhe Gjykata e Apelit në Milano vlerësuan se ato, në përputhje me rregullin e përcaktuar në vendimin *Taricco*, nuk duhet të zbatojnë afatet e parashkrimit, të parashikuara në dispozitat përkatëse të Kodit Penal, dhe të vendosin mbi themelin.

137 Gjykata e Kasacionit, Itali.

138 Gjykata e Apelit në Milano, Itali.

139 Gjykata Kushtetuese, Itali.

140 Dekret që miraton tekstin e dispozitave legislative për çështjet doganore, të 23 janarit 1973 (Gazeta Zyrtare e Republikës Italiane nr. 80, të 28 marsit 1973).

Gjykata Kushtetuese, nga ana e saj, dyshoi nëse kjo zgjidhje ishte e pajtueshme me parimet themelore të rendit kushtetues italian dhe me respektimin e të drejtave të patjetërsueshme të njeriut. Në veçanti, sipas saj, kjo zgjidhje do të mund të cenonte parimin e ligjshmërisë së veprave penale dhe të dënimeve, e cila kërkon, në veçanti, që dispozitat penale të përcaktohen me saktësi dhe nuk mund të jenë prapavepruese. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese specifikoi se, në rendin juridik italian, instituti i parashkrimit në çështjet penale është i një natyre materiale dhe, prandaj, përfshihet në fushën e parimit të ligjshmërisë, të përmendur në nenin 25 të Kushtetutës italiane. Prandaj, instituti në fjalë rregullohet nga dispozitat e shprehura në fuqi në kohën e kryerjes së veprës në fjalë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se është ftuar nga gjykatat kombëtare të interesuara, të vendosë për pajtueshmërinë e rregullit të përcaktuar në vendimin *Taricco*, me kërkesën e “përcaktimit” i cili, sipas Kushtetutës italiane, duhet të karakterizojë rregullat materiale penale.

Prandaj, në radhë të parë, pyetja shtrohej nëse personi në fjalë mund të ketë ditur, në kohën e kryerjes së veprës në fjalë, që e drejta e BE-së i imponon gjykatës kombëtare, sipas kushteve të vendimit *Taricco*, moszbatimin e dispozitave përkatëse të Kodit Penal. Për më tepër, kujtoi ajo, kërkesa që natyra penale e veprës dhe dënimi i zbatueshëm të identifikohen më parë dhe qartë nga autori i sjelljes së dënueshme, rrjedh gjithashtu nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së.

Së dyti, gjykata referuese konstatoi se vendimi *Taricco* nuk specifikon mjaftueshëm elementet që gjykatat kombëtare duhet të mbajnë parasysh në mënyrë që të përcaktojë ‘numrin e konsiderueshëm të rasteve’, me të cilat lidhet zbatimi i rregullës që rrjedh nga ai vendim, dhe për këtë arsye, nuk vendos kufi ndaj diskrecionit të gjyqtarëve. Për më tepër, sipas asaj gjykate, vendimi *Taricco* nuk vendos mbi pajtueshmërinë e rregullit që ai vendim sanksionon me parimet themelore të rendit kushtetues italian dhe ia ka besuar këtë detyrë shprehimisht gjykatave kombëtare kompetente. Në lidhje me këtë pikë, ajo vërejti se, në paragrafin 53 të atij vendimi, thuhet se nëse gjykata kombëtare do të vendosë të lërë të pazbatuara dispozitat përkatëse të Kodit Penal, ajo gjithashtu duhet të sigurojë që të drejtat themelore të

personave respektohen. Ajo shtoi se, në paragrafin 55 të atij vendimi, specifikohet se moszbatimi apo jo i dispozitave përkatëse të Kodit Penal, varet nga verifikimi që gjykata kombëtare bën për respektimin e të drejtave të të akuzuarit.

Për më tepër, gjykata referuese vërejtë se Gjykata, në vendimin *Taricco*, vendosi mbi çështjen e pajtueshmërisë së rregullit të përpunuar në atë vendim me nenin 49 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, vetëm sa i përket parimit të mosprapaveprimit. Megjithatë, Gjykata nuk shqyrtoi aspektin tjetër të parimit të ligjshmërisë së veprave penale dhe dënimeve, përkatësisht kërkesën që rregullat në lidhje me regjimin e sanksioneve duhet të jenë mjaft të sakta. Ndërkohë, ky është një kriter që bën pjesë në traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, gjithashtu e pranishme në sistemin e KEDNJ -së, dhe që, për këtë arsye, korrespondon me një parim të përgjithshëm të së drejtës së BE-së. Sidoqoftë, edhe nëse instituti i parashkrimit në fushën penale në rendin juridik italian do të konsiderohej si i një natyre procedurale, fakti mbetet se ai duhet të zbatohet sipas rregullave të sakta.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese italiane vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i drejtohet Gjykatës me disa pyetje për një vendim paraprak, thelbi i të cilave është si më poshtë:

Gjykata Kushtetuese pyeti së pari nëse neni 325, paragrafët 1 dhe 2, të TFBE-së interpretohet se ju kërkon gjykatave penale të mos zbatojnë rregullat kombëtare për parashkrimin të cilat përbëjnë një pengesë, në një numër të konsiderueshëm rastesh, ndaj ndjekjes së rasteve të mashtrimit serioz që prekin interesat financiare të Bashkimit ose që parashikon një periudhë më të shkurtër parashkrimi për rastet e mashtrimit që prekin interesat financiare të BE sesa për rastet e mashtrimit që prekin interesat financiare të shtetit, edhe nëse një mosaplikimi të tillë i mungon një bazë ligjore mjaft e saktë (i), ose edhe nëse në rendin juridik të shtetit anëtar, periudha e parashkrimit bie nën të drejtën penale materiale dhe i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë (ii)?

Ajo pyeti gjithashtu nëse vendimi *Taricco* duhet interpretuar se u kërkon gjykatave penale të mos zbatojnë rregullat kombëtare për afatet e parashkrimit në situata të përshkruara si më sipër, edhe nëse

ky moszbatim vjen në kundërshtim me parimet mbizotëruese të rendit kushtetues të shtetit anëtar ose me të drejtat e patjetërsueshme që një personi i njihen nga kushtetuta e shtetit anëtar? (iii)¹⁴¹

Vendimi i Gjykatës

Paraprakisht Gjykata kujtoi se u takon shteteve anëtare të sigurojnë pagimin efikas të burimeve të veta të BE-së¹⁴². Për këtë qëllim shteteve anëtare u kërkohet që të sigurojnë pagesën e detyrimeve që përbëjnë burime vetanake të BE-së, të cilat, për shkak të mashtrimit, nuk kanë hyrë në buxhetin e BE-së. Për të siguruar mbledhjen e plotë të të ardhurave nga TVSH-ja dhe duke mbrojtur kështu interesat financiare të BE-së, shtetet anëtare janë të lira të zgjedhin sanksionet e zbatueshme, të cilat mund të marrin formën e sanksioneve administrative, të sanksioneve penale ose të një kombinimi të të dyjave¹⁴³.

Në këtë drejtim, duhet të theksohet megjithatë, në radhë të parë, se sanksionet penale mund të jenë thelbësore për të luftuar në mënyrë efektive dhe bindëse raste të caktuara të mashtrimit të rëndë me TVSH. Kështu, shtetet anëtare, që të mos shkelin detyrimet e tyre sipas nenit 325.1 të TFBE-së, duhet të sigurojnë që, në rastet e mashtrimit serioz që prek interesat financiare të BE-së në fushën e TVSH-së, do të miratojnë sanksione penale efektive dhe bindëse. Prandaj, duhet të arrihet në përfundimin se shtetet anëtare nuk kanë respektuar detyrimet që kanë, në bazë të nenit 325.1 të TFBE-së kur dënimet penale të miratuara për të ndëshkuar mashtrimin serioz të TVSH-së nuk bëjnë të mundur sigurimin e mbledhjes efektive të këtij tatimi në tërësinë e tij. Për këtë qëllim, shtetet anëtare duhet të sigurojnë gjithashtu që instituti i parashkrimit, sipas legjislacionit kombëtar, të lejojë ndjekjen efektive të veprave penale të lidhura me një mashtrim të tillë.

141 Për shkak të rëndësisë Kryetari i Gjykatës pranoi kërkesën e gjykatës referuese që rasti aktual të paraqitet në procedurën e përshpejtuar të parashikuar në nenin 23a të Statutit të Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian dhe në nenin 105 (1) të Rregullores së Punës të Gjykatës (urdhri i Kryetarit të GJDBE i 28 shkurtit 2017, (C 42/17, e pabotuar, BE: C: 2017: 168).

142 Vendimi i 7 prillit 2016, *Degano Trasporti*, C 546/14, BE: C: 2016: 206, paragrafi 21.

143 Shih vendimet e 26 shkurtit 2013, Åkerberg Fransson, C 617/10, BE: C: 2013: 105, paragrafi 34, dhe Taricco, paragrafi 39.

Gjykata kujtoi se i takon së pari ligjvënësit kombëtar të përcaktojë rregullat e parashkrimit që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga neni 325 i TFBE-së, në dritën e konsideratave të Gjykatës në paragrafin 58 të vendimit *Taricco*. Ajo theksoi se i takon ligjvënësit kombëtar që të sigurojë që instituti kombëtar i parashkrimit në çështjet penale të mos çojë në mosndëshkim në një numër të konsiderueshëm të rasteve të mashtrimit serioz në rastet e TVSH-së ose që të mos çojë në ndëshkimin më të rëndë në rastet e mashtrimit që prekin interesat financiare të shtetit anëtar në fjalë sesa në ato që prekin interesat financiare të BE-së. Në këtë drejtim, ajo mbajti qëndrimin se zgjatja e një afati parashkrimi me zbatim të menjëhershëm, përfshirë edhe mbi faktet e pretenduara të cilat nuk janë përshkruar ende, në parim, nuk cenon parimin e ligjshmërisë së veprave dhe dënimeve penale¹⁴⁴.

Megjithatë, Gjykata kujtoi se duhet theksuar se sfera e mbrojtjes së interesave financiare të Bashkimit duke vendosur dënime penale, i përket kompetencës së përbashkët mes BE-së dhe shteteve anëtare, sipas nenit 4.2 të TFBE-së. Në këtë rast, në datën e fakteve në procedurën kryesore, regjimi i kufizimit i zbatueshëm për veprat penale që lidhen me TVSH-në nuk kishte qenë objekt harmonizimi nga ligjvënësi i BE-së¹⁴⁵. Prandaj, sipas Gjykatës, Republika Italiane ishte e lirë, në atë datë, të parashikonte që në rendin e saj juridik ky institut hynte, ashtu si rregullat që lidhen me përcaktimin e veprave penale dhe caktimin e dënimeve, në të drejtën penale materiale dhe, si i tillë, i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë së veprave dhe të dënimeve penale.

Lidhur me kërkesat që rrjedhin nga parimi i ligjshmërisë së veprave dhe dënimeve penale, duhet të theksohet, së pari, se GJEDNJ ka vendosur, në lidhje me nenin 7.1 të KEDNJ-së, që, në bazë të këtij parimi, dispozitat penale duhet të respektojnë disa kritere si ai i qasjes dhe i parashikueshmërisë, për sa i përket përcaktimit të veprës penale dhe caktimit të dënimit¹⁴⁶. Së dyti, duhet të theksohet se kërkesa për

144 GJDBE i referohet në këtë pikë vendimit të saj *Taricco*, paragrafi 57 dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtave të Njeriut.

145 Ligjvënësi i BE-së, që prej atëherë ka ndërhyrë në këtë fushë vetëm pjesërisht, me miratimin e Direktivës (BE) 2017/1371 të PE dhe të Këshillit të 5 korrikut 2017 mbi luftën kundër mashtrimit që prek interesat financiare të Bashkimit në mjetet e së drejtës penale (OJ 2017, L 198, f. 29).

146 Gjykata citon në lidhje me këtë vendimet e GJEDNJ të 15 nëntorit 1996, *Cantoni kundër Francës*, CE:

saktësinë e ligjit në fuqi, e cila është pjesë përbërëse e natyrshme e këtij parimi, nënkupton që ligji përcakton qartë veprat penale dhe dënimet për to. Ky kusht përmbushet kur çdo palë mund të kuptojë, nga formulimi i dispozitës përkatëse dhe nëse është e nevojshme me ndihmën e interpretimit që i jepet asaj nga gjykatat, se cilat veprime dhe mosveprime mund të shkaktojnë përgjegjësinë e tij penale¹⁴⁷. Së treti, parimi i mos-prapaveprueshmërisë së ligjit penal ndalon veçanërisht që një gjyqtar të ketë mundësi që, në një procedurë penale, të konsiderojë si vepër penale një sjellje e cila nuk është e ndaluar nga një dispozitë kombëtare e miratuar para kryerjes së veprës së pretenduar, ose të përkeqësojë regjimin e përgjegjësisë penale të atyre që janë subjekt i procedurave të tilla¹⁴⁸.

Në vazhdim, Gjykata theksoi se neni 325, paragrafët 1 dhe 2, të TFBE-së duhet të interpretohet se kërkon që gjykata kombëtare të lërë të pazbatuar, në procedura penale në lidhje me veprat penale që lidhen me TVSH, dispozitat e brendshme mbi afatet e parashkrimit, sipas të drejtës materiale kombëtare të cilat parandalojnë vendosjen e sanksioneve penale efektive dhe bindëse në një numër të konsiderueshëm të rasteve të mashtrimit serioz, që prekin interesat financiare të BE-së ose që, në raste të tilla, parashikojnë afate kohore më të gjata të parashkrimit sesa në ato që prekin interesat financiare të shtetit anëtar në fjalë, përveçse nëse një moszbatim i tillë çon në një shkelje të parimit të ligjshmërisë së veprave dhe dënimeve penale, për shkak të mungesës së saktësisë së ligjit në fuqi, ose për shkak të zbatimit prapaveprues të legjislacionit që parashikon kushte më të rënda penale se ato në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Gjykata arriti në përfundimin se, nga më sipër rrjedh, së pari, se i takon gjykatës kombëtare të verifikojë nëse analiza e kërkuar nga paragrafi 58 i vendimit *Taricco*, sipas të cilit dispozitat përkatëse të Kodit Penal pengojnë vendosjen e dënimeve efektive penale dhe bindëse në një

KEDNJ: 1996, paragrafi 29, të 7 shkurtit 2002, EK k. Turqisë, GJEDNJ, 2002, paragrafi 51, të 29 marsit 2006, Achour k. Francës, GJEDNJ, 2006, paragrafi 41, dhe të 20 shtatorit 2011, OAO *Neftyanaya Kompaniya Yukos kundër Ruisisë*, GJEDNJ, 2011, paragrafët 567 deri 570.

147 Gjykata i referohet vendimit të saj të 28 marsit 2017, *Rosneft*, C 72/15, BE: C: 2017: 236, paragrafi 162.

148 Shih, vendimin e 8 nëntorit 2016, *Ognyanov*, C 554/14, BE: C: 2016: 835, pikat 62 deri 64.

numër të konsiderueshëm rastesh të mashtrimit serioz që prekin interesat financiare të BE-së, çon në një situatë pasigurie në rendin juridik italian, në lidhje me përcaktimin e institutit të parashkrimit të zbatueshëm, i cili shpërfill parimin e saktësisë së ligjit në fuqi. Nëse ky është rasti, gjyqtari kombëtar nuk është i detyruar të lërë të pazbatuara këto dispozita të Kodit Penal. Nga ana tjetër, kërkesat e përmendura në paragrafin 58 të vendimit *Taricco*, në procedura ndaj personave të akuzuar për kryerjen e shkeljeve në lidhje me TVSH-në para dhënies së vendimit *Taricco*, e pengojnë gjyqtarin kombëtar që të mos zbatojë dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Gjykata tashmë ka theksuar, në paragrafin 53 të atij vendimi, se ata persona, për shkak të moszbatimit të atyre dispozitave, mund t'u nënshtrohen sanksioneve të cilat, sipas të gjitha gjasave, do t'u kishin shpëtuar nëse ato dispozita do të ishin zbatuar. Në këto kushte, këta persona mund t'u nënshtroheshin, në mënyrë retroaktive, kushteve më të rënda penale se ato në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Neni 34

E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër

Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI58/17. PARASHTRUES: UKË MUÇAJ

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/ki_58_17_av_shq.pdf]

4 dhjetor 2017

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Rasti kishte të bënte me një procedurë penale të zhvilluar kundër parashtruesit, që kishte përfunduar me dënimin e tij nga gjykatat e rregullta, për veprën penale “pranimi i ryshfetit”. Çështja kryesore e ngritur përmes kërkesës kushtetuese ishte se a i ishin cenuar parashtruesit të kërkesës të drejtat e kushtetuese të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy Herë për të Njëjtën Çështje]. Kjo, për shkak të mënyrës se si ishin administruar provat, për shkak të kohëzgjatjes së procedurës dhe për shkak të rikthimit të rastit, nga gjykatat në procedurë hetimore.

Faktet kryesore

Në vitin 2009, Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë kishte parashtruar aktakuzë në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër parashtruesit për shkak të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale të pranimit të ryshfetit. Më 8 maj 2009, rasti i parashtruesit të kërkesës ishte transferuar në juridiksionin e gjyqtarëve ndërkombëtarë të EULEX-it dhe më 17 nëntor 2009, Gjykata Komunale e kishte refuzuar aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës. Më 18 dhjetor 2009, Prokurori i Qarkut kishte parashtruar ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut, e cila kishte anuluar vendimin e Gjykatës Komunale dhe kishte kthyer çështjen te Prokurori për rishqyrtim. Më 25 maj 2010, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut kishte miratuar vazhdimin e hetimit për një periudhë prej 6 muajsh. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut, e cila kishte aprovuar ankesën dhe kishte anuluar vendimin e 25 majit 2010, me

arsyetimin se vendimi ishte marrë nga një gjyqtar i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut, i cili nuk kishte juridiksion lëndor. Më 30 gusht 2010, Gjykata Komonale kishte miratuar vazhdimin e hetimit për një periudhe prej një muaji dhe më 4 nëntor 2010, Prokurori Komunal kishte ngritur aktakuzë të re kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale të pranimit të ryshfetit. Më 18 janar 2012, Gjykata Komonale kishte shpallur parashtruesin fajtor për veprën penale të pranimit të ryshfetit, si dhe veprën penale të ushtrimit të ndikimit, duke e dënuar atë me burgim dhe duke ia ndaluar ushtrimin e çfarëdo funksioni publik, për një periudhe trevjeçare. Pas paraqitjes së ankesës së parashtruesit të kërkesës, më 27 mars 2013, Gjykata e Apelit e kishte pranuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke anuluar aktgjykimin e Gjykatës Komonale dhe duke kthyer rastin në Gjykatën Themelore për rigjykim. Më 26 maj 2015, Gjykata Themelore përsëri e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të pranimit të ryshfetit dhe e kishte dënuar atë me burgim. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe më 18 prill 2016, Gjykata e Apelit kishte aprovuar pjesërisht ankesën e parashtruesit në lidhje me shqiptimin e një dënimi më të butë, ndërsa pjesa e mbetur e aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte vërtetuar. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pml. nr. 326/2016, të 23 janarit 2017.

Më 22 maj 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimet e gjykatave të rregullta atij i ishin shkëlur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës) dhe e drejta e për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtin krim (neni 34 i Kushtetutës). Parashtruesi i kërkesës pretendoi se provat e paraqitura në gjykim përfshinin deklarata e dhëna nga dëshmitarët në polici, të cilat, sipas tij, ishin të papranueshme sepse mbrojtja nuk kishte qenë e pranishme kur këto deklarata ishin dhënë dhe ai nuk i kishte marrë ato para gjykimit. Ai gjithashtu pretendoi se i tërë gjykimi nuk ishte mbajtur brenda një kohe të arsyeshme. Në mënyrë të veçantë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se kthimi i rastit

në procedurë hetimore prapë paraqiste shkelje të parimit *res judicata* dhe, rrjedhimisht, shkelje të nenit 34 të Kushtetutës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese theksoi se mbi parashtruesin e kërkesës binte barra që të mbështeste faktet dhe argumentet për shkeljet e pretenduara kushtetuese. Gjykata gjeti se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte mbështetur me prova faktike dhe as me argumente të nevojshme pretendimin e tij se i ishin shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 dhe 34 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 dhe Protokollin nr. 7 të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi që parashtruesi i kërkesës kishte përsëritur ankesën e njëjtë në të gjitha shkallët e gjyqësorit të rregullt, duke përfshirë edhe në kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese. Pretendimet e parashtruesit kishin të bënin kryesisht me fushën e ligjshmërisë dhe, si të tilla, nuk binin nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rikujtoi që vetëm përmendja e thjeshtë e një ose më shumë dispozitave të Kushtetutës, duke pretenduar se të njëjtat janë shkelur, nuk përbënte bazë të mjaftueshme për Gjykatën Kushtetuese që të vlerësonte nëse kishte pasur shkelje të Kushtetutës ose të KEDNJ.

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti që Gjykata Supreme ose gjykatat e rregullta kishin vepruar në mënyrë të padrejtë dhe të paarsyeshme në vërtetimin e fakteve ose në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konkludoi se arsyetimet e dhëna nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, gjatë vendosjes për ankesat e parashtruesit, ishin të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij për shkelje të pretenduar të Kushtetutës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (d) dhe 2 (d) dhe

56 (b) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi që të shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. BOCHAN kundër UKRAINËS (Nr. 2)

[22251/08]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

5 shkurt 2015

***Çështja kyç/le drejta e pretenduar:** dështimet nga gjykatat vendore për t'i siguruar një ridëgjim të çështjes pas një konstatimi nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të nenit 6.1 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ('KEDNJ'), ishte në përputhje racione materiae me nenin 6.1 të KEDNJ; nëse procedurat vendore të kundërshtuara shkelën garancitë e drejtësisë të nenit 6.1 të KEDNJ.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Mariya Ivanivna Bochan, shtetase ukrainase (kërkuesja), kundër Ukrainës, më 7 prill 2008. Kërkuesja ka qenë e përfshirë në një çështje gjyqësore shumë të gjatë por përfundimisht të pasuksesshme në lidhje me titullin e pronësisë së tokës, pranë gjykatave vendore. Fillimisht, në vitin 2001 ajo bëri kërkesë pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku u ankua për padrejtësi në procedurat vendore. Në një vendim të 3 majit 2007, Gjykata kishte gjetur shkelje të nenit 6.1 të Konventës mbi bazën e faktit që vendimet e gjykatave vendore ishin marrë gjatë procedurave të cilat nuk kishin respektuar garancitë e seancës dëgjimore, të drejtën nga neni 6.1 për pavarësi dhe paanshmëri, për siguri juridike dhe kërkesën për dhënie të arsyeve të mjaftueshme. Gjykata i kishte caktuar kërkueses 2.000 (dy mijë) euro për dëmet jomateriale.

Duke u mbështetur në vendimin e Gjykatës Evropiane, kërkuesja më pas ngriti një “apel nën dritën e rrethanave të jashtëzakonshme” (“apel i jashtëzakonshëm”), në të cilin ajo i kërkoi Gjykatës Supreme të Ukrainës që të prishte vendimet e gjykatave vendase në çështjen e saj dhe të pranonte pretendimet e saj në tërësi. Në mars 2008, Gjykata Supreme e rrëzoi apelin e saj pasi gjeti që vendimet vendase ishin të sakta dhe të bazuara. Në qershor 2008, Gjykata Supreme e deklaroi të papranueshëm një apel të mëtejshëm të paraqitur nga kërkuesja.

Në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Evropiane në rastin konkret, kërkuesja u ankua në përputhje me nenin 6.1 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 që, me rastin e rrëzimit të apelit të saj të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme nuk kishte marrë parasysh gjetjet e Gjykatës Evropiane në vendimin e saj të 3 majit 2007.

Përmbledhja e pretendimeve

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 6.1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, kërkuesja u ankua për procedurën në lidhje me “apelin e saj nën dritën e rrethanave të jashtëzakonshme” (“apel i jashtëzakonshëm”) që kulminoi me vendimin e Gjykatës Supreme të 14 marsit 2008. Në mënyrë të veçantë, ajo theksoi që, gjatë trajtimit të apelit të saj të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme nuk kishte marrë parasysh gjetjet e Gjykatës sipas nenit 6.1 të Konventës në vendimin e saj të 3 majit 2007 në lidhje me vlerësimin e provave nga gjykatat vendore. Ajo gjithashtu nuk kishte adresuar aspekte të rëndësishme të çështjes, konkretisht vlefshmërinë e provave kryesore dokumentuese, mbi të cilat ishin mbështetur gjykatat vendase. Më tej, arsyetimi i saj në lidhje me rezultatin e kërkesës së mëparshme të kërkueses kishte qenë në kundërtënie me gjetjet e Gjykatës në vendimin e saj të datës 3 maj 2007. Sipas kërkueses, mënyra e padrejtë në të cilën Gjykata Supreme e kishte trajtuar apelin e saj të jashtëzakonshëm kishte përbërë shkelje të re të nenit 6.1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Qeveria parashtroi se neni 6 i Konventës ishte i pazbatueshëm në procedurat lidhur me “apelin e kërkueses nën dritën e rrethanave të jashtëzakonshme”. Ajo theksoi që vendimi i Gjykatës Supreme i 14 marsit 2008, që refuzoi apelin e saj të parë, kishte qenë i natyrës

së përkohshme dhe nuk kishte përcaktuar të drejtat ose detyrimet e saj civile. Ishte vendimi i mëvonshëm i Gjykatës Supreme, i datës 5 qershor 2008, ku refuzohej apeli i saj i dytë, i cili kishte “përkufizuar” të drejtat dhe detyrimet e saj civile. Megjithatë, meqenëse kërkesja nuk u ankua që procedurat e qershorit 2008 ishin të mangëta, neni 6 nuk ishte i zbatueshëm. Kërkesja parashtroi që neni 6.1 i Konventës ishte i zbatueshëm në procedurat lidhur me apelin e saj të jashtëzakonshëm, që kulminoi me vendimin e Gjykatës Supreme të 14 marsit 2008.

Kërkesja, gjithashtu u ankua duke pretenduar se ajo ishte privuar në mënyrë të paligjshme nga pasuria e saj për shkak të procedurave të apelit të saj të jashtëzakonshëm. Lidhur me këtë, ajo u mbështet në nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 6.1 të Konventës, Gjykata theksoi se duhet të përcaktojë tri çështje: (a) nëse ajo është penguar nga neni 46 i Konventës për të shqyrtuar ankesat e kërkeses, duke marrë parasysh faktin që Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ishte ende duke mbikëqyrur ekzekutimin e vendimit të 3 majit 2007, (b) nëse procedura vendase lidhur me apelin e jashtëzakonshëm të kërkeses kishte vepruar në pajtim me garancitë e Konventës, dhe nëse po, (c) a ishin respektuar kërkesat e nenit 6.1.

(a) Nëse Gjykata është e penguar nga neni 46 për shqyrtimin e ankesave – Dhoma e Madhe përsëriti që roli i Komitetit të Ministrave në aspekt të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës nuk e ndalon Gjykatën nga shqyrtimi i një kërkesë të re lidhur me masat e marra nga një shtet përgjegjës për ekzekutimin e një vendimi, në qoftë se ajo kërkesë përmban informacione relevante në lidhje me çështje të pavendosura nga vendimi fillestar.

Disa nga pretendimet e kërkeses në çështjen në fjalë mund të kuptohen si të tilla, ku ajo ankohet për mungesën e pretenduar të ekzekutimit të duhur të vendimit të Gjykatës të 3 majit 2007. Megjithatë, ankesat për dështimin në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës ose për korrigjimin e një shkeljeje tashmë të gjetur nga Gjykata ishin jashtë

kompetencave të Gjykatës. Prandaj, ankesat e kërkuases lidhur me dështimin e korrigjimit së shkëljes fillestare të nenit 6.1, në çështjen e saj të mëparshme, ishin të papranueshme.

Megjithatë, kërkuësja kishte ngritur gjithashtu një ankimim tjetër në lidhje me sjelljen dhe drejtësinë e procedurës së vendosur nga Gjykata Supreme në mars 2008. Ajo pretendoi, në mënyrë të veçantë, që arsyetimi i përdorur nga Gjykata Supreme në atë vendim kishte qenë në kundërtënie të dukshme me gjetjet përkatëse të Gjykatës në vendimin e saj të vitit 2007. Pra, ky ankimim i ri kishte të bënte me mënyrën se si ishte arritur vendimi i marsit 2008 në procedurën lidhur me apelin e jashtëzakonshëm të kërkuases, jo me rezultatin e asaj procedure, si të tillë, apo me efektivitetin e zbatimit nga gjykatat vendase të vendimit të Gjykatës. Kështu, ai kishte të bënte me një situatë të ndryshme nga ajo e shqyrtuar në vendimin e vitit 2007, dhe përmbante informacione të reja relevante lidhur me çështje të pavendosura nga ai vendim. Rrjedhimisht, Gjykata nuk pengohet nga neni 46 i Konventës për të shqyrtuar ankesën e re të kërkuases lidhur me padrejtësinë e procedurës që kishte kulmuar me vendimin e marsit 2008.

(b) Zbatueshmëria e nenit 6 ndaj procedurës lidhur me apelin e jashtëzakonshëm të kërkuases – Ndërkohë që neni 6.1 normalisht nuk ishte i zbatueshëm në apele të jashtëzakonshme, që kërkonin rihapjen e procedurave gjyqësore të përfunduara, natyra, fushëveprimi dhe tiparet e veçanta të procedurave në një apel të jashtëzakonshëm, të dhënë në një sistem ligjor të caktuar, mund të jenë të atilla që i sjellin procedurat rreth këtij lloj apeli, brenda hapësirës së nenit 6.1 dhe mbrojtjeve për gjykim të drejtë që ai u ofron palëve. Prandaj, Gjykatës iu desh të shqyrtonte natyrën, fushëveprimin dhe tiparet e veçanta të apelit të jashtëzakonshëm që diskutohet në rastin konkret.

Korniza ligjore e zbatueshme kombëtare vinte në dispozicion të kërkuases një zgjidhje, e cila mundësonte shqyrtimin gjyqësor të çështjes së saj civile nga Gjykata Supreme, nën dritën e gjetjeve të Gjykatës Evropiane që vendimet origjinale vendase ishin të mangëta. Për shkak të llojit të shqyrtimit gjyqësor që parashikonte, apeli i jashtëzakonshëm i ngritur nga kërkuësja, mund të shihej si zgjatje e procedurës civile origjinale (e përfunduar), ngjashëm me procedurën

e kasacionit, ashtu siç përkufizohet nga e drejta ukrainase. Kështu, ndërkohë që tiparet e veçanta të kësaj procedure të ngjashme me kasacionin mund të ndikonin në mënyrën se si veprojnë garancitë e parashikuara procedurale të nenit 6.1, Gjykata ishte e mendimit që ato garanci duhet të jenë të zbatueshme ndaj saj, në të njëjtën mënyrë, siç janë të zbatueshme në procedurat e kasacionit në çështje civile, në përgjithësi. Ai përfundim që rezultoi nga dispozitat e së drejtës së zbatueshme vendase, u vërtetua përmes referencës ndaj fushëveprimit dhe natyrës së “shqyrtimit” që faktikisht zhvilloj Gjykata Supreme në mars 2008, para se ajo të rrëzonte apelin e jashtëzakonshëm të kërkuases, duke i lënë vendimet e kontestuara të pandryshuara. Gjykata Supreme i shqyrtoi materialet e çështjes dhe vendimet e gjykatës nga procedura origjinale nën dritën e parashtrimeve të reja të kërkuases bazuar kryesisht mbi vendimin e Gjykatës të vitit 2007.

Kështu, duke pasur parasysh si dispozitat përkatëse të legjislacionit ukrainas, ashtu edhe natyrën dhe fushëveprimin e procedurës që kulminoi me vendimin e Gjykatës Supreme të marsit 2008 lidhur me apelin e jashtëzakonshëm të kërkuases, ndjekur nga vendimi i saj konfirmues në qershor 2008, Gjykata konsideroi që procedura ishte vendimtare për përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësiive civile të kërkuases. Rrjedhimisht, garancitë përkatëse të nenit 6.1 ishin të zbatueshme në atë procedurë.

(c) *Pajtueshmëria me nenin 6.1* – Gjykata përsëriti që nuk ishte roli i saj të vepronte si instancë e katërt dhe të vinte në pyetje sipas nenit 6.1 vendimet e gjykatave vendase, në qoftë se gjetjet e tyre nuk mund të shiheshin si arbitrare ose dukshëm të paarsyeshme.

Në rastin konkret, në vendimin e saj të marsit 2008, Gjykata Supreme kishte keqinterpretuar rëndë gjetjet e Gjykatës Evropiane në vendimin e saj të 3 majit 2007. Në mënyrë të veçantë, ajo kishte treguar me hollësi që Gjykata Evropiane i kishte gjetur vendimet e gjykatave vendase të ligjshme dhe të bazuara dhe, kishte dhënë shpërblim të drejtë për shkelje të garancisë së “kohës së arsyeshme” (kur në fakt ankesa ishte refuzuar si dukshëm e pabazuar). Këto pohime ishin qartazi të pasakta. Arsyetimi i Gjykatës Supreme nuk përbënte thjesht një lexim ndryshe të një teksti ligjor. Për Gjykatën, kjo mund të interpretohej vetëm si

“tepër arbitrar” ose si i tillë që nënkuptonte “mohim të drejtësisë”, në kuptimin që paraqitja e shtrembëruar e vendimit të vitit 2007 kishte efektin e mundjes së përpjekjes së kërkueses për shqyrtimin e pretendimit të saj pronësor nën dritën e atij vendimi, në kuadër të procedurës së ngjashme me kasacionin të parashikuar nga e drejta vendase. Kështu, procedura e kundërshtuar nuk e ka plotësuar kriterin e “gjykimit të drejtë” sipas nenit 6.1.

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 Gjykata theksoi se, duke pasur parasysh gjetjet e saj sipas nenit 6.1 **të Konventës, nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse, në këtë rast, ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.**

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1, pasi që gjykimi i kundërshtuar nuk kishte plotësuar kërkesën e ‘gjykimit të drejtë’ bazuar në këtë nen; në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata theksoi se, duke pasur parasysh gjetjet e saj sipas nenit 6.1 **të Konventës, nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse, në këtë rast, ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.** Gjykata bazuar në nenin 41, përcaktoi që shteti duhet të paguajë 10.000 (dhjetë mijë) euro në lidhje me dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. *MINISTERO DELL'ECONOMIA E DELLE FINANZE ET AGENZIA DELLE ENTRATE kundër PAOLO SPERANZA*

GJDBE

Çështja C-35/09

1 korrik 2010

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=247057&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13711394>]

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: Kjo çështje kishte të bënte me mjetet efektive që duhet të parashikojnë legjislacionet e shteteve anëtare që të mund të garantojnë efektivitetin e së drejtës së BE-së

Faktet kryesore

Më 30 korrik 1993, mbledhja e ortakëve të “LEJA S.r.l.” (në tekstin e mëtejshëm: “LEJA”) vendosi ta shndërrojë atë në shoqëri aksionare dhe të rrisë kapitalin e saj aksionar nga 20,000,000 ITL¹⁴⁹, ose afërsisht 10,329 €, në 58,400,000,000 ITL, ose rreth 30,161,083 euro.

Procesverbali i takimit u ruajt nga z. Speranza, në cilësinë e noterit. Ky procesverbal specifikonte se një nga partnerët e “LEJA”, “Tecnoitalia Srl”, kishte rënë dakord me rritjen regjistruar në të gjithë rritjen e kapitalit të vendosur, duke kontribuar me 6,244 aksione të “Lama dd”, një kompani e regjistruar në regjistrin e gjykatës së Koper në Slloveni. Një ekspert i caktuar nga Gjykata e Padovës e vlerësoi vlerën e aksioneve në fjalë në shumën 58,380,000,000 ITL, ose afërsisht 30,150,754 €.

149 Lireta italiane.

Pas miratimit të vendimit nga Gjykata e Apelit e Venecias, akti i rritjes së kapitalit u tatua me normën proporcionale të parashikuar nga rregulloret përkatëse kombëtare dhe, Zyra e Regjistrimit Tregtar në Padova njoftoi për një rikuperim në vlerë prej 578,102,000 ITL, ose afërsisht 298,565 €, për “LEJA” si dhe për z. Speranza, në cilësinë e tij si noter.

Ky i fundit bëri një padi para gjykatës së shkallës së parë kompetente kundër atij njoftimi për rimëkëmbjen. Kjo padi në shkallë të parë nuk pati sukses, por vendimi u prish në apel. Ministria dell’Economia e delle Finanze¹⁵⁰ dhe Agenzia delle Entrate¹⁵¹ bënë një rekurs mbi pikat e ligjit kundër vendimit të marrë në apel, duke pretenduar shkeljen dhe zbatimin e pasaktë të dispozitave të shumta të tekstit të vetëm.

Speranza pretendoi se rritja e kapitalit në fjalë në procedurën kryesore nuk ka ndodhur asnjëherë, pasi “Tecnoitalia Srl” nuk kishte qenë aspak në gjendje të tenderonte aksionet e “Lama dd”, gjë që, për më tepër, do të kishte rezultuar në falimentim të “LEJA”. Ai më tej pretendoi se legjislacioni kombëtar është në kundërshtim me Direktivën 69/335 për aq sa parashikon, nga njëra anë, mundësinë që përmban rregullorja për tarifën e regjistrimit, për t’i nënshtruar “taksës” aktin e rritjes së kapitalit, pavarësisht nga mungesa e kontributit efektiv në kapitale dhe, nga ana tjetër, detyrimin solidar të noterit.

Corte suprema di cassazione¹⁵² konsideroi se, në bazë të rregullave kombëtare, apeli i paraqitur nga Ministri dell’Economia e delle Finanze dhe Agenzia delle Entrate duhet të lejohet. Por mbi themelin e çështjes ajo ka disa dyshime për sa i përket pajtueshmërisë së legjislacionit italian me Direktivën 69/335, qoftë për sa i përket disa nocioneve themelore, qoftë edhe garancive procedurale, sidomos për noterët e përfshirë në operacione të tilla. Prandaj ajo pezulloi procedurën para saj dhe i drejtoi GJDBE-së një sërë pyetjesh për një vendim paraprak. Thelbi i shqetësimit të Gjykatës së Kasacionit konsistonte nëse neni 4.3 (c) i Direktivës 69/335, në rast të rritjes së

150 Ministria e Ekonomisë dhe Financave

151 Agjencia e Taksave dhe Tatimeve.

152 Gjykata e Kasacionit në Itali.

kapitalit të shoqërive, duhej interpretuar sikur kërkon që detyrimet fiskale të paguhen që kur regjistrohet rritja e kapitalit, apo kur kontributet e kësaj rritjeje paguhen efektivisht (i). Gjithashtu, ajo pyeti nëse kjo dispozitë duhet interpretuar ashtu që, këto detyrime duhen paguar vetëm nga shoqëria, apo edhe nga noteri që ka hartuar ose regjistruar aktet e rritjes së kapitalit (ii). Së fundmi, ajo pyeti nëse një noter në një situatë të tillë gëzon garanci të mjaftueshme procedurale për të përfituar rimbursimin e detyrimeve, në rast anulimi të akteve të rritjes së kapitalit (iii).

Vendimi i Gjykatës

Në lidhje me pyetjen e parë, Gjykata theksoi se nenet 4.1 (c) dhe 5.1 (a) të Direktivës 69/335, në lidhje me tatimin mbi rritjen e kapitalit, të ndryshuar me Direktivën 85/303, duhet të interpretohen se nënkuptojnë që, ato nuk përjashtojnë që një shtet anëtar të konsiderojë regjistrimin e aktit të rritjes së kapitalit të një kompanie si momentin në të cilin lindin detyrimet tatimore, me kusht që të ruhet lidhja midis pagesës së detyrimit në fjalë dhe kontributit aktual pasuror për kompaninë përfituese. Nëse, gjatë miratimit të aktit në fjalë, kontributi aktual në kapitale nuk është bërë ende dhe, nëse nuk është e sigurt se ky kontribut do të bëhet, pagesa e detyrimit tatimor nuk mund të kërkohej nga shteti anëtar në fjalë derisa kontributi në kapitale të jetë bërë efektivisht. Kështu, kur duket se, pas regjistrimit të vendimit për rritjen e kapitalit, pagesa e kontributit në kapitale nuk është bërë gjatë këtij regjistrimi dhe, për shkak të mashtrimit, është e sigurt që nuk do të bëhet, pagesa e detyrimeve tatimore në lidhje me këtë shtim kapitali nuk mund të kërkohej.

Për sa i përket pyetjes së dytë, Direktiva 69/335 mbi taksat indirekte mbi rritjen e kapitalit, e ndryshuar me Direktivën 85/303, duhet të interpretohet ashtu që nuk e pengon një shtet anëtar të parashikojë përgjegjësi solidare të noterit që ka hartuar ose regjistruar aktin e rritjes së kapitalit në aksione, me kusht që noteri në fjalë të ketë të drejtën e padisë ndaj shoqërisë që përfiton nga kontributi.

Në fakt, Direktiva 69/335 nuk kërkon harmonizimin e procedurave për pagimin e rritjes së kapitalit dhe, në parim, nuk përjashton

përgjegjësinë solidarë të noterit në fjalë, i cili përbën njëkohësisht garanci për përmbushjen e detyrimit tatimor të shoqërisë që përfiton nga rritja e kapitalit si masë që synon thjeshtimin e pagesës së rritjes së kapitalit. Sidoqoftë, detyrimi solidar i noterit për të paguar rritjen e kapitalit, do të shkonte përtej asaj që është e nevojshme për të përmbushur objektivat e lartpërmendur, nëse noteri ministror në fjalë nuk do të kishte të drejtë për padi kundër shoqërisë që përfitonte nga kontributi.

Së fundmi, në përgjigje të pyetjes së tretë, Gjykata kujtoi se parimi i efektivitetit duhet të interpretohet në kuptimin që është kundër një rregulloreje kombëtare e cila kërkon që, para juridiksioneve tatimore, si provë për mungesën e kontributit efektiv të rritjes së kapitalit të vendosur të një kompanie, të jetë vetëm paraqitja e një vendimi civil që është bërë *res judicata* dhe që shpall nulitetin ose anulimin e regjistrimit. Sipas Gjykatës, nëse detyrimi tatimor mund të rimbursohet vetëm kur paraqitet një vendim i tillë civil, bie në kundërshtim me Direktivën 69/335, mbi detyrimet indirekte mbi rritjen e kapitalit, të ndryshuar me Direktivën 85/303, sipas të cilave pagesa e një detyrimi të tillë nuk mund të kërkohej duke pasur parasysh mungesën e një kontributi efektiv në rritjen e kapitalit. Pra, përderisa juridiksionet tatimore nuk mund të deklarojnë të pavlefshëm, sipas një procedure incidentale, aktin e rritjes së kapitalit dhe se, për këtë arsye, çdo padi e tyre që synon mospagimin e detyrimeve tatimore është e privuar nga çdo efekt i dobishëm, ndërkohë që mjete juridike të ngjashme në lidhje me detyrime të tjera tatimore mund të jenë efektive, rregullimi konkret i parashikuar nga legjislacioni italian e bën, praktikisht, të pamundur ose tepër të vështirë ushtrimin e të drejtave të njohura nga Direktiva 69/335.

3.2. Åklagaren k. Hans Åkerberg Fransson

GJDBE (Dhomë e Madhe)

çështja C617/10

26 shkurt 2013

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=134202&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1403294>]

Në këtë rast Gjykata vendosi se një sanksion administrativ mund të shoqërohet me një sanksion penal në lidhje me të njëjta fakte dhe të njëjtin person, me kusht që i pari të mos jetë në thelb një sanksion penal.

I. Faktet kryesore

Z. Åkerberg Fransson u thirr në 9 qershor 2009 përpara Haparanda tingsrätt¹⁵³, për t'u përgjigjur sidomos për akuzën e mashtrimit të rëndë tatimor. Ai akuzohej se në deklaratat e tij tatimore për vitet fiskale 2004 dhe 2005, kishte dhënë informacione të pasakta që i shkaktonin buxhetit humbje të të ardhurave të lidhura me mbledhjen e tatimit mbi të ardhurat dhe tatimin mbi vlerën e shtuar ("TVSH"), për shuma prej 319,143 SEK¹⁵⁴ për vitin financiar 2004, nga të cilat 60,000 SEK për TVSH, dhe 307,633 SEK për vitin financiar 2005, nga të cilat 87,550 SEK për TVSH. Z. Åkerberg Fransson u padit gjithashtu për mos deklarim të kontributeve të punëdhënësit për periudhat e tetorit 2004 dhe tetorit 2005, gjë që ju shkaktoi organizatave sociale humbje të të ardhurave në shuma prej respektivisht 35,690 SEK dhe 35,862 SEK. Sipas aktakuzës, veprat duhet të konsideroheshin si të rënda, nga njëra anë, për shkak të rëndësisë së shumave të përfshira dhe, nga ana tjetër, për shkak se ishin në kuadër të 'veprimtarisë së gjerë sistematike kriminale'.

¹⁵³ Gjykata e Rrethit në Haparanda, Suedi.

¹⁵⁴ Korona Suedeze.

Me vendim të 24 majit 2007, skatteverket¹⁵⁵ i vendosi z. Åkerberg Fransson, për vitin fiskal 2004, një gjobë tatimore prej 35,542 SEK në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i tij ekonomik, një gjobë prej 4,872 SEK me TVSH dhe prej 7,138 SEK për kontributet e punëdhënësit. Gjithashtu, me të njëjtin vendim, për vitin fiskal 2005, i vendosi një gjobë tatimore prej 54,240 SEK për të ardhurat nga aktiviteti i tij ekonomik, 3,255 SEK për TVSH dhe 7,172 SEK për kontributet e punëdhënësit. Këto gjopa u shoqëruan e parashikimin e interesave në rast mospagimi në kohë. Sanksionet e sipërpërmendura nuk janë objekt ankimi pranë gjyqtarit administrativ, pasi periudha e kërkuar për këtë qëllim kishte skaduar më 31 dhjetor 2010 për vitin fiskal 2004 dhe më 31 dhjetor 2011 për vitin fiskal 2005.

Ndaj z. Åkerberg Fransson filloi edhe një procedim penal i cili mbështetej në të njëjtat fakte të deklaratave të rreme ashtu si edhe vendimet për pagimin e gjobave të miratuara nga skattenverket.

Para gjykatës suedeze, lind pyetja nëse procedura penale e nisur kundër z. Åkerberg Fransson duhet të rrëzohej me arsyetimin se, në kontekstin e procedurave të tjera, ai ishte dënuar tashmë për të njëjtat fakte, gjë që do të binte ndesh me ndalimin e dënimit i dyfishtë të përcaktuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe në nenin 50 të Kartës. Pikërisht në këto rrethana Haparanda tingsrätt vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i parashtojë Gjykatës pyetjet e mëposhtme për një vendim paraprak:

Sipas ligjit suedez, një gjykatë kombëtare mund të përjashtojë zbatimin e dispozitave të ligjit kombëtar të cilat mund të jenë në kundërshtim me parimin e ndalimit të dënimit të dyfishtë të parashikuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ, dhe për këtë arsye ka të ngjarë të jetë gjithashtu në kundërshtim me nenin 50 të Kartës, vetëm nëse vendimi i saj mund të mbështetet në një tregues të qartë në KEDNJ ose në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata suedeze pyet nëse një kusht i tillë në ligjin kombëtar për të përjashtuar është një përputhje me të drejtën e BE-së, veçanërisht me parimet

155 Administrata fiskale në Suedi.

e tij të përgjithshme, e sidomos me përparësinë dhe efektin e tij të drejtpërdrejtë? Së dyti ajo pyet nëse procedurat penale për mashtrim tatimor përfshihen nën parimin e ndalimit të dënimit të dyfishtë të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe nenit 50 të Kartës nëse i akuzuari ka qënë tashmë subjekt i një sanksioni financiar në kuadër të një procedure të mëparshme administrative për të njëjtat fakte deklarimesh të rreme dhe nëse koordinimi i këtyre procedurave ndikon në këtë vlerësim?

II. Përmbledhje e vendimit

Fusha e veprimit të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, për sa i përket veprimit të Shteteve Anëtare, përcaktohet në nenin 51 § 1 të saj, sipas së cilës dispozitat e Kartës janë të zbatueshme për Shtetet Anëtare vetëm kur këto janë duke zbatuar të drejtën e BE-së. Në të vërtetë, të drejtat themelore të garantuara në rendin juridik të BE-së synohen të zbatohen në të gjitha situatat e rregulluara nga e drejta e BE-së, por jo jashtë situatave të tilla. Prandaj, Gjykata nuk mund të vlerësojë, në dritën e Kartës, legjislacionin kombëtar që nuk bie në kuadrin e së drejtës së BE-së. Nga ana tjetër, kur një rregullim i tillë përfshihet në fushën e veprimit të së drejtës së BE-së, Gjykata, kur i drejtohen pyetje në kuadër të një procedure paragjykimore, duhet të sigurojë të gjitha elementet e interpretimit të nevojshëm për vlerësimin, nga gjykata kombëtare, të përputhshmërisë së rregullimit të brendshëm me të drejtat themelore respektin e të cilave ajo garanton.

Kur një gjykatë të një Shteti Anëtar i kërkohet të shqyrtojë pajtueshmërinë me të drejtat themelore të një dispozite ose mase kombëtare e cila, në një situatë ku veprimi i Shteteve Anëtare nuk përcaktohet plotësisht nga e drejta e BE-së, e zbaton këtë të drejtë sipas kuptimit të nenit 51 § 1 të Kartës, autoritetet dhe gjykatat kombëtare kanë hapësirën që të zbatojnë standardet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore, me kusht që ky zbatim të mos komprometojë nivelin e mbrojtjes së parashikuar nga Karta, siç interpretohet nga Gjykata, ose përparësinë, unitetin dhe efektivitetin i së drejtës së BE-së. Për këtë qëllim, kur gjykatave kombëtare u kërkohet të interpretojnë dispozitat e Kartës, ato kanë mundësinë dhe, kur është e përshtatshme, janë të detyruara t'ia

referojnë çështjen Gjykatës për një vendim paragjykimor në përputhje me nenin 267 TFBE.

Në këto kushte, sanksionet fiskale dhe ndjekja penale për evazion fiskal për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar përbëjnë një zbatim të neneve 2, 250, § 1, dhe 273 të Direktivës 2006/112, në lidhje me sistemin e përbashkët mbi tatimin mbi vlerën e shtuar dhe të nenit 325 TFBE dhe, rrjedhimisht, të së drejtës së BE-së sipas kuptimit të nenit 51, § 1, të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Fakti që rregullimet kombëtare që shërbejnë si bazë për këto sanksione fiskale dhe procedime penale nuk u miratuan për të transpozuar Direktivën 2006/112 nuk mund të jetë i tillë që të vërë në dyshim këtë përfundim, pasi zbatimi i tyre tenton të penalizojë shkeljen e dispozitave të asaj direktive dhe për këtë arsye synon të zbatojë detyrimin e vendosur nga Traktati mbi Shtetet Anëtare për të penalizuar në mënyrë efektive sjelljet e dëmshme për interesat financiare të Bashkimit.

Parimi *ne bis in idem* i sanksionuar në nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së nuk e pengon një Shtet Anëtar të vendosë, për të njëjtat akte të mosrespektimit të detyrimeve për të deklaruar në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar, në mënyrë të njëpasnjëshme një sanksion fiskal dhe një sanksion penal për aq sa sanksioni i parë nuk është i natyrës penale, gjë që i takon gjykatës kombëtare ta verifikojë. Në fakt, për të garantuar mbledhjen e të gjitha të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe, duke mbrojtjen, në këtë mënyrë, interesat financiare të BE-së, Shtetet Anëtare kanë lirinë të zgjedhin sanksionet e zbatueshme. Prandaj, këto mund të marrin formën e sanksioneve administrative, të sanksioneve penale ose një kombinim të të dyjave. Vetëm kur sanksioni tatimor është i natyrës penale sipas kuptimit të nenit 50 të Kartës dhe ka marrë formë të prerë, dispozita e sipërpërmendur parandalon nisjen e procedimit penal për të njëjtat fakte kundër të njëjtit person. Për qëllime të vlerësimit të natyrës kriminale të gjobave tatimore, janë të rëndësishme tre kritere. E para është kualifikimi ligjor i veprës në të drejtën e brendshme, e dyta vetë natyra e veprës penale dhe e treta natyra dhe shkalla e ashpërsisë së sanksionit që mund të pësojë personi në fjalë.

E drejta e Bashkimit nuk rregullon marrëdhëniet ndërmjet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rendeve ligjore të Shteteve Anëtare dhe as nuk përcakton pasojat që duhet të nxirren nga një gjyqtar kombëtar në rast të një konflikti mes kësaj Konvente dhe një rregulli të së drejtës kombëtare. Në fakt, nëse, siç konfirmohet nga neni 6 § 3 TBE, të drejtat themelore të njohura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë pjesë e së drejtës së BE-së si parime të përgjithshme dhe nëse neni 52, § 3, i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së kërkon që të drejtat e përfshira aty dhe që korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, t'u jepet i njëjti kuptim dhe i njëjti fushëveprimi me ato që u jepet nga Konventa në fjalë, kjo e fundit nuk përbën, derisa BE-ja të ketë aderuar në të, një instrument ligjor të përfshirë zyrtarisht në rendin juridik të BE-së.

E drejta e BE-së përjashton një praktikë gjyqësore që ia nënshton detyrimin e një gjyqtari kombëtar për të lënë të pazbatuar çdo dispozitë në kundërshtim me një të drejtë themelore të garantuar nga Karta kushtit që papajtueshmëria në fjalë të dalë qartë nga teksti i kësaj Karte ose nga jurisprudenca përkatëse. Një gjë e tillë do t'i mohonte gjykatës kombëtare kompetencën për të vlerësuar plotësisht, , kur është e përshtatshme, edhe bashkëpunimin e Gjykatës së Drejtësisë, pajtueshmërinë e dispozitës në fjalë me këtë Kartë. Në të vërtetë, një praktikë e tillë ka efektin e reduktimit të efektivitetit të së drejtës së BE-së duke i mohuar gjyqtarit kompetent për të zbatuar këtë të drejtë kompetencën për të bërë, në kohën e një zbatimi të tillë, gjithçka që është e nevojshme për të përjashtuar dispozitat legislative kombëtare që mund të përbëjnë pengesë për efektivitetin e plotë të standardeve të BE-së.

Neni 35

Liria e Lëvizjes

- 1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.*
- 2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.*
- 3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohej hyrja në Republikën e Kosovës.*
- 4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.*
- 5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI06/10. PARASHTRUES: VALON BISLIMI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/ki_06_10_shq.pdf]

30 tetor 2010

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Çështja kushtetuese e kësaj kërkesë ishte shkelja e supozuar e lirisë së lëvizjes së parashtruesit të kërkesës, e garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës, për shkak se atij i ishte pamundësuar largimi nga vendi pasi i ishte refuzuar lëshimi i pasaportës.

Faktet kryesore

Më 11 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte nxjerrë vendim për konfirmimin e kallëzimit penal kundër parashtruesit të kërkesës dhe katër personave të tjerë, për veprën penale të vjedhjes së rëndë. Gati katër vite më vonë, në vitin 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte caktuar tri seanca dëgjimore lidhur me rastin e sipërpërmendur penal kundër parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve. Me gjithë praninë e parashtruesit të kërkesës, të gjitha seancat e caktuara ishin shtyrë për shkak të mungesës së palëve të tjera në procedurë. Pas korrikut të vitit 2008, parashtruesi i kërkesës nuk kishte pranuar kurrfarë thirrje për seancë dëgjimore lidhur me rastin e sipërpërmendur penal. Më 27 prill 2009, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për lëshimin e pasaportës në Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës e kishte bërë pagesën prej 25 eurosh për pasaportë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës as nuk e kishte marrë pasaportën dhe as që kishte marrë ndonjë vendim me shkrim, me të cilin i refuzohej kërkesa e tij për pasaportë. Më 13 janar 2010, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë t'ia lëshonte një certifikatë që nuk ishte nën hetime, për qëllime të aplikimit për të

marrë pasaportën. Ai nuk kishte marrë asnjë certifikatë apo vendim të gjykatës lidhur me moslëshimin e pasaportës. Në vend të kësaj, sipas parashtruesit të kërkesës, ai kishte marrë vetëm një “refuzim verbal” për kërkesën e tij. Më 28 maj 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte nxjerrë aktgjykim, në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve, duke hedhur poshtë kallëzimin penal ndaj tyre.

Më 25 janar 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se i ishte shkelur e drejta e tij për liri të lëvizjes e garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyrë të gabueshme i kishte interpretuar dispozitat ligjore, duke dështuar t’ia lëshojë certifikatën, e cila ishte dokument i domosdoshëm për të marrë pasaportë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Parashtruesi i kërkesës pohoi që i ishte shkelur e drejta për liri të lëvizjes për shkak të zbatimit të gabuar të neneve përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit. Sipas tij, të dy ligjet parashikonin që kufizimi i të drejtës për liri të lëvizjes, i shkaktuar nga refuzimi për lëshim të pasaportës, mund të vendosej vetëm për rastet, në të cilat gjykata kompetente kishte lëshuar vendim paraprak. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu argumentoi se kufizimi i vendosur në të drejtën e tij për liri të lëvizjes nuk ishte i bazuar në ligj, por ishte çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe të praktikës, duke përfshirë keqinterpretimin e një memorandumit të mirëkuptimit, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu u ankua se nuk kishte mjete juridike që mund të përdoreshin për ta zgjidhur këtë situatë. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese caktimin e masës së përkohshme “për të shmangur diskriminimin e mëtejshëm dhe shkeljen e së drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes kur kushtëzohen me ndonjë procedurë penale në zhvillim e sipër”.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht përcaktoi se testi i zbatueshëm për sa i përket shkeljes së supozuar të së drejtës për t'u larguar nga vendi mund të përmbliidhej më sa vijon: çdo kufizim duhet të jetë në përputhje me ligjin; të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë i domosdoshëm për një shoqëri demokratike. Në rastin në fjalë, Gjykata vuri në dukje se nuk ishte kontestuese që kishte pasur ndërhyrje në lirinë e lëvizjes të parashtruesit të kërkesës, që garantohej me nenin 35 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, për shkak të moslëshimit të pasaportës. Sa i përket ligjshmërisë së masës kufizuese, Gjykata arsyetoi se shprehja «në përputhje me ligjin» jo vetëm që kërkonte që masat e sfiduara të kishin bazë ligjore, por kjo kishte të bënte edhe me cilësinë e ligjit në fjalë. Kjo do të thotë se ligji duhej të ishte i qasshëm dhe i parashikueshëm për sa i përket ndikimeve të tij. Në mënyrë që ligji ta përmbushte kriterin e parashikueshmërisë, ai duhej të përcaktonte me mjaft precizitet kushtet, në të cilat një masë mund të zbatohet, për t'u mundësuar personave në fjalë - nëse ishte nevoja edhe më këshilla përkatëse, për të rregulluar sjelljen e tyre.

Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se në përputhje me nenin 27 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, organi kompetent, domethënë Ministria e Punëve të Brendshme, ka të drejtë ta refuzojë kërkesën për pasaportë në bazë të vendimit të gjykatës, nëse gjykata kërkon ndalesën e lëshimit të pasaportës. Sipas Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit të kërkesës Ministria e Punëve të Brendshme ia kishte ndaluar lëshimin e pasaportës pa vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme ose të gjykatës. Gjykata Kushtetuese theksoi se procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës kishte pritur të vendosej para Gjykatës Komunale për më tepër se gjashtë vite dhe se parashtruesi i kërkesës më në fund ishte liruar. Gjykata erdhi në përfundim se autoritetet kishin dështuar në obligimin e tyre sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së për të siguruar që ndërhyrja në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t'u larguar nga vendi i vet është ishte e justifikuar dhe proporcionale. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se kishte pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për liri të lëvizjes, të garantuar me nenin 35 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2, paragrafin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

Për sa i përket kushtit të shterimit të mjeteve juridike nga parashtruesit e kërkesave, para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit arsyetoi se rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në supozimin se ekziston një mjet efektiv juridik në dispozicion. Gjykata gjeti se, në rastin konkret, praktika e bazuar në memorandumun e mirëkuptimit, të zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale e kishte penguar parashtruesin e kërkesës që ta gëzonte të drejtën e tij për mjet efektiv juridik, në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, njëzëri, vendosi që të shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për liri të lëvizjes të garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; të konsiderojë se praktika e bazuar në memorandumun e mirëkuptimit, të zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale, e pengoi parashtruesin e kërkesës që ta gëzojë të drejtën për mjete efektive juridike; të konstatojë që Ministria e Punëve të Brendshme duhet të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesit për pasaportë në pajtim me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit brenda 30 ditësh nga pranimi i Aktgjykimit.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. KOTIY kundër UKRAINËS

[28718/09]

GJEDNJ [Seksioni i pestë]

5 qershor 2015

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: arrestimi dhe ndalimi nuk ishin në përputhje me nenin 5.1 të Konventës, mungesa e së drejtës së zbatueshme për kompensim siç parashikohet nga neni 5.5 i Konventës dhe ndërhyrja e autoriteteve hetuese në jetën private dhe jetën familjare në kundërshtim me nenin 8 të Konventës dhe se vendimet e tyre kufizonin lirinë e lëvizjes, në kundërshtim me nenin 2 të Protokollit nr. 4.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Andrey Pavlovich Kotiy, një shtetas ukrainas (kërkuesi), kundër Ukrainës, më 23 maj 2009. Kërkuesi jetonte dhe punonte për disa vite në Gjermani, së bashku me familjen e tij. Në prill të vitit 2008, Departamenti i Policisë në Kiev filloi procedurën penale kundër kërkuesit në lidhje me një mashtrim financiar, dhe e renditi atë si një person në kërkim, me arsyetimin se ai nuk jetonte në vendbanimin e tij të regjistruar në Ukrainë, dhe vendndodhja e tij nuk dihej. Në nëntor 2008, kërkuesi shkoi në Departamentin e Shërbimit të Migrimit në Kharkiv për të vazhduar pasaportën e tij, dhe në këtë moment aty ai u ndalua dhe u shoqërua në Departamentin e Policisë së Rrethit në Kiev, ku u arrestua pas marrjes në pyetje. Kërkuesi u lirua pas dhjetë ditësh, pasi nënshkroi një zotim me shkrim për të mos lënë vendbanimin e tij të regjistruar në Ukrainë dhe dorëzoi pasaportat e tij. Pas kësaj, kërkuesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër arrestimit dhe ndalimit të tij të paligjshëm, shkeljes së pretenduar të rregullave procedurale nga hetuesi, dhe ndërhyrjes në jetën e tij familjare dhe profesionale. Në dhjetor 2011, masat parandaluese u hoqën dhe pasaportat iu kthyen.

Përmbledhja e pretendimeve

Fillimisht, kërkuesi pohoi se ai ishte ndaluar më 13 nëntor 2008 në Kharkiv, ku ishte shoqëruar për në Kiev, dhe më pas ishte marrë në pyetje. Ai argumentoi se ndalimi i tij i mëtejshëm, midis 14 dhe 24 nëntorit 2008, në bazë të vendimeve të hetuesit dhe të gjykatës nuk ishte i bazuar në dyshime të arsyeshme; ishte i paligjshëm, arbitrar dhe në kundërshtim me nenin 5.1 të Konventës. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për heqjen e lirisë para vendimit të hetuesisë më 14 nëntor 2008, Qeveria pretendoi se ato nuk ishin të mbështetura nga asnjë material dëshmues dhe për këtë arsye ishin të pabazuara. Sa i përket ndalimit të ankuesit midis 14 dhe 24 nëntorit 2008, në bazë të vendimeve të hetuesit dhe të Gjykatës së Qarkut, Qeveria argumentoi se një paraburgim i tillë ishte bazuar në një dyshim të arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer një vepër penale. Për më tepër, më 17 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut kishte dhënë arsye shtesë për zgjatjen e paraburgimit të kërkuesit. Qeveria konsideroi se ndalimi i kërkuesit ishte në përputhje me nenin 5.1 të Konventës.

Ndërkaq në lidhje me shkeljen e nenit 8, Qeveria pranoi se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për respektim të jetës së tij private dhe familjare. Megjithatë, ata konsideruan se kufizimi i kundërshtuar kishte qenë i ligjshëm, kishte ndjekur një qëllim legjitim dhe se kishte qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Zotimi me shkrim për të mos u arratisur ishte i nevojshëm, pasi kërkuesi ishte akuzuar për krime të rënda dhe kjo masë ishte më pak ndërhyrëse se masat e tjera parandaluese të disponueshme në procedurat penale. Qeveria argumentoi gjithashtu se jeta familjare e kërkuesit nuk ishte paragjykuar seriozisht, pasi familja mund të ishte shpërngulur në Ukrainë. Ata, më në fund, vunë në dukje se në datën e arrestimit të tij, kërkuesi kishte paraqitur se ai ishte përkohësisht i papunë dhe ky fakt nuk mbështeti sugjerimin se ai kishte pësuar humbje materiale si rezultat i masës së kundërshtuar.

Kërkuesi pohoi se zotimi me shkrim për të mos ikur dhe sekuestrimi i mëvonshëm i pasaportave të tij të udhëtimit ndërkombëtar, kishin qenë masa të paligjshme dhe joproporcionale. Ai argumentoi se si rezultat i atyre masave, jeta e tij personale, profesionale dhe familjare ishte shkatërruar. Atij i duhej të rindërtonte jetën në një vend ku nuk kishte jetuar prej kohësh. Sa i përket sugjerimit të Qeverisë se familja

mund të ishte shpërngulur në Ukrainë, kërkuesi vuri në dukje se familja e tij, përfshirë fëmijët e tij, jetonin në Gjermani në baza të përhershme dhe ishin integruar në komunitetin gjerman. Kërkuesi pretendoi se zhvendosja e familjes së tij nuk do të kishte qenë një zgjedhje e arsyeshme, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe interesat e fëmijëve. Autoritetet vendase nuk kishin arritur të krijonin një ekuilibër të drejtë midis të gjitha interesave në rrezik dhe nuk kishin siguruar që kufizimi ishte proporcional.

Arsyetimi i Gjykatës

Sipas Gjykatës, çdo heqje lirie duhet të jetë e ligjshme. “Ligjshmëria” e paraburgimit sipas ligjit të brendshëm është elementi kryesor, por jo gjithmonë vendimtar. Gjykata gjithashtu duhet të jetë e bindur se, gjatë periudhës në shqyrtim, paraburgimi ishte në përputhje me qëllimin e nenit 5.1 të Konventës, i cili është të parandalojë që personat të privohen nga liria në mënyrë arbitrare (shih *Oleksiy Mykhaylovych Zakharkin kundër Ukrainës*, nr.1727/04, paragrafi 84, 24 qershor 2010). Në mënyrë që heqja e lirisë të konsiderohet e lirë nga arbitrariteti, nuk mjafton që kjo masë të ekzekutohet në përputhje me ligjin kombëtar: ajo gjithashtu duhet të jetë e nevojshme në rrethanat.

Gjykata rikujtoi se kërkuesi argumentonte se ndalimi i tij kishte filluar më 13 nëntor 2008 - pas arrestimit të tij në Kharkiv, ndërsa përpiquej të shkëmbente pasaportën e tij të udhëtimit ndërkombëtar me një të re - dhe se pas arrestimit të tij, ai ishte shoqëruar për në Kiev. Sidoqoftë, këto pretendime nuk mbështeten nga asnjë material dëshmues. Prandaj, Gjykata nuk ishte në gjendje të vërtetojë nëse faktet e pretenduara kanë ndodhur ose të përcaktojnë, në veçanti, nëse ka pasur heqje të lirisë sipas kuptimit të nenit 5.1 të Konventës. Rrjedhimisht, ajo hodhi poshtë këtë pjesë të ankesës.

Gjykata mori parasysh pretendimin e kërkuesit se paraqitja e tij në Departamentin e Policisë nuk ishte vullnetare dhe se në atë kohë ai kishte qenë në listën e personave në kërkim. Duke pasur parasysh elementin shtrëngues të pranishëm gjatë asaj periudhe kohore (shih *Baisuev dhe Anzorov kundër Gjeorgjisë*, nr. 39804/04, paragrafi 55, 18 dhjetor 2012), Gjykata konstatoi se, nga ora 1.30 e mëngjesit, më 14 nëntor 2008, kërkuesi ishte privuar nga liria sipas kuptimit të nenit 5.1 të Konventës.

Në anën tjetër kur hetuesia urdhëroi arrestimin e kërkuesit, i njëjti nuk kishte marrë një urdhër arresti paraprak nga gjykata, siç kërkohet nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 165-2. 4 i Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: “KPP”), por e bazoi vendimin e tij në nenin 106 të KPP-së, i cili parashihte arsye të jashtëzakonshme për të arrestuar një individ pa urdhër gjykate. Sidoqoftë, raporti i arrestimit vetëm përsëriti baza të tilla të përgjithshme, pa iu referuar ndonjë rrethane të veçantë që shpjegon se pse kjo dispozitë e KPP-së mund të zbatohet në rastin e kërkuesit. Pa këtë informacion, raporti i arrestimit nuk përbënte një garanci kuptimplote që tregon se arrestimi i kërkuesit ishte kryer në bazë të dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi kishte kryer një vepër penale. Për më tepër, as hetuesi në raportin e tij të arrestimit dhe as Gjykata e Qarkut që shqyrtoi çështjen më 17 nëntor 2008 nuk ofruan arsye që përcaktonin pse ndalimi paraprak i kërkuesit - si masë parandaluese e përkohshme sipas kuptimit të nenit 149 të KPP-së ishte i nevojshëm. Autoritetet vendase nuk vërtetuan se kishte pasur ndonjë nga qëllimet specifike të përcaktuara në ligjin e brendshëm për zbatimin e masave parandaluese. Në këtë drejtim, Gjykata nuk konsideroi se ndalimi i kërkuesit mund të justifikohet me faktin se ai ishte vendosur në listën kombëtare të personave në kërkim, pasi nuk ka asgjë për të treguar se ai ishte fshehur. Përkundrazi, duket se kërkuesi po bënte biznes haptazi në Gjermani dhe Ukrainë, kishte jetuar në Gjermani për disa vjet para arrestimit të tij, dhe ishte në komunikim me autoritetet - në veçanti me autoritetet policore të Ukrainës, të cilat duhet të ketë qenë në dijeni se ai banonte në Gjermani si nga komunikimet e tij, ashtu edhe nga dokumentet e disponueshme në dosjen e çështjes penale. Në këto rrethana, vendosja e kërkuesit në listën kombëtare të personave të kërkuar, dhe kështu nxitja e një kërkimi për kërkuesin në territorin e Ukrainës, ishte një masë e kotë dhe nuk mund të jepte një arsye të vlefshme për ndalimin e kërkuesit. Gjykata gjithashtu vërejtë se më 7 dhjetor 2009, Gjykata e Rrethit e liroi kërkuesin nga paraburgimi pikërisht sepse nuk kishte prova që sugjeronin se kërkuesi mund të ikte nga drejtësia, të pengonte hetimin ose të vazhdonte ndonjë aktivitet kriminal.

Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata konstatoi se ndalimi i kërkuesit midis 14 dhe 24 nëntorit 2008 ishte i papajtueshëm me kërkesat e nenit 5.1 të Konventës. Prandaj ka pasur shkelje të nenit 5.1.

Ndërsa sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 8, palët ranë dakord se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për respektim të jetës së tij private dhe familjare. Gjykata nuk gjeti arsye për të vendosur ndryshe, pasi edhe vërejtja se vendimet e hetuesit për të marrë nga kërkuesi një zotim me shkrim për të mos ikur dhe sekuestrimi i mëvonshëm i pasaportave të udhëtimit ndërkombëtar të kërkuesit, e pengoi kërkuesin të udhëtonte në Gjermani, ku ai kishte jetuar për disa vjet dhe ku familja e tij vazhdonte të jetonte. Gjithashtu, fakti që kërkuesi ishte i papunë në kohën materiale nuk e zbuti faktin që ai ishte penguar përkohësisht të kthehej në Gjermani për të rifilluar jetën e tij familjare dhe private. Për më tepër, autoritetet vendase nuk kishin marrë në konsideratë masa të tjera parandaluese të disponueshme sipas ligjit të brendshëm dhe nuk kishte pasur mjete efektive juridike. Që nga nënshkrimi i detyrimit me shkrim për të mos u arratisur, kërkuesit nuk i ishte kërkuar të merrte pjesë në asnjë procedurë hetimore. Si përmbledhje, e drejta e tij për respektimin e jetës së tij private dhe familjare nuk ishte balancuar me interesin publik për të siguruar hetimin efektiv të një çështjeje penale. Prandaj masat në fjalë ndërhyjnë në jetën familjare të kërkuesit. Gjykata vërejtja më tej se, nga viti 2003 deri në mbërritjen e tij në Ukrainë në nëntor 2008, kërkuesi kishte mbajtur poste të ndryshme drejtuese në Gjermani dhe ishte përfshirë profesionalisht në shoqërinë gjermane. Prandaj, kufizimi i imponuar e pengoi atë që të ndiqte aktivitetin e tij normal profesional dhe të mbante marrëdhëniet e tij me rrethin e tij të zakonshëm të njohjeve, gjë që pati pasoja negative në jetën private të kërkuesit (shih *Niemietz kundër Gjermanisë*, 16 dhjetor 1992, paragrafi 29, Seria A nr. 251 - B). Kështu, masat gjithashtu ndikuan në jetën private të kërkuesit brenda kuptimit të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi njëzëri se ka pasur shkelje të nenit 5.1 dhe 5.5 të Konventës si dhe ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës; vendosi se nuk kishte nevojë të shqyrtohej veçmas ankesa sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4; përcaktoi që shteti i paditur duhej t'i paguante kërkuesit, në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, 6,000 (gjashtë mijë) euro, në lidhje me dëmin jomaterial; dhe 2,000 (dy mijë) euro, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. HRISTO GAYDAROV kundër DIRECTOR NA GLAVNA DIREKTSIA “OHRANITELNA POLITSIA” PRI MINISTERSTVO NA VATRESHNITE RABOTI

GJDBE

Çështja C-430/10

17 nëntor 2011

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=114586&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13711618>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Liria e lëvizjes sipas së drejtës së BE-së përfshin edhe të drejtën e një shtetasi për t’u larguar nga shteti i tij.

Faktet kryesore

Z. Gaydarov, është një shtetas bullgar i cili, më 2 tetor 2008, u dënua në Serbi me nëntë muaj burg për transport ilegal të narkotikëve. Më 6 nëntor 2008, nëpërmjet kanaleve diplomatike, autoritetet bullgare u njoftuan për këtë dënim. Në bazë të këtij informacioni, më 13 nëntor 2008, drejtori i policisë, në përputhje me nenin 76.5 të Ligjit për Dokumentet Identifikuese Bullgare (në tekstin e mëtejshëm: ZBLD), mori një vendim që ndalonte largimin e z. Gaydarov nga territori dhe lëshimin e një pasaporte ose dokumenti të ngjashëm në favor të tij. Ky vendim iu dorëzua z. Gaydarov më 16 shtator 2009, kohë në të cilën ai e kishte vuajtur dënimin në Serbi dhe ishte kthyer në Bullgari.

Z. Gaydarov e kundërshtoi atë vendim para gjykatës referuese, duke argumentuar, sipas kësaj të fundit, se ai ishte dënuar tashmë në një vend tjetër dhe se ligji bullgar nuk ishte i zbatueshëm për të. Shefi i policisë pretendoi se kishte respektuar dispozitat e nenit 76, paragrafi 5, të ZBLD-së.

Sipas gjykatës referuese, autoriteti administrativ kompetent kishte diskrecion në marrjen e një mase të tillë dhe shqyrtimi gjyqësor i vendimit përkatës kufizohej në verifikimin e ekzistencës së letrës ose dokumenteve zyrtare të përmendura në dispozitën përkatëse. Duket se Gjykata e Lartë Administrative e kishte konfirmuar këtë praktikë gjyqësore në një rast kundër një vendimi të ngjashëm të marrë kundër një shtetasi bullgar të dënuar në Spanjë¹⁵⁶.

Gjykata referuese nga ana e saj kishte dyshime për pajtueshmërinë e dispozitës në fjalë të ZBLD-së me të drejtën e BE-së e cila, sipas neneve 20 të TFBE-së dhe 21 të TFBE-së, si dhe nenit 45.1 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe Direktivës 2004/38, garanton të drejtën e qytetarëve të BE-së për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare. Megjithatë, ajo vuri në dukje se, sipas nenit 27 të asaj direktive, shtetet anëtare mund të kufizojnë lirinë e lëvizjes së qytetarëve të BE-së për arsye të rendit publik ose shëndetit publik. Për më tepër, gjykata referuese vërejti se një masë që ndalon largimin nga territori, siç është masa në fjalë në procedurën kryesore, bazohet në detyrimin e vendosur shteteve nga neni 71 i Konventës për Zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit për të marrë masa kontrolli në kufijtë e jashtëm për të luftuar transportin e paligjshëm dhe përdorimin e lëndëve narkotike. Së fundi, ajo gjykatë pyeti për zbatueshmërinë e kriterëve të nenit 27 të Direktivës 2004/38 për një shtetas bullgar, ndërkohë që kjo direktivë ishte transpozuar në Bullgari, vetëm për sa i përket lëshimit të dokumenteve të identitetit, por jo edhe për lirinë e shtetasve bullgarë për të udhëtuar në një shtet anëtar tjetër. Gjykata referuese pyeti, në thelb, nëse e drejta e BE-së e pengon marrjen e një vendimi administrativ, me të cilin një Shtet anëtar ndalon një nga shtetasit e tij të largohet nga territori i tij me arsyetimin se personi në fjalë është dënuar për një vepër penale nga një gjykatë e një vendi të tretë për trafik droge.

Vendimi Gjykatës

Statusi i qytetarit të BE-së i jep një shtetasi evropian, edhe në raport me shtetin anëtar të origjinës të tij, të drejtat në lidhje me këtë status,

¹⁵⁶ Vendimi nr. 5013 i 16 prillit 2010.

në veçanti të drejtën për të lëvizur dhe për të qëndruar lirisht brenda territorit të shteteve anëtare. Siç parashikohet nga neni 21 i TFBE-së e drejta për lëvizje të lirë përfshin si të drejtën e qytetarëve të BE-së për të hyrë në një shtet anëtar tjetër nga ai i origjinës së tyre, ashtu edhe të drejtën për t'u larguar nga ky i fundit. Liritë themelore të garantuara nga ky Traktat nuk do kishin asnjë kuptim nëse shteti anëtar i origjinës, pa arsye të vlefshme, mund të ndalojë shtetasit e tij të largoheshin nga territori i tij me qëllim hyrjen në territorin e një shteti anëtar tjetër.

Meqenëse neni 4.1 i Direktivës 2004/38 mbi të drejtën e qytetarëve të BE-së dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, parashikon shprehimisht se çdo qytetar i BE-së, me një kartë identiteti ose pasaportë të vlefshme, ka të drejtë të largohet nga territori i një shteti anëtar për të shkuar në një shtet anëtar tjetër. Prandaj, situata e një personi që ndalohet të largohet nga një shtet anëtar, shtetas i të cilit është ai, bie në fushëveprimin e direktivës në fjalë.

Neni 21 i TFBE-së dhe neni 27 i Direktivës 2004/38, që lidhen me të drejtën e qytetarëve të BE-së dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, nuk përjashtojnë një rregullim kombëtar që parashikon mundësinë e kufizimit të së drejtës së një shtetasi të një shteti anëtar për të udhëtuar në territorin e një shteti anëtar tjetër, veçanërisht me arsyetimin se ai është dënuar për një vepër penale në një shtet tjetër për trafik droge, me kusht që, së pari, sjellja personale e atij shtetasi të përbëjë një kërcënim real, aktual dhe mjaft serioz që prek një interes themelor të shoqërisë; së dyti, që masa kufizuese e parashikuar është e përshtatshme për të garantuar arritjen e objektivit që ndjek dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur atë, dhe, së treti, që e njëjta masë mund të jetë objekt i një shqyrtimi efektiv gjyqësor duke bërë të mundur kontrollin e ligjshmërisë së saj, në themel dhe në ligj, në përputhje me kërkesat e së drejtës së BE-së.

Neni 36

E Drejta e Privatësisë

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

2. Kontrollat e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.

4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI56/18. PARASHTRUES: AHMET FRANGU

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/ki_56_18_agj_shq.pdf]

3 gusht 2020

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Rrethanat e rastit konkret kishin të bënin me pamundësinë e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e birit të tij të ndjerë në regjistrin themeltar të të vdekurve. I biri i ndjerë i parashtruesit të kërkesës kishte udhëtuar në Suedi me qëllim të shërimit nga një sëmundje e rëndë. Çështja kushtetuese e ngritur në këtë rast ishte se a i ishin shkelur parashtruesit të kërkesës disa të drejta kushtetuese, gjegjësisht të drejtat e garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 36 [E Drejta e Privatësisë], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Faktet kryesore

I biri i ndjerë i parashtruesit të kërkesës (I.F.) kishte udhëtuar në Suedi me qëllim të shërimit nga një sëmundje e rëndë. Gjatë qëndrimit të tij në Suedi, i biri i parashtruesit të kërkesës kishte aplikuar për azil, por duke e përdorur një emër tjetër (A.H.). Autoritetet suedeze ia kishin lëshuar kartelën që vërtetonte se i biri i parashtruesit të kërkesës është azilkërkues, por me emër tjetër (emrin e rremë me të cilin ishte regjistruar, A.H.). I biri i parashtruesit të kërkesës kishte vdekur në një institucion shëndetësor në Suedi. Raporti mjekësor lidhur me vdekjen e tij ishte lëshua në emër të personit fiktiv (A.H.). Pas vdekjes së tij, Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi kishte lëshuar një parashtresë përmes të cilës sqaroi se ka informuar autoritetet e Republikës së Kosovës për vdekjen e të birit të parashtruesit të kërkesës, I.F. (duke theksuar emrin e tij të vërtetë). Ambasada po ashtu konfirmoi se nuk kishte asnjë pengesë

për riatdhesimin e të ndjerit në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Komunës së Prishtinës, me kërkesë që i biri i tij i ndjerë të regjistrohej në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve (në tekstin e mëtejme: RTHV), bazuar në Ligjin për Gjendjen Civile. Më 16 tetor 2013, Komuna e Prishtinës kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se dokumentet e lëshuara nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përkojnë me ato të lëshuara në Republikën e Kosovës, sepse të parat përkojnë me personin A.H., ndërsa të dytat me personin I.F. Parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar vendimin e lartcekur, pa sukses, në Agjencinë e Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Agjencia e Regjistrimit Civil dhe gjykatat e rregullta të të tri shkallëve gjyqësore e vërtetuan vendimin e Komunës së Prishtinës, të 16 tetorit 2013 dhe refuzuan kërkesën e parashtruesit të kërkesës për regjistrim të birit të ndjerë I.F në RTHV. Ato arsyetuan se dokumentet e lëshuara nga institucionet shëndetësore suedeze nuk përputheshin me ato të lëshuara në Republikën e Kosovës.

Më 12 prill 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës i kontestoi konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se vendimet e autoriteteve publike ishin nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet kushtetuese në vijim: neni 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]. Parashtruesi i kërkesës prezantoi dëshmi që vërtetonin vdekjen e të birit të tij dhe pretendoi se të njëjtat nuk ishin marrë parasysh nga gjykatat e rregullta. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi argumentoi se, përtej refuzimit të regjistrimit të vdekjes së të birit të tij në RTHV, vendimet e kontestuara gjithashtu kishin prekur statusin civil të bashkëshortes dhe të nipit të tij, gjegjësisht të birit të të ndjerit I.F

Gjatë seancës dëgjimore, Komuna e Prishtinës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Punëve të Jashtme kishin sqaruar se mungesa e

raportit të mjekësor (të vdekjes) në emër të I.F, e kishte pamundësuar regjistrimin e I.F.-së në RTHV. Ndërsa parashtruesi i kërkesës kishte sqaruar se autoritetet publike nuk kishin marrë parasysh faktet dhe veçoritë e rastit të tij dhe, për më tepër, si rezultat i mosregjistrimit të lartcekur, kishte mbetur me status të pazgjidhur civil edhe bashkëshortja dhe i biri i mitur i të ndjerit.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht sqaroi nëse kërkesa ishte dorëzuar nga një palë e autorizuar. Në lidhje me këtë, Gjykata sqaroi se termi “viktimë”, në kontekst të kërkesave individuale, nënkupton personat që janë prekur në mënyrë direkte ose indirekte nga shkelja e pretenduar. Prandaj, termi “viktimë” nënkupton jo vetëm viktimën direkte të shkeljes së pretenduar, por edhe viktimat indirekte, të cilave shkelja mund t’iu shkaktojë dëm ose të cilat do të kishin interes personal dhe të vlefshëm në ndaljen e shkeljes së pretenduar. Gjykata theksoi se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, statusi i viktimës indirekte apo të tërthortë u është njohur vetëm personave të afërm e të cilët kanë interes ligjor për të paraqitur një kërkesë individuale, në rast të vdekjes ose zhdukjes të personave në emër të të cilëve veprojnë. Gjykata iu referua jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila e ka ndërlidhur pranimin e statusit të viktimës indirekte apo të tërthortë me natyrën e shkeljes së pretenduar dhe rëndësinë e zbatimit efektiv të njërës nga të drejtat më themelore të sistemit të KEDNJ-së. Më specifikisht, GJEDNJ ka pranuar statusin e viktimës familjarëve vetëm atëherë kur kanë pretenduar shkelje të neneve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vijim: neni 2 (E drejta për jetën); neni 3 (Ndalimi i torturës); neni 5 (E drejta për liri dhe siguri); neni 8 (E drejta për Jetë Private).

Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese vuri theksin në specifikat e veçanta të këtij rasti, që ishin të ndërlidhura më një kontest civil që ishte iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me të birin e tij të ndjerë dhe vetëm pas vdekjes së tij. Këto procedura të nisura nga parashtruesi kishin përfunduar në pamundësinë e tij për të regjistruar faktin e vdekjes së të birit të tij, në regjistrin themeltar të vdekjes dhe kjo kishte pasur për pasojë, jo vetëm vuajtjen e vazhdueshme të familjes së tij, por edhe statusin e pazgjidhur civil të bashkëshortes dhe të birit të tij. Rrjedhimisht,

Gjykata Kushtetuese ia njohu parashtruesit statusin e viktimës indirekte. Më tutje, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se rrethanat e rastit konkret ngërthenin çështje që ndërlidheshin me të drejtën në jetë private të parashtruesit të kërkesës dhe të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe zgjidhje efektive, siç janë garantuar me nenet 36 dhe 54 të Kushtetutës dhe me nenet 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

Përkritazi me nenin 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se mosregjistrimi i të ndjerit në RTHV ndërlidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vdekjen e të ndjerit, si dhe me integritetin psikologjik e moral të familjes së tij dhe, për më tepër, me statusin civil të bashkëshortes dhe të birit si rezultat i vdekjes së tij. Familja e parashtruesit të kërkesës ishte vënë në pamundësi për të përmbyllur procesin psikologjik të vdekjes së të birit në aspektin formal dhe juridik, sepse në regjistrat civil të shtetit ai figuronte si i gjallë. Më tutje, Gjykata theksoi se autoritetet publike, përfshirë gjykatat e rregullta, ishin mjaftuar duke konstatuar se mungonte raporti mjekësor që e konfirmonte vdekjen e të birit të parashtruesit të kërkesës. Ky konstatim kishte rezultuar në refuzimin e regjistrimit të birit të parashtruesit të kërkesës në RTHV, me pasojën serioze të lënies së pazgjidhur përfundimisht të statusit civil të bashkëshortes dhe të birit të mitur të të ndjerit. Gjykata Kushtetuese theksoi se gjykatat e rregullta nuk kishin marrë parasysh faktin se, nuk ishte kontestuese se i biri i parashtruesit të kërkesës kishte vdekur dhe një fakt të tillë e kishin konfirmuar edhe vetë autoritetet publike të Republikës së Kosovës, përkatësisht Ambasada e Kosovës në Suedi. Pra, gjykatat e rregullta jo vetëm që kishin aplikuar në mënyrë tejet formale ligjin e aplikueshëm, duke mos konsideruar kështu as mundësinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me shtetin suedez dhe, as mundësitë e dhëna përmes dispozitave të procedurës jokontestimore, por nuk kishin shqyrtuar ekuilibrin në mes të veçorive të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe detyrimeve të shtetit për mbrojtjen e të drejtës në jetë private. Gjykata sqaroi se shqyrtimi i një ekuilibri të tillë do të rezultonte në konstatimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte *“e ngushtë dhe e qartë”* dhe nuk rezultonte në detyrime joproporcionale për shtetin. Për më tepër që, përmes një refuzimi të tillë në mungesë të një raporti mjekësor, duke mos marrë parasysh asnjë nga rrethanat dhe veçoritë që ngërthen rasti konkret, vendimet e autoriteteve publike kishin rezultuar në të drejta kushtetuese

vetëm “*teorike dhe iluzore*” për parashtruesin e kërkesës dhe jo të drejta kushtetuese “*praktike dhe efektive*”, siç kërkohet me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se procedurat e ndjekura të sistemit administrativ e gjyqësor në kundërshtim me detyrimet pozitive të shtetit, nuk kishin rezultuar në realizimin e së drejtës së parashtruesit të kërkesës për respektimin e jetës së tij private, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndërsa, përkritazi me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ, Gjykata Kushtetuese theksoi se në kundërshtim me kërkesat e neneve të lartcekura dhe praktikën relevante gjyqësore, mjetet juridike në rrethanat e rastit konkret nuk kishin rezultuar as në shqyrtimin e thelbit të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe, as nuk kishin mundësuar korrigjimin e duhur. Gjykata ritheksoi se shqyrtimi i kufizuar dhe tejet formal i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në izolim prej veçorive të rastit dhe pasojave përkatëse, kishte rezultuar dhe në mungesë të mbrojtjes gjyqësore praktike dhe efektive të të drejtave dhe të së drejtës për zgjidhje efektive të parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 59 (1), 64 (2) dhe 66 të Rregullores së punës, me shumicë votash, vendosi që të shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; të shpallë të pavlefshme vendimet e Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe të gjykatave në rastin konkret, dhe të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Sektorin e Gjendjes Civile të Komunës së Prishtinës që, deri më 30 tetor 2020 të regjistronte I.F., në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve.

1.2. KI01/21. PARASHTRUESË: AJSHE ALIU

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/11/ki_01_21_agj_shq.pdf]

1 nëntor 2021

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me të drejtën e pretenduar të një nëne biologjike për të njoftuar/kontaktuar fëmijën e saj të dhënë në adoptim dhe i cili tashmë ka arritur moshën madhore. Çështjet që ngërthen kërkesa, ndër të tjera, ndërlidhet me të drejtën në jetë private dhe familjare (neni 36).

Faktet kryesore

Më 1 mars 2016, parashtruesja kishte parashtruar kërkesë në Qendrën për Punë Sociale në kuadër të Komunës së Prishtinës, përmes së cilës kishte kërkuar që fëmija i saj biologjik i moshës madhore, të cilin e kishte dhënë për birësim në vitin 1989, të njoftohet për: (i) ekzistimin e nënës së tij biologjike; dhe (ii) interesimin e saj për t'u njohur me atë. Qendra për Punë Sociale ishte përgjigjur duke theksuar se (i) nuk kishte bazë ligjore për të njoftuar fëmijën e saj biologjik në lidhje me birësimin e tij; dhe se (ii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 194 (Parimet) të Ligjit për Familjen të Kosovës, qasja në informatë në lidhje me prindërit biologjikë i garantohet vetëm fëmijës së adoptuar të moshës madhore në bazë të kërkesës së tij/saj. Më 11 mars 2016, parashtruesja në Qendrën për Punë Sociale kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të përgjigjes. Parashtruesja e kërkesës, në kërkesën e saj për rishqyrtim të përgjigjes së lartcekur, specifikoi se kërkesa e saj nuk kishte qenë mbi informimin e [saj] për të dhënat dhe rrethanat e adoptimit të fëmijës, por kishte të bënte me obligimin që ka Qendra për Punë Sociale për ta njoftuar fëmijën madhor në lidhje me birësimin. Qendra për Punë Sociale, kërkesën e parashtrueses e kishte adresuar te Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale [në tekstin e mëtejme: Departamenti i MPMS-së]. Më 25 mars 2016, Komisioni për Shqyrtim dhe Vendosjen e Ankesave në shkallë të dytë në kuadër të Departamentit të MPMS-së (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Ankesa i MPMS-së) e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e

parashtrueses për rishqyrtim të përgjigjes së Qendrës për Punë Sociale. Komisioni për Ankesa, në Aktvendimin e tij, duke iu referuar Ligjit për Familjen dhe Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Adoptimit të Fëmijëve pa Përkujdesje Prindërore, arsyetoi se Qendra për Punë Sociale nuk kishte asnjë mbështetje ligjore dhe obligim ligjor që ta informojë fëmijën e adoptuar për familjen biologjike, përderisa fëmija biologjik nuk paraqet kërkesë me shkrim për njohjen e prindërve biologjikë. E drejta ekskluzive për kërkim të prindërve biologjikë është e fëmijës. Më 29 prill 2016, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore për konflikt administrativ, duke kërkuar anulimin e aktvendimit të Komisionit për Ankesa të MPMS-së dhe duke detyruar Departamentin e MPMS-së që të informonte fëmijën në lidhje me të drejtat e tij që rrjedhin nga Ligji për Familjen dhe nga Udhëzimi Administrativ i MPMS-së. Më 7 maj 2018, Avokati Shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Departamentit të MPMS-së, kishte paraqitur përgjigje ndaj padisë së parashtrueses, duke kërkuar që të hidhej poshtë padia e parashtrueses së kërkesës. Më 25 janar 2019, Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës duke vërtetuar konstatimet e lartcekura të Qendrës për Punë Sociale dhe të Komisionit për Ankesa pranë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe duke konstatuar se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Qendra për Punë Sociale nuk është e obliguar që të njoftojë fëmijën në lidhje me birësimin e tij dhe se të drejtën e qasjes në të dhëna të tilla e ka vetëm i adoptuari i moshës madhore në bazë të kërkesës së tij. Kundër aktgjyqimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, më 6 shkurt 2019 parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Më 15 maj 2020, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës. Gjykata e Apelit konstatoi se nuk ka obligim ligjor që Qendra për Punë Sociale ta njoftojë fëmijën e adoptuar, tashmë të moshës madhore, për nënën e tij biologjike përderisa ai nuk kishte paraqitur kërkesë për njohjen e prindërve biologjike. Gjykata e Apelit po ashtu argumentoi se të dhënat për adoptimin dhe rrethanat e tij nuk duhet të zbulohen ose hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe fëmijës, përveç nëse këtë e kërkojnë arsye të veçanta të interesit publik. Si rezultat i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të parashtruar në Gjykatën Supreme, kjo e fundit përmes aktgjyqimit të 11 qershorit 2020, këtë kërkesë të parashtrueses së

kërkesës gjithashtu e refuzoi si të pabazuar. Gjykata Supreme përmes aktgjykimit të kontestuar kishte vërtetuar konstatimet e Gjykatës Themelore dhe ato të Apelit dhe kishte përfunduar se të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për arsye të interesit publik.

Më 5 janar 2021, parashtruesja paraqiti kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese i kontestoi konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, përfshirë edhe ato të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë. Thelbi i pretendimit të parashtrueses së kërkesës para Gjykatës Kushtetuese ishte se gjykatat e rregullta i kishin shkelur asaj të drejtën për jetë private, të garantuar me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, duke mos i miratuar asaj kërkesën për njoftimin e fëmijës së saj biologjik në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe interesimin e parashtrueses së kërkesës për ta njoftuar atë. Si rezultat i kësaj, ajo po ashtu kishte pretenduar: (i) shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ, për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor; si dhe (ii) shkelje të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, fillimisht, shpalli kërkesën e pranueshme për shqyrtim të meritave të saj. Në vlerësimin e thelbit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata Kushtetuese u fokusua në garancitë e mishëruara në nenin 36 (E Drejta e Privatësisë) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ. Në këtë sfond, Gjykata së pari shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, dhe më pas, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata theksoi se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, përmes së cilës kishte shprehur interesimin

e saj për t'u njohur me fëmijën e saj të dhënë për adoptim në vitin 1989, ngërthente elemente që i përkasin një pjese të rëndësishme të identitetit të saj si nënë biologjike dhe të cilat afektonin të drejtën e saj për jetë private në kuptim të nocionit të “*jetës së saj private*” të garantuar me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të KEDNJ. Thënë këtë, duke pasur parasysh që ky pretendim afektonte të drejtën e saj për jetë private, Gjykata Kushtetuese theksoi se gjatë shqyrtimit të rasteve për të konstatuar nëse në një rast konkret ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, aplikon të njëjtat koncepte, përkatësisht nëse kufizimi apo ndërhyrja përkatëse: (i) ishte “*në përputhje me ligjin*” ose “*e përcaktuar me ligj*”; (ii) kishte “*ndjekur një qëllim legjitim*”; dhe (iii) ishte “*e domosdoshme në një shoqëri demokratike*”. Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese në rrethanat e rastit konkret vlerësoi se vendimet e gjykatave të rregullta, përmes të cilave ishte refuzuar kërkesa specifike e parashtrueses së kërkesës: (i) ishin të bazuara në ligj; (ii) kishin ndjekur një qëllim legjitim – mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të fëmijës së adoptuar dhe familjes së tij adoptuese; dhe (iii) kishin ndjekur një ekuilibër të drejtë në mes të interesave të fëmijës së adoptuar, tashmë të moshës madhore, dhe respektimit të së drejtës së tij private dhe familjare brenda familjes së tij adoptuese. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ishte i përfshirë në shkelje të së drejtës së saj për jetë private të garantuar me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të KEDNJ.

Ndërsa, përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës), si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Në këtë vazhdë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në rastin konkret, aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmbushte kriteret dhe standardin për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi që ta shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ.UZVP. nr.37/2020, i 11 qershorit 2020, është në pajtueshmëri me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së; të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ.UZVP. nr.37/2020, i 11 qershorit 2020, është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATES EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. AKTAŞ DHE ASLANISKENDER kundër TURQISË

[18684/07 DHE21101/07]

GJEDNJ [Seksioni i Dytë]

25 qershor 2019

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: Refuzimi i autoriteteve vendore për të lejuar ndryshimin e mbiemrave, përbënte ndërhyrje në jetën private dhe familjare, vlerësuar nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit në këtë sferë.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Aktaş, një asirian me shtetësi të dyfishtë, turke dhe zvicerane (kërkuesi i parë) dhe Aslaniskender (kërkuesi i dytë), një budist, kundër Republikës Turke. Kërkuesi i parë aplikoi në Gjykatën Rajonale të Midjatit për të ndryshuar mbiemrin e tij nga “Aktaş” në “Amno”, me arsyetimin se: (i) ishte një asirian etnik dhe se ai dhe familja

e tij njiheshin me emrin “Amno”; (ii) vëllait të tij i ishte miratuar tashmë ndryshimi i kërkuar i emrit nga Gjykata Rajonale e Midjatit; (iii) pasja e dy mbiemrave të ndryshëm në dy dokumentet e tij të identitetit, paraqiste probleme praktike në jetën e tij të përditshme.

Gjykata Rajonale e Midjatit pyeti Institutin e Gjuhës Turke nëse mbiemri i kërkuar ishte fjalë turke. Instituti u përgjigj se “Amno” nuk ishte fjalë turke. Prandaj, kërkesa e kërkuarit për ndryshimin e emrit u hodh poshtë. Për më tepër, sipas Ligjit nr. 2525, emrat e huaj nuk mund të zgjidheshin si mbiemra. Përveç kësaj, neni 5 i Rregullores për mbiemrat parashikonte që vetëm emrat në gjuhën turke mund të merreshin si mbiemra. Z. Aktaş apeloj pa sukses.

Kërkuari i dytë arriti të regjistronte fenë budiste në kartën e tij të identitetit turk në vend të “Islamit”. Në vitin 2002 ai aplikoi në Gjykatën Rajonale të Ankarasë, ku ngriti një padi për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit të tij në “Padmapanys Leonalexandros”, duke u mbështetur në besimet e tij fetare, lirinë e tij personale dhe lirinë e tij të ndërgjegjes dhe të shprehjes. Një indolog vuri në dukje se emri i kërkuar ishte një term sanskritisht i rëndësishëm për budizmin, por se kjo nuk vlente për mbiemrin e kërkuar, i cili ishte një përkthim fjalë për fjalë në greqisht i mbiemrit të tij aktual. Gjykata e rrëzoi kërkesën e tij me arsyetimin se ishte në kundërshtim me Ligjin nr. 403 për kombësinë turke. Në apel, Gjykata e Kasacionit e prishi vendimin për shkak të defektit procedural. Gjykata Rajonale e Ankarasë rifilloi procedurat, duke refuzuar që ai të ndryshojë emrin e tij në “Padmapani Leonalexandros”, me arsyetimin se “Leonalexandros” ishte përkthyer nga turqishtja në greqisht. Më pas, kërkuari aplikoi në gjykatë për të ndryshuar emrin e tij në “Padmapani Paramabindu” dhe në vitin 2004 gjykata e pranoi kërkesën. Megjithatë, Regjistri i Gjendjes Civile dhe Prokurori Publik i Ankarasë apeloan dhe Gjykata e Kasacionit mbështeti kërkesën e tij për ndryshimin e emrit të tij, por anuloi vendimin për t’i lejuar atij të ndryshonte mbiemrin e tij, me arsyetimin se ishte e paligjshme zgjedhja e emrave të huaj si mbiemër. Në shtator 2005, Gjykata Rajonale e Ankarasë vendosi të ndryshojë emrin e tij në “Padmapani”, por hodhi poshtë kërkesën e tij për të ndryshuar mbiemrin. Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë kërkesën e tij për korrigjim të aktgjykimit.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit u ankuan se refuzimi i autoriteteve vendore për të ndryshuar mbiemrat e tyre në regjistrin e gjendjes civile ishte shkelje e të drejtave të tyre sipas nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.

Qeveria u përgjigj se kërkuesit nuk kishin demonstruar ndonjë shkelje të të drejtave të tyre sipas nenit 8, sepse refuzimi nga gjykatat kombëtare për të autorizuar ndryshimin e mbiemrave nuk ishte një ndërhyrje. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së bënte dallimin midis detyrimit të ndryshimit të emrit – që do të përbënte ndërhyrje – dhe refuzimit për të lejuar një individ të marrë një emër të ri. Dhe, edhe nëse Gjykata do të arrinte në përfundimin se kishte pasur një ndërhyrje, ajo ndërhyrje do të ishte e justifikuar. Zgjedhja e mbiemrave nuk ishte tërësisht çështje e preferencës personale; dhe shtetet palë gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë drejtim. Legjislacioni që kërkon që mbiemrat të jenë turq justifikohet nga interesi publik, për shembull, në pandryshueshmërinë e mbiemrave, saktësinë e regjistrave të lindjes dhe identifikimin e individëve dhe familjeve të tyre.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata theksoi se Konventa nuk përmbante një dispozitë të qartë për emrat; megjithatë, emri i një personi ishte gjithsesi i lidhur me jetën private dhe familjare, si një mjet identifikimi personal dhe i lidhjes me familjen. Fakti që shteti dhe shoqëria kishin interes për të rregulluar përdorimin e tij nuk mjaftonte për të përjashtuar çështjen e emrit të një personi nga fusha e jetës private dhe familjare. Prandaj, aplikimet ishin brenda fushëveprimit të nenit 8. Ndërsa pranoi se mund të kishte arsye të forta që një individ të dëshironte të ndryshojë emrin e tij ose të saj, Gjykata konsideroi se kufizimet ligjore për një mundësi të tillë mund të justifikohen në interesin publik: për shembull, për të mbrojtur identitetin dhe identifikimin personal ose për të lidhur bartësit e një emri të caktuar për një familje - dhe shtetet palë gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë çështje.

Çështjet e tanishme kishin të bënin me refuzimin e gjykatave vendore për të lejuar kërkuesit të ndryshonin mbiemrat e tyre dhe nuk kishin ngritur asnjë çështje në lidhje me emrat e tyre. Gjykatat vendase kishin hedhur poshtë pretendimet e kërkuesve vetëm sepse, në përputhje me nenin 3 të Ligjit nr. 2525 dhe nenin 5 të Rregullores për mbiemrat, emrat që nuk ishin turq nuk mund të zgjidheshin si mbiemra. Formulimi i nenit 3 të Ligjit 2525 nuk parashikonte një ndalim të përgjithshëm për emrat që nuk janë turq. Sipas kësaj dispozite, ligjvënësi turk kishte ndaluar, ndër të tjera, “përdorimin e emrave të huaj të racës dhe kombit”, por jo emra që nuk janë me origjinë në gjuhën turke – që duket të jenë të ndryshëm. Ndalimi i emrave që nuk kanë origjinë në gjuhën turke ishte në nenin 5 të Rregullores për mbiemrat, i cili përjashtonte mundësinë e adoptimit të mbiemrave joturq.

Autoritetet kombëtare, në parim, ishin të vendosura më mirë për të vlerësuar nivelin e shqetësimit që i atribuohet përdorimit të një emri dhe jo të një tjetri në shoqëritë e tyre. Për të përcaktuar nëse kishte pasur shkelje në një çështje të caktuar, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse zbatimi i legjislacionit ishte mjaftueshëm fleksibël për nevojat e personave që dëshironin të ndryshonin emrat e tyre – por gjykatat kombëtare duhej të tregonin se kishin peshuar interesat në rrezik. Në këtë rast, gjykatat kombëtare nuk kishin bërë asnjë vlerësim të interesave në fjalë: ato kishin kryer një shqyrtim thjesht formalist të teksteve legjislative dhe rregullatore, pa marrë parasysh situatat specifike dhe personale të palëve të interesuara ose argumentet e tyre, dhe pa balancuar interesat në pyetje. Për më tepër, Qeveria nuk kishte demonstruar se si ndryshimi i emrave të kërkuesve në joturq ka të ngjarë të shqetësojë interesin publik. Kjo ishte edhe më e dukshme në rastin e kërkuesit të parë, vëllai i të cilit ishte lejuar të ndryshonte mbiemrin në «Amno».

Përfundimisht, Gjykata theksoi se autoritetet turke kishin dështuar të arrinin një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese të kërkuesve dhe të shoqërisë në tërësi. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 8. Nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej veçmas nëse kishte pasur edhe shkelje të nenit 14.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi, njëzëri, se kishte shkelje të nenit 8; se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej veçmas nëse kishte pasur edhe shkelje të nenit 14; dhe vendosi që shteti i paditur, bazuar në nenin 41, do të paguajë nga 1500 (njëmijë e pesëqind) euro për secilin prej kërkuesve për dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. U. kundër STADT KARLSRUHE

**GJDBE
C101/13**

2 tetor 2012

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=158189&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13712045>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Ky vendim kishte të bënte me të drejtën e emrit të një personi, përfshirë edhe mënyrën se si shkruhet në dokumente, si pjesë e së drejtës për jetë private*

Faktet kryesore

Mbiemri i paditësit në procedurën kryesore është U. dhe emrat e tij të parë janë S P. Emri i tij i lindjes, i cili nuk është pjesë e mbiemrit të tij, është E. Nga dosja gjyqësore rezulton se parashtruesi ka fituar titullin “Doktor” i cili, sipas ligjit gjerman, konsiderohet të jetë pjesë e emrit.

Në fushat e përcaktuara “Name/Surname/Nom”¹⁵⁷ të pasaportës së tij, tregohet si vijon:

157 Pra “Mbiemri”.

“DR [U]
GEB [E]”

Paditësi në procedurën kryesore vlerëson se shkrimi i emrit të tij në pasaportë është i pasaktë dhe se kjo çon në keqkuptime kur ai udhëton jashtë vendit për arsye profesionale. Ai konsideron se përfshirja, në pasaportën e tij, në fushën e përdorur për mbiemrin, të emrit të tij të lindjes, i cili nuk është pjesë e emrit të tij siç përcaktohet nga ligji i brendshëm në lidhje me gjendjen civile, i paraprirë nga shkurtesa “GEB”, si shkurtim i “geboren” (i lindur), ka si pasojë që, në marrëdhëniet e tij të biznesit me persona privatë dhe kur merrte viza, atë e quanin, për shembull, “Z. GEB [E]”, “M. [E U]”, “Dr [U] GEB [E]” apo edhe “[S E] Dr [U]”.

Për këtë arsye, paditësi në procedurën kryesore i kërkoi Stadt Karlsruhe¹⁵⁸ që të modifikonte të dhënat e pasaportës së tij në mënyrë që të dilte pa mëdyshje, veçanërisht për personat jogjermanë, se emri i tij është ‘Dr U’. Stadt Karlsruhe e refuzoi këtë kërkesë. Pas këtij refuzimi, paditësi në procedurën kryesore u drejtua pa sukses në Regierungspräsidium Karlsruhe, dhe pastaj, me një padi për anulim të akteve administrative edhe në Verwaltungsgericht Karlsruhe. Pas refuzimit nga kjo e fundit paditësi iu drejtua Verwaltungsgerichtshof Baden-Württemberg e cila vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i referojë pyetjet e mëposhtme Gjykatës për një vendim paraprak:

Së pari, gjykata referuese pyeti, në thelb, nëse shtojca e Rregullores nr. 2252/2004 duhet të interpretohet sikur kërkon që faqja e të dhënave personale të lexueshme nga makina e pasaportave, e hartuar nga shtetet anëtare, të përmbushë të gjitha specifikimet e detyrueshme të Dokumentit 9303, Pjesa 1, të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

Me pyetjet e dyta dhe të treta, të cilat Gjykata i shqyrtoi së bashku, gjykata referuese pyeti, në thelb, nëse shtojca e Rregullores nr. 2252/2004, e lexuar bashkë me Dokumentin e ICAO 9303, Pjesa 1, duhet të interpretohet sikur lejon një shtet anëtar, legjislacioni i të cilit parashikon që emri i një personi përbëhet nga emrat dhe mbiemri i tij,

158 Bashkisë së Karlsruhe.

që ai shtet të shtojë edhe emrin e lindjes së personit në fushat e caktuara 06 dhe 07 të faqes të të dhënave personale në pasaportë?

Me pyetjen e saj të katërt dhe të pestë, gjykata referuese pyeti nëse Rregullorja e mësipërme, duhet të interpretohet në dritën e nenit 7 të Kartës, në kuptimin që, kur ligji i një shteti anëtar parashikon të përfshijë edhe emrin e lindjes së mbajtësit të pasaportës në fushat 06 dhe/ose 07 të faqes së të dhënave personale të lexueshme nga makina të pasaportës, ai duhet të tregojë që emri i lindjes është shënuar në të.

Me pyetjen e saj të gjashtë, gjykata referuese pyeti, në thelb, nëse shtojca e Rregullores së mësipërme duhet interpretuar se nuk lejon të tregohet edhe emri i lindjes si e dhënë personale opsionale në faqen e lexueshme të të dhënave personale të pasaportës.

Përmbledhja e vendimit

Gjykata theksoi se Shtojca e Rregullores nr. 2252/2004, që përcakton standardet për veçoritë e sigurisë dhe elementët biometrikë të integruar në pasaporta dhe dokumente udhëtimi të lëshuara nga shtetet anëtare, e ndryshuar me Rregulloren nr. 444/2009, duhet interpretuar ashtu që kërkon që të dhënat personale në faqen e pasaportave të lexueshme nga makina të plotësojnë të gjitha specifikimet e detyrueshme të përcaktuara në Dokumentin e ICAO 9303, Pjesa 1.

Sipas Gjykatës, dispozitat a lartpërmendura evropiane, lexuar në kombinim me Dokumentin e ICAO 9303, Pjesa 1, duhet të interpretohet se nuk përjashtojnë që, kur ligji i një shteti anëtar parashikon që emri i një personi përbëhet nga emrat dhe mbiemrat e tyre, ky shtet megjithatë mund të përfshijë edhe emrin e lindjes ose si identifikues parësor në fushën 06 të faqes së të dhënave personale, të lexueshme nga makina të pasaportës, ose si identifikues dytësor, në fushën 07 të kësaj faqeje, ose në një fushë të vetme të përbërë nga fushat 06 dhe 07 në fjalë.

Në këtë drejtim, sipas Gjykatës del qartë nga Dokumenti i ICAO 9303, Pjesa 1, Seksioni IV, pika 5.2, se specifikimet për përmbajtjen e faqes së të dhënave personale të lexueshme nga makina të pasaportës janë krijuar për të qenë të përshtatshme për larminë e kërkesave ligjore dhe

të zakoneve të shteteve të ndryshme që i lëshojnë. Nga kjo rrjedh se, brenda kufijve të kërkesave themelore në prezantimin e standardizuar të kësaj faqe, shtetet lëshuese kanë një diferencë manovrimi në zgjedhjen e elementeve që do të futen në fushat e ndryshme të të dhënave të faqes në fjalë. Duke pasur parasysh këtë hapësirë për manovrim që u është dhënë shteteve dhe meqenëse Dokumenti i ICAO 9303, pjesa 1, seksioni IV, pika 8.6, i referohet “emrit të plotë, të identifikuar nga shteti lëshues” pa e specifikuar më tej këtë koncept, ky i fundit duhet të interpretohet se u lejon këtyre shteteve një hapësirë vlerësimi në zgjedhjen e elementeve që përbëjnë “emrin e plotë”. Një përfundim i tillë vërtetohet nga objektivi i ndjekur nga Rregullorja nr. 2252/2004 për krijimin e një lidhjeje të besueshme midis pasaportës dhe mbajtësit të saj.

Gjykata saktësoi se Shtojca e Rregullores nr. 2252/2004, që përcakton standardet për veçoritë e sigurisë dhe elementët biometrikë të integruar në pasaporta dhe dokumente udhëtimi të lëshuara nga shtetet anëtare, e ndryshuar me Rregulloren nr. 444/2009, lexuar së bashku me dispozitat e Dokumentit të ICAO 9303, Pjesa 1, Seksioni IV, pika 8.6, duhet të interpretohen se ndalojnë që, kur legjislacioni i një shteti anëtar parashikon që emri i një personi përbëhet nga emrat dhe mbiemrat e tij, ky shtet të mund të shkruajë edhe emrin e lindjes si e dhënë personale opsionale në fushën 13 të faqes së të dhënave personale, të lexueshme nga makina të pasaportës.

Sipas Gjykatës, në këtë fushë mund të përmenden vetëm elementë të të dhënave, për të cilët, për shkak të natyrës, nuk janë të detyrueshëm dhe nuk është parashikuar që duhet të figurojnë në një fushë tjetër të të dhënave. Për më tepër, nëse shtetet që lëshojnë pasaporta mund të përfshijnë informacion në lidhje me emrin në fusha të tjera nga ato të caktuara shprehimisht për këtë qëllim, do të kishte rrezik që autoritetet publike të gabonin në identifikimin e mbajtësit të një pasaporte, gjë që do të binte ndesh me objektivin për të siguruar, me anë të një prezantimi mjaft të standardizuar të të dhënave përkatëse, një nivel të kënaqshëm të besueshmërisë së dokumenteve të udhëtimit dhe, kështu, lehtësimin e formaliteteve të inspektimit.

Gjykata shtoi se aktet e mësipërme evropiane, lexuar bashkë me dispozitat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) Dokumenti 9303, Pjesa 1, duhet të interpretohen nën dritën e nenit

7 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, në lidhje me kuptimin që, kur legjislacioni i një shteti anëtar parashikon që emri i një personi përbëhet nga emrat dhe mbiemrat e tij, nëse ai shtet zgjedh gjithsesi të përfshijë edhe emrin e lindjes së mbajtësit të pasaportës në fushat 06 dhe/ose 07 të faqes së të dhënave personale të lexueshme nga makina të pasaportës, ai duhet të tregojë, pa mëdyshje, në emërtimin e këtyre fushave që aty tregohet emri i lindjes.

Në këtë drejtim, nëse në përmbushje të objektivave të Rregullores Nr. 2252/2004, një shtet ka mundësinë të shtojë në emrin e mbajtësit të pasaportës, siç përcaktohet nga ligji i tij i brendshëm për gjendjen civile, elemente të tjera, në veçanti emrin e lindjes, duhet që mënyra e ushtrimit të kësaj mundësie të respektojë të drejtën për jetën private të palës së interesuar. Gjithashtu, për të respektuar këtë të drejtë, emri i mbajtësit duhet të dallohet qartë nga këto elemente shtesë, gjë që nuk pengon në asnjë mënyrë arritjen e objektivave të Rregullores nr. 2252/2004. Është e kuptueshme që tregimi i paqartë ose i pasaktë i emrit të një personi në dokumentet e lëshuara nga një shtet me qëllim vërtetimin e identitetit të tij ka të ngjarë të shkaktojë shqetësime serioze në jetën e tij private dhe profesionale në masën që mund të ngrejë dyshime për identitetin e tij të vërtetë, vërtetësinë e pasaportës ose vërtetësinë e informacionit që përmban.

3.2. “FACEBOOK IRELAND” DHE TË TJERËT

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështjet e bashkuara C-645/19

15 qershor 2021

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=242821&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13712709>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar; sipas Gjykatës RGPD autorizon, sipas kushteve të veçanta, një autoritet mbikëqyrës të një shteti anëtar, edhe kur nuk është autoriteti kryesor për këtë qëllim, që të nisë procedurat kur mendon se ka shkelje në trajtimin e të dhënave personale.

Faktet kryesore

Më 11 shtator 2015, Kryetari i Komisionit belg për Mbrojtjen e Privatësisë (në tekstin e mëtejme: “CPVP”) bëri një padi për pushim cenimi përpara Nederlandstalige rechtbank van eerste aanleg në Bruksel¹⁵⁹, kundër “Facebook Irlandë”, “Facebook Inc.” dhe “Facebook Belgjikë”, duke pretenduar që këto t’i jepnin fund shkeljeve të legjislationit për mbrojtjen e të dhënave. Këto shkelje konsistonin në veçanti në mbledhjen dhe përdorimin e informacionit mbi sjelljen dhe kërkimet nga përdoruesit belgë në internet, pavarësisht nëse kanë apo jo një llogari në Facebook, duke përdorur teknologji të ndryshme, si cookies, modulet sociale¹⁶⁰ ose pikselët.

Më 16 shkurt 2018, gjykata e lartpërmendur u deklarua kompetente për të vendosur mbi këtë padi dhe, në themel, konsideroi se rrjeti social Facebook nuk i kishte informuar sa duhet përdoruesit belgë të internetit për mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave në fjalë. Përveç kësaj, pëlqimi i dhënë nga përdoruesit e internetit në mbledhjen dhe trajtimin e këtyre të dhënave u konsiderua i pavlefshëm.

Më 2 mars 2018, “Facebook Irlandë”, “Facebook Inc.” dhe “Facebook Belgjikë” apelian kundër këtij vendimi para Hof van beroep te Brussel¹⁶¹, që është edhe gjykata referuese në këtë rast. Para kësaj gjykate, Autoriteti Belg i Mbrojtjes së të Dhënave (në tekstin e mëtejme: “AMDH”) zëvendësoi në procedurë Kryetarin e CPVP-së. Gjykata e Apelit u deklarua kompetente vetëm për apelin e paraqitur nga “Facebook Belgjika”. Gjykata e Apelit shprehu dyshime për ndikimin e aplikimit të “Sporteli unik” të parashikuar nga Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave¹⁶² (në tekstin e mëtejme: RGPD) për zotësinë e AMDH-së dhe, në veçanti, nëse, për faktet pas hyrjes në fuqi të RGPD, më 25 maj 2018, AMDH mund të ngrinte padi kundër “Facebook Belgjikës”, ndërkohë që “Facebook Irlanda” ishte identifikuar si përgjegjëse e trajtimit të

159 Gjykata e parë - Organ holandisht-folës në Bruksel.

160 Si për shembull funksionet “pëlqej” ose “shpërndaj”.

161 Gjykata e Apelit e Brukselit.

162 Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të dhënave të tilla. (OJ 2016, L 119, f. 1).

të dhënave në fjalë. Në të vërtetë, që nga ajo datë dhe në veçanti në zbatim të parimit të “sportelit unik” të parashikuar nga RGPD, vetëm Komisioneri Irlandez i Mbrojtjes së të Dhënave do të ishte kompetent për të ngritur një padi për pushim cenimi para gjykatave irlandeze.

Përmbledhja e vendimit

Së pari, Gjykata specifikoi kushtet në të cilat një autoritet kombëtar mbikëqyrës, si AMDH duke mos pasur cilësinë e autoritetit drejtues në lidhje me trajtimin ndërkufitar, mund të ushtrojë kompetencat e tij dhe të kundërshtojë çdo shkelje të pretenduar të RGPD-së para një juridiksioni të një shteti anëtar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqitet si palë për të siguruar zbatimin e kësaj rregulloreje. Kështu, nga njëra anë, RGPD duhet t’i japë këtij autoriteti mbikëqyrës një kompetencë për të miratuar një vendim që konstaton se trajtimi nuk respekton dispozitat e kësaj rregulloreje dhe, nga ana tjetër, ky pushtet duhet të ushtrohet në përputhje me procedurat e bashkëpunimit dhe të kontrollit të koherencës të parashikuar nga kjo rregullore.

Në të vërtetë, për trajtimin ndërkufitar, RGPD parashikon mekanizmin e “sportelit unik”¹⁶³ i cili bazohet në një shpërndarje të kompetencave ndërmjet një “autoriteti udhëheqës mbikëqyrës” dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse kombëtare të interesuara. Ky mekanizëm kërkon bashkëpunim të ngushtë, luajal dhe efikas ndërmjet këtyre autoriteteve, në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje e qëndrueshme dhe uniforme e rregullave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe në këtë mënyrë të ruajnë efektin e dobishëm të Rregullores. Në këtë kuptim, RGPD i njeh si parim kompetencën autoritetit mbikëqyrës kryesor për të miratuar një vendim që konstaton se trajtimi ndërkufitar nuk respekton rregullat e parashikuara nga kjo Rregullore, ndërsa kompetenca e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse kombëtare për të miratuar një vendim të tillë, edhe përkohësisht, është përjashtimi. Megjithatë, në ushtrimin e kompetencave të tij, autoriteti mbikëqyrës kryesor nuk mund të veprojë pa një dialog të domosdoshëm dhe një bashkëpunim luajal dhe efektiv me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të interesuara. Prandaj, si pjesë e

163 Neni 56, paragrafi 1, i RGPD-së.

këtij bashkëpunimi, autoriteti mbikëqyrës kryesor nuk mund të injorojë pikëpamjet e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të interesuara dhe, çdo kundërshtim përkatës i arsyetuar dhe i formuluar nga ana e këtyre autoriteteve të fundit, ka efektin e bllokimit, të paktën përkohësisht, të miratimit të projektvendimit të autoritetit drejtues mbikëqyrës.

Gjykata saktësoi më tej se fakti që një autoritet mbikëqyrës i një shteti anëtar që nuk është autoriteti mbikëqyrës kryesor për trajtimin ndërkufitar të të dhënave të mos mund të ngrëjë një shkelje të pretenduar të RGPD para një gjykate të këtij shteti dhe të mos mund të paraqitet si palë në procedurat përkatëse me qëllim që të respektojë shpërndarjen e kompetencave vendimmarrëse ndërmjet autoritetit mbikëqyrës kryesor dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse është në përputhje me nenet 7, 8 dhe 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, që u garantojnë subjekteve të të dhënave, përkatësisht, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale dhe të drejtën për një mjet efektiv juridik.

Së dyti, Gjykata vendosi se, në rast të trajtimit ndërkufitar të të dhënave, ushtrimi i kompetencave të një autoriteti mbikëqyrës të një shteti anëtar, përveç autoritetit mbikëqyrës kryesor, për të ndërmarrë veprime ligjore nuk kërkon që kontrolluesi ose përpunuesi i trajtimit ndërkufitar të të dhënave personale kundër të cilit bëhet padia ta ketë selinë kryesore ose një seli tjetër në territorin e atij shteti anëtar. Megjithatë, ushtrimi i kësaj kompetence duhet të përfshihet në fushën e zbatimit territorial të RGPD-së, që nënkupton që kontrolluesi ose përpunuesi për trajtimin ndërkufitar është i vendosur në territorin e BE-së.

Së treti, Gjykata vendosi se, në rast të trajtimit ndërkufitar të të dhënave, kompetenca e një autoriteti mbikëqyrës të një shteti anëtar, përveç autoritetit mbikëqyrës kryesor, për të kundërshtuar çdo shkelje të pretenduar të RGPD-së para një juridiksioni të atij shteti anëtar dhe, nëse është e nevojshme, të dalë si palë mund të ushtrohet, si ndaj selisë kryesore të subjektit përgjegjës për trajtimin që ndodhet në atë shtet anëtar ku ky autoritet vepron, ashtu edhe ndaj çdo selie të subjektit përgjegjës, për aq sa procedura ligjore lidhet me trajtimin e të dhënave të kryer në kuadrin e aktiviteteve të këtij autoriteti dhe se ky autoritet e ka këtë kompetencë.

Megjithatë, Gjykata sqaroi se ushtrimi i kësaj kompetence presupozon që të zbatohet RGPD. Në rastin konkret, aktivitetet e grupit “Facebook” me vendndodhje në Belgjikë janë të lidhura në mënyrë të pandashme me trajtimin e të dhënave personale objekt shqyrtimi në procedurën kryesore, dhe përderisa “Facebook Irlandë” është kontrolluesi në lidhje me territorin e BE-së, ky trajtim është kryer “në kuadrin e veprimtarive të një selie të subjektit përgjegjës për trajtimin” dhe për rrjedhojë, përfshihet në fushën e veprimit të RGPD-së.

Së katërti, Gjykata vlerësoi se, kur një autoritet mbikëqyrës i një shteti anëtar i cili nuk është “autoriteti mbikëqyrës kryesor” ka filluar, përpara datës së hyrjes në fuqi të RGPD-së, procedura ligjore për trajtimin ndërkufitar të të dhënave personale, këto procedura mund të vazhdojnë, sipas së drejtës së BE-së, në bazë të dispozitave të Direktivës mbi mbrojtjen e të dhënave, e cila mbetet e zbatueshme në lidhje me shkeljen e rregullave të saj deri në datën kur është shfuqizuar¹⁶⁴. Përveç kësaj, këto procedura mund të nisin nga ky autoritet për shkelje të kryera pas datës së hyrjes në fuqi të RGPD, me kusht që kjo të bëhet në një nga situatat ku, si përjashtim, kjo Rregullore i jep këtij autoriteti kompetencë për të miratuar një vendim që konstaton se trajtimi i të dhënave në fjalë nuk respekton rregullat e parashikuara nga kjo rregullore dhe të jetë në përputhje me procedurat e bashkëpunimit të parashikuara prej saj.

Së pesti dhe së fundi, Gjykata njeh efektin e drejtpërdrejtë të dispozitave të RGPD-së në bazë të të cilave çdo shtet anëtar parashikon, me ligj, se autoriteti i tij mbikëqyrës ka kompetencë të kundërshtojë çdo shkelje të kësaj rregulloreje para autoriteteve gjyqësore dhe, sipas rastit, të paraqitet si palë. Prandaj, ky autoritet mund ta përdorë këtë dispozitë për të filluar ose vazhduar një procedurë kundër individëve, edhe nëse nuk është parashikuar në mënyrë specifike në legjislacionin e shtetit anëtar në fjalë.

¹⁶⁴ Direktiva 95/46/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 24 tetorit 1995 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me trajtimin e të dhënave me karakter personal dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (JO 1995, L 281, p. 31).

Neni 37

E Drejta e Martesës dhe Familjes

- 1. Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.*
- 2. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.*
- 3. Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI63/09. PARASHTRUES: BAJRAM SANTURI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/ki_63_09_shq.pdf]

17 gusht 2011

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Parashtruesi ngriti dy pretendime, për dy procedura të ndryshme gjyqësore. Njëra procedurë kishte të bënte me refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për trashëgiminë pronësore kundër hallës dhe axhës së tij dhe pretendimi i tij se me këtë refuzim atij i ishte shkelur e drejta e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]. Ndërsa procedura e dytë administrative dhe gjyqësore ishte zhvilluar në Suedi dhe kishte të bënte me ndalimin që i ishte bërë parashtruesit të kërkesës që të takonte gruan dhe vajzën e tij. Çështja e ngritur në lidhje me procedurën e dytë kishte të bënte me shkeljen e mundshme të nenit 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes].

Faktet kryesore

Kërkesa e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga parashtruesi ngërthente dy procedura gjyqësore të ndryshme. Njëra procedurë ishte zhvilluar në Kosovë dhe lidhej me një kontest për trashëgiminë dhe që përfshin edhe disa procedura për konteste pronësore të zhvilluara, me disa palë procedurale, duke përfshirë edhe parashtruesin. Procedura tjetër, që kishte të bënte me nenin 37, ishte zhvilluar në Suedi, me ç' rast parashtruesit i ishte ndaluar të takonte vajzën dhe bashkëshorten e tij.

Për sa i përket procedurave për kontestin trashëgimor: në këto procedura parashtruesi nuk kishte mundur të realizonte të drejtat e tij të pretenduara pronësore përmes trashëgimisë. Në lidhje me këto procedura, parashtruesi i kërkesës pretendoi se me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, të 8 majit 2003 dhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të 28 dhjetorit 2006, atij i ishin shkelur të drejtat

kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimin e Gjykatës Komunale, të 8 majit 2003, atij i ishte bërë një padrejtësi pasi që ai nuk kishte qenë palë në këtë procedurë, duke shprehur dyshime për paanshmërinë e gjyqtarit kryesues të kolegjit, i cili kishte pasur marrëdhënie familjare me palët tjera në procedurë. Për më tepër, parashtruesi pretendoi se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të 28 dhjetorit 2006, ai përjetoi edhe një padrejtësi tjetër, pasi që nuk kishte mundur të përfshihej në procedurë dhe me atë rast ishte parandaluar në gëzimin e së drejtës së supozuar në hise (sipas trashëgimisë). Përderisa Gjykata Supreme, sipas tij, nuk kishte qenë plotësisht në dijeni për të gjitha faktet.

Përmbledhje e fakteve për procedurat në çështjen familjare: Më 16 shkurt 2006, shërbimet e sigurimit social në Suedi kishin vendosur që të ndalonin kontaktet në mes të parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes dhe vajzës së tij. Ky vendim ishte vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. I pakënaqur me ato vendime, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar dy kërkesa në GJEDNJ, në Strasburg, kundër Qeverisë suedeze. Më 26 shtator 2006, GJEDNJ vendosi që kërkesa e parë ishte e papranueshme, mbi bazë të asaj se nuk kishte gjetur asnjë bazë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me KEDNJ apo me protokollin e saj. Ndërsa më 18 shtator 2007, GJEDNJ gjeti se kërkesa e dytë ishte po ashtu e papranueshme, për shkak se ajo ishte në thelb e njëjtë me kërkesën paraprake. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në gjykatat e rregullta dhe në Gjykatën e Lartë të Suedisë kundër tre personave: përgjegjësit të Spitalit Universitar të Lundtit, Seksioni Neonatal i Departamentit të Grave, një punëtori të një çerdheje dhe një punëtori tjetër të çerdhes. Në të tri rastet, paditë e parashtruesit të kërkesës ishin hedhur poshtë nga gjykatat e lartpërmendura.

Përmbledhja e pretendimeve (lidhur me çështjen familjare): Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimet e GJEDNJ-së në lidhje me kërkesat e tij kishin qenë të njëanshme dhe të padrejta ndaj tij dhe familjes së tij. Sipas tij, ato vendime u morën nga kolegjet e GJEDNJ-së të përbëra nga gjyqtarë suedezë dhe (ish)jugosllavë, të cilët i mbronin interesat e tyre kundër kërkesës së parashtruesit, me të cilën kritikoheshin shteti suedez dhe ish-Jugosllavia. Parashtruesi i kërkesës

më tutje pretendoi se vendimet e gjykatave në Suedi ishin rezultat i racizmit dhe ksenofobisë së suedezëve dhe Suedisë ndaj të huajve. Si provë, parashtruesi i kërkesës iu referua një libri në suedisht të quajtur “Social Vanvard” dhe një numri të CD-ve, shënimeve dhe fotografive. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se, për arsye të racizmit dhe përfitimit material, autoritete suedeze e kishin ndarë atë nga bashkëshortja e parë si dhe nga bashkëshortja e dytë dhe fëmija i tyre, duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës ishte gjoja në gjendje të paqëndrueshme mendore për të mbajtur familjen e tij.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vuri në pah se për të qenë në gjendje për të gjykuar për ankesën e parashtruesit, ajo së pari duhej të vlerësonte nëse parashtruesi i kërkesës i kishte plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, Gjykata arsyetoi se ngjarjet dhe procedurat që kishin ndodhur apo që ishin zhvilluar në Suedi, sikundër edhe vendimet e GJEDNJ-së, për të cilat ankohej parashtruesi i kërkesës nuk ishin të ndërlidhura me autoritetet publike në Kosovë, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47(1) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se kërkesa binte jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, kjo pjesë e kërkesës duhet të hidhet poshtë si *ratione personae* e papranueshme.

Vendimi i Gjykatës

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56(2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. BABIARZ kundër POLONISË

[1955/10]

GJEDNJ [Seksioni i katërt]

10 prill 2017

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Martesa dhe divorci, pretendime se refuzimi për të dhënë divorcin në përputhje me ligjin e brendshëm nuk është në pajtueshmëri me nenin 8 dhe me nenin 12 të Konventës Evropiane.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Artur Babiarz, një shtetas polak (kërkuesi), kundër Republikës së Polonisë të paraqitur në Gjykatë më 15 dhjetor 2009. Në vitin 2005, kërkuesi la gruan e tij me të cilën kishte qenë i martuar prej shtatë vitesh dhe u bashkua me një grua tjetër me të cilën më vonë ai kishte një fëmijë. Pas një kohe ai kërkoi divorc, por gruaja e tij refuzoi dhe kërkesa e tij u hodh poshtë me arsyetimin se, megjithëse martesa ishte prishur në mënyrë të pakthyeshme, ligji i brendshëm nuk lejonte që një divorc t'i jepej palës me faj në mungesë të pëlqimit (me kusht që pëlqimi nuk jepej pa arsye) nga pala e pafajshme.

Pas procedurave në gjykata nacionale, kërkuesi u ankua në Gjykatë duke u bazuar në nenet 8 dhe 12 të Konventës me pretendimin se autoritetet kishin refuzuar t'i jepnin divorc, kështu duke e ndaluar atë të martohej me gruan me të cilën ai tani jetonte.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi argumentoi se e drejta e tij për t'u martuar dhe për të pasur një familje ishte shkelur nga refuzimi i gjykatës për t'i dhënë atij një divorc. Si rezultat, autoriteti publik kishte ndërhyrë në planet e tij në lidhje me

jetën e tij private dhe familjare dhe ato të vajzës dhe partneres së tij. Në lidhje me pretendimet e kërkuarit, Qeveria ishte e mendimit se nuk kishte pasur shkelje të detyrimeve të shtetit sipas nenit 8. Autoritetet nuk kishin ndërhyrë në dëshirën e kërkuarit për t'u martuar, në jetën e tij martesore për shtatë vjet e as në vendimin e tij për t'u shkëputur nga bashkësia martesore dhe fillimi i një lidhjeje me një grua tjetër. Fakti që procedurat gjyqësore të divorcit të formalizuara ekzistonin sipas ligjit kombëtar dhe se duheshin plotësuar disa kushte që divorci të jepet, në vetvete, nuk bie ndesh me nenin 8 të Konventës. Më tej u argumentua nga Qeveria se gjykatat vendore kishin theksuar se të drejtat e garantuara sipas nenit 8 të Konventës nuk ishin të natyrës absolute dhe ndërhyrja në këto të drejta ishte e lejueshme në kushte të caktuara. Në rastin konkret, ndërhyrja ishte paraparë me nenin 56 paragrafët 2 dhe 3 të Kodit të Familjes dhe Kujdestarisë. Kjo ndërhyrje ndoqi të paktën dy qëllime legjitime: mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, përkatësisht interesat dhe mirëqenien e gruas së kërkuarit dhe mbrojtjen e moralit. Tutje, Qeveria pohoi se Konventa nuk impononte një detyrim pozitiv ndaj shteteve kontraktuese për të lejuar një divorc si dhe vuri në dukje se çështja ishte shqyrtuar nga gjykata të pavarura dhe të paanshme vendase.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vërejti se ankesa e kërkuarit për shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij të garantuara me nenet 8 dhe 12 të Konventës bazohej në të njëjtin fakt, domethënë në refuzimin e gjykatave për t'i dhënë atij një divorc. Për aq sa kërkuari mbështetet në nenin 8 të Konventës, Gjykata përsëriti se, ndërsa qëllimi thelbësor i nenit 8 është mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike, ai nuk e detyron shtetin të përmbahet nga një ndërhyrje e tillë në miratimin e masave të krijuara për të siguruar respekt për jetën private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve mes tyre (shih *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, paragrafi 57, KEDNJ 2002-I).

Sa i përket nenit 12 të Konventës, Gjykata përsëriti në lidhje me këtë se ky nen siguron të drejtën themelore të një burri dhe një gruaje për t'u martuar dhe për të krijuar një familje. Gjykata tashmë ka konstatuar se, as neni 12, as neni 8 i Konventës nuk mund të interpretohen si dhënie e të drejtave të divorcit individëve. Gjykata vërejti se ligji polak i

divorcit siguron rregulla të detajuara themelore dhe procedurale të cilat mund të çojnë në dhënien e një divorci. Në veçanti, neni 56.3 i Kodit të Familjes dhe Kujdestarisë mund të konsiderohet se synohet të jetë një garanci për të mbrojtur një palë, zakonisht më të dobëtën, kundër keqbesimit të palës tjetër. Ekziston gjithashtu një praktikë gjyqësore e brendshme për zbatimin e dispozitave përkatëse themelore në situatat kur një palë e pafajshme dhe, nga ana tjetër, një palë fajtoresh për prishjen e marrëdhënieve martesore janë të përfshirë në procedurat e divorcit, duke dhënë sqarime të mëtejshme dhe udhëzime për gjykatat (shih Ligjin përkatës vendor). Në rastin konkret, gjykatat shqyrtuan faktet në detaje, në kontekstin e duhur të ligjit të brendshëm dhe gjatë procedurës së divorcit u mblodhën prova të plota. Kërkuesi kishte një mundësi për të paraqitur qëndrimin e tij në gjykatë dhe për të bërë pyetje dëshmitarëve. Aktgjykimi i shkallës së parë iu nënshtrua një rishikimi nga gjykata e apelit. Arsyetimi i atij aktgjykimi përmbante një shpjegim të hollësishëm të interesave që u morën parasysh, si u vlerësuan provat dhe cilat ishin bazat për vendimin për të hedhur poshtë kërkesën e kërkuesit për divorc.

Gjykata ishte në dijeni se kërkuesi kishte një vajzë me partneren e tij të re, se ai ishte me sa duket në një marrëdhënie të qëndrueshme dhe se gjykatat vendase kishin pranuar një prishje të plotë dhe të pakthyeshme të martesës së tij. Sidoqoftë, kjo nuk heq asgjë nga ajo që u përmend më lart. Të mendosh ndryshe do të thoshte se një kërkesë për divorc do të duhej të lejohej pavarësisht nga rregullat procedurale dhe thelbësore të ligjit të divorcit në familje, nga një person që thjesht vendos të braktisë bashkëshortin/en e tij ose të saj dhe të ketë një fëmijë me një partner të ri. Ndërsa sipas nenit 8, familjet dhe marrëdhëniet *de facto* mbrohen, një mbrojtje e tillë nuk do të thotë që atyre duhet t'u jepet njohje e veçantë ligjore. Nuk është argumentuar, lëre më të tregohet, se dështimi për të marrë një divorc dhe trillimi ligjor i martesës së tij të vazhdueshme, e penguan ankuesin të njohë atësinë e tij në lidhje me fëmijën që kishte me A.H.

Gjykata vërejti më tej se nuk është argumentuar se sipas ligjit polak refuzimi i divorcit krijon *res iudicata*, duke penguar kështu kërkuesin të paraqesë një kërkesë të re për divorc në gjykata në një fazë të mëvonshme, nëse dhe kur rrethanat ndryshojnë. Sipas mendimit të Gjykatës, nëse dispozitat e Konventës nuk mund të interpretohen si garantuese e një mundësie, sipas ligjit të brendshëm, të marrjes së divorcit, ato nuk mund

të interpretohen, *fortiori*, si një garanci për një rezultat të favorshëm në procedurat e divorcit të ngritura sipas dispozitës së atij ligji që lejon divorcin. Duke pasur parasysh rrethanat e cekura më sipër, Gjykata konsideroi se nuk ka pasur shkelje të së drejtës së kërkesit për t'u martuar dhe se në rrethanat e çështjes në fjalë, detyrimet pozitive që dalin sipas nenit 8 të Konventës bënë që të mos u imponojë autoriteteve polake një obligim për të pranuar kërkesën e kërkesit për divorc. Nga kjo rrjedh se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 ose 12 të Konventës, duke supozuar se kjo dispozitë e fundit është e zbatueshme.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës; Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 12 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. SOHA SAHYOUNI kundër RAJA MAMISCH

GJDBE

Çështja C-372/16

20 dhjetor 2017

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=198045&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13712923>]

Çështja kyçe / e drejta e pretenduar: *Kjo çështje ka të bëjë në thelb me njohjen apo jo të divorceve private nga e drejta e BE-së.*

Faktet kryesore

Z. Mamisch dhe znj. Sahyouni (palët në procedurën kryesore) u martuan para gjykatës islame në Homs, në Siri më 27 maj 1999. Z. Mamisch është

shtetas sirian që nga lindja e tij. Në 1977 ai fitoi shtetësinë gjermane me natyralizim. Që nga ai vit, ai mban këto dy shtetësi. Z. Sahyouni është shtetase qytetare siriane që nga lindja. Ajo fitoi shtetësinë gjermane pas martesës së saj.

Deri në vitin 2003, çifti jetonte në Gjermani dhe më pas u transferuan në Homs. Në verën e vitit 2011, për shkak të luftës civile në Siri, ata u kthyen për një periudhë të shkurtër në Gjermani, pastaj, që nga shkurti 2012, jetuan herë në Kuvajt, herë në Liban. Gjatë kësaj periudhe, ata shkuan disa herë në Siri. Aktualisht, të dy palët në procedurën kryesore jetojnë në Gjermani, në vendbanime të ndryshme.

Më 19 maj 2013, z. Mamisch deklaroi se donte të divorcohej nga gruaja e tij, dhe avokati i tij shqiptoi formulën e divorcit para gjykatës fetare të Sheriatit në Latakia në Siri. Më 20 maj 2013, kjo gjykatë konstatoi divorcin e bashkëshortëve. Më 12 shtator 2013, znj. Sahyouni nënshkroi një deklaratë në lidhje me përfitimet që ajo do të merrte nga z. Mamisch sipas ligjit fetar për një shumë totale prej 20,000 USD, deklaratë e formuluar si vijon:

“[...] Unë kam marrë të gjitha përfitimet që më takojnë sipas kontratës së martesës për shkak të divorcit me dëshirë të njëanshme dhe kështu e liroj atë nga të gjitha detyrimet e tij ndaj meje sipas kontratës së martesës dhe urdhrit të divorcit, të datës 20 maj 2013, lëshuar nga Gjykata e Sheriatit në Latakia [...]”

Më 30 tetor 2013, z. Mamisch kërkoi njohjen në Gjermani të vendimit të divorcit të shpallur në Siri. Me vendimin e 5 nëntorit 2013, Kryetari i Oberlandesgericht München¹⁶⁵ e miratoi këtë kërkesë, duke vënë në dukje se kushtet ligjore për njohjen e këtij vendimi divorci ishin përmbushur. Më 18 shkurt 2014, znj. Sahyouni kërkoi që vendimi të anulohet dhe të vendosej që kushtet për njohjen e vendimit të divorcit nuk ishin plotësuar.

165 Gjykata e Lartë Rajonale e Mynihut.

Me një vendim të 8 prillit 2014, Kryetari i Oberlandesgericht München refuzoi ta lejojë apelin e znj. Sahyouni. Në atë vendim, u theksua se njohja e vendimit të divorcit bëhej nga Rregullorja nr. 1259/2010, e cila zbatohet edhe për divorcet e shpallura, pa përfshirë asnjë rol konstitutiv të një gjykate ose një autoriteti publik (në tekstin e mëtejshëm: “divorcet private”). Përderisa bashkëshortët nuk kishin zgjedhur së bashku ligjin e zbatueshëm dhe nuk kishin pasur një vendbanim të zakonshëm të përbashkët gjatë vitit që i paraprinte divorcit, ligji i zbatueshëm do të përcaktohej sipas dispozitave të nenit 8, pika c) të kësaj Rregulloreje. Sipas këtij neni kur të dy bashkëshortët kanë shtetësi të dyfishtë, faktori vendimtar është shtetësia efektive sipas kuptimit të ligjit kombëtar. Në datën e divorcit në fjalë, shtetësia efektive do ishte ajo siriane. U vlerësua gjithashtu se rendi publik, sipas kuptimit të nenit 12 të Rregullores nr. 1259/2010, nuk pengonte njohjen e vendimit të divorcit në fjalë.

Me një vendim të 2 qershorit 2015, Oberlandesgericht München, e cila po shqyrtonte mosmarrëveshjen, pezulloi procedimin dhe i referoi Gjykatës pyetje të ndryshme për një vendim paraprak në lidhje me interpretimin e Rregullores nr. 1259/2010. Me një urdhër të 12 majit 2016¹⁶⁶, Gjykata shpalli haptazi se nuk ishte kompetente për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve për një vendim paraprak, sidomos për shkak se Rregullorja nr. 1259/2010 nuk zbatohet për njohjen e vendimit të divorcit të lëshuar në një vend të tretë dhe se gjykata referuese nuk kishte ofruar ndonjë dëshmi që mund të vërtetojë se dispozitat e asaj rregulloreje ishin bërë të zbatueshme, drejtpërdrejt dhe pa kushte, sipas ligjit kombëtar, në situata siç është ajo në fjalë në procedurën kryesore. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se gjykata referuese ruante të drejtën për të paraqitur një kërkesë të re për një vendim paraprak kur të ishte në gjendje t’i jepte Gjykatës të gjithë informacionin që i mundësonte asaj të merrte një vendim.

Në sqarim të këtyre kërkesave nga GJDBE, gjykata referuese në kërkesën e re theksoi se divorcet e shpallura në një vend të tretë njihen në Gjermani sipas procedurës së parashikuar në nenin 107 të Ligjit për Procedurat në Çështjet e Familjes. Përveç kësaj, në lidhje me njohjen

166 Urdhri Sahyouni C-281/15, BE: C: 2016: 343.

e divorceve private, është pranuar përgjithësisht që gjykatat gjermane të shqyrtojnë vlefshmërinë në themel të divorceve të tilla në dritën e Rregullores nr. 1259/2010. Kjo praktikë ligjore rezulton nga shfuqizimi, nga ana e ligjvënësit gjerman, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të dispozitës në lidhje me të drejtën materiale të zbatueshme për divorcin. Ky shfuqizim bazohej në faktin se ligjvënësi gjerman, duke marrë parasysh se edhe divorcet private përfshiheshin në këtë Rregullore, vlerësoi se dispozita e vjetër gjermane nuk kishte më vlerë, pikërisht për shkak të ekzistencës së Rregullores në fjalë.

Në këto rrethana, Oberlandesgericht München vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i referojë Gjykatës një sërë pyetjesh për një vendim paraprak, thelbi i të cilave ishte nëse Rregullorja nr. 1259/2010 zbatohet edhe ndaj divorceve apo ndarjeve private të bëra në një shtet të tretë apo jo. Pra, nëse e drejta evropiane në stadin aktual rregullonte edhe pasojat e divorceve private.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata sqaroi se neni 1 i Rregullores së Këshillit (BE) nr. 1259/2010, të 20 dhjetorit 2010, i cili zbaton bashkëpunimin e përforcuar në fushën e ligjit të zbatueshëm për divorcin dhe ndarjen, duhet të interpretohet se një divorc që rrjedh nga një deklaratë e bërë nga njëri prej bashkëshortëve para një gjykate fetare, siç është ajo në fjalë në procedurën kryesore, nuk përfshihet në fushën materiale të asaj Rregulloreje.

Për sa i përket, në radhë të parë, kushteve të nenit 1 të Rregullores nr. 1259/2010, ai nen thjesht tregon, në paragrafin 1, se ajo Rregullore zbatohet, në situatat kur ka konflikt ligjesh të zbatueshme ndaj divorcit dhe ndarjes. Prandaj formulimi i atij neni nuk ofron asnjë element të dobishëm për përkufizimin e konceptit të “divorcit” në kuptimin e saj.

Për sa i përket, së dyti, kontekstit në të cilin përshtatet neni 1 i Rregullores nr. 1259/2010, para së gjithash, duhet të theksohet se asnjë dispozitë tjetër e Rregullores nuk jep një përkufizim të nocionit të “divorcit” në kuptimin e saj. Në vijim, megjithëse është e vërtetë që divorcet private nuk përjashtohen në mënyrë të shprehur nga fusha e Rregullores nr. 1259/2010, siç vërejtë Avokati i Përgjithshëm në paragrafin 60 të

Opinionit të tij, referencat në ndërhyrjen nga një “gjykatë” dhe në ekzistencën e një «procedure», të pranishme në disa dispozita të kësaj Rregulloreje, të tilla si neni 1, paragrafi 2, neni 5, paragrafët 2 dhe 3, nenet 8 dhe 13, si dhe neni 18 (2) i saj, tregojnë se këto të fundit lidhen ekskluzivisht me divorcet e shpallura ose nga një gjykatë shtetërore ose nga një autoritet publik ose nën kontrollin e tij. Së fundi, sipas recitalit 10 të Rregullores nr. 1259/2010, qëllimi material dhe dispozitat e tij duhet të jenë në përputhje me Rregulloren nr. 2201/2003.

Për sa i përket, së treti, objektivit të ndjekur nga Rregullorja nr. 1259/2010, ajo krijon, siç duket nga titulli i saj, bashkëpunim të përforcuar midis shteteve anëtare pjesëmarrëse në fushën e ligjit të zbatueshëm të divorcit dhe ndarjes. Siç vërejt Avokati i Përgjithshëm në paragrafin 65 të Opinionit të tij, kur u miratua kjo Rregullore, në sistemet ligjore të shteteve anëtare që marrin pjesë në një bashkëpunim të tillë të përforcuar, vetëm organet publike mund të miratojnë vendime që kanë vlerë ligjore për çështjet në fjalë. Në këtë kuptim, edhe pse është e vërtetë që, që nga miratimi i Rregullores nr. 1259/2010, disa shtete anëtare kanë miratuar në sistemet e tyre ligjore, mundësinë e shpalljes së divorcit pa ndërhyrjen e një autoriteti shtetëror, gjithsesi, siç e theksoi edhe Avokati i Përgjithshëm në paragrafin 66 të Opinionit të tij, përfshirja e divorceve private në fushëveprimin e kësaj rregulloreje do të kërkonte rregullime që bien vetëm në kompetencën e legjislativit.

Kështu, në dritën e përkufizimit të konceptit të ‘divorcit’ që figuron në Rregulloren nr. 2201/2003, është e qartë nga objektivat e ndjekur nga Rregullorja nr. 1259/2010 që kjo e fundit mbulon vetëm divorcet e shpallura, ose nga një juridiksion shtetëror, ose nga një autoritet publik ose nën kontrollin e tij.

Neni 38

Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë

- 1. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.*
- 2. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.*
- 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.*
- 4. Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit, ose të të drejtave të personave të tjerë.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI36/11. PARASHTRUES: ARJETA HALIMI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KI_36_11_shq.pdf]

30 shtator 2011

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Ky rast kishte të bënte me mospërmbarimin e një vendimi të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, i cili kishte detyruar Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Kulturës që t'i mundësonin parashtrueses së kërkesës vijimin e mësimimit dhe gëzimitin e të gjitha të drejtave si nxënëse e shkollës së mesme, përkundër asaj se ajo bartte shami. Çështja kryesore e ngritur në Gjykatën Kushtetuese ishte se mospërmbarimi i vendimit të Gjykatës së Qarkut kishte shkaktuar shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtrueses, të garantuara me nenet në vijim: neni 24 (Barazia para Ligjit), neni 38 (Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë) dhe neni 47 (E Drejta për Arsimin).

Faktet kryesore

Parashtruesja kishte qenë nxënëse në shkollën e mesme publike “Kuvendi i Lezhës”, në Komunën e Vitisë dhe kishte filluar bartjen e shamisë (mbulesës së kokës sipas bindjes fetare/muslimane) në shkollë, gjatë klasës së 10-të. Parashtruesja pretendoi se ajo ishte njoftuar gojarisht nga drejtorja e shkollës se ajo nuk do të lejohej të vijonte shkollimin, përveç nëse do të hiqte shaminë. Sipas saj, shkolla kishte njoftuar Drejtorinë Komunale të Arsimit (në tekstin e mëtejme: “DKA”) dhe kjo e fundit ia kishte bërë të njohur shkollës se bartja e shamisë në shkollë paraqiste shkelje të aktit nënligjor që kishte të bënte me uniformën në shkollë. Më 15 prill 2009, parashtruesja kishte kërkuar që Drejtorja Komunale e Arsimit në Viti t’ia paraqiste njoftimin zyrtar lidhur me statusin e saj (si nxënëse) dhe për arsyet e përjashtimit të saj nga shkolla. Më 28 prill 2009, DKA i ishte përgjigjur me shkrim parashtrueses, si në vijim: “*Informoheni se drejtorja e Shkollës së mesme*

“Kuvendi i Lezhës” në Viti nuk i ka mohuar dhe nuk i ka parandaluar Arjeta Halimit, nxënëse në klasën e 10-të në këtë shkollë, të drejtën në shkollim. Drejtoria e shkollës kësaj nxënëseje i ka shqiptuar vërejtje gojore lidhur me bartjen e mbulesës dhe kësaj nxënëse i ka sugjeruar që të mos bartë mbulesën në shkollë përndryshe do t’i ndalohet qasja në shkollë. II. Kjo nxënëse u tërhoq nga procesi mësimor pa iu kërkuar një gjë e tillë dhe ajo nuk ka kërkuar asnjë komunikim ose parashtruar ndonjë kërkesë drejtorisë së shkollës a DKA-së, por DKA-së i është kërkuar që asaj t’i mundësohet e drejta e hyrjes në provimet e vitit të fundit, andaj, e drejta e saj për arsimim nuk është shkelur në asnjë mënyrë. III. Sipas Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Arsimi i Mesëm nuk është i detyrueshëm por fakultativ, dhe neni 22, pika d e Rregullores Nr. 01-013/86 të Kodit të Mirësjelljes dhe Disiplinës përcakton se nxënësi duhet të veshë të njëjtën uniformë dhe kjo nxënëse ka shkelur këtë Rregullore dhe rregullat e shkollës. Kjo shkollë ka nxënës të besimeve dhe religjioneve të ndryshme dhe nëse një veshje e tillë do të lejohej, atëherë do të dëmtohej procesi arsimor në shkollën tonë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, po ashtu e përcakton Kosovën si shtet laik sa i përket besimeve fetare”.

Më 6 maj 2009, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në Departamentin për Inspektoratin Arsimor në Gjilan, duke kërkuar që DKA-ja e Vitisë të obligohej të lejonte të vijonte shkollimin në shkollën “Kuvendi i Lezhës” dhe t’u shqiptoheshin dënime personave të caktuar brenda DKA-së së Vitisë për shkeljen e Ligjit Kundër Diskriminimit. Inspektorati Regjional për Arsim në Gjilan i ishte përgjigjur duke thënë se pretendimet e parashtrueses për shkeljen e ligjit në rastin e saj ishin të pabaza. Më 18 shtator 2009, parashtruesja e kërkesës kishte ushtruar në Gjykatën Supreme padi për konflikt administrativ. Parashtruesja kishte kërkuar nga Gjykata Supreme që të anuloheshin të gjitha veprimet e Komunës së Vitisë më të cilat ishin shkelur të drejtat e saj. Më 19 tetor 2009, Gjykata Supreme ishte deklaruar se nuk kishte juridiksion për të gjykuar në rastin e parashtrueses dhe kishte vendosur që të përcillte rastin për gjykim në Gjykatën e Qarkut në Gjilan. Më 17 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan kishte nxjerrë Aktgjykimin Cn. nr. 24/09, me të cilin e kishte miratuar padinë e parashtrueses së kërkesës dhe e kishte obliguar Departamentin Komunal të Arsimit të Vitisë që “t’ia pranojë paditëses (parashtrueses së kërkesës) të gjitha të drejtat që buronin nga statusi i nxënësit të rregullt në Gjimnazin ‘Kuvendi i Lezhës’ në

Viti”. Më 23 nëntor 2009, parashtruesja e kërkesës e kishte informuar Departamentin Komunal të Arsimit në Viti për aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe kishte kërkuar që aktgjykimi të zbatohet. Më 25 janar 2010, parashtruesja e kërkesës i kishte shkruar Gjykatës së Qarkut për ta informuar së Aktgjykimi Cr. nr. 24/09 akoma nuk ishte zbatuar nga ana e DKA-së së Vitisë dhe kishte kërkuar që gjykata të merrte masa për zbatimin e aktgjykimit.

Më 10 mars 2011, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Ndërkohë, në përgjigjet e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata e Qarkut në Gjilan kishte theksuar se nuk ishte në kompetencën e saj të vepronte në lidhje me këtë çështje dhe se gjykatë kompetente për përmbardimin e aktgjykimit ishte Gjykata Komunale në Viti. Ndërsa në përgjigjen e saj, DKA e kishte kundërshtuar thelbin e ankesës së parashtrueses, duke pohuar se ankesa e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese ishte e pabazuar dhe pa argumente. Gjykata Komunale në Viti në përgjigjen e saj kishte konfirmuar se parashtruesja e kërkesës kurrë nuk kishte paraqitur propozim për përmbardimin e Aktgjykimit të formës së prerë, Cn. nr. 24/09, të Gjykatës së Qarkut.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se, pavarësisht se në Kosovë njihen të drejtat e saj për shkollim, që dy vite asaj nuk i ishte lejuar të vijonte shkollën. Sipas parashtrueses, kjo situatë ishte në shkelje të neneve e Kushtetutës si në vazhdim: neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë] dhe neni 47 [E drejta për Arsimin]. Parashtruesja e kërkesës theksoi se nenet e lartpërmendura janë shkelur, meqë institucioni publik ia kishte mohuar asaj të drejtën për të ndjekur procesin e mësimin përderisa ajo bart shaminë islame, ndonëse ky akt konsiderohet nga Kushtetuta si diskriminim në baza fetare. Sipas parashtrueses së kërkesës, DKA në Viti ka dështuar në implementimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, ndonëse aktgjykimi ishte i obligueshëm. Parashtruesja argumentoi se nuk kishte mjet tjetër juridik që mund ta shfrytëzonte për të siguruar përmbardimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht arsyetoi se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj kishte theksuar se nuk kishte mjet tjetër juridik që do të mund ta shfrytëzonte për të siguruar përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Gjykata e Qarkut, në anën tjetër, kishte arsyetuar se parashtruesja e kërkesës duhej të shteronte, në Gjykatën Komunale në Viti, të gjitha mjetet juridike në dispozicion për përmbarimin e aktgjykimit. Gjykata Kushtetuese po ashtu vuri në dukje se Gjykata Komunale në Viti kishte konfirmuar se parashtruesja e kërkesës kurrë nuk kishte paraqitur propozim për përmbarimin e Aktgjykimit Cn. nr. 24/09, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut.

Gjykata Kushtetuese më tutje sqaroi konfuzionin lidhur me ligjin e aplikueshëm në këtë rast, duke sqaruar se procedura përmbarimore ishte e përcaktuar me Ligjin e Procedurës Përmbarimore, të vitit 2008. Në dritën e fakteve dhe rrjedhës procedurale të rastit dhe në dritën e dispozitave përkatëse ligjore, Gjykata Kushtetuese gjeti se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk kishte paraqitur kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Prandaj, Gjykata erdhi në përfundim se parashtruesja e kërkesës nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj.

Gjykata Kushtetuese, më tej, rikujtoi se ishte e pakontestueshme ndërmjet palëve se parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk kishte pranuar ndonjë vendim nga shkolla në të cilën vijonte mësimin (e as nga DKA), se asaj i ishte ndaluar vazhdimi i shkollimit apo se ishte përjashtuar nga shkolla. Për më tepër, padia e parashtrueses së kërkesës ishte miratuar nga Gjykata e Qarkut me Aktgjykimin e 17 nëntorit 2009. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se nuk ishte e bindur me argumentin e parashtrueses së kërkesës se asaj i ishte ndaluar vijimi në shkollën “Kuvendi i Lezhës”. Gjykata vuri në pah se parashtruesja e kërkesës e kishte ndërprerë vijimin e shkollimit në shkollën e saj, në bazë të një “vërejtje gojore”. Vetëm pas tre muajsh ajo i ishte drejtuar një organi shtetëror relevant, DKA-së. Prandaj, Gjykata konsideroi se parashtruesja e kërkesës nuk kishte arsyetuar *prima facie* kërkesën e saj.

Në fund, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së, rikujtoi që neni 8 i Kushtetutës e përcakton

Republikën e Kosovës si një shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, me shumicë votash, vendosi që të shpallë të papranueshme kërkesën, për shkak të mospërmbushjes së kushteve të pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. EWEIDA DHE TË TJERËT kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

[48420/10, 59842/10, 51671/10 DHE 36516/10]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

27 maj 2013

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: manifestimi i lirisë së fesë ose besimit; masat disiplinore ndaj punonjësve për mbajtjen e simboleve fetare (kryq) në punë ose refuzimin e kryerjes së detyrave që i konsideronin të papajtueshme me besimet e tyre fetare.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga katër shtetas britanikë, Nadia Eweida (kërkuesja e parë), Shirley Chaplin (kërkuesja e dytë), Lillian Ladele (kërkuesja e tretë), dhe Gary McFarlane (kërkuesi i katërt) (kërkuesit), më 24 qershor 2010 kundër Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Të katër kërkuesit ishin praktikues të krishterë, të cilët u ankuan se ligji vendor kishte dështuar për të mbrojtur në mënyrë adekuate të drejtën e tyre për të shfaqur bindjet e tyre fetare. Kërkuesja e parë, znj. Eweida, një punonjëse e British Airways, dhe kërkuesja e dytë, znj.

Chaplin, një infermiere geriatrike, u ankuan se punëdhënësit e tyre kishin vendosur kufizime në mbajtjen e dukshme të kryqeve të krishterë rreth qafës, gjatë punës. Kërkuesja e tretë, znj. Ladele, nëpunëse e gjendjes civile të lindjeve, vdekjeve dhe martesave; dhe kërkuesi i katërt, McFarlane, një këshilltar me një shërbim konfidencial të terapisë seksuale dhe këshillimit të marrëdhënieve, u ankua se ata ishin pushuar nga puna për refuzimin për të kryer disa nga detyrat e tyre (mirëkuptimi dhe pranimi i homoseksualitetit), për të cilat ata konsideronin si një praktikë që ishte e papajtueshme me besimet e tyre fetare.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit u ankuan se ligji vendor nuk arriti të mbronte në mënyrë adekuate të drejtën e tyre për të shfaqur fenë dhe besimin e tyre. Eweida dhe Chaplin u ankuan posaçërisht për kufizimet e vendosura nga punëdhënësit e tyre në mbajtjen e një kryqi të dukshëm rreth qafës së tyre. Ladele dhe McFarlane u ankuan në mënyrë specifike për sanksionet e marra kundër tyre nga punëdhënësit e tyre, si rezultat i shqetësimeve të tyre në lidhje me kryerjen e shërbimeve, të cilat ata i konsideronin si pranim të homoseksualitetit. Znj. Eweida, znj. Chaplin dhe z. McFarlane u thirrën në nenin 9 të Konventës, marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 14, ndërsa znj. Ladele u ankua vetëm në bazë të nenit 14, në lidhje me nenin 9.

Më 12 prill 2011, kërkesa e znj. Chaplin u bashkua me atë të znj. Eweida dhe kërkesa e z. McFarlane u bashkua me atë të znj. Ladele. Të katër kërkesat iu komunikuan Qeverisë. Gjykata gjithashtu vendosi që për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e kërkesave të vendosë në të njëjtën kohë (neni 29.1), si dhe vendosi t'i bashkojë të katër kërkesat.

Individëve dhe organizatave të mëposhtme iu dha leja nga Kryetari për të ndërhyrë si palë të treta në procedurën me shkrim (neni 36.2 i Konventës dhe rregulli 44.2): Komisioni për Barazinë dhe të Drejtat e Njeriut; Shoqëria Laike Kombëtare; Dr. Jan Camogursky dhe Fondi i Mbrojtjes së Aleancës; Peshkopi Mikael Nazir-Ali; Trusti i Medias Premier Christian; peshkopët e Chester dhe Blackburn; Associazione Giuseppe Dossetti: i Valori; Observatori mbi Jotolerancën, Lirinë nga Diskriminimi kundër të Krishterëve në Evropë; Instituti Clapham dhe

KLM; Qendra Evropiane për Ligj dhe Drejtësi; Lord Carey i Clifton; dhe Fédération Internationale des Ligues des Droits de l'Homme (FIDH, ICJ, ILGA-Europe).

Më 4 shtator 2012 u mbajt seanca dëgjimore publike në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut, Strasburg, bazuar në rregullin 59.3.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 9, të vetëm dhe/ose në lidhje me nenin 14, Gjykata vuri në pah se tanimë ekziston një praktikë gjyqësore e Gjykatës dhe e Komisionit që tregon se, nëse një person është në gjendje të ndërmarrë hapa për të anashkaluar një kufizim të vendosur në lirinë e tij/saj për të manifestuar fenë ose besimin, nuk ka asnjë ndërhyrje në të drejtën sipas nenit 9.1 dhe, si rrjedhim, kufizimi nuk kërkon të justifikohet sipas nenit 9.2. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë në një shoqëri demokratike të lirisë së fesë, Gjykata vlerësoi se, kur një individ ankohet në një kufizim të lirisë së fesë në vendin e punës, në vend që të pohohet se mundësia e ndryshimit të punës do të mohonte çdo ndërhyrje në të drejtën, qasja më e mirë do të ishte vënia e kësaj mundësie në balancën e përgjithshme, kur shqyrtohet nëse kufizimi ishte apo jo proporcional.

Në situatën, si në rastin e kërkuesit të parë dhe të katërt, kur veprimet për të cilat ankohen, janë kryer nga kompani private dhe, për rrjedhojë, nuk i atribuohen drejtpërdrejt shtetit të paditur, Gjykata duhet t'i shqyrtojë çështjet në lidhje me detyrimin pozitiv të autoriteteve shtetërore për të siguruar të drejtat sipas nenit 9 për ata që janë në juridiksionin e tyre.

Për sa i përket parimeve të zbatueshme sipas nenit 14 të Konventës, ndërkohë që, në përgjithësi, që një çështje të lindë, duhet të ketë një dallim në trajtimin e personave në situata analoge ose përkatësisht të ngjashme, e drejta për të mos u diskriminuar gjithashtu shkelet kur shtetet, pa arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk arrijnë të trajtojnë ndryshe personat, situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme. Veprime të tilla janë diskriminuese nëse nuk kanë arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim, ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Sa i përket rastit të (a) kërkueses së parë – Gjykata u bind se këmbëngulja e kërkueses së parë për të mbajtur një kryq të dukshëm në punë ishte një manifestim i besimit të saj fetar dhe se refuzimi nga “British Airways” midis shtatorit 2006 dhe shkurtit 2007 për ta lejuar atë të qëndronte në pozitën e saj, teksa dukshëm mbante një kryq, përbënte ndërhyrje në të drejtën e saj për të shfaqur fenë e saj. Meqenëse ndërhyrja nuk i atribuohet drejtpërdrejt shtetit, Gjykata shqyrtoi nëse shteti kishte respektuar detyrimin pozitiv sipas nenit 9.

Gjykata nuk konsideroi se mungesa e mbrojtjes eksplicite në ligjin e Mbretërisë së Bashkuar për të rregulluar mbajtjen e veshjeve dhe simboleve fetare në vendin e punës, në vetvete, nënkuptonte shkeljen e së drejtës për të manifestuar fenë, pasi çështjet mund të konsideroheshin nga gjykatat vendase në kontekstin e pretendimeve për diskriminim të paraqitura nga parashtruesit.

Qëllimi i kodit të uniformës së “British Airways” ishte komunikimi i një imazhi të caktuar të kompanisë dhe për të promovuar njohjen e markës dhe stafit të saj, dhe si i tillë, ishte legjitim. Megjithatë, gjykatat vendase i kishin dhënë shumë peshë këtij synimi. Kryqi i kërkueses së parë ishte i thjeshtë dhe nuk mund t’i prishte pamjen e saj profesionale. Nuk kishte asnjë provë që bartja e simboleve dhe veshjeve fetare të tjera të autorizuar më parë, si çallmat dhe hixhabet, nga punonjës të tjerë, të kishte ndonjë ndikim negativ në markën ose imazhin e “British Airways”.

Për më tepër, fakti që kompania më vonë ishte në gjendje të ndryshonte kodin e uniformës për të lejuar veshjen e dukshme të bizhuterive simbolike fetare, tregoi se ndalimi i mëparshëm nuk kishte qenë i një rëndësie vendimtare.

Prandaj, duke qenë se nuk kishte prova për ndonjë cenim real të interesave të të tjerëve, autoritetet vendase kishin dështuar për të mbrojtur mjaftueshëm të drejtën e kërkueses së parë për të shfaqur fenë e saj, duke shkelur detyrimin pozitiv sipas nenit 9. Një shqyrtim i veçantë i ankesës së saj sipas nenit 14 në lidhje me nenin 9 nuk ishte i nevojshëm. Gjykata vendosi se kishte shkelje në lidhje me kërkuesen e parë (pesë vota për dhe dy kundër).

Në lidhje me rastin e (b) kërkueses së dytë – Gjykata u bind se vendosmëria e kërkueses së dytë për të mbajtur kryq në punë ishte një manifestim i besimit të saj fetar dhe se refuzimi nga autoriteti shëndetësor për ta lejuar atë të qëndronte në postin e infermierisë, ndërkohë që mbante kryqin, ishte një ndërhyrje në lirinë e saj për të manifestuar fenë e saj.

Kufizimi në fjalë kishte një qëllim legjitim, që ishte mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së infermierëve dhe pacientëve. Provat ishin se menaxherët e kërkueses së dytë konsideruan se ekzistonte rreziku që një pacient i shqetësuar mund të kapte dhe tërhiqte zinxhirin me rrezikun e lëndimit, ose që kryqi mund të lëkundet përpara dhe, për shembull, të vinte në kontakt me një plagë të hapur. Arsyeja e kufizimit në këtë situatë ishte, rrjedhimisht, e një përmase më të madhe sesa në rastin e kërkueses së parë. Kishte gjithashtu prova që një infermiereje tjetër të krishterë i ishte kërkuar të hiqte kryqin dhe një zinxhir; dy infermiereve sikhe u ishte thënë se nuk mund të mbanin një byzylyk ose kirpan; dhe se hixhabet ishin të ndaluara. Kërkueses së dytë i ishte ofruar mundësia për të bartur një kryq në formën e një karficë zbukurimi të ngjitur në uniformën e saj, ose të futur nën një veshje të epërme që mbulon qafen, të veshur nën tunikën e saj, por ajo nuk e kishte konsideruar se kjo do të ishte e mjaftueshme për t'u pajtuar me bindjet e saj fetare.

Kjo ishte një fushë ku autoriteteve vendore duhej t'u lejohej një hapësirë e gjerë vlerësimi. Drejtuesit e spitalit ishin më mirë të pozicionuar për të marrë vendime për sigurinë klinike sesa një gjykatë, veçanërisht një gjykatë ndërkombëtare që nuk kishte dëgjuar asnjë provë të drejtpërdrejtë. Si rrjedhojë, Gjykata nuk ishte në gjendje të arrinte në përfundimin se masat në fjalë ishin joproporcionale dhe se ndërhyrja në lirinë e kërkueses së dytë për të shfaqur fenë e saj kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 9, vetëm ose në lidhje me nenin 14. Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje në lidhje me kërkuesen e dytë (njëzëri).

Në lidhje me rastin e (c) kërkueses së tretë – Gjykata theksoi se ishte e qartë se kundërshtimi i kërkueses së tretë për të marrë pjesë në krijimin e partneriteteve civile të të njëjtit seks ishte i motivuar drejtpërdrejt nga bindjet e saj fetare. Prandaj, ngjarjet në fjalë binin në kuadër të nenit 9

dhe neni 14 ishte i zbatueshëm. Krahasuesi përkatës në këtë rast ishte një regjistruer pa kundërshtime fetare ndaj bashkimeve të të njëjtit seks. Gjykata pranoi se kërkesa e autoritetit vendor që të gjithë regjistruerit e lindjeve, martesave dhe vdekjeve të caktoheshin gjithashtu si regjistruer të partneritetit civil, kishte pasur një ndikim veçanërisht të dëmshëm për të, për shkak të bindjeve të saj fetare. Kërkesa ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së mundësive të barabarta për ata me orientime të ndryshme seksuale. Në shqyrtimin e proporcionalitetit të masave, u vu re se pasojat për kërkuesen e tretë ishin të rënda: duke qenë se nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të përballej me masa disiplinore në vend që të caktohej regjistruer e partneritetit civil dhe, në fund, humbi punën. Për më tepër, nuk mund të thuhet se kur ajo kishte lidhur kontratën e punës, kishte hequr dorë në mënyrë specifike nga e drejta për të shfaqur besimin fetar duke kundërshtuar pjesëmarrjen në krijimin e partneriteteve civile, pasi kjo kërkesë ishte paraqitur nga punëdhënësi i saj më vonë.

Nga ana tjetër, megjithatë, politika e autoritetit vendor synonte të siguronte të drejtat e të tjerëve, të cilat gjithashtu mbroheshin nga Konventa dhe Gjykata, në përgjithësi, u lejoj autoriteteve kombëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi kur bëhej fjalë për arritjen e një ekuilibri midis të drejtave konkurruese të Konventës. Në të gjitha rrethanat, Gjykata konsideroi se, as punëdhënësi i autoritetit vendor që kishte nisur procedurën disiplinore, as gjykatat vendase që kishin hedhur poshtë pretendimin për diskriminim të kërkueses së tretë, nuk e kishin tejkaluar kufirin e vlerësimit në dispozicion të tyre. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 9 (pesë vota për dhe dy kundër).

Sa i përket rastit të (d) kërkuesit të katërt - Gjykata konsideroi se, përderisa kërkuesi ishte i punësuar nga një kompani private me një politikë që kërkonte nga punonjësit të ofronin shërbime në mënyrë të barabartë për çiftet heteroseksuale dhe homoseksuale, kërkuesi i katërt kishte refuzuar të angazhohej për të ofruar këshillim psiko-seksual për çiftet e të njëjtit seks. Si rezultat, ndaj tij ishte ngritur procedurë disiplinore. Gjykata pranoi se kundërshtimi i kërkuesit të katërt ishte i motivuar drejtpërdrejt nga bindjet e tij të krishtera ortodokse për martesën dhe marrëdhëniet seksuale, dhe vendosi se refuzimi i tij

për të marrë përsipër të këshillonte çiftet homoseksuale përbënte një manifestim të fesë dhe besimit të tij. Prandaj, shteti kishte një detyrim pozitiv sipas nenit 9 për të siguruar të drejtat e tij. Për të vendosur nëse detyrimi pozitiv përmbushej duke arritur një ekuilibër të përshtatshëm midis interesave konkurruese, Gjykata mori parasysh se humbja e vendit të tij të punës ishte një sanksion i rëndë me pasoja të rënda për parashtruesin e katërt. Nga ana tjetër, ai ishte regjistruar vullnetarisht në programin e trajnimit pasuniversitar të punëdhënësit të tij në këshillim psiko-seksual, duke e ditur se punëdhënësi i tij operonte një politikë mundësish të barabarta dhe se filtrimi i klientëve në bazë të orientimit seksual nuk do të ishte i mundur. Ndërkohë që vendimi i një individi për të lidhur një kontratë pune dhe për të ndërmarrë përgjegjësi të cilat ai e dinte se do të ndikonin në lirinë e tij për të shfaqur besimin e tij fetar nuk ishte përcaktues për çështjen nëse ka pasur apo jo, një ndërhyrje në të drejtat e nenit 9, kjo ishte një çështje për t'u peshuar në balans kur vlerësohej nëse ishte arritur një balansim i drejtë. Megjithatë, faktori më i rëndësishëm për t'u marrë parasysh ishte se veprimi i punëdhënësit synonte të siguronte zbatimin e politikës së tij për ofrimin e një shërbimi pa diskriminim. Prandaj, autoritetet shtetërore kishin përfituar nga një hapësirë e gjerë vlerësimi në vendimmarrje. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 9, marrë si të vetëm ose në lidhje me nenin 14.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se në rastin e kërkuesses së parë kishte shkelje të nenit 9; njëzëri se nuk kishte shkelje në rastin e kërkuesses së dytë; nuk kishte shkelje në lidhje me kërkuessen e tretë dhe njëzëri se nuk kishte shkelje në lidhje me kërkuessin e katërt. Bazuar në nenin 41, Gjykata i kërkoi shtetit të paditur t'i paguajë 2,000 (dy mijë) euro kërkuesses së parë për dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. SAMIRA ACHBITA ET CENTRUM VOOR GELIJKHEID VAN KANSEN EN VOOR RACISMEBESTRIJDING kundër G4S SECURE SOLUTIONS NV

GJDBE (Dhoma e Madhe)
C157/15

14 mars 2017

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=188852&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13714478>]

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Kjo çështje kishte të bënte me të drejtën e individëve për të shfaqur besimin e tyre fetar nëpërmjet veshjes, dhe për lejimin apo jo, të këtyre shfaqjeve nga punëdhënësit privatë.

Faktet kryesore

G4S është një kompani private që ofron, ndër të tjera, shërbime të pritjes dhe akomodimit për klientët si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Më 12 shkurt 2003, znj. Achbita, me besim mysliman, filloi të punojë si recepcioniste për G4S. Ajo ishte punësuar nga kjo e fundit në bazë të një kontrate pune pa afat. Në kompani kishte një rregull të pashkruar që punëtorët nuk mund të mbanin shenja të dukshme të bindjeve të tyre politike, filozofike ose fetare në vendin e punës.

Në prill 2006, znj. Achbita informoi eprorët e saj se ajo tani kishte ndërmend të mbante shaminë islame gjatë orarit të punës. Drejtuesit e G4S informuan znj. Achbita se mbajtja e shamisë nuk do të tolerohej, pasi veshja e dukshme e shenjave politike, filozofike ose fetare ishte në kundërshtim me neutralitetin e kompanisë.

Më 12 maj 2006, pas ndërprerjes së punës për arsye shëndetësore, znj. Achbita informoi punëdhënësin e saj se do të kthehej në punë më 15 maj dhe se do të mbante shaminë islame. Më 29 maj 2006, komiteti drejtues i kompanisë G4S miratoi një ndryshim në rregulloret e brendshme, i cili hyri në fuqi më 13 qershor 2006, sipas të cilit “punëtorëve u ndalohet të mbajnë në vendin e punës shenja të dukshme me karakter politik, filozofik ose fetar ose për të kryer ndonjë rit me karaktere të tilla”.

Më 12 qershor 2006, për shkak të dëshirës së vazhdueshme të treguar nga znj. Achbita për të mbajtur shaminë islame në vendin e saj të punës, ajo u pushua nga puna. Ajo përfitoi pagesën e një shpërblimi për largim nga puna, të barabartë me pagën e tre muajve dhe përfitimet e grumbulluara sipas kontratës së punës.

Pas rrëzimit të padisë të ngritur nga znj. Achbita kundër atij shkarkimi para Arbeidsrechtbank të Antwerpen¹⁶⁷, ajo apeloj në Arbeidshof te Antwerpen¹⁶⁸. Ky apel u refuzua me arsyetimin, sidomos, se shkarkimi nuk mund të konsiderohet i pajustificuar pasi ndalimi i përgjithshëm i veshjes në vendin e punës të shenjave të dukshme të bindjeve politike, filozofike ose fetare nuk çonte në diskriminim të drejtpërdrejtë dhe se nuk kishte asnjë diskriminim indirekt shkelje të lirisë individuale ose lirisë së fesë.

Për sa i përket mungesës së diskriminimit të drejtpërdrejtë, gjykata e punës vuri në dukje më saktësisht se duket që znj. Achbita u shkarkua, jo për shkak të besimit të saj mysliman, por sepse ajo këmbëngulte në dëshirën për ta shfaqur atë dukshëm, gjatë orarit të punës, duke veshur një shami islame. Dispozita e rregulloreve të brendshme, e shkëlur nga znj. Achbita, thuhet se është e përgjithshme përderisa i ndalon çdo punonjësi të mbajë shenja të dukshme të besimeve politike, filozofike ose fetare në vendin e tij të punës. Nuk ka asnjë fakt që do ta bënte gjykatën të supozojë se G4S kishte një sjellje më pajtuese ndaj një punonjësi tjetër, të vendosur në një situatë të krahasueshme, veçanërisht ndaj një punonjësi me bindje të tjera fetare ose filozofike që do të kishte refuzuar me këmbëngulje për ta respektuar këtë detyrim.

167 Tribunali i punës në Antwerp, Belgjikë.

168 Gjykata e punës në Antwerp.

Arbeidshof te Antwerpen hodhi poshtë argumentin se ndalimi, i vendosur nga G4S, për të veshur shenja të dukshme të besimeve fetare ose filozofike përbën në vetvete diskriminim të drejtpërdrejtë kundër znj. Achbita si besimtare, duke marrë parasysh se ky ndalim nuk kishte të bënte vetëm me veshjen e shenjave që lidhen me bindjet fetare, por edhe me veshjen e shenjave që lidhen me bindjet filozofike, duke respektuar në këtë drejtim kriterin e mbrojtjes të miratuar nga Direktiva 2000/78, e cila flet për “fenë ose [të] bindjet”.

Në kasacion, znj. Achbita argumentoi, në veçanti, se, duke marrë parasysh se bindja fetare mbi të cilën bazohet ndalimi i vendosur nga G4S përbën një kriter neutral dhe, duke mos e cilësuar atë ndalim si pabarazi të trajtimit midis punëtorëve që veshin një shami koke islame dhe atyre që nuk e bëjnë këtë, me arsyetimin se ndalimi në fjalë nuk synon një bindje të caktuar fetare dhe se u drejtohet të gjithë punonjësve, Arbeidshof te Antwerpen kishte shpërfillur konceptet e “diskriminimit të drejtpërdrejtë” dhe “diskriminimit indirekt” sipas kuptimit të nenit 2.2 të Direktivës 2000/78.

Në këto rrethana, Hof van Cassatie¹⁶⁹ vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i referojë Gjykatës për një vendim paraprak, pyetjen nëse neni 2.2 (a) i Direktivës 2000/78 duhet interpretuar në kuptimin që ndalimi i mbajtjes së shamisë, si myslimane në vendin e punës, nuk përbën diskriminim të drejtpërdrejtë, kur rregulli në fuqi te punëdhënësi ndalon të gjithë punëtorët të veshin shenja që shfaqin bindje politike, filozofike ose fetare në vendin e punës? “

Vendimi i Gjykatës

Në përgjigjen e saj, Gjykata theksoi se neni 1 i Direktivës 2000/78, nuk përmban një përkufizim të konceptit të fesë. Sidoqoftë, ligjvënësi i BE-së iu referua, në recitalin 1 të Direktivës 2000/78, të drejtave themelore të garantuara nga KEDNJ, e cila parashikon, në nenin 9, se secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, dhe se kjo e drejtë nënkupton, në veçanti, lirinë e shfaqjes së fesë ose besimit të

169 Gjykata e Kasacionit në Belgjikë.

tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose privatisht, përmes adhurimit, mësimit, praktikave dhe riteve.

Në të njëjtin recital, ligjvënësi i BE-së u referohet traditave kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës së BE-së. Midis të drejtave që rrjedhin nga këto tradita të përbashkëta dhe të cilat janë riafirmuar në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, ekziston e drejta për lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë, e parashikuar në nenin 10.1 të Kartës. Në përputhje me këtë dispozitë, kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndërruar fenë ose besimin, si dhe lirinë për të shfaqur fenë ose besimin individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, mësimit, praktikës dhe kryerjes së riteve. Siç duket nga shpjegimet në lidhje me Kartën e të Drejtave Themelore¹⁷⁰, e drejta e garantuar në nenin 10.1 të saj korrespondon me të drejtën e garantuar në nenin 9 të KEDNJ-së dhe, në përputhje me nenin 52 (3) të Kartës, ato kanë të njëjtin kuptim dhe shtrirje.

Përderisa KEDNJ dhe, më pas, Karta i japin një kuptim të gjerë konceptit të “fesë”, meqenëse ato përfshijnë në këtë koncept lirinë e personave për të shfaqur fenë e tyre, është e nevojshme të konsiderohet se ligjvënësi i BE-së synonte të miratonte të njëjtën qasje kur miratoi Direktivën 2000/78, në mënyrë që koncepti i «fesë» në nenin 1 të asaj direktive të interpretohet se përfshin si *forum internum*, d.m.th. pasjen e besimit, ashtu edhe *forum externum*, d.m.th. shfaqjen publike të besimit fetar.

Sipas Gjykatës, neni 2.2 (a) i Direktivës së Këshillit 2000/78/EC, të 27 nëntorit 2000, që krijon një kornizë të përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe punë, duhet të interpretohet se nënkupton që ndalimi i mbajtjes së shamisë islame, ndalim që parashikohet nga një rregull i brendshëm i një kompanie private që ndalon veshjen e dukshme të çdo shenje politike, filozofike ose fetare në vendin e punës, nuk përbën diskriminim të drejtpërdrejtë të bazuar në fe ose besim brenda kuptimit të kësaj direktive.

170 OJ 2007, C 303, f.17.

Në rastin konkret, rregulli i brendshëm i kompanisë GS4 i referohet veshjes së shenjave të dukshme të besimeve politike, filozofike ose fetare dhe, për këtë arsye, mbulon në mënyrë të njëjtë çdo shfaqje të këtyre besimeve. Rregulli i lartpërmendur duhet të konsiderohet se trajton të gjithë punonjësit në kompani në mënyrë të njëjtë, duke u imponuar atyre, në mënyrë të përgjithshme dhe të padallueshme, një neutralitet veshjesh që bie në kundërshtim me shenja të tilla.

Nga ana tjetër, një rregull i tillë i brendshëm i një ndërmarrjeje private mund të përbëjë një diskriminim indirekt sipas kuptimit të nenit 2.2 (b) të Direktivës 2000/78, nëse vërtetohet se detyrimi për pamje neutrale që ai parashikon, në fakt, përbën një disavantazh të veçantë për ata që ndjekin një fe ose besim të caktuar, përveç nëse justifikohet në mënyrë objektive nga një qëllim legjitim, siç është ruajtja nga punëdhënësi, në marrëdhëniet me klientët e tij, e një qëndrimi neutral politik, filozofik dhe fetar, dhe se mjetet për arritjen e këtij objektivi janë të përshtatshme dhe të nevojshme, gjë që i takon gjykatës referuese të vërtetojë në rastet konkrete.

Për sa i përket, në radhë të parë, kushtit që lidhet me ekzistencën e një objektivi legjitim, duhet të theksohet se dëshira për të shfaqur, në marrëdhëniet me klientët publikë dhe privatë, një politikë neutraliteti politik, filozofik ose fetar, duhet të konsiderohet si legjitime. Në të vërtetë, dëshira e një punëdhënësi për të shfaqur një imazh neutraliteti në lidhje me klientët ka të bëjë me lirinë për të kryer një biznes, të njohur në nenin 16 të Kartës, dhe është, në parim, legjitime, sidomos kur përfshihen në ndjekjen e këtij objektivi vetëm ata punëtorë që supozohet se do të jenë në kontakt me klientët e punëdhënësit.

Për sa i përket, së dyti, karakterit të përshtatshëm të një rregulli të brendshëm, siç është ai në fjalë në procedurën kryesore, duhet të theksohet se fakti që punëtorëve u ndalohet të mbajnë dukshëm shenja me karakter të organizatave politike, filozofike ose fetare, është i tillë që të sigurojë zbatimin e duhur të një politike neutrale, me kusht që kjo politikë të ndiqet vërtet në mënyrë koherente dhe sistematike.

Për sa i përket, së treti, karakterit të nevojshëm të ndalimit në fjalë në procedurën kryesore, duhet të vërtetohet nëse ai ndalim është i

kufizuar në atë që është rreptësisht e nevojshme. Në këtë rast, duhet të verifikohet nëse ndalimi i veshjes së dukshme të ndonjë shenje ose i ndonjë veshjeje që ka të ngjarë të lidhet me një besim fetar ose një bindje politike ose filozofike synon vetëm punonjësit e G4S që janë në kontakt me klientët. Nëse është kështu, ndalimi në fjalë duhet të konsiderohet si rreptësisht i nevojshëm për të arritur qëllimin e ndjekur.

Në rastin konkret, në lidhje me refuzimin e një punëtoreje si znj. Achbita për të hequr dorë nga mbajtja e shamisë islame në ushtrimin e aktiviteteve të saj profesionale me klientët e G4S, i takon gjykatës referuese të verifikojë nëse, duke marrë parasysh interesat e kompanisë, dhe pa qenë e nevojshme t'i ngarkohen detyrime shtesë, do të kishte qenë e mundur që G4S, përballë një refuzimi të tillë, t'i ofronte znj. Achbita një punë që nuk përfshinte kontakt direkt me klientët, në vend që ta shkarkonte atë. I takon gjykatës referuese, duke pasur parasysh të gjithë materialin në dosje, të marrë parasysh interesat e përfshira dhe t'i mbajë kufizimet ndaj lirive në fjalë, në atë që është rreptësisht e nevojshme.

Neni 39

Konfesionet Fetare

- 1. Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë fetare dhe monumentet fetare brenda territorit të saj.*
- 2. Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare.*
- 3. Konfesionet fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirëse në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI133/17. PARASHTRUES: ALI GASHI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/08/ki_133_17_av_shq.pdf]

26 gusht 2019

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky rast kishte të bënte me një të drejtë në pension në bazë të vendimit të Këshilli të Bashkësisë Islame që fillimisht i ishte njohur parashtruesit të kërkesës (i cili ishte pensionuar si imam) dhe më pas i ishte ndërprerë, me një vendim tjetër të së njëjtës instancë. Në procedurë gjyqësore, Gjykata Supreme kishte vendosur përfundimisht se gjykatat e rregullta nuk kishin juridiksion për të vendosur çështjen. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese ngriti çështjen e zbatimit të nenit 39 të Kushtetutës [Konfesionet Fetare].

Faktet kryesore

Parashtruesi i kërkesës kishte shërbyer si Kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame (në tekstin e mëtejme: “KBI”) në Pejë dhe ishte pensionuar më 27 gusht 2009. Mbështetur në vendimet e KBI-së së Kosovës, ai kishte përfituar nga pensioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, deri më 30 dhjetor 2011, datë kjo më të cilën KBI në Pejë ia ndërpreu të ardhurat e parashtruesit të kërkesës. Ky i fundit kishte kontestuar këtë vendim të KBI-së në Pejë, fillimisht brenda strukturave të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe më pas përmes gjykatave të rregullta. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kishin miratuar, përkatësisht vërtetuar, padinë e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, këto aktgjykime ishin anuluar nga Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit Rev. nr. 96/2017, të 1 qershorit 2017. Gjykata Supreme kishte arsyetuar se gjykatat në Republikën e Kosovës nuk kishin juridiksion për të shqyrtuar ndërgjyqësinë ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe KBI-së në Pejë, bazuar në paragrafin 2 të nenit 39 të Kushtetutës dhe në paragrafin 2 të nenit 5 dhe në paragrafin 2 të nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut për Liritë Fetare.

Këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës e kontestoi në Gjykatën Kushtetuese, përmes kërkesës së paraqitur më 14 nëntor 2017.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës Kushtetuese se përmes aktvendimit të Gjykatës Supreme atij i ishin shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenet kushtetuese në vijim: 3 [Barazia para Ligjit], 8 [Shteti Laik], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi se ky aktvendim ishte nxjerrë në shkelje të nenit 6 [E drejta për proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “KEDNJ”) dhe të nenit 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi u përqendrua kryesisht në pretendimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të së drejtës për qasje në gjykatë.

Arsyetimi i Gjykatës

Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese së pari elaboroi parimet e përgjithshme (nga praktika gjyqësore e konsoliduar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), lidhur me të drejtën për qasje në gjykatë duke shpjeguar: (i) natyrën juridike dhe fushëveprimin e së drejtës për qasje në gjykatë; (ii) kushtet që duhen plotësuar për ta pretenduar të drejtën për qasje në gjykatë; dhe (iii) kufizimet, në rrethana të caktuara, ndaj së drejtës për qasje në gjykatë. Në këtë sfond, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte “*një të drejtë civile*”, sepse e drejta e tij në “*pension-ndihmë materiale*”, ishte e rregulluar me rregullat dhe vendimet e brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe nuk ishte e bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Më tutje, Gjykata po ashtu vlerësoi nëse kufizimi i së drejtës për qasje në gjykatë kishte “*ndërlidhje të arsyeshme proporcionaliteti në mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet*”.

Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se bazuar në nenin 39 të Kushtetutës, ndër të tjera, konfesionet fetare kanë autonomi dhe janë

të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm. Megjithatë, Gjykata u shpreh se autonomia dhe pavarësia organizative e konfesioneve fetare nuk rezulton detyrimisht në kufizim të së drejtës për qasje në gjykatë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me individët që shërbejnë në konfesionet fetare. Gjykata theksoi se zbatueshmëria e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duhet të vlerësohet në secilin rast për të konstatuar nëse është e përfshirë një “*e drejtë civile*” dhe nëse ekziston një “*kontest*”, rrethana këto, të cilat ua garantojnë të drejtën e qasjes në gjykatë edhe të gjithë individëve që shërbejnë në konfesionet fetare.

Gjykata sqaroi se parimi i autonomisë së konfesioneve fetare dhe pavarësia e tyre e brendshme organizative nuk mund të rezultojë në cenim të të drejtave të individëve për qasje në gjykatë, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Sipas Gjykatës Kushtetuese, gjykatat duhet të vlerësojnë zbatueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e secilit rast, për të përcaktuar nëse kishte një “*të drejtë civile*” dhe një “*kontest*”. “*E drejta civile*” përkatëse duhet të jetë e bazuar në ligjet e aplikueshme civile të Republikës së Kosovës dhe gjatë zgjidhjes së këtyre kontesteve, gjykatat duhet të respektojnë edhe autonominë e konfesionit fetar përkatës, siç është e përcaktuar me Kushtetutë.

Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Kushtetuese gjeti se nuk ishte përfshirë “*një e drejtë civile*” e përcaktuar me ligjet civile të Republikës së Kosovës, por çështja kishte të bënte me një të drejtë të përcaktuar me rregullat dhe vendimet e brendshme të Bashkësisë Islame të Kosovës. Si rezultat, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk ishin të aplikueshëm. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk ishte në pajtueshmëri *ratione materiae* me Kushtetutën.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 39 (3) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, njëzëri, e shpalli kërkesën të papranueshme sepse kërkesa nuk ishte në pajtueshmëri *ratione materiae* me Kushtetutën.

2. PËRBMLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. FERNÁNDEZ MARTÍNEZ kundër SPANJËS

[56030/07]

[Dhoma e Madhe]

12 qershor 2014

Çështja kyçele drejta e pretenduar: e drejta e individuale për jetën private dhe familjare, dhe e drejta e organizatave fetare për autonomi; neni 8 - ndërprerja (mosvazhdimi) e kontratës së punës ka rezultuar me ndërhyrjen në të drejtën në jetën private dhe familjare.

Faktet kryesore

Ky rast ka të bëjë me një kërkesë të ngritur kundër Mbretërisë së Spanjës nga një shtetas i saj, M. José Antonio Fernández Martínez (kërkuesi), i cili i është drejtuar Gjykatës më 11 dhjetor 2007 në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore.

Kërkuesi është një prift katolik dhe në vitin 1984, ai i kërkoi Vatikanit të lirohej nga detyrimi i beqarisë (celibatit). Një vit më pas, u martua me një grua me të cilën ka pesë fëmijë. Që nga viti 1991, ai punoi si mësues i fesë dhe moralit në një gjimnaz publik, kontrata e tij vjetore e punës përsëritej bazuar në rekomandimin e peshkopit të dioqezës, dhe ky rekomandim respektohej nga Ministria e Arsimit. Ky modalitet i vazhimit të kontratave bazohej në dispozitat e një Marrëveshjeje të vitit 1979 ndërmjet Spanjës dhe Selisë së Shenjtë, e cila parashikonte se “edukimi fetar do të jepet nga personat të cilët, çdo vit shkollor, emërohen nga autoriteti administrativ nga ata që propozohen nga Ordinari [d.m.th. peshkopi] i dioqezës”.

Në vitin 1996, kërkuesi mori pjesë në një mbledhje të ‘Lëvizjes pro Beqarisë Fakultative’ (Movement for Optional Celibacy (MOCEOP). Aty, pjesëmarrësit paraqitën kundërshtimin e tyre ndaj qëndrimeve të Kishës mbi shumë

tema si abortin, divorcin, seksualitetin ose kontrollin mbi lindjet. Në një gazetë rajonale (La Verdad) u publikua një artikull (me fotografi të kërkuetit me familjen, emri i tij, dhe shumë nga komentet e tij). Më 29 shtator 1997, Dioqeza e Kartagenës informoi Ministrinë e Arsimit në një memorandum me shkrim se kërkueti nuk do të konsiderohej më si mësues i fesë “i propozuar nga Ordinari i dioqezës” dhe, si pasojë, punësimi i tij u ndërpre nga Ministria e Arsimit. Kësisoj, punësimi i tij u ndërpre nga një autoritet qeveritar laik, por në bazë të një vendimi të marrë nga një autoritet fetar. Kontrata e tij e punës si mësues religjioni nuk u vazhdua për arsye se, duke shpallur publikisht situatën e tij si ‘prift i martuar’, ai nuk e kishte përmbushur detyrimin për të dhënë mësim ‘pa rrezikuar shkaktimin e skandalit’.

Kërkueti e kundërshtoi, pa sukses, këtë vendim para gjykatave vendore, përfshirë edhe kërkesën e kërkuetit pranë Gjykatës kushtetuese. Këto të fundit vlerësuan se, përderisa arsyetimi për mosvazhdimin e kontratës ishte ‘ngushtësisht fetar’, ato duhej të kufizoheshin në verifikimin e respektimit të të drejtave themelore të kërkuetit që ndërlidheshin me këtë çështje. Veçanërisht, pasi kishte shqyrtuar me kujdes faktet e çështjes, Gjykata kushtetuese vlerësoi se detyrimi i Shtetit për neutralitet ia ndalonte këtij të fundit të shprehej mbi nocionin e ‘skandalit’ të përdorur nga peshkopi për të kundërshtuar përsëritjen e kontratës së kërkuetit, si dhe mbi legjitimitetin e beqarisë fakultative të priftërinjve të mbrojtur nga pala e interesuar (Kisha katolike). Në vlerësim të cenimit të të drejtave të kërkuetit, Gjykata kushtetuese kishte vlerësuar se “ndërhyrjet në të drejtat e kërkuetit as nuk ishin joproportionale, e as jokushtetuese, por justifikoheshin me detyrimin për respektim të ushtrimit të ligjshëm të së drejtës së Kishës katolike për liri fetare në dimensionin kolektiv dhe komunitar, në lidhje me të drejtën e prindërve për të zgjedhur edukimin fetar të fëmijëve të tyre (neni 27.3 i Kushtetutës)”.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkueti u ankua për mosvazhdimin e kontratës së tij të punës, që, për pasojë, sipas kërkuetit në rastin e tij kishte shkelje të së drejtës në jetën e tij private dhe familjare dhe iu referua nenit 8 të Konventës.

Fillimisht, në vendimin e 15 majit 2012, Dhoma e GJEDNJ-së vuri në dukje se në të drejtën spanjolle nocioni i autonomisë së komuniteteve

fetare plotësohet nga parimi i neutralitetit fetar të shtetit, i pranuar nga Kushtetuta, i cili e ndalon këtë të fundit të shprehet mbi çështje të tilla si celibati i priftërinjve. Ajo gjithsesi e pranoi se ky detyrim për neutralitet nuk është i pakufizuar: vendimi i Gjykatës kushtetuese i dhënë në këtë rast kishte konfirmuar se ky detyrim nuk u hiqte gjykatave mundësinë për të kontrolluar vendimin e peshkopit, për të siguruar respektimin e të drejtave themelore dhe lirive publike; vendimi në fjalë kishte shtuar se, megjithatë përkufizimi i kritereve fetare ose morale si arsye thelbësore për mosvazhdimin e një kontrate pune, i përkiste vetëm autoritetit fetar, dhe, se gjykatat vendore mund të vlerësonin dhe të siguronin balancimin e të drejtave themelore në çështjen kontestuese dhe të gjenin nëse arsye të ndryshme nga ato me karakter ngushtësisht fetar kishin ndërhyrë në vendimin për të mos e vazhduar kontratën e kandidatit, meqë arsyet fetare mbrohen nga parimi i lirisë fetare.

Dhoma kishte konstatuar se kërkuesi kishte pasur mundësinë ta çonte çështjen e tij para Gjyqtarit të punës, pastaj para Gjykatës së Lartë të Drejtësisë së Murcie-së dhe, në instancë të fundit, para Gjykatës Kushtetuese përmes një ankimi bazuar në procedurën e *amparo-s*. Ajo ka shtuar se leja për lirim nga celibati, që iu dha të kërkuesit, saktësonte se përfituesit e një mase të tillë nuk mund të jepnin mësim për fenë katolike në institucione publike, përveçse me një autorizim të peshkopit.

Dhoma ishte e mendimit se rrethanat që kishin arsyetuar mosvazhdimin e kontratës së kërkuesit ishin të natyrës ‘ngushtësisht fetare’ dhe se detyrimet e parimeve të lirisë fetare dhe të neutralitetit e ndalonin Gjykatën të shkonte më tej në shqyrtimin që lidhej me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e vendimit për mosvazhdimin e kontratës se kërkuesit për postin e mësuesit.

Si përfundim, Dhoma vlerësoi se gjykatat kompetente kishin ruajtur një ekuilibër të drejtë midis shumë interesave private dhe se, aty nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Për kërkuesin, vendimi i Dhomës së GJEDNJ-së ‘ka sakrifikuar të drejtën e tij për jetë private dhe familjare në favor të një të drejte absolute të Kishës katolike’. Kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij iu referua jurisprudencës së Gjykatës që buron nga çështja *Hassan dhe Tchaouch*

kundër Bullgarisë ([DHM]paragrafi 60, GJEDNJ 2000XI), sipas së cilës, sipas mendimit të tij, e drejta për liri të besimit nuk mbron çfarëdo akti të motivuar ose të frymëzuar nga një fe ose një bindje. Ai çmoi se, në këtë rast, vendimi i mosvazhdimin të kontratës i marrë pas bërjes publike të gjendjes së tij, ishte qartësisht joproporcional. Kërkuesi theksoi se argumenti për 'rrezikun e skandalit' i përmendur nga peshkopata mbështetej mbi publikimin në shtyp të një fotografie, ku ai shfaqej me familjen e tij. Në këtë drejtim, ai pretendoi se nuk ishte shprehur kurrë kundër postulateve të Kishës, veçanërisht kundër beqarisë së priftërinjve, gjatë orëve të mësimin të fesë që ai jepte. Ai përmendi edhe notën mbështetëse të drejtorit të gjimnazit ku jepte mësim.

Në deklaratimet e saj, Qeveria theksoi se është thelbësore të zgjidhet çështja qendrore, d.m.th. të përcaktohet se cilat fakte kanë arsyetuar vendimin e peshkopatës së Kartagjenës për të mos ripërtërirë certifikatën e kërkuesit për aftësi në mësimdhënien e fesë katolike, rrjedhimisht mosvazhdimin e kontratës. Qeveria pretendoi se mosripërtëritja është shkaktuar nga ngjarjet e provokuara nga vetë kërkuesi, kur ka zbuluar, sipas Qeverisë, vullnetarisht në media gjendjen e tij si prift i martuar dhe përkatësinë e tij në Lëvizjen pro beqarisë fakultative (MOCEOP), si dhe mendimet e tij kundër qëndrimit të Kishës katolike mbi tema të ndryshme. Këto deklarata publike e kishin thyer lidhjen e besimit, që është thelbësore, midis Kishës dhe kërkuesit.

Qeveria pretendoi se në këtë rast arsytet e kontestuarat ishin me natyrë 'ngushtësisht fetare' dhe preknin detyrimin për besnikëri dhe koherencë që kërkuesi duhet të përmbushë në punën që ka zgjedhur lirisht dhe që, për më tepër, dallon nga mësimdhënia e një lënde tjetër, si historia apo matematika. Pra, Qeveria e ftoi Gjykatën të ketë parasysh se lidhja e besnikërisë, në këtë rast, është më e theksuar se ajo që ekziston në çështje që kanë të bëjnë me një organist të një famullie, me një person që ruan fëmijët në një shkollë fetare, ose edhe me një drejtor të marrëdhënieve me publikun në një Kishë.

Për Qeverinë, ka rëndësi të dihet se deri në ç' masë një organizatë fetare është e detyruar të emërojë ose të vazhdojë të punësojë si mësues të fesë një person që ka shpallur publikisht ide të kundërta me doktrinën e saj. Fjalët e shprehura dhe deklaratimet e kërkuesit sigurisht kishin lidhje me

të drejtën e tij për liri të shprehjes, por ato gjithsesi ishin në kundërshtim me doktrinën e Kishës dhe me kushtet e kërkuara për aftësinë kanonike të profesorëve të saj.

Rasti u referua në Dhomën e madhe të GJEDNJ-së me kërkesë të kërkuarit. Seanca dëgjimore publike u zhvillua para Dhomës së Madhe më 30 janar 2013.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata çmoi se në këtë rast duhet të merren parasysh elementet e mëposhtme:

a) *Statusi i kërkuarit* – Kërkuari, duke nënshkruar kontratat e njëpasnjëshme të punës, ka pranuar me vetëdije dhe vullnetarisht detyrimin për besnikëri të madhe kundrejt Kishës Katolike, çka e ka kufizuar deri në një farë mase shtrirjen e së drejtës së tij për respektim të jetës private dhe familjare. Kufizime të tilla kontraktuale janë të pranueshme sipas Konventës, kur ato pranohen lirisht. Në fakt, nga pikëpamja e interesit të Kishës për mbrojtjen e koherencës së rregullave të saj, mësimdhënia e fesë për adoleshentët duhet të konsiderohet si një funksion kyç që kërkon një besnikëri të veçantë. Edhe pse statusi i kërkuarit si prift i martuar nuk ishte i qartë, mund të pritej ende nga ky i fundit që të respektonte një detyrim besnikërie përderisa peshkopi e kishte konsideruar të denjë për të dhënë mësim fenë katolike.

b) *Bërja publike nga ana e kërkuarit të gjendjes së tij si prift i martuar* – Duke pranuar ta bëjë publike gjendjen e tij familjare dhe pjesëmarrjen në një tubim, që peshkopi e ka konsideruar si protestë, kërkuari ka ndërprerë lidhjen e mirëbesimit të veçantë, që ishte e domosdoshme për përmbushjen e detyrave që i ishin ngarkuar. Duke pasur parasysh rëndësinë e mësimin të fesë për të gjitha besimet, nuk ishte e papritur që një shkoputje e tillë të kishte pasoja. Ekzistenca e një divergjence midis ideve që duhet të mësohen dhe bindjeve personale të profesorit mund të përbëjnë një problem besueshmërie, kur ky mësues shprehet aktivisht dhe publikisht kundër ideve në fjalë. Kështu, problemi në këtë rast ka të bëjë me rrethanën që kërkuari mund të konsiderohet se shprehet në favor të mënyrës së tij të jetesës, me qëllim që të provokojë

një ndryshim në rregullat e Kishës, dhe me kritikën e hapura ndaj këtyre rregullave.

c) *Bërja publike nga kërkuesi e përkatësisë së tij në MOCEOP dhe fjalët që i janë atribuar* – Nëse dihej nga të gjithë se kërkuesi ishte i martuar dhe baba i pesë fëmijëve, është vështirë të përcaktohet se deri në ç’masë dihej nga publiku i gjerë se ai merrte pjesë në një organizatë që ndiqte objektiva të papajtueshme me doktrinën zyrtare të Kishës para daljes së artikullit të kontestuar. Sidoqoftë, vetëm fakti se asgjë s’jep shkas për të menduar se kërkuesi ka dhënë, në orët e mësimit, teza të papajtueshme me doktrinën e Kishës Katolike nuk lejon të konkludojmë se ai e ka plotësuar detyrimin e tij për besnikëri të madhe. Nga ana tjetër, s’ka pikë dyshimi se kërkuesi, si ish-prift dhe drejtor seminari, ishte dhe duhej të ishte i vetëdijshëm për përmbajtjen dhe rëndësinë e këtij detyrimi. Nga ana tjetër, ndryshimet e krijuara nga bërja publike e përkatësisë së kërkuesit në MOCEOP dhe fjalëve të tij merrnin edhe më shumë rëndësi për shkak se i interesuari u jepte mësim adoleshentëve, të cilët nuk kishin pjekurinë e mjaftueshme për të bërë dallimin midis informacioneve që lidhen me doktrinën e Kishës Katolike dhe ato që përbënin mendimin personal të kërkuesit.

d) *Përgjegjësia e Shtetit si punëdhënës* – Fakti që kërkuesi ishte i punësuar dhe i paguar nga shteti nuk mund të ndikojë në shtrirjen e detyrimit për besnikëri që kërkuesi duhej të përmbushte ndaj Kishës Katolike ose mbi masat, që kjo e fundit mund të marrë në rastin kur nuk përmbushet ky detyrim.

e) *Ashpërsia e sanksionit* – Fakti që një punonjës i pushuar nga një punëdhënës kishtar ka mundësi të kufizuara për të gjetur një punë të re, merr një rëndësi të veçantë. Kjo është e vërtetë, aq më tepër, kur një punëdhënës zë një pozicion mbizotërues në një sektor të dhënë aktivitetesh dhe përfiton nga disa shmangie nga legjislacioni i përgjithshëm, ose kur formimi i të punësuarit të pushuar është aq specifik, sa që ai e ka të vështirë, ose të pamundur të gjejë një vend të ri pune jashtë Kishës që e punëson. Nga ana tjetër, për shkak të përgjegjësive të dikurshme në gjirin e Kishës, ai i njihte rregullat e saj dhe duhej, pra, ta dinte se bërja publike vullnetarisht e përkatësisë së tij në MOCEOP, nuk mbetej pa pasoja për kontratën e tij. Në fund të fundit, në

këtë çështje, një masë më pak kufizuese për kërkuesin sigurisht nuk do të kishte pasur të njëjtën efektshmëri sa i përket ruajtjes së besueshmërisë së Kishës. Pasojat për kërkuesin lidhur me mosvazhdimin e kontratës duket se nuk kanë qenë të tepruara në rrethanat e çështjes, veçanërisht, po të merret parasysh fakti se ai e ka vënë veten, me ndërgjegje, në një situatë krejtësisht të kundërt me mësimet e Kishës.

f) *Kontrolli i ushtruar nga gjykatat e brendshme* – Kërkuesi ka mundur të kontestojë mosvazhdimin e kontratës së tij para shumë gjykatave të niveleve të ndryshme. Gjykatat vendore kanë marrë parasysh elementët përkatës dhe, edhe pse e kanë vënë theksin mbi të drejtën e ankuesit për liri të shprehjes, ato kanë bërë një vënie në balancë, të hollësishme dhe të thelluar, të interesave në lojë, në kufijtë që iu impononte respektimi i autonomisë së Kishës katolike. Përfundimet në të cilat arritën nuk duken të paarsyeshme. Fakti që Gjykata Kushtetuese bëri një analizë të thelluar është edhe më e qartë nga fakti se dy opinione ndryshe gjenden bashkëlidhur me këtë vendim, çka tregon se gjykata e lartë e ka shqyrtuar problemin në këndvështrime të ndryshme, duke mos u shprehur mbi thelbin e parimeve që miraton Kisha. Sa për autonominë e Kishës, në dritën e kontrollit të ushtruar nga gjykatat kombëtare, nuk duket të jetë përmendur në mënyrë abuzive në këtë çështje, d.m.th. nuk duket që vendimi i peshkopatës për të mos propozuar vazhdimin e kontratës së kërkuesit të ketë qenë i paarsyetuar mjaftueshëm, arbitrar ose të jetë marrë për një qëllim që nuk lidhet me ushtrimin e autonomisë së Kishës katolike.

Duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit të Shtetit në këtë rast, ndërhyrja në ushtrimin nga ana e kërkuesit të së drejtës së tij për respektim të jetës private, nuk ishte joproportionale.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

VERA EGENBERGER kundër

3.1. EVANGELISCHES WERK FÜR DIAKONIE UND ENTWICKLUNG EV

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C414/16

17 prill 2018

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=201148&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13714652>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Kjo çështje ka të bëjë me kriterin e besimit fetar për qëllimet e punësimit në një institucion fetar dhe me shmangien e diskriminimit në raste të tilla.*

Faktet kryesore

Në nëntor 2012, Evangelisches Werk publikoi një ofertë pune për një afat të caktuar për një projekt në lidhje me përgatitjen e Raportit Paralel mbi Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Në përputhje me këtë ofertë, detyrat që do të kryheshin përfshinin: mbështetjen e procesit të krijimit të raporteve shtetërore mbi Konventën në fjalë për periudhën nga 2012 në 2014, përgatitjen e një raporti paralel me raportin e Qeverisë gjermane, si dhe vëzhgimet dhe kontributet e specialistëve, përfaqësimin, në kuadrin e projektit, të strukturave të diakonisë gjermane në raport me politikën, publikun dhe organizatat e të drejtave të njeriut, si dhe bashkëpunimin brenda organeve të caktuara, informacionin dhe koordinimin e procesit të formimit të opinionit publik, si dhe organizimin, administrimin dhe krijimin e raporteve teknike në fushën e punësimit.

Gjithashtu, ajo ofertë specifikohte kushtet që duhet të plotësonin kandidatët. Njëri prej tyre përcaktonte:

“Pjesëmarrja në një kishë protestante ose në një kishë anëtare të komunitetit të punës të kishave të krishtera në Gjermani dhe identifikimi me misionin diakonal janë parakushte. Ju lutemi tregoni besimin tuaj në jetëshkrimin tuaj”.

Znj. Egenberger, e cila nuk i përkiste asnjë besimi, aplikoi për postin e shpallur. Edhe pse kandidatura e saj mbeti në listë pas një përzgjedhjeje fillestare të bërë nga Evangelisches Werk, ajo nuk u ftua për intervistë. Nga ana e tij, kandidati i përzgjedhur në fund kishte treguar, në lidhje me përkatësinë e tij fetare, se ishte “një i krishterë që bënte pjesë në kishën protestante rajonale të Berlinit”.

Duke marrë parasysh që kërkesa e saj ishte refuzuar me arsyetimin se ajo nuk i përkiste një besimi, znj. Egenberger bëri një padi në Arbeitsgericht Berlin¹⁷¹, duke kërkuar që Evangelisches Werk të dënohej dhe, sipas nenit 15.2 të Ligji i përgjithshëm mbi barazinë në trajtim (në tekstin e mëtejshëm: AGG)¹⁷², ta dëmshpërblente në shumën prej 9,788.65 euro. Padiësja shpjegoi se marrja parasysh e fesë në procedurën e rekrutimit, e identifikueshme në ofertën e punës në fjalë, nuk ishte në përputhje me ndalimin e diskriminimit të parashikuar nga AGG, siç interpretohet në përputhje me të drejtën e BE-së, dhe se neni 9.1 i AGG nuk mund të justifikojë diskriminimin, viktimë e të cilit ishte ajo.

Evangelisches Werk argumentoi se, në këtë rast, një dallim në trajtim për shkak të fesë ishte i justifikuar sipas nenit 9.1 të AGG. Sipas Evangelisches Werk, e drejta për të imponuar anëtarësimin në një kishë të krishterë është pjesë e së drejtës për autoqefalinë kishtare të mbrojtur nga neni 140 i Ligjit Themelor të Gjermanisë (në tekstin e mëtejshëm: GG)¹⁷³, lexuar në lidhje me nenin 137, paragrafi 3, të Kushtetutës së Weimarit (WRV). Një e drejtë e tillë do të ishte në përputhje me të drejtën e BE-

171 Gjykata e Punës, Berlin, Gjermani.

172 Ligji i përgjithshëm mbi barazinë në trajtim, i 14 gushtit 2006 (BGBl. 2006 I, p.1897) që synon transpozimin e direktivës 2000/78 në të drejtën gjermane.

173 Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland – Ligji themelor i Republikës Federale Gjermane.

së, veçanërisht për shkak të dispozitave të nenit 17 të TFBE-së. Për më tepër, për shkak të natyrës së aktivitetit të mbuluar nga oferta e punës në fjalë në procedurën kryesore, përkatësia fetare përbën një kërkesë të justifikuar profesionale duke pasur parasysh ndërjegjen kishtarë të Evangelisches Werk.

Arbeitsgericht Berlin e pranoi pjesërisht padinë e znj. Egenberger. Ajo vendosi se kjo e fundit kishte qenë viktimë e diskriminimit, por e kufizoi shumën e kompensimit në 1,957.73 euro. Meqenëse apeli i znj. Egenberger kundër këtij vendimi u refuzua nga Landesarbeitsgericht Berlin-Brandenburg¹⁷⁴, ajo bëri një padi për rishikim para gjykatës referuese në këtë rast, Bundesarbeitsgericht¹⁷⁵, në mënyrë që të merrte kompensimin e pretenduar.

Bundesarbeitsgericht vlerësoi se rezultati i procedurës kryesore varej nga fakti nëse dallimi i bazuar në përkatësinë fetare i bërë nga Evangelisches Werk ishte i ligjshëm, në kuptimin e nenit 9.1 të AGG. Sidoqoftë, përderisa kjo dispozitë duhet të interpretohet në përputhje me të drejtën e BE-së, zgjidhja e çështjes varej nga interpretimi i nenit 4.2 të Direktivës 2000/78, të cilin neni 9 i AGG supozohej se e kishte transpozuar në të drejtën gjermane. Gjykata referuese nënvizoi gjithashtu që ky ndryshim në trajtim duhet të ushtrohet në përputhje me dispozitat kushtetuese të shteteve anëtare, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së dhe me nenin 17 të TFBE-së.

Së pari, gjykata referuese pyeti, në thelb, nëse neni 4.2 i Direktivës 2000/78 duhet të interpretohet se në kuptimin që një kishë ose organizatë tjetër, etika e së cilës bazohet në fe ose në besim, e cila synon të punësojë persona, mund të përcaktojë se në cilat aktivitete profesionale, nga natyra e veprimtarisë ose nga konteksti në të cilin ato ushtrohen, feja përbën një kërkesë thelbësore profesionale, e ligjshme dhe e justifikuar duke pasur parasysh etikën e kësaj kishe apo organizate.

174 Gjykata e Lartë e Punës, Berlin-Brandenburg, Gjermani

175 Gjykata Federale e Punës, Gjermani.

Me pyetjen e saj të dytë, gjykata referuese pyeti, në thelb, nëse një gjykatë kombëtare është e detyruar, në kontekstin e një mosmarrëveshjeje midis individëve, të lërë të pazbatuar një dispozitë kombëtare, e cila nuk mund të interpretohet në përputhje me nenin 4.2 të Direktivës 2000/78.

Me pyetjen e saj të tretë, e cila duhet të shqyrtohet para pyetjes së dytë, gjykata referuese pyeti, në thelb, mbi bazën e kritereve që është e përshtatshme të verifikohen në secilin rast të caktuar nëse, duke pasur parasysh etikën e kishës ose organizatës në fjalë, feja ose besimet përbëjnë, në lidhje me natyrën e aktivitetit në fjalë ose kontekstin në të cilin ai kryhet, një kërkesë thelbësore, legjitime dhe të justifikuar profesionale, në kuptimin e nenit 4.2 të Direktivës 2000/78.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata theksoi së pari se neni 4.2 i Direktivës së Këshillit 2000/78/EC të 27 nëntorit 2000 që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion, lexuar bashkë me nenet 9 dhe 10 të tij, si dhe me nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, duhet të interpretohen ashtu që, kur një kishë ose organizatë tjetër, etika e së cilës bazohet në fe ose besime argumenton, në mbështetje të një akti ose një vendimi të tillë, si refuzimi i një kërkesë për një punësim në këtë organizatë, që, nga natyra e aktiviteteve në fjalë ose nga konteksti në të cilin kryhen këto aktivitete, feja përbën një kërkesë thelbësore profesionale, të ligjshme dhe të justifikuar, duke pasur parasysh etikën e kësaj kishe ose të kësaj organizate, një pretendim i tillë duhet të jetë në gjendje, nëse është e nevojshme, të jetë objekt i rishikimit efektiv gjyqësor për t'u siguruar se, në këtë rast, plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 4.2 të asaj Direktive.

Ndërsa Direktiva 2000/78 synon të mbrojë të drejtën themelore të punëtorëve për të mos u diskriminuar në bazë të fesë ose bindjeve të tyre, fakti mbetet se, nëpërmjet nenit 4.2, ajo Direktivë gjithashtu synon të marrë parasysh të drejtën për autonomi të kishave dhe organizatave të tjera publike ose private, etika e të cilave bazohet në fe ose besim, siç njihet në nenin 17 të TFBE-së dhe në nenin 10 të Kartës, që korrespondon me nenin 9 të KEDNJ-së.

Qëllimi i nenit 4.2 të Direktivës 2000/78 është të sigurojë një ekuilibër të drejtë midis, nga njëra anë, të drejtës për autonomi të kishave dhe organizatave të tjera, etika e të cilave bazohet në fe ose besime dhe, nga ana tjetër, të drejtës së punëtorëve që të mos i nënshtrohen, veçanërisht gjatë marrjes në punë, diskriminimit të bazuar në fe ose besim, në situata në të cilat këto të drejta mund të jenë konkurrense. Në këtë këndvështrim, kjo dispozitë përcakton kriteret që duhen marrë parasysh në kontekstin e baraspeshës që duhet bërë në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër i drejtë midis këtyre të drejtave potencialisht konkurruese.

Megjithatë, në rast mosmarrëveshjeje, një baraspeshë e tillë, kur është e përshtatshme, duhet të jetë në gjendje t'i nënshtrohet rishikimit nga një autoritet i pavarur dhe, në shkallë të fundit, nga një gjykatë kombëtare.

Neni 17 i TFBE-së shpreh neutralitetin e Bashkimit në lidhje me organizimin nga shtetet anëtare të marrëdhënieve të tyre me kishat dhe shoqatat ose bashkësitë fetare. Nga ana tjetër, ai nen nuk është i tillë që të parandalojë pajtueshmërinë me kriteret e përcaktuara në nenin 4.2 të Direktivës 2000/78 për sa i përket shqyrtimit efektiv gjyqësor.

Neni 4.2 i Direktivës 2000/78 duhet të interpretohet se nënkupton që kërkesa thelbësore, legjitime dhe e justifikuar profesionale, e përmendur në të, i referohet një kërkesë të nevojshme dhe të diktuar objektivisht, duke pasur parasysh etikën e kishës ose organizatës në fjalë, nga natyra ose kushtet e ushtrimit të veprimtarisë profesionale në fjalë dhe nuk mund të mbulojë konsiderata jashtë kësaj etike ose të drejtës për autonomi të kësaj kishë ose të kësaj organizate. Kjo kërkesë duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Për sa i përket interpretimit të konceptit të “kërkesave thelbësore, legjitime dhe të justifikuar profesionale” në nenin 4.2 të Direktivës 2000/78, nga ajo dispozitë del qartë se “natyra” e aktiviteteve në fjalë ose “konteksti” në të cilin ato kryhen janë të tilla që, feja ose besimi mund të përbëjnë një kërkesë të tillë profesionale.

Kështu, ligjshmëria, nën këndvështrimin e kësaj dispozite, e një trajtimi të ndryshëm të bazuar në fe ose besim i nënshtrohet ekzistencës

objektivisht të verifikueshme të një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis kërkesës profesionale të vendosur nga punëdhënësi dhe aktivitetit në fjalë. Një lidhje e tillë mund të lindë ose nga natyra e atij aktiviteti, për shembull kur përfshin pjesëmarrjen në përcaktimin e etikës së kishës ose organizatës në fjalë ose në bashkëpunimin në shpalljen e misionit të saj, ose nga kushtet në të cilat një aktivitet i tillë duhet të kryhet, siç është nevoja për të siguruar përfaqësim të besueshëm të kishës ose organizatës në publik.

Për më tepër, siç kërkohet nga neni 4.2 i Direktivës 2000/78, kjo kërkesë profesionale duhet të jetë “thelbësore, e ligjshme dhe e justifikuar” duke pasur parasysh etikën e kishës ose të organizatës. Ndërsa në parim nuk u takon gjykatave kombëtare të vendosin për etikën, si të tillë, në lidhje me kriteret profesionale të kërkuara, u takon gjithsesi atyre të përcaktojnë, rast pas rasti, nëse, në lidhje me këtë etikë, janë përmbushur këto tri elemente.

Është e rëndësishme të specifikohet lidhur me to, para së gjithash për sa i përket natyrës “thelbësore” të kërkesës, se përdorimi i këtij termi kupton që, për ligjvënësin e BE-së, përkatësia në një fe ose respektimi i bindjeve mbi të cilat bazohet etika e kishës ose organizatës në fjalë, duhet të duket e nevojshme për shkak të rëndësisë së veprimtarisë profesionale në fjalë për afirmimin e kësaj etike ose ushtrimin nga ajo kishë ose organizatë të së drejtës së saj për autonomi.

Për sa i përket, së dyti, natyrës “legjitime” të kërkesës, përdorimi i këtij termi tregon se ligjvënësi i BE-së synonte të siguronte që kërkesa në lidhje me anëtarësimin në fe ose respektimin e besimeve mbi të cilat bazohet etika e kishës ose organizatës, nuk përdoret për të ndjekur ndonjë qëllim që nuk lidhet me një etikë të tillë ose me ushtrimin nga ajo kishë ose organizatë të së drejtës së saj për autonomi.

Për sa i përket, së treti, natyrës së “justifikuar” të kërkesës, ky term nënkupton jo vetëm që kontrolli i pajtueshmërisë me kriteret e përcaktuara në nenin 4.2 të Direktivës 2000/78 të mund të kryhet nga një gjykatë kombëtare, por gjithashtu që kisha ose organizata që ka vendosur këtë kriter ka detyrimin të tregojë, në dritën e rrethanave faktike të çështjes në fjalë, se rreziku i pretenduar për të minuar etikën e

saj ose të drejtën e saj për autonomi është i mundshëm dhe serioz, dhe prandaj parashikimi i një kriteri të tillë është vërtet i nevojshëm.

Një gjykatë kombëtare që shqyrton një mosmarrëveshje midis dy individëve, kur nuk është e mundur që ajo të interpretojë ligjin kombëtar të zbatueshëm në përputhje me nenin 4.2 të Direktivës 2000/78, është e detyruar të sigurojë, brenda kuadrit të kompetencave të saj, mbrojtjen ligjore që rezulton për palët ndërgjyqëse nga nenet 21 dhe 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe për të garantuar efektin e plotë të këtyre neneve, duke lënë të pazbatuar, nëse është e nevojshme, çdo dispozitë të kundërt kombëtare. Në këtë drejtim, duhet të kujtohet se u takon gjykatave kombëtare, në përputhje me të gjitha rregullat e së drejtës së brendshme dhe në zbatim të metodave të interpretimit të njohura prej saj, për të vendosur nëse dhe në çfarë mase një dispozitë kombëtare, siç është neni 9.1 i AGG, mund të interpretohet në përputhje me nenin 4.2 të Direktivës 2000/78 pa bërë një interpretim *contra legem* të kësaj dispozite kombëtare. Në rast se do të ishte e pamundur që ajo të kryente një interpretim të tillë të pajtueshëm të dispozitës kombëtare në fjalë në procedurën kryesore, duhet të theksohet, së pari, se Direktiva 2000/78 nuk përcakton vetë parimin e trajtimit të barabartë në çështje të punësimit dhe profesionit, i cili e ka burimin në instrumente të ndryshme ndërkombëtare dhe në traditat kushtetuese të përbashkëta për shtetet anëtare, por ka për qëllim vetëm të krijojë, në këto fusha, një kuadër të përgjithshëm për luftën kundër diskriminimit për motive të ndryshme, përfshirë fenë ose besimin, siç duket nga titulli dhe nga neni 1 i tij.

Ndalimi i çdo diskriminimi të bazuar në fe ose besim është imperativ, si parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së. Ky ndalim, i sanksionuar nga neni 21.1 i Kartës, është i mjaftueshëm në vetvete për t'ua njohur individëve një të drejtë të cilën mund ta pretendojnë si të tillë në një mosmarrëveshje midis tyre në një fushë të mbuluar nga e drejta e BE-së. Në lidhje me efektin imperativ që ka, neni 21 i Kartës nuk ndryshon, në parim, nga dispozitat e ndryshme të traktateve themeluese që ndalojnë diskriminimin për motive të ndryshme, edhe kur një diskriminim i tillë vjen nga kontratat e lidhura midis individëve.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se, ashtu si neni 21 i Kartës, neni 47 i saj, që lidhet me të drejtën për mbrojtje efektive gjyqësore, është i mjaftueshëm në vetvete dhe nuk ka nevojë të specifikohet me dispozita të tjera të BE-së ose të së drejtës kombëtare me qëllim që t'ua njohë individëve një të drejtë të cilën mund ta pretendojnë si të tillë.

Rrjedhimisht, aty ku është e përshtatshme, gjykata kombëtare duhet të sigurojë, brenda kuadrit të kompetencave të saj, mbrojtjen gjyqësore që rrjedh për palët ndërgjyqëse nga nenet 21 dhe 47 të Kartës dhe të garantojë efektin e plotë të atyre neneve duke lënë të pazbatueshme, nëse është e nevojshme, ndonjë dispozitë të papajtueshme të së drejtës kombëtare.

Neni 40

Liria e Shprehjes

1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI 130/16. PARASHTRUES: HAMDI IBRAHIMI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_130_16_shq.pdf]

16 qershor 2017

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Parashtruesi i kërkesës në këtë rast ishte Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Në këtë cilësi, ai kishte dhënë një intervistë në një medium radio-televiziv në Kosovë ku kishte komentuar punën e Prokurorisë së Shtetit. Për këtë, atij i ishte shqiptuar masa disiplinore e qortimit. Çështja kryesore e ngritur në këtë rast kishte të bënte me pretendimin se parashtruesit të kërkesës i ishte cenuar e drejta e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës [Liria e Shprehjes].

Faktet kryesore

Më 29 qershor 2015, parashtruesi në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte dhënë një intervistë në një stacion radio-televiziv, në të cilën kishte paraqitur qëndrimin e tij (me tone kritike) dhe kishte komentuar punën e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës. Më 4 dhjetor 2015, Zyra e Prokurorit të Shtetit i kishte paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: “KDKGJK”) ankesë me të cilën e kishte ngarkuar parashtruesin për sjellje të pahijshme, në kundërshtim me nenet gjegjëse të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës që kanë të bëjnë me shkeljen e Kodit të Etikës për Sjellje Profesionale për gjyqtarë. Më 31 mars 2016, KDKGJK kishte marrë vendim me të cilin kishte konstatuar se parashtruesi ishte përgjegjës për sjellje të pahijshme dhe rrjedhimisht i kishte shqiptuar atij masën disiplinore qortim. Më 27 prill 2016, parashtruesi kishte paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: “KGJK”) kundër vendimit të KDKGJK-së. Më 6 korrik 2016, KGJK kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit.

Më 11 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimet e KGJK/KDGJK atij i ishte shkelur e drejta e lirisë së shprehjes e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës, për të adresuar kritika ndaj punës së një institucioni apo bartësve të përgjegjësive në atë institucion. Sipas parashtruesit, deklarata e kryetarit të gjykatës, si shprehje e lire e mendimit, kishte qenë në funksion të ngritjes së autoritetit të sistemit të drejtësisë në Kosovë e assesi me qëllim të denigrimit të ndonjë institucioni apo individi. Parashtruesi argumentoi se kundër vendimit të KGJK-së ai kishte pasur mundësi që të shfrytëzonte mjetin juridik në procedurë administrative. Konkretisht, parashtruesi sqaroi se kishte mundur që më padi të fillonte procedurën e konfliktit administrativ në Departamentin për Çështje Administrative që vepron brenda kompetencave lëndore dhe territoriale të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Por, për shkak të faktit se ai udhëheq drejtpërsëdrejti edhe me Departamentin në fjalë të Gjykatës Themelore (Kryetar i së cilës ishte parashtruesi), ai nuk kishte dashur të shfrytëzonte atë mjet juridik. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të caktonte masën e përkohshme, ashtu që vendimi i KGJK-së, i 6 korrikut 2016, të lihej jashtë fuqisë deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesi pas marrjes së vendimeve të KGJK-së, të cilat i konteston, i ishte drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, nga e cila kishte kërkuar vlerësimin kushtetues të atyre vendimeve, lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë. Kjo, përkundër faktit se parashtruesi kishte në dispozicion edhe mjete të tjera juridike të përcaktuara me ligj dhe me shfrytëzimin e të cilave ai do mund t'i kishte mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij. Gjykata vuri në dukje se parashtruesi konsideroi se fakti që ai kishte një pozitë specifike e cila bart të drejta, obligime dhe përgjegjësi të caktuara (detyrën e Kryetarit të Gjykatës Themelore) vetvetiu duhej ta lironte atë

nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj dhe të cilat ishin në dispozicion të tij. Por, Gjykata arsyetoi se ky fakt nuk mund të ishte arsye që parashtruesi i kërkesës të lirohej nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike.

Gjykata theksoi se parashtruesi i kërkesës ishte individ që kishte cilësinë e palës së autorizuar, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe, në kuadër të kësaj cilësie, u trajtua edhe kërkesa e tij në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë vazhde, Gjykata rikujtoi se edhe aktet e tjera ligjore, sikundër edhe parimi i subsidiaritetit, kërkojnë që parashtruesit t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë pranë gjykatave të rregullta, para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në këtë rast nuk ekzistonte një vendim përfundimtar i autoritetit kompetent, i cili në këtë fazë do të mund të ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese erdhi në përfundimin se kërkesa ishte e papranueshme, sepse nuk ishin shteruar mjetet juridike, Gjykata refuzoi edhe kërkesën e parashtruesit për shqiptimin e masës së përkohshme (në bazë të rregullit 55.4 të Rregullores së punës).

Vendimi Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme për shkak të moshterimit të mjeteve juridike.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. KUDESHKINA kundër RUSISË

[29492/05]

GJEDNJ [Seksioni i Parë]

14 shtator 2009

Çështja kyçele drejta e pretenduar: largimi i kërkueses nga pozita e gjyqtarit për shkak të deklaratave kritike të publikuara në media për gjyqësorin rus; shkarkimi nga gjyqësori sepse kishte akuzuar publikisht zyrtarë të lartë të drejtësisë për presion ndaj saj në lidhje me një çështje penale të profilit të lartë; shkelje e së drejtës për lirinë e të shprehurit.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Olga Borisovna Kudeshkina, një shtetase ruse (kërkuesja), kundër Federatës Ruse, më 12 korrik 2005. Në vitin 2003, kërkuesja e cila në atë kohë ishte gjyqtare në Gjykatën e Qytetit të Moskës, u caktua të merrte pjesë në një çështje penale të profilit të lartë në lidhje me abuzimin e pushtetit nga një hetues policie, Zaytsev. Kërkuesja parashtroi se gjatë procedurës në fjalë, Kryetarja e Gjykatës së Qytetit të Moskës, znj. Yegorova, e thirri atë në zyrën e saj dhe i bëri disa pyetje në lidhje me zhvillimin e gjykimit. Palët nuk ranë dakord për rrethanat e tërheqjes së kërkueses nga çështja. Vetë kërkuesja pohoi se znj. Yegorova e kishte hequr atë nga çështja pa dhënë arsye, ndërsa Qeveria pretendoi se çështja i ishte caktuar një gjyqtari tjetër me arsyetimin se ajo kishte vonuar shqyrtimin e saj. Më pas, kërkuesja kërkoi që znj. Yegorova të akuzohej për shkelje disiplinore me pretendimin se kishte ushtruar presion të paligjshëm ndaj saj. Gjyqtari i caktuar për të shqyrtuar pretendimet e kërkueses arriti në përfundimin se znj. Yegorova kishte vendosur të ricaktojë çështjen, sepse ajo nuk e miratonte mënyrën se si kërkuesja po zhvillonte seancën dhe, sepse kishte “raporte konfidenciale nga agjencitë përkatëse” mbi ekzaminimin e Zaytsev. Prandaj, autoriteti kompetent vendosi të mos iniciojë procedurë disiplinore kundër znj. Yegorova.

Disa muaj më vonë, kërkuesja doli si kandidat në zgjedhjet e përgjithshme për Dumën Ruse. Gjatë fushatës së saj, e cila përfshinte një program për reformën në drejtësi, ajo dha intervista për dy gazeta dhe një radio stacion, në të cilat ishte shumë kritike ndaj gjyqësorit rus. Ndër të tjera, ajo shprehu dyshime për pavarësinë e gjykatave në Rusi dhe frikën e “paligjshmërisë gjyqësore” brenda vendit. Ajo nuk u zgjodh në Dumë, por u rikthye në detyrën e mëparshme gjyqësore.

Ndërkohë, Presidenti i Këshillit Gjyqësor të Moskës kërkoi shkarkimin e kërkueses nga detyra duke pretenduar se gjatë fushatës së saj zgjedhore ajo ishte sjellë në një mënyrë që nuk përputhej me autoritetin dhe pozicionin e një gjyqtari. Në maj 2004, pa dëgjuar përfaqësimin e parashtrueses që mungonte, me sa duket, pa një justifikim të vlefshëm, autoriteti kompetent vendosi ta largonte atë nga detyra, duke deklaruar se ajo kishte “përhapur ... trillime të rreme dhe të pavërteta” dhe se deklaratat ishin “të bazuara qartë mbi fantazitë, mbi fakte të rreme dhe të shtrembëruara me vetëdije”. Autoriteti më tej arriti në përfundimin se kërkuesja kishte “zbuluar informacion specifik faktik në lidhje me procedurën penale kundër Zaytsev përpara se aktgjykimi në këtë çështje të kishte hyrë në fuqi ligjore”. Më pas, kërkuesja apeloi në Gjykatën e Qytetit të Moskës dhe kërkoi transferimin e çështjes së saj për shkak të mungesës së paanësisë, por pa sukses.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesja u ankua se shkarkimi i saj nga detyra gjyqësore pas deklaratave të saj në media përbënte shkelje të lirisë së shprehjes të parashikuar në nenin 10 të Konventës. Kërkuesja u ankua se vendimi i Bordit të Kualifikimit të Gjyqësorit të Moskës për ta ndaluar atë nga mbajtja e funksioneve gjyqësore për shkak të deklaratave të saj kritike publike ishte i papajtueshëm me parimet e parashikuara në nenin 10 të Konventës. Ajo pretendoi se gjyqtarët, ashtu si personat e tjerë, gëzojnë mbrojtjen e nenit 10 dhe se ndërhyrja në lirinë e saj të shprehjes nuk ishte “e parashikuar me ligj”, nuk ndiqte një qëllim legjitim dhe, së fundi, nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Ajo pretendoi se dënimi disiplinor i ishte shqiptuar në mënyrë të paligjshme; se, megjithëse autoritetet kishin deklaruar se largimi i saj nga detyra ishte i nevojshëm për “ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit”, ky nuk ishte

qëllimi i vërtetë i masës së kontestuar. Së fundi, kërkuesja pretendoi se masa e kundërshtuar përbënte një ndërhyrje joproporcionale në lirinë e saj të shprehjes dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohej si «e nevojshme në një shoqëri demokratike».

Kërkuesja përfundimisht pretendoi se nuk duhej të ishte penguar të kritikonte sistemin e brendshëm të drejtësisë vetëm sepse ishte gjyqtare. Ndonëse ishte nëpunëse civile, ajo gëzonte të drejtat dhe liritë e mbrojtura në Konventë, përfshirë ato të garantuara nga neni 10, ashtu si qytetarët e tjerë. Ajo këmbënguli se deklaratat në bazë të të cilave ajo u akuzua për një shkelje disiplinore ishin një shprehje e mendimit të saj, pra një gjykim vlerësues dhe jo një deklaratë fakti. Megjithatë, ajo pohoi se të gjitha faktet në bazë të mendimit të saj ishin të vërteta dhe të mbështetura me prova.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata përsëriti se neni 10 zbatohet për vendin e punës, se nëpunësit civilë gëzonin gjithashtu të drejtën e lirisë së shprehjes dhe se zbulimi i informacionit të marrë gjatë punës së tyre, madje edhe për çështje me interes publik, gjithmonë duhej të shqyrtohej në dritën e detyrave të tyre të besnikërisë dhe diskrecionit. Për sa i përket zbulimit të pretenduar të kërkueses, të fakteve në lidhje me procedurat penale në pritje, autoritetet vendore nuk ishin mbështetur në ndonjë deklaratë specifike dhe Gjykata nuk pa asgjë në intervistat e kundërshtuara që do të përbënte një “zbulim”. Megjithëse kërkuesja iu referua përvojës së saj në çështjen *Zaytsev* dhe presionit të pretenduar të ushtruar nga znj. Yegorova, kjo ishte vetëm në mbështetje të kritikës së saj ndaj rolit të kryetarëve të gjykatave dhe, në asnjë mënyrë, nuk përbënte zbulim të informacionit të klasifikuar të marrë në cilësinë e saj zyrtare. Për më tepër, rrëfimet e kërkueses për përvojën e saj në çështjen *Zaytsev* u konsideruan si deklarata fakti që duhej të mbështeteshin me fakte dhe të cilat, në kontekst, ishin të pandashme nga opinionet e saj të shprehura në të njëjtat intervista. Për sa i përket vërtetimit faktik të pretendimeve të saj, Qeveria ishte mbështetur në gjetjet e autoriteteve kompetente vendore se nuk kishte prova që znj. Yegorova ishte përpjekur të ndikonte kërkuesen në drejtimin e çështjes. Edhe pse ishte e vështirë të përcaktohej përmbajtja e komunikimit mes kërkueses dhe

znj. Yegorova në mënyrë private, Gjykata i kushtoi rëndësi mënyrës në të cilën kërkuesja ishte larguar nga çështja *Zaytsev*. Në veçanti, përveç ekzistencës së dëshmitarëve në mbështetje të pretendimeve të kërkueses kundër znj. Yegorova, sugjerimi se “ekzistenca e raporteve konfidenciale nga agjencitë përkatëse” në lidhje me sjelljen e kërkueses mund të ketë shkaktuar transferimin e çështjes tek një gjyqtar tjetër, është anashkaluar nga autoritetet kompetente, të cilat për këtë arsye nuk kishin arritur të hidhnin poshtë në mënyrë bindëse pretendimet e kërkueses për presion. Duke vënë në dukje se kërkuesja kishte kritikuar publikisht sjelljen e zyrtarëve të ndryshëm dhe kishte pretenduar se presioni ndaj gjyqtarëve ishte praktikë e zakonshme në gjykatat ruse, Gjykata konstatoi se ajo padyshim kishte ngritur një çështje shumë të rëndësishme me interes publik, e cila duhej të ishte e hapur për debat të lirë në një shoqëri demokratike. Edhe duke lejuar një shkallë të caktuar ekzagjerimi dhe përgjithësimi, Gjykata konstatoi se deklaratat e saj nuk ishin plotësisht të lira nga baza faktike dhe, rrjedhimisht, duhej të konsideroheshin si koment i drejtë për një çështje me rëndësi të madhe publike.

Sa i përket frikës së saj në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së qytetit të Moskës, Gjykata i konsideroi ato të justifikuar duke pasur parasysh akuzat që ajo kishte bërë kundër Kryetarit të asaj gjykate. Meqenëse argumentet e saj nuk u morën parasysh në procedurat e brendshme, Gjykata arriti në përfundimin se asaj i ishin mohuar garanci të rëndësishme procedurale. Së fundi, dënimi – shkarkimi nga shërbimi gjyqësor – ishte në mënyrë disproporcionale i rëndë dhe mund të kishte pasoja penguese (chilling effect) për gjyqtarët që dëshironin të merrnin pjesë në debatin publik mbi efektivitetin e institucioneve gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 10 në rastin e kërkueses; urdhëroi që shteti i paditur t’i paguajë kërkueses, në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, 10,000 (dhjetë mijë) euro për dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. *NH kundër ASSOCIAZIONE AVVOCATURA PER I DIRITTI LGBTI – RETE LENFORD*

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C 507/18

23 prill 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=225526&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13714819>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Deklaratat homofobike përbëjnë diskriminim të punësimit dhe profesionit kur bëhen nga një person, i cili ka ose mund të perceptohet se ka një ndikim vendimtar në politikën e punësimit.

Faktet kryesore

N.H. është avokat dhe “Associazione” është një shoqatë avokatësh që mbrojnë të drejtat e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transjinorëve ose interseksualëve (LGBTI). Për shkak se N.H. kishte bërë deklaratat që përbëjnë sjellje diskriminuese për shkak të orientimit seksual të punëtorëve, në kundërshtim me nenin 2.1 (a) të Dekretit Legjislativ nr. 216, “Associazione” e paditi N.H. para Tribunale di Bergamo¹⁷⁶.

Me urdhër të 6 gushtit 2014, kjo gjykatë e shpalli të paligjshme, për shkak se ishte drejtpërdrejt diskriminuese, sjelljen e N.H., i cili gjatë një interviste në një program në radio, kishte deklaruar se nuk donte të punësonte homoseksualë në firmën e tij ligjore. Mbi këtë bazë,

¹⁷⁶ Gjykata e Rrethit e Bergamos, Itali.

Tribunale di Bergamo urdhëroi N.H. t'i paguante "Associazione" 10,000 euro dëmshpërblim dhe urdhëroi botimin e këtij urdhri në ekstrakte në një të përditshme kombëtare.

Me mendimin e 23 janarit 2015, Corte d'appello di Brescia¹⁷⁷ hodhi poshtë padinë e ngritur nga N.H. kundër këtij urdhri. N.H. e apeloj këtë vendim në Corte suprema di cassazione¹⁷⁸, që është gjykata referuese. Në apelin e tij N.H. pretendoi, në veçanti, zbatim të gabuar të nenit 5 të Dekretit Legjislativ nr. 216, përderisa gjykata e apelit legjitimoi "Associazione"-n për të ngritur padi, si dhe një shkelje ose zbatim të pasaktë të nenit 2.1 (a) dhe të nenit 3 të atij dekreti legjislativ, me arsyetimin se ai shprehu një opinion në lidhje me profesionin e avokatit, jo duke u paraqitur si punëdhënës, por si një qytetar i zakonshëm, dhe se deklaratat e kundërshtuara ishin shkëputur nga konteksti profesional.

Gjykata referuese vërejti se, në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit kishte konstatuar, nga njëra anë, se *'në një bisedë të zhvilluar gjatë një transmetimi në radio, [NH] shqiptoi një sërë fjalish që ia kërkoi vazhdimisht bashkëbiseduesi i tij [...] duke mbështetur neverinë e tij të përgjithshme ndaj një kategorie të caktuar njerëzish, të cilët ai nuk dëshiron t'i ketë pranë në zyrën e tij [...] as në zgjedhjen e mundshme të bashkëpunëtorëve'* dhe, nga ana tjetër, se asnjë procedurë punësimi nuk ishte në zhvillim e sipër ose nuk ishte parashikuar në atë kohë.

Në ato rrethana, Corte suprema di cassazione vendosi të pezullojë procedurën dhe t'i parashtojë pyetjet e mëposhtme Gjykatës për një vendim paraprak:

Së pari gjykata referuese pyeti nëse neni 9 i Direktivës 2000/78¹⁷⁹ duhet interpretuar ashtu që një shoqatë e përbërë nga avokatë të specializuar në mbrojtjen ligjore të një kategorie personash me orientim të ndryshëm seksual dhe që synon, sipas kushteve të saj ligjore, të promovojë kulturën

177 Gjykata e Apelit në Brescia, Itali.

178 Gjykata e Kasacionit, Itali.

179 Direktiva e Këshillit 2000/78 / EC e 27 nëntorit 2000 që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (OJ 2000, L 303, f.16). Kjo direktivë mishëron, në fushën që mbulon, parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit të mishëruar tani në nenin 21 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

dhe respektimin e të drejtave të kësaj kategorie, është automatikisht bartëse e një interesi kolektiv dhe përbën një shoqatë jofitimprurëse që mund të ndërmarrë veprime ligjore, përfshirë paditë për kompensim, kur faktet konsiderohen diskriminuese kundër asaj kategorie njerëzish?

Së dyti ajo pyeti nëse nenet 2 dhe 3 të Direktivës duhet të interpretohen ashtu që fusha e zbatimit të regjimit kundër diskriminimit, e parashikuar në atë direktivë, mbulon shprehjen e një opinionit kundër homoseksualëve gjatë një interviste në një program argëtues në radio, në të cilin i intervistuari tha se ai kurrë nuk do të punësonte njerëz të tillë në [studion e tij ligjore], edhe pse asnjë procedurë punësimi nuk ishte në zhvillim e sipër ose nuk ishte parashikuar nga ky person? “

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi që deklaratat e bëra nga një person gjatë një programi audiovizual, ku ai shprehet se kurrë nuk do të punësonte persona të një orientimi të caktuar seksual në kompaninë e tij, i përket fushës materiale të Direktivës 2000/78, dhe veçanërisht koncepti i “Kushteve të qasjes në punësim ... ose në punë”, sipas kuptimit të nenit 3.1 (a) të asaj Direktive, edhe nëse asnjë procedurë rekrutimi nuk kishte filluar ose nuk ishte parashikuar kur u bënë këto deklaratat, me kusht që, sidoqoftë, lidhja midis deklaratave të përmendura dhe kushteve të qasjes në punësim ose punë brenda kompanisë të mos jenë hipotetike.

Në lidhje me interpretimin e konceptit të “kushteve të qasjes në punësim [...] ose në punë”, në kuptimin e direktivës “antidiskriminim”, Gjykata, pasi kujtoi se ky koncept kërkon një interpretim autonom dhe uniform dhe nuk mund t’i nënshtrohet një interpretimi kufizues, e interpretoi këtë koncept duke iu referuar vendimit të saj *Asociația Accept*¹⁸⁰. Kështu, Gjykata kishte theksuar, ndër të tjera, se deklaratat që sugjerojnë ekzistencën e një politike punësimi homofobike bien brenda konceptit të “kushteve të qasjes në punësim ... ose në punë”, edhe nëse ato burojnë nga një person që nuk është ligjërisht i aftë të punësojë, me kusht që të ketë një lidhje johipotetike midis këtyre deklaratave dhe politikës së punësimit të punëdhënësit.

180 Vendimi i GJDBE i 25 prillit 2013, *Asociația Accept*, çështja C-81/12.

Ekzistenca e një lidhjeje të tillë duhet të vlerësohet nga gjykatat kombëtare në bazë të të gjitha rrethanave që i karakterizojnë ato deklarata. Në këtë drejtim, statusi i autorit të deklaratave dhe cilësia në të cilën ai është shprehur, janë veçanërisht të rëndësishme, dhe mbi bazë të tyre duhet të vlerësohet nëse ai ka ose mund të perceptohet se ka një ndikim vendimtar në politikën e punësimit të punëdhënësit. Gjykatat kombëtare duhet të marrin gjithashtu parasysh natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave në fjalë, si dhe kontekstin në të cilin janë bërë këto deklarata, në veçanti natyrën e tyre publike ose private.

Sipas Gjykatës, fakti që ky interpretim i konceptit të “kushteve të qasjes në punësim ... ose në punë” mund të çojë në një kufizim të mundshëm në ushtrimin e lirisë së shprehjes, nuk e vë në dyshim këtë interpretim. Gjykata kujtoi, në këtë drejtim, se liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute dhe se ushtrimi i saj mund të përfshijë kufizime, me kusht që ato të parashikohen nga ligji dhe të respektojnë përmbajtjen thelbësore të kësaj të drejte, si dhe parimin e proporcionalitetit. Ky parim përfshin verifikimin nëse këto kufizime janë të nevojshme dhe plotësojnë në mënyrë efektive objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga BE-ja ose nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Në rastin konkret, ato kushte janë plotësuar, duke qenë se kufizimet rrjedhin drejtpërdrejt nga Direktiva kundër diskriminimit dhe zbatohen vetëm për të arritur objektivat e saj, domethënë për të garantuar parimin e trajtimit të barabartë në punësim dhe në punë dhe arritjen e një niveli të lartë të punësimit dhe të mbrojtjes sociale. Për më tepër, ndërhyrja në ushtrimin e lirisë së shprehjes nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur objektivat e asaj Direktive, duke ndaluar vetëm deklaratat që përbëjnë diskriminim në çështjet e punësimit ose të punës. Për më tepër, kufizimet që rrjedhin nga Direktiva kundër diskriminimit janë të nevojshme për të garantuar të drejtat e punësimit dhe të punës që gëzojnë ata që mbulohen nga kjo Direktivë. Në të vërtetë, vetë thelbi i mbrojtjes nga Direktiva në fjalë në çështjet e punësimit dhe të profesionit mund të bëhet iluziv, nëse deklaratat që bien brenda konceptit të «kushteve të qasjes në punësim ... ose në punë», sipas kuptimit të asaj Direktive, ngelin jashtë fushëveprimit të saj me arsyetimin se ato ishin bërë në kontekstin e një programi argëtimi audiovizual ose që ato ishin shprehje e një opinioni personal të autorit të tyre.

Së fundmi, Gjykata vendosi që Direktiva “kundër diskriminimit” nuk përjashton legjislacionin italian, i cili njihet automatikisht qasjen në gjykatë me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Direktiva dhe, kur është e përshtatshme, marrjen e dëmtshpërblimit nga një shoqatë avokatësh, statutet e së cilës kanë si objekt mbrojtjen e personave me një orientim të caktuar seksual në gjykatë dhe promovimin e kulturës dhe respektimin e të drejtave të kësaj kategorie njerëzish. Kjo është e pranueshme për shkak të këtij objekti dhe pavarësisht nga ekzistenca apo jo e qëllimit fitimprurës, kur ndodhin fakte që mund të përbëjnë diskriminim, brenda kuptimit të asaj Direktive, kundër kategorisë së përmendur të personave dhe kur personi i dëmtuar nuk është i identifikueshëm.

Gjykata sqaroi, në këtë drejtim, se edhe nëse Direktiva nuk imponon njohjen e legjitimitetit të një shoqate të tillë si ajo në fjalë në procedurën kryesore, kur asnjë person i dëmtuar nuk është i identifikueshëm, ajo ua njihet mundësinë shteteve anëtare që të miratojnë ose të mbajnë dispozita më të favorshme për mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë sesa ato që përmbahen në të. Prandaj, u takon shteteve anëtare që kanë bërë këtë zgjedhje të vendosin se në çfarë kushtesh një shoqatë mund të fillojë procedura ligjore që synojnë të vërtetojnë ekzistencën e diskriminimit dhe ta ndëshkojnë atë. U takon atyre që të përcaktojnë nëse natyra fitimprurëse ose jo e shoqatës duhet të ushtrojë një ndikim në vlerësimin e legjitimitetit të saj për të bërë padi në këtë drejtim dhe të specifikojë fushën e një padie të tillë, në veçanti për sa u përket sanksioneve që mund të jepen në fund të procedurës, sanksione të tilla që, sipas nenit 17 të Direktivës kundër diskriminimit, duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse, përfshirë edhe kur asnjë person i dëmtuar nuk është i identifikueshëm.

Neni 41

E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike

- 1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*
- 2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI205/13. PARASHTRUES: FETI ISLAMI

[https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_205_13_shq.pdf]

25 prill 2014

***Çështja kyç/e drejta e pretenduar:** Rasti kishte të bënte me një kontest pronësor (padi për vërtetim të pronësisë), të cilën parashtruesi i kërkesës së bashku me disa persona të tjerë (si bashkë-paditës), e kishin humbur në të gjitha (tri) shkallët e gjykatave të rregullta. Parashtruesi pretendonte se vendimet e gjykatave të rregullta i kishin cenuar atij disa të drejta kushtetuese, duke përfshirë edhe të drejtën për qasje në dokumente publike, të garantuar me nenin 41 të Kushtetutës.*

Faktet kryesore

Më 26 maj 2006, Gjykata Komunale në Pejë kishte hedhur poshtë si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të disa paditësve të tjerë, për vërtetimin e së drejtës së shfrytëzimit të disa ngastrave kadastrale ndërtimore. Më 22 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Komunale. Po ashtu edhe Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 395/2008, të 2 qershorit 2009, kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e paditësve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Më 8 qershor 2010, i autorizuari i paditësve kishte paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës. Më 18 tetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës ia kishte kthyer shkresat e lëndës Gjykatës Komunale në Pejë, në përputhje me nenin 236 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: "LPK"). Më 22 shtator 2011, Gjykata Komunale në Pejë kishte hedhur poshtë si të paafatshëm propozimin për përsëritjen e procedurës. Kundër këtij aktvendimi të Gjykatës Komunale i autorizuari i paditësve kishte paraqitur ankesë, e cila ishte refuzuar me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 10 janarit 2012. Kundër këtij vendimi të Gjykatës

së Qarkut paditësit kishin paraqitur revizion, i cili ishte refuzuar me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 85/2012, të 3 qershorit 2013. Gjykata Supreme kishte arsyetuar se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kishin konstatuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore se parashtruesi dhe paditësit e tjerë e kishin paraqitur kërkesën për revizion pas afatit.

Më 15 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. 85/2012, të 3 qershorit 2013.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta kishin bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPK-së, duke qenë të njëanshme, të padrejta dhe arbitrare. Në këtë mënyrë, sipas parashtruesit të kërkesës, atij i ishin cenuar të drejtat të cilat ua garantonte Kushtetuta, në nenet vijuese: 21, 22, 23, 24, 31, 32, 41, 46, 48 dhe 54, si dhe neni 6 i KEDNJ, si dhe pikës 1 të Protokollit nr. 1 të kësaj Konvente. Pra, ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës pretendoi edhe shkeljen e së drejtës për qasje në dokumentet publike, të garantuar me nenin 4 të Kushtetutës.

Parashtruesi argumentoi shkeljen e një numri të madh të dispozitave ligjore të LPK-së, të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit, kishin ndodhur gjatë procedurave në të cilat ishte vendosur për të drejtën e shfrytëzimit të ngastrave të shpronësuara ndërtimore të qytetit. Pretendimet e parashtruesit, në thelb, reduktohen në argumentet lidhur me interpretimin e gabuar të normave ligjore në lidhje me kërkesën për përsëritjen e procedurës dhe me refuzimin e kërkesave për përsëritjen e procedurës si të paafatshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese fillimisht vuri në pah se ajo nuk është gjykatë e apelit, ky shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykata sqaroi se është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dispozitat përkatëse të së drejtës procedurale, në këtë rast të LPK-së.

Në këtë sfond, Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese, duke përfshirë edhe të drejtën për qasje në dokumente publike. Përkundrazi, sipas Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi vetëm kishte ngritur pretendime se ishin shkelur të drejtat e tij me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos treguar në mënyrë të qartë se si këto vendime i kishin shkelur të drejtat e tij kushtetuese. Sipas Gjykatës, fakti i thjeshtë se parashtruesi ishte i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk ishte i mjaftueshëm për të ngritur kërkesë të argumentueshme për shkelje kushtetuese. Gjykata Kushtetuese argumentoi se parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta, në të gjitha shkallët gjyqësore, që të paraqiste rastin e tij dhe të kontestonte interpretimin e ligjit për të cilin konsideronte se ishte interpretim i pasaktë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se në rastin konkret nuk ishin plotësuar kriteret për pranueshmëri të kërkesës dhe se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi ta shpallë kërkesën të papranueshme.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. MAGYAR HELSINKI BIZOTTSAG kundër HUNGARISË

[18030/11]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

8 nëntor 2016

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Komiteti Hungarez i Helsinkit pretendoi se e drejta e tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ ishte shkelur nga mohimi i qasjes në informacionin e kërkuar.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga një organizatë joqeveritare e regjistruar sipas ligjit hungarez, Magyar Helsinki Bizottság (“OJQ-ja kërkuese”), kundër Hungarisë, më 14 mars 2011. Komiteti Hungarez i Helsinkit (Magyar Helsinki Bizottság) është një organizatë joqeveritare në Hungari që monitoron zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në vend. Në vitin 2008, në kuadër të aktiviteteve të hetimeve për mungesën e transparencës në emërimet e policisë për avokatët e mbrojtjes publike (mbrojtësit publikë), Komiteti Hungarez i Helsinkit kërkoi që departamentet e policisë në vend të japin (i) emrat e mbrojtësve publikë të përzgjedhur nga ato, në atë vit, dhe (ii) numrin e detyrave të dhëna për çdo avokat. Këto kërkesa janë bërë në përputhje me Ligjin për të Dhënat, i cili siguron kuadrin hungarez për qasje në informacionin me interes publik. Neni 19 (4) i Ligjit për të Dhënat lejonte zbulimin e të dhënave personale të “personave që kryejnë detyra publike” që ishin me interes publik. Në gusht 2009, dy departamente policie refuzuan të përmbushnin kërkesat e OJQ-së, duke deklaruar se emrat e mbrojtësve publikë të caktuar, nuk duhej të zbuloheshin sipas Ligjit për të Dhënat sepse informacioni nuk ishte me interes publik dhe mbrojtësit publikë nuk ishin anëtarë të një organi që kryen detyra shtetërore, komunale ose publike. Në shtator 2009, Komiteti Hungarez i Helsinkit ngriti një padi kundër departamenteve të policisë, duke argumentuar se për shkak se mbrojtësit publikë kryejnë një detyrë publike, të financuar nga fondet e Qeverisë, kërkesa për emrat e tyre dhe numrin e përgjithshëm të detyrave të tyre cilësohet si informacion që i nënshtrohet zbulimit në interes të publikut. Gjykata e Qarkut në Debrecen vendosi në favor të OJQ-së dhe urdhëroi departamentet e policisë të zbulojnë informacionin e kërkuar. Në apel, Gjykata Rajonale e Qarkut Hajdú-Bihar anuloi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Debrecen, duke u shprehur se mbrojtësit publikë *ex officio* nuk ushtronin funksione publike, pavarësisht nëse financoheshin përfundimisht nga shteti.

Në shtator 2010, Gjykata e Lartë e Hungarisë hodhi poshtë një ankesë për të rishikuar vendimin e Gjykatës Rajonale të Qarkut Hajdú-Bihar. Gjykata e Lartë vërejti se organet e prokurorisë dhe hetimit kryejnë një detyrë publike duke emëruar mbrojtës publikë, por kjo detyrë përfundon me emërimin e mbrojtësit publik përkatës. Prandaj, Gjykata

e Lartë doli në përfundimin se aktivitetet e një mbrojtësi publik përbëjnë aktivitete private dhe departamentet e policisë nuk janë të detyruara të dorëzojnë të dhënat e tyre personale sipas Ligji për të Dhënat.

Komiteti Hungarez i Helsinkit paraqiti rastin në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pretenduar se e drejta e tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së ishte shkelur nga mohimi i qasjes në informacionin e kërkuar. Në maj 2015, Dhoma e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut hoqi dorë nga juridiksioni i saj në favor të Dhomës së Madhe të Gjykatës.

Përmbledhja e pretendimeve

OJQ-ja kërkuese u ankua se mohimi i qasjes nga autoritetet në informacionin e kërkuar prej saj, nga departamente të caktuara policore, përbën një shkelje të të drejtave të saj, siç përcaktohet në nenin 10 të Konventës. Pyetja thelbësore që duhet trajtuar në rastin konkret është nëse neni 10 i Konventës mund të interpretohet se i garanton OJQ-së kërkuese të drejtën e qasjes në informacionin e mbajtur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykatës i kërkohet të vendosë nëse mohimi i kërkesës së kërkueses për informacion rezultoi, në rrethanat e çështjes, në një ndërhyrje në të drejtën e saj për të marrë dhe dhënë informacion, siç garantohet nga neni 10. Prandaj, çështja nëse ankesa e ngritur nga OJQ-ja kërkuese, bie brenda fushëveprimit të nenit 10 është e lidhur pazgjidhshmërisht me bazueshmërinë e ankesës së saj. Prandaj, Gjykata vlerësoi se kërkesa nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35.3 (a) të Konventës dhe se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Prandaj, kërkesa duhej të shpallej e pranueshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata në lidhje me (a) zbatueshmërinë dhe ekzistencën e një ndërhyrjeje – theksoi se Konventa duhej të interpretohet në dritën e rregullave të parashikuara në nenet 31 deri në 33 të Konventës së Vjenës mbi Ligjin e Traktateve të vitit 1969 dhe se objekti dhe qëllimi i Konventës duhet lexuar si një tërësi. Gjykata nuk mund të shpërfillte standardet e përbashkëta ndërkombëtare ose të së drejtës së brendshme të shteteve evropiane dhe konsensusi i dalë nga instrumentet e

specializuara ndërkombëtare dhe praktika e shteteve kontraktuese përbën gjithashtu një konsideratë të rëndësishme. Së fundi, gjatë interpretimit të Konventës, mund t'u drejtohet edhe mjeteve plotësuese të interpretimit, duke përfshirë *travaux préparatoires*.

Në dritën e këtyre parimeve, Gjykata duhej të merrte në konsideratë nëse dhe në çfarë mase një e drejtë për qasje në informacionin e mbajtur nga shteti mund të shihet si pjesë e objektit të nenit 10, pavarësisht nga fakti se një e drejtë e tillë nuk ishte menjëherë e dukshme nga teksti i asaj dispozite.

Legjislacioni kombëtar në shumicën e shteteve kontraktuese njohu një të drejtë ligjore për qasje në informacion dhe ekzistonte një konsensus i gjerë mbi nevojën për të njohur një të drejtë individuale të qasjes në informacionin e mbajtur nga shteti, në mënyrë që t'i mundësonte publikut të shqyrtonte dhe të formonte një opinion për çdo çështje me interes publik, duke përfshirë edhe mënyrën e funksionimit të autoriteteve publike në një shoqëri demokratike. Një shkallë e lartë konsensusi ishte shfaqur edhe në nivel ndërkombëtar. Në veçanti, e drejta për të kërkuar informacion garantohej shprehimisht nga neni 19 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 dhe ekzistenca e së drejtës për qasje në informacion ishte konfirmuar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në disa raste. Përveç kësaj, neni 42 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian u garantonte qytetarëve të drejtën e qasjes në dokumente të caktuara. Miratimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare, edhe pse ishte ratifikuar vetëm nga shtatë shtete anëtare, tregoi një evolucion të vazhdueshëm drejt njohjes së detyrimit të shtetit për të ofruar qasje në informacionin publik.

Duke marrë parasysh këta faktorë, Gjykata nuk konsideroi se ajo ishte penguar të interpretonte nenin 10.1, duke përfshirë të drejtën e qasjes në informacion. Gjykata pranoi se në interes të sigurisë juridike, parashikueshmërisë dhe barazisë para ligjit, ajo nuk duhet të largohet, pa arsye të fortë, nga precedentët e përcaktuar në çështjet e mëparshme por, meqenëse Konventa ishte para së gjithash një sistem për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duhet pasur parasysh edhe ndryshimin e kushteve brenda shteteve kontraktuese dhe Gjykata duhej t'i përgjigjej

çdo konvergjence në zhvillim për sa i përket standardeve që duheshin arritur.

E drejta për të marrë informacion nuk mund të ndërtohej si një detyrim pozitiv ndaj një shteti për të mbledhur dhe shpërndarë informacionin dhe neni 10 nuk i jep individit të drejtën e qasjes në informacionin e mbajtur nga një autoritet publik ose nuk e detyron qeverinë t'i japë një informacion të tillë individit. Megjithatë, një e drejtë ose detyrim i tillë mund të lindë, së pari, kur zbulimi i informacionit imponohet nga një urdhër gjyqësor i cili ka fituar fuqi ligjore dhe, së dyti, në rrethanat kur qasja në informacion është instrumentale për ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes nga individit, në veçanti, të lirisë për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe kur mohimi i saj përbën ndërhyrje në këtë të drejtë.

Nëse dhe në çfarë mase mohimi i qasjes në informacion përbënte një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së OJQ-së kërkuese duhej të vlerësohej në çdo rast individual dhe në dritën e rrethanave të tij të veçanta, duke përfshirë; (i) qëllimin e kërkesës për informacion; (ii) natyrën e informacionit të kërkuar; (iii) rolin e kërkuesit ; dhe (iv) nëse informacioni ishte i gatshëm dhe i disponueshëm. Gjykata u bind se kërkuesi në këtë çështje dëshironte të ushtronte të drejtën për të dhënë informacion për një çështje me interes publik dhe kishte kërkuar qasje në informacion për këtë qëllim dhe se informacioni ishte i nevojshëm për ushtrimin e së drejtës së tij për lirinë e shprehjes. Informacioni për emërimin e mbrojtësve publikë ishte i një natyre të jashtëzakonshme të interesit publik. Nuk kishte asnjë arsye për të dyshuar se sondazhi në fjalë përmbante informacione, të cilat kërkuesi kishte marrë përsipër t'ia jepte publikut dhe që publiku kishte të drejtë t'i merrte dhe, Gjykata ishte e bindur se ishte e nevojshme që kërkuesi të kishte qasje në informacionin e kërkuar për përmbushjen e asaj detyre. Së fundi, informacioni ishte i gatshëm dhe i disponueshëm. Bazuar në këto vlerësime Gjykata konstatoi se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur sipas nenit 10, i cili ishte i zbatueshëm në këtë rast.

Në vlerësim të asaj (b) nëse ndërhyrja ishte e justifikuar, Gjykata pranoi se ndërhyrja ishte parashikuar me ligj dhe se kufizimi i lirisë së shprehjes së kërkuesit ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve.

Kërkesa për të dhëna, megjithëse përbëhet nga të dhëna personale, lidhet kryesisht me kryerjen e veprimtarive profesionale në kuadër të procedurave publike. Në këtë kuptim, aktivitetet profesionale të mbrojtësve publikë nuk mund të konsideroheshin si çështje private. Informacioni i kërkuar nuk kishte të bënte me veprimet ose vendimet e mbrojtësve publikë në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre si përfaqësues ligjorë ose lidhur me konsultimet me klientët e tyre dhe qeveria nuk kishte treguar se zbulimi i informacionit të kërkuar mund të kishte ndikuar në mbrojtësit publikë në gëzimin e së drejtës së tyre për respektimin e jetës private sipas kuptimit të nenit 8 të Konventës. Nuk kishte asnjë arsye për të supozuar se informacionet për emrat e mbrojtësve publikë dhe emërimet e tyre nuk mund të njiheshin nga publiku përmes mjeteve të tjera. Interesat të cilave iu referua Qeveria në lidhje me nenin 8 nuk ishin të një natyre dhe shkalë të tillë që do të kërkonin zbatimin e kësaj dispozite dhe vënien e saj në funksion të një ushtrimi balancues kundrejt të drejtës së kërkuarit të mbrojtur nga neni 10.

Tema e anketës kishte të bënte me efikasitetin e sistemit të mbrojtësve publikë dhe ishte e lidhur ngushtë me të drejtën për një gjykim të drejtë, një e drejtë themelore në ligjin hungarez dhe një e drejtë e një rëndësie të madhe sipas Konventës. Çdo kritikë ose përmirësim i sugjeruar për një shërbim kaq të lidhur drejtpërdrejt me të drejtat e gjykimit të drejtë, duhet të shihet si pjesë e shqetësimeve legjitime të publikut. Gjykata ishte e bindur se kërkuari synonte të kontribuonte në një debat mbi një çështje me interes publik dhe, refuzimi për të pranuar kërkesën kishte dëmtuar në mënyrë efektive kontributin e tij në një debat publik për një çështje me interes të përgjithshëm. Megjithëse informacioni i kërkuar kishte të bënte me të dhëna personale, ai nuk përfshinte informacione jashtë domenit publik. Gjykata arriti në përfundimin se pavarësisht nga kufiri i vlerësimit të shtetit, nuk kishte pasur një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis masës së ankumuar dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata, me shumicë, deklaroi kërkesën të pranueshme; konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës; vendosi (a) që shteti i paditur duhet t'i paguajë OJQ-së kërkuese, brenda tre muajve, (i) 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë) euro dhe (ii) 8,875 (tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër PATRICK BREYER

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C213/15 P

18 korrik 2017

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=192887&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13715012>]

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: Kjo çështje ka të bëjë me qasjen në parashtrimet që shtetet anëtare bëjnë përpara organeve gjyqësore të BE-së.

Faktet kryesore

Me një letër të 30 marsit 2011, z. Patrick Breyer i paraqiti Komisionit një kërkesë për qasje në dokumente, në përputhje me nenin 6 të Rregullores nr. 1049/2001. Dokumentet e kërkuara kishin të bënin me procedurat e shkëljes të filluara në vitin 2007 nga Komisioni kundër Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Austrisë, në lidhje me transpozimin e Direktivës 2006/24. Më saktësisht, M. Breyer kërkoi qasje në të gjitha dokumentet në lidhje me procedurat administrative të zhvilluara nga Komisioni, si dhe në të gjitha dokumentet që lidhen me procedurat gjyqësore, të cilat çuan në vendimin e 29 korrikut 2010, *Komisioni kundër Austrisë*⁸¹.

Më 11 korrik 2011, Komisioni hodhi poshtë kërkesën e z. Breyer. Më 13 korrik 2011, z. Breyer, në përputhje me nenin 7.2 të Rregullores 1049/2001, paraqiti një kërkesë të re. Me vendimet e 5 tetorit dhe 12

181 Çështja C-189/09, BE: C: 2010: 455.

dhjetorit 2011, Komisioni i dha z. Breyer, në lidhje me procedurat e shkeljes të filluara kundër Republikës Federale të Gjermanisë, qasje në një pjesë të dokumenteve të kërkuara. Në këto vendime, Komisioni informoi më tej z. Breyer për synimin e tij për të miratuar një vendim të veçantë në lidhje me dokumentet që lidhen me vendimin e 29 korrikut 2010 në çështjen *Komisioni kundër Austrisë*.

Më 3 prill 2012, Komisioni miratoi vendimin e quajtur Ares¹⁸² (në tekstin e mëtejshëm: “vendimi i 3 prillit 2012”). Me këtë vendim, Komisioni vendosi për qasjen e z. Breyer, nga njëra anë, në dokumentet e dosjes administrative në lidhje me procedurat e shkeljes të nisura kundër Republikës së Austrisë dhe, nga ana tjetër, në dokumentet që lidhen me procedurat gjyqësore në çështjen që ka sjellë vendimin e 29 korrikut 2010 në çështjen *Komisioni kundër Austrisë*. Në lidhje me këtë të fundit, Komisioni, në veçanti, refuzoi qasjen në pretendimet e paraqitura nga Republika e Austrisë në kontekstin e procedurave gjyqësore në fjalë (në tekstin e mëtejshëm: “pretendimet austriake”), me arsyetimin se ato pretendime nuk përfshiheshin brenda fushëveprimit të Rregullores nr. 1049/2001. Sipas Komisionit, së pari, në bazë të nenit 15.3 të TFBE-së, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, si institucion, i nënshtrohet rregullave që lidhen me qasjen në dokumente vetëm në kryerjen e funksioneve të saj administrative. Së dyti, Komisioni deklaroi se ankesat në fjalë i drejtoheshin Gjykatës, ndërsa Komisioni, si palë në çështjen që çoi në vendimin e 29 korrikut 2010, *Komisioni kundër Austrisë*, mori vetëm kopje. Së treti, Komisioni konsideroi se neni 20 i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së parashikon komunikimin e parashtrimeve me shkrim në procedurat gjyqësore, vetëm palëve në ato procedura dhe institucioneve vendimet e të cilave janë objekt shqyrtimi. Së katërti, sipas Komisionit, në vendimin e saj të 21 shtatorit 2010, *Suedia dhe të tjerët kundër API dhe Komisionit*¹⁸³, Gjykata nuk e trajtoi pyetjen nëse institucionet duhet t’u japin qasje kërkesave të një pale tjetër në procedurat gjyqësore. Rrjedhimisht, në lidhje me pretendimet e paraqitura në kuadrin e procedurave gjyqësore, vetëm parashtrimet e institucioneve, me përjashtim të atyre të paraqitura nga

182 Vendimi (2012) 399467.

183 Çështja C-514/07 P, C 528/07 P dhe C 532/07 P, [...] BE: C: 2010: 541.

palët e tjera, bien në fushëveprimin e Rregullores nr. 1049/2001, dhe se çdo interpretim i ndryshëm do të anashkalonte dispozitat e nenit 15 të TFBE-së dhe rregullat specifike që rezultojnë nga Statuti i Gjykatës dhe nga Rregullorja e Funksionimit të Gjykatës.

Me anë të një kërkesë të paraqitur në Sekretariatit e Tribunalit më 30 prill 2012, z. Breyer ngriti një padi duke kërkuar, në veçanti, anulimin e vendimit të 3 prillit 2012, për atë që, me këtë vendim, Komisioni i mohoi atij qasjen në parashtrimet me shkrim në procedurat gjyqësore. Në padinë e tij, ai ngriti një kërkesë të vetme, shkeljen nga Komisioni të nenit 2.3 të Rregullores nr. 1049/2001. Ai argumentoi se arsyeja e dhënë në atë vendim, sipas së cilës pretendimet e kontestuara nuk bien brenda fushëveprimit të asaj rregulloreje, ishte e pasaktë.

Me një vendim të 27 shkurtit 2015¹⁸⁴, Tribunali e pranoi padinë dhe, rrjedhimisht, e anuloi vendimin e 3 prillit 2012.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata në vendimin e saj konfirmoi që neni 3 (b) i Rregullores nr. 1049/2001, për qasjen e publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, të Këshillit dhe të Komisionit, parashikon shprehimisht se e drejta e qasjes në dokumentet e mbajtura nga këto institucione mbulon jo vetëm dokumentet të cilat ata vetë i kanë hartuar, por edhe ato që kanë marrë nga palët e treta, duke përfshirë edhe institucionet e tjera të Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare. Kështu, qëllimi i Rregullores nr. 1049/2001 përcaktohet duke iu referuar institucioneve të renditura prej tij, dhe jo kategorive të veçanta të dokumenteve ose autorit të dokumentit të mbajtur nga një prej këtyre institucioneve.

Fakti që dokumentet e mbajtura nga një prej institucioneve të përmendura në Rregulloren nr. 1049/2001, mbi qasjen publike në dokumentet e Parlamentit Evropian, të Këshillit dhe të Komisionit, janë hartuar nga një shtet anëtar dhe kanë lidhje me procedurat gjyqësore nuk është i tillë që të përjashtojë dokumente të tilla nga fushëveprimi i

184 Çështja *Breyer kundër Komisionit*, T188/12.

kësaj Rregulloreje. Nga njëra anë, fakti që Rregullorja nr. 1049/2001 nuk është e zbatueshme për kërkesat për qasje në dokumente që posedon Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian nuk do të thotë se dokumentet që lidhen me veprimtarinë gjyqësore të atij institucioni dalin, në parim, jashtë fushëveprimit të asaj Rregulloreje, kur dokumente të tilla janë në posedim të institucioneve të BE-së të renditura në atë Rregullore, siç është Komisioni. Nga ana tjetër, mbrojtja e interesave legjitime të shteteve anëtare në lidhje me dokumente të tilla ka të ngjarë të sigurohet nga përjashtimet nga parimi i së drejtës për qasje në dokumente të parashikuara në Rregulloren nr. 1049/2001.

Është fakt që as Statuti i Gjykatës së Drejtësisë të BE-së dhe as rregullat e procedurës së gjykatave të BE-së nuk parashikojnë të drejtën e qasjes të palëve të treta në pretendimet e ngritura në kuadrin e procedurave gjyqësore, dhe ky fakt mund të merret parasysh për qëllimet e interpretimit të përjashtimit të parashikuar në nenin 4.2 të Rregullores nr. 1049/2001. Megjithatë ky fakt nuk mund, nga ana tjetër, të çojë në pazbatueshmërinë e asaj Rregulloreje në lidhje me kërkesat për qasje në parashtrimet e hartuara nga një shtet anëtar në kuadrin e procedurave gjyqësore para gjykatave të BE-së, parashtrime që i disponon një prej institucioneve.

Sipas kushteve të nënparagrafit 4 të nenit 15.3 të TFBE-së, Gjykata e Drejtësisë e BE-së nuk i nënshtrohet sistemit të qasjes në dokumentet e institucioneve të përmendura në nënparagrafin 1 të së njëjtës dispozitë, përveçse në lidhje me kryerjen e funksioneve të saj administrative. Nga kjo rrjedh se kushtet që rregullojnë qasjen në dokumentet e mbajtura nga ai institucion që lidhen me veprimtarinë e tij gjyqësore nuk mund të përcaktohen me Rregullore të miratuara sipas nënparagrafit 2 të nenit 15.3 të TFBE-së. Megjithatë, pazbatueshmëria e sistemit të qasjes në dokumente, e parashikuar në nënparagrafin 1 të nenit 15.3 të TFBE-së, ndaj Gjykatës së Drejtësisë të BE-së, kur kjo e fundit ushtron funksione gjyqësore, nuk përjashton zbatimin e këtij regjimi për një institucion, për të cilin dispozitat e nenit 15.3 të TFBE-së dhe të Rregullores nr. 1049/2001, mbi qasjen publike në dokumentet e Parlamentit Evropian, të Këshillit dhe të Komisionit, janë plotësisht të zbatueshme, siç është Komisioni, kur ky i fundit mban dokumente të hartuar nga një shtet anëtar, të tilla si padi të paraqitura nga një shtet anëtar në kuadër të

procedurave gjyqësore të shkeljes, sipas nenit 258 të TFBE-së. Në të vërtetë, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, futja e nenit 15 të TFBE-së, i cili zëvendësoi nenin 255 të KE-së, zgjeroi fushën e parimit të transparencës në BE, duke siguruar tani një të drejtë qasjeje në dokumentet e institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të BE-së, përfshirë Gjykatën e Drejtësisë të BE-së, Bankën Qendrore Evropiane dhe Bankën Evropiane të Investimeve, kur ushtrojnë funksione administrative. Në këto kushte, asgjë nuk të bën të mendosh se shtrirja e asaj të drejte edhe ndaj aktiviteteve administrative të këtyre të fundit shoqërohet paralelisht me futjen e ndonjë kufizimi në fushën e zbatimit të Rregullores nr. 1049/2001 në lidhje me dokumentet që burojnë nga një Shtet anëtar, siç janë pretendimet në fjalë, të cilat mbahen nga Komisioni në lidhje me procedurat gjyqësore para Gjykatës së Drejtësisë të BE-së.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh nenet 15.1 të TFBE-së dhe 298 të TFBE-së, si dhe sanksionimin e së drejtës për qasje në dokumente në nenin 42 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së, të cilat mishërojnë objektivin e një administrate evropiane, nënparagrafi 4 i nenit 15.3 të TFBE-së nuk mund të interpretohet se kërkon një lexim kufizues të fushës së zbatimit të Rregullores nr. 1049/2001, që do bënte që dokumentet e hartuara nga një Shtet anëtar, siç janë pretendimet e paraqitura në kuadrin e procedurave të shkeljes sipas nenit 258 të TFBE-së, të mos bien në fushën e asaj rregulloreje kur këto pretendime mbahen nga Komisioni.

Kufizimet në qasje në dokumente të një natyre gjyqësore, qoftë kur parashikohen nga neni 255 i KE-së, i zëvendësuar nga neni 15 i TFBE-së, qoftë sipas Rregullores nr. 1049/2001, në lidhje me qasjen e publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, të Këshillit dhe të Komisionit, ndjekin të njëjtin qëllim, përkatësisht atë për të siguruar që e drejta e qasjes në dokumentet e institucioneve të ushtrohet pa cenuar mbrojtjen e procedurave gjyqësore, dhe në veçanti, respektimin e parimeve të barazisë së armëve dhe të administrimit të mirë të drejtësisë. Duke pasur parasysh faktin se Rregullorja nr. 1049/2001 bën të mundur refuzimin, aty ku është e përshtatshme, të qasjes në dokumente që lidhen me procedurat para gjykatave të BE-së dhe, kësisoj, për të garantuar mbrojtjen e procedurave të tilla gjyqësore, është e nevojshme

të konsiderohet se nënparagrafi 4 i nenit 15.3 të TFBE-së nuk kërkon një interpretim, sipas të cilit pretendimet e hartuara nga një shtet anëtar dhe të mbajtura nga Komisioni duhet domosdoshmërisht të përjashtohen nga fusha e veprimit të asaj Rregulloreje. Në fakt, me kusht që të sigurohet mbrojtja e procedurave gjyqësore në përputhje me qëllimin e nenit 15.3, nënparagrafi 4, të TFBE-së, efekti i dobishëm i kësaj dispozite nuk mund të vihet në dyshim.

Neni 42

Liria e Medieeve

1. Garantohet liria dhe pluralizmi i medieeve.

2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieeve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO63/12. PARASHTRUES: ALMA LAMA DHE 10 DEPUTETË TË TJERË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

[https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjk_ko_63_12_12_shq.pdf]

10 dhjetor 2012

Çështja kyçele drejta e pretenduar; Ky rast kishte të bënte me përfshirjen e disa neneve në Kodin e ri penal, që rregullonin çështjen e përgjegjësisë penale të kryeredaktorëve, botuesve, shtypshkronjave apo prodhuesve të publikimit të informatave me anë të të cilave kryhen vepra penale, si dhe mbrojtjen e burimit të informatës dhe zbatimin e dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të medieve. Çështja kyçe ishte pretendimi se nenet në fjalë të Kodit Penal ishin në kundërshtim me nenet 40 [Liria e Shprehjes] dhe 42 [Liria e Medieve] të Kushtetutës.

Faktet kryesore

Më 20 prill 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi Kodin Penal të Kosovës, i cili që shpallur nga Kuvendi më 22 qershor 2012 dhe do të duhej të hynte në fuqi më 1 janar 2013. Pas kësaj, parashtruesit paraqitën kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal. Më 18 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të shtynte vendimin për meritat e kërkesës deri më 15 dhjetor 2012. Neni 37 i Kodit Penal rregullonte çështjen e përgjegjësisë penale të kryeredaktorëve, botuesve, shtypshkronjave apo prodhuesve të publikimit të informative, me anë të të cilave kryhej vepra penale; neni 38 rregullonte mbrojtjen e burimit të informatës; dhe neni 39 rregullonte zbatimin e dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të medieve.

Më 12 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese kishte pranuar një letër nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me të cilën Gjykata

njoftohej se “Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur me 19 tetor 2012, e kishte miratuar Ligjin nr. 04/1-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Më miratimin e Ligjit nr. 04/1-129 ishin shfuqizuar nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës”. Letrës së 12 nëntorit i ishte bashkëngjitur Dekreti Presidencial DL-048-2012 për shpalljen e Ligjit nr. 04/1-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të 2 nëntorit 2012.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në nenin 113.5 të Kushtetutës, duke pohuar se nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal ishin në kundërshtim me Kushtetutën. Parashtruesit pohuan se nenet e kontestuara ishin në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që garantojnë lirinë e medieeve (neni 42) dhe lirinë e shprehjes (neni 40), në ndërlidhje me nenin 10 të KEDNJ-së.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se në vendimin e saj për pranueshmëri të kërkesës dhe shtyrje të vendimmarrjes kishte marrë parasysh se nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal ishin miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 20 prill 2012 dhe ishin shpallur me vendim të Kuvendit, më 22 qershor 2012. Sidoqoftë, Gjykata vuri në spikamë se dispozitat e kontestuara nga ana e parashtruesve të kërkesës u bënë objekt i një iniciative tjetër legjislative të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ky proces legjislativ ishte përmbyllur më 2 nëntor 2012, më shpalljen e Ligjit nr. 04/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese theksoi se neni 2 i këtij Ligji përcaktonte që “nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës hiqen”, kurse në nenin 3 thuhej se “Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar”.

Në dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata Kushtetuese argumentoi se heqja e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal, që garantohej me hyrjen e njëkohshme në fuqi të Kodit Penal dhe me Ligjin për Ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ishte relevante

dhe ndikonte në mënyre thelbësore në kërkesën e parashtruesve, përkatësisht në bazat dhe në themelësinë e saj. Rrjedhimisht, Gjykata arsyetoi se qëllimi i kërkesës ishte arritur plotësisht dhe se nuk kishte merita për të shqyrtuar më tutje këtë çështje. Gjykata Kushtetuese u shpreh se ajo nuk duhej të nxjerrë vendime për raste ku çështja nuk ekzistonte më dhe rasti mbetej pa objekt shqyrtimi, prandaj kërkesa duhej hequr nga lista.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 26 (4) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi ta heqë nga lista kërkesën.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. BÉDAT kundër ZVICRËS

[56925/08]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

29 mars 2016

Çështja kyçele drejta e pretenduar: ankesa dhe dënimi rezultues për publikimin e informacioneve (konfidenciale) në lidhje me një aksident komunikacioni shkelnin të drejtën e kërkuarit për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Arnaud Bédat, një shtetas zviceran (kërkuar) kundër Konfederatës Zvicerane, paraqitur në Gjykatë më 7 nëntor 2008. Në korrik 2003, në një aksident automobilistik në Urën e Lozanës në qytetin e Lozanës, Zvicër, vdiqën tre persona dhe tetë të tjerë u plagosen. Për shkak numrit të viktimave, aksidenti shkaktoi polemika në vend dhe

më vonë shkaktoi mbulim të madh mediatik. Gjatë procedurës penale kundër shoferit në faj, Arnaud Bédard botoi një artikull në revistën javore *L'Illustré*, duke detajuar rrethanat e rastit. Në një paragraf, Bédard diskutoi përmbajtjen e letrave të dërguara nga shoferi te gjyqtari hetues. Dhe si dëshmi, ai i kishte bashkangjitur artikullit disa fotografi të atyre letrave. Gjithashtu, ai dha një përmbledhje të pyetjeve të bëra nga oficerët e policisë dhe gjyqtari hetues, si dhe përgjigjet e shoferit. Ai përmendi edhe kallëzimet penale në pritje dhe deklaratat e dhëna nga gruaja e shoferit dhe mjeku i tij. Ndërkohë, në gazetën “*Tribune de Genève*” u botua një artikull tjetër me të njëjtën temë, i cili trajtonte disa aspekte të hetimit penal, të ofruara vullnetarisht nga autoritetet policore. Megjithatë, artikulli i Bédard e shtyu prokurorin publik të ngrejë një ankesë kundër tij për publikimin e informacionit konfidencial në kundërshtim me nenin 293 të Kodit Penal. Bédard argumentoi se ai e mblodhi informacionin në mirëbesim pa e marrë atë në mënyrë të paligjshme. Provat zbuluan se shumë nga informacionet e përmendura në artikull bazoheshin në një kopje të dosjes së çështjes kundër shoferit, e cila ishte humbur nga njëri prej paditësve në këtë rast dhe më vonë u gjet nga një person i panjohur.

Në qershor 2004, Bédard u dënua me një muaj burgim. Pas apelit të parë, Gjykata e Policisë e Lozanës e zëvendësoi dënimin me burg me 4000 franga zvicerane gjobë. Bédard parashtrroi ankesa të mëtejshme për çështje ligjore, të cilat përfundimisht u hodhën poshtë si nga Gjykata Penale e Kasacionit të Kantonit të Vaud-it, ashtu edhe nga Gjykata Federale.

Pasi kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme, Bédard më vonë paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke argumentuar se ankesa dhe dënimi rezultues shkelnin të drejtën e tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në korrik 2014, Dhoma e Gjykatës arriti në përfundimin se dënimi i Bédard shkelte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Ajo fillimisht konsideroi se veprimi kundër gazetarit përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tij, por ishte në përputhje me interesin e qeverisë për të parandaluar zbulimin e informacionit konfidencial. Megjithatë, Dhoma ishte e mendimit

se ajo që u diskutua në artikull ishte një çështje e interesit publik dhe përmbajtja e saj nuk mund të rrezikonte prezumimin e pafajësisë së të akuzuarit, duke pasur parasysh faktin se publikimi ndodhi dy vjet përpara seancës së parë dhe se gjykimi ishte pa juri. Në shtator 2014, Qeveria Zvicerane kërkoi që çështja t'i referohej Dhomës së Madhe të Gjykatës sipas nenit 43 të Konventës.

Përmbledhja e pretendimeve

Bédats argumentoi para Dhomës së Madhe se publikimi nuk kishte për qëllim të zbulonte informacione konfidenciale. Përkundrazi, ai kishte përmbushur detyrimin për të informuar publikun për aksidentin automobilistik që kishte tronditur qytetarët. Përndryshe, ai argumentoi se natyra e informacionit nuk e justifikonte qeverinë për ta mbajtur atë sekret.

Ai gjithashtu vuri në dukje se publikimi as nuk ndikoi në hetimin në vazhdim dhe as nuk e cenoi prezumimin e pafajësisë së të akuzuarit. Së fundi, Bédats parashtroi pranë Dhomës së Madhe se çështja përfshinte një akt balancues “virtual” midis të drejtave të tij si gazetar, i cili u dënua për një krim dhe të drejtave të privatësisë së të akuzuarit që nuk kërkoi kurrë kompensim për mbrojtjen e privatësisë së tij, pavarësisht se kishte mundësi për ta bërë këtë.

Qeveria e Zvicrës, nga ana tjetër, argumentoi se nuk kishte arsye bindëse për të informuar publikun për procedurën penale. Ai shpjegoi se vëmendja dhe interesi i shkaktuar nga mbulimi mediatik në lidhje me aksidentin nuk krijonte në vetvete një interes publik për zbulimin e informacionit konfidencial. Dhe si provë, qeveria vuri në dukje se ajo që u publikua nga Bédats nuk hodhi dritë mbi rrethanat e aksidentit, por u fokusua vetëm në korrespondencën konfidenciale të të akuzuarve. Qeveria theksoi më tej se kur balancohen interesat kontradiktore në lojë, e drejta e publikut për informacion në lidhje me aktivitetet gjyqësore duhet t'i nënshtrohet mbrojtjes së të drejtës së dikujt për prezumimin e pafajësisë dhe privatësisë, siç sigurohet përkatësisht nga nenet 6 dhe 8 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 10, Gjykata theksoi se dënimi i kërkuesit kualifikohej si ndërhyrje, e parashikuar me ligj, në ushtrimin nga ana e tij, të së drejtës së lirisë së shprehjes, që është e siguar sipas nenit 10.1 të Konventës. Masa e kundërshtuar kishte një qëllim legjitim, që ishte parandalimi i ‘deklarimit të informacionit të marrë në mirëbesim’, ruajtja e ‘autoritetit të paanësisë së gjyqësorit’ dhe mbrojtja e ‘së drejtës (dhe) reputacionit të të tjerëve’. E drejta e kërkuesit për të informuar publikun dhe e drejta e publikut për të marrë informacion përballen me interesat publike dhe private po aq të rëndësishme që mbrohen nga ndalimi i deklarimit të informacionit që i nënshtrohet fshehtësisë hetimore. Këto interesa, nga njëra anë, janë autoriteti dhe paanësia e gjyqësorit dhe, nga ana tjetër, e drejta e të akuzuarit për prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjes së jetës së tij private. Gjykata ishte e mendimit që ishte e nevojshme të specifikohen kriteret që duhet të ndiqen nga autoritetet e brendshme të Shteteve Palë në Konventë për të peshuar këta interesa dhe, në këtë mënyrë, për të vlerësuar ‘domosdoshmërinë’ e ndërhyrjes në rastet e shkeljes së fshehtësisë hetimore nga një gazetar.

Në rishikim të asaj se (a) si erdhi kërkuesi në zotërimin e informacionit në fjalë – Gjykata vërejti se, edhe pse nuk u pretendua që kërkuesi kishte siguar informacionin në mënyrë të paligjshme, si gazetar profesionist ai nuk mund të mos ishte në dijeni të konfidencialitetit të informacionit që ai kishte ndër mend të publikonte.

E sa i përket (b) përmbajtjes së artikullit të kundërshtuar – Gjykata vërejti se edhe pse artikulli i kundërshtuar nuk merrte ndonjë qëndrim të caktuar në lidhje me natyrën e qëllimit të veprës penale që i akuzuari akuzohej se kishte kryer, ai bënte një përshkrim tepër negativ për të, duke u shprehur në një mënyrë pothuaj tallëse. Titujt e përdorur nga kërkuesi, si dhe fotografia e madhe përmyllëse e të akuzuarit që shoqëronte tekstin, nuk lënë asnjë hije dyshimi që kërkuesi donte që artikulli i tij të ishte sa më sensacional që ishte e mundur. Për më tepër, artikulli theksonte zbrazëtinë e deklarimeve të tij dhe thëniet e tij të shumta kontradiktore, që shpesh përshkruheshin si ‘gënjeshtër të përsëritura’, duke përfunduar me pyetjen nëse i akuzuari, nëpërmjet ‘kësaj përzierje të naivitetit dhe arrogancës’, ‘nuk po bënte gjithçka që

kishte mundësi për ta bërë mbrojtjen e tij të pamundur'. Ishin pikërisht këto lloj pyetjesh që autoriteteve gjyqësore u duhej të jepnin përgjigje, si në fazën e hetimit ashtu edhe të gjyqimit.

Në lidhje me (c) kontributin e artikullit të kundërshtuar në një debat me interes publik – Gjykata vërejti se subjekti i artikullit, që ishte hetimi penal i tragjedisë së Urës së Lozanës, ishte një çështje me interes publik. Ky incident tepër i veçantë ishte bërë shkak për një valë emocionale te popullata dhe autoritetet gjyqësore kishin vendosur të informonin shtypin në lidhje me aspekte të caktuara të hetimit në vazhdim. Megjithatë, çështja ishte nëse informacioni që jepej nëpërmjet artikullit dhe që i nënshtrohej fshehtësisë hetimore ishte në gjendje të kontribuonte në debatin publik për këtë çështje, apo thjesht kishte si qëllim të shuante kuriozitetin e një rrethi të caktuar lexuesish në lidhje me hollësitë e jetës private të të akuzuarit. Në këtë kontekst, pas një vlerësimi të thellë të përmbajtjes së artikullit, natyrës së informacionit të dhënë dhe rrethanave në lidhje me çështjen, Gjykata Federale, në një vendim me një arsyetim të gjerë, që nuk kishte asnjë nuancë arbitrariteti, ishte e mendimit që deklarimi i protokollit të intervistave dhe i letrave të dërguara gjyqtarit hetimor nga i akuzuari, nuk ofronin ndonjë vështrim të rëndësishëm për debatin publik dhe që interesi publik në këtë çështje nuk shkonte më tej se 'shuarja e një kurioziteti të cekët'. Nga ana e tij, kërkuesi nuk kishte demonstruar se si fakti i publikimit të protokollit të intervistave, deklarimeve të bëra nga bashkëshortja e të akuzuarit dhe nga mjeku, dhe letrave që i akuzuari i kishte dërguar gjyqtarit hetimor në lidhje me aspekte banale të jetës së tij të përditshme, mund të kishin kontribuar në një debat publik për hetimin në vazhdim. Për pasojë, Gjykata nuk shihte asnjë shkak thelbësor për të zëvendësuar këndvështrimin e Gjykatës Federale me këndvështrimin e vet, ku kjo e fundit kishte një hapësirë të caktuar vlerësimi në çështje të tilla.

Në lidhje me (d) ndikimin e artikullit të kundërshtuar në procedurën penale – Gjykata theksoi se, edhe pse të drejtat e garantuara përkatësisht nga neni 10 dhe neni 6.1 meritojnë *a priori* respektimin e barabartë, është legjitime që fshehtësisë së hetimit gjyqësor t'i jepet mbrojtje e veçantë, duke pasur parasysh çështjet e përfshira në procedurën penale, si për administrimin e drejtësisë, ashtu edhe për të drejtën e personave nën hetim për t'u prezumuar të pafajshëm. Fshehtësia e hetimeve penale orientohet drejt mbrojtjes, nga njëra anë, të interesave të procedurës penale ndaj rrezikut

të fshehjes dhe rrezikut të falsifikimit ose asgjësimit të provave dhe, nga ana tjetër, të interesave të të akuzuarit, kryesisht nga këndvështrimi i prezumimit të pafajësisë dhe, më përgjithësisht, të marrëdhënieve dhe interesave të saj ose të tij personale. Një fshehtësi e tillë justifikohet gjithashtu nga nevoja e mbrojtjes së procesit të formimit të opinionit dhe procesit të vendimmarrjes brenda gjyqësorit. Megjithëse artikulli i kundërshtuar nuk mbështeste hapur mendimin që i akuzuari kishte vepruar me qëllim, megjithatë ai ishte i orientuar në mënyrë të tillë që kërkonte një përkrahim negativ për këtë të fundit, duke theksuar disa aspekte negative për personalitetin e tij dhe duke nxjerrë përfundimin që ai po bënte gjithçka që ‘kishte në dorë për ta bërë të pamundur mbrojtjen e vet’. Publikimi i një artikulli të orientuar në atë mënyrë në momentin kur hetimi nuk kishte përfunduar përbënte rrezikun e brendshëm të ndikimit mbi zhvillimin e procedurës në një mënyrë apo në një tjetër, potencialisht duke ndikuar në punën e gjyqtarit hetimor, vendimet e përfaqësuesve të të akuzuarit, pozicionet e palëve që pretendojnë zhdëmtim ose objektivitetin e gjykatës që i kërkohet të gjykojë çështjen, pavarësisht nga përbërja e saj. Nuk mund të pritet që një qeveri të japë prova *ex post facto* që ky tip publikimi, faktikisht, ka ndikuar në zhvillimin e një procedure të caktuar. Rreziku i ndikimit në procedurë në vetvete justifikon miratimin nga autoritetet e brendshme të masave parandaluese sikurse ndalimi i deklarimit të informacionit të fshehtë. Ligjshmëria e këtyre masave sipas së drejtës së brendshme dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat e Konventës duhet të jenë në gjendje të vlerësohen në momentin e miratimit të masave dhe jo, ashtu siç kërkoi kërkuesi, nën dritën e zhvillimeve të mëtejshme që tregonin ndikimin faktik të publikimeve mbi gjykimin, siç është përbërja e gjykatës së faktit. Kështu, Gjykata Federale kishte të drejtë që në vendimin e 29 prillit 2008 u shpreh që protokollet e intervistave dhe korrespondenca e të akuzuarit ishin “diskutuar në publik, para përfundimit të hetimit (dhe) jashtë kontekstit, në një mënyrë që mund të ndikonte vendimet e marra nga gjyqtari hetimor dhe nga gjykata e faktit”.

Në lidhje me (e) cenimin e jetës private të të akuzuarit – Gjykata theksoi se çështja penale e iniciuar ndaj kërkuesit nga autoritetet e ndjekjes penale rajonale ishte në pajtim me detyrimet pozitive që i takonin Zvicrës sipas nenit 8 të Konventës për të mbrojtur jetën private të personit të akuzuar. Për më tepër, informacioni i deklaruar nga kërkuesi ishte thjesht personal si dhe mjekësor në natyrën e vet, duke përfshirë deklaratimet nga mjeku i personit të akuzuar dhe letrat e dërguara nga i akuzuari nga qendra e

ndalimit gjyqtarit hetues përgjegjës për çështjen. Ky lloj informacioni kërkonte nivelin më të lartë të mbrojtjes sipas nenit 8; ky konstatim është tepër i rëndësishëm pasi i akuzuari nuk ishte i njohur për publikun dhe thjesht fakti që ai ishte objekt i hetimit penal, megjithëse për një vepër penale të rëndë, nuk e justifikonte trajtimin e tij në të njëjtën mënyrë si një figurë publike, e cila ekspozohet në mënyrë të vullnetshme në publik. Në momentin e botimit të artikullit, personi i akuzuar ishte në burg, pra në një situatë pamundësie mbrojtjeje. Për më tepër, në dosjen e çështjes nuk kishte asgjë që të tregonte se ai ishte i informuar për publikimin e artikullit dhe për natyrën e informacionit që ai deklaronte. Për më tepër, ai eventualisht vuante nga çrregullimet mendore, duke e forcuar kështu pamundësinë e mbrojtjes. Në këto rrethana, autoritetet kantonale nuk mund të fajësohen për konsideratën e tyre që për të përmbushur detyrimet e tyre pozitive për mbrojtjen e së drejtës së personit të akuzuar për respektimin e jetës së tij private, ato nuk mund të prisnin për këtë të fundit të ndërmernte iniciativën e fillimit të çështjes penale ndaj parashtruesit dhe, për pasojë, zgjodhën një qëndrim aktiv, një prej të cilëve është ushtrimi i ndjekjes penale.

Në vlerësim të (f) proporcionalitetit të dënimit të dhënë – Gjykata vërejtí se fillimi i çështjes penale dhe masa e dënimit të dhënë kërkuesit nuk kualifikohen si ndërhyrje joproporcionale në ushtrimin e së drejtës së tij për lirinë e shprehjes. Kërkuesit fillimisht iu dha një dënim me kusht prej një muaj burgim. Dënimi i tij në vijim u zbrit në një gjobë prej 4 000 CHF, e cila u caktua duke pasur parasysh të kaluarën e kërkuesit dhe nuk u pagua nga ai, por nga punëdhënësi i tij. Ky dënim u dha për shkelje të fshehtësisë së hetimit penal dhe qëllimi i tij, në çështjen në fjalë, ishte mbrojtja e funksionimit të rregullt të sistemit të së drejtës dhe të të drejtave të të akuzuarit për një gjykim të drejtë dhe për respektim të jetës së tij private. Në këto rrethana, nuk mund të thuhet që një dënim i tillë mund të kishte një efekt pengues për ushtrimin e lirisë së shprehjes nga kërkuesi ose nga një gazetar tjetër që dëshiron të informojë publikun në lidhje me çështjet e papërfunduara penale.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. DMITRII KONSTANTINOVICH KISELEV kundër KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

**Tribunali i BE-së
Çështja T262/15**

15 qershor 2017

[<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A62015TJ0262>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: kjo çështje kishte të bënte me rolin por edhe përgjegjësinë që ka media në shoqëritë bashkëkohore dhe sanksionet e BE-së ndaj përfaqësuesve të mediave që përkrahnin veprimet ruse në Ukrainë.

Faktet kryesore

Më 17 mars 2014, Këshilli i Bashkimit Evropian, në bazë të nenit 29 të TBE-së, miratoi Vendimin 2014/145/CFSP mbi masat kufizuese në lidhje me veprimet që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

Në të njëjtën datë, Këshilli miratoi, në bazë të nenit 215.2 të TFBE-së, Rregulloren (BE) nr. 269/2014, mbi masat kufizuese në lidhje me veprimet që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

Emri i ankuesit, z. Dmitrii Konstantinovich Kiselev, ishte përfshirë, me arsyetimin e mëposhtëm, në listat e personave të prekur nga masat kufizuese të parashikuara nga Vendimi zbatues i Këshillit 2014/151/CFSP i 21 marsit 2014, që zbaton Vendimin 2014/145, dhe Rregullorja zbatuese (BE) nr. 284/2014 të Këshillit, të 21 marsit 2014, që zbaton Rregulloren nr. 269/2014:

“Emëruar më 9 dhjetor 2013, me dekret presidencial, drejtor i Agjencisë Shtetërore të Lajmeve të Federatës Ruse ‘Rossiya Segodnya’, figura qendrore në propagandën qeveritare që mbështet vendosjen e forcave ruse në Ukrainë”.

Më pas, më 25 korrik 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/499/CFSP, për ndryshimin e Vendimit 2014/145, dhe Rregulloren (BE) nr. 811/2014, për ndryshimin e Rregullores nr. 269/2014, në veçanti për të përshtatur kriteret, sipas të cilave personat fizikë ose juridikë, subjektet ose organet mund të preken nga masat kufizuese në fjalë.

Në nenin 2, paragrafët 1 dhe 2, të Vendimit 2014/145, të ndryshuar me Vendimin 2014/499 (‘vendimi i ndryshuar 2014/145’), thuhet si më poshtë:

“1. Të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që u përkasin:

a) personave fizikë që janë përgjegjës për veprimet ose politikat që minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin ose sigurinë në Ukrainë, ose që pengojnë veprimin e organizatave ndërkombëtare në Ukrainë, të personave fizikë që aktivisht mbështesin ose zbatojnë veprime ose politika të tilla, dhe personave fizikë ose juridikë, subjekteve ose organeve të lidhura me to;

...

si dhe të gjitha fondet dhe burimet ekonomike që këta persona, njësi ose organe zotërojnë, mbajnë ose kontrollojnë, të renditura në aneks.

2. Asnjë fond ose burim ekonomik nuk vihet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dispozicion të personave fizikë ose juridikë, subjekteve ose organeve të renditura në aneks, ose të përdoret për përfitimin e tyre”.

Kushtet e ngrirjes së këtyre fondeve përcaktohen në paragrafët vijues të të njëjtit nen.

Neni 1.1 (a) i Vendimit të ndryshuar 2014/145 ndalon hyrjen ose kalimin transit përmes territorit të shteteve anëtare të personave fizikë që

plotësojnë kriteret të cilat janë në thelb identike me ato të përcaktuara në nenin 2.1 (a) të të njëjtit vendim.

Rregullorja nr. 269/2014, në versionin e saj të ndryshuar me Rregulloren nr. 811/2014, kërkon miratimin e masave për ngrirjen e fondeve dhe përcakton kushtet e këtyre masave në terma identikë, në thelb, me ato të Vendimit 2014/145 të ndryshuar. Neni 3.1 (a) i asaj Rregulloreje në thelb riprodhon nenin 2.1 (a) të atij vendimi.

Me një letër të 4 shkurtit 2015, ankuesi, përmes avokatëve të tij, i kërkoi Këshillit në veçanti, që në bazë të Rregullores (KE) nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 30 majit 2001, për qasjen e publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, të Këshillit dhe të Komisionit, të kishte qasje në dokumentet mbi të cilat ishte bazuar përfshirja e emrit të tij në listat në fjalë.

Me një letër të 13 shkurtit 2015, drejtuar avokatëve të ankuesit, Këshilli e informoi atë në veçanti për faktin se kishte për qëllim ta zgjaste deri në shtator 2015 afatin e masave kufizuese në lidhje me të dhe e ftonte të paraqiste komente në këtë drejtim deri më 26 shkurt 2015. Më 25 shkurt 2015, ankuesi, përmes avokatëve të tij, iu përgjigj asaj ftese, duke argumentuar se miratimi i masave kufizuese në lidhje me të nuk ishte i justifikuar.

Më 13 mars 2015, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2015/432, duke ndryshuar Vendimin 2014/145, dhe Rregulloren zbatuese (BE) 2015/427, në zbatim të Rregullores nr. 269/2014 (aktet e marsit 2015), me anë të së cilës, pas shqyrtimit të secilit emër, ajo e mbajti emrin e ankuesit në listat në fjalë deri më 15 shtator 2015, pa e ndryshuar arsyetimin në lidhje me ankuesin.

Me një letër të 16 marsit 2015, Këshilli i njoftoi avokatët e ankuesit për aktet e marsit 2015, duke specifikuar, në veçanti, se argumentet në të cilët ky i fundit ishte mbështetur në letrën e 25 shkurtit 2015 nuk vinin në dyshim themelin e arsyeve të dhëna në lidhje me të, pasi Agjencia Kombëtare e Shtypit e Federatës Ruse Rossiya Segodnya i kishte paraqitur ngjarjet që kishin ndodhur në Ukrainë në një dritë të favorshme për Qeverinë ruse dhe kështu kishte mbështetur politikën e qeverisë në fjalë në lidhje me situatën në Ukrainë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata u shpreh se në lidhje me situatën në Ukrainë në mars dhe shtator 2015, si dhe në mars 2016, veprimet e Federatës Ruse mund të konsiderohet se përbëjnë një “rast lufte ose tensioni serioz ndërkombëtar që kërcënon të çojë në një konflikt të armatosur”, sipas kuptimit të nenit 99.1 (d) të Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Federatës Ruse, në anën tjetër. Duke marrë parasysh interesin e BE-së dhe të shteteve të saj anëtare për të pasur, si një vend fqinj, një Ukrainë të qëndrueshme, mund të konsiderohet e nevojshme të vendosen masa kufizuese në mënyrë që të ushtrohet presion mbi Federatën Ruse për ta shtyrë atë që t’i japë fund aktiviteteve të saj të cilat minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin ose pavarësinë e Ukrainës. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se marrëveshja e partneritetit nuk kërkon nga një palë që dëshiron të marrë masa në bazë të asaj dispozite, që ta informojë paraprakisht palën tjetër, as ta konsultojë atë ose t’i japë arsytet.

Duke pasur parasysh rëndësinë e rolit që media, veçanërisht ato në sektorin audioviziv, luajnë në shoqërinë bashkëkohore, ishte e parashikueshme që mbështetja e medias për veprimet dhe politikat e qeverisë ruse do të destabilizonte Ukrainën, veçanërisht gjatë transmetimeve shumë të njohura, nga një person i emëruar me dekret të Presidentit Putin si drejtor i një agjencie lajmesh të përshkruar si një “ndërmarrje që i përket” shtetit rus, mund të ndikohet nga kriteri që synon personat fizikë që mbështesin në mënyrë aktive veprimet ose politikat, të cilat minojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës.

Në të vërtetë, koncepti i “mbështetjes aktive” mund të interpretohet vetëm në kuptimin që ai synon njerëzit që, pa qenë përgjegjës për veprimet dhe politikat e qeverisë ruse që destabilizojnë Ukrainën dhe pa zbatuar këto veprimeve ose politika, ofrojnë mbështetje për to. Kriteri nuk mbulon asnjë formë të mbështetjes për qeverinë ruse, por synon forma të mbështetjes të cilat, nga rëndësia e tyre sasiore ose cilësore, kontribuojnë në ndjekjen e veprimeve dhe politikave të kësaj të fundit që destabilizojnë Ukrainën. I interpretuar, nën kontrollin e gjyqtarit

të BE-së, duke pasur parasysh objektivin e ushtrimit të presionit mbi qeverinë ruse në mënyrë që ta detyrojë atë që t'u japë fund veprimeve dhe politikave të përmendura, kriteri përkatës përcakton kështu në mënyrë objektive një kategori të kufizuar personash dhe subjektsh që u nënshtrohen masave për ngrirjen e fondeve. Kur interpretohet ky kriter, duhet të merret parasysh praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila njih pamundësinë e arritjes së saktësisë absolute në hartimin e ligjeve, veçanërisht në fushat ku situata ndryshon sipas opinionëve mbizotëruese në shoqëri, dhe e cila pranon se nevoja për të shmangur ngurtësinë dhe për t'u përshtatur me ndryshimin e situatave nënkupton që shumë ligje përdorin formula pak a shumë të paqarta interpretimi dhe zbatimi i të cilave varen nga praktika. Kushti sipas të cilit ligji duhet të përcaktojë qartë veprat penale përmbushet kur subjektet mund ta dinë, nga formulimi i dispozitës në fjalë, nëse është e nevojshme me ndihmën e interpretimit të dhënë nga gjykatat, cilat veprime dhe mosveprime mund të çojnë në lindjen e përgjegjësisë së tij.

Neni 43

Liria e Tubimit

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO54/20. PARASHTRUES: PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/04/ko_54_20_agj_shq.pdf]

6 prill 2020

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky rast kishte të bënte me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të luftuar pandeminë Covid-19. Çështja kushtetuese e ngritur në ndërlidhje me vendimin e Qeverisë ishte se a kishte mbështetje ligjore kufizimi i të drejtave të njeriut që kishte bërë Qeveria përmes vendimit në fjalë, i cili, ndër të tjera, kufizonte edhe të drejtën e garantuar me nenin 43 të Kushtetutës [Liria e Tubimit].

Faktet kryesore

Nga 11 marsi 2020 e tutje, Qeveria nxori disa vendime që ndërlidheshin me pandeminë COVID-19. Më 15 mars 2020, Qeveria nxori Vendimin nr. 01/11 për shpalljen e “emergjencës për shëndetin publik”. Më 23 mars 2020, Qeveria nxori një Vendim tjetër, gjegjësisht Vendimin nr. 01/15, i cili u kontestua në Gjykatën Kushtetuese përmes kërkesës në rastin në fjalë (KO54/20). Në hyrje të Vendimit të kontestuar theksohej se ai ishte marrë në mbështetje të bazës vijuese kushtetuese: a) Neni 55 [Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore]; b) Paragrafi 4 i nenit 92 [Parimet e përgjithshme]; c) Paragrafin 4 i nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë]; si dhe, d) Nenin 41 [Pa titull] dhe nenin 44 [Pa titull] të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; e) Paragrafit 1.11 të nenit 12 [Masat dhe Veprimet] dhe nenin 89 [Përgjegjësitë e Ministrisë] të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi; f) Nenin 4 [Qeveria] të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive; g) Nenin 17 [Mbledhjet korresponduese] dhe 19 [Marrja e vendimeve] të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011; si dhe, h) Në

zbatim të Vendimit të Qeverisë nr. 01/11 të 15 marsit 2020 [të lartcekur] për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik.

Sipas vendimit të kontestuar, Qeveria pas aprovimit të kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë miratoi ndërmarrjen e një varg masave specifike për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Kjo përfshinte, ndër të tjera, ndalimin e qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve private gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00, përveç për raste dhe nevoja të veçanta (të specifikuar në vendim); lejohej qarkullimi i lirë për operatorët ekonomik të klasifikuar si më të rëndësishme; ndalohej lëvizja në rrugë, në grupe më të mëdha se dy persona së bashku dhe gjithmonë duke mbajtur distancën dy metra me të tjerët; ndaloheshin tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura - përveç kur është e domosdoshme për raste të veçanta të përcaktuara specifikisht, etj. Vendimi hyri në fuqi në ditën e nënshkrimit (23 mars 2020).

Më 24 mars 2020, në orën 12:03, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 01/15, të 23 marsit 2020.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit i kërkesës (gjegjësisht Presidenti i Republikës) kontestoi kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë, të 23 marsit 2020, duke pretenduar se i njëjti ishte marrë në kundërshtim me nenet 21, 22, 35, 43, 55, 56 të Kushtetutës; nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; si dhe nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata Kushtetuese caktimin e masës së përkohshme dhe pezullimin e zbatimit të vendimit të Qeverisë, deri në vendosjen e rastit. Për sa i përket përmbajtjes së vendimit të kontestuar, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Qeveria e kishte shpërfillur mandatin kushtetues e ligjor, duke e tejkalar kompetencat e saj dhe duke kufizuar në thelb lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit, të garantuar sipas nenit 35 dhe nenit 43 të Kushtetutës. Sipas parashtruesit, kufizimi i këtyre të drejtave për të gjithë qytetarët pa dallim mund të bëhet me ligj dhe vetëm në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe në kushte e rrethana që

e arsyetojnë një kufizim të tillë dhe në masë proporcionale. Parashtruesi i kërkesës, duke cituar nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, theksoi se i njëjti garanton se çfarëdo kufizimi i të drejtave dhe lirive, me përjashtim të atyre në paragrafin 2 të këtij neni, mund të bëhen vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe vetëm në mënyrën e përcaktuar në Kushtetutë dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme në rrethanat e dhëna.

Për sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, parashtruesi i kërkesës argumentoi se vendosja e masës së përkohshme ishte në interesin publik, sepse zbatimi i vendimit të kontestuar të Qeverisë do të shkaktonte dëme të pariparueshme dhe do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në shkaktimin e pasojave juridike (ligjore, financiare, ekonomike, etj.).

Arsyetimi i Gjykatës

Pas shqyrtimit të kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës dhe konstatimit se ato ishin plotësuar, Gjykata Kushtetuese sqaroi se nuk ishte roli i saj që të vlerësonte se a ishin të duhura masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se nevoja për të ndërmarrë masa dhe domosdoshmëria e tyre nuk ishte kontestuar nga asnjë palë në këtë rast.

Çështja kushtetuese që ngërthente ky rast, sipas Gjykatës Kushtetuese, ishte nëse me nxjerrjen e vendimit të kontestuar, Qeveria kishte kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në përputhje me ligjin, apo kjo ishte bërë përtej autorizimeve të përcaktuara me ligj. Për të vlerësuar nëse kufizimet e të drejtave të njeriut të bëra në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës përmes Vendimit të kontestuar të Qeverisë ishin të përcaktuara me ligj, Gjykata Kushtetuese u ndal në analizimin e autorizimeve të përcaktuara përmes neneve 41 dhe 44 të Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Këtë analizë të kornizës normative Gjykata Kushtetuese e bëri duke pasur parasysh: (i) kërkesën e parashtruesit dhe pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë; (ii) komentet e dorëzuara nga Qeveria dhe palët e tjera të interesuara; (iii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-s dhe posaçërisht, parimeve të

përgjithshme rreth zbatueshmërisë së kriterit “*e përcaktuar me ligj*” për sa i takon aspektit të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore; dhe (iv) praktikën gjyqësore të vetë Gjykatës Kushtetuese.

Në dritën e kësaj analize, Gjykata Kushtetuese gjeti se Vendimi [nr. 01/15] i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i nxjerrë më 23 mars 2020, nuk ishte në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E Drejta për Privatësi], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4, nenin 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare) dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së. Gjykata Kushtetuese konstatoi se kufizimet që përmbante vendimi i kontestuar i Qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk ishin të “*përcaktuara me ligj*”. Andaj, sipas Gjykatës, ato kufizime ishin në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës, në lidhje me nenet përkatëse të KEDNJ-s, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

Në arritjen e këtij përfundimi, Gjykata Kushtetuese theksoi faktin që vendimi i kontestuar i Qeverisë i referohej zbatimit të dy ligjeve të lartcekura, të cilat e autorizonin Ministrinë e Shëndetësisë që të ndërmerre masa të përcaktuara në ato ligje me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, Gjykata konstatoi se ligjet e lartcekura nuk e autorizonin Qeverinë që të kufizonte të drejtat dhe liritë kushtetuese të përcaktuara me nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në nivel të të gjithë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kufizimet e shqiptuara përmes vendimit të kontestuar të Qeverisë: (i) lidhur me lirinë e lëvizjes dhe të tubimit të përcaktuara përmes neneve 35 dhe 43 të Kushtetutës, tejkalonin kufizimet e lejuara përmes ligjit të lartcekur të miratuar nga Kuvendi; dhe (ii) lidhur me “*tubimet në të gjitha mjediset – private dhe publike, të hapura ose të mbyllura*” e që ngërthejnë aspekte të të drejtave të garantuara përmes nenit 36 të Kushtetutës, kufizimet nuk ishin të bazuara në asnjë autorizim të përcaktuar me ligjin e lartcekur apo edhe ndonjë ligj tjetër të Kuvendit.

Gjykata Kushtetuese sqaroi se Qeveria nuk mund të kufizojë asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i së drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit. Qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se ky nen nuk ishte i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, ngase i njëjti është i aplikueshëm vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme.

Lidhur me mospajtimin e palëve në kontest, Presidentit dhe Qeverisë, rreth kuptimit të termeve kushtetuese “*kufizim*” dhe “*shmangie*” që figurojnë në nenet 55 dhe 56 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese qartësoi se “*kufizimi*” i të drejtave dhe lirive të njeriut mund të bëhet “vetëm me ligj” të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që “*kufizimi*” i të drejtave mund të bëhet vetëm përmes dhe pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Gjykata po ashtu sqaroi se termi “*kufizim*” i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore përmes ligjit, por vetëm për aq sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Thënë ndryshe, “*kufizimi*” nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme; ndërkaq “*shmangia*” nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes ngase nuk mund të bëhet kurrësi pa u shpallur gjendja e jashtëzakonshme.

Pas konstatimit se vendimi i kontestuar i Qeverisë nuk ishte në pajtim me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese vendosi që aktgjykimi i saj në këtë rast nuk do hynte në fuqi në ditën e shpalljes, por me datën 13 prill 2020. Në lidhje me këtë, Gjykata theksoi se gjatë kësaj periudhe kohore dhe në kuptim të nenit 55 të Kushtetutës përkitazi me “*kufizimin*” e të drejtave dhe lirive themelore, institucionet gjegjëse të Republikës së Kosovës – në radhë të parë Kuvendi – duhet të ndërmerrnin masat e duhura për t’u siguruar që kufizimet e nevojshme të të drejtave dhe lirive themelore

më qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, të bëhen në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim. Në fund, Gjykata Kushtetuese sqaroi se Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht Qeveria, vazhdonte të ishte e autorizuar që të nxirrte vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.2 (1) dhe 116 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi: ta shpallë kërkesën të pranueshme; të shpallë që Vendimi nr. 01/15 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 23 marsit 2020, nuk ishte në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 43 [Liria e Tubimit] dhe nenet 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 11 (Liria e tubimit dhe e organizimit) të KEDNJ-së dhe nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së; të konstatojë që neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] i Kushtetutës nuk ishte i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret; të konstatojë që, bazuar në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhej “vetëm me ligj” të Kuvendit të Republikës së Kosovës; ta shpallë të pavlefshëm vendimin e Qeverisë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, përkatësisht nga 13 prilli 2020.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. NAVALNYYE kundër RUSISË

[29580/12, 36847/12, 11252/13]

GJEDNj [Dhoma e Madhe]

15 nëntor 2018

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: pengesat për lirinë e tubimit me synimin për të shtypur pluralizmin; Aktivisti politik arrestohet dhe ndiqet vazhdimisht për kundërvajtje administrative lidhur me paligjshmërinë e tubimeve publike.

Faktet Kryesore

Çështja filloi në pesë kërkesa (nr. 29580/12, 36847/12, 11252/13, 12317/13 dhe 43746/14) kundër Federatës Ruse të paraqitura në Gjykatë nga Aleksey Anatolyevich Navalnyy (“kërkuesi”), një shtetas rus, më 14 maj 2012, 28 maj 2012, 30 nëntor 2012, 14 janar 2013 dhe 6 qershor 2014, respektivisht. Kërkuesi, një figurë e opozitës politike, u arrestua shtatë herë ndërmjet viteve 2012 dhe 2014 në tubime të ndryshme publike. Kërkuesi u ndoq penalisht për shkelje administrative që lidhen me natyrën e tyre formalisht të paligjshme.

Në një aktgjykim të datës 2 shkurt 2017, duke iu referuar praktikës gjyqësore të mëparshme lidhur raste të ngjashme të shqyrtuara nga Gjykata e të paraqitura kundër Rosisë, një Dhomë e Gjykatës kishte vendosur, në veçanti, se kishte pasur shkelje e neneve 11 dhe 5 paragrafi 1 të Konventës në lidhje me secilin prej arrestimeve. Në këtë rast, Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej çështja sipas nenit 18. Gjykata arriti në përfundimin, njëzëri, se kishte pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 Konventës në gjashtë nga shtatë procedurat për kundërvajtje administrative.

Më 29 maj 2017, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesën e të dyja palëve.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u ankua se arrestimi i tij në ngjarje publike në shtatë raste kishte shkelur të drejtën e tij për lirinë e tubimit paqësor dhe të drejtën për liri. Ai gjithashtu pretendoi se arrestimi i tij, ndalimi dhe akuzat administrative të ngritura kundër tij kishin ndjekur qëllimin për të cenuar të drejtën e tij për lirinë e tubimit, për arsye politike. Së fundi, ai pretendoi se procedurat administrative para gjykatave vendase nuk kishin garanci për një gjykim të drejtë.

Në lidhje me arrestimet e tij, kërkuesi pretendoi se tubimet në fjalë nuk ishin të një shkalle të tillë që të cenonin rendin publik. Në lidhje me arrestimin e katërt dhe të shtatë, kur ai u akuzua për mosbindje ndaj urdhrorit të policisë (më 9 maj 2012 dhe 24 shkurt 2014), ai nuk kishte marrë asnjë urdhër apo paralajmërim përpara se policia ta arrestonte. Në çdo rast, një shkelje e rendit publik nuk iu ngarkua atij në proceset e brendshme. Për më tepër, nuk kishte asnjë arsye që kallëzimet e kundërvajtjes administrative të mos hartoheshin aty për aty, siç parashikohet nga neni 27 paragrafi 2 i Kodit të Kundërvajtjeve Administrative. Kërkuesi vuri në dukje se në çdo rast ai u ishte bindur oficerëve të policisë që e arrestonin dhe kishte qenë nën kontrollin e plotë të tyre. Në secilin rast ai u dërgua në një furgon policie, i cili do të ishte një vend i përshtatshëm për të bërë një procesverbal pa u larguar nga vendi i ngjarjes. Sipas tij, nuk kishte qenë e nevojshme ta sillnin atë në komisariat për të plotësuar dokumentet në asnjërin nga këto raste, veçanërisht për shkak se atij iu desh të kalonte një kohë të gjatë – herë pas here duke kaluar tre orë – në tranzit në stacionin e policisë. Ai u mbështet në konstatimin e Gjykatës në *Navalnyy dhe Yashin* (paragrafi 95) se, duke pasur parasysh mungesën e kufirit ligjor për kohëzgjatjen e një transferimi në një komisariat, një transferim i gjatë në mënyrë të paarsyeshme mund të përbëjë në vetvete ndalim të paregjistruar dhe të papranuar në shkelje e nenit 5 paragrafi 1.

Përveç kësaj, më 9 maj 2012 dhe 24 shkurt 2014 ai u ndalua për më shumë se tre orë, në shkelje të afatit ligjor, megjithëse nuk kishte pasur

rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin vendimin për të mos liruar atë në pritje të gjykimit. Ai pretendoi se paraburgimi i tij në ato dy raste nuk ishte në përputhje me qëllimet e heqjes së lirisë të përcaktuara në nënparagrafët përkatës të nenit 5 paragrafi 1.

Qeveria pretendoi se arrestimi i kërkuesit kishte qenë i ligjshëm dhe i nevojshëm për qëllimin e sjelljes së tij para drejtësisë në lidhje me kundërvajtjet administrative. Ata treguan se transferimi i tij në komisariat ka qenë i nevojshëm në çdo rast, sepse raportet administrative nuk mund të përpiloheshin aty për aty, pasi rrethanat ishin të tilla që e bënin të pamundur dokumentacionin. Për sa i përket ndalimit administrativ, kohëzgjatja e tij nuk i kalonte tre orë nga momenti i sjelljes së kërkuesit në komisariat, me përjashtim të dy rasteve kur ai u akuzua për vepra të dënueshme me heqje lirie, në të cilat raste ndalimi i tij binte brenda ligjit, respektivisht në afatin kohor prej dyzet e tetë orësh.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata rikujtoi praktikën e saj, ku Gjykata kishte shqyrtuar më parë ankesat e bëra nga persona të arrestuar në rrethana të ngjashme, duke përfshirë edhe një rast të arrestimit të kërkuesit. Në ato raste, policia kishte ndërprerë tubimet e parregullta por paqësore, dhe arrestoi pjesëmarrësit dhe i shoqëroi në komisariat për të bërë kallëzime për kundërvajtje administrative. Gjykata vuri në dukje, në veçanti, se sipas nenit 27.2 të Kodit të Kundërvajtjeve Administrative, kërkuesit mund të shoqëroheshin në një komisariat vetëm nëse raportet nuk mund të hartoheshin në vendin ku kishte ndodhur shkelja. Megjithatë, në ato raste nuk ishte dhënë asnjë arsye për të mos e bërë këtë në vend, gjë që çoi në konstatimin se arrestimi dhe shoqërimi në komisariat kishte përbërë një privim arbitrar dhe të paligjshëm të lirisë (shih *Navalnyy dhe Yashin*, paragrafët 68 dhe 93-97, dhe, *mutatis mutandis*, *Novikova dhe të tjerët*, paragrafët 182-83 dhe 226-27). Për më tepër, pasi të ishin përpiluar kallëzimet e kundërvajtjes administrative në komisariat, qëllimi i shoqërimit do të ishte përmbushur dhe ndalimi i mëtejshëm në paraburgim në pritje të seancës gjyqësore do të kërkonte justifikim specifik, siç është rreziku i shfaqur i arratisjes ose pengimit të rrjedhës së drejtësisë. Në mungesë të ndonjë arsyeje të qartë për moslirimin e kërkuesit, Gjykata e konsideroi ndalimin në pritje të

gjykimit të pajustificuar dhe arbitrar edhe pse ai binte brenda afatit kohor dyzet e tetë orësh të parashikuar nga neni 27.5 paragrafi 3 i Kodit të Kundërvajtjeve Administrative (shih *Navalnyy dhe Yashin*, cituar më lart, paragrafi 96, dhe *Frumkin kundër Rusisë*, nr. 74568/12, paragrafi 150, 5 janar 2016).

Duke pas parasysh se Qeveria nuk parashtrroi asnjë të dhënë të re në lidhje me arrestimet e kërkuesit, Dhoma e Madhe miratoi arsyet e Dhomës dhe konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 1 të Konventës për shkak të arrestimit të kërkuesit në shtatë raste dhe paraburgimit të tij në dy raste.

Kërkuesi, gjithashtu kishte pretenduar shkelje të nenit 6 paragrafët 1, 2 dhe 3 (d) të Konventës. Ai pretendoi se në të shtatë rastet, procedurat në të cilat ai u dënua për një kundërvajtje administrative nuk i përmbaheshin garancive të dëgjimit të drejtë, veçanërisht parimeve të barazisë së armëve, procedurave kundërshtare, pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës dhe prezumimit të pafajësisë. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata theksoi se duke pasur parasysh vlerësimet e mëhershme (kur kishte gjetur se neni 6 ishte i zbatueshëm në rastin e parashtruesit), Dhoma e Madhe nuk sheh asnjë arsye për t'u larguar nga konkluzionet e Dhomës dhe konstatoi që neni 6 ishte i zbatueshëm në pjesën e tij penale për shtatë grupet e procedurave administrative në çështjen në fjalë.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 11, Gjykata theksoi se neni 11 ishte i zbatueshëm për secilin nga shtatë ngjarjet/arrestimet. Gjykata theksoi se veprimet në fjalë të autoriteteve përbënin një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së kërkuesit për lirinë e tubimit. Në lidhje me këtë ndërhyrje, Gjykata vlerësoi si në vijim:

(a) Qëllimi legjitim – Dhoma e Madhe konsideroi se dështimi për të ndjekur një qëllim legjitim ishte qartësisht i dukshëm në ngjarjet përkitazi me arrestimin e pestë dhe të gjashtë (duke shprehur gjithashtu dyshime serioze për ekzistencën e tij në lidhje me arrestimet e tjera):

– në rastin e parë, kërkuesi po largohej nga vendi i një demonstrimi statik dhe ishte ndjekur nga një grup personash, mes tyre edhe

gazetarë. Autoritetet e perceptuan këtë si një “marshim i paautorizuar”, megjithëse kërkuesi nuk kishte shfaqur ndonjë qëllim për ta bërë diçka tjetër përveç thjesht largimit nga vendi i ngjarjes, dhe grupi nuk ishte formuar me ndonjë iniciativë të tij dhe se grupi vetëm po ecte përgjatë trotuarit;

– në rastin e dytë, asgjë në shkresat e lëndës nuk sugjeronte se personat që formonin grupin (i përshkruar nga autoritetet si një “mbledhje publike”) pritej t’u ndalohej hyrja në gjykatë, ose se ata kishin planifikuar të mbanin një demonstratë nëse do të u ndalohej hyrja. Megjithëse grupi me të vërtetë kishte filluar të thërriste parulla politike, nuk u vërejt se kërkuesi vetë kishte thërritur parulla ose kishte demonstruar një qëllim për të mbajtur një tubim politik. Sido që të jetë, trafiku rreth godinës së gjykatës tashmë kishte qenë bllokuar nga policia.

(b) Proporcionaliteti – Pesë arrestimet e tjera kishin ndodhur gjatë ngjarjeve publike, pa njoftim ose pas përfundimit të periudhës kohore të autorizuar. Të gjitha këto ngjarje ishin tubime paqësore të cilat pothuajse nuk shkaktuan ndonjë shqetësim. Si në rastet e mëparshme, paligjshmëria formale e tubimit ishte parashtruar si justifikim i vetëm. Duke qenë se nuk ishte demonstruar ndonjë nevojë urgjente shoqërore, arrestimi i kërkuesit dhe sanksioni në secilin prej episodeve u duk si një reagim joproporcional. Për më tepër, ekzistonte një lidhje midis këtyre dështimeve dhe atyre të vërejtura më parë, një pamjaftueshmëri strukturore në kuadrin rregullator, i cili parashikonte në mënyrë të tepruar kërkesat formale kufizuese për organizimin e tubimeve të caktuara publike. Përveç nga interpretimi i gjerë i asaj që përbënte një tubim objekt njoftimi, mungesa e tolerancës ndaj tubimeve të cilat nuk janë në përputhje me procedurën theksonte edhe një dimension tjetër të këtij problemi strukturor: diskrecioni tepër i gjerë i autoriteteve në shqiptimin e privimit të menjëhershëm të lirisë, madje edhe të sanksioneve të natyrës penale, në raste të tilla. Për rrjedhojë, nuk mund të thuhet se ligji përkatës kombëtar parashikonte masa mbrojtëse efektive kundër abuzimit. Po kështu, masat e kontestuara kishin një potencial serioz për të parandaluar mbështetësit e tjerë të opozitës dhe publikun në përgjithësi nga pjesëmarrja në demonstrata dhe, në përgjithësi, nga pjesëmarrja në debat të hapur politik; veçanërisht pasi që, në shënjestrimin e një figure të njohur publike, ata ishin të detyruar

të tërhiqnin mbulim të gjerë mediatik. Përfundimisht, Gjykata gjeti shkelje (njëzëri) për secilin nga shtatë arrestimet.

Në lidhje me nenin 18, Gjykata theksoi se ankesa sipas këtij neni përfaqësonte një aspekt themelor të rastit aktual, mjaftueshëm të ndryshëm nga ato të shqyrtuara më sipër. Gjykata iu referua metodës së përcaktuar në vendimin e saj në *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], duke specifikuar se qëllimi mbizotërues i masave të kontestuara mund të kishte ndryshuar gjatë periudhës në shqyrtim: çfarë mund të dukej një qëllim ose qëllim legjitim në fillim, mund të dukej më pak i besueshëm me kalimin e kohës. Në rastin konkret, konstatimi i mungesës së qëllimit legjitim në lidhje me ngjarjet/arrestimin e pestë dhe të gjashtë mënjantuan nevojën për çdo diskutim mbi një pluralitet qëllimesh. Megjithatë, kishte ende nevojë të shqyrtohej nëse kishte një qëllim të identifikueshëm “të fshehtë”. Në lidhje me ngjarjet/arrestimet e tjera, koncepti i pluralitetit të qëllimeve ishte ende i rëndësishëm. Një model i caktuar mund të dallohej nga seria e episodeve: kërkuesi kishte qenë i arrestuar shtatë herë në një periudhë relativisht të shkurtër dhe në mënyrë praktikisht identike, ndërsa duke ushtruar të drejtën e tij nga Konventa për lirinë e tubimit.

Pretekstet për arrestimet ishin bërë gjithnjë e më të pabesueshme, ndërsa shkalla e çrregullimit të mundshëm ose të vërtetë të shkaktuar nga kërkuesi, ishte zvogëluar. Veçanërisht, edhe pse në katër arrestimet/ngjarjet e para kërkuesi ishte një nga drejtuesit e tubimeve, ai nuk kishte luajtur ndonjë rol të veçantë në ngjarjet e mëvonshme.

Për më tepër, përveç mungesës së lartpërmendur ose natyrës shumë të diskutueshme të qëllimit legjitim, autoritetet duhet të kenë qenë gjithnjë e më të vetëdijshme se praktikrat në fjalë ishin të papajtueshme me standardet e Konventës. Në lidhje me këtë, gjithashtu duhet pasur parasysh kontekstin më të gjerë, veçanërisht për gjetjet e ngjashme të Gjykatës në lidhje me një demonstrim të mbajtur tre muaj përpara ngjarjes së parë nga shtatë ngjarjet e tanishme (shih *Navalnyy dhe Yashin kundër Rusisë*) dhe në lidhje me mangësitë e gjetura në dy grupe procedurash penale që po zhvilloheshin kundër kërkuesit (shih *Navalnyy dhe Ofitserov kundër Rusisë* dhe *Navalnyy kundër Rusisë*). Përveç kësaj, kishte prova konvergjente kontekstuale që autoritetet ishin

duke u bërë gjithnjë e më të ashpra në reagimin e tyre ndaj sjelljes së kërkuesit, në dritën e pozicionit të tij si lider i opozitës, dhe të aktivistëve të tjerë politikë dhe, më të ashpër, përgjithësisht, në qasjen e tyre ndaj tubimeve publike të natyrës politike. Përveç ndryshimeve legislative të miratuara gjatë periudhës në shqyrtim, futja e mëvonshme e kufizimeve të tjera në kuadrin legjislativ për lirinë e tubimit mund të konsiderohet tregues i një tendence të vazhdueshme. Disa organe të Këshillit të Evropës kishin shprehur shqetësimet e tyre për këtë çështje.

Në thelb të ankesës aktuale qëndronin pretendimet e kërkuesit për persekutimin e tij, jo si individ, por si politikan opozitar i përkushtuar që luan një funksion të rëndësishëm publik nëpërmjet diskutit demokratik. Si i tillë, kufizimi në fjalë do të kishte prekur jo vetëm kërkuesin ose aktivistët dhe mbështetësit e opozitës, por vetë thelbin e demokracisë si mjet i organizimit të shoqërisë, në të cilën liria individuale mund të kufizohej vetëm në interes të përgjithshëm, pra në emër të “lirisë më të lartë” të përmendur në *travaux préparatoires* në lidhje me nenin 18.

Në dritën e të gjithë këtyre elementeve, Gjykata e gjeti përtej dyshimit të arsyeshëm se kufizimet e vendosura ndaj kërkuesit në episodin e pestë dhe të gjashtë ndoqën një qëllim të fshehtë (i cili ishte i një serioziteti të konsiderueshëm), domethënë të shtypte pluralizmin politik, një shenjë dalluese e “demokracisë politike efektive” të qeverisur nga “sundimi i ligjit”, të dy konceptet e përmendura në Preambulën e Konventës. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 18 në lidhje me nenin 5 dhe nenin 11 të Konventës.

Në lidhje me nenin 46: Gjykata vlerësoi se duke pasur parasysh natyrën strukturore të problemit, shteti i paditur duhet të marrë masat e duhura legislative dhe/ose të tjera të përgjithshme për të siguruar në legjisllacionin e tij të brendshëm një mekanizëm që u kërkon autoriteteve kompetente të kenë parasysh karakterin themelor të lirisë së tubimit paqësor dhe të tregojnë tolerancë të përshtatshme ndaj tubimeve të paautorizuara por paqësore që shkaktojnë vetëm një pengesë të caktuar në jetën e zakonshme që nuk shkon përtej nivelit të shqetësimit të vogël; ato do të duhej ta kufizonin këtë liri vetëm pasi të jetë verifikuar siç duhet nëse kufizimi është i justifikuar nga qëllimet

legjitime, të tilla si nevoja për parandalimin e çrregullimit ose krimit dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve; dhe autoritetet do të duhej të vendosnin një ekuilibër të drejtë midis të interesave të tilla dhe interesave të individit në ushtrimin e së drejtës së tij/saj për lirinë e tubimit paqësor. Për më tepër, për çdo shqiptim të sanksioneve do të duhej të kërkoheshin arsyetime të veçanta.

Parandalimi i shkeljeve të ngjashme në të ardhmen do të duhej të adresohet në kuadrin e duhur ligjor, në veçanti duke siguruar që instrumentet ligjore kombëtare që kanë të bëjnë me kufizimet dhe modalitetet e ushtrimit të së drejtës për lirinë e tubimit të mos paraqesin një pengesë të fshehtë për lirinë e tubimit paqësor të mbrojtur nga neni 11 i Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Në dritën e sa më sipër, Gjykata gjeti se ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 1 të Konventës për shkak të arrestimit të kërkuesit në shtatë raste dhe paraburgimit të tij në dy raste; se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës në lidhje me procedurat administrative në lidhje me ngjarjet e 5 marsit 2012; se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës në lidhje me gjashtë grupet e mbetura të procedurave administrative; se nuk ka nevojë të shqyrtohet pjesa e mbetur e ankesave sipas nenit 6 paragrafët 1 dhe 3 (d) të Konventës në lidhje me gjashtë grupet e procedurave administrative; se ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës; se ka pasur shkelje të nenit 18 të Konventës lidhur me nenet 5 dhe 11 të Konventës; se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankimi sipas nenit 14 të Konventës. Bazuar në nenin 41, Gjykata konstatoi se shteti i paditur duhet të paguajë 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro për dëmin jomaterial; 1,025 (një mijë e njëzet e pesë) euro në lidhje me dëmin material.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. EUGEN SCHMIDBERGER, INTERNATIONALE TRANSPORTE UND PLANZÜGE kundër REPUBLIK ÖSTERREICH

GJDBE
C-112/00

12 qershor 2003

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=47920&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13715242>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Kjo çështje ka të bëjë me kufizimet që mund t'i vihen lëvizjes së lirë të mallrave brenda Komunitetit/ Bashkimit Evropian, me qëllim që të arrihet të respektohet e drejta e tubimit dhe demonstrimit.

Faktet kryesore

Më 15 maj 1998, shoqata “Transitforum Austria Tirol”, objektivi i së cilës është ‘mbrojtja e hapësirës së jetesës në rajonin Alpine’, informoi Bezirkshauptmannschaft Innsbruck¹⁸⁵, siç kërkohet nga nenet 2 të VslgG¹⁸⁶ dhe 86 të StVO¹⁸⁷, që do të mbahej një tubim nga ora 11 e mëngjesit të së premtes, 12 qershor 1998, deri në orën 3 pasdreke të së shtunës, 13 qershor 1998, në autostradën Brennerit (A 13), gjë që do të çonte, gjatë kësaj periudhe kohore, në mbylljen e të gjithë trafikut të kësaj autostrade në pjesën midis zonës së pushimit Europabrücke dhe stacionit të pagimit të autostradës Schönberg në Austri.

185 Autoritetin administrativ të bashkësisë territoriale të Rrethit, në Innsbruck.

186 Versammlungsgesetz – ligji austriak mbi tubimet i vitit 1953.

187 Kodi Rrugor austriak i vitit 1960.

Në të njëjtën ditë, presidenti i shoqatës në fjalë dha një konferencë për shtyp, pas së cilës mediat austriake dhe gjermane transmetuan informacione për mbylljen e autostradës e Brennerit. Klubet automobilistike austriake dhe gjermane, pasi u lajmëruan mbi këtë bllokim, ofruan informacion praktik për ata që do të udhëtonin përgjatë këtij itinerari, duke treguar në veçanti se kjo autostradë duhet të shmangej gjatë periudhës në fjalë.

Më 21 maj 1998, Bezirkshauptmannschaft i kërkoi udhëzime Sicherheitsdirektion für Tirol¹⁸⁸ në lidhje me këtë tubim. Më 3 qershor 1998, Sicherheitsdirektor urdhëroi që tubimi të mos ndalohej. Më 10 qershor 1998, u mbajt një takim i anëtarëve të autoriteteve të ndryshme lokale me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së tubimit. Duke çmuar se tubimi ishte i ligjshëm sipas ligjit austriak, Bezirkshauptmannschaft vendosi të mos e ndalonte atë, por nuk shqyrtoi nëse vendimi i tij ka të ngjarë të shkelte të drejtën e Komunitetit.

Tubimi u zhvillua në vendin dhe datën e parashikuar. Rrjedhimisht, automjetet e mallrave të rënda, të cilat duhej të kishin kaluar nëpër autostradën e Brennerit, u bllokuan të premtën më 12 qershor 1998 në orën 9 të mëngjesit. Kjo autostradë u rihap për trafikun të shtunën 13 qershor 1998 rreth orës 3.30 pasdite, në varësi të ndalimeve të drejtimit për kamionët mbi 7.5 t gjatë orëve të caktuara të shtunave dhe të dielave, sipas rregullave austriake.

“Eugen Schmidberger”, Internationale Transporte und Planzüge (në tekstin e mëtejshëm: “Schmidberger”) është një kompani ndërkombëtare transporti me qendër në Rot an der Rot në Gjermani, e cila ka gjashtë automjete të rënda me rimorkio. Aktiviteti i saj kryesor është transporti i lëndës drusore nga Gjermania në Itali dhe çelik nga Italia në Gjermani. Për këtë qëllim, kamionët e saj përdorin kryesisht autostradën e Brennerit.

“Schmidberger” bëri një padi para Landesgericht Innsbruck¹⁸⁹ duke kërkuar që Republika e Austrisë t’i paguajë një dëmshpërblim prej 140,000

188 Drejtoria e përgjithshme e policisë për Tirolin.

189 Gjykatës së Rrethit të Innsbruck.

ATS¹⁹⁰, për shkak të pamundësisë që pesë kamionë të tij të “përdornin autostradën e Brennerit për katër ditë rresht, duke pasur parasysh se, nga njëra anë, e enjtja 11 qershor 1998 ishte një festë publike në Austri, ndërsa 13 dhe 14 qershori vijues ishin një e shtunë dhe një e diel, dhe se, nga ana tjetër, rregulloret austriake parashikojnë ndalimin e lëvizjes së kamionëve mbi 7.5t gjatë shumicës së fundjavave dhe festave publike. Kjo autostradë përbënte të vetmen rrugë transiti që mund të përdornin automjetet e saj midis Gjermanisë dhe Italisë. Sipas paditësit, mosndalimi i tubimit dhe dështimi i autoriteteve austriake për të ndërhyrë për të parandaluar bllokimin e këtij aksi rrugor përbënte një pengesë për lëvizjen e lirë të mallrave. Përderisa nuk mund të justifikohet me të drejtat për lirinë e shprehjes dhe lirinë e tubimit të demonstruesve, kjo pengesë shkelte të drejtën komunitare dhe për këtë arsye ishte e tillë që çonte në lindjen e përgjegjësisë së shtetit anëtar në lidhje me të. Në këtë rast, dëmi i pësuar nga “Schmidberger” do të konsistonte në bllokimin e automjeteve të tij të rënda të mallrave (50,000 ATS), kostot fikse që lidhen me shoferët (5,000 ATS) dhe një humbje të fitimeve që rezultojnë nga ulja e tarifave për klientët për shkak të vonësive të gjata në transportin e mallrave si dhe dështimin për të arritur në kohë gjashtë udhëtime midis Gjermanisë dhe Italisë (85,000 ATS).

Landesgericht Innsbruck vlerësoi se vendimi për të mos ndaluar tubimin në fjalë ishte marrë pas një shqyrtimi të kujdesshëm të situatës, se informacioni mbi datat e mbylljes së autostradës e Brennerit ishte publikuar më parë në Austri, Gjermani dhe Itali dhe se ky tubim nuk do të kishte shkaktuar bllokime të mëdha trafiku apo incidente të tjera. Sipas autoriteteve, pengesa për lëvizjen e lirë që rridhte nga tubimi nuk ishte e përhershme dhe serioze. Ato arritën në përfundimin se vlerësimi i interesave në fjalë duhet të anonte në favor të lirive të shprehjes dhe tubimit, pasi të drejtat themelore janë të paprekshme në një shoqëri demokratike. Pasi vuri në dukje se nuk mund të vërtetohej që kamionët “Schmidberger” duhej të kishin marrë autostradën e Brennerit më 12 dhe 13 qershor 1998 dhe që, gjithsesi, kompania në fjalë duhet të kishte marrë parasysh organizimin e tubimit, duke ndryshuar rrugë, përderisa kishte informacion për këtë tubim, Landesgericht Innsbruck,

190 Shilinga austriake.

me vendimin e 23 shtatorit 1999, e hodhi poshtë ankesën në bazë të ligjit material dhe procedural austriak.

“Schmidberger” e apeloj këtë vendim në Oberlandesgericht Innsbruck¹⁹¹, e cila vlerësoi se duhej të merrej parasysh edhe e drejta e Komunitetit, përderisa pretendimet për lëvizjen e lirë ngriheshin në bazë të saj. Për këtë arsye, ajo iu drejtua Gjykatës së Luksemburgut me disa pyetje paragykimore. Në thelb pyetjet e gjykatës referuese ngrinin dy probleme të ndryshme, por gjithsesi të lidhura me njëra-tjetrën. Nga njëra anë, gjykata referuese pyeti Gjykatën nëse mbyllja e plotë e autostradës së Brennerit për rreth 30 orë pa ndërprerje përbën një pengesë të papajtueshme me lëvizjen e lirë të mallrave dhe, për këtë arsye, duhet të konsiderohet si një shkelje e së drejtës komunitare. Nga ana tjetër, pyetjet lidhen më konkretisht me kushtet në të cilat një shtet anëtar mund të konsiderohet përgjegjës për dëmin e shkaktuar individëve si rezultat i shkeljes të së drejtës komunitare.

Përmbledhja e vendimit

Gjykata e Luksemburgut, në përgjigjen e saj, theksoi se, duke pasur parasysh rolin themelor që luan lëvizja e lirë e mallrave në sistemin e Komunitetit, në veçanti për funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, secili shtet anëtar ka për detyrë të sigurojë lëvizjen e lirë të mallrave në territorin e tij, duke marrë masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të parandaluar ndonjë kufizim për shkak të veprimeve të individëve. Ky detyrim zbatohet pa pasur nevojë të dallohet ndërmjet rasteve kur pengesa të tilla ndikojnë fluksin e importeve apo të eksporteve apo nëse ato prekin thjesht transitin e mallrave. Ky detyrim përfshin jo vetëm eliminimin e pengesave të vëna nga vetë shtetet anëtare, por edhe mosveprimin e shteteve për të hequr pengesa të tilla, kur ato lindin nga veprime që nuk vijnë si pasojë e veprimit të shteteve anëtare.

Fakti që organet kompetente të një shteti anëtar nuk kanë ndaluar mbajtjen e një tubimi nga protestuesit, tubim që çoi, për një periudhë të caktuar, në mbylljen e plotë të një rruge kryesore transiti ndërmjet

191 Gjykata Rajonale (e apelit) e Innsbruck, e cila ishte edhe gjykata referuese në këtë rast.

shteteve anëtare vjen në kundërshtim me nenet 30 dhe 34 të Traktatit të KEE-së¹⁹², lexuar së bashku me nenin 5 të Traktatit të KEE-së¹⁹³ përveçse kur kufizimi i tregtisë së mallrave ndërmjet shteteve anëtare justifikohet nga interesa legjitime për mbrojtjen e të drejtave themelore, në këtë rast lirinë e shprehjes dhe lirinë e tubimit të protestuesve, interesa që gjejnë zbatim si ndaj Komunitetit, ashtu edhe ndaj shteteve anëtare.

Duke marrë parasysh këtë arsyetim, duhet të peshohen interesat e përfshira, përkatësisht, nga njëra anë, lëvizja e lirë e mallrave, e cila, në rrethana të caktuara, mund t'u nënshtrohet kufizimeve për arsye të përcaktuara në nenin 36 të Traktatit, ose për arsye mbizotëruese që kanë të bëjnë për interesin publik, dhe nga ana tjetër, liria e shprehjes dhe e tubimit, të cilat gjithashtu u nënshtrohen disa kufizimeve të justifikuar sipas objektivave në interes publik, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit me qëllim që të përcaktohet nëse është mbajtur një baraspeshë ndërmjet këtyre interesave.

Në këtë rast, autoritetet kombëtare u mbështetën në nevojën për të respektuar të drejtat themelore të garantuara si nga KEDNJ, ashtu edhe nga Kushtetuta e shtetit anëtar në fjalë për të lejuar kufizimin e një prej lirive themelore të parashikuara nga Traktati.

Kështu, çështja në fjalë ngre problemin e harmonizimit të nevojshëm të kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore në Komunitet me ato që rrjedhin nga një liri themelore e parashikuar në Traktat dhe, në veçanti, mes lirisë së shprehjes dhe të tubimit, të garantuar nga nenet 10 dhe 11 të KEDNJ-së, dhe lëvizjes së lirë të mallrave, kur të parat përdoren si justifikim për kufizimin e kësaj të fundit. Si të drejtat themelore të parashikuara nga KEDNJ, ashtu edhe liria e lëvizjes e parashikuar nga Traktati, për nga vetë natyra e tyre, mund kufizohen.

Është e vërtetë që autoritetet kombëtare gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë drejtim, por i takon Gjykatës të përcaktojë nëse kufizimet ndaj tregtisë brenda Komunitetit janë proporcionale në

192 Pas ndryshimeve të Traktatit, respektivisht nenet 34 dhe 35 të TFBE-së.

193 Ky nen është zëvendësuar, në thelb, nga neni 4, paragrafi 3, i TBE-së.

dritën e objektivit legjitim të ndjekur, domethënë, në rastin konkret, mbrojtjen e të drejtave themelore.

Ndërsa një tubim publik në autostradë, zakonisht, sjell pengesa për jopjesëmarrësit, veçanërisht në lidhje me lëvizjen e lirë, këto pengesa, në parim, mund të tolerohen me kusht që objektivi i ndjekur të jetë demonstrimi publik dhe i ligjshëm i një mendimi ose i një qëndrimi.

Duke iu referuar fakteve të çështjes, Gjykata theksoi, në radhë të parë, se tubimi në fjalë u zhvillua pas një kërkesë për autorizim, të bërë në bazë të ligjit kombëtar dhe, pasi autoritetet kompetente vendosën të mos e ndalojnë atë.

Së dyti, për shkak të pranisë së demonstruesve në autostradën e Brennerit, trafiku rrugor u ndalua në një rrugë të vetme, në një rast të vetëm dhe për një periudhë prej gati 30 orësh. Për më tepër, pengesa për lëvizjen e lirë të mallrave që erdhi si pasojë e tubimit në fjalë, ishte e kufizuar gjeografikisht në raport me çështjen *Komisioni kundër Francës*¹⁹⁴.

Së treti, nuk kundërshtohet se me tubimin në fjalë, qytetarët ushtronin të drejtat e tyre themelore duke shprehur publikisht një opinion të cilin e konsiderojnë të rëndësishëm në jetën e komunitetit. Është gjithashtu jokontestuese që ajo ngjarje publike nuk kishte për qëllim të pengonte tregtinë e mallrave të një natyre ose origjine të caktuar. Nga ana tjetër, në çështjen *Komisioni kundër Francës*, qëllimi i ndjekur nga demonstruesit ishte qartësisht parandalimi i qarkullimit të produkteve specifike nga shtetet anëtare të tjera nga Republika Franceze, jo vetëm me anë të pengesave të vendosura në transportin e mallrave në fjalë, por edhe me shkatërrimin e tyre në transit ose gjatë transitit nëpër Francë, apo edhe kur ato ishin tashmë në dyqanet franceze.

Së katërti, duhet kujtuar se në këtë rast ishin marrë masa të ndryshme mbikëqyrëse dhe mbështetëse nga organet kompetente për të kufizuar sa më shumë ndërprerjen e qarkullimit rrugor. Kështu, në veçanti autoritetet, përfshirë forcat e policisë, organizatorët e demonstratës

194 Vendim i 9 dhjetorit 1997, C-265/95, Rec. p. I-6959.

dhe shoqatat e ndryshme të automobilistëve, bashkëpunuan për të garantuar mbarëvajtjen e tubimit. Shumë kohë përpara datës në të cilën do të zhvillohej tubimi, kishte nisur një fushatë e gjerë informacioni nga mediat dhe klubet e automobilave, si në Austri ashtu edhe në vendet fqinje, dhe ishin planifikuar rrugë të ndryshme alternative, sa operatorët ekonomikë në fjalë ishin informuar siç duhet për kufizimet e lëvizjes në datën dhe vendin e tubimit të planifikuar dhe ishin në gjendje të merrnin të gjitha masat e nevojshme në kohë për të shmangur këto kufizime. Përveç kësaj, një shërbim sigurie ishte ngritur pikërisht në vendin ku do të mbahej demonstrata.

Për më tepër, është e zakonshme që veprimi i izoluar në fjalë nuk ka krijuar një klimë të përgjithshme pasigurie me pasoja penguese në shkëmbimet tregtare brenda Komunitetit në tërësi, ndryshe nga shqetësimet serioze dhe të përsëritura të rendit publik në çështjen që ngrihet në vendimin *Komisioni kundër Francës*, i cituar më sipër.

Së fundi, në lidhje me mundësitë e tjera për tubim, është e përshtatshme, duke pasur parasysh diskrecionin e gjerë në dispozicion të shteteve anëtare, të konsiderohet se, në rrethana të tilla si ato në rastin konkret, autoritetet kompetente të shtetit anëtar ishin në gjendje të konsideronin se një ndalim tërësor i tij do të përbënte një ndërhyrje të papranueshme në të drejtat themelore të demonstruesve për tubim dhe për të shprehur në mënyrë paqësore opinionin e tyre në publik.

Rrjedhimisht, autoritetet kombëtare, duke marrë parasysh hapësirën e gjerë të vlerësimit që u njihet në këtë çështje, në mënyrë të arsyeshme ishin në gjendje të konsideronin se objektivi i ndjekur në mënyrë legjitime nga ky tubim nuk mund të arrihej në rastin konkret me kufizime më të vogla ndaj tregtisë komunitare.

Në dritën e këtyre vlerësimeve, Gjykata arriti në përfundimin se fakti që autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar nuk e ndaluan një tubim të tillë nuk shkel nenet 30 dhe 34 të Traktatit, të lexuara në lidhje me nenin 5 të tij.

Duke pasur parasysh këtë përgjigje mbi problemin e parë, Gjykata vlerësoi se nuk kishte vend për t'iu përgjigjur problemit të dytë, mbi kushtet e përgjegjësive së shtetit në rast të shkeljes së të drejtës komunitare.

Neni 44

Liria e Asociimit

- 1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.*
- 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.*
- 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO97/12. PARASHTRUES AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_97_12_shq_.pdf]

12 prill 2013

Çështja kyçele drejta e pretenduar; Çështja kryesore e ngritur në këtë rast kishte të bënte me pretendimin që Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, ishte në kundërshtim me Kushtetutën, duke përfshirë edhe nenin 44 [Liria e Asociimit].

Faktet kryesore

Më 12 prill 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nr. 04/L-093. Më 19 prill 2012, organizatat joqeveritare: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës, të mbështetur dhe nga 55 OJQ të tjera, i drejtuan një letër Presidentit të Republikës së Kosovës, duke kërkuar që Ligji të mos shpallej dhe të kthehej në Kuvend për rishqyrtim. Më 11 maj 2012, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare u publikua në Gazetën Zyrtare. Më 11 maj 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit mori një parashtrësë nga OJQ-të e sipërcekura, të cilat së bashku iu drejtuan Institucionit të Avokatit të Popullit duke kërkuar që Gjykata Kushtetuese të vlerësonte kushtetutshmërinë e disa neneve specifike të Ligjit në fjalë, me argumentin se ato nene ishin në kundërshtim me Kushtetutën. OJQ-të po ashtu kërkuan pezullimin e zbatimit të Ligjit, derisa Gjykata të nxirrte një vendim meritator përkitazi më këtë rast. Konkretisht, OJQ-të e lartpërmendura konsideruan se dispozitat e neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare,

shkelnin nenin 44 [Liria e Asociimit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 10 [Ekonomia], të Kushtetutës, parimet ndërkombëtare të OJQ-ve jofitimprurëse dhe legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë, që rregullon fushën e lirisë së asociimit në OJQ.

Më 11 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar kushtetutshmërinë e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nr. 04/L-093.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi pretendoi se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nr. 04/L-093, lejonte OJQ-të që ishin institucione mikrofinanciare që të transformoheshin në shoqëri aksionare, gjegjësisht në subjekte private, në kundërshtim me qëllimin e themelimit të tyre. Si i tillë, sipas parashtruesit, ky Ligj shkelte parimet kushtetuese dhe ndërkombëtare të së drejtës së sektorit jofitimprurës. Si i tillë, ai Ligj ishte në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë që rregullonte lirinë e asociimit në OJQ, duke vënë në rrezik të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi. Sipas parashtruesit, OJQ-të institucione mikrofinanciare janë themeluar në pajtim me të drejtën për asociim, të garantuar me nenin 44 të Kushtetutës dhe më Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ. Sipas parashtruesit, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, me ndryshimin e subjektivitetit juridik të OJQ-ve, institucione mikrofinanciare, dhe duke lejuar transformimin e tyre në shoqëri aksionare, i largon ato prej fushëveprimit të nenit 44 të Kushtetutës, derisa Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ pengonte të drejtën e tyre për të vepruar në bazë të së drejtës për asociim. Në këtë vazhde, sipas parashtruesit, Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ, në nenin 4, paragrafët 2 dhe 3, nuk lejonte një OJQ të transformohej në një subjekt tjetër juridik, aq më pak në një subjekt juridik profitabil. Për më tepër, parashtruesi argumentoi se sipas nenit 46 të Kushtetutës, askush nuk do të privohet arbitrarisht nga prona e tij, duke përfshirë pronën e personave juridike. Rrjedhimisht, parashtruesi pohoi se ky nen mbronte pasurinë edhe të organizatave joqeveritare. Po ashtu, sipas parashtruesit, Ligji në fjalë, duke lejuar transformimin e OJQ IMF në shoqëri aksionare, lejonte që kapitali i fituar pa pagesën e tatimeve

të injektohej në konkurrencën e tregut komercial në mes të bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të cilat janë të detyruara të paguajnë taksa që nga themelimi i tyre. Kjo ishte në kundërshtim me nenin 10 të Kushtetutës që parasheh se “ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë për rregullimin ekonomik të Republikës së Kosovës”. Parashtruesi kërkoi gjithashtu vënien e masës së përkohshme nga Gjykata Kushtetuese dhe pezullimin e zbatimit të Ligjit të kontestuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Para se të shqyrtonte pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës, Gjykata Kushtetuese kishte pezulluar zbatimin e Ligjit të kontestuar, duke vendosur masën e përkohshme për një periudhë tremujore dhe, mandej duke e zgjatur të njëjtën edhe për tre muaj. Po ashtu, më 5 mars 2013, Gjykata Kushtetuese mbajti një seancë dëgjimore ku ishin dëgjuar: Parashtruesi i kërkesës; b) Komisioni për Legjislacion, i përfaqësuar i Kuvendit të Kosovës; c) Ministria e Financave; d) Banka Qendrore; dhe e) Ministria e Administratës Publike.

Pas shpalljes së kërkesës si të pranueshme për vlerësimin e meritave të saj, Gjykata Kushtetuese iu referua Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare, si dhe Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nr. 04/L-093. Në analizimin e kornizës ligjore përkatëse, Gjykata vuri në dukje se neni 95 (1.6) i Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare përcaktonte që institucionet mikrofinanciare – OJQ nuk lejohen të shesin ose të transferojnë veprimtarinë e vet, të bashkojnë, të ndajnë ose të ndryshojnë në ndonjë mënyrë strukturën, misionin ose pronësinë e tij, përveç në përputhje me dispozitat për likuidim vullnetar dhe likuidim të detyruar ose administrim, siç parashihet me këtë ligj dhe me miratimin me shkrim të BQK-së.

Për sa i përket zbatimit të ligjeve në fjalë, Gjykata Kushtetuese iu referua parimit *Lex specialis derogat legi generali* dhe, në ndërlidhje me këtë, vuri në dukje se Ligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare kishte karakter të përgjithshëm që rregullon sektorin bankar dhe financiar, ndërsa Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ rregullon në mënyrë specifike të drejtat dhe detyrat

e OJQ-ve. Gjykata Kushtetuese iu referua pretendimit të parashtruesit se lejimi që një institucion mikrofinanciar OJQ të shndërrohej në një institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare, nuk ishte në përputhje me ligjin e zbatueshëm në Kosovë dhe me parimet ndërkombëtare të ligjit jofitimprurës. Kjo sepse Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ nuk lejonte që një OJQ të shndërrohej në një entitet tjetër juridik dhe se ai Ligj ishte ligji i vetëm në Kosovë që rregullonte themelimin dhe funksionimin e OJQ-ve.

Në këtë sfond, në vijë me parimin e sigurisë juridike, Gjykata Kushtetuese theksoi detyrimin për të zbatuar ligjet në mënyrë uniforme dhe ky detyrim kushtetues cenohet duke nxjerrë dispozita të reja ligjore që ndërhyjnë në zbatimin e ligjit për OJQ, pa e ndryshuar këtë të fundit. Më tutje, Gjykata Kushtetuese, duke u ndërlidhur me pretendimin e parashtruesit lidhur me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], vuri në pah se pasuritë që janë pronë e OJQ-ve mund të shfrytëzohen vetëm në funksion të përmbushjes së qëllimeve dhe të objektivave mbi të cilat janë themeluar OJQ-të në përputhje me parimin e shpërndarjes jofitimprurëse. Prandaj, transferimi i pronësisë mbi pasuritë e OJQ-ve për çdo person fizik apo juridik do të jetë kundër këtij parimi. Ndërsa për sa i përket pretendimeve për cenimin e nenit 10 të Kushtetutës [Ekonomia], Gjykata theksoi se OJQ-të mikrofinanciare rrisin fondet e tyre dhe rrisin pasuritë e tyre kryesisht nëpërmjet marrjes së granteve nga donatorët, qoftë nga brenda apo nga jashtë vendit. Duke qenë se ato nuk janë të detyruara të paguajnë tatime, nga transformimi prej një OJQ-je në një shoqëri aksionare, kjo i vë në disavantazh komercial institucionet e tjera që paguajnë rregullisht tatime, në përputhje me ligjet në fuqi.

Përveç pretendimeve për papajtueshmëri me Kushtetutën të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, parashtruesi gjatë seancës dëgjimore kishte ngritur pretendime edhe lidhur me jokushtetutshmërinë e procedurës për miratimin e Ligjit në fjalë (lidhur me kuorumin e nevojshëm për nxjerrjen e Ligjit). Por, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje kushtetuese vetëm lidhur me përmbajtjen e Ligjit, jo për procedurën e ndjekur në Kuvend për nxjerrjen dhe shpalljen e tij.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, vendosi njëzëri ta shpallë kërkesën të pranueshme dhe, me shumicë votash, të shpallë se nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, nuk ishin në përputhje me nenin 10 [Ekonomia], me nenin 44 [Liria e Asociimit] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash, vendosi që nenet: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, t'i shpallë të pavlefshme.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. MAGYAR KERESZTÉNY MENNONITA EGYHÁZ DHE TË TJERËT kundër HUNGARISË

**[70945/11, 23611/12, 26998/12, 41150/12, 41155/12, 41463/12,
41553/12, 54977/12 dhe 56581/12]**

GJEDNJ [Seksioni i Dytë]

8 prill 2014

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Kishave kërkuese (bashkësitë fetare dhe individët anëtarë të këtyre bashkësive) u kërkohet të reregjistrohen për statusin e inkorporimit në mënyrë që të rifitojnë përfitime materiale nga shteti; bashkësitë fetare, klerikë dhe anëtarë të bashkësive fetare pretendonin se kërkesa për reregjistrim dhe çregjistrimi i tyre bazuar në ligjin e ri përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas neneve 9 dhe 11.

Faktet kryesore

Kërkuesit janë bashkësi fetare dhe individë. Kërkesa nr. 70945/11 - Magyar Keresztény Mennonita Egyház është një komunitet fetar aktiv

në Hungari që nga viti 1998. Z. J. Izsák-Bács është një shtetas hungarez i cili ka lindur më 1959 dhe jeton në Budapest. Kërkesa nr. 23611/12 - Evangéliumi Szolnoki Gyülekezet Egyház është një komunitet fetar aktiv në Hungari që nga viti 1998. Z. P.J. Soós është një shtetas hungarez i cili ka lindur më 1954 dhe jeton në Budapest. Kërkesa nr. 26998/12 - Budapesti Autonóm Gyülekezet është një komunitet fetar aktiv në Hungari që nga viti 1998. Z. T. Görbicz është një shtetas hungarez i cili ka lindur në vitin 1963 dhe jeton në Budapest. Kërkesa nr. 41150/12 - Szim Salom Egyház është një komunitet fetar aktiv në Hungari që nga viti 2004. Z. G.G. Guba është një shtetas hungarez, i lindur në 1975 dhe jeton në Budapest. Kërkesa nr. 41155/12 - Reforma Magyar Zsidó Hitközségek Szövetsége Egyház është një komunitet fetar aktiv në Hungari që nga viti 2007. Zonja L.M. Bruck është një shtetase hungareze e lindur në vitin 1931 dhe jeton në Budapest. Kërkesa nr. 41463/12 - Bashkimi Evropian për Judaizmin Progressiv është një shoqatë fetare me seli në Londër. Ajo vepron si një organizatë ombrellë për kongregacionet progresive judaiste në Evropë. Szim Salom Egyház (shih Kërkesën nr. 41150/12) dhe Reforma Magyar Zsidó Hitközségek Szövetsége Egyház (shih Kërkesën nr. 41155/12) u përkasin anëtarëve të saj. Kërkesa nr. 54977/12 - Magyarországi Evangéliumi Testvérközösség është një komunitet fetar aktiv në Hungari që nga viti 1981. Kërkesa nr. 56581/12 Magyarországi Biblia Szól Egyház është një komunitet fetar aktiv në Hungari për më shumë se 20 vjet. Kërkesa nr. 41553/12 - ANKH Az Örök Élet Egyháza dhe 8 të tjerë, parashtruesit në këtë rast (Ankh Az Orok Elet Egyháza, Árpád Rendjének Jögalapja Tradicionális Egyház, Dharmaling Magyarország Buddhista Egyház, i trageteve Gyermekei Magyar Esszénus Egyház, Mantra MAGYARORSZAGI Buddhista Egyháza, Szangye Menlai Gedün A Gyógyító Buddha Közössége Egyház, Univerzum Egyháza, Usui Szellemi School Közösség Egyház, Út és Erény Közössége Egyház) janë komunitete fetare aktive në Hungari përkatësisht që nga viti 1999, 2008, 2005, 2001, 2007, 1992, 1998, 2008 dhe 2007 (Parashtruesit janë bashkësi fetare ose ministra ose anëtarë të komuniteteve të tyre).

Rrethanat e veçanta të rasteve aktuale

Më 30 dhjetor 2011 Kuvendi Hungarez miratoi Ligjin nr. Akti CCVI i 2011 mbi të Drejtën për Lirinë e Ndërgjegjes dhe Fesë dhe Statusin Ligjor të Kishave, Besimeve dhe Bashkësive Fetare. Ligji ka hyrë në fuqi

më 1 janar 2012. Përveç kishave të njohura të renditura në Shtojcën e Aktit, të gjitha bashkësitë e tjera fetare, të regjistruara më parë si kisha, humbën statusin e tyre si kisha dhe mund të vazhdonin aktivitetet e tyre si shoqata. Ligji parashikonte se nëse synojnë të vazhdojnë si kisha, komunitetet fetare duhet të aplikojnë në Parlament për njohje individuale si të tilla. Kërkuesit nuk u reregjistruan dhe për rrjedhojë humbën statusin e tyre si kisha, së bashku me subvencionet shtetërore që u ishin dhënë atyre si të tilla.

Sipas Aktit të Kishës të vitit 2011, i cili u miratua me synimin për të adresuar problemet që lidhen me shfrytëzimin e fondeve shtetërore nga kisha të caktuara, sistemi i njohjes së kishës u vendos në dy nivele. Një numër kishash konsideroheshin të inkuorpuara dhe kështu kishin të drejtë të vazhdojnë, duke gëzuar disa avantazhe monetare dhe fiskale nga shteti për kryerjen e veprimtarive të lidhura me besimin.

Kishat kërkuese, të cilat para miratimit të Aktit të 2011 ishin regjistruar si kisha dhe merrnin financime nga shteti, nuk ishin përfshirë ndër kishat që trajtohen automatikisht si të inkuorpuara. Pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, shoqatat apo bashkësitë fetare si p.sh kërkuesit mund të vazhdonin të funksionojnë si kisha dhe t'i referohen vetes si kisha vetëm duke u regjistruar nëse dëshironin të rifitonin qasjen në përparësitë dhe përfitimet monetare. Nëse një kishë e caktuar mund të ishte apo jo e inkuorpuar, varej nga numri i anëtarëve dhe nga kohëzgjatja e ekzistencës si dhe nga dëshmi se nuk përbënte rrezik për demokracinë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit, bashkësitë fetare, klerikë dhe anëtarë të bashkësive fetare pretendonin se kërkesa për reregjistrim dhe çregjistrimi i tyre bazuar në ligjin e ri përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas neneve 9 dhe 11. Ndërhyrja në fjalë bazohej në Ligjin e 2011 dhe kishte si qëllim legjitim parandalimin e abuzimit me përfitimin financiar të akorduar nga shteti nga subjekte të cilat pretendonin se ishin të përfshira në aktivitete religjioze dhe të besimit. Gjykata vlerësoi nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të nenit 11 (i lexuar në dritën e nenit 9), Gjykata vërejtë se çregjistrimi i kishave parashtruese përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas neneve 9 dhe 11. Ndërhyrja në fjalë bazohej në Ligjin e vitit 2011 dhe kishte si qëllim legjitim parandalimin e abuzimit me përfitimin financiar të akorduar nga shteti nga subjekte të cilat pretendonin se ishin të përfshira në aktivitete. Gjykata vlerësoi nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Nuk ka asnjë të drejtë në bazë të nenit 11 lexuar në lidhje me nenin 9 për sa i përket marrjes së një statusi të veçantë ligjor nga ana e organizatave fetare. Shtetet duhet vetëm të sigurojnë që komunitetet fetare të kenë mundësinë e marrjes së zotësisë juridike, si subjekte të së drejtës civile. Megjithatë, Gjykata nuk mund të mos e vinte re rrezikun që pasuesit e një feje të ndjeheshin thjesht të toleruar - por jo të mirëpritur - nëse shteti refuzonte ta njihë dhe ta mbështeste organizimin e tyre fetar, ndërkohë që nuk vepronte kështu me besimet e tjera. Një situatë e tillë e perceptuar inferioriteti kishte të bënte me lirinë për të shfaqur fenë. Për më tepër, Qeveria nuk kishte demonstruar se nuk ekzistonin zgjidhje më pak drastike se ato të ndërmarra, të tilla si kontrolli gjyqësor ose shpërbërja e kishave që rezultojnë të jenë të një karakteri abuziv, për problemin e perceptuar nga autoritetet. Rezultati i legjislacionit të kundërshtuar ishte privimi i kishave ekzistuese nga korniza e tyre ligjore dhe, në disa raste, pasojat ishin me ndikim të gjerë në aspektin material dhe në drejtim të reputacionit të tyre. Për sa i përket sistemit të njohjes së kishave në dy nivele, Gjykata ishte e bindur se një skemë e tillë mund *per se* të binte brenda hapësirës së vlerësimit të shteteve dhe çdo skemë e tillë normalisht u takonte traditave historike dhe kushtetuese të atyre vendeve. Megjithatë, Qeveria nuk kishte paraqitur prova bindëse për të treguar se lista e kishave të njohura sipas Ligjit të Kishës të 2011, reflektonte plotësisht traditën historike hungareze. Refuzimi i regjistrimit për faktin se nuk ishin paraqitur informacionet e nevojshme në lidhje me parimet themelore të një feje mund të justifikohet në rrethana të veçanta, kur është e nevojshme të përcaktohet nëse komuniteti fetar që kërkon njohjen paraqet rrezikshmëri për shoqërinë demokratike në përgjithësi dhe parimet e demokracisë. Gjithsesi, kërkuesit operonin ligjërisht prej disa vjetësh në Hungari si komunitete fetare dhe nuk ishin paraqitur dëshmi para Gjykatës se gjatë asaj kohe autoritetet kishin

nisur procedura që kundërshtonin ekzistencën e kërkuesve apo të veprimtarisë së tyre fetare dhe religjioze, veçanërisht me arsyetimin se ata po operonin në mënyrë të paligjshme apo abuzive. Prandaj, arsyet se përse këtyre komuniteteve u ishte kërkuar të reregjistrohen duhet të ishin madhore dhe detyruese.

Është e vërtetë se liria për të shfaqur fenë ose bindjet, nuk u jep komuniteteve kërkuese apo pjesëtarëve të tyre të drejtën për të siguruar fonde shtesë nga buxheti i shtetit. Megjithatë, privilegjet e fituara nga komunitetet fetare, lehtësojnë arritjen e qëllimeve të tyre fetare dhe, për këtë arsye, autoritetet shtetërore detyrohen të qëndrojnë neutrale kur është fjala për dhënien e këtyre përfitimeve. Kur shteti ka vendosur vullnetarisht t'ua njohë komuniteteve fetare të drejtën e marrjes së subvencioneve apo përfitimeve të tjera, ai nuk mund të marrë masat diskriminuese në dhënien e këtyre përfitimeve. Për më tepër, shtetet kishin liri të konsiderueshme në zgjedhjen e formave të bashkëpunimit me bashkësitë fetare, duke përfshirë mundësinë e rikonceptimit të këtyre privilegjeve me masa legjislative. Megjithatë, detyrimi i neutralitetit të shtetit kërkon që zgjedhja e partnerëve të bazohet në kritere të përcaktueshme për të parandaluar situatat në të cilat pasuesit e një komuniteti fetar ndjehen qytetarë të dorës së dytë (për arsye fetare), për shkak të pozitës më pak të favorshme të komunitetit të tyre në raport me shtetin. Në rastin në fjalë, heqja e përfitimeve kishte prekur vetëm komunitete të caktuara, përfshirë parashtruesit.

Gjykata nuk gjeti asnjë dëshmi që të tregonte se kërkuesit ishin penguar të praktikojnë fenë e tyre si persona juridikë. Megjithatë, në bazë të legjislacionit në fuqi, disa aktivitete fetare të kryera nga kishat nuk ishin në dispozicion të shoqatave fetare, një faktor i cili kishte një ndikim në të drejtën e këtyre të fundit për lirinë e organizimit fetar. Për këtë arsye, një diferencim i tillë nuk i përmbushte kërkesat e neutralitetit të shtetit dhe, ishte i pabazuar objektivisht.

Gjykata arriti në përfundimin se, me heqjen e statusit të kishës kërkuesve nëpërmjet një procedure reregjistrimi politikisht të ndikueshme dhe, me arsye të cilat lëjnë shteg për dyshime (në vend që të zbatoheshin masa më pak të rrepta) dhe si rrjedhim, në trajtimin e ndryshëm të kërkuesve krahasuar me kishat e njohura të inkorporuara, jo vetëm në

lidhje me mundësitë e bashkëpunimit, por edhe në lidhje me të drejtën për përfitime për qëllime të aktiviteteve fetare, autoritetet nuk e kishin respektuar detyrimin e tyre për të qenë neutral *vis-à-vis* komuniteteve kërkuese. Këto elemente, të marra veçmas dhe së bashku, ishin të mjaftueshme për Gjykatën për të vendosur se masa e kundërshtuar nuk korrespondonte me një “nevojë të ngutshme shoqërore” (pressing social need).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht vendosi t’i bashkojë kërkesat, dhe njëzëri konstatoi se kërkesën nr. 41463/12 e sheh të papranueshme; bashkoi kundërshtimin e Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike me themelin e çështjes dhe e rrëzoi atë, njëzëri; deklaroi, njëzëri, të pranueshme ankesat e mbetura të kërkuësve sipas nenit 11 në dritën e nenit 9, të lexuara vetëm dhe në lidhje me nenin 14, si dhe ankesat sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, të lexuara vetëm dhe në lidhje me nenin 14; deklaroi, njëzëri, të papranueshme ankesat e mbetura të kërkuësve sipas nenit 13 të Konventës; konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 11 të lexuar në dritën e nenit 9 të Konventës; konstatoi se nuk ka nevojë të shqyrtohen veçmas ankesat sipas nenit 14 në lidhje me nenin 11 dhe 9 të Konventës; konstatoi se nuk ka nevojë të shqyrtohen veçmas ankesat sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, të lexuara vetëm ose në lidhje me nenin 14 të Konventës; vendosi se nuk ka nevojë të shqyrtohet veçmas pranueshmëria ose themeli i ankesave sipas nenit 6.1 të Konventës; konstatoi se konstatimi i një shkeljeje përbën shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me dëmin jomaterial të pësuar nga Izsák-Bács (nr. 70945/11), Soós (nr. 23611/12), Görbicz (nr. 26998/12), Guba (nr. 41150/12) dhe Bruck (nr. 41155/12).

2.2. REFAH PARTISI (PARTIA E MIRËQENIES) DHE TË TJERËT kundër TURQISË

[41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

13 shkurt 2003

Çështja kyçe /e drejta e pretenduar: ankesa se shpërbërja e partisë politike dhe ndalimi i liderëve të saj nga mbajtja e posteve të ngjashme në ndonjë parti tjetër politike kishte cenuar të drejtën e tyre për lirinë e organizimit, të garantuar nga neni 11; pasojat e shpërbërjes së partisë politike përkatësisht konfiskimi i aseteve dhe transferimi i tyre në Thesar, si dhe ndalimi i liderëve të marrin pjesë në zgjedhje, ishin në shkelje të neneve 1 dhe 3 të Protokollit nr. 1

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga një parti politike e regjistruar sipas ligjit turk, Refah Partisi (Partia e Mirëqenies (kërkuesi i parë) dhe tre shtetas turq, Necmettin Erbakan, Şevket Kazan dhe Ahmet Tekdal (kërkuesit) kundër Republikës së Turqisë, më 22 maj 1998. Kërkuesi i parë, Refah Partisi (Partia e Mirëqenies) ishte një parti politike, ndërsa kërkuesit e tjerë ishin liderë të kësaj partie dhe anëtarë të parlamentit.

Partia mori 16,88% të votave në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1991 dhe 22% të votave në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1995, kur u bë partia më e madhe në Parlament. Më pas, ajo formoi një qeveri koalicioni me Partinë Rruga e Vërtetë (*Doğru Yol*). Më 1997 Këshilltari i Parë Shtetëror pranë Gjykatës së Kasacionit filloi procedurat pranë Gjykatës Kushtetuese për shpërndarjen e Refah Partisi, të cilën ai e akuzonte se ishte bërë “një qendër aktiviteteve të drejtuara kundër parimit të laicitetit”. Në mbështetje të kërkesës së tij, ai u bazua në akte dhe deklarata të ndryshme të udhëheqësve dhe anëtarëve të Refah-ut, të cilat sipas tij nxirrnin në pah se disa prej objektivave të partisë, të tilla si futja e shariatit dhe e një regjimi teokratik, të cilat ishin të papajtueshme me kërkesat e një shoqërie demokratike. Këto pretendime u kundërshtuan nga përfaqësuesit e Refah-ut. Më 1998 Gjykata Kushtetuese vendosi që

Refah Partisi të shpërndahej duke argumentuar që ajo ishte bërë një “qendër aktiviteteve kundër parimit të laicitetit”. Ajo deklaroi gjithashtu që pasuritë e partisë t’i kalonin thesarit. Gjykata Kushtetuese vendosi në vijim se deklaratat publike të udhëheqësve të Refah-ut kishin çuar drejtpërdrejt në lindjen e përgjegjësive së kësaj të fundit në lidhje me kushtetutshmërinë e aktiviteteve të saj. Për pasojë, ajo i ndaloi ata që të merrnin pjesë në punimet e Parlamentit ose të mbanin poste politike për një periudhë prej pesë vjetësh.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretenduan se shpërbërja e Refah-ut dhe ndalimi i liderëve të tij – duke përfshirë z. Erbakan, z. Yılmaz dhe z. Tekdal – nga mbajtja e posteve të ngjashme në ndonjë parti tjetër politike kishte cenuar të drejtën e tyre për lirinë e organizimit, të garantuar nga neni 11. Ata pohuan se kriteret e aplikuar nga Gjykata Kushtetuese për të vërtetuar se Refah ishte bërë qendër e aktiviteteve antikushtetuese, ishin më të gjera se ato të përcaktuara me Ligjin për rregullimin e partive politike, dispozitat përkatëse të të cilit ishin shfuqizuar në të njëjtën ditë me shpërbërjen e Refahut. Përveç këtyre pikave të ligjit të brendshëm, kërkuesit nuk e kundërshtuan ligjshmërinë e procedurës së shpërbërjes sipas ligjit turk, pasi mundësia e shpërbërjes parashikohej në Kushtetutë. Kërkuesit parashtruan se liria e shprehjes e tre kërkuesve, përveç Refah, ishte cenuar nga humbja e statusit të deputetit për shkak të vërejtjeve që kishin shkaktuar shpërbërjen e Refah-ut.

Kërkuesit pretenduan shkeljen e neneve 9, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës. Ata parashtruan më tej se pasojat e shpërbërjes së Refah-ut, përkatësisht konfiskimi i aseteve të tij dhe transferimi i tyre në Thesar, si dhe ndalimi i liderëve të tij nga pjesëmarrja në zgjedhje, ishin në shkelje të neneve 1 dhe 3 të Protokollit nr. 1

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 11, Gjykata theksoi se shpërbërja përbënte ndërhyrje në lirinë e organizimit. Sa i përket faktit nëse shpërbërja parashikohej me ligj, nuk diskutohet se aktivitetet në kundërshtim me parimet e barazisë dhe të respektit për republikën demokratike laike

ishin jokushtetuese ose se Gjykata Kushtetuese kishte juridiksionin e vetëm për të shpërbërë një parti që ishte qendër e aktiviteteve të tilla. Edhe pse kishte lindur një divergjencë ndërmjet Ligjit për rregullimin e partive politike dhe Kushtetutës, Kushtetuta kishte përparësi ndaj ligjit dhe, qartësisht nga Gjykata Kushtetuese kërkohej që t'u jepte përparësi dispozitave të Kushtetutës. Për më tepër, Refah ishte një parti e madhe politike, e cila kishte këshilltarë ligjorë që njihnin ligjin kushtetues dhe rregullat që rregullonin partitë politike, ndërsa kërkuesit e tjerë ishin politikanë me përvojë dhe dy prej tyre ishin gjithashtu avokatë. Në këto rrethana, kërkuesit në mënyrë të arsyeshme ishin në gjendje të parashikonin shpërbërjen e partisë, nëse drejtuesit e saj do të angazhoheshin në aktivitete antisekulare. Për më tepër, duke marrë parasysh rëndësinë e parimit të laicizmit për sistemin demokratik në Turqi, shpërbërja e Refah-ut ndoqi qëllimet legjitime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, parandalimin e çrregullimeve ose krimit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Për sa i përket domosdoshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata vlerësoi (i) nëse kishte prova të besueshme se rreziku për demokracinë ishte i afërt, (ii) nëse aktet dhe deklaratat e liderëve dhe anëtarëve të partisë i ngarkoheshin partisë në tërësi, dhe (iii) nëse aktet dhe deklaratat që i atribuohen partisë formonin një tërësi, e cila jepte një pamje të qartë të një modeli shoqërie të mbrojtur nga partia, i cili ishte i papajtueshëm me një “shoqëri demokratike”.

Në vlerësim të (a) nevojës urgjente shoqërore (pressing social need) – në funksion të rezultateve të saj zgjedhore, partia kishte në kohën e shpërbërjes së saj potencialin real për të arritur pushtetin politik, pa u kufizuar nga kompromiset e qenësishme të një koalicioni. Për më tepër, edhe pse deklaratat ishin bërë disa vite më parë, gjykatat mund të merrnin në mënyrë legjitime në konsideratë ecurinë me kalimin e kohës të rrezikut real që përfaqësonin aktivitetet e partisë. Programi dhe politikat e një partie mund të bëhen të qarta nëpërmjet akumulimit të akteve dhe fjalimeve për një periudhë relativisht të gjatë dhe partia me kalimin e viteve mund të rrisë shanset e saj për të fituar pushtet politik dhe për të zbatuar politikat e saj. Ndërsa politikat e Refah ishin të rrezikshme për të drejtat dhe liritë e Konventës, shanset reale për zbatimin e këtyre politikave e bënë atë rrezik më të prekshëm dhe më të menjëhershëm, në mënyrë që gjykatat të mos mund të kritikoheshin

se nuk vepruan më herët. Sa i përket mundësisë së akteve dhe fjalimeve të anëtarëve të saj në Refah, partia nuk kishte propozuar ndryshimin e rregullimeve kushtetuese të Turqisë në një mënyrë që bie ndesh me demokracinë as në kushtetutën e saj, as në programin e saj të koalicionit. Shpërbërja iu referua më tepër deklaratave të bëra nga disa figura kryesore. Deklaratat e bëra nga tre kërkuesit mund t'i atribuohen në mënyrë të pakontestueshme Refah-ut, meqenëse komentet e zyrtarëve mbi çështjet politike i ngarkohen partisë që ata përfaqësojnë, përveç nëse tregohet ndryshe. Për më tepër, për aq sa aktet dhe fjalimet e anëtarëve të tjerë në postet e zgjedhura formonin një tërësi, që zbulonte synimet dhe qëllimet e partisë dhe projektonte një imazh të shoqërisë që donte të krijonte, këto mund t'i ngarkoheshin edhe Refahut. Së fundi, Refah i kishte paraqitur ata që kishin bërë deklaratat të tilla si kandidatë për poste të rëndësishme dhe nuk kishin marrë asnjë masë disiplinore ndaj tyre, përpara se të fillonte procedura e shpërbërjes. Në lidhje me arsyet kryesore për shpërbërjen, këto mund të klasifikohen në tri grupe kryesore:

(i) një pluralitet sistemesh juridike nuk mund të konsiderohet i pajtueshëm me sistemin e Konventës, pasi ai do të prezantonte një dallim midis individëve bazuar në fenë dhe kështu, së pari, do të hiqte rolin e shtetit si garantues të paanshëm të të drejtave dhe lirive individuale, dhe, së dyti, krijon një diskriminim të papranueshëm;

ii) për sa i përket zbatimit të shariatit brenda kontekstit të një pluraliteti të tillë sistemesh, të propozuara në mënyrë eksplicite në disa nga deklaratat e përmendura, Gjykata pranoi përfundimin e Gjykatës Kushtetuese se, këto deklaratat përbënin një tërësi dhe ato dhanë një pamje të qartë të një modeli të propozuar. Sheriati është i papajtueshëm me parimet themelore të demokracisë, pasi parime të tilla si pluralizmi në sferën politike dhe evoluimi i vazhdueshëm i lirive publike nuk kanë vend në të, dhe një regjim i bazuar në shariat dallon qartë nga vlerat e Konventës; Shtetet kontraktuese mund të kundërshtojnë lëvizjet politike të bazuara në fundamentalizmin fetar në dritën e përvojës së tyre historike, dhe duke marrë parasysh rëndësinë e parimit të laicizmit në Turqi, Gjykata Kushtetuese me të drejtë konsideroi se politika e Refah-ut për vendosjen e shariatit ishte e papajtueshme me demokracinë;

(iii) për sa i përket marrëdhënies ndërmjet shariatit dhe pluralitetit të sistemeve juridike, politika e Refah-ut ishte të zbatonte disa nga rregullat e ligjit privat të shariatit ndaj popullatës muslimane në kuadrin e një pluraliteti të sistemeve juridike; megjithatë, një politikë e tillë shkon përtej lirisë së individëve për të respektuar parimet e fesë së tyre dhe bie jashtë sferës private, në të cilën Turqia e kufizon fenë, duke vuajtur kështu nga të njëjtat kontradikta me sistemin e Konventës si futja e shariatit; liria e fesë, duke përfshirë lirinë e manifestimit të fesë, është kryesisht një çështje e ndërgjegjes individuale dhe sfera e ndërgjegjes individuale është krejt e ndryshme nga fusha e së drejtës private, e cila ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e shoqërisë – nuk ishte diskutuar se në Turqi çdokush mund të respektojë në jetën e tij private kërkesat e fesë së tij, por nga ana tjetër, çdo shtet mund të parandalojë ligjërisht zbatimin brenda juridiksionit të tij të rregullave të së drejtës private të frymëzimit fetar që dëmtojnë rendin publik dhe vlerat e demokracisë;

(iv) për sa i përket mundësisë së përdorimit të forcës, çfarëdo kuptimi që i jepet “xhihadit”, kishte paqartësi në terminologjinë e përdorur për t’iu referuar metodës që do të përdorej për të fituar pushtetin politik dhe në të gjitha fjalimet e referuara nga Gjykata Kushtetuese përmendej mundësia për përdorimin “legjitim” të forcës; Për më tepër, liderët nuk kishin ndërmarrë hapa të menjëhershëm për t’u distancuar nga anëtarët që kishin miratuar publikisht përdorimin e forcës.

Si përfundim, duke pasur parasysh faktin se planet e Refah-ut ishin të papajtueshme me konceptin e një “shoqërie demokratike” dhe mundësive reale që ajo kishte për t’i zbatuar ato në praktikë, vendimi (shpërbërja e partisë) nga Gjykata Kushtetuese mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme se ka përmbushur një “nevojë urgjente shoqërore”.

(b) proporcionaliteti – Anëtarët e tjerë të Parlamentit nga Refah qëndruan në detyrë dhe, për shkak të vlerës së ulët të aseteve të tij, transferimi në Thesar nuk kishte asnjë ndikim në proporcionalitetin. Për më tepër, ndalimi i vendosur ndaj parashtruesve individualë ishte i përkohshëm. Prandaj, ndërhyrja nuk ishte joproporcionale.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës; konstatoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohen veçmas ankesat sipas neneve 9, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës dhe neneve 1 dhe 3 të Protokollit nr. 1.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështja C-78/18

18 qershor 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=227569&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13715411>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Kufizimet e vendosura nga Hungaria për financimin e organizatave civile nga persona të vendosur jashtë atij shteti anëtar nuk janë në përputhje me ligjin e BE-së.*

Faktet kryesore

Në vitin 2017, Hungaria miratoi një ligj që synonte të siguronte transparencën e organizatave civile që merrnin donacione nga jashtë (në tekstin e mëtejme: “Ligji i Transparencës”¹⁹⁵). Sipas kushteve të këtij ligji, këto organizata duhet të regjistrohen në gjykatat hungareze si “organizata që marrin ndihmë nga jashtë”, kur sasia e donacioneve që ata kanë marrë nga shtetet e tjera anëtare ose nga vende të treta gjatë një viti, tejkalon

195 Ligji nr. LXXVI i vitit 2017 mbi transparencën e organizatave që marrin ndihmë nga jashtë.

një prag të caktuar. Kur regjistrohen, ata gjithashtu duhet të tregojnë, në veçanti, emrat e donatorëve ndihma e të cilëve ka arritur ose tejkaluar shumën prej 500,000 forintë hungarezë (afërsisht 1,400 euro) dhe shumën e saktë të ndihmës. Ky informacion publikohet më pas në një platformë elektronike publike të qasshme pa pagesë. Përveç kësaj, organizatat civile përkatëse duhet të deklarojnë, në faqen e tyre në Internet dhe në të gjitha botimet, se ato janë një “organizatë që merr ndihmë nga jashtë”.

Më 14 korrik 2017, Komisioni i dërgoi Hungarisë një letër zyrtare në të cilën vlerësonte se, duke miratuar Ligjin për Transparencën, ai shtet anëtar kishte shkelur detyrimet e tij sipas nenit 63 të TFBE-së si dhe nenet 7, 8 dhe 12 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: “Karta”), dhe i dha një periudhë prej një muaji për të paraqitur vëzhgimet e saj.

Më 17 korrik 2017, Hungaria kërkoi një zgjatje të atij afati, të cilin Komisioni e refuzoi. Më 14 gusht dhe 7 shtator 2017, Hungaria i dërgoi Komisionit dy grupe vëzhgimesh në lidhje me letrën zyrtare, duke kundërshtuar themelin e pretendimeve të Komisionit.

Më 5 tetor 2017, Komisioni dha një opinion të arsyetuar, në të cilin ai vlerësonte se Hungaria nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 63 të TFBE-së, si dhe neneve 7, 8 dhe 12 të Kartës, duke miratuar kufizime diskriminuese, të pajustificuara dhe të panevojshme për donacionet e huaja të dhëna organizatave të shoqërisë civile përmes dispozitave të Ligjit të Transparencës, të cilat vendosin detyrime për “regjistrimin, deklarimin dhe bërjen publike për kategori të caktuara të organizatave të shoqërisë civile që përfitojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi ndihma të huaja përtej një pragu të caktuar, dhe të cilat parashikojnë mundësinë e vendosjes së sanksioneve ndaj organizatave që nuk i përmbushin këto detyrime. Komisioni gjithashtu i dha Hungarisë një muaj për të marrë masat e nevojshme për të qenë në përputhje me opinionin e arsyetuar ose për të paraqitur vërejtje.

Më 12 tetor 2017, Hungaria kërkoi një zgjatje të atij afati, të cilin Komisioni e refuzoi. Më 5 dhjetor 2017, Hungaria i dërgoi Komisionit vëzhgimet e saj në lidhje me opinionin e arsyetuar, duke kundërshtuar themelin e pretendimeve të përfshira në të.

Duke mos qenë i bindur nga këto vëzhgime, më 7 dhjetor 2017 Komisioni vendosi të paraqesë një padi para Gjykatës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se, duke imponuar detyrime regjistrimi, deklarimi dhe publikimi për kategori të caktuara të organizatave të shoqërisë civile që përfitojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi ndihma të huaja përtej një pragu të caktuar dhe duke parashikuar mundësinë e vendosjes së sanksioneve kundër organizatave që nuk respektojnë këto detyrime, Hungaria kishte vendosur kufizime diskriminuese dhe të pajustificuara si ndaj organizatave në fjalë, ashtu edhe ndaj personave që u jepnin atyre një ndihmë të tillë. Këto kufizime shkelin detyrimet që kanë shtetet anëtare në përputhje me lirinë e lëvizjes së kapitalit, të përcaktuara në nenin 63 të TFBE-së si dhe nenet 7, 8 dhe 12 të Kartës, që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për lirinë e organizimit.

Përpara shqyrtimit të çështjes në themel, Gjykata, duke vendosur lidhur me kundërshtimet paraprake të ngritura nga Hungaria, kujtoi se fakti që Komisioni inicioi një procedurë paragjyqësore në afate të shkurtra nuk çon, sipas mendimit të saj, në papranueshmërinë e ankimit të mëvonshëm për shkelje. Një procedurë e tillë është e papranueshme vetëm në rast se sjellja e Komisionit e ka bërë më të vështirë për shtetin anëtar në fjalë që të hedhë poshtë pretendimet e atij institucioni dhe, kështu, ka shkelur të drejtat e mbrojtjes, gjë që nuk është vërtetuar në këtë rast.

Për sa i përket themelit, Gjykata vendosi, paraprakisht, se Hungaria nuk justifikohet në kritikën ndaj Komisionit për faktin se ky nuk kishte provuar efektet praktike të Ligjit për transparencën në lirinë e lëvizjes të garantuar në nenin 63 të TFBE-së. Në fakt, ekzistenca e një shkeljeje mund të vërtetohet, në rast se ajo e gjen origjinën në miratimin e një mase legislative ose rregullatore, ekzistenca dhe zbatimi i së cilës nuk kundërshtohen ligjërisht.

Më tej, duke shqyrtuar themelin e pretendimeve të Komisionit, Gjykata konstatoi, së pari, se transaksionet e mbuluara nga Ligji i Transparencës

bien brenda konceptit të “lëvizjes së kapitalit” sipas nenit 63.1 të TFBE-së dhe se ligji në fjalë përbën një masë kufizuese me natyrë diskriminuese. Në të vërtetë, ai krijon një dallim në trajtimin midis lëvizjeve kombëtare dhe ndërkufitare të kapitalit, i cili nuk mund të shpjegohet me ndonjë ndryshim objektiv midis situatave në fjalë dhe që është në gjendje të pengojë personat fizikë ose juridikë të vendosur në shtetet e tjera anëtare ose në vende të treta, për të ofruar ndihmë financiare për organizatat në fjalë. Në veçanti, Ligji për Transparencën është i zbatueshëm, në mënyrë të specifike dhe ekskluzive, për shoqatat dhe fondacionet që marrin ndihmë financiare nga shtetet e tjera anëtare ose vendet e treta, të cilat i veçon duke u kërkuar atyre të deklarohen, të regjistrohen dhe të tregohen publikisht me emrin “organizatë që merr ndihmë nga jashtë”, nën ndëshkimin e sanksioneve të cilat mund të shkojnë deri në shpërbërjen e tyre. Përveç kësaj, masat që Ligji parashikon ka të ngjarë të krijojnë një klimë mosbesimi ndaj këtyre shoqatave dhe fondacioneve. Zbulimi publik i informacionit në lidhje me personat e vendosur në shtetet e tjera anëtare ose në vendet e treta që ofrojnë ndihmë financiare për të njëjtat shoqata dhe fondacione, për më tepër, ka të ngjarë t’i pengojë ata nga ofrimi i një ndihme të tillë. Rrjedhimisht, detyrimet e regjistrimit, të deklarimit dhe të publikimit si dhe sanksionet e parashikuara nga Ligji i Transparencës, të marra së bashku, përbëjnë një kufizim në lëvizjen e lirë të kapitalit, të ndaluar nga neni 63 i TFBE-së.

Për sa i përket justifikimit të mundshëm të këtij kufizimi, Gjykata theksoi se objektivi i rritjes së transparencës së financimit të shoqatave mund të konsiderohet si një arsye e rëndësishme në interes publik. Në të vërtetë, disa organizata të shoqërisë civile, duke pasur parasysh qëllimet që ata ndjekin dhe mjetet në dispozicion të tyre, ka të ngjarë të kenë një ndikim të rëndësishëm në jetën publike dhe në debatin publik. Kjo mund të justifikojë që financimi i tyre t’u nënshtrohet masave që synojnë të sigurojnë transparencën e tyre, veçanërisht kur e ka origjinën nga vendet jashtë Bashkimit Evropian. Megjithatë, në rastin konkret, Hungaria nuk ka provuar pse objektivi i rritjes së transparencës së financimit të organizatave jofitimprurëse, të cilit i referohet, do të justifikonte masat konkrete të vendosura nga Ligji për Transparencën. Në veçanti, këto zbatohen pa dallim në lidhje me çdo ndihmë financiare të huaj që tejkalon një prag të caktuar dhe për të gjitha organizatat që

përfshihen në fushën e këtij ligji, në vend që të synojnë ato që kanë të ngjarë të kenë vërtet një ndikim të rëndësishëm në jetën publike dhe në debatin publik.

Për sa i përket arsyeve të politikës publike dhe të sigurisë publike të përmendura në nenin 65.1 (b) të TFBE-së, Gjykata kujtoi se arsye të tilla mund të ngrihen në një fushë të caktuar, për aq sa legjislativi i BE-së nuk ka harmonizuar plotësisht masat që synojnë sigurimin e mbrojtjes së tyre, dhe kur ato përfshijnë, në veçanti, luftën kundër pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimin të organizuar. Sidoqoftë, këto arsye janë të lejueshme vetëm në prani të një kërcënimi real, aktual dhe mjaft serioz që prek një interes themelor të shoqërisë. Megjithatë, në rastin konkret, Hungaria nuk ka paraqitur ndonjë argument që mund të vërtetojë, në mënyrë konkrete, një kërcënim të tillë. Përkundrazi, Ligji i Transparencës bazohet në një supozim parimor dhe pa dallim se çdo financim i huaj i organizatave civile do të ishte, në vetvete, i dyshuar.

Gjykata arriti në përfundimin se kufizimet që rrjedhin nga Ligji i Transparencës nuk ishin të justifikuar dhe, për këtë arsye, Hungaria kishte dështuar në detyrimet e saj sipas nenit 63 të TFBE-së.

Së dyti, Gjykata shqyrtoi nëse dispozitat e Ligjit të Transparencës ishin në përputhje me nenet 7, 8 dhe 12 të Kartës, me të cilat një masë kombëtare duhet të përputhet kur shteti anëtar, që e miraton këtë masë, synon të justifikojë kufizimin që ajo përfshin me një arsye kryesore në interes të përgjithshëm ose me një arsye të përmendur në TFBE.

Lidhur, para së gjithash, me të drejtën për lirinë e organizimit, të parashikuar në nenin 12.1 të Kartës, Gjykata theksoi se ajo përbën një nga bazat thelbësore të një shoqërie demokratike dhe pluraliste, pasi u lejon qytetarëve të veprojnë kolektivisht në fushat me interes të përbashkët dhe, në këtë mënyrë, kontribuojnë në funksionimin e duhur të jetës publike. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se masat e parashikuara nga Ligji i Transparencës e kufizuan këtë të drejtë pasi, në disa aspekte, ato e bënë shumë më të vështirë veprimin dhe funksionimin e shoqatave që i përkasin këtij ligji.

Për sa i përket të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, të mishëruar në nenin 7 të Kartës, Gjykata kujtoi se ky nen kërkonte nga

autoritetet publike të përmbaheshin nga çdo ndërhyrje e pajustificuar në jetën e njerëzve. Në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje se detyrimet e raportimit dhe të zbulimit të parashikuara nga Ligji i Transparencës e kufizuan këtë të drejtë. Lidhur me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale të mishëruara në nenin 8.1 të Kartës, e cila lidhet, në një masë të caktuar, me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, Gjykata kujtoi se kjo e drejtë nuk lejonte që informacioni që lidhet me personat fizikë të identifikuar ose të identifikueshëm, t'u jepet palëve të treta, qofshin ato autoritete publike ose publik i gjerë, përveç nëse kjo bëhet për shkak të trajtimit të drejtë që plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 8.2 të Kartës. Përveç kësaj hipoteze, një përcjellje e këtyre të dhënave, e cila përbën përpunimin e të dhënave personale, duhet të konsiderohet si një kufizim i së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të garantuara në nenin 8.1 të Kartës. Në këtë rast, megjithatë, Ligji i Transparencës parashikon zbulimin e të dhënave personale dhe Hungaria nuk ka argumentuar se ky përpunim plotëson kërkesat e lartpërmendura.

Duke iu kthyer, së fundi, çështjes së justifikimit të mundshëm të kufizimeve të bëra në të drejtat themelore, Gjykata vuri në dukje se dispozitat e Ligjit për Transparencën nuk mund të justifikohen, siç ishte e qartë nga analiza e kryer tashmë në dritën e TFBE-së, nga asnjë prej objektivave të interesit të përgjithshëm të referuara nga Hungaria.

3.2 FRONT NATIONAL kundër PARLAMENTIT EVROPIAN

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështja C-486/01 P

29 qershor 2004

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=49318&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13715609>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky vendim kishte të bënte me mënyrën e formimit të grupeve politike në gjirin e Parlamentit Evropian.

Faktet kryesore

Një grup deputetësh që rridhnin nga grupime politike të ndryshme më 19 korrik 1999 i bënë të ditur me një komunikim Presidentit të Parlamentit Evropian krijimin e një grupi të ri politik të quajtur “Grupi Teknik i Deputetëve të Pavarur (TDI) - Grup i Përzier” (në tekstin e mëtejshëm: “Grupi TDI”), qëllimi i deklaruar i të cilit ishte të siguronte që të gjithë anëtarët të mund të ushtrojnë plotësisht mandatin e tyre parlamentar. Pas këtij komunikimi, kryetarët e grupeve të tjera politike ngritën kundërshtime për krijimin e këtij grupi për shkak të mungesës së afiniteteve politike midis përbërësve të ndryshëm të tij. Si pasojë, duke u mbështetur në nenin 180.1 të Rregullores së Funkcionimit të Parlamentit, iu bë një kërkesë Komisionit për Çështjet Kushtetuese të Parlamentit për interpretimin e nenit 29.1 të kësaj Rregulloreje.

Kryetari i këtij Komisioni e njoftoi për interpretimin e kërkuar Presidentin e Parlamentit me letër të 28 korrikut 1999. Kjo letër specifikonte në veçanti sa vijon:

“Gjatë takimit të tij më 27 dhe 28 korrik 1999, Komisioni për Çështjet Kushtetuese shqyrtoi kërkesën për interpretim të nenit 29.1 të Rregullores së Funkcionimit, të kërkuar nga Konferenca e Kryetarëve në takimin e saj të 21 korrikut 1999.

Pas një shkëmbimi të thelluar të pikëpamjeve dhe me 15 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, Komisioni për Çështjet Kushtetuese interpretoi nenin 29.1 të Rregullores së Funkcionimit si më poshtë:

Deklarata e krijimit të Grupit TDI nuk përputhet me nenin 29.1 të Rregullores.

Në të vërtetë, deklarata e krijimit të këtij grupi, veçanërisht Aneksi 2 i letrës së krijimit, drejtuar Presidentit të Parlamentit Evropian, përjashton çdo afinitet politik. Ai i jep pavarësi të plotë politike brenda këtij grupi komponentëve të ndryshëm nënshkrues. Unë sugjeroj që të futni, si një shënim interpretues në nenin 29.1 të Rregullores, tekstin e mëposhtëm:

‘Krijimi i një grupi që mohon hapur çdo karakter politik dhe çdo afinitet politik midis anëtarëve të tij nuk mund të pranohet sipas kuptimit të këtij neni.’

[...] “

Përmbajtja e kësaj letre iu komunikua Parlamentit nga Presidenti i tij, gjatë seancës plenare të 13 shtatorit 1999. Pasi Grupi TDI kishte paraqitur, në bazë të nenit 180.4 të Rregullores, një kundërshtim ndaj shënimit interpretues të propozuar nga Komisioni për Çështjet Kushtetuese, ky shënim u hodh në votim në Parlament, i cili e miratoi atë, me shumicën e anëtarëve të tij, gjatë seancës plenare të 14 shtatorit 1999.

Duke pasur parasysh që, në këto rrethana, kjo votë ndikoi negativisht ndaj tij, Front National¹⁹⁶ ngriti një padi për anulimin e aktit të kundërshtuar me një ankesë të paraqitur në Regjistrin e Tribunalit më 19 nëntor 1999¹⁹⁷. Me kërkesat e paraqitura në sekretarinë e Gjykatës më 5 tetor, respektivisht më 22 nëntor 1999, dy ankesa që kishin të njëjtin objekt të lëndës u paraqitën gjithashtu nga MM. Martinez dhe de Gaulle¹⁹⁸, si dhe nga zonja Bonino, MM. Pannella, Cappato, Dell’Alba, Della Vedova, Dupuis, Turco dhe Lista Emma Bonino¹⁹⁹.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata kujtoi se kushti që një person fizik ose juridik duhet të jetë ‘drejtpërdrejt’ i cenuar nga vendimi i cili është objekt i një padie për anulim, siç përmendet në paragrafin e katërt të nenit 230 të KE, kërkon që masa e ankimuar e Komunitetit duhet të prodhojë efekte të drejtpërdrejta mbi situatën juridike të individit dhe se nuk i lë asnjë diskrecion atyre të cilëve iu drejtohet, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e saj, pasi kjo ka një karakter thjesht automatik dhe rezulton vetëm nga legjislacioni i Komunitetit pa ndërhyrjen e rregullave të tjera të ndërmjetme.

Një vendim i Parlamentit Evropian, në lidhje me interpretimin e nenit 29.1 të Rregullores së Funksionimit të këtij të fundit dhe shpërndarjen, me efekt prapaveprues, të «Grupit Teknik të Deputetëve të Pavarur (TDI) - Grup i Përzier» -, me të cilin ai i privoi deputetët që kishin

196 Fronti kombëtar, parti politike në Francë.

197 Çështja T-327/99.

198 Çështja T-222/99.

199 Çështja T-329/99.

deklaruar krijimin e grupit TDI dhe, në veçanti, deputetët e zgjedhur në listën e Front National, nga mundësia e krijimit, përmes grupit TDI, të një grupimi politik sipas kuptimit të nenit 29 të Rregullores së Funksionimit - prek drejtpërdrejt anëtarët në fjalë. Këta deputetë në fakt u penguan, nga fakti i vetëm i këtij akti, që të krijonin një grup politik dhe ata u konsideruan, që nga ai moment, si deputetë të paregjistruar sipas kuptimit të nenit 30 të së njëjtës Rregullore, duke përfituar, si rezultat, përparësi më të kufizuara parlamentare, si dhe më pak përparësi materiale dhe financiare sesa ato që do t'u ishin akorduar nëse do të kishin qenë anëtarë të një grupi politik brenda kuptimit të nenit 29 të përmendur.

Sidoqoftë, një përfundim i tillë nuk zbatohet kur bëhet fjalë për një parti politike kombëtare siç është Front National. Nëse është e natyrshme, në fakt, që një parti politike kombëtare, e cila paraqet kandidatë gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Parlamentit Evropian, të aspirojë që kandidatët e saj, sapo të jenë zgjedhur, të ushtrojnë mandatin e tyre në kushte të njëjta me ato të parlamentarëve të tjerë, ky interes nuk i jep asaj asnjë të drejtë që përfaqësuesit e saj të zgjedhur të formojnë grupin e tyre ose që ata të bëhen anëtarë të njërit prej grupeve që janë formuar brenda Parlamentit.

Nga njëra anë, sipas nenit 29.2 të Rregullores së Funksionimit, krijimi i një grupi politik në Parlamentin Evropian presupozon praninë e një numri minimal të deputetëve nga disa shtete anëtare dhe, nga ana tjetër, në çdo rast, paragrafi 1 i këtij neni i referohet vetëm perspektivës së një rigrupimi të deputetëve sipas përkatësisë politike. Këto dispozita nuk i japin ndonjë rol specifik partive politike kombëtare të cilave u përkasin këta deputetë në procesin e formimit të një grupi politik.

NENI 45

Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI207/19. PARASHTRUES: NISMA SOCIALDEMOKRATE, ALEANCA KOSOVA E RE DHE PARTIA E DREJTËSISË

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/ki_207_19_agj_shq.pdf]

5 janar 2021

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Çështja kushtetuese që ngërthente kjo kërkesë ishte nëse vendimet e Gjykatës Supreme sipas të cilave votat nga jashtë vendit duhet të numëroheshin, përkundër faktit që ato kishin arritur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pas afatit të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullën Zgjedhore, ishin në kundërshtim me nenet kushtetuese në vijim: nenin 7 [Vlerat]; nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; dhe nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes].*

Faktet kryesore

Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet parlamentare në Republikën e Kosovës. Më 17 tetor 2019, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kishte paraqitur ankesë në Panelin Zgjedhur për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), përmes së cilës kërkoi që të urdhërohet KQZ që t'i bartë në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) për numërim edhe 4639 pako me fletëvotime që kishin arritur me postë, por që nuk ishin numëruar dhe nuk ishin përfshirë në rezultatin përfundimtar zgjedhor. LVV kishte pretenduar pranë PZAP-it se mosnumërimi i këtyre pakove me vota që kishin arritur me postë paraqiste shkelje të nenit 45 të Kushtetutës, ngase pengonte realizimin e “vullnetit të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit”. Në të njëjtën ditë, KQZ kishte parashtruar përgjigje ndaj apelit të LVV-së. Më 19 tetor 2019, PZAP kishte shqyrtuar ankesën e lartcekur të LVV-së duke e hedhur poshtë atë si të palejuar. PZAP kishte qartësuar se nuk ishte në juridiksionin e PZAP-it të merrte vendim lidhur me këtë çështje në këtë fazë të procesit,

duke qenë se KQZ akoma nuk kishte marrë vendim, por vetëm kishte raportuar në aspekt të informimit në mbledhjen e saj të 12 tetorit 2019. Kundër vendimit të lartcekur të PZAP-it, LVV kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme. Më 25 tetor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.19/2019] e kishte pranuar si të bazuar ankesën e LVV-së duke anuluar vendimin e PZAP-it. Më 28 tetor 2019, PZAP, sipas urdhrit të Gjykatës Supreme, rishqyrtoi apelin e LVV-së të paraqitur më 17 tetor 2019 duke e refuzuar atë si të pabazuar [Sqarim: herën e parë e kishte hedhur poshtë si të palejuar]. Në arsyetim të vendimit të tij, PZAP kishte theksuar se në mes të palëve në procedurë, respektivisht LVV-së dhe KQZ-së, nuk ishte kontestuese se ishin pranuar 4639 pako me fletëvotime nga votuesit jashtë shtetit, nga data 8 tetor 2019 deri më 11 tetor 2019, dhe se të njëjtat ishin pranuar pas datës së zgjedhjeve me 6 tetor 2019. Po ashtu, sipas PZAP-it, nuk ishte kontestues as fakti se këto pako me fletëvotime ishin dërguar nga votuesit jashtë Kosovës përmes postës në shtetin ku ata jetojnë, nga data 19 tetor 2019 deri më 30 tetor 2019. Kontestuese, sipas PZAP-së, mbetej vetëm çështja e vlefshmërisë së këtyre pakove me fletëvotime duke qenë se të njëjtat në KQZ ishin pranuar pas afatit të paraparë ligjor për pranimin e pakove me fletëvotime nga votues jashtë Kosovës. PZAP arsyetoi se neni 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] nuk ishte cenuar ngase, me asnjë veprim apo vendim, KQZ-ja nuk ua kishte mohuar të njëjtëve të drejtën për të votuar, pasi që rregullat për ta shfrytëzuar të drejtën kushtetuese për të votuar dhe zgjedhur ishin përcaktuar me nenin 96 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (në tekstin e mëtejme: "LZP") dhe me nenin 4 paragrafi 4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 të KQZ-së. Sipas këtyre dispozitave, votat nga jashtë duhet të arrijnë në KQZ, 24 orë para ditës së zgjedhjeve. PZAP theksoi se në këtë rast nuk bëhej fjalë për të drejta zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, por për mosrespektim të afateve ligjore prekluzive dhe të cilat nuk mund të ndryshoheshin apo të zgjateshin. LVV kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartcekur të PZAP-it, të 28 tetorit 2019. Më 30 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit A.A.U.ZH.nr.20/2019, kishte aprovuar si të bazuar ankesën e LVV-së duke e ndryshuar vendimin e PZAP-it të 28 tetorit 2019 dhe duke e detyruar KQZ-në që të bënte rinumërimin e 4639 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës. Gjykata Supreme arsyetoi se ishin të bazuara pretendimet e LVV-së, paraqitur në ankesën ndaj vendimit të kontestuar të PZAP-it, sepse i njëjti përmban

parregullsi dhe për këtë arsye është dashtë të ndryshohet. Gjykata Supreme argumentoi se me nenin 96 paragrafi 2 të LZP-së, përcaktohet se vota përmes votimit jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, ndërsa me nenin 4 paragrafi 4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, përcaktohet se vota jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Më tutje, Gjykata Supreme iu referua edhe neneve kushtetuese 31, 32, 54 dhe 22, si dhe KEDNJ-së për të arritur në përfundim se konkludimi juridik i PZAP-it se apeli i paraqitur nga subjekti politik LVV ishte i pabazuar, binte ndesh me Protokollin 1, neni 3, të KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën për të votuar dhe të drejtën për t'u zgjedhur. Sipas Gjykatës Supreme, parimi i votimit universal është shumë i fortë dhe shtetit i kërkohet në mënyrë shumë strikte të justifikojë humbjen e votës nga individë ose kategori të caktuara personash. Duke u bazuar në gjendje të tillë të çështjes, sipas Gjykatës Supreme, rezultonte se neni 96 paragrafi 2 i LPZ-së dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 ishin në kolizion me nenin 3 të Protokollit 1 të KEDNJ dhe se votuesve u ishte mohuar vetë thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në rastin konkret (siç del nga vendimi i kontestuar i PZAP-it), votuesit fletëvotimet i kanë dorëzuar në postë në datat 19, 20, 23, 25 dhe 30 shtator 2019, në kohë të mjaftueshme për të arritur në KQZ. Mirëpo këto fletëvotime kishin arritur në KQZ prej datës 8 deri 11 tetor 2019. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, arritja me vonesë e këtyre fletëvotimeve nuk kishte cenuar rregullsinë dhe ligjshmërinë e tyre dhe se mosnumërimi i tyre e bënte të kontestueshëm gjithë procesin e numërimit të fletëvotimeve.

Më 2 nëntor 2019, pas publikimit të aktgjykimit të parë të kontestuar të Gjykatës Supreme, LVV kishte paraqitur edhe një ankesë tjetër në PZAP me kërkesë të ngjashme, gjegjësisht duke pretenduar se më 1 nëntor 2019, 1806 pako me fletëvotime nuk ishin dërguar nga Sekretariati i KQZ-së në QNR për verifikim dhe numërim me arsyetimin se këto fletëvotime kishin arritur në KQZ më vonesë. Më 3 nëntor 2019, PZAP kishte nxjerrë Vendimin A.nr.381/2019, përmes së cilit refuzoi si të pabazuar ankesën e LVV-së. PZAP kishte argumentuar se pakot me fletëvotime ishin pranuar në KQZ pas afatit të paraparë ligjor. Kundër vendimit të PZAP, LVV kishte parashtruar ankesë pranë Gjykatës Supreme. Më 5 nëntor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit A.A.U.ZH.nr.21/2019,

kishte aprovuar si të bazuar ankesën e LVV, duke e ndryshuar vendimin e PZAP-it të 3 nëntorit 2019; dhe duke e detyruar KQZ-në që të bënte numërimin e 1806 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës. Gjykata Supreme, edhe këtë Aktgjykim, e mbështeti në arsyetim të njëjtë me atë të mësipërm (të 30 tetorit 2019).

Më 19 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar dy Aktgjykime të Gjykatës Supreme, gjegjësisht Aktgjykimin A.A.U.ZH.nr.20/2019, të 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimin A.A.U.ZH.nr.21/2019, të 5 nëntorit 2019.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Koalicioni “NISMA-AKR-PD”, pretenduan se me dy vendimet e kontestuara, Gjykata Supreme kishte bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi pretendoi se vendimet e kontestuara ishin arbitrare në tërësi për shkak të interpretimit me hamendje të dispozitave kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], si dhe arbitrar lidhur me rolin dhe pozitën kushtetuese të nenit 3 të Protokollit 1 (E drejta për zgjedhje të lira) të KEDNJ-së.

Parashtruesi i kërkesës u ndal posaçërisht në arsyetimin e Gjykatës Supreme e cila i ishte referuar nenit 22 të Kushtetutës kur kishte vendosur ta bazojë vendimin e saj në Kushtetutë, e jo në LZP. Në lidhje me këtë, parashtruesi argumentoi se nga ky interpretim shihet qartë se Gjykata Supreme nuk e kishte kuptuar se dispozitat kushtetuese të nenit 22 kanë fuqi të njëjtë kushtetuese si çdo dispozitë tjetër dhe se funksioni i kësaj dispozite nuk është që të autorizojë shmangien e zbatimit të ligjeve pozitive të Kosovës, por të detyrojë Shtetin e Kosovës që të garantojë vënien në jetë të lirive dhe të drejtave të garantuara me ato marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare që përmenden në atë nen. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se Kushtetuta nuk autorizon asnjë organ shtetëror, përfshirë Gjykatën Supreme, për të mënjanuar

apo shmangur zbatimin e ligjeve kur ato bien në kundërshtim me normat kushtetuese. Sipas parashtruesit, në një rast të tillë, pra kur gjykatat vijnë deri te një konstatim se ligji apo norma që duhet ta zbatojnë është kundërkushtetuese, atëherë ato kanë autorizimin e vetëm për të iniciuar procedurat e kontrollit incidental, sipas nenit 113.8 të Kushtetutës. Andaj, sipas parashtruesit të kërkesës, çdo dyshim për kushtetutshmërinë e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ishte dashur të dërgohej në Gjykatën Kushtetuese për kontroll incidental kushtetues, jo të bëhej shmangia e zbatimit të tij, siç kishte vepruar Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare i kishte cilësuar si norma ligjore dispozitat e nenit 3 të Protokollit nr. 1, sikur ato të ishin norma të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuara në kuptim të nenit 19.2 të Kushtetutës. Parashtruesi argumentoi se normat e nenit 22 janë norma të Kushtetutës dhe askush nuk mund të vlerësojë nëse një normë ligjore bie ndesh me to, përveç Gjykatës Kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se arbitrariteti i dytë i Gjykatës Supreme konsistoi në faktin se ajo nuk e kishte kuptuar natyrën juridike të normës së nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Ai nen nuk ka fare të bëjë me gjykatat e vendeve që janë palë të KEDNJ-së, por vetëm me shtetet anëtare. Si i tillë, ky nen ngërthen një detyrim për Shtetet Anëtare apo Palë të KEDNJ-së për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të realizuar të drejtën e parashikuar në të dhe nuk ka natyrë të vetëzbatueshme, d.m.th. nuk mund të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykatat nacionale.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht vuri në pah se e drejta dhe obligimi për të aplikuar dhe interpretuar Kushtetutën, u njihet të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës dhe të gjitha autoriteteve publike në Republikën e Kosovës. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ritheksoi fuqishëm se kompetenca e “konstatimit” të jokushtetutshmërisë së një norme ligjore dhe “shfuqizimit” të një norme ligjore si të papajtueshme me Kushtetutën, është kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese. Pra, përkundër faktit që Kushtetuta ua njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme të rangut ligjor në harmoni me një normë të rangut kushtetues dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të normës së rangut kushtetues, kjo nuk do të thotë se gjykatat e rregullta mund të konstatojnë ose të shpallin një

normë ligjore si normë në kundërshtim me Kushtetutën ose KEDNJ-në. Një kompetencë të tillë, të konstatimit të jokushtetutshmërisë dhe të shfuqizimit të një norme ligjore, Kushtetuta nuk e ka paraparë si kompetencë për gjykatat e rregullta. Një të drejtë të tillë, Kushtetuta ia ka veshur në mënyrë ekskluzive vetëm Gjykatës Kushtetuese e cila, pas paraqitjes së kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, mund të shfuqizojë një normë ligjore që është në kundërshtim me Kushtetutën si dhe të përcaktojë efektet e një shfuqizimi të tillë.

Sa i përket pajtueshmërisë së vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese theksoi se koha për vendimmarrje në konteste zgjedhore është relativisht e shkurtër dhe se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, nuk aplikohet në kontestet zgjedhore. Por, sipas Gjykatës Kushtetuese, kjo nuk nënkupton që vendimet që ndërlidhen me konteste zgjedhore nuk duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Supreme dhe përfundimet e arritura bazuar në atë arsyetim, ishin arbitrare dhe nuk plotësonin asnjë nga kriteret e një vendimi gjyqësor mjaftueshëm të arsyetuar. Kjo për faktin se Gjykata Supreme nuk kishte aplikuar asnjë test relevant të shqyrtimit gjyqësor e as nuk kishte elaboruar asnjë nga çështjet vijuese që ishin relevante dhe të domosdoshme për t'u qartësuar në rrethanat e rastit konkret: (i) çfarë nënkupton “parimi i votimit universal” në të cilin ishte thirrur Gjykata Supreme, si ndërlidhet ai parim me të drejtën e votës nga jashtë dhe si është shkelur i njëjti në rrethanat e rastit konkret; (ii) cilat janë obligimet që neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vendosë mbi shtetet përkitazi me votimin nga jashtë; dhe (iii) çfarë është saktësisht ajo që e bën afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të jetë normë ligjore në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Gjykata Supreme nuk kishte arritur të vërtetonte, në asnjë mënyrë, se si vendimmarrja e PZAP-it ishte e gabuar dhe se përse linja e arsyetimit të PZAP-it duhej zëvendësuar me një linjë krejtësisht tjetër, që nuk ishte në përputhje me LZP-në dhe me praktikën e deriatëhershme zgjedhore. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se Gjykata Supreme nuk

kishte ofruar arsytim të mjaftueshëm ligjor e kushtetues dhe se vendimmarrja e saj në rrethanat e rastit konkret ishte arbitrare dhe, për rrjedhojë, në kundërshtim me garancitë e nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Për sa i përket përputhshmërisë së normës ligjore që kërkonte që votat për votim nga jashtë duhet të arrijnë në KQZ njëzet e katër (24) orë para ditës së votimit, në mënyrë që të njëjtat të mund të numërohen, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se ky kufizim i të drejtës së votës: (1) ishte një kufizim i paraparë me ligj; (2) ekzistonte një qëllim legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; si dhe (3) ekzistonte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të së drejtës në fjalë dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej. Gjithashtu, Gjykata gjeti se afati i përcaktuar me nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, nuk ishte arbitrare dhe nuk kishte ndikuar në pamundësim të shprehjes së lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e vet në Kuvend dhe, si i tillë, ishte në pajtueshmëri me nenin 45 të Kushtetutës dhe me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Për sa i takon efektet e këtij Aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese sqaroi se konstatimi i saj që vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk ishin në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës nuk kishte efekt prapaveprues në rezultatin e shpallur zgjedhor. Sidoqoftë, Gjykata sqaroi se Aktgjykimi i saj në këtë rast prodhon të paktën katër efekte të rëndësishme: (1) sqarimi i të drejtave dhe obligimeve të gjykatave të rregullta për rastet kur ato ballafaqohen me norma të rangut ligjor që pretendojnë se janë në kolizion me norma të rangut kushtetues; (2) shfuqizimi i dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme dhe lënia në fuqi e dy vendimeve të PZAP-së ashtu që, përderisa Kuvendi i Republikës së Kosovës e lë në fuqi nenin 96.2 të LZP-së, të gjitha votat që arrijnë në KQZ pas afatit të paraparë ligjor duhet të deklarohen si vota të pavlefshme dhe nuk duhet të numërohen e as të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve; (3) qartësimi se në rrethanat e rastit konkret nuk ka ekzistuar kolizion në mes të normës së rangut ligjor dhe asaj të rangut kushtetues dhe se, në këtë aspekt, Gjykata Supreme e ka deklaruar kolizionin në fjalë në mënyrë arbitrare, duke tejkaluar kompetencat e saj kushtetuese dhe pa arsytim të mjaftueshëm dhe adekuat; dhe se (4) gjetja e shkeljes

ia mundëson parashtruesit të kërkesës të konsiderojë shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejme të të drejtave të tij në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi që të shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se aktgjykimet e Gjykatës Supreme, A.A.U.ZH.nr.20/2019 dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, nuk ishin në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës; të konstatojë që vendimet e PZAP-it, A.nr.375-2/2019 dhe A.nr.381/2019, ishin në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës; dhe e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

1.2. KI 152/17. PARASHTRUES SHAQIR TOTAJ

[https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2018/02/ki_152_17_av_shq.pdf]

5 janar 2018

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: Ky rast ndërlidhej me zgjedhjet lokale të vitit 2017, ku parashtruesi kishte qenë kandidat për Kryetar të Komunës së Prizrenit nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe kishte humbur garën me një përqindje shumë të vogël votash. Çështja kryesore e ngritur në këtë kërkesë ishte nëse parashtruesit i ishin shkelur të drejtat e garantuara me nenin 45 të Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], kur Gjykata Supreme dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) kishin refuzuar ankesat e PDK-së që pretendoi se kishte pasur parregullsi në procesin zgjedhor në Prizren.

Faktet kryesore

Më 22 tetor 2017, u mbajt raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës, ku parashtruesi i kërkesës ishte kandidati i PDK-së për Kryetar të Komunës së Prizrenit. Rezultatet përfundimtare të raundit të parë zgjedhor përcaktuan se gara për Kryetar të Komunës së Prizrenit do të vendosej nga rezultati i raundit të dytë zgjedhor (balotazhit), që do të zhvillohej në mes të dy kandidatëve me më së shumti vota në raundin e parë, përkatësisht në mes të parashtruesit të kërkesës, z. Shaqir Totaj nga PDK dhe z. Mytahir Haskuka nga Lëvizja VETËVENDOSJE!. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve lokale, dhe më 29 nëntor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, ku parashtruesi i kërkesës kishte marrë 49.64% të votave, ndërsa kundër kandidati i tij kishte marrë 50.36% të votave. Më 30 nëntor 2017, PDK ishte ankuar në PZAP duke kërkuar që të kontrolloheshin fletëvotimet dhe materialet e tjera zgjedhore dhe, pas vërtetimit të fakteve për cenim të procesit zgjedhor në ditën e votimit, të anuloheshin rezultatet zgjedhor dhe të urdhërohej Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të përsëritej votimi në Komunën e Prizrenit. Më 1 dhjetor 2017, PZAP hodhi poshtë ankesën e PDK-së si të palejuar, me arsyetimin se pretendimet ankimore të PDK-së për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, të mbajtura në datën 19.11.2017, në atë fazë të procesit zgjedhor ishin të palejueshme, sepse për të gjitha parregullsitë që ndërlidheshin me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP ishte 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit (në këtë rast afati për të parashtruar ankesë në PZAP ishte me datën 20.11.2017). Më 5 dhjetor 2017, PDK parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme përmes së cilës kontestoi ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it. Më 7 dhjetor 2017, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. A. U. ZH. nr. 63/2017, e refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur nga PDK, me arsyetimin se PDK nuk i kishte argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta, kurse ato prova, të cilave u referohej nuk ishin me ndikim në marrjen e një vendimi tjetër. Gjykata Supreme, po ashtu, kishte arsyetuar se afati për ankesë në PZAP, për të gjitha parregullsitë që ndërlidheshin me ditën e votimit, kishte qenë 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit. Më 11 dhjetor 2017, KQZ kishte certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për raundin e dytë për Kryetar të Komunës së Prizrenit (si dhe të disa komunave të tjera).

Më 15 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit kishte kërkuar nga parashtruesi që të sqaronte nëse kërkesën e paraqiste në Gjykatën Kushtetuese në emër personal, apo në emër të partisë (PDK). Në përgjigjen e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi kishte sqaruar së kërkesën e kishte paraqitur në emër personal dhe në cilësi individuale. Po ashtu, në cilësinë e palës së interesuar, kundërkandidati i parashtruesit në zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Prizrenit kishte dorëzuar komente lidhur me pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ishte shkelur neni 45 i Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], si dhe neni 3 [Parimet themelore] të Ligjit për Zgjedhjet Lokale. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendoi se Gjykata Supreme nuk kishte arritur të verifikonte faktet dhe provat e ankuesit (PDK), e të cilat ndërlidheshin drejtpërsëdrejti me interesin ligjor të parashtruesit dhe ishin vendimtare për konstatimin e shkeljes të së drejtës pasive zgjedhore. Parashtruesi arsyetoi se, përkundër që PDK kishte ushtruar ankesë, bazuar në fakte dhe prova të qëndrueshme që ndërlidheshin me procesin zgjedhor dhe numërimin, PZAP vendimin për hedhje poshtë të ankesës së PDK-së e kishte bazuar në faktin e mosparaqitjes së ankesës brenda 24 orëve nga mbyllja e qendrave të numërimit, duke mos shqyrtuar në mënyrë meritore këtë ankesë. Për më tepër, parashtruesi pretendoi se PZAP-i kishte zbatuar gabimisht nenin 119.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të vendoste si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese vuri në pah se kërkesa e parashtruesit ishte parashtruar si kërkesë individuale, në cilësinë e tij si person fizik,

përmes së cilës kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme. Ndërkaq që aktgjykimi në fjalë ishte nxjerrë nga Gjykata Supreme pas ankesës që PDK, në cilësinë e subjektit politik dhe rrjedhimisht në cilësinë e personit juridik, kishte parashtruar kundër një vendimi të PZAP-it. Pas sqarimeve të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte shteruar ndonjë mjet juridik në emrin e tij personal, pra si person fizik apo si “person i cili ka interes ligjor”, pranë PZAP-it apo pranë Gjykatës Supreme, para se të dorëzonte kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër, Gjykata vërejti se parashtruesi i kërkesës nuk përmendej asnjëherë në vendimet, të cilat ishin objekt i vlerësimit kushtetues. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese argumentoi se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi ligjore që, si person fizik, apo si “person i cili ka interes ligjor”, të paraqiste ankesa për sa i përket pretendimeve të tij për shkelje të së drejtës pasive. Ai kishte pasur mundësi që pretendimet për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese t’i paraqiste pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vetëm pasi të kishte shteruar mjetet e tilla juridike, ai do të mund të paraqiste në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë individuale për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve në fjalë, të PZAP-it dhe të Gjykatës Supreme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shteruar mjetet juridike që i kishte në dispozicion, të parapara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë, kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion; ndërkaq që, si rezultat i papranueshmërisë, edhe kërkesa për masë të përkohshme u refuzua si e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. SITAROPOULOS DHE GIAKOUPOULOS kundër GREQISË

[42202/07]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

15 mars 2012

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: mungesa e instrumenteve legislative për modalitetet e ushtrimit të së drejtës së votës në zgjedhjet parlamentare për shtetasit grekë që jetojnë jashtë shtetit në kundërshtim me nenin 3 të Protokollit nr. 1

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga tre shtetas grekë, Nikolaos Sitaropoulos, Stephanos Stavros dhe Christos Giakoumopoulos (kërkuesit), kundër Republikës Greke të paraqitur në Gjykatë më 20 shtator 2007. Kërkuesit janë tre shtetas grekë që jetojnë në Strasburg, Francë. Me Dekretin Presidential nr. 154/2007, parlamenti grek u shpërnda dhe u shpall data e zgjedhjeve të parakohshme më 16 shtator 2007. Kërkuesit i dërguan një faks ambasadorit të Greqisë në Francë, ku i kërkonin të shprehnin vullnetin e tyre me votë për zgjedhjet e ardhshme, prej vendit ku ata jetonin.

Ambasadori, duke u mbështetur edhe në direktivat e dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme e Greqisë, i ktheu përgjigje kërkesës tyre, duke u shpjeguar kërkuesve se mungonte baza ligjore për mënyrën e votimit të qytetarëve grekë rezidentë në një vend tjetër, pa shkuarjen e tyre në Greqi ditën e votimit.

Zgjedhjet u zhvilluan në datën e përcaktuar dhe kërkuesit, duke mos pasur mundësi që të udhëtonin për në Greqi, nuk e ushtruan të drejtën e tyre për të votuar. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke pretenduar se me pamundësinë që kishin emigrantët grekë për të votuar jashtë Greqisë ishte shkelur e drejta e

tyre për të shprehur lirshëm vullnetin e tyre me votë, një e drejtë kjo që garantohej nga neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretenduan se e drejta për qytetarët grekë për të votuar prej jashtë shtetit është njohur për herë të parë në vitin 1862 gjatë zgjedhjeve të anëtarëve të Kongresit të II Kombëtar dhe se qytetarët grekë kishin pasur mundësi të votonin prej vendit të tyre të rezidencës jashtë shtetit. Sipas tyre detyrimin për të nxjerrë ligje e kanë ligjvënësit grekë në përputhje me nenet 108 dhe 51.4 të Kushtetutës, gjë që përbën një *obligatio* dhe jo një *facultas*. Ata çmojnë se vonesa prej tridhjetë e gjashtë vitesh, që i është dashur shtetit grek për të bërë të efektshme normën kushtetuese që garanton të drejtën e votës përbën shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1.

Kërkuesit pohuan se ishin mjaft të interesuar për zhvillimet politike në vendin e tyre të origjinës dhe se donin të ruanin lidhje të ngushta me Greqinë. Në veçanti, ata theksuan se janë regjistruar në listat e zgjedhësve në Greqi, se posedonin pasaporta të vlefshme greke, ishin pronarë pasurish të patundshme në Greqi, si edhe tatimpagues në bazë të të ardhurave të tyre, dhe se kurdoherë të gatshëm për të ushtruar profesionin e tyre të avokatit në Greqi. Për ta, pamundësia për të votuar prej shtetit të tyre të qëndrimit në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në Greqi, përbën një pengesë për të drejtën e tyre të votës, të cilën e quajnë në kundërshtim me Kushtetutën greke si edhe me Konventën.

Kërkuesit argumentuan se nga instrumentet e Këshillit të Evropës përkatësisht nga Rezoluta 1459 (2005) dhe nga Rekomandimi 1714 (2005) i Asamblesë Parlamentare, si edhe nga Kodi i mbarëvajtjes zgjedhore i hartuar nga Komisioni i Venecias, del se shtetet anëtare kanë detyrimin për ta bërë të efektshme të drejtën e votës. Ata vërejtën se, sipas studimit të cilit i është referuar Dhoma në vendimin e saj të 8 korrikut 2010, të paktën njëzet e nëntë Shtete Anëtare të Këshillit të Evropës u garantojnë në mënyrë të efektshme të mërguarve të drejtën e votës prej jashtë shtetit në zgjedhjet parlamentare.

Qeveria në anën tjetër çmoi se mundësia e njohur nga Kushtetuta për të rregulluar me anë të rrugës legislative ushtrimin e së drejtës së votës

për zgjedhësit me qëndrim jashtë territorit të shtetit Helen, nuk mund të luajë një rol vendimtar në konstatimin ose jo të një shkeljeje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 për këtë çështje. Në veçanti, ajo theksoi se, neni 51.4 i Kushtetutës ka një përmbajtje fakultative dhe se nuk i vendos asnjë detyrim ligjvënës. Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 ka shpallur se shtetet kontraktuese gëzojnë një shkallë të gjerë vlerësimi për sa i përket organizimit të sistemit të tyre zgjedhor. Qeveria shtoi se, në kuptimin e nenit 51.4 të Kushtetutës, modalitetet e votimit për grekët e diasporës duhet të përcaktohen me shumicën e dy të tretave të Parlamentit, çka tregon se Greqisë i duhet të arrijë një konsensus politik mjaft të gjerë në lidhje me këtë çështje. Për më tepër, ajo vërejti se, në vitin 2009, kishte provuar njëherë të miratojë një ligj mbi të drejtën e votës së grekëve të mërguar, çka dëshmon vullnetin politik për të zgjidhur problemin që buron nga çështja. Për Qeverinë, përcaktimi i këtyre modaliteteve është një çështje politike tejet e ndërlikuar. Njohja e përgjithshme e së drejtës së të mërguarve për të votuar në zgjedhjet parlamentare që prej vendit të tyre të qëndrimit, mund të ngërthejë probleme politike dhe ekonomike të mëdha, jo vetëm në Greqi por edhe në shtete të tjera anëtare të Këshillit të Evropës.

Duke iu referuar në veçanti punimeve parlamentare gjatë rishikimit kushtetues të vitit 2001, Qeveria vërejti se ligji i parashikuar me nenin 51.4 të Konventës mbetet fakultativ. Për Qeverinë, qytetarët grekë me qëndrim të përhershëm jashtë shtetit janë tashmë të lidhur me jetën sociale, ekonomike, politike dhe kulturore të vendit të tyre të pritjes dhe të rezidencës dhe se atje është qendra e interesave të tyre *par excellence*. Për më tepër, Qeveria çmoi se krahasimi në mes të Greqisë dhe të shteteve të tjera që njohin të drejtën e votës për të mërguarit që prej vendit të tyre të rezidencës, duhet të mbajë parasysh veçoritë e secilit prej rasteve, veçanërisht numrin e qytetarëve të cilët jetojnë jashtë vendit të tyre të origjinës, kontekstin socio-politik të secilit vend si edhe sistemin zgjedhor në fuqi.

Së fundmi, Qeveria pretendoi se pjesëmarrja e grekëve të mërguar në zgjedhjet parlamentare nuk mund të krahasohet me zbatimin e kësaj të drejte për sa i përket zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Në rastin e fundit, bëhet fjalë vetëm për njohjen e së drejtës së votës për një pjesë të grekëve të mërguar, domethënë të atyre që qëndrojnë në territorin e

shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të një të detyrimi i cili rrjedh drejtpërdrejt nga e drejta komunitare dhe shprehimisht i parashikuar në legjislacionin e brendshëm. Përfundimisht, Qeveria kujtoi se kërkuesit përmbushin kushtet e përcaktuara nga ligji zgjedhor për ushtrimin e së drejtës së tyre të votës në Greqi. Ajo ripohoi se çështja e së drejtës së votës së të mërguarve prej vendit të tyre të rezidencës lidhet me shkallën e vlerësimit të autoriteteve të brendshme, të cilat sipas saj kanë mundësinë të zgjedhin se në cilën kohë dhe sipas cilave modaliteteve do ta vulosin këtë të drejtë.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendim për shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1, në vendimin e saj të 8 korrikut 2010, Dhoma u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 Ajo vlerësoi se çështja në fjalë nuk kishte të bënte me njohjen e së drejtës së votës së kërkuesve si të tillë, e cila tashmë ishte e njohur nga Kushtetuta greke, por kishte të bënte më tepër me kushtet që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte nga shtetasit grekë që jetojnë jashtë vendit. Në këtë pikë, Dhoma vuri në dukje se neni 51.4 i Kushtetutës Greke, i miratuar në vitin 1975 dhe i qartësuar gjatë rishikimit kushtetues të vitit 2001, i jepte kompetencën legjislativ të specifikonte kushtet në fjalë. Edhe pse kërkuesit kishin ende opsionin e udhëtimit në Greqi për të votuar, në praktikë kjo e ndërlikonte ndjeshëm ushtrimin e kësaj të drejte, pasi sillte shpenzime dhe çrregullime në jetën e tyre profesionale dhe familjare. Dhoma pranoi se neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk impononte asnjë detyrim për të siguruar të drejtën e votës në zgjedhjet parlamentare për votuesit që jetojnë jashtë vendit. Megjithatë, dispozita kushtetuese në fjalë (neni 51.4) nuk mund të mbetej e pazbatueshme pafundësisht, duke privuar nga çdo vlerë normative përmbajtjen e saj dhe synimin e hartuesve të saj. Tridhjetë e pesë vjet (në kohën e gjykimit) pas hyrjes në fuqi të nenit 51.4, ligjvënësi grek ende nuk i kishte dhënë efekt përmbajtjes së tij. Dhoma gjithashtu u shpreh se dështimi për të miratuar legjislacionin që jep efekt praktik për të drejtat e votës për emigrantët ka të ngjarë të përbëjë trajtim të padrejtë të shtetasve grekë që jetojnë jashtë vendit – veçanërisht atyre që jetojnë në një distancë të konsiderueshme – në krahasim me ata që jetojnë në Greqi, pavarësisht nga fakti që Këshilli i Evropës u kishte kërkuar shteteve anëtare që t’u mundësonin qytetarëve

të tyre që jetojnë jashtë vendit të marrin pjesë në masën më të plotë të mundshme në procesin zgjedhor. Mbi bazën e një studimi krahasues të ligjit të brendshëm në tridhjetë e tri Shtete Anëtare të Këshillit të Evropës, Dhoma vuri re se shumica dërrmuese kishte zbatuar procedura për këtë qëllim dhe arriti në përfundimin se Greqia ende nuk kishte arritur të zbatojë procedura të qarta.

Kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 22 nëntor 2010

Në vlerësimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse, pavarësisht dështimit të miratimit të legjislacionit për kushtet e ushtrimit të së drejtës së votës, sistemi zgjedhor megjithatë lejonte “shprehjen e lirë të mendimit të popullit” dhe ruante “vetë thelbin e së drejtës për të votuar”, dhe, në përgjithësi, nëse neni 3 i Protokollit nr. 1 u vendosi shteteve detyrimin për të futur në zbatim një sistem që u mundëson qytetarëve të huaj të ushtrojnë të drejtat e tyre të votës nga jashtë.

Së pari, as traktatet përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe as interpretimi i tyre nga organet kompetente ndërkombëtare nuk dhanë bazë për të arritur në përfundimin se të drejtat e votës për personat që nuk janë të pranishëm përkohësisht ose përgjithmonë në shtetin, nënshtetas të të cilit ata ishin, shtrihen aq sa t’i kërkohet shtetit në fjalë që të marrë masa për ushtrimin e këtyre të drejtave jashtë vendit. Ishte e vërtetë që institucionet e Këshillit të Evropës në disa raste i kishin ftuar shtetet anëtare që t’u mundësonin qytetarëve të tyre që jetojnë jashtë vendit të marrin pjesë në masën më të plotë të mundshme në procesin zgjedhor. Megjithatë, siç theksohet nga Komisioni i Venecias, lehtësimi i ushtrimit të të drejtave të votimit të emigrantëve, megjithëse sigurisht i dëshirueshëm, nuk ishte i detyrueshëm për shtetet, por përkundrazi ishte një mundësi për t’u marrë në konsideratë nga legjislativi në çdo vend.

Së dyti, një studim krahasues i legjislacionit të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës tregoi se, siç ishte ligji, nuk mund të argumentohej se këto shtete ishin të detyruara t’u mundësonin shtetasve të tyre që jetonin jashtë vendit të ushtrojnë të drejtën e votës. Ndërsa shumica e shteteve kontraktuese lejuan shtetasit e tyre të votojnë nga jashtë, disa

nuk e bënë këtë. Për sa i përket kushteve që rregullonin ushtrimin e kësaj të drejte, ato aktualisht ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme, gjë që nënkuptonte se shtetet kontraktuese kishin një hapësirë të gjerë vlerësimi për këtë çështje.

Së treti, megjithëse Kushtetuta greke përmbante një dispozitë që lejonte ligjvënësit të rregullonin ushtrimin e së drejtës së votës së emigrantëve nga vendbanimi i tyre, ajo nuk i detyronte ligjvënësit ta bënë këtë, pasi përmbajtja e dispozitës ishte fakultative. Prandaj, nuk i takonte Gjykatës t'u tregonte autoriteteve kombëtare se kur dhe si ta zbatonin atë dispozitë. Për më tepër, ishte e pamohueshme që autoritetet greke kishin bërë përpjekje të përsëritura për të miratuar legjislacionin për të zbatuar dispozitën në fjalë; megjithatë, këto përpjekje nuk kishin arritur të siguronin marrëveshje politike.

Së fundi, pavarësisht nga fakti se kërkuesit ishin të shqetësuar për çështjet në vendin e tyre në të njëjtën masë si banorët, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të vënë në pikëpyetje situatën ligjore në Greqi. Në çdo rast, autoritetet kompetente nuk mund të merrnin parasysh çdo rast individual në rregullimin e ushtrimit të së drejtës së votës, por duhej të përcaktonin një rregull të përgjithshëm. Për sa i përket çrregullimit të jetës financiare, familjare dhe profesionale të kërkuesve që do të ishte shkaktuar nëse do të duhej të udhëtonin në Greqi për të votuar, kjo nuk dukej të ishte joproporcionale deri në masën e cenimit të së drejtës në fjalë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi, njëzëri, se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. M. G. EMAN, O. B. SEVINGER kundër COLLEGE VAN BURGEMEESTER EN WETHOUDERS VAN DEN HAAG²⁰⁰

GJDBE

Çështja C-300/04

12 shtator 2006

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=63875&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13715940>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Në këtë vendim, Gjykata thekson se megjithëse në stadin ku gjendej e drejta komunitare në atë kohë mund të pranohej që shtetasit me banim jashtë të mos mund të votojnë ose kandidojnë për zgjedhjet në PE, një rregull i tillë nuk mund të ketë natyrë diskriminuese të pajustificueshme për situata të ngjashme

Faktet kryesore

Mbretëria e Holandës përbëhet nga Holanda, si dhe nga Ishujt e Arubës dhe Antilet Holandeze. Të gjithë banorët e Mbretërisë së Holandës kanë një shtetësi të vetme, atë holandeze.

Sipas Ligjit Zgjedhor Holandez, Nederlandse Kieswet, çdo shtetas mbi 18 vjeç, me përjashtim të shtetasve me banim në Antilet holandeze dhe në Aruba, kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet për Parlamentin e Holandës dhe të drejtën për të votuar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

Z. Eman dhe z. Sevinger, janë dy shtetas holandezë me banim në Oranjestad në Aruba. Ata aplikuan për t'u regjistruar në regjistrin e

zgjedhësve për zgjedhjet në Parlamentin Evropian të vitit 2004. Për shkak të dispozitave të Ligjit Zgjedhor holandez, kërkesa e z. Eman dhe z. Sevenger u refuzua nga Kolegji Bashkiak i Hagës, me arsyetimin se ata janë banues në Aruba.

Z. Eman dhe z. Sevenger u ankuan kundër këtij refuzimi në Nederlandse Raad van State Afdeling bestuursrechtspraak²⁰¹. Ata pretenduan se refuzimi për t'i regjistruar në listat zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve të Parlamentit Evropian, vetëm me arsyetimin se ata e kishin vendbanimin në Aruba, ishte i paligjshëm. Ata pretenduan se, në përputhje me nenin 17.1 të KE-së, ata janë shtetas të Bashkimit Evropian. Ata theksuan se neni 19 (2) i KE-së, i interpretuar në dritën e nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, ua njeh të drejtën për të votuar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, edhe nëse ata banojnë në një territor, emri i të cilit përmendet në listën e Vendeve dhe Territoreve përtej Detit (në tekstin e mëtejshëm: "VTPD"), të cilat përfshihen në Shtojcën II të Traktatit. Në këtë kuptim, ata pretenduan se kishte një diskriminim të pajustificuar dhe shkelje të drejtave të tyre zgjedhore sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

Këshilli i Shtetit në Holandë, pezulloi procedurën dhe iu drejtua Gjykatës së Luksemburgut me pyetjen nëse dispozitat e Traktatit të KE-së në lidhje me qytetarinë e BE-së zbatohen për personat që kanë shtetësinë e një shteti anëtar dhe që janë rezidentë ose jetojnë në një VTPD. Këshilli i Shtetit pranoi se, duke qenë se zgjedhjet për deputetët e Parlamentit Evropian ishin bërë tashmë, ishte tepër vonë për një vendim që anulon refuzimin e regjistrimit të parashtruesve në procedurën kryesore në listat zgjedhore për të lejuar të interesuarit të marrin pjesë në zgjedhjet e vitit 2004. Megjithatë, ai nuk përjashton mundësinë e kompensimit që t'u jepet atyre sipas së drejtës komunitare.

Përmbledhja e vendimit

Personat që kanë shtetësinë e një Shteti Anëtar dhe që banojnë në një territor që është pjesë e vendeve dhe e territoreve përtej detit, të

201 Këshilli i Shtetit në Holandë.

përmendura në nenin 299.3 të TKE-së, mund të pretendojnë të gëzojnë të drejtat e njohura për qytetarët e BE-së nga Pjesa II e Traktatit.

Në gjendjen aktuale të së drejtës komunitare, përcaktimi i titullarëve të së drejtës për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, sipas së drejtës komunitare, bie në kompetencën e çdo Shteti Anëtar. Në fakt, as nenet 189 të TKE-së dhe 190 të TKE-së dhe as Akti për Zgjedhjen e Parlamentarëve të Parlamentit Evropian me votim të drejtpërdrejtë dhe të përgjithshëm, nuk tregojnë në mënyrë të shprehur dhe të saktë se cilët janë titullarët e së drejtës për të votuar dhe për të kandiduar për zgjedhje në Parlamentin Evropian. Pra, asnjë përfundim i qartë në këtë drejtim nuk mund të nxirret nga nenet 189 të TKE-së dhe 190 të TKE-së, në lidhje me Parlamentin Evropian, të cilat vetëm tregojnë se ky i fundit përbëhet nga përfaqësues të popujve të shteteve anëtare, pasi termi 'popull', i cili nuk është përcaktuar, ka gjasa të ketë kuptime të ndryshme në shtete të ndryshme anëtare dhe gjuhë të ndryshme të BE-së. Për më tepër, dispozitat e Pjesës II të Traktatit, në lidhje me qytetarinë e Bashkimit, nuk njohin që qytetarët e Bashkimit Evropian kanë të drejtë të pakushtëzuar për të votuar dhe për të kandiduar si kandidatë në zgjedhjet për Parlamentin Evropian. Në të vërtetë, neni 19 (2) i KE-së kufizohet në zbatimin e kësaj të drejte për të votuar dhe për t'u kandiduar si kandidat në parimin e mosdiskriminimit në bazë të kombësisë.

Rrjedhimisht, në gjendjen aktuale të së drejtës komunitare, asgjë nuk i pengon shtetet anëtare të përcaktojnë, në përputhje me të drejtën komunitare, kushtet e së drejtës për të votuar dhe për të kandiduar si kandidat në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, duke iu referuar kriterit të vendbanimit në territorin në të cilin mbahen zgjedhjet.

Megjithatë, parimi i trajtimit të barabartë nuk lejon që kriteret e zbatueshme të kenë efektin e trajtimit të ndryshëm të shtetasve në situata të krahasueshme, pa u justifikuar objektivisht ky dallim në trajtim.

Vendet dhe territoret përtej detit (VTPD) i nënshtrohen një regjimi të posaçëm asociimi të përcaktuar në Pjesën IV të Traktatit (nenet 182 të TKE-së deri 188 të TKE-së), në mënyrë që dispozitat e përgjithshme

të Traktatit të mos zbatohen në lidhje me to pa pasur një referencë të shprehur. Nga kjo rrjedh se nenet 189 të TKE-së dhe 190 të TKE-së, të cilat kanë të bëjnë me Parlamentin Evropian, nuk janë të zbatueshme për këto vende dhe territore dhe se shteteve anëtare nuk u kërkohet të organizojnë në këto vende zgjedhje për Parlamentin Evropian.

Për më tepër, neni 19.2 i TKE-së, i cili zbaton parimin e mosdiskriminimit në bazë të kombësisë në lidhje me të drejtën për të zgjedhur dhe për të kandiduar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, nuk është i zbatueshëm për qytetarin e BE-së që banon në një VTPD dhe dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në Shtetin Anëtar shtetas të të cilit janë.

Në mungesë të rregullimeve komunitare në lidhje me mosmarrëveshjet mbi të drejtën për të votuar dhe për t'u kandiduar në Parlamentin Evropian, i takon legjislacionit të brendshëm të çdo Shteti Anëtar të përcaktojë masat që lejojnë rivendosjen e të drejtave të një personi i cili, për shkak të një dispozite kombëtare në kundërshtim me të drejtën e Komunitetit, nuk ishte regjistruar në listën zgjedhore për zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit Evropian më 10 qershor 2004 dhe për këtë arsye u përjashtua nga pjesëmarrja në këto zgjedhje. Këto masa, të cilat mund të përfshijnë kompensimin për dëmin e shkaktuar nga shkelja e së drejtës komunitare që i atribuohet Shtetit, nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato që kanë të bëjnë me të drejtat që do ta kishin origjinën në rendin juridik të brendshëm (parimi i ekuivalencës) dhe as ta bëjnë të pamundur ose tepër të vështirë, në praktikë, për të ushtruar të drejtat e dhëna nga rendi juridik i Komunitetit (parimi i efektivitetit). Megjithatë, duhet të vlerësohet nëse e drejta komunitare ndalon një situatë të tillë, si ajo e parashtruesve para gjykatave holandeze, në të cilën shtetasit holandezë me banim në Aruba nuk kanë të drejtë të votojnë dhe të kandidojnë për Parlamentin Evropian.

Së pari, Gjykata kujtoi se nenet 189 dhe 190 të TKE-së nuk janë të zbatueshme për VTPD. Për më tepër, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk e përjashton këtë interpretim dhe as atë të vendbanimit për qëllimet elektorale. Meqenëse dispozitat e Traktatit nuk janë të zbatueshme për VTPD-të, Parlamenti Evropian nuk mund të konsiderohet si “organi legjislativ” i këtyre të fundit në kuptimin e asaj

dispozite. Nga ana tjetër, është brenda organeve të krijuara në kuadër të asociacionit ndërmjet Komunitetit dhe VTPD-ve që popullsia e këtyre vendeve dhe territoreve të mund të shprehet, nëpërmjet autoriteteve që i përfaqësojnë ato. Për më tepër legjislacioni komunitar nuk ka një impakt të drejtpërdrejtë ndaj VTPD-ve. Në këto kushte nuk duket se, në parim, kriteri që lidhet me vendbanimin është i papërshtatshëm për të përcaktuar se kush është përfituesi i së drejtës për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

Megjithatë, parashtruesit, ashtu si dhe Komisioni Evropian, argumentuan se ligji zgjedhor holandez shkel parimin e trajtimit të barabartë përderisa e njuh të drejtën për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian për çdo banor holandez që banon në një shtet të tretë, ndërkohë që një e drejtë e tillë nuk njihet për holandezët me banim në Antilet Hollandeze ose në Aruba.

Në lidhje me këtë, duhet të kujtojmë se parimi i trajtimit të barabartë ose i mosdiskriminimit, i cili është një nga parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare, kërkon që situatat e krahasueshme të mos trajtohen në një mënyrë të ndryshme dhe që situata të ndryshme të mos trajtohen në mënyrë të barabartë, përveçse kur një trajtim i tillë justifikohet objektivisht.

Në rastin konkret, krahasimi bëhet në mes të një holandezi me banim në Antilet Hollandeze ose Aruba dhe një holandezi me banim në një Shtet të tretë. Këta persona kanë të përbashkët se janë shtetas holandezë dhe nuk banojnë në territorin e Holandës. Megjithatë, ka një ndryshim në trajtim mes këtyre dy personave, i dyti ka të drejtën e votës dhe të kandidimit në zgjedhjet për Parlamentin Evropian që mbahen në Holandë, ndërsa i pari nuk e ka këtë të drejtë. Një ndryshim i tillë në trajtim duhet të arsyetohet objektivisht.

Në përfundim të analizës së saj mbi këtë pikë, Gjykata vlerësoi se Qeveria holandeze nuk demonstroi mjaftueshëm se ndryshimi në trajtim i vërejtur midis holandezëve që banojnë në një shtet të tretë dhe atyre që banojnë në Antilet Hollandeze ose Aruba është objektivisht i justifikuar dhe, për këtë arsye, nuk përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Pra, përgjigja e Gjykatës në këtë pikë është se, në statusin

aktual të së drejtës komunitare, megjithëse asgjë nuk i pengon shtetet anëtare të përcaktojnë, në përputhje me ligjin komunitar, kushtet e së drejtës për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian duke iu referuar kriterit të vendbanimit në territorin ku zhvillohen zgjedhjet, parimi i trajtimit të barabartë, megjithatë, ndalon që kriteret e zbatueshme të jenë të tilla që të trajtojnë ndryshe qytetarët në situata të krahasueshme, pa arritur ta justifikojnë objektivisht këtë dallim në trajtim.

Për sa u përket mjeteve ankimore në rast të shkeljes së të drejtave themelore, Gjykata theksoi se parimi i përgjegjësisë së një shteti anëtar për dëmet e shkaktuara individëve si pasojë e shkeljes së të drejtës komunitare për të cilën ai është përgjegjës, është pjesë përbërëse e sistemit të Traktatit dhe një shtet anëtar është i detyruar të korrigjojë dëmin e shkaktuar kur rregulli juridik që është shkelur, u njeh individëve të drejta, kur shkelja është mjaft e rëndë dhe kur ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë shkakësore midis shkeljes së detyrimit që i takon shtetit dhe dëmit të pësuar nga personat e dëmtuar, pa përjashtuar, megjithatë, mundësinë që shtetit mund t'i lindë përgjegjësia në kushte më pak kufizuese në bazë të ligjit kombëtar.

Në varësi të së drejtës për dëmshpërblim, e cila bazohet drejtpërdrejt në të drejtën komunitare, pasi të plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën e mëparshme, shtetit i takon të bëjë dëmshpërblimin e pasojave të dëmit të shkaktuar sipas kuadrit të së drejtës kombëtare mbi përgjegjësinë, duke u kuptuar që kushtet e vendosura nga ligjet kombëtare për kompensimin e dëmit nuk mund të jenë më pak të favorshme se ato që kanë të bëjnë me pretendime të ngjashme të brendshme dhe nuk mund të rregullohen në mënyrë të tillë që ta bëjnë të pamundur në praktikë ose tepër të vështirë marrjen e dëmshpërblimit.

3.2. THIERRY DELVIGNE kundër COMMUNE DE LESPARRE-MÉDOC & PRÉFET DE LA GIRONDE

GJDBE

Çështja C-650/13

6 tetor 2015

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=169189&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13716138>]]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: *Kjo çështje ka të bëjë me të drejtën për të votuar si dënim plotësues penal dhe për veprimin e ligjit penal më të butë ndaj rivendosjes së kësaj të drejte.*

Faktet kryesore

Thierry Delvigne, një shtetas francez, u dënua me dënim me burg prej dymbëdhjetë vjetësh për një krim të rëndë, dënim që u shpall në shkallë të fundit më 30 mars 1988. Nga dosja gjyqësore rezultoi se, në zbatim të dispozitave të neneve 28 dhe 34 të ish-Kodit Penal francez, ai dënim çonte automatikisht në humbjen e disa të drejtave civile të z. Delvigne, sidomos privimin e të drejtës së tij për të votuar dhe për t'u zgjedhur.

Ligji i 16 dhjetorit 1992, mbi ndryshimet në Kodin Penal, i cili hyri në fuqi më 1 mars 1994, e shfuqizoi dënimin plotësues për humbjen automatikisht të disa të drejtave civile në rast të një dënimi për një krim. Kodi i ri penal tani parashikonte që, në rast të një dënimi për një krim, humbja e të drejtave civile ose e një pjese të tyre duhet të shpallet nga një gjykatë dhe, për një periudhë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dhjetë vjet. Megjithatë, sipas nenit 370 të Ligjit të 16 dhjetorit 1992, të ndryshuar, humbja e të drejtave civile nga z. Delvigne vazhdoi edhe pas 1 marsit 1994, pasi rridhnin nga një dënim për krim që ishte bërë përfundimtar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal.

Në vitin 2012, komisioni administrativ kompetent, në bazë të nenit L6 të Kodit Zgjedhor, urdhëroi heqjen e z. Delvigne nga listat zgjedhore të

Bashkisë Lesparre Médoc, ku ai banonte. Ai e kundërshtoi këtë urdhër dhe kërkoi anulimin e tij para Gjykatës Civile të Shkallës së Parë të Bordosë (në tekstin e mëtejshëm: “gjykata referuese”).

Z. Delvigne i kërkoi Gjykatës së Rrethit të Bordosë që t’i drejtohej për një vendim paraprak GJDBE-së me qëllim që të jepte një interpretim të së drejtës së BE-së, duke pretenduar trajtim të pabarabartë që rridhte nga zbatimi i Ligjit të 16 dhjetorit 1992, të ndryshuar. Në veçanti, ai argumentoi se neni 370 i këtij ligji binte ndesh me disa dispozita të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

Në ato rrethana, Gjykata e Rrethit të Bordosë vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i parashtrijë Gjykatës për një vendim paraprak pyetjen se (i) a duhet të interpretohet neni 49 i Kartës se nuk lejon që një nen i së drejtës kombëtare të parashikojë një ndalim, për më tepër të pakufishëm dhe joproportional, për dhënien e një dënimi më të lehtë personave të dënuar para hyrjes në fuqi të ligjit më të butë penal? (ii) a duhet të interpretohet neni 39 i Kartës, i zbatueshëm për zgjedhjet në Parlamentin Evropian, se kërkon nga Shtetet Anëtare të BE-së që të mos parashikojnë një ndalim të përgjithshëm, të pacaktuar dhe automatik të ushtrimit të të drejtave civile dhe politike, në mënyrë që të mos krijohet trajtim i pabarabartë midis shtetasve të shteteve anëtare?

Vendimi i Gjykatës

Në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës së Rrethit të Bordosë, GJDBE kujtoi se nenet 39.2 dhe 49 (1), fjalia e fundit, e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian duhet të interpretohen se ato nuk përjashtojnë që legjislacioni i një shteti anëtar të BE-së të përjashtojë automatikisht nga e drejta për të votuar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, persona të cilët janë dënuar penalisht për një krim të rëndë, dënim i bërë përfundimtar para 1 marsit 1994.

Gjykata kujtoi se është e qartë se një ndalim i tillë i së drejtës së votës përbën një kufizim në ushtrimin e së drejtës së garantuar nga neni 39, paragrafi 2, i Kartës. Megjithatë, neni 52, paragrafi 1, i Kartës pranon se mund të vendosen kufizime në ushtrimin e të drejtave të tilla, si ato të parashikuara në nenin 39 paragrafi 2 i saj, me kusht që kufizime të tilla

të parashikohen me ligj, të respektojnë thelbin e atyre të drejtave dhe lirive dhe që, në respektim të parimit të proporcionalitetit, të jenë të nevojshme dhe të përmbushin në mënyrë efektive objektivat me interes të përgjithshëm, të njohura nga Bashkimi Evropian ose nevojën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Në këtë kuadër, meqenëse ndalimi i së drejtës për të votuar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian rrjedh nga zbatimi i dispozitave të ligjit francez, duhet të konsiderohet se kufizimi parashikohet me ligj. Gjithashtu, kufizimi në fjalë respekton përmbajtjen thelbësore të së drejtës së votës të përmendur në nenin 39, paragrafi 2, të Kartës. Në të vërtetë, ky kufizim nuk e vë në pikëpyetje këtë të drejtë si të tillë, pasi ka efektin e përjashtimit të personave të caktuar, në kushte të veçanta dhe për shkak të sjelljes së tyre, nga ushtrimi i të drejtës së votës në zgjedhjet e Parlamentit Evropian, me kusht që të përmbushen kushtet në fjalë. Së fundi, një kufizim i tillë rezulton të jetë proporcional, pasi, nga njëra anë, ai merr parasysh natyrën dhe rëndësinë e veprës penale të kryer, si dhe kohëzgjatjen e dënimit dhe, nga ana tjetër, që ligji kombëtar ofron mundësi për një person, i cili i nënshtrohet këtij kufizimi, të kërkojë dhe përfitojë heqjen e tij.

Në lidhje me rregullin e prapaveprimit të ligjit penal më të butë, të parashikuar në nenin 49, paragrafi 1, fjalia e fundit, e Kartës, ky rregull thotë se, nëse, pas një shkeljeje, ligji parashikon një ndëshkim më të lehtë, ai duhet aplikuar. Sidoqoftë, ky rregull nuk bie ndesh me legjislacionin kombëtar në fjalë, pasi ai legjislacion kufizohet në mbajtjen e ndalimit të së drejtës së votës që rrjedh automatikisht nga një dënim penal që është bërë përfundimtar në kohën e veprimit të Kodit të vjetër Penal.

Neni 46

Mbrojtja e Pronës

E drejta e pronës është e garantuar.

- 1. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 2. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 3. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
- 4. Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI 144/14 DHE KI 156/14. PARASHTRUES: VILIJAMIN HAJDUKOVIC DHE STANKA TUS

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_144_14_156_14_shq.pdf]

4 gusht 2015

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *Çështja kyçe në këtë rast ishte mospërmbarimi i dy aktgjykimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, të cilat ua kishin njohur dy parashtruesve të drejtat e tyre të pronësisë mbi prona të paluajtshme, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës].*

Faktet kryesore

Përmbledhje e fakteve për parashtruesin e parë (Vilijamin Hajdukovic): Në vitin 1992, parashtruesit të parë i ishte dhënë e drejta e banimit në një banesë në pronësi shoqërore në Komunën e Pejës dhe, po në këtë vit, ai kishte lidhur kontratë për blerjen e banesës nga Ndërmarrja Shoqërore “Boris Kidric”. Pas luftës në vitin 1999, parashtruesi i parë ishte larguar nga Kosova dhe banesa e tij në Pejë ishte zënë nga një palë e tretë. Më 8 shkurt 2002, parashtruesi kishte parashtruar kërkesë në Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejme: “DÇPB”), me të cilën kërkoi vërtetimin e së drejtës mbi banesën. Në një datë të pacaktuar, pala e tretë B.B. kishte parashtruar kërkesë në DÇPB, me të cilën, edhe ai gjithashtu kërkoi vërtetimin e së drejtës mbi banesën e njëjtë. DÇPB-ja i kishte drejtuar të dy kërkesat te Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (më tutje: KKPB). Më 18 qershor 2005, KKPB -ja kishte nxjerrë një vendim kolektiv i cili përfshinte të dy kërkesat e lartpërmendura. Në vendimin e tij, KKPB -ja ia kishte njohur palës së tretë B. B. të drejtën e posedimit të banesës. Më vendimin e njëjtë, parashtruesit të kërkesës së parë (Vilijamin Hajdukovic) nuk i ishte njohur e drejta e posedimit të banesës së kontestuar por atij i ishte

njohur e drejta e kompensimit. Më 10 tetor 2005, parashtruesi i parë kishte dorëzuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të 18 qershorit 2005 dhe kjo kërkesë ishte refuzuar nga KKPB-ja, më 19 janar 2007. Më 23 prill 2007, parashtruesi i parë sërish i ishte drejtuar KKPB-së, duke kërkuar anulimin e vendimit të 19 janarit 2007. Parashtruesi i parë kishte pretenduar se ky vendim ishte vendim kolektiv në lidhje me një numër të kërkesave për rishqyrtim, por se kërkesa e tij për rishqyrtim nuk ishte përfshirë. Më 8 qershor 2007, KKPB-ja e kishte informuar parashtruesin e parë se kërkesa për rishqyrtim ishte refuzuar. Më 12 janar 2012, parashtruesi i parë i kishte dërguar një letër Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) duke kërkuar përmbarimin e vendimit të KKPB-së, të 18 qershorit 2005, me të cilin atij i ishte njohur e drejta për kompensim. Më 7 mars 2012, AKP-ja u përgjigj në kërkesën e parashtruesit të parë, duke argumentuar, *inter alia*, se Agjencia Kosovare e Pronës, e cila kishte trashëguar një pjesë të përgjegjësisë nga DÇPB, e kishte pranuar letrën e parashtruesit. AKP kishte sqaruar se KKPB kishte marrë dy vendime, një për parashtruesin, me të cilën i ishte njohur e drejta në kompensim dhe një për palën e tretë (B.B), të cilit i ishte njohur e drejta për shfrytëzimit të banesës. AKP më tutje kishte theksuar se nëse pala e tretë do ta shfrytëzonte të drejtën mbi pronën në fjalë, parashtruesi do merrte kompensimin adekuat. AKP po ashtu sqaroi se Agjencia Kosovare e Pronës kishte aprovuar kriteret dhe procedurën e kompensimit si dhe kishte bërë përpjekje për të siguruar fondet adekuate për zbatimin e vendimeve të DÇPB-së, por se ende nuk kishte arritur të siguronte fondet e nevojshme.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtrueses së dytë (Stanka Tus): Duke filluar nga 1 prilli 1968, parashtrueses së dytë i ishte ndarë e drejta e banimit në një banesë në pronësi shoqërore. Parashtruesja e dytë kishte banuar në këtë banesë deri më 23 mars 1991, kur ajo ishte larguar si rezultat i rrethanave të luftës dhe banesa e saj ishte zënë nga një palë e tretë (S.D). Parashtruesja e dytë pretendoi se ajo ndërmoi procedura të ndryshme ligjore në mënyrë që të kthejë të drejtat e saj mbi banesën në fjalë. Pala e tretë (S. D.), me sa duket, kishte blerë banesën në një periudhë të papërcaktuar ndërmjet vitit 1991 dhe 1999, sipas Ligjit për banim. Për më tepër, në një kohë të papërcaktuar pas vitit 2000, S.D. pretendohet se ia kishte shitur banesën një pale tjetër (A.G).

Në një kohë të pacaktuar, pas vitit 2000, parashtruesja e dytë kishte parashtruar kërkesë në DÇPB, duke kërkuar konfirmimin e të drejtave të saj për ta shfrytëzuar banesën. Më 31 mars 2006, KKPB kishte nxjerrë vendim me të cilin kishte vërtetuar se parashtruesja e dytë ishte bartëse e ligjshme e së drejtës së shfrytëzimit të banesës. Palës së tretë (S.D.) i ishin njohur të drejtat e parashtruesit të kategorisë C (kompensimi). Në një datë të papërcaktuar, banuesi faktik i banesës (A.G.) kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të KKPB-së dhe më 11 dhjetor 2006, KKPB-ja nxori vendimin grupor, përmes të cilit, ndër të tjera, kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë. Më 14 gusht 2008, parashtruesja e dytë dorëzoi një kërkesë në AKP, si pasardhëse juridike e DÇPB-së, duke kërkuar përmbarimin e vendimeve të KKPB-së. Më 4 shtator 2008, AKP-ja iu përgjigj parashtrueses së dytë të kërkesës, duke argumentuar, ndër të tjera, se ende nuk ishte përcaktuar procedura apo përqindja e kompensimit për këtë lloj të kërkesave që hyjnë në grupin e kompensimit të ndërsjellë. Më 23 shkurt 2012, parashtruesja e dytë i ishte drejtuar përsëri me një shkresë të re AKP-së, duke kërkuar përmbarimin e vendimit të KKPB-së, të 11 dhjetorit 2006. Më 5 mars 2012, AKP-ja me një shkresë të re i ishte përgjigjur parashtrueses së dytë në mënyrë pothuajse identike si në shkresën e parë të saj. Më 28 gusht 2012, parashtruesja e dytë e kërkesës i ishte drejtuar me një shkresë koordinatorit të Misionit të EULEX-it për çështje pronësore, duke kërkuar që EULEX-i t'i shfrytëzonte kompetencat e veta dhe ta përshpejtonte procedurën në AKP. Më 20 shtator 2012, koordinatori i Misionit të EULEX-it i ishte përgjigjur, duke theksuar se nëse parashtruesja konsideronte se asaj i ishte cenuar e drejta kushtetuese për shqyrtim të drejtë publik dhe për ekzekutimin e vendimit të marrë në dobinë e saj, ajo mund të parashtronte ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Më 13 shtator 2012, parashtruesja e dytë kishte dorëzuar kërkesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit, duke kërkuar ndërhyrje për përshpejtimin e procedurës së përmbarimit të vendimeve të KKPB-së. Më 22 korrik 2013, parashtruesja e dytë i ishte drejtuar përsëri AKP-së, me qëllim të njoftimit për vdekjen e burrit të saj dhe për të përsëritur kërkesën e saj për ekzekutimin e vendimeve të KKPB-së. Më 24 korrik 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit kishte njoftuar parashtruesen e dytë lidhur me rezultatet e hetimit, duke informuar se Avokati i Popullit kishte pranuar një përgjigje nga AKP-ja ku theksohej se kërkesa e z. Tus ishte duke pritur ekzekutimin nga ana e AKP-së. AKP kishte informuar se Agjencia Kosovare e Pronës

së bashku me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët po bënë përpjekje për krijimin e fondeve për zbatimin e këtyre vendimeve, por që ata aktualisht nuk ishin në gjendje të përcaktonin datën kur do të ekzekutohej vendimi në lidhje me kërkesën e z. Tus.

Më 24 shtator 2014, parashtruesi i parë e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese dhe më 10 tetor kërkesën e dorëzoi edhe parashtruesja e dytë. Ata kërkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2000. Më 23 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit pretenduan *inter alia* se për shkak të mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë dhe të detyrueshme të KKPB-së, që ishin në dobi të tyre, atyre u ishin shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe e drejta për gëzimin e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës. Si parashtruesi i parë, ashtu edhe parashtruesja e dytë pretenduan që në sistemin ekzistues ligjor të Kosovës, nuk ekzistonte mjeti efektiv juridik mbi bazën e të cilit do të ishte e mundur të parandalohesh shkelja e mëtutjeshme e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë (përveçse t'i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese).

Arsyetimi i Gjykatës

Duke iu referuar mospërmbarimit të vendimeve të KKPB-së, Gjykata Kushtetuese argumentoi se kompleksiteti i krijimit të një sistemi të akteve nënligjore dhe fondeve për përmbarimin e vendimeve do të ishte dashur të arrihej në një periudhë prej 14 (katërmbëdhjetë) vitesh. Prandaj, nuk mund të gjendej një arsye e vlefshme me të cilën do të arsyetohej moszbatimi i masave (vendimeve) ligjore të cilat ishin vendosur në mandatin, së pari të DÇPB -së dhe më vonë, të AKP-së. Gjykata arsyetoi se barra e mosgjetyes së mekanizmave përkatës për përmbarimin e këtyre dy vendimeve të formës së prerë, binte vetëm mbi AKP-në. Mungesa e mekanizmave implementues të këtij institucioni,

në asnjë mënyre, nuk duhej të ishte arsye për mohimin e së drejtës së parashtruesve të kërkesës për gëzimin e pronës.

Sa i përket pretendimeve lidhur me nenin 46 të Kushtetutës [Mbrojta e Pronës], Gjykata Kushtetuese arsyetoi se vendimi i KKPB-së përbënte pritje legjitime për parashtruesit e kërkesës, se të njëjtit e kishin të drejtën mbi atë pronë. Prandaj, parashtruesit e kërkesës kishin të drejtë të gëzonin në mënyrë paqësore atë pronë.

Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se mospërmbarimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas, për përmbarimin e vendimit të formës së prerë, është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 31 i Kushtetutës), në lidhje me të drejtën për gëzim paqësor të pronës (neni 46 i Kushtetutës).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me neni 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31, 54 dhe 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenet gjegjëse të KEDNJ-së; të deklarojë se vendimet e KKPB-së duhet të përmbroheshin dhe urdhëroi Agjencinë Kosovare të Pronës që të informonte Gjykatën Kushtetuese, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, lidhur me masat e ndërmarra për ta zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. KASMI kundër SHQIPËRISË

[1175/06]

GJEDNJ [Seksioni i Dytë]

23 shtator 2020

Çështja kyçele drejta e pretenduar: shkelje e së drejtës pronësore të përcaktuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të pamundësisë së tij për të rimarrë posedimin e shtëpisë dhe për të marrë të ardhura nga ajo.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Gëzim Kasmi, një shtetas shqiptar (kërkuesi), kundër Republikës së Shqipërisë, më 19 dhjetor 2005. Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, familjet zakonisht jetonin në ambiente shtetërore, të lëshuara si banesa, në përputhje me marrëveshjet e qirasë së banimit të lidhura midis qiramarrësve dhe Kompanisë së atëhershme Shtetërore të Mirëmbajtjes së Banesave (Ndërmarrja Komunale Banesa - “Kompania e Strehimit”). Banesat në pronësi private, të cilat kishin kaluar në pronësi të shtetit përmes legjislacionit mbi shtetëzimin, u ndanë nga Qeveria e atëhershme për familjet - anëtarët e të cilave, si rregull, punonin për shtetin në atë kohë - në bazë të marrëveshjeve të qiramarrjes.

Në vitin 1992, pas përfundimit të regjimit komunist, u miratua Akti i Privatizimit, sipas të cilit banesat në pronësi të shtetit, përveç atyre që më parë ishin pronë private, do t'i nënshtroheshin privatizimit. Në vitin 1993 u miratua Akti i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në tekstin e mëtejshëm: “Akti i Pronës”), sipas të cilit ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre kishin të drejtë të kërkonin kthimin e pronave të shpronësuara ose të shtetëzuara, si dhe kompensim në vend të kthimit. Sidoqoftë, banesat në ato prona zakonisht ishin të zëna nga qiramarrësit që kishin lidhur një marrëveshje qiraje me shtetin.

Babai i kërkuesit zotëronte dy shtëpi të vendosura në Tiranë. Në një datë të papërcaktuar në vitet 1950, të dy pronat u shtetëzuan nga Shteti, të cilat më pas u morën me qira nga familjet. Pas hyrjes në fuqi të Aktit të Pronës më 1993, në një datë të papërcaktuar - ka shumë të ngjarë më 1994 ose 1995 - babai i kërkuesit paraqiti një kërkesë pranë Komisionit të Tiranës për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës (në tekstin e mëtejshëm: “Komisioni”) për kthimin e shtëpive. Rezulton se me një vendim të 27 shtatorit 1995, kopja e të cilit nuk është paraqitur nga palët, Komisioni ia njohu të drejtat pronësore babait të kërkuesit mbi shtëpitë.

Meqenëse kërkuesi nuk mund të rimerrte në posedim një prej shtëpive, pasi ajo ishte e zënë nga qiramarrësit, ai paraqiti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë (në tekstin e mëtejshëm: “Gjykata e Rrethit”) duke kërkuar dëbimin e tyre. Sipas mendimit të tij, qiramarrësit nuk posedonin asnjë të drejtë pronësore në shtëpi, ata kurrë nuk i kishin paguar ndonjë qira dhe nuk ishin ligjërish të pastrehë. Ai argumentoi se, duke qenë pronar i ligjshëm i shtëpisë, zënia e saj nga qiramarrësit kishte cenuar drejtpërdrejt të drejtat e tij pronësore, mbrojtja e të cilave ishte e garantuar me Kushtetutë dhe me Konventë.

Më 17 mars 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë la në fuqi veprimin e kërkuesit dhe urdhëroi që të gjithë qiramarrësit të lirojnë shtëpinë. Qiramarrësit paraqitën një apel në Gjykatën e Apelit Tiranë (në tekstin e mëtejshëm: “Gjykata e Apelit”), e cila më 23 prill 2004 rrëzoi pjesërisht vendimin e Gjykatës së Rrethit për aq sa lidhej me J.D., B.S. dhe M.S. Më 19 korrik 2005, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia njohu të drejtat e padiskutueshme të pronës kërkuesit mbi shtëpinë. Megjithatë, në lidhje me J.D., Gjykata Supreme gjeti se, pasi ai ishte ligjërish i pastrehë, ai kishte zënë ligjërish një nga banesat në bazë të një autorizimi për përdorim që nga viti 1986. Ai kishte marrë më tej një vendim përfundimtar të gjykatës më 1993, i cili mbeti i pazbatuar, duke i dhënë atij të drejtën për vazhdimin e qiramarrësit.

Kështu kërkuesi iu drejtua GJEDNJ-së duke u ankuar për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të pamundësisë së tij për të rimarrë posedimin e shtëpisë së tij dhe për të marrë të ardhura nga ajo.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi parashtroi se atij i ishte hequr posedimi i pronës dhe i të ardhurave nga shfrytëzimi i saj në treg. Ai tutje theksoi se Shteti kishte dështuar të garantonte mirëmbajtjen e pronës, e cila do të kërkonte kosto shtesë për ta kthyer atë në gjendje të mirë. Kërkuesi argumentoi se paragrafi i parë i nenit 1 të Protokollit nr. 1 në Konventë zbatohet në rastin konkret. Sa i përket testit të proporcionalitetit, kërkuesi parashtroi se ish-pronarët nuk i kishin gëzuar plotësisht të drejtat e tyre pronësore gjatë gjithë asaj kohe. Nuk ishte arritur një ekuilibër midis interesave konkurruese; shteti kishte favorizuar qiramarrësit në dëm të të drejtave të ish-pronarëve. Sidoqoftë, në situatën e tij, dëbimi i qiramarrësve nuk do të kishte rezultuar në ndonjë pasojë të rëndë ose shkelje të rendit publik, pasi B.S. dhe M.S. jetonin jashtë vendit kurse J.D jetonte i vetëm.

Për më tepër kërkuesi parashtroi se një qira mujore e ulët u ishte paguar ish-pronarëve, e barabartë me qiranë që kishte ekzistuar para vitit 1990, përkatësisht dy euro në muaj, ndërsa qiraja mujore e tregut të lirë ishte në fakt shumë më e lartë. Së bashku me vëllezërit e motrat e tij ai do të kishte fituar 2,160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) euro në muaj duke lëshuar me qira shtëpinë.

Qeveria parashtroi se paragrafi 2 i nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës duhet të zbatohet në këtë rast. Ata pranuan se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesi në pronë. Sidoqoftë, ndërhyrja ishte parashikuar me ligj dhe kishte ndjekur gjithashtu një qëllim legjitim, domethënë mbrojtjen e të drejtave të qiramarrësve për strehim. Qeveria më tej parashtroi se ndërhyrja kishte origjinën në regjimin komunist dhe kishte të bënte me procesin e tranzicionit të vendit.

Sa i përket testit të proporcionalitetit, Qeveria parashtroi se ndërhyrja kishte lindur në kontekstin e politikave që synonin drejtësinë sociale për individët dhe familjet që kishin nevojë për mbrojtje të së drejtës së tyre për një jetë familjare dhe të drejtën e tyre për një shtëpi. Situata mund të klasifikohet si e jashtëzakonshme. Më konkretisht, procedurat për dëbimin e qiramarrësve do të shoqëroheshin me pasoja të rënda për rendin publik, duke prekur qindra familje. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve administrative që njohin të drejtat pronësore të ish-

pronarëve do të kishte ndikuar në nivelet minimale të jetesës që gëzonin qiramarrësit, ndërsa ish-pronarët, nga ana tjetër, përfitonin nga disa të ardhura si rezultat i pagesës së qirasë.

Qeveria më tej parashtroi se shteti shqiptar ishte përpjekur disa herë për të gjetur një zgjidhje për problemin, por kompleksiteti i situatës dhe fakti që disa masa ishin rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese, do të thoshte se ata nuk e kishin gjetur ende një të tillë. Sidoqoftë, autoritetet vendase kishin marrë dhe ishin ende duke marrë një sërë masash procedurale dhe institucionale për të zgjidhur problemet e banimit të qiramarrësve. Për shembull, autoritetet lokale ishin përgjegjëse për ndërtimin e banesave në mënyrë që t'u siguronin atyre banesa. Procesi i ndërtimit kërkoi një kohë të caktuar për shkak të numrit të madh të familjeve të përfshira, përkatësisht 5,000. Sidoqoftë, ata po merrnin masa për të zgjidhur problemin sa më shpejt të ishte e mundur.

Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte pasur nevojë për strehim. Prona e tij ishte dhënë me qira për persona që kishin status të pastrehë. Prandaj ata kishin paguar një qira, e cila kontrollohej nga Shteti dhe e cila ende nuk ishte rregulluar. Prandaj, nuk mund të thuhet se ndërhyrja vendosi një barrë serioze për kërkuesin dhe pronarët e tjerë të mëparshëm, sepse ishte e një natyre të përkohshme.

Arsyetimi i Gjykatës

Sipas Gjykatës çdo ndërhyrje në pronë gjithashtu duhet të plotësojë kërkesën e proporcionalitetit. Siç është shprehur vazhdimisht Gjykata, duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, kërkimi i një ekuilibri të tillë të drejtë është i natyrshëm në të gjithë Konventën. Në secilin rast që përfshin një shkelje të pretenduar të atij neni, Gjykata duhet të konstatojë nëse për shkak të ndërhyrjes së shtetit, personi në fjalë duhej të mbartte një barrë joproporcionale dhe të tepërt.

Gjykata konsideroi se thelbi kryesor i ankesës së kërkuesit para Gjykatës lidhet me pamundësinë e tij për të rimarrë posedimin e pronës së tij,

e cila ishte zënë nga qiramarrësit në bazë të marrëveshjeve të qirasë. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejti se korniza ligjore përkatëse kishte për qëllim sigurimin e mbrojtjes së strehimit për një kategori të kufizuar qiramarrësish të cilët do të preken nga kthimi i pronave ish-pronarëve në një kontekst kalimtar; si e tillë, ajo nuk përbënte një sistem të përgjithshëm të kontrollit të qirasë në dobi të familjeve me të ardhura të ulëta. Për më tepër, duke u bazuar në marrëveshjen e qirasë të lidhur midis njërit prej qiramarrësve dhe Shtetit, një kopje e së cilës u sigurua nga kërkuesi, Gjykata vërejti se marrëveshja nuk ishte e kufizuar në kohë. Gjykata vlerësoi se detyra e gjykatave vendase ishte sfiduese në një çështje të ndjeshme shoqërore. Ajo vërejti se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë u penguan të vendosnin një ekuilibër të drejtë midis interesave në rrezik për shkak të kufizimeve të vendosura nga legjislacioni kombëtar.

Më e rëndësishmja, kërkuesi nuk kishte asnjë mundësi për të marrë një qira të arsyeshme, duke qenë se niveli i qirasë ishte ngrirë në masën që kishte ekzistuar në vitin 1993 dhe gjatë pjesës tjetër të periudhës në shqyrtim nga Gjykata. Për më tepër, legjislacioni nuk parashikonte ndonjë rregullim të qirasë, duke marrë parasysh ndryshimet e inflacionit. Pas përfundimit të pasuksesshëm të procedurës së dëbimit, kërkuesi nuk kishte mjete të tjera për të përfunduar marrëveshjet e qirasë. Kjo e bëri të pamundur që ai të rimarrë në posedim pronën e tij, duke e bërë atë të varur nga qiramarrësit për të përfunduar marrëveshjet e qirasë. Kjo situatë në mënyrë të pashmangshme e la kërkuesin në një gjendje të pasigurisë 'së përhershme' se a do të jetë në gjendje ai të rimarrë pronën e tij. Përveç kësaj, nuk është treguar se autoritetet kombëtare kanë marrë ndonjë masë konkrete për të siguruar strehim alternativ për qiramarrësit që zënë shtëpinë e kërkuesit gjatë gjithë periudhës në shqyrtim nga Gjykata. Korniza ligjore kombëtare, siç interpretohet nga gjykatat vendase dhe zbatohet nga agjencitë përkatëse zbatuese, në mënyrë efektive vendosi mbi kërkuesin, të gjithë barrën e një situatë komplekse shoqërore.

Në dritën e këtyre konsideratave dhe, veçanërisht, duke pasur parasysh marrëveshjet e qirasë të vendosura me ligj, mungesën e mekanizmave adekuatë që mbrojnë të drejtën e kërkuesit për të përfunduar marrëveshjet e qiramarrësit, përfshirë mungesën e një afati kohor

specifik të përcaktuar me ligj për këtë qëllim, shumën e ulët të qirasë të përcaktuar me ligj, e cila nuk lejonte indeksimin e saj në inflacion, dhe periudhën e gjatë të pasigurisë në të cilën gjendej parashtruesi, Gjykata konstatoi se kërkuesi ishte ngarkuar me një barrë joproporcionale dhe të tepërt dhe nga kjo rrjedh se shteti nuk arriti të krijojë ekuilibrin e duhur të drejtë midis interesave të përgjithshme të komunitetit dhe mbrojtjes së të drejtës së pronësisë të kërkuesit.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Gjykata përcaktoi se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, 30,000 (tridhjetë mijë) euro, plus çdo taksë që mund të paguhet, në emër të dëmit material.

2.3. VUČKOVIĆ DHE TË TJERËT kundër SERBISË

[17153/11, 17157/11, 17160/11, 17163/11, 17168/11, 17173/11, 17178/11, 17181/11, 17182/11, 17186/11, 17343/11, 17344/11, 17362/11, 17364/11, 17367/11, 17370/11, 17372/11, 17377/11, 17380/11, 17382/11, 17386/11, 17421/11, 17424/11, 17428/11, 17431/11, 17435/11, 17438/11, 17439/11, 17440/11 dhe 17443/11]
GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

25 Mars 2014

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: mosngritja e pretendimit për diskriminim, qoftë shprehimisht ose në thelb, në procedurat para Gjykatës Kushtetuese.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga tridhjetë kërkues (kërkesa të ndara) kundër Serbisë të paraqitura në Gjykatë më 14 shkurt 2011. Kërkuesit janë të gjithë shtetas serbë (detajet për të dhënat personale janë paraqitur në shtojcën e aktgjykimit në këtë rast). Kërkuesit ishin rezervistë të ish-

ushtrisë jugosllave, të cilët pretendonin të drejtën për kompensime ditore në lidhje me shërbimin ushtarak që kishin kryer midis marsit dhe qershorit 1999. Qeveria serbe fillimisht i hodhi poshtë pretendimet, por, pas negociatave të zgjatura, në vitin 2008 ra dakord t'u paguante kompensime atyre rezervistëve, të cilët banonin në komunat «e pazhvilluara». Kërkuesit nuk u kualifikuan për pagesë sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, pasi ata nuk ishin banorë në komunat në fjalë dhe kështu, në mars 2009, paraqitën padi civile për pagesë sipas Rregullave për Udhëtimet dhe Shpenzimet e tjera në Ushtrinë Jugosllave. Ata gjithashtu pretenduan se kushtet e marrëveshjes së vitit 2008 ishin diskriminuese. Megjithatë, pretendimet e tyre u refuzuan në shkallën e parë dhe në apel si të paafatshme. Kërkuesit më pas paraqitën ankesë në Gjykatën Kushtetuese duke kundërshtuar zbatimin e periudhës së parashkrimit në rastet e tyre. Megjithëse Gjykata Kushtetuese vendosi në favor të tyre në lidhje me ankesat e tyre për jokonsistencë gjyqësore në zbatimin e periudhës së parashkrimit, ajo vendosi që publikimi i vendimit të saj në Gazetën Zyrtare përbënte korrigjim të mjaftueshëm. Ndërkohë, në një numër rastesh të ngjashme, që u vendosën midis vitit 2002 dhe fillimit të marsit 2009, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Serbi mbështetën kërkesat e rezervistëve të caktuar, të cilat nuk ishin deklaruar të parashkruara.

Përmbledhja e pretendimeve

Në ankesën e tyre në Gjykatën Evropiane, kërkuesit u ankuan për diskriminim në lidhje me pagesën e mëditjeve pas marrëveshjes së vitit 2008. Në një aktgjykim të 28 gushtit 2012, një Dhomë e Gjykatës vendosi, me gjashtë vota për dhe një kundër, se kishte pasur shkelje të nenit 14 të Konventës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Para Dhomës së Madhe, Qeveria e paditur argumentoi se ankuesit nuk kishin shteruar mjetet juridike të brendshme pasi nuk kishin arritur të ngrinin çështjen e diskriminimit të pretenduar para Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesit u ankuan për diskriminim që rrjedh nga marrëveshja e vitit 2008, duke u mbështetur në nenin 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, dhe në nenin 1 të Protokollit nr. 12.

Kontestuese midis kërkuesve dhe Qeverisë ishte nëse ankesa kushtetuese ishte një mjet juridik efektiv i brendshëm. Qeveria parashtroi se ky ishte

një mjet juridik efektiv i brendshëm, i cili duhej të shterohej siç duhet, që do të thotë në veçanti: thelbi i ankesës, diskriminimi i pretenduar, duhej të ishte ndjekur. Për më tepër, sipas mendimit të Qeverisë, kërkesit nuk u mbështetën në Aktin e Ndalimit të Diskriminimit as në procedurat e mëparshme. Nga ana tjetër, kërkesit argumentuan se ata kishin ngritur thelbin e çështjes së diskriminimit në shkallën e parë dhe në apel. Në lidhje me procedurat para Gjykatës Kushtetuese, ata argumentuan se i kishin dhënë Gjykatës Kushtetuese mundësinë për të shqyrtuar çështjen e diskriminimit, pasi çështja përkatëse gjendej në shkresat e lëndës; për më tepër, ata konsideruan se ankimi kushtetues ishte një mjet juridik thjesht teorik, i cili nuk kishte nevojë të shterohej.

Sipas Qeverisë kërkesit nuk e kishin shteruar siç duhet rrugën kushtetuese. Padyshim, ata i ishin referuar Marrëveshjes në ankesën e tyre kushtetuese, por ata nuk kishin kërkuar “mbrojtje nga diskriminimi”. Për më tepër, kërkesit ishin mbështetur në mënyrë specifike në nenet 32 dhe 36 të Kushtetutës, që garantojnë respektivisht të drejtën për një shqyrtim të drejtë dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë para gjykatave, por nuk kishin bërë asnjë referencë në nenin 21 të Kushtetutës, i cili ndalonte diskriminimin. Në rrethana të tilla, e lidhur me ankesat e kërkesve, Gjykata Kushtetuese nuk mund të kishte shqyrtuar diskriminimin e pretenduar. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 17 shkurtit 2011 hodhi poshtë ankesën kushtetuese “në baza procedurale”, prandaj ankesa për diskriminim nuk u diskutua kurrë në thelbin e saj.

Së fundmi, Qeveria argumentoi se që nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 7 nëntorit 2012 (Už. nr. 2157/11), dhe veçanërisht pas vendimit në favor të kërkesve të dhënë nga ajo gjykatë më 5 dhjetor 2012, parashtruesit mund të kishin paraqitur një kërkesë për rihapjen e padisë së tyre civile, bazuar në dispozitat përkatëse të Aktit të Gjykatës Kushtetuese ose të Aktit të Procedurës Civile.

Kërkesit në anën tjetër pohuan se ata kishin respektuar kërkesën e shterimit të mjeteve efektive të brendshme. Vetë Gjykata kishte deklaruar prej kohësh se parimi i subsidiaritetit nuk ishte absolut, që do të thotë se mjetet juridike që nuk janë adekuate ose efektive në rrethanat e veçanta të një rasti, nuk duhet të shterohen. Sa i përket kompensimit civil, kërkesit

theksuan se kur e kuptuan se Marrëveshja nuk do të zbatohet për ta, ata kishin paraqitur një kërkesë civile. Duke vepruar kështu, ata kishin ngritur në thelb çështjen e diskriminimit para Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe Gjykatës së Apelit, dhe kërkuan të vendoseshin në një pozitë të barabartë me ata rezervistë që përfituan nga Marrëveshja. Por kjo “do t’i kushtonte shtetit shumë para” dhe “ishte një mundësi për gjyqtarët që i mbijetuan reformave gjyqësore të vitit 2009” për t’i “shërbyer interesit” të Qeverisë që i kishte “kursyer ata nga shkarkimi”. Kështu, sipas kërkuesve gjykatat përkatëse vendase e shpërfillën plotësisht qëllimin e kërkesës së kërkuesve dhe e hodhën poshtë si të paafatshme, pa vendosur ndonjëherë mbi diskriminimin e pretenduar. Kërkuesit vunë re se diskriminimi në fjalë kishte ndodhur në vitin 2008, kur u arrit Marrëveshja.

Lidhur me ankesën kushtetuese, kërkuesit pranuan se nuk e kishin pritur rezultatin e atyre procedurave para se të paraqisnin kërkesat e tyre në Gjykatë. Sidoqoftë, kjo nuk duhet të mbahet kundër tyre, duke pasur parasysh llojin e vendimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese, para dhe pas asaj date. Këto përfshinin, ndër të tjera, vendimin e 5 dhjetorit 2012 në rastin aktual, ku parashtruesve nuk iu dha asnjë dëmshpërblim i atillë që do t’i vendoste ata në të njëjtën situatë me rezervistët që kishin përfituar nga Marrëveshja. Ndërsa ishte e vërtetë që kërkuesit nuk ishin mbështetur në nenin 21 të Kushtetutës në ankesën e tyre, Gjykata Kushtetuese mund të kishte shqyrtuar çështjen e diskriminimit pasi kishte informacione relevante për të në dosjen e çështjes (në mbështetje të këtij argumenti parashtruesit iu referuan vendimit të Gjykatës Kushtetuese UŽ, nr. 2156/11). Në raste të tjera, megjithatë, kur rezervistët kishin ngritur në mënyrë specifike çështjen e diskriminimit që buronte nga Marrëveshja dhe ishin mbështetur për këtë, në nenin 21 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese kishte bërë të kundërtën dhe nuk kishte asnjë detyrim që ta merrte parasysh (shih, për shembull, UŽ. 43/11). Arsyetimi në të gjitha vendimet në lidhje me rastet si ato të kërkuesve ishte praktikisht identik dhe përbëhej nga formula të gatshme. Sidoqoftë, në disa raste, Gjykata Kushtetuese kishte gjetur se kishte pasur një trajtim të ndryshëm në shkelje të Kushtetutës bazuar në aspektin e moskonsistencës gjyqësore të çështjes, por thjesht kishte urdhëruar publikimin e vendimeve të saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, si një formë kompensimi.

Duke pasur parasysh sa më sipër, kërkuesit parashtruan përfundimisht se nuk mund të ketë dyshim se ankesa kushtetuese ishte një mjet thjesht teorik, duke pasur parasysh kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik dhe situatën e rezervistëve në veçanti (shih paragrafët 30 dhe 32 të Aktgjykimit të Dhomës, dhe gjithashtu vendimet e Gjykatës Kushtetuese U.ž. nr. 2156/11, 43/11, 2886/10, 649/11 dhe 2021/11).

Arsyetimi i Gjykatës

Në arsyetimin e saj, Gjykata fillimisht rikujtoi se ajo merret me mbikëqyrjen e zbatimit nga shtetet kontraktuese të detyrimeve të tyre sipas Konventës. Si e tillë, Gjykata nuk merr rolin e shteteve kontraktuese, përgjegjësia e të cilave është të sigurojnë që të drejtat dhe liritë themelore të përfshira në Konventë të respektohen dhe të mbrohen në nivel të brendshëm. Shtetet nuk përgjigjen para një organi ndërkombëtar për veprimet e tyre para se të kenë pasur një mundësi për të rregulluar çështjet përmes sistemit të tyre ligjor, dhe ata që thirren në juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës në lidhje me ankesat kundër një shteti, janë të detyruar të përdorin së pari mjetet juridike të siguruara nga sistemi juridik kombëtar.

Në rastin konkret, Gjykata vërejti se sipas neneve 199 dhe 200 të Aktit të Detyrimeve, një rezervist i cili kishte shërbyer në ushtri midis marsit dhe qershorit 1999 mund të fillonte procedura para gjykatave civile kundër autoriteteve të shtetit të paditur dhe në kushte të caktuara të kërkonte kompensim për shkak të çfarëdo mospagimi të mëditjeve nga ato autoritete sipas Rregullave për Udhëtimet dhe Shpenzimet e tjera në Ushtrinë Jugosllave dhe dy vendimet e veçanta (nr. 03/825-2 dhe 06/691-1) miratuar nga Shefi i Shtabit të saj, më 1, respektivisht 3 prill 1999. Në rastin në shqyrtim, më 26 mars 2009, kërkuesit paraqitën padi civile kundër Shtetit të paditur bazuar në Rregullat e lartpërmendura mbi Udhëtimet dhe Shpenzimet e tjera në Ushtrinë Jugosllave dhe vendimet e miratuara nga Shefi i Shtabit të saj. Me anë të dëmshpërblimit ata kërkuan pagesën e shumave të veçanta për shkak të mëditjeve të pretenduara të papaguara dhe gjithashtu disa përfitime të tjera. Kërkuesit nuk e mbështetën kërkesën e tyre në ndalimin e diskriminimit në nenin 21 të Kushtetutës, ose në klauzolat e mosdiskriminimit në nenin 14 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit

nr. 12, edhe pse këto ishin drejtpërdrejt të zbatueshme sipas nenit 18 të Kushtetutës. Ata as nuk u thirrën në Aktin e Ndalimit të Diskriminimit, i cili hyri në fuqi me efekt të menjëhershëm më 7 prill 2009, menjëherë pasi ishte ngritur padia civile e lartpërmendur. Në parashtrimet e tyre të bëra në mbështetje të kërkesës së tyre, kërkuarit iu referuan diskriminimit të pretenduar që rrjedh nga Marrëveshja.

Gjykata e Shkallës së Parë edhe pse pranoi se pretendimi i kërkuarve kishte një bazë ligjore të vlefshme, më 8 korrik 2010, e hodhi poshtë atë si të parashkruar për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit trevjeçar të përcaktuar në nenin 376.1 të Akti të Detyrimeve, duke pasur parasysh se afati kohor kishte filluar që nga momenti i çmobilizimit të tyre. Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e tyre më 16 nëntor 2010 për arsye të ngjashme, domethënë që periudhat e parashkrimit trevjeçar dhe pesëvjeçar të parashikuara në nenin 376. paragrafët 1 dhe 2, kishin skaduar.

Gjykata ritheksoi se u takon në radhë të parë autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, për të zgjidhur problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm (shih *Pérez de Rada Cavanilles kundër Spanjës*, 28 tetor 1998, paragrafi 43, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998 - VIII; *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 26083/94, paragrafi 54, KEDNJ 1999 - I; dhe *Anđelković kundër Serbisë*, nr. 1401/08, paragrafi 24, 9 prill 2013). Sipas interpretimit të dhënë nga gjykatat civile, kërkuarit nuk kishin respektuar rregullat kombëtare të zbatueshme të parashkrimit, i cili është një nga kushtet që normalisht duhet të përmbushet për të respektuar kërkesën e shterimit të mjeteve juridike të brendshme sipas nenit 35.1 të Konventës.

Sipas pikëpamjes së Dhomës së Madhe, mjeti kushtetues do të kishte ofruar perspektivë të arsyeshme suksesi në lidhje me ankesën për diskriminim të kërkuarve, nëse ata do të kërkonin ta ngrinin atë siç duhet para Gjykatës Kushtetuese. Në këtë sfond, Gjykata konstatoi se, megjithëse mjetet juridike civile dhe kushtetuese ishin të mjaftueshme dhe të disponueshme për të kërkuar dëmshpërblimin në lidhje me shkeljet e pretenduara, kërkuarit nuk arritën t'i shteronin këto mjete juridike. Gjykata vërejti se, megjithëse pretendimi i kërkuarve për mëditjet në fjalë që datojnë nga viti 1999, nuk është dhënë asnjë

shpjegim bindës se pse ata nuk filluan procedura për të siguruar kthimin e borxheve të pretenduara më herët.

Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes në tërësi, Gjykata konstatoi se nuk kishte ndonjë arsye të veçantë për të përjashtuar kërkesit nga kërkesa për të shteruar mjetet juridike të brendshme në përputhje me rregullat dhe procedurën në fuqi të së drejtës së brendshme. Kështu, kërkesit dështuan të ndër marrin hapat e duhur për t'i mundësuar gjykatave kombëtare të përmbushin rolin e tyre themelor në sistemin e mbrojtjes së drejtave të njeriut. Prandaj, Dhoma e Madhe mbështeti kundërshtimin paraprak të Qeverisë në lidhje me ankesën për diskriminim të kërkesve. Dhe nuk mundi të marrë parasysh bazueshmërinë e kësaj ankese.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata mbështeti kundërshtimin paraprak të Qeverisë në lidhje me dështimin e kërkesve për të shteruar mjetet juridike të brendshme në lidhje me ankesën e tyre të diskriminimit sipas nenit 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit nr. 1, dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12, dhe rrjedhimisht konsideroi se nuk mund të marrë parasysh bazueshmërinë e kësaj ankese.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështja C235/17

21 maj 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=214283&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13716317>]

Çështja kyçe le drejta e pretenduar: Duke hequr të drejtat e usufuktit që mbahen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shtetasit e shteteve të tjera anëtare në tokat bujqësore në territorin e saj, Hungaria ka shkelur detyrimet e saj sipas parimit të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe të drejtës së pronës të garantuar nga Karta

Faktet kryesore

Në vitin 2013, Hungaria miratoi një ligj (në tekstin e mëtejshëm: “Ligji i 2013”) sipas të cilit të drejtat e usufuktit mbi tokën bujqësore dhe pyjore të fituara më parë nga persona juridikë ose nga persona fizikë, të cilët nuk mund të justifikojnë një marrëdhënie të ngushtë me pronarin e këtyre tokave, duhej të anulohen *ex lege*, pa parashikuar asnjë kompensim për këta persona. Në mbështetje të këtij ligji, Hungaria argumentoi se kontratat përkatëse të usufuktit kishin anashkaluar ndalimet për fitimin e pronësisë mbi tokën bujqësore në fuqi para hyrjes së Hungarisë në BE dhe se ata, për më tepër, kishin shpërfillur dispozitat kombëtare për kontrollin e këmbimit të zbatueshme në atë kohë, kështu që ata ishin, pra, *nul ab initio* para këtij aderimi. Ajo gjithashtu iu referua objektivave të ndryshme të politikës bujqësore, përkatësisht për të siguruar që toka bujqësore prodhuese të jetë në pronësi vetëm të personave fizikë që e punojnë atë dhe jo për qëllime spekulative, për të parandaluar copëzimin e fondeve dhe për të ruajtur

një popullsi rurale dhe bujqësi të qëndrueshme, si dhe për krijimin e fermave të zbatueshme dhe konkurruese.

Me pretendimin se, duke miratuar kufizimet në lidhje me të drejtën e uzufuktit mbi tokën bujqësore të përfshira në disa dispozita të Ligjit të vitit 2013 mbi masat kalimtare, përfshirë nenin 108.1 të tij, Hungaria kishte shkelur nenet 49 dhe 63 të TFBE-së si dhe nenin 17 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejshëm: “Karta”), më 17 tetor 2014 Komisioni i dërgoi qeverisë hungareze një letër njoftimi zyrtar. Kjo e fundit u përgjigj me letrën e 18 dhjetorit 2014, në të cilën kundërshtoi shkeljet e përmendura.

Më 19 qershor 2015, Komisioni dha një opinion të arsyetuar në të cilin ai u shpreh se, duke hequr disa të drejta të usufuktit, me efekt nga 1 maji 2014, me nenin 108.1 të Ligjit të vitit 2013 për masat kalimtare, Hungaria kishte ka shkelur dispozitat e së drejtës së BE-së të përmendura në pikën e mëparshme. Qeveria hungareze iu përgjigj Komisionit me letrat e 9 tetorit 2015 dhe 18 prillit 2016, duke argumentuar se shkeljet e pretenduara nuk ekzistonin.

Në këto rrethana, Komisioni vendosi të paraqesë këtë padi para Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Komisionit pretendoi se, duke miratuar nenin 108.1 të Ligjit të vitit 2013 për masat kalimtare dhe duke anuluar, *ex lege*, të drejtat e usufuktit të krijuara më parë, midis personave që nuk janë anëtarë të afërt të së njëjtës familje në tokën bujqësore në Hungari, ky Shtet anëtar ka shkelur detyrimet e tij sipas neneve 49 dhe 63 të TFBE-së si dhe nenit 17 të Kartës.

Vendimi i Gjykatës

Pasi vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej Ligji i vitit 2013 nën dritën e nenit 49 të TFBE-së, Gjykata konstatoi se, duke parashikuar anulimin *ex lege* të të drejtave të usufuktit mbi tokën bujqësore nga persona që nuk mund të provojnë një afërsi marrëdhënieje familjare me pronarin e një toke të tillë, përfshirë shumë shtetas të shteteve të tjera anëtare, ky ligj kufizoi, përmes vetë objektit të tij dhe për shkak të këtij fakti të vetëm, të drejtën e palëve të interesuara për lëvizjen e lirë të kapitalit të garantuar me nenin 63 të TFBE-së. Në të vërtetë, kjo

rregullore kombëtare u heq atyre mundësinë për të vazhduar të gëzojnë të drejtën e tyre të usufuktit dhe mundësinë e tjetërsimit të kësaj të drejte. Ky rregullim ka gjithashtu të ngjarë të pengojë personat që nuk janë rezidentë të investojnë në Hungari në të ardhmen.

Në këto rrethana, Gjykata konsideroi se ishte e nevojshme të shqyrtohej nëse kufizimi në fjalë mund të justifikohet për arsye që kanë përparësi në interesin publik ose nga arsyet e përmendura në nenin 65 të TFBE-së, dhe, në veçanti, nëse ai ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu kujtoi se të drejtat themelore të garantuara me Kartë synohen të zbatohen në të gjitha situatat e rregulluara nga e drejta e BE-së dhe se, për këtë arsye, ato duhet të respektohen kur një rregullore kombëtare bie brenda fushës së zbatimit të kësaj të drejte. Ky është rasti, në veçanti, kur legjislacioni kombëtar mund të cenojë një ose më shumë nga liritë themelore të garantuara nga TFBE dhe shteti anëtar në fjalë iu referohet arsyeve të referuara në nenin 65 të TFBE-së ose arsyeve që i referohen interesit të përgjithshëm të njohura nga e drejta e BE-së për justifikimin e pengesave të tilla. Në një rast të tillë, legjislacioni kombëtar në fjalë mund të justifikohet vetëm nëse përputhet me të drejtat themelore, respektimin e të cilave e siguron Gjykata. Në këtë drejtim, përdorimi nga një shtet anëtar i përjashtimeve të parashikuara nga e drejta e BE-së për të justifikuar një cenim të lirive themelore të garantuara nga Traktati duhet të konsiderohet si “zbatim i së drejtës së BE-së”, në kuptimin e nenit 51.1 të Kartës.

Në këto kushte, Gjykata shqyrtoi pajtueshmërinë e Ligjit të vitit 2013 me të drejtën e BE-së nën këndvështrimin e përjashtimeve të parashikuara nga Traktatet dhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe të drejtat themelore të garantuara me Kartë, ndër të cilat me të drejtën e pronësisë të sanksionuar në nenin 17 të kësaj të fundit, të cilin Komisioni pretendoi se ishte shkelur në rastin konkret.

Në lidhje me nenin 17 të Kartës, Gjykata së pari sqaroi se mbrojtja e njohur nga paragrafi 1 i këtij neni lidhet me të drejtat që kanë një vlerë ekonomike nga të cilat rrjedh, duke pasur parasysh rendin juridik në fjalë, një pozicion juridik i fituar duke lejuar një ushtrim të pavarur të

këtyre të drejtave nga dhe për përfitimin e bartësit të tyre. Sipas Gjykatës, është e qartë se të drejtat e usufruktit në fjalë kanë një vlerë ekonomike dhe i japin bartësit një pozitë të fituar juridike, edhe pse mundësia për t'i transferuar këto të drejta tilla është e kufizuar ose e përjashtuar sipas ligjit kombëtar në fuqi. Në fakt, blerja, me anë të kontratës, e të drejtave të tilla të usufruktit në tokën bujqësore shoqërohet, në parim, me pagesën e një çmimi. Këto të drejta u lejojnë titullarëve të tyre të gëzojnë një tokë të tillë, veçanërisht për qëllime ekonomike, apo edhe, kur është e përshtatshme, t'ua japin me qira palëve të treta, dhe kështu përfshihen në fushën e veprimit të nenit 17.1 të Kartës.

Së dyti, Gjykata vendosi që të drejtat e usufruktit, të cilat i anuloi Ligji i vitit 2013, duhet të konsiderohen si të "fituara ligjërisht", në kuptimin e kësaj dispozite të Kartës. Në fakt, ato të drejta ishin krijuar në një kohë kur krijimi i të drejtave të tilla nuk ishte i ndaluar nga legjislacioni në fuqi dhe nuk ishte vërtetuar nga Hungaria se këto të drejta ishin të pavlefshme për shkak të një shkeljeje të legjislacionit kombëtar lidhur me kontrollin e këmbimit në atë kohë. Përveç kësaj, të njëjtat të drejta u regjistruan sistematikisht në regjistrat e tokës nga autoritetet kompetente kombëtare dhe ekzistenca e tyre u konfirmua me një ligj të miratuar më 2012.

Së treti, Gjykata vendosi që Ligji i vitit 2013 nuk përmban kufizime në përdorimin e pronës, por privim të pronës, në kuptimin e nenit 17.1 të Kartës. Kjo për arsye se, pavarësisht se të drejtat e usufruktit nuk i kanë kaluar autoritetit publik, zhdukja e tyre ka çuar në rivendosjen e pronësisë së plotë të tokës në fjalë në dobi të pronarëve.

Në fund të kësaj analize, Gjykata specifikoi, megjithatë, se ushtrimi i të drejtave të garantuara me Kartë mund të kufizohet me kusht që ky kufizim të parashikohet me ligj, të respektojë thelbin e të drejtave të përmendura dhe që, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, të jetë i nevojshëm dhe në mënyrë efektive të përmbushë objektivat në interes të përgjithshëm të njohura nga BE-ja ose nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Në këtë drejtim, një lexim i kombinuar i nenit 17.1 dhe nenit 52.1 të Kartës çon në përfundimin se, kur pretendohet një interes publik për të justifikuar privimin e pronës, është e nevojshme që të sigurohet respektimi i parimit të proporcionalitetit të

parashikuar në nenin 52.1 të Kartës nën dritën e këtij interesi. Një lexim i tillë do të thotë gjithashtu se, mospasja e një interesi publik që mund të justifikojë privimin e pronës, ose, kur ai ekziston por që nuk përmbush kushtet e përcaktuara në fjalinë e dytë të nenit 17.1 të Kartës, shkelet e drejta e pronës e garantuar me atë dispozitë.

Në lidhje me këtë, Gjykata pranoi që rregulloret kombëtare mund të kufizojnë lëvizjen e lirë të kapitalit, në emër të objektivave të tillë si ata të referuar nga Hungaria në mbështetje të Ligjit të vitit 2013. Megjithatë ajo vendosi që ligji në fjalë, në mungesë të provave, nuk mund të pranohet se ndjek në mënyrë efektive objektiva të tillë, as se është në gjendje të garantojë arritjen e tyre. Gjykata shtoi se ky ligj shkon, në çdo rast, përtej asaj që është e nevojshme për t'i arritur ato. Për të njëjtat arsye, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte interesa publike të tillë që të justifikonin privimin e pronës që rezultonte nga anulimi i të drejtave të usufruktit në fjalë.

Në lidhje me privimin e pronës, Gjykata shtoi se, në çdo rast, Ligji i vitit 2013 nuk plotëson kërkesën për pagesën e kompensimit të drejtë në kohë, të parashikuar në nenin 17.1, fjalina e dytë, e Kartës. Në të vërtetë, ky ligj nuk përmban asnjë dispozitë që parashikon kompensimin e mbajtësve të të drejtave të usufruktit të shpronësuar dhe referenca e thjeshtë, e parashtruar nga Hungaria, në rregullat e përgjithshme të së drejtës civile nuk mund të plotësojë këtë kërkesë. Në këtë rast, një referim i tillë do të vendoste mbi titullarët e të drejtave të usufruktit barrën e fillimit të padive, përmes procedurave të cilat mund të rezultojnë të gjata dhe të kushtueshme, për kompensimin që mund t'u detyrohet atyre pronari i tokës. Rregulla të tilla të së drejtës civile nuk bëjnë të mundur përcaktimin në mënyrë të lehtë dhe mjaftueshëm të saktë ose të parashikueshme nëse mund të merret në të vërtetë kompensimi në fund të një procedure të tillë, dhe as të dihet se cila do të jetë natyra e atij kompensimi.

Neni 47

E Drejta për Arsimin

- 1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike.*
- 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS²⁰²

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. MÛRSEL EREN kundër TURQISË

[60856/00]

GJEDNJ [Seksioni i Dytë]

7 shkurt 2006

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: anulimi i rezultateve të suksesshme të një kandidati që merr pjesë në provimet e pranimit në universitet duke pasur parasysh rezultatet e tij të dobëta në vitet e mëparshme.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Mürsel Eren (kërkuesi), një shtetas turk, kundër Republikës së Turqisë, paraqitur në Gjykatë më 26 qershor 2000.

Kërkuesi iu nënshtrua një provimi pranues në universitet për herë të parë në vitin 1994, pasi kishte mbaruar shkollën e mesme. Provimi, i cili organizohet çdo vit nga Qendra e Përzgjedhjes dhe Vendosijes së Studentëve të Këshillit të Arsimit të Lartë (në tekstin e mëtejshëm: “OSYM”), përbëhet nga një provim me dy nivele me shumë zgjedhje. Kërkuesi nuk arriti të kalonte fazën e parë të provimit në përpjekjet e tij për dy vitet në vijim. Në vitin 1997, kërkuesi ndoqi një kurs privat për t’u përgatitur për provimin. Atë vit dha provimin e parë dhe kaloi në fazën e dytë. Pas provimit të dytë, ai besoi se kishte pasur sukses.

²⁰² Në lidhje me nenin 47 [E drejta për arsimin] shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të paraqitur më lart KI 36/11, me parashtruese: Arjeta Halimi.

Mirëpo emri i tij nuk u shpall në listën e studentëve të suksesshëm. Më pas ai u informua nga OSYM se kishte marrë një nga rezultatet më të larta në mesin e studentëve në provimin e dytë, por se rezultatet e tij ishin anuluar me këshillën e një këshilli akademik, të përbërë nga tre profesorë, i cili konstatoi se, duke marrë parasysh rezultatet e dobëta në vitet e mëparshme, nuk mund të shpjegoheshin arritjet e tij të shkëlqyera. Autoritetet pretenduan se kjo ishte në përputhje me rregulloret e OSYM-së. Kërkuesi inicioi procedurat në gjykatat administrative duke kërkuar pezullimin dhe anulimin e vendimit të OSYM-së. Edhe pse gjyqtari raportues (relator) i Gjykatës së Lartë Administrative vlerësoi se vendimi i OSYM-së bazohej në supozim të pastër dhe duhej të anulohet, shumica e gjyqtarëve e refuzuan kërkesën, duke e konsideruar të pashpjegueshme që një student që kishte marrë rezultate shumë të dobëta në provimet e mëparshme, mund të ishte aq i suksesshëm në provimet e mëpasshme. Apelet e njëpasnjëshme të kërkuesit u hodhën poshtë me arsyetimin se ai nuk mund të kishte arritur rezultatin nëpërmjet njohurive dhe aftësive të tij.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u ankua se vendimi i ÖSYM-së për anulimin e rezultateve të provimit të tij i mohoi arbitrarisht të drejtën e tij për arsimim sipas nenit 2 të Protokollit nr. 1. Ai parashtrij se vendimi i ÖSYM-së, i cili bazohej në rekomandimin e një këshilli akademik, nuk kishte asnjë bazë ligjore. Ai argumentoi se i kishte plotësuar kushtet e hyrjes në universitet pasi kishte kaluar me sukses provimin pa pasur asnjë dyshim për parregullsi, por se këto fakte nuk ishin marrë parasysh nga gjykatat administrative. Në lidhje me referencat e Qeverisë për performancën e tij të pasuksesshme gjatë gjithë arsimit të mesëm, kërkuesi parashtrij se ai kishte përfunduar arsimin e mesëm në Diyarbakır, në juglindje të Turqisë, gjatë një periudhe kur dhuna në atë rajon ishte në kulmin e saj. Ai argumentoi se Diyarbakır ndodhej në një rajon i cili ishte mjaft i pazhvilluar në krahasim me rajonet e tjera të Turqisë. Për më tepër, cilësia e mësimdhënies ishte gjithashtu shumë më e ulët se në shkollat në pjesë të tjera të Turqisë, pasi shumica e mësuesve të emëruar në Turqinë juglindore ose kishin kërkuar të postoheshin diku tjetër ose kishin dhënë dorëheqjen për shkak të shqetësimit për sigurinë e tyre. Një numër i konsiderueshëm i orëve gjatë arsimit të mesëm duhej të anulohet për shkak të mungesës së mësuesve.

Në mbështetje të argumentit të tij, kërkuesi iu referua informacionit të dhënë nga Qeveria në lidhje me tetëmbëdhjetë kandidatët e tjerë, rezultatet e provimit të të cilëve ishin anuluar atë vit (shih paragrafin 35 të vendimit në këtë rast). Pothuajse të gjithë këta kandidatë kanë ardhur nga lindja apo juglindja e Turqisë.

Kërkuesi theksoi se nuk ishte argumenti i tij se shteti kishte një detyrim pozitiv për t'i siguruar atij një arsim universitar. Përkundrazi, ai pretendoi se kishte fituar të drejtën për arsimim, në përputhje me ligjin e brendshëm, dhe se kjo e drejtë nuk duhet të shkelej në mënyrë të paligjshme. Sipas mendimit të kërkuesit, vendimi i këshillit akademik ishte arbitrar dhe cenonte të drejtën e tij për arsimim në kuptim të nenit 2 të Protokollit nr. 1.

Sipas Qeverisë, ÖSYM kishte ushtruar diskrecionin e saj për t'i mohuar kërkuesit qasjen në arsimin universitar duke pasur parasysh vendosjen e drejtë të studentëve. Duke iu referuar *Masson dhe Van Zon kundër Holandës* (28 shtator 1995, paragrafi 51, Seria A nr. 327-A), Qeveria argumentoi se ÖSYM kishte një diskrecion të gjerë në këtë çështje, saqë, në fakt, nuk kishte asnjë të drejtë reale që pranimit në universitet njihej në ligj. Qeveria arriti në përfundimin se kërkuesi nuk kishte përmbushur kushtet e pranimit në arsimin e lartë të përcaktuara nga ÖSYM, dhe për këtë arsye nuk i ishte mohuar e drejta për arsimim.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësim të pretendimeve, Gjykata theksoi se në kontekst të nenit 2 të Protokollit nr. 1, nuk diskutohej që kërkuesi nuk ishte në gjendje të fitonte qasje në arsimin universitar, pavarësisht se kishte marrë notat dhe kishte arritur vlerësimin e kërkuar. Prandaj, zbatoheshin garancitë e kësaj dispozite. Qeveria nuk kishte vënë në dukje ndonjë bazë ligjore për diskrecionin e ÖSYM-së për të anuluar rezultatet e provimeve të kandidatëve për shkak të paaftësisë së tyre për të shpjeguar suksesin e tyre. Në çdo rast, çdo bazë ligjore që jep një diskrecion kaq të gjerë, mund të krijojë pasiguri juridike të papajtueshme me sundimin e ligjit, ose do të dëmtonte vetë thelbin e së drejtës për arsimim. Gjithashtu, Gjykata vërejti se rezultatet e arritura nga pjesëmarrësit u llogaritën në një mënyrë shumë të përpunuar, gjë që nuk u dha autoriteteve

liri për të zëvendësuar rezultatet e sistemeve të kompjuterizuara që shënonin fletët e provimit me pikëpamjet e tyre personale. Për më tepër, formulimi i Rregullores së OSYM-së i lejoi një student të mirëbesim të krijonte pritshmëri të legjitime se ai ose ajo do të ishte në gjendje të ndiqte shkollimin universitar për të cilin ai ose ajo kishte marrë notat e nevojshme në provim. Në mungesë të ndonjë prove që kërkuesi ka mashtruar – apo edhe ndonjë akuze të qartë kundër tij për këtë qëllim – dhe duke pasur parasysh parashtrimin e padiskutueshëm që ai ishte përgatitur për provimet e vitit 1997 duke ndjekur një kurs privat, përfundimi i arritur nga këshilli akademik se rezultatet e tij të mira nuk mund të shpjegoheshin, ishte i paqëndrueshëm. Vendimit për anulimin e rezultateve të tij, i cili u la në fuqi nga gjykatat, i mungonte baza ligjore dhe arsyeshmëria, duke rezultuar në arbitraritet.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1. Bazuar në nenin 41, Gjykata përcaktoi se shteti i paditur do t'i paguajë parashtruesit 5,000 (pesë mijë) euro për dëmin jomaterial, si dhe përcaktoi pagesën e shpenzimeve procedurale.

2.2. ÇAM kundër TURQISË

[51500/08]

GJEDNJ [Seksioni i Dytë]

23 maj 2016

Çështja kyçe/ e drejta e pretenduar: *trajtim ndryshe/diskriminim si pasojë e refuzimi për t'u pranuar në Akademinë Kombëtare të Muzikës si rezultat i faktit të të qenit e verbër, duke mos shqyrtuar mundësinë e "akomodimit të arsyeshëm" të aftësisë së veçantë.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga znj. Ceyda Evrim Çam, (kërkuesja) shtetase turke kundër Republikës së Turqisë, paraqitur në Gjykatë më 22 tetor 2008. Në vitin 2004, kërkuesja, e cila është e verbër, kishte kaluar testin e pranimit për

Akademinë Kombëtare Turke të Muzikës, pjesë e Universitetit Teknik të Stambollit. Si pjesë e procedurave të pranimit, një komision nga spitali Bakırköy kishte hartuar një raport mjekësor që vinte në përfundimin se ajo mund të vijonte mësimet në seksionet e akademisë së muzikës ku nuk kërkohej të pamurit. Duke deklaruar se asnjë nga seksionet e akademisë nuk mund të konsiderohet se nuk kërkon shikimin ose të pamurit, Akademia e Muzikës kishte kërkuar nga zyrtari kryesor i spitalit që të hartonte një raport të ri për të sqaruar nëse, si rezultat i kësaj deklarate, kërkesja do të mund të vijonte mësimet në Akademi të Muzikës. Akademia, gjithashtu, kishte refuzuar regjistrimin e kërkuarës. Prindërit e kërkuarës, në emër të saj, kishin kërkuar nga Gjykata Administrative e Stambollit të anulonte vendimin e Universitetit Teknik të Stambollit. Gjykata kishte lënë në fuqi vendimin e administratës së universitetit mbi bazën se kërkesja nuk kishte ofruar një raport nga një spital publik që deklaronte se ajo ishte në gjendje të jetë studente në Akademinë e Muzikës. Kërkesja dhe prindërit e saj apeluan vendimin në Gjykatën Supreme Administrative të Turqisë, e cila e hodhi poshtë apelin. Ata kishin bërë kërkesa paralele për të ndaluar ekzekutimin e vendimit në lidhje me aplikimin për regjistrim, por pa sukses. Po ashtu, ata kishin paraqitur ankesë, ndonëse pa sukses, edhe kundër Spitalit Bakırköy, i cili ndërkohë kishte plotësuar raportin mjekësor dhe deklaronte përfundimisht se kërkesja nuk ishte në gjendje për të vijuar Akademinë e Muzikës.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 2 të Protokollit nr. 1 (E drejta për arsim), kërkesja u ankua për shkelje të së drejtës së saj në arsim, me arsyetimin se shteti kishte dështuar t'u ofronte personave me aftësi të kufizuara të njëjtat mundësi sikurse të tjerëve. Ajo, po ashtu, deklaroi se është diskriminuar mbi bazë të verbërisë së saj, në shkelje të nenit 14 të Konventës (Ndalimi i diskriminimit). Ajo kontestoi argumentin se të pamurit është kërkuar për regjistrim në Akademi të Muzikës, duke theksuar se një kërkesë e tillë është në kundërshtim me të drejtën në arsim. Ajo më tej ka argumentuar se shteti nuk ka respektuar detyrimin e tij pozitiv për t'u ofruar personave me aftësi të kufizuara të njëjtat mundësi sikurse edhe të gjithë të tjerëve. Qeveria, nga ana e saj, kontestoi këto pretendime. Ajo iu referua rregullave të pranimit dhe

regjistrimit në universitet. Sipas Qeverisë, rregullat e procedurës së Akademisë së Muzikës ishin legjitime dhe të parashikueshme; se kriteret procedurale ishin të publikuara dhe të qasshme për publikun, dhe se ato nuk përmbanin dispozita shprehimore që përjashtojnë personat e verbër, diçka që do të përbënte diskriminim të qartë të kësaj kategorie të personave.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata vuri re, si fillim, se legjislacioni në fuqi në kohën përkatëse ka përcaktuar se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën në arsim, pa diskriminim. Gjithashtu, Gjykata vuri re se përjashtimi i kërkueses është mbështetur në rregullat e procedurës të Akademisë, që kërkojnë lëshimin e një certificate mjekësore të përshtatshmërisë fizike për të ndjekur mësimet në akademi. Ndonëse këto rregulla të procedurës nuk përjashtonin personat e verbër, Gjykata vlerësoi se, fakti se kërkuesve që aplikojnë për vijimin e mësimet në këtë akademi u kërkohet të deponojnë një raport/certifikatë të (pa)aftësisë së tyre, Gjykata nuk mund të anashkalojë efektet e një kërkese të tillë te personat që vuajnë nga paaftësi fizike, sikurse në rastin e kërkueses. Më tej, Gjykata shtoi se kërkuesja në fakt kishte paraqitur certifikatën e përshtatshmërisë fizike, me përmbajtje të një rezervimi rreth verbërisë së saj, por Akademia e Muzikës e ka refuzuar atë, dhe madje ka kërkuar ndryshimin e saj nga zyrtari mjekësor i spitalit. Për pasojë, edhe pse Akademia e Muzikës ka bërë përpjekje që të justifikojë refuzimin për regjistrim të kërkueses mbi bazën e dështimit të saj për t'u sjellë në pajtim me formalitetet e nevojshme administrative, sidomos në lidhje me certifikatën mjekësore, Gjykata vlerësoi se verbëria e kërkueses ka qenë arsyeja e vetme e refuzimit. Për më tepër, Gjykata vlerësoi se fakti që kërkuesja ka kaluar provimin pranues, e që ka qenë parakusht për çfarëdo kërkese për regjistrim, kërkuesja ka dëshmuar se ajo ka qenë plotësisht e kualifikuar për regjistrim në Akademinë Kombëtare të Muzikës. Si pasojë e mungesës së infrastrukturës së përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara, dhe duke vlerësuar se diskriminimi mbi bazë të paaftësisë përfshin refuzimin për të bërë “akomodime të arsyeshme” për paaftësinë e saj, Gjykata gjeti se autoritetet kombëtare nuk kanë bërë përpjekje që të identifikojnë nevojat e kërkueses dhe kanë dështuar të shpjegojnë se si verbëria e saj ia parandalon ndjekjen e mësimëve

të muzikës. Gjithashtu, Gjykata vërejti se Akademia nuk ka bërë asnjë përpjekje për t'ua përshtatur mësimet studentëve të verbër. Si rezultat, Gjykata arriti në përfundimin se refuzimi për të regjistruar kërkuesen, që ka qenë i mbështetur vetëm në verbërinë e saj, ka qenë i lidhur edhe me faktin se autoritetet kombëtare nuk e kanë shqyrtuar asnjëherë mundësinë për të bërë “akomodime të arsyeshme” për paaftësinë e saj. Përfundimisht, Gjykata vlerësoi se kërkueses i është mohuar, pa ndonjë justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, përfitimi nga arsimimi muzikor, dhe kështu gjeti shkelje të nenit 14 të Konventës, në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1. Në dritën e gjetjes së shkeljes së nenit 14, Gjykata vlerësoi të panevojshme që të shqyrtojë ankesën edhe mbi bazën e nenit 2 të Protokollit nr. 1. Gjykata urdhëroi shtetin turk që t'i paguajë kërkueses 10,000 (dhjetë mijë) euro si dëmshpërblim për dëmin jomaterial dhe 3,000 (tre mijë) euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. KOMISIONI EVROPIAN kundër HUNGARISË

GJDBE (Dhomë e Madhe)

Çështja C66/18

6 tetor 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=232082&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13716529>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Në këtë çështje, Gjykata vendosi se kushtet e reja të vendosura nga Hungaria për të lejuar institucionet e huaja të arsimit të lartë të kryejnë aktivitetet e tyre në territorin e saj, janë të papajtueshme me të drejtën e BE-së.

Faktet kryesore

Më 4 prill 2017, me një procedurë urgjente, Hungaria miratoi një ndryshim në Ligjin për Arsimin e Lartë²⁰³. Megjithëse Qeveria hungareze shpalli se ky ndryshim synonte garantimin e cilësisë në arsimin e lartë, në fakt, qëllimi kryesor i ligjit ishte rishikimi i regjimit të autorizimit për institucionet e huaja të arsimit të lartë. Sipas ndryshimit të miratuar, pavarësisht nëse kishin marrë apo jo miratim, ndërkaq dhe pavarësisht se operonin në Hungari, institucionet e huaja të arsimit të lartë u nënshtroheshin kushteve të reja.

Duke pretenduar se me miratimin e këtij ndryshimi legjislativ, Hungaria nuk respektonte detyrimet e saj sipas neneve 9, 10 dhe 13, nenit 14 (3)

203 Nemzeti felsőoktatásról szóló 2011. évi CCIV. törvény módosításáról szóló 2017. évi XXV. törvény (Ligji Nr. XXV i 2017, që ndryshon Ligjin Nr. CCIV të 2011 mbi Arsimin e Lartë Kombëtar – në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Arsimit të Lartë i vitit 2017).

dhe nenit 16 të Direktivës 2006/123²⁰⁴, sipas neneve 49 dhe 56 të TFEU-së, nenit XVII të GATS²⁰⁵, dhe sipas neneve 13, 14(3) dhe 16 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejshëm: “Karta”), më 27 prill 2017, Komisioni i dërgoi një njoftim zyrtar Hungarisë, duke i dhënë një periudhë prej një muaji për të paraqitur vëzhgimet e saj. Hungaria u përgjigj me një letër të 25 majit 2017, në të cilën ajo kundërshtoi mangësitë për të cilat u akuzua.

Më 14 korrik 2017, Komisioni miratoi një opinion të arsyetuar në të cilin u shpreh, ndër të tjera, se:

– duke u kërkuar institucioneve të huaja të arsimit të lartë që ndodhen jashtë HEE-së²⁰⁶ që të lidhin marrëveshje ndërkombëtare si kusht për të ofruar shërbime arsimore, sipas nenit 76 (1) (a) të Ligjit për Arsimin e Lartë të vitit 2017, Hungaria kishte shkelur detyrimet e saj sipas nenit XVII të GATS;

– duke u kërkuar institucioneve të huaja të arsimit të lartë që të ofrojnë arsim të lartë edhe në vendin e tyre të origjinës, sipas nenit 76 (1) (b) të Ligjit për Arsimin e Lartë të vitit 2017, Hungaria kishte shkelur detyrimet që i takonin sipas nenit 16 të Direktivës 2006/123 dhe, në çdo rast, sipas neneve 49 dhe 56 të TFBE-së, dhe

– duke miratuar këto masa, Hungaria shkelte detyrimet e saj sipas nenit 13, nenit 14 (3) dhe nenit 16 të Kartës.

Komisioni i caktoi Hungarisë një periudhë prej një muaji që të marrë masat e nevojshme për të respektuar këtë opinionin të arsyetuar ose për të paraqitur vërejtjet e saj.

Me një letër të 17 korrikut 2017, Hungaria kërkoi një zgjatje të asaj periudhe, kërkesë që Komisioni e refuzoi. Hungaria iu përgjigj opinionit të arsyetuar më 14 gusht 2017, duke u shprehur se asnjë nga shkeljet

204 4 Neni 16 i Direktivës 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 12 dhjetorit 2006 për shërbimet në tregun e brendshëm (OJ 2006 L 376, f. 36), më poshtë “Direktiva për shërbimet”.

205 Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve.

206 HEE – Hapësirës Ekonomike Evropiane.

e pretenduara nga Komisioni nuk qëndronin. Më 11 shtator 2017, Hungaria i dërgoi Komisionit vëzhgime të reja që synonin, në veçanti, krahasimin e situatës së saj me atë të shteteve të tjera anëtare dhe sigurimin e informacionit shtesë në lidhje me disa shtete anëtare. Më 26 shtator 2017, u zhvillua një takim i ekspertëve të Komisionit dhe atyre të Hungarisë. Më 5 tetor 2017, Komisioni i dërgoi Hungarisë një opinion shtesë të arsyetuar në të cilin pohoi se, duke u vendosur institucioneve të huaja të arsimit të lartë detyrimin për të ofruar arsim të lartë në vendin e tyre të origjinës, në përputhje me 76 (1) (b) të Ligjit për Arsimin e Lartë, Hungaria gjithashtu nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas nenit XVII të GATS.

Më 6 tetor 2017, Hungaria i dha Komisionit informacion shtesë, në të cilin shpjegoi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin i vetmi shtet federal joanëtar i HEE-së me të cilin duhej të lidhej një marrëveshje paraprake, siç parashikohet në nenin 76 (1) (a) të Ligjit për Arsimin e Lartë. Më 18 tetor 2017, ajo e informoi Komisionin për miratimin nga Parlamenti hungarez, më 17 tetor 2017, të një projektligji që ndryshon Ligjin për Arsimin e Lartë të vitit 2017 duke shtyrë deri më 1 janar 2019 afatin e parashikuar në nenin 115, pika 7, të atij ligji për plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 76 (1) i tij. Ajo e informoi gjithashtu Komisionin se marrëveshja për bashkëpunimin në arsimin e lartë, e lidhur midis Qeverisë hungareze dhe shtetit Maryland (SHBA), në lidhje me ushtrimin, nga Kolegji McDaniel, të një aktiviteti në Hungari, ishte publikuar në Magyar Közlöny²⁰⁷. Më 13 nëntor 2017, Hungaria i dërgoi Komisionit informacion shtesë, duke deklaruar se, më 30 tetor 2017 ishte nënshkruar marrëveshja ndërkombëtare e nevojshme për vazhdimin e veprimtarisë së Universitetit Mjekësor Heilongjiang Daxue (Kinë) në Hungari.

Duke mos u bindur nga këto vëzhgime, më 1 shkurt 2018, Komisioni paraqiti një padi në Gjykatë me pretendimin se duke adoptuar ndryshimet legislative në fjalë, Hungaria nuk kishte përmbushur detyrimet që rridhnin nga e drejta e BE-së²⁰⁸. Komisioni argumentonte

207 Gazeta Zyrtare e Republikës së Hungarisë.

208 Këto padi rregullohen nga neni 258 i TFBE-së.

se Ligji për Arsimin e Lartë i vitit 2017 ishte i papajtueshëm si me angazhimet e Hungarisë sipas GATS, ashtu dhe me lirinë e vendosjes, me lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe me dispozitat e Kartës në lidhje me lirinë akademike, lirinë për të krijuar institucione të arsimit të lartë dhe lirinë e biznesit.

Me një vendim të 25 korrikut 2018, Kryetari i Gjykatës i dha kësaj çështjeje trajtim prioritar, në përputhje me nenin 53 (3) të Rregullores së Gjykatës.

Përmbledhja e vendimit

Paraprakisht, Gjykata hodhi poshtë arsyet e papranueshmërisë të paraqitura nga Hungaria. Nga njëra anë, për sa i përket afateve të shkurtra kohore të aplikuara nga Komisioni gjatë procedurës paragjyqësore, Gjykata, duke konfirmuar praktikën e saj gjyqësore për këtë çështje²⁰⁹, vazhdoi shqyrtimin e çështjes dhe arriti në përfundimin se Hungaria nuk kishte arritur të vërtetonte shkeljen e pretenduar të të drejtave të mbrojtjes. Për më tepër, ajo vërejti se afatet e kontestuara ishin caktuar duke marrë parasysh hyrjen e menjëhershme në fuqi të dispozitave në fjalë, të përcaktuara fillimisht më 1 janar 2018. Nga ana tjetër, Gjykata konsideroi se qeveria hungareze nuk mund të mbështetej në paligjshmërinë e qëllimeve politike të Komisionit, përkatësisht në mbrojtjen e interesave të veçanta të Universitetit të Evropës Qendrore, meqenëse e drejta për të nisur procedurat lidhur me shkeljen është pjesë e diskrecionit të organit të pushtetit që e ka këtë të drejtë dhe, si e tillë, del jashtë kontrollit gjyqësor të ushtruar nga Gjykata.

Gjykata më pas e shpalli veten kompetente për të dëgjuar ankesat e bazuara në shkelje të së drejtës së OBT-së²¹⁰. Në këtë drejtim, pasi theksoi se çdo marrëveshje ndërkombëtare e lidhur nga Bashkimi

209 Shih, në veçanti, vendimin e 18 qershorit 2020, *Komisioni kundër Hungarisë* (Transparenca e shoqatave) (C 78/18, EU:C:2020:476, paragrafi 30, ose vendimin e 2 prillit 2020, *Komisioni kundër Polonisë, Hungarisë dhe Republikës Çeke* (Mekanizmi i përkohshëm i rishpërndarjes së kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare), C715/17, C718/17 et C719/17, EU:C:2020:257, paragrafi 92.

210 Organizata Botërore e Tregtisë.

Evropian është pjesë përbërëse e së drejtës të Bashkimit Evropian, Gjykata konstatoi se i tillë ishte rasti edhe me marrëveshjen për themelimin e OBT-së, pjesë e së cilës është GATS. Më pas, për sa i përket marrëdhënies ndërmjet kompetencës ekskluzive të BE-së në fushën e politikës së përbashkët tregtare dhe kompetencës së zgjeruar të shteteve anëtare në fushën e arsimit, Gjykata specifikoi se angazhimet e marra në kuadër të GATS, duke përfshirë ato në lidhje me liberalizimin e tregtisë së shërbimeve të arsimit privat, hyjnë në politikën e përbashkët tregtare të BE-së. Për më tepër, duke iu përgjigjur argumentit të qeverisë hungareze bazuar në juridiksionin ekskluziv të interpretimit që i atribuohet, në veçanti, organeve që përbëjnë sistemin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të OBT-së, Gjykata theksoi se ekzistenca e sistemit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve specifike për OBT jo vetëm që nuk e pengonte Gjykatën nga ushtrimi i juridiksionit të saj për të shqyrtuar ankesat që pretendojnë shkelje të ligjit të OBT-së, konkretisht të GATS, por për më tepër ushtrimi i kësaj kompetence ishte plotësisht në përputhje me detyrimin e secilit anëtar të OBT-së, duke përfshirë edhe BE-në, për të siguruar respektimin e detyrimeve që u lindin nga e drejta e asaj organizate. Në këtë drejtim, Gjykata vuri në dukje se BE-së mund t'i lindë përgjegjësi ndërkombëtare për shkak të mosrespektimit të mundshëm nga një shtet anëtar të detyrimeve që ai ka marrë në bazë të GATS.

Në të njëjtin këndvështrim, Gjykata specifikoi pasojat konkrete, në ushtrimin e juridiksionit të saj, të dispozitave të konventave ndërkombëtare që janë të detyrueshme për të, si dhe të rregullave dhe parimeve të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare të natyrës zakonore, për të cilat ajo kujton se, kanë natyrë detyruese për BE-në. Kështu, në lidhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme të kodifikuar në çështjet e përgjegjësisë së shtetit për aktet e paligjshme ndërkombëtare, Gjykata vërejti se shqyrtimi i një padie për mospërbushje të detyrimeve, madje edhe të detyrimeve sipas rregullave të OBT-së, nuk i detyron anëtarët e tjerë të OBT-së, dhe as nuk ndikon në vlerësimin e mëvonshëm që Organi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të OBT-së mund të bëjë.

Pasi pranoi juridiksionin e saj, Gjykata shqyrtoi pretendimet e Komisionit. Së pari, për sa i përket vlerësimit, në dritën e nenit XVII të

GATS për trajtimin kombëtar, të kushtit në lidhje me ekzistencën e një konvente ndërkombëtare paraprake, Gjykata konstatoi që në fillim se, në fushën e shërbimeve të arsimit të lartë, Hungaria është plotësisht e angazhuar për dhënien e trajtimit kombëtar të parashikuar në këtë nen, pavarësisht nga një rezervë e shprehur në lidhje me angazhimin e bërë në lidhje me qasjen në treg (neni XVII GATS), në kuptimin që krijimi i institucioneve arsimore në Hungari mbetet subjekt i autorizimi. Në të vërtetë, sipas ligjit të OBT-së, një rezervë e tillë e autorizimit paraprak që synon kufizimin e angazhimit të marrë për sa i përket qasjes në treg mund të jetë e vlefshme në aspektin e trajtimit kombëtar, vetëm për aq sa lidhet me një masë që bie ndesh me detyrimin e qasjes në treg dhe detyrimin e trajtimit kombëtar. Në rastin konkret, natyra e përgjithshme e rezervës së autorizimit paraprak me të cilin Hungaria synonte të kufizonte angazhimin e saj në lidhje me qasjen në treg nuk është aspak diskriminuese, kështu që Hungaria nuk mund të mbështetet tek ajo në lidhje me detyrimin e trajtimit kombëtar.

Gjykata më pas sqaroi se përfundimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare, siç kërkohet nga Ligji për Arsimin e Lartë të vitit 2017, vendos një kusht shtesë për ofruesit e huaj të interesuar në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime të arsimit të lartë në Hungari. Përmbushja e këtij kushti bie në kompetencën diskrecionale të autoriteteve hungareze, gjë që mjafton për t'u konsideruar një modifikim i kushteve të konkurrencës në dëm të ndërmarrjeve në fjalë dhe në favor të ndërmarrjeve hungareze. Më në fund, Gjykata vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga qeveria hungareze në lidhje me objektivat e ndjekura nga kushti në fjalë nuk ishin të mjaftueshme për ta justifikuar atë, në dritën e nenit XIV të GATS. Në të vërtetë, në lidhje me pretendimin e Hungarisë për mbrojtjen e rendit publik, qeveria e atij Shteti Anëtar nuk vërtetoi, në mënyrë konkrete dhe të detajuar, ekzistencën e një kërcënimi real dhe mjaft serioz që prekte një interes themelor të shoqërisë hungareze. Për më tepër, për aq sa kushti në fjalë kishte për qëllim parandalimin e praktikave mashtruese, Gjykata vendosi se ajo përbënte një mjet diskriminimi arbitrar për shkak të natyrës vendimtare të vullnetit politik të autoriteteve hungareze për qëllimin e përmbushjes së këtij kushti. Prandaj edhe ky justifikim nga Hungaria nuk u pranua. Për më tepër, Gjykata e konsideroi kushtin në fjalë si joproporcional, duke vërejtur se ai zbatohet pa dallim, duke përfshirë entitetet tashmë të pranishme në tregun hungarez.

Së dyti, Gjykata shqyrtoi kriterin e ushtrimit të një aktiviteti arsimor në shtetin e origjinës. Për sa i përket, para së gjithash, angazhimit të marrë nga Hungaria sipas nenit XVII të GATS, Gjykata, pasi theksoi disavantazhin konkurrues që rezulton nga ky kriter për institucionet në fjalë, vuri në dukje, si më parë, pamjaftueshmërinë e shpjegimeve të ofruara nga qeveria hungareze në lidhje me objektivat që mund të justifikojnë nevojën për këtë kriter. Për arsye të ngjashme me ato të miratuara në kontekstin e analizës së pretendimit të parë, ajo arriti në përfundimin se kjo kërkesë, për aq sa zbatohet për institucionet e arsimit të lartë të themeluara në një shtet të tretë anëtar të OBT-së, vinte në kundërshtim me këtë dispozitë. Për më tepër, për aq sa kjo kërkesë zbatohet për institucionet arsimore që kanë selinë e tyre të regjistruar në një Shtet tjetër Anëtar të Bashkimit, Gjykata vlerësoi ekzistencën e një kufizimi të pajustificuar si për lirinë e vendosjes së garantuar nga neni 49 i TFBE-së, ashtu edhe për lëvizjen e lirë të shërbimeve, të parashikuar në nenin 16 të Direktivës së Shërbimeve. Së fundi, në lidhje me pretendimin se kriteri në fjalë synon sigurimin e një niveli të lartë të cilësisë në arsimin e lartë, Gjykata vërejtë se aktiviteti i kërkuar, cilësia e të cilit mbetet për t'u përcaktuar, në asnjë mënyrë nuk paragjykon cilësinë e arsimit që ofrohet në Hungari, kështu që një objektiv i tillë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar kërkesën në fjalë.

Së treti, Gjykata shqyrtoi nëse kriteret në fjalë, të parashikuara nga Ligji për Arsimin e Lartë i vitit 2017, ishin në përputhje me nenet 13, 14 (3) dhe 16 të Kartës. Në lidhje me këtë, Gjykata deklaroi se, edhe në lidhje me dispozitat e kundërshtuara, Hungaria ishte e detyruar të respektonte dispozitat e Kartës përderisa si përmbushja e detyrimeve të saj sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare që përbën një pjesë integrale të së drejtës së BE-së, si p.sh. GATS, ashtu edhe kufizimet e vendosura nga këto dispozita hungareze ndaj lirive themelore, përfshihen në fushën e veprimit të së drejtës së BE-së, sipas kuptimit të nenit 51 (1) të Kartës.

Duke shqyrtuar në mënyrë të njëpasnjëshme garancitë e njohura nga dispozitat e Kartës, Gjykata nënvizoi, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, se liria akademike nuk kishte vetëm një dimension individual, përderisa lidhet me lirinë e shprehjes dhe më konkretisht me fushën e kërkimit, me lirinë e komunikimit, hulumtimit dhe përhapjes së rezultateve të fituara në këtë

mënyrë, por edhe një dimension institucional dhe organizativ, duke gjetur shprehje në autonominë e këtyre institucioneve. Megjithatë, Gjykata konstatoi se masat në fjalë mund të rrezikonin veprimtarinë akademike të institucioneve të huaja të arsimit të lartë në territorin hungarez dhe, për rrjedhojë, t'u privonin akademikëve të interesuar infrastrukturën autonome të nevojshme për kryerjen e kërkimit të tyre shkencor dhe ushtrimin e veprimtarive të tyre arsimore, përderisa ato masa kufizonin lirinë akademike të mbrojtur në nenin 13 të Kartës. Për më tepër, krijimi i këtyre institucioneve bie në fushëveprimin e neneve 14 (3) dhe 16 të Kartës dhe, për arsye të ngjashme me ato të përmendura më sipër, masat në fjalë përbëjnë një ndërhyrje në të drejtat e parashikuara në ato dispozita. Meqenëse këto ndërhyrje të ndryshme nuk justifikoheshin sipas nenit 52, paragrafi 1, të Kartës, Gjykata konstatoi se Hungaria kishte shkelur dispozitat e lartpërmendura të Kartës.

Neni 49

E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KO131/12. PARASHTRUES SHAIPI MUJA DHE 11 DEPUTET TË TJERË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KO131_12_Aktgjykim_SHQ_.pdf]

15 prill 2013

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Çështja kyçe në këtë rast ishte kushtetutshmëria e dispozitave specifike të Ligjit për Shëndetësinë, që ua ndalonin punëtorëve shëndetësorë të institucioneve shëndetësore publike që të punonin edhe në institucione shëndetësore private. Parashtruesit e kërkesës (deputetët e Kuvendit të Kosovës) që kontestuan këtë Ligj në Gjykatën Kushtetuese ngritën çështjen e cenimit të së drejtës së punëtorëve shëndetësorë të sektorit publik, për barazi para ligjit (neni 3 dhe 24 i Kushtetutës) dhe të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit (neni 49 i Kushtetutës).

Faktet kryesore

Më 13 dhjetor 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte debatuar dhe, në leximin e dytë, kishte votuar për Projektligjin për Shëndetësi (me një numër amandamentesh që ishin propozuar nga komisionet përkatëse të Kuvendit). Ky Projektligj ishte sponsorizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Projektligji ishte miratuar me 43 vota për, 18 vota kundër dhe 3 abstenime. Më 17 dhjetor 2012, Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës i kishte dërguar Avokatit Popullit kërkesën për iniciimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 41 të Ligjit për Shëndetësinë, duke pretenduar si ai nen binte ndesh me Kushtetutën dhe veçanërisht me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]. Më 21 dhjetor 2012, Kryetari i Kuvendit i kishte dërguar Presidentit të Republikës për shpallje për Shëndetësi (Ligjin e kontestuar).

Më 20 dhjetor 2012, nëpërmjet postës, parashtruesi parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar kushtetutshmërinë e Ligjit për Shëndetësi.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se Ligji për Shëndetësinë përmbante dispozita që punëtorët shëndetësorë i vinte në pozita të pabarabarta me të punësuarit në institucione të tjera publike. Në mënyrë specifike, parashtruesit pretenduan se nenet 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit të kontestuar ishin në kundërshtim me Kushtetutën. Parashtruesit u ndalën sidomos tek neni 41 paragrafi 1 i Ligjit të kontestuar, i cili ndalonte çdo profesionist shëndetësor të punësuar në institucione publike shëndetësore – qoftë edhe me orar jo të plotë të punës – që të punojë në institucione shëndetësore private. Parashtruesit argumentuan se ky nen i Ligjit të kontestuar i vinte punëtorët shëndetësorë të sektorit publik në pozitë të pabarabartë me të punësuarit e tjerë në sektorin publik dhe ua cenonte atyre të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit. Përveç këtij pretendimi qendror, parashtruesit pretenduan se nenet 18 dhe 19 të Ligjit të kontestuar ishin në kundërshtim me Ligjin për Partneritetin Publiko-Privat, dhe neni 60 i Ligjit ishte në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike (sepse i cilësonte institucionet shëndetësore si institucione jofitimprurëse).

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i parashtruesve kishte ngritur edhe çështjen e procedurës për miratimin e Ligjit për Shëndetësi, duke argumentuar se nuk ishte ndjekur procedura e duhur gjatë leximit të dytë të Projektligjit në Kuvend. Po ashtu, gjatë seancës dëgjimore parashtruesi kishte argumentuar se Ligji i kontestuar do shkatërronte sektorin shëndetësor dhe se praktikat që përcaktonte ai Ligji nuk gjendeshin askund në rajon apo më gjerë.

Parashtruesit kishin kërkuar gjithashtu vendosjen e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të Ligjit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me këtë kërkesë.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, pasi kishte shpallur kërkesën të pranueshme për shqyrtim meritor, Gjykata Kushtetuese më 24 dhjetor 2012 kishte miratuar kërkesën për masë të përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013. Më 24 janar 2013, Gjykata kishte marrë vendim që të mbajë dëgjim publik, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, ndërsa afati kohor i Masës së Përkohshme i ishte vazhduar edhe për tre (3) muaj.

Më 7 mars 2013, Gjykata Kushtetuese kishte mbajtur seancë dëgjimore, ku ishin dëgjuar: përfaqësuesit e parashtruesve të kërkesës, të Kuvendit, të Ministrisë së Shëndetësisë, të Sindikatës së Shëndetësisë dhe të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Për sa i përket meritave të kërkesës, Gjykata Kushtetuese trajtoi specifikisht dhe ndaras pretendimet për jokushtetutshmëri të neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi.

Për sa i përket pretendimeve lidhur me nenet 18 [Kujdesi parësor shëndetësor] dhe 19 [Kujdesi dytësor shëndetësor] të Ligjit, duke marrë parasysh argumentet e paraqitura nga palët në procedurë dhe pas shqyrtimit të dispozitave të kontestuara të nenit 18 dhe 19, Gjykata gjeti se parashtruesit nuk e kishin mbështetur pretendimin e tyre mbi papajtueshmërinë e pretenduar të neneve 18 dhe 19 me Kushtetutë. Sipas Gjykatës Kushtetuese, parashtruesit nuk kishin argumentuar fare se pse ata konsideronin se nenet përkatëse nuk ishin në përputhje me Kushtetutën.

Sa i përket nenit 60 të Ligjit për Shëndetësi [Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor], Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se pretendimet e ngritura nga parashtruesit ishin të bazuara në tekstin e nenit 60 të Projektligjit, i cili ishte ndryshuar. Prandaj, Gjykata konstatoi se nuk janë relevante argumentet e parashtruesve sa i përket papajtueshmërisë së pretenduar me nenin 60 të Kushtetutës.

Për sa i përket pretendimeve për jokushtetutshmërinë e nenit 41 të Ligjit për Shëndetësinë [Parandalimi i konfliktit të interesit], Gjykata

Kushtetuese vuri në pah se përfaqësuesi i parashtruesve kishte argumentuar në përgjithësi që ai nen ishte në kundërshtim me instrumentet ndërkombëtare që, sipas nenit 22 të Kushtetutës janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese, gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së nenit 41 të kontestuar të Ligjit për Shëndetësi me Kushtetutën, mori parasysh dispozitat e instrumenteve përkatëse ndërkombëtare, duke theksuar faktin se parashtruesit pretendonin se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 49 të Kushtetutës. Në këtë vazhdë, Gjykata Kushtetuese sqaroi se kur një ligj, si në këtë rast Ligji për Shëndetësi, i kufizon të drejtat kushtetuese, siç është këtu e drejta e garantuar me nenin 49, një kufizim i tillë është kushtetues, në qoftë se ai është proporcional. Testi i proporcionalitetit është përshkruar në nenin 55 të Kushtetutës dhe ai ofron arsyetim për kufizimin e të drejtave kushtetuese, por në të njëjtën kohë ofron edhe kufijtë e kufizimit të tillë. Duke u referuar në kriteret e nenit 55 të Kushtetutës, Gjykata vërejti se kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhej me kërkesën që kufizimi është përcaktuar me ligj, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55. Më tej, Gjykata iu referua paragrafit 2, të nenit 55, duke arsyetuar se kufizimet mund të vendosen mbi të drejtat e parashikuara nga neni 49 i Kushtetutës, por vetëm në masën e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kufizimit në një shoqëri të hapur demokratike. Në këtë kuadër, Gjykata sqaroi se nocioni i termit “masën e nevojshme në një shoqëri të hapur dhe demokratike”, duhet të lexohet në lidhje me kërkesat specifike të dhëna në paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 55. Këto kërkesat janë të renditura si në vijim: a. Thelbi i së drejtës kushtetuese; b. Rëndësia e qëllimit të kufizimit; c. Natyra dhe shkalla e kufizimit; d. Lidhja ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që duhet të arrihet; dhe e. Mundësia e arritjes së atij qëllimi me kufizim më të vogël. Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese u ndal posaçërisht tek “natyra dhe shkalla e kufizimit” të së drejtës për punë dhe ushtrim të profesionit. Në këtë sfond, Gjykata vërejti se neni 41.1 i ndalonte të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor, të punësuar në sektorin publik shëndetësor, nga ndonjë punësim dhe nga të gjitha punësimet në ndonjë institucion

të kujdesit shëndetësor privat. Kjo vlente nëse profesionisti i kujdesit shëndetësor ishte i punësuar me orar të plotë, ose të pjesshëm, në sektorin publik shëndetësor. Nga ana tjetër, neni 41.5 i lejonte profesionistët e kujdesit shëndetësor, që punojnë në sektorin e kujdesit shëndetësor publik, të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore në institucionin e kujdesit shëndetësor publik, në pajtim me autorizimin paraprak nga udhëheqësi i institucionit publik. Çështja se kur dhe si mund të jepen autorizimet e tilla, duhej të rregullohej edhe më tej me akte nënligjore që do të nxirren nga Ministria e Shëndetësisë. Gjykata Kushtetuese konsideroi se ndalimet e parashikuara në nenin 41.1, kufizonin ashpër mundësitë për profesionistët e kujdesit shëndetësor, që punojnë në sektorin publik shëndetësor, për të plotësuar të ardhurat e tyre nëpërmjet punësimit ose lidhjes me ndonjë institucion privat të kujdesit shëndetësor, apo me ndonjë biznes. Përderisa ata mund të autorizoheshin për të kryer veprimtari private shëndetësore në sektorin e kujdesit shëndetësor publik, mënyra dhe masa në të cilën mund të autorizohet kjo, nuk ishte përcaktuar ende me ligj. Pavarësisht asaj, Gjykata konstatoi se natyra dhe shkalla e kufizimit, e përcaktuar me nenin 41, ishte e tillë që rrënjësisht kufizonte ushtrimin e profesionit të kujdesit shëndetësor të profesionistit, qoftë në sektorin publik, qoftë në sektorin privat. Më tutje, Gjykata Kushtetuese analizoi raportin ndërmjet kufizimit të të drejtave të garantuara me nenin 49 dhe qëllimit që dëshirohej të arrihej. Kështu, Gjykata pranoi argumentimin e Ministrisë së Shëndetësisë se Ligji kishte qëllim legjitim, që ndërli dhej me mbarëvajtjen e punës në sektorin shëndetësor. Por, për sa i përket ekuilibrit në mes të kufizimit dhe qëllimit që dëshirohej të arrihej, Gjykata vërejti se ndalimi për punësim në institucionet private të kujdesit shëndetësor për profesionistët e kujdesit shëndetësor, të punësuar në sistemin e kujdesit shëndetësor publik, nuk synonte parandalimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor që ata të punonin në dy vende të punës njëkohësisht. Në të vërtetë, një ndalim i tillë tashmë ekzistonte në kuadër të detyrimeve kontraktuese të profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Në vend të kësaj, dispozitat e nenit 41 të Ligjit ndalonin punësimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor jashtë orarit të punës të punësimit të tyre brenda institucionit publik shëndetësor. Në lidhje me këtë, Gjykata konstatoi se nuk ishte demonstruar mënyra se si do të kontribuonte një ndalim i tillë në qëllimin e kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës dhe kualitativ

në sektorin publik. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ndalimi i gjerë i punësimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor publik në të dy institucionet shëndetësore të kujdesit, publike dhe private, ishte një mjet i papërshtatshëm për arritjen e qëllimit të dëshiruar publik të Ligjit për Shëndetësi. Më tej, Gjykata Kushtetuese analizoi edhe nëse kishte pasur mundësi që të arrihej qëllimi i Ligjit për Shëndetësi (nenit 41) më kufizime më të vogla. Në këtë sfond, Gjykata sqaroi se, përderisa nuk i përkiste Gjykatës të këshillonte se cilat masa duhej të përdoreshin për të siguruar një kufizim më të vogël, masat e tjera nuk ishin marrë fare parasysh. Gjykata argumentoi, ndër të tjera, se Ligji i Punës mundësonte arritjen e qëllimit të dëshiruar, duke vënë në dukje se neni 85 i Ligjit të Punës parashikonte masat disiplinore në rast të shkeljes së detyrave të punës.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjeti se dispozitat e nenit 41 të Ligjit për Shëndetësi kufizonin të drejtën për punë, siç parashihet me nenin 49 të Kushtetutës dhe këto kufizime nuk ishin në përputhje me natyrën e kufizimeve të autorizuara sipas nenit 55 të Kushtetutës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në bazë të rregullave 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të shpallë se nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, ishin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe, me shumicë votash, vendosi se neni 41, paragrafët 1, 5 dhe 6 të Ligjit për Shëndetësi, nr. 04/L-125, ishin në mospërputhje me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe se neni 41, paragrafët 1, 5 dhe 6 të Ligjit për Shëndetësi ishin të pavlefshëm.

1.2. KI 55/11 PARASHTRUES: FATMIR PIRECI

[\[https://gjk-ks.org/decision/vlersim-i-kushtetutshmrir-t-vendimit-t-gjykats-s-qarkut-n-prizren-ac-nr-5182010-t-26-nntorit-2010/\]](https://gjk-ks.org/decision/vlersim-i-kushtetutshmrir-t-vendimit-t-gjykats-s-qarkut-n-prizren-ac-nr-5182010-t-26-nntorit-2010/)

16 korrik 2012

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: Çështja kyçe në këtë rast ishte moszbatimi i vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili i kërkonte Komunës së Prizrenit që të kthente parashtruesin në vendin e tij të punës, në administratën komunale. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit ngrinte pretendime për shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe neni 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Faktet kryesore

Më 31 janar 2008, Zyra e Personelit e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme e Komunës së Prizrenit ia kishte ndërprerë kontratën e punës parashtruesit të kërkesës, pasi që pozita që ai mbante nuk parashihej me ligjin përkatës (Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës). Ndaj këtij vendimi parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Bordin e Ankesave pranë Komunës së Prizrenit dhe më 15 shkurt 2008 ankesa e tij ishte refuzuar. Ndaj vendimit të Bordit të Ankesave parashtruesi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: “KPM”). Më 25 qershor 2008, KPM-ja e kishte miratuar ankesën dhe kishte urdhëruar punëdhënësin që ta kthente në punë parashtruesin e kërkesës (Vendimi nr. 49/08). KPM-ja kishte arsyetuar se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për Shërbimin Civil të Kosovës nuk e parashihte ndërprerjen e kontratës së punësimit në bazë shuarjes së vendit të punës, kur kontrata është ende e vlefshme. Sipas KPM-së, vetëm nëse do kishte skaduar kontrata e punësimit, atëherë punëdhënësi do mund të refuzonte vazhdimin e kontratës së punësimit në bazë të shuarjes së vendit të punës. Vendimi i KPM-së ishte i formës së prerë. Më 2008, parashtruesi i kërkesës kishte njoftuar Kuvendin e Kosovës dhe Kryeministrin se vendimi i KPM-së ishte shpërfillur nga Komuna e Prizrenit. Më 13 nëntor 2008, Kuvendi i kishte rekomanduar

parashtruesit të kërkesës që të paraqiste padi në Gjykatën Komunale. Më 30 prill 2010, Gjykata Komunale në Prizren kishte hedhur poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarrim të vendimit të KPM-së. Gjykata Komunale kishte arsyetuar se vendimi i KPM-së ishte vendim i nxjerrë nga një organ administrativ që nuk kishte asgjë të bënte më kërkesë në të holla, siç parashihej më Ligjin për Procedurën Përmbarrimore. Prandaj, sipas Gjykatës Komunale vendimi i KPM-së nuk ishte titull përmbarrimor të cilin Gjykata Komunale duhej ta përmbarronte, por ishte në kompetencat e KPM-së që të përmbarronte vendimet e veta. Më 26 nëntor 2010, edhe Gjykata e Qarkut kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar vendimin e Gjykatës Komunale.

Më 22 prill 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar kushtetutshmërinë e Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës kontestoi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, me pretendimin se ishte marrë në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe neni 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, pasi që gjykatat kishin refuzuar propozimin e parashtruesit për përmbarrimin e vendimit të KPM-së.

Arsyetimi i Gjykatës

Pas shpalljes së kërkesës si të pranueshme për shqyrtimin e meritave të saj, Gjykata Kushtetuese arsyetoi që KPM-ja kishte gjetur shkelle të së drejtës së parashtruesit për punë dhe ai vendim ishte bërë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm. Parashtruesi kishte të drejtë për mjet efektiv juridik, pasi që Komuna e Prizrenit kishte refuzuar ta ekzekutonte vendimin e KPM-së. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se, në vend të ekzekutimit të vendimit të KPM-së, siç ishte detyra e tyre ligjore, Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut kishin refuzuar ta bënin këtë. Duke iu referua legjislacionit relevant (rregulloret gjegjëse të UNMIK-ut), Gjykata Kushtetuese theksoi se vendimet e KPM-së ishin të

formës së prerë dhe të zbatueshme në procedurën administrative dhe se ankesa ndaj vendimeve të KPM-së nuk e ndalonte përmbarrimin e tyre. Gjykata Kushtetuese po ashtu vuri në dukje se, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/12, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi i KPM-së paraqiste vendim administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese theksoi se Komuna e Prizrenit nuk kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim gjyqësor të vendimit të KPM-së në gjykatën kompetente. Rrjedhimisht, Komuna kishte pranuar obligimin për përmbarrimin e vendimit të KPM-së.

Gjykata Kushtetuese vuri në dukje gjithashtu se edhe Zyra e Kryeministrit në përgjigjen e dërguar në Gjykatë kishte theksuar se vendimi i KPM-së është dashur të përmbarrohej dhe se, edhe Kuvendi në përgjigjen e tij i kishte rekomanduar parashtruesit të kërkesës që të paraqiste kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren, për përmbarrimin e vendimit të KPM-së. Por, Gjykata e Qarkut në Prizren e kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Komunale dhe kërkesa e parashtruesit për përmbarrim të vendimit të KPM-së ishte refuzuar.

Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesi i kërkesës kishte bërë çdo përpjekje të mundshme për të shfrytëzuar të gjitha mjetet që i kishte në dispozicion në bazë të ligjeve të Kosovës që të përmbarrohej vendimi i KPM-së. Me gjithë përpjekjet e tij, vendimi i KPM-së nuk ishte zbatuar as nga organet përgjegjëse komunale dhe as nga gjykatat kompetente. Gjykata arsyetoi se sundimi i ligjit, që është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën e prerë dhe janë të përmbarrueshme.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, duke mos e zbatuar vendimin e KPM-së të 25 qershorit 2008, autoritetet përkatëse i kishin zhveshur dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ nga të gjitha efektet e dobishme. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konsideroi se e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet gjegjëse të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, ishte shkelur dhe se vendimi përfundimtar dhe i ekzekutueshëm i KPM-së, i 25 qershorit 2008, duhej të ekzekutohej.

Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje (vetëm) të së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi ta shpallë kërkesën të pranueshme; të shpallë të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010, i cili shkelte nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së dhe të kthente atë vendim në Gjykatën e Qarkut në Prizren për rishqyrtim.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. FÁBIÁN kundër HUNGARISË

[78117/13]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

5 shtator 2017

Çështja kyçe/le drejta e pretenduar: pezullimi i pensionit të tij shtetëror të pleqërisë gjatë kohës sa kërkuesi ishte i punësuar në sektorin publik, përbënte ndërhyrje të pajustificuar dhe diskriminuese në të drejtat e tij pronësore në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1, marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Gyula Fábían (kërkuesi), një shtetas hungarez kundër Hungarisë, paraqitur në Gjykatë më 5 dhjetor 2013. Në vitin 2012, kërkuesi, i cili tashmë merrte një pension pleqërie, u punësua si nëpunës civil. Në vitin 2013 hyri në fuqi një ndryshim i Ligjit të Pensioneve të vitit 1997, që pezulloi pagesën e pensioneve të pleqërisë për personat e punësuar njëkohësisht në disa kategori të sektorit

publik. Amendamenti nuk zbatohet për pensionistët që punonin në sektorin privat. Si pasojë, pagesa e pensionit të kërkuesit u pezullua. Ankesa e tij administrative kundër atij vendimi ishte e pasuksesshme. Në procedurat sipas Konventës, kërkuesi u ankua për një ndërhyrje të pajustificuar dhe diskriminuese në të drejtat e tij pronësore.

Në një vendim të 15 dhjetorit 2015 (shih shënimin informativ 191), një Dhomë e Gjykatës vendosi, njëzëri, se kishte pasur shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (dhe për rrjedhojë se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohet vetëm ankesa sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1). Në veçanti, Dhoma u shpreh se argumentet e Qeverisë për të justifikuar dallimin në trajtimin mes pensionistëve të punësuar publikisht dhe privatisht nuk ishin bindëse dhe si rrjedhim nuk bazoheshin në ndonjë “arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm”.

Më 2 maj 2016, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi se pezullimi i pensionit të tij shtetëror të pleqërisë gjatë kohës që ai ishte i punësuar në sektorin publik, përbënte ndërhyrje të pajustificuar dhe diskriminuese në të drejtat e tij pronësore në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1, marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës. Ai parashtrroi se e drejta e tij për pension ishte një e drejtë e pakontestueshme e mbrojtur nga ligji i brendshëm. Çdo cenim i saj duhet të justifikohet bindshëm; dhe një referim i thjeshtë në interesin e përgjithshëm, pa fakte apo rrethana konkrete për kufizimin e një të drejte të tillë, ishte i pamjaftueshëm. Pohimi i Qeverisë se ndalimi i kompensimit të dyfishtë ishte pjesë e masave që synonin të reduktonin borxhin publik dhe të ndihmonin në shmangien e procedurës së deficitit të tepruar të Bashkimit Evropian, i mungonte mbështetja pasi nuk u parashtruan asnjë element për ndonjë kursim faktik të bërë nëpërmjet masës ose qëllimit për të cilin u vendosën këto masa. Kërkuesi vuri në dukje se numri i personave të prekur nga rregulli i kundërshtuar i kalonte dy milionë. Çdo kursim i bërë në pensionin e një grupi kaq të vogël, nuk mund të ishte substancial për uljen e borxhit publik apo për t'i shpëtuar procedurës së deficitit të tepruar. Për më tepër, ai theksoi se

ndërhyrja në këtë të drejtë ishte prapavepruese, pavarësisht periudhës së mospagimit të përmendur nga Qeveria pasi ajo kufizonte një të drejtë që tashmë ishte fituar duke arritur moshën e pensionit. Më tej ishte diskriminuese në atë që, në mënyrë të pajustificueshme, trajtohej ndryshe: (i) sektori publik dhe sektori privat; dhe (ii) disa kategori punonjësish shtetërorë dhe të tjerë (për shembull: ministrat e qeverisë ose kryetarët e bashkive, që përjashtohen nga rregulli). Në të vërtetë, ndërkohë që pensioni i kërkuesit po pezullohej, shumë pensionistë të tjerë merrnin pagesën për punën në sektorin publik dhe pensionin në të njëjtën kohë – sepse pezullimi i dhënies së pensionit kishte të bënte vetëm me pensionistët me statusin e nëpunësit civil.

Përfundimisht, kërkuesi argumentoi se rregullat e reja kishin rezultuar në një situatë ku ai duhej të zgjidhte në mënyrë efektive midis punës dhe pensionit të tij. Duke qenë se ai do të humbiste rreth gjysmën e të ardhurave të tij, parashtruesi theksoi se ishte, me të vërtetë, një barrë e tepërt individuale për t’u mbajtur.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vërejti se ligjshmëria e ndërhyrjes nuk ishte e diskutueshme dhe Gjykata nuk gjeti arsye për të dyshuar se ndalimi i dhënies së njëkohshme të pagave dhe pensioneve, të cilave iu nënshtrohej kërkuesi, i shërbente interesit të përgjithshëm të mbrojtjes së parasë publike. Pyetja ishte nëse ndërhyrja vendosi një ekuilibër të drejtë midis kërkesave të interesave të përgjithshme të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit.

Në shqyrtimin nëse autoritetet kombëtare kishin vepruar brenda kufijve të tyre të vlerësimit, Gjykata duhej të kishte parasysh veçanërisht faktorët që praktika gjyqësore e saj në lidhje me uljen, pezullimin ose ndërprerjen e pensioneve të sigurimeve shoqërore, i kishte identifikuar si të rëndësishëm. Çështja në fjalë nuk kishte të bënte me humbjen e përhershme dhe të plotë të të drejtave të pensionit të kërkuesit, por më tepër me pezullimin e pagesave të tij mujore të pensionit. Pezullimi ishte i një natyre të përkohshme dhe rifilloi kur kërkuesi u largua nga puna në shtet. Prandaj, ajo nuk goditi vetë thelbin e së drejtës së tij dhe

thelbi i së drejtës nuk u cenua. Pasi legjislacioni në fjalë kishte hyrë në fuqi, parashtruesi ishte në gjendje të zgjidhte midis ndërprerjes së punësimit në shërbimin civil dhe vazhdimit të marrjes së pensionit, ose qëndrimit në atë punë dhe pezullimit të pagesave të pensionit. Ai zgjodhi këtë të fundit. Ishte e qartë se kur kërkuesit iu pezulluan pagesat e pensionit të pleqërisë, ai vazhdoi të merrte pagën e tij. Pezullimi i pagesave të pensioneve nuk e la atë në asnjë mënyrë pa asnjë mjet të jetesës. Kështu ishte arritur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të kërkuesit dhe ai nuk ishte detyruar të mbante një barrë të tepërt individuale.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1: Çështja e parë ishte nëse kërkuesi, si një person që merrte një pension pleqërie, i punësuar më pas në shërbimin civil, ishte në një situatë analoge ose të ngjashme krahasuar me një person që merr pension pleqërie, i punësuar më pas në sektorin privat. Elementet që karakterizonin situata të ndryshme dhe përcaktonin krahasueshmërinë e tyre, duhej të vlerësoheshin në dritën e objektit dhe qëllimit të masës që bënte dallimin në fjalë.

Tri nga elementet që duheshin marrë parasysh, ishin pasqyruar gjerësisht në praktikën gjyqësore të Gjykatës, që njeh dallimin midis nëpunësve civilë dhe punonjësve privatë. Së pari, Palët Kontraktuese, sipas nevojës, gëzonin liri të gjerë në organizimin e funksioneve shtetërore dhe shërbimeve publike, duke përfshirë çështje të tilla si rregullimi i qasjes në punësim në sektorin publik dhe termat dhe kushtet që rregullojnë këtë punësim. Së dyti, për arsye institucionale dhe funksionale, punësimi në sektorin publik dhe në atë privat zakonisht u nënshtrohej dallimeve thelbësore ligjore dhe faktike, jo më pak në fushat që përfshijnë ushtrimin e pushtetit sovran shtetëror dhe ofrimin e shërbimeve publike thelbësore. Së treti, nuk mund të supozohej se termat dhe kushtet e punësimit, duke përfshirë ato financiare, ose të drejtën për përfitime sociale të lidhura me punësimin, do të ishin të ngjashme në shërbimin civil dhe në sektorin privat, dhe si rrjedhim nuk mund të supozohej se ato kategori punonjësish do të ishin në situata përkatësisht të ngjashme në këtë drejtim. Çështja e kërkuesit zbuloi nevojën për të marrë parasysh një faktor të katërt,

përkatësisht rolin e shtetit kur vepron në cilësinë e tij si punëdhënës. Në veçanti, si punëdhënës, shteti dhe organet e tij nuk ishin në një pozitë të krahasueshme me subjektet e sektorit privat, as nga këndvështrimi i kuadrit institucional në të cilin ata operonin, as për sa i përket bazave financiare dhe ekonomike të aktiviteteve të tyre; bazat e financimit ishin rrënjësisht të ndryshme, si dhe opsionet e disponueshme për marrjen e masave për të përballuar vështirësitë financiare dhe krizat.

Punonjësit e sektorit shtetëror dhe privat ishin të lidhur me skemën e detyrueshme të pensioneve të sigurimeve shoqërore, në të cilën ata kishin kontribuar në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë. Megjithatë, kjo nuk ishte në vetvete e mjaftueshme për të vërtetuar se ata ishin në situata përkatësisht të ngjashme. Pas ndryshimit të Ligjit të Pensioneve të vitit 1997, ishte punësimi i kërkuesit pas daljes në pension në shërbimin civil që solli pezullimin e pagesave të pensionit të tij. Ishte pikërisht fakti që ai si nëpunës civil merrte një rrogë nga shteti që ishte e papajtuësme me dhënien e njëkohshme të pensionit të pleqërisë nga i njëjti burim. Për sa i përket politikës financiare, sociale dhe të punësimit, ndalimi i kundërshtuar i akumulimit të njëkohshëm të pensioneve dhe pagave nga buxheti i shtetit, ishte vendosur si pjesë e masave legjislative që synonin korrigjimin e veçorive të paqëndrueshme financiarisht në sistemin e pensioneve të shtetit të paditur. Kjo nuk pengoi akumulimin e pensioneve dhe pagave për personat e punësuar në sektorin privat, pagat e të cilëve, në ndryshim nga ato të personave të punësuar në shërbimin civil, financoheshin jo nga shteti, por nga buxhetet private jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të këtij të fundit. Kërkuesi, si një anëtar i shërbimit civil, punësimi, shpërblimi dhe përfitimet sociale të të cilit vareshin nga buxheti i shtetit, ishte në një situatë të ngjashme me pensionistët e punësuar në sektorin privat.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, marrë vetëm; se ankesa në lidhje me një dallim të supozuar të pajustificuar në trajtim ndërmjet pensionistëve të punësuar në kategori të ndryshme brenda sektorit publik është paraqitur jashtë afatit dhe, për këtë arsye, është e papranueshme në përputhje me nenin 35.1 dhe 4 të Konventës; se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1.

2.1. GJYLI kundër SHQIPËRISË

[32907/07]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

29 shtator 2009

Çështja kyç/le drejta e pretenduar: mosekzekutimi i dy vendimeve gjyqësore që urdhërojnë rikthimin e parashtruesit në detyrën e drejtorit të qendrës së formimit profesional dhe pagesën të pagave të mbetura.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Ali Gjyli (kërkuesi), një nënshtetas shqiptar kundër Republikës së Shqipërisë, dërguar në Gjykatë më 13 korrik 2007. Kërkuesi ishte i punësuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit (në tekstin e mëtejshëm: “SHKP”) si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional në Durrës (“SHKP-ja e Durrësit”), në kuadër të Ministrisë së Punës. Më 9 korrik 2005, kërkuesit iu ndërpre marrëdhënia e punës. Duke e konsideruar arbitrar largimin e tij nga puna, ai iu drejtua Gjykatës së Rrethit të Durrësit. Kërkuesi nuk kërkoi dëmshpërblim për dëm material. Në vendimin e saj të 27 shtatorit 2005, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi të pavlefshëm largimin nga puna si rezultat i një procedure të parregullt dhe urdhëroi kthimin e tij në punë. Më 1 nëntor 2005, SHKP-ja e apeloj vendimin në Gjykatën e Apelit të Durrësit (Gjykata e Apelit). Me anë të vendimit të 12 dhjetorit 2005, Gjykata e Apelit e Durrësit e deklaroi ankimin të papranueshëm si të pasafatshëm. Ky vendim mori formë të prerë, pasi për të nuk u depozitua ndonjë ankim në Gjykatën e Lartë. Për qëllime të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të 27 shtatorit 2005, gjykata lëshoi një urdhër ekzekutimi më 22 dhjetor 2005, në përputhje me nenet 510 (a) dhe 511 (a) të Kodit të Procedurës Civile (shih “legjislacionin dhe praktikën e brendshme përkatëse” në vendimin e plotë). Më 23 janar 2006, Zyra e përmbarimit lëshoi një gjobë për Ministrin e Punës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit. As sot e kësaj dite vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit nuk është ekzekutuar.

Në një datë të paspecifikuar, kërkuesi depozitoi një ankesë në Gjykatën e Rrethit të Durrësit, ku kërkonte pagimin e pagave të humbura që prej

9 korrikut 2005. Më 24 tetor 2006, Gjykata e Rrethit të Durrësit vendosi në favor të kërkuarit dhe urdhëroi SHKP-në t'i paguante atij pagën e tij që prej datës 9 korrik 2005 deri në datën e rikthimit të tij në punë. Më 14 qershor 2007, Gjykata e Apelit e Durrësit e rrëzoi ankimin e bërë nga SHKP-ja. SHKP-ja ankimoi vendimin në Gjykatën e Lartë. Më 6 dhjetor 2006, me kërkesë të kërkuarit, Gjykata e Rrethit të Durrësit lëshoi një urdhër ekzekutimi për vendimin e saj të 24 tetorit 2006. Në një datë të paspecifikuar, SHKP-ja kërkoi pezullimin e menjëhershëm të ekzekutimit. Gjykata e Rrethit të Durrësit vendosi që çështja dilte jashtë juridiksionit të saj territorial dhe ia transferoi atë Gjykatës së Rrethit të Tiranës. Më 31 janar 2008, Gjykata e Rrethit të Tiranës rrëzoi padinë e SHKP-së. Në një datë të paspecifikuar, SHKP-ja e ankimoi këtë vendim. Çështja mbeti pezull në Gjykatën e Apelit të Tiranës.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuari u ankua sipas nenit 6.1 të Konventës për moszbatim të vendimit të Gjykatës së Durrësit të 27 shtatorit 2005, që urdhëronte kthimin e tij në detyrë dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të 24 tetorit 2006, që urdhëronte pagimin e pagave të papaguara. Qeveria u shpreh se kërkuari nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike në lidhje me këtë ankim. Deri më sot, procesi ishte pezull në Gjykatën e Lartë. Kërkuari pranoi se proceset ishin pezull para Gjykatës së Lartë, por pretendoi se vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrësit ishte i zbatueshëm. Gjykata e Lartë nuk kishte pezulluar zbatimin sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Arsyetimi i Gjykatës

Në çështjen në fjalë, Gjykata vuri re se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit i 24 tetorit 2006, i vërtetuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrësit i 14 qershorit 2007, i njihnte të drejtën kërkuarit për pagimin e pagave të tij të papaguara nga 9 korriku 2005 deri në datën e kthimit të tij në punë. Në përputhje me nenet 510 (a) dhe 511 (a) të Kodit të Procedurës Civile, u lëshua një urdhër ekzekutimi. Ndërkohë, pala e paditur apeloj në Gjykatën e Lartë të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta.

Në këto rrethana, Gjykata theksoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit i 24 tetorit 2006 nuk mund të konsiderohet përfundimtar dhe detyrues, pasi ai ishte i hapur për ankim. Në fakt, procesi i apelimit është pezull para Gjykatës së Lartë. Edhe nëse një ankesë në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues në mënyrë automatike dhe, pavarësisht nga kompetencat e Gjykatës së Lartë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata kujtoi se neni 6 mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare dhe detyruese, dhe jo të vendimeve të cilat mund të jenë objekt i kontrollit të mëpasshëm të një gjykate të një niveli më të lartë, dhe, eventualisht, mund të rrëzohen (shih, për shembull, *Ouzounis dhe të tjerë kundër Greqisë*, nr. 49144/99, paragrafi 21, 18 prill 2002; *Ioannis Karahalios kundër Greqisë* (Vendim), nr. 62499/00, 26 shtator 2002; *Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, paragrafi 70, 29 korrik 2008).

Duke pasur parasysh proceset pezull në Gjykatën e Lartë, do të thotë që vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës nuk ka efekt *res judicata*, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është e pranueshme, pasi është e parakohshme dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Më pas Gjykata theksoi se neni 6.1 në pjesën “civile” (civil limb) është i zbatueshëm për të gjitha mosmarrëveshjet që përfshijnë nëpunësit civilë, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm përjashton shprehimisht qasjen në një gjykatë për postin ose kategorinë e stafit/ personit në fjalë, dhe kur ky përjashtim është i justifikuar me arsye objektive në interes të shtetit. Në parim nuk mund të ketë justifikim për përjashtim nga garancitë e nenit 6 të kontesteve të zakonshme të punës, të tilla si mosmarrëveshje që lidhen me pagat, shtesat apo çështje të tilla të ngjashme, mbi bazën e natyrës së posaçme të marrëdhënies ndërmjet nëpunësit civil të veçantë dhe shtetit në fjalë (shih *Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*, nr. 43803/98, paragrafi 62, 8 gusht 2006). Në rastin konkret, Gjykata vuri re se pretendimi civil i kërkuarit u shqyrtua dhe u zgjidh nga gjykatat e brendshme sipas rregullave të zakonshme të procedurës civile. Kërkuari nuk u përjashtua nga legjislacioni i brendshëm nga “qasja në gjykatë” brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Bazuar në testin e zhvilluar në çështjen *Eskelinen dhe të tjerë*, Gjykata arriti në përfundimin se neni 6 është i zbatueshëm në proceset e brendshme në fjalë. Gjykata është e mendimit se çështja

e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore, është e lidhur ngushtë dhe thelbësisht për çështjen e efektivitetit të ankesës kushtetuese në lidhje me moszbatimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, i cili është shqyrtuar sipas nenit 13 më poshtë. Ajo konstatoi se ky ankim nuk është haptazi i papabazuar në kuptimin e nenit 35.3 të Konventës. Ajo konstatoi më tej se kërkesa nuk është e papranueshme për arsye të tjera. Si rezultat, ajo duhet deklaruar e pranueshme.

Gjykata theksoi se një vonesë e tejzgjatur e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi përfundimtar dhe detyrues, mund të shkelë Konventën (shih *Burdov kundër Ruisë*, nr. 59498/00, ECHR 2002III). Arsyeshmëria e një vonese të tillë duhet përcaktuar duke pasur parasysh, në veçanti, kompleksitetin e zbatimit të proceseve, sjelljen e vetë ankuesit dhe të organeve kompetente dhe masën dhe natyrën e dëmshpërblimit të përcaktuar nga gjykata (shih *Raylyan kundër Ruisë*, nr. 22000/03, paragrafi 31, 15 shkurt 2007). Një person që ka fituar një aktgjykim kundër shtetit, mund të mos pritët të iniciojë një proces të posaçëm për zbatimin (shih *Metaxas kundër Greqisë*, nr. 8415/02, paragrafi 19, 27 maj 2004). Në raste të tilla, autoriteti i shtetit të paditur duhet njoftuar në kohë për vendimin dhe, në këtë mënyrë, të jetë i mirëpozicionuar për ta përmbushur vendimin ose për t'ia transferuar atë një tjetër autoriteti shtetëror që është përgjegjës për ekzekutimin. Gjykata vuri re se Qeveria nuk parashtrroi ndonjë arsye bindëse për moszbatimin nga autoritetet përgjegjëse të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të 27 shtatorit 2005. Në lidhje me sugjerimin e Qeverisë se emërimi i kërkuesit ishte i padrejtë, gjykatat e brendshme vendosën në favor të tij. Rreziku i çdo gabimi duhet t'i ngarkohet shtetit dhe ato (gabimet) nuk duhet të ndreqen në kurriz të individit përkatës (shih *Xheraj*, cituar më lart, . 58). Autoritetet kombëtare duket se nuk kanë bërë përpjekje për t'i ofruar kërkuesit një zgjidhje alternative, për shembull për t'i dhënë atij një tjetër pozicion të të njëjtit nivel. Nuk ka informacione për të dëshmuar se zbatimi përfshinte ndonjë kompleksitet specifik. Kërkuesi nuk e pengoi zbatimin. Gjykata nuk gjeti justifikim për këtë periudhë moszbatimi, e cila vijon dhe sot e kësaj dite dhe ka cenuar thelbin e së drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt para gjykatës. Për arsyet e lartpërmenduar, Gjykata ishte e mendimit se ka shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

Kërkuesi nuk u ankua për mungesë të mjeteve juridike efektive të brendshme në lidhje me moszbatimin e vendimeve në favor të tij. Megjithatë, Gjykata vuri re se mungesa e efektivitetit të masave të brendshme ligjore po rritet gjithnjë e më tepër para kësaj Gjykate në çështjet që lidhen me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme të formës së prerë. Si rezultat, Gjykata ka vendosur me vetëiniciativë të shqyrtojë këtë çështje sipas nenit 13 të Konventës (shih, për shembull, *Burdov kundër Rusisë (nr.2)*, nr. 33509/04, paragrafët 89-117, 15 janar 2009; *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, 22 gusht 2006; dhe *Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004). Në çështjen në fjalë, gjithsesi, Gjykata vuri re se kërkuesi nuk depozitoi një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të 27 dhjetorit 2005. Gjykata duhet të përcaktojë nëse mjetet juridike të sipërpërmendura kanë qenë “efektive” në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar apo të vijimësisë së saj, ose të ofrimit të dëmshpërblimit të përshtatshëm për çdo shkelje të ndodhur. Gjykata vuri re se vendimet e Gjykatës Kushtetuese njohën se kishte shkelje të së drejtës së kërkuesit për qasje në gjykatë lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatave të brendshme. Gjithsesi, gjetjet e tyre ishin deklaruese në kuptimin që Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë dëmshpërblim efektiv. Më specifikisht, ajo nuk dha ndonjë dëmshpërblim për dëme materiale e jomateriale, dhe as që mundi të ofrojë një perspektivë të qartë për të parandaluar një shkelje të pretenduar ose vijimësinë e saj. Për më tepër, Gjykata vuri re se veprimet e përmbaruesit nuk ishin efektive në rastin në fjalë, Qeveria nuk konsideroi praninë e ndonjë mase alternative parandaluese, e cila, në rrethanat e kësaj çështjeje, do t’i ishte ofruar kërkuesit. Gjykata arrin në përfundimin se, si rrjedhim, ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenit 6.1 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata deklaroi pretendimet sipas nenit 6.1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit, të 24 tetorit 2006, të papranueshme; u pajtua me kundërshtimin paraprak të Qeverisë në lidhje me mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike nga parashtruesi për sa i përket vendimit të Gjykatës së Rrethit të

Durrësit të 27 shtatorit 2005 dhe e deklaroi pjesën tjetër të kërkesës të pranueshme; vendosi se kishte shkelje të nenit 6.1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të 27 shtatorit 2005; vendosi se kishte shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6.1 të Konventës për sa i përket mungesës së mjeteve juridike efektive për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të 27 shtatorit 2005 dhe, rrjedhimisht, rrëzoi kundërshtimin paraprak të Qeverisë; vendosi se shteti i paditur do t'i paguajë parashtruesit, brenda tre muajsh nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar sipas nenit 44.2 të Konventës: i) 2,100 (dy mijë e njëqind) euro, në lidhje me dëmin jomaterial; ii) 2,150 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, plus çdo tatim që mund të vendoset në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. DENNIS MAC QUEN, DEREK POUTON, CARLA GODTS, YOUSSEF ANTOUN DHE “GRANDVISION BELGIUM SA”

GJDKE

Çështja C-108/96

1 shkurt 2001

[<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/GA/TXT/?uri=CELEX:61996CJ0108>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Kjo çështje ka të bëjë me kufizimet që mund të vendosin shtetet anëtare ndaj filialeve të kompanive të krijuara në një shtet anëtar tjetër, për arsye të shëndetit publik.

Faktet kryesore

“Grandvision” është një kompani publike me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjit belg e cila ka selinë e saj të regjistruar në Bruksel. “Grandvision” është pjesë e një grupi kompanish që tregtojnë produkte dhe shërbime në fushën e optikës. Ajo kontrollon nga kompania

angleze “Vision Express UK Ltd”. Z. Mac Quen ishte drejtor i kësaj të fundit para se të ushtronte, nga nëntori 1990 deri në korrik 1991, funksionet e drejtorit të “Vision Express Belgium SA”. Z. Pouton e pasoi atë në këto funksione nga korriku 1991 deri më 1993.

Menjëherë pas regjistrimit të saj, “Vision Express Belgium SA” shpërndau në Belgjikë një reklamë në lidhje me ekzaminimet e ndryshme të syve që kryhen në dyqanet e saj, sidomos “tonometri të kompjuterizuar”, me qëllim zbulimin e “hipertensionit të mundshëm intraokular”, një “retinoskopi të përgjithshme”, që synon të ekzaminojë “gjendjen e retinës”, si dhe një “vlerësim të fushës vizuale duke përdorur një pajisje ultra-moderne” dhe një “biomikroskopi” e cila jep “gjendjen e kornesë, konjunktivës, qepallat dhe lotët [...]”. Kjo reklamë ishte me sa duket përkthimi fjalë për fjalë i reklamës së bërë në Mbretërinë e Bashkuar nga kompania “Vision Express UK Ltd”. Bazuar në këtë reklamë, në shtator 1991, Shoqata belge e specialistëve të okulistikës dhe kirurgjisë së syve (në tekstin e mëtejme: “UPBMO”), bëri një padi, duke dalë vetë si palë civile, kundër “Grandvision”, për praktikë të paligjshme të mjekësisë dhe reklama të rreme. Në përfundim të hetimit penal, dosja kundër z. Mac Quen dhe z. Pouton, si dhe z. Antoun, opticienit dhe znj. Godts, sekretare, së bashku me kompaninë “Grandvision” që si punëdhënëse e katër të pandehurve kishte përgjegjësi civile, u dërgua para Gjykatës së Shkallës së Parë të Brukselit. Duke pasur dyshime për pajtueshmërinë e legjislacionit belg, siç interpretohet nga Gjykata e Kasacionit, me të drejtën komunitare, Gjykata e Shkallës së Parë të Brukselit vendosi ta pezullojë procedurën dhe t’i dërgojë Gjykatës pyetjet e mëposhtme për një vendim paraprak:

‘1) A është në përputhje me nenet 5, 52 dhe 59 të Traktatit të KE-së një interpretim ose zbatim i një dispozite të ligjit kombëtar që u ndalon okulistëve nga shtetet e tjera anëtare ofrimin, brenda një shteti anëtar, në kuadër të korigjimit të defekteve thjesht optike të shikimit, të shërbimeve të ekzaminimit objektiv të shikimit, që do të thotë me një metodë në të cilën vetë klienti përcakton defektet optike nga të cilat ai vuan dhe vetëm siguron korigjimin që duhet bërë?

2) A janë të pajtueshme me nenin 30 të Traktatit të KE-së ndalimet që rrjedhin nga ligji kombëtar për tregtimin, brenda një shteti anëtar,

të pajisjeve që lejojnë një ekzaminim objektiv të vizionit me qëllim korrigjimin e defekteve thjesht optike të shikimit, të cilat ndalojnë okulistët e vendosur në shtetet e tjera anëtare të ofrojnë shërbime të ekzaminimit objektiv të shikimit? “

Përmbledhja e vendimit

Përderisa çështja nuk kishte të bënte me shërbime ndërkufitare, Gjykata arriti paraprakisht në përfundimin se nenet 5 dhe 59 të Traktatit të KE-së nuk janë relevante për analizën e saj. Prandaj ajo e kufizoi analizën e saj mbi papajtueshmërinë e legjislacionit belg nën dritën e neneve 30²¹¹ dhe 52²¹² të Traktatit të KE-së.

Në gjendjen aktuale të së drejtës së Komunitetit Evropian, neni 52 i Traktatit nuk i pengon autoritetet kompetente të një shteti anëtar të interpretojnë ligjin kombëtar në lidhje me “praktikimin e mjekësisë” në atë mënyrë që, në kuadrin e korrigjimit të mangësive thjesht optike të shikimit të klientit, ekzaminimi objektiv i të pamurit të klientit, domethënë një ekzaminim që nuk përdor një metodë sipas së cilës vetë klienti identifikon mangësitë optike nga të cilat ai vuan, i rezervohet, për arsye që lidhen me mbrojtjen e shëndetit publik, një kategori profesionistësh me kualifikime specifike, siç janë okulistët, duke përjashtuar, në veçanti, opticienët jo-mjekë. Në të vërtetë, zgjedhja e një shteti anëtar për t’u rezervuar këtyre profesionistëve të drejtën për të kryer te pacientët e tyre një ekzaminim objektiv të shikimit duke përdorur instrumente të sofistikuara për të bërë të mundur vlerësimin e tensionit intraokular, përcaktimin e fushës së shikimit ose analizimin e gjendjes së retinës, mund të konsiderohet si një mjet i duhur për të siguruar arritjen e një niveli të lartë të mbrojtjes shëndetësore.

Sidoqoftë, ndalimi i vendosur për opticienët jo-mjekë për të kryer disa ekzaminime optike, i cili zbatohet pavarësisht nga shtetësia dhe nga shteti anëtar ku janë vendosur personat të cilëve u drejtohet, duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional për të arritur këtë objektiv. Në

211 Aktualisht neni 36 i TFBE-së

212 Aktualisht neni 49 i TFBE-së.

këtë drejtim, vlerësimi i rreziqeve për shëndetin publik ka të ngjarë të ndryshojë me kalimin e viteve, veçanërisht në varësi të përparimit teknik dhe shkencor.

Gjykata vlerësoi se e njëjta logjikë gjen zbatim edhe në lidhje me nenin 30, nëse pranohet se ndalimi në fjalë paraqet masë kufizuese ndaj lëvizjes së lirë të mallrave. I takon gjykatës kombëtare të vlerësojë, në dritën e dispozitave të Traktatit që lidhen me lirinë e vendosjes, si dhe me kërkesat e sigurisë juridike dhe mbrojtjen e shëndetit publik, nëse interpretimi i ligjit të brendshëm të miratuar për këtë qëllim nga autoritetet kombëtare kompetente, mbetet një bazë e vlefshme për procedurat penale të iniciuara në procedurën kryesore përpara gjykatave belge.

3.2. RY kundër KOMISIONIT EVROPIAN

Tribunali i BE-së
Çështja T160/17

10 janar 2019

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=T-160/17&language=EN>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: në këtë çështje, Tribunali anuloi një vendim të Komisionit Evropian që ndërpriste, për shkelje të lidhjes së besimit, kontratën me një funksionar të Komisionit për shkak të shkeljes të së drejtës së tij për t'u dëgjuar.

Faktet kryesore

Parashtruesi, RY, u punësua në Komisionin Evropian më 1 nëntor 2014 si agjent i përkohshëm, i rekrutuar sipas nenit 2 (c) të Kushteve të Punësimit të Funksionarëve të Tjerë të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: “KPFT”), në kuadër të një kontrate pa afat. Në bazë të neneve 2 dhe 3 të Kontratës së punës të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Burimeve Njerëzore dhe i Sigurisë të Komisionit më 11 dhjetor 2014, parashtruesi ushtroi, nga 1 nëntori 2014, postin e zëvendësimit të

Kabinetit të një anëtari të Komisionit, duke u klasifikuar në gradën AD 12, shkalla 2. Me një ndryshim në Kontratën e punës të nënshkruar më 2 tetor 2015 që hynte në fuqi nga 1 tetori 2015, funksionet e parashtruesit u ndryshuan, dhe ai kaloi në postin e ekspertit në Kabinetin e anëtarit të Komisionit, duke u klasifikuar në gradën AD 13, shkalla 2.

Me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve Njerëzore dhe të Sigurisë, të 27 prillit 2016, Komisioni ndërpreu kontratën e parashtruesit si agjent i përkohshëm sipas nenit 47 (c), (i) të KPFT-së me efekt nga 1 gushti 2016. Ky vendim parashikonte një periudhë njoftimi paraprak prej tre muajsh, nga 1 maji 2016 deri më 31 korrik 2016, gjatë së cilës parashtruesi vihej në dispozicion të një drejtorie të përgjithshme. Pasi parashtruesi ishte me leje shëndetësore gjatë periudhës së njoftimit, kjo periudhë mori fund më 30 tetor 2016.

Më 27 korrik 2016, parashtruesi paraqiti një ankesë pranë Autoritetit të Autorizuar për të Lidhur Kontrata Pune (në tekstin e mëtejme: "AALK") të Komisionit kundër vendimit të 27 prillit 2016, sipas nenit 90.2 të Rregullores së Stafit të Funkionarëve të BE-së. Në mbështetje të ankesës së tij, RY pretendoi, nga njëra anë, shkelje të nenit 41 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejme: "Karta") dhe, nga ana tjetër, shkelje të nenit 2 (c) të KPFT-së.

Në lidhje me nenin 41 të Kartës, parashtruesi pretendoi se vendimi i 27 prillit 2016 ishte tërësisht i pamotivuar dhe shkelte të drejtën për t'u dëgjuar. Në pjesën B, pika 1 të ankesës së tij, të titulluar "mbi themelin", parashtruesi deklaroi në veçanti se ai nuk ishte informuar për arsyet që çuan në ndërprerjen e kontratës së tij, kështu që ai nuk kishte qenë në gjendje t'i paraqiste AALK-së pretendimet e tij kundër vendimit të 27 prillit 2016. Në pikën 2, në vijim, ai shtoi se as anëtari në fjalë i Komisionit për të cilin punonte dhe askush tjetër nuk e kishin informuar për shkeljen e marrëdhënies së besimit.

Me një vendim të 28 nëntorit 2016, Zëvendëspresidentja e Komisionit, që është përgjegjëse për buxhetin dhe burimet njerëzore, duke vepruar si AALK, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Në këtë vendim, AALK konsideroi se detyrimi për të dëgjuar parashtruesin në fjalë para shkarkimit nuk zbatohet kur, si në rastin aktual, bëhet fjalë për një agjent

të përkohshëm të kontraktuar në bazë të nenit 2 (c) të KPFT-së, vendimi për përfundimin e kontratës është marrë në bazë të shkëljes së lidhjes së besimit. AALK vlerësoi gjithsesi, se argumenti i bazuar në shkëljen e të drejtave të mbrojtjes duhet të refuzohet, meqenëse parashtruesit i ishte mundësuar të paraqiste pikëpamjen e tij mbi largimin e tij nga kabineti, veçanërisht gjatë takimeve të organizuara në shtator dhe dhjetor 2015. Në vijim, AALK vlerësoi se vendimi i ndërprerjes së kontratës ishte arsyetuar siç duhet. Në lidhje me këtë, AALK tregoi në veçanti se ankuesi ishte informuar në disa raste se puna e tij ishte e pakënaqshme dhe se mundësia e ndërprerjes së kontratës së tij ishte ngritur të paktën dy herë gjatë vitit gjatë bisedave me Shefin e Kabinetit dhe me Anëtarin e Komisionit. AALK shtoi se vendimi për ndërprerjen e kontratës përmbante arsye shtesë.

Përmbledhja e vendimit

Në vendimin e tij Tribunali vlerësoi, para së gjithash, se natyra specifike e funksioneve të ushtruara brenda zyrës së një Anëtari të Komisionit dhe nevoja për të ruajtur një marrëdhënie besimi të ndërsjellë, nuk mund të privojnë funksionarët në fjalë nga e drejta për t'u dëgjuar para miratimit të një vendimi që ndërpret në mënyrë të njëanshme kontratën e tij me pretendimin e shkëljes së lidhjes së besimit. Tribunali kujtoi se e drejta e personit në fjalë për t'u dëgjuar para miratimit të ndonjë vendimi individual që ndikon negativisht ndaj tij, është e parashikuar shprehimisht në dispozitat e nenit 41.2 (a) të Kartës, e cila ka të njëjtën vlerë juridike si traktatet.

Sipas nenit 41 të Kartës, me titull “E drejta për administrim të mirë”:

“1. Gjithkush ka të drejtë që punët e tij të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Unionit.

2. Kjo e drejtë përfshin në veçanti:

(a) të drejtën e gjithkujt për t'u dëgjuar përpara se të merret kundër tij një masë individuale që do të ndikonte negativisht [...]”

Tribunali theksoi se, siç duket nga formulimi i saj, kjo dispozitë ka zbatim të përgjithshëm. Gjykata e Drejtësisë ka pohuar gjithmonë rëndësinë e së drejtës për t'u dëgjuar dhe shtrirjen e saj shumë të gjerë në rendin juridik të Bashkimit Evropian, duke konsideruar se kjo e drejtë duhet të zbatohet për çdo procedurë që mund të “rezultojë në një veprim që ka pasoja negative”. Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar kërkohet edhe kur legjislativi në fuqi nuk e parashikon shprehimisht një formalitet të tillë. E drejta për t'u dëgjuar i garanton të gjithëve mundësinë për të bërë të njohur, në mënyrë të dobishme dhe efektive, këndvështrimin e tyre gjatë procedurës administrative dhe para miratimit të çdo vendimi që mund të ndikojë negativisht në interesat e tyre. Qëllimi i kësaj të drejte është në veçanti, që të sigurojë mbrojtje efektive të personit në mënyrë që ky i fundit të jetë në gjendje të korrigjojë një gabim ose të parashtrojë elemente të tilla që lidhen me situatën e tij personale, e të cilat mund të ndikojnë në ndryshimin e vendimit. E drejta për t'u dëgjuar nënkupton gjithashtu që administrata duhet t'i kushtojë të gjithë vëmendjen e kërkuar vëzhgimeve të paraqitura nga personi i interesuar duke shqyrtuar, me kujdes dhe paanshmëri, të gjithë elementet përkatëse të çështjes. Kështu, e drejta në fjalë duhet t'i mundësojë administratës që të shqyrtojë çështjen për të marrë një vendim në njohuri të plotë të fakteve dhe për ta justifikuar atë në mënyrën e duhur, në mënyrë që, nëse është e nevojshme, personi në fjalë të mund të ushtrojë në mënyrë të vlefshme të drejtën e tij. Tribunali shtoi se respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar është edhe më i nevojshëm, në rast të ndërprerjes, me nismën e administratës, të kontratës pa afat të një funksionari të përkohshëm duke pasur parasysh se një masë e tillë, sado e justifikuar të jetë, përbën një akt me pasoja të rënda për personin në fjalë.

Tribunali e pranoi kompetencën e gjerë diskrecionale që kanë anëtarët e Komisionit të BE-së për të zgjedhur bashkëpunëtorët e tyre, gjë që justifikohet veçanërisht nga natyra specifike e funksioneve të ushtruara brenda kabinetit të një anëtari të Komisionit dhe, nga nevoja për të ruajtur një marrëdhënie besimi reciprok ndërmjet anëtarëve të Komisionit dhe kolegëve tyre. Megjithatë, natyra specifike e funksioneve të kryera brenda kabinetit të një anëtari të Komisionit dhe nevoja për të mbajtur një marrëdhënie besimi reciprok, nuk mund ta privojnë funksionarin në fjalë nga e drejta për t'u dëgjuar përpara miratimit të

një vendimi që zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën e tij për shkak të shkeljes së lidhjes së besimit.

Kjo është e nevojshme sipas Tribunalit për shkak se komisioneri në fjalë mund të marrë në konsideratë, pasi funksionarit në fjalë i është mundësuar paraqitja e vëzhgimeve të tij, se lidhja e besimit nuk është prishur përfundimisht. Për më tepër, edhe pse nuk i takon AALK-së të zëvendësojë me vlerësimin e saj atë të komisionerit të interesuar në lidhje me shkeljen apo jo të lidhjes së besimit, AALK megjithatë duhet, para së gjithash, të verifikojë nëse mungesa ose humbja e një lidhjeje besimi është referuar efektivisht. Në vijim AALK duhet të sigurohet për saktësinë materiale të fakteve dhe, së fundi, për të siguruar që, duke pasur parasysh arsyen e parashtruar, kërkesa për përfundimin e kontratës nuk shkel të drejtat themelore ose nuk përbën abuzim me pushtetin. Në këtë kuadër, AALK mund të konsiderojë në veçanti, në dritën e vëzhgimeve të dhëna nga personi i interesuar, se rrethana të veçanta justifikojnë marrjen e masave të tjera përveç largimit nga puna.

Së fundi, Tribunali vlerësoi se, kur agjenti i përkohshëm mohon se është dëgjuar, i takon AHCC-së të sigurojë prova se personit në fjalë i është mundësuar të paraqesë vërejtjet e tij mbi qëllimin e Komisionit për të ndërprerë kontratën e tij në bazë të shkeljes së lidhjes së besimit. Si përfundim, Tribunali e anuloi vendimin e sipërpërmendur të AALK-së.

Neni 50

Të Drejtat e Fëmijës

- 1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.*
- 2. Fëmijët e lindur jashtë martesë, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.*
- 3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.*
- 4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.*
- 5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI113/17. PARASHTRUES: X

[\[https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2019/04/ki_113_17_av_shq.pdf\]](https://gjk-ks.org/ep-content/uploads/2019/04/ki_113_17_av_shq.pdf)

23 prill 2019

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Parashtruesi kishte jetuar në Suedi me familje nga viti 2010 deri në vitin 2011 kur ai ishte kthyer në Kosovë nga autoritetet suedeze. Në Kosovë, parashtruesi fillimisht kishte përfitur nga Programi për Riintegrim të personave të kthyer (riatdhësuar), në Kosovë. Por atij i ishte refuzuar kërkesa për ndërtimin e shtëpisë. Çështja e ngritur përmes kërkesës lidhej me pretendimet e parashtruesit se në rastin e tij ishin shkelur nenet 22 dhe 50 të Kushtetutës [Të Drejtat e Fëmijës] dhe neni 25 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Faktet kryesore

Më 5 qershor 2010, parashtruesi kishte shkuar në Suedi me familje. Më 29 qershor 2011, parashtruesi ishte kthyer nga autoritetet suedeze në Kosovë. Pas kthimit dhe deri më 1 shkurt 2013, parashtruesi kishte jetuar në shtëpinë e vëllait të tij në një dhomë banimi. Më 18 maj 2012, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë në Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) të Komunës së Podujevës për ndërtimin e shtëpisë dhe ndihmë urgjente për strehim, për shkak të kushteve të rënda të jetesës dhe pamundësisë që ai vetë ta zgjidhte çështjen e banimit për të dhe familjen e tij. ZKKK-Podujevë kishte dërguar kërkesën e parashtruesit në Bordin Ekzekutiv për Riintegrimin e Personave të Riatdhësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (DRPR i MPB-së). Më 1 shkurt 2013, parashtruesi ishte akomoduar në banesë me qira nga ana e DRPR së MPB-së, por kontrata për akomodim kishte skaduar në fund të muajit korrik 2014. Më 18 korrik 2014, Kryetari i Komunës së Podujevës kishte nxjerrë vendim me të cilin parashtruesit i miratohej

kërkesa për vazhdimin e strehimit edhe për 6 muaj. Më 30 korrik 2014, DRPR i MPB-së kishte informuar me shkresë Komisionin Komunal për Riintegrim në Komunën e Podujevës se parashtruesi i kishte kaluar të gjitha afatet kohore të parapara për banim përmes qerasë. Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror për Riintegrim kishte nxjerrë vendim me të cilin parashtruesit i ishte refuzuar kërkesa për ndërtim të shtëpisë, sipas kërkesës së parashtruar nga Komuna e Podujevës. Më 27 qershor 2014, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave kundër vendimit të Komisionit Qendror për Riintegrim e cila ishte refuzuar. Më 21 gusht 2014, parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore e cila ishte refuzuar si e pabazuar. Më 7 shkurt 2017, parashtruesi kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e cila ishte refuzuar si e pabazuar. Më 14 korrik 2017, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke kërkuar rishikimin e të gjitha vendimeve që kanë të bëjnë me çështjen juridike ku ai ishte palë në procedurë. Më 4 gusht 2017, Gjykata Supreme kishte nxjerrë Aktvendimin Rev. A. (U) nr. 13/2017, me të cilin kishte hedhur poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion. Më 12 shtator 2017, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe më 15 shtator 2017, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit i kishte bërë të ditur parashtruesit se nuk kishte gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Më 22 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 13/2017, të 4 gushtit 2017.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimet e kontestuara atij i janë shkelur nenet 22.1 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 50.4 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës dhe neni 25 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut por pa specifikuar mënyrën dhe kushtet, në të cilat këto shkelje të pretenduara kanë ndodhur. Ai argumentoi se kishte kërkuar që të kishte “një kulm mbi kokë”, sepse nuk kishte mundësi të ndërtonte vetë dhe se ishte i bindur se gjatë shqyrtimit të rastit të tij ishin bërë shkelje procedurale.

Parashtruesi gjithashtu kishte kërkuar që të mos i zbulohet identiteti për shkak të gjendjes së tij materiale dhe turpit që do të ndiente tek rrethi ku ai jetonte.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesi në kërkesën e tij thjesht vetëm i kishte përmendur dispozitat e nenit 22.1 të Kushtetutës dhe të nenit 25.4 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Gjykata rikujtoi se neni 22 i Kushtetutës përcaktonte se cilat marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Si e tillë, kjo dispozitë kushtetuese në raport me parashtruesin nuk mund të ishte objekt i një shkelje nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale.

Për sa i përket pretendimit për shkeljen e nenin 50 të Kushtetutës [Të Drejtat e Fëmijës], Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se parashtruesi vetëm e kishte përmendur pretendimin për shkelje të këtij neni, por nuk kishte dhënë asnjë shpjegim dhe nuk kishte bashkëngjitur ndonjë provë se si, dhe në ç'mënyrë ishte shkelur kjo dispozitë kushtetuese dhe cilat të drejta të fëmijëve ishin cenuar me veprimet e autoriteteve publike.

Gjykata Kushtetuese, më tej, konstatoi se edhe organet administrative, edhe gjykatat e rregullta kur kishin vendosur për kërkesën e parashtruesit, vendimet refuzuese i kishin nxjerrë mbi bazën e veprimeve procedurale të parashtruesit (mosaplikimi me kohë dhe çështja e titullarit të pronësisë për ndërtimin e shtëpisë) dhe jo mbi bazën e përcaktimit të gabuar të fakteve apo zbatimit të gabuar të ligjit, sikur pretendonte ai. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vërejtë se nuk mund të konstatonte se veprimet e ndërmarra nga institucionet publike nuk ishin “në interesin më të mirë të fëmijëve”, sikur parasheh neni 50.4 i Kushtetutës. Kjo sepse në çështjen juridike përgjatë tërë procesit, vendosej për një të drejtë të parashtruesit dhe jo drejtpërsëdrejti të fëmijëve, edhe pse rezultati përfundimtar i çështjes padyshim që afektonte edhe fëmijët e parashtruesit. Gjykata konsideroi se nga vendimet e paraqitura në kërkesë, parashtruesit dhe familjes së tij i ishte ofruar mbështetje, duke përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin, qoftë edhe në baza të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese më tutje vuri në pah se argumentimi i parashtruesit lidhur me shkeljet kushtetuese konsistonte në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimeve procedurale si dhe faktit që ai nuk kishte qenë fajtor për lëshimin e një afati në procedurë administrative, e i cili sipas tij, kishte rezultuar me refuzimin e kërkesës së tij. Lidhur me këtë, Gjykata analizoi pretendimet dhe arsyetimet e vendimeve të organeve administrative dhe gjykatave dhe erdhi në përfundim se parashtruesi kishte pasur mundësi të shumta që të paraqiste rastin e tij në organet administrative-komisionet përkatëse të MPB-së, si dhe në tri shkallët e gjykatave të rregullta. Gjykata theksoi se duke përdorur mjetet e ankimit, parashtruesi kishte marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore, andaj, procesi në tërësinë e tij nuk mund të cilësohej si arbitrar apo i padrejtë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konkludoi se parashtruesi nuk dëshmoi dhe nuk mbështeti në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtave të garantuara më Kushtetutë. Në fund, duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit dhe shpjegimin për gjendjen e tij materiale, Gjykata aprovoi kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit (në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 39 (2) dhe (6) të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi të shpallë kërkesën të papranueshme.

1.2. KI36/12 PARASHTRUES: BAJRAM LUTA

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_36_12_shq.pdf]

6 nëntor 2012

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky rast kishte të bënte me kujdestarinë e fëmijës që ishte nipi i parashtruesit të kërkesës, të cilin Qendra për Punë Sociale fillimisht ia kishte besuar parashtruesit, por më vonë gjykatat kishin urdhëruar parashtruesin që fëmijën e mitur t'ia kthente nënës së vet. Çështja kyçe në këtë rast ishte se a i ishin cenuar parashtruesit të drejtat e tij kushtetuese, si dhe a ishte shkelur Ligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (çështje kjo që ndërlidhej edhe më nën 50 të Kushtetutës).

Faktet kryesore

Më 11 tetor 2010, Qendra për Punë Sociale në Rahovec kishte marrë vendim për t'ia dhënë parashtruesit të kërkesës në kujdestari të përkohshme një fëmijë të mitur, që ishte nip i tij. Më 29 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte nxjerrë vendimin N. Nj. C 2/2011 dhe kishte urdhëruar parashtruesin e kërkesës t'ia kthente fëmijën e mitur nënës së vet. Gjykata e Qarkut gjithashtu kishte vendosur se, në rast të mosrespektimit të urdhrit të Gjykatës, parashtruesi do të gjobitej me gjobë 10,000 euro. Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte arsyetuar se fëmija i mitur jetonte me parashtruesin pa lejen e nënës së fëmijës. Gjithashtu, ishte theksuar se Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Austrisë kishin kërkuar nga parashtruesi t'ia kthente fëmijën nënës së vet (e cila jetonte në Austri). Kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme kishte nxjerrë vendimin AC nr. 40/2011, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit si e pabazuar dhe ishte vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut. I pakënaqur me këtë vendim, parashtruesi i kërkesës i kishte kërkuar Gjykatës Supreme që të përsëriste procedurën. Gjykata Supreme e kishte refuzuar propozimin e parashtruesit për përsëritjen e procedurës, përmes vendimit PPC nr. 62/11, të 29 shtatorit 2011.

Më 26 shtator 2011, Qendra për Punë Social në Rahovec kishte nxjerrë një vendim të ri dhe kishte prishur vendimin e saj të mëhershëm, të 11 tetorit 2010, me të cilin parashtruesit i ishte dhënë kujdestaria e përkohshme. Qendra për Punë Sociale kishte njoftuar se arsyeja për këtë vendim ishte bashkimi i fëmijës së mitur me nënën e tij. Parashtruesi më pas kishte kontestuar vendimin e Gjykatës Supreme (të 29 shtatorit 2011) në panelin e Gjykatës Supreme. Ai kishte argumentuar, ndër të tjera, se Gjykata nuk i kishte dhënë mundësi kundërpropozuesit (d.m.th., parashtruesit) që të merrte pjesë në shqyrtim gjyqësor. Më 17 janar 2012, Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazë. Gjykata Supreme, ndër të tjera, kishte vlerësuar se provat e reja nuk kishin ndikim në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga ai ku ishte vendosur që fëmija t'i kthehej nënës. Në pajtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe në pajtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, gjykatat gjithmonë veprojnë në interes të fëmijës së mitur.

Më 3 prill 2012, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 17 janarit 2012.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se i ishin shkelur të drejtat e garantuara më nenin 113 të Kushtetutës dhe më nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër, parashtruesi theksoi se Gjykata Supreme kishte shkelur nenin 3, pika 1.1., të Ligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, nr. 03/L- 238.

Arsyetimi i Gjykatës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se nga faktet e paraqitura në këtë kërkesë rezultonte se parashtruesi i kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe se gjykatat e rregullta i kishin marrë parasysh dhe i ishin përgjigjur ankesave të tij. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideroi se nuk kishte asgjë në kërkesë që tregonte se vendimmarrjes i kishte munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta apo që ishin shkelur të drejtat e fëmijës. Gjykata Kushtetuese konsideroi se

parashtruesi as nuk e kishte ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe as që kishte ofruar ndonjë provë *prima facie* për atë shkelje. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri, vendosi që të hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. PARADISO DHE CAMPANELLI kundër ITALISË

[25358/12]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

1 qershor 2015

Çështja kyçe/e drejta e pretenduar: *refuzimi për të regjistruar të dhënat e certifikatës së lindjes së fëmijës në regjistrin italian të lindjeve, martesave dhe vdekjeve, si dhe marrja e fëmijës së mitur nga kërkuesit, ishin të papajtueshme me nenin 8 të Konventës.*

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Donatina Paradiso dhe Giovanni Campanelli (kërkuesit), dy shtetas italianë, kundër Republikës Italiane, depozituar në Gjykatë më 27 prill 2012. Kërkuesit kanë paraqitur edhe një kërkesë në emër të fëmijës, i cili, në bazë të certifikatës së lindjes të lëshuar nga autoritetet ruse më 1 mars 2011, ishte djali i tyre, i lindur më 27 shkurt 2011, dhe u quajt Teodoro Campanelli. Kërkuesit janë një çift i martuar. Pas përpjekjeve të pasuksesshme për fertilizim *in vitro*, ata vendosën të përdornin zëvendësimin gestacional për t'u bërë prindër. Për këtë qëllim,

ata kontaktuan një klinikë me seli në Moskë, e cila ishte e specializuar në teknologjinë e riprodhimit të asistuar. Ata hynë në një marrëveshje për zëvendësimin gestacional me kompaninë Rosjurconsulting. Pas një suksesi në fertilizimin *in vitro*, më 19 maj 2010, dy embrionet “që u përkisnin atyre” ishin futur në barkun e një nëne zëvendësuese më 19 qershor 2010. Nuk kishte asnjë lidhje gjenetike midis kësaj gruaje dhe embrioneve. Foshnja ka lindur më 27 shkurt 2011. Nëna zëvendësuese dha pëlqimin e saj me shkrim për fëmijën duke e regjistruar si djalin e kërkuesve.

Certifikata e lindjes e lëshuar në Rusi, e cila nuk përmbante asnjë referencë për zëvendësimin gestacional, është certifikuar në përputhje me dispozitat e Konventës së Hagës të 5 tetorit 1961 për Heqjen e Kërkesës për Legalizim për Dokumentet Publike të Huaja (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa e Hagës”).²¹³ Më 29 prill 2011, kërkuesja e parë shkoi në Konsullatën Italiane në Moskë për të marrë dokumentet që do të lejonin fëmijën të largohej për në Itali me të. Kërkuesja iu përgjigj pyetjeve dhe dorëzoi dokumentet në lidhje me lindjen e fëmijës. Konsullata italiane lëshoi dokumentet që mundësonin largimin e djalit në Itali me kërkuesen e parë. Më 30 prill 2011, kërkuesja e parë dhe fëmija mbërritën në Itali. Një ditë më vonë kërkuesi i dytë ka kontaktuar komunën Colletorto, duke kërkuar që të dhënat e certifikatës së lindjes të regjistrohen në regjistër.

Në maj të vitit 2011, pasi kishin kërkuar që autoritetet italiane të regjistronin certifikatën e lindjes, kërkuesit u vunë nën hetim për “paraqitje e rreme e gjendjes civile” dhe shkelje të legjislacionit të birësimit, pasi kishin sjellë fëmijën në vend duke shkelur ligjin dhe autorizimin për birësim, i cili kishte përjashtuar adoptimin e një fëmije kaq të vogël. Në të njëjtën ditë, prokurori publik kërkoi hapjen e procedurës për lirim të fëmijës për adoptim, pasi që ai do të konsiderohej si fëmijë në “gjendje të braktisjes”. Në gusht 2011, me kërkesë të gjykatës u krye një test i ADN-së. Ai tregoi se, ndryshe nga

213 Konventa e 5 tetorit 1961 Për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Publike të Huaja (Konventa Apostille HCCH 1961) lehtëson përdorimin e dokumenteve publike jashtë vendit. Qëllimi i Konventës është të shfuqizojë kërkesën tradicionale të legalizimit, duke zëvendësuar procesin shpeshherë të gjatë dhe të kushtueshëm të legalizimit me lëshimin e një certifikate të vetme Apostille nga një Autoritet Kompetent në vendin nga e ka origjinën dokumenti. Programi elektronik Apostille (e-APP) u lançua në vitin 2006 për të mbështetur lëshimin elektronik dhe verifikimin e Apostileve në mbarë botën.

sa kishin deklaruar kërkuesit, nuk kishte asnjë lidhje gjenetike midis kërkuesit të dytë dhe fëmijës. Në tetor 2011, Gjykata për të Miturit vendosi të largonte fëmijën nga kërkuesit. Kontakti midis kërkuesve dhe fëmijës ishte i ndaluar. Në prill 2013, gjykata vendosi se ishte legjitime të refuzohej regjistrimi i certifikatës ruse të lindjes dhe urdhëroi që të lëshohej një certifikatë e re lindjeje, duke treguar se fëmija kishte lindur nga prindër të panjohur dhe duke i dhënë atij një emër të ri. Fëmija u birësua nga një familje tjetër. Gjykata vendase vlerësoi se kërkuesit nuk kishin status për të vepruar në ato procedura birësimi.

Me një vendim të 27 janarit 2015 (shih Shënimin e Informacionit 181), një Dhomë e Gjykatës konstatoi, me pesë vota për dhe dy kundër, se largimi i fëmijës përbënte shkelle të nenit 8 të Konventës për shkak të, në veçanti, konkluzionit të nxituar se prindërit e synuar nuk ishin të aftë për t'u kujdesur për fëmijën dhe fakti që interesat e fëmijës, i cili ishte pa identitet ligjor për më shumë se dy vjet, nuk ishin marrë në konsideratë siç duhet.

Më 1 qershor 2015, rasti iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretenduan, në veçanti, se refuzimi për të regjistruar të dhënat e certifikatës së lindjes së fëmijës në regjistrin italian të lindjeve, martesave dhe vdekjeve, si dhe marrja e fëmijës së mitur nga ata, ishin të papajtueshme me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të Konventës. Kërkuesit pretenduan se masat e marra nga autoritetet italiane në lidhje me fëmijën, të cilat rezultuan në largimin e përhershëm të këtij të fundit, kishin cenuar të drejtën e tyre për respektimin e jetës private dhe familjare, të garantuar nga neni 8 i Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me (a) zbatueshmërinë e nenit 8, Gjykata vlerësoi si në vijim:

(i) Jeta familjare - Ndërprerja e marrëdhënies së kërkuesve me fëmijën ishte pasojë e pasigurisë ligjore që ata vetë kishin krijuar në

lidhje me marrëdhënien në fjalë, duke u përfshirë në sjellje që ishin në kundërshtim me ligjin italian. Autoritetet italiane kishin reaguar me shpejtësi ndaj kësaj situate duke kërkuar pezullimin e autoritetit prindëror dhe hapjen e procedurave për vënien e fëmijës në dispozicion për birësim. Duke pasur parasysh mungesën e ndonjë lidhjeje biologjike midis fëmijës dhe prindërve të synuar, kohëzgjatjen e shkurtër të marrëdhënies me fëmijën (rreth tetë muaj) dhe pasigurinë e lidhjeve nga pikëpamja ligjore, dhe pavarësisht nga ekzistenca e një projekti prindëror dhe nga cilësia e lidhjeve emocionale, Gjykata vlerësoi se nuk ishin plotësuar kushtet që i mundësonin të arrinte në përfundimin se kishte ekzistuar *de facto* një jetë familjare. Në këto rrethana, Gjykata arriti në përfundimin se në rastin konkret nuk kishte ekzistuar një jetë familjare.

Sa i përket vlerësimit të ndërhyrjes në (ii) jetën private, Gjykata theksoi se duke pasur parasysh se kërkuesit kishin pasur një qëllim të vërtetë për t'u bërë prindër dhe kishin eksploruar opsionet e ndryshme në dispozicion, për të dashur dhe rritur një fëmijë, ajo që ishte në diskutim ishte e drejta për respektimin e kërkuesve për t'u bërë prindër dhe zhvillimi personal i tyre nëpërmjet rolit të prindërve, që ata dëshironin të merrnin përballë fëmijës. Së fundi, duke qenë se procedurat para Gjykatës për të Mitur kishin të bënin me çështjen e lidhjeve biologjike midis fëmijës dhe kërkuesit të dytë, këto procese dhe vërtetimi i fakteve gjenetike kishin pasur ndikim në identitetin e kërkuesit të dytë dhe marrëdhëniet midis tyre. Si rrjedhojë, faktet e çështjes binin në sferën e jetës private të kërkuesve.

(b) Meritat - Masat e marra në lidhje me fëmijën kishin çuar në një ndërhyrje në jetën private të kërkuesve. Kjo ndërhyrje kishte qenë në përputhje me ligjin dhe synonte parandalimin e çrregullimeve dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Gjykatat kombëtare i kishin bazuar vendimet e tyre në mungesën e ndonjë lidhjeje gjenetike midis kërkuesve dhe fëmijës dhe në shkeljen e legjislacionit vendor në lidhje me birësimin ndërkombëtar dhe me riprodhimin e asistuar mjekësor. Masat e marra nga autoritetet kishin për qëllim të siguronin ndërprerjen e menjëhershme dhe të përhershme të çdo kontakti midis kërkuesve dhe fëmijës, dhe vendosjen e këtij të

fundit në një shtëpi dhe nën kujdestari. Faktet e çështjes preknin çështje etike të ndjeshme - birësimi, marrja e një fëmije në kujdes, riprodhimi i asistuar nga mjekësia dhe amësia zëvendësuese - në të cilat shtetet anëtare gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi. Autoritetet vendore ishin mbështetur veçanërisht në dy argumente: paligjshmërinë e sjelljes së kërkuesve dhe urgjencën e marrjes së masave në lidhje me fëmijën, të cilin ata e konsideronin “në një gjendje të braktisur” sipas kuptimit të seksionit 8 të Aktit të Birësimit. Arsyet e paraqitura nga gjykatat vendase ishin të lidhura drejtpërdrejt me qëllimin legjitim të parandalimit të çrregullimeve, si dhe me atë të mbrojtjes së fëmijëve - në rastin konkret por edhe më në përgjithësi - duke pasur parasysh prerogativën e shtetit për të vendosur prejardhjen nëpërmjet birësimit dhe nëpërmjet ndalimit të disa teknikave të riprodhimit të asistuar mjekësor.

Meqenëse çështja duhej të shqyrtohej nga këndi i së drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës së tyre private, duke pasur parasysh se ajo që ishte në rrezik, ishte e drejta e tyre për zhvillim personal nëpërmjet marrëdhënies së tyre me fëmijën, arsyet e dhëna nga gjykatat vendase, e cila ishte përqendruar në situatën e fëmijës dhe në paligjshmërinë e sjelljes së tyre, kishte qenë e mjaftueshme. Gjykatat vendore i kishin kushtuar rëndësi të konsiderueshme mosrespektimit të ligjit nga kërkuesi dhe faktit që ata kishin përdorur jashtë vendit metodat e riprodhimit të asistuar mjekësor që ishin të ndaluara në Itali. Në proceset e brendshme, gjykatat, të fokusuar në nevojën imperative për marrjen e masave urgjente, nuk ishin zgjeruar në interesat publike të përfshira; as nuk i kishin trajtuar në mënyrë eksplicite çështjet delikate etike që qëndrojnë në themel të dispozitave ligjore të shkelura nga kërkuesit. Për gjykatat e brendshme, shqetësimi kryesor kishte qenë t’i jepnin fund një situatë të paligjshme. Ligjet që ishin shkelur nga kërkuesit dhe masat që u morën në përgjigje të sjelljes së tyre, i shërbenin mbrojtjes së interesave shumë të rëndësishme publike.

Në lidhje me interesat e fëmijës, Gjykata e të Miturve kishte marrë parasysh faktin se nuk kishte asnjë lidhje biologjike midis kërkuesve dhe fëmijës dhe kishte vendosur që një çift i përshtatshëm duhet të identifikohet sa më shpejt që ishte e mundur për t’u kujdesur për të. Nisur nga mosha e vogël e fëmijës dhe periudha e shkurtër e kaluar me kërkuesit, gjykata nuk ishte pajtuar me raportin e psikologut të

paraqitur nga kërkuesit, duke sugjeruar se ndarja do të kishte pasoja shkatërruese për fëmijën. Kishte konstatuar se trauma e shkaktuar nga ndarja nuk do të ishte e pariparueshme.

Për sa i përket interesit të kërkuesve për të vazhduar marrëdhënien e tyre me fëmijën, gjykata e të miturve kishte vënë re se nuk kishte asnjë provë në dosje për të mbështetur pretendimin e tyre se ata i kishin ofruar klinikës ruse materialin gjenetik të kërkuesit të dytë. Pasi kishin marrë miratimin për birësim ndërshtetëror, ata kishin anashkaluar ligjin e birësimit duke e çuar fëmijën në Itali pa miratimin e Komisionit të Birësimeve Ndërmjet Vendeve. Në lidhje me atë sjellje, Gjykata e të Miturve kishte shprehur shqetësimin se fëmija mund të ishte një instrument për të përmbushur një dëshirë narcisiste të kërkuesve ose për të shuar një problem individual ose të përbashkët. Për më tepër, sjellja e kërkuesve kishte hedhur një “hije të qëndrueshme mbi zotërimin nga ana e tyre, të aftësive të vërteta emocionale dhe edukative dhe të instinktit të solidaritetit njerëzor, që duhet të jetë i pranishëm në çdo person që dëshiron të sjellë fëmijët e të tjerëve në jetën e tyre si fëmijët e tyre».

Fëmija nuk ishte kërkues në rastin në fjalë. Përveç kësaj, ai nuk ishte anëtar i familjes së kërkuesit sipas kuptimit të nenit 8 të Konventës. Megjithatë, kjo nuk do të thoshte se interesat më të mira të fëmijës dhe mënyra në të cilën ato ishin adresuar nga gjykatat vendase nuk ishin të rëndësishme.

Gjykatat vendase nuk ishin të detyruara t'i jepnin përparësi ruajtjes së marrëdhënies midis kërkuesve dhe fëmijës. Përkundrazi, atyre iu desh të bënin një zgjedhje të vështirë midis lejimit të kërkuesve për të vazhduar marrëdhënien e tyre me fëmijën, duke legalizuar kështu situatën e paligjshme të krijuar prej tyre, si një fakt i kryer, ose marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës një familje në përputhje me legjislacionin për adoptim.

Gjykatat italiane i kishin kushtuar pak peshë interesit të kërkuesve për të vazhduar zhvillimin e marrëdhënieve të tyre me një fëmijë, prindërit e të cilit dëshironin të ishin. Ata nuk kishin trajtuar në mënyrë eksplicite ndikimin që do të kishte ndarja e menjëhershme dhe e pakthyeshme

nga fëmija në jetën e tyre private. Megjithatë, kjo duhej parë në sfondin e paligjshmërisë së sjelljes së kërkuesve dhe faktit që marrëdhënia e tyre me fëmijën kishte qenë e pasigurt që në momentin që ata kishin vendosur të jetonin me të në Itali. Marrëdhënia ishte bërë edhe më e dobët pasi doli, si rezultat i testit të ADN-së, se nuk kishte asnjë lidhje biologjike midis kërkuesit të dytë dhe fëmijës.

Procedura kishte qenë e një natyre urgjente. Çdo masë që zgjat qëndrimin e fëmijës me kërkuesit, si për shembull, vendosja e tij në kujdesin e përkohshëm të tyre, do të kishte mbartur rrezikun që thjesht kalimi i kohës të përcaktonte rezultatin e çështjes.

Gjykata nuk e nënvlerësoi ndikimin që duhet të ketë pasur ndarja e menjëhershme dhe e pakthyeshme nga fëmija në jetën private të kërkuesve. Ndërsa Konventa nuk e njihte të drejtën për t'u bërë prind, Gjykata nuk mund të injoronte vështirësitë emocionale që pësonin ata, dëshira e të cilëve për t'u bërë prindër nuk ishte përmbushur ose nuk mund të përmbushej. Megjithatë, interesat publike në rrezik peshonin shumë në ekuilibër, ndërkohë që një peshë relativisht më e vogël duhej t'i jepej interesit të kërkuesve për zhvillimin e tyre personal duke vazhduar marrëdhënien e tyre me fëmijën. Pranimi për të lënë fëmijën të qëndrojë me parashtruesit, ndoshta me qëllim që ata të bëhen prindër birësues, do të ishte e barabartë me legalizimin e situatës së krijuar prej tyre në shkelje të rregullave të rëndësishme të ligjit italian. Gjykatat italiane, pasi vlerësuan se fëmija nuk do të pësonte dëm serioz ose të pariparueshëm nga ndarja, kishin vendosur një ekuilibër të drejtë midis interesave të ndryshme në lojë, duke mbetur në kufirin e gjerë të vlerësimit që kishin në dispozicion në këtë çështje.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata hodhi poshtë, njëzëri, kundërshtimet paraprake të Qeverisë; konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. *J. McB. kundër L. E.*

GJDBE

C-400/10 PPU

5 tetor 2010

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=81398&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13716810>]]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: ky vendim ka të bëjë me mënyrën e interpretimit të së drejtës së kujdestarisë së fëmijës nga secili prej prindërve, në mënyrë që të respektohen si të drejtat e secilit prej tyre për një jetë private dhe familjare, ashtu edhe interesi më i mirë i fëmijës

Faktet kryesore

Paditësi në procedurën kryesore, z. McB., shtetas irlandez, dhe e paditura në atë procedurë, znj. E., shtetase britanike, kishin jetuar së bashku për më shumë se dhjetë vjet në Angli, Australi, Irlandën Veriore dhe, nga nëntori 2008, në Irlandë. Ata nuk ishin të martuar, por kishin tre fëmijë së bashku, J., i lindur në Angli më 21 dhjetor 2000, E., i lindur në Irlandën e Veriut më 20 nëntor 2002 dhe J. C., i lindur në Irlandën e Veriut më 22 korrik 2007.

Ndërsa marrëdhëniet midis prindërve u përkeqësuan në fund të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009, nëna, duke pretenduar në veçanti se ishte dhunuar nga babai, ishte larguar disa herë me fëmijët e saj në një strehë për gratë. Në prill 2009, dy prindërit u pajtuan dhe vendosën të martoheshin më 10 tetor 2009. Megjithatë më 11 korrik 2009, kur babai u kthye nga një udhëtim pune në Irlandën e Veriut, ai zbuloi se nëna ishte larguar përsëri nga shtëpia me fëmijët e saj për t'u vendosur në strehën e lartpërmendur.

Më 15 korrik 2009, avokatët e babait, me kërkesën e tij, hartuan një padi për fillimin e procedurave para gjykatës kompetente irlandeze, përkatësisht Gjykatës së Rrethit, duke kërkuar të drejtat e kujdestarisë për tre fëmijët e tij. Sidoqoftë, më 25 korrik 2009, nëna iku në Angli, duke marrë tre fëmijët e lartpërmendur me vete, së bashku me një fëmijë të saj më të madh nga një marrëdhënie e mëparshme. Deri në atë datë, kërkesa në fjalë nuk i ishte njoftuar nënës, kështu që, sipas ligjit procedural irlandez, padia nuk ishte ngritur siç duhet dhe gjykata irlandeze nuk mund ta niste procedurën.

Më 2 nëntor 2009, z. McB. paraqiti një padi para Gjykatës së Lartë të Drejtësisë (Angli dhe Uells), Divizioni i Çështjeve Familjare, në Mbretërinë e Bashkuar, duke kërkuar kthimin e fëmijëve në Irlandë, në përputhje me dispozitat e Konventës së Hagës të vitit 1980 dhe Rregullores nr. 2201/2003. Më 20 nëntor 2009, ajo gjykatë i kërkoj babait, në përputhje me nenin 15 të së njëjtës Konventë, që të paraqiste një vendim ose një vërtetim nga autoritetet irlandeze që konstatonte se largimi i fëmijëve ishte i paligjshëm në kuptim të nenit 3 të Konventës në fjalë.

Më 22 dhjetor 2009, z. McB. paraqiti një padi pranë Gjykatës së Lartë në Irlandë duke kërkuar, nga njëra anë, për të marrë një vendim ose një certifikatë që deklaronte se largimi i tre fëmijëve të tij, më 25 korrik 2009, ishte i paligjshëm sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës së Hagës të vitit 1980 dhe, nga ana tjetër, t'i njihte atij të drejtën e kujdestarisë.

Më 28 prill 2010, Gjykata e Lartë hodhi poshtë kërkesën e parë, me arsyetimin se babai nuk kishte të drejta kujdestarie në lidhje me fëmijët në datën e largimit të tyre, dhe në këto kushte largimi nuk ishte i paligjshëm në kuptimin e Konventës së Hagës të vitit 1980 ose Rregullores nr. 2201/2003.

Babai apeloj kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme Irlandeze. Në kërkesën e saj për një vendim paraprak, kjo gjykatë vërejti se babai nuk kishte të drejtën e kujdestarisë në lidhje me fëmijët e tij më 25 korrik 2009, në kuptimin e dispozitave të Konventës së Hagës të vitit 1980. Megjithatë, ajo vërejti se koncepti i "së drejtës së kujdestarisë" për qëllimet e kërkesave për kthimin e fëmijëve nga një Shtet anëtar në një

tjetër, në bazë të Konventës së Hagës të vitit 1980, tani përcaktohet, në nenin 2, pika 9, të Rregullores së lartpërmendur.

Gjykata referuese vlerësoi se as dispozitat e Rregullores nr. 2201/2003 dhe as neni 7 i Kartës nuk nënkuptojnë që babai natyror i një fëmije duhet domosdoshmërisht të konsiderohet se ka kujdestarinë e fëmijës për qëllimet e sqarimit nëse largimi i fëmijës është i paligjshëm apo jo, në mungesë të një vendimi gjyqësor që i jep atij një të drejtë të tillë. Megjithatë, ai pranon se interpretimi i këtyre dispozitave të së drejtës së BE-së bie në kompetencën e Gjykatës.

Në këto rrethana, Gjykata Supreme vendosi të pezullojë procedurën dhe të bëjë pyetjen e mëposhtme për një vendim paraprak: “Rregullorja nr. 2201/2003, e interpretuar në përputhje me nenin 7 të Kartës, a e pengon ligjin e një shteti anëtar që të kërkojë nga babai i një fëmije që nuk është i martuar me nënën e këtij të fundit, të marrë nga gjykata kompetente një vendim që i njej kujdestarinë e këtyre fëmijëve në mënyrë që atij t’i njihet një «e drejtë kujdestarie», gjë që e bën largimin e fëmijëve jashtë vendit të vendbanimit të tyre të zakonshëm të paligjshëm për qëllimet e nenit 2.11 të asaj Rregulloreje?”

Gjykata referuese kërkoi që kjo referencë për një vendim paraprak t’i nënshtrohet procedurës urgjente të parashikuar në nenin 104 (b) të Rregullores së Gjykatës. Ajo e justifikoi këtë kërkesë duke argumentuar se, sipas recitalit të shtatëmbëdhjetë të Rregullores nr. 2201/2003, në rast të largimit të paligjshëm të një fëmije, kthimi i fëmijës duhet të bëhet pa vonesë. Duke pasur parasysh se çështja në fjalë kishte të bënte me tre fëmijë, përkatësisht të moshës 3, 7 dhe 9 vjeç, të cilët janë ndarë nga babai i tyre për më shumë se një vit dhe se vazhdimi i situatës aktuale mund të dëmtojë seriozisht marrëdhënien me babanë e tyre, GJDBE vendosi të pranonte kërkesën e gjykatës referuese për të paraqitur vendimin paraprak sipas procedurës urgjente.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata kujtoi se nga neni 52.3 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejshëm: “Karta”) rrjedh se, përderisa Karta përmban të drejta që korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga KEDNJ, kuptimi

dhe shtrirja e tyre janë të njëjta me ato që përmbahen në këtë Konventë. Megjithatë, kjo dispozitë nuk përjashton që e drejta e BE-së të ofrojë një mbrojtje më të gjerë. Në lidhje me nenin 7 të Kartës, sipas të cilit secili ka të drejtë për respektin e jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe komunikimet e tij, formulimi i tij është identik me atë të nenit 8.1 të Konventës, përveç kur në vend të termit «korrespondencës» Karta përdor termin «komunikimeve». Sidoqoftë, neni 7 përmban të drejta që përputhen me ato të garantuara nga neni 8.1 i Konventës. Prandaj është e përshtatshme që nenit 7 të Kartës t'i jepet i njëjti kuptim dhe i njëjti fushëveprim me ato që i jepen nenit 8.1 të Konventës, siç interpretohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më pas Gjykata saktësoi se Rregullorja nr. 2201/2003 mbi juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet martesore dhe në çështjet e përgjegjësisë prindërore që shfuqizon Rregulloren nr. 1347/2000 duhet interpretuar se nuk ndalon që e drejta e një shteti anëtar të parashikojë që fitimi i së drejtës së kujdestarisë nga babai i një fëmije, i cili nuk është i martuar me nënën e këtij të fundit, t'i nënshtrohet marrjes nga ky i fundit të një vendimi të gjykatës kompetente kombëtare që i njuh atij një të drejtë të tillë, njohje e cila e bën të paligjshëm, sipas kuptimit të nenit 2, pika 11, të asaj Rregulloreje, që nëna ta largojë fëmijën ose të mos e kthejë.

Sipas Gjykatës, Rregullorja nr. 2201/2003 nuk përcakton se cili është personi i cili duhet të ketë të drejtën e kujdestarisë, të tillë që ta bëjë largimin e paligjshëm të një fëmije, në kuptim të nenit 2.11 të saj por i referohet të drejtës së shtetit anëtar në të cilën fëmija kishte vendbanimin e tij të zakonshëm menjëherë para largimit ose moskthimit të tij në lidhje me përcaktimin e titullarit të kësaj të drejte kujdestarie. Kështu, është ligji i atij shteti anëtar që përcakton kushtet në të cilat babai natyror fiton të drejtën e kujdestarisë së fëmijës së tij, sipas kuptimit të nenit 2.9 të Rregullores, aty ku është e përshtatshme duke e kushtëzuar këtë të drejtë me marrjen e një vendimi nga gjykata kompetente kombëtare që ia njuh këtë të drejtë. Rrjedhimisht, Rregullorja nr. 2201/2003 duhet të interpretohet se ka kuptimin që natyra e paligjshme e largimit të një fëmije për qëllimet e zbatimit të kësaj Rregulloreje varet ekskluzivisht nga ekzistenca e një të drejte kujdestarie, të dhënë nga ligji kombëtar në fuqi, në shkëlqje të së cilës u krye ky largim.

Nenet 7 dhe 24 të Kartës nuk e përjashtojnë një interpretim të tillë.

Në të vërtetë, nëse, për qëllimet e zbatimit të Rregullores nr. 2201/2003, për të përcaktuar natyrën e ligjshme të largimit të një fëmije, i cili çohet në një Shtet tjetër Anëtar nga nëna e tij, babai natyror i atij fëmije duhet të ketë të drejtën të kërkojë në gjykatën kompetente kombëtare, para zhvendosjes, në mënyrë që të kërkojë që atij t'i jepet një e drejtë e kujdestarisë së fëmijës së tij, e cila përbën thelbin e së drejtës së një babai natyror për një jetë private dhe familjare në një rast të tillë. Nga ana tjetër, fakti që babai natyror nuk është automatikisht, ndryshe nga nëna, titullar i një të drejte kujdestarie për fëmijën e tij sipas kuptimit të nenit 2 të asaj Rregulloreje, nuk ndikon në përmbajtjen thelbësore të së drejtës së tij për jetë private dhe familjare, të përcaktuar në nenin 7 të Kartës, me kusht që të ruhet e drejta e tij për të kërkuar të drejtën e kujdestarisë nga gjykata kompetente.

Ky konstatim nuk cenohet nga fakti se, në mungesë të marrjes së hapave nga një baba në kohën e duhur për të fituar të drejtën e kujdestarisë, ai të mos jetë në gjendje, në rast të largimit të fëmijës në një shtet anëtar tjetër nga shteti i nënës së tij, të fitojë kthimin e këtij fëmije në shtetin anëtar ku ishte vendbanimi i tij i mëparshëm i zakonshëm. Në të vërtetë, një largim i tillë përfaqëson ushtrimin e ligjshëm, nga nëna që ka kujdestarinë e fëmijës, të së drejtës së saj të lëvizjes së lirë, të parashikuar në nenet 20.2 (a) të TFBE-së dhe 21.1 të TFBE-së, dhe të drejtën e saj për të zgjedhur vendbanimin e fëmijës, por pa e privuar babanë natyror, nga mundësia për të ushtruar të drejtën e tij për të paraqitur një kërkesë që synon marrjen e mëvonshme të së drejtës së kujdestarisë së këtij fëmije ose të drejtën e vizitës në lidhje me këtë të fundit. Kështu, njohja, në favor të babait natyror, e së drejtës për kujdestarinë e fëmijës së tij, sipas nenit 2.11 të Rregullores 2201/2003, pavarësisht mungesës së dhënies së një të drejte të tillë sipas së drejtës kombëtare bie ndesh me kërkesat e sigurisë juridike dhe me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve, në kuptim të nenit 52.1 të Kartës, në këtë rast të nënës. Një zgjidhje e tillë do të rrezikonte gjithashtu shkeljen e nenit 51.2 të Kartës.

Për më tepër, duke pasur parasysh diversitetin e madh të marrëdhënieve pa lidhur martesë dhe marrëdhënien që rezultojnë midis prindërve dhe

fëmijëve të tyre, e cila çon në njohje të ndryshme të shtrirjes dhe ndarjes së përgjegjësive prindërore brenda shteteve anëtare, neni 24 i Kartës, i cili duhet të lexohet bashkë me nenin 7 të saj, nuk përjashton, për qëllimet e zbatimit të Rregullores nr. 2201 /2003, që e drejta e kujdestarisë t'i jepet, në parim, ekskluzivisht nënës dhe se një baba natyror të mund ta fitojë vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor. Një kërkesë e tillë i lejon gjykatës kompetente kombëtare të marrë një vendim mbi kujdestarinë e fëmijës, si dhe mbi të drejtat e vizitës, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, dhe veçanërisht ato që lidhen me lindjen e fëmijës, natyrën e marrëdhënies midis prindërve, atë midis secilit prind dhe fëmijës, si dhe aftësinë e secilit prej prindërve për të marrë përsipër përgjegjësinë e kujdestarisë. Marrja parasysh e këtyre rrethanave krijon mundësinë që të mbrohen interesat më të mira të fëmijës, në përputhje me nenin 24.2 të Kartës.

Neni 51

Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

- 1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.*
- 2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI124/10 PARASHTRUESE: SHKURTE KRASNIQI

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_124_10_shq.pdf]

13 qershor 2011

***Çështja kyçele drejta e pretenduar:** Rasti kishte të bënte me refuzimin nga ana e Administratës Pensionale të Kosovës dhe gjykatave, të kërkesës së parashtrueses për vazhdimin e pensionit invalidor. Parashtruesja pretendoi se përmes këtyre vendimeve, asaj i ishin cenuar të drejtat kushtetuese të mbrojtura me nenin 51.2 [Kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale].*

Faktet kryesore

Në vitin 1982, parashtruesja e kërkesës kishte qenë e punësuar si motër medicinale me orar të plotë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: QKUK). Në ndërkohë, parashtruesja ishte sëmurë nga TBC-ja në veshkë dhe i ishte nënshtruar disa intervenimeve kirurgjike. Më 22 mars 1990, Sigurimi Pensional dhe Invalidor i Kosovës ia kishte njohur parashtrueses të drejtën për punësim me orar të kufizuar, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Më 5 korrik 2007, Departamenti i Burimeve Njerëzore të QKUK-së, më kërkesë të parashtrueses së kërkesës, kishte dhënë pëlqimin për të ndërprerë marrëdhënien e saj të punës, duke filluar nga 1 marsi 2007, pasi që ajo kishte pësuar sulm në zemër në orar të punës. Më 20 shtator 2007, Departamenti i Administratës së Pensioneve të Kosovës pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kishte miratuar kërkesën e parashtrueses për pension të aftësisë së kufizuar duke filluar nga 5 janari 2007. Më 6 maj 2008, parashtruesja e kërkesës i ishte nënshtruar operacionit në zemër. Më 19 prill 2010, Komisioni për Shqyrtim Mjekësor kishte vlerësuar se parashtruesja nuk kishte aftësi të kufizuar të përhershme dhe, rrjedhimisht, më 26 prill

2010, Departamenti i Administratës së Pensioneve kishte konstatuar se parashtruesja nuk i kishte plotësuar kriteret sipas Ligjit për Pensionet e Personave më Aftësi të Kufizuar dhe kërkesa e parashtrueses për pension të personave me aftësi të kufizuar ishte refuzuar. Më 21 maj 2010, ndaj vendimit të Departamentit të Administratës të Pensioneve të Kosovës, parashtruesja kishte paraqitur ankesë në Komisionin për Ankesa pranë Departamentit të Administratës së Pensioneve të Kosovës. Më 23 qershor 2010, Komisioni për Ankesa i Departamentit të Administratës së Pensioneve të Kosovës kishte refuzuar ankesën e parashtrueses, si të pabazuar. Më 19 gusht 2010, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme dhe, më 27 tetor 2010, Gjykata Supreme e kishte refuzuar ankesën e parashtrueses si të pabazuar, me arsyetimin se dokumentet e parashtruara nga ana e saj nuk çonin në ndonjë përfundim tjetër nga ai që kishin arritur organet e shkallës më të ulët. Më 25 nëntor 2010, pas nxjerrjes së aktgjykimit të fundit të Gjykatës Supreme, QKUK-ja kishte lëshuar një raport mjekësor ku thuhej se bazuar në kriteret objektive dhe në ekzaminimin klinik parashtruesja e kërkesës ishte e paaftë për punë.

Më 10 dhjetor 2010, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesja pretendoi se i ishte shkelur e drejta e garantuar me nenin 51 të Kushtetutës [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale], sepse, sipas saj, në bazë të shumë raporteve mjekësore ajo i përmbushte kushtet për marrjen e pensionit të aftësisë së kufizuar, sipas Ligjit për Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar. Për më tepër, ajo pretendoi se i ishte shkelur e drejta për asistencë mjekësore dhe sociale, e paraparë me nenin 13 [E drejta për asistencë mjekësore dhe sociale] të Kartës Evropiane Sociale, në lidhje me nenin 22 [Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese së pari shqyrtoi nëse kërkesa i përmbushte kriteret e pranueshmërisë për vlerësim të meritave të saj, siç përcaktohen në

Kushtetutë, si dhe në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese fillimisht sqaroi se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale dhe, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se parashtruesja e kërkesës jo vetëm që nuk e kishte argumentuar rastin në lidhje me shkeljen, por ajo as nuk kishte paraqitur prova relevante që do të tregonin se aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte qenë i padrejtë apo i njollosur nga arbitrariteti kur e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar. Më tutje, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se, nga dokumentet e parashtruara nga parashtruesja e kërkesës shihej se më 25 nëntor 2010, QKUK-ja kishte lëshuar një raport të ri mjekësor ku thuhej se në bazë të ekzaminimeve të fundit klinike parashtruesja ishte e paaftë për punë. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kjo provë e re mjekësore duhej të konsiderohej si fakt i ri që do të ngrinte rast të ri. Gjykata sqaroi se, siç ishte theksuar edhe në aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Komisioni Mjekësor ishte ligjërish i autorizuar për të konstatuar aftësinë ose paaftësinë e ndonjë paditësi. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese theksoi se parashtruesja nuk kishte parashtruar kërkesë pranë Komisionit Mjekësor për të shqyrtuar atë raport të ri mjekësor të 25 nëntorit 2010 dhe se ajo nuk e kishte argumentuar se si dhe përse një kërkesë e tillë e re nuk do të ishte efektive. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se kërkesa ishte e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, njëzëri, vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. FEDULOV kundër RUSISË

[53068/08]

GJEDNJ [Dhoma]

8 janar 2020

Çështja kyçele drejta e pretenduar: refuzimet e autoriteteve publike për të përmbushur detyrimin e tyre ligjor për t'i dhënë atij barnat falas të nevojshme për trajtimin e kancerit dhe për t'i dhënë dëmshpërblim në lidhje me këtë shkelje; pretendime se gjykimi i çështjes nuk ishte i drejtë për shkak të mungesës së ndihmës juridike.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Igor Pavlovich Fedulov (kërkuesi), një shtetas rus, kundër Federatës Ruse, paraqitur në Gjykatë më 17 tetor 2008. Kërkuesi vuan nga kanceri i avancuar metastatik i prostatës. Duket se ai u diagnostikua për herë të parë me kancer në fillim të vitit 2007. Në lidhje me këtë, më 26 shkurt 2007 kërkuesit iu dha statusi i personit me aftësi të kufizuara, me rezultat që, në bazë të Ligjit Federal nr. 178 - FZ të 17 korrikut 1999 për ndihmën sociale shtetërore ("Akti i Ndihmës Sociale Shtetërore" - shih paragrafin 34 të vendimit të plotë), ai pati të drejtën për sigurimin e disa ilaçeve pa pagesë, në bazë të recetave mjekësore të lëshuara nga mjekët kompetentë. Lista e barnave përkatëse është miratuar me Dekretin nr. 665 të Ministrisë Ruse të Shëndetësisë dhe të Zhvillimit Social të 18 shtatorit 2006 (shih paragrafin 38 të vendimit të plotë). Në shkurt 2007, kërkuesi u regjistrua në regjistrin federal të personave që kishin të drejtë për asistencë sociale shtetërore, duke përfshirë sigurimin e barnave falas. Kërkuesi ishte caktuar në farmacinë nr. 162 të Shën Petersburgut, ku ai kishte të drejtë të merrte barnat falas për trajtimin e sëmundjes së tij.

Megjithatë, farmacia e ngarkuar për t'i dhënë barërat pa pagesë, e furnizoi vetëm një herë në ato kushte. Në të gjitha rastet e tjera, i tha atij se nuk ishte në gjendje t'i jepte bicalutamide falas, por se ai mund t'i blinte me shpenzimet e veta. Gjatë muajve në vijim ai pagoi 1,400 euro për trajtimin. Ai u ankua pranë autoriteteve dhe gjykatave për mungesën e ilaçeve falas dhe kërkoi të merrte rimbursim, por në shkurt 2008 Gjykata e Rrethit e refuzoi kërkesën e tij në tërësi. Gjykata e Rrethit gjeti që autoritetet e përfshira, Fondi i Sigurimeve Mjekësore i Shën Petersburgut dhe Komisioni i Shëndetësisë i Shën Petersburgut kishin bërë gjithçka që u kërkohej me ligj. Në veçanti, Fondi i Sigurimeve Mjekësore në Shën Petersburg kishte përmbushur detyrimin e tij për të kërkuar fonde nga Fondi Federal i Sigurimeve Mjekësore për të paguar barnat falas, por fondi Federal e kishte refuzuar kërkesën më 2007, pasi buxheti federal i caktuar për këtë qëllim ishte tejkaluar tashmë.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi pretendoi, në veçanti, se refuzimi i shtetit për të përmbushur detyrimin e tij ligjor për t'i siguruar atij barna falas, të nevojshme për trajtimin e kancerit, dhe refuzimi për t'i dhënë atij kompensim në lidhje me atë refuzim, kishte shkelur nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Ai gjithashtu pretendoi se procedurat civile që ai kishte iniciuar në lidhje me këtë, ishin përfshirë në mangësi të ndryshme, duke përfshirë mungesën e ndihmës juridike, e cila i kishte bërë ato të padrejta, në kundërshtim me nenin 6.1 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht theksoi se nuk ishte kontestuese se, në katër nga pesë raste, kërkuesi nuk ishte në gjendje të merrte barnat e nevojshme për trajtimin e sëmundjes së tij, për shkak të mungesës së atij bari në dispozicion për shpërndarje falas. Duke pasur parasysh se kërkuesi kishte një "pritje legjitime" që ai do të merrte përfitimin e mirëqenies në fjalë, Gjykata arrin në përfundimin se kishte një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1. Mbetet për t'u konstatuar nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar.

Kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin paqësor të zotërimeve duhet të jetë e ligjshme (shih, për shembull, *Grudić kundër Serbisë*, nr. 31925/08, paragrafi 73, 17 prill 2012). Kur flet për “ligjin”, neni 1 i Protokollit nr. 1 aludon për të njëjtin koncept, si ai të cilit i referohet Konventa diku tjetër kur përdor atë term dhe kërkon që masa e ankimuar të bazohet në legjislacionin vendas që është mjaftueshëm i qasshëm dhe mjaftueshëm i saktë (shih gjithashtu, mes shumë autoriteteve të tjera, *Lekić kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 36480/07, paragrafët 94-95, 11 dhjetor 2018). Për më tepër, shteti i së drejtës, një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, është natyrshëm i integruar në të gjitha nenet e Konventës (shih *Iatridis kundër Greqisë* [DHM], nr. 31107/96, paragrafi 58, ECHR 1999 - II). Kështu, çështja nëse është arritur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, bëhet e rëndësishme vetëm pasi të konstatohet se ndërhyrja në fjalë përmbush kërkesën e ligjshmërisë dhe nuk është arbitrare (po aty).

Në rastin konkret, Gjykata vërejtë se, ndërkohë që e drejta e kërkuarit për përfitimin në fjalë nuk u vu kurrë në dyshim, gjykatat vendore, në thelb, e justifikuan mohimin e përfitimit, duke iu referuar mungesës së fondeve buxhetore të destinuara për qëllimin e autoriteteve të Shën Petersburgut për t’u siguruar barna falas banorëve që kishin nevojë. Në të njëjtën kohë, ata nuk u mbështetën në asnjë dispozitë ligjore që do të kushtëzonte dhënien e përfitimit në fjalë me ndonjë kufizim në fondet buxhetore, që parashikonte çdo liri të autoriteteve ekzekutive për të reduktuar ose refuzuar atë, pasi të jetë arritur kufiri i fondeve buxhetore të alokuara, ose ndonjë dispozitë e ngjashme, e cila mund të kishte formuar një bazë ligjore për një konstatim të tillë. Vlen të përmendet në lidhje me këtë se, në vendimet e mëvonshme gjyqësore të marra në kuadër të proceseve që shqyrtojnë pretendime të ngjashme, u shpreh qartë se korniza ligjore ekzistuese vendosi të drejtën e atyre që kanë të drejtë të pajisen me barnat e nevojshme jo vetëm pa pagesë, por gjithashtu edhe pa asnjë kufizim, dhe se caktimi i një sasive maksimale të një ilaçi të caktuar për person, ose ndarja e fondeve të pamjaftueshme buxhetore për një rajon të caktuar, nuk mund të jetë bazë për refuzimin për t’u siguruar individëve të interesuar ilaçe që ishin thelbësore për jetën e tyre.

Gjykata e konsideroi të rëndësishme të theksojë se një shtet ka hapësirë të gjerë vlerësimi në zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike, duke përfshirë, në veçanti, miratimin e ligjeve në kontekstin e një ndryshimi të regjimit politik ose ekonomik, miratimin e politikave për të mbrojtur publikun, ose risigurimin e fondeve, dhe futjen e masave shtrënguese të shkaktuara nga një krizë e madhe ekonomike (shih *Béláné Nagy*, paragrafët 113-14, dhe autoritetet e cituara aty). Gjykata ripohoi se fakti që një person ka hyrë dhe është pjesë e një sistemi shtetëror të sigurimeve shoqërore, nuk do të thotë domosdoshmërisht se ai sistem nuk mund të ndryshohet, qoftë për sa i përket kushteve të pranueshmërisë për pagesë, qoftë për sa i përket sasisë së përfitimit. Gjykata ka pranuar mundësinë e ndryshimeve në legjislacionin e sigurimeve shoqërore, të cilat mund të miratohen si përgjigje ndaj ndryshimeve shoqërore dhe pikëpamjeve në zhvillim mbi kategoritë e personave që kanë nevojë për ndihmë sociale, si dhe për evoluimin e situatave individuale. Në kushtet e sotme, këto konsiderata luajnë një rol parësor në vlerësimin e ankesave që ngrihen për cenimin e të drejtave të mirëqenies sociale dhe, padyshim që ato i ofrojnë shtetit një hapësirë të gjerë vlerësimi në racionalizimin e sistemeve të tyre të sigurimeve shoqërore (shih, së fundi, *Baczúr kundër Hungarisë*, nr. 8263/15, paragrafi 28, 7 mars 2017).

Situata në rastin konkret, megjithatë, nuk u shkaktua nga ndonjë ndryshim në legjislacion. Siç u përmend më lart, përshtatshmëria e kërkuarit për përfitimin në fjalë, nuk u vu kurrë në dyshim nga asnjë prej autoriteteve, as nuk u pretendua ndonjëherë se ai nuk plotësonte asnjë nga kushtet e përcaktuara, se statusi i tij përkatës kishte ndryshuar, ose se çfarëdo kushti ligjor kishte ndryshuar në mënyrë që ai të mos ketë përmbushur asnjë nga ato kushte. Është gjithashtu e rëndësishme që përfitimi i mirëqenies në fjalë kishte të bënte me të drejtën e kërkuarit për të marrë ilaçin e nevojshëm për trajtimin e kancerit, i cili supozonte se pasja e pandërprerë e atij përfitimi ishte kritike për jetën e tij. Gjykata vlerësoi se, në rrethana të tilla, një refuzim për t'i ofruar një përfitim të tillë një kërkuar që plotësonte të gjitha kushtet, ishte e pamundur të parashikohej dhe, në fund të fundit, vështirë se mund të jetë në pajtueshmëri me shtetin e së drejtës. Gjykata përsëriti se Konventa synon të garantojë të drejta që janë “praktike dhe efektive” dhe jo teorike dhe iluzore (shih *Béláné Nagy*, cituar më lart, paragrafi 99). As kompleksiteti i sistemit buxhetor të shtetit, as mungesa e fondeve apo burimeve të

tjera, nuk mund ta lirojnë shtetin nga detyrimet e tij përkatëse sipas Konventës. U takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të mund të përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me këtë (shih, *mutatis mutandis*, *Burdov kundër Ruisë* (nr. 2), nr. 33509/04, paragrafi 70, GJEDNJ 2009).

Përfundimisht, Gjykata arriti në përfundimin se mohimi përfundimtar i dhënies së përfitimit në fjalë parashtruesit nga autoritetet vendore, duke iu referuar mungesës së fondeve, nuk kishte bazë në ligjin e brendshëm dhe ishte arbitrare. Ky përfundim e bëri të panevojshme që Gjykata të konstatojë nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit, nga njëra anë, dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, nga ana tjetër (shih, ndër autoritetet e tjera, *Grudić*, cituar më lart, paragrafi 81). Prandaj, ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Në lidhje me pretendimet e kërkuarit se kishte mangësi të ndryshme procedurale, duke përfshirë mungesën e ndihmës juridike, dhe refuzimin e gjykatave për të miratuar kërkesat e tij ose mosadresimin e disa prej argumenteve të tij, në procesin civil për rimbursimin e shpenzimeve të tij për barnat në fjalë dhe se ato procedura ishin të padrejta, Gjykata ritheksoi se Konventa, si e tillë, nuk garanton të drejtën për ndihmë juridike në proceset civile (shih *Staroszczyk kundër Polonisë*, nr. 59519/00, paragrafi 127, 22 mars 2007). Çështja nëse ofrimi i ndihmës juridike është i nevojshëm për një shqyrtim të drejtë, duhet të përcaktohet në bazë të fakteve dhe rrethanave të veçanta të secilit rast dhe do të varet, ndër të tjera, nga rëndësia e asaj që është në rrezik për kërkuarin në procedurë, nga kompleksiteti i ligjit dhe i procedurës përkatëse dhe nga aftësia e kërkuarit për ta përfaqësuar veten në mënyrë efektive (shih *Steel and Morris*, paragrafi 61). Në çështjen në fjalë, palët nuk ranë dakord nëse kërkuari kishte kërkuar nga gjykata që t'i caktonte një avokat për ndihmë juridike. Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të trajtojë këtë pikë, pasi ishte e qartë se sipas ligjit të brendshëm në fuqi në kohën përkatëse, kërkuari nuk kishte të drejtë për ndihmë juridike në proceset civile. Më tej, ajo konsideroi se, megjithëse ajo që ishte në rrezik për kërkuarin ishte e një rëndësie të konsiderueshme për të, çështja e tij nuk duket të ketë qenë veçanërisht e ndërlikuar as nga pikëpamja faktike, as nga pikëpamja juridike. Në të vërtetë, as faktet dhe as ligji nuk u kontestuan nga palët. Materialet në posedim të Gjykatës zbuluan

se parashtrerasat me shkrim të kërkuesit ishin të zhvilluara dhe të arsyetuara mirë; se ai ishte në gjendje të paraqiste kërkesa me shkrim, të cilat u shqyrtuan nga gjykatat dhe u miratuan, për aq sa gjykatat e konsideronin të përshtatshme për ta bërë këtë; dhe se ai ka marrë pjesë aktive në deklaratat verbale dhe ka paraqitur argumentet e tij. Në përgjithësi, ishte e qartë se kërkuesi ishte plotësisht në gjendje të paraqiste çështjen e tij dhe të përfaqësonte veten në mënyrë efektive, dhe argumentet e tij jo vetëm që u adresuan, por gjithashtu morën përgjigje të arsyetuara. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që do të vërtetonte se kërkuesi nuk ishte në gjendje të përfaqësonte veten në mënyrë efektive ose se ai ishte privuar nga një shqyrtim i drejtë sipas kuptimit të nenit 6.1 të Konventës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës ishte haptazi e pabazuar dhe duhej të refuzohej, në përputhje me nenin 35.4 të Konventës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata vendosi se në rastin konkret Qeveria kishte shkelur kërkesat e nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe vendosi që kërkuesit t'i paguhet shuma prej 6,500 (gjashtë mijë e pesëqind) eurosh si kompensim për dëmin jomaterial.

2.1. DAUTI kundër SHQIPËRISË

[19206/05]

GJEDNJ [Seksioni i Katërt]

3 shkurt 2009

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: mungesa e kontrollit gjyqësor të vendimeve administrative sipas nenit 6.1; mospasja e mundësisë për të kundërshtuar përpara gjykatave të brendshme vendimet e dhëna nga organet administrative në lidhje me pensionin e invaliditetit.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Ramiz Dauti (kërkuesi) kundër Republikës së Shqipërisë më 12 maj 2005. Më 14 prill 1992, kërkuesi pësoi një aksident serioz në

punë dhe, për pasojë, nuk ishte më në gjendje të vazhdonte punën. Në mars 2001, ai iu drejtua Komisionit lokal të Ekzaminimit Mjekësor për Aftësitë në Punë duke kërkuar që të përcaktohej statusi i tij si invalid dhe të përfitonte pension. I pakënaqur me vendimin, i cili i jepte pension për një periudhë të kufizuar kohe, kërkuasi paraqiti apelim në Komisionin e Apelit. Më 30 janar 2003, Komisioni i Apelit e anuloi në tërësi vendimin e Komisionit të Rrethit, duke e shpallur kërkuasin të aftë për punë dhe të papërshtatshëm për të përfituar pensionin e invaliditetit.

Parashtruesi nisi një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Tiranë, për të kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Apelit. Gjykata e Rrethit e hodhi poshtë kërkesën e tij me arsyetimin se vendimet e Komisionit të Apelit ishin të formës së prerë dhe me karakter detyrues, duke mos u bërë kështu objekt i shqyrtimit nga gjykatat. Kërkuasi e apeloj këtë vendim në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Kushtetuese lidhur me pamundësinë e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Apelit, por apelimi ishte i pasuksesshëm.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 6.1 dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkuasi pretendoi se ai nuk kishte qenë në gjendje të kundërshtojë para gjykatave të brendshme vendimet e dhëna nga organet administrative në lidhje me pensionin e invaliditetit. Kërkuasi parashtroi se vendimet administrative i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor në përputhje me nenin 86 të Ligjit të Sigurimeve Shoqërore dhe me nenin 324 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas tij, gjykatat vendase ishin gjithashtu të detyruara ligjërisht të pranonin ankesat e tij në bazë të vendimeve të mëparshme të gjykatave vendase.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata theksoi fillimisht se neni 6.1 i Konventës është i zbatueshëm, dhe se kërkuasi kishte të drejtë që çështja e tij të shqyrtohej nga “një gjykatë” që plotëson kushtet e përcaktuara në atë nen. Ndërsa neni 6.1 mishëron “të drejtën për një gjykatë”, ai megjithatë nuk i detyron shtetet kontraktuese të paraqesin “kontestime” (mosmarrëveshje) mbi “të drejtat dhe detyrimet civile” në një procedurë të zhvilluar në secilën nga

fazat e saj përpara “gjykatave” duke përmbushur kërkesat e ndryshme të nenit 6. Kërkesat për fleksibilitet dhe efikasitet, të cilat janë plotësisht në përputhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të justifikojnë ndërhyrjen paraprake të organeve administrative ose profesionale dhe, *a fortiori*, të organeve gjyqësore që nuk i plotësojnë kërkesat e përmendura në çdo aspekt. “E drejta për një gjykatë” mbulon çështjet e faktit, po aq sa çështjet e ligjit (shih *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, 23 qershor 1981, paragrafi 51, Seria A nr. 43).

Gjykata vuri në dukje se sipas nenit 6.1 të Konventës ishte e nevojshme që vendimet e autoriteteve administrative, të cilat vetë nuk plotësojnë kërkesat e atij neni, duhet t’i nënshtrohen kontrollit të mëvonshëm nga një “organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë” shih, për shembull, *Ortenberg kundër Austrisë*, 25 nëntor 1994, paragrafi 31, Seria A nr. 295-B, dhe *Crişan kundër Rumanisë*, nr. 42930/98, paragrafi 24, 27 maj 2003).

Gjykata vërejti se të paktën në një rast, gjykatat vendase, vendimet përfundimtare të të cilave nuk u kundërshtuan nga Qeveria, rishikuan vendimin e Komisionit të Apelit. Në rastin konkret, në bazë të praktikës së brendshme, kërkuesi paraqiti ankime në gjykatat vendase, të cilat hodhën poshtë pretendimet e tij me arsyetimin se vendimi i Komisionit të Apelit ishte përfundimtar dhe nuk i nënshtrohej kontrollit gjyqësor. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk adresoi ankesën e kërkuesit për mungesën e kontrollit gjyqësor të vendimit të Komisionit të Apelit. Gjykata theksoi se gjykatat vendase në rastin konkret duhej të kishin shqyrtuar “çështjet e faktit po aq sa çështjet e ligjit”.

Prandaj ishte e nevojshme të përcaktohet nëse Komisioni i Apelit përbën një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” sipas kuptimit të nenit 6.1 të Konventës. Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet si «e pavarur», duhet pasur parasysh, ndër të tjera, mënyrën e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandatin e tyre, ekzistencën e garancive kundër presioneve të jashtme dhe pyetjen nëse organi paraqet një pamje të pavarësisë (shih, ndër të tjera, *Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 38784/97, paragrafi 58, GJEDNJ 2002-I).

Gjykata vërejti se Komisioni i Apelit përbëhej tërësisht nga mjekë, të emëruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në tekstin e mëtejshëm:

“ISS”) dhe të miratuar përfundimisht nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e së cilës punojnë mjekët. Asnjë anëtar ligjërishit i kualifikuar ose gjyqsor nuk ishte i pranishëm në Komisionin e Apelit (shih, në të kundërt, *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere*, paragrafi 58). Ligji dhe rregulloret e brendshme nuk përmbanin asnjë rregull që rregullon mandatin e anëtarëve, largimin, dorëheqjen e tyre ose ndonjë garanci për mosshkarkimin e tyre. Rregullat ligjore nuk parashikonin mundësinë e betimit nga anëtarët e saj. Duket se ata mund të hiqeshin nga detyra në çdo kohë, sipas dëshirës së ISS dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat ushtrojnë diskrecion të papenguar. Prandaj, qëndrimi i anëtarëve të Komisionit të Apelit ishte i hapur ndaj presioneve të jashtme. Një situatë e tillë minon pamjen e saj të pavarësisë. Në dritën e sa më sipër, Gjykata vlerësoi se Komisioni i Apelit nuk mund të konsiderohej si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” siç kërkohet nga neni 6.1 i Konventës. Duke pasur parasysh faktin se Komisioni i Apelit nuk përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” dhe se vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në kohën në fjalë, nuk mund të kundërshtoheshin para një gjykate vendase, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të së drejtës së kërkuesit për qasje në gjykatë sipas nenit 6.1 të Konventës. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se ai nuk kishte asnjë mjet efektiv me të cilin mund të kundërshtonte vendimin e Komisionit të Apelit para gjykatave vendase, Gjykata ritheksoi se, për aq sa e drejta nga neni 13 i Konventës, e pohuar nga kërkuesi, është një «e drejtë civile», neni 6.1 konsiderohet se përbën një *lex specialis* në lidhje me nenin 13. Masat mbrojtëse të tij janë më të rrepta dhe absorbojnë ato të nenit 13 (shih *Menesheva kundër Rusisë*, nr. 59261/00, paragrafi 105, GJEDNJ 2006). Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa e kërkuesit sipas kërkesave më pak të rrepta të nenit 13.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës; vendosi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa sipas nenit 13 të Konventës; vendosi që shteti i paditur duhet t'i paguajë parashtruesit 6,000 (gjashtë mijë) euro për dëmin jomaterial.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. GEORG NEIDEL kundër STADT FRANKFURT AM MAIN²¹⁴

GJDBE

Çështja C-337/10

3 maj 2012

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=122390&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13717009>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky vendim kishte të bënte me të drejtën e një zyrtari publik në gjermani për t'u paguar për ditët e pushimit që nuk kishte arritur t'i shfrytëzonte për shkak se kishte ndërprerë marrëdhënien për arsye shëndetësore

Faktet kryesore

Z. Georg Neidel, i lindur më 2 gusht 1949, filloi të punojë në shërbimet e Stadt Frankfurt am Main në 1970. Atje ai shërbeu si zjarrfikës, më pas si shef në një stacion zjarrfikësish. Ai gëzonte statusin e nëpunësit civil.

Nga 12 qershori 2007, z. Neidel nuk ishte në gjendje të punonte për arsye mjekësore. Në fund të gushtit 2009, pasi kishte mbushur 60 vjeç, ai doli në pension dhe, që atëherë, merrte një pension mujor në vlerë prej 2,463.24 euro. Duke pasur parasysh faktin se orët normale javore të punës të zjarrfikësve të punësuar në Stadt Frankfurt am Main nuk korrespondonin me orët javore 5 ditëshe të punës, z. Neidel kishte të drejtën e 26 ditëve të pushimit për secilin nga vitet 2007 deri në 2009. Përveç kësaj, ai kishte të drejtë për pushim kompensues, të llogaritur në orë, kur ai kishte punuar në ditë pushimi zyrtar. Duke pasur parasysh ato

214 Bashkia e Frankfurt mbi Main.

rregulla, dy palët në procedurat para gjykatave gjermane konsideruan se z. Neidel kishte të drejtë, në total, për 31 ditë pushim për vitin 2007, 35 ditë për vitin 2008 dhe 34 ditë për vitin 2009. Nga ato pushime, ai nuk kishte marrë vetëm 14 ditë për vitin 2007. Prandaj, ai kishte të drejtën për pagesën e pushimeve për 86 ditë që nuk i kishte shfrytëzuar, që korrespondonte me një shumë prej 16,821.60 eurosh bruto.

Z. Neidel kërkoi që atij t'i paguhej ky kompensim financiar për pushimin që nuk e kishte shfrytëzuar, por kjo iu refuzua me një vendim të Stadt Frankfurt am Main me arsyetimin se ligji gjerman i shërbimit civil nuk parashikonte pagesën për ditët e pushimit që nuk është shfrytëzuar. Sipas Stadt Frankfurt am Main, neni 7.2 i Direktivës 2003/88 nuk është i zbatueshëm për nëpunësit civilë. Ajo më tej argumentoi se dalja në pension nuk përfshihet në konceptin e “përfundimit të marrëdhënies së punës” sipas asaj dispozite.

Z. Neidel e kundërshtoi këtë vendim në Verwaltungsgericht Frankfurt am Main²¹⁵, e cila duke pasur dyshime për vlefshmërinë e interpretimit të nenit 7 të Direktivës 2003/88 nga Stadt Frankfurt am Main, vendosi të pezullojë procedurat dhe parashitroi pyetjet e mëposhtme në Gjykatë për një vendim paraprak:

“1) A zbatohet neni 7 i Direktivës 2003/88 edhe për zyrtarët e shërbimit civil?

2) A mbulon neni 7.1 i Direktivës 2003/88 edhe të drejtën për pushim vjetor ose javor nëse ligji kombëtar parashikon një të drejtë të tillë për më shumë se 4 javë.

3) A mbulon neni 7.1 i Direktivës 2003/88 edhe të drejtat e pushimit të dhëna sipas ligjit kombëtar, përveç pushimeve vjetore ose javore për të kompensuar pushimet publike gjatë të cilave është punuar për shkak të shpërndarjes së parregullt të kohës së punës.

4) A mundet një zyrtar në pension të përfitojë drejtpërdrejt nga neni 7.2 i Direktivës 2003/88 një të drejtë për kompensim për pushime vjetore

215 Gjykata Administrative e Frankfurt mbi Main.

ose javore, nëse ai nuk i ka ushtruar funksionet për shkak të sëmundjes dhe që, si rezultat, ishte i paaftë për të marrë pushimin e tij në formën e një të drejte për të munguar në punë?

5) A mundet që përfundimi i parakohshëm i së drejtës për pushim, siç parashikohet nga ligji kombëtar, të jetë kundër një të drejte të tillë për kompensim për pushimet që nuk merren?

6) A lidhet e drejta për kompensim e parashikuar në nenin 7.2 të Direktivës 2003/88 vetëm në të drejtën për një pushim vjetor minimal prej katër javësh të garantuar në nenin 7.1 të së njëjtës direktivë apo e shtrin atë edhe në të drejtat për ditë shtesë të pushimit të parashikuara nga ligji kombëtar? A përfshijnë këto të drejta të zgjeruara edhe të drejtat e pushimit, të cilat rezultojnë vetëm nga një shpërndarje specifike e kohës së punës?"

Vendimi i Gjykatës

Sipas Gjykatës, neni 7 i Direktivës 2003/88, në lidhje me aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës, duhet të interpretohet se ai zbatohet për një zyrtar të shërbimit civil që kryen aktivitete të zjarrfikësve në kushte normale.

Gjykata sqaroi se neni 7.2 i Direktivës 2003/88, në lidhje me aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës, duhet të interpretohet se nënkupton që një zyrtar ka të drejtë, në pension, të ketë kompensim financiar për pushimin vjetor të paguar që nuk është shfrytëzuar për shkak të faktit se nuk i ka kryer detyrat për shkak të sëmundjes.

Në vijim, Gjykata u shpreh se neni 7 i Direktivës 2003/88, në lidhje me aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës, duhet të interpretohet ashtu që nuk përjashton dispozitat e ligjit kombëtar që u japin zyrtarëve të drejta shtesë të pushimit të paguar, përveç të drejtës minimale të pushimit vjetor të paguar prej katër javësh, pa parashikuar një kompensim financiar kur zyrtari në pension nuk është në gjendje të përfitojë nga këto të drejta shtesë për shkak se ai nuk ishte në gjendje të kryente funksionet e tij për shkak të sëmundjes.

Së fundmi, Gjykata u shpreh se neni 7.2 i Direktivës 2003/88, në lidhje me aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës, duhet të interpretohet se kundërshton një dispozitë të ligjit kombëtar që, duke vendosur afate nëntë mujore për të drejtën e marrjes së pushimit vjetor të paguar, kufizon të drejtën e një zyrtari në pension për të grumbulluar kompensim për pushimin vjetor të paguar, që nuk është marrë për shkak të paaftësisë për të punuar në punë.

Neni 52

Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

- 1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.*
- 2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajolai jeton.*
- 3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI56/09 PARASHTRUESE: FADIL HOXHA DHE TË TJERËT

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_56_09_shq.pdf]

22 dhjetor 2010

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Rasti kishte të bënte me vendimin e Kuvendit Komunal në Prizren për të ndryshuar planin urbanistik, ashtu që një zonë e gjelbër u përcaktua të shndërrohej në zonë ndërtimore. Duke qenë se këtij ndryshimi nuk i kishte paraprirë asnjë debat publik me banorët e zonës, çështja kushtetuese në këtë rasti ishte: a ishte shkelur neni 52 i Kushtetutës [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor].

Faktet kryesore

Më një vendim të Kuvendit Komunal të Prizrenit, i cili ishte miratuar dhe kishte hyrë në fuqi më 30 prill 2009, ishte ndryshuar një vendim i vjetër i Kuvendit Komunal të Prizrenit, lidhur me planin urbanistik të lagjes Dardania (ish-Jaglenica). Ndër të tjera, me këtë ndryshim parashihej që në vend të një zone të gjelbër ekzistuese do ndërtoheshin objekte të larta, të planifikuara për familjet e dëshmorëve dhe për rastet sociale. Sipas parashtruesve të kërkesës, asnjë debat publik dhe/apo pjesëmarrje nuk i kishte paraprirë miratimit të vendimit të 30 prillit 2009. Komuna e Prizrenit e kishte konfirmuar këtë pohim të parashtruesve me një shkresë që i kishte dorëzuar Gjykatës Kushtetuese, si dhe gjatë seancës publike të mbajtur më 15 korrik 2010. Vendimi i lartcekur i Komunës së Prizrenit nuk përmbante asnjë këshillë juridike për mundësinë e ankimimit të tij. Komuna e Prizrenit argumentoi se ndërhyrja në atë zonë do ta lehtësonte menaxhimin e mirëfilltë të atij lokacioni, i cili, sipas Komunës, ishte shndërruar në deponi mbeturinash. Më 13 korrik 2009, parashtruesit e kërkesës (Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë), si anëtarë të së ashtuquajturës “Nisma ad

hoc e komunës së Dardanisë”, kishin dorëzuar një kërkesë në Kuvendin Komunal të Prizrenit, me të cilën kërkonin anulimin e vendimit të 30 prillit 2009. Parashtruesit ia kishin bashkëngjitur kërkesës një peticion të nënshkruar nga 393 banorë të lagjes. Më 11 shtator 2009, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit. Me 30 tetor 2009, Avokati i Popullit ia kishte paraqitur një kërkesë urgjente Kryetarit të Komunës së Prizrenit për vënien e masës së përkohshme, në të cilën kërkonte pezullimin e menjëhershëm të çfarëdo ndërtimi në lokacionin në fjalë, derisa Avokati i Popullit ta shqyrtonte rastin, si dhe derisa Gjykata Kushtetuese të merrte vendim meritor për këtë rast. Më 19 prill 2010, parashtruesi i parë, z. Fadil Hoxha, i ishte ankuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për parregullsitë dhe të metat që i kishin paraprirë miratimit të vendimit të 30 prillit 2009. Parashtruesit nuk kishin marrë kurrfarë përgjigje me shkrim në kërkesën e tyre. Më 14 maj 2010, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor kishte ftuar për një diskutim publik, për 24 maj 2010, për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Detal Urbanistik për lagjen Dardania (Jaglenica). Sipas pohimeve që kishte bërë Komuna e Prizrenit në Gjykatën Kushtetuese, diskutimi publik për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Detal Urbanistik për lagjen Dardania (Jaglenica) ishte mbajtur më 24 maj 2010. Por vendimi i 30 prillit 2009 nuk ishte ndryshuar në asnjë mënyrë.

Më 11 shtator 2009, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën kërkonin që Gjykata ta vlerësonte kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit Komunal në Prizren, të 30 prillit 2009.

Pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, më 11 nëntor 2009 Kuvendi Komunal i Prizrenit kishte paraqitur parashtresë më shkrim në Gjykatë duke i kontestuar pohimet e parashtruesve të kërkesës me arsyetimin se vendimi i 30 prillit 2009 ishte miratuar në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe se ngastra e tokës në fjalë ishte klasifikuar si pronë publike.

Më 25 nëntor 2009, Gjykata Kushtetuese kishte nxjerrë vendim për shqiptimin e masës së përkohshme duke pezulluar zbatimin e vendimit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, të datës 30 prill 2009.

Më 15 korrik 2010 ishte mbajtur seancë dëgjimore në Gjykatën Kushtetuese, ku përveç palëve në cilësi të palës së interesuar ishte dëgjuar edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se u ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 52 (2) të Kushtetutës, i cili përcakton se secilit duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet nga institucionet publike dhe mendimet e tyre të konsiderohen lidhur me çështjet që kanë ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë. Parashtruesit u ankuan se ekzistonte rreziku i drejtpërdrejtë që ndërtimi i objekteve në fjalë do t'u shkaktonte atyre dëme të pariparueshme (prandaj ata kërkuan që Gjykata Kushtetuese ta shqiptonte edhe masën e përkohshme).

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht konstatoi dhe vendosi që kërkesa ishte e pranueshme për shqyrtim të meritave të saj. Më tej, Gjykata iu referuar nenit 52 (2) të Kushtetutës, i cili thekson se: "*Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajolai jeton*". Në ndërlidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje se e drejta për të jetuar në mjedis të shëndoshë klasifikohet në të ashtuquajturën «të drejtat e gjeneratës së tretë». Të drejtat e gjeneratës së tretë janë të drejta të pranuar ndërkombëtarisht si të drejta të njeriut, por që nuk klasifikohen lehtë as si të drejta civile dhe politike, as si të drejta ekonomike dhe sociale. Gjykata Kushtetuese më tej iu referua instrumenteve dhe rezolutave të trupave të OKB-së dhe të Këshillit të Evropës lidhur me të drejtat mjedisore, duke vënë theksin posaçërisht në praktikën e GJEDNJ. Në këtë vazhdë, Gjykata vuri në pah se GJEDNJ ka dhënë udhëzime të qarta se mbrojtja e mjedisit përfshihet edhe në nenin 2 (E drejta për jetën) edhe në nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, kur shtetet duhet të vendosin për çështje të ndërlikuara të politikave për mjedis dhe ekonomi, procesi i vendimmarrjes së pari duhet të përfshijë hulumtime dhe studime të mirëfillta për t'u mundësuar atyre që paraprakisht t'i parashikojnë dhe vlerësojnë efektet e atyre

veprimeve që mund ta dëmtojnë mjedisin dhe t'i cenojnë të drejtat e individëve dhe për t'u mundësuar shteteve që të vendosin ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshme kundërthënëse. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se parashtruesit e kërkesës nuk kishin pasur rast të dëgjoheshin nga institucioni publik, d.m.th, nga Komuna e Prizrenit dhe ta shprehnin mendimin e tyre lidhur me çështjen në fjalë, që kishte ndikim në mjedisin në të cilin ata jetojnë. Në këtë sfond, Gjykata u thirr në praktikën përkatëse gjyqësore të GJEDNJ, që kishte të bënte me mbrojtjen e mjedisit, për të arsyetuar se personat e interesuar duhet të jenë në gjendje të paraqesin ankesë në gjykatë kundër çdo vendimi, akti ose lëshimi, që, sipas mendimit të tyre, nuk u ka kushtuar rëndësi të mjaftueshme interesave apo pikëpamjeve të tyre në proceset e vendimmarrjes publike. Në dritën e kësaj, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se parashtruesit e kërkesës nuk e kishin gëzuar nivelin e kërkuar për mbrojtjen e mjedisit, siç garantohet me nenin 52 (2) të Kushtetutës. Rrjedhimisht, vendimi i Kuvendit Komunal të Prizrenit kishte shkelur nenin 52 (2) të Kushtetutës.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së punës, vendosi, që kërkesa ishte e pranueshme dhe njëzëri konstatoi që kishte pasur shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës të garantuar me nenin 52 (2) të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese kërkoi që Kuvendi Komunal i Prizrenit duhej t'i dorëzonte Gjykatës, brenda gjashtë muajve, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. TĂTAR kundër RUMANISË

[67021/01]

GJEDNJ [Dhoma]

6 korrik 2009

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Detyrimet e të drejtave të njeriut në lidhje me gëzimin e një mjedisi të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm; pasiviteti në rregullimin e proceseve teknologjike të një impianti në afërsi të shtëpisë së parashtruesve që lëshonte ndotës të rrezikshëm.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Vasile Gheorghe Tătar (kërkuesi i parë) dhe Paul Tătar (kërkuesi i dytë), baba dhe bir (kërkuesit), shtetas rumunë kundër Rumanisë. Kompania “S.C. Aurul S.A.”, që tani vepron si “S.C. Transgold S.A.”, mori një licencë në vitin 1998 për të shfrytëzuar minierën e arit Baia Mare. Procesi i nxjerrjes përfshinte përdorimin e cianidit të natriumit. Një pjesë e aktivitetit të saj ndodhej në afërsi të shtëpisë së kërkuesve. Më 30 janar 2000 ndodhi një aksident mjedisor në vend. Një studim i Kombeve të Bashkuara raportoi se një digë ishte thyer, duke lëshuar rreth 100,000 m³ ujë të mbeturinave të kontaminuar me cianid në mjedis. Në raport thuhej se “S.C. Aurul S.A.” nuk i kishte ndaluar operacionet e saj. Pas aksidentit, kërkuesi i parë paraqiti ankesa të ndryshme administrative në lidhje me rrezikun e shkaktuar ndaj tij dhe familjes së tij si rezultat i përdorimit të cianidit të natriumit nga “S.C. Aurul S.A.” në procesin e nxjerrjes. Ai gjithashtu vuri në dyshim vlefshmërinë e licencës së operimit të kompanisë. Ministria e Mjedisit, në nëntor 2003, e informoi atë se aktivitetet e kompanisë nuk përbënin rrezik për shëndetin publik dhe se e njëjta teknologji e nxjerrjes përdorej në vende të tjera. Kërkuesi i parë ngriti gjithashtu procedurë penale, në vitin 2000, duke u ankuar se procesi i minierave

ishte një rrezik për shëndetin e banorëve të Baia Mare, se ai përbënte një kërcënim për mjedisin dhe se po përkeqësonte gjendjen mjekësore të djalit të tij, përkatësisht astmën. Me një urdhër të 20 nëntorit 2001, gjykatat rumune pushuan procedurën penale në lidhje me aksidentin e 30 janarit 2000 me arsyetimin se faktet për të cilat ankoheshin nuk përbënin vepra penale. Asnjë urdhër apo vendim gjyqësor në lidhje me ankesat e tjera nuk është lëshuar më pas.

Përmbledhja e pretendimeve

Duke u mbështetur në nenin 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkuesit u ankuan se procesi teknologjik i përdorur nga “SC Transgold SA” Baia Mare (ish “SC Aurul SA” Baia Mare) vuri jetën e tyre në rrezik dhe se autoritetet nuk kishin arritur të ndërmerren asnjë veprim përkundër ankesave të shumta të paraqitura. Në vendimin e saj të pranueshmërisë të korrikut 2007, Gjykata vendosi që ankesat e kërkuesve duhej të shqyrtoheshin sipas nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 8, Gjykata vërejti se ndotja mund të ndërhynte në jetën private dhe familjare të një personi duke dëmtuar mirëqenien e tij/saj dhe se shteti kishte për detyrë të siguronte mbrojtjen e qytetarëve të tij duke rregulluar autorizimin, ngritjen, funksionimin, sigurinë dhe monitorimin e aktiviteteve industriale, veçanërisht aktiviteteve të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Gjykata nuk vuri në dyshim realitetin e gjendjes shëndetësore të Paul Tatarit, i cili u diagnostikua në vitin 1996 dhe që kërkonte ndihmë mjekësore, as atë të toksicitetit të cianidit të natriumit dhe të ndotjes së zbuluar, tej normave të autorizuara, nga organizatat ndërkombëtare në afërsi të shtëpisë së kërkuesve pas aksidentit mjedisor.

Gjykata vuri në dukje se, në dritën e asaj që dihej aktualisht për këtë temë, kërkuesit nuk kishin arritur të provonin ekzistencën e një lidhjeje shkakësore midis ekspozimit ndaj cianidit të natriumit dhe astmës. Megjithatë, ajo vërejti se ekzistenca e një rreziku serioz dhe material për shëndetin dhe mirëqenien e kërkuesve kërkonte një detyrë nga ana e

shtetit për të vlerësuar rreziqet, si në kohën kur dha lejen e funksionimit, ashtu edhe në vijim të aksidentit, dhe të merren masat e duhura.

Gjykata vuri re se një vlerësim paraprak i ndikimit, i kryer në vitin 1993 nga Ministria Rumune e Mjedisit, kishte nxjerrë në pah rreziqet që sjell aktiviteti për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe se kushtet e funksionimit të përcaktuara nga autoritetet rumune kishin qenë të pamjaftueshme për të përjashtuar mundësinë e dëmtimit të rëndë.

Gjykata vuri në dukje më tej se kompania kishte mundur të vazhdonte operacionet e saj industriale pas aksidentit të janarit 2000, në kundërshtim me parimin e parandalimit, sipas të cilit mungesa e sigurisë në lidhje me njohuritë aktuale shkencore dhe teknike, nuk mund të justifikonte ndonjë vonesë nga ana e shtetit në miratimin e masave efektive dhe proporcionale. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se autoritetet duhej të siguronin qasje publike në përfundimet e hetimeve dhe studimeve. Gjykata përsëriti se shteti kishte për detyrë të garantonte të drejtën e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me çështjet mjedisore. Ajo theksoi se dështimi i Qeverisë rumune për të informuar publikun, veçanërisht duke mos bërë publik vlerësimin e ndikimit të vitit 1993 mbi bazën e të cilit ishte dhënë licenca e funksionimit, e kishte bërë të pamundur për publikun që të kundërshtonin rezultatet e atij vlerësimi. Gjykata më tej vuri në dukje se kjo mungesë informacioni kishte vazhduar edhe pas aksidentit të janarit 2000, pavarësisht ankthit të mundshëm të banorëve vendas.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet rumune kishin dështuar në detyrën e tyre për të vlerësuar, në një shkallë të kënaqshme, rreziqet që mund të sillte aktiviteti i kompanisë dhe për të marrë masat e duhura për të mbrojtur të drejtat e personave të prekur për respektimin e jetës së tyre private dhe të banesës, sipas kuptimit të nenit 8, dhe në përgjithësi të drejtën e tyre për të gëzuar një mjedis të shëndetshëm dhe të mbrojtur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës; urdhëroi që shteti i paditur duhet t'u paguajë parashtruesve bashkërisht, në përputhje me nenin 44.2 të Konventës, 6,266 (gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) euro për kostot dhe shpenzimet.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. L. B., STICHTING VARKENS IN NOOD, STICHTING DIERENRECHT, STICHTING LEEFBAAR BUITENGEBIED kundër COLLEGE VAN BURGEMEESTER EN WETHOUDERS VAN DE GEMEENTE ECHT-SUSTEREN

GJDBE

Çështja C826/18

14 janar 2021

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=236421&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=13717276>]

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: ky vendim ka të bëjë me interpretimin e Konventës së Aarhusit mbi të drejtën e publikut për qasje në drejtësi në çështjet mjedisore

Faktet kryesore

“Sebava B.V.” është një kompani private holandeze me aktivitet në rritjen dhe tregtimin e derrave dhe produkteve përkatëse. Më 13 tetor 2016, ajo paraqiti në komunën e Echt-Susteren një kërkesë për leje për zgjerimin dhe modifikimin e një stalle derrash që ndodhej në Koningsbosch, me qëllim ndërtimin e një stalle të re për 855 dosa dhe për të ndërtuar një shtegu të mbuluar për dosa.

Kjo kërkesë kaloi në procedurën përgatitore, gjatë së cilës organi kompetent miratoi një projektvendim për kërkesën për leje, në lidhje me të cilin mund të paraqiten komente. Gjatë kësaj procedure, komuna e Echt-Susteren vendosi që nuk ishte i nevojshëm të përgatitej edhe një raport i ndikimit mjedisor.

Ky vendim, së bashku me një kopje të dosjes së njoftimit dhe dokumente të tjera mbështetëse, u vunë në dispozicion të publikut për konsultim në ndërtesën e komunës. Një njoftim u botua në Staatscourant van het Koninkrijk der Nederlanden²¹⁶, ku thuhej se vendimi në fjalë do të konsiderohej si një akt përgatitor, sipas kuptimit të ligjit holandez, dhe për këtë arsye nuk mund të bëhej objekt i një ankimi administrativ ose gjyqësor, përveç rastit kur ai cenon drejtpërdrejt interesat e një “palë të interesuar”. Aplikimi për leje si dhe shpallja e projektit të lejes u publikuan edhe në Gemeentebled van Echt-Susteren²¹⁷.

Me vendim të 28 shtatorit 2017, komuna Echt-Susteren dha edhe lejen mjedisore të kërkuar për këtë projekt. L.B., një person fizik, dhe Stichting Varkens in Nood, Stichting Dierenrecht dhe Stichting Leefbaar Buitengebied, shoqata për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve, paraqitën një padi në Rechtbank Limburg²¹⁸ për anulimin e kësaj leje.

Për sa i përkonte padisë së ngritur nga L.B., gjykata e Limburgut vlerësoi se ajo duhet të hidhej poshtë si e papranueshme me arsyetimin se L.B. nuk i plotësonte kushtet për t’u konsideruar si “palë e interesuar”, sipas kuptimit të së drejtës administrative holandeze, përderisa ajo nuk jeton pranë projektit në fjalë, por rreth 20 kilometra larg tij dhe për këtë arsye nuk vuante personalisht efektet mjedisore të atij projekti. Gjykata e Limburgut theksoi se profesioni i L.B.-së si veterinerë nuk është i mjaftueshëm për t’i njohur një interes personal dhe se aktivitetet dhe cilësitë e tjera në të cilat ishte mbështetur, janë paraqitur me vonesë, pas skadimit të afatit për ankim. Gjykata e Limburgut shtoi se padia e L.B.-së gjithashtu mund të hidhej poshtë si e papranueshme edhe me arsyetimin se ankuesi nuk kishte paraqitur vërejtje kundër atij projekti gjatë procedurës përgatitore.

L.B. pohoi se ajo duhet të njihej si “palë e interesuar” sipas kuptimit të ligjit holandez dhe se ajo nuk mund të kritikohej se nuk kishte bërë vërejtje gjatë procedurës përgatitore, duke marrë parasysh parregullsitë gjatë kësaj faze. Në veçanti, nuk ishte treguar se projekti kishte të

216 Gazeta Zyrtare e Mbretërisë së Holandës.

217 Buletini Komunal i Echt-Susteren.

218 Gjykata e Limburgut, Holandë.

bënte me zgjerimin e një stalle derrash dhe bëhej e qartë që vetëm “të interesuarit” ishin ftuar të parashtronin komente.

Në këtë kontekst, Gjykata e Limburgut pyeti Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: GJDBE) nëse kufizimi i qasjes në drejtësi për “personat e interesuar”, sipas kuptimit të ligjit kombëtar, është në përputhje me Konventën e Aarhus-it. Nenet 6 dhe 9 të Konventës së Aarhusit të referuara në këto procedura, respektivisht parashikojnë, në thelb, të drejtën për t’u informuar mbi projektet që prekin mjedisin dhe qasjen në gjykatë për të kundërshtuar paligjshmërinë e projekteve ose vendimmarrjeve të tilla.

Gjykata e Limburgut pyeti në veçanti nëse neni 9.2 i asaj Konvente duhet të interpretohet se kërkon që personat të cilët, si L.B., nuk konsiderohen si “palë të interesuara”, në kuptimin e ligjit holandez dhe nuk janë as pjesë e “publikut të interesuar”, sipas kuptimit të Konventës së Aarhus-it, munden gjithsesi, si pjesë e “publikut”, sipas kuptimit të kësaj Konvente, të dalin si palë gjyqësore në lidhje me çdo shkelje të mundshme të të drejtave që neni 6, paragrafët 3 dhe 7 deri në 9, të kësaj Konvente i njohin “publikut” dhe jo vetëm “publikut të interesuar”.

Për sa i përket shoqatave të mbrojtjes së mjedisit që ishin paditës në procedurën kryesore, Gjykata e Limburgut vlerësoi se ato janë “palë të interesuara”, sipas kuptimit të ligjit kombëtar, pasi mirëqenia dhe mbrojtja e kafshëve janë pjesë e objektit të tyre ligjor dhe është vërtetuar mjaftueshëm se ata kryejnë aktivitete konkrete për këtë qëllim. Megjithatë, ajo gjykatë vlerësoi se padia e ngritur nga këto shoqata duhet të hidhej poshtë si e papranueshme me arsyetimin se ato nuk kishin ndërhyrë gjatë procedurës përgatitore. Megjithatë, ajo pyeti GJDBE-në nëse ky kusht i pranueshmërisë respekton të drejtën e BE-së dhe, në veçanti, nenin 9.2 të Konventës së Aarhus-it.

Gjykata referuese gjithashtu vuri në dyshim nëse kjo dispozitë është në përputhje me të drejtën holandeze e cila parashikon se ankesat që nuk kanë të bëjnë me aspekte të projektvendimit të cilat janë kontestuar në procedurën përgatitore janë të papranueshme.

Në këto rrethana, Gjykata e Limburgut vendosi të pezullojë procedurën dhe t’i drejtojë GJDBE-së një sërë pyetjesh mbi problemet e mësipërme.

Përmbledhja e vendimit

Gjykata konstatoi se pyetjet që i drejtohen nga gjykata holandeze kanë të bëjnë me interpretimin dhe fushën e zbatimit të Konventës së Aarhusit, të nënshkruar në Aarhus, të Danimarkës më 25 qershor 1998 dhe të miratuar në emër të Komunitetit Evropian me Vendimin 2005/370/CE të Këshillit, të 17 shkurtit 2005²¹⁹.

Në përgjigje të pyetjeve të gjykatës holandeze, GJDBE kujtoi se, sipas nenit 9.2 të Konventës së Aarhus-it, secili Shtet Kontraktues, në kuadër të ligjit të tij të brendshëm, dhe në përputhje me objektivin, kujdeset për t'i dhënë "publikut të interesuar" qasje të gjerë në procedura gjyqësore, në mënyrë që pjesëtarët e publikut të bëjnë padi ose, kur ligji kombëtar vendos një kusht të tillë, të mund të kundërshtojnë një shkelje të një të drejte para një organi gjyqësor ose organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm për të kundërshtuar ligjshmërinë e çdo vendimi që bie në fushëveprimin e nenit 6 të kësaj Konvente dhe, nëse ligji vendos e parashikon këtë, të dispozitave të tjera përkatëse të saj. Pra, qëllimi i nenit 9.2 të Konventës së Aarhusit nuk është që t'ia njohë të drejtën e ankimit kundër vendimeve dhe akteve të tjera që përfshihen në fushëveprimin e nenit 6 të saj, publikut të gjerë, por t'ua garantojë këtë të drejtë vetëm pjesëtarëve të "publikut të interesuar" që plotësojnë disa kushte.

Sipas Gjykatës, është e vërtetë që neni 6 i Konventës së Aarhusit përdor vazhdimisht termin «publik». Megjithatë, leximi i këtij neni në tërësi tregon se ai vlen vetëm për "publikun e interesuar", domethënë të vetmin që kërkohet pjesëmarrja e tij në procesin e vendimmarrjes. Për më tepër, duke ftuar që të parashikohen afate të arsyeshme për informimin e publikut, sipas kuptimit të nenit 6.2 të Konventës së Aarhus-it dhe për përgatitjen dhe pjesëmarrjen efektive të këtij publiku gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, neni 6.3 i kësaj Konvente konfirmon se fazat e ndryshme të procedurës së pjesëmarrjes publike janë të zbatueshme vetëm për publikun e interesuar.

219 JO 2005, L 124, p.1.

Kjo do të thotë se, nën kushtin e verifikimeve që do bëjë gjykata holandeze, një person si L.B., i cili nuk është pjesë e “publikut të interesuar” sipas kuptimit të Konventës së Aarhusit, nuk mund të mbështetet në shkëljen e nenit 9.2 të asaj konvente për arsye se ajo nuk ka qasje në drejtësi në procedurën kryesore. Megjithatë, Gjykata u shpreh se qasja e një personi të tillë në drejtësi duhet t’i nënshtrohet një regjimi tjetër nëse ligji kombëtar i një shteti anëtar i jep publikut të drejtën për të marrë pjesë në procesin më të gjerë të vendimmarrjes, në veçanti të drejtën për t’u informuar për një projekt në mënyrë efikase dhe në kohë, siç lejohet nga neni 3.5 i Konventës së Aarhusit. Sipas këtij neni, Palët në Konventën e Aarhusit mund të miratojnë, në legjislacionin e tyre kombëtar, masa më të favorshme se ato të parashikuara në këtë Konventë, të tilla që sigurojnë pjesëmarrje më të gjerë të publikut në procesin e vendimmarrjes të përmendur në nenin 6 të kësaj Konvente. Në një rast të tillë, mjetet gjyqësore të ngritura në bazë të këtyre masave do të përfshiheshin në paragrafin 3 të nenit 9 të Konventës së Aarhusit, i cili parashikon se secila palë e kësaj Konvente siguron që “pjesëtarët e publikut që plotësojnë çdo kriter të parashikuar nga ligji i saj i brendshëm” mund të nisin procedura administrative ose gjyqësore për të kundërshtuar veprimet ose mosveprimet e individëve ose autoriteteve publike që janë në kundërshtim me dispozitat kombëtare për mjedisin. Gjykata ka vendosur ndërkaq që e drejta e ankimit, e parashikuar në atë dispozitë, do të zhvishej nga çdo efekt i dobishëm nëse, me vendosjen e këtyre kriterëve, disa kategorive të “pjesëtarëve të publikut” do t’i mohohesh çdo e drejtë ankimi²²⁰.

Duke pasur parasysh sa më sipër, përgjigja për këtë problem është se neni 9.2 i Konventës së Aarhusit duhet të interpretohet në kuptimin që ai nuk ndalon që pjesëtarët e “publikut” të përmendur në nenin 2.4 të asaj Konvente të mos kenë qasje si të tillë në procedurat gjyqësore për qëllime të kundërshtimit të një vendimi që bie në fushëveprimin e nenit 6 të Konventës. Por nga ana tjetër, neni 9.3 i Konventës së Aarhusit nuk lejon që pjesëtarët e “publikut”, sipas kuptimit të kësaj Konvente, të mos

220 Gjykata i referohet vendimit të 20 dhjetorit 2017, *Protect Natur-, Arten- und Landschaftsschutz Umweltorganisation*, C664/15, EU:C:2017:987, paragrafët 46 dhe 48, si dhe të 3 tetorit 2019, *Wasserleitungsverband Nördliches Burgenland e.a.*, C197/18, EU:C:2019:824, paragrafi 34.

mund të kenë qasje në procedura gjyqësore me qëllim që të përfitojnë nga të drejtat më të gjera në vendimmarrje më të gjerë, kur kjo u njihet nga e drejta mjedisore e shtetit anëtar.

Në vijim, gjykata referuese e Limburgut pyeti, në thelb, nëse neni 9.2 i Konventës së Aarhusit dhe neni 9.3 i kësaj të fundit, lejojnë apo jo që pranueshmëria e padive të paraqitura, respektivisht nga organizatat joqeveritare që janë pjesë e “publikut të interesuar” sipas nenit 6 të Konventës, dhe nga një pjesëtar i “publikut” sipas së drejtës së brendshme, të varen nga pjesëmarrja e tyre në procedurën përgatitore të vendimit të kundërshtuar, përveçse kur kjo ka qenë e pamundur. Ajo pyeti gjithashtu nëse këto dispozita lejojnë apo jo, që të jenë të pranueshme vetëm ankesat që kanë të bëjnë me pretendime që janë ngritur më parë nga paditësit gjatë këtyre procedurave përgatitore.

Nga praktika gjyqësore e Gjykatës rezultonte se anëtarët e “publikut të interesuar”, sipas kuptimit të Konventës së Aarhusit, duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë një mjet juridik kundër akteve të përmendura në nenin 9.2 të asaj Konvente, cilido qoftë roli që ata mund të kenë luajtur gjatë procedurave përgatitore, dhe se Palët në këtë Konventë nuk mund ta kushtëzojnë pranueshmërinë e padisë me pjesëmarrjen e paditësit në procesin e vendimmarrjes së vendimit të kontestuar dhe me mundësinë e tij për të paraqitur këndvështrimin e vet në lidhje me të. Kjo aq më tepër kur neni 9.2 synon një qasje sa më të gjerë në procedura gjyqësore dhe, po ajo dispozitë i konsideron organizatat mjedisore se kanë një interes të drejtpërdrejtë në vendimet që lidhen me mjedisin.

Megjithatë, theksoi Gjykata, një kusht i tillë mund të pranohet në lidhje me pjesëtarët e publikut, siç ishte L.B. në këtë procedurë. Në këtë rast, pavarësisht nga fakti se ai përbën, si parakusht për paraqitjen e një padie, një kufizim të së drejtës për një mjet efektiv para një gjykate, sipas kuptimit të nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së një kusht i tillë mund të justifikohet, në përputhje me nenin 52.1 të Kartës, për aq sa parashikohet me ligj, respekton përmbajtjen thelbësore të së drejtës në fjalë, është i nevojshëm, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, dhe përmbush efektivisht objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga BE.

Në çështjen konkrete duket se ky kusht i pranueshmërisë së një padie me pjesëmarrjen përgatitore në procesin e vendimmarrjes, parashikohet me ligj, në kuptimin e nenit 47 të Kartës. Ky kusht respekton gjithashtu përmbajtjen thelbësore të së drejtës themelore për mbrojtje efektive gjyqësore, siç parashikohet në këtë nen, pasi nuk e vë në dyshim këtë të drejtë si të tillë, por vetëm imponon një hap procedural shtesë për qëllimet e ushtrimit të saj. Ai gjithashtu përmbush objektivin e interesit të përgjithshëm me qëllim që të lejojë zgjidhjen e pretendimeve që në fazën administrative dhe nuk duket të ketë një raport jo të drejtë ndërmjet këtij objekti dhe detyrimit për të marrë pjesë në procedurën përgatitore të vendimit të kundërshtuar.

Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se neni 9.2 i Konventës së Aarhusit duhet të interpretohet në kuptimin që ai përjashton që pranueshmëria e padive nga organizatat joqeveritare që bëjnë pjesë në “publikun e interesuar”, të përmendur në nenin 2.5 të kësaj Konvente, t’i nënshtrohet pjesëmarrjes së këtyre organizatave në procedurën përgatitore të vendimit të kundërshtuar. Nga ana tjetër, neni 9.3 i kësaj Konvente nuk e përjashton pranueshmërinë e një padie me pjesëmarrjen e paditësit, pjesëtar të “publikut”, në procedurën përgatitore të vendimit të kundërshtuar, përveç rasteve kur kjo pjesëmarrje ka qenë e pamundur.

Neni 54

Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

1.1. KI94/13. PARASHTRUES: AVNI DOLI, MUSTAFA DOLI, ZIJA DOLI DHE XHEMILE OSMANAJ

[https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_94_13_shq.pdf]

14 prill 2014

Çështja kyç/e drejta e pretenduar: Ky rast kishte të bënte me mospërmbarimin e vendimeve të ndërlidhura të Drejtorisë për Çështje Pronësore, Kadastër, Gjeodezi dhe Komasion të Komunës së Gjakovës, si dhe vendimeve të ndërlidhura, që kishin anuluar vendimin e Komunës së Gjakovës për eksproprijimin e një prone të parashtruesve. Çështja e ngritur në këtë rast ishte se a i ishin cenuar parashtruesve të drejtat kushtetuese në vijim: e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së); të drejtat pronësore (neni 46 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së) dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave (neni 54 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së).

Faktet kryesore

Më 6 prill 1975, Komuna e Gjakovës kishte marrë vendim për eksproprijimin e pronës së parashtruesve. Më 1 gusht 2002, sipas kërkesës së parashtruesve, Drejtoria për Çështje Pronësore, Kadastër, Gjeodezi dhe Komasion të tokës e Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejshëm: "Drejtoria") kishte nxjerrë aktvendim për ndryshimin e vendimit të lartpërmendur dhe kthimin e disa ngastrave kadastrale specifike në posedim të parashtruesve. Drejtoria me tej kishte vendosur që Shërbimi për Kadastër dhe Gjeodezi i Drejtorisë për Punë Pasurore-Juridike, Kadastër, Gjeodezi dhe Komasion të Komunës së Gjakovës ta bënte çregjistrimin e paluajtshmërisë së lartpërmendur prej emrit të Komunës së Gjakovës dhe ta regjistronte në emër të parashtruesve. Në atë vendim këshillohej se kundër tij mund të ushtrohej ankesë te

Kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Gjakovës në afat prej 15 ditësh. Në vërtetimin e vendimit thuhej se “vendimi ishte përfundimtar”. Më pas, Drejtoria kishte përmbaruar vendimin në fjalë në raport me palën e tretë, por jo në raport më parashtruesit. Më 4 qershor dhe më 17 shtator 2004, parashtruesit kishin kërkuar nga Drejtoria përmbarimin e vendimit të saj. Më 22 shtator 2011, Drejtoria i kishte njoftuar parashtruesit se «Aktvendimi për deeksproprijim i dt. 01.08.2002 i plotfuqishëm nga dt. 09.01.2003 nuk mund të jetësohet në aparatën kadastral sepse ka mangësi”. Drejtori kishte shprehur mendimin që parashtruesit duhet t’i drejtoheshin Gjykatës Komunale në Gjakovë lidhur me realizimin e të drejtave që kërkonin. Më 13 dhjetor 2011, parashtruesit kishin paraqitur propozim në Gjykatën Komunale në Gjakovë për përmbarimin e Vendimit 11 nr. 465-8/93, të 1 gushtit 2002. Më 24 prill 2012, Gjykata Komunale kishte refuzuar propozimin për përmbarim, duke arsyetuar se dokumenti-Aktvendimi i cituar nuk paraqiste titull ekzekutiv, pasi që në dispozitivin e Aktvendimit nuk parashihej kurrfarë detyrimi në të holla i debitorit ndaj kreditorëve. Më 15 maj 2012, parashtruesit kishin ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër vendimit të Gjykatës Komunale. Parashtruesit kishin arsyetuar se Aktvendimi E. nr. 1395/11 i Gjykatës Komunale, i 22 dhjetorit 2011, kundër të cilit nuk ishte paraqitur ankesë nga Drejtoria, ishte bërë i formës së prerë dhe i përmbarueshëm. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe kishte vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë. Parashtruesit kishin parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit. Më 7 mars 2013, Prokurori i Shtetit i kishte njoftuar parashtruesit se nuk kishte bazë ligjore për të vazhduar me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Më 3 korrik 2013, parashtruesit e parashtruan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese. Më 21 tetor 2013, Drejtoria kishte paraqitur komente në Gjykatë, duke sqaruar se mbështeste në tërësi aktvendimin e plotfuqishëm të Drejtorisë për Punë Pasurore-Juridike, Kadastër, Gjeodezi dhe Komacion të Komunës së Gjakovës, të 1 gushtit 2001, i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 9 janar 2013. Më 25 tetor 2013, Gjykata Kushtetuese kishte kërkuar nga Drejtoria që ta njoftonte për arsytet e regjistrimit të pronës në fjalë në emër të një personi të tretë (R. Doli) dhe pse ende nuk e kishte regjistruar pronën e njëjtë në emër të parashtruesve, siç përcaktohej me vendimin e Drejtorisë, të 1 gushtit 2002. Më 7 nëntor 2013, Drejtoria kishte njoftuar se vendimi në fjalë

i ishte përcjellë Shërbimit për Kadastër dhe Gjeodezi në Gjakovë dhe se lidhur me pyetjen se në emër të cilit përfitues ishte regjistruar kjo paluajtshmëri, Gjykata Kushtetuese duhej t'i drejtohej Shërbimit për Kadastër dhe Gjeodezi.

Përmbledhja e pretendimeve

Parashtruesit argumentuan se Komuna e Gjakovës nuk kishte parashtruar fare kundërshtim ndaj aktvendimit në fjalë kështu që aktvendimi ishte bërë i plotfuqishëm në përputhje më dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Si rrjedhojë, parashtruesit pretenduan se ishin diskriminuar dhe se u ishin shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenet 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese fillimisht konstatoi se kërkesa plotësonte kushtet e pranueshmërisë, siç përcaktohen me nenet përkatëse të Kushtetutës, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të Rregullores së punës së Gjykatës. Për sa i përket meritave të kërkesës, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se Gjykata Komunale, përmes Vendimit E. nr. 1395/11, të 22 dhjetorit 2011, kishte vendosur për përmbartimin e vendimit të Drejtorisë. Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Komunale këshillonte që kundër atij aktvendimi mund të ushtrohej ankesë në afat prej 7 ditësh dhe Drejtoria nuk kishte ushtruar ankesë. Rrjedhimisht, Gjykata theksoi se, në mungesë të ankesës nga ana e Drejtorisë në cilësinë e debitorit, vendimi ishte bërë i plotfuqishëm dhe i obligueshëm (*res judicata*) dhe, si i tillë, i përmbartueshëm. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se më 24 prill 2012 Gjykata Komunale kishte marrë aktvendim që nuk mundësonte përmbartimin e vendimit të Drejtorisë. Ky aktvendim ishte marrë pothuajse pesë muaj pasi që Gjykata Komunale e kishte marrë Aktvendimin E. nr. 1395/11, të 22 dhjetorit 2011, për përmbartim dhe pa asnjë kërkesë të palëve të interesuara. Në këtë vazhdë, Gjykata Kushtetuese vuri në pah se parashtruesit i kishin propozuar Gjykatës Komunale përmbartimin e Aktvendimit të Drejtorisë dhe se Gjykata Komunale, në vendimin e saj të parë, e kishte aprovuar propozimin e parashtruesve për përmbartimin e vendimit të Drejtorisë. Ai vendim i Gjykatës Komunale kishte marrë formë të prerë dhe kështu kishte fituar

statusin *res judicata*. Megjithatë, e drejta e parashtruesve në gjykatë u ishte bërë iluzore, sepse e njëjta Gjykatë Komunale, me vendimin e saj të dytë, e kishte anuluar këtë vendim të plotfuqishëm dhe detyrues. Më tutje, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se e drejta për gjykim të drejtë nënkupton se një vendim i formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*) bëhet i pakthyesëm dhe se parimi i sigurisë juridike presupozon respektimin e parimit *res judicata*. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese theksoi se aktvendimi i dytë i Gjykatës Komunale, që kishte shfuqizuar aktvendimin e parë, ishte nxjerrë pa asnjë iniciativë ose ankesë nga palët. Në dritën e kësaj, për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se vendimi i dytë i Gjykatës Komunale kishte rihapur një proces gjyqësor, i cili tashmë ishte përmbyllur me një vendim gjyqësor të plotfuqishëm dhe të detyrueshëm dhe, në këtë mënyrë, ishte *res judicata*. Si rezultat, Gjykata e Qarkut, me rastin e vërtetimit të aktvendimit të dytë të Gjykatës Komunale, kishte shkelur parimin e sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, kishte shkelur të drejtën e parashtruesve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Për sa i përket nenit 54 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese iu referua neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Gjykata vuri në pah se parashtruesit kishin shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, lidhur me përmbardimin e aktvendimit të Drejtorisë. Por, pavarësisht përpjekjeve të tyre, ai aktvendim i Drejtorisë nuk ishte përmbarduar as nga organet kompetente të Komunës së Gjakovës dhe as nga gjykatat kompetente. Gjykata theksoi se mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektivë për përmbardimin e aktvendimit të Drejtorisë cenonte të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, në bazë të këtyre dispozitave, secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij. Prandaj, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundim se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbardimin e vendimit të Drejtorisë paraqiste shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

Për sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese iu referua konceptit të “pritjeve legjitime”. Në këtë sfond, Gjykata gjeti se parashtruesit kishin pasur «pritje legjitime» të regjistruar në pronën në emrat e tyre, siç përcaktohej me aktvendimin e Drejtorisë, i cili kishte marrë formën e prerë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesve të kërkesës u ishte shkelur po ashtu edhe e drejta e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës].

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Kushtetuese, në pajtim më nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, njëzëri vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje më nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-se dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 324/12 të 21 dhjetorit 2012 dhe t’ia kthejë rastin Gjykatës së Apelit për rishqyrtim në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, gjegjësisht të marrë parasysh se aktvendimi i Drejtorisë duhet të përmbahet.

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. KUDŁA kundër POLONISË

[30210/96]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

26 tetor 2000

Çështja kyçele drejta e pretenduar: mungesa e marrjes së trajtimit adekuat psikiatrik gjatë paraburgimit të tij, zgjatja e paraburgimit ishte e pabazuar dhe e paarsyeshme, se e drejta për një “dëgjim brenda një kohe të arsyeshme” nuk ishte respektuar dhe mungesa e mjetit efektiv vendor për t’u ankuar për zgjatjen e tepërt të procedurës penale.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Andrzej Kudła (kërkuesi), një shtetas polak, kundër Republikës së Polonisë, më 2 dhjetor 1999. Rasti u referua në Gjykatë në përputhje me dispozitat e zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të Protokollit nr. 11 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa”), nga Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Komisioni”) më 30 tetor 1999 (neni 5.4 i Protokollit nr. 11). Kërkuesi u ndalua në paraburgim në gusht 1991. Pasi kërkesat e tij të vazhdueshme për lirim ishin refuzuar, urdhri i paraburgimit u anulua përfundimisht në qershor 1992, në bazë të një raporti psikiatrik që thoshte se kërkuesi shfaqte tendenca të vazhdueshme vetëvrasëse. Më pas, kërkuesi nuk mori pjesë në një seancë dëgjimore për çështjen e tij në shkurt 1993 dhe, duke qenë se ai nuk dorëzoi certifikatën mjekësore të kërkuar nga gjykata brenda afatit të caktuar, u lëshua një urdhër arresti. Kërkuesi u arrestua në lidhje me një kundërvajtje trafiku në tetor 1993 dhe u vendos në paraburgim. Kërkesa të shumta për lirim u refuzuan gjatë vitit vijues dhe në janar 1995 kërkuesi tentoi të bënte vetëvrasje. Megjithatë, një kërkesë për lirim u refuzua nga Gjykata Rajonale në bazë të një raporti nga oficerët e burgut, sipas të cilit përpjekja ishte thjesht

për të kërkuar vëmendje. Disa kërkesa të tjera u refuzuan përpara se kërkesi të dënohej në qershor 1995. Dënimi u anulua në shkurt 1996 dhe u urdhërua një rigjykim. Në maj të vitit 1996, urdhri i paraburgimit u anulua, duke iu nënshtuar pagesës së dorëzarisë prej 10,000 (dhjetë mijë) zloti. Apelimet e kërkesit kundër shumës, ishin të pasuksesshme. Ai më në fund u lirua në tetor 1996 por u dënua përsëri në dhjetor 1998, dënimi i shqiptuar u zvogëluar në apel në tetor 1999 dhe një apel për kasacion ishte në pritje në Gjykatën Supreme.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkesi pretendoi, në veçanti, se ai nuk kishte marrë trajtimin adekuat psikiatrik gjatë paraburgimit të tij, se paraburgimi i tij ishte i gjatë në mënyrë të paarsyeshme, se e drejta e tij për një “dëgjim brenda një kohe të arsyeshme” nuk ishte respektuar dhe se ai nuk kishte mjet efektiv vendor për t’u ankuar për zgjatjen e tepërt të procedurës penale kundër tij.

Kërkesi pretendoi se ai nuk kishte marrë trajtimin e duhur psikiatrik kur ishte në paraburgim nga 4 tetori 1993 e tutje. Ai ishte mbajtur në Qendrën e Paraburgimit në Krakov, ku nuk kishte pasur repart psikiatrik dhe ku nuk ishte bërë asnjë përpjekje serioze për të trajtuar depresionin e tij kronik. Sipas tij, kjo kishte rezultuar në përpjekjet e tij të përsëritura për të kryer vetëvrasje në burg dhe përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Tutje, kërkesi u ankua, së dyti, se paraburgimi i tij ishte i tepruar dhe ai pretendoi shkelje të nenit 5.3 të Konventës. Më tej, kërkesi pohoi se e drejta e tij për një gjykim “brenda një kohe të arsyeshme” nuk ishte respektuar dhe se kishte pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

Përfundimisht, kërkesi parashtroi se ai nuk kishte pasur një mjet juridik efektiv për të ngritur çështjen e zgjatjes së tepërt të procedurave në rastin e tij para një autoriteti kombëtar. Sipas tij, rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

Arsyetimi i Gjykatës

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 3 – Gjykata theksoi se kjo dispozitë nuk mund të interpretohet si një detyrim i përgjithshëm për

të liruar një të paraburgosur për arsye shëndetësore ose për të vendosur në një spital civil me qëllim që të ketë trajtim të veçantë, por megjithatë shteti duhet të sigurojë që një i paraburgosur të mbahet në kushte të përputhshme me dinjitetin e tij dhe se shëndeti dhe mirëqenia e tij të jenë të siguruara në mënyrë adekuate, në veçanti me ofrimin e kujdesit të duhur mjekësor. Në këtë rast, kërkuesi kërkoi dhe mori rregullisht kujdes mjekësor dhe nuk ka asgjë që tregon se autoritetet mund të mbajnë përgjegjësi për tentativën e tij për vetëvrasje. As nuk ka pasur ndonjë dështim të mëvonshëm për të ofruar vëzhgim psikiatrik – në të vërtetë, ishte dhënë asistencë e rregullt. Kështu, ndonëse ndalimi mund të ketë përkeqësuar ndjenjat e ankthit të parashtruesit, nuk është vërtetuar se ai i është nënshtruar keqtrajtimit të një niveli mjaft të rëndë për t’u përfshirë në fushëveprimin e nenit 3.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 5.3 – Gjykata theksoi se periudha e paraburgimit që do të ekzaminohet, përbëhet nga dy periudha, e para fillon nga data kur Polonia njohu të drejtën për petition (1 maj 1993) deri në dënimin fillestar të kërkuesit në qershor 1995 dhe e dyta nga prishja e dënimit të tij në shkurt 1996 deri në lirimin e tij në tetor 1996 (periudha nga dënimi deri në shfuqizimin përjashtohet sepse bie nën nenin 5.1 (a)). Periudha totale është pra 2 vjet 4 muaj dhe 3 ditë. Nuk duket të kontestohet se arsyeja kryesore për të cilën u urdhërua ndalimi ishte mosrespektimi i afatit kohor për dorëzimin e një certifikate mjekësore nga ana e kërkuesit, duke krijuar besimin se ekzistonte rreziku i arratisjes së tij. Kjo arsye fillimisht mund të mjaftonte për të justifikuar paraburgimin e tij, por me kalimin e kohës ajo u bë më pak e rëndësishme, veçanërisht pasi ai kishte kaluar tashmë gati një vit në paraburgim përpara se të arrestohej sërish. Vetëm arsye shumë bindëse do të justifikonin kohëzgjatjen e paraburgimit dhe arsye të tilla nuk mund të identifikohen në këtë rast. Prandaj, arsyet mbi të cilat mbështetej paraburgimi nuk ishin të mjaftueshme.

Në vlerësim të pretendimeve për shkelje të nenit 6.1 – Gjykata theksoi se gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së përgjithshme duhet të merret parasysh kohëzgjatja e ankimit ose e kasacionit dhe në mungesë të ndonjë prove që Gjykata e Lartë ka nxjerrë vendimin, procedurat kanë zgjatur mbi 9 vjet, duke përfshirë 7 vjet dhe 5 muaj nga data kur Polonia e ka njohur të drejtën e petitionit. Kjo periudhë nuk mund të

konsiderohet e arsyeshme, dhe përfundimisht, Gjykata njëzëri konstatoi shkelje.

Në lidhje me neni 13 – Në disa raste të mëparshme, Gjykata ka konsideruar se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej një ankesë sipas nenit 13 kur ishte konstatuar shkelja e nenit 6, pasi nuk kishte interes ligjor për të rishqyrtuar të njëjtën çështje sipas kërkesave më pak strikte të dispozitës së parë. Megjithatë, nuk ka mbivendosje kur, si në këtë rast, shkelja e nenit 6 ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave, një çështje kjo e ndarë nga çështja e disponueshmërisë së një mjeti efektiv për t’u ankuar për një kohëzgjatje të tillë. Ndërsa Gjykata në të kaluarën, megjithatë, ka refuzuar të vendosë për një ankesë sipas nenit 13 në rrethana të tilla, kjo praktikë gjyqësore duhet të rishqyrtohet në dritën e akumulimit të vazhdueshëm të kërkesave në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, dhe për këtë arsye, është e nevojshme të shqyrtojë veçmas ankesa sipas nenit 13. Karakteri subsidiar i makinerisë së Konventës artikullohet në nenin 13 dhe nenin 35.1 dhe i pari shpreh drejtpërdrejt detyrimin e shteteve për të mbrojtur të drejtat e njeriut kryesisht brenda sistemeve të tyre ligjore. Ndërsa nuk ka një model mbizotërues brenda shteteve kontraktuese të mjeteve juridike për zgjatjen e tepërt të procedurave, ka shembuj që tregojnë se mjete të tilla mund të krijohen dhe të funksionojnë në mënyrë efektive. Interpretimi i saktë i nenit 13 është se ai garanton një mjet juridik efektiv kundër shkeljes së pretenduar të së drejtës për të përcaktuar një çështje gjyqësore brenda një kohe të arsyeshme. Në këtë rast të veçantë, Qeveria parashtrroi se grupi i disa mjeteve juridike plotësonte kërkesat e nenit 13, por nuk tregoi nëse dhe si mund të siguronte kërkuesit zgjidhje duke i shfrytëzuar ato masa. Nuk u sugjerua se ato mund të kishin përshpejtuar përcaktimin e akuzave kundër tij ose t’i siguronin kompensim adekuat për vonesat ekzistuese. Për rrjedhojë, masat e përmendura nuk përmbushën standardin e “efektivitetit”.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës; se ka pasur shkelje të nenit 5.3 të Konventës; se ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës; se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës. Bazuar në nenin 41, Gjykata konstatoi se kërkuesi nuk kishte treguar se dëmi

material që ai pretendonte ishte shkaktuar nga mbajtja në paraburgim gjatë periudhës përkatëse. Gjykata i caktoi atij shumën 30,000 (tridhjetë mijë) zloty (PLN) në lidhje me dëmin jomaterial dhe, gjithashtu, i dha një shpërblim në lidhje me kostot.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. ASSOCIAZIONE NAZIONALE GRANOSALUS – LIBERI CEREALICOLTORI & CONSUMATORI kundër KOMISIONIT EVROPIAN

**GJDBE
C313/19 P**

28 tetor 2020

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=233016&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13717552>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Në këtë vendim, Gjykata thekson se neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore njih të drejtën për ankim efektiv në sistemin e BE-së, por ankime të tilla duhet të respektojnë kriteret procedurale të parashikuara nga Traktatet.

Faktet kryesore

Glifosati është një substancë aktive, përfshirja e së cilës në produktet për mbrojtjen e bimëve ishte autorizuar në saxe të direktivave të njëpasnjëshme, nga 1 korriku 2002 deri më 14 qershor 2011. Pas kësaj date, glifosati u përfshi në listën e substancave aktive të miratuara sipas Rregullores nr. 1107/2009, e cila figuron në Shtojcën e Rregullores zbatuese të Komisionit (BE) nr. 540/2011, të 25 majit 2011, për zbatimin e Rregullores (KE) nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me listën e substancave aktive të miratuara. Data e skadimit të periudhës së miratimit për këtë substancë aktive ishte caktuar 31 dhjetori 2015.

Pas fillimit të procedurës për vazhdimin e miratimit të substancës aktive në fjalë dhe për shkak të vonesave në vlerësimin e saj, Komisioni Evropian zgjati periudhën e vlefshmërisë së glifosatit deri më 30 qershor 2016, pastaj deri më 15 dhjetor 2017. Më 12 dhjetor 2017, Komisioni miratoi Rregulloren zbatuese (BE) 2017/2324, e cila ripërtërin, në kushte të caktuara, miratimin e substancës aktive glifosati deri më 25 dhjetor 2022.

Me një kërkesë të paraqitur në Regjistrin e Tribunalit më 28 shkurt 2018, GranoSalus, një shoqatë italiane e prodhuesve të grurit, e konsumatorëve dhe e shoqatave të tyre mbrojtëse, ngriti një padi për anulimin e Rregullores zbatuese (BE) 2017/2324. Në padinë e tyre ata pretenduan, në thelb, shkelje të neneve 168, 169 dhe 191 të TFBE-së, të disa akteve të së drejtës dytësore, si dhe të parimeve të kujdesit, proporcionalitetit dhe mirëadministrimit.

Me një kërkesë të veçantë të depozituar në Regjistrin e Tribunalit më 30 maj 2018, Komisioni paraqiti pretendimet për papranueshmërinë e kësaj padie.

Tribunali e pranoi këtë kërkesë të Komisionit me urdhrin që është objekt i këtij apeli para Gjykatës së Drejtësisë dhe e hodhi poshtë padinë si të papranueshme. Tribunali e argumentoi urdhrin e tij në mungesën e interesit të ankuesve, pasi shqyrtoi *locus standi* aktiv, të pjesëtarëve të GranoSalus një nga një, nën dritën e tri rasteve të parashikuara në paragrafin 4 të nenit 263 të TFBE-së.

Lidhur me këtë, Tribunali vlerësoi se pjesëtarët e GranoSalus nuk ishin objekt i rregullores së kundërshtuar. Pastaj vlerësoi se ankuesit nuk kishin treguar se ata ishin prekur individualisht nga ajo rregullore. Së fundi, ai konsideroi se rregullorja në fjalë nuk përbënte një akt rregullator të pashoqëruar me masa zbatuese. Ai sqaroi, në këtë pikë të fundit, se, duke pasur parasysh procedurat e përcaktuara në Rregulloren nr. 1107/2009, rregullorja e kundërshtuar prodhon pasoja ndaj pjesëtarëve të GranoSalus, vetëm përmes ripërtëritjes, nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, të autorizimeve të produkteve për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë substancën aktive glifosat.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata kujtoi fillimisht se pranimi i një padie të ngritur nga një person fizik ose juridik kundër një akti të cilit nuk i nënshtrohet, sipas paragrafit 4 të nenit 263 të TFBE-së, i nënshtrohet kushtit që atij i njihet e drejta për të bërë padi në dy raste. Së pari, ai mund të paraqesë një padi kundër aktit nëse ky e cenon drejtpërdrejt dhe individualisht. Së dyti, një person i tillë mund të ngrejë padi kundër një akti rregullator i cili nuk përfshin edhe masat zbatuese nëse ky akt ka të bëjë drejtpërdrejt me atë person.

Në vlerësimin e tij, Tribunali vlerësoi se rregullorja e kundërshtuar përbën një akt rregullator, në kuptimin e nenit 263, paragrafi 4, fjalia e tretë, të TFBE-së, gjë që nuk kundërshtohet nga palët në apel. Por GranoSalus pretendoi në apelin e tij para Gjykatës se Tribunali ka gabuar në ligj në përfundimin se rregullorja e kundërshtuar përmban masa zbatuese.

Në lidhje me këtë pretendim duhet të kujtohet se, sipas praktikës së Gjykatës, shprehja “që nuk përmban masa zbatuese”, në kuptimin e fjalisë së tretë të nenit 263, paragrafi 4, të TFBE-së, duhet të jetë interpretuar në dritën e objektivit të kësaj dispozite, e cila konsiston, siç duket nga gjeneza e saj, në parandalimin e një individi që të detyrohet të shkelë ligjin për të qenë në gjendje të ketë qasje te një gjyqtar. Sidoqoftë, kur një akt rregullator prodhon drejtpërdrejt efekte ndaj pozitës juridike të një personi fizik ose juridik pa kërkuar masa zbatuese, ky i fundit do të rrezikonte të privohej nga mbrojtja efektive gjyqësore, nëse nuk do të kishte një mjet juridik para gjyqtarit të BE-së me qëllim që të kundërshtonte ligjshmërinë e këtij akti rregullator. Në të vërtetë, në mungesë të masave zbatuese, një person fizik ose juridik, megjithëse i cenuar drejtpërdrejt nga akti në fjalë, do të ishte në gjendje të kishte një shqyrtim gjyqësor të këtij akti vetëm pasi të kishte shkelur dispozitat e tij dhe duke pretenduar në paligjshmërinë e tyre në kuadër të procedurave të iniciuara kundër atij personi para gjykatave kombëtare.

Nga ana tjetër, kur një akt rregullator përfshin masa zbatuese, kontrolli gjyqësor i pajtueshmërisë me rendin juridik të BE-së sigurohet pavarësisht nëse ato masa burojnë nga organet e BE-së apo nga shtetet anëtare. Megjithëse personat fizikë ose juridikë nuk mundën, për shkak të kushteve të pranueshmërisë të parashikuara në paragrafin 4 të nenit

263 të TFBE-së, të kundërshtojnë drejtpërdrejt një akt rregullator të BE-së para Gjykatave të BE-së, ata mbrohen nga zbatimi i një akti të tillë ndaj tyre nëpërmjet mundësisë së kundërshtimit të zbatimit të masave që përfshin ky akt.

Në këtë drejtim, nga njëra anë, nëse zbatimi i një akti të tillë është përgjegjësi e institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të BE-së, personat fizikë ose juridikë mund të bëjnë një padi të drejtpërdrejtë para gjykatave të BE-së kundër akteve të zbatimit sipas kushteve të përmendura në paragrafin 4 të nenit 263 të TFBE-së dhe ta mbështesin padinë, në zbatim të nenit 277 të TFBE-së, në paligjshmërinë e aktit bazë. Nga ana tjetër, kur zbatimi është përgjegjësi e shteteve anëtare, këta persona mund të pretendojnë pavlefshmërinë e aktit bazë në fjalë para gjykatave kombëtare dhe t'u kërkojnë atyre që t'i drejtohen Gjykatës për një vendim paragjykimor, në bazë të nenit 267 të TFBE-së.

Në paragrafët 81 deri në 83 të vendimit të tij, Tribunali vendosi që një rregullore e Komisionit që ripërtërin miratimin e një substance aktive, nuk përbën në vetvete, në bazë të Rregullores nr. 1107/2009, një konfirmim, zgjatje ose vazhdim të autorizimit të tregtimit nga shtetet anëtare për një produkt mbrojtës të bimëve që përmban këtë substancë aktive. Kjo do të thotë se autorizimi i një produkti për mbrojtjen e bimëve ose ripërtëritja e një autorizimi të tillë rrjedh, sipas neneve 36 dhe 43 të asaj rregulloreje, nga një vendim i miratuar nga një Shtet anëtar dhe, prandaj, nuk rezulton drejtpërdrejt nga ripërtëritja e miratimit të një substance aktive nga Komisioni. Për pasojë, efektet e ripërtëritjes së miratimit të një substance aktive do të krijohen vetëm për një person që prodhon ose tregton një produkt mbrojtës të bimëve që përmban këtë substancë aktive, nëpërmjet miratimit të akteve të mëvonshme nga një Shtet anëtar sipas procedurave për autorizimin e produkteve të tilla ose për vazhdimin e një autorizimi të tillë. Prandaj, akte të tilla ka të ngjarë të përbëjnë masat zbatuese të përfshira në vazhdimin e atij miratimi.

Megjithatë, Gjykata ka deklaruar vazhdimisht se, për të vlerësuar nëse një akt rregullator përfshin masa zbatuese, është e nevojshme të merret parasysh pozicioni i personit që ushtron të drejtën e padisë sipas nenit 263, paragrafi 4, fjalia e tretë, të TFBE-së. Prandaj është e parëndësishme nëse akti në fjalë përfshin masa zbatuese kundër palëve të tjera ndërgjyqëse.

Del qartë nga neni 33.1 i Rregullores se një kërkesë për autorizimin e një produkti për mbrojtjen e bimëve duhet të bëhet nga një person që dëshiron të vendosë një produkt të tillë në treg. Neni 43.1 i Rregullores rezervon paraqitjen e një kërkesë për vazhdimin e një autorizimi të tillë personit që ka ndërkaq një autorizim. Në këto rrethana, do të ishte artificiale të detyrohej një konsumator ose një fermer që nuk ka ndërmend të tregtojë produkte për mbrojtjen e bimëve që përmbajnë substancën aktive glifosat, të paraqesë një kërkesë për autorizimin e një produkti të tillë ose për vazhdimin e një autorizimi të tillë dhe të kundërshtojë aktin që refuzon miratimin e kësaj kërkesë para një gjykate kombëtare, me qëllim që kjo e fundit t'i drejtohet me pyetje Gjykatës mbi vlefshmërinë e Rregullores që miraton substancën aktive glifosati. Vendosja e një detyrimi të tillë do të ishte edhe më artificiale pasi është e qartë nga nenet 33.3 dhe 43.2 të Rregullores nr. 1107/2009 se një kërkesë për autorizimin e një produkti për mbrojtjen e bimëve duhet të shoqërohet me një dosje të plotë që përfshin teste, studime dhe analiza, gjë të cilën normalisht nuk mund ta bëjnë konsumatorët dhe fermerët.

Në këtë kuptim, Tribunali dha një interpretim të gabuar duke vendosur se ripërtëritjet e autorizimeve të tregtimit për produktet për mbrojtjen e bimëve përbëjnë, në lidhje me anëtarët e GranoSalus, masa zbatuese të Rregullores së kontestuar, sipas kuptimit të nenit 263, paragrafi 4, fjalia e tretë, të TFBE-së. Për pasojë, Tribunali gaboi edhe kur arriti në përfundimin se Rregullorja e kundërshtuar nuk përbën një akt rregullator pa masa zbatuese, në kuptimin e asaj dispozite.

Megjithatë, siç analizoi Tribunali në vendimin e tij, një shoqatë përgjegjëse për mbrojtjen e interesave kolektive mund të ngrejë, në parim, një padi për anulim sipas nenit 263, paragrafi 4, të TFBE-së vetëm nëse mund të provojë se ka një interes të vetin ose nëse personat që përfaqëson ose disa prej tyre, kanë të drejtë të veprojnë në cilësinë individuale. Tribunali konstatoi në rastin konkret se GranoSalus nuk ka interes të vetin që i mundëson asaj të ngrejë padi për anulimin e rregullores së kontestuar dhe nuk ka arsye që kjo të kundërshtohet.

Për sa i përket anëtarëve të GranoSalus, përderisa Rregullorja nuk ju drejtohet atyre, e drejta e tyre për të bërë padi u nënshtrohet dy

kushteve të përmendura në paragrafin e parë të kësaj përmbledhjeje. Siç thotë Tribunali anëtarët e GranoSalus nuk preken individualisht nga rregullorja e kontestuar, dhe kjo nuk kundërshtohet. Sidoqoftë, meqenëse rezulton se Rregullorja nuk përmban masa zbatuese në lidhje me këta anëtarë, ata do të kishin të drejtë të kërkonin anulimin e asaj rregulloreje, nëse vërtetohej se ata cenoheshin drejtpërdrejt prej saj.

Sipas praktikës së Gjykatës, një person fizik ose juridik preket drejtpërdrejt nga vendimi i cili është objekt ankimi, siç parashikohet në nenin 263.4 të TFBE-së, kërkon që dy kriteret të kombinohen në mënyrë kumulative, domethënë që masa e kontestuar, nga njëra anë, të prodhojë drejtpërdrejt efekte në gjendjen juridike të individit dhe, nga ana tjetër, të mos i lërë asnjë diskrecion organeve të ngarkuara me zbatimin e saj, zbatim që bëhet automatikisht dhe rrjedh vetëm nga legjislacioni i BE-së, pa kërkuar nxjerrjen e rregullave të tjera.

Gjykata theksoi se kriteri i dytë më lart nuk përmbushet në rastin konkret. Duket qartë nga Rregullorja nr. 1107/2009 se, para miratimit të një kërkesë për autorizimin e një produkti për mbrojtjen e bimëve, shteteve anëtare u kërkohej të kryejnë një vlerësim të pavarur, objektiv dhe transparent, duke pasur parasysh, veçanërisht, verifikimin për mungesën e dëmit të produktit në fjalë, në dritën e të dhënave më të besueshme shkencore në dispozicion, si dhe rezultatet më të fundit të kërkimit ndërkombëtar. Kjo do të thotë, që miratimi paraprak nga Komisioni i substancave aktive të përfshira në produktin në fjalë përbën, në përputhje me nenin 29.1 (a) të Rregullores nr. 1107/2009, vetëm një kusht kumulativ që duhet verifikuar nga shteti anëtar që merr një kërkesë autorizimi për një produkt mbrojtës të bimëve para se ta miratojë. E njëjta gjë vlen, sipas nenit 43.1 të Rregullores, kur një Shtet anëtar ka marrë një kërkesë për vazhdimin e një autorizimi tashmë të dhënë. Ndërsa është e vërtetë, siç thekson GranoSalus, se miratimi nga Komisioni i substancës aktive glifosat nuk mund të rishikohet nga shtetet anëtare, fakti mbetet se u takon këtyre që, para se të japin ose të ripërtërijnë një autorizim, të vlerësojnë nëse plotësohen kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores. Për më tepër, shtetet anëtare janë të autorizuar në raste të caktuara, në zbatim të nenit 36.3 të Rregullores, që të vendosin masa specifike kombëtare apo edhe ta refuzojnë autorizimin e një produkti të tillë në

territorin e tyre, me qëllim përjashtimin e një rreziku të papranueshëm për shëndetin e njeriut ose mjedisin.

Duke pasur parasysh të gjithë këta elementë, autorizimi i një produkti për mbrojtjen e bimëve dhe ripërtëritja ose zgjatja e një autorizimi të tillë nuk mund të konsiderohen si një zbatim thjesht automatik i miratimit nga Komisioni, të një substance aktive të përmbajtur në këtë produkt.

Nga ana tjetër, pretendimi i GranoSalus se autoritetet italiane i kanë ripërtërirë sistematikisht autorizimet për produktet që përmbajnë glifosat, pa respektuar kërkesat e përcaktuara në Rregulloren nr. 1107/2009, edhe nëse i vërtetë, nuk rrjedh nga rregullorja e kontestuar, por, përkundrazi, është rezultat i një vendimi thjesht kombëtar dhe jo nga aktet e BE-së. Po kështu, mungesa e pretenduar, në ligjin italian, e mjeteve juridike efektive kundër akteve kombëtare që kanë ripërtërirë autorizimet e produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë substancën aktive glifosat nuk e bën padinë të pranueshme.

Në të vërtetë, është e qartë nga praktika gjyqësore e qëndrueshme e Gjykatës që i takon secilit Shtet anëtar të sigurojë një sistem të mjeteve juridike dhe procedurave për të siguruar respektimin e së drejtës themelore për mbrojtje efektive gjyqësore. Për këtë qëllim, neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian nuk kërkon që palët ndërgjyqëse të jenë në gjendje, pa kushte, të paraqesin një padi për anulim, drejtpërdrejt para gjykatave të BE-së në lidhje me aktet e BE-së. Kështu, kushtet e pranueshmërisë të parashikuara në paragrafin 4 të nenit 263 të TFBE-së duhet të interpretohen në dritën e së drejtës themelore për mbrojtje efektive gjyqësore, sidoqoftë pa çuar në lënien mënjane të kushteve të parashikuara shprehimisht nga TFBE.

Nga sa më sipër rezulton se anëtarët e GranoSalus nuk preken drejtpërdrejt nga rregullorja e kundërshtuar dhe se ankesa duhet, pra, të hidhet poshtë në tërësi.

**3.2. YASSIN ABDULLAH KADI DHE AL BARAKAAT
INTERNATIONAL FOUNDATION kundër KËSHILLIT
TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EVROPIANE**

GJDKE

Çështjet e bashkuara C-402/05 P dhe C-415/05 P

3 shtator 2008

[<https://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?num=C-402/05>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Ky vendim, me vlera themelore për rendin kushtetues të Bashkimit Evropian, thekson se ky rend, dhe të drejtat themelore që ai mbron, kërkojnë që çdo akt i një organi të BE-së t'i nënshtrohet kontrollit efektiv gjyqësor, edhe kur akti është marrë në zbatim të së drejtës ndërkombëtare.

Faktet kryesore

Më 15 tetor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi, në kuadrin e Kreut VII të Kartës së OKB-së, Rezolutën 1267 (1999), në të cilën dënoi, ndër të tjera, faktin që terroristët vazhdonin të pranohen dhe të stërviten dhe se aktet terroriste po përgatiteshin në territorin afgan, ripohoi bindjen e tij se shtypja e terrorizmit ndërkombëtar është thelbësore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe shprehu keqardhje që talebanët vazhdonin t'i jepnin strehë Osama bin Ladenit dhe Al-Qaeda, dhe t'i lejonin atë dhe bashkëpunëtorët e tij, të udhëheqin një rrjet kampesh stërvitore terroriste nga territori i mbajtur prej tyre dhe të përdorin Afganistanin si bazë për kryerjen e operacioneve terroriste ndërkombëtare.

Për t'i konkretizuar këto përpjekje, në po atë Rezolutë, Këshilli i Sigurimit parashikoi vënien e sanksioneve kundër individëve dhe subjekteve që supozohej se ishin të lidhur me Osama bin Laden, rrjetin e Al-Kaedës dhe talebanët. Këto sanksione përfshinin ngrirjen e fondeve dhe asetëve të tjera financiare të këtyre personave dhe subjekteve. Këshilli i Sigurimit krijoi Komitetin e Sanksioneve, i përbërë nga të gjithë anëtarët e KS të

OKB-së, për të mbikëqyrur zbatimin e këtyre sanksioneve. Komiteti i Sanksioneve hartonte një listë të personave dhe subjekteve të caktuara që dyshohej se mbështesnin terrorizmin dhe e përditësonte rregullisht atë.

Komiteti i Sanksioneve ishte i autorizuar të vlerësonte kërkesat për përfshirjen dhe heqjen nga lista. Shtetet dhe organizatat rajonale mund të propozonin emra për t'u përfshirë në listë duke dhënë edhe argumentet për këtë qëllim. Individët dhe subjektet e interesuara kishin të drejtë të paraqisnin një kërkesë për heqje nga lista nëpërmjet shtetit të vendbanimit ose të shtetësisë së tyre ose nëpërmjet një "pikë qendrore" në Sekretariatit e OKB-së. Komiteti i Sanksioneve merrte vendim për përfshirjen ose heqjen nga lista me konsensus.

Duke marrë parasysh se veprimi nga Komuniteti Evropian ishte i nevojshëm për të zbatuar Rezolutën 1267 (1999), Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi më 15 nëntor 1999 Qëndrimin e Përbashkët 1999/727/CFSP mbi masat kufizuese kundër talebanëve²²¹. Neni 2 i këtij Qëndrimi të përbashkët parashikon ngrirjen e fondeve dhe të burimeve të tjera financiare të mbajtura jashtë vendit nga talebanët, sipas kushteve të përcaktuara në Rezolutën në fjalë. Rezoluta e OKB-së u përditësua dhe u plotësua disa herë me radhë dhe po kështu edhe Rregullorja që u miratua në zbatimin e saj²²².

Më 17 tetor 2001 dhe 9 nëntor 2001, Komiteti i Sanksioneve të OKB-së emërtoi respektivisht z. Yasin Kadi, shtetas i Arabisë Saudite, si dhe Al Barakaat International Foundation, të themeluar në Suedi, si të lidhur me Al-Kaedën. Rrjedhimisht, Komuniteti Evropian vendosi sanksione kundër tyre, duke përfshirë ngrirjen e fondeve të tyre dhe asetëve të tjera financiare²²³.

Në dhjetor 2001, z. Kadi dhe Al Barakaat filluan procedurat përpara Tribunalit të KEE-së dhe fillimisht kërkuan anulimin e Rregullores së Këshillit (EC) nr. 467/2001 të 6 marsit 2001 dhe, më pas, ata kërkuan

221 (OJ L 294, fq. 1).

222 Fillimisht Rregullorja e Këshillit (EC) nr. 467/2001 e 6 marsit 2001, e ndryshuar më pas me Rregullore të tjera.

223 Fillimisht këto sanksione u vendosën me Rregulloren (KE) nr. 467/2001 e cila pastaj u përditësua dhe u zëvendësua me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 881/2002 të 27 majit 2002.

anulimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 881/2002 të 27 majit 2002, e cila zëvendësoi Rregulloren (KE) nr. 467/2001, që vendos masa specifike të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara të lidhura me Osama bin Laden, rrjetin e Al-Kaedës dhe Talibanët.

Parashtruesit argumentuan, së pari, se Këshillit të BE-së i mungonte kompetenca për të miratuar Rregulloret përkatëse sepse këtyre u mungonte baza ligjore në të drejtën e KE-së. Së dyti, parashtruesit pretenduan se, për aq sa Rregulloret paragjykonin drejtpërdrejt të drejtat e individëve dhe parashikonin vendosjen e sanksioneve individuale, ato nuk kishin zbatim të përgjithshëm dhe, për këtë arsye, binin ndesh me nenin 294 të Traktatit të KE-së, i cili parashikon se rregulloret e KE-së kanë zbatim të përgjithshëm. Së treti, ata pretenduan se rregullorja shkelte disa nga të drejtat e tyre themelore, përkatësisht të drejtën për respektimin e pronës, të drejtën për t'u dëgjuar para një gjykate dhe të drejtën për rishqyrtim gjyqësor efektiv.

Tribunali vendosi se nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar vlefshmërinë e Rregulloreve të kundërshtuara dhe, në mënyrë indirekte, vlefshmërinë e rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit OKB-së, përveçse në lidhje me normat *jus cogens*, për shkak se këto rregullore zbatonin një Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të miratuar sipas Kreut VII të Kartës së OKB-së. Rezoluta të tilla të Këshillit të Sigurimit të OKB-së janë detyruese për Shtetet Anëtare të KE-së dhe ato kanë përparësi mbi detyrimet e tyre sipas Traktatit të KE-së, në bazë të nenit 103 të Kartës së OKB-së. Tribunali arriti në përfundimin se masat kufizuese të parashikuara në Rregulloret e kundërshtuara nuk cenonin të drejtat themelore të mbrojtura të ankuesit. Në këtë mënyrë me vendimin e 21 shtatorit 2005, Tribunali hodhi poshtë të gjitha pretendimet e z. Kadi dhe Al Barakaat dhe konfirmoi vlefshmërinë e Rregulloreve. Parashtruesit e apeluan këtë vendim të Tribunalit para Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane.

Përmbledhja e vendimit

Gjykata nga ana e saj hodhi poshtë dy pretendimet e para të apelit si të pabazuara. Në lidhje me pretendimin e parë të apelit, Gjykata konfirmoi vendimin e Tribunalit se Këshilli i BE-së ishte kompetent për të miratuar

Rregulloret në fjalë, në bazë të neneve 60, 301 dhe 308 të Traktatit të KE-së. Për sa i përket pretendimit të dytë të apelit, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 294 të Traktatit të KE-së.

Në lidhje me pretendimin e tretë, Gjykata kujtoi se Komuniteti është një bashkësi e së drejtës në kuptimin që as shtetet e tij anëtare dhe as institucionet e tij, nuk i shpëtojnë kontrollit të përputhshmërisë së akteve të tyre me aktin themelor kushtetues që është Traktati dhe se ky i fundit ka krijuar një sistem të plotë mjetesh dhe procedurash juridike që synojnë t'i besojnë Gjykatës kontrollin e ligjshmërisë së akteve të institucioneve. Një marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të minojë rendin e kompetencave të përcaktuara nga Traktatet dhe, për këtë arsye, as autonominë e sistemit ligjor të Komunitetit, me të cilin Gjykata siguron pajtueshmërinë duke ushtruar juridiksionin ekskluziv që i është dhënë nga neni 220 i KE-së, kompetencë e cila qëndron në themelet e Komunitetit.

Për sa i përket një akti të Komunitetit, siç është Rregullorja nr. 881/2002, e cila përcakton disa masa kufizuese specifike të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara të lidhura me Osama bin Laden, rrjetin e Al-Kaidës dhe talebanët, ajo synon zbatimin e një rezolute të Këshillit të Sigurimit të miratuar sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Gjykata theksoi se nuk i takon gjykatave të Komunitetit, në kuadrin e kompetencës ekskluzive të parashikuar në nenin 220 të KE-së, të rishikojnë ligjshmërinë e një rezolute të tillë të miratuar nga ky organ ndërkombëtar, edhe nëse ky kontroll do të ishte i kufizuar në shqyrtimin e pajtueshmërisë së kësaj rezolute me *jus cogens*, por për të kontrolluar ligjshmërinë e aktit të zbatimit të Komunitetit.

Një gjykim i një gjykate të Komunitetit me të cilin vendoset që një akt i Komunitetit që synon zbatimin e një rezolute të tillë, është në kundërshtim me një standard më të lartë që është pjesë e rendit juridik të Komunitetit, nuk nënkupton vënien në dyshim të përparësisë së kësaj rezolute në nivelin e së drejtës ndërkombëtare.

Pasi rikujtoi këtë hierarki formale, Gjykata theksoi se të drejtat themelore përbëjnë një pjesë integrale të parimeve të përgjithshme të së drejtës, respektimin e të cilave e siguron Gjykata. Për këtë qëllim, Gjykata frymëzohet nga traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare,

si dhe nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar ose aderuar. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka rëndësi të veçantë në këtë drejtim. Respektimi i të drejtave të njeriut përbën një kusht për ligjshmërinë e akteve të Komunitetit dhe masat e papajtueshme me respektimin e tyre, nuk mund të pranohen në Komunitet.

Në këtë drejtim, detyrimet e vendosura nga një marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të kenë si efekt minimin e parimeve kushtetuese të Traktatit të KE-së, një prej të cilëve është parimi se të gjitha aktet e Komunitetit duhet të respektojnë të drejtat themelore. Ky respekt përbën një kusht të ligjshmërisë së tyre dhe i takon Gjykatës ta kontrollojë atë brenda kuadrit të sistemit të plotë të mjeteve juridike të vendosura nga ky Traktat.

Parimet që rregullojnë rendin juridik ndërkombëtar që rezulton nga Kombet e Bashkuara, nuk nënkuptojnë që përjashtohet një rishikim gjyqësor, në lidhje me të drejtat themelore, i ligjshmërisë së brendshme të Rregullores nr. 881/2002, që përcakton disa masa kufizuese specifike kundër personave dhe subjekteve të caktuara të lidhura me Osama bin Laden, rrjetin Al-Kaida dhe talebanët, sepse ky akt synon të zbatojë një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të miratuar sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Një imunitet i tillë juridiksional i një akti të Komunitetit, si rrjedhojë e parimit të përparësisë në nivelin e së drejtës ndërkombëtare të detyrimeve që rrjedhin nga Karta e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rezolutave të miratuara të Këshillit të Sigurimit sipas Kreut VII të kësaj Karte, nuk gjen bazë në Traktatin e KE -së. Neni 307 i KE-së në asnjë rrethanë nuk mund të lejojë që të vihen në dyshim parimet që janë pjesë e themeleve të rendit juridik të Komunitetit, përfshirë parimet e lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, të sanksionuara në nenin 6.1 të TBE-së si themele të Bashkimit Evropian. Nëse dispozita e nenit 300.7 të KE-së, që parashikon se marrëveshjet e lidhura sipas kushteve të përcaktuara në të detyrojnë institucionet e Komunitetit dhe të shteteve anëtare, do të zbatohet ndaj Kartës së Kombeve të Bashkuara, do t'i jepte kësaj të fundit epërsi mbi aktet e së drejtës dytësore të Komunitetit. Sidoqoftë, në nivelin e së drejtës së Komunitetit, kjo përparësi nuk shtrihet edhe ndaj së drejtës parësore

dhe, në veçanti, ndaj parimeve të përgjithshme në të cilat bëjnë pjesë të drejtat themelore.

Prandaj, gjykatat e Komunitetit duhet që, në përputhje me kompetencat që u janë dhënë në sajë të Traktatit të KE-së, të sigurojnë kontroll, në parim të plotë, të ligjshmërisë së të gjitha akteve të Komunitetit në raport me të drejtat themelore, përfshirë aktet e Komunitetit të cilat, siç janë rregulloret në fjalë, synojnë zbatimin e rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Kompetencat e Komunitetit duhet të ushtrohen në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe një akt i miratuar në bazë të këtyre kompetencave duhet të interpretohet dhe fushëveprimi i tij të kufizohet, në dritën e rregullave përkatëse të së drejtës ndërkombëtare.

Për sa i përket të drejtave të mbrojtjes, dhe veçanërisht të drejtës për t'u dëgjuar, në lidhje me masat kufizuese të tilla si ato të vendosura nga Rregullorja nr. 881/2002, duke imponuar disa masa kufizuese specifike kundër personave dhe subjekteve të caktuara të lidhura me Osama bin Laden, Rrjetin Al-Kaida dhe talebanët, autoriteteve të komunitetit nuk u kërkohet të komunikojnë, para përfshirjes fillestare të një personi ose subjekti në listën e personave ose subjekteve të synuara nga këto masa, arsyet mbi të cilat bazohet kjo përfshirje. Në të vërtetë, një komunikim i tillë paraprak mund të rrezikojë efektivitetin e masave për ngrirjen e fondeve dhe burimeve ekonomike të vendosura nga kjo Rregullore. Për arsye që lidhen gjithashtu me objektivin e ndjekur nga ajo Rregullore dhe me efektivitetin e masave të parashikuara në të, autoriteteve të Komunitetit gjithashtu nuk u kërkohet të dëgjonin parashtruesit para përfshirjes fillestare të emrave të tyre në listën në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje. Përveç kësaj, në rastin e një akti të Komunitetit që synon zbatimin e një Rezolutive të miratuar nga Këshilli i Sigurimit në kontekstin e luftës kundër terrorizmit, konsideratat e rëndësishme në lidhje me sigurinë ose zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Komunitetit dhe të shteteve të tij anëtare mund të kundërshtojnë komunikimin e elementeve të caktuara palëve të interesuara dhe, për këtë arsye, dëgjimin e tyre lidhur me ato elemente.

Sidoqoftë, të drejtat e mbrojtjes, veçanërisht e drejta për t'u dëgjuar, nuk respektohen qartë pasi as Rregullorja në fjalë dhe as qëndrimi i

përbashkët 2002/402, në lidhje me masat kufizuese kundër Osama bin Ladenit, anëtarëve të rrjetit Al-Kaida si dhe talebanëve dhe personave, grupeve, kompanive dhe subjekteve të tjera të lidhura me ta, nuk parashikojnë një procedurë për komunikimin e elementeve që justifikojnë përfshirjen e emrave të personave të interesuar në Shtojcën I të asaj Rregulloreje dhe dëgjimin e tyre, kurdo që janë shënuar në këtë listë. Më pas, Këshilli nuk u komunikoi parashtruesve provat që dispononte kundër tyre për të justifikuar masat kufizuese ose t'ju jepte atyre të drejtën për t'u njohur me elementet e përmendura, brenda një kohe të arsyeshme pas nxjerrjes së masave të tilla.

Parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore përbën një parim të përgjithshëm të së drejtës së Komunitetit, i cili rrjedh nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare dhe i cili është mishëruar në nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky parim për më tepër ishte riafirmuar në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Pajtueshmëria me detyrimin për të komunikuar bazat mbi të cilat është bërë përfshirja e emrit të një personi ose subjekti në listën që përbën Shtojcën I të Rregullores 881/2002, duke vendosur disa masa kufizuese specifike kundër personave dhe subjekteve të lidhura me Osama bin Laden, me rrjetin Al-Kaida dhe talebanët, është e nevojshme si për të lejuar personat e prekur nga këto masa kufizuese për të mbrojtur të drejtat e tyre në kushtet më të mira të mundshme, ashtu edhe për t'i vënë ata në dijeni të plotë të fakteve, nëse është e dobishme t'i drejtohen me padi gjykatave të Komunitetit për t'i vënë këto të fundit plotësisht në gjendje të ushtrojnë kontroll mbi ligjshmërinë e aktit në fjalë të Komunitetit.

Kështu, nëse personat ose subjektet në fjalë nuk informohen për faktet për të cilat akuzohen, duke pasur parasysh marrëdhënien midis të drejtave të mbrojtjes dhe të drejtës për një mjet juridik efektiv, ata nuk mund të mbrojnë as të drejtat e tyre dhe as të ofrojnë ato elemente të nevojshme para Gjykatave të Komunitetit që këto të fundit të jenë në gjendje të ushtrojnë një rishikim të ligjshmërisë së asaj rregulloreje, për aq sa ka të bëjë me këta persona ose subjekte. Në këtë mënyrë krijohet një shkelje e së drejtës në fjalë për një mjet juridik efektiv.

Në lidhje me një objektiv me interes të përgjithshëm, themelor për bashkësinë ndërkombëtare, si lufta me të gjitha mjetet, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, kundër kërcënimeve ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare që sjellin aktet terroriste, ngrirja e fondeve, e aseteve financiare dhe e burimeve të tjera ekonomike të personave të identifikuar nga Këshilli i Sigurimit ose nga Komiteti i Sanksioneve, si të lidhur me Osama bin Ladenin, me rrjetin Al-Kaida dhe me talebanët, në vetvete, nuk mund të konsiderohet si e papërshtatshme ose joproporcionale. Në këtë drejtim, masat kufizuese të vendosura nga Rregullorja nr. 881/2002, që vendosin masa të veçanta kufizuese të drejtuara kundër këtyre personave dhe subjekteve, përbëjnë kufizime në të drejtën e pronës të cilat, në parim, mund të justifikohen.

Megjithatë, procedurat e zbatueshme duhet t'i japin personit ose subjektit të interesuar një mundësi të përshtatshme për të paraqitur rastin e tyre tek autoritetet kompetente, siç kërkohet nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kështu, vendosja e masave kufizuese nga ajo Rregullore në lidhje me një person ose subjekt, për shkak të përfshirjes së këtij të fundit në listën e Shtojcës I të saj, përbën një kufizim të pajustificuar të së drejtës së tij për pronën, pasi kjo rregullore është miratuar pa ofruar asnjë garanci që i lejon atij personi ose subjekti të paraqesë çështjen e tij tek autoritetet kompetente, dhe kjo në një situatë në të cilën kufizimi i të drejtave të tij pronësore, duhet të kualifikohet si i konsiderueshëm, duke pasur parasysh fushëveprimin e përgjithshëm dhe kohëzgjatjen efektive të kufizimit masave të cilave i nënshtrohet.

Megjithëse një rregullore si ajo nr. 881/2002, që vendos masa të caktuara kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara të lidhura me Osama bin Laden, rrjetin e Al-Kaidës dhe talebanët, duhet të anulohet, për aq sa ka të bëjë me parashtruesit, për shkak të shkeljes së parimeve të zbatueshme gjatë procedurës së ndjekur në miratimin e masave kufizuese të vendosura nga ajo rregullore, nuk mund të përjashtohet që, në themel, vendosja e masave të tilla ndaj parashtruesve mund të jetë e justifikuar.

Anulimi i kësaj rregulloreje me efekt të menjëhershëm do të mund të dëmtonte seriozisht dhe në mënyrë të pakthyeshme efektivitetin e masave kufizuese të vendosura nga ajo Rregullore dhe të cilat Komuniteti duhet t'i zbatojë, pasi, ndërkohë, para zëvendësimit të mundshëm të saj me një rregullore të re, parashtruesit mund të marrin masa për të parandaluar zbatimin ndaj tyre të masave të ngrirjes së fondeve. Në ato rrethana, neni 231 i KE-së zbatohet në mënyrë korrekte duke ruajtur efektet e asaj rregulloreje, për sa u përket parashtruesve, për një periudhë që nuk i kalon tre muaj nga data e shpalljes së këtij vendimi.



Neni 55

Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*
- 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*
- 3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*
- 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*
- 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS ²²⁴

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. *MERABISHVILI kundër GJEORGJISË*

[72508/13]

GJEDNJ [Dhoma e Madhe]

28 nëntor 2017

Çështja kyçele drejta e pretenduar: zgjatja e paraburgimit të liderit të opozitës me qëllim parësor marrjen e informacionit për çështje që nuk kanë lidhje me veprën e dyshuar; paraburgimi nuk ishte në përputhje me parimin e sigurisë juridike për një sërë arsyesh.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Ivane Merabishvili (kërkuesi), një shtetas gjeorgjian, kundër Gjeorgjisë, paraqitur në Gjykatë më 20 nëntor 2013. Në kohën përkatëse kërkuesi, një ish-kryeministër, ishte lider i partisë kryesore opozitare United National Movement (UNM). Ndërmjet viteve 2012 dhe 2013, menjëherë pasi Lëvizja “Ëndrra Gjeorgjiane” (“Georgian Dream”) u zgjodh në pushtet në tetor 2012, kundër kërkuesit u ngritën procedura penale për shpërdorim detyre dhe vepra të tjera. Kërkuesi, i cili ishte mbajtur në paraburgim në pritje të gjykimit të tij, u ankua se ishte larguar kështu nga skena politike. Ai gjithashtu pretendoi se një natë në dhjetor 2013 ai ishte marrë fshehurazi nga qelia për t’u marrë në pyetje nga Kryeprokurori për vdekjen e një ish-kryeministri në vitin 2005 dhe për aktivitetet financiare të ish-presidentit. Në vitin 2014 ai u shpall fajtor për shumicën e akuzave të ngritura kundër tij.

²²⁴ Në lidhje me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] shih rastet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të paraqitura më lart; KO54/20 (Aktgjykim me shkelje) dhe KO131/12 (Aktgjykim me shkelje).

Kërkuesi ishte ankuar në Gjykatë, ku në një vendim të 14 qershorit 2016, një dhomë e Gjykatës u shpreh në veçanti se kishte pasur shkelje të nenit 18 në lidhje me nenin 5.1, me arsyetimin se paraburgimi ishte përdorur jo vetëm me qëllim sjelljen e kërkuesit para autoritetit ligjor kompetent për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ai kishte kryer vepra penale, por edhe për të ushtruar presion ndaj tij në lidhje me një hetim që nuk kishte lidhje me veprat për të cilat ai ishte akuzuar.

Më pas rasti u transferua në Dhomën e Madhe të Gjykatës më 17 tetor 2016.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesi u ankua se paraburgimit të tij i mungonte baza ligjore, për shkak të një sërë mangësish në ligjin dhe praktikën përkatëse vendore, në kundërshtim me nenin 5.1 të Konventës. Ai u ankua se paraburgimi i tij nuk ishte në përputhje me parimin e sigurisë juridike për një sërë arsyesh. Së pari, urdhri fillestar i paraburgimit, i 22 majit 2013, as nuk tregoi drejtpërdrejt se ai ishte paraburgosur për periudhën maksimale të lejuar ligjore prej nëntë muajsh dhe as nuk i referohej specifikisht paragrafit 2 të nenit 205 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Për rrjedhojë, ai theksoi se e kishte të vështirë të lexonte nga vendimi i kundërshtuar i gjykatës se sa duhet të ishte saktësisht kohëzgjatja e paraburgimit të tij. Edhe duke supozuar se Gjykata e Qytetit Kutaisi kishte autorizuar me të vërtetë paraburgimin e tij për periudhën ligjore prej nëntë muajsh, në përputhje me praktikën gjyqësore mbizotëruese, zbatimi i verbër i kësaj praktike të përgjithshme ishte i pajustificuar dhe joproportional në rastin e tij, pasi aty kishin ekzistuar rrethana të veçanta faktike të cilat duhet të ishin marrë parasysh nga gjykata vendase. Kërkuesi pretendoi se gjykatat e brendshme e kishin vendosur atë në një situatë ku ai ishte lënë në paraburgim për një “kohë të pakufizuar ose të paparashikueshme” (një referencë iu bë rastit *Baranowski kundër Polonisë*, nr. 28358/95, paragrafi 56, ECHR 2000-III), ose një “periudhë e pacaktuar kohore” (një referencë iu bë rastit *Tymoshenko kundër Ukrainës*, nr. 49872/11, paragrafi 267, 30 prill 2013). Kështu, duke mos dhënë arsye të mjaftueshme dhe afate specifike për paraburgimin e tij, gjykatat e brendshme e vendosën kërkuesin në një gjendje pasigurie për arsyet e paraburgimit të tij, në kundërshtim me nenin 5.1 të Konventës

(një referencë e mëtejshme iu bë rastit *Kharchenko kundër Ukrainës*, nr. 40107/02, paragrafi 75, 10 shkurt 2011).

Kërkuesi u ankua sipas nenit 5.3 të Konventës se vendimet gjyqësore në lidhje me paraburgimin e tij nuk kishin baza të arsyeshme. Ai pohoi se vendimet fillestare të gjykatës të 22 dhe 25 majit 2013 nuk kishin pasur arsye të mjaftueshme për caktimin e paraburgimit. Ai argumentoi se argumentet e zgjeruara të Qeverisë para Gjykatës, nuk pasqyronin saktë arsyetimin shumë të mangët që, në fakt, ishte dhënë në ato vendime. Për sa i përket vendimit të gjykatës të 25 shtatorit 2013, të cilin kërkuesi sërish e cilësoi si zgjatje të një periudhe fillestare të paraburgimit të tij, ai u ankua se vendimi nuk i ishte dorëzuar me shkrim dhe i arsyetuar.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht Gjykata, Dhoma e Madhe, vendosi njëzëri se nuk kishte pasur shkelje të nenit 5.1 në lidhje me arrestimin dhe paraburgimin e kërkuesit, ose të nenit 5.3 në lidhje me vendimet e para gjyqësore që urdhëronin vendosjen e tij në paraburgim, por se kishte pasur shkelje të nenit 5.3, sepse më pas kishte pasur arsye të pamjaftueshme për të justifikuar mbajtjen e tij në paraburgim. Neni 18, marrë së bashku me nenin 5.1: Gjykata e konsideroi të nevojshme të sqaronte praktikën e saj gjyqësore si më poshtë.

(a) Pikat paraprake – lidhja midis nenit 18 dhe klauzolave të tjera të Konventës – Konsistenca justifikon përafrimin e përdorimit të termave “i pavarur” dhe “autonom” në lidhje me nenin 18, me praktikën e ndjekur në lidhje me nenin 14.

Ashtu si neni 14, edhe neni 18 i Konventës nuk ka një ekzistencë të pavarur; ai mund të zbatohet vetëm në lidhje me një nen të Konventës ose me Protokollet e saj, të cilat përcaktojnë ose cilësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara nga ajo. Ky rregull rrjedh si nga formulimi i nenit 18, i cili plotëson atë të klauzolave të tilla si, për shembull, fjalinë e dytë të nenit 5.1 dhe paragrafët e dytë të neneve 8 deri në 11, ashtu edhe nga vendi i tij në Konventë, në fund të seksionit I, i cili përmban nenet që përcaktojnë dhe kualifikojnë ato të drejta dhe liri. Megjithatë, neni 18 nuk shërben thjesht për të sqaruar qëllimin e këtyre klauzolave kufizuese. Ai

gjithashtu ndalon shprehimisht Palët e Larta Kontraktuese të kufizojnë të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë për qëllime që nuk parashikohen nga vetë Konventa, dhe në këtë masë ai është autonom. Prandaj, siç ishte edhe qëndrimi në lidhje me nenin 14, mund të ketë shkelje të nenit 18 edhe nëse nuk ka shkelje të nenit në lidhje me të cilin ai zbatohet. Më tej, nga kushtet e nenit 18 rrjedh se një shkelje mund të lindë vetëm nëse e drejta ose liria në fjalë i nënshtrohet kufizimeve të lejuara sipas Konventës. Megjithatë, fakti i thjeshtë që një kufizim i një të drejte ose lirie të Konventës nuk plotëson të gjitha kërkesat e klauzolës që e lejonte atë, nuk ngre domosdoshmërisht një çështje sipas nenit 18. Shqyrtimi i veçantë i një ankese sipas atij neni justifikohet vetëm nëse pretendimi se një kufizim është aplikuar për një qëllim që nuk parashikohet nga Konventa, duket të jetë një aspekt themelor i çështjes.

(b) Aty ku ka shumë qëllime – Kur një kufizim ndjek një sërë qëllimesh, ai mund të jetë i pajtueshëm me dispozitën thelbësore të Konventës që e autorizon, sepse ndjek një qëllim të lejueshëm sipas asaj dispozite, por gjithsesi shkel nenin 18 sepse është kryesisht i destinuar për një qëllim tjetër që nuk parashikohet nga Konventa – me fjalë të tjera, nëse ai qëllim tjetër është mbizotërues. Në të kundërtën, nëse qëllimi i parashikuar është qëllimi kryesor, kufizimi nuk bie ndesh me nenin 18 edhe nëse ai ndjek edhe një qëllim tjetër. Ky interpretim është në përputhje me praktikën gjyqësore të gjykatave kombëtare të shteteve kontraktuese dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, të cilën Gjykata mund ta marrë parasysh kur interpreton Konventën, veçanërisht e përshtatshme në këtë rast, meqenëse punimet përgatitore të Konventës tregojnë qartë se neni 18 duhej të ishte versioni i Konventës i nocionit administrativo-ligjor të “keqpërdorimit të pushtetit”. Se cili qëllim është mbizotërues në një rast të caktuar varet nga të gjitha rrethanat, veçanërisht nga natyra dhe shkalla e dënueshmërisë së qëllimit të fshehtë të supozuar. Në situatat e vazhdueshme, nuk mund të përjashtohet që vlerësimi se cili qëllim ka qenë mbizotërues, mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Gjithashtu duhet mbajtur parasysh se Konventa ishte krijuar për të ruajtur dhe promovuar idealet dhe vlerat e një shoqërie demokratike të qeverisur nga shteti i së drejtës.

(c) Çështjet në lidhje me provat – Për të përcaktuar nëse ka pasur apo jo një qëllim të mëparshëm dhe nëse ai ka qenë mbizotëruesi,

Gjykata mund dhe duhet t'i përmbahet qasjes së saj të zakonshme ndaj provës në vend që të ndjekë ndonjë rregull të veçantë: (i) si rregull i përgjithshëm, barra e provës nuk bartet nga njëra apo tjetra palë dhe Gjykata mund të marrë parasysh vështirësitë e provave me të cilat përballen kërkuesit dhe, anasjelltas, të nxjerrë përfundime kur qeveria e paditur përmbahet ose refuzon të zbulojë informacionin pa ofruar një shpjegim të kënaqshëm; (ii) standardi i provës është "përtej dyshimit të arsyeshëm"; dhe (iii) Gjykata është e lirë të vlerësojë jo vetëm pranueshmërinë dhe rëndësinë, por edhe vlerën provuese të secilës provë përpara saj. Prandaj, nuk ka asnjë arsye që Gjykata të kufizohet në prova të drejtpërdrejta në lidhje me ankesat sipas nenit 18 të Konventës ose të zbatojë një standard të veçantë provash.

Sipas parashtruesit, autoritetet në rastin në fjalë kishin përdorur paraburgimin për dy qëllime të fshehta. Gjykata shqyrtoi secilin me radhë për të përcaktuar nëse njëri nga dy qëllimet kishte qenë mbizotërues.

(i) Qëllimi i largimit të kërkuesit nga skena politike – Nuk ka një të drejtë, si të tillë, sipas Konventës, për të mos u ndjekur penalisht. Prandaj, Gjykata ishte kryesisht e shqetësuar për qëllimin e paraburgimit. Gjykata nuk mori në konsideratë prova të mjaftueshme në lidhje me këtë: fakti që ishin iniciuar ndjekje penale kundër një numri ish-ministrash dhe zyrtarësh të tjerë të lartë të UNM-së (anëtarët e një qeverie të mëparshme nuk mund të mbaheshin përgjegjës gjatë kohës sa ishin në pushtet; më e rëndësishmja, nuk kishte prova që gjykatave që kishin vendosur për paraburgimin u kishte munguar pavarësia); vendi i procedurës, dhe, përputhshmëria e saj me ligjin e brendshëm nuk ishte kontestuar; mangësitë në vendime nga pikëpamja e nenit 5.3; fakti që gjykatat e shteteve të tjera anëtare kishin refuzuar kërkesat për ekstradimin e ish-zyrtarëve të tjerë nga MNU me arsyetimin se ndjekjet penale kundër tyre kishin qenë të motivuara politikisht (së pari, faktet e çështjeve nuk kishin qenë identike; së dyti, ato gjykata kishin vlerësuar një rrezik të ardhshëm, ndërsa Gjykata ishte e shqetësuar me faktet e së kaluarës, të cilat ndikuan në vlerësimin e tyre përkatës të provave kontekstuale jobindëse). Të njëjtat konsiderata vlejné edhe për vendimet e Interpolit në lidhje me ish-Presidentin.

(ii) Qëllimi për të ushtruar presion ndaj kërkuesit për qëllime të marrjes së informacionit që nuk lidhet me arsyet e paraburgimit

(α) Prova e këtij qëllimi: Gjykata ishte e ndjeshme ndaj rolit të saj ndihmës dhe pranoi se ajo duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të një hetuesi të fakteve; megjithatë mund të marrë parasysh cilësinë e hetimeve të brendshme dhe çdo defekt të mundshëm në procesin e vendimmarrjes.

Gjykata theksoi se disa pjesë të rrëfimit të kërkuesi – i cili ishte i detajuar, specifik, mbeti i qëndrueshëm gjatë gjithë kohës dhe u vërtetua nga disa prova të tërthorta – rrjedhimisht mundësuan verifikimin e pretendimeve të tij me mjete objektive (paradë identiteti, kontrollim i të dhënave telefonike dhe i të dhënave të kullës celulare, videoregjistrime) ose me marrjen e deklaratave të dëshmitarëve nga palët e treta. Megjithatë, ato veprime nuk ishin hulumtuar.

Në lidhje me provat e paraqitura nga Qeveria Gjykata vërejti se provat nuk ishin mjaftueshëm bindëse:

– në përgjithësi, gjetjet e marra pas dy hetimeve që ishin kryer duheshin trajtuar me kujdes: i pari ishte kryer nga zyrtarë të Ministrisë së Burgjeve në sfondin e mohimeve të prera nga ministri i tyre; i dyti ishte hapur vetëm pas vendimit të Dhomës në këtë rast;

– Pas një ekzaminimi konkret, disa elemente vënë në dyshim pohimin se pamjet nga kamerat e vëzhgimit ishin fshirë automatikisht pas njëzet e katër orësh; metoda e saktë e përdorur për të ekzaminuar pamjet e tjera (të cilat nuk i ishin vënë në dispozicion avokatit të parashtruesit); deklaratat e ndryshme të prodhuara në prova (që burojnë ose nga vartësit e autorëve të supozuar ose nga persona, sjellja e të cilëve mund të jetë vënë në pikëpyetje); vlera provuese e të dhënave të marra nga sistemi i administrimit të dokumenteve të organeve të akuzës gjatë natës së ngjarjes;

– Mungesa e shënimeve në regjistrat e burgut që vërtetonin largimin e kërkuesit nga qelia ishte në përputhje me natyrën e fshehtë të operacionit të supozuar.

Duke nxjerrë konkluzione nga ai material dhe sjellja e autoriteteve, Gjykata u bind se kërkuesi ishte marrë fshehurazi nga qelia e tij e burgut.

Mbizotërimi i këtij qëllimi: Nëse kufizimi i së drejtës për liri të kërkuesi shihej kështu si tërësi, ishte e vështirë të konkludohej se marrja e informacionit për vdekjen e ish-kryeministrit ose për llogaritë bankare të ish-presidentit, kishte qenë qëllimi kryesor i masës. Nuk kishte asnjë provë se paraburgimi i kërkuesit ishte përdorur për këtë qëllim për shtatë muajt e parë. Megjithatë, në rastin konkret, kufizimi në fjalë përbënte një situatë të vazhdueshme. Faktorët e mëposhtëm e çuan Gjykatën në përfundimin se qëllimi fillestar ishte zëvendësuar nga një tjetër: ndërsa në fillim kishte qenë hetimi i veprave të bazuara në një dyshim të arsyeshëm, më vonë ishte bërë marrja e informacionit në lidhje me vdekjen e një ish-kryeministri dhe për llogaritë bankare të Presidentit.

Disa nga këta faktorë që lidhen me kohën e incidentit: arsyet për mbajtjen e kërkuesit në paraburgim dukej se ishin zvogëluar; ish-Presidenti, i cili ishte bërë objektiv i disa hetimeve penale, sapo ishte larguar nga Gjeorgjia pas përfundimit të mandatit të tij; hetimi për vdekjen e ish-kryeministrit me sa duket nuk kishte bërë përparim të rëndësishëm. Faktorë të tjerë treguan rëndësinë e konsiderueshme të pyetjeve në lidhje me këta dy burra për autoritetet. Kështu, Qeveria kishte deklaruar në seancën dëgjimore përpara Dhomës së Madhe se kishte ende një “pyetje të madhe” që kërkuesi duhej t’i përgjigjej në këtë pikë. Autoritetet e ndjekjes kishin pasur kompetencën për të hequr të gjitha akuzat kundër kërkuesit në çdo moment pa kontroll gjyqësor dhe kishin premtuar se do ta bënin këtë nëse ai jepte informacionin e kërkuar, kështu që gjykatave do t’u duhej të pushonin procedurën penale kundër tij. Kërkuesi ishte marrë në mënyrë të fshehtë dhe, siç duket, në mënyrë të parregullt, në një operacion klandestin të kryer në mes të natës, për t’u takuar me një individ që ishte emëruar në detyrën e tij tre javë më parë. Reagimi fillestar i autoriteteve në këtë drejtim kishte qenë bërja e mohimeve të prera dhe hetimi që pasoi ishte dëmtuar nga një sërë lëshimesh nga të cilat mund të konkludohej se autoritetet kishin vepruar ashtu që çështja të mos dilte në dritë: protagonistët kryesorë nuk ishin intervistuar gjatë hetimit fillestar, por vetëm gati tre vjet pas ngjarjeve, dhe provat vendimtare në këtë rast – pamjet nga kamerat e vëzhgimit të burgut – nuk ishin gjetur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht e hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme në lidhje me një pjesë të ankesës sipas nenit 5.3 të Konventës; hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë për mosrespektimin e afatit gjashtëmuor në lidhje me një pjesë të ankesës sipas nenit 18 të Konventës; konstatoi, se nuk ka pasur shkelje të nenit 5.1 të Konventës në lidhje me arrestimin e kërkuesit; se nuk ka pasur shkelje të nenit 5.1 të Konventës në lidhje me paraburgimin e kërkuesit; se nuk ka pasur shkelje të nenit 5.3 të Konventës në lidhje me vendosjen fillestare të kërkuesit në paraburgim; konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 5.3 të Konventës në atë që, të paktën nga data 25 shtator 2013 e në vazhdim, paraburgimi i kërkuesit pushoi së qeni i bazuar mjaftueshëm; konstatoi, se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankimi sipas nenit 5.4 të Konventës; konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 18 të Konventës në lidhje me nenin 5.1.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. STEFANO MELLONI kundër MINISTERIO FISCAL

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështja C399/11

26 shkurt 2013

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=134203&pageIndex=0&doclang=FR&mode=lst&dir=&occ=-first&part=1&cid=13717744>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: Në këtë vendim shumë të rëndësishëm, Gjykata thekson se mbrojtja e të drejtave themelore sipas kushtetutave të shteteve anëtare nuk mund të cenohet parimet themelore të së drejtës së BE-së dhe efektivitetin e saj.

Faktet kryesore

Z. Melloni është një biznesmen italian, i cili ndiqej penalisht për mashtrim nga autoritetet italiane. Më 13 maj dhe 15 qershor 1993, Tribunale di Ferrara²²⁵ në Itali lëshoi urdhrat e arrestit nr. 554/1993 dhe 444/1993. Meqenëse z. Melloni fshihej në Spanjë, në vitin 1996 autoritetet italiane kërkuan nga autoritetet spanjolle ekstradimin e tij. Ai u arrestua në Spanjë, por u lirua pas një garancie prej 5.000.000 pesetash spanjolle, shumë që e pagoi më 30 prill 1996 dhe u arratis, për të mos iu dorëzuar autoriteteve italiane, duke qenë në dijeni të akuzave kundër tij. Me urdhër të 1 tetorit 1996, Seksioni i Parë i Dhomës Penale të Audiencia Nacional²²⁶ vendosi për ekstradimin në Itali të z. Stefano Melloni, me qëllim që ky të gjykohej për faktet e referuara.

Me një vendim të 27 marsit 1997, Tribunale di Ferrara vuri në dukje se z. Melloni nuk ishte paraqitur dhe vendosi që njoftimet për procedurat në ngarkim të tij, që nga ai moment e tutje, t'u dërgoheshin avokatëve që ishin emëruar prej tij për ta përfaqësuar. Me një vendim të Tribunale di Ferrara të 21 qershorit 2000, i cili më pas u konfirmua nga një vendim i Corte d'Appello di Bologna²²⁷, i 14 marsit 2003, z. Melloni u dënua në mungesë me dhjetë vjet burgim për falimentim mashtrues. Me një vendim të 7 qershorit 2004, Dhoma e Pestë Penale e Corte Suprema di Cassazione²²⁸, hodhi poshtë rekursin e bërë nga avokatët e z. Melloni. Më 8 qershor 2004, Prokurori Publik i Corte d'Appello di Bologna lëshoi Urdhër-arrestin Evropian nr. 271/2004 për ekzekutimin e dënimit të dhënë nga Tribunale di Ferrara.

Më 1 gusht 2008 z. Melloni u arrestua nga policia spanjolle në bazë të këtij Urdhër-arresti Evropian. Pas këtij arresti, Juzgado Central de Instrucción nr. 6²²⁹, me një urdhër të 2 gushtit 2008, vendosi t'i drejtohej Seksionit të Parë të Dhomës Penale të Audiencia Nacional në lidhje me ekzekutimin e këtij Urdhër-arrestit Evropian.

225 Gjykata e Shkallës së Parë në Ferrara, Itali.

226 Gjykatë me juridiksion në lidhje me çështjet me interes mbarëkombëtar në Spanjë.

227 Gjykata e Apelit në Bolonja, Itali.

228 Gjykata e Lartë e Kasacionit në Itali.

229 Tribunali Qendror i Hetimeve Paraprake në Spanjë.

Z. Melloni kundërshtoi dorëzimin e tij tek autoritetet italiane, duke argumentuar, së pari, se gjatë procesit të apelit, ai kishte caktuar një avokat tjetër nga dy avokatët e mëparshëm dhe kishte shfuqizuar prokurën e dhënë këtyre të fundit dhe se, pavarësisht nga kjo, autoritetet kishin vazhduar dërgimin e njoftimeve dy avokatëve të parë. Së dyti, ai pohoi se ligji procedural italian nuk parashikon mundësinë e apelit kundër dënimeve të dhëna në mungesë dhe se ekzekutimi i urdhër-arrestit evropian duhet, sipas rastit, të bëhet me kushtin që Republika Italiane të garantojë mundësinë e një apeli ndaj vendimit që e dënon personin e gjykuar në mungesë.

Me një urdhër të 12 shtatorit 2008, Seksioni i Parë i Dhomës Penale të Audiencia Nacional vendosi t'ua dorëzonte z. Melloni autoriteteve italiane për ekzekutimin e dënimit të vendosur ndaj tij nga Tribunale di Ferrara, si autor i një falimentimi mashtrues, duke pasur parasysh, nga njëra anë, se nuk ishte vërtetuar se avokatët që ai kishte caktuar nuk e përfaqësonin më pas vitit 2001 dhe, nga ana tjetër, se të drejtat e mbrojtjes ishin respektuar, pasi ai kishte qenë i informuar paraprakisht për zhvillimin e procesit, se kishte vendosur vetë të mos paraqitej dhe kishte caktuar dy avokatë për ta përfaqësuar dhe mbrojtur, të cilët ndërhyjnë në këtë cilësi në shkallë të parë, në apel dhe në kasacion, duke shteruar të gjitha mjetet e ankimit.

Z. Melloni bëri një '*recurso de amparo*'²³⁰ para Tribunalit Kushtetues kundër këtij urdhri. Në mbështetje të kërkesës së tij, ai pretendoi shkelje indirekte të kërkesave absolute që rrjedhin nga e drejta për një gjykim të drejtë, e parashikuar në nenin 24, paragrafi 2, të Kushtetutës spanjolle. Sipas tij, shkelja konsistonte në vetë thelbin e një gjykimi të drejtë në mënyrë të tillë që cenon dinjitetin njerëzor, për shkak të pranimi të ekstradimit në shtetet të cilat, në rast të veprave të rënda penale, njohin vlefshmërinë juridike të dënimeve të dhëna në mungesë, pa e kushtëzuar dorëzimin e të dënuarit me mundësinë e tij për t'i kundërshtuar këto dënime, në mënyrë që të gëzojë të drejtat e mbrojtjes.

230 Kërkesë për kontroll kushtetutshmërie.

Më 18 shtator 2008, një seksion i Tribunalit Kushtetues të Spanjës e pranoi *'recurso de amparo'* duke vendosur të pezullojë ekzekutimin e urdhrit të 12 shtatorit 2008 dhe, më 1 mars 2011, Asambleja Plenare e Tribunalit Kushtetues vendosi ta shqyrtonte vetë këtë ankesë. Është ky Tribunal që i drejtohet GJDBE-së me një kërkesë paragjykimore në këtë çështje. Tribunali Kushtetues kujtoi se në vendimin e tij 91/2000 të 30 marsit 2000, ai ishte shprehur se përmbajtja detyruese e të drejtave themelore është më e kufizuar kur ato konsiderohen *ad extra*, pra vetëm kriteret më themelore dhe më elementare, mund t'i referohen nenit 24 të Kushtetutës spanjolle për të çuar në konstatimin e një antikushtetutshmërie indirekte. Megjithatë, sipas këtij Tribunali, vendimi i gjykatave spanjolle për pranimin e ekstradimit përbën një shkelje "indirekte" të kërkesave të së drejtës për një proces të drejtë, duke cenuar përmbajtjen thelbësore të një gjykimi të drejtë në një mënyrë që cenon dinjitetin njerëzor, përderisa ai autorizon ekstradimin drejt shteteve të cilat, në rast të një veprë penale shumë të rëndë, njohin vlerën juridike të dënimeve në mungesë, pa iu nënshtruar dorëzimi i personit të dënuar kushtit që ai të mund t'i kundërshtojë këto dënime për të gëzuar të drejtat e mbrojtjes.

Tribunali rikujtoi se ajo praktikë gjyqësore kombëtare është gjithashtu e zbatueshme në kontekstin e procedurës së dorëzimit të përcaktuar me Vendimin-Kuadër 2002/584²³¹, për dy arsye. E para është se kushti i vendosur për dorëzimin e një personi të dënuar është pjesë e natyrshme e përmbajtjes thelbësore të së drejtës kushtetuese për një gjykim të drejtë. Së dyti neni 5 paragrafi 1 i atij Vendimi-Kuadër, në formulimin në fuqi në periudhën përkatëse, parashikonte mundësinë që ekzekutimi i një urdhërarresti evropian të lëshuar për ekzekutimin e një dënimi të dhënë në mungesë t'i nënshtrohet "nga ligji i shtetit anëtar zbatues", sidomos kushtit që "autoriteti gjyqësor që e lëshon të japë garanci që konsiderohen të mjaftueshme për t'i garantuar personit që kërkohet me Urdhër-arrestit Evropian se ai do të jetë në gjendje të kërkojë rihapjen e procedurës, e cila garanton të drejtat e tij të mbrojtjes në shtetin anëtar lëshues dhe të gjykohet në praninë e tij"²³².

231 Vendimi-Kuadër 2002/584/JAI i Këshillit, i 13 qershorit 2002, në lidhje me Urdhër-arrestin Evropian dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare (JO L 190, p. 1), siç është modifikuar nga Vendimi-Kuadër 2009/299/JAI i Këshillit, i 26 shkurtit 2009 (JO L 81, p. 24).

232 Vendimi i Tribunalit Kushtetues 177/2006, i 5 qershorit 2006.

Sipas Tribunalit Kushtetues, vështirësia lind nga fakti se Vendimi-Kuadër 2009/299 ka fshirë nenin 5 paragrafi 1 të Vendimit-Kuadër 2002/584 dhe ka parashikuar nenin 4 bis. Ky nen 4 bis, nuk lejon “refuzimin e ekzekutimit të Urdhërarrestit Evropian të lëshuar për ekzekutimin e një dënimi ose një mase sigurie që përfshin heqjen e lirisë, nëse personi në fjalë nuk është paraqitur në procesin që ka çuar në marrjen e vendimit”, kur personi i interesuar, pasi është informuar për procesin e planifikuar, ka autorizuar mbrojtësin e tij ligjor, të caktuar nga vetë personi i interesuar ose nga shteti për ta mbrojtur atë në gjyq, dhe është mbrojtur efektivisht nga ky avokat gjatë gjykimit”. Në çështjen konkrete para Tribunalit referues, ky i fundit vërejti se ishte e qartë se z. Melloni kishte autorizuar dy avokatë që gëzonin besimin e tij, të cilët Tribunale di Ferrara i njoftoi se gjykimi do të zhvillohej në të ardhmen, në mënyrë që ai të ishte i vetëdijshëm për këtë. Është gjithashtu e qartë, sipas së njëjtës gjykatë, se z. Melloni ishte mbrojtur efektivisht nga këta dy avokatë gjatë gjykimit që pasoi në shkallën e parë, si dhe gjatë proceseve gjyqësore në apel dhe në Kasacion.

Në këto kushte, sipas Tribunalit Kushtetues, lind pyetja nëse Vendimi-Kuadër 2002/584 i pengon gjykatat spanjolle që të kushtëzojnë dorëzimin e z. Melloni me mundësinë që dënimi në fjalë të mund të rishikohet. Nëse kjo nuk është e mundur sipas nenit 4 bis paragrafi 1, të lartpërmendur, atëherë Tribunali pyeti nëse ky nen respekton kërkesat që rrjedhin nga e drejta për një mjet efektiv dhe për një proces të drejtë të parashikuar në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së (në tekstin e mëtejshëm: “Karta”), si dhe me të drejtat e mbrojtjes të garantuara me nenin 48, paragrafi 2, të saj? Nëse përgjigja e pyetjes së dytë është pozitive, atëherë a e lejon neni 53 i Kartës, i interpretuar sistematikisht me të drejtat e njohura në nenet 47 dhe 48 të Kartës, një shtet anëtar të bëjë dorëzimin e një personi të dënuar në mungesë me kushtin që dënimi të mund të rishikohet në shtetin kërkues, duke u dhënë kështu këtyre të drejtave një nivel më të lartë mbrojtjeje se ai që rezulton nga e drejta e BE-së, në mënyrë që të shmanget një interpretim që kufizon ose cenon një të drejtë themelore të njohur në Kushtetutën e atij shteti anëtar?”

Përmbledhja e vendimit

Gjykata theksoi se neni 4 bis paragrafi 1 i Vendimit-Kuadër 2002/584 mbi Urdhërarrestin Evropian dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet shteteve anëtare, të ndryshuar nga Vendimi-Kuadër 2009/299, duhet të interpretohet në kuptimin që nuk lejon që autoriteti gjyqësor ekzekutues, në rastet e treguara në këtë dispozitë, ta kushtëzojë ekzekutimin e një urdhër-arresti evropian të lëshuar me qëllim ekzekutimin e një dënimi në mungesë me mundësinë e rishikimit të dënimit në shtetin anëtar lëshues. Zgjidhja e miratuar nga ligjvënësi i BE-së, që konsiston në parashikimin në mënyrë shteruese të rasteve në të cilat ekzekutimi i një urdhërarresti evropian të lëshuar me qëllim ekzekutimin e një vendimi të dhënë në mungesë, duhet të konsiderohet se nuk cenon të drejtat e mbrojtjes, dhe nuk lejon që autoriteti gjyqësor ekzekutues të mund ta kushtëzojë këtë ekzekutim me garancinë që dënimi në fjalë të mund të rishikohet, për të garantuar të drejtat e mbrojtjes së personit në fjalë.

Gjykata sqaroi se neni 4 bis paragrafi 1 i lartpërmendur, nuk e shkel as të drejtën për një mjet efektiv juridik për një gjykim të drejtë dhe as të drejtat e mbrojtjes të garantuara përkatësisht nga nenet 47 dhe 48 paragrafi 2 të Kartës, dhe për këtë arsye është në përputhje me kërkesat që dalin nga këto nene. Në të vërtetë, ndërsa e drejta e të akuzuarit për t'u paraqitur personalisht në gjykim përbën një element thelbësor të së drejtës për një proces të drejtë, kjo e drejtë nuk është absolute. I akuzuari mund të heqë dorë prej saj, me vullnetin e tij të lirë, shprehimisht ose në heshtje, me kusht që heqja dorë të përcaktohet në mënyrë të qartë, të jetë e shoqëruar nga një minimum garancish që korrespondojnë me seriozitetin e procesit dhe të mos bie ndesh me asnjë interes publik të rëndësishëm. Në veçanti, cenimi i së drejtës për një proces të drejtë nuk është konstatuar, edhe nëse i akuzuari nuk është paraqitur personalisht, pasi të jetë vënë në dijeni për datën dhe vendin e gjykimit ose të jetë mbrojtur nga një avokat mbrojtës, të cilin e ka autorizuar për këtë qëllim.

Gjithashtu, harmonizimi i kushteve për ekzekutimin e urdhërarresteve evropiane të lëshuara me qëllim të ekzekutimit të vendimeve të dhëna në përfundim të një gjykimi, në të cilin personi në fjalë nuk është paraqitur personalisht, i arritur me Vendimin-Kuadër 2009/299, synon, siç tregohet në nenin 1 të tij, të forcojë të drejtat procedurale të personave

që u nënshtrohen procedurave penale, duke përmirësuar njëkohësisht njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore ndërmjet shteteve anëtare.

Në lidhje me pyetjen e fundit, që është edhe kontributi më i rëndësishëm i Gjykatës në këtë çështje, ajo shprehet se neni 53 i Kartës duhet të interpretohet se nënkupton që ai nuk e lejon një shtet anëtar ta kushtëzojë dorëzimin e një personi të dënuar në mungesë, me garancinë që dënimi të mund të rishikohet në shtetin anëtar ku dorëzohet, për të shmangur cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të drejtave të mbrojtjes të garantuara me kushtetutën e tij. Një interpretim i ndryshëm i nenit 53 të Kartës do të minonte parimin e përparësisë së të drejtës së BE-së, përderisa do t'i lejonte një shtet anëtar të parandalonte zbatimin e akteve të së drejtës së BE-së që janë plotësisht në përputhje me Kartën, sapo që këto akte të mos respektojnë të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta e këtij shteti.

Pa dyshim, neni 53 i Kartës konfirmon se, kur një akt i së drejtës së BE-së kërkon masa zbatuese kombëtare, autoritetet dhe gjykatat kombëtare kanë mundësinë që të zbatojnë standardet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore, me kusht që ky zbatim të mos komprometojë nivelin e mbrojtjes të parashikuar nga Karta, siç interpretohet nga Gjykata, ose përparësinë, unitetin dhe efektivitetin e së drejtës së BE-së. Megjithatë, neni 4 paragrafi 1 i Vendimit-Kuadër 2002/584, në lidhje me urdhër-arrestin evropian dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet shteteve anëtare, i ndryshuar nga Vendimi-Kuadër 2009/299, nuk u jep shteteve anëtare mundësinë për të refuzuar ekzekutimin e një urdhër-arresti evropian kur personi në fjalë ndodhet në një nga katër situatat e renditura në këtë dispozitë.

Lejimi i një shteti anëtar që t'i referohet nenit 53 të Kartës për ta kushtëzuar dorëzimin e një personi të dënuar në mungesë me kushtin, që nuk parashikohet në Vendimin-Kuadër 2009/299, që dënimi të mund të rishikohet në shtetin anëtar lëshues për të parandaluar cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të drejtave të mbrojtjes të garantuara nga Kushtetuta e shtetit anëtar ekzekutues, do të vinte në pikëpyetje uniformitetin e standardit të mbrojtjes së të drejtave themelore të përcaktuara nga ky Vendim-Kuadër, duke minuar parimet e besimit dhe njohjes reciproke, të cilat ky i fundit synon t'i konsolidojë dhe, për rrjedhojë, do të rrezikonte efektivitetin e Vendimit-Kuadër në fjalë.

Neni 56

Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*
- 2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.*
- 3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*
- 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.*
- 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.*

1. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS²³³

2. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2.1. *LAWLESS kundër IRLANDËS (3)*

[332/57]

GJEDNJ [Dhoma]

1 korrik 1961

Çështja kyçele drejta e pretenduar: justifikimi i ndalimit të personave në shmangie të procedurës normale për shkak të situatës së jashtëzakonshme me pretendimin se Irlanda kishte shkelur nenet 5, 6, 7, dhe 15, paragrafët 1 dhe 3, të Konventës për shkak të mbajtjes në gjendje paraburgimi pa vendim të një organi gjyqësor.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Gerard Richard Lawless (kërkuesi), shtetas i Republikës së Irlandës, kundër Qeverisë së atij shteti më 12 prill 1960. Kërkuesi kishte pranuar para Komisionit se ishte bërë anëtar i IRA-s (“Ushtria Republikane Irlandeze”) në janar 1956. Sipas deklaratave të tij, ai u largua nga IRA në qershor 1956 dhe nga një grup i ndarë i IRA-s në dhjetor 1956. Më 21 shtator 1956, ai ndalohet, së bashku me tre burra, në një hangar të braktisur (në Keshcarrigan, County Leitrim) ku policia gjen armë. Gjykata Penale e Qarkut të Dublinit dha vendimin për lirim të katër të akuzuarve më 23 nëntor 1956. I dyshuar për veprimtari të paligjshme, kërkuesi ndalohet përsëri më 14 maj 1957. Gjatë një kontrolli në shtëpinë

²³³ Në lidhje me nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] shih Rastin KO54/20 (Aktgjykim me shkelje), paraqitur më lart.

e tij, u gjet një dokument dorëshkrimor mbi organizatën IRA. Më 16 maj, Gjykata Penale e Qarkut të Dublinit e dënoi me një muaj heqje lirie për këtë fakt, por jo për anëtarësimin në IRA. Më 5 korrik 1957, në Gazetën Zyrtare, Qeveria Irlandeze shpall hyrjen në fuqi, që nga 8 korriku, të kompetencave për arrestim dhe paraburgim që u ishin dhënë ministrave të shtetit në bazë të Ligjit nr. 2, të vitit 1940, i cili ndryshonte Ligjin e vitit 1939 mbi shkeljet e sigurisë shtetërore. Në zbatim të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë, më 12 korrik 1956, nxori një vendim për paraburgimin e kërkuesit, i cili ishte ndaluar një ditë më parë, kur ai po përpiqej të shkonte në Angli. Kërkuesi u dërgua në një kamp ushtarak, bashkë me rreth 120 persona të tjerë, pa u paraqitur para një gjyqtari. Më 10 dhjetor 1956, ai paraqitet para Komisionit të paraburgimit: ai zotohet gojarisht se nuk do të merret me asnjë veprimtari të paligjshme sipas kuptimit të legjislacionit të vitit 1939 dhe 1940. Të nesërmen, Ministri i Drejtësisë urdhëroi lirimin e tij. Ndërkohë, më 11 tetor 1957, Gjykata e Lartë kishte nxjerrë një vendim me të cilin hodhi poshtë një ankim për shkelje të *habeas corpus* të paraqitur nga kërkuesi, i cili apeloi kundër këtij vendimi para Gjykatës Supreme, por pa sukses.

Përmbledhja e pretendimeve

Pasi kishte shteruar mjetet juridike vendore, kërkuesi i iu drejtua Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut më 8 nëntor 1957 për lirim dhe kompensim, duke pretenduar se Qeveria e Irlandës kishte mohuar të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Komisioni e shpalli kërkesën të pranueshme dhe mbajti seanca dëgjimore dhe inicioi hetime. Kërkuesi pretendonte se Konventa ishte shkelur për shkak të paraburgimit të tij pa një vendim gjykate, që nga 13 gushti i vitit 1957. Në raportin e tij të 19 dhjetorit 1959, Komisioni vlerësoi se neni 7 nuk gjente zbatim dhe arriti në një përfundim në lidhje me nenin 15. Sipas tij, përderisa një rrezik publik kërcënonte ekzistencën e shtetit, masat e arrestimit dhe të paraburgimit të marra nga Qeveria Irlandeze justifikoheshin nga situata.

Arsyetimi i Gjykatës

Për sa i përket themelit të çështjes së pretenduar, Gjykata vendosi të shqyrtojë pesë çështje si në vijim: fillimisht, në lidhje me nenin

17, Gjykata vlerësoi: A mundej që Qeveria Irlandeze t'i kundërvihej kërkuesit në lidhje me nenin 17? Gjykata vlerësoi se kjo dispozitë ka një vlerë negative dhe nuk mund të privojë kërkuesin nga të drejtat themelore të garantuara nga nenet 5 dhe 6. Në fakt, kërkuesi nuk u mbështet në Konventë për të justifikuar ose jo, nëse kishte veprime në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e garantuara prej saj.

Në lidhje me nenet 5 dhe 6, Gjykata vlerësoi: A ishte paraburgimi i kërkuesit pa paraqitje në Gjykatë, në kundërshtim me detyrimet e Irlandës në bazë të nenit 5 dhe 6 të Konventës? Neni 6 nuk merrej parasysh, meqenëse kërkuesi nuk iu nënshtrua ndonjë akuze penale. Për sa i përket nenit 5, bëhej fjalë vetëm për paragrafët 1 (c) dhe 3. Për Gjykatën ata krijojnë një tërësi dhe kanë një kuptim të qartë dhe natyral: ata imponojnë detyrimin e paraqitjes para një gjyqtari, me synimin për të shqyrtuar problemin e heqjes së lirisë ose të një vendimi lidhur me themelin e çështjes, të çdo personi të ndaluar që dyshohet se do të kryejë një vepër penale. Por, ky nuk ishte rasti i kërkuesit. Paraburgimi i tij nuk mund të justifikohet në arsyet e paraqitura në nenin 5 paragrafët 1 (c) dhe 3.

Në lidhje me nenin 7, Gjykata vlerësoi: A ishte paraburgimi i kërkuesit në kundërshtim me detyrimet e Irlandës në bazë të nenit 7 të Konventës? Gjykata iu përgjigj negativisht kësaj pyetje, sepse ky nen i cili ndalonte prapaveprimin e dënimit, ishte i pazbatueshëm në këtë çështje. Paraburgimi i kërkuesit përbënte një masë parandaluese dhe nuk mund të konsiderohej si rezultat i një dënimi penal.

Në lidhje me nenin 15, Gjykata vlerësoi: A bazohej paraburgimi i kërkuesit mbi të drejtën e derogimit të shteteve palë të garantuar nga neni 15.1? Gjykata u shpreh pozitivisht, pasi kishte verifikuar se tri kushtet e kërkuara nga ky test ishin plotësuar. Në radhë të parë, Qeveria mund të deklaronte, me legjitimitet, se një rrezik publik i kanosej kombit gjatë periudhës në fjalë: në territorin e Republikës së Irlandës ndodhej një ushtri sekrete që vepronte jashtë kuadrit kushtetues dhe përdorte dhunë për të arritur objektivat e saj; kjo ushtri vepronte edhe jashtë territorit të shtetit, duke vështirësuar kështu marrëdhëniet e këtij të fundit me vendet fqinje; aktivitetet terroriste ishin rritur në mënyrë alarmuese që nga vjeshta e vitit 1956 dhe gjatë pjesës së parë të vitit 1957. Së dyti, paraburgimi pa paraqitje para një gjyqtari dukej si një

masë që zbatohet vetëm për shkak të presionit të kohës (veprimeve të ngutshme). Në fakt, zbatimi i legjislacionit të zakonshëm nuk kishte mundur të ndalonte rritjen e rrezikut që i kanosej Republikës në vitin 1957. Funksionimi i gjykatave penale të zakonshme, i gjykatave penale speciale ose i gjykatave ushtarake nuk mjaftonte për të vendosur paqen dhe rendin publik; në veçanti, mbledhja e provave të mjaftueshme për të dënuar personat e lidhur me IRA-n dhe grupet e saj disidente ndeshej me vështirësitë të mëdha për arsye të karakterit ushtarak dhe sekret të tyre dhe të frikës që ata shkaktonin në popull. Për sa i përket mbylljes së kufirit me Irlandën e Veriut, ky veprim do të sillte për të gjithë popullatën, pasoja shumë të rënda që do të kishin tejkaluar kërkesat e rastit të urgjencës. Për këtë arsye, paraburgimi administrativ i personave që dyshoheshin se donin të merrnin pjesë në veprimtari terroriste dukej i justifikueshëm. Për më tepër, Gjykata vërejti se Ligji nr. 2 i vitit 1940 parashikonte një sërë garancish kundër abuzimeve: kontroll i vazhdueshëm i Parlamentit mbi zbatimin e ligjit; krijimi i një komisioni paraburgimi i përbërë nga një oficer dhe dy magistratë, të cilit mund t'i drejtohej çdo i paraburgosur; vendimi i këtij komisioni për lirimin e këtij të fundit ishte i detyrueshëm për Qeverinë. Kjo e fundit i garantonte lirimin personit të ndaluar, në qoftë se ai zotohej se do të respektonte ligjin. Së fundi, asnjë element nuk i lejonte Gjykatës që të vlerësonte se masat e marra nga Qeveria, duke deroguar nga Konventa, binin ndesh me detyrimet e tjera që rridhnin nga e drejta ndërkombëtare.

Gjykata përfundimisht vlerësoi: A përbënte një njoftim të mjaftueshëm, letra e dërguar më 20 korrik 1957 nga Qeveria, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në bazë të nenit 15.3 të Konventës? Përsëri, Gjykata dha një përgjigje pohuese. Ajo çmoi se njoftimi ishte bërë pa vonesë dhe se asgjë nuk e pengonte shtetin të shpallte në territorin e tij vendimin e derogimit. Rrjedhimisht, në bazë të përgjigjeve të dhëna në lidhje me këto pesë çështje të shqyrtuara, Gjykata arriti në përfundimin se Konventa nuk ishte shkelur.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata hodhi poshtë parashtresën e ngritur nga Qeveria Irlandeze nga neni 17 i Konventës; deklaroi se nenet 5 dhe 6 të Konventës nuk ofronin bazë ligjore për ndalimin pa gjykim të G.R. Lawless, nga 13 korriku deri

më 11 dhjetor 1957, në bazë të nenit 4 të Ligjit për veprat penale kundër shtetit (Amendament), të vitit 1940; deklaroi se nuk ka pasur shkelje të nenit 7 të Konventës; deklaroi se ndalimi i parashtruesit nga 13 korriku deri më 11 dhjetor 1957 u bazua në të drejtën e derogimit të ushtruar siç duhet nga Qeveria Irlandeze në zbatim të nenit 15 të Konventës në korrik 1957; deklaroi se komunikimi nga Qeveria Irlandeze drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës më 20 korrik 1957 përbënte një njoftim të mjaftueshëm sipas kuptimit të nenit 15, paragrafi 3 të Konventës; prandaj, vendosi që në rastin konkret faktet e gjetura nuk zbulojnë shkelje nga Qeveria Irlandeze të detyrimeve të saj sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; vendosi që nuk lind çështja e së drejtës së kërkuesit për kompensim në lidhje me një shkelje të tillë.

2.2. BROGAN DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

[**1120984, 1123484, 1126684, dhe 1138685]**

GJEDNJ [Seanca Plenare]

29 nëntor 1988

Çështja kyçele drejta e pretenduar: zbatimi i kriterëve procedurale të arrestimit dhe zgjatjes së periudhës së ndalimit në kushtet e një shtete të rënduar nga aktet terroriste; Akti i Parandalimit të Terrorizmit: Paraburgimi: dyshimi i arsyeshëm, dështimi për paraqitje menjëherë përpara gjyqtarit, habeas corpus.

Faktet kryesore

Rasti u ngrit nga Terence Brogan, Dermot Coyle, William McFadden dhe Michael Tracey, të cilët janë shtetas britanikë (kërkuesit), me banim në Irlandën e Veriut, më 18 tetor 1984, më 22 tetor 1984, më 22 nëntor 1984 dhe më 8 shkurt 1985, respektivisht. Në vjeshtën e vitit 1984 ata u arrestuan në bazë të nenit 12 të Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit të vitit 1984 (dispozita të përkohshme), sipas dyshimeve të arsyeshme se ata merreshin me kryerjen, përgatitjen ose nxitjen e akteve terroriste

të lidhura me ngjarjet në Irlandën e Veriut. “Terrorizmi” përkufizohet në Ligjin e vitit 1984 si “përdorimi i forcës për qëllime politike”, duke përfshirë “përdorimin e dhunës me qëllim për të frikësuar publikun ose një pjesë të tij”. Në secilën çështje, periudha fillestare e paraburgimit prej dyzet e tetë orësh, e lejuar nga legjislacioni, u zgjat me një vendim të Sekretarit të Shtetit për Irlandën e Veriut. Kërkuesit ishin mbajtur, respektivisht, në periudha prej pesë ditë e njëmbëdhjetë orë, gjashtë ditë e gjashtëmbëdhjetë orë e gjysmë, katër ditë e gjashtë orë, dhe katër ditë e njëmbëdhjetë orë. Të katërtit ishin marrë në pyetje për incidente konkrete me karakter terrorist, por asnjëri prej tyre nuk u akuzua apo dërgua para një autoriteti gjyqësor deri në momentin e lirit të tyre.

Situata e emergjencës në Irlandën e Veriut në vitet 1970 dhe niveli i pranishëm i akteve terroriste formonin rrethanat e miratimit të legjislacionit fillestar në vitin 1974 që parashikonte kompetencat speciale kundër terrorizmit mbi bazën e të cilave kërkuesit ishin arrestuar dhe paraburgosur. Që nga miratimi i kompetencave speciale, nevoja për vazhdimësinë e tyre ishte vëzhguar në mënyrë të vazhdueshme nga Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatimi i tyre ka qenë rregullisht i shqyrtuar nga personalitete të pavarura. Autorët e këtyre rishikimeve arritën në përfundimin, midis të tjerash, se duke pasur parasysh problemet përbërëse të parandalimit dhe hetimit të terrorizmit, përdorimi i vazhdueshëm i kompetencave speciale të arrestit dhe paraburgimit, ishte i domosdoshëm. Propozimi sipas të cilit vendimet që zgjasnin periudhën e paraburgimit duhet të merreshin nga gjykatat, u hodh poshtë, sepse informimi rreth këtyre vendimeve ishte i ndjeshëm dhe nuk mund t'i kumtohej personave të burgosur ose përfaqësuesve të tyre ligjorë.

Të katër kërkesat iu paraqitën Komisionit midis tetorit të vitit 1984 dhe shkurtit 1985. Komisioni urdhëroi bashkimin e tyre më 10 korrik 1986 dhe, të nesërmen, i deklaroi të pranueshme. Në raportin e tij të 14 majit 1987, Komisioni arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 5 në çështjet e z. Brogan dhe z. Coyle, por jo në çështjet e z. McFadden dhe z. Tracey; se nuk ka pasur shkelje të paragrafëve 1 dhe 4 të nenit 5; dhe, së fundi, se nuk lind problem tjetër në bazë të nenit 13.

Çështja iu paraqit Gjykatës nga Komisioni, më 15 korrik 1987, dhe nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, më 3 gusht 1987.

Përmbledhja e pretendimeve

Kërkuesit pretenduan shkelje të nenit 5 paragrafi 1 të Konventës, sepse ata as nuk u akuzuan dhe as nuk u sollën para gjykatës gjatë ndalimit të tyre. Akuza nuk duhej të pasonte domosdoshmërisht pas një arrestimi sipas nenit 12 të Ligjit të vitit 1984 dhe kërkesa, sipas ligjit të zakonshëm, për ta sjellë personin para një gjykate, ishte bërë e pazbatueshme. Ata argumentuan se privimi i lirisë që ata pësuan në bazë të nenit 12 të Ligjit të vitit 1984, nuk ishte në përputhje me nenin 5 paragrafi 1 (c) , me arsyetimin se ata nuk ishin arrestuar për shkak të dyshimit për një “vepër penale” dhe as qëllimi i arrestimit të tyre nuk ishte nxjerrja e tyre para autoritetit ligjor kompetent.

Kërkuesit pretenduan gjithashtu se si pasojë e arrestimit dhe e ndalimit të tyre, sipas këtij legjislacioni, ata ishin viktima të shkeljes së nenit 5 paragrafi 3 . Kërkuesit vunë në dukje se . . . nuk kishte asnjë arsye të besueshme pse ishte e nevojshme periudha shtatëditore e paraburgimit, duke u kufizuar nga e drejta e zakonshme. . . As nuk kishte një justifikim për mosbesimin e vendimeve të tilla gjyqësorit të Irlandës së Veriut. Sipas Ligjit të vitit 1984, një person i arrestuar sipas nenit 12 për shkak të dyshimit të arsyeshëm për përfshirje në akte terrorizmi, mund të ndalohet nga policia për një periudhë fillestare prej dyzet e tetë orësh dhe, me autorizimin e Sekretarit të Shtetit për Irlandën e Veriut, për një periudhë të mëtejshme ose për periudha deri në pesë ditë.

Kërkuesit argumentuan se, meqenëse neni 5 i Konventës nuk ishte përfshirë në Ligjin e Mbretërisë së Bashkuar, një rishikim efektiv i ligjshmërisë së paraburgimit të tyre, siç kërkohet nga paragrafi (4) i nenit 5, ishte përjashtuar.

Gjithashtu kërkuesit u ankuan sepse nuk kishin mundësi për të ngritur një kërkesë për kompensim. Një kërkesë për kompensim për heqjen e paligjshme të lirisë mund të bëhet në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me një shkelje të ligjit të brendshëm (shih paragrafin 41 të vendimit të plotë për burgimin e rremë). Meqenëse neni 5 nuk konsiderohet pjesë e ligjit të brendshëm të Mbretërisë së Bashkuar, asnjë kërkesë për kompensim nuk qëndron për shkeljen e ndonjë dispozite të nenit 5 që nuk përbën, në të njëjtën kohë, shkelje të ligjit të Mbretërisë së Bashkuar.

Kërkuesit pretenduan para Komisionit se nuk kishin mjete juridike efektive në Irlandën e Veriut në lidhje me ankesat e tyre sipas nenit 5 dhe se, si pasojë, kishte gjithashtu shkelje të nenit 13.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimeve pranë Komisionit, kërkuesit parashtruan se donin të shtonin një kërkesë në bazë të nenit 5.2 (E drejta e individit për t'u informuar menjëherë për arsyet e arrestimit të tij), të cilën ata e kishin tërhequr gjatë fazës së pranueshmërisë para Komisionit. Gjykata vërejti se pas tërheqjes së kërkesës, Komisioni kishte ndërprerë shqyrtimin e pranueshmërisë së saj në lidhje me nenin 5.2. Në këto kushte, pa pasur një vendim pranueshmërie në lidhje me këtë aspekt, pretendimi i shkeljes së nenit 5.2 nuk mund të merrej në shqyrtim.

Arsyetimi i Gjykatës

Fillimisht, Gjykata pasi kishte konstatuar një rritje të akteve terroriste në shoqëritë moderne, njohu nevojën, e cila është edhe pjesë përbërëse e sistemit të Konventës, për një ekuilibër të duhur midis mbrojtjes së institucioneve demokratike në interesin e përbashkët dhe mbrojtjes së të drejtave të individëve. Në këto procedura nuk u ngrit çështja e shqyrtimit nëse, derogimet e Mbretërisë së Bashkuar nga detyrimet që rridhnin nga Konventa, mund të lejoheshin në bazë të nenit 15, për shkak të ekzistencës së një fushate terroriste në Irlandën e Veriut. Megjithatë, ky problem nuk pengoi vlerësimin e duhur të rrethanave të çështjes.

Në lidhje me nenin 5.1, kërkuesit pretendonin se heqja e lirisë së tyre në bazë të nenit 12 të Ligjit të vitit 1984 nuk përputhej me nenin 5.1 (c), përderisa ata nuk ishin arrestuar nën dyshimin e kryerjes së një “vepre penale”, dhe se qëllimi i arrestimit të tyre nuk kishte qenë për t'i çuar ata para autoritetit kompetent. Ligji i vitit 1984, në të vërtetë, nuk kërkonte që arresti të bazohet mbi dyshimin e kryerjes së një vepre penale të përcaktuar, por mbi dyshimin e pjesëmarrjes në “akte terrorizmi”. Sidoqoftë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, përcaktimi ligjor i “terrorizmit” përputhet më së miri me nocionin e “veprës penale” të parashikuar nga Konventa. Për më tepër, çdo kërkues është marrë në pyetje për disa orë gjatë arrestit nën dyshimin për pjesëmarrjen e tij në vepra penale specifike. Në bazë të argumentit të dytë të kërkuesve,

sipas të cilit, ata as nuk ishin akuzuar, as nuk ishin çuar para një gjykate, ekzistenca e një qëllimi të duhur, duhej të merrej si e pavarur nga realizimi i tij. Ndoshta ishte e pamundur të mblidheshin prova të mjaftueshme ose, duke pasur parasysh natyrën e veprave penale për të cilat akuzoheshin, të çoheshin para gjykatësit pa vënë në rrezik jetën e tjetrit. Asgjë nuk të bën të mendosh se heqja e lirisë së tyre, nuk kishte si qëllim plotësimin e hetimeve të policisë për të konfirmuar ose hequr dyshimet konkrete që justifikonin ndalimin e tyre. Si rrjedhim, kushtet e një ndalimi dhe heqjeje lirie të drejtë, të parashikuar nga neni 5.1 (c), ishin plotësuar në çështjet e kërkuesve. Pra, nuk kishte shkelje të nenit 5.1.

Në lidhje me nenin 5.3 kërkuesit pretendonin gjithashtu se ishin privuar nga e drejta për t'u çuar para një gjyqtari ose magjistrati tjetër kur ishin nën mbikëqyrjen e policisë. Në përputhje me nenin 5.3, në qoftë se personi nuk është liruar, ai ka të drejtë të paraqitet menjëherë përpara gjyqtarit. Sipas Gjykatës, termi “promptly” (menjëherë) lë të kuptojë sikur lejon një hapësirë fare të vogël fleksibiliteti, po atë që konfirmon termi në frëngjisht “aussitot” që do të thotë menjëherë. Në qoftë se shpejtësia vlerësohet sipas kushteve të veçanta të çdo çështjeje, rëndësia që u jepet atyre nuk mund të shkojë deri aty sa të shkelë në thelb të drejtën e garantuar nga neni 5.3, pra që ta lirojë shtetin nga detyra e çuarjes së menjëhershme të personit të ndaluar përpara një autoriteti gjyqësor. Duke iu rikthyer fakteve, Gjykata pranoi se hetimi mbi veprat penale i vendos autoritetet e Irlandës së Veriut përpara disa problemeve të veçanta. Ajo mori gjithashtu parasysh, garancitë e kontrollit të ministrive, mbikëqyrjen konstante nga Parlamenti për nevojën e legjislacionit dhe shqyrtimin e rregullt të zbatimit të tij nga personalitete të pavarura. Konteksti i terrorizmit në Irlandën e Veriut e kishte efektin e zgjatjes së periudhës së mbikëqyrjes policore përpara se i arrestuari të çohet përpara një gjykate ose një magjistrati tjetër. Për më tepër, vështirësia e kontrollit gjyqësor të vendimit të arrestimit ose paraburgimit të terroristit të dyshuar, mund të kërkojë kujdes të veçantë procedural. Megjithatë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, edhe koha më e shkurtër nga të katër periudhat, pra katër ditët dhe gjashtë orët e mbikëqyrjes policore të z. McFadden, i tejkalon kufizimet e lejuara nga termi “menjëherë”. Në qoftë se do t'i konsideronim karakteristikat e çështjes së një rëndësie të veçantë për të justifikuar një mbikëqyrje

policore kaq të gjatë, pa ballafaquar personin me gjykatësin ose me një magjistrat tjetër, do të arrinim në pasoja, në thelb, të kundërta me të drejtën për një shqyrtim gjyqësor të menjëhershëm, të garantuar nga neni 5.3. Pra, ky nen ishte shkelur.

Në lidhje me nenin 5.4 - Neni 5.4 u garantonte kërkuesve të drejtën për të bërë një ankim në gjykatë, i cili lejon shqyrtimin e kërkesave mbi aktet procedurale dhe mbi themelin, të nevojshëm për “ligjshmërinë” e heqjes së lirisë së tyre, sipas kuptimit të nenit 5.1 (c). Sipas GJEDNJ-së, e drejta për t’u ankuar përpara një gjykate mund t’u lejonte juridiksioneve gjyqësore të Irlandës së Veriut të verifikonin, në të njëjtën kohë, respektimin e rregullave procedurale të Ligjit të vitit 1984, dhe arsyeshmërinë e dyshimeve që justifikonin ndalimin si dhe legjitimitetin e qëllimit të ndjekur nga ndalimi, dhe më pas mbikëqyrjen policore (arrestimin). Megjithatë, kërkuesit kishin vendosur të mos e mbështesnin këtë pretendim. Pra neni 5.4 nuk ishte shkelur.

Në lidhje me nenin 5.5, në kundërshtim me Qeverinë Britanike, Gjykata vlerësoi se e drejta e dëmshpërblimit e garantuar nga neni 5.5 nuk ka të bëjë vetëm me rastet e një privimi lirie të parregullt ose arbitrar sipas së drejtës së brendshme. Teksti i nenit 5.5 flet për arrestim ose burgim “që bien ndesh me dispozitat e këtij neni”. Por shkelja e nenit 5.3 e konstatuar nga Gjykata, nuk mundej, as nuk mundet, edhe pas këtij vendimi, t’u lërë vend kërkesave për dëmshpërblim të viktimave para gjykatave vendase; Qeveria nuk e kundërshtonte këtë. Pra edhe neni 5.5 ishte shkelur.

Në lidhje me nenin 13, duke qenë se Gjykata arriti në përfundimin se neni 5.4 nuk ishte shkelur, ajo nuk e vlerësoi të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në bazë të nenit 13.

Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41) - në bazë të nenit 50, kërkuesit nuk pretendonin një rimbursim të kostove dhe të shpenzimeve, por kërkonin një dëmshpërblim të madh për riparimin e dëmit të pësuar. Meqenëse kjo çështje nuk ishte gati për gjykim, Gjykata e shtyu atë për më vonë. Duke qenë se vendimi i vitit 1988 ishte përfundimtar, Gjykata nuk mund të merrte parasysh kërkesa të tjera mbi rimbursimin e shpenzimeve dhe të kostove të bëra gjatë procedurës së ndjekur

para institucioneve të Strasburgut. Ajo nuk përjashtoi faktin se shkelja e nenit 5.3 mund t'u ketë shkaktuar një dëm moral viktimave. Por në vendimin e saj të 30 majit 1989, ajo çmoi se vendimi i vitit 1988 përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi, se nuk ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 1; se ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 3 në lidhje me të katër kërkuesit; konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 4 ; se ka pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 5 në lidhje me të katër kërkuesit; konstatoi njëzëri se nuk është e nevojshme të shqyrtohet neni 13 , dhe neni 50 në lidhje me rimbursimin e kostove ose shpenzimeve.

3. PËRMBLEDHJE E RASTEVE TË GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN

3.1. N. S. kundër SEKRETARIT TË SHKETIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME dhe M. E. DHE TË TJERË kundër KOMISIONERIT PËR APLIKIMET PËR REFUGJATË dhe MINISTRIT TË DREJTËSISË, BARAZISË DHE REFORMËS NË DREJTËSI

GJDBE (Dhoma e Madhe)

Çështjet e bashkuara C-411/10 dhe C-493/10

21 dhjetor 2011

[<https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=117187&pageIndex=0&doclang=FR&mode=req&dir=&occ=-first&part=1&cid=13717920>]

Çështja kyçele drejta e pretenduar: në rast se një vend anëtar përballet me një krizë të jashtëzakonshme fluksi azilkërkuesish, Rregullorja e Dublinit duhet interpretuar në atë mënyrë që, me anë të derogimeve të parashikuara prej saj, t'u ofrohen azilkërkuesve kushte dhe trajtim që respektojnë standardet e BE-së.

Faktet kryesore

Këto dy çështje kanë të bëjnë me zbatimin dhe interpretimin e Rregullores së Dublinit II²³⁴ e cila përcaktonte kriteret e përdorura për të përcaktuar shtetin anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil nga një shtetas i vendit të tretë. Kur një shtetas i një vendi të tretë ka aplikuar për azil në një shtet anëtar, të cilin Rregullorja nuk e konsideron si shtetin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës, Rregullorja parasheh një procedurë për transferimin e azilkërkuetit në shtetin anëtar përgjegjës.

Rasti i parë kishte të bënte me një shtetas afgan që erdhi në Mbretërinë e Bashkuar dhe aplikoi për azil më 12 janar 2009, pasi udhëtoi përmes Greqisë. Ai pretendoi se ishte ndaluar pas mbërritjes në Greqi dhe, më pas ishte ndaluar dhe dëbuar në Turqi, ku u ndalua edhe për dy muaj të tjerë. Ai deklaroi se ishte arratisur nga paraburgimi në Turqi dhe u nis për në Mbretëria e Bashkuar.

Rasti i dytë ndërlidhej me pesë persona, që nuk kishin të bënin me njëri-tjetrin, nga Afganistani, Irani dhe Algjeria. Ata kishin udhëtuar edhe nëpërmjet Greqisë dhe kërkuar azil pas mbërritjes në Irlandë. Ata ishin arrestuar në Greqi për kalim të paligjshëm të kufirit. Autoritetet britanike dhe irlandeze vlerësuan se, sipas Rregullores së Dublinit II, Greqia ishte shteti anëtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për azil të këtyre personave. Kërkuesve iu dhanë urdhër të transferoheshin në Greqi. Të gjithë parashtruesit kundërshtuan transferimin e tyre në Greqi dhe pretenduan se autoritetet britanike ose irlandeze duhet të pranojnë përgjegjësinë për shqyrtimin e kërkesës së tyre për azil sipas nenit 3.2 të Rregullores së Dublinit, i cili lejon një shtet anëtar, i cili nuk është shtet anëtar përgjegjës sipas Kreut III të Rregullores, që duke deroguar, të shqyrtojë një kërkesë për azil të paraqitur nga një shtetas i një vendi të tretë. Ata kërkuar shqyrtimin gjyqësor të vendimit për transferimin e tyre në Greqi. Në rastin e parë, Gjykata e Lartë e Anglisë dhe Uellsit e hodhi poshtë kërkesën, por parashtruesi u ankua në Gjykatën e Apelit.

234 Rregullorja e Dublinit II, (KE) nr. 343/2003 e 18 shkurtit 2003, e cila nuk është më në fuqi sepse është zëvendësuar nga Rregullorja e Dublinit III (Rregullorja e Këshillit të BE-së nr. 604/2013 mbi Përcaktimin e Kriterëve dhe Mekanizmave për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës për ekzaminimin e një kërkesë azili të paraqitur në një nga Shtetet Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi).

Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Gjykata e Lartë e Irlandës iu drejtuan Gjykatës së Luksemburgut me kërkesa për vendime paraprake në lidhje me interpretimin e nenit 3.2 të Rregullores së Dublinit II. Së pari, Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit, në thelb, e pyeti GJDBE-në nëse shqyrtimi i një kërkesë për azil sipas nenit 3.2 të Rregullores së Dublinit II binte brenda fushëveprimit të së drejtës së BE-së, që do të thoshte se Karta e të Drejtave Themelore e BE-së do të ishte e zbatueshme. Së dyti, të dyja gjykatat kombëtare pyetën, në thelb, nëse, në dritën e kushteve problematike të azilkërkuesve dhe trajtimit të tyre në Greqi, shtetet e tjera anëtare kanë detyrimin të kontrollojnë, para transferimit të azilkërkuesve atje, nëse shteti anëtar përgjegjës sipas Rregullores së Dublinit II (në këtë rast Greqia) respekton plotësisht të drejtat themelore. Gjykatat kombëtare e pyetën gjithashtu GJDBE-në nëse ata janë të detyruar të marrin përgjegjësinë për të shqyrtuar vetë kërkesat e azilit sipas nenit 3.2 të Rregullores së Dublinit II nëse ata konstatojnë se shteti anëtar përgjegjës nuk respekton të drejtat themelore.

Vendimet e Gjykatës

Së pari, GJDBE-ja u shpreh se kur një shtet anëtar vendos të ushtrojë diskrecionin e tij duke shqyrtuar një kërkesë për azil sipas nenit 3.2 të Rregullores së Dublinit II, ai është duke zbatuar legjislacionin e BE-së. Kështu, Karta e të Drejtave Themelore zbatohet dhe shtetet anëtare duhet të respektojnë të drejtat dhe parimet e parashikuara nga ajo.

Së dyti, GJDBE-ja kujtoi se Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit (SPEA) është ndërtuar mbi parimin e besimit të ndërsjellë midis shteteve anëtare dhe se të gjitha shtetet anëtare duhet të respektojnë të drejtat themelore, duke përfshirë të drejtat e bazuara në Konventën e Gjenevës të vitit 1951 dhe në KEDNJ. Qëllimi i Rregullores së Dublinit II ishte që të përshpejtohej përpunimi i kërkesave për azil duke identifikuar dhe siguruar një shtet anëtar të vetëm përgjegjës dhe, në këtë mënyrë, të shmangej fenomeni, ku azilkërkuesit aplikojnë disa herë në shtete të ndryshme anëtare që i përkasin të njëjtës hapësirë ligjore në këtë drejtim. GJDBE-ja pranoi se sistemi mund të përjetojë probleme të mëdha operationale të cilat mund të çojnë në trajtimin e azilkërkuesve në kundërshtim me të drejtat e tyre themelore. Megjithatë, çdo shkelje e të drejtave themelore të një azilkërkuesi nga shteti anëtar përgjegjës ose

shkelja më e vogël e legjislacionit dytësor të azilit, nuk mund të ndikojë në situatën ligjore të shteteve të tjera anëtare sipas Rregullores.

Gjithsesi, GJDBE-ja deklaroi se “nëse ka arsye thelbësore për të besuar se ka të meta sistematike në procedurën e azilit dhe në kushtet e pritjes për azilkërkuesit në shtetin anëtar përgjegjës, që rezulton në trajtim çnjerëzor ose degradues, sipas kuptimit të nenit 4 të Kartës, të azilkërkuesve të transferuar në territorin e atij shteti anëtar, transferimi do të ishte i papajtueshëm me atë dispozitë”. Prandaj, e drejta e BE-së përjashton një prezumim përfundimtar se shteti anëtar i caktuar nga Rregullorja si përgjegjës, respekton të drejtat themelore të BE-së. Shtetet anëtare duhet të përdorin instrumentet në dispozicion, duke përfshirë raportet e OJQ-ve ndërkombëtare, UNHCR-së dhe Komisionit, për të vlerësuar nëse një azilkërkues rrezikonte të pësojë nga një shkelje e të drejtave të tij themelore, nëse do të transferohej në shtetin anëtar përgjegjës sipas Rregullores.

Në lidhje me çështjen nëse shteti anëtar transferues duhet të marrë përgjegjësinë sipas nenit 3.2 të Rregullores nëse konstaton se azilkërkuesi do të ishte në rrezik, po të transferohej në shtetin e parë përgjegjës, GJDBE-ja u shpreh se shteti anëtar transferues duhet të shqyrtojë kriteret e tjera të përcaktuara në Kapitullin III të Rregullores për të përcaktuar nëse një shtet tjetër anëtar mund të identifikohet si përgjegjës për të shqyrtuar kërkesën për azil. Megjithatë, nëse të drejtat themelore të kërkuesve janë shkelur tashmë, shteti anëtar transferues nuk duhet të përdorë një procedurë që do të kërkonte një kohë të paarsyeshme për të përcaktuar shtetin anëtar përgjegjës për kërkesën për azil. Nëse është e nevojshme, shteti anëtar që përcakton shtetin anëtar përgjegjës duhet ta shqyrtojë vetë aplikimin në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3.2 të Rregullores.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

347

347.97/99(496.51:4)

Istrefi, Remzije Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të Njeriut : përmbledhje e rasteve kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian / Remzije Istrefi, Bekim Sejdiu, Ledi Bianku. - Prishtinë : Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës, 2023. -1050 f. ; 24 cm.

1. Sejdiu, Bekim 2. Bianku, Ledi

ISBN 978-9951-8664-5-3

ISBN 978-9951-8664-5-3



9 789951 866453 >